PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS SË LARTË

(Të botuara në Fletoret Zyrtare 2021-2023)

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë, 2024

ISBN: 9789928011602

Adresa
Rruga: "Nikolla Jorga"
Tel/fax: +355 42 427005, 04 2427006

E-mail: info@qbz.gov.al,
Web:www.qbz.gov.al

Përmbajtja

Vendim nr. 1215 datë 15.7.2021	Me objekt detyrimin e palës së paditur t'i njohë paditësit gradën "kryekomisar"	5
Vendim nr. 00-2021- 1317 datë 22.7.2021	Me objekt anulimin e vendimit nr. 173, datë 1.11.2010, të Komisionit të Caktimit të Aftësive për Punë (KMCAP), pranë Drejtorisë Rajonale të Komisionit Qendror të Caktimit të Aftësive për Punë Epror, duke përcaktuar statusin mjekësor, si "invalid i grupit të dytë", dhe detyrimin e të padituri, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, t'i paguajë pensionin e invaliditetit nga data 1.11.2010 deri më datë 1.11.2011	15
Vendim nr. 23-2021- 712 datë 27.7.2021	Me objekt parashtrimin e mosmarrëveshjes së kompetencës drejtuar Gjykatës së Lartë. Gjykimin e të akuzuarit për veprën penale "Shpifja", parashikuar nga neni 120/2 të Kodit Penal	38
Vendim nr. 00-2021- 1120 (55) datë 13.10.2021	Me objekt heqjen e masës së sigurimit pasuror, të sekuestros preventive, të caktuar me vendimin nr. 16, datë 10.1.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe me vendimin nr. 19, datë 31.7.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda	53
Vendim nr. 00-2021-1134(62) datë 1.11.2021	Me objekt shuarjen e masës së sigurimit	64
Vendim nr. 00-2021- 1135 (147) datë 23.12.2021	Me objekt sekuestrimin e të dhënave kompjuterike	74
Vendim nr.00-2022-1513 (186) datë 12.5.2022	Me objekt: 1. Konstatimin e cenimit të statusit të gjyqtarit nëpërmjet heqjes së pasaportës së shërbimit, me vendimin nr. 389, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit", si një e drejtë e fituar e që nuk mund të ulet, në kundërshtim me nenin 22, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". 2. Konstatimin e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e lidhjes 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.6.2019, "Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit", në pjesën që nuk parashikon gjyqtarët, si subjekte zyrtare që kanë të drejtë të pajisen me pasaportë shërbimi. 3. Konstatimin e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e pikës 14, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.6.2019, "Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit", në pjesën që parashikon se pasaportat e shërbimit të gjyqtarëve të lëshuara para datës 14 qershor 2019 humbasin vlefshmërinë më datë 31 dhjetor 2019	91
Vendim nr. 00-2022-1036(114) datë 7.4.2022	Me objekt rehabilitimin nga dënimi i dhënë me vendimin penal nr. 55-04, datë 20.11.2014, dhënë me 6 muaj burgim për veprën penale të goditjes së gjyqtarit, sipas nenit 316 të Kodit Penal, dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin; Rehabilitimin nga dënimi i dhënë me vendimin penal nr. 158, datë 30.3.2015, dhënë me 5 muaj e 10 ditë burgim për kryerjen e veprës penale të përndjekjes, sipas nenit 121/1 të Kodit Penal, dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke u quajtur i "padënuar"	108
Vendim nr. 00-2022- 1679 (217) datë 27.7.2022	Për kryerjen e veprës penale "Trafikimi i personave të rritur", kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetases Engjëllushe Xhafa, të parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal	136
Vendim nr. 00-2023-470 (4) datë 12.1.2023	Parashtrim i mosmarrëveshjes së kompetencës drejtuar Gjykatës së Lartë	164

Vendim nr. 2, datë 18.11.2022	Me objekt rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë	173
Vendim nr. 00-2022-4586 (392) datë 26.10.2022	Me objekt kundërshtimin, pezullimin dhe anulimin e veprimeve përmbarimore të njoftuar me vendimin "Për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm", me nr. 77215 regj.-nr. 19582-prot., datë 22.5.2015, të shërbimit përmbarimor gjyqësor privat "ZIG" sh.p.k., për të cilin kam marrë dijeni më datë 25.5.2015, nëpërmjet shërbimit postar (njoftuar vajzën tonë të quajturën Alketa Bicala, e cila është e martuar dhe nuk banon në banesën tonë	204
Vendim nr. 00-2022-4596 (393) datë 26.10. 2022	Me objekt: 1. Interpretimin e kontratës nr. 1106, datë 9.3.1998, duke e konsideruar si një kontratë shitjeje me kusht. 2. Detyrimin e palës së paditur të më njohë pronare mbi tokën arë prej 4790 m² e ndodhur në parcelën nr. 63/11 në vendin e quajtur "Gjon Preni"	218
Vendim nr. 00-2023-3406 (258) datë 7.7.2023	Me objekt përcaktimin e kompetencës lëndore midis Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë	249
Vendim nr. 00-2023-3628 (302) datë 22.9.2023	Me objekt detyrimin e të padituve: Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria e Përgjithshme dhe Enti Kombëtar i Banesave, Dega Rajonale Tiranë, t'i kthejnë paditësit shumën e vlerës monetare, sipas ekstraktit bankar të datës 18.8.2018, të përllogaritur vetëm për periudhën pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 367, datë 18.4.2013, "Për një ndryshim në vendimin nr. 678, datë 18.6.2009, 'Për kthimin në fond banesa të disa objekteve të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta në Tiranë, të Ndërmarrjes Mekanike Tekstile Tiranë dhe ish-Shkollës së Partisë Tiranë'", dhe faturave bankare të datës 27.8.2015, gjithsej në vlerën totale 1.319.828 lekë, derdhur nga paditësi pranë institucionit bankar "Credins Bank" sh.a., për llogari të të padituve, vjelë në kundërshtim me pikën 1, të VKM-së së sipërcituar	266
Vendim nr. 00-2023-4279 (259) datë 7.7.2023	Me objekt rivendosjen në afat për paraqitjen e ankimit kundër vendimit nr. 411, datë 17.6.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër	285
Vendim nr. 00-2023-4411 datë 2.3.2023	Me objekt shuarjen e dorëzanisë së paditësit Nuri Hasa në "Marrëveshje kredi nr. 256, datë 3.7.2009", nr. 2059 rep., nr. 618/1 kol., datë 17.7.2009, lidhur ndërmjet shoqërisë Banka Credins sh.a. dhe shoqërisë "Italdruri" sh.p.k.	300

VENDIM
Nr. 1215, datë 15.7.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:
Sokol Sadushi kryesues;
Sokol Binaj anëtar;
Ilir Panda anëtar;
Klodian Kurushi anëtar;
Ervin Pupe anëtar,
në datën 15.7.2021, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr. 31003-1562-2018 akti, që iu përket palëve:
PADITËS: Leonard Ndreka
I PADITUR: Drejtoria e Policisë së Shtetit
OBJEKTI: Detyrimin e palës së paditur t'i njohë paditësit gradën "kryekomisar".
BAZA LIGJORE: Ligji nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", nenet 51 e vijuese, VKM-në nr. 892, datë 21.12.2016, "Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimin për gradat në Policinë e Shtetit".

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Sadushi dhe diskutoi, në seancë gjyqësore, çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi Leonard Ndreka, me urdhrin nr. 900/1, datë 31.12.2001, është bërë pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit, duke ushtruar detyra të ndryshme përgjatë periudhës 2001–2010, përkatësisht nën gradat "nëntoger", "nëninspektor", "nënkomisar".

2. Me urdhrin nr. 3052/1, datë 2.11.2010, të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, paditësit rezulton t'i jetë njohur grada "Komisar". Me urdhrin nr. 2304 prot., datë 15.10.2015, të Drejtorit të Policisë së Shtetit, paditësi është transferuar përkohësisht në detyrën e shefit të komisariatit, në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër. Në vijim, drejtori i Policisë Vendore Shkodër ka disponuar me urdhrin nr. 1364 prot., datë 15.10.2015, përmes së cilit është konfirmuar fillimi i të drejtave administrative dhe financiare të paditësit, përkatësisht në datë 16.10.2015.

3. Me urdhrin nr. 452, datë 8.2.2016, të drejtorit të Policisë së Shtetit, është ndërprerë transferimi i përkohshëm i paditësit Leonard Ndreka, duke e transferuar dhe emëruar paditësin në detyrën e shefit të komisariatit, në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Shkodër. Drejtori i Policisë Vendore Shkodër ka disponuar përmes urdhrit nr. 140, datë 9.2.2016, konfirmimin për fillimin e të drejtave administrative dhe financiare të paditësit, përkatësisht në datë 10.2.2016.

4. Në muajin janar të vitit 2017, paditësi i është drejtuar palës së paditur me kërkesën për njohjen e gradës policore "kryekomisar". Në këtë kërkesë paditësi ka pretenduar se ka kaluar afati trevjeçar i qëndrimit në gradën policore "Komisar" dhe se aktualisht ushtron një funksion të cilit i takon grada "kryekomisar". Pala e paditur përmes shkresës nr. 159/1-2 prot., datë 9.2.2017 me lëndë: "Kthim përgjigje", i ka komunikuar paditësit se në mbështetje të ligjit nr. 108/2014 nuk parashikohet marrja e gradës sipas pozicionit të punës dhe se fitimi i gradës së radhës bëhet përmes vlerësimit konkurrues nga Komisioni i Gradimit. Në këtë shkresë pala e paditur fton paditësin të marrë pjesë në konkurrimin e radhës në rast se plotëson kriteret ligjore.

5. Për shkak të mosnjohjes nga pala e paditur të gradës korresponduese "kryekomisar", paditësi Leonard Ndreka i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër në datë 15.3.2017, duke pretenduar nëpërmjet kërkesëpadisë objekt gjykimi, detyrimin e palës së paditur t'i njohë gradën "kryekomisar".

6. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër**, me vendimin nr. 202, datë 5.4.2017, ka vendosur: *"1. Pranimin e kërkesëpadisë; 2. Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Policisë së Shtetit t'i njohë paditësit Leonard Ndue Ndreka gradën policore 'Kryekomisar'...".*

7. Në marrjen e këtij vendimi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, ka vlerësuar: "*Nga mosveprimi i palës së paditur në hapjen e procedurave të konkurrimit për gradën policore "kryekomisar", paditësit i është mohuar një e drejtë e fituar me ligj, e drejta e mbajtjes së gradës sipas vjetërsisë dhe funksionit që kryen, dhe për këtë fakt çështja objekt shqyrtimi bën pjesë në juridiksionin gjyqësor ... Kërkimet e paditësit janë të mbështetura në ligj e në prova për faktin se nga ana e palës së paditur i mohohet e drejta për të përfituar nga benifitet që i njeh ligji. Gjykata në këtë konkluzion arriti duke pasur parasysh se siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës ... Në seancë u provua se paditësi plotëson kriteret e mësipërme pasi ai nga data e gradimit "komisar" ka mbi 3 vite që i ka lindur e drejta për t'u graduar "kryekomisar", që prej datës 2.11.2013. Sipas nenit 61, pika 2, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit": "Çdo funksioni i caktohet grada korresponduese", e miratuar kjo në tabelën e funksioneve korresponduese për çdo gradë nga Këshilli i Ministrave ... Paditësi plotëson kushtin për vjetërsi shërbimi në detyrë dhe duke qenë se edhe detyra që ai ushtron aktualisht i korrespondon grada "kryekomisar" ... Gjykata çmon se paditësit Leonard Ndue Ndreka i takon grada policore "kryekomisar".*

8. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur Drejtoria e Policisë së Shtetit, duke parashtruar këto shkaqe:

" - Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër ka zbatuar keq ligjin.

- Gjykata e ka mbështetur vendimin e saj kryesisht në pretendimet e paditëses dhe në kundërshtim me nenin 309 të Kodit të Procedurës Civile, sepse nuk ka marrë parasysh faktet e përmendura nga ana jonë.

- Pretendimi i paditësit, për të fituar gradën "kryekomisar", nuk qëndron, pasi po të analizojmë historikun e periudhës së punës së paditësit rezulton se ai ka një karrierë shumëvjeçare në strukturat policore, duke pranuar njëkohësisht se gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore, ka fituar gradën sipas ligjit.

- Kërkesëpadia duhet rrëzuar nga gjykata për arsye se është e parashkruar.

- Nuk ndodhemi përpara asnjë rasti të parashikuar nga neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative, lidhur me pavlefshmërinë e akteve.

- Pretendimi i paditësit se nuk i jepet grada "kryekomisar" nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, nuk qëndron pasi referuar ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", nenet 50–60, si dhe në zbatim të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM-në nr. 750, datë 16.9.2015, fitimi i gradës "nënkomisar" deri në "Drejtues i parë" bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues nga një komision gradimi".

- Në referim të VKM-së nr. 917, datë 4.10.2013, nuk rezulton që në rastin konkret të vërtetohen rrethana që dhënia e gradës të jetë kryer në kundërshtim me ligjin.".

9. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1812, datë 28.4.2018 ka vendosur: "*Lënien në fuqi të vendimit nr. 202, datë 5.4.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër ...".*

10. Në marrjen e këtij vendimi gjykata ka vlerësuar: *"Gjykata e Apelit Administrativ tërheq vëmendjen e palës së paditur mbi faktin se, përparimi në gradë nëpërmjet procesit të konkurrimit, brenda periudhës 1-vjeçare, përbën kusht ligjor vetëm për ata punonjës të Policisë së Shtetit, "të emëruar në bazë të vendimit nr. 917, datë 4.10.2013, të Këshillit të Ministrave, 'Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 803, datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave, 'Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre", të ndryshuar, çka nuk përkon me situatën faktike të paditësit Leonard Ndreka, emëruar me ligjin e ri. Në kohën e shqyrtimit administrativisht të ankesës së paditësit pala e paditur do të duhej të kishte proceduar me disponimin e aktit që i njihte ankuesit gradën 'kryekomisar', në zbatim të kuadrit ligjor ekzistues në fuqi, në momentin e shqyrtimit/refuzimit, çka do të kishte shmangur investimin e mëtejshëm të gjykatës në funksion të zgjidhjes së kësaj çështjeje.".*

11. Kundër vendimit nr. 1812, datë 26.4.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur brenda afatit ligjor, e cila përfundimisht ka kërkuar prishjen e vendimit nr. 1812, datë 26.4.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe kalimin e çështjes për shqyrtim gjykatës kompetente. Pala e paditur në rekurs ka parashtruar këto pretendime:

"- Gjykata Administrative e Apelit nuk ka hetuar nëse Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër ka qenë kompetente nga pikëpamja territoriale për të shqyrtuar këtë padi.

- Ngritja në gradë bëhet pasi plotësohen dy kushte kumulative, vjetërsia në gradën pasuese dhe ekzistenca e vendeve të lira për konkurrim në gradën pasuese. Përcaktimi i numrit të mbajtësve të një grade bëhet në përputhje me politikat e rendit dhe të sigurisë.

- Kërkesëpadia është parashkruar.

- Nuk ndodhemi përpara asnjë rasti të parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative lidhur me pavlefshmërinë e akteve.

- Pretendimi i paditësit, se nuk i jepet grada "kryekomisar" nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, nuk qëndron, pasi referuar ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", nenet 50–60, si dhe në zbatim të rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM-në nr. 750, datë 16.9.2015, përcaktohet se fitimi i gradës "nënkomisar" deri në "drejtues i parë" bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues nga një komision gradimi".

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

I. Në lidhje me shqyrtimin me përparësi të rekursit

12. Përmes shkresës nr. 1600 prot., datë 18.5.2021, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka paraqitur kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të një sërë çështjesh gjyqësore me objekt "*Njohje gradë*", duke parashtruar shqetësimin lidhur me promovimin në gradë policore të punonjësve të Policisë së Shtetit, përmes vendimeve gjyqësore të gjykatave administrative.

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim "Kolegji") vlerëson se akordimi i gradës policore, në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin nr. 108/2014, si dhe në ligjin tashmë të shfuqizuar nr. 9749/2007, nga i cili varen ende çështje për gjykim, nga njëra anë, ka një impakt të gjerë në zhvillimin dhe promovimin e karrierës së punonjësve të Policisë së Shtetit dhe, nga ana tjetër reflekton drejtpërdrejt në efekte të konsiderueshme financiare dhe administrative për Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

14. Pa lënë mënjanë rëndësinë që ka çdo çështje e depozituar në Gjykatën e Lartë, vlerësohet se çështje të tilla paraqesin në vetvete një nevojë publike për shpejtësi gjykimi. Në këto kushte Kolegji ka vlerësuar se mosmarrëveshja objekt gjykimi të shqyrtohet me përparësi.

II. Për njësimin e praktikës gjyqësore lidhur me sistemin e fitimit të gradave policore të punonjësve të Policisë në Republikën e Shqipërisë

15. Pikësëpari, Kolegji sjell në vëmendje se nga vëzhgimi i praktikës gjyqësore që lidhet me shqyrtimin e mosmarrëveshjeve me objekt njohjen e gradës policore, është konstatuar se praktika gjyqësore e gjykatave administrative për çështje të ngjashme është e ndryshme.

16. Pas shqyrtimit të akteve të fashikullit gjyqësor dhe arsyetimit të gjykatave për çështjen konkrete, pas kryerjes së një analize të plotë të kuadrit ligjor, por edhe të qasjes së praktikës gjyqësore të gjykatave administrative të shkallës së parë, si dhe të Gjykatës Administrative të Apelit, në lidhje me çështje të ngjashme me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, Kolegji vlerëson se shkaqet ligjore të ngritura në rekurs për shkelje të ligjit material e procedural nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit në vendimin nr. 1812, datë 26.4.2018, dhe nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, në vendimin nr. 202, datë 5.4.2017, janë të një rëndësie themelore, të cilat në mbështetje të nenit 58, shkronja "a", të ligjit nr. 49/2012 (pas ndryshimeve me ligjin nr. 39/2017) përligjin nisjen e procedurës gjykimore për njësimin e praktikës gjyqësore.

17. Për shkak të paqartësisë që është hasur në praktikën gjyqësore lidhur me kufijtë e shqyrtimit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative të organit publik në procesin e dhënies së gradave policore, duke marrë në konsideratë faktin se në vendimin unifikues nr. 1, datë 29.2.2016, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk u arrit të njësohej praktika gjyqësore, në lidhje me pyetjen e shtruar për unifikim, mbi kriteret ligjore që duhet të merren parasysh për caktimin e gradës së re, në rastin e ekuivalentimit të gradave policore, por edhe duke konstatuar se praktika e mbajtur në ndonjë rast nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, nuk ka gjetur pasqyrim në praktikën gjyqësore të gjykatave administrative të të gjitha niveleve, Kolegji vlerëson të domosdoshme që të shtrohet për diskutim interpretimi përfundimtar i dispozitave të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", konkretisht nenet 50–60 të tij, lidhur me plotësimin e kushteve dhe kritereve që nevojiten për fitimin e gradave policore për punonjësit e Policisë së Shtetit, me synim për të konkluduar me një qëndrim njësues, për këtë çështje.

18. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vlerëson të shtrojë për njësim këtë çështje:

- A mund të fitohet gjyqësisht grada policore, për shkak të plotësimit të kriterit të vjetërsisë në gradë dhe/ose ushtrimit të funksionit përkatës për gradën e pretenduar, pa iu nënshtruar procedurës së vlerësimit konkurrues nga një komision gradimi?

Analizë mbi kuadrin ligjor

19. Në përputhje me statusin institucional, që u është njohur punonjësve të Policisë së Shtetit me ligjin nr. 8553, datë 25.11.1999, "Për Policinë e Shtetit" (në vijim "ligji nr. 8553/1999"), u miratua ligji nr. 8643, datë 20.7.2000, "Për gradat në Policinë e Shtetit" (në vijim "ligji nr. 8643/2000"), në të cilin u konfiguruan rishtazi gradat policore, si shprehje e hierarkisë së punonjësve të policisë. Ligji nr. 8643/2000 parashikonte se gradat policore fitohen sipas arsimit dhe kualifikimit profesional, vjetërsisë në shërbim, duke përfshirë edhe periudhën e mëparshme të shërbimit ushtarak të kohës (sipas parashikimeve të ligjit nr. 8553/1999) dhe karrierës në strukturat policore. Ligji nr. 8553/1999 dhe ligji nr. 8643/2000 u shfuqizuan përmes ligjit nr. 9749/2007, "Për Policinë e Shtetit" (në vijim "ligji nr. 9749/2007") dhe ky i fundit rezulton të jetë shfuqizuar përmes nenit 144, të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit" (në vijim "ligji nr. 108/2014"), që aktualisht është në fuqi.

20. Në pasqyrim të ndryshimeve ligjore, si më sipër, ka evoluar edhe qasja e legjislatorit lidhur me njohjen dhe fitimin e gradës policore. Ligji nr. 9749/2007 shënoi kalimin në një sistem të ri gradash policore, duke detajuar

ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë në raport me ushtrimin e gradës. Neni 36 i ligjit nr. 9749/2007 gruponte gradat në nivel zbatues, drejtues të ulët, të mesëm dhe të lartë, duke njohur si grada funksionale, të cilat merren *ex legge,* për shkak të emërimit në funksion, atë të drejtorit/zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Sipas nenit 39 të ligjit nr. 9749/2007, përcaktimi i funksionit korrespondues për secilën prej gradave realizohej me akte normative nënligjore. Në mbështetje të nenit 39 dhe 126, të ligjit nr. 9749/2007, kalimi nga sistemi i vjetër i gradave, parashikuar në ligjin nr. 8643/2000, në gradat sipas ligjit nr. 9749/2007, u realizua përmes vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 803, datë 21.11.2007, "Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre".

21. Ligji nr. 9749/2007 përcaktonte rregullat dhe parimet përmes të cilave fitohen gradat policore. Neni 41/1, i ligjit nr. 9749/2007, parashikonte: *"Ngritjet në gradë nga 'inspektor' deri në 'drejtues i parë' bëhen nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues, që përfshin raportet e vlerësimit të punës dhe një provimi, i cili teston aftësitë e aplikantëve për të marrë gradën pasardhëse. E drejta për të marrë pjesë në këtë proces përcaktohet në pikën 4 të këtij neni."*.

22. Neni 41/5, shkronja "a", i ligjit nr. 9749/2007, parashikonte se punonjësve të Policisë u lind e drejta për të konkurruar në procesin e përzgjedhjes pas plotësimit të kohës së qëndrimit në gradë, duke përcaktuar afatet e nevojshme të vjetërsisë për secilën prej gradave. Në nenin 42, të këtij ligji, parashikoheshin kushtet për fitimin e gradës si vijon: "*1. a) ngritja në gradë e punonjësit të policisë nënkupton ngritjen e tij në detyrë, sipas tabelës së funksioneve korresponduese për çdo gradë, sipas nenit 39 të këtij ligji. Ngritjet në gradë bëhen vetëm për të plotësuar vendet e lira për çdo gradë. Në urdhrin për ngritjen në gradë, autoriteti përgjegjës përcakton, gjithashtu, funksionin përkatës të punonjësit të Policisë; b) punonjësit e Policisë mund të ngrihen në gradë vetëm pasi të kenë përfunduar me sukses kursin e trajnimit përkatës për atë gradë; c) punonjësit e Policisë zgjidhen për të ndjekur kursin e trajnimit duke u bazuar në listat emërore të së drejtës për gradët hartuar pas procesit konkurrues; ç) pas përfundimit me sukses të trajnimit përzgjedhja për ngritje në gradë bëhet sipas listës emërore të së drejtës për gradë, të përcaktuar në pikën 1 shkronja "c" të këtij neni."*. Gjithashtu, neni 3.1, i VKM-së nr. 803, datë 21.11.2007, "Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre" parashikonte se pas kalimit në sistemin e ri të gradave ngritja në gradë do të realizohet, sipas parashikimeve të nenit 41, të ligjit nr. 9747/2007.

23. Në analizë të dispozitave ligjore dhe nënligjore të mësipërme Kolegji vlerëson se procedura e fitimit të gradës policore, sipas ligjit nr. 9749/2007, pas kalimit në sistemin e ri të gradave, realizohet ekskluzivisht përmes procesit të fitimit të gradës me konkurrim. Sipas kërkesave të ligjit, punonjësi i policisë do të duhet t'i nënshtrohej më parë procesit kualifikues dhe testimit, në mënyrë që të realizohej efektivisht e drejta e ngritjes në gradë dhe vetëm në përfundim të kësaj procedure, organi kompetent do të mund të merrte vendim për fitimin ose jo të gradës.

24. Sipas ligjit nr. 9747/2007, ngritja në gradë nënkuptonte ngritjen në detyrë dhe jo të anasjellën. Ngritja në detyrë nuk prezumon vetiu përfitimin e gradës, vetëm për shkak të ushtrimit të funksionit. Në vështrim të dispozitave të mësipërme çmohet se ligjvënësi qartësisht ka sanksionuar se fitimi i gradës policore realizohet përmes një procedure administrative, e cila, *së pari,* kërkon kalimin me sukses të procedurës konkurruese dhe, *së dyti,* ndjekjen e trajnimit korrespondues për secilën gradë policore. Në këtë kuptim, ngritja në gradë sipas ligjit nr. 4979/2007, pas sistemit të ri të gradave, kërkon plotësimin kumulativ të kushteve vijuese:

1. Punonjësi i policisë duhet të plotësojë kushtin e vjetërsisë në gradë, sipas nenit 41/5, të ligjit nr. 4979/2007;

2. Ngritja në gradë realizohet vetëm për të plotësuar vendet e lira që ka sistemi i policisë për çdo gradë dhe, për këtë arsye, ngritja në gradë sjell ngritjen në detyrë;

3. Ngritja në gradë kërkon kalimin me sukses të procesit të vlerësimit konkurrues;

4. Në vijim, punonjësit duhet të ndjekin kursin e trajnimit përkatës për gradë.

25. Një ndër risitë e ligjit nr. 9747/2007 ishte përcaktimi i një sistemi të ri gradash policore. Në këtë kontekst lindi nevoja për ekuivalentimin e gradave, të fituara sipas ligjit të mëparshëm nr. 8643/2000, "Për gradat në Policinë e Shtetit". Sipas nenit 126, të ligjit nr. 9749/2007, kalimi në sistemin e ri të gradave realizohej përmes procesit të ekuivalentimit të tyre në mbështetje të VKM-së nr. 803, datë 21.11.2007, "Për përcaktimin e funksioneve korrespsonduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre".

26. Neni 126/2, i ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, parashikonte: "*Punonjësi merr gradën që i korrespondon funksionit që kryen vetëm nëse ka minimalisht 2/3 e vjetërsisë së shërbimit, llogaritur sipas afateve të përcaktuara në nenin 41, shkronja "a", të këtij ligji. a) Punonjësit të policisë që nuk plotëson vjetërsinë për gradën që i korrespondon funksionit, që kryen në çastin e kalimit i jepet grada më e lartë për të cilën plotëson minimumi 2/3 e vjetërsisë së shërbimit, duke e emëruar në një funksion që i korrespondon gradës që merr.*".

27. VKM-ja nr. 803, date 21.11.2007 përcaktonte funksionin korrespondues për çdo gradë, në përputhje me parashikimet e ligjit të ri, si dhe ekuivalentimin e gradave të reja me ato të vjetra. Në këtë akt nënligjor

parashikohej: *"Punonjësi personel i policisë merr gradën, që i korrespondon funksionit që kryen, vetëm nëse në çastin e kalimit në këtë sistem gradash, ka vjetërsi shërbimi, jo më pak se: a) 1 vit e 4 muaj për gradën 'inspektor', përfshirë edhe periudhën e shkollimit policor, me përjashtim të punonjësve të policisë, që janë në periudhën e provës; b) 2 vjet e 8 muaj për gradën 'kryeinspektor'; c) 4 vjet për gradën 'nënkomisar', përfshirë edhe periudhën e shkollimit policor. Specialistëve të lartë të policisë në detyrë, u jepet grada 'nënkomisar' edhe, nëse nga përllogaritja nuk plotësojnë vjetërsinë e shërbimit, përcaktuar në këtë shkronjë; ç) 6 vjet për gradën 'komisar'; d) 8 vjet për gradën 'kryekomisar'; dh) 10 vjet për gradën 'drejtues'; e) 12 vjet e 8 muaj për gradën 'drejtues i parë'; 15 vjet e 4 muaj për gradën 'zëvendësdrejtor i përgjithshëm'. 3. Pas kalimit në sistemin e ri të gradave, ngritja në gradë bëhet sipas afateve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 41, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, 'Për Policinë e Shtetit' ...".* Punonjësit e policisë përmes ekuivalentimit të gradës përfitonin gradën, në përputhje me funksionin vetëm nëse plotësohej kushti i vjetërsisë në gradën që i korrespondonte funksionit, në të kundërt punonjësi përfitonte gradën më të lartë sipas vjetërsisë përkatëse në gradë.

28. Sipas akteve ligjore dhe nënligjore të mësipërme, ndryshe nga rregulla e përgjithshme e parashikuar në nenet 41 dhe 42, të ligjit nr. 9749/2007, për fitimin e gradës policore, në procesin e ekuivalentimit të gradave të vjetra me ato të reja, u ndoq parimi "funksioni përcakton gradën". Kolegji vlerëson se kjo qasje e ligjvënësit, në vështrim të situatës ligjore dhe faktike të kohës ka qenë e drejtë dhe ka ardhur natyrshëm në kushtet ku ekuivalentimi i gradës nuk përbënte fitim të një grade të re dhe as përparim në karrierë, por vetëm barasvlerësim të sistemit të gradave, për shkak të ndryshimeve ligjore.

29. Për sa më sipër, Kolegji çmon të sjell në vëmendje se ngritja ose ulja në gradë, për shkak të ekuivalentimit të gradave, ndjek një regjim juridik të ndryshëm nga fitimi i gradës policore, për shkak të përparimit në karrierën policore.

30. I njëjti regjim juridik gradimi është ruajtur edhe për punonjësit e policisë, të cilët u ripranuan në Policinë e Shtetit, pasi kanë ndërprerë marrëdhënien e punës, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9749/2007, në përputhje me parashikimet e VKM-së nr. 917, datë 4.10.2013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 803 datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave, 'Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre'".

31. Nga sa më sipër, Kolegji vlerëson se në kuptim të ligjit nr. 9479/2007, pas sistemit të ri të gradave, për fitimin e gradës policore nga niveli "inspektor" deri në nivelin "drejtues i parë", punonjësit e policisë duhet t'i nënshtroheshin procedurës konkurruese, në përputhje me parashikimet e neneve 41 dhe 42 të ligjit.

32. Kolegji vlerëson se të njëjtën qasje për mënyrën e fitimit të gradave policore, ka edhe ligji i ri, aktualisht në fuqi, nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit". Në kreun VIII të këtij ligji titulluar "Gradat", rregullohet sistemi, hierarkia dhe llojet e gradave në Policinë e Shtetit, gjithashtu, kriteret për dhënien dhe trajnimin përkatës për fitimin e gradës, përcaktimin e funksioneve takuese për gradë, si dhe procedura administrative e ankimit për të gjitha fazat e procesit të fitimit të gradës policore. Në dispozitat përkufizuese të ligjit nr. 108/2014, grada policore është konceptuar, si: "*shprehje e hierarkisë policore, emërtimi i çdo shkalle dhe shenja dalluese, shprehje e cilësive individuale, eksperiencës dhe përgjegjësisë në ushtrimin e funksioneve në Policinë e Shtetit, që fitohet nga punonjësi i policisë nëpërmjet një procesi konkurrues."* (neni 6).

33. Ligji nr. 108/2014 përcakton se ecuria në karrierë e punonjësve të Policisë së Shtetit, bazohet në avancimin gradual dhe meritokratik në gradë policore, sipas konfigurimit të përgjithshëm të sistemit të gradave të parashikuara në të. Përmes ligjit nr. 108/2014, legjislatori synon rishikimin e rolit të gradave në Policinë e Shtetit, duke ribashkuar gradën me funksionin, e më pas funksionin me trajtimin financiar.

34. Legjislatori e ka konceptuar gradën policore si një e drejtë që fitohet nëpërmjet procesit vlerësues e konkurrues, duke i njohur kompetencën ekskluzive autoritetit përkatës, komisionit të gradimit, për zhvillimin e karrierës policore të punonjësve të policisë, përmes ecurisë në gradë.

35. Neni 51, i ligjit nr. 108/2014, parashikon sistemin e gradave policore në rend hierarkik: *"1. Gradat në Policinë e Shtetit, sipas rendit hierarkik rritës, emërtohen, si më poshtë: a) inspektor; b) nënkomisar; c) komisar; ç) kryekomisar; d) drejtues; dh) drejtues i parë; e) drejtues i lartë; ë) drejtues madhor. 2. Autoriteti përgjegjës për vlerësimin e përparimit të punonjësve të policisë në karrierë janë komisionet e gradimit. Përbërja, detyrat dhe mënyra e funksionimit të tyre përcaktohet në rregulloren e Policisë.".*

36. Në nenet 53 dhe 54, të ligjit nr. 108/2014, parashikohet procedura për fitimin e gradës, autoriteti përgjegjës për dhënien e gradës përkatëse dhe parimet e përgjithshme për fitimin e gradave policore. Në nenin 53, pika 2 të ligjit parashikohet se grada "nënkomisar" deri "drejtues i parë" jepet nga drejtori i Policisë së Shtetit për punonjësit, të cilët fitojnë gradën përmes procesit të konkurrimit sipas ligjit. Në nenin 54 të ligjit sanksionohet: "*1. Fitimi i gradës "nënkomisar" deri në "Drejtues i parë" bëhet nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësimi konkurrues nga një komision gradimi. 2. Çdo vit evidentohen nevojat për çdo gradë për vitin pasardhës. Drejtori i Policisë së Shtetit, në varësi të nevojave dhe prioriteteve, miraton urdhrin për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës respektive. 3. Fitimi i gradës bëhet vetëm për të*

plotësuar vendet e lira për çdo gradë dhe vetëm për gradën pasardhëse. 4. Të drejtën për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit e kanë të gjithë punonjësit e policisë që plotësojnë kriteret e vendosura në këtë ligj.".

37. Ligjvënësi, në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë, në frymë të ligjit dhe *ad litteram* ka përcaktuar se procedura e fitimit të gradës policore për punonjësit e Policisë së Shtetit kalon nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces vlerësues dhe konkurrues, i cili administrohet nga komisioni i gradimit. Ligji nr. 108/2014 njeh kompetencën ekskluzive dhe diskrecionare të komisionit të gradimit për vlerësimin e kandidatëve pjesëmarrës në procesin konkurrues për fitimin e gradës, duke përcaktuar parimet, kriteret, fazat e testimit të kandidatëve dhe ankimin për procesin administrativ të fitimit të gradës policore. Gjithashtu, ligji i njeh autoritetit përgjegjës, drejtorit të Policisë së Shtetit, kompetencën diskrecionare për të vlerësuar nevojat e sistemit dhe në varësi të prioriteteve të çelë procedurat për fitimin e gradës. Ligji nr. 108/2014 synon që çdo pozicion brenda strukturave të Policisë së Shtetit të ushtrohet nga mbajtësi i gradës takuese dhe, për këtë qëllim, dispozitat ligjore i kushtojnë një vëmendje të veçantë procedurës së fitimit të gradës, avancimit meritokratik dhe gradual në gradë të punonjësve të Policisë së Shtetit. Në këtë mënyrë, ligjvënësi garanton plotësimin e nevojave të sistemit policor me punonjës të kualifikuar, duke synuar shkrirjen e gradës me funksionin e ushtruar efektivisht.

38. Përcaktimi i funksionit korrespondues për secilën prej gradave policore ka gjetur rregullim të detajuar në VKM-në nr. 892, datë 21.12.2016. Pika 3 e këtij akti normativ nënligjor nxjerr në pah nevojën e bashkimit përfundimtar të gradës me funksionin, duke parashikuar edhe zgjidhjen për rregullimin përfundimtar të situatës kur pozicioni i punës, pra funksioni që ushtron efektivisht një punonjës policie, nuk përputhet me gradën e caktuar sipas ligjit. Në këtë dispozitë parashikohet: "*Punonjësit e Policisë së Shtetit, të emëruar në bazë të vendimit nr. 917, datë 4.10.2013, të Këshillit të Ministrave, 'Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 803, datë 21.11.2007, të Këshillit të Ministrave, 'Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre", të ndryshuar, në funksione të njëjta apo të barasvlershme me ato të parashikuara në këtë vendim, vazhdojnë të qëndrojnë në këto detyra, duke mbajtur gradën ekzistuese për një periudhë deri në 1 vit. Nëse gjatë kësaj periudhe këta punonjës nuk fitojnë gradën korresponduese të funksionit që mbajnë, emërohen në një funksion tjetër, në përputhje me gradën që kanë.*".

39. Neni 55, i ligjit nr. 108/2014, rendit kriteret që duhet të përmbushin punonjësit e policisë për fitimin e gradës nga niveli "nënkomisar" në nivelin "drejtuesi i parë", konkretisht: *"a) të ketë vlerësim të aftësive individuale të punës jo më të ulët se 70 për qind të vlerësimit të përgjithshëm; b) të përmbushë kriteret për pozicionin e punës; c) të jetë parashkruar masa disiplinore për shkelje të rënda, sipas afatit të përcaktuar në këtë ligj; ç) të ketë përfunduar ciklin e parë të studimeve në arsimin e lartë; d) të ketë përfunduar trajnimin e detyrueshëm për gradë; dh) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi penal; e) të mos ketë filluar ndaj tij procedimi disiplinor për shkelje të rëndë; ë) të plotësojë kohën e qëndrimit në gradë, sipas afateve të mëposhtme: i. nga "inspektor" në "nënkomisar", 5 vite; ii. nga "nënkomisar" në "komisar", 3 vite; iii. nga "komisar" në "kryekomisar", 3 vite; iv. nga "kryekomisar" në "drejtues", 5 vite; v. nga "drejtues" në "drejtues i parë", 3 vite; vi. nga "drejtues i parë" në "drejtues i lartë" ose "drejtues madhor", 2 vite.".*

40. Plotësimi i kritereve formale për fitimin e gradës, të parashikuara në nenin 55 të ligjit, nuk përbën kushtin e vetëm për përfitimin e gradës policore. Ligji nr. 108/2014, në nenet 55–59 ka parashikuar të gjitha hallkat e procedurës administrative për fitimin e gradave policore. Kriteret e parashikuara në nenin 55 të ligjit kanë natyrë objektive formale, plotësimi i të cilave verifikohet nga strukturat qendrore të burimeve njerëzore gjatë fazës së aplikimit, testimit, trajnimit, deri në momentin e fitimit të gradës. Këto kritere përbëjnë vetëm kushtet formale që shoqërojnë aplikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë procedurave vlerësuese dhe konkurruese.

41. Për fitimin e gradës policore punonjësit e Policisë së Shtetit duhet të kalojnë me sukses fazën e testimit me shkrim, intervistës me gojë dhe specifikisht për përfitimin e gradës "kryekomisar" deri në "drejtues i parë" parashikohet edhe kryerja e ushtrimeve vlerësuese. Kufiri minimal për kalimin e testimit përkatës përcaktohet nga drejtori i Policisë së Shtetit dhe nuk mund të jetë më i ulët se 70%. Numri i personave të shpallur fitues për përfitimin e gradës nuk mund të jenë më shumë se 30% mbi numrin e vendeve të lira të shpallura për gradën përkatëse.

42. Konkurrentët e shpallur fitues për gradat "nënkomisar" dhe "drejtues" përfundojnë programin e arsimit përkatës, ndërsa për gradat e tjera duhet të kenë përfunduar programin e trajnimit përkatës sipas gradës. Në vijim të procedurës administrative hartohet lista emërore e së drejtës për gradë policore, duke filluar nga punonjësi me vlerësimin më të lartë në rend zbritës, duke u mundësuar të drejtën e përzgjedhjes së pozicionit të lirë për emërim. Në përfundim të procedurës sa më sipër, dhënia e gradës policore realizohet përmes urdhrit të drejtorit të Policisë së Shtetit, bazuar në aktin e vlerësimit të komisionit të gradës. Në këtë urdhër përcaktohet edhe funksioni që do të kryejë punonjësi.

43. Nisur nga analiza e mësipërme e kuadrit ligjor mbi fitimin e gradave policore, Kolegji vlerëson se në mbështetje të ligjit nr. 108/2014, fitimi i gradës policore realizohet përmes një procedure administrative që kalon

nëpër disa faza dhe kuadrohet nga detyrimi i kandidatëve për plotësimin e një sërë kriteresh formale. Kolegji konkludon se procesi i dhënies së gradave policore, në mbështetje të ligjit nr. 108/2014, kushtëzohet, *së pari,* me plotësimin e kritereve objektive për konkurrim, të cilat listohen në nenin 55, të ligjit dhe, *së dyti,* me kalimin me sukses të procedurës konkurruese të testimit dhe të kryerjes së trajnimeve përkatëse. Gjithashtu, vlerësohet se këto faza duhet të paraprihen nga ekzistenca e vendeve vakante për funksionet takuese, të cilat i korrespondojnë gradës, për të cilën zhvillohet konkurrimi. Ky proces formësohet nëpërmjet ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit të organit publik, në drejtim të çeljes dhe administrimit tërësor të procedurave konkurruese.

B. Parimet kushtetuese dhe procesi i fitimit të gradave policore

44. Kolegji, nisur nga autoriteti kushtetues që gëzon në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit përfundimtar dhe të drejtë të ligjit, në përputhje me parimet koventore dhe kushtetuese, në vështrim të problematikave që parashtron interpretimi i hasur gjerësisht nga ana e gjykatave të faktit për procesin e fitimit të gradave policore dhe në mbështetje të analizës ligjore të parashtruar sa më sipër, vlerëson se në rastin konkret implikohet zbatueshmëria e parimeve kushtetuese të ndarjes dhe e balancimit të pushteteve, të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit dhe të parimit të shanseve të barabarta.

45. Parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve sanksionohet në nenin 7 të Kushtetutës, në të cilin parashikohet: "*Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore".* Kolegji vlerëson se ky parim synon të garantojë që të gjitha pushtetet janë të kufizuara dhe i nënshtrohen një kontrolli të balancuar. Parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve përbën thelbin e shtetit të së drejtës.

46. Pavarësia funksionale e organeve dhe institucioneve kushtetuese është e lidhur ngushtësisht me përmbajtjen e veprimtarisë që këto realizojnë, e cila rregullohet drejtpërsëdrejti dhe e ka themelin e vet në dispozitat përkatëse kushtetuese. Në përputhje me detyrat që i ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur. Asnjë organ apo institucion tjetër, në përbërje ose jo të një prej tri pushteteve qendrore, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese. (*Shih vendimi nr. 19, datë 27.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese.)*

47. Kolegji vlerëson se asnjë institucion pushteti nuk mund të marrë përsipër kompetenca nga një institucion tjetër e as mund të transferojë ose të heqë dorë prej tyre**.** Kolegji çmon se çdo vendimmarrje gjyqësore që detyron organin publik të njohë gradën policore punonjësve të policisë, pa lejuar zhvillimin sipas ligjit të një procedure administrative vlerësimi nga komisioni përkatës i gradimit, duke ushtruar në mënyrë të paligjshme kompetenca ekskluzive dhe ekzekutive të organit publik, në cenim të pushtetit të tij diskrecionar për të vlerësuar përmbushjen e të gjitha kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligj për fitimin e gradës, në thelb ka zëvendësuar funksionin që ka organi publik në këtë proces ligjor të rëndësishëm. Një qëndrim i tillë cenon rëndë parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe parimin e ligjshmërisë.

48. Shtrirja e kontrollit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative përfshin kontrollin e ligjshmërisë së veprimit administrativ dhe veprimtarisë administrative në tërësi, në drejtim të ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit të organit publik, i cili garantohet përmes parimit kushtetues të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve. Funksioni thelbësor i kontrollit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative, kryesisht synon të garantojë mungesën e arbitraritetit në ushtrimin e kompetencave administrative të organit publik. Në këtë drejtim, gjykata duhet të jetë e kujdesshme për të mos vepruar vetë si një organ administrativ, përveç rasteve kur një gjë e tillë parashikohet shprehimisht nga ligji.

49. Autoriteti publik i organeve administrative ushtrohet përmes kompetencave urdhëruese ligjzbatuese, si edhe nëpërmjet kompetencave diskrecionare. Diskrecioni konsiderohet i pashmangshëm dhe i lidhur në mënyrë të natyrshme me vetë karakterin e veprimtarisë administrative, madje i konsideruar se përbën vetë "thelbin e veprimit administrativ".

50. Kolegji vlerëson se kompetencat diskrecionare gëzojnë legjitimim kushtetues dhe janë të pajtueshme me shtetin e së drejtës, nëse ato i janë dhënë administratës publike me ligj. Pushteti diskrecional është pushteti që i jep një autoriteti administrativ një shkallë të caktuar lirie për të marrë vendime, duke i mundësuar që të zgjedhë mes disa vendimeve të pranueshme ligjore atë që është më i përshtatshëm. Ushtrimi diskrecionar i kompetencave është antiteza e veprimtarisë së ngushtë ligjzbatuese të organit publik, në zbatim të normave urdhëruese të së drejtës. Hapësira e vlerësimit të organit publik mbi zgjedhje të caktuara përbën thelbin praktik të kompetencës diskrecionare. Parimi i ligjshmërisë, vendos kufijtë negativë të sjelljes së organit publik, duke e detyruar atë të veprojë në zbatim të kërkesave urdhëruese të ligjit. Nga ana tjetër, kompetenca diskrecionare e organit duhet të jetë e parashikuar në ligj, duke deleguar gjykimin autonom për kryerjen e zgjedhjeve alternative të caktuara, për të

qenë në përputhje me parimin e ligjshmërisë. Në këtë kuptim, diskrecioni është ushtrimi i pushtetit të autorizuar nga ligji, por i kufizuar nga e drejta.

51. Ligji nr. 108/2014 ka parashikuar një sërë kompetencash diskrecionare të organit publik në procesin administrativ për fitimin e gradës si: evidentimi i nevojave për çdo gradë sipas prioriteteve dhe miratimi i urdhrit për fillimin e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës (neni 54, pika 1), verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kritereve për konkurrim gjatë fazës së aplikimit, testimit, trajnimit deri në momentin e fitimit të gradës (neni 56, pikat 1 dhe 2), përcaktimi i nivelit minimal për kalimin me sukses të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë (neni 57, pika 3), si dhe dhënien e gradës përmes vlerësimit në tërësi nga ana e komisionit të gradimit (neni 59).

52. Kolegji vlerëson se ligji nr. 108/2014 ka autorizuar në mënyrë të shprehur hapësirën diskrecionare për vlerësim të organit publik, përkatësisht Drejtorit të Policisë së Shtetit lidhur me vlerësimin e nevojave dhe prioriteteve për çeljen e fazës së aplikimeve për fitimin e gradës, sikurse ka autorizuar komisionin e gradimit për vlerësimin dhe përparimin e punonjësve të Policisë së Shtetit në karrierë, në të cilin përfshihet edhe pjesëmarrja në procesin konkurrues për fitimin e gradës. Kolegji çmon se ka rëndësi të veçantë të sjellë në vëmendje, se këto kompetenca diskrecionare nuk janë të pakufizuara, sepse përndryshe do të cenohej thelbi i shtetit të së drejtës. Kolegji vlerëson se sistemi procedural i drejtësisë administrative synon vendosjen e një balance ndërmjet respektimit të kërkesave të veprimtarisë administrative, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së të drejtave të individit, nga ana tjetër.

53. Qëllimi i një koncepti kushtetues të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve siguron të parandalojë çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar. Kontrollet dhe ekuilibrat që njeh Kushtetuta i japin secilës degë pushtet që të kompensojnë apo të zbusë ato të degëve të tjera. Ekzistojnë mjete apo mekanizma që balancojnë pushtetet, sepse në analizën e fundit asnjë pushtet më vete nuk është në gjendje të përmbushë misionin, nëse veprimtaria e tij nuk harmonizohet me veprimtarinë e pushteteve të tjera dhe nëse nuk sigurohet një ekuilibër, bashkërendim dhe kontroll reciprok, që, natyrisht, nuk ndërhyn në atë masë sa të dëmtojë misionet e tyre kushtetuese (*shih vendimin nr. 11, datë 6.3.2004, të Gjykatës Kushtetuese).*

54. Kolegji vlerëson se misioni i mbrojtjes së të drejtave dhe i lirive themelore që i është ngarkuar pushtetit gjyqësor mund të realizohet vetëm atëherë kur zbatimi i normës nga pushteti ekzekutiv, i cili ka ndërhyrë në sferën e të drejtave të qytetarëve, bëhet i kontrollueshëm nga gjykatat administrative. Për aq sa administratës i është lejuar hapësirë vlerësimi diskrecionar, ajo duhet të veprojë në përputhje me detyrat e veta funksionale dhe të shfrytëzojë mundësitë që i janë dhënë në përputhje me ligjin. Ky zbatim i së drejtës kryhet nën urdhërimet e parimit të shtetit të së drejtës e, sidomos, të parimit të barazisë. Ushtrimi i gabuar i vlerësimit diskrecionar nga ana e autoriteteve publike i nënshtrohet kontrollit të gjykatave administrative. Ndarja e pushteteve midis tri degëve të qeverisjes mund të garantohet vetëm nëpërmjet sistemit të kontrolleve dhe të ekuilibrave.

55. Në këtë kuptim, shtrirja e juridiksionit gjyqësor mbi veprimtarinë administrative të organeve publike ka për qëllim të garantojë parimin e ligjshmërisë dhe kontrollin gjyqësor mbi veprimtarinë diskrecionare të organit publik, por pa dubluar ose zëvendësuar kompetenca të cilat ekskluzivisht i janë njohur organit publik, sipas ligjit. Kolegji vlerëson se ky është një qëndrim i konsoliduar që pasqyrohet gjerësisht edhe në praktikën e gjykatave supreme evropiane. Në rastin kur organi publik ka një pushtet diskrecionar ndërmjet disa zgjidhjeve, ligjshmëria e vendimmarrjes së tij mund të kontrollohet në gjykatë, por në rast se gjykata konkludon se vendimi është i paligjshëm nuk mund të vendosë vetë për thelbin. Gjykata ka të drejtën të rikthejë çështjen edhe njëherë para organit administrativ kompetent, në mënyrë që ky i fundit të marrë një vendim të ri, brenda pushtetit të tij diskrecionar (*shih vendimi nr. 207, datë 21.12.2004, i Gjykatës Kushtetuese Belge).*

56. Kolegji çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në këtë drejtim, kur në rastin *Meltex Sh.p.k. dhe Mesrop Movsesyan kundër Armenisë (shih prg. 81, 2008),* mbi konstatimin e shkeljes së nenit 10 të Konventës, për shkak të ushtrimit të diskrecionit, në lidhje me refuzimin për dhënien e licencës, Gjykata ka arsyetuar, se, me qëllim që ligji i brendshëm të përmbushë kërkesat cilësore, ai duhet të sigurojë mjete ligjore, mbrojtje kundër ndërhyrjeve arbitrare nga autoritetet publike lidhur me të drejtat e garantuara nga Konventa. Në çështje që ndikojnë të drejtat themelore do të ishte në kundërshtim me shtetin e së drejtës një diskrecion ligjor që i është njohur ekzekutivit të shfaqet në formën e një pushteti të pakontrolluar. Rrjedhimisht, ligji duhet të parashikojë mjaftueshëm qartë edhe shtrirjen e çdo diskrecioni të tillë që u është dhënë autoriteteve kompetente, si edhe mënyrën se si ushtrohet ky diskrecion *(Navalnyy kundër Rusisë 2018, prg. 113*), duke pasur parasysh synimin legjitim të masës përkatëse, me qëllim që t'i japë individit mbrojtjen e duhur ndaj ndërhyrjeve arbitrare (*Maestri kundër Italisë* 2004, prg. 30).

57. Kolegji vlerëson se në këndvështrim të standardeve konventore, gjykatat administrative gëzojnë pushtetin e kontrollit të kufijve ligjorë të vendimmarrjes së autoriteteve publike. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim,

Kolegji vlerëson se juridiksioni gjyqësor në kontrollin e veprimtarisë administrative të organit publik, në procesin e dhënies së gradave, mund të shtrihet në drejtim të vlerësimit të gabuar të ligjit, konstatimit të rrethanave të pasakta ose kryerjes së gabimeve procedurale, të tilla që kanë ndikuar në vlerësimin e gabuar të përmbushjes së kritereve formale për aplikimin në fazën e konkurrimit, duke përfshirë kundërshtimin e secilës prej fazave administrative për fitimin e gradës, të cilat, sipas nenit 60 të ligjit nr. 108/2014, i nënshtrohen paraprakisht edhe procesit të ankimit administrativ dhe veçanërisht kontrollit mbi rastet e ushtrimit *ultra vires* të pushtetit diskrecionar të organit publik lidhur me administrimin tërësor të procesit të konkurrimit për fitimin e gradës. Kolegji vlerëson se juridiksioni gjyqësor që gëzojnë gjykatat administrative në këtë proces duhet të ketë për qëllim mbrojtjen e meritokracisë për avancimin në gradë në kuadër të lirisë së ushtrimit të profesionit dhe nuk mund të zëvendësojë organin publik, konkretisht komisionin e gradimit, duke dhënë gjyqësisht gradën policore, në kushtet ku aplikanti nuk i është nënshtruar konkurrimit për fitimin e gradës.

58. Kolegji vlerëson se nënshtrimi i punonjësve të policisë në procedurën konkurruese për fitimin e gradës është në përputhje me parimet kushtetuese të sigurisë juridike, stabilitetit ligjor dhe pritshmërive legjitime, në kushtet ku legjislacioni mbi fitimin e gradave policore, që në vitin 2007, ka ofruar qartësi dhe qëndrueshmëri, në drejtim të përcaktimit të mënyrës së fitimit të gradës përmes procedurave konkurruese. Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson se fitimi i gradave policore gjyqësisht, pa iu nënshtruar më parë punonjësit e policisë procedurës konkurruese, cenon rëndë edhe parimin e shanseve të barabarta.

59. Jurisprudenca kushtetuese ka elaboruar në vijimësi parimin e barazisë, duke vlerësuar se ky parim synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. *(Shih vendimet nr. 34, datë 10.4.2017, nr. 10, datë 29.2.2016; nr. 71, datë 27.11.201, nr. 20, datë 20.4.2021, të Gjykatës Kushtetuese).* Në këtë drejtim, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën autoritative të Gjykatës Federale Kushtetuese Gjermane, në të cilën është trajtuar e drejta e shanseve të barabarta në fushën e vlerësimeve konkurruese. Sipas parimit të shanseve të barabarta, e cila mbizotëron në të drejtën mbi provimet për ata që merren në provime të ngjashme, duhet të vlejnë me sa të jetë e mundur, kushte të ngjashme të marrjes në provim dhe kritere të ngjashme vlerësimi. Do të ishte e papajtueshme nëse kandidatëve të veçantë, të cilët fillojnë një proces gjyqësor administrativ, do t'u jepej shansi i një vlerësimi të pavarur e pa kuadrin e krahasimeve. Do të cenohej rëndë gjykimi i barabartë i të gjithë kandidatëve të ngjashëm. Ai është i mundur vetëm kur komisioneve të provimeve u lihet një hapësirë veprimi në vlerësimet për provime specifike dhe nëse kufizohet kontrolli gjyqësor. Provimet e shtetit, të cilat kufizojnë pranimin për profesione akademike, kërkojnë vlerësime të vështira, të cilat duhet të merren duke marrë parasysh shanset e barabarta për të gjithë kandidatët në një kontekst të përgjithshëm të procedurës së provimit dhe të mos kryhen menjëherë në mënyrë të izoluar në proceset administrative të kandidatëve të veçantë. Vetëm vlerësime për provime specifike, shpeshherë të gërshetuara në mënyrë të pandashme me gjykime profesionale, mbeten në kompetencën e fundit vendimmarrëse të komisioneve të provimit. Por as përgjigjja për çështje të tilla vlerësimi nuk i shpëton çdo kontrolli. Hapësira e lirë e vlerësimit ka kufij, respektimi i të cilëve duhet verifikuar me rrugë gjyqësore *(shih vendimin e Gjykatës Federale Gjermane 1 BvR 419/81 dhe 21 3/83, i Senatit të Parë, datë 17.4.1991).*

60. Së fundmi, Kolegji çmon të theksojë, se procesi konkurrues synon të rrisë profesionalizmin[1] në radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit, të garantojë meritokracinë, në kuadër të zhvillimit të tyre profesional, në përputhje me parashikimet e nenit 49 të Kushtetutës, ku sanksionohet: *"Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional.".*

61. Nisur nga kjo analizë e hollësishme që i bëhet çështjes në shqyrtim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konkludon në sentencën unifikuese:

Procesi i fitimit të gradave policore nga niveli "nënkomisar" deri në nivelin "drejtues i parë", duhet t'i nënshtrohet domosdoshmërisht procedurës së vlerësimit konkurrues, sipas parashikimeve të neneve

[1] Në vendimin nr. 55/1999, Gjykata Kushtetuese e RSH-së ka marrë në vlerësim kushtetutshmërinë e nenit 48, të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", ku, ndër të tjera, ka theksuar se: "*Format për kualifikimin profesional janë nga më të larmishmet dhe një prej tyre është edhe organizimi i provimit, i cili shërben si nxitje për gjyqtarët për studim, por në të njëjtën kohë shërben edhe si një mjet për të vlerësuar shkallën e dijeve të gjithsecilit, në kuadrin e përgjithshëm të vlerësimit profesional. Në këtë aspekt, pjesëmarrja në provim përbën një detyrë ligjore, që secili gjyqtar, sipas kritereve të përcaktuara nga ligji, duhet t'i nënshtrohet këtij provimi. Nëse duhet zbatuar ose jo ky detyrim nuk është lënë në vlerësimin e gjyqtarëve, ndërsa përgjegjësia për mospërmbushjen e këtij detyrimi është individuale dhe çmohet në çdo rast konkret në varësi të shkaqeve që pretendon gjithsecili.*"

50–60 të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit". Plotësimi i kritereve formale për fitimin e gradës, si vjetërsia në gradën pararendëse dhe/ose ushtrimi efektiv i funksionit, në përputhje me gradën e pretenduar, nuk mund të sjellin fitimin gjyqësisht të gradës policore, pa iu nënshtruar më parë punonjësit e Policisë së Shtetit një procesi vlerësimi konkurrues nga komisioni i gradimit.

III. Në lidhje me shqyrtimin e rekursit të palës së paditur

62. Rekursi plotëson kushtet formale të pranueshmërisë dhe është ushtruar brenda afatit 30-ditor për paraqitjen e tij. Vendimi nr. 1812, datë 26.4.2018, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, përmes të cilit është lënë në fuqi vendimi nr. 202, datë 5.4.2017, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është marrë në zbatim të gabuar të ligjit.

63. Paditësit i është njohur grada "komisar" me urdhrin nr. 3052/1, datë 2.11.2010, të drejtorit të Policisë së Shtetit. Me urdhrin nr. 2304 prot., datë 15.10.2015, të drejtorit të Policisë së Shtetit, paditësi rezulton të jetë transferuar përkohësisht në detyrën shef komisariati, pranë Komisariatit të Policisë Malësi e Madhe, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër e, më pas, me urdhrin nr. 452, datë 8.2.2016, të drejtorit të Policisë së Shtetit, paditësi është transferuar dhe emëruar në detyrën shef komisariati, në Komisariatin e Policisë Malësi e Madhe, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkodër.

64. Paditësi ka pretenduar, se, për shkak të funksionit që ushtron dhe plotësimit të viteve në vjetërsi në gradë dhe pasi pala e paditur nuk ka zhvilluar konkurrime për fitimin e gradave policore, duhet t'i njihet grada "kryekomisar". Pala e paditur përmes shkresës nr. 159/1 prot, datë 9.2.2017 ka refuzuar kërkesën e paditësit për njohjen e gradës "kryekomisar", për shkak se ligji nr. 108/2014 nuk parashikon marrjen e gradës, sipas pozicionit të punës dhe se fitimi i gradës mundësohet vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes në proces konkurrimi, pas plotësimit të kritereve të përcaktuara në ligj.

65. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër me vendimin nr. 202, datë 5.4.2017, ka pranuar padinë, duke vlerësuar se paditësit i takon përfitimi i gradës, për shkak se plotëson kushtin e vjetërsisë në detyrë dhe efektivisht ushtron funksionin, në përputhje me gradën e pretenduar "kryekomisar". Gjykata ka vlerësuar, se, në kuadër të parimit të sigurisë juridike dhe të drejtave të fituara, padia është e mbështetur në ligj. Vendimi nr. 202, datë 5.4.2017, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër është lënë në fuqi me vendimin nr. 1812, datë 26.4.2018, të Gjykatës Administrative e Apelit.

66. Në vijim të përfundimit njësues, Kolegji vlerëson se plotësimi i kriterit të ushtrimit të funksionit të kërkuar për gradën e pretenduar dhe vjetërsisë në gradë, nuk mund të sjellë përfitimin gjyqësisht të gradës policore të pretenduar, pa iu nënshtruar procedurës së konkurrimit vlerësues nga komisioni i gradimit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 108/2014.

67. Në vështrim të analizës së mësipërme, Kolegji vlerëson, se pretendimet e paditësit se plotëson kushtet për fitimin e gradës dhe duhet ta fitoj atë gjyqësisht, pasi organi nuk ka hapur procedurën e konkurrimit vlerësohet i pabazuar në ligj. Në këtë aspekt, Kolegji çmon të theksojë se paditësi do mund të kishte orientuar gjykimin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi në një tjetër drejtim, duke vlerësuar gjyqësisht ushtrimin e diskrecionit nga ana e palës së paditur në administrimin dhe në` çeljen e procesit të konkurrimit dhe jo duke pretenduar dhënien e menjëhershme të gradës nga gjykatat, në kushtet ku nuk është ndjekur procedura ligjore konkurruese për fitimin e gradës policore.

68. Sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në rekurs, Kolegji vlerëson se ato nuk janë të bazuara në ligj. Kolegji çmon të ndalet në pretendimin për mungesën e kompetencës tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Kolegji sjell në vëmendje se në mbështetje të nenit 13, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, moskompetenca tokësore mund të ngrihet ose të kundërshtohet nga palët vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i provave. Në këtë drejtim, pala e paditur ka pasur mundësinë të parashtrojë gjatë gjykimit në shkallë të parë çështjen e moskompetencës tokësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Nga aktet bashkëlidhur dosjes gjyqësore nuk rezulton të ketë pasur kërkesa procedurale të kësaj natyre nga pala e paditur. Kolegji vlerëson se çështja e kompetencës tokësore ka rënë në dekadencë dhe nuk mund të merret në shqyrtim gjatë gjykimit pranë Gjykatës së Lartë.

69. Në vështrim të analizës së mësipërme, Kolegji konkludon se vendimet e gjykatave të faktit janë dhënë në zbatim të gabuar të ligjit dhe se çështja që shtrohet për zgjidhje në mosmarrëveshjen objekt gjykimit është ekskluzivisht çështje ligji, për të cilën nuk është e nevojshme të kryhet rivlerësimi i provave apo i fakteve të vëna në themel të mosmarrëveshjes. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 63, shkronja "dh", të ligjit nr. 49/2012, pas ndryshimeve me ligjin nr. 49/2021, Kolegji nuk pengohet të zgjidhë në themel mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 63, shkronja "dh", të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", pas ndryshimeve me ligjin nr. 49/2021, si dhe në nenin 35, pika 4, të ligjit nr. 98, datë 6.10.2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 1812, datë 26.4.2018, të Gjykatës Administrative e Apelit dhe vendimit nr. 202, datë 5.4.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe rrëzimin e padisë së paditësit Leonard Ndreka.
2. Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore publikohet në Fletoren Zyrtare të radhës.

Tiranë, më 15.7.2021

Anëtarë: Sokol Sadushi (Kryesues), Sokol Binaj, Klodian Kurushi, Ilir Panda, Ervin Pupe

VENDIM
Nr. 00-2021-1317, datë 22.7.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë, nga:
Sokol Sadushi - kryesues;
Ilir Panda - anëtar;
Sokol Binaj - anëtar;
Albana Boksi - anëtar;
Ervin Pupe - anëtar,
në seancën gjyqësore më datë 22.7.2021, mori në shqyrtim çështjen, që u përket palëve:
PADITËS: Merushe Shpata
I PADITUR: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë
Instituti i Sigurimeve Shoqërore
OBJEKTI: Anulimin e vendimit nr. 173, datë 1.11.2010, të Komisionit të Caktimit të Aftësive për Punë (KMCAP), pranë Drejtorisë Rajonale të Komisionit Qendror të Caktimit të Aftësive për Punë Epror, duke përcaktuar statusin mjekësor, si "invalid i grupit të dytë", dhe detyrimin e të padituri, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, t'i paguajë pensionin e invaliditetit nga data 1.11.2010 deri më datë 1.11.2011.
BAZA LIGJORE: Kodi i Procedurës Civile; ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

KOLEGJI ADMINISTRATIV,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. Sokol Sadushi dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Padia është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 25.1.2011.
2. Nga aktet e fashikullit të gjykimit rezultoi se pala paditëse, prej vitesh është trajtuar për një lloj sëmundjeje dhe duke qenë e paaftë për punë, i është drejtuar palës së paditur për të njohur shkallën e invaliditetit dhe për t'i caktuar shumën e mbrojtjes shoqërore respektive.
3. Me vendimin nr. 173, datë 1.11.2010, Komisioni i Caktimit të Aftësisë për Punë, pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, e ka përcaktuar paditësen si të paaftë për punët e lehta. Pala paditëse nuk ka qenë dakord me këtë vendim, duke pretenduar se konkluzioni i organit administrativ është i gabuar dhe se ajo duhet të përcaktohet se është e paaftë për punë sipas ligjit. Pala paditëse është trajtuar me pension invaliditeti nga

viti 2004 deri në vitin 2010. Ankimi administrativ i paditëses nuk është pranuar me vendimin nr. 44, datë 21.12.2010 të Komisionit të Caktimit të Aftësive për Punë Epror, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore (në vijim "KMCAP"). Në këto kushte, pala paditëse i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar anulimin e vendimit të komisionit rajonal dhe KMCAP-së dhe përcaktimin e saj si invalide e grupit të dytë.

II. Procedura gjyqësore

4. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10751, datë 9.11.2012,** ka vendosur: "*Pranimin e kërkesëpadisë. Anulimin e vendimit nr. 173, datë 1.11.2010, të Komisionit të Caktimit të Aftësive për Punë pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe vendimit nr. 44, datë 21.12.2010 të Komisionit të Caktimit të Aftësive për Punë Epror pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.*

Detyrimin e të paditurit Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë për t'i paguar paditëses pensionin e invaliditetit si person i paaftë për punë, nga data 1.11.2010 deri me datë 1.11.2011, në masën që e ka pasur kur e ka ndërprerë.".

5. Gjykata, duke mbajtur parasysh konkluzionet e arritura në gjykim nga ekspertët dhe pasi ka sjellë në vëmendje konkluzionet e vendimit të GJEDNJ-së në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*", ka konkluduar se nga ana e palës së paditur është zbatuar gabim ligji dhe se palës paditëse për periudhën respektive duhet ta paguanin me vlerën e pensionit të invaliditetit të plotë. Gjykata ka vlerësuar se karakteristikat e sëmundjes së paditëses janë të tilla, që shkaktojnë paaftësi të plotë për punë. Nuk rezulton që gjykata e shkallës së parë të ketë analizuar në vendimin e saj ndryshimet që iu bënë ligjit nr. 7703/1993, në vitin 2011, për sa i përket zbatimit të vendimit "*Dauti kundër Shqipërisë*", të GJEDNJ-së dhe, për rrjedhojë, nuk ka arsyetuar se përse nuk zbatohet paragrafi i katërt i nenit 35 të ligjit nr. 7703/1993 dhe njëherazi nuk ka arsyetuar se përse nuk zbatohet edhe pika 3 e nenit 39/1 e këtij ligji, të ndryshuar, në vitin 2011.

6. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim pala e paditur. Në apel është kërkuar ndryshimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimi i padisë. Është pretenduar gjithashtu, se vendimi i KMCAP-së Epror është i formës së prerë, për sa i përket themelit të konkluzioneve dhe se nuk mundet të ushtrohet padi në gjykatë, sipas nenit 35, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993. Rezulton se pas ndryshimeve ligjore të vitit 2011, ky parashikim i ligjit ndodhet në pikën 3, të nenit 39/1, të ligjit nr. 7703/1993, dhe se ka të njëjtin rregullim imunitar nga kontrolli gjyqësor.

7. **Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 687, datë 4.3.2014,** ka vendosur: "*Të shpallë moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për gjykimin e çështjes civile nr. 223 akti, datë 1.2.2013, dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.*".

8. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2318, datë 5.6.2014,** ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. 10751, datë 9.11.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*".

9. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar njëlloj, sikurse gjykata e shkallës së parë, lidhur me themelin e gjykimit. Gjykata e apelit ka marrë në shqyrtim çështjen, nëse KMCAP Epror është apo jo gjykatë, në kuptimin material, sipas parashikimeve të nenit 35, të ligjit nr. 7703/1993, nenit 6 të KEDNJ-së dhe vendimit të GJEDNJ-së: "*Dauti kundër Shqipërisë*", duke sjellë në vëmendje edhe qëndrimin e mbajtur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 00-2014-555 (41), datë 21.1.2014. Gjykata e apelit ka konkluduar se KMCAP Epror nuk rezulton të jetë gjykatë në kuptimin material dhe se nuk mundet të konkludohet se vendimi ka marrë formë të prerë dhe, për rrjedhojë, të mos lejohet ankim në gjykatë. Sikurse gjykata e shkallës së parë, edhe Gjykata Administrative e Apelit nuk rezulton të ketë analizuar në vendimin e saj ndryshimet ligjore të vitit 2011, në ligjin nr. 7703/1993, për sa i përket zbatimit të gjetjeve në jurisprudencën "*Dauti kundër Shqipërisë*" të GJEDNJ-së dhe, për rrjedhojë, nuk ka arsyetuar se përse nuk zbatohet paragrafi i katërt i nenit 35, të ligjit nr. 7703/1993 ,dhe njëherazi nuk ka arsyetuar as për moszbatimin e pikës 3, të nenit 39/1, të këtij ligji, të ndryshuar në vitin 2011.

10. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Drejtoria Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, më datë 24.7.2014. Rekursi është njoftuar te palët ndërgjyqëse dhe nuk rezulton të jetë paraqitur kundërrekurs. Në rekurs është parashtruar:

- Vendimi i gjykatës së apelit është marrë në kundërshtim me ligjin dhe në shkelje të rregullave të procesit të rregullt ligjor;

- Neni 35, në paragrafin e katërt, në kohën e paraqitjes së padisë dhe neni 39/1, pika 3, gjatë gjykimit të çështjes, i ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, parashikon se vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë dhe, si të tilla, nuk mundet të ankimohen në gjykatë;

- Vendimet e gjykatave të faktit duhet të prishen dhe duhet të vendoset rrëzimi i padisë si e pambështetur në ligj dhe në prova.

11. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, më datë 19.9.2014. Rekursi është njoftuar te ndërgjyqësit dhe nuk rezulton të ketë kundërrekurs. Në rekurs janë parashtruar të njëjta shkaqe, si edhe Drejtoria Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë:

- Vendimi i gjykatës së apelit është marrë në kundërshtim me ligjin dhe në shkelje të rregullave të procesit të rregullt ligjor;

- Neni 35, në paragrafin e katërt, në kohën e paraqitjes së padisë, dhe neni 39/1, pika 3, gjatë gjykimit të çështjes, i ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, parashikon se vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë dhe si të tilla nuk mundet të ankimohen në gjykatë;

- Vendimet e gjykatave të faktit duhet të prishen dhe duhet të vendoset rrëzimi i padisë si e pambështetur në ligj dhe në prova.

III. Kontrolli incidental, sipas nenit 145 të Kushtetutës.

12. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim "Kolegji"), ka planifikuar gjykimin e kësaj çështje në dhomë këshillimi më datë 12.10.2020. Për këtë qëllim janë njoftuar palët, sipas parashikimeve të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (në vijim "ligji nr. 49/2012").

13. Në praktikën gjyqësore të gjykatave administrative të shkallës së parë, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, janë vënë re qëndrime të kundërta mbi interpretimin dhe zbatimin e nenit 39/1, pika 3, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 (në vijim "ligji nr. 7703/1993"), në lidhje me kuptimin e formës së prerë të vendimeve të KMCAP-së.

14. Në çështje gjyqësore të ndryshme, nga gjykatat është marrë në analizë, nëse KMCAP-ja, sipas ligjit nr. 7703/1990, plotëson kushtet e gjykatës, në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim "KEDNJ") dhe sipas standardeve të vendosura nga GJEDNJ-ja, në çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë"*, për të konkluduar mbi juridiksionin gjyqësor mbi këto çështje.

15. Sipas njërit qëndrim të mbajtur në praktikën gjyqësore, neni 39/1, pika 3, i ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, nuk lejon kontrollin gjyqësor mbi vendimet e KMCAP Epror dhe se ky organ, me ndryshimet që pësoi ligji nr. 7703/1993, në vitin 2011, plotëson elementet e gjykatës, në kuptimin material. Në të tilla raste, gjykatat kanë konkluduar mungesën e juridiksionit gjyqësor mbi kontrollin e këtyre vendimeve *(shih vendimin nr. 00-2017-1934, datë 26.9.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; vendimin nr. 1651, datë 2.5.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë).*

16. Në raste të tjera të ngjashme, Gjykata e Lartë, duke referuar në standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja, në çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë"*, ka vlerësuar se duhet të njihet e drejta e ankimit gjyqësor mbi vendimet e KMCAP Epror *(shih vendimin nr. 00-2017-116, datë 1.2.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; vendimin datë 6.6.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; vendimin nr. 5325 (06125), datë 26.10.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; vendimin nr. s'ka, datë 21.2.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë etj.).*

17. Në këto kushte, para Kolegjit, në rastin konkret, u shtrua për diskutim çështja e ushtrimit ose jo të së drejtës së ankimit gjyqësor ndaj vendimit të KMCAP Epror, sipas rregullimit të parashikuar në nenin 39/1, pika 3, të ligjit nr. 7703/1993 (të ndryshuar në vitin 2011) dhe në nenin 35/4, të ligjit, (para ndryshimeve), i cili ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së padisë, si një nga shkaqet e rekursit të palës së paditur.

18. Kolegji vlerësoi se KMCAP Epror, edhe me ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 7703/1993, në vitin 2011, nuk plotëson elementet e *quazi (pothuajse)* gjykatës, sipas nenit 6 të KEDNJ-së, nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe praktikës së GJEDNJ-së, në çështjen e referuar më sipër.

19. Nga ana tjetër, Kolegji vlerësoi se rekursi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë nuk mund të shqyrtohej dhe të vendosej për ligjshmërinë apo jo të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, në kushtet kur këto dy dispozita ligjore, nga viti 1995 e deri më sot, ndalojnë ushtrimin e kontrollit gjyqësor mbi vendimet e KMCAP Epror.

20. Kolegji vlerësoi se të dyja këto parashikime ligjore, i pari i zbatueshëm sa kohë është realizuar kontrolli administrativ (deri në vitin 2011) dhe i dyti i zbatueshëm gjatë kontrollit gjyqësor, pas ushtrimit të padisë dhe nga momenti i hyrjes në fuqi të ndryshimeve të ligjit nr. 7703/1993 të vitit 2011 e deri më sot, vijnë në kundërshtim me nenin 42 dhe 83 të Kushtetutës, por edhe me nenin 6 të KEDNJ-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, të artikuluar mbi këtë dispozitë ndër vite. Për rrjedhojë, Kolegji konkludoi se asnjë vlerësim ligjor mbi rekurset objekt gjykimi nuk mund të ishte i mundur, derisa Gjykata Kushtetuese të shprehet mbi kushtetutshmërinë e dispozitës së zbatueshme për zgjidhjen e çështjes, konkretisht, pika 3, e nenit 39/1, të ligjit nr. 7703/1993.

21. Mbi këtë analizë, në bazë të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 68, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*", me vendimin e ndërmjetëm datë 12.10.2020, Kolegji pezulloi gjykimin dhe iu drejtua Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin si antikushtetuese të pikës 3, të nenit 39/1, të ligjit nr. 7703/1993.

22. Në argumentet për shpalljen e antikushtetutshmërisë së dispozitës ligjore, Gjykata e Lartë shtroi para Gjykatës Kushtetuese disa çështje të natyrës kushtetuese, zgjidhja e të cilave varej nga analiza, interpretimi dhe qëndrimi që do të mbante ky autoritet i lartë kushtetues, se:

i. A mundet gjykata në zgjidhjen e çështjes të refuzojë të zbatojë ligjin, duke zbatuar drejtpërdrejt Kushtetutën dhe të drejtën ndërkombëtare, duke shmangur zbatimin e nenit 145/2 të Kushtetutës, apo thënë ndryshe, duke shmangur nisjen e kontrollit incidental kushtetues të ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese?

ii. Çfarë fuqie juridike kanë konkluzionet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës që konstatojnë përmbushjen e masave të përgjithshme që GJEDNJ-ja ka lënë si detyrë ndaj shtetit në një nga vendimet e saj që ka marrë formë të prerë, nëse pas rezolutës konstatohet se në të vërtetë masat ligjore të marra nga shteti nuk e kanë zbatuar jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe sërish ka shkelje të dispozitave të KEDNJ-së?

iii. A e kanë respektuar jurisprudencën "Dauti kundër Shqipërisë" të GJEDNJ-së ndryshimet e ligjit nr. 7703/1993 në vitin 2011 dhe a e kanë shndërruar ndryshimet e ligjit për sigurimet shoqërore të vitit 2011 KMCAP Epror materialisht në një gjykatë me të gjitha elementet e nenit 6 të KEDNJ-së?

iv. A munden të krijohen organet quasi gjyqësore me ligj me shumicë të zakonshme, duke pasur parasysh rregullimin e nenit 81 të Kushtetutës?

v. A mundet të rregullohet organizimi, funksionimi dhe procedurat e shqyrtimit të organeve quasi gjyqësore me ligje me shumicë të zakonshme apo me akte nënligjore normative?

23. Me vendimin nr. 55, datë 31.3.2021, të Mbledhjes së Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është vendosur moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

24. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se zgjidhja e këtyre çështjeve lidhej më së shumti me interpretimin e ligjit, çka përbën funksion natyral për Gjykatën e Lartë. Ndër të tjera, Mbledhja e Gjyqtarëve e Gjykatës Kushtetuese ka konkluduar, se çështjet e interpretimit të ligjit i përkasin kompetencës së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos Gjykatës së Lartë, si organi më i lartë i sistemit gjyqësor që ka për funksion të përgjithshëm njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore. Shprehja e vënë në dyshim nga gjykata referuese "*formë e prerë*" është përdorur nga legjislacioni procedural edhe në raste të tjera, pa penguar kontrollin gjyqësor deri në Gjykatën e Lartë *(shih ligjin nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar; ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH", të ndryshuar; ligjin 133/2015, "Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave)"*. Po ashtu, ky koncept i është nënshtruar unifikimit nga Gjykata e Lartë në procedura të tjera gjyqësore, në raport me konceptin e vendimit përfundimtar (*shih vendimin unifikues nr. 2, datë 3.11.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

25. Po ashtu, Mbledhja e Gjyqtarëve e Gjykatës Kushtetuese ka theksuar, se, pavarësisht ndryshimeve që ka pësuar në kohë, neni 86 i ligjit nr. 7703/1993, parashikonte dhe vazhdon të parashikojë të drejtën e ankimit gjyqësor të individëve kundër vendimeve administrative që përcaktojnë përfitime të pafavorshme. Në këtë mënyrë, mund të thuhet se ky ligj garanton aksesin në gjykatë të procesit kryesor që përcakton të drejtat e ligjshme të individit dhe për efekte të të cilit zhvillohet procesi administrativ i caktimit të shkallës së aftësisë për punë nga Komisioni Epror. Sipas Gjykatës Kushtetuese, në këtë çështje, Gjykata e Lartë duhet të ushtrojë funksionin e saj, duke vlerësuar brenda kufijve kushtetues, nëse është vendi për njësimin, zhvillimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore.

IV. Gjykimi njësues

26. Përderisa Gjykata Kushtetuese, për pesë çështjet e sipërcituara, të shtruara nga gjykata referuese nuk ka vlerësuar se duhet të ushtrojë përmes rrugës së kontrollit incidental, kontrollin e papajtueshmëria e ligjit me Kushtetutën, atëherë Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë,

- në ushtrim të së drejtës së tij kushtetuese dhe ligjore, që lidhet me funksionin nomofilatik;
- në respektim të standardeve të vendosura nga GJEDNJ-ja, në çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë"*;
- duke pasur parasysh praktikat e ndryshme të gjykatave të niveleve më të ulëta dhe të vetë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë;
- meqenëse përpara Gjykatës së Lartë gjenden për shqyrtim raste të ngjashme, për të cilat duhet të jepet një zgjidhje e njëjtë në interpretimin e ligjit,

në zbatim të neneve 12/3, 58/a dhe 62/a, të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar me ligjin nr. 49/2021 ka konkluduar me vendim të ndërmjetëm se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë gjyqësore, me një trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, për arsye se rekursi ngre shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural, të një rëndësie themelore për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

27. Mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson se çështjet që duhet të shtrohen për njësim janë:

1. A e kanë respektuar jurisprudencën "Dauti kundër Shqipërisë" të GJEDNJ-së ndryshimet e ligjit nr. 7703/1993 në vitin 2011 dhe, a e kanë shndërruar ndryshimet e ligjit për sigurimet shoqërore të vitit 2011 KMCAP Epror materialisht në një gjykatë me të gjitha elementet e nenit 6 të KEDNJ-së?

2. Si duhet interpretuar dhe zbatuar neni 39/1, i ligjit nr. 7703/1993, konkretisht pika 3, në pjesën ku parashikon, se " ... Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë", dhe si qëndron kjo dispozitë në raport me dispozitat e tjera procedurale, ligjore dhe kushtetuese që parashikojnë të drejtën e përgjithshme të ankimit, si e drejtë themelore?

28. Sa më sipër, Kolegji planifikoi çështjen për shqyrtim më datë 22.7.2021 dhe vijoi me procedurën e posaçme, të parashikuar në nenin 62/a të ligjit nr. 49/012, të ndryshuar me ligjin nr. 49/2021.

29. Në këto kushte, u formua trupa gjykuese prej 5 gjyqtarësh, sipas pikës 3, të kësaj dispozite dhe u procedua, mbi vendimin e ndërmjetëm të Kolegjit, me njoftimin individual të palëve, sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit, për sa i përket datës dhe orës së seancës gjyqësore, trupës gjykuese, çështjeve të shtruara për njësim, duke iu lënë palëve afatin minimum prej 15 ditësh, midis njoftimit dhe datës së seancës. Po ashtu, vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ku u pasqyruan çështjet e shtruara për njësim, u publikua në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

V. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

30. Kolegji vlerëson se çështjet e shtruara për njësim kanë një lidhje organike me njëra-tjetrën, ku zgjidhja e çështjes së parë, kushtëzon të dytën. Si rrjedhojë, edhe trajtimi analitik i tyre do të ndjekë të njëjtën renditje. Konkretisht, për të konkluduar mbi mënyrën e interpretimit dhe të zbatimit të nenit 39/1, pika 3, të ligjit nr. 7703/1993, në pjesën ku parashikon, se: "*... vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë*", nëse vendimet e KMCAP Epror janë përfundimtare apo duhet të ushtrohet kontrolli dhe juridiksioni gjyqësor mbi to, fillimisht do të duhet të merret në analizë nëse KMCAP Epror, sipas ligjit nr. 7703/1993, pas ndryshimeve të vitit 2011, plotëson kushtet materiale të një organi *quazi* gjyqësor, në kuptim të nenit 6 të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së GJEDNJ-së.

I. Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim:

A e kanë respektuar vendimin "Dauti kundër Shqipërisë" të GJEDNJ-së ndryshimet e ligjit nr. 7703/1993, të kryera në vitin 2011 dhe, a e kanë shndërruar ndryshimet e ligjit për sigurimet shoqërore të vitit 2011 KMCAP Epror, materialisht, në një gjykatë me të gjitha elementet e nenit 6 të KEDNJ-së?

31. Për të konkluduar mbi këtë çështje, Kolegji çmon të marrë në analizë ndryshimet që ka pësuar, ndër vite, ligji nr. 7703/1993, nën një vështrim historik dhe krahasimor me dispozitat ligjore në fuqi, të para këto nën dritën e jurisprudencës relevante të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim "GJEDNJ").

32. Neni 35 i ligjit nr. 7703/1993 është ndryshuar fillimisht me ligjin nr. 7932, datë 17.5.1995. Pjesa relevante e kësaj dispozite parashikonte deri në vitin 2011, se: "*Kundër vendimit të KMCAP-së të rrethit, personi mund të ankohet në KMCAP-në Epror pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, vendimi i të cilit, për sa i përket aftësisë për punë, është i formës së prerë. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve caktohen me rregullore të ISSH-së dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.*"

33. Pra, sipas kësaj dispozite, të zbatueshme gjatë kohës që është zhvilluar procedimi administrativ për rastin konkret, parashikohej, ndër të tjera, se KMCAP Epror është organi administrativ më i lartë që përcakton paaftësinë për punë, masën e invaliditetit dhe, për rrjedhojë, edhe masën e pensionit për shkak të paaftësisë në punë. Në këto raste, vendimi i KMCAP Epror tregon shkaqet e paaftësisë për punë, datën e fillimit dhe shkallën e paaftësisë. Në çdo rast, vendimi i KMCAP Epror nuk mund të ankimohej gjyqësisht, pasi ligji e parashikonte si një akt të formës së prerë dhe të pakundërshtueshëm gjyqësisht.

34. Në atë kohë, ligji nr. 7703/1993 nuk kishte rregulla organike që të përcaktonin organizimin dhe funksionimin e KMCAP Epror. Neni 35 i ligjit, ndër të tjera, parashikonte se rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-ve caktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

35. Rregullorja e përbashkët e datës 13 korrik 1995 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe e Ministrisë së Shëndetësisë mbi organizimin, të drejtat dhe detyrat, si dhe funksionimin e KMCAP-ve rajonale dhe KMCAP Epror parashikonte, ndër të tjera, se këto organe raportojnë për punën e tyre para Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Lidhur me kompozimin e këtyre organeve parashikohej se komisionet rajonale përbëheshin nga tre ose pesë mjekë të specializuar nga fushat e kardiologjisë, neurologjisë, psikiatrisë, patologjisë etj., që kanë të paktën pesë vjet eksperiencë, përveç mjekut të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Anëtarët e lartpërmendur emëroheshin për një periudhë të pacaktuar kohe nga drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore. Në këto raste, emërimi miratohej nga titullari i njësisë së shëndetit, nën mbikëqyrjen e të cilit punojnë mjekët e emëruar dhe se çdo ndryshim anëtarësh duhet të merrte miratimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Rregullorja parashikonte se komisioni rajonal shqyrtonte kërkesën e ankimuesit, dokumentet mjekësore dhe financiare, paaftësinë e personit për punë dhe nivelin e paaftësisë. Ky organ vendoste për shkakun e paaftësisë, kohën e fillimit, kohëzgjatjen dhe

mundësinë e rishqyrtimit/rishikimit dhe trajnimin fizik dhe në punë.

36. Ndërkohë, KMCAP Epror shqyrtonte ankimet kundër vendimeve të komisioneve rajonale. KMCAP Epror, sipas rregullores, përbëhej nga mjekë të specializuar në fushën e kardiologjisë, neurologjisë, psikiatrisë dhe patologjisë dhe anëtarësia në këtë komision duhet të merrte miratimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Ministrisë së Shëndetësisë. Rregullorja parashikonte se KMCAP kryesohej nga titullari i njësisë së shëndetit. As në ligj dhe as në aktet nënligjore nuk kishte dispozita që të parashikonin rregullime për shkaqet e largimit nga detyra apo të mbarimit të mandatit të anëtarëve të KMCAP Epror. Gjithashtu, nuk kishte dispozita që të rregullonin garancitë e qëndrimit në detyrë për anëtarët e këtij komisioni apo mekanizma *restitutio in integrum,* në rast të largimit të padrejtë nga detyra.

37. Në jurisprudencën "*Dauti kundër Shqipërisë*", GJEDNJ-ja ka marrë në analizë dhe interpretuar nëse KMCAP Epror, me karakteristikat e rregullimit ligjor dhe nënligjor si më lart, është apo jo gjykatë ose tribunal, në kuptimin autonom që jurisprudenca e saj i ka njohur nenit 6 të KEDNJ-së. Në këtë vendim, ndër të tjera, GJEDNJ-ja ka arsyetuar:

"*46. Ndërsa neni 6§1 parashikon "të drejtën për në gjykatë", ai nuk i detyron shtetet kontraktuese t'ia nënshtrojnë mosmarrëveshjet në lidhje me të "drejtat dhe detyrimet civile", një procedure të zhvilluar në të gjitha fazat e saj para "gjykatave" që përmbushin kërkesat e ndryshme të nenit. Nevoja për fleksibilitet dhe eficiencë, që janë plotësisht në pajtim me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mund ta justifikojnë ndërhyrjen fillestare të organeve administrative ose profesionale dhe, aq më tepër, të organeve gjyqësore që nuk përmbushin këto kërkesa në çdo aspekt. "E drejta për në gjykatë" mbulon çështjet e faktit po aq sa edhe çështjet e ligjit (shih Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere v. Belgium, 23 qershor 1981, §51, seria A nr. 43).*

47. Gjykata vëren, se, në bazë të nenit 6§1 të Konventës, është e nevojshme që vendimet e organeve administrative që nuk përmbushin vetë kërkesat e këtij neni duhet t'i nënshtrohen kontrollit pasues të një "organi gjyqësor që ka juridiksion të plotë" (shih për shembull, Ortenberg v. Austria, 25 nëntor 1994, §31, seria A nr. 295-B, dhe Crisan v. Rumania, nr. 42930/98, §24, 27 maj 2003) ...

51. Me qëllim që të përcaktohet nëse një gjykatë konsiderohet e pavarur, duhet t'i kushtohet vëmendje, ndër të tjera, mënyrës së emërimit të anëtarëve të saj dhe mandatit në detyrë, ushtrimit të garancive ndaj presioneve të jashtme dhe çështjes nëse organi ka shprehjen e pavarësisë (shih, ndër të tjerash, Morris v. Mbretërisë së Bashkuar nr. 38784/97, § 58, KEDNJ 2002-I).

52. Gjykata vëren që Komisioni i Ankimeve përbëhet tërësisht nga mjekë në detyrë, të emëruar nga ISSH-ja dhe të aprovuar së fundi nga Ministria e Shëndetësisë, nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e së cilës mjekët punojnë. Në Komisionin e Ankimeve nuk ka anëtarë të kualifikuar ligjorë apo gjyqësorë (shih, për kontrast, Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere të përmendur më sipër, §58).

53. Ligji dhe rregulloret e brendshme nuk përmbajnë rregulla që të rregullojnë mandatin e anëtarëve në detyrë, largimin e tyre, dorëheqjen apo ndonjë garanci për patundshmërinë e tyre. Rregullat statusore nuk parashikojnë mundësinë e betimit të bërë nga anëtarët e tij. Duket sikur ata mund të largohen në çdo moment nga detyra, sipas dëshirës së ISSH-së ose Ministrisë së Shëndetësisë, që ushtrojnë diskrecion të pakufizuar. Pozicioni i anëtarëve të komisionit të ankimeve është i hapur ndaj presioneve të jashtme. Një situatë e tillë e minon pamjen e pavarësisë.

54. Nga sa më sipër, gjykata konsideron që Komisioni i Ankimeve nuk mund të konsiderohet si një "gjykatë e pavarur dhe e paanshme", siç kërkohet në nenin 6§1 të Konventës.

55. Duke pasur parasysh faktin që komisioni i ankimeve nuk përbën një "gjykatë të pavarur dhe të paanshme" dhe që vendimet e tij, sipas ligjit në fuqi në këtë kohë, nuk mund të kundërshtohen para një gjykate vendëse, gjykata konkludon që ka pasur shkelje të së drejtës së ankimuesit për t'iu drejtuar gjykatës sipas nenit 6§1 të Konventës" (*shih çështjen "Dauti kundër Shqipërisë", ap. nr. 19206/05, vendimi i GJEDNJ-së datë 3.2.2009).*

38. Ky vendim i GJEDNJ-së ka marrë formë të prerë më datë 3.5.2009. Thelbi i vendimmarrjes së GJEDNJ-së në çështjen e sjellë në vëmendje më sipër ishte, se, sipas nenit 6 të KEDNJ-së, shtetet kontraktuese, duke përfshirë këtu edhe Republikën e Shqipërisë, kanë hapësirë për të krijuar edhe organe alternative *"për shqyrtimin e të drejtave dhe të detyrimeve civile"*, që nuk janë gjykata në kuptimin formal, por që materialisht dhe në mënyrë ekuivalente, plotësojnë të gjitha elementet e organit të caktuar me ligj, paanësisë dhe pavarësisë. Në të kundërt, duhet domosdoshmërish të njihet ankimi dhe aksesi në gjykatë, ndaj vendimmarrjes së tyre.

39. Nga kjo jurisprudencë e detyrueshme ndërkombëtare rezulton të jenë vendosur detyra dyplanëshe për Republikën e Shqipërisë. Në planin individual, pala paditëse në këtë proces duhet të kompensohej dhe të rishikoheshin vendimet gjyqësore vendëse, që kishin refuzuar proceduralisht shqyrtimin e padisë. Në planin e përgjithshëm, Shqipëria detyrohej të ndryshonte paragrafin e katërt të nenit 35, të ligjit nr. 7703/1993, që do të thotë të lejonte kundërshtimin në gjykatë të vendimeve të KMCAP Epror. Nëse kjo nuk do të ndodhte, do të duhej që Shqipëria të shndërronte me ligj, KMCAP Epror në një gjykatë apo tribunal me të gjitha karakteristikat jurisprudenciale dhe autonome të nenit 6, të KEDNJ-së, që GJEDNJ-ja i ka elaboruar ndër vite.

40. Në vitin 2011, Kuvendi miratoi ndryshime ligjore në ligjin nr. 7703/1993. Ndryshimet u destinuan dhe u synuan të zbatonin detyrat e përgjithshme të vendimit "*Dauti kundër Shqipërisë*". Në mënyrë të detajuar, të gjitha ndryshimet ligjore, Kolegji do t'i marrë në analizë në vijim.

41. Në raportin e veprimit datë 3.5.2013 të Sekretariatit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, pasi bëhet një pasqyrim i ndryshimeve ligjore të vitit 2011 për adresimin e zgjidhjes mbi zbatimin e përgjithshëm të vendimit të GJEDNJ-së në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*", në pikën 10 të tij konkludohet se shqetësimi i ngritur nga GJEDNJ-ja, se KMCAP Epror nuk përbënte një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, ka gjetur zgjidhje nëpërmjet amendamenteve ligjore të miratuar në ligjin nr. 7703/1993 të vitit 2011. Më tej, në pikën 11 të raportit, konkludohet se zgjidhja finale e vendimit të GJEDNJ-së, në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*" është arritur edhe në planin e përgjithshëm, edhe në planin individual *(shih raportin datë 3.5.2013 të Sekretariatit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, DH-DD(2013)506, nga mbledhja e datës 4–6 qershor 2013 ("Execution of the judgment of the European Court of Human Rights Dauti v. Albania (19206/05), judgment of 03/02/2009, final on 03/05/2009").*

42. Në këtë pikë të analizës, për Kolegjin u shtrua për zgjidhje çështja se çfarë fuqie juridike kanë konkluzionet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës që konstatojnë përmbushjen e masave të përgjithshme që GJEDNJ-ja ka lënë si detyrë ndaj shtetit në një nga vendimet e saj që ka marrë formë të prerë, në rast se pas rezolutës konstatohet, se, në të vërtetë, masat ligjore të marra nga shteti nuk e kanë zbatuar jurisprudencën e GJEDNJ-së, duke lejuar vijimin e shkeljeve të dispozitave të KEDNJ-së.

43. Kolegji vlerëson se, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, i përbërë, si rregull, nga ministrat e jashtëm të vendeve anëtare të kësaj organizate, është një ndër organet vendimmarrëse dhe ekzekutive kryesore të Këshillit të Evropës. Sipas nenit 20 të Statutit të Këshillit të Evropës, Komiteti i Ministrave mund të nxjerrë vendime, rekomandime, rezoluta apo edhe kërkesa gjatë ushtrimit të detyrave që i janë caktuar. Ndërkohë, neni 46 i KEDNJ-së i ka ngarkuar Komitetit të Ministrave detyrën e mbikëqyrjes së ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së nga shtetet anëtare, ndaj të cilave ato janë dhënë, qoftë për masat individuale dhe qoftë për masat e përgjithshme.

44. Neni 46 i KEDNJ-së ka parashikuar se vendimet e formës së prerë të GJEDNJ-së i kalojnë Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr përmbushjen e tyre. Nga rregullimi i pikës 5 të kësaj dispozite del se, nëse Komiteti i Ministrave vlerëson se vendimi i GJEDNJ-së është zbatuar në masat individuale dhe të përgjithshme, atëherë vendoset mbyllja e shqyrtimit të çështjes. Në rastin konkret, sikurse është pasqyruar më lart, del se Komiteti i Ministrave, në vitin 2013, pasi ka marrë në shqyrtim cilësinë e ndryshimeve ligjore të vitit 2011, në ligjin nr. 7703/1993, ka konkluduar se masat e përgjithshme të vendimit "*Dauti kundër Shqipërisë*" të GJEDNJ-së janë përmbushur dhe, mbi këtë bazë, është vendosur mbyllja e shqyrtimit të çështjes së regjistruar, si pasojë e ekzekutimit të këtij vendimi të formës së prerë.

45. Kolegji thekson se duhet të mbahet parasysh rregullimi i nenit 17 të Kushtetutës, dispozitë që i ka parashikuar standardet ndërkombëtare të KEDNJ-së, si një kufi minimum të kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Nga kjo konkludohet se Republika e Shqipërisë është e lirë dhe e pakondicionuar nga e drejta ndërkombëtare që të njohë standarde më të larta se sa ato që janë parashikuar në KEDNJ dhe të formësuara, ndër vite, nga jurisprudenca e GJEDNJ-së. Për rrjedhojë, nga neni 17 i Kushtetutës del konkluzioni se gjykatat shqiptare, sikurse edhe Gjykata Kushtetuese, janë të lira të pranojnë standarde më të larta të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut se sa ato që rrjedhin prej Këshillit të Evropës.

46. Pavarësisht rolit të rëndësishëm që i jepet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës në mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave të përgjithshme që rrjedhin nga vendimet e formës së prerë të GJEDNJ-së, nuk mundet që këtij institucioni t'i njihet edhe autoriteti gjyqësor i vetë GJEDNJ-së, i gjykatave kushtetuese apo edhe i gjykatave vendëse të pushtetit gjyqësor. Kjo do të thotë, se, pavarësisht konkluzioneve të arritura, rast pas rasti, nga ana e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, mbi ekzekutimin e masave të përgjithshme të vendimeve të formës së prerë të GJEDNJ-së prej shteteve anëtare, konkluzioni nëse këto masa përmbushin cilësisht standardet kushtetuese dhe konventore mbeten në pushtetin e natyrshëm dhe sovran të pushtetit gjyqësor, gjykatave kushtetuese dhe vetë GJEDNJ-së. Në këtë këndvështrim, konkludohet se nuk mund t'i njihet Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës një pushtet i tillë juridik që të zëvendësojë dhe njëkohësisht t'i imponohet gjykatave të zakonshme, gjykatave kushtetuese dhe vetë GJEDNJ-së.

47. Duke mbajtur parasysh sa më lart u analizua Kolegji arrin në përfundimin, se, edhe në rastin konkret, nuk mundet të imunizohet kontrolli i kushtetutshmërisë apo konvencionalitetit të ndryshimeve të ligjit nr. 7703/1993, vetëm nga fakti se Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës ka konkluduar se masat e

përgjithshme të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë, në vitin 2011, e kanë përmbushur jurisprudencën "*Dauti kundër Shqipërisë*". Për shkak të statusit kushtetues që ka KEDNJ-ja, nuk mund të pengohen gjykatat e zakonshme të shmangin zbatimin e një ligji të brendshëm, kur vlerësojnë se është në kundërshtim me të.

i. Jurisprudenca e GJEDNJ-së, e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës së Lartë mbi quazi gjykatat

48. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë për organet *quazi* gjyqësore.

49. Terminologjinë e *quazi* gjykatës e ka përdorur Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, fillimisht, për të shquar kompetenca *quazi gjyqësore* të organeve kushtetuese, të cilat nuk janë pjesë e pushtetit gjyqësor, konkretisht të komisioneve hetimore parlamentare, të ngritura sipas nenit 77 të Kushtetutës *(shih vendimin nr. 18, datë 14.5.2003 dhe vendimin nr. 21, datë 1.8.2008, të Gjykatës Kushtetuese)*. Gjykata Kushtetuese ka pranuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e krijimit nga ligji të organeve *quasi* gjyqësore *(shih vendimin nr. 27, datë 26.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese)*, të cilat paraqiten me karakteristikat e qenësishme, herë të organeve administrative dhe herë të organeve gjyqësore. Kjo jurisprudencë, në vijim të qëndrimeve të mbajtura ndër vite edhe nga GJEDNJ-ja, ka njohur si organe *quasi* gjyqësore komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronës, që organizoheshin dhe funksiononin përmes ligjit të parë të kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve *(shih ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993, "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve")*. Nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese nuk ka njohur statusin e organit *quasi* gjyqësor të Agjencisë së Kthimit të Pronave *(shih vendimin nr. 43, datë 6.10.2011, të Gjykatës Kushtetuese)* dhe të Agjencisë së Trajtimit të Pronave *(shih vendimin nr. 1, datë 16.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese)*, të krijuar si institucion në vitin 2015, pasi ka konkluduar se varësia e tyre te ministri i Drejtësisë nuk përmbush elementin e pavarësisë së këtyre organeve. Gjykata Kushtetuese nuk ka vënë në diskutim më parë cilësinë dhe procedurën që duhet të ketë ligji organik që krijon, rregullon dhe parashikon mënyrën e funksionimit të organeve *quasi* gjyqësore, si dhe procedurat e shqyrtimit të tyre.

50. Konceptin e organeve *quazi* gjyqësore e ka elaboruar edhe Gjykata e Lartë. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet një vendimi unifikues, kanë arritur në konkluzionin se Komisioni i Shërbimit Civil është një organ *quazi* gjyqësor *(shih vendimin unifikues nr. 3, datë 24.1.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë)*. Në këtë rast, Kolegjet e Bashkuara kanë vlerësuar se pavarësia që ky institucion gëzonte në ushtrimin e detyrës nga pushteti legjislativ dhe ekzekutiv, garancitë ligjore të qëndrimit në detyrë, elementet e parashikuara në ligjin me shumicë të cilësuar prej tre të pestave të deputetëve për miratimin e strukturës organizative, të vendeve të punës dhe buxhetit i japin Komisionit të Shërbimit Civil të gjitha tiparet e një organi administrativ, të pavarur dhe të ngarkuar me zgjidhjen e ankimeve ndaj vendimeve lidhur me nëpunësin civil dhe, gjithashtu, i japin atij të gjitha tiparet e një arbitri administrativ, apo të një trupe (organi) me funksion dhe kompetenca *quasi* gjyqësore.

51. Në vazhdën e këtij arsyetimi, Kolegjet e Bashkuara kanë konkluduar se ankimet gjyqësore të vendimeve të Komisionit të Shërbimit Civil nuk e shndërrojnë atë palë ndërgjyqëse, pasi palët janë punëmarrësi dhe punëdhënësi dhe se ky organ *quasi* gjyqësor nuk mund të ankimojë vendimet e gjykatës së shkallës së parë apo të apelit që cenojnë vendimet e tij. Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë konkluduar se edhe vendimi i pushimit të çështjes nga ana e prokurorit, para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale të vitit 2017, është një vendim *quasi* gjyqësor *(shih vendimin unifikues nr. 2, datë 20.6.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë)*.

52. Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk e kanë vënë në diskutim çështjen nëse aktet nënligjore me karakter normativ mund të rregullojnë çështje themelore të së drejtës procedurale mbi shqyrtimin e ankimeve apo kërkesave të individëve nga organet *quazi* gjyqësore. Për më tepër, Kolegjet e Bashkuara në këtë jurisprudencë njësuese e pranojnë pa asnjë mëdyshje zbatimin e rregullores së brendshme të Komisionit të Shërbimit Civil që parashikonte rregullat procedurale të shqyrtimit të ankimeve si organ *quasi* gjyqësor *(shih vendimin unifikues nr. 3, datë 24.1.2007, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë)*.

53. Gjykata e Lartë, në disa çështje të shqyrtuara përmes ankimeve të veçanta të subjekteve paditës kundër vendimeve të gjykatave të shkallës së parë administrative, që kanë nxjerrë nga juridiksioni gjyqësor paditë kundër vendimeve të KMCAP Epror, ka mbajtur qëndrimin se karakteristikat e sjella nga ndryshimet që iu bënë ligjit nr. 7703/1993 në vitin 2011, e kanë bërë KMCAP Epror një organ *quazi* gjyqësor, duke konkluduar se ndaj këtyre vendimeve nuk mund të ushtrohet padi në gjykatë, sipas pikës 3, të nenit 39/1 të ligjit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar ndër të tjera:

"*... karakteristikat e përcaktuara në dispozitat e mësipërme, i japin Komisionit Epror të Caktimit të Aftësisë për Punë, natyrë quasi gjyqësore, rrjedhimisht edhe vendimet e tij janë të formës së prerë dhe nuk mund të shqyrtohen nga gjykata.*

10. Në rastin në gjykim, gjykata administrative e shkallës së parë ka zbatuar keq ligjin. Duke arsyetuar si më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se çështja objekt gjykimi nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor dhe Gjykata

Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk është kompetente në lëndë për gjykimin e saj." *(Shih vendimin nr. 00-2017-1934, datë 29.6.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.)*

54. Ndërkohë, GJEDNJ-ja, sipas jurisprudencës konstante të saj, mban qëndrimin se, nëse një organ administrativ i ngarkuar për të shqyrtuar mosmarrëveshjet mbi të "*drejtat dhe detyrimet me karakter civil*" nuk përmbush të gjitha kërkesat e nenit 6, pika 1, nuk ka shkelje të Konventës nëse procedura para këtij organi ka qenë objekt kontrolli përfundimtar në një organ gjyqësor me juridiksion të plotë, i cili mbart të gjitha garancitë e kësaj dispozite *(shih çështjen "Ramos Nunes de Carvalho e Sá c. Portugal", Req. nos 55391/13 et 2 autres, vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, datë 6.11.2018, paragrafi 132. Gjithashtu, shih çështjen "Vera Fernández-Huidobro c. Espagne", Req. no 74181/01, vendim i GJEDNJ-së, datë 6.1.2010, paragrafi 131).* Megjithatë, nëse një kontroll i tillë materialisht gjyqësor nuk lejohet nga ligji dhe organi administrativ nuk përmbush kushtet materiale për t'u kualifikuar si gjykatë, atëherë mosparashikimi i kontrollit gjyqësor passjell shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së *(shih çështjen "Peleki c. Grece", Req. no. 69291/12, vendim i seksionit të GJEDNJ-së, datë 5.3.2020, paragrafi 59–60).*

55. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se edhe një organ administrativ dhe jogjyqësor klasik apo jo i integruar në pushtetin gjyqësor mund të kualifikohet si gjykatë apo tribunal në konceptin autonom të nenit 6 të KEDNJ-së *(shih çështjen "Ali Riza and others v. Turkey")*, edhe pse ai e ka juridiksionin e kufizuar, për shkak të lëndës së gjykimit *(shih çështjen "Rolf Gustafson c. Sueden"*. Karakteristikat kryesore që duhet të përmbushë një organ i tillë, që të kualifikohet si tribunal janë: krijimi i tyre nga pushteti ligjvënës; organizimi dhe funksionimi i tyre të rregullohet nga ligji; ligji duhet të ofrojë garanci materiale dhe procedurale për pavarësinë dhe paanësinë e trupës gjykuese, qoftë nga pushteti ekzekutiv dhe qoftë nga vetë palët (*shih çështjen "Beaumartin v. France", vendim i GJEDNJ-së datë 24.11.1994, paragrafi 38, Series A no. 296 B dhe çështjen "Di Giovanni v. Italy", Ap. no. 51160/06, vendim i GJEDNJ-së datë 9.7.2013, paragrafi 52);* juridiksion i plotë mbi ligjin dhe faktin në shqyrtimin e çështjes, sikurse është në kuptimin material juridiksioni i gjykatave klasike *(shih çështjen "Cyprus v. Turkey", Ap. no. 25781/94, vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, datë 10.5.2001, paragrafi 233, ECHR 2001 IV);* parashikimi i rregullave procedurale për garantimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor të procedurës së gjykimit (*shih çështjen "Benthem v. the Netherlands", vendim i GJEDNJ-së datë 23.10.1985, paragrafi 40, series A no. 97).*

56. Gjithashtu, jurisprudenca e GJEDNJ-së ka konfirmuar se mungesa e presionit të jashtëm dhe të brendshëm e një tribunali apo organi *quasi* gjyqësor duhet të konkludohet në mënyrë të tillë që të përjashtojë mundësinë e cenimit të pavarësisë dhe paanësisë së trupës gjykuese, në mënyrë që të mos cenohet besimi që në një shoqëri demokratike gjykata duhet të transmetojë te publiku *(shih çështjen "Morice v. France", Ap. no. 29369/10, vendim i Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, datë 23.4.2015, paragrafi 78, ECHR 2015 dhe çështjen "Oleksander Volkov v. Ukraine", Ap. no. 21722/11, vendim i GJEDNJ-së, datë 9.1.2013, paragrafi 106).* Në këtë mënyrë, vlerësohet se elementi i pavarësisë dhe i paanësisë së trupës gjykuese është konstitutiv dhe thelbësor në procesin e vlerësimit, nëse një autoritet publik përbën apo jo gjykatë, në kuptimin autonom të nenit 6 të KEDNJ-së *(shih "Guide sur l'article 6 de la Convention européenne des droits de l'homme. Droit à un procès équitable (volet civil)", publikim zyrtar i GJEDNJ-së, përditësuar deri në 30.4.2020, faqe 37).*

57. Gjithashtu, në vlerësimin e kësaj çështje duhet të mbahet parasysh edhe jurisprudenca relevante e Gjykatës Kushtetuese mbi nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e së drejtës për gjykim dhe se kjo e drejtë kushtetuese, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Kjo jurisprudencë vlerëson se shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë, duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit *(shih vendimin nr. 10, datë 4.4.2007, të Gjykatës Kushtetuese)* dhe se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit), nënkupton të drejtën që ka çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen *(shih vendimin nr. 10, datë 11.5.2006, të Gjykatës Kushtetuese).*

58. Për të konkretizuar këto vlerësime të përgjithshme jurisprudenciale, të parashtruara më lart, Kolegji e vlerëson të nevojshme të analizojë nëse KMCAP Epror, si një organ i administratës publike, përmbush kushtet dhe kriteret material për t'u konsideruar *quazi* gjykatë, për efekt të nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 42 të Kushtetutës. Për këtë arsye, duhet të analizohen dhe të interpretohen dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë juridiksionin, kompetencën, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të tyre.

ii. Përmbushja e elementit të paanësisë dhe pavarësisë

59. Kolegji sjell në vëmendje sërish, disa nga konkluzionet e GJEDNJ-së, në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*", sipas së cilës KMCAP Epror, para ndryshimeve ligjore të vitit 2011, nuk plotësonte standardet e nenit 6 të KEDNJ-së për t'u kualifikuar si një gjykatë apo tribunal. Rezervat e GJEDNJ-së në këtë vendim ishin, ndër të

tjera, se nuk ishte mirërregulluar mënyra e emërimit në detyrë e anëtarëve; mungesa e parashikimit ligjor për kohëzgjatjen e mandatit; mungesa e parashikimeve ligjore për mbarimin e mandatit; emërimi dhe vënia nën autoritetin dhe mbikëqyrjen e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrisë së Shëndetësisë; mungesa e anëtarit jurist në komision; mungesa e garancive nga ushtrimi i presionit dhe i ndikimit të organeve të emërtesës dhe të mbikëqyrjes; mungesa e parashikimeve në ligj apo në rregullore për patundshmërinë e anëtarëve nga detyra dhe ushtrimi i diskrecionit të pakufizuar të organeve të emërtesës dhe të mbikëqyrjes për largimin nga detyra të anëtarëve; mungesa e parashikimit në ligj për betimin e anëtarëve para marrjes në detyrë; mungesa e pavarësisë së KMCAP Epror.

60. Këto shkelje të evidentuara nga GJEDNJ të çojnë paraprakisht në përfundimin se të gjitha vendimet e KMCAP Epror, që referojnë në paragrafin e katërt të nenit 35 të ligjit nr. 7703/1993 (para hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të vitit 2011), janë marrë nga një organ administrativ që nuk ka garancitë kushtetuese dhe konventore të një organi *quazi* gjyqësor. Ky konkluzion është gjë e gjykuar dhe i detyrueshëm për Shqipërinë (shih nenin 5 të Kushtetutës), për shkak të vendimmarrjes së formës së prerë të GJEDNJ-së në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*". Në rrethana të tilla, në bazë dhe për zbatim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, do të duhet që ligji të lejojë dhe të krijojë një mjet ankimi efektiv në një gjykatë kundër vendimeve të KMCAP Epror *(shih për analogji konkluzionet dhe arsyetimin e çështjes "Ortenberg v. Austria", vendim i GJEDNJ-së, datë 25.11.1994, paragrafi 31, seria A nr. 295-B. Shih, gjithashtu, dhe çështjen "Crisan v. Rumania", kërkesa nr. 42930/98, vendim i GJEDNJ-së datë 27.5.2003, paragrafi 24).*

61. Mbi bazën e kësaj analize, mbetet të vlerësohet nga Kolegji, *<u>nëse ndryshimet ligjore të vitit 2011 e kanë formatuar KMCAP Epror si një organ quazi gjyqësor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së e të Gjykatës Kushtetuese mbi konceptin autonom të gjykatës apo tribunalit, sipas standardeve të së drejtës për proces të rregullt ligjor?</u>*

62. Neni 35 i ligjit nr. 7703/1993, i ndryshuar, që është në fuqi aktualisht, përcakton ndër të tjera se invaliditeti caktohet nga KMCAP Epror dhe se në vendimin e tij shënohen shkaqet e invaliditetit, koha e fillimit të tij, si dhe shkalla e humbjes së aftësisë në punë, duke konkluduar njëherazi mbi juridiksionin dhe mbi kompetencën e këtij organi. Kjo do të thotë se ligji, si akt normativ formal, i miratuar nga Kuvendi, ka përcaktuar organin, juridiksionin dhe kompetencën e tij.

63. Ligji parashikon se shqyrtimi i sëmundjes, shkalla e invaliditetit dhe koha e fillimit të invaliditetit përcaktohet në dy shkallë shqyrtimi, fillimisht nga KMCAP rajonal dhe, më tej, nga KMCAP Epror. Ky i fundit është organi që shqyrton ankimet ndaj shkallës së parë të shqyrtimit administrativ. Kjo dispozitë parashikon se rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisioni Epror caktohen në këtë ligj, ndërsa rregullat për organizimin dhe funksionimin e KMCAP-së të nivelit të parë caktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

64. Neni 39/1 i ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar në vitin 2011, i cili aktualisht është në fuqi, parashikon:

"*1. Kundër vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të nivelit të parë, personi mund të bëjë ankim brenda 30 ditëve në Komisionin Epror Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (më poshtë "Komisioni Epror");*

2. Ankimi paraqitet në formën e parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

3. Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë.".

65. Neni 39/2 i ligjit nr. 7793/1993 parashikon përbërjen e KMCAP-së Epror me 5 anëtarë, të cilët zgjidhen në detyrë me vendim të Këshillit të Ministrave. Kryetari dhe 3 anëtarët e Komisionit Epror zgjidhen me propozim të përbashkët të ministrit të Financave, ministrit që mbulon fushën shëndetësore dhe ministrit që mbulon çështjet sociale, procedurë emërimi në të cilën ministrat respektivë propozojnë dy kandidatura për çdo vend të anëtarit të Komisionit Epror. Ndërkohë, dispozita parashikon se anëtari i pestë i Komisionit Epror propozohet nga ministri i Drejtësisë, me kandidaturë alternative, me profesion jurist dhe me përvojë në fushën gjyqësore.

66. Pika 3 e nenit 39/2 parashikon se anëtar i Komisionit Epror mund të emërohet shtetasi që përmbush këto kritere:

a) të jetë me gradë shkencore "profesor", "profesor i asociuar" ose "Doktor shkencash";

b) të ketë përvojë profesionale prej jo më pak se 10 vjet punë në fushën e vet të ekspertizës;

c) të mos jetë i dënuar penalisht;

ç) të ketë një figurë të pastër morale.

67. Në ndryshim nga parashikimi i mëparshëm, KMCAP Epror, në përbërjen dhe konstituimin e tij nuk rregullohet nga aktet nënligjore normative, por nga ligji dhe për sa kohë ligji shteron në parashikime, atëherë rregullimi i organizimit dhe funksionimit të këtij organi realizohet me një vendim të Këshillit të Ministrave, i cili është një akt nënligjor normativ. Kështu, pika 4 e nenit 39 të ligjit parashikon se rregullat e detajuara për

organizimin dhe funksionimin e KMCAP Epror, si dhe masa e shpërblimit mujor të tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

68. Më tej, në nenet 39/3 dhe 39/4 rregullohet me ligj vijueshmëria e mandatit të anëtarëve të KMCAP Epror dhe lëvizshmëria e tyre nga detyra. Ligji parashikon se anëtari i KMCAP Epror ka mandat 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje dhe se anëtari i KMCAP Epror e ushtron këtë detyrë me kohë jo të plotë. Ligji ka parashikuar se secili prej anëtarëve të KMCAP Epror e ushtron funksionin në mënyrë të pavarur dhe në përputhje me bindjen e tij profesionale.

69. Me qëllim përmbushjen e një prej detyrimeve, që rrjedh nga vendimi *"Dauti kundër Shqipërisë"*, neni 39 i ligjit ka rregulluar edhe procedurën e betimit të anëtarëve të KMCAP Epror. Në të parashikohet, se përpara fillimit të detyrës, anëtari i KMCAP Epror kryen betimin në një ceremoni publike, të organizuar nga ministri i Financave, ministri që mbulon fushën e shëndetësisë dhe ministri që mbulon fushën e çështjeve sociale. Ligji ka parashikuar se teksti i betimit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

70. Neni 39/4 i këtij ligji ka rregulluar mbarimin e mandatit të anëtarëve të KMCAP Epror para kohe, duke përcaktuar se mandati mbaron, para kohe, kur:

a) dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

b) nuk paraqitet, pa arsye, në detyrë për më shumë se dy mbledhje radhazi;

c) jep dorëheqjen;

ç) deklarohet i paaftë me vendim gjykate të formës së prerë.

71. Lidhur me mbarimin e mandatit, nëpërmjet shkarkimit nga detyra, ligji parashikon se anëtari i KMCAP Epror shkarkohet me vendim nga Këshilli i Ministrave:

a) për shkelje të dispozitave të këtij ligji apo akteve të tjera ligjore;

b) kur kryen veprimtari, që krijon konflikt interesash.

72. Për të përcaktuar mënyrën se si organizohen, si funksionojnë komisionet eprore dhe mënyrën e shpërblimit të tyre është miratuar dhe ka hyrë në fuqi vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 10.6.2015, "*Për organizimin, funksionimin dhe shpërblimin e komisioneve eprore të caktimit të aftësisë për punë*" (në vijim "VKM nr. 505).

73. Rezulton se rregullimet e mëtejshme janë parashikuar të bëhen me VKM-në nr. 505. Në pikën 1 të këtij akti nënligjor normativ përcaktohet edhe juridiksioni dhe kompetenca e këtyre organeve. Sipas pikës 2 të VKM-së nr. 505, do të ketë 10 komisione eprore, nga të cilat 6 komisione eprore ngrihen dhe funksionojnë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe 4 pranë Shërbimit Social Shtetëror. Ato janë konceptuar si struktura kolegjiale, juridiksioni dhe kompetenca e të cilave është shqyrtimi i ankesave të personave të interesuar, lidhur me vendimet e marra nga komisionet e nivelit të parë për vlerësimin e gjendjes shëndetësore dhe të aftësive për punë, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 7703/1993.

74. Në pikën 3 të këtij akti nënligjor është parashikuar se anëtari i KMCAP Epror, pas zgjedhjes në detyrë dhe përpara fillimit të ushtrimit të detyrës betohet në një ceremoni publike, të organizuar nga ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministri i Shëndetësisë, ministri i Financave dhe ministri i Drejtësisë, sipas tekstit të dhënë në aneksin 2 të këtij vendimi. Ndërkohë, për të gjithë anëtarët dhe kryetarët e komisioneve eprore është parashikuar se nuk angazhohen në detyrat e përditshme të ushtrimit të profesionit të tyre, si dhe punojnë me kohë të plotë gjatë ditëve që janë të mbledhur në Komision, pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore/Shërbimit Social Shtetëror. VKM-ja nr. 505 ka parashikuar se anëtarët dhe kryetarët e komisioneve shpërblehen sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave për masën e shpërblimit të organeve kolegjiale *(shih vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 27.6.2012, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore").*

75. VKM-ja nr. 505 ka rregulluar edhe procedurën, nën të cilën formësohen vendimmarrjet e KMCAP Epror, duke parashikuar njëkohësisht edhe rregulla mbi ankimin e vendimeve të komisioneve rajonale dhe të nivelit të parë te komisionet eprore. Nga rregullimet normative nënligjore kuptohet se KMCAP epror duhet ta shqyrtojë ankimin sipas ritit plenar dhe se pala ankimuese ka të drejtë të marrë pjesë personalisht dhe të mbrohet duke u dëgjuar drejtpërdrejt.

76. VKM-ja nr. 505 parashikon, gjithashtu, se mbledhja e KMCAP Epror mundet të zhvillohet edhe me katër anëtarë, por, në asnjë rast, nuk mund të zhvillohet në mungesë të kryetarit. Kjo do të thotë se vendimi i Këshillit të Ministrave lejon që mbledhja të zhvillohet edhe në mungesën e anëtarit jurist. Më tej, parashikohet rregulla se, kur ka barazi në votim, në përfundim vendos vota e kryetarit.

77. VKM-ja nr. 505 parashikon se, në rast se provohet mungesa me arsye e më shumë se një anëtari, atëherë njoftohet për pjesëmarrje në mbledhje zëvendësuesi respektiv, i përcaktuar për çdo KMCAP Epror. Ky akt nënligjor parashikon se kriteret dhe procedura e miratimit të anëtarëve zëvendësues është e njëjtë me kriteret dhe

procedurën e anëtarëve të miratuar. Kjo do të thotë se edhe anëtarët zëvendësues do të emërohen nga ministrat respektivë, nën të njëjtat kushte dhe kritere, sikurse anëtarët permanentë dhe se edhe anëtarët zëvendësues do të duhet të betohen në ceremoni publike në prani të ministrave, sikurse anëtarët permanentë.

78. VKM-ja nr. 505 ka parashikuar se, nëse ankimuesit nuk paraqiten për komisionim dy herë radhazi dhe refuzojnë të kryejnë ekzaminimet e kërkuara apo mjekimin e rekomanduar, KMCAP epror merr vendim "*pa invaliditet*" apo "*pa aftësi të kufizuara*", dhe dosja i kthehet Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore apo Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror. Në këtë rast, dosja konsiderohet e mbyllur dhe për rihapjen e saj do të ndiqet procedura, si për rastet që paraqiten për komisionin për herë të parë. Pra, mungesa personalisht në seancë plenare e ankuesit apo moszbatimi i detyrave të lëna nga komisionet eprore nga ankuesi passjell dhe provokon një vendimmarrje përfundimtare mbi procesin e nisur pranë komisioneve eprore, pasi ato e mbyllin procedimin me konkluzionin se ankuesi nuk ka invaliditet apo se kërkuesi nuk ka aftësi të kufizuara. Kjo do të thotë se mospjesëmarrjen në proces apo mosplotësimin e detyrave të komisionit nga ankimuesi vendimi i Këshillit të Ministrave e kualifikon si argument prove dhe si provë për të konkluduar se ankimi është tërësisht i pabazuar në ligj.

79. Në këtë kuadër, Kolegji çmon të nevojshme të theksojë paraprakisht se, mungesa e subjektit aktiv në gjykimin civil, penal dhe administrativ në Shqipëri, sipas ligjeve procedurale, që kanë qenë dhe janë në fuqi, nuk është parashikuar ndonjëherë si shkak për rrëzimin e padisë apo shkak për konkluzionin e pathemelësisë së saj apo për fajësinë e të gjykuarit. Për herë të parë, në historinë e legjislacionit procedural shqiptar, një procedurë e tillë gjykimi krijohet me një akt nënligjor normativ. Megjithatë, VKM-ja nr. 505, nuk i ka dhënë statusin final të gjësë së gjykuar këtyre vendimeve, pasi ka parashikuar se sërish individi mundet të pretendojë të fitojë statusin e të paaftit plotësisht apo pjesërisht për punë, por për ta bërë këtë duhet të nisë procesin e verifikimit nga e para, që do të thotë që në nivelin e parë të verifikimit të aftësisë për punë.

80. VKM-ja nr. 505 ka parashikuar edhe fuqinë juridike detyruese të vendimeve përfundimtare të KMCAP Epror. Kështu është parashikuar se KMCAP Epror nuk mund të marrë në rishqyrtim rastet, për të cilat ai është shprehur një herë, kur ankimuesi ka të njëjtën gjendje shëndetësore apo aftësi të kufizuara. Kjo do të thotë se vendimet përfundimtare të KMCAP Epror, të marra në prezencën personale të palës ankimuese, kanë të njëjtat efekte me vendimet gjyqësore gjë të gjykuar apo institutin e *res judicata*, sikurse ka parashikuar neni 451/a i Kodit të Procedurës Civile.

81. Gjithashtu, në aktin nënligjor normativ është parashikuar se organizimi, shpërndarja dhe përbërja e KMCAP-së realizohen bazuar në rregulloren datë 30.5.2005, "*Për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të Invalidëve*", të miratuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Ministria e Shëndetësisë.

82. Në vijim të kësaj analize, Kolegji konkludon se, nga problematika e evidentuar nga jurisprudenca "*Dauti kundër Shqipërisë*", ndryshimet ligjore të vitit 2011 kanë plotësuar këto masa të përgjithshme: i. parashikimin e procedurës së betimit të anëtarëve të KMCAP Epror; ii. përcaktimin e kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të KMCAP Epror; iii. përcaktimin taksativ të shkaqeve për mbarimin e mandatit të anëtarit të KMCAP Epror; iv. përcaktimin taksativ të shkaqeve të shkarkimit nga detyra të anëtarit të KMCAP Epror; v. proklamimin në ligj të ushtrimit të detyrës së anëtarëve të KMCAP Epror në pavarësi dhe sipas bindjes profesionale; vi. garantimin e anëtarësisë së një anëtari me profesion jurist dhe me përvojë gjyqësore në KMCAP Epror, i cili emërohet nga ministri i Drejtësisë.

83. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se ka edhe çështje të tjera, të cilat, megjithëse janë lënë si detyrë, në kuadër të masave të përgjithshme të vendimit "*Dauti kundër Shqipërisë*" të GJEDNJ-së, nuk kanë gjetur zbatim në ndryshimet që i janë bërë ligjit në vitin 2011. Analiza e këtyre çështjeve, që në fakt përbën edhe një ndër drejtimet kryesore të këtij vendimi njësues, që ndihmon në nxjerrjen e konkluzionit nëse KMCAP Epror plotëson kushtet e një organi *quazi* gjyqësor është e lidhur, me:

i. garantimin e pavarësisë materiale dhe funksionale nga presionet e organeve të emërtesës;

ii. garantimin e patundshmërisë nga detyra;

iii. garantimin e kthimit në detyrë, në rast shkarkimi në kundërshtim me shkaqet e parashikuara në nenin 39/4 të ligjit nr. 7703/1993;

iv) parashikimin e garancive procedurale të procesit të rregullt ligjor gjatë shkarkimit nga detyra për anëtarët e KMCAP Epror.

84. Kolegji vlerëson të sjell në vëmendje se pika 2, e nenit 39/3, të ligjit nr. 7703/1993, parashikon se anëtarët e KMCAP Epror e ushtrojnë detyrën me kohë jo të plotë. Duke pasur parasysh se anëtarët e KMCAP Epror emërohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit të linjës rezulton se këto funksionarë janë të

punësuar në organikën e ministrisë respektive apo në organet e vartësisë të fushës përkatëse të veprimtarisë që ato mbulojnë. Kështu, anëtarët e KMCAP Epror mund të rezultojnë nëpunës, që kanë statusin e nëpunësit civil, ashtu siç mund të ketë nëpunës që nuk e kanë përfituar këtë status.

85. Ligji, në pikën 2, të nenit 39/3, është përpjekur të kryejë një rregullim të dyfishtë të statusit të anëtarit të KMCAP Epror, duke parashikuar rregullime të posaçme dhe të pavarura statutore për këtë funksionar shtetëror, që e ushtron veprimtarinë me kohë të pjesshme, në raport me pozicionin si nëpunës që ai ka jashtë kësaj detyre, detyrë kjo me kohë të plotë dhe e rregulluar nga normat ligjore respektive, që përcaktojnë nëpunësinë e institucionit të emërtesës.

86. Çështja që shtrohet në këto raste ka të bëjë me faktin *<u>nëse ky rregullim ligjor i dyfishtë, i posaçëm dhe i pavarur, a garanton anëtarin e KMCAP Epror të jetë i pavarur nga presionet që mund t'i vijnë atij nga institucioni ku është i emëruar si nëpunës?</u>* Kolegji vlerëson se për t'iu përgjigjur në mënyrë pohuese kësaj pyetje duhet, në radhë të parë, të sanksionohen përmes parashikimeve ligjore disa garanci që arrijnë të krijojnë besimin se nëpunësit shtetërorë të zakonshëm, marrëdhënia e punës e të cilëve rregullohet sipas Kodit të Punës ose nëpunësit shtetëror që kanë statusin e nëpunësit civil gëzojnë një status pavarësie dhe patundshmërie me natyrë të ngjashme me gjyqtarët.

87. Është e vërtetë që ndryshimet e ligjit në vitin 2011 përcaktuan kohëzgjatjen, shkaqet e mbarimit të mandatit dhe shkaqet e shkarkimit nga detyra, por në të njëjtën kohë duhet të mbahet parasysh se as ligji nr. 7703/1993, i ndryshuar, dhe as aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, nuk kanë parashikuar garancitë procedurale të shkarkimit nga detyra të anëtarit të KMCAP Epror. Në ligj janë parashikuar vetëm shkaqet e shkarkimit në mënyrë taksative nga kjo detyrë, jo me kohë të plotë dhe se anëtarët e KMCAP Epror shkarkohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

88. Duke mos parashikuar asnjë garanci procedurale për shkarkimin e anëtarit të KMCAP Epror, është e pamundur të plotësohet teorikisht dhe praktikisht standardi i procesit të rregullt ligjor dhe se për rrjedhojë diskrecioni i lënë në shkaqet e parashikuara në nenin 39/4 të ligjit në kompetencën e Këshillit të Ministrave nuk është shoqëruar me garanci procedurale për kontrollin e ushtrimit të tij. Mungesa e këtyre garancive ligjore bën që anëtarët e KMCAP Epror të jenë fillimisht njëlloj të pambrojtur nga ushtrimi i presionit të organit punëdhënës në cilësinë e tyre të parë si nëpunës dhe, më tej, të jenë njëlloj të pambrojtur nga ushtrimi i presionit të organit që i shkarkon nga detyra si anëtar të KMCAP Epror.

89. Gjithashtu duhet të mbahet parasysh se KMCAP Epror nuk plotëson standardet e detyrueshme për t'u quajtur organ *quazi* gjyqësor, pasi ometimi i ligjit nr. 7703/1993, shoqëruar me mënyrën e emërimit dhe të shkarkimit të tyre nga detyra nuk garanton parimin e pavarësisë dhe të patundshmërisë, që duhet të ketë një organ shtetëror administrativ për t'u kualifikuar juridikisht si *quazi* gjykatë apo si tribunal, në kuptim të konceptit autonom që ka elaboruar jurisprudenca e GJEDNJ-së, ndër vite, mbi nenin 6 të KEDNJ-së.

90. Këtu duhet të sillet në vëmendje se anëtarët e KMCAP Epror emërohen nga ministrat respektivë të linjës dhe shkarkohen nga Këshilli i Ministrave dhe njëkohësisht ata nuk kanë status të posaçëm punësimi që mundet t'i garantojë të drejtën e *restitutio in integrum,* në rast të shkarkimit nga detyra në kundërshtim me shkaqet e parashikuara në pikën 2 të nenit 39/4 të ligjit nr. 7703/1993. Edhe sikur të jenë nëpunës civilë, në statusin si nëpunës me kohë të plotë, ky fakt nuk ka relevancë për sa i përket rregullimit ligjor të statutit të anëtarit të KMCAP Epror. Në asnjë nga dispozitat e ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar nuk ka një parashikim për kthimin në këtë detyrë të anëtarëve të KMCAP, të shkarkuar në mënyrë të paligjshme nga Këshilli i Ministrave.

91. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje interpretimet e kryera në vendimin unifikues nr. 31/2003, në vendimin unifikues nr. 19/2007, si dhe në vendimin unifikues nr. 7/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilat është konkluduar se e drejta e punëmarrësve të shkarkuar pa të drejtë nga detyra, kur ligji i posaçëm nuk e parashikon të drejtën e rikthimit në punë, në mënyrë të qartë dhe eksplicite, nuk gëzon mbrojtje ligjore dhe se këto padi janë të destinuara të rrëzohen gjyqësisht.

92. Kjo do të thotë se nuk mund të bëhet fjalë për pavarësi dhe patundshmëri në ushtrimin e detyrës së anëtarëve të KMCAP Epror, kur në ligj nuk parashikohet e drejta e rikthimit në detyrë, për shkak të vendimmarrjes së paligjshme të Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra. Në këtë pikë të analizës ligjore vlen të sillet në vëmendje dhe merr një rëndësi të madhe edhe natyra juridike e organit të emërtesës dhe të shkarkimit nga detyra, për të cilët janë ministritë e linjës si organe emërtese dhe si organ shkarkimi nga detyra është Këshilli i Ministrave. Duke pasur parasysh statusin në punësimin e përhershëm të tyre dhe se organi i emërtesës dhe i shkarkimit nga detyra janë institucionet kushtetuese më të larta ekzekutive në vend, së bashku me mungesën e garancive procedurale të shkarkimit dhe të garancive statutore të rikthimit në detyrë, Kolegji arrin në përfundimin se ndryshimet ligjore të vitit 2011 nuk kanë arritur ta konturojnë

KMCAP Epror si një organ *quazi* gjyqësor.

iii. Përmbushja e elementit formal të krijimit me ligj të quazi gjykatës

93. Në vijim të analizës së mësipërme, Kolegji risjell në vëmendje jurisprudencën e GJEDNJ-së mbi aktin normativ që krijon gjykatën. Ndër të tjera, GJEDNJ ka theksuar, se thelbësore për garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së është që gjykata të krijohet me ligj dhe se kjo kërkesë eksplicite e nenit 6 të KEDNJ-së reflekton parimin themelor të shtetit të së drejtës, mbi bazën e të cilit është ndërtuar KEDNJ-ja dhe protokollet e saj. GJEDNJ-ja ka konkluduar se një organi të krijuar pa vullnetin e ligjvënësit i mungon legjitimiteti i nevojshëm në një shoqëri demokratike për të ushtruar juridiksion dhe kompetenca gjyqësore dhe se fraza "*e krijuar me ligj*" e nenit 6 të KEDNJ-së mbulon jo vetëm bazën ligjore të krijimit të tribunalit, por edhe të kompozimit të trupit gjykues në çdo çështje *(shih çështjen "Lavents v. Latvia", Ap. no. 58442/00, vendim i GJEDNJ-së datë 28.11.2002, paragrafi 114).* Në këtë mënyrë, sipas GJEDNJ-së, koncepti "*ligj*" i parashikuar në nenin 6 të KEDNJ-së nuk u referohet vetëm parashikimeve për themelimin dhe krijimin e gjykatave, por edhe parashikimeve të tjera që mund të shkaktojnë pjesëmarrjen e një apo më shumë anëtari në trupën gjykuese *(shih çështjen "Ali Riza and others v. Turkey", Ap. nos. 30226/10 and 4 others, vendimi i datës 28.1.2020 i seksionit II të GJEDNJ-së, paragrafi 194).*

94. Në çështjen konkrete, të shtruar për njësim, Kolegji konstaton se VKM-ja nr. 505 ka krijuar rishtazi edhe një figurë tjetër anëtari në KMCAP Epror, konkretisht atë të anëtarit zëvendësues. Në fakt, ligji nr. 7703/1993, i ndryshuar, nuk parashikon mundësinë e zgjedhjes së anëtarëve të tjerë, qoftë edhe zëvendësues. Në këtë aspekt, akti nënligjor normativ kapërcen përmbajtjen e ligjit, duke rregulluar kryesisht dhe duke krijuar një tjetër pozicion të anëtarit vendimmarrës në KMCAP Epror, të cilin ligji nuk e individualizon dhe as nuk e njeh.

95. VKM-ja nr. 505 ka parashikuar, gjithashtu, se KMCAP Epror mund të shqyrtojë ankimet administrative të subjekteve ndaj komisioneve rajonale edhe me 4 anëtarë, ndërkohë që neni 39/2, pika 1 i ligjit nr. 7703/1993 ka parashikuar pa ekuivok se KMCAP Epror përbëhen nga 5 anëtarë. Për më tepër, pika 2 e kësaj dispozite parashikon edhe mënyrën e kompozimit të trupit gjykues, duke përcaktuar se kryetari dhe 3 anëtarët e Komisionit Epror zgjidhen me propozim të përbashkët të Ministrit të Financave, ministrit që mbulon fushën shëndetësore dhe ministrit që mbulon çështjet sociale. Ministrat propozojnë dy kandidatura për çdo vend të anëtarit të Komisionit Epror. Anëtari i pestë i Komisionit Epror propozohet nga ministri i Drejtësisë, me kandidaturë alternative, me profesion jurist dhe me përvojë në fushën gjyqësore. Kjo do të thotë se çdo trupë gjykuese e KMCAP Epror duhet të ketë një përbërje të larmishme të anëtarësisë, që të konformohet me ligjin. Ndërkohë, ky akt nënligjor normativ ka parashikuar se në trupën gjykuese të KMCAP Epror mund të mos jetë edhe një prej anëtarëve dhe se trupa gjykuese mund të gjykojë edhe me katër anëtarë.

96. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se në mënyrën se si krijohet dhe konstituohet trupa gjykuese e KMCAP Epror ka parashikime të tilla, të cilat në rastin më të mirë nuk janë rregullime ligjore dhe nuk janë vullnet i ligjvënësit dhe, në rastin më të keq, janë rregullime nënligjore normative, të cilat ndryshojnë vullnetin e ligjvënësit dhe parashikimet për formësimin e trupës gjykuese të KMCAP Epror.

97. Duke sjellë në vëmendje, se, në rastin në shqyrtim, trupa gjykuese e KMCAP Epror nuk rregullohet vetëm nga vullneti i ligjvënësit, por edhe me akte nënligjore që tejkalojnë vullnetin e ligjvënësit, Kolegji konkludon natyrshëm se KMCAP Epror nuk përbën një *quazi* gjykatë, të caktuar me ligj, sipas konceptit autonom të nenit 6 të KEDNJ-së. Gjithashtu, duhet të mbahet parasysh se eventualisht trupës gjykuese mund t'i mungojë, sipas rregullimit nënligjor normativ, edhe anëtari jurist dhe sërish ankimi i individit do të shqyrtohet dhe vendimi i KMCAP Epror do të rezultojë si i pakundërshtueshëm sipas ligjit. Evidentimi i një rasti të tillë do të konsiderohej haptazi në kundërshtim me jurisprudencën e detyrueshme "*Dauti kundër Shqipërisë*" të GJEDNJ-së. Pikërisht, rregullime të tilla normative që janë bërë me këtë akt normativ nënligjor, ndërkohë që vlerësohen se e kanë tejkaluar haptazi përmbajtjen e ligjit, tek i cili duhet të bazohen, konsiderohen nga Kolegji, sipas nenit 38 të ligjit 49/2012, si të paligjshme dhe, për rrjedhojë, të pazbatueshme.

98. Një çështje tjetër që shtrohet për diskutim, për sa i përket standardit të *quazi* gjykatës së caktuar me ligj, është edhe çështja e procedurës së miratimit të ligjit, me të cilin krijohet dhe rregullohet organizimi dhe funksionimi i organeve *quazi* gjyqësore. Kjo është një çështje që nuk lidhet drejtpërdrejt me jurisprudencën e GJEDNJ-së apo me detyrimet e së drejtës ndërkombëtare relevante dhe të detyrueshme për Shqipërinë. Kjo çështje lidhet ekskluzivisht me zbatimin e drejtë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në këtë pjesë të posaçme të veprimtarisë së pushtetit legjislativ.

99. Në vijim të kësaj analize, për Kolegjin u shtrua për zgjidhje *nëse, në referim të rregullës të nenit 81 të Kushtetutës, mund të krijohen organet quazi gjyqësore me një ligj me shumicë të zakonshme?* Kjo pyetje u shtrua, gjithashtu, për zgjidhje para Gjykatës Kushtetuese, e cila vlerësoi se edhe kjo çështje i përkiste funksionit nomofilatik të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, sipas nenit 132 të Kushtetutës dhe fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, mbetet detyrë e Kolegjit të marrë në analizë dhe t'i japë përgjigje kësaj çështjeje, duke interpretuar ligjin nr. 7703/1993, në raport me dispozitat respektive kushtetuese.

100. Fillimisht, Kolegji sjell në vëmendje se procedura e miratimit të ligjit me anën e së cilit krijohet, organizohet dhe funksionon një organ *quazi* gjyqësor nuk bën pjesë në rregullimet e nenit 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, çështja nuk zgjidhet vetëm me këtë konstatim, pasi, sipas nenit 17 të Kushtetutës, KEDNJ është detyrim minimal, përkundrejt kreativitetit të pushtetit legjislativ në mënyrën se si i rregullon normativisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Kjo do të thotë se Republika e Shqipërisë është e lirë dhe sovrane që të parashikojë standarde më të larta ligjore për mbrojtjen e tyre. Kështu Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk është mjaftuar vetëm me rregullimin e neneve 42 dhe 135, sikurse ka bërë KEDNJ-ja, në nenin 6 të saj. Përkundrazi, Kushtetuta në nenin 81, ndër të tjera, ka parashikuar:

"*2. Miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit:*

a) ligjet për organizimin dhe funksionimin e institucioneve, të parashikuara nga Kushtetuta; ...

... d) kodet;".

101. Nga mënyra se si është formuluar neni 81 i Kushtetutës rrjedh se ligjet për organizimin dhe funksionimin e gjykatave apo edhe për krijimin e tyre (neni 135 i Kushtetutës) duhet të miratohen me shumicë prej tre të pestave të anëtarëve të Kuvendit. Kjo do të thotë se Kushtetuta nuk lejon krijimin, organizimin dhe funksionimin e gjykatave, me ligje me shumicë të zakonshme. Më tej, mbetet përmes analizës dhe interpretimit, për t'i dhënë përgjigje pyetjes, se: *Në rast se gjykatat nuk mund të krijohen, të funksionojnë dhe të organizohen me ligje me shumicë të thjeshtë, a është e mundur që në zbatim të Kushtetutës, Kuvendi të krijojë, të organizojë apo të bëjë të mundur, me ligje të tilla, funksionimin e organeve quazi gjyqësore?*

102. Duhet të mbahet parasysh se, nëse kjo pyetje do të merrte një përgjigje pozitive atëherë garancitë që jep shumica e cilësuar parlamentare në krijimin e institucioneve që ushtrojnë drejtpërdrejt funksione kushtetuese dhe që i përkasin pushtetit gjyqësor apo pushtetit të dhënies së drejtësisë, nuk do të shërbenin për organet ekuivalente të tyre dhe që materialisht ushtrojnë të njëjtin juridiksion në zgjidhjen e çështjeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Nëse kjo do të lejohej, atëherë do të pranohej se Kuvendi mund të miratojë edhe me procedurë të përshpejtuar ligje për krijimin, organizimin dhe funksionimin e organeve *quazi* gjyqësore, në kuptim të pikave 2 dhe 3 të nenit 83 të Kushtetutës. Gjithashtu, Kolegji çmon se, nëse pyetja e shtuar më lart do të merrte përgjigje pozitive, atëherë do të konkludohej se organet *quazi* gjyqësore do të lejoheshin të krijoheshin, të organizoheshin dhe të funksiononin edhe me akt normativ të Këshillit të Ministrave, në kuptim të nenit 101 të Kushtetutës.

103. Nga një analizë historike që i bëhet ligjit nr. 7703/1993, i cili është miratuar dhe ndryshuar me shumicë të zakonshme parlamentare rezulton të mos i ketë shpëtuar ndërhyrjeve, qoftë nëpërmjet procedurave të përshpejtuara parlamentare, në kuptim të nenit 83, qoftë edhe me akt normativ nga Këshilli i Ministrave, sipas nenit 101 të Kushtetutës (*shih për shembull, ligjin nr. 81/2019, "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 7, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për një shtesë në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, 'Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë'", të ndryshuar*). Kjo mënyrë e ndërhyrjeve ligjore që është ndjekur në të shkuarën, nuk përjashton mundësitë që eventualisht, në të ardhmen, të ndryshojnë, si me procedurë të përshpejtuar, ashtu edhe me akt normativ, edhe dispozitat që kanë të bëjnë me KMCAP Epror.

104. Duke pasur parasysh sa u përmend më lart, Kolegji vlerëson se nëse organet *quazi* gjyqësore nuk do të gëzojnë garancinë e nenit 81 të Kushtetutës, atëherë garancitë kushtetuese të dhënies së drejtësisë nga gjykatat dhe nga ana e ligjeve organike do të ishin me ndikim jo pozitiv për funksionimin e shtetit të së drejtës. Mos vendosja e pengesave ligjore për krijimin e organeve *quazi* gjyqësore do të krijonte premisat e shtimit të tyre, gjë e cila sjell shpërpjesëtimisht edhe zvogëlimin e efekteve të organeve të mirëfillta gjyqësore. Shfaqja e një fenomeni të tillë bën që të mos ekzistojë asnjë kufizim ndaj çdo shumice të zakonshme parlamentare, në legjislatura të ndryshme për të zbehur juridiksionin e përgjithshëm të gjykatave klasike, nëpërmjet partikularizimit të juridiksionalizimit të organeve administrative me funksione gjyqësore. Një zgjidhje e tillë nuk duket se ndalohet shprehimisht nga Kushtetuta, por Kolegji vlerëson se ajo që Kushtetuta ka synuar të ndalojë kategorikisht është rregullimi ligjor i dhënies së drejtësisë dhe mbrojtjes juridiksionale të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me ligje me shumicë të zakonshme.

105. Vlerësohet e domosdoshme të sillet në vëmendje, në këtë rast, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese mbi elaborimin që i ka bërë respektimit të nenit 81 të Kushtetutës. Gjykata Kushtetuese ka mbajtur qëndrimin se ligjet

e zakonshme nuk mund të trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet apo ligjet organike të institucioneve të parashikuara nga Kushtetutë. Sipas saj, nëse kushtetutëbërësi do të kishte dëshiruar një trajtim të njëjtë të tyre, neni 81, pika 2, i Kushtetutës nuk do të ekzistonte si një standard i rëndësishëm. Pavarësisht se në formë, neni 81, pika 2, shkronja "a", i Kushtetutës është normë me natyrë procedurale, hartuesit e Kushtetutës, me synim mbrojtjen e institucioneve të parashikuara nga Kushtetuta, e kanë përfshirë këtë rregullim, nisur nga rëndësia e fushave që rregullojnë ligjet e cilësuara, me qëllim për t'i bërë ato sa më të qëndrueshme, për të kërkuar një konsensus më të gjerë nga forcat politike të përfaqësuara në Kuvend dhe për të shmangur mundësinë që forca politike që ka shumicën, të mund të cenojë parime themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike *(shih vendimin nr. 25, datë 5.12.2008, dhe vendimin nr. 1, datë 12.1.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

106. Gjykata Kushtetuese në këtë drejtim ka vlerësuar se respektimi i kriterit kushtetues "*shumicë e cilësuar*" është edhe në funksion të parimit të sigurisë juridike, parim që ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligjet në tërësi duhet të garantojnë qartësi, parashikueshmëri dhe kuptueshmëri për individin *(shih vendimin nr. 23, datë 8.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

107. Kolegji çmon të mbahet parasysh se Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar vazhdimisht se respektimi i kritereve formale dhe materiale që vendos Kushtetuta, gjatë procedurës ligjvënëse përbën një domosdoshmëri në shtetin e së drejtës. Referimi i drejtpërdrejtë nga Kushtetuta i mënyrës së miratimit të ligjeve organike u jep atyre fuqi të veçantë juridike, në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ato renditen pas Kushtetutës dhe para ligjeve të zakonshme të Kuvendit *(shih vendimin nr. 19, datë 3.5.2007, vendimin nr. 9, datë 23.3.2010 dhe vendimin nr. 23, datë 8.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

108. Në këtë linjë arsyetimi, është vlerësuar nga ana e Gjykatës Kushtetuese se raporti midis ligjeve organike, të miratuara me një shumicë të cilësuar të Kuvendit dhe ligjeve të zakonshme, të miratuara sipas rregullit të përgjithshëm, mund të shihet nga dy këndvështrime: si marrëdhënie midis burimeve të së drejtës, të vendosura në nivele të ndryshme në hierarkinë e normave – ligjet që miratohen me shumicë të cilësuar qëndrojnë më lart se ato të miratuara me shumicë të thjeshtë –, ose si një marrëdhënie e bazuar mbi parimin e shpërndarjes së kompetencës legjislative. Është, pikërisht, ky raport që përcakton rregullin se Kuvendi nuk mund të miratojë me "*shumicë të thjeshtë*" një ligj të ri ose shtesa në një ligj të mëparshëm, të cilat kërkojnë "*shumicë të cilësuar*", sepse në këtë mënyrë ligjet që kërkojnë "*shumicë të cilësuar*" mund ta humbasin rëndësinë e tyre. Kjo gjë arsyetohet me faktin e thjeshtë se rendi juridik nuk përbëhet nga norma juridike të barasvlershme apo me të njëjtën fuqi juridike, përkundrazi ai është një sistem i shkallëzuar, ku normat e së drejtës renditen në bazë të fuqisë juridike që kanë *(shih vendimin nr. 19, datë 3.5.2007, të Gjykatës Kushtetuese).*

109. Mbi këtë jurisprudencë të elaboruar prej saj, Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se ligjet e zakonshme duhet të nxirren jo vetëm në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës, por duhet treguar kujdes i veçantë që ato të mos prekin rregullimet që përfshihen natyrshëm në sferën ekskluzive të ligjeve organike, përndryshe ato do të binin në kundërshtim me nenin 81, pika 2, shkronja "a", të Kushtetutës *(shih vendimin nr. 19, datë 3.5.2007, vendimin nr. 9, datë 23.3.2010, si dhe vendimin nr. 23, datë 8.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

110. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e një akti normativ, sipas kuptimit të nenit 101 të Kushtetutës, i cili ndryshonte një nga ligjet, që sipas nenit 81 të Kushtetutës, miratohen me shumicë parlamentare prej 3/5 të deputetëve *(shih vendimin nr. 5, datë 5.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese.).* Ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se, përderisa ligji është pjesë përbërëse e listës shteruese të ligjeve që parashikohen në shkronjën "e", të nenit 81, pika 2, të Kushtetutës, për miratimin e tij nevojiten tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Po ashtu, edhe në referim të rregullimit të nenit 83, pika 3, Kuvendit i ndalohet që një ligj të tillë ta miratojë me procedurë të përshpejtuar. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se rregullimi i statusit të nëpunësve publikë është një fushë që i rezervohet ekskluzivisht Kuvendit, i cili e realizon këtë kompetencë përmes miratimit të ligjit me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij, nëpërmjet një procedure normale legjislative. Për rrjedhojë, shqyrtimi dhe miratimi i çdo çështjeje që përfshihet në sferën e rregullimit të këtij ligji, përbën vetëm rezervë të Kuvendit.

111. Kjo jurisprudencë e zhvilluar kushtetuese ka konkluduar se ligji që miraton Kuvendi, duke vlerësuar, formalisht dhe substancialisht aktin normativ me fuqinë e ligjit, sipas nenit 101, të Kushtetutës, është instrumenti konvertues i të parit si ligj material në një ligj formal dhe, ky i fundit, nuk mund të jetë veçse ligj i thjeshtë. Bazuar në këtë karakteristikë të ligjit miratues të aktit normativ, Gjykata Kushtetuese ka konkluduar se edhe çdo ndryshim që mund t'i bëhet ligjeve të listës së nenit 81 të Kushtetutës në tërësi, ose dispozitave të veçanta të tyre, nuk mund të arrihet nëpërmjet një ligji të thjeshtë, siç ka ndodhur në rastin konkret, por nëpërmjet një ligji të cilësuar, të miratuar në një procedurë normale nga Kuvendi, me të paktën tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se për sa kohë Kuvendi nuk mund të delegojë pushtetin e tij ligjbërës, por ka detyrimin kushtetues të përmbushë kërkesat procedurale dhe lëndore për miratimin e ligjeve të cilësuara, sipas neneve 81/2

dhe 83, të Kushtetutës, në raport me nenet 1, 2, 4, 7 dhe 116, të Kushtetutës, aq më pak, Këshilli i Ministrave mund të ndërhyjë me akte normative me fuqinë e ligjit në ato fusha, rregullimi i të cilave, *expressis verbis*, përbën kompetencë ekskluzive të Kuvendit.

112. Në vijim të kësaj analize, bazuar në nenet 6, 42, 135 dhe, në veçanti, në nenin 81, të Kushtetutës, Kolegji konkludon, se me qëllim ruajtjen e standardit kushtetues të mbrojtjes juridiksionale të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i gjithë procesi i dhënies së drejtësisë në Republikën e Shqipërisë krijohet, organizohet dhe funksionon, sipas ligjit që miratohet me shumicën e cilësuar të Kuvendit. Shkronja "a"", e nenit 81, të Kushtetutës nuk lidhet ngushtësisht me institucionin në kuptimin formal, por me përmbajtjen dhe substancën e funksioneve kushtetuese dhe ligjore që një institucion ushtron. Kjo detyron Kuvendin që sa herë miraton gjykata e posaçme të vlerësojë se ligji i përmendur në dispozitat e sipërcituara do të duhet të miratohet me 3/5 e të gjithë deputetëve, pasi dhënia e drejtësisë është një nga pushtetet kryesore të sistemit të qeverisjes *(shih nenin 7 të Kushtetutës)*.

113. Në respektim të këtij standardi kushtetues, që i shërben mirëfunksionimit të shtetit të së drejtës, Kolegji vlerëson se edhe në rastin kur pushteti i dhënies së drejtësisë i besohet, jo një gjykate në kuptim të nenit 135, pika 1, të Kushtetutës, por një organi publik, i cili jo aq për emërtimin që mban apo klasifikimin institucional që ka në organikën shtetërore, por për funksionin e rëndësishëm *quazi* gjyqësor që kryen, do të duhet që procesi i ligjbërjes të respektojë garancitë kushtetuese të nenit 81, të Kushtetutës. Është e domosdoshme se për t'i dhënë pushtet një organi administrativ, që cilësohet apo njihet si *quazi* gjyqësor, duhet t'i jepen të paktën të njëjtat garanci pavarësie dhe paanësie, sikurse gjykatat klasike. Të dyja këto kategori organesh shtetërore e kanë njëlloj të nevojshme garancinë e nenit 81 të Kushtetutës, jo për emrin që mbajnë, por për funksionet që kryejnë.

114. Kolegji vlerëson se edhe aktet nënligjore normative nuk mund të rregullojnë, në bazë dhe për zbatim të nenit 118 të Kushtetutës, organizimin dhe funksionimin e organeve *quazi* gjyqësore në kundërshtim me ligjin apo në rastet kur nuk ka një autorizim ligjor nga një ligj i miratuar, sipas nenit 81, të Kushtetutës.

115. Në vijim të kësaj analize, vlen të interpretohet, gjithashtu, nga Kolegji, <u>nëse është e mundur me një ligj me shumicë të zakonshme parlamentare apo me akte nënligjore normative të rregullohet procedura apo riti i shqyrtimit të organeve *quazi* gjyqësore?</u> Në praktikën kushtetuese dhe parlamentare të Shqipërisë, tradita ka formësuar konkluzionin se koncepti i organizimit dhe i funksionimit të një institucioni shtrihet edhe në procedurën e shqyrtimit të çështjeve. Kështu mjafton të sillet në vëmendje ligji organik i Gjykatës Kushtetuese apo ligji organik që krijoi gjykatat administrative për të kuptuar se si pjesë e organizimit dhe funksionimit të një institucioni kushtetues është vlerësuar edhe procedura e shqyrtimit të çështjeve. Në këtë kuptim, nxirret konkluzioni se edhe vetë procedura e shqyrtimit të një çështje nga ana e organeve *quazi* gjyqësore është një aspekt i organizimit dhe i funksionimit të tyre.

116. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim rezulton se procedura e shqyrtimit të KMCAP Epror, fillimisht parashikohet në disa dispozita të ligjit nr. 7793/1993 dhe, më tej, detajohet, sipas pikës 4, të nenit 39/2, të këtij ligji me VKM-në nr. 505.

117. Në leximin e parashikimeve procedurale të VKM-së nr. 505, konstatohet se, për herë të parë, në historinë e së drejtës procedurale civile, penale dhe administrative prezantohet një procedurë e posaçme e gjykimit në mungesë të ankuesit, në të cilën akti nënligjor normativ i jep vlerë provuese dhe vendimmarrëse vetë mungesës si fakt procedural. Ndër të tjera, ky akt nënligjor normativ parashikon se mungesa e pajustifikuar e ankuesit në proces passjell rrëzimin e ankimit apo humbjen e statusit të invaliditetit, që do të thotë edhe shuarjen e së drejtës për të përfituar nga mbrojtja shoqërore.

118. Kolegji vlerëson se çështje të tilla me rëndësi themelore të së drejtës procedurale nuk mund të prezantohen në rendin juridik, për herë të parë, nga një akt nënligjor normativ. Këtë gjë, në historinë e shtetit shqiptar, nuk e ka bërë as Shtojca e Dytë e Procedurës Civile, as Kodi i Procedurës Civile, i vitit 1958, as Kodi i Procedurës Penale, i vitit 1953, as Kodi i Procedurës Civile, i vitit 1981, as Kodi i Procedurës Penale, i vitit 1977, as Kodi i Procedurës Civile në fuqi, pavarësisht ndryshimeve ligjore ndër vite, as Kodi i Procedurës Penale në fuqi, pavarësisht ndryshimeve ligjore ndër vite, as Kodi i Procedurave Administrative, i vitit 1999 dhe i vitit 2014, dhe as ligji nr. 49/2012.

119. Për rrjedhojë, përmes këtij shembulli të marrë nga rregullimet procedurale me karakter nënligjor, në rastin e KMCAP Epror, Kolegji vlerëson se procedura e shqyrtimit të çështjeve ka një rëndësi themelore për vetë të drejtën kushtetuese dhe konventore të procesit të rregullt ligjor dhe, si e tillë, ajo do të duhet të jetë objekt i rregullimeve parësore ligjore. Bazuar në shkronjat "a" dhe "d", të pikës 2, të nenit 81, të Kushtetutës, mund të konkludohet se riti i gjykimit penal, civil apo administrativ do të duhet të jetë objekt rregullimi, kryesisht i ligjeve organike apo i kodeve dhe, në çdo rast, i ligjeve me shumicë të cilësuar. Për rastin në shqyrtim, zgjidhja ligjore mund të ishte gjetur edhe në parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative apo me një ligj tjetër, por jo të

krijohej një rit i posaçëm gjykimi me akt nënligjor normativ. Sigurisht, nuk mund të përjashtohet mundësia që një ligj i tillë të zbatojë parashikimet e delegimit të rregullimit normativ, sipas nenit 118, të Kushtetutës, por, në çdo rast, delegime të tilla të pushtetit normativ nuk mund të bëhen për çështje kaq themelore të së drejtës procedurale. Ato do të duhet gjithnjë të jenë domen ekskluzivisht i ligjit me shumicë të cilësuar.

120. Në rastin konkret, konstatohet se e gjithë procedura e shqyrtimit të rekurseve administrative e KMCAP Epror është rregulluar me ligj, me shumicë të thjeshtë, dhe për më tepër, me akt nënligjor normativ, sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 39/2, të ligjit. Për rrjedhojë, Kolegji konkludon se edhe parashikimet procedurale të procesit të shqyrtimit të rekursit administrativ të individit kundër një vendimi të komisioneve rajonale nga ana e KMCAP Epror nuk plotësojnë proceduralisht dhe materialisht garancitë e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të parashikuara nga neni 42, i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

121. Nga analiza e mësipërme, Kolegji konkludon në sentencën e parë të këtij vendimi njësues, duke vendosur se:

Ligji nr. 7703/1993, i ndryshuar në vitin 2011, nuk plotëson të gjitha standardet e vendosura nga GJEDNJ-ja, në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*" dhe standardet kushtetuese të gjykatës së caktuar me ligj, mbi pavarësinë dhe patundshmërinë e anëtarëve të KMCAP Epror, sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për rrjedhojë, konkludohet se KMCAP Epror, sipas rregullimit që i ka bërë ky ligj, nuk është formësuar si një organ *quazi* gjyqësor. Përderisa nuk plotëson këtë kusht thelbësor, nuk mundet që paditë kundër vendimeve të KMCAP Epror të mos i nënshtrohen kontrollit gjyqësor dhe këto vendime nuk mund të përcaktohen nga ligji si akte administrative të pakundërshtueshme.

B. Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për njehsim:

Si duhet interpretuar dhe zbatuar neni 39/1, i ligjit nr. 7703/1993, konkretisht pika 3, në pjesën ku parashikon se "…Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë" dhe si qëndron kjo dispozitë në raport me dispozitat e tjera procedurale, ligjore dhe kushtetuese që parashikojnë të drejtën e përgjithshme të ankimit, si e drejtë themelore?

122. Pasi u konkludua më sipër, me sentencën njësuese mbi çështjen e parë, duket se merr një zgjidhje edhe çështja e dytë. Duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, nëse organi administrativ i krijuar nga ligji për shqyrtimin e "të drejtave dhe detyrimeve civile", nuk plotëson elementet material të gjykatës, atëherë mosparashikimi i kontrollit gjyqësor passjell shkelje të nenit 6, të KEDNJ-së.

123. Megjithatë, sa e thjeshtë paraqitet zgjidhja në parim e kësaj çështjeje, po aq ndërlikohet për shkak të parashikimeve të ligjit nr. 7703/1993, sepse duhet respektuar sa detyrimi kushtetues nga çdo gjykatë, sipas nenit 145 të Kushtetutës, për zgjidhjen e një çështjeje konkrete, po ashtu edhe dhënia e arsyeve në rast të shmangies së zbatimit të ligjit, në respektim të parimit të epërsisë dhe të zbatimit të drejtpërdrejtë të marrëveshjes ndërkombëtare, sipas nenit 122, të Kushtetutës.

124. Neni 39/1, i këtij ligji, pas ndryshimeve në vitin 2011, ka parashikuar se:

"*1. Kundër vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë të nivelit të parë, personi mund të bëjë ankim brenda 30 ditëve në Komisionin Epror Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (më poshtë "Komisioni Epror");*

2. Ankimi paraqitet në formën e parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave;

3. Vendimi i Komisionit Epror është i formës së prerë."

125. Kolegji risjell në vëmendje se Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 55, datë 31.3.2021 ka orientuar Gjykatën e Lartë për të bërë interpretim pajtues të kësaj dispozite, duke theksuar se koncepti "*formë e prerë*" mund të marrë kuptime të ndryshme sipas legjislacionit në fuqi dhe jo në çdo rast është i barasvlershëm me konceptin e vendimit final. Gjykata Kushtetuese ka sjellë si shembull, për analogji, vendimin unifikues nr. 2, datë 3.11.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku është diferencuar fuqia ekzekutive e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, nga cilësia gjë e gjykuar.

126. Kolegji ndan një qëndrim të ndryshëm nga ky orientim i Gjykatës Kushtetuese, mbi interpretimin e këtij ligji, për arsyet që do të parashtrohen në vijim.

127. Së pari, ligji nuk ka dhënë përkufizime për të sqaruar kuptimin e frazës "vendim gjyqësor i formës së prerë". Megjithatë konceptin "formë e prerë", si cilësi dhe status ligjor të një vendimi, ligji e përmend edhe në dy dispozita të tjera. Njërin formulim e gjen në nenin 39/4, ku parashikohet se anëtari i KMCAP Epror shkarkohet nga detyra, nëse dënohet me një vendim gjyqësor penal të formës së prerë. Për të përcaktuar vendimin gjyqësor të formës së prerë, sipas këtij rregullimi, do t'i referohemi parashikimit që jepet në nenin 462, të Kodit të Procedurës Penale. Formulimin tjetër e gjen në shkronjën "d" të së njëjtës dispozitë ligjore, ku parashikohet se mandati i anëtarit të KMCAP Epror përfundon kur vërtetohet paaftësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Edhe për këtë formulim do të duhet t'i referohemi parashikimit që bën neni 451 i Kodit të Procedurës Civile.

128. E përbashkëta e këtyre dy parashikimeve normative mbi konceptin "formë e prerë e një vendimi", për llogari të zbatimit të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, qëndron te situata juridike e prekluzivitetit të ankimeve dhe njëherazi te finaliteti i një zgjidhjeje ligjore administrative apo gjyqësore.

129. Ligji nr. 7703/1993 përmban edhe një tjetër formulim mbi formën e prerë të vendimit, në nenin 86, pika 3, ku parashikohet se ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme (duke iu referuar Komisionit të Ankimit pranë drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore apo Komisionit të Ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore), bëhen në gjykatë, vendimi i së cilës është përfundimtar. Pra, cilësisë së vendimit të formës së prerë, sipas këtij ligji, i shtohet edhe cilësia e vendimit përfundimtar, duke konkluduar se kjo zgjidhje administrative është finale dhe e pamundur të kontestohet gjyqësisht.

130. Krahas interpretimit literal dhe sistematik, Kolegji çmon të ndalet edhe tek interpretimi teleologjik dhe se cili ka qenë qëllimi i ligjvënësit në përdorimin e togfjalëshit "formë e prerë", kur përcakton efektet e vendimeve të KMCAP Epror. Në këtë kuadër, Kolegji risjell në vëmendje Raportin e Veprimit, datë 3.5.2013, të Sekretariatit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, ku janë marrë në analizë, ndër të tjera, edhe masat e përgjithshme të Republikës së Shqipërisë për të adresuar zgjidhje në sistemin e brendshëm ligjor për zbatimin e vendimit të GJEDNJ-së në çështjen "*Dauti kundër Shqipërisë*". Në raport pasqyrohet se në Kuvend u hodh poshtë propozimi për të lejuar ankim gjyqësor kundër vendimeve të KMCAP Epror, të pafavorshme për llogari të subjekteve kërkuese, duke u miratuar norma ligjore në variantin se vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë, të paankimueshme dhe të detyrueshme.

131. Nisur nga këto tri forma të interpretimit të ligjit, Kolegji vlerëson se koncepti "formë e prerë", i përdorur nga ligjvënësi në nenin 39/1, pika 3, të ligjit nr. 7703/1993, pa ekuivok dhe pa dyshim është i njëjtë me konceptin e vendimit përfundimtar dhe të paankimueshëm gjyqësisht. Me këtë zgjidhje ligjvënësi ka konkluduar se çështja konsiderohet e përfunduar në procedurën administrative, pa asnjë mundësi ankimi në gjykatë.

132. Së dyti, nëse ligjvënësi do të kishte pasur të konsoliduar si qëllim të këtij ligji se cilësia "formë e prerë" e vendimeve të KMCAP Epror, nuk është e njëjtë me cilësinë e "vendimit përfundimtar, të paankimueshëm gjyqësisht", nuk do të ishte e nevojshme angazhimi i Kuvendit, në vitin 2011, që nëpërmjet ndryshimeve të ligjit nr. 7703/1993, të kërkonte përmbushjen e standardeve të GJEDNJ-së, për ta konturuar KMCAP Epror si *quazi* gjykatë. Kolegji vlerëson se synimi i ligjvënësit, pavarësisht se nuk e ka përmbushur tërësisht këtë detyrim të GJEDNJ-së, për ta formatuar KMCAP Epror, si një organ *quazi* gjyqësor, përputhet me konceptin për të mos lejuar kundërshtimin në gjykatë të këtyre vendimeve.

133. Në kushtet ku neni 39/1, pika 3, ka ndaluar shprehimisht kontrollin gjyqësor të vendimeve të KMCAP Epror, përpara Kolegjit shtrohet për zgjidhje çështja: *Nëse i lejohet gjykatës, në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, të refuzojë apo të shmangë zbatimin e ligjit, kur vlerëson se ky i fundit vjen në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, në veçanti me KEDNJ-në, duke kërkuar zbatimin e drejtpërdrejtë të kësaj të fundit.* Kjo është një nga çështjet që Gjykata e Lartë ia shtroi për zgjidhje Gjykatës Kushtetuese, nëpërmjet kontrollit incidental, me qëllim shfuqizimin e nenit 39/1, pika 3, të ligjit nr. 7703/1993.

134. Në mënyrë të përgjithshme, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se edhe kjo çështje i përket funksionit njësues të Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, në respekt të vendimit të Gjykatës Kushtetuese që nuk vlerësoi se zgjidhja e çështjes i përket atij autoriteti të lartë kushtetues, por Gjykatës së Lartë, mbetet detyrë e këtij Kolegji për të mbajtur një qëndrim përfundimtar, nëpërmjet njësimit të praktikës gjyqësore, mbi raportin juridik midis së drejtës së brendshme dhe së drejtës ndërkombëtare.

135. Një nga parimet bazë në marrëdhëniet ndërshtetërore, të sanksionuar edhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë është ai i zbatueshmërisë së detyrueshme të marrëveshjeve ndërkombëtare (*pacta sunt servanta*), i cili përbën një nga instrumentet bazë të globalizimit dhe unifikimit të së drejtës. Parimi *pacta sunt servanta* është sanksionuar në Kushtetutë, në nenet 5, 116, 122, ku marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara i është dhënë një status i veçantë. Në këtë mënyrë, Kushtetuta ka ofruar një qëndrim të ri për të drejtën ndërkombëtare në raport me të drejtën e brendshme, sepse aktet ndërkombëtare të ratifikuara, *së pari*, kanë efekt normues, duke i radhitur pas Kushtetutës, *së dyti*, i konsideron pjesë të sistemit të brendshëm juridik, *së treti*, i bën të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë, *së katërti*, i klasifikon me epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

136. Neni 116 i Kushtetutës, i cili përcakton hierarkinë e akteve normative në Republikën e Shqipërisë i rendit marrëveshjet ndërkombëtare pas Kushtetutës dhe u jep atyre fuqi mbiligjore në sistemin e burimeve normative. Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar dhe interpretuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, që sanksionon:

"1. *Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji…*

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të…".

137. Në veçanti, KEDNJ-ja, si një nga dokumentet më të rëndësishme ligjore evropiane, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, gëzon një status të privilegjuar në rendin kushtetues shqiptar kundrejt të gjitha marrëveshjeve të tjera. Kolegji sjell në vëmendje nenin 17/2, të Kushtetutës, i cili konstitucionalizon shprehimisht statusin e kufizimeve të të drejtave të parashikuara nga KEDNJ-ja, e parë kjo nën dritën e praktikës së GJEDNJ-së. Kjo është një dispozitë referuese, për sa u përket kufizimeve të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe, në këtë plan, KEDNJ-ja ka të njëjtin status me dokumentin themeltar të shtetit.

138. Nisur nga fakti se të drejtat dhe liritë individuale, që renditen në Kushtetutën e Republikës së Shqiptare dhe në KEDNJ, janë analoge dhe se kufizimet e të drejtave e lirive kanë status kushtetues, konkludohet se çdo shkelje e KEDNJ-së është njëkohësisht edhe shkelje e Kushtetutës. Për rrjedhojë, korrigjimi i shkeljeve konventore do të thotë njëkohësisht edhe korrigjim i shkeljeve të Kushtetutës.

139. Neni 46, i KEDNJ-së, ka parashikuar fuqinë detyruese të vendimeve të GJEDNJ-së dhe jurisprudencës së saj, e cila është cilësuar si "konventa në veprim". Në pikën 1, të kësaj dispozite, është parashikuar: *"Palët e larta kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë...".* Kërkesat e këtij neni kanë gjetur zbatim gjerësisht në jurisprudencën e GJEDNJ-së. Kjo e fundit e ka konsideruar ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së, si burimin e përgjegjësisë ndërkombëtare të shtetit palë, i cili, në këtë rast, ka detyrimin jo vetëm të shlyejë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrë masa individuale dhe/ose, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor, që t'i japë fund shkeljes së gjetur nga gjykata dhe rregullimit të pasojave të shkeljes, me qëllimin që kërkuesi të rikthehet, për aq sa është e mundur (*restitutio in integrum*), në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja *(Scozzari dhe Giunta kundër Italisë [DHM], nr. 39221/98 dhe 41963/98, GJEDNJ 2000-VIII, para. 249; Assanidze kundër Gjeorgjisë [DHM], nr. 71503/01, GJEDNJ 2004-II, parag. 198.)*

140. Në praktikën e saj, GJEDNJ-ja është shprehur se, nuk është detyrë e Gjykatës të tregojë se si mund të sigurohet një mundësi e tillë dhe çfarë forme duhet të marrë ajo. Shteti i paditur mbetet i lirë, nën monitorimin e Komitetit të Ministrave, për të zgjedhur mjetet me të cilat do të kryejë detyrimin e tij për të vendosur ankuesin, sa është e mundur, në pozicionin që ai do të kishte qenë nëse kërkesat e Konventës nuk do të ishin shkelur *(shih çështjen Piersack k. Belgjikës).*

141. Në veçanti, nëse shkelja e të drejtave dhe lirive themelore, sipas KEDNJ-së ka ardhur si rrjedhojë e ometimit legjislativ apo parashikimeve të ligjit të brendshëm, GJEDNJ-ja ka theksuar se është detyrë e shtetit të paditur që në sistemin e tij ligjor të brendshëm të heqë pengesat që mund të pengojnë rregullimin e mjaftueshëm të situatës së ankuesit *(shih, Karanović k. Bosnjës dhe Hercegovinës, nr. 39462/03, § 28, 20 nëntor 2007)* ose të propozojë një mjet të ri ligjor, i cili do t'i mundësonte ankuesit të rregullojë situatën.

142. Në këtë kuadër, Kolegji çmon të nevojshme të sjellë në vëmendje çështjen *Xheraj kundër Shqipërisë,* ku GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 6 në procesin penal nga gjykatat vendëse. Rikthimi i kërkuesit në gjendjen e mëparshme nënkuptonte, ndër të tjera, sipas GJEDNJ-së rihapje të procesit gjyqësor dhe rishikim të vendimit penal. Në atë kohë, kishte një pengesë formale ligjore, pasi Kodi i Procedurës Penale nuk parashikonte vendimin e GJEDNJ-së, si shkak për rishikim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në zbatim të ligjit të brendshëm, vendosën mospranimin e kërkesës për rihapjen e procesit gjyqësor.

143. Çështja e zbatimit të vendimit të GJEDNJ-së, në këtë rast, u adresua para Gjykatës Kushtetuese, e cila me vendimin nr. 20, datë 1.6.2011, vendosi si standard zbatimin e drejtpërdrejtë të vendimit të GJEDNJ-së. Ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese, u shpreh:

"... interpretimi i bërë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është i gabuar dhe vjen në kundërshtim me nenet 122 e 124 të Kushtetutës, si dhe me nenin 46 të KEDNJ-së... vendimet e GJEDNJ-së janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, palë të KEDNJ-së, duke përmbushur në këtë mënyrë zotimet që burojnë nga neni 46/1 i saj. Gjykata, konstaton, gjithashtu, se krahas domosdoshmërisë së plotësimit nga Kuvendi të boshllëkut ligjor në legjislacionin penal procedural, Gjykata e Lartë duhet të bëjë përpjekje për të gjetur zgjidhjen e duhur, për të vënë në vend të drejtën e shkelur të kërkuesit, qoftë duke përdorur edhe analogjinë me Kodin e Procedurës Civile...

... Gjykata, në vijim të argumenteve të saj, e sheh me vend të theksojë se, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GJEDNJ-ja ka në sistemin tonë juridik një kompetencë eksklusive. Kjo kompetencë është e pranuar nga sistemi ynë i brendshëm juridik, për efekt të zbatimit të nenit 122, të Kushtetutës, po edhe të nenit 17/2 të saj, të cilët sjellin si detyrim që vendimet e GJEDNJ-së të zbatohen drejtpërdrejti...

...Me rastin e ratifikimit të KEDNJ-së, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si përfaqësues i sovranitetit popullor, ka marrë përsipër detyrime të cilat janë të zbatueshme nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve, pavarësisht llojit të tyre. Për sa më sipër, detyrimet që mbartin secili nga pushtetet për zbatimin e vendimeve përfundimtare të GJEDNJ-së janë të ndryshme. Nëse për ekzekutivin janë menjëherë të ravijëzueshme këto detyrime, si p.sh., në rastin e pagimit të dëmshpërblimeve të imponuara nga GJEDNJ-ja, për sa u përket dy pushteteve të tjera ka vend për interpretim.

...Posaçërisht për sa i përket vendimeve të GJEDNJ-së për procedime penale, për legjislativin lind nevoja që të marrë masa për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me dispozitat e KEDNJ-së. ***Nëse nuk ka harmonizim pra, nëse jemi në rastet e vakumit legjislativ, ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e GJEDNJ-së, në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46 të KEDNJ-së.*** *Neni 122 i Kushtetutës përcakton shprehimisht, se dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...*

...Gjykata Kushtetuese çmon se respektimi i KEDNJ-së dhe standardeve kushtetuese është detyrim jo vetëm i saj, por edhe i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë të veçantë Gjykatës së Lartë për shkak të kompetencave të veçanta të saj të natyrës rishikuese, por edhe në drejtim të unifikimit të praktikës gjyqësore...

...Gjykata çmon se duke pasur parasysh edhe rolin qendror të Gjykatës së Lartë në sistemin tonë gjyqësor, lipset që kjo Gjykatë, në përputhje edhe me nenin 1 të Kodit të Procedurës Penale, të mos kufizohet vetëm në dispozitat e këtij Kodi, por të zbatojë drejtpërsëdrejti Kushtetutën dhe KEDNJ-në."

144. Qasja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në vendimin e sipërcituar, erdhi si rrjedhojë e rekomandimit të Komitetit të Ministrave R (2000), të miratuar më datë 19.1.2000, për shtetet anëtare mbi rishqyrtimin apo rihapjen e çështjeve të caktuara në nivel vendi pas vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

145. Të njëjtën problematikë mbi ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së kishte edhe çështja *Lika dhe Laska kundër Shqipërisë*. Në këtë rast, në lidhje me nenin 46 të KEDNJ-së, GJEDNJ-ja u shpreh se:

"Gjykata konsideron se, në çështjen në fjalë, një rigjykim ose rihapje e çështjes, nëse kërkohet nga ankuesi, në parim përfaqëson mënyrën e duhur të rregullimit të shkeljes. Kjo është në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Ministrave, që në rekomandimin nr. R (2000) 2 i kërkonte shteteve anëtare të Konventës futjen e mekanizmave për rishqyrtimin e çështjes dhe rihapjen e procedimeve gjyqësore në nivelin e brendshëm, duke zbuluar që masa të tilla përfaqësonin "mjetin më efikas, nëse jo të vetmin për arritjen e dëmshpërblimit in integrum" (shih paragrafin 33 më lart). Gjithashtu, kjo reflekton parimet e së drejtës ndërkombëtare ku një shtet përgjegjës për një akt të paligjshëm është i detyruar të bëjë dëmshpërblimin, që konsiston në rivendosjen e situatës që ekzistonte para se të kryhej akti i paligjshëm (neni 35 i projektneneve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësitë e Shteteve për Aktet e Paligjshme Ndërkombëtare – shih paragrafin 35 më lart dhe, mutatis mutandis, Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) k. Zvicrës (nr. 2) [GC], nr. 32772/02, §§85–86, GJEDNJ 2009...).

76. Gjykata vëren se sistemi ligjor penal i shtetit të paditur nuk parashikon mundësinë e rishqyrtimit të çështjeve, duke përfshirë rihapjen e procedimeve të brendshme, në rast se kjo Gjykatë konstaton shkelje të rëndë të së drejtës së ankuesit për gjykim të drejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës të tregojë se si mund të sigurohet një mundësi e tillë dhe çfarë forme duhet të marrë ajo. Shteti i paditur mbetet i lirë, nën monitorimin e Komitetit të Ministrave, për të zgjedhur mjetet me të cilat do të kryejë detyrimin e tij për të vendosur ankuesin, sa është e mundur, në pozicionin që ai do të kishte qenë nëse kërkesat e Konventës nuk do të ishin shkelur (shih Piersack k. Belgjikës (neni 50), 26 tetor 1984, § 12, seria A nr. 85), me kusht që mjete të tilla të jenë në përputhje me përfundimet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës, si dhe me të drejtat e mbrojtjes (shih Lyons dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr. 15227/03, GJEDNJ 2003-IX).

77. Megjithatë, Gjykata konsideron që është detyrë e shtetit të paditur që në sistemin e tij ligjor të brendshëm të heqë pengesat që mund të pengojnë rregullimin e mjaftueshëm të situatës së ankuesit (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, Karanović k. Bosnjës dhe Hercegovinës, nr. 39462/03, § 28, 20 nëntor 2007) ose të propozojë një mjet të ri ligjor, i cili do t'i mundësonte ankuesit të rregullonte situatën. Për më tepër, shtetet kontraktuese janë të detyruara të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore, në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të plotësojnë kërkesat e Konventës. Gjithashtu, ky parim zbatohet për rihapjen e procedimeve gjyqësore dhe rishqyrtimin e çështjeve të ankuesve. (Shih, mutatis mutandis, Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) (nr. 2), cituar më lart, §97.)

146. Në mënyrë të ngjashme, GJEDNJ-ja dhe Këshilli i Ministrave në rekomandimin e tij 6/2004, për përmirësimin e mjeteve të brendshme të ankimit, përcaktuan se shtetet ishin të detyruara të modifikonin të drejtën e tyre të brendshme për t'u dhënë fund shkeljeve të Konventës dhe për të ekzekutuar vendimet e GJEDNJ-së. Modifikimi i së drejtës së brendshme nënkupton edhe krijimin e mjetit juridik nga gjykatat, në mungesë të ligjit të shprehur *(shih çështjen Maestri kundër Italisë; Asanzide kundër Gjermanisë etj.)*. Në interpretim dhe zbatim të nenit 46 të KEDNJ-së, në këto raste, GJEDNJ-ja është shprehur se:

"…detyrimi i shtetit për të zbatuar vendimet e GJEDNJ-së, nuk nënkupton vetëm zhdëmtimin monetar, por edhe që shteti të përzgjedhë masa të përshtatshme, individuale në rendin ligjor të brendshëm, në mënyrë që t'i jepet fund shkeljes dhe të rregullojë për sa

është e mundur pasojat." See Scozzari and Giunta v. Italy [GC], nos. 39221/98 and 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII, and Pisano v. Italy (striking out) [GC], no. 36732/97, § 43, 24 October 2002) ... Për më tepër, nga neni 1 i Konventës, në veçanti, rrjedh se shtetet, palë kontraktuese, me ratifikimin e Konventës kanë marrë përsipër, të përshtatin ligjin e brendshëm me parashikimet e Konventës. Si rrjedhojë, është detyrë e shteteve, të heqin çdo pengesë ligjore që mund të pengojë rikthimin e aplikantit në gjendjen e mëparshme ..."

147. Në vijim të kësaj analize, duke u bazuar te dispozitat kushtetuese mbi statusin e posaçëm të KEDNJ-së në rendin e brendshëm, si dhe në nenet 1 dhe 46, të KEDNJ-së, Kolegji konkludon se vendimet dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së, adreson detyrime për të gjitha pushtetet shtetërore të brendshme për të bërë të mundur zbatimin e menjëhershëm dhe të përshtatshëm të KEDNJ-së. Krahas pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ, një rol të rëndësishëm e luajnë gjykatat, të cilat në veprimtarinë e përditshme ligjzbatuese, duhet të garantojnë zbatimin e KEDNJ-së dhe vendimeve të GJEDNJ-së, nëpërmjet teknikave të interpretimit pajtues të ligjit, interpretimeve me analogji dhe kur është rasti, në kushtet e ometimit legjislativ apo të ligjit në kundërshtim me KEDNJ-në, të zbatojnë drejtpërdrejt këtë të fundit.

148. Në veçanti, refuzimi nga gjykatat për të zbatuar drejtpërdrejt KEDNJ-në dhe praktikën e GJEDNJ-së, me argumentimin formal të mungesës së ligjit apo ekzistencës së ligjit që pengon zbatimin e saj, në pritje për reforma apo ndërhyrje nga pushteti ligjvënës apo edhe nga Gjykata Kushtetuese, nuk pajtohet me nenin 46 të KEDNJ-së dhe standardin e vendosur nga GJEDNJ-ja, mbi marrjen e çdo lloj mase të shpejtë, efikase dhe të përshtatshme për rikthimin në gjendjen e mëparshme. Kështu, në çështjen *Vermeire kundër Belgjikës*, GJEDNJ-ja është shprehur, se: "*Liria e zgjedhjes e lejuar një shteti lidhur me mënyrat e përmbushjes së detyrimeve të tij që burojnë nga neni 53, nuk i japin atij të drejtën të pezullojë zbatimin e Konventës deri në përfundimin e një reforme*".

149. Nën këtë vështrim krahasues, Kolegji konstaton se zbatimin e drejtpërdrejtë të vendimeve të GJEDNJ-së, edhe në kushtet e ometimit legjislativ apo të kundërshtive me sistemin e brendshëm ligjor, jurisprudenca e gjykatave të larta të vendeve evropiane e ka përdorur si një ndër mekanizmat e respektimit të nenit 46, të KEDNJ-së, duke zbatuar standardin e vendosur nga GJEDNJ-ja për "*heqjen e pengesave ligjore për kthimin në gjendjen e mëparshmë*". Kështu, në çështjen *Barbera etj. kundër Spanjës*, Gjykata Kushtetuese Spanjolle, në mungesë të ligjit të shprehur, vendosi rishikimin e vendimit përfundimtar me efekt *res judicata* me argumentin se lënia në fuqi e një vendimi me shkelje të rënda procedurale ishte në kundërshtim me rendin kushtetues. Kolegji sjell në vëmendje gjithashtu, qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Kasacionit e Republikës së Francës, pas vendimit të GJEDNJ-së, në çështjen *Brusco kundër Francës,* ku mohimi i së drejtës për të pasur kontakt me një avokat gjatë orëve të para të paraburgimit dhe kërkesa për të pandehurit për t'u betuar para dhënies së dëshmisë u konsideruan shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së. Gjithashtu, Asambleja Plenare e Gjykatës së Lartë Franceze vendosi t'i japë efekt të menjëhershëm vendimit të GJEDNJ-së lidhur me të drejtën për të pasur kontakt të menjëhershëm me një avokat, megjithëse legjislacioni përkatës, nuk ishte amenduar ende. Ndër të tjera, Gjykata e Kasacionit u shpreh: "*Shtetet palë të Konventës janë të detyruara të respektojnë vendimet e GJEDNJ-së, pa pritur të paditen para saj apo pa pritur modifikimin e legjislacionit përkatës...". (Shih më gjerë vendimin e kësaj gjykate - Arrêt n° 589 du 15 avril 2011 (10-17.049).*

150. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje Konventën e Vjenës "Për të drejtën e traktateve", e cila ka përcaktuar rregulla për zbatimin dhe interpretimin e marrëveshjeve ndërkombëtare (siç është dhe KEDNJ-ja). Në këtë Konventë, Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 8696, datë 23.12.2000, duke e bërë pjesë të sistemit të brendshëm juridik. Në nenin 27, të kësaj Konvente, është parashikuar, se: "*Një palë nuk mund të përdorë dispozitat e së drejtës së brendshme si justifikim për pamundësinë e tij për të zbatuar një traktat*".

151. Në veçanti, Kolegji vlerëson se detyrimi për zbatimin e drejtpërdrejtë të Konventës rëndon mbi Gjykatën e Lartë, e cila nëpërmjet funksionit të saj kushtetues për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore (sipas nenit 141 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë), arrin të garantojë zbatimin e KEDNJ-së dhe të vendimeve të GJEDNJ-së me efekt *erga omnes*, në rastet kur ka ometim legjislativ apo kur ligji vjen në kundërshtim me këtë marrëveshje ndërkombëtare. Vendimet njësuese janë të detyrueshme për gjykatat më të ulëta në raste të ngjashme dhe, në këtë mënyrë, garantohet edhe një kontroll i centralizuar i konvencionalitetit të ligjit. Në këtë mënyrë arrihet uniformiteti në zbatimin e KEDNJ-së, garantohet neni 5 i Kushtetutës, sipas të cilit Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të, si edhe neni 122 i Kushtetutës mbi zbatimin e drejtpërdrejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare.

152. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, për të gjitha argumentet e dhëna në pjesën e parë të këtij vendimi njësues, në kushtet ku KMCAP Epror nuk plotëson të gjitha elementet e tribunalit në kuptimin material, sipas standardeve të nenit 6 të KEDNJ-së, të trajtuara në çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë"*, parashikimi i nenit 39/1, pika 3 se vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë, përbëjnë mohim të pajustifikuar të aksesit në gjykatë dhe, për rrjedhojë, shkelje të nenit 6, të KEDNJ-së.

153. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se në raste të tilla gjen zbatim drejtpërdrejt vendimi i GJEDNJ-së, në çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë"*, se në rast se KMCAP Epror nuk plotëson kushtet për t'u konsideruar *quazi* gjykatë, atëherë duhet të njihet kontrolli dhe juridiksioni gjyqësor mbi vendimmarrjen e këtij organi.

154. Si rrjedhojë, Kolegji vlerëson se neni 39/1, pika 3, i ligjit nr. 7703/1993, do të mbetet i pazbatueshëm, në raport me vendimin e GJEDNJ-së, si më sipër, dhe në raport me dispozitat e tjera me natyrë procedurale, ligjore dhe kushtetuese, që njohin të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj aktit administrativ.

155. Kolegji sjell në vëmendje, parashikimin e nenit 86/3, të ligjit nr. 7703/1993, i cili ka parashikuar, se: *"Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në Gjykatë, vendimi i së cilës është përfundimtar ..."*. Përderisa nuk ka rregullim ndryshe, mbi procedurën, afatet, kushtet e ushtrimit të padisë ndaj aktit administrativ, do të gjejnë zbatim dispozitat e përgjithshme të ligjit nr. 49/2012.

156. Kolegji vlerëson se e drejta e ankimit gjyqësor ndaj aktit administrativ është një prezumim kushtetues që buron nga e drejta e përgjithshme e kujtdo për akses në gjykatë (neni 42), dhe e drejta kushtetuese themelore për t'u zhdëmtuar/dhe ose rehabilituar nga aktet e paligjshme të organeve publike (neni 44), përveç rasteve kur ligji në mënyrë të shprehur mund ta kufizojë, sipas kritereve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.

157. Kolegji vlerëson se, parimi i shtetit të së drejtës kërkon jo vetëm që veprimtaria e organeve të administratës publike të rregullohet me ligj, por edhe që kjo veprimtari, në raport me të drejtat e shtetasve, t'i nënshtrohet kontrollit gjyqësor. Prandaj, sipas nenit 42 të Kushtetutës, individi ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës edhe kur cenimi i të drejtave, i lirive dhe i interesave kushtetues e ligjorë të tij ka ardhur nga akti apo veprimtaria e organeve të administratës publike *(shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 27, datë 27.7.2009)*. Aksesi në gjykatë përbën një të drejtë themelore kushtetuese dhe konventore për individin, e cila duhet të garantojë në çdo rast juridiksion fillestar apo rishikues të plotë, ligji apo fakti, me të gjitha karakteristikat e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

158. Në përfundim, Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se nevoja për fleksibilitet dhe eficiencë, që janë plotësisht në pajtim me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mund ta justifikojnë shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në lidhje me të *"drejtat dhe detyrimet civile"* nga organe administrative, profesionale dhe të specializuara, në kushtet ku organet gjyqësore nuk përmbushin këto kërkesa në çdo aspekt. Në këtë kuptim, konkluzionet e Gjykatës së Lartë, nuk pengojnë ligjvënësin që në të ardhmen, nëpërmjet ndryshimeve në ligjin nr. 7703/1993, të marrë masat për të konturuar KMCAP Epror si një *quazi* gjykatë, me të gjitha elementet që e karakterizojnë atë, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, të analizuara në këtë vendim njësues. Vetëm në një eventualitet të tillë, kufizimi i aksesit në gjykatë kundër vendimmarrjes së këtyre organeve do të vlerësohet i pajtueshëm me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe me vendimin *"Dauti kundër Shqipërisë"* të GJEDNJ-së.

159. Në vijim, Kolegji konkludon në sentencën e dytë të këtij vendimi njësues, se:

Neni 39/1, pika 3, i ligjit nr. 7703/1993, në pjesën ku parashikon se *"... Vendimet e KMCAP Epror janë të formës së prerë"*, vjen në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë"*. Si rrjedhojë, kjo dispozitë mbetet e pazbatueshme, për aq sa rregullimi ligjor për KMCAP-në nuk arrin të plotësojë kushtet e një organi *quazi* gjyqësor. Në rastet ku kundërshtohet një vendim i KMCAP Epror, sipas këtij ligji, do të zbatohet drejtpërdrejt ky vendim i GJEDNJ-së, dhe dispozitat kushtetuese dhe ligjore të përgjithshme që garantojnë kontrollin gjyqësor mbi aktin administrativ.

C. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

160. Kolegji vlerëson se pretendimi themelor i palës së paditur, Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, në të dyja shkallët e gjykimit, pretendim i parashtruar edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, ka qenë mbi mungesën e juridiksionit gjyqësor për kontrollin e vendimit të KMCAP Epror, pranë Instituti të Sigurimeve Shoqërore, për shkak të parashikimit të nenit 39/1, pika 3, të ligjit nr. 7703/1993.

161. Sipas analizës dhe interpretimit të kryer nga Kolegji në këtë vendim njësues, rezulton se ky pretendim i palës së paditur është i pabazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në vendimin e GJEDNJ-së, në çështjen *"Dauti kundër Shqipërisë"* dhe në dispozitat e tjera ligjore që njohin të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj këtij akti administrativ, sikurse janë cituar më sipër. Kolegji vlerëson se me të drejtë gjykatat më të ulëta kanë pranuar se mosmarrëveshja i përket juridiksionit gjyqësor.

162. Nga ana tjetër, pretendimet e palës së paditur në rekurs, mbi mënyrën e vlerësimit të provave, nga gjykatat më të ulëta, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin rishikues të Gjykatës së Lartë dhe si të tilla janë të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenet 62 dhe 63, shkronja "e", të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 2318, datë 5.6.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
2. Ky është vendim për njësimin e praktikës gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më datë 22.7.2021.

Anëtar: Sokol Sadushi (kryesues), Ervin Pupe, Ilir Panda, Albana Boksi, Sokol Binaj

VENDIM
Nr. 23-2021-712, datë 27.7.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Ilir Panda	kryesues;
Albana Boksi	anëtare;
Sokol Binaj	anëtar;
Sandër Simoni	anëtar;
Klodian Kurushi	anëtar,

sot, në datë 27.7.2021, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale, që u përket:
KËRKUES: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar
OBJEKTI: Parashtrim i mosmarrëveshjes së kompetencës drejtuar Gjykatës së Lartë.
BAZA LIGJORE: Neni 90 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.
Në çështjen penale:
VIKTIMA AKUZUESE: Lulzim Basha
I AKUZUARI: Erion Veliaj
Me pjesëmarrjen e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
OBJEKTI: Gjykimin e të akuzuarit për veprën penale "Shpifja", parashikuar nga neni 120/2, të Kodit Penal.
BAZA LIGJORE: Neni 120 i Kodit Penal, nenet 59, 60, 75/b, 83 dhe 89, të Kodit të Procedurës Penale; neni 8/2, i ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar".

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Ilir Panda, mbrojtësit e viktimës akuzuese, Lulzim Basha, që kërkuan nga Kolegji Penal zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, duke përcaktuar Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si gjykatë kompetente, mbrojtësit e të akuzuarit, Erion Veliaj, që kërkuan zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, duke përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si gjykata kompetente, prokurorin e Prokurorisë së Posaçme, që kërkoi zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, duke përcaktuar Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si gjykatë kompetente, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Lulzim Basha, me cilësinë procedurale penale të viktimës akuzuese, i është drejtuar Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me dy kërkesa penale, duke kërkuar gjykimin e të akuzuarit Erion Veliaj për veprën penale "Shpifja", kryer botërisht, parashikuar nga neni 120, paragrafi i dytë i Kodit Penal, konkretisht me kërkesën penale nr. 115/11 akti, datë 5.10.2020 dhe kërkesën penale nr. 117 akti, datë 6.10.2020. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin datë 26.10.2020, ka vendosur bashkimin e këtyre dy kërkesave penale, në bazë të neneve 79 dhe 92, të Kodit të Procedurës Penale, dhe gjykimin e tyre në një të vetme.

2. Nga aktet rezulton se viktima akuzuese, Lulzim Basha, është Kryetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë, ndërsa i akuzuari, Erion Veliaj është Kryetar i Bashkisë Tiranë. Viktima akuzuese ka pretenduar se i akuzuari, në datën 24.9.2020, ka qenë i ftuar në emisionin "Opinion", në televizionin kombëtar "Klan", dhe aty ka shpifur për viktimën akuzuese duke pretenduar edhe se ka prova për to. Gjithashtu, në datën 2.10.2020, ka qenë duke drejtuar fushatën elektorale në Tiranë dhe ka vijuar të thellojë shpifjen në drejtim të viktimës akuzuese. Viktima akuzuese ka pretenduar se i akuzuari ka konsumuar veprën penale "Shpifja", duke deklaruar një sërë thëniesh të pavërteta, prandaj i është drejtuar gjykatës me kërkesën objekt gjykimi.

3. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11 akti, datë 2.2.2021,** ka vendosur: *"Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes penale nr. 11 Regj. Themeltar, datë regjistrimi 5.10.2020, me viktimë akuzuese Lulzim Basha, të akuzuar Erion Veliaj, për veprën penale "Shpifja", parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal.*

Dërgimin e akteve Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si gjykatë kompetente për gjykimin e kësaj çështje penale.".

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndër të tjera, ka arsyetuar se në rastin konkret kompetente për gjykimin e kësaj çështje është Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Kjo pasi, në nenin 75/a, të K. Pr. Penale, nën titullin "Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar", parashikohet shprehimisht se: *"Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e; b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal; c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Larte të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj; ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.".* Gjykata arsyeton se, nga faktet që viktima akuzuese i atribuon të akuzuarit, rezulton se ky i fundit, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ka shpifur ndaj viktimës akuzuese. Ndodhur në këto kushte, kompetente për ta gjykuar këtë çështje sipas nenit 75/a, germa "c", të K. Pr. Penale, është Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

5. Aktet i kanë kaluar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Përfaqësuesi i të akuzuarit dhe prokuroria kërkuan para gjykatës ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës para Gjykatës së Lartë, pasi kanë pretenduar se kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje e ka Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. **Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me vendimin nr. 27, datë 11.3.2021,** ka vendosur: *"Ngritjen para Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë të çështjes së mosmarrëveshjes për kompetencë lëndore në shqyrtimin e çështjes penale nr. 77 Regj. Themeltar, datë 26.2.2021, me viktimë akuzuese Lulzim Basha, të akuzuar Erion Veliaj, për veprën penale "Shpifja", të parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal midis Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.".*

7. Gjykata e Posaçme, në ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, ndër të tjera, ka arsyetuar se në nenin 135/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili ruan parashikimin e akteve ndërkombëtare për gjykatën e krijuar me ligj, parashikohet se: *"Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.".* Në paragrafin e dytë, të nenit 135, po të ligjit themelor, parashikohet se: *"Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur".*

8. Po në nenin 148/dh/1, të Kushtetutës, përcaktohet se: *"Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë".* Gjithashtu, formulimi i nenit 75/a, të ligjit procedural penal aktual, me ndryshimet e bëra në ligjin nr. 35/2017, është i ndryshëm në termat e përdorura nga dispozita 75/a/2, e K. Pr. Penale, para ndryshimeve të mësipërme,

duke vënë në dukje qëllimin e legjislatorit në përcaktimin e kompetencës lëndore të Gjykatës së Posaçme, duke përfshirë subjektet e posaçme vetëm për akuzat penale, në ndryshim nga kompetenca e Gjykatës së Lartë si gjykatë e juridiksionit fillestar për këto subjekte.

9. Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, me ndryshimet aktuale, në paragrafët e tij përshkrues, përdor termat: "krime", "vepër penale" dhe "akuzë penale", duke treguar dhe qëllimin e ligjvënësit në këtë detajim, lidhur me përcaktimin e kompetencës lëndore të Gjykatës së Posaçme. Në analizë gramatikore (literale) të termave të përdorur, kjo gjykatë analizon se paragrafi i parë/pika "a", e nenit 75/a, i referohet termit "krime", duke përjashtuar kundërvajtjet penale dhe duke mos lënë vend për diskutime, me citimin edhe të dispozitës përkatëse që emërton krimet që janë në kompetencën lëndore të Gjykatë së Posaçme.

10. Paragrafi i dytë/pika "b", e nenit 75/a, i referohet termit "vepër penale" si term përgjithësues, por i kryer në një nga format e veçanta të bashkëpunimit (grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur), përkufizimi i të cilave jepet në nenin 28, të Kodit Penal, duke qenë tërësisht i qartë edhe ky parashikim i kompetencës lëndore nga ligjvënësi. Paragrafi i tretë dhe i katërt/pikat "c" dhe "ç", të nenit 75/a, janë të lidhura mes tyre për shkak të subjekteve që u referohen dhe për shkak të referimit të të njëjtit term "akuzë penale", e cila përmendet jo vetëm në nenin 75/a të ligjit procedural penal, por edhe në dispozita të tjera të tij, pa përkufizuar kuptimin e termit "akuzë penale" të përdorur.

11. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, nisur nga parashikimi i nenit 6, të Konventës Evropiane, koncepti "akuzë penale" ka një kuptim "autonom", të pavarur prej kategorizimeve të përdorura nga sistemet juridike kombëtare të shteteve anëtare (Adolf k. Austrisë, §30). Koncepti i "akuzës" duhet të merret në kuptimin e Konventës. Prandaj, ai mund të përkufizohet si njoftimi zyrtar i një individi, nga ana e autoritetit kompetent, se mendohet që ka kryer një "vepër penale", përkufizim ky që varet gjithashtu nga ekzistenca ose jo e "pasojave të rëndësishme në situatën e të dyshuarit" (Deweer k. Belgjikës, §§42 dhe 46; Eckle k. Gjermanisë, §73).

12. Përveç jurisprudencës së GJEDNJ-së, edhe teoria e së drejtës procedurale penale njeh termat akuzë penale dhe akuzë private në procesin penal, duke iu referuar me akuzë penale asaj të përpiluar nga prokurori në ushtrim të ndjekjes penale, në përputhje me funksionin kushtetues dhe procedural të tij, dhe akuzë private atë të ngritur nga viktima akuzuese ndaj autorit të veprës penale, për vepra penale të parashikuara nga ligji penal. Në vlerësim të kësaj gjykate, mbështetur mbi kuadrin ligjor të analizuar me sipër, parashikimet e të cilit janë në harmoni dhe koherencë mes tyre, Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk është gjykatë kompetente dhe e krijuar me ligj për të gjykuar kërkesat e paraqitura nga viktimat akuzuese ndaj personave të akuzuar, të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale. Kërkesat me viktimë akuzuese për veprat penale të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale duhet të gjykohen nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

13. **Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, meqenëse ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatës së juridiksionit të posaçëm (GJKKO), si dhe Gjykatës së Lartë kishte qëndrime të ndryshme,** në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, me vendimin e datës 4.5.2021, **vendosi kalimin e çështjes penale me nr. 52810-227-2021, datë regjistrimi 30.3.2021, për shqyrtim në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen**:

Cila është gjykata kompetente për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale?

14. Në seancë gjyqësore, mbrojtësit e viktimës akuzuese, Lulzim Basha, kërkuan nga Kolegji Penal zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, duke përcaktuar Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si gjykatë kompetente, duke parashtruar këto argumente:

- Nga përmbajtja e neneve 75/a dhe 75/b, të KPP-së, të bie në sy fakti se kompetenca e gjykimit të kategorisë së subjekteve të posaçme/funksionarëve publikë, të cilët para ndryshimeve me ligjin nr. 35, viti 2017, ishin në kompetencë (juridiksion fillestar) të Gjykatës së Lartë, me shfuqizimin e pikës 2, të nenit 75/b, kompetenca lëndore për gjykimin e tyre i ka kaluar Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Por, ndërsa në nenin 75/b, pika 2, të KPP-së (para ndryshimeve me ligjin 35/2017), ligjvënësi parashikonte "veprat penale" të kryera nga funksionarët publikë, në dispozitën aktuale të nenit 75/a/"c", të këtij kodi, bën fjalë për "akuza penale" kundër kësaj kategorie të veçantë të subjekteve të veprës penale.

- Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që normojnë ushtrimin e funksioneve të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme pranë kësaj gjykate në gjykimin e akuzës penale ndaj funksionarëve publikë, nuk e kufizojnë gjykimin e tyre vetëm me shqyrtimin "akuzës publike" dhe as përjashtojnë "akuzën private", por, kanë përcaktuar në kompetencë lëndore të asaj gjykate të gjithë "akuzat

penale" pa përjashtim, në ngarkim të tyre, natyrisht kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

- Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 3/2008, ka arritur në përfundimin se përmbajtja e nenit 59/1, të Kodit të Procedurës Penale, nuk bie ndesh me nenin 148/1, të Kushtetutës. Ato plotësojnë njëri-tjetrin në funksion të harmonizimit më të mirë të interesit publik me atë privat. Ligjvënësi ka pasur për qëllim t'i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre. Megjithatë, edhe në këto raste, ligji procedural penal nuk e shmang pjesëmarrjen e prokurorit në gjykimin e këtyre çështjeve. Prokurori jo vetëm merr pjesë në gjykimin e të pandehurit, por sipas rastit, kërkon dënimin ose pafajësinë e tij.

- Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e ka pranuar tanimë faktin që është kompetente në shqyrtimin e kësaj kërkese dhe se sot ndodhemi përpara një praktike të unifikuar dhe të pranuar nga gjykatat e kompetencave të ndryshme. Për rrjedhojë, sot kemi të bëjmë me një praktikë të konsoliduar dhe ndaj ne kërkojmë që në unifikimin e praktikës gjyqësore Gjykata e Lartë të vendosi si gjykatë kompetente, për shqyrtimin e këtyre kërkesave penale, ku i akuzuar është një prej subjekteve të veçanta të ligjit, dhe më konkretisht të nenit 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, të jetë Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

15. Mbrojtësit e të akuzuarit, Erion Veliaj, kërkuan nga Kolegji Penal zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, duke përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si gjykatë kompetente, duke parashtruar këto argumente:

- Në teorinë e të drejtës procedurale penale, ndjekja penale nënkupton kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji, me qëllim vërtetimin e akuzës së ngritur nga prokurori. Procedimi i personit të akuzuar, për kryerjen e një vepre penale nga organi i ngarkuar me këtë funksion, përfshin hetimin e plotë nga organi i akuzës, mbi bazën e të cilit gjykata do të vendosë fajësinë ose pafajësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale. Procedimi penal është tagër e prokurorisë dhe i takon këtij organi, në bazë të nenit 148/1 të Kushtetutës dhe nenit 24/3 të KPP-së, të ushtrojë ndjekjen penale dhe të ngrejë akuzë publike në emër të shtetit, nëse ndodhet para kryerjes së një vepre penale, të parashikuar si të tillë nga Kodi Penal (shih vendimin nr. 3, datë 6.2.2008, të Gjykatës Kushtetuese).

- Akuza private është akti me të cilin personi i dëmtuar manifeston vullnetin për të iniciuar procedimin penal dhe për të venë para përgjegjësisë autorin e një vepre penale nga e cila personit të dëmtuar, sipas vlerësimit të tij, i kanë ardhur pasoja negative. I dëmtuari akuzues mund të përcaktohet si titullar i interesit juridik të mbrojtur nga norma që pretendohet se është cenuar nga vepra penale dhe KPP-ja i njeh atij cilësinë e "subjektit të procesit" (shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

- Sipas nenit 148/dh, të Kushtetutës, Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën përpara gjykatave të posaçme, të parashikuar nga neni 135/2 të Kushtetutës, si edhe para Gjykatës së Lartë. Pra, është Kushtetuta ajo që ka përcaktuar funksionet e prokurorisë për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzave përpara gjykatës së posaçme.

- Në të gjitha këto raste, akuza e ngritur përpara gjykatës së posaçme përfaqësohet nga Prokuroria e Posaçme pranë kësaj gjykate. Duke qenë kështu, edhe akuzat hetohen në të gjitha fazat nga Prokuroria e Posaçme. Veprat e hetuara janë përgjithësisht të rënda e që e cenojnë së tepërmi rendin publik.

- Në krahasim me akuzat që hetohen nga Prokuroria e Posaçme, akuza private ngrihet për vepra penale me një rrezikshmëri tepër të lehtë shoqërore dhe nuk e cenojnë rendin publik. Sipas nenit 148/dh, paragrafi i parë, i Kushtetutës, ndjekja penale dhe ngritja e akuzës penale ndaj funksionarëve publikë është e drejta ekskluzive e Prokurorisë së Posaçme, kurse ngritja e akuzës private është në tagrin ligjor të çdo personi të dëmtuar dhe kjo kërkon gjithashtu, domosdoshmërish, praninë e prokurorit.

- Përgjatë zhvillimit të së drejtës procedurale penale, parashikohej se gjykimi i funksionarëve të lartë publikë bëhej në Gjykatën e Lartë, me juridiksion fillestar. Kjo gjykatë gjykonte të gjithë veprat e kryera nga këta funksionarë, pavarësisht nëse akuza ngrihej nga prokuroria apo vetë shtetasi, viktima akuzuese.

- Rezulton se tashmë është bërë një ndarje në nivel kushtetues, sipas të cilit është Prokuroria e Posaçme ajo që përfaqëson akuzën përpara gjykatave të posaçme. Në çdo rast tjetër, pra, kur akuza përfaqësohet nga viktima akuzuese, pikërisht për shkak të këtij parashikimi kushtetues, gjykata e posaçme nuk ka kompetencë që të gjykojë kërkesën e viktimës akuzuese.

- Në këndvështrimin historik apo të shkakut për të cilin janë krijuar organet e hetimit të posaçëm, ky konkluzion është i kuptueshëm dhe logjik, pasi veprat penale që ndiqen me kërkesën e viktimës nuk janë me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

- Ligjvënësi ka pasur parasysh se nuk është në interesin publik ushtrimi i ndjekjes penale dhe, sipas rastit, dënimi i autorit të një vepre me pasoja të vogla ose të një mase të tillë që nuk rrezikojnë shëndetin, pasurinë apo jetën e të dëmtuarit. Ligjvënësi është përpjekur të vendosë një balancë sa më të drejtë midis interesave publikë, nga njëra anë, të përfaqësuara dhe të mbrojtura nga prokuroria, dhe interesave private nga ana tjetër, që lidhen ngushtë me individin, dhe që për këtë arsye mund të mbrohen drejtpërdrejt prej tij (shih vendimin nr. 03/2008, i Gjykatës Kushtetuese).

- Në bazë të dispozitave ligjore të sipërcituara, çmojmë se Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk është kompetente për gjykimin e akuzave private ndaj funksionarëve publikë sipas nenit 75/a, të K. Pr. Penale, pasi akuza përpara kësaj gjykate, sipas parashikimit kushtetuese, neni 148/dh, përfaqësohet vetëm nga Prokuroria e Posaçme.

16. Prokurori pranë Prokurorisë së Posaçme kërkoi nga Kolegji Penal zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës duke përcaktuar Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si gjykatë kompetente, duke parashtruar ndër të tjera këto argumente:

- Në rastet kur ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës, ndjekja penale ushtrohet nga prokuroria, është krejtësisht e qartë që kompetenca për gjykimin e tij është e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Por në rastin konkret, pyetja që shtrohet për diskutim është: "A jemi para gjykimit të një akuze penale ndaj shtetasit Erion Veliaj, me funksion Kryetar i Bashkisë Tiranë?

- Kodi Penal, në nenin 120, parashikon "Shpifjen", si vepër penale. Kjo dispozitë përcakton qartë, në dy paragrafë, anën objektive se si kryhet kjo vepër penale dhe masën konkrete të dënimit për autorët e kryerjes së saj. Kodi Procedurës Penale, në nenin 59, parashikon që ndjekja penale në rastet e "Shpifjes" ushtrohet me kërkesë të të dëmtuarit (viktima akuzuese). Ndërkohë prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.

- Për sa më sipër, është krejtësisht e qartë që "Shpifja" është një vepër penale e dënueshme, e parashikuar në Kodin Penal. Për autorët e kryerjes së kësaj vepre penale Kodi Penal parashikon masa konkrete dënimi, të cilat ndryshojnë nga paragrafi i parë në të dytin në varësi të rrethanave të kryerjes së veprës. Kërkesa për fillimin e gjykimit ndaj të pandehurit paraqitet drejtpërdrejt në gjykatë nga i dëmtuari (viktima akuzuese), i cili paraqet dhe provat përkatëse për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit. Prokurori merr pjesë në gjykim dhe në përfundim të gjykimit kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.

- Parashikimet e mësipërme ligjore përcaktojnë qartë së në rastet e ndjekjes penale me kërkesë të dëmtuarit (viktima akuzuese), jemi para një situate ku pretendohet se ka ndodhur një vepër penale, por që kërkesën për gjykim dhe paraqitjen e provave e bën i dëmtuari, ndërkohë prokurori merr pjesë pasiv gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në përfundim, në varësi të provave të paraqitura nga i dëmtuari, kërkon para gjykatës dënimin ose pafajësinë e të pandehurit. Kjo lloj zgjidhjeje ligjore është dhënë nga ligjvënësi nisur nga rrezikshmëria më e ulët shoqërore e këtyre veprave penale dhe autorëve të dyshuar, por nga kjo zgjidhje procedurale nuk mund të vihet në dyshim fakti se jemi para një akuze penale kundër një të pandehuri për të cilën do të shprehet me vendim gjykata nëse është fajtor ose i pafajshëm.

- Kodi Procedurës Penale, në nenin 75/a/c, përcakton Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si gjykatë kompetente për gjykimin e akuzave penale kundër subjekteve të posaçme (në rastin konkret Kryetari i Bashkisë Tiranë). Kjo është e shprehur qartë dhe në asnjë moment nuk përmendet apo nënkuptohet fakti që Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente vetëm për shqyrtimin e akuzave penale të paraqitura nga prokuroria dhe jo për ato të paraqitura nga të dëmtuarit (viktima akuzuese).

- Nga sa më sipër, bazuar në nenet 91, 438 dhe 441/2, të Kodit të Procedurës Penale, kërkojmë njësimin e praktikës gjyqësore duke formuluar rregullin e së drejtës për çështjen e shtruar për zgjidhje: *"Në rastet e gjykimit të akuzave penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, gjykatë kompetente është Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar."*.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

17. Paraprakisht, vlen të evidentohet fakti i ndryshimeve ligjore që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 41/2021, hyrë në fuqi në datën 29.5.2021. Në nenin 38, të ligjit nr. 41/2021, mbi dispozitat tranzitore, parashikohet se: *"1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre"*. Në kuptim të kësaj dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues, si dhe procedurën e gjykimit, Kolegji Penal

zbaton parashikimet e ligjit nr. 41/2021, ndërsa në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit, i referohet ligjit procedural që ka qenë në fuqi në kohën e depozitimit të tij.

18. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se në çështjen në shqyrtim ekziston konflikti për kompetencë, pasi dy gjykata të ndryshme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (në vijim GJKKO), nuk pranojnë të gjykojnë çështjen e paraqitur, konkretisht kërkesën e paraqitur nga viktima akuzuese, Lulzim Basha, kundër të akuzuarit, Erion Veliaj, sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim K. Pr. Penale).

19. Kodi i Procedurës Penale, në kreun II, seksionin V, titulluar "Mosmarrëveshjet për kompetencat", nenet 89, 90 dhe 91, të Kodit të Procedurës Penale, ka parashikuar rastet e mosmarrëveshjeve, mënyrën e parashtrimit të tyre dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për kompetencë. Neni 89/1 i Kodit Procedurës Penale parashikon: *"Ka mosmarrëveshje, në çdo gjendje a shkallë të procedimit, kur dy a më shumë gjykata në të njëjtën kohë marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën akuzë, që i atribuohet të njëjtit person."*.

20. Neni 90 i këtij Kodi parashikon parashtrimin e mosmarrëveshjes në këtë mënyrë: *"Mosmarrëveshja mund të parashtrohet nga prokurori pranë njërës prej gjykatave në mosmarrëveshje ose nga i pandehuri dhe palët private. Parashtrimi paraqitet në sekretarinë e njërës prej gjykatave në mosmarrëveshje, me kërkesë të shkruar e të motivuar, të cilës i bashkohet dokumentacioni i nevojshëm. 2. Gjykata që ngre çështjen e mosmarrëveshjes, merr vendim, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj, duke treguar palët dhe mbrojtësit. 3. Gjykata që ka dhënë vendimin, njofton menjëherë gjykatën në mosmarrëveshje."*.

21. Neni 91 e në vijim, i Kodit parashikon: *"1. Mosmarrëveshjet zgjidhen nga Gjykata e Lartë me vendim. Gjykata merr të dhënat, aktet dhe dokumentet që i çmon të nevojshme. 2. Vendimi u komunikohet menjëherë gjykatave në mosmarrëveshje, prokurorive përkatëse, të pandehurit dhe palëve private."*.

22. Kolegji vlerëson se parashtrimi i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk është i drejtë, prandaj aktet duhet t'i kthehen kësaj gjykate, me qëllim vazhdimin e gjykimit të çështjes, referuar argumentimit që do të trajtohet në vijim. Gjithashtu, Kolegji Penal, në dhomën e këshillimit të datës 4.5.2021, vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a, i Kodit të Procedurës Penale. Fillimisht, Kolegji çmon me vend të sqarojë se përse lindi nevoja për njësim të praktikës gjyqësore, në lidhje me çështjen objekt gjykimi, dhe përse është e nevojshme të përcaktohet çështja/çështjet që do të shtrohen për njësim nga Kolegji.

23. Kolegji vlerëson se vendimmarrja e tij, në lidhje me çështjen e mësipërme, duhet të shërbejë si vendimmarrje njësuese, pasi është konstatuar se ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatës së juridiksionit të posaçëm, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (GJKKO), si dhe Gjykatës së Lartë ka qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a, i Kodit të Procedurës Penale.

24. **Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-254, datë 19.3.2021,** ka vendosur: *"Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke përcaktuar si Gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar."*. Nga ana tjetër, konstatohet se në Gjykatën e Lartë janë paraqitur një sërë çështjesh për mosmarrëveshje kompetence ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatës së juridiksionit të posaçëm (GJKKO), në lidhje me çështjen e mësipërme. Rezulton se midis këtyre gjykatave ka qëndrime të ndryshme se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a, i Kodit të Procedurës Penale.

25. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se jemi në kushtet që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të shprehet me një vendimmarrje njësuese, konform nenit 438/1, të K. Pr. Penale, që parashikon: *"Kolegji Penal, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njësuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore."*.

26. Kolegji Penal, në dhomë këshillimi, vendosi që çështja e shtruar për njësim të praktikës gjyqësore nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të jetë si më poshtë:

- Cila është gjykata kompetente për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a, i Kodit të Procedurës Penale?

27. Pasi trajtoi arsyen e njësimit të praktikës gjyqësore, në lidhje me çështjen e mësipërme dhe çështjen e shtruar për njësim, Kolegji vendos të ndalet në trajtimin e pyetjes njësuese dhe në vijim në zgjidhjen e çështjes konkrete. Në çështjen objekt gjykimi, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shpallur moskompetencën lëndore për gjykimin e çështjes penale, me argumentimin se kemi të bëjmë me një akuzë penale të ngritur ndaj

Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Ky është një subjekt i posaçëm dhe referuar nenit 75/a, të K. Pr. Penale, kompetencën lëndore për gjykimin e akuzave penale të ngritur ndaj tij, sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka Gjykata e Posaçme.

28. Nga ana tjetër, GJKKO-ja, në parashtrimin e mosmarrëveshjes së kompetencës, ka parashtruar se neni 75/a, i K. Pr. Penale, kur i referohet akuzës penale nuk përfshin akuzën e ngritur nga viktima akuzuese, sipas nenit 59, të K. Pr. Penale. Sipas GJKKO-së kjo është akuza private e njohur në të drejtën procedurale penale, e cila nuk përfshihet në kuptimin e akuzës penale që përcakton neni 75/a, i K. Pr. Penale, si kompetencë lëndore e Gjykatës së Posaçme. Kompetencë e saj është gjykimi vetëm i akuzave penale ndaj subjekteve të posaçme, akuza që përfaqësohen në gjykim nga Prokuroria e Posaçme, ndërsa akuzat e tjera të ashtuquajtura private, janë kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

29. Neni 75/a i K. Pr. Penale (i ndryshuar me ligjin nr. 41/2021) përcakton kompetencën lëndore të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në këtë mënyrë: *"Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të Kodit Penal;*

b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.".

30. Në çështjen objekt gjykimi, para Kolegjit shtrohet detyra e interpretimit të termit "akuzë penale" parashikuar nga pika "c" dhe "ç", e nenit 75/a të K. Pr. Penale. Në kuadër të zgjidhjes drejtë të çështjes objekt gjykimi nga ky Kolegj, lind nevoja për përcaktimin, nëse tek akuza penale e përcaktuar nga neni 75/a i Kodit përfshihen edhe kërkesat e paraqitura nga viktima akuzuese kundër subjekteve të posaçme, sipas nenit 59 të K. Pr. Penale.

31. Kolegji vlerëson të nevojshëm rikonfirmimin e qëndrimit se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Ky Kolegj thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale, me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejtë *(shih vendimin nr. 917, datë 11.5.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).*

32. Kompetenca lëndore është një parakusht procedural, i cili determinon konceptin e gjykatës së krijuar me ligj. "Gjykata e krijuar me ligj" është pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar edhe nga neni 6/1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim KEDNJ). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka trajtuar kuptimin e "gjykatës së krijuar me ligj", duke përcaktuar se në kuadër të procesit të rregullt ligjor gjykatat gjithmonë duhet të jenë të krijuara me ligj. Kjo shprehje pasqyron parimin e shtetit të së drejtës që është pjesë e pandarë e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, parashikuar nga KEDNJ-ja dhe Protokollet e saj.[2] Një organ i pa krijuar me ligj, do të privohej nga legjitimiteti i kërkuar në një shoqëri demokratike për të dëgjuar ankesat e individëve.[3]

33. Termi "ligj", në kuptim të nenit 6/1 të KEDNJ-së, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, përfshin, në veçanti, jo vetëm legjislacionin që përcakton krijimin dhe funksionimin (kompetencën) e organeve gjyqësore por edhe çdo dispozitë ligjore të legjislacionit të brendshëm që, nëse shkelet, do ta shndërronte pjesëmarrjen e një ose

[2] Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, *Jorgic v Germany* nr. aplikimi 74613/01, datë 12.7.2007, paragrafi i 64; *Richert v Poland* nr. aplikimi 54809/07, datë 25.1.2012, paragrafi 41.

[3] Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, *Lavents v Latvia* nr. aplikimi 58422/00, datë 28.2.2003, paragrafi 114; *Gorgiladze v Georgia;* nr. aplikimi 4313/04, datë 20.10.2009, paragrafi 67; *Kontalexis v Greece* nr. aplikimi 59000/08, datë 21.11.2011, paragrafi 38.

më shumë gjyqtarëve në shqyrtimin e një çështje konkrete në një pjesëmarrje të paligjshme.[4] Shprehja "e caktuar me ligj" përfshin bazën ligjore për ekzistencën e gjykatës, pajtueshmërinë e veprimtarisë së gjykatës me normat e veçanta që rregullojnë veprimtarinë e saj, si dhe përbërja (kompozimi) e gjykatës në çdo rast që ajo merr në shqyrtim.[5]

34. Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese evropiane, ndër vite, kanë përpunuar disa kritere themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash, gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete[6] dhe ky është rregulli i përgjithshëm se si një gjykatë e zakonshme merr juridiksion dhe kompetencë për çështjet. Megjithëse në të drejtën pozitive procedurale penale, në fuqi, në Republikën e Shqipërisë nuk parashikohet në mënyrë eksplicite parimi i gjyqtarit natyral të çështjes, dispozitat ligjore në frymën e tyre, parimet kushtetuese dhe sidomos jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka pranuar se rendi juridik, një ndër elementet kryesor të gjykatës së caktuar me ligj, ka standardin e gjyqtarit natyral, standard[7] i cili është nga ana tjetër edhe e drejtë themelore e individit. Qëllimi i krijimit dhe mbrojtjes kushtetuese të kësaj figure shtetërore është te nevoja për të qenë tej çdo dyshimi dhe mundësie e paanshme përgjatë gjithë procesit gjyqësor. Nëpërmjet këtij parimi dhe kësaj figure ligjore të autoritetit shtetëror kompetent për të zgjidhur një mosmarrëveshje, shteti i së drejtës siguron garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nëpërmjet një gjyqtari kompetent, të pavarur dhe të paanshëm.

35. Kjo do të thotë se në momentin kur çdo subjekt është bërë titullar i një procesi gjyqësor dhe përballë tij Republika ka caktuar një gjyqtar apo trupë gjykuese, që në kohën dhe momentin e caktimit ka marrë juridiksion dhe kompetencë, çdo lloj kompetence, në bazë dhe për zbatim të ligjit, ka garancinë e akteve të gjithëpushtetshme juridike se nuk do të ketë mundësi që ky gjyqtar apo trupë gjykuese të spostohet, ndryshohet *(translatio iudicii)* apo të shndërrohet më vonë *ex ante factum* në gjykatë/gjyqtar pa juridiksion ose jokompetent. Bëjnë përjashtim këtu rastet kur gjykata suprimohet dhe nuk ekziston më apo kur Kushtetuta, marrëveshja ndërkombëtare apo ligji me shumicë të cilësuar, për arsye objektive dhe reformuese të institucioneve të drejtësisë, urdhërojnë në mënyrë eksplicite, nëpërmjet dispozitave tranzitore, ndryshe *(shih vendimin njësues të Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2018-148, datë 4.4.2018).*

36. Duke iu rikthyer çështjes së shtruar për njësim, Kolegji vlerëson se për të përcaktuar në mënyrë të qartë kuptimin e akuzës penale, të përcaktuar nga neni 75/a i K. Pr. Penale, është e nevojshme të ndalet në interpretimin historik, logjik, sistematik e së fundi në interpretimin literal të dispozitës.

37. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e miratuar në vitin 1998, në nenin 141 parashikonte: *"Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.".* Gjykata e Lartë, sipas këtij parashikimi kushtetues, kishte juridiksion fillestar të gjykonte akuzat penale kundër funksionarëve të lartë shtetërorë. Gjykata e Lartë gjykonte të gjitha akuzat penale të ngritura ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pavarësisht faktit nëse akuza përfaqësohej në gjykim nga Prokuroria e Përgjithshme, apo nëse ishte akuzë me të dëmtuar akuzues, sipas nenit 59, të K. Pr. Penale. Në juridiksionin fillestar që Kushtetuta i kishte dhënë Gjykatës së Lartë nuk është vënë ndonjëherë në diskutim fakti nëse akuzat e ngritura nga viktima/i dëmtuari akuzues ishin apo jo në kompetencë të saj, pasi çdo akuzë penale e ngritur ndaj subjekteve të posaçme shqyrtohej nga Gjykata e Lartë. Një parashikim i tillë lidhej me garancitë e nevojshme që Kushtetuta ofronte për gjykimin e këtyre subjekteve, për shkak të cilësive të tyre të posaçme dhe funksionit që ushtronin, të lidhur ngushtësisht me interesin publik. Parashikimi kushtetues nuk bënte dallim nëse akuza përfaqësohej nga Prokuroria e Përgjithshme apo nga një subjekt privat, sipas nenit 59 të K. Pr. Penale.

38. Nga ana tjetër, neni 75/b i K. Pr. Penale, para ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 35/2017, parashikonte: *"Gjykata e Lartë gjykon në shkallë të parë, me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë, të caktuar me short, veprat penale të kryera nga Presidenti i Republikës, deputetët, Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kur këta janë në këto funksione në kohën e gjykimit.".*

---

[4] Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, *Pandjikidzeandothers v Georgia* nr. aplikimi 30323/02, datë 27.1.2010, paragrafi 104.

[5] Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, *Posokhov v Russia* nr. aplikimi 63486/00, datë 4.6.2003, paragrafi 39; *Fatullayev v Azerbaijan* nr. aplikimi 40984/07, datë 4.10.2010, paragrafi 144.

[6] Shiko vendimin nr. 31, datë 5.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

[7] Shiko vendimin nr. 31, datë 5.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

39. Më datë 11.8.2016, hynë në fuqi ndryshimet e Kushtetutës, në kuadër të paketës normative të Reformës në Drejtësi. Referuar këtyre ndryshimeve, rezulton se, aktualisht neni 135 i Kushtetutës parashikon: *"Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur."*.

40. Me ndryshimet e miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, në dallim nga sa parashikohej më parë në nenin 135 të Kushtetutës së pandryshuar, ndryshimet e kësaj dispozite, në pikën 2, parashikuan krijimin e një gjykate të posaçme penale, kompetenca lëndore e së cilës parashikohej drejtpërdrejtë në Kushtetutë, njëlloj sikurse parashikohej juridiksioni fillestar penal i Gjykatës së Lartë në nenin 141, pika 1, të Kushtetutës së pandryshuar. Më tej ndryshimet kushtetuese prekën edhe nenin 148 të Kushtetutës, ku ndër të tjera u përcaktua edhe kompetenca lëndore e ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq për prokurorinë. Pika 4, e kësaj dispozite kushtetuese, parashikon se: *"Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme."*.

41. Ndryshimet kushtetuese prekën edhe juridiksionin fillestar penal të Gjykatës së Lartë, duke e hequr këtë atribut të ushtrimit të pushtetit gjyqësor nga kjo gjykatë dhe duke e bërë pjesë integrale të juridiksionit të specializuar penal të gjykatës së posaçme, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës. Gjithashtu, juridiksioni fillestar i ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq i Prokurorisë së Përgjithshme, sipas nenit 141, pika 1, të pandryshuar, të Kushtetutës, i kaloi Prokurorisë së Posaçme.

42. Ky ndryshim i Kushtetutës është pasqyruar edhe në nenin 75/a, të K. Pr. Penale, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 dhe me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, i cili parashikon se: *"Gjykata për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e; b) çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal; c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj; ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës."*.

43. Nga tërësia e dispozitave të mësipërme, arrihet në përfundimin se juridiksioni fillestar që Kushtetuta parashikonte për Gjykatën e Lartë u suprimua, duke i dhënë asaj të drejtën vetëm të gjykimit të çështjeve, lidhur me zbatimin dhe interpretimin e ligjit, referuar nenit 141/1 të Kushtetutës, që parashikon: *"Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit."*.

44. Kolegji vë në dukje se, pas ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, Gjykata e Lartë nuk ka më juridiksion fillestar për gjykimin e akuzave penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë. Kompetencën lëndore për gjykimin e subjekteve të posaçme e ka Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kompetencë lëndore që përcaktohet në nenin 75/a, të K. Pr. Penale. Pra, pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, rezulton se kompetenca që kishte Gjykata e Lartë për të gjykuar: ... *"akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ..."*, i ka kaluar Gjykatës së Posaçme, e cila ndër të tjera, gjykon: ... *"akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave"*.

45. Nga interpretimi i mësipërm historik, Kolegji arrin në përfundimin se juridiksioni fillestar për gjykimin e akuzave penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë i ka kaluar në bllok Gjykatës së Posaçme, e cila, sipas të njëjtit parashikim ligjor, ka të drejtë të gjykojë po akuzat penale të ngritura ndaj këtyre funksionarëve apo akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës. Në këtë linjë arsyetimi, në kushtet kur Gjykata e Lartë gjykonte çdo akuzë penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pavarësisht nëse ajo përfaqësohej nga Prokuroria e Përgjithshme apo ngrihej nga i dëmtuari akuzues edhe Gjykata e Posaçme aktualisht ka kompetencë lëndore të gjykojë të gjitha akuzat penale të ngritura ndaj këtyre funksionarëve të lartë shtetërorë, pa u bërë një diferencim, në lidhje me akuzat e ngritura nga viktima akuzuese, sipas nenit 59, të K. Pr. Penale.

46. Përfundimi i mësipërm arrihet nga Kolegji edhe po të bëhet interpretimi logjik i dispozitave të mësipërme, duke identifikuar qëllimin e ligjvënësit në bërjen e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore. Gjykata e Posaçme e

Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar rregullohet me ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Qëllimi i krijimit të kësaj gjykate ishte krijimi i një gjykate të juridiksionit të posaçëm, e cila do të gjykonte një kategori të caktuar veprash penale që kanë një rrezikshmëri të theksuar shoqërore, për të cilat lindi nevoja për t'u gjykuar nga një gjykatë e posaçme, në kuadër të nevojës për të luftuar korrupsionin dhe veprat penale në fushën e krimit të organizuar, prioritet i shtetit shqiptar, në kuadër të paketës ligjore për reformimin e drejtësisë.

47. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar u krijua në radhë të parë si një gjykatë veprash, pra me qëllimin për të gjykuar një kategori të caktuar veprash penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe që cenojnë dukshëm rendin publik; krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b, të Kodit Penal, si dhe çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal.

48. Së dyti, Gjykata e Posaçme u krijua si një gjykatë subjektesh, pasi kjo gjykatë ka kompetencë të gjykojë të gjitha akuzat penale të kryera nga funksionarët e lartë shtetërorë ose ish-funksionarët e lartë, në rast se veprat penale për të cilat akuzohen janë kryer gjatë kohës që ata kanë qenë në ushtrim të detyrës. Ligjvënësi ka përcaktuar gjykimin e akuzave penale ndaj këtyre subjekteve të posaçme dhe nuk rezulton të ketë bërë dallim, në varësi të faktit se kush e përfaqëson akuzën në gjyq, Prokuroria e Posaçme apo viktima akuzuese, pasi qëllimi i ligjvënësit ka qenë që Gjykata e Posaçme të gjykonte funksionarët e lartë shtetërorë. Kolegji çmon që në kushtet kur ligjvënësi nuk ka bërë dallim në këtë drejtim, atëherë një dallim i tillë nuk mund të bëhet as nga gjykatat, pasi një interpretim i tillë do të ishte tejkalim i parashikimit ligjor dhe gjithashtu i qëllimit që ka pasur ligjvënësi në ndryshimet thelbësore që miratoi me paketën e Reformës në Drejtësi.

49. Së fundmi, Kolegji çmon të nevojshme të kalohet tek interpretimi sistematik dhe literal i dispozitave procedurale penale, për të arritur në një konkluzion të qartë se çfarë do të konsiderohet akuzë penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 75/a, të K. Pr. Penale.

50. Neni 148/1, i Kushtetutës parashikon: *"Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj."*. Nga ana tjetër, paragrafi 4 i kësaj dispozite parashikon se: *"Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës, janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme."*.

51. Neni 24/1, i K. Pr. Penale parashikon: *"Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod."*. Neni 25 i K. Pr. Penale parashikon se: *"Për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i këtij Kodi, funksionet, sipas nenit 24, të tij, ushtrohen në të gjitha shkallët e gjykimit nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme."*.

52. Neni 4, i ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", parashikon: *"Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe Gjykatës së Lartë, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara me ligj."*.

53. Neni 8, i ligjit të mësipërm, parashikon se: *"Kompetenca lëndore parësore e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar parashikohet në nenin 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, por nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, të Kushtetutës. 2. Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokuroria e Posaçme janë kompetente për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo vepër penale, sipas pikës 1, të këtij neni, edhe në rastet kur nuk ngrihet akuzë kundër një zyrtari, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, ose kundër një drejtuesi të një institucioni qendror ose të pavarur, sipas këtij ligji, ose nëse ai zyrtar publik ose zyrtar i lartë largohet gjatë kohëzgjatjes së hetimit."*.

54. Referuar parashikimeve të mësipërme, Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson në gjyq akuzën penale për veprat penale që janë në kompetencë të GJKKO-së, sipas përcaktimit të bërë në nenin 75/a, të K. Pr. Penale. Nga ana tjetër, ligjvënësi për një kategori të caktuar veprash penale parashikon të drejtën e viktimës akuzuese për të paraqitur kërkesë në gjykatë, me qëllim për të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit, sipas nenit 59, të K. Pr. Penale që parashikon: *"1. Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112, paragrafi i parë, 119,119/b, 120, 121, 122, 125, 127, dhe 254, të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën*

dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

2. Prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.".

55. Ligjvënësi parashikon se, për një kategori të caktuar veprash penale, viktima akuzuese ka të drejtë të paraqitet vet në gjykim duke pasur si barrë prove vërtetimin e akuzës së ngritur prej tij. Veprat penale për të cilat parashikohet paraqitja e kërkesës nga viktima akuzuese janë vepra penale me një rrezikshmëri më të ulët shoqërore, prandaj ligji parashikon se për këto kategori veprash penale është vet viktima akuzuese që paraqitet në gjyq dhe provon akuzën e ngritur prej saj. Nga ana tjetër, prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.

56. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të K. Pr. Penale, rezulton se procesi gjyqësor penal fillon në bazë të depozitimit në Gjykatë:

- Të kërkesës së prokurorit, i cili në bazë të nenit 148/1 të Kushtetutës, ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit (neni 24/1, i K. Pr. Penale); për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i këtij Kodi, funksionet, sipas nenit 24, të tij, ushtrohen në të gjitha shkallët e gjykimit nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme (neni 25 i këtij Kodi);

- Me kërkesë të viktimës akuzuese (në referim të nenit 60, të K. Pr. Penale) për kategorinë e veprave penale të parashikuara shprehimisht në nenin 59 të këtij Kodi.

57. Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga viktima akuzuese, sipas nenit 59, të K. Pr. Penale, **Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 3, datë 6.2.2008,** me objekt: "Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale", ka vendosur: "*Rrëzimin e kërkesës".*

58. Në arsyetimin e këtij vendimi, ndër të tjera, theksohet se: *" ... si akuza publike ashtu edhe akuza private të parashikuara nga legjislacioni procedural penal janë dy mekanizma që shërbejnë për ndjekjen penale të autorit të veprës penale dhe në asnjë rast ato nuk kanë për qëllim eliminimin e njëra-tjetrës. Ato bashkëveprojnë dhe në raste të caktuara gjejnë zbatim veçmas. Gjykata Kushtetuese rithekson se në asnjë rast akuza publike nuk mund të shmanget. Ajo ushtrohet sa herë që prokuroria krijon bindjen se vepra e kryer cenon rendin publik apo interesin e shoqërisë. Këtë prokuroria e bën edhe duke ndërhyrë në procesin e iniciuar nga i dëmtuari akuzues. (neni 59/2 i Kodit të Procedurës Penale).*

.... në rastet e parashikuara nga neni 59/1, nuk përjashtohet tërësisht pjesëmarrja e prokurorit. Ai ka të drejtë, që gjatë gjykimit të këtyre çështjeve të marrë pjesë duke kërkuar, sipas rastit, fajësinë ose jo të të pandehurit. Përjashtimi i hetimit paraprak nga këto çështje dhe lejimi i të dëmtuarit akuzues për të ngritur akuzë nuk është marrje e kompetencave të prokurorit, por thjesht dhënie e mundësisë të dëmtuarit për të qenë aktiv në një proces ku ai është i interesuar drejtpërdrejtë.

... Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se përmbajtja e nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale nuk bie ndesh me nenin 148/1 të Kushtetutës. Ato plotësojnë njëri-tjetrin në funksion të harmonizimit më të mirë të interesit publik me atë privat. Ligjvënësi ka pasur për qëllim t'i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre. Megjithatë, edhe në këto raste, ligji procedural penal nuk e shmang pjesëmarrjen e prokurorit në gjykimin e këtyre çështjeve. Prokurori jo vetëm merr pjesë në gjykimin e të pandehurit, por sipas rastit, kërkon dënimin ose pafajësinë e tij".

59. Kolegji çmon të nevojshëm edhe trajtimin e mjetit procedural, kërkesën e viktimës akuzuese, parashikuar nga neni 59, i K. Pr. Penale. Së pari, Kolegji vë në dukje se termi akuzë private nuk është një term i parashikuar nga Kushtetuta dhe as nga ligji. Ky term është zhvilluar dhe përpunuar në doktrinën dhe teorinë e të drejtës procedurale penale dhe i referohet kërkesës që paraqitet në gjykim nga viktima/i dëmtuari akuzues, i cili ka detyrimin të përfaqësojë akuzën e ngritur prej tij, si dhe barrën e provës për ta provuar atë. Referuar nenit 59, të K. Pr. Penale, prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij. Nga ana tjetër, prokurori në këtë gjykim nuk përfaqëson akuzën dhe as ka barrën e provës për ta provuar atë. Arsyeja e një parashikimi të tillë ligjor lidhet me kategorinë e veprave penale, që parashikohen nga neni 59, i K. Pr. Penale, të cilat më shumë se interesin publik cenojnë interesin privat të viktimës akuzuese, në funksion të harmonizimit më të mirë të interesit publik me atë privat. Me anë të këtij mjeti procedural, ligjvënësi ka pasur për qëllim t'i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre *(shih vendimin më sipër të Gjykatës Kushtetuese).*

60. Neni 59, i K. Pr. Penale, ka për qëllim t'i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre. Ligjvënësi, me parashikimin e institutit të akuzës private, është përpjekur të vendosë një balancë sa më të drejtë midis interesave publikë, nga njëra anë, të përfaqësuara dhe të mbrojtura nga prokuroria, dhe interesave privatë, nga ana tjetër, që lidhen ngushtë me individin dhe që për këtë arsye mund të mbrohen drejtpërdrejt prej tij.

61. Neni 59, i K. Pr. Penale zbatohet vetëm për veprat penale që parashikohen nga nenet 90, 91, 92, 112, paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, dhe 254 të Kodit Penal, të cilat përmenden në mënyrë taksative në paragrafin e parë të nenit 59. Këto vepra penale karakterizohen nga mungesa e rrezikshmërisë së lartë shoqërore dhe interesi i vogël publik në çështjen konkrete. Sa më serioze të jetë vepra penale ose sa më i madh të jetë rreziku për vepra penale të përshkallëzuara, aq më tepër duhet që ndjekja penale të vazhdojë kryesisht, në interes publik, edhe sikur viktimat t'i kenë tërhequr kallëzimet e tyre.

62. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Kolegji vlerëson se dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, që normojnë ushtrimin e funksioneve të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme pranë kësaj gjykate në gjykimin e akuzës penale ndaj funksionarëve publikë, nuk e kufizojnë gjykimin e tyre vetëm me shqyrtimin "akuzës publike" dhe as përjashtojnë "akuzën private", siç parashtrohet nga GJKKO-ja në mosmarrëveshjen për kompetencë, por kanë përcaktuar në kompetencë lëndore të asaj gjykate të gjithë "akuzat penale" pa përjashtim në ngarkim të funksionarëve të lartë shtetërorë, sipas përcaktimit të nenit 75/a të Kodit, natyrisht kur vepra penale është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

63. Kolegji çmon se pavarësisht rrezikshmërisë më të ulët shoqërore që kanë veprat penale të parashikuara nga neni 59, i K. Pr. Penale, këto vepra penale do të gjykohen nga Gjykata e Posaçme, pikërisht për shkak të faktit se janë akuza penale që ngrihen ndaj subjekteve të posaçme, me funksione të larta shtetërore, të lidhura drejtpërdrejt me interesin publik. Kompetencën Gjykata e Posaçme, në rastin e pikës "c" dhe "ç", të nenit 75/a, të Kodit, e merr pikërisht për shkak se i akuzuar është subjekti i posaçëm dhe nuk kushtëzohet nga lloji i veprës penale apo ndaj faktit se kush e përfaqëson akuzën në gjykim. Në rast se ligjvënësi do të kishte pasur një qëllim të tillë, ai do e kishte parashikuar, siç ka bërë ndarjen në varësi të llojit të veprës penale në pikën "a", të nenit 75/a të K. Pr. Penale.

64. Kolegji çmon se është e vërtetë se GJEDNJ-ja, në çështjen Deweer kundër Belgjikës, është shprehur se "akuza", në kuptimin e nenit 6§1, mund të përkufizohet si *"njoftimi zyrtar i një individi, nga ana e autoritetit kompetent, se mendohet që ka kryer një vepër penale",* megjithatë ky vendim duhet të interpretohet sipas kontekstit të dhënë nga kjo Gjykatë. GJEDNJ-ja, në këtë vendim, por edhe në vendime të tjera, ka mbajtur qëndrimin se një person i ndaluar dhe i detyruar për t'u betuar, përpara se të merrej në pyetje në cilësi dëshmitari, ishte tashmë objekt i një "akuze penale" dhe përfitonte nga e drejta për të heshtur (Brusco kundër Francës, §§46–50). Sipas GJEDNJ-së nuk është përfaqësimi i akuzës nga prokuroria që kushtëzon faktin nëse ka një akuzë të ngritur ndaj të akuzuarit apo jo. Akuza është e tillë, pavarësisht se përfaqësohet nga organi publik apo një subjekt privat. Akuza i referohet atribuimit ndaj të akuzuarit të kryerjes së një vepre penale, e cila sjell pasoja ndaj të akuzuarit, në lidhje me të drejtat apo liritë e tij personale.

65. Për sa i përket kuptimit autonom të termit "penal", sipas GJEDNJ-së, Konventa nuk u kundërvihet prirjeve për "depenalizim" që hasen brenda shteteve kontraktuese. Megjithatë, veprat që pas depenalizimit klasifikohen si "shkelje administrative" mund t'i përkasin kuptimit autonom të veprës "penale". Lënia në dorë të shteteve e kompetencës për t'i përjashtuar këto vepra mund të sillte rezultate të papajtueshme me objektin dhe qëllimin e Konventës (Öztürk k. Gjermanisë, §49).

66. Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka arsyetuar se pikënisja e shqyrtimit të zbatueshmërisë së pjesës penale të nenit 6 të Konventës, mbështetet te kriteret e parashtruara në vendimin *Engel me të tjerë k. Vendeve të Ulëta*, §§82–83, kritere që janë:

1. Cilësimi në të drejtën e brendshme;
2. Natyra e veprës;
3. Ashpërsia e dënimit që rrezikon t'i jepet personit të interesuar.

67. Kriteri i parë është me peshë relative dhe shërben vetëm si pikënisje. Vendimtare është të shihet nëse një vepër klasifikohet apo jo si vepër penale nga e drejta e brendshme. Në mungesë të këtij klasifikimi, Gjykata do të shohë se çfarë ka prapa klasifikimit kombëtar, duke marrë në shqyrtim realitetin substancial të procedurës në fjalë. Kriteri i dytë dhe ai i tretë, që parashtrohen në vendimin *Engel me të tjerë k. Vendeve të Ulëta,* janë alternativë dhe jo medoemos të bashkueshëm; që neni 6 të gjykohet i zbatueshëm, mjafton që vepra në fjalë të konsiderohet, për vetë natyrën e saj, si "penale" nga këndvështrimi i Konventës ose që vepra ta bëjë personin subjekt për një sanksion, i cili, për vetë natyrën dhe shkallën e tij të ashpërsisë, i takon përgjithësisht sferës "penale" *(Lutz k. Gjermanisë, §55; Öztürk k. Gjermanisë, §54).*

68. Sipas GJEDN-sëJ, fakti që një vepër mund të mos jetë e dënueshme me masë burgimi nuk është në vetvete vendimtar, sepse dobësia relative e masës së parashikuar të dënimit nuk e zhvesh një vepër nga karakteri i saj i brendshëm penal *(po aty, §53; Nicoleta Gheorghe k. Rumanisë, §26)*. Megjithatë, mund të zgjidhet një qasje bashkuese në qoftë se një analizë më vete e secilit kriter nuk jep mundësi për të arritur në një përfundim të qartë,

për sa i përket ekzistencës së një akuze në fushën penale *(Bendenoun k. Francës, §47)*. Duke përdorur shprehjet "akuzë penale" dhe "i akuzuar për një vepër", tre paragrafët e nenit 6 u referohen situatave identike. Për rrjedhojë, sipas GJEDNJ-së kriteri i zbatueshmërisë së nenit 6, në pjesën e tij penale, është i njëjti për të tre paragrafët.

69. Sa më sipër, duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ-ja si të rëndësishme në përcaktimin nëse kemi një akuzë penale, në kuptim të nenit 6 të Konventës, arrihet në përfundimin se edhe kërkesa me të dëmtuar akuzues përfshihet në konceptin e akuzës penale. Prandaj, edhe në vështrim të praktikës së GJEDNJ-së, Kolegji vlerëson se akuza penale përfshin si koncept si akuzën e përfaqësuar në gjykim nga prokuroria, ashtu edhe kërkesën e paraqitur nga viktima akuzuese, sipas nenit 59 të K. Pr. Penale.

70. Duke iu rikthyer kuadrit ligjor shqiptar, referuar interpretimit historik të dispozitave kushtetuese dhe atyre procedurale penale, para ndryshimeve të vitit 2016–2017, rezulton se juridiksioni fillestar për akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë iu suprimua Gjykatës së Lartë dhe i kaloi një gjykate të posaçme, Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Kjo gjykatë u krijua si një gjykatë e posaçme për gjykimin e veprave penale të parashikuar nga neni 75/a, paragrafi 1 dhe 2, i K. Pr. Penale, si dhe gjykatë që do të gjykonte subjekte të posaçme, konkretisht ata të parashikuar në paragrafin 3, të nenit 75/a, të Kodit.

71. Pra, rezulton se pas ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, të pasuara me ndryshimet ligjore, juridiksioni fillestar i Gjykatës së Lartë i kaloi Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në kushtet kur Gjykata e Lartë gjykonte të gjitha akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pa u bërë dallimi nëse akuza përfaqësohej nga prokuroria apo nga viktima akuzuese, Kolegji çmon se nuk ka arsye pse një dallim i tillë të bëhet tani që kompetencën lëndore për gjykimin e subjekteve të posaçme e ka Gjykata e Posaçme. Për më tepër, ky dallim nuk mund të bëhet për aq kohë sa nuk e bën vet ligji.

72. Pranimi i interpretimit të bërë nga Gjykata e Posaçme do të cenonte garancitë e vendosura nga vet Kushtetuta dhe ligji, që një kategori e subjekteve të posaçme të gjykoheshin jo nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por nga një gjykatë e juridiksionit të posaçëm, e krijuar enkas për të ofruar garanci shtesë, në drejtim të garantimit të procesit të rregullt ligjor dhe një vendimmarrje të drejtë. Në kushtet kur vet ligjvënësi nuk ka bërë një dallim të tillë, interpretimi tej parashikimit kushtetues dhe ligjor do të cenonte jo vetëm parimin e ligjshmërisë, por edhe atë të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

73. Në mbështetje të këtij arsyetimi të Kolegjit vjen edhe interpretimi logjik, sipas qëllimit që ka pasur ligjvënësi kur ka bërë ndryshimet kushtetuese dhe ato ligjore. Krijimi i Gjykatës së Posaçme, si një gjykatë subjekti, që do të gjykonte funksionarët e lartë shtetërorë, kishte si qëllim ofrimin e garancive shtesë që një kategori e veçantë subjektesh, për shkak të funksionit që mbajnë, e lidhur kjo drejtpërdrejtë me interesin publik, të gjykohen nga një gjykatë e posaçme, që ofron garanci shtesë si për sa i përket përbërjes së saj, mënyrës së zgjedhjes së gjyqtarëve dhe në funksion të rritjes së standardit të procesit të rregullt ligjor. Qëllimi i ligjvënësit ka qenë që juridiksioni fillestar që ushtronte Gjykata e Lartë t'i kalonte një gjykate të posaçme dhe nuk rezulton që ligjvënësi të ketë bërë diferencim te kompetenca lëndore e Gjykatës së Posaçme, në varësi të faktit se kush e përfaqësonte akuzën në gjykim. Në kushtet kur vet ligjvënësi nuk ka bërë një dallim të tillë, Kolegji vlerëson se arsyetimi i Gjykatës së Posaçme, në ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, është një tejkalim i parashikimit ligjor.

74. Kolegji çmon se Gjykata e Posaçme ka interpretuar në mënyrë të ngushtuar, duke i dhënë nenit 75/a, paragrafët 3 dhe 4, një kuptim të ndryshëm nga ai që i ka dhënë ligjvënësi. Ligjvënësi ka përcaktuar se gjykata e posaçme gjykon akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë dhe nuk përcakton se kompetenca i referohet vetëm akuzës që përfaqëson në gjykim Prokuroria e Posaçme. Në kushtet kur Kodi i Procedurës Penale parashikon se akuza në gjykim përfaqësohet nga prokuroria, por mund të ketë edhe kërkesë nga viktima akuzuese, Kolegji vlerëson se kur i akuzuari është një nga subjektet e posaçme, të parashikuara nga neni 75/a i K. Pr. Penale, kompetenca lëndore për gjykimin e këtyre akuzave i përket Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

75. Sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson që lidhje me pyetjen e shtruar për njësim, duhet të arrihet në këtë përfundim njësues:

Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e të gjitha akuzave penale të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e akuzave penale në të cilat akuza në gjykim përfaqësohet nga prokuroria, si dhe për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese, të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm, sipas nenit 59 të K. Pr. Penale.

76. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, referuar përfundimit të mësipërm njësues, Kolegji Penal vendos zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për shqyrtimin e çështjes penale me nr. 227-2021 Regj. Themeltar, datë regjistrimi 30.3.2021, me viktimë akuzuese Lulzim Basha, kundër të akuzuarit Erion Veliaj për veprën penale "Shpifja", parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal, duke përcaktuar Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 91 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

1. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për shqyrtimin e çështjes penale me nr. 227-2021 Regj. Themeltar, datë regjistrimi 30.3.2021, me viktimë akuzuese Lulzim Bashën, kundër të akuzuarit Erion Veliaj për veprën penale "Shpifja", parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal, duke përcaktuar Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes.
2. Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore publikohet në Fletoren Zyrtare të radhës.

Tiranë, më 27.7.2021.

Anëtarë: Ilir Panda (kryesues), Albana Boksi, Sandër Simoni.
Anëtarë kundër: Klodian Kurushi, Sokol Binaj

MENDIM I PAKICËS

1. Ne gjyqtarët, Klodian Kurushi dhe Sokol Binaj, jemi kundër vendimit njehsues të dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në çështjen penale regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 23-2021- vendimi, datë 27.7.2021, që i referohet rastit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes për kompetencë midis Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për gjykimin e veprës penale të "Shpifjes", parashikuar nga neni 120/2, i Kodit Penal, ndaj të akuzuarit Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë.
2. Shtetasi Lulzim Basha, me cilësinë procedurale penale të viktimës akuzuese, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me dy kërkesa penale, duke kërkuar gjykimin e të akuzuarit Erion Veliaj, për veprën penale "Shpifja" kryer botërisht, parashikuar nga neni 120, paragrafi i dytë, i Kodit Penal, konkretisht me kërkesën penale nr. 115/11 akti, datë 5.10.2020 dhe kërkesën penale nr. 117 akti, datë 6.10.2020. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin datë 26.10.2020, ka vendosur bashkimin e këtyre dy kërkesave penale, në bazë të neneve 79 dhe 92, të Kodit të Procedurës Penale, dhe gjykimin e tyre në një të vetme.
3. Nga aktet rezulton se viktima akuzuese, Lulzim Basha, është Kryetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë, ndërsa i akuzuari, Erion Veliaj, është Kryetar i Bashkisë Tiranë. Viktima akuzuese ka pretenduar se i akuzuari, në datën 24.9.2020, ka qenë i ftuar në emisionin "Opinion" në televizionin kombëtar "Klan", dhe aty ka shpifur për viktimën akuzuese duke pretenduar edhe se ka prova për to. Gjithashtu, në datën 2.10.2020, ka qenë duke drejtuar fushatën elektorale në Tiranë dhe ka vijuar të thellojë shpifjen në drejtim të viktimës akuzuese. Viktima akuzuese ka pretenduar se i akuzuari ka konsumuar veprën penale "Shpifja", duke deklaruar një sërë thëniesh të pavërteta, prandaj i është drejtuar gjykatës me kërkesën objekt gjykimi.
4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për këtë çështje të regjistruar pranë saj, shpalli moskompetencën lëndore dhe i dërgoi aktet Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, pasi mori në shqyrtim aktet e sjella, ngriti përpara Gjykatës së Lartë çështjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore që kishte lindur midis dy gjykatave të shkallëve të para.
5. Në përfundim, Gjykata e Lartë, në zgjidhjen e mosmarrëveshjes për kompetencë lëndore, vendosi që Gjykata e Posaçme, në bazë të nenit 75/a, germa "c", të KPP-së, është gjykatë kompetente për gjykimin e kërkesave të paraqitura drejtpërdrejtë në gjykatë nga viktima akuzuese, në bazë të nenit 59, të KPP-së, ku si palë e akuzuar është një prej funksionarëve të parashikuar nga neni 75/a, germa "c", i KPP-së.
6. Një ndër çështjet e shtruara për njehsim i referohej interpretimit të termit "akuzë penale", i parashikuar si i tillë në nenin 75/a, germa "c", të KPP-së. Në vendimin njehsues, Kolegji arriti në përfundimin se

pavarësisht rrezikshmërisë më të ulët shoqërore që kanë veprat penale të parashikuara nga neni 59, i Kodit të Procedurës Penal, këto vepra penale do të gjykohen nga Gjykata e Posaçme, pikërisht për shkak të faktit se janë akuza penale që ngrihen ndaj subjekteve të posaçme, me funksione të larta shtetërore, të lidhura drejtpërdrejt me interesin publik[8].

7. Pakica nuk ndan të njëjtin mendim në lidhje me përfundimin e mësipërm. Formulimi i parashikuar në nenin 75/a, germa "c", të KPP-së, i referohet si burim ligjor nenit 135, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këtë pikë përmbajtja e nenit 75/a, germa "c", të KPP-së, është identike për nga formulimi me përmbajtjen e nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, që i referohet rastit të gjykimit të akuzave penale kundër funksionarëve shtetërorë në Gjykatën e Posaçme. Kështu që interpretimi i termit "akuzë penale" duhet të mbështetet në burimet kushtetuese.

8. Në vlerësimin e pakicës termi "akuzë" dhe "akuzë penale", parashikuar nga nenet 135, pika 2, 148, pika 1, 148/dh, pika 1, në Kushtetutë, përfshin vetëm Organin e Prokurorisë si subjekt kushtetues i ngarkuar me funksionin e ushtrimin të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në emër të shtetit përpara gjykatave. Në funksion të këtij qëllimi, edhe në aneksin e Kushtetutës, në nenin E, pika 2, të saj, që bën fjalë për rastin e "Vlerësimit të aftësive profesionale", përmendet termi "Akuzë Publike". Në asnjë dispozitë kushtetuese nuk është parashikuar mundësia e subjekteve të tjera, të ndryshme nga Prokuroria, të ushtrojnë ndjekjen penale apo/dhe të përfaqësojnë akuzën përpara gjykatave. Në këtë kuptim, Kushtetuta i jep atributin kushtetues vetëm Prokurorisë, si subjekt i saj, për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësuar akuzën në emër të shtetit përpara gjykatave.

9. Si rrjedhim, edhe neni 75/a, germa "c", të Kodit të Procedurës Penale, që është i njëjtë në formulim me nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, në vlerësimin e pakicës, duhej të interpretohej në të njëjtën frymë, duke e lidhur termin e "akuzës penale" me Prokurorinë e Posaçme që është subjekti i vetëm procedural, që pasi ushtron ndjekjen penale në vijim të saj, përfaqëson akuzën përpara gjykatës së posaçme ndaj funksionarëve shtetërorë. Akuza e integruar në kërkesën për gjykim nga viktima akuzuese ndaj të akuzuarit, sipas nenit 59, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale, nuk është njëjtë dhe e barasvlershme me akuzën penale të parashikuar si term nga neni 135, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 75/a, germa "c", i Kodit të Procedurës Penale.

10. Akuza penale përbëhet nga disa komponentë të rëndësishëm kushtetues që janë ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i saj nga prokuroria përpara gjykatave. Në këtë kuptim "akuza penale" përgjatë procesit penal përfaqëson sintezën e hetimeve paraprake, konkretizon ushtrimin e ndjekjes penale, si dhe lejon prokurorin ta prezantojë atë përpara gjykatës. Me fillimin e përfaqësimit të akuzës penale përpara gjykatës, prokurori nuk ka mundësi të disponojë mbi vetë akuzën e paraqitur prej tij në gjykim.

11. Këto komponentë të përmendur më lart, nuk i gjejmë tek akuza e përfaqësuar nga viktima akuzuese sipas nenit 59, të Kodit të Procedurës Penale. Pakica mendon se në gjykimet mbi bazën e kërkesës së viktimës akuzuese nuk ka ndjekje penale dhe as hetime paraprake, siç ndodh në rastin e akuzës publike. Në rastet e parashikuara nga neni 59/1, i KPP-së, ka vetëm hetim gjyqësor, i cili shërben për të vërtetuar bazueshmërinë e kërkesës së të dëmtuarit akuzues (*shih vendimin nr. 3, datë 6.2.2008, dhe vendimin nr. 27, datë 9.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim "akuza penale" nuk është e njëjtë me "akuzën" që përfaqëson viktima akuzuese para gjykatës.

12. Interpretimi i termit "akuzë penale", në rastin në gjykim, merr një rëndësi të veçantë në aspektin e procesit të rregullt ligjor duke iu referuar elementit të *"gjykatës së krijuar me ligj"*. Sipas mendimit të pakicës, gjykata e posaçme, në bazë të nenit 75/a, germa "c", të Kodit të Procedurës Penale gjykon funksionarët shtetërorë për akuzat penale që detyrimisht përfaqësohen nga Prokuroria e Posaçme, për të gjitha arsyet e përmendura më lart. Akuza e ngritur nga viktima akuzuese në bazë të nenit 59, të Kodit të Procedurës Penale, të cilës i mungon faza e hetimeve paraprake, si dhe ushtrimi i ndjekjes penale, nuk duhet të shqyrtohet nga gjykata e posaçme pasi ajo nuk është akuzë penale. Si rrjedhim, në gjykimin e veprave penale dhe subjekteve të parashikuara nga neni 75/a, i Kodit të Procedurës Penale, sipas pakicës gjykata e posaçme vihet në lëvizje vetëm nga Prokuroria e Posaçme. Gjykimi i akuzave të ngritura nga viktima akuzuese përpara gjykatës së posaçme nuk përshtatet me elementin e *"gjykatës së krijuar me ligj"*.

[8] Një përfundim i tillë është pasqyruar në paragrafët 63, 64, 65 të vendimit njehsues.

13. Sipas mendimit të pakicës, veprat penale që ndiqen me ankimin e viktimës akuzuese sipas nenit 59, të Kodit të Procedurës Penale, duhet të gjykohen nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Duke iu referuar rastit në gjykim, pakica mendon se gjykimi i veprës penale të "Shpifjes" parashikuar nga neni 120/2, i Kodit Penal, kërkuar nga viktima akuzuese, Lulzim Basha, Kryetar i Partisë Demokratike, ndaj të akuzuarit, Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë, duhet të gjykohet nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

Tiranë më 27.7.2021.

Anëtarë: Sokol Binaj, Klodian Kurushi.

VENDIM
Nr. 00-2021-1120 (55), datë 13.10.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

Ilir Panda	kryesues;
Sokol Binaj	anëtar;
Sandër Simoni	anëtar;
Albana Boksi	anëtare;
Klodian Kurushi	anëtar,

sot, më datë, 13.10.2021, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen penale që i përket:
KËRKUESE: Drita Hoxha.
ME OBJEKT: Heqjen e masës së sigurimit pasuror, të sekuestros preventive, të caktuar me vendimin nr. 16, datë 10.1.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe me vendimin nr. 19, datë 31.7.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.
BAZA LIGJORE: Nenet 88, 274, 274/3, 275/1, 276, të Kodit të Procedurës Penale.

KOLEGJI PENAL,

dëgjoi relatimin e gjyqtarit Sokol Binaj. Dëgjoi përfaqësuesin e Prokurorisë së Përgjithshme, prokurorin Arqilea Koça, i cili në përfundim, në lidhje me çështjet e shtruara për njësim, parashtroi qëndrimin se: për pyetjen e parë - neni 88 i K. Pr. Penale është i zbatueshëm për të dyja llojet e masave të sigurimit; për pyetjen e dytë - jo domosdoshmërish gjykata që cakton masën e sigurimit është e njëjtë me gjykatën që në të njëjtën kohë ose më vonë shpall moskompetencën; dhe, për pyetjen e tretë - parashikimi i nenit 88 të K. Pr. Penale gjen zbatim edhe në rastin e shpalljes së moskompetencën nga prokurori në fazën e hetimit paraprak sipas nenit 88/2 të Kodit; ndërsa për zgjidhjen e çështjes konkrete kërkoi: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 154, datë 7.4.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë*. Dëgjoi mbrojtësin e kërkueses, Av. Ardian Leka, që në lidhje me çështjet e shtruara për njësim parashtroi se për dy pyetjet e para nuk ka nevojë për njësim pasi është e zbatuar prej vitesh në praktikë gjyqësore që gjykata që cakton masën e sigurimit nuk është e njëjtë me gjykatën që në të njëjtën kohë ose më vonë shpall moskompetencën, në lidhje me pyetjen e tretë parashtroi se neni 88 i K. Pr. Penale duhet të zbatohet edhe për moskompetencën e shpallur nga prokurori, pasi në nenin 84/2 të K. Pr. Penale është përcaktuar qartë çfarë duhet të kryejë organi i akuzës. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete kërkoi: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 154, datë 7.4.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë*. Dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, më datë 22.6.2016, ka regjistruar procedimin penal nr. 220, për veprat penale "Mashtrimi", i kryer në bashkëpunim, në formën e grupit të strukturuar kriminal, "Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë", "Korrupsioni pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë", të kryera në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 143/1, 333/a, 319 - 25, 319/ç - 25, të KP-së, si dhe, në të njëjtën kohë, emrat e personave

që ju atribuohen veprat penale të sipërcituara, të identifikuar në shtetasit Ador Dibra, Drita Hoxha, Ardian Dauti dhe Eduard Spahiu, me cilësinë (formale) e personave të hetuar.

2. Në kuadër të këtij procedimi penal, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (gjyqtari për hetimet paraprake pranë asaj Gjykate), me vendimin nr. 16, datë 10.1.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, duke urdhëruar vendosjen e masës së sigurimit pasuror, të sekuestros preventive mbi pasuritë sipas objektit të kërkesës.

3. Gjithashtu, me vendimin nr. 19, datë 31.7.2018, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda (gjyqtari për hetimet paraprake pranë asaj Gjykate) ka vendosur heqjen e sekuestros të vendosur me vendimin nr. 16, datë 10.1.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe vendosjen e sekuestros preventive, mbi 35 % të sipërfaqes së ndërtimit që do të realizohej mbi pasurinë me nr. 2/291, z.k. 8160, vol. 35, faqe 2, që do të regjistrohej, në ZVRPP Tiranë, pas nënshkrimit të aneks kontratës dhe kontratës së shkëmbimit midis palëve, për pjesën takuese të të hetuarës Drita Hoxha.

4. **Me vendimin datë 31.7.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda**, ka vendosur: *"Shpalljen e moskompetencës lëndore për çështjen penale nr. 220, viti 2017, për veprat penale të parashikuara nga nenet 143/2, 186/2, 248 - 25, 278/2 të Kodit Penal.*

Kalimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë si prokuroria kompetente në lëndë dhe territor.".

5. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përfundim të hetimeve paraprake, të zhvilluara në kuadrin e këtij procedimi penal të përcjellë pranë saj, nga Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Renda, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesën me objekt gjykimin e çështjes penale nr. 7011, viti 2018, ndër të tjera, në ngarkim të të pandehurës Drita Hoxha, duke e akuzuar, këtë të fundit, për kryerjen e veprave penale; "Mashtrimi", parashikuar nga neni 143/3 i KP-së, "Falsifikimi i dokumenteve", parashikuar nga neni 186/2 i KP-së, dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale", parashikuar nga neni 287/c i KP-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2998/30 akti, datë 5.3.2021, ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale nr. 7011, të vitit 2018.

6. Kërkuesja Drita Hoxha, në datën 1.2.2021, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën me objekt heqjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, të vendosur, fillimisht, me vendimin nr. 16, datë 10.1.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe përfundimisht, me vendimin nr. 19, datë 31.7.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

7. Kërkuesja Hoxha, në kërkesën e paraqitur, ka pretenduar se, në kushtet kur çështja penale e regjistruar në ngarkim të kësaj të fundit, në Prokurorinë pranë Gjykatës për Krime të Rënda, është dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 17.9.2018, për shkak të shpalljes së moskompetencës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, prej këtij momenti, masat e sigurimit, në rastin konkret masa e sigurimit me karakter pasuror e "sekuestros preventive", e caktuar në konformitet me përcaktimet e nenit 274 të KPP-së, ndaj pasurisë së të hetuarës Hoxha, në kuadrin e procedimit penal të regjistruar ndaj saj dhe të bashkëtëhetuarve të tjerë, fillimisht në Prokurorinë pranë Gjykatës për Krime të Rënda dhe, më pas, të dërguar, për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas përcaktimeve të nenit 88 të KPP-së, kanë (ka) kaluar në "gjendje" provizoriteti (për sa i përket fuqisë, efekteve, të saj) të tejkalueshme (në drejtim të "fitimit" të stabilitetit) vetëm në kushtet e rinovimit të kësaj mase, brenda një afati 10-ditor (nga marrja e akteve), prej Gjykatës (tashmë kompetente) të Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjë që në realitet nuk ka ndodhur duke provokuar, në mënyrë automatike, "humbjen (shuarjen e efekteve) e fuqisë" së kësaj mase të sigurimit pasuror të sekuestros preventive (të caktuar me vendimin nr. 19, dt. 31.7.2018), si masë e caktuar nga Gjykata, e cila, më pas, është deklaruar jokompetente. Që nga kjo datë organit të akuzës i ka lindur detyrimi të zbatojë kërkesat e nenit 88 të KPP-së.

8. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 320/1 akti, datë 12.2.2021,** ka vendosur: *"Rrëzimin e kërkesës.".*

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndër të tjera, ka arsyetuar se: masat e sigurimit, dhe në rastin në gjykim masa e sigurimit pasuror, e sekuestros preventive, caktohen si në fazën e hetimeve paraprake dhe në fazën e procesit gjyqësor dhe gjykata shpall moskompetencën si në fazën e hetimeve paraprake dhe në fazën e procesit gjyqësor.

10. Në kundërshtim me sa parashtron kërkuesja nëpërmjet mbrojtjes së saj, Gjykata, në zbatim të nenit 88 të KPP-së, çmon se paqëndrueshmëria e masës së sigurimit të vendosur nga gjykata jokompetente shfaqet përtej efektit kohor prej 10 ditësh, që në momentin që akuza nuk ka vënë në dijeni gjykatën kompetente, kur ka disponuar aktet nga prokuroria dhe gjykata jokompetente (viti 2018). Por gjithashtu rezulton se prokuroria jokompetente nuk i ka dërguar aktet gjykatës kompetente sipas kërkesave të nenit 84 e vijues të KPP-së. Gjykata

çmon se caktimi, i njëkohshëm, i masës së sigurimit (pasuror, të sekuestros preventive, në rastin konkret), dhe i deklarimit të moskompetencës së gjykatës, për caktimin e masës së sipërcituar, nuk shkakton humbjen e fuqisë së masës, por përcakton efektin e kufizuar në kohë të saj, që zgjidhet me vendimin përfundimtar.

11. Në caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive kërkohet me cilësinë e kushtit legjitimues të saj prezenca e dyshimit ose prova, për verifikimin e veprës penale në ngarkim të personit të hetuar, si dhe lidhja e sendit, objektit të sekuestrimit, me këtë vepër, në kuptimin që "disponimi i lirë i tij (prej këtij të fundit) mund të rëndojë ose zgjasë pasojat e saj, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera". Duke qenë se sekuestro preventive mund të kërkohet dhe të caktohet në fazën e hetimeve paraprake, kompetente për të disponuar mbi të është gjykata që shqyrton themelin e çështjes. Në çështjen objekt gjykimi nuk rezulton verifikimi i ndryshimit të kushteve të vendosjes së sekuestros preventive mbi pasuritë e cituara, në pronësi të kërkueses. Në sekuestron preventive objekt i aplikimit të saj është sendi (sendet) që lidhen me veprën penale, që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale, dhe kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurës në gjykim në bashkëpunim me të pandehurit e tjerë, dhe është gjykata e themelit që e vlerëson në dhënien e vendimit përfundimtar.

12. Duke e parë çështjen në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se, kërkesa e paraqitur nga ana e kërkueses, është e pambështetur ligjërisht ndaj si e tillë duhet rrëzuar.

13. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesja Drita Hoxha, me anë të së cilit ka kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e kërkesës për heqjen e sekuestros. Në ankim kërkuesja ka parashtruar të njëjtat argumente si në kërkesën drejtuar gjykatës.

14. **Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 154, datë 7.4.2021,** ka vendosur: *"Pranimin e kërkesës. Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit pasuror të sekuestros, të vendosur me vendimin nr. 16, datë 10.1.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë. Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, të vendosur me vendimin nr. 19, datë 31.7.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë."*.

15. **Gjykata e Apelit Tiranë**, ndër të tjera, ka arsyetuar se, referuar nenit 88 të KPP-së, masat e sigurimit të vendosura nga gjykata, e cila, në të njëjtën kohë ose më vonë, shpallet jokompetente për çdo lloj shkaku, i humbasin efektet, në qoftë se brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, gjykata kompetente nuk vendos për masën e sigurimit. Në këtë mënyrë, ligji, ndonëse parashikon mundësinë e caktimit të një mase sigurimi edhe nga një gjykatë që nuk është kompetente, parashikon njëkohësisht edhe një afat për vlefshmërinë e masës së caktuar, duke diktuar nevojën që vendimi përfundimtar për fatin e masës së caktuar, të merret nga gjykata kompetente.

16. Sipas këtij normimi procedural penal, organi procedues, i cili është bërë kompetent, pasi është dhënë vendimi i caktimit të masës së sigurimit, ka në dispozicion një afat 10-ditor, brenda të cilit duhet të çmojë rëndësinë e masës së sigurimit të caktuar nga gjykata jokompetente, dhe në varësi të nevojave përkatëse, në raport me procedimin penal, të kërkojë (ose jo), në gjykatën kompetente, caktimin e masës së sigurimit e cila ishte caktuar nga gjykata jokompetente. Kalimi i afatit 10-ditor, në kuptim të nenit 88 KPP-së, passjell humbjen e efekteve të masës së sigurimit të caktuar nga gjykata jokompetente. Në rastin objekt shqyrtimi, gjykata kompetente duhet ta shqyrtonte masën e sigurimit brenda afatit 10-ditor, nga data 17.9.2018 që dosja i ka kaluar për hetime të mëtejshme Gjykatës dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjë që nuk ka ndodhur. Për rrjedhoje, *ipso lege*, masa e sigurimit pasuror, e caktuar më herët, e ka humbur fuqinë. Ky përbën një fakt që do të duhej të ishte konstatuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, në momentin kur ju kërkua nga kërkuesja, pasi gjykata ka detyrimin ligjor të garantojë procesin e rregullt, sikurse edhe të drejtat e subjekteve procedurale. Shmangia nga dhënia e një vendimi, lidhur me këtë çështje, me arsyetimin se kjo është në kompetencë të gjykimit të gjyqtarit që do e gjykojë çështjen (në themel) cenon në thelb të drejtat e kërkueses.

17. **Kundër vendimit nr. 154, datë 7.4.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë ka paraqitur rekurs në datë 20.5.2021 Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë** me anë të së cilit ka kërkuar: *Prishjen e vendimit nr. 154, datë 7.4.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 320/1 akti, datë 12.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

18. Në rekurs prokuroria ka parashtruar, ndër të tjera, këto shkaqe:

- Në rastin konkret, gjatë gjykimit, nuk rezultojnë të verifikuara ndryshime të kushteve të zbatimit të masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, të cilat, referuar kërkesave të nenit 274/3 të KPP-së, do të detyronin Gjykatën, të deklaronte revokimin e saj.

- Ligji procedural penal humbjen e fuqisë së sekuestros (preventive, në rastin konkret) e lidh me zgjidhjen përfundimtare të çështjes në themel të saj, si dhe me vendimin e pafajësisë, pushimit të çështjes apo të dënimit. Asnjë nga këto rrethana ligjore nuk rezultojnë të verifikuara, në rastin konkret, dhe të jenë marrë në konsideratë, për pasojë, në dhënien e vendimit, nga Gjykata e Apelit Tiranë.

- Nga aktet rezulton se në momentin e shqyrtimit të kërkesës nga gjykatat, procedimi penal në ngarkim të

pandehurës Drita Hoxha etj., ka kaluar për gjykim dhe ndodhet në fazën e gjykimit të saj. Do të ishte përfundimi i gjykimit të themelit të çështjes që do të zgjidhte dhe efektet e sekuestros preventive. Prandaj, çdo vendimmarrje e Gjykatës, lidhur me deklarimin e humbjes së fuqisë së sekuestros, kur nuk rezultojnë të verifikuara ndryshime të kushteve të vendosjes së saj, pa e zgjidhur çështjen në themel, sipas nenit 275 i KPP-së, është e gabuar dhe joligjore.

Qëndrimi i mbajtur nga Gjykata Apelit Tiranë ndryshe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, duke vendosur deklarimin (konstatimin) e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, në referim të nenit 88 të KPP-së, konsiderohet i gabuar, po të kemi parasysh faktin që kjo rrethanë ka ekzistuar që në vitin 2018.

- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, ndryshe nga ai i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është rezultat i mosrespektimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal me rëndësi për zhvillimin e praktikës gjyqësore, shkak ligjor, i parashikuar nga neni 432/1 germa "a", të KPP-së, për të ushtruar rekurs, në Gjykatën e Lartë, kundër këtij vendimi.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal

19. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), në funksion të gjykimit të çështjes, pranë kësaj Gjykate, vlerëson të evidentojë faktin e ndryshimeve ligjore që ka pësuar KPP-ja, me ligjin nr. 41/2021, hyrë në fuqi më datë 29.5.2021. Në nenin 38, të ligjit nr. 41/2021, mbi dispozitat tranzitore, parashikohet se: *"1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë, rregullohen sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre".* Në kuptim të kësaj dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues si dhe me procedurën e gjykimit, Kolegji Penal, mban parasysh parashikimet e ligjit nr. 41/2021, ndërsa, në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit, ato që referojnë tek ligji procedural, në fuqi, në kohën e depozitimit të tij.

20. Kolegji, në shqyrtim të kushteve të pranueshmërisë së rekursit të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në dhomë këshillimi, konstatoi verifikimin e kushteve formale, të identifikuara në "paraqitjen e rekursit, prej palës rekursuese, brenda afatit ligjor (45 ditë nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të Gjykatës së Apelit), të parashikuar në paragrafin e parë, të nenit 435, të KPP-së", si dhe të atyre substanciale, të identifikuara në "mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural", sipas përcaktimit të shkronjës "a", të paragrafit të parë, të nenit 432, të KPP-së. Kolegji, në respektim të detyrimit të tij për të "shqyrtuar çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs", sikurse përcaktohet në paragrafin e parë të nenit 434 të KPP-së, por pa paragjykuar të drejtën e kësaj Gjykate/këtij Kolegji "për të vendosur, kryesisht, edhe për çështje të ligjit" (pavarësisht shkaqeve të paraqitura në rekurs), sikurse përcaktohet në paragrafin e dytë të kësaj dispozite, vlerësoi se duhet gjykuar mbi bazueshmërinë në ligj të shkaqeve të parashtruara nëpërmjet rekursit, në kushtet e aplikimit të gabuar, prej Gjykatës së Apelit Tiranë, të ligjit procedural, konkretisht, të nenit 88 të KPP-së që parashikon "humbjen e fuqisë (efekteve) të masës së sigurimit të caktuar prej gjykatës, e cila, në të njëjtën kohë apo më vonë, shpallet jokompetente (për çdo lloj shkaku), në qoftë se, brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, gjykata kompetente nuk vendos për masën e sigurimit".

21. Nga ana tjetër, Kolegji, me vendimin e datës 23.7.2021, duke evidentuar edhe prezencën e kushtit (të karakterit kumulativ), të parashikuar në shkronjën "a", të paragrafit të parë, të nenit 432, të KPP-së, të rëndësisë që ka problematika e krijuar prej zbatimit të gabuar të kësaj dispozite, në funksion të zbatimit uniform të nenit 88 të KPP-së nga praktika gjyqësore, disponoi për kalimin e kësaj çështje për shqyrtim në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore. Kolegji vlerësoi se në rastin konkret verifikohet ekzistenca e kushtit të parashikuar në pjesën e parë të nenit 432/1-a të KPP-së, të "mosrespektimit apo të zbatimit të gabuar të ligjit procedural", duke vlerësuar, në të njëjtën kohë, edhe konkurrimin e kushteve për nisjen e procedurës së parashikuar në paragrafin e parë të nenit 438 të KPP-së, pikërisht të gjykimit, për të njësuar praktikën gjyqësore.

22. Kolegji konstaton se ka qëndrime të ndryshme në lidhje me zbatimin e nenit 88 të KPP-së, kryesisht të kolegjeve të veçantë të Gjykatës së Lartë që, lidhur me aplikimin e përcaktimeve të kësaj dispozite, kanë operuar në mënyrë kontradiktore, duke pranuar, herë-herë, aplikimin e kësaj dispozite, pra nenit 88 të KPP-së dhe deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit të caktuar nga gjykata (gjyqtari për hetimet paraprake) edhe në rastin e deklarimit të moskompetencës nga ana e prokurorit gjatë hetimeve paraprake, për vazhdimin e këtyre hetimeve dhe të dërgimit, për pasojë, të çështjes tek prokurori kompetent (vendimet nr. 25 dhe 64, datë 29.4.2015; nr. 14, datë 30.3.2015, të këtyre kolegjeve); si dhe herë-herë, kanë disponuar edhe të kundërtën. Por, Kolegji konstaton se edhe gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me zbatimin e nenit 88 të KPP-së, situatë procedurale e verifikuar edhe në rastin konkret në shqyrtim.

23. Kolegji ka identifikuar si çështje me rëndësi për njësimin e praktikës gjyqësore, sa më poshtë vijon:

- A është i zbatueshëm neni 88 i KPP-së për masat e sigurimit pasuror apo është një dispozitë që i referohet vetëm masave të sigurimit personal?

- Sipas përcaktimit të nenit 88 të KPP-së, gjykata që cakton masën e sigurimit a është e njëjtë me gjykatën që, në të njëjtën kohë ose më vonë, shpall moskompetencën?

- A zbatohen parashikimet e nenit 88 të KPP-së edhe në rastin e shpalljes së moskompetencës nga prokurori dhe të dërgimit të akteve prokurorisë kompetente sipas përcaktimit të nenit 84/1- të KPP-së.

24. Në funksion të zgjidhjes së problematikës kryesore, të vendosur në bazë të këtij gjykimi, Kolegji, në cilësinë e "aktorit" iniciues të procedurës së gjykimit njësues, ka detyrimin për t'u prononcuar edhe lidhur me kuptimin, interpretimin e normës referuese, nenit 88 të KPP-së, aspekteve të veçanta të saj, të identifikuara në dy çështjet e para të renditura në objektin e këtij gjykimi njësues. Konkretisht, Kolegji, së pari, vlerëson të sqarojë nëse neni 88 i KPP-së zbatohet edhe për masat e sigurimit të karakterit pasuror, të sekuestros preventive, në rastin konkret, si dhe në mundësinë e interpretimit të zgjeruar të përcaktimit preciz dhe univok të kësaj dispozite, për pjesën që bën fjalë për "identicitetin" e gjykatës që cakton masën e sigurimit me gjykatën që, kontekstualisht apo më vonë, shpallet/deklarohet në kushtet e moskompetencës.

25. Në këtë kuadër, neni 88 i KPP-së, përmbajtja e tij, konsiderohet si një disiplinë e përgjithshme dhe organike për të gjithë lëndën e masave të sigurimit, të caktuara nga gjyqtari jokompetent dhe që, bashkë me nenin 87 të KPP-së, që bën fjalë për "provat e marra nga gjykata jokompetente", janë shprehje e parimit të "konservimit/ruajtjes së akteve". Neni 88 i KPP-së, sikurse qartazi (*ictu oculi)* evokon përmbajtja e tij, verifikohet i zbatueshëm, sidomos për sa i përket tipologjisë së ndryshme të masave të sigurimit, si të atyre më karakter personal, ashtu edhe të atyre shtrënguese, të parashikuara në nenin 232 të KPP-së apo të atyre ndaluese, të parashikuara në nenin 240 të KPP-së, po kështu edhe të atyre të karakterit real pasuror, të parashikuara në nenet 270 dhe 274 të KPP-së që bëjnë fjalë për masat e sigurimit pasuror të sekuestros konservative dhe preventive. Në të njëjtën kohë, konsiderohet se dispozita e sipërcituar, neni 88 i KPP-së, nuk gjen zbatim për sa i përket "sekuestros provuese", e ashtuquajtura sekuestro penale, e parashikuar në nenin 208 të KPP-së, për sa kohë që, kjo e fundit, konkretizon njërin nga "mjetet e sigurimit të provës", të parashikuara në Kreun e Tretë të Titullit të Katërt të KPP-së, konkretisht seksionin i tretë, "Sekuestrimet".

26. Pra, për sa i përket çështjes së parë të shtruar për njësim, qartazi dispozita, neni 88 i KPP-së, nuk parashikon asnjë lloj diferencimi midis masave të sigurimit të të gjitha llojeve, sikurse u sipërcitua, përfshirë edhe masën e sigurimit pasuror të sekuestros preventive. Kolegji vlerëson se edhe masat e sigurimit pasuror, do t'i nënshtrohen pasojave, të identifikuara në "humbjen e efekteve të fuqisë" së tyre, në kushtet e deklarimit kontekstual, me momentin e caktimit të masës apo edhe në një moment të mëvonshëm, të moskompetencës së gjykatës (gjyqtarit për hetimet paraprake) që ka caktuar këtë masë dhe të mosripërtëritjes (mosrinovimit) të saj nga gjykata kompetente, brenda një afati dhjetë ditor nga marrja e akteve.

27. Me verifikimin e kushteve të parashikuara në nenin 88 të KPP-së, të deklarimit (kontekstual apo të mëvonshëm) të moskompetencës të gjykatës (gjyqtarit për hetimet paraprake) që ka caktuar masën e sigurimit të karakterit pasuror të sekuestros preventive, të parashikuar nga neni 274 i KPP, si dhe të mosripërtëritjes të saj prej gjykatës kompetente, brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, kjo e fundit, pra masa e sigurimit (pasuror) humbet efikasitetin – provizor/të përkohshëm – të "fituar", me rastin e deklarimit të kësaj moskompetence (prej këtij momenti), si një masë e caktuar prej gjyqtarit (gjykatës) jokompetent. Masa e sigurimit (pasuror) e caktuar nga gjyqtari jokompetent ka karakter të jashtëzakonshëm dhe emergjencial/si një masë e caktuar në kushte emergjence.

28. Kolegji, në funksion të interpretimit të dispozitës, objekt i referimit të këtij gjykimi njësues, nenit 88 të KPP-së, lidhur me kushtet e aplikimit të saj, konsideron se "shkronja" – përmbajtja e kësaj dispozite – e bazuar në identitetin midis (në kuptimin e të njëjtës gjykatë/gjyqtar) gjyqtarit që cakton masën e sigurimit me atë (gjyqtarin) që deklaron, në të njëjtën kohë apo më pas, moskompetencën e tij, nuk përjashton mundësinë që kjo disiplinë e "humbjes së fuqisë së masës së sigurimit" të interpretohet në mënyrë të zgjeruar dhe të zbatohet edhe në eventualitetin e verifikimit të diversitetit (në kuptimin e gjykatës/gjyqtarit të ndryshëm) midis gjyqtarit që disponon masën e sigurimit dhe gjyqtarit që deklaron moskompetencën. Ky konkluzion, sikurse u sipërcitua, mbështetet në faktin se masa e sigurimit e caktuar nga gjyqtari jokompetent ka vlefshmëri/efikasitet provizor, duke qenë shprehje e një pushteti të jashtëzakonshëm dhe emergjencial, të "akorduar", këtij të fundit, prej ligjvënësit, dhe si rrjedhojë nuk mund të kufizohet vetëm në rastet e "identitetit" midis dy gjyqtarëve/gjykatave.

29. Rast emblematik i aplikimit të këtij interpretimi zgjerues të disiplinës së parashikuar nga dispozita, neni 88 i KPP-së, do të konsiderohej "deklarimi i moskompetencës, jo vetëm nga gjyqtari (për hetimet paraprake) që ka

caktuar masën e sigurimit, por edhe nga gjyqtari (i gjykatës së apelit), që gjykon ankimin ndaj vendimit të këtij gjyqtari që ka caktuar këtë masë me karakter të përkohshëm. Mbi këtë bazë arsyetimi, konkludohet prej këtij Kolegji, në funksion të problematikës së identifikuar, objekt i njësimit nëpërmjet gjykimit të kësaj çështjeje (pika 2 e çështjeve objekt njësimi), se: provizoriteti (*ad interim*)/përkohshmëria e masës së sigurimit merr jetë ekskluzivisht vetëm në kushtet e deklarimit të moskompetencës, për çdo lloj shkaku pa përjashtim, të moskompetencës lëndore apo tokësore, prej gjykatës/gjyqtarit për hetimet paraprake, gjatë kësaj faze të procedimit, të hetimeve paraprake, në të njëjtën kohë (me caktimin e kësaj mase) ose më vonë, e cila (i cili) presupozohet në kushtet e identitetit, me gjykatën (gjyqtarin) që ka caktuar këtë masë, pra e njëjta gjykatë. "Jetëgjatësia" e këtij provizoriteti (të kësaj mase të caktuar, të deklaruar në këto kushte) merr fund (në kuptimin e humbjes së efekteve, të fuqisë së kësaj mase) në kushtet e mosrinovimit (ripërtëritjes) të saj prej gjykatës kompetente brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, pra, në thelb, kur nuk konfirmohet nëpërmjet deklarimit stabiliteti/qëndrueshmëria e saj. Ky është rregulli bazë i sanksionuar nga dispozita – neni 88 i KPP-së, që nuk përjashton, sikurse u argumentua më sipër, diversitetin e gjykatës që ka caktuar masën e sigurimit, me gjykatën që më pas, ka deklaruar moskompetencën, lidhur me caktimin e kësaj mase sigurimi. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji arrin në konkluzionin njësues si më poshtë vijon: "Jo domosdoshmërish, në kushtet e aplikimit të përcaktimeve të dispozitës, nenit 88 të KPP-së, Gjykata që ka caktuar masën e sigurimit do të (duhet) jetë e njëjtë me Gjykatën, e cila, më vonë, ka deklaruar moskompetencën e saj, për çdo lloj shkaku, për gjykimin e çështjes me këtë objekt."

30. Duke ju referuar konkluzioneve njësuese lidhur me dy problematikat e para të trajtuara, konkluzioni mbi problematikën e tretë, të identifikuar në mundësinë e aplikimit të përcaktimeve të nenit 88 të KPP, në thelb, "të humbjes së efikasitetit/shuarjes së masave të sigurimit", të caktuara nga gjykata/gjyqtari për hetimet paraprake, edhe në rastin e deklarimit të moskompetencës nga prokurori gjatë fazës së hetimeve paraprake (pas caktimit të tyre prej gjykatës kompetente dhe në kushtet e mungesës së një prononcimi gjyqësor lidhur me (mos)kompetencën) dhe dërgimit të akteve (të çështjes) tek prokurori kompetent, sipas përcaktimit të nenit 84/1 të KPP-së, është automatik dhe i pashmangshëm. Për sa kohë që masa e sigurimit e caktuar nga gjykata (gjyqtari për hetimet paraprake) kompetente, verifikohet në kushtet e stabilitetit (të efikasitetit të plotë), pra nuk rezulton që gjykata që ka caktuar këtë masë të ketë deklaruar, kontekstualisht apo më vonë, moskompetencën e saj, për çdo lloj shkaku, transferimi i hetimit të çështjes, sipas nenit 84/1 të KPP-së, nga një prokurori tek tjetra, për vazhdimin e hetimeve, i motivuar ky transferim me verifikimin e moskompetencës së prokurorisë që kishte regjistruar fillimisht/*ab initio* procedimin penal, nuk paraqet asnjë lloj ndikimi lidhur me efikasitetin e masës së sigurimit të caktuar nga ajo gjykatë, në drejtim të humbjes së efikasitetit të masës së caktuar. Kolegji vlerëson se neni 88 i KPP-së kushtëzon provizoritetin (përkohshmërinë) e masës së sigurimit të caktuar dhe inefikasitetin e saj (në kushtet e mospërtëritjes së saj brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve prej gjykatës kompetente), vetëm në rastin e deklarimit (kontekstual apo të mëvonshëm) të moskompetencës (për çfarëdo lloj shkaku) prej gjykatës (gjyqtarit), në cilësinë e deklarimit të organit juridiksional. Kolegji çmon se nuk sjell asnjë pasojë për masën e sigurimit të caktuar, në rastin kur disponohet për kalimin e akteve, gjatë hetimeve paraprake, nga një prokurori tek tjetra, e motivuar me konstatimin e moskompetencës për të hetuar, duke qenë se bëhet fjalë për akte të nxjerra nga një organ/prokurori, i konsideruar palë (megjithëse palë publike) në proces (procedim), pa pushtet dhe kompetenca të karakterit juridiksional.

31. Me të drejtë ligjvënësi, sikurse rezulton nga përmbajtja e dispozitës, nuk ka toleruar (duke mos parashikuar) në funksion të qëllimit të ruajtjes së efikasitetit të masës së sigurimit, domosdoshmërinë e nxjerrjes së një vendimi (disponimi) të ri, prej gjyqtarit kompetent, në rastin kur, menjëherë mbas adoptimit, prej gjyqtarit për hetimet paraprake, të një mase sigurimi dhe në mungesë të një vendimi (disponimi) gjyqësor mbi (mos)kompetencën, prokurori, pranë këtij gjyqtari (kësaj gjykate), transmeton aktet e hetimit të (kësaj) çështjes, sipas përcaktimit të paragrafit të parë të nenit 84 të KPP-së, tek organi i akuzës (prokurori) pranë gjykatës që ai vlerëson kompetente. Ligjvënësi, duke mbajtur parasysh cilësinë e palës të organit të akuzës/prokurorit, megjithëse palë publike në procesin penal, si dhe rrethanën që, gjatë fazës së hetimeve paraprake të zhvilluara në drejtimin e këtij të fundit (prokurorit), për shkak të dinamikës (fluiditetit) së zhvillimit të tyre, hipotezat mbi karakterizimin (rindërtimin) e fakteve janë subjekt i modifikimit me pasojë ndikimi të drejtpërdrejtë mbi kualifikimin (juridik) të tyre, ka privilegjuar nevojën e efikasitetit dhe të menjëhershmërisë së zhvillimit të funksionit investigativ, nëpërmjet adoptimit të kriterit të elasticitetit në përcaktimin e raporteve (marrëdhënieve) midis prokurorive të ndryshme, duke evituar një ndarje të thellë dhe rigoroze të "pushteteve" respektive, kriter i ndryshëm në raport me ato që përcaktojnë kompetencën midis gjykatave.

32. Sakaq, mbi bazën e kësaj logjike, gjithnjë prej ligjvënësit, nga njëra anë, është ometuar parashikimi i "mekanizmave" detyruese të prokurorit të "palegjitimuar", për të transmetuar aktet tek titullari i hetimeve paraprake, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 25 të KPP-së dhe toleruar prokurorit titullar të hetimeve paraprake të zhvilluara lidhur me çështjen penale të regjistruar ndaj personit që aplikohet masa e sigurimit, të vazhdojë hetimet edhe në kushtet e deklarimit të moskompetencës prej gjyqtarit të hetimeve paraprake që ka caktuar masën. Por, nga ana tjetër, adresohet rregullimi i konflikteve negative të kompetencës midis prokurorive të ndryshme, gjatë kësaj faze të hetimeve paraprake, në brendësi të strukturës organike të kësaj pale/prokurorisë, duke i atribuuar zgjidhjen e tyre "prokurorit më të lartë", sipas përcaktimit të paragrafit të dytë të nenit 89 të KPP-së (për mosmarrëveshjet mes prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm), si dhe "duke i dhënë përparësi" kompetencës së Prokurorisë së Posaçme, në rastet e krijimit të konfliktit të kësaj të fundit, me prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm. Ligjvënësi me këtë zgjidhje ligjore ka evituar, në këtë mënyrë, investimin dhe prononcimin e gjykatës në lidhje me këtë moment.

33. Në këtë kontekst, të implementimit të kësaj disipline normative, vetëm rrethana që prokurori procedues, në një moment të caktuar të zhvillimit të fazës së hetimeve paraprake, gjatë hetimeve paraprake ose në përfundim të tyre, sipas përcaktimit të paragrafit të parë të nenit 84 të KPP-së, transmeton aktet tek prokurori pranë gjykatës që ai mendon dhe vlerëson si gjykata kompetente, nuk është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të legjitimuar kompetencën e këtij të fundit/gjyqtarit për t'u shprehur mbi masën e sigurimit. Gjyqtari në këtë rast, "paqësisht", mund ta refuzojë atë (kërkesën) në rastin kur i kërkohet prej palëve, të prononcohet nëpërmjet një disponimi të tij mbi masën, apo për të përjashtuar/shmangur, kompetencën e gjyqtarit pranë të cilit ushtron funksionet, prokurori që ka transmetuar aktet.

34. Për pasojë, konkludohet se transmetimi i akteve, i verifikuar në këto kushte, të deklarimit të moskompetencës së prokurorit procedues, në favor të kompetencës së prokurorit pranë gjykatës të vlerësuar (prej tij – prokurorit procedues) si gjykata kompetente, gjatë fazës së hetimeve paraprake të procedimit të regjistruar dhe mbas caktimit të masës së sigurimit prej gjykatës kompetente, nuk paraqet asnjë lloj ndikimi në drejtim të efikasitetit të masës së sigurimit (të caktuar si më sipër). Në të njëjtën kohë, disponimi i prokurorit për deklarimin e moskompetencës është "i paaftë" për t'i "atribuuar" kësaj mase, efikasitet të përkohshëm/të limituar, të tillë që të imponojë deklarimin e humbjes së fuqisë së saj në kushtet e mosrinovimit brenda afatit dhjetë ditor nga marrja e akteve, sikurse parashikohet në dispozitë, nenin 88 të KPP-së, për sa kohë që mungon deklarimi i moskompetencës prej organit juridiksional – gjykatës.

35. Ndërkohë ligjvënësi, me ndryshimet e adoptuara me ligjin nr. 35/2017, neni 52 i këtij ligji, ka shtuar një paragraf të ri në nenin 84, paragrafin e dytë, me këtë përmbajtje: "Kur prokurori shpall moskompetencën, ai njofton menjëherë të dyja gjykatat. Gjykata, brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit të prokurorit, i përcjell gjykatës kompetente aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në atë moment përpara asaj gjykate".

36. Përpos përmbajtjes së paqartë të kësaj dispozite, për sa kohë që i atribuon prokurorit "akte të hetimit paraprak të kryera para gjykatës" (të cilat gjykata jokompetente duhet t'ia dërgojë gjykatës kompetente), kur cilësinë e një akti të tillë e "gëzon" vetëm prova e marrë prej gjyqtarit për hetimet paraprake me procedurën e jashtëzakonshme të "sigurimit" të saj, të parashikuar nga nenet 317–322 të KPP-së, mbi kërkesën e palëve, e justifikuar kjo urgjencë me rrezikun e zhdukjes së saj", dhe për sa kohë që "aktet e hetimit paraprak konsiderohen në diskrecionin ekskluziv të prokurorit dhe të policisë gjyqësore" të realizuara prej tyre, nën drejtimin e prokurorit titullar i kësaj faze, në funksion të ushtrimit të ndjekjes penale", Kolegji çmon se duhet theksuar qe në këtë fazë ndërhyrja e gjykatës/gjyqtarit për hetimet paraprake është e karakterit incidental, garantues, e "provokuar"/stimuluar prej palëve, në kushtet e mungesës së disponibilitetit mbi to (hetimet paraprake). Në këto rrethana, dispozita e sipërcituar, paragrafi i dytë i nenit 84 të KPP-së, me gjithë "përkujdesjet" për të vënë në gjendje "gatishmërie" gjykatat respektive, të "interesuara" dhe të "shqetësuara" prej kalimit të akteve nga një prokurori tek tjetra gjatë kësaj faze të hetimeve paraprake, për shkak të kompetencës dhe paragjykimit, për pasojë, të karakterit definitiv të masave të sigurimit të caktuara, qartazi, për asnjë moment, nuk kontraston dhe nuk mohon arsyen e përcaktimit të nenit 88 të KPP, moskompetencën e deklaruar nga gjykata, si e vetmja mundësi për të "provokuar" provizoritetin/përkohshmërinë e masës së sigurimit personal të caktuar gjatë fazës së hetimeve paraprake. Në konkluzion të këtij parashtrimi, Kolegji thekson se as përcjellja e akteve nga njëra gjykatë tek gjykata pranë të cilës funksionin prokuroria, të cilës i kanë kaluar aktet për kompetencë, nuk nënkupton zbatimin e nenit 88 të KPP, për sa kohë ky kalim i akteve nuk vjen si pasojë e një vendimi gjyqësor për shpalljen e moskompetencës.

37. Përfundimisht, mbi këtë bazë, Kolegji, lidhur me problematikën e tretë të shtruar për njësim, konkludon se "Parashikimet (përcaktimet) e nenit 88 të KPP-së nuk janë të aplikueshme me rastin e shpalljes (deklarimit) së

moskompetencës prej prokurorit, gjatë hetimeve paraprake apo në përfundim të tyre, dhe të dërgimit të akteve prokurorisë (prokurorit) kompetente, sipas përcaktimit të nenit 84/1 të KPP-së.".

38. Sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson që lidhje me pyetjen e shtruar për njësim, duhet të arrihet në këto përfundime njësuese:

38.1. Në lidhje me pyetjen e parë të ngritur për njësimin e praktikës gjyqësore: "A zbatohet neni 88 i KPP-së për masat e sigurimit pasuror, apo është një dispozitë që i referohet vetëm masave të sigurimit personal?", të mbahet ky qëndrim njësues:

Neni 88 i KPP-së zbatohet si për masat e sigurimit personal, ashtu dhe për masat e sigurimit pasuror.

38.2. Në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për njësim: "Sipas nenit 88 të KPP-së, gjykata që cakton masën e sigurimit a është e njëjtë me gjykatën që, në të njëjtën kohë ose më vonë, shpall moskompetencën?", të mbahet ky qëndrim njësues:

Gjykata që cakton masën e sigurimit, jo domosdoshmërish është e njëjtë me gjykatën që shpall moskompetencën.

38.3. Në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për njësim: "A zbatohen parashikimet e nenit 88 të KPP-së edhe në rastin e shpalljes së moskompetencës nga prokuroria dhe dërgimit të akteve prokurorisë kompetentë sipas nenit 84/1 të KPP-së?", të mbahet ky qëndrim njësues:

Parashikimet e nenit 88 të KPP-së në lidhje me masën e sigurimit të vendosura nga gjykata jokompetente, nuk zbatohen në rastin e shpalljes së moskompetencës nga prokuroria dhe dërgimit të akteve prokurorisë kompetente, sipas nenit 84/1 të KPP-së.

39. Duke u kthyer tek zgjidhja e çështjes konkrete, që nxiti këtë gjykim të karakterit njësues, konkludohet prej këtij Kolegji, duke ju referuar konkluzionit të tretë të këtij vendimi, pamundësia e aplikimit/zbatimit të përcaktimeve të nenit 88 të KPP-së, me rastin e kalimit të akteve nga njëra prokurori tek tjetra, gjatë fazës së hetimeve paraprake, për shkak moskompetence. Në zbatim të korrekt të ligjit dhe të konkluzioneve njësuese të cituara më lart, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit Tiranë, vendimi nr. 154, datë 7.4.2021, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit procedural me rëndësi për njësimin e praktikës gjyqësore, parashikuar në shkronjën "a" të paragrafit të parë të nenit 432 të KPP-së, e lidhur kjo më zbatimin e gabuar të përcaktimeve të nenit 88 të këtij Kodi. Si rrjedhojë, Kolegji çmon se vendimi nr. 154, datë 7.4.2021, i Gjykatës së Apelit Tiranë është i cenueshëm duke sjellë si pasojë prishjen e këtij vendimi, sipas përcaktimit të shkronjës "b" të paragrafit të parë të nenit 441 të KPP-së. Në të njëjtën kohë, prej këtij Kolegji, konkludohet mbi ligjshmërinë (në thelb) të vendimmarrjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi nr. 320/1 akti, datë 12.2.2021, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës së të hetuarës Drita Hoxha me objekt "Deklarimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit me karakter pasuror të sekuestros preventive", me rastin e kalimit të akteve nga prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda tek Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të deklarimit të moskompetencës prej prokurorit, me pasojë lënien në fuqi të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 438 dhe 441/1/b të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

Prishjen e vendimit nr. 154, datë 7.4.2021, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 320/1 akti, datë 12.2.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Tiranë, më 13.10.2021.

Kryesues: Ilir Panda
Anëtarë: Sokol Binaj, Albana Boksi
Anëtarë pjesërisht kundër: Klodian Kurushi, Sandër Simoni

MENDIM I PAKICËS

1. Ne gjyqtarët Sandër Simoni dhe Klodian Kurushi jemi pjesërisht kundër vendimit njësues të dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në çështjen penale regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 61011-00482-2021

regjistri themeltar, datë 16.6.2021, vetëm në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për njësim, që i referohet pyetjes nëse zbatohen parashikimet e nenit 88 të K. Pr. Penale edhe në rastin e shpalljes së moskompetencës nga prokuroria dhe dërgimit të akteve prokurorisë kompetente sipas nenit 84/1 të K. Pr. Penale?

2. Në lidhje me këtë pyetje, jemi të mendimit se fillimisht është i nevojshëm trajtimi i dispozitave të K. Pr. Penale që rregullojnë shpalljen e moskompetencës së prokurorisë dhe gjykatës gjatë fazës së hetimeve paraprake apo gjatë gjykimit në shkallë të parë.

3. Neni 83 i K. Pr. Penale parashikon: *"Moskompetenca lëndore ngrihet, edhe kryesisht, në çdo gjendje e shkallë të procesit.*

Moskompetenca tokësore dhe ajo që rrjedh nga bashkimi i procedimeve për shkak lidhje, mund të ngrihet ose të kundërshtohet, vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor.".

4. Neni 84 i K. Pr. Penale parashikon: *"1. Kur gjatë hetimeve paraprake ose në përfundim të tyre prokurori konstaton moskompetencën e vet për çdo lloj shkaku vendos dërgimin e akteve prokurorit pranë gjykatës kompetente.*

2. Kur prokurori shpall moskompetencën, ai njofton menjëherë të dyja gjykatat. Gjykata, brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit të prokurorit, i përcjell gjykatës kompetente aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në atë moment përpara asaj gjykate.".

5. Neni 85 i K. Pr. Penale parashikon: *"Në qoftë se në gjykimin e shkallës së parë gjykata çmon se procedimi është në kompetencën e një gjykate tjetër, shpall me vendim moskompetencën e vet për çdo lloj shkaku dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente."*.

6. Neni 88 i K. Pr. Penale parashikon: *"Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata, e cila në të njëjtën kohë ose më vonë shpallet jokompetente për çdo lloj shkaku, i humbasin efektet, në qoftë se brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, gjykata kompetente nuk vendos për masën e sigurimit."*.

7. Referuar nenit 84/1 të K. Pr. Penale, prokurori gjatë hetimeve paraprake apo në përfundim të tyre vendos moskompetencën për çdo lloj shkaku dhe i dërgon aktet prokurorisë kompetente. Në këtë rast, aktet i përcillen prokurorisë kompetente e cila vazhdon hetimet në lidhje me çështjen. Kjo situatë verifikohet edhe në ato raste kur gjykata pranë prokurorisë që ka shpallur moskompetencën ka disponuar në lidhje me një masë sigurimi, si rrjedhojë e kërkesës së prokurorit. Diskutimi që shtrohet para Kolegjit lidhet me faktin nëse këtë situatë do të zbatohen parashikimet e nenit 88 të K. Pr. Penale, në lidhje me masën e sigurimit për të cilën ka disponuar gjykata e mëparshme?

8. Mendojmë se nga interpretimi logjik i bërë kësaj situate ligjore arrihet në përfundimin se neni 88 i K. Pr. Penale do të zbatohet edhe në këtë rast. Pavarësisht se moskompetenca lëndore është shpallur nga prokuroria pranë gjykatës që ka caktuar masën e sigurimit dhe jo nga kjo gjykatë, në kushtet kur është shpallur moskompetenca dhe aktet i kanë kaluar prokurorisë kompetente, në thelb masa e sigurimit është caktuar nga një gjykatë që nuk është më kompetente në lidhje me çështjen. Ky përfundim nuk duhet të çojë në konkluzionin se është prokuroria ajo që përcakton kompetencën e gjykatës, por lidhet me faktin se kompetenca e prokurorisë dhe gjykata pranë të cilës ajo ushtron funksionet janë të lidhura ngushtësisht dhe nuk mund të shihen veç si gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe gjatë gjykimit të çështjes.

9. Diskutimi në lidhje me zbatimin e nenit 88 të K. Pr. Penale mendojmë se mund të lindte para ndryshimeve që ka pësuar neni 84/2 i K. Pr. Penale. Me ndryshimet që ka pësuar kjo dispozitë situata është e zgjidhur nga ligjvënësi, pasi në këtë rast prokurori që shpall moskompetencën ka detyrimi të njoftojë të dyja gjykatat. Gjykatës kompetente i përcillen aktet e hetimeve paraprake nga gjykata jokompetente. Në këto kushte, gjykata kompetente do të duhet të marrë në vlerësim masën e sigurimit në mënyrë që kjo e fundit të vazhdojë të ketë fuqi juridike.

10. Në Kodin e Procedurës penale, parashikohen rregullat për përcaktimin se kompetencës lëndore dhe tokësore të cilat lidhen me faktin se kush do jetë gjykata kompetente për gjykimin e themelit të çështjes, rregulla këto që vlejnë edhe për fazën e hetimeve paraprake lidhur me kompetencën e prokurorisë që do të hetojë rastin konkret.

11. Duke iu referuar nenit 83/1 të K. Pr. Penale, parashikohet se, kompetenca lëndore ngrihet edhe "kryesisht", në çdo gjendje e shkallë të procesit. Ky është një parashikim parimor, pasi në dispozitat në vijim ligjvënësi bën përcaktimet se si veprohet në rastet kur moskompetenca konstatohet gjatë hetimeve paraprake dhe si gjatë fazës së gjykimit të çështjes së themelit.

12. Kështu, në nenin 84/1 të K. Pr. Penale, parashikohet se: *"Kur gjatë hetimeve paraprake ose në përfundim të tyre prokurori konstaton mos kompetencën e vet për çdo lloj shkaku, vendos dërgimin e akteve prokurorit pranë gjykatës kompetente"*. Ndërsa në nenin 85 të po këtij Kodi, përcaktohet se: *"Në qoftë se në gjykimin e shkallës së parë gjykata çmon se procedimi është në kompetencën e një gjykate tjetër, shpall me vendim moskompetencën e vet për çdo lloj shkaku dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente"*.

13. Para ndryshimeve të nenit 84 të Kodit, ku me ligjin nr. 35/2017, u shtua pika 2 e tij, parashikohej e drejta e prokurorit të shpallte moskompetencën e tij, përfshi dhe atë lëndore, i cili ia dërgonte drejtpërdrejtë aktet e

hetimit prokurorit pranë gjykatës kompetente, pa qenë i detyruar që këtë konstatim të tijin ta konvalidonte në gjykatën pranë së cilës ai vetë i ushtronte funksionet. Përdorimi i shprehjes "...prokurorit pranë gjykatës kompetente" tregon pikërisht se, legjislatori ka dashur të thotë që prokurori ushtron ndjekjen penale pikërisht nëpërmjet kompetencave territoriale apo lëndore të gjykatës ku ai ushtron funksionet pasi në asnjë rast nuk është parashikuar që për sa i takon lëndës apo territorit prokurori të ketë kompetenca të ndryshme nga ajo e gjykatës ku ushtron funksionet.

14. Në këtë logjikë, vjen edhe parashikimi i rasteve të mosmarrëveshjeve që lidhen me moskompetencën, pasi në nenin 89/2 të K. Pr. Penale, thuhet që mosmarrëveshjet e lindura në fazën e hetimit paraprak zgjidhen nga prokurori më i lartë, ndërsa në nenin 91/1 të po këtij Kodi parashikohet rastet e mosmarrëveshjeve të konstatuara gjatë gjykimit zgjidhen nga Gjykata e Lartë.

15. Me këtë duam të themi se ligjvënësi ka dashur të krijojë fleksibilitet në fazën e hetimeve paraprake për të mos krijuar pengesa e zvarritje fiktive që do të ndikonin në mbarëvajtjen e procesit hetimor dhe nga ana tjetër, nëse do të donte që konfliktet e kompetencës edhe gjatë fazës së hetimeve paraprake t'ia linte gjykatës, nuk kishte përse të bënte ndarje për fazën e hetimeve dhe atë të gjykimit, apo do avanconte parashikimet më tej, duke kërkuar nga prokurori që, kur ai të konstatonte kompetencën gjatë hetimeve paraprake, t'i drejtohej gjykatës pranë së cilës ai ushtronte funksionet për të shpallur moskompetencën dhe në vijim, çdo mosmarrëveshje do zgjidhej nga Gjykata e Lartë.

16. Ky fleksibilitet i legjislatorit gjen shprehjen e vet edhe në rastet kur në nenin 87/1 të K. Pr. Penale i cili parashikon se mosrespektimi i dispozitave mbi kompetencën nuk sjell pavlefshmërinë e provave të marra. Jo vetëm kaq, por neni 88 të K. Pr. Penale rregullon edhe vlefshmërinë e masave të sigurimit të marra nga gjykata kompetente kur shprehet që: *"Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata, e cila në të njëjtën kohë ose më vonë shpallet jokompetente për çdo lloj shkaku, i humbasin efektet, në qoftë se brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, gjykata kompetente nuk vendos për masën e sigurimit".*

17. Po të kryhet interpretimi sistematik i neneve 84 dhe 88 të K. Pr. Penale, vihet re se këto dispozita rregullojnë në mënyrë të qartë veprimtarinë e organit procedues si dhe të gjykatës në rast të shpalljes së moskompetencës në fazën e hetimeve paraprake. Kështu, prokuroria shpall moskompetencën gjatë hetimeve paraprake dhe për këtë ka detyrimin të njoftojë menjëherë të dyja gjykatat. Këtu ligji si afat përdor termin menjëherë. Në vijim gjykata jokompetente brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit të prokurorit, i përcjell gjykatës kompetente aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në atë moment përpara asaj gjykate. Në vijim gjykata kompetente, nëse është caktuar masë sigurimi nga gjykata jokompetente, e merr atë në vlerësim brenda afatit 10-ditor në mënyrë që ajo të vazhdojë të ketë fuqi juridike.

18. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur qëndrimin se: Gjykatat e faktit, gjatë fazës së hetimeve paraprake gjithmonë vihen në lëvizje me kërkesë të prokurorit që ushtron funksionet pranë asaj që merr vendimet lidhur me masat e sigurimit personal, me sekuestro, kontrollet e banesave e personale, etj., ku vlerëson kushtet dhe kriteret e parashikuara nga ligji vendosjen e këtyre masave që i shërbejnë mbarëvajtjes së hetimeve.

19. Në këtë kuadër, për gjykatën që tashmë vihet në lëvizje nga prokuroria kompetente duhet të ketë rëndësi që ajo të njoftohet lidhur me një masë sigurimi të karakterit shtrëngues të vendosur nga gjykata jokompetente brenda afatit 10-ditor për ta vlerësuar atë masë, në mënyrë që të shmangë kufizimet e mëtejshme të lirisë personale në rastet kur gjatë kohës ndërmjetëse mund të kenë ndryshuar rrethanat apo nuk janë vlerësuar drejt kushtet dhe kriteret ligjore, për sa kohë prokurori i cili e ka sjellë kërkesën i ushtron funksionet pranë saj.

20. Duke u kthyer tek rasti konkret, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk mund të refuzonte asnjë kërkesë të prokurorit pranë kësaj gjykate lidhur me masat të karakterit shtrëngues personal, pasuror etj., vetëm me argumentin se nuk i ka ardhur praktika e akteve mbi të cilat gjykata jokompetente kishte vendosur për masat e sigurimit. Neni 88 i K. Pr. Penale kërkon vetëm që të marrë aktet e masës së sigurimit të vendosura nga gjykata jokompetente por nuk thotë shprehimisht që merr këto akte të masës së sigurimit nga gjykata jokompetente. Siç thamë dhe më lart, gjatë hetimeve paraprake moskompetenca lëndore apo për çdo shkak tjetër shpallet nga prokuroria e cila në vendimin e saj nuk bën gjë tjetër veçse deklaron mos kompetencën e gjykatës ku ajo i ushtron funksionet. *(shih vendimet nr. 64, datë 29.4.2015; nr. 25, datë 29.4.2015; nr. 14, datë 30.3.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

21. Përfundimi i mësipërm është mbajtur në mënyrë të konsoliduar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë edhe para ndryshimeve të nenit 84 të K. Pr. Penale, duke interpretuar dispozitat e K. Pr. Penale që rregullojnë kompetencën gjatë hetimeve paraprake dhe gjatë gjykimit. Megjithatë, mendojmë se jemi në kushtet kur tashmë situata rregullohet nga ligji, pasi zbatimi me korrektësi i nenit 84/2 të K. Pr. Penale nga prokuroria krijon një

praktikë të qartë dhe të konsoliduar gjyqësore. Ky përfundim arrihet po të marrim në konsideratë ndryshimet që ka pësuar neni 84 i Kodit Penal, ku është shtuar pika 2 me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, me këtë përmbajtje: *"Kur prokurori shpall moskompetencën, ai njofton menjëherë të dyja gjykatat. Gjykata, brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit të prokurorit, i përcjell gjykatës kompetente aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në atë moment përpara asaj gjykate."* Qëllimi i një ndryshimi të tillë ka qenë pikërisht që të shmangte praktikat e ndryshme të zbatimit të nenit 88 të K. Pr. Penale në rast të shpalljes së moskompetencës nga prokuroria gjatë hetimeve paraprake. Me këtë ndryshim është përforcuar qëndrimi dhe qëllimi i ligjvënësit që pavarësisht se gjatë hetimeve paraprake moskompetenca shpallet nga gjykata ose nga prokuroria, masat e sigurimit duhet të vlerësohen nga gjykata kompetente brenda 10 ditësh.

22. Sipas dispozitës së mësipërme, prokurori kur shpall moskompetencën, ka detyrimin të njoftojë menjëherë të dyja gjykatat, pra si gjykatën që ka qenë kompetente dhe që në eventualitet mund të ketë disponuar edhe në lidhje me masën e sigurimit, por edhe gjykatën e re që në vlerësim të tij është kompetente të lidhje me çështjen. Në vijim të këtij njoftimi, gjykata që ka qenë kompetente, brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit të prokurorit, i përcjell gjykatës kompetente aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në atë moment përpara asaj gjykate. Me përcjelljen e akteve nga kjo gjykatë, gjykata kompetente do të duhet që brenda afatit 10-ditor, të parashikuar nga neni 88 i K. Pr. Penale të marrë në vlerësim masën e sigurimit të caktuar nga gjykata jokompetente, në të kundërt ndaj saj do të zbatohet pasoja e parashikuar nga kjo dispozitë, pra humbja e fuqisë juridike të masës.

22. Mendojmë se nëse zbatohet siç duhet parashikimi i nenit 84/2 të K. Pr. Penale nuk krijohen dyshime në lidhje me përgjigjen e pyetjes së tretë të shtruar për njësim. Gjithashtu, mendojmë se zbatimi korrekt i kësaj dispozite do të shmangte edhe praktikat jouniforme në lidhje me zbatimin e nenit 88 të K. Pr. Penale në rastin kur moskompetenca shpallet nga prokuroria. Mendojmë se parashikimi i nenit 88 të K. Pr. Penale do të gjejë zbatim në çdo rast, pavarësisht se cili organ e shpall moskompetencën, gjykata e hetimeve paraprake apo prokuroria. Këtu një rol determinant ka zbatimi me korrektësi i detyrimit të parashikuar nga neni 84/2 i K. Pr. Penale nga ana e prokurorit që vendos moskompetencën gjatë hetimeve paraprake.

23. Mendojmë se përfundimi i mësipërm arrihet po të lexohet neni 88 i K. Pr. Penale në raport me neni 84/2 të Kodit. Edhe në rast se moskompetenca shpallet nga prokuroria gjatë apo në përfundim të fazës së hetimeve paraprake, ajo ka detyrimin të njoftojë të dyja gjykatat. Gjykata pranë prokurorisë që ka shpallur moskompetencën njofton gjykatën kompetente brenda 3 ditëve dhe i përcjell asaj aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në atë moment përpara asaj gjykate. Arsyeja e një parashikimi të tillë ka qenë pikërisht që gjykata kompetente të njihet me aktet e hetimeve paraprake si dhe të përmbushë edhe detyrimin e parashikuar nga neni 88 i K. Pr. Penale.

24. Mendojmë se nëse nuk do të duhej që gjykata kompetente të merrte në vlerësim masën e sigurimit brenda afatit 10-ditor, atëherë ligjvënësi nuk kishte pse të parashikonte detyrimin e prokurorit që të njoftonte të dyja gjykatat në lidhje me shpalljen e moskompetencës. Gjithashtu, nuk do të parashikohej detyrimi i gjykatës së parë që brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit të prokurorit, t'i përcjellë gjykatës kompetente aktet e hetimeve paraprake të kryera deri në atë moment përpara asaj gjykate. Parashikimi i nenit 84/2 të K. Pr. Penale dëshmon pikërisht qëllimin e ligjvënësit që edhe në këtë rast, gjykata kompetente të zbatojë parashikimin e nenit 88 të K. Pr. Penale dhe të marrë në vlerësim masën e sigurimit të vendosur nga gjykata jokompetente.

25. Hartimi i dispozitave të K. Pr. Penale është uniform me qëllimin e ligjvënësit që jo vetëm kur moskompetenca shpallet nga gjykata e hetimeve paraprake, por edhe kur ajo shpallet nga prokuroria, aktet e hetimeve paraprake t'i kalojnë sa më shpejt gjykatës kompetente e cila njihet me to dhe nëse nga gjykata jokompetente është caktuar masë sigurimi, ajo merret në vlerësim nga gjykata kompetente brenda 10 ditësh. Edhe afati 3 ditor i përcaktuar nga neni 84/2 i K. Pr. Penale brenda të cilës gjykata jokompetente i përcjell aktet gjykatës kompetente është një afat i shkurtër, i caktuar pikërisht me qëllimin që t'i japë mundësi gjykatës kompetente që brenda afatit 10-ditor të marrë në vlerësim masën e sigurimit, sipas nenit 88 të K. Pr. Penale.

26. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga gjykata sjell si pasojë që masa e sigurimit të bjerë nga fuqia *ipso lege,* pra për shkak të ligjit dhe kjo masë konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e afatit 10-ditor që nga momenti që aktet janë marrë nga gjykata kompetente, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Argumentimi i prokurorisë në rekurs, se kjo rrethanë ka ekzistuar që në vitin 2018, nuk është i bazuar dhe as përligj fuqinë e masës së sigurimit pasuror. Pasoja në lidhje me masën e sigurimit pasuror të caktuar nga një gjykatë jokompetente, për të cilën nuk shprehet gjykata kompetente brenda 10 ditëve nga marrja e akteve, parashikohet shprehimisht në ligj. Kjo pasojë është humbja e fuqisë juridike të masës së sigurimit pasuror.

27. Sa më sipër, jemi të mendimit se në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për njësim, Kolegji duhet të arrinte në këtë përfundim njësues:

Parashikimet e nenit 88 të K. Pr. Penale do të gjejnë zbatim edhe në rastin kur prokuroria gjatë hetimeve paraprake shpall moskompetencën dhe i dërgon aktet prokurorisë kompetente, sipas nenit 84/1 të K. Pr. Penale.

Në këtë rast është e domosdoshme që nga prokuroria që shpall moskompetencën të përmbushet me korrektësi detyrimi i parashikuar nga neni 84/2 i K. Pr. Penale.

Tiranë më 13.10.2021.

Anëtarë: Sandër Simoni, Klodian Kurushi

VENDIM
Nr.00-2021-1134(62), datë 1.11.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:
Ilir Panda kryesues;
Sokol Binaj anëtar;
Albana Boksi anëtare;
Sandër Simoni anëtar;
Klodian Kurushi anëtar,
në datat 26.10.2021 dhe 1.11.2021, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen penale që i përket:
KËRKUES: Durim Vata
PERSON I INTERESUAR: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës
OBJEKTI: Shuarje e masës së sigurimit.
BAZA LIGJORE**:** Nenet 238, 261/1/ç, 262 dhe 263/2/b të Kodit të Procedurës Penale (në vijim "KPP").

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË,

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Sokol Binaj; avokatin Sokol Tahiraj, mbrojtës i kërkuesit Durim Vata, që kërkoi nga Kolegji Penal shuarjen e masës së sigurimit; Prokurorin e Prokurorisë së Përgjithshme Arqilea Koça, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër; si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr. (467)25, datë 18.5.2020, ka caktuar masën e sigurimit personal "arrest në burg", të parashikuar nga neni 238 i KPP-së, midis të tjerëve edhe për shtetasin Durim Vata, me cilësinë e personit të dyshuar (hetuar) për kryerjen e veprës penale "Kultivimi i bimëve narkotike", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal (në vijim "KP").

2. Më datë 21.5.2020, nga oficerët e policisë gjyqësore pranë Komisariatit të Policisë Kukës, është depozituar në gjykatë procesverbali i zbatimit të masës së sigurimit personal të caktuar ndaj kërkuesit Durim Vata. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, gjyqtari për hetimet paraprake pranë asaj gjykate, me vendimin nr. (471)242, datë 21.5.2020, ndër të tjera, ka verifikuar pozitivisht, në përputhje me përcaktimet e nenit 248/2 të KPP-së, kushtet dhe kriteret e caktimit dhe të zbatimit të masës së sigurimit personal të "arrestit në burg", ndaj të hetuarit Vata, (si dhe nevojat e sigurimit, sipas përcaktimit të neneve 228, 229, 230 të KPP-së).

3. Më datë 30.7.2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës ka paraqitur kërkesë për dërgimin për gjykim të çështjes penale që i përket procedimit penal me nr. 420, të vitit 2018, ku, ndër të tjerë, është marrë i pandehur edhe kërkuesi Durim Vata, për veprën penale "Kultivimi i lëndës narkotike", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i KP-së. Me vendimin nr. (1107) 355, datë 6.11.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, gjyqtari i seancës paraprake pranë asaj gjykate, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin për gjykim të çështjes penale që i përket procedimit penal me nr. 420, viti 2018, me të pandehur, ndër të tjerë, edhe kërkuesin Durim Vata.

4. Më datë 10.6.2021, kërkuesi Durim Vata ka paraqitur kërkesë për shuarje të masës së sigurimit personal të "arrestit në burg", caktuar ndaj tij me vendimin nr. (467)25, datë 18.5.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës. Kjo kërkesë është marrë në shqyrtim nga kolegji gjykues në disponim të të cilit rezulton, ndërkohë, gjykimi në themel i akuzës së kontestuar nga prokurori, të pandehurit Vata, si gjykata kompetente, që disponon aktet në zbatim të nenit 261/3 të KPP-së. Kërkuesi pretendon se është në kushtet e verifikimit të tejkalimit të afateve të paraburgimit të vuajtura prej tij, për efekt të aplikimit të asaj mase, të përcaktuara në nëntë muaj – pa u dhënë vendimi i dënimit – sipas përmbajtjes së nenit 263/2/b të KPP-së, pasi sanksioni i parashikuar në dispozitën që i atribuohet këtij të fundit, sipas akuzës neni 283/2 të KP-së, parashikon një dënim, në maksimum deri në 10 vjet.

5. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës**, me vendimin nr. 104 të Regjistrit Themeltar, datë 12.6.2021, ka vendosur:

"*- Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit Durim Vata.*

- Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë bërë.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër brenda 5 ditëve, afat ky që fillon nga dita e njoftimit të vendimit.".

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës ka arsyetuar, ndër të tjera, se:

"Nga interpretimi gramatikor logjik dhe sistematik, i neneve 332/dh, 332/c dhe 332/d të Kodit të Procedurës Penale, gjykata çmon se Seanca Paraprake është parashikuar nga legjislatori si një fazë filtrimi i aktivitetit hetimor të prokurorisë, gjatë së cilës vlerësohen pretendimet për pavlefshmëri të akteve dhe papërdorshmëri të provave, kontrollohen veprimet hetimore të kryera dhe nëse çmohet e nevojshme disponohet për plotësimin e tyre, duke përcaktuar edhe drejtimet përkatëse, kontrollohet cilësimi juridik i akuzës së formuluar dhe bëhet një vlerësim paraprak mbi provueshmërinë e akuzës mbi kriterin e provave të mjaftueshme.

Sa më sipër, gjykata çmon se kjo fazë e procesit penal (seanca paraprake), nuk mund të kualifikohet si fazë e gjykimit në themel të çështjes , e për pasojë, përllogaritja e afatit të paraburgimit parashikuar nga neni 263, pika 2, germa "b" e Kodit të Procedurës Penale duhet të fillojë nga momenti kur gjyqtari i seancës paraprake disponon me vendimin për dërgimin e çështjes në gjykim, pasi prej gjykatës çmohet se kjo është dita e dorëzimit të akteve në gjykatë dhe jo momenti kur Prokurori disponon me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq përpara Gjyqtarit të Seancës Paraprake.".

7. Ndaj vendimit të mësipërm ka ushtruar ankim i pandehuri Durim Vata, duke kërkuar: "Ndryshimin e vendimit nr. 104, datë 12.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, dhe deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit personal të "arrestit në burg" të aplikuar ndaj tij".

8. **Gjykata Apelit Shkodër**, me vendimin nr. 145, datë 24.6.2021, ka vendosur:

"- Lënien në fuqi të vendimit nr.(639)104, datë 12.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

- Kundër vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë, brenda afatit ligjor që është 45 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.".

9. Kjo gjykatë ka arsyetuar se, në analizë të përmbajtjes së nenit 332/dh të KPP-së, që bën fjalë për "vendimin e gjyqtarit të seancës paraprake", në kuadër të kësaj vendimmarrjeje rezultojnë të verifikuara dy faza të identifikuara në: fazën e parë, që konfiguron disponimin e gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjykim që vijon deri në momentin e shprehjes së këtij gjyqtari lidhur me kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq. Në këtë fazë nuk kemi dorëzim aktesh në gjykatë për efekt gjykimi, por për efekt verifikimi nëse ekzistojnë kushtet për dërgimin e çështjes në gjyq disponim ky që përkon me kërkesat e nenit 332/dh të KPP-së. Në seancë paraprake, gjyqtari sipas nenit 332/ç të KPP-së mund të urdhërojë edhe plotësimin e hetimeve, duke përcaktuar drejtimin dhe, kur është rasti, edhe aktet që duhet të kryhen. Gjykata cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë dhe datën e seancës së re. Qartazi, veprimet e kryera prej këtij gjyqtari nuk mund të konsiderohen si të kryera në fazën e gjykimit në themel të çështjes, po kështu, në pikën 3, të kësaj dispozite – nenit 332/dh të KPP-së, parashikohet ndër të tjera, se procedura e shqyrtimit në seancë paraprake nuk zëvendëson gjykimin e çështjes në themel. Kjo do të thotë se gjykimi i themelit është i ndryshëm nga gjykimi në seancë paraprake. Në çdo fazë të procedimit ka afate të caktuara procedurale.

Data 30.7.2020, e identifikuar nga kërkuesi si momenti i fillimit të konsumimit të afateve të paraburgimit të fazës së gjykimit (9 muaj), ka të bëjë me momentin e dërgimit nga prokurori të akteve në gjykatë për shqyrtimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, dhe jo me depozitimin e akteve për gjykimin e themelit të çështjes. Ndaj ky afat, për aq sa u arsyetua më lart nuk mund të shërbejë si moment i fillimit të llogaritjes së afateve të paraburgimit, të kësaj faze, të gjykimit, pasi në këtë rast aktet nuk dërgohen në gjykatë për gjykimin e themelit të çështjes. Pra, afati i paraburgimit i përcaktuar në nenin 263/2 të KPP-së duhet të llogaritet duke filluar nga dita e paraqitjes së akteve në gjykatë për gjykimin në themel të çështjes.

10. **Kundër vendimit nr. 145, datë 24.6.2021, të Gjykatës së Apelit Shkodër, më datë 8.7.2021, ka paraqitur rekurs kërkuesi Durim Vata**, i cili ka kërkuar:

- Ndryshimin e vendimeve të Gjykatës së Apelit Shkodër nr. 145, datë 24.6.2021, që ka vendosur: "lënien në fuqi" të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës – nr. 104, datë 1206.2020, dhe të këtij vendimi, deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit personal të "arrestit në burg", të caktuar me vendimin nr. (467) 25, datë 18.5.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, gjyqtarit për hetimet paraprake pranë asaj gjykate, ndaj të hetuarit (të pandehurit aktualisht) Durim Vata, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Kultivimit të bimëve narkotike", në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 284/2 i Kodit Penal.

10.1 Në mënyrë të përmbledhur, në rekurs janë parashtruar këto shkaqe:

- Për sa i përket shuarjes së masës së sigurimit personal "arrest në burg", të vendosur ndaj kërkuesit, nga dita e regjistrimit të çështjes në gjykatë, datë 30.7.2020 deri më datë 7.7.2021, që përkon me momentin e gjykimit të çështjes (kërkesës) nga Gjykata e Apelit Shkodër, kanë kaluar 11 muaj e 7 ditë. Referuar nenit 263/2/b të KPP-së, afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit konsiderohen të tejkaluara, me pasojë humbjen e fuqisë – shuarjen – e masës së sigurimit personal, të caktuar, në rastin konkret, të masës së "arrestit në burg", në qoftë se nga dita e dorëzimit të akteve në gjykatë ka kaluar afati prej 9 muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe nuk është dhënë dënim.

- Mbi bazën e këtyre të dhënave, duke llogaritur edhe pezullimet e afatit të paraburgimit të të pandehurit Vata, të operuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, gjatë gjykimit të themelit të çështjes penale, në ngarkim të tij, të cilat rezultojnë në masën e gjashtë ditëve, natyrshëm, konkludohet se afati i paraburgimit të konsumuar nga i pandehuri Vata, për fazën e gjykimit të çështjes, në shkallë të parë, i parashikuar prej nenit 263/2, germa "b", të KPP-së (llogaritja e këtij afati prej nëntë muaj, sipas kësaj dispozite, "mbulon" periudhën nga "dita e dorëzimit të akteve në gjykate deri në konkludimin e gjykimit të çështjes në shkallë të parë"), verifikohet i tejkaluar, prej afër dy muajsh, me konsekuencë të pashmangshme, humbjen e fuqisë – shuarjen – e masës së sigurimit personal të "arrestit në burg", të caktuar dhe të zbatuar ndaj të pandehurit Vata. Me konstatimin e këtij fakti, në mënyrë imediate prej gjykatës duhet deklaruar, gjithnjë duke konsideruar me cilësinë e momentit fillestar të llogaritjes së këtij afati – ditën e dorëzimit të akteve në gjykatë – momentin (ditën) e depozitimit, në sekretarinë e gjykatës – gjyqtarit të seancës paraprake – të kërkesës së prokurorit "për dërgimin e çështjes në gjyq", në përputhje me përcaktimet e nenit 331 të KPP-së.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, meqenëse ndërmjet gjykatave më të ulëta ka qëndrime dhe arsyetime të ndryshme në lidhje me llogaritjen e afatit të paraburgimit të konsumuar gjatë periudhës së gjykimit të kërkesës së prokurorit nga gjyqtari i seancës paraprake, me vendimin e datës 30.9.2021, vendosi kalimin në seancë gjyqësore për shqyrtimin e çështjes penale me nr. 61010-00587-2021, datë regjistrimi 28.7.2021, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, në lidhje me çështjen:

"Cilës fazë procedurale i takon afati i paraburgimit që konsumohet gjatë gjykimit nga gjyqtari i seancës paraprake?".

12. Në seancë gjyqësore, mbrojtësi i kërkuesit Durim Vata kërkoi shuarjen e masës së sigurimit, si pasojë e llogaritjes së afatit të paraburgimit të konsumuar gjatë gjykimit në seancë paraprake, si afat i kaluar për llogari të afateve gjykimore. Nga ana e tij, në seancë u parashtruan këto argumente:

- Ndjekja penale fillon me dërgimin e kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes për gjyq, pasi vetëm në këtë çast kemi krijimin e një marrëdhënie procedurale me gjykatën.

- Vetëm pas njoftimit të përfundimit të hetimeve paraprake, prokurori, sipas nenit 327, pika 6, të KPP-së, pasi i ka njoftuar edhe akuzën dhe i ka njohur të drejtën për të ushtruar mbrojtjen brenda 10 ditëve të pandehurit, kur nuk ka proceduar sipas neneve 400 (gjykimi i drejtpërdrejtë), 406/a (urdhër penal) dhe 406/dh (me marrëveshje), të KPP-së, bën kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq.

- Pra, është në këtë çast kohor që kemi ushtrimin e ndjekjes penale, dhe në këtë çast duhet të konsiderohet se afatet e paraburgimit duhet të lidhen me fazën e gjykimit të themelit të shkallës së parë dhe jo me atë të hetimeve.

- Çdo gjë që ndodh në fazën e seancës paraprake dhe koha që kalon aty, pra edhe ecja e afateve të paraburgimit, me paraqitjen e kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes për gjyq që shënon çastin e ushtrimit të ndjekjes penale duhet të konsiderohet si fazë paraprake "gjykimi" dhe jo si pjesë e hetimeve paraprake.

13. Prokurori, pranë Prokurorisë së Përgjithshme, kërkoi nga Kolegji Penal lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër, duke llogaritur afatin e paraburgimit të konsumuar gjatë gjykimit në seancë paraprake, si afat i kaluar për llogari të afateve të hetimit paraprak. Prokurori ka parashtruar këto argumente:

- Për të kuptuar qëllimin e seancës paraprake duhet parë synimi i këtij instituti, që është kalimi në një filtër gjyqësor të vendimmarrjes së prokurorit gjatë hetimeve paraprake; kontrollin gjyqësor të diligjencës/kujdesit të prokurorit gjatë hetimeve paraprake; efektiviteti i shqyrtimit gjyqësor në themel të procedimit penal nëpërmjet parandalimit dhe riparimit të të metave; mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve pjesëmarrës në një procedim penal nga një shqyrtim në themel me debatin gjyqësor.

- Në interpretim sistematik, konstatojmë se instituti i seancës paraprake është parashikuar në kreun IX të KPP-së, i cili nga ana e tij është pjesë përbërëse e titullit IV të tij "Hetimet paraprake". Ky titull pasndiqet nga titulli V nën emërtimin "Gjykimet", pra nisur nga ky interpretim konkludohet se ligjvënësi e ka vendosur institutin e seancës paraprake si pjesë përbërëse e fazës së hetimeve e për pasojë, bazuar në logjikë formale, afati i paraburgimit i konsumuar gjatë gjykimit të seancës paraprake, i takon fazës së hetimit paraprak.

- Në interpretim analogjik me jurisprudencën italiane, konkludohet se për t'i dhënë një përgjigje çështjes së shtruar për zgjidhje bazuar në lidhje me parashikimet e bëra në nenin 332/dh të Kodit tonë të Procedurës Penale duhet të mbështetemi në mënyrë kumulative në dy kritere. Kriteri i parë është ai që buron nga interpretimi sistematik i dispozitës që sikurse argumentuam çon në konkluzionin se instituti i seancës paraprake është pjesë e fazës së hetimeve paraprake e për rrjedhojë dhe paraburgimi i konsumuar gjatë kësaj faze i takon fazës së hetimit paraprak. Dhe kriteri i dytë është kriteri funksional i organit procedues, në rastin konkret të gjykatës. Pra vlerësimi se në cilin moment gjykata ushtron funksionet kontrolluese vlerësuese të hetimeve paraprake dhe në cilin moment gjykata ushtron funksionet kushtetuese të bërjes së drejtësisë.

- Aktiviteti i gjykatës, pas vendimmarrjes së përshkruar kryesisht në shkronjat "b" dhe "c" të nenit 332/dh të KPP-së, përfshihen në aktivitetin funksional kushtetues të gjykatës dhe nuk i takon fazës së hetimit paraprak e për pasojë dhe afatet e paraburgimit të konsumuara pas vendimmarrjes së mësipërme i takojnë fazës së gjykimit.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal

14. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim "Kolegji"), në dhomë këshillimi, në datë 30.9.2021, verifikoi rekursin e paraqitur nga kërkuesi/i pandehuri Vata, në funksion të plotësimit të kushteve formale dhe substanciale të pranueshmërisë së tij, në përputhje me përcaktimet e neneve 432 dhe 433 të KPP-së. Kolegji vlerësoi se rekursi objekt shqyrtimi plotëson kërkesat e ligjit për t'u pranuar, konkretisht të kushtit të karakterit substancial, të përcaktuar në germën "a", të paragrafit të parë të nenit 432 të KPP-së, të identifikuar në: "mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural", prej gjykatave të të dyja shkallëve (të Rrethit Gjyqësor Kukës dhe të Apelit Shkodër), lidhur me kërkesën e paraqitur nga kërkuesi/i pandehuri Vata, gjatë gjykimit në themel të çështjes penale në ngarkim të tij, me objekt deklarimin e humbjes së fuqisë (shuarjes) së masës së sigurimit personal të "arrestit në burg" caktuar ndaj tij. Gjykatat e faktit, në shqyrtimin e kësaj kërkese, kanë disponuar për rrëzimin e saj, duke vlerësuar qëndrimin e mbrojtësit se afatet e paraburgimit janë konsumuar, pasi kanë kaluar nëntë muaj pa u shprehur gjykata me vendim përfundimtar, si të pabazuar në ligj. Në interpretimin e ligjit procedural penal, gjykatat e faktit kanë arritur në konkluzionin se afati i paraburgimit i "konsumuar"/që ka kaluar gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes nga gjyqtari i seancës paraprake deri në momentin që ky i fundit ka disponuar "për dërgimin e çështjes në gjyq", duhet përfshirë si afat i fazës së hetimit paraprak. Sipas gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit, afati i parashikuar në nenin 263/2 të KPP-së për fazën e gjykimit, fillon nga momenti i depozitimit dhe i regjistrimit të fashikullit të gjykimit te gjyqtari i gjykimit të çështjes në themel, duke vlerësuar këtë moment, si: "dorëzimi i akteve në gjykatë".

15. Në verifikim të praktikës gjyqësore në drejtimin e sipërcituar, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin e rëndësishëm të ndryshimeve që ka pësuar KPP-ja (me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017), ku është parashikuar seanca paraprake si një fazë e procedimit penal, por, nga ana tjetër, edhe faktin që ky ndryshim nuk është shoqëruar edhe me ndryshimin e nenit 263 të KPP-së, Kolegji çmoi se ekzistojnë kushtet e parashikuara në nenin 438 të KPP-së për inicimin e procedurës së gjykimit për njësimin e praktikës gjyqësore. Seanca paraprake është parashikuar si një fazë e rëndësishme dhe e pashmangshme e procedimit penal, që synon të garantojë të drejtat e mbrojtjes, duke verifikuar dhe kontrolluar plotësinë e hetimeve të kryera, veprimet dhe vendimmarrjen e prokurorit gjatë fazës së hetimit paraprak.[9] Kolegji konstaton se, ndonëse ligjvënësi ka parashikuar seancën paraprake në procesin penal, nuk e ka shoqëruar këtë ndryshim të rëndësishëm edhe me ndryshimin e nenit 263 që parashikon afatet e paraburgimit për çdo fazë të procedimit. Ndërkohë, në funksion të ushtrimit të kontrollit të hetimeve paraprake, gjyqtari i seancës paraprake mund të disponojë edhe për plotësimin e hetimeve, sipas nenit 332/ç të KPP-së dhe/ose për korrigjimin ose saktësimin e akuzës, sipas nenit 332/d të KPP-së, fakt ky që ndikon edhe në afatin e paraburgimit, për të pandehurin ndaj të cilit është caktuar masa e arrestit.

16. Përballur me problematikën e sipërcituar, Kolegji konstaton se nga gjykatat e faktit ka pasur qëndrime të ndryshme, në lidhje me kohëzgjatjen e paraburgimit dhe ndikimin e kësaj faze të re të procedimit (seanca paraprake) në afatet e posaçme (të secilës fazë përkatëse) dhe/ose në ato të përgjithshme (tërësore) të

[9] Për më tepër, relacioni i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, që shoqëroi miratimin e ndryshimeve në KPP, me ligjin nr. 35/2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale".

paraburgimit, të parashikuara në nenin 263 të KPP-së. Në rastin konkret, gjykatat e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe e Apelit Shkodër, kanë përcaktuar se seanca paraprake, parashikuar në nenet 332–332/gj të KPP-së, është pjesë e fazës së hetimeve paraprake, për efekt të llogaritjes së afateve të paraburgimit (të kohëzgjatjes së tyre). Ndërkohë, në raste të tjera të ngjashme, gjykatat kanë mbajtur qëndrimin se seanca paraprake dhe afati i zgjatjes së saj është pjesë e fazës së gjykimit, për efekt të llogaritjes së afateve të paraburgimit (për më tepër, shih vendimet nr. 77, datë 30.7.2018 dhe nr. 219, datë 27.11.2019 të (ish) Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda). Në ndryshim nga ligji procedural penal shqiptar, KPP-ja italiane që është marrë si model referimi nga ligjvënësi shqiptar, parashikon afate të qarta paraburgimi për secilën fazë, përfshi këtu edhe seancën paraprake. Kolegji vlerëson me rëndësi të theksojë faktin se edhe pas ndryshimeve të fundit të KPP-së, me ligjin nr. 41/2021, ku faza e seancës paraprake ka pësuar ndryshime thelbësore, ligjvënësi nuk ka reflektuar në përmbajtjen e nenit 263 të KPP-së.

17. Në terma të tjerë, kjo problematikë, se: "Cilës fazë procedurale i përket (i atashohet) afati i (kohëzgjatjes) paraburgimit të konsumuar, prej të pandehurit, gjatë fazës së procedimit të gjykimit (trajtimit) të çështjes prej gjyqtarit të seancës paraprake", objekt i këtij gjykimi njësues, do të gjejë zgjidhje në varësi të interpretimit nëse kjo fazë e re e procedimit penal do të cilësohet si një fazë ndërmjetëse midis fazës së hetimeve paraprake dhe fazës së gjykimit të çështjes (në shkallë të parë dhe të dytë) apo do të renditet/përfshihet – *tout court*/*thjesht* – në përbërje të njërës apo të tjetrës fazë (hetim apo gjykim). Në këtë vështrim, Kolegji vlerëson me rëndësi të evidentojë qëllimin e përfshirjes së kësaj faze procedurale në procesin penal, rolin dhe kompetencat që ka gjyqtari i seancës paraprake.

18. Kolegji sjell edhe një herë në vëmendje se, me ligjin nr. 35/2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", (të ndryshuar), është parashikuar faza e seancës paraprake, si një fazë "filtri dhe kontrolli" mbi veprimet dhe vendimmarrjen e prokurorit. Gjyqtari i seancës paraprake ka kompetencë të verifikojë provat e mbledhura në ngarkim të të pandehurit gjatë fazës së hetimeve paraprake, si dhe bazueshmërinë/qëndrueshmërinë e akuzës në gjykimin e themelit. Me fjalë të tjera, detyra kryesore e gjyqtarit të seancës paraprake është të kontrollojë nëse kërkesa e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq është e bazuar, si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu edhe nga pikëpamja e përdorshmërisë dhe vlefshmërisë së akteve, por nuk ka si qëllim të arrijë në konkluzione mbi fajësinë e të pandehurit. Kontrolli i ushtruar nga gjyqtari i seancës paraprake mbi hetimet e kryera, përfshi këtu edhe saktësimin apo korrigjimin e akuzës, nuk do të thotë se ai merr funksionet e prokurorit në ushtrimin e ndjekjes penale.

19. Përfshirja e seancës paraprake si një nga fazat e procedimit penal, paraqet rëndësi në funksion të forcimit të institutit të mbrojtjes, nëpërmjet kontrollit (filtrimit) të akuzave të nxituara dhe të pambështetura, të paraqitura prej prokurorit, fryt i një veprimtarie hetimore të pakompletuar/të paplotë, përfshirë sidomos rastet kur prokurori anashkalon apo nuk tregon vëmendjen e duhur në lidhje me integrimin e kontributit të mbrojtjes në funksion të kësaj kompletueshmërie. Ligjvënësi, gjithsesi ndryshe nga fazat e tjera klasike të procedimit penal, të hetimeve paraprake dhe të gjykimit të çështjes në themel (në shkallë të parë dhe të dytë), nuk parashikoi *(ometoi)* afate të veçanta kohëzgjatjeje të paraburgimit për këtë fazë dhe as një pasqyrim të ndikimit të kësaj faze të re, të shtuar, të procedimit, në afatin tërësor të kohëzgjatjes së paraburgimit, të parashikuar në nenin 263/6 të KPP-së. Kjo fazë e procedimit penal ka ndikim në ecurinë e gjithë procesit, përfshi këtu edhe në kohëzgjatjen e e paraburgimit për të pandehurin.

20. Verifikimi i kësaj situate ligjore nga njëra anë, dhe "modelimi" i seancës paraprake, nga ana tjetër, për sa i përket aspektit procedural të zhvillimit të saj, sipas tipologjisë së zhvillimit të seancës gjyqësore të gjykimit të çështjes në themel, me elemente tipike karakterizues të këtij gjykimi *(in primis* "kompetenca" e gjyqtarit të seancës paraprake, për të pezulluar afatet e paraburgimit të të pandehurit, në përputhje me përcaktimet e nenit 265 të KPP-së), sipas konsideratës së këtij Kolegji imponon pashmangshmërisht, një linjë interpretimi të problematikës së identifikuar në këtë gjykim njësues, në favor të konsiderimit të periudhës së kohëzgjatjes së paraburgimit, të vuajtur prej të pandehurit gjatë seancës paraprake, si periudhë që i përket (integrohet) në fazën e gjykimit të çështjes, të parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 263 të KPP-së. Ky afat fillon prej momentit (ditës) të "dorëzimit të akteve në gjykatë", nga prokurori dhe zgjat deri në momentin e "dhënies së vendimit të dënimit në gjykatën e shkallës së parë", gjithnjë duke respektuar kjo kohëzgjatje afatet e parashikuara, me pasojë humbjen e fuqisë së masës (shuarjen e saj), në shkronjat "a", "b", "c", të paragrafit të dytë të kësaj dispozite, sipas llojit të akuzës për të cilën procedohet.

21. Por, nga ana tjetër, Kolegji konstaton se gjyqtari i seancës paraprake në ushtrim të funksioneve që i ka njohur ligji, mund të disponojë edhe për plotësimin e hetimeve, kur ato nuk janë të plota, si dhe mund të urdhërojë prokurorin të korrigjojë apo të saktësojë akuzën e atribuar të pandehurit. Vendimmarrja e gjyqtarit të seancës paraprake në këto raste, nuk i jep fund seancës paraprake, pra nuk përmbyll këtë fazë të procedimit penal.

Diskutimi që lind në këtë rast është nëse kemi një regres në fazën e hetimit paraprak apo kjo vendimmarrje është pjesë e seancës paraprake dhe rolit të saj si një fazë që synon kontrollin e plotësisë së hetimeve dhe garantimin e të drejtave procedurale të të pandehurit.

22. Për arritjen në një përfundim në lidhje me sa më lart parashtroi, Kolegji vlerëson se duhet bërë një interpretim i normave procedurale që rregullojnë institutin e ri të seancës paraprake, por duke e lidhur me mungesën e reflektimit të kësaj fazë të re të procedimit për sa u përket afateve të paraburgimit. Kolegji çmon se parashikimi i figurës së gjyqtarit të seancës paraprake synon jo thjesht ushtrimin e një "kontrolli" mbi veprimtarinë procedurale të prokurorit gjatë hetimit paraprak, por, mbi të gjitha, garantimin e të drejtave të mbrojtjes, duke synuar edhe efektivitetin e gjykimit të çështjes penale në themel.

23. Në mungesë të parashikimit ligjor në lidhje me afatin e paraburgimit të konsumuar gjatë seancës paraprake, Kolegji vlerëson se duhet analizuar edhe përmbajtja e nenit 263 të KPP-së. Neni 263/2 i KPP-së në gjendjen aktuale edhe pas ndryshimeve të vitit 2017, parashikon se: "*Paraburgimi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dorëzimit të akteve në gjykatë kanë kaluar afatet e mëposhtme, pa u dhënë vendimi i dënimit në shkallë të parë:*

a) dy muaj, ku procedohet për kundërvajtje penale;

b) nëntë muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;

c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

23.1 Ndërsa, neni 263/6 i KPP-së përcakton se: *"kohëzgjatja tërësore e paraburgimit, duke marrë parasysh dhe zgjatjen e parashikuar nga neni 264, pika 2, nuk mund të kalojë këto afate:*

a) dhjetë muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;

b) dy vjet, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;

c) tre vjet, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.".

24. Kjo dispozitë, në pikën "1" të saj, e lidh humbjen e fuqisë së paraburgimit të hetimit, me kalimin e afateve të parashikuara "*pa u dorëzuar aktet në gjykatë".* Interpretimi ligjor që duhet bërë nga Gjykata e Lartë, në këtë rast është nëse "dorëzimi i akteve në gjykatë" lidhet me momentin e parashikuar në nenin 327 pika 6, kur prokuroi në përfundim të hetimeve kërkon dërgimin e çështjes në gjyq apo në momentin kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për pranimin e kësaj kërkese, sipas nenit 332/dh të KPP-së. Në këto dy dispozita ligjvënësi ka parashikuar: i. detyrimin për prokurorin që, së bashku me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, të depozitojë edhe aktet e provat që përmban fashikulli i hetimeve, sipas nenit 331, pika "4" të KPP; ii. detyrimin e gjyqtarit të seancës paraprake, që kur vendos dërgimin e çështjes në gjyq, të përcaktojë aktet që duhet të përmbajë fashikulli i gjykimit (neni 332/ë) dhe më pas ta depozitojë këtë fashikull së bashku me aktet e masave të sigurimit, në sekretarinë e gjykatës kompetente (neni 332/f).

25. Në interpretim të neneve që kanë rregulluar institutin e seancës paraprake, Kolegji Penal niset nga kriteri teleologjik i normës dhe nga kriteri funksional i organit procedues, në rastin konkret të gjykatës. Pra, vlerësimi se në cilin moment gjykata ushtron funksionet kontrolluese vlerësuese të hetimeve paraprake dhe në cilin moment gjykata ushtron funksionet kushtetuese të bërjes së drejtësisë. Nga vendi që zë në renditjen e normave procedurale, i vendosur në kreun IX të KPP-së, "seanca paraprake", si dhe nga qëllimi i krijimit të kësaj figure të gjyqtarit të seancës paraprake, Kolegji vlerëson se ajo është një fazë e ndërmjetme procedurale, të cilën ligjvënësi nuk e ka përcaktuar as si pjesë e hetimit, por as si pjesë e fazës së gjykimit. Në rrethanat e parashtruara, në lidhje me llogaritjen e afateve të paraburgimit për këtë fazë, në mungesë të një parashikimi të saktë ligjor, Kolegji vlerësoi se duhet t'i referohemi natyrës së vendimmarrjes së gjyqtarit të seancës paraprake, nëse ky vendim i jep fund kësaj faze apo nëse aktet i kthehen prokurorit.

26. Kolegji vë në dukje se, në zbatim të nenit 327, pika "6" të KPP-së, prokurori me depozitimin e kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, depoziton njëkohësisht edhe të gjitha aktet në gjykatë/gjyqtari i seancës paraprake. Ky moment procedural, sipas ligjit (shprehimisht në këtë nen parashikohet: "*në përfundim të hetimeve* ...*"*), shënon përfundimin e hetimeve paraprake. Në favor të këtij interpretimi të karakterit teleologjik, në përshtatje me qëllimin e ligjvënësit në parashikimin e këtij instituti procedural, është edhe përcaktimi i nenit 331 të KPP-së (kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq), që nënkupton përfundimin e fazës së hetimeve paraprake me kontestimin/atribuimin e akuzës të pandehurit dhe dërgimin e çështjes për gjykim. Është pikërisht kjo kërkesë (për dërgimin e çështjes në gjyq) e paraqitur nga prokurori në përfundim të hetimeve paraprake (përmbajtja e së cilës pasqyron në thelb akuzën e kontestuar prej këtij të fundit të hetuarit, i cili prej këtij momenti "fiton" statusin e të pandehurit, duke u akuzuar për një akuzë të caktuar), që "provokon" konstituimin e seancës paraprake si një moment kyç në funksion, sikurse u sipërcitua, të verifikimit të akuzës të atribuar të pandehurit, si për sa i përket aspektit të kompletueshmërisë së hetimeve të zhvilluara, ashtu edhe në

drejtim të kualifikimit të saktë juridik të faktit penal të atribuar nëpërmjet akuzës, të pandehurit.

27. Neni 327 i KPP parashikon: "*2. Brenda afatit të parashikuar nga neni 324, i këtij Kodi, prokurori njofton mbi përfundimin e hetimeve paraprake të pandehurin, mbrojtësin e tij, si dhe viktimën ose trashëgimtarët e saj, kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit. 3. Njoftimi përmban përshkrimin e përmbledhur të faktit penal për të cilin procedohet, kohën dhe vendin e kryerjes, cilësimin juridik, lajmërimin për depozitimin e akteve në sekretari dhe të drejtën për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje. 4. I pandehuri njoftohet, gjithashtu, se ka të drejtë që brenda dhjetë ditëve të paraqesë memorie e dokumente, t'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklarime apo të kërkojë që të merret në pyetje. Kur i pandehuri kërkon të pyetet, prokurori është i detyruar të procedojë me pyetjen e tij ...*".

28. Me kryerjen e këtyre veprimeve procedurale, nga ana e prokurorit merret vendimi për dërgimin e çështjes në gjykim, duke kërkuar diçka të tillë para gjyqtarit të seancës paraprake. Në këtë mënyrë prokurori ka mbyllur fazën e tij të hetimeve duke vlerësuar se i ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore. Zakonisht në praktikë ky moment procedural korrespondon me përmbushjen e afatit të përcaktuar nga neni 263/1 përfshi dhe atë të nenit 327 të KPP-së. Kontrolli i hetimeve nga gjyqtari i seancë paraprake është konfirmim e kryerjes së hetimeve paraprake në funksion të një gjykimi efektiv e që garanton më mirë të drejtat e garancitë procedurale. Por duke qenë tipar i një kontrolli gjyqësor që realizohet në debat e kontradiktoritet në mes të palëve të thirrur në seancë gjyqësore nënkuptohet që kur gjyqtari i seancës paraprake vendos sipas nenit 332/dh të KPP-së ai sillet si gjyqtari i gjykimit, në një gjykim të kufizuar, por pa marrë atributet e gjyqtarit të themelit për çështje të vlerësimit të fakteve, provave e fajësisë.

29. Sipas interpretimit sistematik të normës, seanca paraprake është shtuar si krye më vete (kreu IX, "Seanca paraprake"), me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017. Më përpara ne nuk kemi pasur një figurë të gjyqtarit të seancës paraprake, kemi pasur vetëm gjyqtarin e hetimit. Që në fillim të parashikimit të rregullave të dhëna nga neni 332 i KPP-së (i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, ndryshuar pika 1, shtuar pika 1/1, me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021) parashikohet se: *"... kërkesa për dërgimin e çështjes në gjykim shqyrtohet në seancë paraprake nga gjyqtari i vetëm. Kërkesa për dërgimin në gjykim të çështjeve të ndara nga i njëjti procedim penal shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar i seancë paraprake. ... Gjykata vendos mbi kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj."*

30. Nga interpretimi i këtij rregullimi ligjor del se tashmë kemi një figurë të veçantë gjyqtari i cili ka kompetenca për të shqyrtuar në këtë fazë kërkesën e prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjykim, shqyrtim i cili duhet të kryhet brenda 30 ditëve. Gjyqtari i seancës paraprake ka kompetencë për shqyrtimin e kërkesave të paraqitura nga palët e procesit penal, gjatë kohës që ky gjyqtar disponon me vendim për plotësimin e hetimeve, sipas nenit 332/ç të KPP-së shqiptare.

31. Disa nga llojet e kërkesave që mund të paraqiten nga palët e procedimit penal, gjatë kësaj kohe janë: zgjatja e afateve të paraburgimit, kërkesa që lidhen me masat e sigurimit (revokimi dhe zëvendësimi); kërkesa që lidhen me marrjen e provave të reja; kërkesa që lidhen me pavlefshmërinë e akteve procedurale dhe papërdorshmërinë e provave, të kryera këto gjatë kohës që gjyqtari i seancës paraprake ka disponuar me vendim, sipas nenit 332/ç të KPP-së shqiptare; kërkesa që paraqet i pandehuri për gjykimin e shkurtuar, pasi gjyqtari i seancës paraprake ka disponuar me vendim sipas nenit 332/ç të KPP-së shqiptare apo kërkesa për përgjimin e komunikimeve etj.

32. Kontrolli i hetimeve nga gjyqtari i seancës paraprake është në funksion të një gjykimi efektiv e që garanton më mirë të drejtat e garancitë procedurale të të pandehurit. Por, duke qenë tipar i një kontrolli gjyqësor që realizohet nëpërmjet debatit dhe në zbatim të kontradiktoritetit mes të palëve të thirrura në seancë gjyqësore, nënkuptohet që kur gjyqtari i seancës paraprake vendos sipas nenit 332/dh të KPP-së, ai ushtron funksione juridiksionale (si gjyqtar i gjykimit), në një gjykim të kufizuar, por pa marrë atributet e gjyqtarit që shqyrton themelin e çështjes, në lidhje me vlerësimin e fakteve, provave dhe fajësisë së të pandehurit.

33. Gjyqtari i seancës paraprake kontrollon hetimet paraprake dhe, nëse konstaton se akuza nuk është e plotë, urdhëron plotësimin e tyre sipas nenit 332/ç të KPP-së, duke përcaktuar drejtimet e hetimeve, afatin brenda të cilit ato duhet të kryhen, provat që duhet të ribëhen, si dhe cakton datën e seancës së re. Nenet 332/ç të KPP-së dhe 332/dh, parashikojnë dy situata të ndryshme rrethanash e kushtesh procedurale.

34. Kolegji vlerëson se, kur gjyqtari i seancës paraprake vepron sipas nenit 332/ç të KPP-së, duke urdhëruar plotësimin e hetimeve nuk disponon me vendim që i jep fund seancës paraprake. Në këtë rast, gjyqtari urdhëron kryerjen e veprimeve të mirëfillta procedurale hetimore e, për rrjedhojë, afatet e paraburgimit në këtë rast duhen llogaritur si afate të paraburgimit të fazës së hetimit. Kur gjyqtari i seancës paraprake urdhëron *plotësimin e hetimeve,* sipas nenit 332/ç të KPP-së, palët e procesit penal mund të paraqesin kërkesë për zgjatjen e afateve të paraburgimit. Afati i caktuar nga gjykata për plotësimin e hetimeve është në funksion të hetimeve, ndërsa afati i paraburgimit është autonom nga ai i hetimeve. Afati i caktuar nga gjyqtari i seancës paraprake gjithnjë duhet të jetë brenda afatit tërësor të hetimeve. Në momentin e kthimit të akteve prokurorit, lidhur me afatin e

paraburgimit, nëse afati i paraburgimit përfundon gjatë periudhës kur aktet janë kthyer sipas kësaj dispozite, prokurori mund të kërkojë zgjatjen e afateve të paraburgimit, nëse më parë nuk i ka zgjatur ato, sipas nenit 264/2 të KPP-së.

35. Gjyqtari i seancës paraprake ka kompetencë të vendosë mbi kërkesat e paraqitura nga palët e procesit penal gjatë kohës që ai ka disponuar me vendim për plotësimin e hetimeve, sipas nenit 332/ç të KPP-së. Kërkesat e paraqitura nga palët për zgjatjen e afatit të paraburgimit, revokimin/zëvendësimin e masave të sigurimit, marrjen e provave të reja, konstatimin e pavlefshmërisë së akteve procedurale dhe papërdorshmërisë së provave, pranimin e gjykimit të shkurtuar apo për përgjimin e komunikimeve etj. shqyrtohen nga gjyqtari i seancës paraprake, gjatë kohës që ai ka urdhëruar plotësimin e hetimeve sipas nenit 332/ç të KPP-së. Një konkluzion i tillë bazohet në faktin se ligjvënësi ka parashikuar që bashkë me urdhërimin për plotësimin e hetimeve, gjyqtari i seancës paraprake cakton edhe datën kur duhet të përfundojnë hetimet, si dhe seancën e re.

36. Ndërkohë, me ndryshimet në KPP me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.32021, gjyqtari i seancës paraprake është kompetent për vijimin e gjykimit dhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit, si dhe kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar. Në shkronjat "b" dhe "c" të nenit 332/dh të KPP-së, parashikohet tashmë: "*që gjyqtari i seancës paraprake, pasi dëgjon diskutimet e palëve vendos:*

b) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e pranimit të fajësisë dhe caktimin e dënimit;

c) të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimit të nenit 332/c të këtij Kodi.

37. Edhe në këtë rast, për këtë disponim të gjyqtarit të seancës paraprake, sipas pikave "b" e "c" të nenit 332/dh të KPP-së, i cili zgjidh çështjen përfundimisht, nuk është parashikuar nëse afatet e paraburgimit i përkasin gjykimit apo nëse janë afate autonome. Kompetenca e gjyqtarit të seancës paraprake për të vlerësuar nëse ka prova të mjaftueshme për ta dërguar çështjen në gjykim ose ajo për pushimin e akuzës ose të çështjes të përcaktuara nga shkronjat "a" dhe "ç" të nenit 332/dh të KPP-së, janë kompetenca të natyrës gjykimore, pasi në këtë rast gjyqtari i seancës paraprake bën një vlerësim tjetër nga ai i hetimeve paraprake. Një element tjetër që tregon se kjo fazë e procedimit ka një karakter juridiksional është edhe parashikimi i pezullimit të afateve të paraburgimit bazuar në nenin 265 të KPP-së nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake. Pezullimi është ndërprerje e afateve të paraburgimit për shkaqe të parashikuara shprehimisht në ligj, afate që rifillojnë pasi të ketë rënë shkaku i pezullimit, dhe vazhdojnë për pjesën e pakonsumuar të tyre. Parashikimi i referimit nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake i mundësisë së pezullimit të afateve të paraburgimit, sipas nenit 332/b, paragrafi 7, nënkupton një mundësi procedurale për të frenuar ecjen e pajustifikuar të këtyre afateve.

38. Pezullimi i afateve të paraburgimit nga ana tjetër, si një mundësi procedurale me nenin 265 të KPP-së, nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake nënkupton që legjislatori është mjaftuar në këtë mundësi procedurale për të frenuar kalimin e afateve të paraburgimit, kur shqyrtimi në seancë paraprake nuk ecën për shkak të mungesës nga ana e të pandehurve. Pezullimi është ndërprerje e afateve për shkaqe të parashikuara shprehimisht ne ligj dhe këto afate rifillojnë, pasi të ketë mbaruar, ose të jetë hequr shkaku i pezullimit dhe vazhdojnë për pjesën e pakonsumuar të tyre.

39. Kur gjykata disponon për një nga shkaqet që ligji parashikon për pezullim të afateve të paraburgimit, këto afate nuk ecin, por rifillojnë pas heqjes së pezullimit. Kjo do të thotë, se vetë afati maksimal i paraburgimit nuk tejkalohet proceduralisht, por koha fizike e paraburgimit mund të jetë më e gjatë se afati tërësor. Po t'u referohemi shkaqeve të pezullimit të afateve të paraburgimit, ato lidhen me veprime dhe kërkesa të padrejta të mbrojtësit apo të të pandehurit, apo me mosparaqitjen apo largimin e mbrojtësit nga gjykimi. Pra, pezullimi i afateve të paraburgimit vendoset për shkaqe që kanë të bëjnë me sjelljen e të pandehurve e të mbrojtësve të tyre dhe jo me ato të organit të akuzës apo të gjykatës. Parashikimi i referimit nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake i mundësisë së pezullimit të afateve të paraburgimit, sipas nenit 332/b, paragrafi 7, nënkupton një mundësi procedurale për të frenuar ecjen e pajustifikuar të këtyre afateve.

40. Kolegji konstaton se në fakt, nga analiza e dispozitave që rregullojnë seancën paraprake, evidentohen elemente që të shtyjnë drejt konsiderimit të kësaj faze, në përbërje të fazës së hetimeve paraprake, referuar përcaktimit të nenit 332/ç të KPP-së (vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake për plotësimin e hetimeve, duke përcaktuar drejtimin e tyre), si dhe të nenit 332/d, pika 3, të KPP-së (vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake për kthimin e akteve prokurorit, kur ky i fundit nuk vepron për të bërë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme të akuzës). Gjithsesi, konstatimi i këtyre diferencave në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të seancës paraprake, sipas Kolegjit, konsiderohet i pamjaftueshëm për të "eklipsuar" karakterin tendencialisht juridiksional të kësaj faze të

procedimit penal (seancës paraprake), dhe përfshirjen e saj (për efekt të llogaritjes së afateve të paraburgimit të të pandehurit, sipas përcaktimit të nenit 263 të KPP-së) në një fazë tjetër, të ndryshme nga faza e gjykimit të çështjes (në shkallë të parë), të asaj të hetimeve paraprake. Kolegji çmon se qëllimi i dy dispozitave të cituara më lart është në funksion të kompetencës funksionale të gjyqtarit të seancës paraprake, në lidhje me kontrollin dhe verifikimin e akuzës së paraqitur prej prokurorit, në aspektet e përmendura më lart, për sa i përket nivelit (standardit) provues të "provave" (burimeve të provave në fakt) të mjaftueshme, për të "toleruar" (standardi minimal) gjykimin e çështjes (akuzës). Kjo kompetencë e gjyqtarit të seancës paraprake, që në thelb lidhet me verifikimin e kushteve të gjykueshmërisë së çështjes, ka diferenca edhe me funksionin e gjyqtarit të gjykimit të çështjes (akuzës) në themel, i cili duhet të verifikojë bazueshmërinë e akuzës në funksion të fajësisë së të pandehurit.

41. Diferencat e evidentuara më lart, në vlerësimin e Kolegjit, mbështesin konkluzionin se seanca paraprake, sipas ligjit procedural penal shqiptar, është një fazë e ndërmjetme, por që ka tipare juridiksionale.

41.1 Në interpretimin teleologjik të normave, për aq sa ka parashikuar legjislacioni ynë i ri procedural, kompetencën funksionale të gjyqtarit të seancës paraprake dhe duke iu përmbajtur karakterit funksional të organit procedues në këtë rast, arrihet në përfundimin se afati 30-ditor i paraburgimit që konsumohet gjatë gjykimit të çështjes para gjyqtarit të seancës paraprake, i takon fazës së gjykimit të çështjes në themel (në shkallë të parë), kur gjyqtari i seancës paraprake disponon, për:

- pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq;
- vijimin e gjykimit nga e njëjta Gjykatë, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e fajësisë dhe caktimit të dënimit;
- vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar;
- pushimin e akuzës ose të çështjes apo deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente, në rastet e parashikuara në ligj, sipas nenit 332/dh, shkronjat "c" dhe "d" të KPP-së.

41.2 Ndërsa, për sa i përket situatës procedurale të parashikuar në nenet 332/ç dhe 332/d paragrafi i tretë i KPP-së, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon: *"kthimin e akteve prokurorit"* për *"plotësimin e hetimeve"* dhe për "*korrigjimin dhe saktësimin e akuzës"*, pra me verifikimin e pamundësisë së konkludimit të seancës paraprake, në dy rastet e sipërcituara, Kolegji, konsideron periudhën e konsumimit të afateve të paraburgimit për llogari të fazës së procedimi penal, të hetimeve paraprake.

42. Sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson që në lidhje me pyetjen e shtruar për njësim, duhet të arrihet në këtë përfundim njësues:

1. Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të hetimit paraprak, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon "Për plotësimin e hetimeve", sipas nenit 332/c dhe/ose "Për kthimin e akteve prokurorit për korrigjimin ose saktësimin e akuzës", sipas nenit 332/d, pika 3, e KPP-së.

2. Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të gjykimit, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon, për:

a) pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq;

b) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e fajësisë dhe të caktimit të dënimit;

c) vijimin e gjykimit nga e njëjta gjykatë, kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar;

ç) për pushimin e akuzës ose të çështjes apo deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente, në rastet e parashikuara në ligi, sipas nenit 332/dh shkronjat "ç" e "d" të Kodit të Procedurës Penale.

43. Duke u kthyer te rasti konkret, çështja objekt gjykimi, që i përket rekursit të paraqitur prej kërkuesit Vata, ndaj vendimmarrjes së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe asaj të Apelit Shkodër, të cilat lidhur me kërkesën për deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit personal "arrest në burg" të caktuar ndaj tij, me vendimin nr. 25, datë 18.5.2020 (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës – gjyqtari për hetimet paraprake pranë asaj gjykate), Kolegji Penal, duke iu referuar konkluzionit njësues, sipas të cilit (shkronja "a" e pikës 1 të tij): "periudha e afatit të paraburgimit të konsumuar gjatë fazës të trajtimit të çështjes para gjyqtarit të seancës paraprake, kur prej këtij të fundit, është vendosur dërgimi i çështjes në gjyq, sipas përcaktimit të germës "a", të paragrafit të parë, të nenit 332/dh të KPP-së, konsiderohet/përfshihet, në cilësinë e afatit të paraburgimit të fazës së gjykimit (në themel, në shkallë të parë) të çështjes, të parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 263 të KPP-së", konkludon mbi aplikimin e gabuar të ligjit procedural – përcaktimi i germës "a", të paragrafit të parë të nenit 332 të KPP-së – prej gjykatave të faktit (të shkallës së parë dhe të dytë). Si pasojë, Kolegji vlerëson se vendimmarrja e gjykatave të faktit, për sa i përket përllogaritjes të afatit të paraburgimit të konsumuar prej të pandehurit Vata, për periudhën prej

datës 30.7.2020 deri më datë 6.11.2020, si afat të konsumuar gjatë fazës së hetimit paraprak, është i gabuar, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe në vlefshmërinë e masës së sigurimit personal të "arrestit në burg", të caktuar ndaj tij.

44. Kolegji së pari vlerëson, se, në lidhje me masat e sigurimit, e drejta për të ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, është parashikuar shprehimisht në pikën 8, të nenit 249, të KPP-së, ku theksohet, se: "*Rekursi në Gjykatën e Lartë lejohet për shkelje të ligjit, brenda kompetencës së saj*". Në këtë vështrim, rekursi në lëndë të masave të sigurimit duhet të evidentojë shprehimisht shkeljen e ligjit, e lidhur kjo edhe me sa parashikon neni 432 i KPP-së, ku janë parashikuar shkaqet për të cilat lejohet rekursi në Gjykatën e Lartë. Kolegji thekson se juridiksioni rishikues i Gjykatës së Lartë, nënkupton shqyrtimin e rekurseve për shkelje të ligjit material dhe procedural, duke siguruar zbatimin uniform të ligjit apo zhvillimin e praktikës gjyqësore. Ligji nuk i jep Gjykatës së Lartë asnjë kompetencë për të shqyrtuar elementet materiale dhe faktike të ngjarjeve të hetuara, përfshirë nivelin e provave që mbështesin dyshimin e arsyeshëm apo elementet, që lidhen me vlerësimin e nevojave të sigurimit në rastin konkret.

45. Kolegji vlerëson, se, edhe në rastin e rekurseve në lëndë të masave të sigurimit, shqyrtimi i tyre lidhet ngushtësisht me pretendimet për shkelje të ligjit. Në këtë vështrim, shqyrtimi i fakteve dhe i provave/akteve edhe në këtë rast, del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Kolegji arriti në këtë konkluzion, pasi shtroi për diskutim nëse kushtet e kërkuara nga neni 266 i KPP-së mund të verifikohen në Gjykatën e Lartë, si gjykatë ligji apo duhen verifikuar në gjykatat e faktit. Ky diskutim lind pasi shqyrtimi i kushteve për caktimin e masave të sigurimit, siç mund të jetë ekzistenca në vijim e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova ose/dhe shqyrtimi i kritereve si përshtatshmëria e masës së sigurimit apo analiza e proporcionalitetit, kërkon domosdoshmërisht edhe çmuarjen e provave/akteve të përfshira në fashikull, vlerësim të rrethanave të faktit dhe të nevojave të sigurimit, vlerësim të personalitetit të të hetuarit/dyshuarit, vlerësim të rrezikshmërisë së veprës penale dhe të autorit të dyshuar të saj. Kolegji vlerëson se, kufizimi në këtë rast është i lidhur me pamundësinë e Gjykatës së Lartë për të caktuar masën më të përshtatshme të sigurimit, qoftë në favor apo kundër të dyshuarit.

46. Kolegji Penal, duke vlerësuar ligjshmërinë (e munguar) të vendimmarrjes së Gjykatës së Apelit Shkodër, por në të njëjtën kohë edhe pamundësinë faktike të tij për të disponuar korrigjimin e kësaj paligjshmërie, në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke zëvendësuar dhe "uzurpuar" diskrecionin e gjykatave të faktit, çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër nr. 145, datë 24.6.2021, që ka vendosur "lënien në fuqi" të vendimit nr. 104, datë 12.6.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, duhet të prishet duke u kthyer çështja për rigjykim, pranë asaj gjykate si gjykata kompetente.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 438 dhe 441/1/, shkronja "c" të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit nr. 145, datë 24.6.2021, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë si gjykata kompetente.
2. Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore publikohet në Fletoren Zyrtare të radhës.

Tiranë, më 1.11.2021.

Kryesues: Ilir Panda
Anëtarë pro: Albana Boksi, Klodian Kurushi, Sandër Simoni
Anëtarë pjesërisht kundër: Sokol Binaj

Procesverbal mbi motivet e kundërshtimit (të pjesshëm) të vendimit të Kolegjit Penal

I mbajtur nga unë gjyqtar Sokol Binaj, me cilësinë e anëtarit të Kolegjit Penal në disponim të të cilit rezultoi gjykimi (njehsues) i çështjes që i përket kërkuesit Durim Vata me objekt deklarimin e shuarjes së masës së sigurimit personal të "arrestit në burg", të caktuar ndaj tij, me vendimin nr. 25, datë 18.5.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, ardhur, mbi rekursin, e këtij të fundit, ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër nr. 145, datë

24.6.2021, që kishte vendosur miratimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës (nr. 104, datë 12.6.2021), që, nga ana e tij, kishte vendosur rrëzimin e kësaj kërkese, me të cilin paraqes motivet e kundërshtimit (të pjesshëm) të vendimit (njehsues) të këtij Kolegji, në justifikim të votës sime (pjesërisht) kundër këtij vendimi.

Me vendimin nr. 00-2021, date 1.11.2021, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në cilësinë e Kolegjit njehsues të praktikës gjyqësore, sipas përcaktimit të nenit 438 të K. Pr. Penale, ka vendosur:

Prishjen e vendimit nr. 45, date 24.6.2021 të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim, në atë Gjykate, si gjykata kompetente.

Ndërsa për sa u përket përfundimeve njehsuese, të realizuara në kuadrin e këtij gjykimi, prej këtij Kolegji, është konkluduar, si me poshtë:

1. Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të hetimit paraprak, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon për "plotësimin e hetimeve", sipas nenit 332/c dhe/ose "për kthimin e akteve Prokurorit për korrigjimin ose saktësimin e akuzës", sipas nenit 332/d, pika 3 e K. Pr. Penale.

2. Afati i paraburgimit që konsumohet gjatë seancës paraprake i takon fazës procedurale të gjykimit, kur gjyqtari i seancës paraprake disponon, për:

a) pranimin e kërkesës së Prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq;

b) vijimin e gjykimit nga e njëjta Gjykate, kur palët paraqesin marrëveshje mbi kushtet e fajësisë dhe të caktimit të dënimit;

c) vijimin e gjykimit nga e njëjta Gjykate kur i pandehuri ka kërkuar gjykim të shkurtuar;

d) për pushimin e akuzës ose të çështjes apo deklarimin e moskompetencës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente, në rastet e parashikuara në ligj, sipas nenit 332/dh, shkronjat "c", "e", "d", të K. Pr. Penale.

Lidhur me konkluzionet njehsuese të Kolegjit Penal, të sipërcituara, ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, me përjashtim të momentit, të përfundimit – konkluzionit – njehsues, të përcaktuar në pikën 1, sipas të cilit, konsiderohen me cilësinë e "afateve të paraburgimit të konsumuara gjatë fazës së hetimeve paraprake", afatet e konsumuara, si rrjedhojë e vendimmarrjes së këtij gjyqtari – të seancës paraprake – për të "degraduar" – kthyer – çështjen në disponim të prokurorit, pra, në fazën e hetimeve paraprake, nën justifikimin e "plotësimit të hetimeve" apo të "korrigjimit dhe të saktësimit të akuzës prej prokurorit", për të cilin kam mendimin, në saktësim të konceptit, se vërtet, afatet e konsumuara në plotësim të rekomandim/urdhërimeve të gjyqtarit të seancës paraprake, duhet të konsiderohen me cilësinë e afateve të fazës së hetimeve paraprake, por të afateve të rifilluara, të rillogaritura, nga e para, në të njëjtat kushte sikurse, në rastet e parashikuara në paragrafin e katërt, të nenit 263 të K. Pr. Penale, për afatet e paraburgimit, të fazave të gjykimit të çështjes në shkallë të parë dhe të dytë, me rastin e prishjes së çështjes nga gjykatat superiore, të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë, të cilat fillojnë të llogariten rishtazi, nga e para, gjithnjë, të toleruara, prej afatit të kohëzgjatjes tërësore të paraburgimit, eventualisht të paezauruar.

GJYQTAR
Sokol Binaj

VENDIM
Nr. 00-2021-1135 (147), datë 23.12.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:
Ilir Panda kryesues;
Sokol Binaj anëtar;
Albana Boksi anëtare;
Medi Bici anëtar;
Sandër Simoni anëtar,
në datën 23.12.2021, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen penale që u përket:
KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë
SUBJEKTE TË INTERESUARA: 1. Lapsi.al; 2. Andi Bushati; 3. Armand Shkullaku.
OBJEKTI: Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike.
BAZA LIGJORE: Nenet 208, 208/a e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relacionin e gjyqtarit Sokol Binaj; përfaqësuesin e Prokurorisë së Përgjithshme, prokurorin Arqilea Koça, i cili kërkoi mospranimin e rekursit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ndaj vendimit/urdhrit nr. 116, datë 6.5.2021, të Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; mbrojtësin e subjekteve të interesuara, Av. Dorian Matlija, i cili u shpreh se urdhri nr. 116, datë 6.5.2021, i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar duhet lënë në fuqi, si i marrë nga gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit, ankim ky i bërë brenda afateve ligjore, si dhe duke u caktuar nga Gjykata e Lartë standardet që do të duhet të udhëzojnë kriteret e zbatimit të sekuestrimit të të dhënave kompjuterike, me fokus të veçantë te mbrojtja e burimeve dhe sekreteve profesionale të gazetarit, duke u bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në respekt të nenit 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kryesisht, ka regjistruar, në datën 13.4.2021, me nr. 95, në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, në konformitet me përcaktimet e nenit 287/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), njoftimin për veprën penale "Përhapja e sekreteve private", të parashikuar nga neni 122 i Kodit Penal (KP).

2. Regjistrimi i këtij procedimi është iniciuar nga informacioni i marrë në portalet Lapsi.al dhe Syri.net, nga përmbajtja e të cilëve krijohej dyshimi se subjekti elektoral, Partia Socialiste e Shqipërisë, kishte krijuar një sistem të dhënash konfidenciale, në funksion të zgjedhjeve të përgjithshme të datës 25.4.2021, duke ndërhyrë dhe shfrytëzuar për këtë qëllim të dhënat e databazës shtetërore "e-Albania".

3. Në artikujt e këtyre portaleve pasqyrohej se bëhej fjalë për të dhënat konfidenciale të 910 000 votuesve nga mosha 19 deri 99 vjeç. Dokumenti përmban të dhënat personale për çdo person, si numrin e telefonit, numrin e kartës së identitetit, numrin e qendrës së votimit, vendin e punës për shumicën e të regjistruarve dhe një përshkrim të përkatësisë politike.

4. Po ashtu, me numër 100, datë 14.4.2021, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Prokuroria e Posaçme), ka përditësuar regjistrin e njoftimeve të veprave penale, me njoftimin për veprën penale "Korrupsioni aktiv në zgjedhje", të parashikuar nga neni 328 i KP-së, krahas regjistrimit të datës 13.4.2021, të njoftimit për veprën penale "Përhapja e sekreteve private", të parashikuar nga neni 122 i KP-së, mbi bazën, këtë radhë, të kallëzimit penal nr. 326 prot., datë 14.4.2021, të paraqitur prej subjektit elektoral Partia Demokratike e Shqipërisë. Faktet e kallëzuara lidheshin me bazën e të dhënave, pjesë të të cilave ka publikuar portali Lapsi.al, objekt hetimi, i Prokurorisë së Posaçme, në kuadër të procedimit penal të regjistruar me nr. 95, të vitit 2021.

5. Me vendimin e datës 14.4.2021, prokurori i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka bashkuar të dy procedimet në një të vetëm, me nr. 95, datë 13.4.2021.

6. Në vijim të zbatimit urdhërimit të prokurorit (të datës 13.4.2021), të sekuestrimit dhe/ose këqyrjes së bazës së të dhënave në zotërim të medias Lapsi.al, më datë 14.4.2021, oficerët e policisë gjyqësore dhe ekspertët përkatës janë paraqitur pranë zyrave të kësaj medieje për të proceduar me kryerjen e veprimit, por nga ana e shtetasve Andi Bushati dhe Armand Shkullaku, titullarët e saj dhe gazetarë të medias me të njëjtin emër, është refuzuar dhënia e kësaj baze të dhënash, me justifikimin e "ruajtjes së burimit të informacionit" të imponuar prej kodit profesional të gazetarit.

7. Pasi ka çmuar, në funksion të ecurisë dhe të kompletimit/plotësimit të hetimeve të filluara, rëndësinë e databazës së të dhënave kompjuterike, në zotërim të medias Lapsi.al, si dhe, në kushtet e verifikimit të prezencës së të dhënave të mjaftueshme konfirmuese të dyshimit për konsumimin e veprave penale të regjistruara, objekt i këtij hetimi (procedimi penal), prokurori i Prokurorisë së Posaçme i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në konformitet me përcaktimet e neneve 208 dhe 208/a, të KPP-së, vendosjen e sekuestros provuese penale, në thelb, sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, databazës së sistemit të të dhënave, duke u marrë sendi në të cilin gjenden të depozituara të dhënat. Sipas organit të akuzës, kjo provë do të shërbente për të orientuar hetimin drejt origjinës së burimit të shpërndarjes së të dhënave të sipërcituara dhe implikimit eventual të institucioneve shtetërore të ngarkuara nga ligji për ruajtjen e konfidencialitetit të këtyre të dhënave me ndjeshmëri të lartë.

8. **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, me vendimin nr. 131, datë 18.4.2021, ka vendosur:

"*- Pranimin e kërkesës së prokurorit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke urdhëruar menjëherë:*

Hyrjen, kërkimin, marrjen dhe sekuestrimin e të dhënave kompjuterike në sistemin kompjuterik ku mund të gjenden këto të dhëna dhe konkretisht:

Baza e të dhënave me gjeneralitetet e shtetasve shqiptarë dhe të dhëna të tjera personale të tyre, e identifikuar në artikujt e botuar nga media Lapsi.al, si: "sistem të dhënash që është vënë në dispozicion të zyrave elektorale të Partisë Socialiste dhe që ngre dyshime të forta për përdorimin e databazës shtetërore e-Albania...", e disponuar nga shoqëria Lapsi.al me NIPT: L51327021A dhe ortakët, dhe administratorët e saj, shtetasit Armand Shkullaku dhe Andi Bushati, kudo ku gjendet e ruajtur dhe e transferuar, si: aparat telefonik, server, kompjuter, USB, CD, DVD etj., që disponohen nga shoqëria Lapsi.al sh.p.k., me seli në rrugën "Papa Gjon Pali 2", godinë banimi, kati i 5-të, Tiranë dhe nga ortakët dhe administratorët e kësaj shoqërie Armand Shkullaku dhe Andi Bushati.

- Urdhërohen shtetasit Armand Shkullaku dhe Andi Bushati, si ortakë dhe administratorë të shoqërisë Lapsi.al sh.p.k. të identifikojnë vendin, apo sendin ku ruhen këto të dhëna kompjuterike.

- Sekuestrimi të kryhet duke u marrë sendi në të cilin gjenden të dhënat dhe duke u krijuar edhe një kopje unike e këtyre të dhënave kompjuterike, me qëllim ruajtjen e tyre.

- Në rast të pamundësisë për t'u marrë sendi në të cilin gjenden të dhënat, pamundësi objektive që lidhen me natyrën e sendit, të procedohet me nxjerrjen dhe marrjen e kopjeve të të dhënave kompjuterike, duke u urdhëruar mbajtësi i tyre të ndalojë kryerjen e veprimeve të mëtejshme në lidhje me këto të dhëna, si dhe të sigurohet sistemi kompjuterik, duke u ruajtur nga mbajtësi i të dhënat kompjuterike të mësipërme.

- Të sigurohet paprekshmëria e të dhënave përkatëse të memorizuara.

- Për kryerjen e tij të ngarkohen oficerët e policisë gjyqësore pranë Njësisë C, Hetimi i Krimit Kompjuterik në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe oficerë të policisë gjyqësore në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ankim i cili nuk pezullon zbatimin e këtij vendimi.".

9. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë ka çmuar si të drejtë dhe të bazuar në KPP kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke argumentuar vendimmarrjen e saj si më poshtë:

10. Neni 208/a i KPP-së parashikon urdhërimin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike nga gjykata në rastin e procedimeve për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit. Gjykata e gjen të pabazuar në nenin 159/3 të KPP-së refuzimin e shtetasve Andi Bushati dhe Armand Shkullaku, të cilët nuk kanë zbatuar vendimin e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, duke moslejuar sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, që edhe sipas shpjegimeve të tyre, dëshmojnë qartazi se janë të domosdoshme për zbulimin e veprës penale dhe të autorëve të saj.

11. **Kundër vendimit nr. 131, datë 18.4.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kanë paraqitur ankim subjekti Lapsi.al dhe shtetasit Andi Bushati dhe Armand Shkullaku**, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për vendosjen e sekuestros, si të pambështetur në prova dhe në ligj. Në ankimet e tyre është parashtruar se:

"- Vendimi i gjykatës është tërësisht i kundërligjshëm kur disponon, si në pikën 6 të dispozitivit, detyrimin e subjektit Lapsi.al administratorëve të tij, Andi Bushatit dhe Armand Shkullakut, ndalimin e kryerjes së veprimeve të mëtejshme, në lidhje me të dhënat që kërkohet të sekuestrohen;

- Gjykata cenon burimin e informacionit, duke ardhur në kundërshtim me praktikën e Gjykatës së Strasburgut;

- Me vendimin kuptohet sikur të dyshuar për veprat penale, për të cilat është regjistruar procedimi, janë Lapsi.al dhe shtetasit Andi Bushati dhe Armand Shkullaku. Qëllimi përfundimtar i prokurorisë dhe i gjykatës nuk është sekuestrimi i të dhënave kompjuterike, por të identifikohet burimi i informacionit.

- Gjykata e hetimeve paraprake nuk ka asnjë pengesë ligjore procedurale për të orientuar prokurorinë në kryerjen e atyre veprimeve hetimore që mund të çojnë në plotësimin ose jo të elementeve të ndonjë figure vepre penale, si ato për të cilat është regjistruar procedimi penal, pa cenuar mbrojtjen që i jep gjykata, ligji dhe KEDNJ-ja burimeve të informacionit të gazetarit profesionist.

- Prokuroria, gjithashtu, nuk ka arsyetuar në asnjë paragraf të kërkesës së saj se përse administrimi i të dhënave nga Lapsi.al është një veprim hetimor i nevojshëm dhe i domosdoshëm për ecurinë e hetimeve, në një kohë kur të dhënat e plota të cilat kërkohen të administrohen nga kjo medie, janë sot të aksesueshëm, siç shprehet vetë prokuroria, në internet, nëpërmjet një shërbimi WeTransfer (faqe 3, e vendimit të gjykatës).".

12. **Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**, me urdhrin nr. 116, datë 6.5.2021, ka vendosur: "*Shfuqizimin e vendimit nr. 131, datë 18.4.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.*".

13. Kjo gjykatë ka çmuar se qëndron kundërshtimi i ankuesve për ç'ka dhe duhet të pranohet, duke u shfuqizuar urdhri nr. 131, datë 18.4.2021, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

14. Gjykata ka vlerësuar të sqarojë se sekuestro është ndalimi përkohësisht i zotërimit apo/ose i tjetërsimit të sendit provë materiale dhe dokument, i marrë në ruajtje e në dispozicion të organit të akuzës. Për këtë ai shfaqet si instrument ligjor që justifikon marrjen në zotërim të sendit që shërben për vërtetimin e fakteve penalisht të ndëshkueshme dhe për këtë i klasifikuar si mjet i kërkimit të provës. Sekuestro provuese, neni 208 i KPP-së, është e ndryshme nga sekuestro konservuese, neni 270 i KPP-së, si dhe e ndryshme nga sekuestro preventive/parandaluese, neni 274 i KPP-së.

15. Kështu, është objekt i sekuestros provuese sendi provë materiale drejtpërdrejt apo tërthorazi i lidhur me veprën penale që është i domosdoshëm për vërtetimin e faktit, neni 208 i KPP-së. Pra, është ai send pa të cilin nuk mund të arrihet në njoftimin mbi ekzistencën e faktit dhe sekuestrimi është mjeti i marrjes së tij, krejt instrumental dhe aspak shtrëngues. Mund të ndodhë që vërtet sendi të jetë drejtpërdrejt apo tërthorazi i lidhur me veprën penale, por jo domosdoshmërish vërtetues i faktit, sepse ekzistenca e të njëjtit fakt njoftohet edhe me prova të tjera, për çka dhe jashtë objektit të sekuestrimit provues. Për arsye se lidhet me nevoja të të provuarit dhe aspak me raportin e pronësisë, sekuestro provuese bie mbi çdo send, pavarësisht nga personi titullar i pronësisë, apo i përdorimit të sendit, por kurdoherë vetëm kur është domosdoshmërish vërtetues i faktit. Ekzekutimi i sekuestros provuese, përmbushet "... nga vetë ai që ka nxjerrë vendim ..." (neni 208, paragrafi 2, i KPP-së) dhe për këtë, sipas rastit gjykata apo prokurori. Po ashtu ajo mund të përmbushet dhe nga OPGJ-të, të cilët për këtë delegohen me të njëjtin vendim (neni 208, paragrafi 2, i KPP-së), që ka vendosur sekuestrimin provues.

16. Për sekuestron provuese, të caktuar gjatë procesit nga gjykata, të drejtat e mbrojtjes janë të siguruara, kjo si pasojë e disiplinimit normues të vetë procesit. Po ashtu edhe për atë të urdhëruar nga prokurori këto të drejta janë të siguruara pasi prokurori, kur do të kryejë kontroll ose sekuestrim, njofton të pandehurin që të jetë i pranishëm së bashku me mbrojtësin e zgjedhur dhe, kur nuk e ka këtë, cakton një mbrojtës kryesisht (par. 1, i nenit 310, të KPP-së), por pa u njohur me objektin konkret të tij, çka nuk i humbet veprimtarisë sekuestruese befasinë, duke shpëtuar nevojat e procedimit. Ndërsa sekuestro provuese me iniciativë të policisë gjyqësore përgjatë hetimit paraprak, në mënyrë të kufizuar, është e garantuar. Në çdo rast, mbrojtësi ka të drejtën të jetë i pranishëm dhe pastaj, sepse edhe sekuestro provuese është veprimtari befasuese, në verifikime të ngutshme në vend (neni 300, paragrafi 2, i KPP-së), ndihma e mbrojtësit nuk shtrihet në lajmërimin e tij që më parë, për ekzekutimin e saj (neni 302, i KPP-së).

17. Përkundrejt ankimit të Lapsi.al sh.p.k., përfaqësuar nga Andi Bushati dhe Armand Shkullaku, vendimi nr. 131, datë 18.4.2021, është i gabuar, sepse sekuestrimi nuk është i domosdoshëm (neni 208, paragrafi 1, i KPP-së), sepse nuk është rasti i procedimit për krim (neni 208/a, par. 1, i KPP-së) dhe sepse nuk mund të sekuestrohen mbajtëset e të dhënave kompjuterike (neni 208/a, paragrafi 1, i KPP-së), ashtu siç ka urdhëruar gjykata e shkallës së parë.

18. Kështu, *së pari*, sekuestro e të dhënave kompjuterike të ndodhura në median Lapsi.al, apo në aparatin me sistem kompjuterik të A. Bushatit dhe A. Shkullaku, nuk është e domosdoshme (neni 208, paragrafi 1, i KPP-së) për të arritur në ekzistencën e faktit, objekt i hetimit nga Prokuroria e Posaçme dhe kështu është e pabazuar në ligj sekuestroja e dhënë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë. Shfaqja nga ana e medias Lapsi.al e sekuencave të bazës së të dhënave me shënimin "patronazhist", në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë tregon se burimi i kësaj të fundit nuk është personi që ka për detyrë të ruajë sekretin, siç dyshohet se është e-Albania, por dyshohet në mënyrë të arsyeshme që kjo bazë të dhënash të jetë në posedim të subjektit elektoral Partia Socialiste, e cila ka vendosur shënimet "patronazhist" dhe që nuk është personi që për shkak të detyrës ose profesionit është i detyruar të ruajë sekretin vetjak, siç kërkon neni 122, i KP-së.

19. *Së dyti*, "përhapja e sekreteve vetjake", e cila sipas nenit 122 të KP-së është kundërvajtje penale në të dy paragrafët e saj, ndërsa sipas tekstit të paragrafit 1, të nenit 208 të KPP-së, rezulton se sekuestrimi i të dhënave ose sistemeve kompjuterike bëhet për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit. Për çka sekuestroja e urdhëruar me vendimin nr. 131, datë 18.4.2021, rezulton e ndaluar nga parashikimi ligjor, ku shkelja e këtij ndalimi, mbi bazën e normimit të nenit 151 paragrafi 1, i KPP-së, se: "provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren...".

20. *Së treti*, ky Kolegj e gjen të gabuar dhe të pambështetur në ligj, atë pikë të vendimit të sekuestrimit të të dhënave kompjuterike, ku urdhërohet se: "sekuestrimi të kryhet duke u marrë sendi në të cilin gjenden të dhënat ...". Ndryshe nga sa parashikon neni 208 i KPP-së, i cili lejon sekuestrimin e provave materiale dhe me këtë rast edhe i çdo sendi që identifikon nëpërmjet fotografimit filmik, fonografimit ose çdo mjeti tjetër fakte, persona ose sende, neni 208/a i KPP-së, përjashton sekuestrimin e mbajtësve magnetike të të dhënave kompjuterike, duke përjashtuar kategorikisht mundësinë e sekuestrimit materialisht të mbajtësve magnetikë të të dhënave kompjuterike, aparat telefonik, server, kompjuter, USB, CD, DVD, në të cilat ndodhet, apo janë shënuar të dhënat kompjuterike. Për pasojë sekuestroja e urdhëruar me vendimin nr. 131, datë 18.4.2021, rezulton e ndaluar nga parashikimi ligjor, ku shkelja e këtij ndalimi, mbi bazën e normimit të nenit 151 paragrafi 1, i KPP-së, se: "provat e marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren ...".

21. **Kundër urdhrit nr. 116, datë 6.5.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka paraqitur rekurs Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar**, e cila kërkon prishjen e këtij vendimi/urdhri dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 131, datë 18.4.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në rekurs janë parashtruar këta shkaqe:

- Organi procedues vlerësoi se duhet të posedonte së pari provën, pra bazën e të dhënave, me qëllim këqyrjen e saj. U vlerësua e domosdoshme për vijimësinë e hetimit, për arsye se vetëm me njohjen me të mund të ngriheshin dhe planet hetimore që kishin të bënin me faktin nëse dokumenti ishte autentik/origjinal, i mëvetësishëm si i tillë apo mund të kryheshin dhe ndërhyrje nga të tretët, cfarë rubrikash konkrete përmbante dokumenti, krahasimi i të dhënave të rubrikave të dokumentit me realitetin e tyre (p.sh.: datëlindje, atësi e amësi, punësimi, nr. i identitetit etj.), me qëllim identifikimin e institucioneve që mund të dispononin këto të dhëna, identifikimin e mënyrës së përpunimit dhe mundësinë e shpërndarjes së tyre; njohja me emrat e personave të identifikuar si patronazhistë, me qëllim identifikimin saktësisht të tyre, profesionit dhe lidhjes që mund të kishin, nëse kishin një të tillë me ndonjë subjekt partiak, apo institucion shtetëror etj. Organi procedues nuk kishte dijeni të formës së ekzistencës së kësaj prove, nëse ekzistonte si një dokument në letër, apo elektronik. Këqyrja do të na mundësonte të merrnim të dhëna më konkrete mbi vetë dokumentin dhe ndoshta edhe mundësinë e identifikimit të subjekteve që e kishin krijuar atë. Pra në vetë këtë provë, nga organi procedues, vlerësohej se mund të zbuloheshin gjurmë të veprës penale.

- Sekuestrimi është urdhëruar të kryhet duke u mundësuar marrja e databazës, në mënyrë që të garantohej autenticiteti në momentin e marrjes dhe mosndryshimi edhe në vijimësi i materialit të sekuestruar, me qëllim që të mos ngriheshin pretendime nga palët për ndryshime në këtë bazë të dhënash, duke vlerësuar që ky veprim të asistohej dhe nga dy ekspertë përkatës. Qëllimi i organit procedues nuk ka qenë asnjëherë të cenohej në ndonjë mënyrë burimi i gazetarit që kishte ofruar këtë bazë të dhënash, por të sigurohej vetë prova materiale. Nga organi procedues po kërkohej dorëzimi i provës dhe jo i burimit.

- Më datë 14.4.2021, shtetasit Andi Bushati dhe Armand Shkullaku janë shprehur se nuk pranonin të jepnin dokumentet, pasi nuk duan të tregojnë burimin e informacionit. Vendimi i sekuestrimit nuk rezultoi të kundërshtohej në Gjykatë, sikundër parashikohet në nenin 212 të KPP-së.

- Më datë 15.4.2021, rezultoi se është një link ku lehtësisht mund të aksesohej nga cilido dhe të shfaqej një bazë të dhënash të shtetasve shqiptarë, me të dhëna të tyre personale dhe sensitive. Organit procedues i rezultoi edhe një fushë tjetër që ka të bëjë me hetimin e faktit se kush mundësoi shpërndarjen nëpërmjet një shërbimi WeTransfer të kësaj baze të dhënash dhe nëse kjo është e njëjtë me atë që posedonte shoqëria Lapsi.al.

- Organi procedues vlerësoi, në respektim të nenit 208/a të KPP-së, t'i paraqesë kërkesë Gjykatës, duke pasur parasysh edhe ligjin nr. 8888, datë 25.4.2002, "Për ratifikimin e Konventës për krimin në fushën e kibernetikës", për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar mori vendimin nr. 131, datë 18.4.2021.

- Për ekzekutimin e këtij vendimi, më datë 19.4.2021, oficerët e policisë gjyqësore dhe ekspertët e ngarkuar, morën kontakt me shtetasit Armand Shkullaku dhe Andi Bushati. Shtetasi Armand Shkullaku, nëpërmjet komunikimit telefonik është përgjigjur se nuk ishin në zyrë dhe nuk ofrojnë hapjen e zyrës së redaksisë. Pas disa minutash është paraqitur poshtë pallatit shtetasi Andi Bushati, i cili verbalisht konfirmoi se nuk do të mundësonte vajtjen te zyra lidhur me zbatimin e vendimit të gjykatës, duke refuzuar bashkëpunimin për zbatimin e tij.

- Vendimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit është i pabazuar në ligj dhe në prova. Është rezultat i interpretimit, respektimit, e zbatimit të gabuar të dispozitave penale dhe procedurale penale, të cilat vlerësojmë se kanë rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, e konkretisht ajo që lidhet me "domosdoshmërinë" e sekuestrimit dhe me faktin se, sipas nenit 208/a të KPP-së, nuk mund të sekuestrohet sendi. Kjo pasjell nevojën e dhënies së përgjigjes për çështjet sa vijon:

- Së pari: Sipas nenit 208/a të KPP-së, a lejohet sekuestrimi i sendit në të cilin gjenden të dhënat kompjuterike, apo vetëm të dhënat kompjuterike?

- Së dyti: Nëse lejohet vetëm sekuestrimi i të dhënave kompjuterike, si mund të realizohet pa u poseduar sendi? Sjellim në vëmendje se për shkak të volumit, jo në çdo rast është i mundur krijimi i kopjes dhe marrja e saj në moment dhe gjithashtu mund të gjendemi para faktit se e dhëna mund të jetë fshirë dhe duhet rikuperuar nga ekspertët përkatës, procedurë që ka nevojë për aparaturat përkatëse.

- Së treti: Cili është roli i gjykatës në trajtimin e domosdoshmërisë së marrjes së provës? Duhet të arsyetojë mbi atë që kërkohet të vërtetohet/provohet në raport me të drejtat që rrezikojnë të shkelen? Apo duhet gjykata të analizojë se faktet mund të vërtetohen në rrugë tjetër? Nëse duhet të vërtetohen në rrugë tjetër, a duhet që gjykata, si gjykatë e hetimit paraprak, të tregojë se si mund të vërtetohen ndryshe faktet? Nëse po, a përbën kjo ndërhyrje e gjykatës cenim të kompetencave të prokurorit, për ushtrimin e ndjekjes penale, drejtimin dhe kontrollin e hetimeve paraprake (neni 24 i KPP-së)?

- Së katërti: Cilët janë rrugët që shërbejnë për të kryer verifikimin, nëse përbën sekret që lidhet me profesionin, kur kërkohet dokumenti, akti apo sendi dhe jo burimi i informacionit, në rastin e gazetarëve (shih nenin 211, pika 1, të KPP-së)? Në rastin e sekretit shtetëror neni 211 i KPP-së, në pikën 2 të tij e ka të përcaktuar si kryhet verifikimi kur kemi të bëjmë me sekret shtetëror, por nuk ka asnjë parashikim në lidhje me sekretin profesional të gazetarit.

- Anashkalimi i veprës penale të parashikuar nga neni 328 i KPP-së nuk gjen asnjë justifikim ligjor.

- Në lidhje me arsyetimin e gjykatës se: "sekuestrimi nuk është i domosdoshëm", në referim të neneve 150, 151, 208, 187, të KPP-së dhe 36 të Kodit Penal, baza e të dhënave mund të shihet në dy aspekte, si produkt dhe si mjet. Në këtë moment kundërshtojmë plotësisht vendimin e gjykatës, që e trajton bazën e të dhënave vetëm në logjikën e produktit dhe si të tillë jo të domosdoshëm për të proceduar me sekuestrimin. Për më tepër ka një tërësi veprash penale që mund të dënohen vetëm kur arrihet të merret produkti. Për shembull në rastin e falsifikimit të dokumentit, personi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi penale në qoftë se nuk gjendet dokumenti i falsifikuar. Kjo vjen jo vetëm për shkak të mungesës së dokumentit të falsifikuar, por edhe për shkak të domosdoshmërisë që paraqet pasja e dokumentit të falsifikuar për t'iu nënshtruar ekspertimeve përkatëse, me qëllim identifikimin e autorit të falsifikimit.

- Së pari, mund të aludojmë se baza e të dhënave është produkt i një sërë veprash penale. Së dyti, baza e të dhënave mund të jetë dhe mjet i kryerjes së veprës penale, ashtu siç pretendohet nga kallëzuesi për të kryer korrupsionin aktiv në zgjedhje (neni 328 i KPP-së). Së treti, mund të jetë një provë në të cilën gjenden gjurmë dhe ka qenë objekt i veprimeve të të pandehurit. Me ndihmën e ekspertëve mund të arrijmë të zbulojmë të dhëna që do të na ndihmojnë për zbulimin e autorit që ka marrë të dhënat dhe nga cili sistem kompjuterik mund të ketë realizuar marrjen e të dhënave (në këtë moment kërkoj të theksoj se qëllimi i organit procedues nuk është të zbulojë se kush është personi që i ka poseduar këto të dhëna dhe ia ka dhënë administratorëve të Lapsi.al, por burimi në origjinë i këtyre të dhënave, pra nëse janë marrë nga një sistem i caktuar kompjuterik, i krijuar sipas legjislacionit në Shqipëri.).

- Kjo provë mund të na shërbejë për të treguar se fakti në radhë të parë ka ndodhur, mënyra se si ka ndodhur (pra, si është arritur marrja nga institucionet që e kanë për detyrë të ruajnë), mund të identifikojmë gjurmë të autorit që prezantohet se ka ndërhyrë në ndonjë sistem kompjuterik, fakte që mund të kenë ndodhur para dhe pas në lidhje me këtë dokument, në funksion të vërtetimit të veprës penale të autorit.

- Kualifikimi në këtë fazë të hetimit që baza e të dhënave është produkt dhe nuk vlerësohet e domosdoshme për t'u administruar, nuk gjendet i drejtë dhe në përputhje me ligjin.

- Në lidhje me arsyetimin që parashtron gjykata mbi rrugët ku prokuroria duhet të drejtojë hetimin për të zbardhur faktin, kjo gjykatë parashtron një arsyetim konfondues, të paqartë, si dhe të nxituar lidhur me autorët e mundshëm, kur arsyeton se: shënimin "patronazhist", në mënyrë të qartë dhe të padyshimtë tregon se burimi i kësaj të fundit nuk është personi që ka për detyrë të ruajë sekretin, siç dyshohet se është e-Albania, por dyshohet në mënyrë të arsyeshme që kjo bazë të dhënash të jetë në posedim të subjektit elektoral Partia Socialiste e Shqipërisë, e cila ka vendosur shënimet "patronazhist". Sjellim në vëmendje se jemi në fazën e hetimeve dhe sipas nenit 24 të KPP-së është prokurori ai që ushtron ndjekjen penale, drejton dhe kontrollon hetimet. Gjykata mund t'i hyjë analizës së sipërcituar vetëm në fazën e gjykimit. Ky arsyetim nuk mund të justifikojë domosdoshmërinë apo jo të sekuestrimit të bazës së të dhënave. Konkludimi i gjykatës se sekuestrimi i bazës së të dhënave është i pabazuar si në prova, ashtu edhe në ligj mbështetet në deduktime të një arsyetimi, i cili është thjesht aludim, pasi nuk ka asnjë bazë mbi të cilin po kryhet. Vetëm pas një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm mund të konkludohet mbi autorin e veprës penale.

- Normalisht, ajo që gjykata duhet të vlerësojë është: a) A parashikohet në legjislacionin tonë sekuestrimi i dokumenteve, sendet etj. nga një gazetar? Pyetje, e cila merr përgjigje pozitive nga legjislacioni ynë procedural penal (neni 211 i KPP-së); b) A kemi ndërhyrje? c) A është e nevojshme në një shoqëri demokratike? (Në këtë pjesë vlerësojmë se duhet të ishte arsyetuar mbi raportin e të drejtave të cenuara dhe të drejtave të gazetarëve).

- Nga përmbajtja e vendimit të gjykatës nuk arrihet të kuptohet, përveç trajtimit teorik në lidhje me llojet e provave, se për çfarë nuk është vlerësuar i domosdoshëm sekuestrimi i këtyre të dhënave kompjuterike dhe se cilat janë rrugët që duhet të ndjekë prokuroria për t'i gjetur ato. A kemi mundësi të tregojmë se ka ndodhur vepra penale që ka pretenduar shoqëria Lapsi.al (pra disponimi nga një subjekt politik) në mungesë të objektit, bazës së të dhënave?

- Pretendimet që ngrihen në vijim se tashmë prokuroria mund të shfrytëzojë rrugët e tjera, siç është administrimi i bazës së të dhënave nëpërmjet shërbimit të llojit WeTransfer (veprim që është kryer nga prokuroria), është një objekt krejt tjetër, që e shtrin hetimin në një pistë tjetër dhe e shkëput nga fokusi fillestar, për sa kohë nuk na vërteton se është e njëjta bazë të dhënash.

- Në lidhje me arsyetimin se nuk lejohet sekuestrimi i mbajtësve magnetikë të të dhënave kompjuterike, si aparat telefonik, server etj., sjellim në vëmendje përkufizimet e ofruara nga Konventa për krimin në fushën e kibernetikës. Duke iu rikthyer nenit 208/a të KPP-së, konstatojmë se legjislatori ka parashikuar se gjykata urdhëron sekuestrimin e të dhënave kompjuterike ose sistemeve kompjuterike. Duke qenë se sistemi kompjuterik është një lloj pajisjeje ose grup i ndërlidhur, atëherë nënkupton se sekuestrohet pajisja.

- Nuk qëndron ndarja që bën gjykata se neni 208 e legjitimon marrjen e sendit, kurse neni 208/a nuk e legjitimon. Neni 208/a nuk ka për qëllim të bëjë ndarjen në faza të sekuestros, por ka për qëllim t'i shtojë kontrollit të gjykatës një sekuestro të tillë kaq delikate. Gjithashtu, nga vetë kjo gjykatë është arsyetuar mbi domosdoshmërinë e sekuestrimit, pikërisht referuar nenit 208 të KPP-së. Nëse nuk merret sendi, atëherë në kushtet e nevojshmërisë së një ekspertimi tekniko-elektronik, si do të procedohet? Laboratori i ekspertit duhet të zhvendoset në vendin ku ndodhet sendi, qoftë dhe kur bëhet fjalë dhe për një CD, USB, aparat telefonik etj.?

- Në asnjë moment nuk është arritur të arsyetohet përse do të rrezikohej burimi i gazetarit nga sekuestrimi i të dhënave (kur një gjë e tillë nuk është kërkuar asnjëherë).

- Ankuesit kanë keqinterpretuar vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, duke marrë disponimet e saj të shkëputura. Kjo gjykatë në disponimet e saj ka mbajtur parasysh në çdo moment ruajtjen e burimit të informacionit dhe i ka mëshuar faktit se ajo që duhet të sekuestrohet është baza e të dhënave, ose krijimi i një kopje të saj unike. Është e vërtetë që gjykata është shprehur të sekuestrohet sendi ku ndodhen të dhënat, pasi mund të gjendet edhe në një CD të thjeshtë, por duke lënë alternativën që për shkak të natyrës së sendit, sekuestrimi të kryhet duke u proceduar me nxjerrjen dhe marrjen e kopjeve të të dhënave kompjuterike. Nëse ankuesit shqetësohen nga sekuestrimi i sendit, ata mund të kishin ofruar vetë vetëm bazën e të dhënave, ashtu si neni 211, i KPP-së sanksionon, pa e vendosur organin procedues në kushtet e sekuestrimit të pajisjes ku është vendosur kjo bazë.

- Kjo çështje, sipas informacionit të marrë nga mediat, apo dhe nga Avokatura e Përgjithshme e Shtetit, është bërë objekt i një kërkese të paraqitur nga ankuesit në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ku më datë 21.4.2021, GJEDNJ-ja ka vendosur të informojë qeverinë shqiptare se autoritetet duhet të pezullojnë zbatimin e vendimit nr. 131, datë 18.4.2021, dhe të mos kryejnë sekuestrimin e asnjë pajisje për ruajtjen e të dhënave.

- Gjykata e Posaçme e Apelit ka pasur mundësinë të ndryshonte vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, duke urdhëruar lënien në fuqi të këtij vendimi, vetëm në pjesën që ka disponuar për sekuestrimin e bazës së të dhënave, nëse shqetësimi ishte te sekuestrimi i pajisjeve, e megjithatë i ka hyrë arsyetimit të domosdoshmërisë së sekuestrimit, i cili është kontradiktor dhe në kundërshtim me frymën e ligjit.

- Në ankim ankuesit shprehen se tashmë këto të dhëna gjenden edhe në burime të tjera, por prej vetë atyre na është konfirmuar se nuk i kanë shpërndarë, duke mos i dhënë asnjë siguri organit procedues se kemi të bëjmë me të njëjtën bazë të dhënash.

II. Gjykimi njësues

22. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), ka planifikuar gjykimin e kësaj çështje në dhomë këshillimi më datë 12.11.2021. Për këtë qëllim janë njoftuar palët, në përputhje me parashikimet e KPP-së.

23. Gjatë gjykimit në dhomën e këshillimit, Kolegji, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar në dosje dhe analizoi llojin e çështjes penale në gjykim, vendimet e gjykatave dhe shkaqet e rekursit, vlerësoi se në rekurs janë ngritur një sërë çështjesh, trajtimi dhe zgjidhja e të cilave do t'i shërbejë zhvillimit të praktikës gjyqësore, në përputhje me parashikimet e nenit 438 të KPP-së, si dhe zgjidhjes së drejtë të çështjes konkrete, objekt shqyrtimi.

24. Kështu, evidentohet se, në rekursin e paraqitur nga prokurori, ngrihet nevoja e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike të publikuara nga një portal i medias elektronike, marrja e të cilave pretendohet si e domosdoshme për kryerjen e hetimit.

25. Nga ana tjetër, pavarësisht se organi i akuzës pretendon se synimi i tij nuk është që të arrihet te burimi i informacionit të gazetarit, Kolegji vlerëson se sekuestrimi i pajisjeve përbën një rrezik për zbulimin e burimit. Gjithashtu, në këto pajisje mund të përmbahen të dhëna të tjera, të cilat nuk kanë lidhje me procedimin konkret të organit akuzës.

26. Për këtë arsye, për të vendosur një balancë të drejtë midis nevojave të organit të akuzës për sekuestrim të të dhënave kompjuterike dhe nga ana tjetër për të siguruar një mbrojtje efektive të personave të cilëve u sekuestrohen këto të dhëna, në mënyrë të veçantë gazetarëve profesionistë, Kolegji, në zbatim të parashikimeve të nenit 438 të KPP-së, ka konkluduar, me vendim të ndërmjetëm, se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë gjyqësore, me një trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, për arsye se rekursi ngre shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural të një rëndësie themelore për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

27. Mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson të njësojë praktikën gjyqësore lidhur me zbatimin e nenit 212 të KPP-së, pas ndryshimeve ligjore që ka pësuar kjo dispozitë, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 35/2017, datë 30.3.2017, si dhe të neneve 208 dhe 208/a, të KPP-së, duke shtruar për njësim çështjet si vijon:

"1. Cili është momenti i ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të Gjykatës për Hetime Paraprake për vendosjen, në vijim të kërkesës së prokurorit, të sekuestros provuese, sipas parashikimeve të nenit 212 të KPP-së dhe cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit?

2. Cilat janë kriteret nga të cilat duhet të niset gjykata për të lejuar sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike?".

28. Sa më sipër, Kolegji vijoi me procedurën e posaçme, të parashikuar në nenin 438 të KPP-së, të ndryshuar me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021.

29. Në këto kushte, u formua trupa gjykuese prej 5 gjyqtarësh, sipas pikës 3 të kësaj dispozite dhe u procedua mbi vendimin e ndërmjetëm të Kolegjit, me njoftimin individual të palëve, sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit, për sa i përket datës dhe orës së seancës gjyqësore, trupës gjykuese, çështjeve të shtruara për njësim, duke u lënë palëve afatin prej 15 ditësh, midis njoftimit dhe datës së seancës. Po ashtu, vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ku u pasqyruan çështjet e shtruara për njësim, u publikua në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

III. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

A. Në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim:

1. Cili është momenti i ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj vendimit të Gjykatës për Hetimet Paraprake për vendosjen, në vijim të kërkesës së prokurorit, të sekuestros provuese, sipas parashikimeve të nenit 212 të KPP-së dhe cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit?

30. Në arsyetimin e tij, lidhur me këtë çështje, Kolegji analizoi dispozitat si vijon:

Neni 187 (**kuptimi i provës materiale**)

1. Prova materiale janë sendet që kanë shërbyer si mjete për realizimin e veprës penale ose mbi të cilat gjenden gjurmë apo që kanë qenë objekt i veprimeve të të pandehurit, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër, që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të KP-së, si dhe çdo send tjetër që mund të ndihmojë për sqarimin e rrethanave të çështjes.

Neni 208 (**objekti i sekuestrimit**)

1. Gjyqtari ose prokurori disponojnë me vendim të arsyetuar sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. 2. Sekuestrimin e kryen vetë ai që ka nxjerrë vendim ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim. 3. Kopja e vendimit të sekuestrimit i dorëzohet të interesuarit.

Nenit 212 (**kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit**)

1. I pandehuri, personi tek i cili janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtën e kërkimit të tyre, mund të bëjnë ankim në gjykatë, e cila merr vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve. 2. Kundër vendimit të gjykatës lejohet ankim brenda 5 ditëve. Gjykata e Apelit jep vendim të arsyetuar brenda 10 ditëve nga marrja e akteve. 3. Ankimi nuk e pezullon zbatimin e vendimit.

Neni 278 (**kompetencat e gjykatës – gjyqtarit për hetimet paraprake**)

1. Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata – gjyqtari për hetimet paraprake.

Neni 301 (**vleftësimi i sekuestros**)

1. Kur vë sekuestron, sipas nenit 300, policia gjyqësore shënon në procesverbal shkakun dhe i dorëzon një kopje të aktit personit të cilit i janë sekuestruar sendet. Procesverbali i dërgohet pa vonesë dhe sidoqoftë jo më vonë se dyzet e tetë orë, prokurorit të vendit ku është zbatuar sekuestroja. 2. Prokurori, brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron, në qoftë se ekzistojnë kushtet, ose vendos kthimin e sendeve të sekuestruara. Kopja e vendimit i njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 72 orë, të pandehurit, mbrojtësit dhe personit të cilit i janë sekuestruar sendet. Kundër tij mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t'i kthehen ato. Ankimi nuk pezullon zbatimin e sekuestros.

31. Fillimisht, Kolegji çmon të analizojë dhe të sqarojë kuptimin e termit "sekuestro provuese" e ashtuquajtura sekuestro penale. Sekuestroja provuese është mjet tipik i kërkimit të provës në procesin penal. Si e tillë, do të kuptohet ndalimi përkohësisht i disponimit dhe/ose tjetërsimit të sendit, provë materiale apo dokument, i marrë në ruajtje e në dispozicion të organit të akuzës/procedimit. Sekuestroja provuese shfaqet si instrument ligjor që justifikon marrjen në posedim të sendit që shërben për vërtetimin e fakteve penalisht të ndëshkueshme dhe për këtë i klasifikuar si mjet i kërkimit të provës. Është objekt i sekuestros provuese, sendi provë materiale drejtpërdrejt apo tërthorazi i lidhur me veprën penale, që është i domosdoshëm për vërtetimin e faktit (neni 208 i KPP-së). Pra, është ai send pa të cilin nuk mund të arrihet në njoftimin mbi ekzistencën e faktit dhe sekuestrimi është mjeti i marrjes së tij. Duke qenë se lidhet me nevoja të të provuarit dhe aspak me raportin e pronësisë, sekuestro provuese bie mbi çdo send, pavarësisht nga personi titullar i pronësisë apo i përdorimit të sendit, por kurdoherë vetëm kur është domosdoshmërish vërtetues i faktit.

33. Si mjet tipik i marrjes së provës që realizohet, si rregull, me ndalimin përkohësisht të disponimit dhe/ose tjetërsimit të sendit objekt sekuestrimi, sekuestroja provuese passjell kufizim të disponimit të sendit dhe për rrjedhojë kufizim të së drejtës së pronësisë, e cila është një e drejtë themelore që gëzon mbrojtje të shumëfishtë, si në planin kushtetues (neni 41 i Kushtetutës), ashtu dhe në atë konventor, sipas konventave ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë ka aderuar, ose synon të aderojë (neni 1, i protokollit 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), neni 17 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, apo neni 345 i Traktatit të Bashkimit Evropian). Për këtë është i domosdoshëm garantimi i zhvillimit të një procesi të drejtë, i cili i imponon gjykatës të japë arsyet për të cilat është i nevojshëm ky kufizim i të drejtës së pronësisë.

34. Nevoja për të evituar kufizime të pronës private, të cilat nuk janë ngushtësisht të lidhura me qëllimin për të cilin merret masa, duhet të mbizotërojë ndaj arsyes së vendosjes së sekuestros. Nga këtu buron dhe nevoja e veçantë e arsyetimit (motivimit) të vendimit, i cili duhet të argumentojë se provueshmëria e faktit nuk mund të arrihet në mënyrë tjetër, pa u kufizuar e drejta e disponimit të sendit dhe për rrjedhojë të legjitimojë vendosjen e sekuestros. Për rrjedhojë, vetëm përmes arsyetimit të vendimit të sekuestrimit mund të vendoset një raport i drejtë midis ndërhyrjes së autoriteteve dhe lirive dhe të drejtave themelore, si ajo e pronësisë dhe e iniciativës së lirë, të cilat gëzojnë mbrojtje kushtetuese dhe konventore (v*endimi i Gjykatës së Kasacionit të Italisë nr. 18316, datë 2 maj 2019*).

35. Edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) është theksuar se nuk mund të konsiderohet i drejtë raporti midis interesave, nëse personi i interesuar i nënshtrohet një sakrifice më të madhe sesa është e nevojshme në të drejtën e tij të pronësisë (*GJEDNJ, S.C. Fiercolect Impex S.R.L. v. Rumania, App. no. 26429/07, 13.12.2016*). Qëllimi është që të garantohet një ekuilibër i drejtë ose një raport i arsyeshëm proporcionaliteti midis mjetit të përdorur ose e thënë ndryshe heqjen nga përdorimi të sendit dhe qëllimit procesual për vërtetimin e faktit penal (*GJEDNJ, Agosi v. The United Kindom, App. no. 9118/80, 24.10.1986*).

36. Për shkak të nevojave hetimore sekuestroja provuese (penale) vendoset në mënyrë të njëanshme, nga prokurori apo dhe nga gjykata, gjyqtari për hetimet paraprake mbi kërkesën e këtij të fundit. Në pikën 1, të nenit 208, të KPP-së parashikohen si subjekte të legjitimuara për vendosjen e sekuestros gjyqtari ose prokurori. Për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të subjekteve që preken nga vendosja e sekuestros provuese, ligjvënësi shqiptar imponon detyrimin që gjyqtari ose prokurori të arsyetojnë vendimin për vendosjen e sekuestros, duke dhënë edhe arsyet se përse sendi, objekt sekuestrimi, është i domosdoshëm dhe jo thjesht i nevojshëm për vërtetimin e fakteve. Në pikën 3 të kësaj dispozite, parashikohet që të interesuarit duhet t'i dorëzohet një kopje e vendimit të sekuestrimit.

37. Në nenin 212 të KPP-së, të titulluar "Kundërshtimi i vendimit të sekuestrimit", ligjvënësi, në vijim të garantimit të interesave të personit ndaj të cilit (pasurisë së tij) është vendosur sekuestro e këtij lloji, i cili preket në mënyrë të drejtpërdrejtë nga vendimi i sekuestrimit, ka parashikuar të drejtën e tij për të kundërshtuar, në gjykatë, këtë vendim.

38. Sipas këtyre parashikimeve, personi i interesuar, i cili nuk lidhet domosdoshmërish vetëm me personin ndaj të cilit zhvillohen hetimet (mbi bazën e regjistrimit të njoftimit për veprën penale që i atribuohet këtij të fundit), por mund të jetë çdo person tek i cili ndodhet sendi ose dhe ata persona që kanë të drejtën e kërkimit të tij, mund të paraqesë ankim, në gjykatë, ndaj vendosjes së kësaj mase të sekuestros. Nga interpretimi literal i kësaj dispozite, pra i nenit 212 të KPP-së, Kolegji çmon të evidentojë se, referuar terminologjisë së përdorur nga ligjvënësi, duhet që vendimi i gjykatës ose i prokurorit, për sekuestrimin e sendeve, të jetë ekzekutuar. Ky fakt rezulton shumë qartë nga teksti i paragrafit të parë, të kësaj dispozite, ku ligjvënësi ka përdorur togfjalëshin "*tek i cili janë sekuestruar sendet*", që mbart në vetvete një veprim tashmë të kryer dhe që është pikërisht ai i sekuestrimit të sendeve. Gjithashtu, po në këtë paragraf, është përdorur togfjalëshi "*ai që ka të drejtën e kërkimit të tyre*", që gjithashtu, i referohet një personi i cili kërkon, pra pikërisht një send që i takon, por që nuk e ka, për shkak të vendosjes së sekuestros provuese, në rastin konkret. Pra, kundërshtimi në gjykatë i vendimit të sekuestrimit, nuk mund të bëhet nëse nuk është ekzekutuar sekuestroja provuese mbi sendet. Ky përfundim, që vjen si rrjedhojë e interpretimit literal të pikës 1, të nenit 212, të KPP-së, është dhe një përfundim logjik për të mos u investuar gjykata për kundërshtimin e vendimeve, të cilat nuk kanë prodhuar efekt.

39. Për sa i përket të drejtës së ankimit lidhur me "kundërshtimin e vendimit të sekuestrimit" prej të pandehurit (të hetuarit), personit "tek i cili janë sekuestruar sendet" dhe atij që "ka të drejtën e kërkimit të tyre", sikurse përcaktohet në paragrafin e parë, të nenit 212, të KPP-së, momenti i realizimit të kësaj të drejte, qartazi, me këtë cilësi do të identifikohet momenti kur pala e interesuar merr dijeni për zbatimin e sekuestros, të caktuar nga gjykata (mbi kërkesën e prokurorit), nga prokurori ose nga policia gjyqësore (në rastet kur kjo e fundit operon sipas përcaktimeve të paragrafit të dytë dhe të tretë, të nenit 207, të KPP-së, duke sekuestruar me iniciativë sende

që lidhen me veprën penale për të cilën është regjistruar procedimi penal ose sende që lidhen me një vepër tjetër penale për të cilën procedohet kryesisht). Nëse, nga njëra anë, mund të ndodhë që subjektet e interesuara e të parashikuar në paragrafin e parë, të nenit 212, të KPP-së, të vihen menjëherë në dijeni për zbatimin e sekuestros në kohë reale në momentin e zbatimit të saj dhe, për rrjedhojë, nga ai moment u lind e drejta për të kundërshtuar vendimin e zbatimit të sekuestros, nga ana tjetër, mund të ndodhë që personat e interesuar, të cilët janë të legjitimuar për paraqitjen e ankimit, të marrin dijeni në një moment të mëvonshëm. Kolegji çmon se momenti i lindjes së të drejtës, në këtë eventualitet të dytë, nuk mund të përkojë me momentin e zbatimit të sekuestros, por duhet të përkojë me momentin e marrjes dijeni nga titullari i së drejtës për të paraqitur ankim ndaj vendimit të sekuestrimit, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 212, të KPP-së. Kolegji çmon se në këtë mënyrë garantohet ushtrimi efektiv i të drejtës së ankimit nga ana e subjekteve të legjitimuara për ta paraqitur atë.

40. Mbi bazën e këtij arsyetimi konkludohet (konkluzion njësues) se e drejta e ankimit ndaj vendimit që ka disponuar sekuestrimin e sendeve lind në momentin që të interesuarit i dorëzohet kopja e vendimit të arsyetuar (nga prokurori ose gjykata). Ky moment mund të jetë i njëkohshëm me zbatimin e sekuestrimit ose me momentin që i interesuari merr dijeni për sekuestrimin e një sendi.

41. Pasi u evidentuan subjektet e legjitimuara për kundërshtimin e vendimit të aplikimit të sekuestros dhe pasi u konkludua mbi momentin në të cilin u lind e drejta këtyre subjekteve për të ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit që ka disponuar vendosjen e sekuestros, për të kompletuar të gjithë gamën e parashikimeve të së drejtës së ankimit të parashikuar nga neni 212 i KPP-së, të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, lind nevoja që të përcaktohet afati për paraqitjen e këtij ankimi në gjykatë dhe cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e tij.

42. Për të konkluduar lidhur me këto aspekte që lidhen me të drejtën e ankimit, është e nevojshme të bëhet një interpretim literal dhe sistematik i dispozitave të KPP-së. Sikundër u arsyetua më lart, në nenin 208 të KPP-së parashikohet se disponimi për vendosjen e sekuestros mund të merret nga prokurori ose, në raste të veçanta, nga gjykata me kërkesë të prokurorit. Praktika gjyqësore ka evidentuar se paraqitja në gjykatë e kërkesës së prokurorit për aplikimin e sekuestros provuese, në një kohë që ligjvënësi i ka garantuar mundësinë e aplikimit në mënyrë të drejtpërdrejtë të saj këtij të fundit, aq më tepër kur bëhet fjalë për një nga mjetet më të zakonshëm të kërkimit të provës në dispozicion të organit të procedimit, prokurorit, por edhe të policisë gjyqësore në rastin e "verifikimeve të ngutshme", gjatë fazës së hetimeve paraprake, presupozon inercinë e prokurorit për të proceduar me realizimin e një veprimi të tillë, të gjeneruar prej vlerësimit negativ të tij lidhur me domosdoshmërinë e aplikimit të këtij "instrumenti" procedural dhe, në të njëjtën kohë, insistimin e palës së dëmtuar nga vepra penale pavarësisht kësaj inercie, mosveprimi, në funksion të stimulimit, për të proceduar me aplikimin e sekuestros së këtij lloji. Pra, si rregull, për këtë lloj sekuestroje, të sekuestrimit të "sendeve, provave materiale, të sendeve që lidhen me veprën penale", sipas përcaktimit të paragrafit të parë, të nenit 208, të KPP-së, prokurori i kërkon gjykatës aplikimin e saj (duke mos e aplikuar vetë, në mënyrë të drejtpërdrejtë) vetëm në rastet e insistimit të palës së dëmtuar, me gjithë disaprovimin e tij për të kryer vetë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, një veprim të tillë.

43. Në varësi të organit që disponon lidhur me aplikimin e mjetit të kërkimit të provës, sekuestro provuese, të parashikuar në nenin 208 të KPP-së, do të përcaktohet edhe *iteri procedural (shtegu procedural)* i paraqitjes së ankimit ndaj këtij disponimi dhe, për pasojë, gjykata kompetente për të trajtuar këtë ankim. Në rastin e aktivizimit të drejtpërdrejtë të prokurorit për të aplikuar masën e sekuestros së sipërcituar, paragrafi i parë, i nenit 212, të KPP-së, që parashikon "kundërshtimin e vendimit të sekuestrimit", "adreson" ankimin e palëve – të personit nën hetim (pasi për të pandehur, në këtë fazë fillestare të procedimit – të hetimeve paraprake – nuk mund të bëhet fjalë), të personit tek i cili janë sekuestruar sendet apo të kujtdo që ka të drejtën e kërkimit të tyre – natyrshëm, në gjykatë, duke nënkuptuar – identifikuar – në këtë cilësi "gjyqtarin e hetimeve paraprake" – e cila (i cili) do të rezultojë në kushtet e kompetencës për të gjykuar edhe ankimin e paraqitur nga palët, në rastin e vendosjes së sekuestros (të të njëjtit lloj – provuese), me iniciativë, nga oficeri i policisë gjyqësore, gjatë "verifikimeve të ngutshme në vend", sipas përcaktimit të neneve 300, 301, të KPP-së, mbas vleftësimit të saj, brenda 48 orëve, nga prokurori, mbi bazën e parimit, që çdo vendimmarrje e njëanshme e prokurorit gjatë fazës së hetimeve paraprake, në lëndë të masave të sigurimit personal (masave parasiguruese të "arrestimit në flagrancë dhe të ndalimit") dhe pasuror, por edhe në lëndë të aplikimit të drejtpërdrejtë të mjeteve të kërkimit të provës, sikurse në rastin e sekuestros provuese penale, i nënshtrohet, në mënyrë të pashmangshme, kontrollit juridiksional.

44. Sakaq, duke iu referuar rastit të aplikimit të sekuestros provuese, indirekt mbi kërkesën e prokurorit, prej të njëjtës gjykatë, gjyqtarit për hetimet paraprake, *inaudita altera parte* – pa prezencen e palës së interesuar –

menjëherë pas marrjes dijeni prej kësaj pale, lidhur me këtë disponim, që mund të përkojë, sikurse u sipërcitua, me momentin e zbatimit të sekuestros, por edhe me një moment të mëpasshëm, paragrafi i dytë, i nenit 212, të KPP-së, parashikon të drejtën e ankimit të palëve, brenda 5 ditëve (prej momentit të marrjes dijeni për vendosjen e sekuestros) në Gjykatën e Apelit.

45. Për të zgjidhur këtë problematikë, të përcaktimit të gjykatës kompetente për trajtimin e ankimit, ndaj vendimit të gjykatës – gjyqtarit për hetimet paraprake – për vendosjen e sekuestros, në kushtet e inercisë së legjislatorit për të identifikuar qartësisht këtë gjykatë, Kolegji çmon se në këtë rast do të zbatohen rregullat e përgjithshme, lidhur me gjykatën kompetente për shqyrtimin e ankimit, sipas të cilave ankimi shqyrtohet nga një gjykatë më e lartë.

46. Mbi këtë bazë, **Kolegji dedukton konkluzionin se gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit, kur sekuestrimi është disponuar nga gjykata, në vijim të kërkesës së prokurorit, është Gjykata e Apelit. Afati për paraqitjen e ankimit është përcaktuar në pikën 2, të nenit 212, të KPP-së dhe është 5 ditë nga marrja dijeni.**

47. Për sa i përket rastit kur sekuestrimi është vendosur nga prokurori (në mënyrë të drejtpërdrejtë), sikundër u evidentua më lart në këtë vendim, dispozita – neni 212 i KPP-së – në paragrafin e parë të saj, megjithëse parashikon të drejtën e ankimit në gjykatë (nga i pandehuri, personi tek i cili janë sekuestruar sendet, ai që ka të drejtën e kërkimit të tyre), si dhe detyrimin e gjykatës për të gjykuar çështjen dhe për të disponuar me një vendim të arsyetuar, brenda 10 ditëve, hesht lidhur me modalitetet përkatëse përcaktuese të nisjes së afatit të ankimit, si dhe me gjykatën kompetente për shqyrtimin e këtij ankimi, kur objekt i kundërshtimit është vendimi i prokurorit për vendosjen e sekuestros.

48. Për këtë, Kolegji çmon se është e nevojshme të bëhet një interpretim sistematik i dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, në mënyrë që të konkludohet mbi zgjidhjen e çështjes së parashtruar për njësim duke identifikuar, natyrshëm, me cilësinë e gjykatës kompetente, për të trajtuar ankimet (si rregull), në fazën e hetimeve paraprake, kundër disponimeve të drejtpërdrejta dhe të "njëanshme" të prokurorit, gjykatën – gjyqtarin për hetimet paraprake. Në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 278, të KPP-së, gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata – gjyqtari për hetimet paraprake. Ky parashikim ligjor është plotësisht i aplikueshëm në rastin e vendosjes së sekuestros provuese nga prokurori dhe posaçërisht për kundërshtimin, nga ana e subjekteve të parashikuara në paragrafin e parë, të nenit 212, të KPP-së, të vendimit të prokurorit për vendosjen e sekuestros provuese. Këto subjekte mund të paraqesin ankim në gjykatën e shkallës së parë (gjyqtari për hetimet paraprake).

49. Çështja e fundit, të cilës duhet t'i jepet përgjigje për të konkluduar plotësisht mbi pyetjen e shtruar për njësim nga Kolegji Penal, ka të bëjë me afatin për paraqitjen e ankimit ndaj vendimit të prokurorit për vendosjen e sekuestros penale. Edhe në këtë rast, dispozita – neni 212 i KPP-së – ka ometuar parashikimin e një afati konkret për ankimimin e vendimit, ç'ka imponon detyrimin e një interpretimi – nëpërmjet referimit te dispozitat e ngjashme, në mënyrë të veçantë te përcaktimi i nenit 301 të këtij Kodi, që parashikon vlerësimin e sekuestros provuese nga prokurori, kur është vendosur, në rastet e "verifikimeve të ngutshme", nga Policia Gjyqësore.

50. Në këtë dispozitë, në paragrafin e dytë të saj, parashikohet e drejta e të pandehurit (të hetuarit), mbrojtësit, e personit të cilit i janë sekuestruar sendet dhe e atij që ka të drejtën e kthimit të tyre, për të ankimuar vendimin e prokurorit, që ka miratuar sekuestron (provuese) të aplikuar me iniciativë nga policia gjyqësore – në kushte emergjence – brenda një afati prej dhjetë ditësh nga dita e njoftimit të vendimit (miratues të prokurorit), në gjykatë.

51. Kolegji çmon t'i referohet parashikimeve të kësaj dispozite, paragrafit të dytë, të nenit 301, të KPP-së, duke e konsideruar sekuestrimin e aplikuar nga policia gjyqësore, me rastin e "verifikimeve të ngutshme në vend", të realizuara në konformitet me përcaktimet e nenit 300/2 të këtij Kodi, si situatë analoge me atë të parashikuar nga neni 208 i KPP-së, kur vendimi i sekuestrimit është disponuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga prokurori, pa "ndërmjetësimin" e gjykatës. Në rastin e vendosjes së sekuestros mbi provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale, legjislatori ka parashikuar se kundër sekuestrimit të realizuar në kushtet e sipërcituara nga policia gjyqësore, të miratuar nga prokurori, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda dhjetë ditëve nga (marrja dijeni për vendimin e prokurorit) i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, nga personi të cilit i janë sekuestruar sendet dhe ai që ka të drejtë t'i kthehen ato. Kolegji, duke pasur në vëmendje natyrën e disponimit, që lidhet me sekuestron provuese, çmon se i njëjti afat 10-ditor do të zbatohet dhe për paraqitjen e ankimit nga subjektet e përcaktuara në pikën 1, të nenit 212, të KPP-së, ndaj vendimit të prokurorit që ka vendosur sekuestron provuese. Në përputhje me përfundimet e arritura më lart në këtë arsyetim të Kolegjit, ky afat do të fillojë nga momenti i marrjes dijeni.

52. Në vijim të arsyetimit të mësipërm**, në lidhje me çështjen e parë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin njësues se:**

53. E drejta e ankimit ndaj vendimit që ka disponuar sekuestrimin e sendeve lind në momentin që të interesuarit i dorëzohet kopja e vendimi të arsyetuar (nga prokurori ose gjykata). Ky moment mund të jetë i njëkohshëm me zbatimin e sekuestrimit ose me momentin që i interesuari merr dijeni për sekuestrimin e një sendi.

Gjykata kompetente për shqyrtimin e këtij ankimi, në rastet kur sekuestrimi është urdhëruar nga prokurori, është gjykata e shkallës së parë (gjyqtari për hetime paraprake), në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 212 të Kodit të Procedurës Penale. Afati për paraqitjen e ankimit është 10 ditë (duke pasur në vëmendje natyrën e disponimit, që lidhet me sekuestron provuese, referimi për afatin e ankimit bëhet në nenin 301 pika 2, të KPP-së).

Në rastet kur sekuestrimi është disponuar nga gjykata, në vijim të kërkesës së prokurorit, gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit është gjykata e apelit, në përputhje me parashikimet e pikës 2, të nenit 212 të KPP-së.

B. Në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për njësim:

2. Cilat janë kriteret nga të cilat duhet të niset gjykata për të lejuar sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike?

54. Së pari, Kolegji çmon të evidentojë se dispozita ligjore në KPP, që rregullon sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, është neni 208/a, i cili parashikon:

Neni 208/a, **sekuestrimi i të dhënave kompjuterike** *(shtuar me ligjin nr. 10054, datë 29.12.2008; ndryshuar pika 1, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017)*

1. Në rastin e procedimeve për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit, gjykata, me kërkesën e prokurorit, urdhëron sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike. Në këtë vendim gjykata përcakton të drejtën për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo sigurimin e të dhënave ose të sistemit kompjuterik. 2. Kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të menduar se të dhënat e kërkuara kompjuterike janë memorizuar në një sistem tjetër kompjuterik apo në një pjesë të tij dhe këto të dhëna janë në mënyrë të ligjshme të kapshme prej ose janë të disponueshme nga sistemi kompjuterik fillestar, që kontrollohet, gjykata, me kërkesë të prokurorit, urdhëron menjëherë kërkimin ose hyrjen edhe në këtë sistem kompjuterik. 3. Në zbatim të vendimit të gjykatës, prokuroria ose oficeri i policisë gjyqësore, i deleguar nga prokurori, merr masa: a) për të ndaluar kryerjen e veprimeve të mëtejshme ose për të siguruar sistemin kompjuterik, vetëm të një pjese të tij ose të një mjeti tjetër memorizimi të dhënash; b) për të nxjerrë dhe marrë kopje të të dhënave kompjuterike; c) për të penguar hyrjen në të dhënat kompjuterike, ose për t'i hequr këto të dhëna nga sistemet kompjuterike me të drejtë hyrjeje; ç) për të siguruar paprekshmërinë e të dhënave përkatëse, të memorizuara. 4. Për zbatimin e këtyre veprimeve, prokurori mund të urdhërojë thirrjen e një eksperti, i cili ka njohuri rreth funksionimit të sistemeve kompjuterike apo të masave të zbatuara për mbrojtjen e të dhënave kompjuterike në të. Eksperti i thirrur nuk mund të refuzojë detyrën pa shkaqe të arsyeshme.

Konventa e Budapestit për krimin në fushën e kibernetikës, e ratifikuar me ligjin nr. 8888, datë 25.4.2002, "Për ratifikimin e konventës për krimin në fushën e kibernetikës", ka dhënë këto përkufizime për "të dhënat kompjuterike" dhe "sistemin kompjuterik":

1. Sistemi kompjuterik – *me sistem kompjuterik nënkuptohet çdo lloj pajisjeje apo grup i ndërlidhur ose pajisje të lidhura, një ose më shumë prej të cilave, vazhduese të një program, kryejnë procesime automatike të të dhënave;*

2. Të dhëna kompjuterike – *me të dhëna kompjuterike nënkuptohet çfarëdolloj përfaqësimi të fakteve, informacioni apo konceptesh në një formë të përshtatshme për procesim në një sistem kompjuterik, që përfshijnë një program të përshtatshëm për punën e një sistemi kompjuterik për të kryer një funksion.*

55. Zhvillimi i vrullshëm që ka marrë në dekadat e fundit teknologjia e informacionit, nuk mund të mosndikonte fushën e së drejtës në përgjithësi dhe konkretisht procesin penal. Të dhënat dokumentare (përfshirë ato fotografike e filmike) tashmë nuk janë të materializuara vetëm në format "*hard copy*", por gjenden edhe në "*format kompjuterik*". Tanimë provat e domosdoshme për vërtetimin e fakteve penalisht të ndëshkueshme gjenden jo rrallë në formën e të dhënave kompjuterike. Për rrjedhojë, ka lindur domosdoshmëria e ndërhyrjes nga ana e ligjvënësit për të normuar këtë situatë faktike të krijuar. Specifikisht, në lidhje me sekuestron provuese, me ligjin nr. 10054, datë 29.12.2008, është shtuar në KPP neni 208/a, i titulluar "*Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike*".

56. Sikundër konstatohet, kjo dispozitë është vendosur pas nenit 208 të KPP-së, që normon rregullat e përgjithshme mbi sekuestron provuese. Kolegji vlerëson se rregullat e përgjithshme të parashikuara në nenin 208 të KPP-së, përveçse kur në nenin 208/a ka parashikim të posaçëm, do të zbatohen edhe në rastin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike. Kolegji çmon të theksojë se garancitë e analizuara në pjesën e parë arsyetuese të këtij vendimi njësues, lidhur me nevojën e arsyetimit të vendimit në drejtim të domosdoshmërisë së sekuestrimit të të dhënave, duhet të zbatohen edhe në rastin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike. Po kështu janë të zbatueshme dhe përfundimet në të cilat arriti ky Kolegj lidhur me të drejtën e ankimit, të parashikuar në nenin 212 të KPP-së.

57. Në tekstin e dispozitës, nenit 208/a të KPP-së, konstatohen edhe disa parashikime ndryshe nga ato të nenit 208 të KPP-së. Konkretisht, vërehet se ligjvënësi në dispozitën e re të shtuar në vitin 2008, në rastin kur procedohet për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit, sekuestrimi i të dhënave kompjuterike do të bëhet me vendim të gjykatës, në vijim të paraqitjes së kërkesës nga ana e prokurorit. Kolegji e lexon parashikimin e përmbajtur në nenin 208/a të KPP-së, si vullnet të ligjvënësit që sekuestrimi në këto raste të bëhet vetëm me vendim të gjykatës, si një garanci shtesë, por të domosdoshme për të garantuar sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, nëse përbëjnë të dhëna të domosdoshme për vërtetimin e faktit penal dhe më e rëndësishme është që të sekuestrohen vetëm ato të dhëna që janë të nevojshme për vërtetimin e këtij fakti penalisht të ndëshkueshëm. Ky preokupim i ligjvënësit konsiderohet i arsyeshëm për faktin se të dhënat kompjuterike, objekt i sekuestros, ndryshe nga të dhënat e përftuara nëpërmjet vendosjes së sekuestros mbi sendet e tjera, për shkak të natyrës së tyre të veçantë, është më e vështirë të individualizohet, si dhe, duke qenë se si rregull "depozitohen" në sisteme kompjuterike, në të cilat "parkohen" edhe të dhëna të tjera që mund të mos kenë lidhje me vërtetimin e faktit penal, ekziston rreziku i ekspozimit të të dhënave të tjera (që nuk kanë lidhje me faktin penal për të cilin hetohet), marrja e të cilave mund të cenojë liri dhe të drejta të rëndësishme të qytetarëve, të cilat gëzojnë mbrojtje kushtetuese dhe konventore, si: liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit, nëpërmjet nenit 36 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, nenit 8 të KEDNJ-së, apo lirinë e shprehjes, neni 22 i Kushtetutës, të drejtën e informimit, neni 23 i Kushtetutës, të mbrojtura gjithashtu dhe nga neni 10 i KEDNJ-së. Sikundër parashikohet në nenin 17 të Kushtetutës, kufizime të të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

58. Në KEDNJ parashikohet se ushtrimi i këtyre lirive, që përmban detyrime dhe përgjegjësi mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

59. Kolegji çmon të sjellë në vëmendje jurisprudencën e konsoliduar të GjEDNJ-së në këtë drejtim, kur Gjykata e Strasburgut, në një sërë vendimesh, është shprehur në mbrojtje të lirisë së shprehjes, të parashikuar në nenin 10 të KEDNJ-së, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e sekretit të burimit të gazetarit (*GJEDNJ*, *Sanoma Uitgevers v. The Netherlands, App. no. 38224/03, 14.9.2010*), si dhe referuar nenit 8 të Konventës, e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare (*GJEDNJ, Iliya Stefanov v. Bulgaria, App. no. 65755/01, 22.8.2008*, *GJEDNJ, Cronin v. The Umited Kindom, App. no. 15848/03, 6.1.2004*). Gjykata e Strasburgut ka arsyetuar se, në lidhje me ndërhyrjen e pashmangshme të veprimeve hetimore që kanë për objekt të dhëna sensitive, në rastin e sekuestrimit të të dhënave të nxjerra nga një kompjuter, gjykata duhet të shqyrtojë rrethanat dhe të vlerësojë nëse kuadri ligjor dhe kufizimi i të drejtave japin mbrojtje të mjaftueshme kundër ndërhyrjeve arbitrare të autoriteteve.

60. Për sa më sipër, Kolegji çmon të ritheksojë nevojën e vendosjes së një balance të drejtë midis të drejtave të qytetarëve apo profesionistëve, në veçanti gazetarëve profesionistë dhe nevojës për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit. Sikundër ka parashikuar kushtetutbërësi, ndërhyrja bëhet vetëm me ligj dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka ndikuar këtë ndërhyrje. Në rastin konkret të sekuestrimit të të dhënave kompjuterike, neni 208/a, që i bashkëngjitet nenit 208 të KPP-së, përbëjnë parashikimet ligjore për sekuestrimin provues të këtyre të dhënave. Sikundër u evidentua më lart, ligjvënësi ka parashikuar që sekuestrimi i të dhënave kompjuterike të bëhet me vendim gjykate, në vijim të kërkesës së prokurorit. Por cilat janë kriteret, të cilave gjykata duhet t'u përmbahet në vendimmarrjen e saj për të lejuar sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike?

61. Parashikimin e parë në këtë drejtim e ka bërë kushtetutbërësi, në nenin 17 të Kushtetutës, ku është parashikuar se kufizimet e të drejtave, që bëhen përmes ligjit, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, duhet të jenë në përpjesëtim me të drejtën që e ka diktuar atë. Në të njëjtën linjë janë dhe parashikimet e KEDNJ-së. Nga këto parashikime evidentohen lehtësisht dhe qartësisht tre parime kryesore: domosdoshmëria, proporcionaliteti dhe përshtatshmëria.

62. Antikushtetutshmëria qëndron edhe për shkak të mosrespektimit të parimit të proporcionalitetit. Sipas këtij parimi, nga të gjitha mjetet e ndryshme që mund të shfrytëzohen për të arritur një qëllim të ligjshëm, autoriteti administrativ duhet të përdorë mjetet ligjore më të përshtatshme, me të cilat mund të arrihet në shkaktimin e padrejtësisë më të vogël për individin. Prandaj duhen përdorur vetëm mjetet që shkaktojnë padrejtësinë minimale

për individin dhe me masa sa më pak të dëmshme për të. Kjo nënkupton elementin e dytë të parimit. Ky parim kërkon detyrimisht edhe përmbushjen e kushtit të tretë, sipas të cilit ndërhyrja në të drejtat e individit nuk duhet të jetë jashtë raportit të qëllimeve të synuara. Në këtë mënyrë, përfshirja e tri elementeve të domosdoshme kërkon që një masë ose mjet duhet të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të arritur një qëllim të kërkuar dhe mjeti e qëllimi të qëndrojnë në përpjesëtim të arsyeshëm (*vendimi nr. 20, datë 11.7.2006, i Gjykatës Kushtetuese §3, f. 6*).

63. Gjykata Kushtetuese në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur qëndrimin se parimi i proporcionalitetit nënkupton që ndërhyrja e ligjvënësit për kufizimin e një të drejte ose lirie të caktuar të bëhet me mjete të përshtatshme që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet. Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, ç'ka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria lidhet edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Kushti i përpjesëtimit të kufizimit me gjendjen që e ka diktuar konkretizohet në kërkesën e domosdoshmërisë, të dobishmërisë dhe të proporcionalitetit.

64. Në jurisprudencën e saj, kjo gjykatë, kur ka çmuar ndërhyrjen në të drejtat themelore, ka marrë parasysh kriteret në vijim: i. *nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; ii. nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; iii. nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhen për të arritur objektivin e kërkuar, sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme.* gjykata ka theksuar se proporcionaliteti i një kufizimi vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh që aspektet e mësipërme të mos analizohen veç e veç, por të jenë të gërshetuara me njëra-tjetrën (*vendimi nr. 33, datë 8.6.2016, i Gjykatës Kushtetuese, § 32, f. 16*). Pra, në thelb të parimit të proporcionalitetit qëndron ekuilibrimi i drejtë i interesave, vlerësimi objektiv i tyre, si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet përzgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre (*shih vendimet nr. 16, datë 1.3.2017, § 33, f. 18; nr. 1, datë 6.2.2013, § 42, f. 17; nr. 52, datë 5.12.2012, § 29, f. 10, të Gjykatës Kushtetuese*).

65. Sipas jurisprudencës së konsoliduar të GJEDNJ-së, termi "nevojë" kërkon që ndërhyrja, apo kufizimi i të drejtave të bëhet për shkak të një nevoje të interesit të përgjithshëm dhe, në mënyrë të veçantë, të jetë proporcional me qëllimin e ligjshëm që ndiqet. Për të përcaktuar nëse një ndërhyrje është e nevojshme në një shoqëri demokratike, duhet të mbahet në konsideratë fakti që pushteti diskrecional që i është dhënë autoriteteve shtetërore i nënshtrohet kontrollit të gjykatës, e cila verifikon përputhshmërinë e ndërhyrjes me kriteret e KEDNJ-së. Ky pushtet diskrecional varion në varësi të natyrës së çështjes dhe rëndësisë së interesave në çështje *(GJEDNJ, Pretty v. The United Kindom, App. no. 2346/02, 29.7.2002, § 70).*

66. Kolegji vlerëson se parimet e domosdoshmërisë, përshtatshmërisë dhe proporcionalitetit duhet të udhëheqin vendimmarrjen e gjykatës, qoftë në marrjen e vendimit për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, ashtu edhe në lidhje me parashikimin e modaliteteve konkrete për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike.

67. Lidhur me kriterin e domosdoshmërisë, së pari, sikundër është argumentuar më lart në këtë arsyetim njësues të Kolegjit, rregullat e përgjithshme të parashikuara në nenin 208 të KPP-së, përveçse kur në nenin 208/a ka parashikim të posaçëm, do të zbatohen edhe në rastin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike. Kështu, duke qenë se sekuestroja provuese është mjet tipik i kërkimit të provës në procesin penal, kjo do të thotë se sekuestrimi edhe në rastin e të dhënave kompjuterike vendoset për provat materiale (kuptimi i të cilave jepet në nenin 187 të KPP-së) dhe për sendet që lidhen me veprën penale. Për rrjedhojë është e nevojshme të arsyetohet se përse këto të dhëna janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve penalisht të ndëshkueshme.

68. Kjo implikon ekzistencën e një fakti penalisht të ndëshkueshëm, pra ekzistencën e një vepre penale, e cila në fazën fillestare të hetimit dyshohet në mënyrë të arsyeshme se është kryer. Gjykata e Kasacionit të Italisë, të cilës Kolegji ka vlerësuar t'i referohet për shkak të mungesës së trajtimit të mëparshëm nga Gjykata e Lartë të dispozitave objekt njësimi, si edhe për shkak të aferisë që legjislacioni procedural penal shqiptar ka me legjislacionin e Republikës së Italisë, me vendimin nr. **37639,** të datës **11.9. 2019, të** seksionit VI penal, **lidhur me ekzekutimin e sekuestros provuese që ka për objekt të dhëna dhe sisteme kompjuterike,** ka arsyetuar se, në këto raste kërkohet një vëmendje e veçantë si nga pikëpamja formale, ashtu dhe ajo ngushtësisht teknike. Në rastin konkret, gjykata ka arsyetuar se vendimi i sekuestrimit të prokurorit dhe vendimi i gjykatës nuk janë të qartë se cila është vepra penale konkrete për të cilën procedohet dhe për rrjedhojë konsiderohet i pamotivuar mbi përcaktimin konkret të sendeve që do të sekuestrohen; përse këto të dhëna kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale ose që kanë lidhje me të dhe cili është qëllimi provues që do të arrihet nëpërmjet sekuestrimit. Gjykata e Kasacionit ka theksuar se duhet të tregohet gjithmonë ekzistenca e një vepre që dyshohet se është kryer, duke qenë se vetëm në këtë mënyrë mund të verifikohet nevoja e sekuestrimit dhe përkatësia provuese e të dhënave me veprën penale.

69. Këtu lind nevoja e arsyetimit nga ana e gjykatës se përse për vërtetimin e kësaj vepre penale është e domosdoshme vendosja e sekuestros mbi të dhënat kompjuterike. Vlen të theksohet, sikundër është parashikuar në nenin 208 të KPP-së se ligjvënësi ka përdorur termin "domosdoshmëri" dhe jo "nevojë". Kjo do të thotë se arsyetimi i gjykatës duhet të shtrihet qoftë në drejtim të vërtetimit të lidhjes së të dhënave kompjuterike për të cilat kërkohet sekuestrimi me vërtetimin e faktit penalisht të ndëshkueshëm, por edhe me arsyetimin se ky vërtetim mund të bëhet vetëm nëpërmjet sekuestrimit të të dhënave kompjuterike, pa të cilat nuk mund të arrihet në njoftimin mbi ekzistencën e faktit.

70. Pasi të përmbushet edhe ky kriter, gjykatës i imponohet detyrimi të përcaktojë cilat janë konkretisht të dhënat ose sistemet kompjuterike që do t'i nënshtrohen sekuestrimit dhe çfarë synohet të provohet nëpërmjet vendosjes së sekuestros mbi këto të dhëna apo sistemet kompjuterike të përcaktuara për t'u sekuestruar. Në këtë përcaktim/veçim të të dhënave dhe të sistemeve kompjuterike, gjykata duhet të mbajë në konsideratë parimet e domosdoshmërisë në kuptimin se do të përzgjidhen vetëm ato të dhëna të cilat i shërbejnë vërtetimit të faktit dhe pa të cilat nuk mund të arrihet në njoftimin mbi ekzistencën e faktit. Sekuestrimi i të dhënave të tjera, jo të domosdoshme do të konsiderohet si shkelje nga ana e gjykatës. I njëjti arsyetim duhet përdorur edhe për sistemet kompjuterike nëse do të jetë e nevojshme të sekuestrohen. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë, jo vetëm që duhet të përzgjidhen ato sisteme kompjuterike në të cilat përmbahen të dhënat e veçuara si të domosdoshme dhe jo sisteme të tjera, por ndër këto sisteme kompjuterike, nëse ekziston mundësia e zgjedhjes, do të përzgjidhen ato sisteme kompjuterike, sekuestrimi i të cilave do të cenojë më pak të drejtat e personit të cilit i përkasin sistemet kompjuterike të përcaktuara për t'u sekuestruar. Gjithashtu, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë, sekuestrimi i të dhënave dhe në mënyrë të veçantë i sistemeve kompjuterike do të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme në vërtetimin e fakteve, duke u parashikuar në këtë mënyrë se proporcionaliteti nuk mund të mos raportohet edhe me kohëzgjatjen e kufizimit, e cila do të vlerësohet sipas një kriteri kohor të arsyeshëm (*GJEDNJ Smirnov v. Russia, App. no.* 71362/01*, 7.6.2007, GJEDNJ, Draghici v. Portugal, App. no. 43620/10, datë 19.6.2014*).

71. Gjykata e Kasacionit të Italisë, me vendimin nr. 3764, të datës 1 shkurt 2021*,* ka arsyetuar se edhe kur ekziston (verifikohet) lidhja me nevojat e hetimit, kërkohet evidentimi i proporcionalitetit në planin sasior, cilësor e kohor. Në rastin konkret, ajo gjykatë ka arsyetuar se duke u proceduar vetëm pas dy muajsh me marrjen e të dhënave apo bërjen e kopjeve, kohë e konsideruar e pajustifikuar në rastin konkret, janë cenuar të drejtat e gazetarit, të mbrojtura nga neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të sanksionuara në shumë vendime të GJEDNJ-së. Gjykata ka theksuar së është shkelur parimi i proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë, në mënyrë të tillë që i ka shkaktuar ankuesit një privim të pajustifikuar të të dhënave personale e të rezervuara, përtej kohës së nevojshme për të seleksionuar ato që kanë lidhje me veprën për të cilën procedohet.

72. Së fundmi, por jo më pak e rëndësishmja, në vendimin e gjykatës nuk duhet të mungojë parashikimi mbi modalitetet për sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike. Edhe në përcaktimin e modaliteteve të sekuestrimit të të dhënave ose pajisjeve kompjuterike, gjykata duhet të udhëhiqet nga parimi i proporcionalitetit dhe përshtatshmërisë. Mënyra e sekuestrimit të të dhënave ose pajisjeve duhet të jetë e tillë që të sekuestrohen vetëm të dhënat ose sistemet specifikisht të përcaktuara në vendimin e gjykatës. Duhet të mbahet në konsideratë që sekuestrimi i pajisjeve të bëhet në mënyrë të tillë që personit të cilit do t'i sekuestrohen të dhënat apo pajisjet të cenohet sa më pak e mundur. Për nxjerrjen e të dhënave mund të sekuestrohen pajisjet, vetëm në rast se është e domosdoshme. Nëse ka disa sisteme apo pajisje alternative që mund të sekuestrohen, duhet të përzgjidhen ato pajisje të cilat cenojnë më pak personin tek i cili sekuestrohen këto të dhëna apo pajisje, duke mbajtur në konsideratë bërjen e kopjeve nga autoritetet, në mënyrë që të shmanget sa më shumë të jetë e mundur procesi i sekuestrimit. Nëse sekuestrimi i pajisjeve është i domosdoshëm, ky të bëhet për aq kohë sa është e nevojshme për marrjen e të dhënave apo bërjen e kopjeve.

73. Me vendimin nr. 34625, datë 22 shtator 2020, Gjykata e Kasacionit të Italisë, lidhur me modalitetet operative për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, kur është e nevojshme që sekuestrimi të bëhet me marrjen e pajisjes ku janë memorizuar të dhënat, shprehet se më parë duhet të procedohet me kopjimin e integruar të përmbajtjes së memorizuar dhe në mënyrë që pajisja t'i kthehet titullarit të ligjshëm. Më pas, kopja e integruar analizohet për të përzgjedhur përmbajtjen e të dhënave informatike që kanë lidhje me veprën për të cilën procedohet. Në përfundim të kësaj përzgjedhjeje, kopja me përmbajtjen e integruar të memories, duhet t'u kthehet personave që gëzojnë të drejtat. Për rrjedhojë, prokurori mund të mbajë kopjen e integruar të të dhënave për aq kohë sa është ngushtësisht e nevojshme për të kryer operacionin e përzgjedhjes së të dhënave që do të sekuestrohen, duke u kërkuar në këtë mënyrë që prokuroria të bëjë organizimin e duhur që këtë veprimtari ta kryejë në kohën më të shkurtër të mundshme.

74. Por, në mënyrë të veçantë, për shkak të ndjeshmërisë që paraqet, referuar dhe rastit objekt shqyrtimi, nga i cili Kolegji vlerësoi të kalojë në këtë vendimmarrje njësuese, Kolegji çmon të nevojshëm të ndalet pak më tepër në rastin kur sekuestrimi i të dhënave ose sistemeve kompjuterike bëhet ndaj gazetarëve profesionistë. Kjo për faktin se liritë dhe të drejtat themelore, të cilat u evidentuan më lart, duhet të mbrohen në rastin kur është e nevojshme të procedohet me sekuestrimin e të dhënave kompjuterike dhe janë liria e shprehjes, liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit, dhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, të cilat mbrohen në të gjitha sistemet demokratike, bëhen më evidente dhe më të ndjeshme në rastin e gazetarëve profesionistë. Jurisprudenca kushtetuese dhe e GJEDNJ-së është shumë e pasur në këtë drejtim, duke sanksionuar me vendosmëri respektimin e këtyre të drejtave nga autoritetet shtetërore, nënshkruese të KEDNJ-së.

75. Sikundër u evidentua në pjesën hyrëse të këtij vendimi, në rastin specifik të gazetarëve profesionistë, sekuestrimi i të dhënave kompjuterike kërkon një vëmendje të veçantë, pasi përbën një rrezik të dukshëm për zbulimin e burimit të informacionit. Lidhur me rëndësinë e ruajtjes së burimit të informacionit, në çështjen *Goodwin v. The United Kindom, App. no. 17488/90, 27.3.1996*, GJEDNJ-ja ka konkluduar se kërkesa e autoriteteve drejtuar gazetarëve për të zbuluar burimin e informacionit përbën shkelje të lirisë së shprehjes. Po ashtu, sipas GJEDNJ-së, në çështjen *Roemen e Schmit v. Luxembourg, App. no. 51772/99, 25.5.2003*, shkelje edhe më të rëndë përbëjnë kontrollet, edhe nëse nuk kanë rezultat, të cilat kanë për objekt zbulimin e identitetit të burimit të provës. Sipas Gjykatës së Strasburgut, mbrojtja e burimit të gazetarëve përbën një nga shtyllat e lirisë së shprehjes, pa të cilën këto burime mund të mos e ndihmojnë shtypin të informojë publikun për çështje të interesit të përgjithshëm. Për rrjedhojë, shtypi mund të mos jetë në gjendje të kryejë rolin e tij në ofrimin e informacioneve të sakta e të besueshme.

76. Në përputhje me këtë qëndrim të GJEDNJ-së, Kolegji vlerëson se, sikundër u arsyetua më lart, përveç garancive të parashikuara lidhur me sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, specifikisht lidhur me sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike ndaj gazetarëve profesionistë, gjykata duhet të lejojë sekuestrimin, pasi të jetë shteruar kërkimi në të gjitha burimet e tjera të mundshme të të dhënave, duke pasur parasysh paragrafin 3, të nenit 159 të KPP-së, i cili parashikon lidhur me emrat e personave nga të cilët gazetarët profesionistë kanë marrë të dhëna gjatë ushtrimit të profesionit të tyre dhe vetëm kur të dhënat janë të domosdoshme për të provuar veprën penale, dhe vërtetësia e këtyre të dhënave mund të dalë vetëm nëpërmjet identifikimit të burimit, gjykata urdhëron gazetarin që të tregojë burimin e informacionit të tij. Kjo do të thotë se ndërhyrje të tilla duhet të jenë të mirëargumentuara dhe vetëm në rastet kur e dhëna nuk mund të merret në mënyrë tjetër.

77. Sa më sipër, **lidhur me çështjen e dytë të shtruar për njësim, Kolegji arrin në përfundimin njësues se:**

Së pari, duhet të ekzistojnë kushtet e përgjithshme sipas nenit 208 të KPP-së:

i. kjo do të thotë se sekuestrimi edhe në rastin e të dhënave kompjuterike, vendoset për provat materiale, kuptimi i të cilave jepet në nenin 187 të KPP-së dhe për sendet që lidhen me veprën penale;

ii. për sendet që lidhen me veprën penale, duhet të arsyetohet se edhe këto sende janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve.

Së dyti, gjykata duhet të argumentojë se cila është vepra penale që në mënyrë të arsyeshme dyshohet se është kryer.

Së treti, gjykata duhet të arsyetojë përse sekuestrimi i të dhënave ose i sistemeve kompjuterike është i domosdoshëm për zgjidhjen e çështjes.

Së katërti, gjykata duhet të përcaktojë ose të argumentojë se cilat janë të dhënat ose sistemet kompjuterike që do t'i nënshtrohen sekuestrimit dhe çfarë synohet të provohet nëpërmjet vendosjes së sekuestros mbi të dhënat ose sistemet kompjuterike. Në këtë përcaktim gjykata duhet të bazohet në parimet e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë, duke lejuar sekuestrimin e të dhënave ose të sistemeve kompjuterike për nevoja të hetimit, vetëm nëse është e nevojshme, për sa është e nevojshme dhe për aq kohë sa është e nevojshme.

Së pesti, gjykata duhet të përcaktojë dhe të arsyetojë në vendim modalitetet për sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike. Edhe në këtë rast, gjykata duhet të bazohet në parimet e proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë. Sekuestrimi duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të sekuestrohen vetëm të dhënat ose sistemet specifikisht të përcaktuara në vendimin e gjykatës. Për nxjerrjen e të dhënave mund të sekuestrohen pajisjet, vetëm në rast se është e domosdoshme dhe për aq kohë sa është e nevojshme për marrjen e të dhënave apo krijimin e kopjeve.

Së gjashti, përveçse sa më sipër, specifikisht lidhur me sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve

kompjuterike ndaj gazetarëve profesionistë, gjykata duhet të lejojë sekuestrimin, pasi të jetë shteruar kërkimi në të gjitha burimet e tjera të mundshme të të dhënave, duke pasur parasysh paragrafin 3, të nenit 159 të KPP-së. Kjo do të thotë se ndërhyrje të tilla, duhet të jenë të mirëargumentuara dhe vetëm në rastet kur e dhëna nuk mund të merret në burimin e saj. Në raste të tilla përjashtimore gjykata duhet të saktësojë të dhënat konkrete që kërkohet të sekuestrohen, përse ato janë të domosdoshme/thelbësore për zgjidhjen e çështjes sipas nenit 211/2 të KPP-së, si dhe arsyet përse sekuestrimi i tyre është i pamundur të realizohet në një mënyrë tjetër. Në çdo rast, gjykata duhet të tregojë kujdes për moscenim të marrëdhënies së gazetarit me burimin e informacionit, duke shmangur zbulimin e këtij burimi kur vërtetësia e të dhënave mund të verifikohet në një mënyrë tjetër.

C. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

78. Kolegji evidenton se subjektet e interesuara, të cilat dispononin të dhënat kompjuterike objekt sekuestrimi të vendimeve të Prokurorisë së Posaçme dhe më pas të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kanë kundërshtuar vendimin e kësaj gjykate me të cilin është vendosur sekuestrimi i të dhënave kompjuterike në Gjykatën e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Referuar rrethanave të çështjes rezulton se si vendimi i prokurorisë i datës 13.4.2021, për sekuestrimin dhe/ose këqyrjen e bazës së të dhënave që zotërohet nga Lapsi.al, ashtu edhe vendimi nr. 131, datë 18.4.2021, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk janë ekzekutuar nga policia gjyqësore, duke mos u realizuar sekuestrimi i të dhënave.

79. Sipas analizës dhe interpretimit të kryer më sipër në këtë vendim njësues, Kolegji ka arsyetuar se, *nga interpretimi literal dhe i kësaj dispozite, pra i nenit 212 të KPP-së, referuar terminologjisë së përdorur nga legjislatori, së pari duhet që vendimi i gjykatës ose i prokurorit për sekuestrimin e sendeve të jetë ekzekutuar. Ky fakt rezulton shumë qartë nga teksti i pikës 1 të kësaj dispozite, në të cilën legjislatori ka përdorur togfjalëshin "tek i cili janë sekuestruar sendet", i cili mbart në vetvete një veprim tashmë të kryer dhe që është pikërisht ai i sekuestrimit të sendeve. Gjithashtu, po në këtë paragraf është përdorur togfjalëshi "ai që ka të drejtën e kërkimit të tyre", i cili, gjithashtu, i referohet një personi i cili kërkon, pra pikërisht një send i cili i takon, por që nuk e ka, për shkak të vendosjes së sekuestros provuese në rastin konkret. Pra, kundërshtimi në gjykatë i vendimit të sekuestrimit nuk mund të bëhet nëse nuk është ekzekutuar sekuestroja provuese mbi sendet. Ky përfundim, që vjen si rrjedhojë e interpretimit literal të pikës 1, të nenit 212, të KPP-së, është dhe një përfundim logjik për të mos u investuar gjykata për kundërshtimin e vendimeve të cilat nuk kanë prodhuar efekt.*

80. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret objekt shqyrtimi, në përputhje me parashikimet e shkronjës "d", të pikës 1, të nenit 420, sipas të cilit: "*Me përjashtim të rasteve kur konstatohet në seancë, ankimi nuk pranohet në dhomë këshillimi kur ankimi nuk ka më objekt.*", duke qenë se vendimet e sekuestrimit nuk janë ekzekutuar, në përputhje dhe me parashikimet e shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 441, të KPP-së, duhet të vendoset mospranimi i rekursit.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 420, pika 1, shkronja "d", dhe 441, pika 1, shkronja "a", të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ndaj vendimit nr. 116, datë 6.5.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Ky vendim është njësues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 23.12.2021.

Kryetar: Ilir Panda

Anëtar: Albana Boksi, Sokol Binaj, Sandër Simoni, Medi Bici

VENDIM
Nr.00-2022-1513 (186), datë 12.5.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

Sokol Sadushi	kryesues
Arbena Ahmeti	anëtare
Asim Vokshi	anëtar
Gentian Medja	anëtar
Ervin Pupe	anëtar,

në datë 12.5.2022, mori në shqyrtim çështjen administrative me nr. 31003-00369-00-2020 Regjistri Themeltar, datë regjistrimi 3.6.2020, me palë:

PADITËSE: Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë

I PADITUR: Këshilli i Ministrave

PERSON I TRETË: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

OBJEKTI: 1. Konstatimin e cenimit të statusit të gjyqtarit nëpërmjet heqjes së pasaportës së shërbimit, me vendimin nr. 389, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "*Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit*", si një e drejtë e fituar e që nuk mund të ulet, në kundërshtim me nenin 22, të ligjit nr. 96/2016, "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*".

2. Konstatimin e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e lidhjes 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.6.2019, "*Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit*" në pjesën që nuk parashikon gjyqtarët si subjekte zyrtare që kanë të drejtë të pajisen me pasaportë shërbimi.

3. Konstatimin e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e pikës 14, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.6.2019, "*Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit*" në pjesën që parashikon se pasaportat e shërbimit të gjyqtarëve të lëshuara para datës 14 qershor 2019 humbasin vlefshmërinë më datë 31 dhjetor 2019.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 116, 118 dhe 138 të Kushtetutës; nenet 1, 2, shkronja "gj", 10 dhe 22, të ligjit nr. 96/2016, "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*"; nenet 2, pika 3, 7, shkronja "a", 10, pika 2, shkronja "b", 15, shkronja "d", 17, pika 1, shkronja "a", 18, pika 3, 37, pikat 3 e 4; 40, pika 1, shkronja "a" dhe 43, i ligjit nr. 49/2012, *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative"*.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

pasi zhvilloi gjykimin në seancë gjyqësore, në prani të përfaqësuesit të palës paditëse, z. Erion Bani, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe pranimin e padisë, në prani të palës së paditur, përfaqësuar në këtë gjykim nga Avokati i Shtetit, z. Abaz Deda, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit, dëgjoi relacionin e paraqitur nga gjyqtari Sokol Sadushi, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Pala paditëse, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë (në vijim, SHKGJ) është një bashkim vullnetar i gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, e formuar sipas parashikimeve të nenit 39, të Kodit Civil dhe nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001, "*Për organizatat jofitimprurëse*". SHKGJ-ja është e organizuar si person juridik, në kuptim të nenit 26, të Kodit Civil dhe regjistruar me vendimin nr. 2160, datë 25.1.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Në përputhje me nenin 22, paragrafi i dytë, të ligjit nr. 7692, datë 31.3.1993, "*Për një shtojcë në ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991, 'Për dispozitat kryesore kushtetuese'*", Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 335, datë 2.9.1997, "*Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit*" (në vijim VKM nr. 335/1997) ka parashikuar kategoritë e zyrtarëve që pajisen, për shkak të funksionit, me pasaporta diplomatike dhe shërbimi, ku në pikën 4 të tij janë përfshirë edhe gjyqtarët si subjekte që pajisen me pasaportë shërbimi.

3. Këshilli i Ministrave, në zbatim të rezervës ligjore relative, të parashikuar në ligjin nr. 8668, datë 23.11.2000, *"Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit"*, si dhe të neneve 100, pikat 1, 2 e 5, të Kushtetutës dhe nenit 28, shkronja "b", të ligjit nr. 9000/2003, *"Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"* ka miratuar

një akt të ri nënligjor, vendimin nr. 389, datë 12.6.2019, "*Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit*" (në vijim VKM nr. 389/2019), me të cilin ka parashikuar rikategorizimin e funksionarëve shtetërore që pajisen me këto pasaporta, duke përjashtuar gjyqtarët nga përfitimi i kësaj të drejte.

4. Në VKM nr. 389/2019, Këshilli i Ministrave njeh vlefshmërinë e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit për subjektet që e kanë përfituar atë përpara hyrjes në fuqi të këtij akti, për një afat deri më datë 31.12.2019. Ky vendim ka pësuar disa ndryshime, konkretisht me VKM nr. 873, datë 24.12.2019, VKM nr. 510, datë 1.7.2020, VKM nr. 1078, datë 24.12.2020, VKM nr. 54, datë 1.2.2021, si dhe me VKM nr. 389, datë 30.6.2021, me të cilat është parashikuar shtyrja për çdo vit e afatit të vlefshmërisë së pasaportave diplomatike dhe të shërbimit për subjektet që e kanë përfituar atë, duke e lejuar përfundimisht deri në datën 31.12.2022.

5. Në mbledhjen e datës 11.7.2019, Këshilli Drejtues i SHKGJ-së ka vendosur të kundërshtojë në rrugë gjyqësore VKM nr. 389/2019, me pretendimin se cenon statusin e gjyqtarëve, si dhe të drejtat e fituara në mënyrë të ligjshme, referuar parimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 96/2016, "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*" (në vijim ligji nr. 96/2016).

6. Kërkespadia është depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në datën 11.7.2019. Palët i kanë parashtruar të gjitha pretendimet e tyre ligjore përpara Gjykatës Administrative të Apelit që, sipas arsyetimit të vendimit, rezulton të kenë qenë pjesë e hetimit gjyqësor dhe t'i jenë nënshtruar edhe debatit mes tyre.

7. **Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 264 (86-2019-3792), datë 27.12.2019** ka vendosur: "*Rrëzimin e padisë së palës paditëse, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës paditëse. Kundër vendimit mund të ushtrohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.*".

8. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në mënyrë të përmbledhur, arsyeton:

8.1 Pala paditëse gëzon *prima facie* legjitimim procedural aktiv që i buron nga neni 3, nënparagrafi i fundit, si dhe neni 11, nënparagrafi 9 i statutit të saj. Interesi i SHKGJ-së, në paraqitjen e padisë është real, i drejtpërdrejtë dhe vetjak, pasi kjo kategori zyrtarësh mund ta përdorë pasaportën e shërbimit deri në datë 31.12.2019, duke e humbur pas kësaj date këtë të drejtë të fituar më parë.

8.2 Lidhur me themelin e pretendimeve të palës paditëse, e drejta e gjyqtarit për të mos i'u cenuar paga dhe përfitimet e tjera është e garantuar në nivel kushtetues dhe jo ligjor. Koncepti "përfitimet e tjera" është interpretuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, duke detyruar ligjvënësin që mbi këto standarde të orientojë veprimtarinë ligjvënëse, me qëllim moscenimin e statusit të gjyqtarëve, të drejtat dhe përfitimet që ata duhet të gëzojnë për shkak të detyrës. Sipas jurisprudencës së kësaj gjykate, neni 138 i Kushtetutës përcakton elementet përbërëse të statusit të gjyqtarit, pa të cilët nuk mund të garantohet ushtrimi i pavarur i funksionit të tyre. Garancitë e kësaj norme të Kushtetutës u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë, por edhe në elemente të tjera që burojnë nga ushtrimi i funksionit të tyre. Paprekshmëria e pagës dhe e përfitimeve të tjera janë ngritur në nivel kushtetues, me qëllim që të drejtat apo përfitimet, që burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, të mos ndryshohen me efekt negativ. Formulimi i togfjalëshit "përfitime të tjera" është i një natyre të përgjithshme dhe nuk konkretizon në mënyrë shteruese rrethin e përfitimeve të gjyqtarëve. Kushtetutbërësi jo pa qëllim e ka lënë të hapur kuptimin që i duhet dhënë rrethit të përfitimeve, pasi ka synuar të përfshijë tërësinë e të drejtave që gjyqtarët gëzojnë në funksion të ushtrimit të detyrës së tyre.

8.3 Gjykata e konsideron pajisjen e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit me pasaportat shërbimi si pjesë e të drejtave të tjera të fituara që lidhet me statusin e tyre, e drejtë që mbrohet nga Kushtetuta dhe jo nga ligji i zakonshëm. Për pasojë, pala paditëse, SHKGJ-ja i ka ngritur pretendimet për paligjshmërinë e VKM-së nr. 389/2019 në nivel kushtetueses, ndaj ato duhet të merren në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese dhe jo nga Gjykata Administrative e Apelit. Për të arritur në këtë përfundim, gjykata pati parasysh normimin kushtetues të nenit 131, shkronja "c", por edhe të nenit 8, të ligjit nr. 49/2012, *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative",* që ndalon Gjykatën Administrative të Apelit të marrë në shqyrtim çështje që janë në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese. E ndodhur përpara pretendimeve për mungesën e kushtetutshmërisë së aktit normativ nënligjor, pasi identifikoi saktë shkakun juridik të padisë, në zbatim të parimit *iura novit curia,* sipas përcaktimeve të vendimit njësues nr. 3, datë 29.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur rrëzimin e padisë, pasi çështja nuk i përket juridiksionit gjyqësor administrativ, por atij kushtetues.

8.4 Ajo ka vlerësuar se nuk mund të shpallë mungesën e juridiksionit gjyqësor dhe dërgimin e çështjes organit kompetent, në vështrim të nenit 9, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative"*, pasi kjo normë gjen zbatim vetëm kur gjykata administrative konstaton mungesën e juridiksionit gjyqësor dhe njëkohësisht qenien e çështjes në kompetencë të organit publik, ndërkohë që në këtë rast çështja

është përpara juridiksionit kushtetues. Sipas Gjykatës Administrative të Apelit, gjykatat e zakonshme kanë pengesë t'i dërgojnë çështjen për kompetencë drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese, pasi një ndalim të tillë e parashikon neni 145, pika 2, i Kushtetutës. Për të arritur në këtë përfundim, ky kolegj mbajti në konsideratë edhe vendimin nr. 00-2010-1351 (436), datë 2.12.2010, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

9. Gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit është zhvilluar në seancë gjyqësore. Pala paditëse ka marrë dijeni për vendimin në datën 12.5.2020, ndërkohë që rekursi është dorëzuar në datën 18.5.2020. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë në fazën e shqyrtimit të pranueshmërisë ka vendosur pranimin e rekursit dhe lejimin e dërgimit të çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

10. **Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin datë 26.7.2021,** bazuar në nenin 62, të ligjit nr. 49/2012, *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative"* (në vijim ligji nr. 49/2012), ka vendosur: "*Kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore*".

11. **Rekursuesi, pala paditëse, SHKGJ-ja** kërkon ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur:

12. Rezulton se pala paditëse ka respektuar afatin 30-ditor për depozitimin e rekursit. Gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit është zhvilluar në seancë gjyqësore. Pala paditëse ka marrë dijeni për vendimin e kësaj gjykate në datën 12.5.2020, ndërsa rekursi është dorëzuar në datën 18.5.2020.

12.1 *Në lidhje me juridiksionin gjyqësor për shqyrtimin e kësaj çështjeje*

- Pala paditëse pretendon se argumenti i përdorur nga Gjykata Administrative e Apelit se çështja nuk i përket sferës së pushtetit gjyqësor, por atij kushtetues është krejtësisht i gabuar dhe i pambështetur në dispozitat kushtetuese dhe ligjore që përkufizojnë dallimin ndërmjet juridiksionit të gjykatave të zakonshme me atë të Gjykatës Kushtetuese;

- Statusi i gjyqtarit nuk është një fushë ekskluzive e rregullimeve kushtetuese, sepse në të kundërt nuk do të kishte vend për ligjin për statusin (ligji nr. 96/2016, i ndryshuar), ligjin për pushtetin gjyqësor (ligji nr. 98/2016), ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë (ligji nr. 115/2016, i ndryshuar) dhe as rregullime të tjera ligjore apo nënligjore;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave, objekt padie, është e vërtetë që nuk ka dalë në bazë të nenit 22 të ligjit nr. 96/2016, por ai ka shkelur këtë normë supreme dhe, për rrjedhojë, duhet të shfuqizohet. Kur Gjykata Kushtetuese apo Gjykata Administrative e Apelit shqyrton pretendimet e palës inicuese të gjykimit për jokushtetutshmëri apo paligjshmëri të aktit nënligjor normativ nuk mundet të kufizohet vetëm në konkluzionin nëse akti e ka zbatuar ligjin, duke individualizuar se në bazë dhe për zbatim të kujt ka dalë. Akti nënligjor normativ duhet të zbatojë çdo ligj në fuqi, sepse në hierarkinë e akteve normative qëndron më poshtë ligjeve (*shih nenin 116 dhe 118 të Kushtetutës*);

- Lidhur me argumentin për ndarjen e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Administrative të Apelit, referuar praktikës gjyqësore e kushtetuese, gjykatat e sistemit të zakonshëm gjyqësor kanë shqyrtuar edhe më parë ligjshmërinë e akteve nënligjore normative të nxjerra nga organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, duke u kufizuar në natyrën e kërkimeve. Pikërisht, kjo praktikë gjyqësore ka diktuar Shoqatën Kombëtare të Gjyqtarëve të përzgjedhë aktin për të inicuar procesin gjyqësor, si edhe forumin gjyqësor kompetent;

- Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 49/2012, për herë të parë u parashikua ngritja e padisë ndaj aktit nënligjor normativ në gjykatat e zakonshme. Kjo kompetencë iu ngarkua Gjykatës Administrative të Apelit, e cila në këtë rast do të gjykojë si shkallë e parë, si dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në rrugën e kontrollit të vendimit mbi bazën e rekursit;

- Lidhur me kriteret që duhet të mbahen parasysh për të bërë dallimin ndërmjet paligjshmërisë dhe antikushtetutshmërisë së aktit nënligjor normativ është pranuar në doktrinë dhe në jurisprudencë si një kriter ndarës ndërmjet dy juridiksioneve lloji i pretendimit të ngritur nga kërkuesi, përkatësisht nëse kërkuesi pretendon paligjshmërinë apo antikushtetutshmërinë e aktit nënligjor normativ. Një ndarje e tillë ndërmjet juridiksioneve jo vetëm është mekanike dhe formaliste, nuk mban parasysh dualizmin paligjshmëri-antikushtetutshmëri, por as nuk i jep zgjidhje situatës në të cilën subjekti iniciues i procesit pretendon njëkohësisht paligjshmërinë dhe antikushtetutshmërinë e aktit nënligjor normativ të kundërshtuar prej tij. Një tjetër kriter bazohet në parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit gjykimi kushtetues nga natyra është një gjykim subsidiar dhe si i tillë mund të investohet vetëm kur subjekti iniciues i procesit nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion. Sipas paditësit ky qëndrim bën një ndarje më të saktë midis dy juridiksioneve;

- Pala paditëse vlerëson se elementi që bën dallimin ndërmjet juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe atij të Gjykatës Administrative të Apelit është subjekti që inicion gjykimin përkatës. Në referim të nenit 134, paragrafi i dytë i Kushtetutës, organizatat dhe individët janë subjekte me legjitimitet të kushtëzuar. Në referim të nenit 15 të

ligjit për gjykatat administrative, shoqatat janë subjekte që mund të vënë në lëvizje gjykimin administrativ për të kundërshtuar një akt nënligjor normativ në një gjykim abstrakt. Për rrjedhojë vlerësohet se Gjykata Administrative e Apelit, si pjesë e gjykatave të zakonshme, ka juridiksion për gjykimin e kësaj çështje.

12.2 *Në lidhje me themelin e pretendimeve*

- Është cenuar statusi i gjyqtarit, si pasojë e mohimit të një të drejtë të fituar më parë. Gjykata Administrative e Apelit, në vendimin objekt i këtij rekursi e konfirmon një gjë të tillë, duke i dhënë të drejtë palës paditëse, pavarësisht se në përfundim refuzon të japë drejtësi, duke hequr dorë nga juridiksioni që Kushtetuta dhe ligji nr. 49/2012 i kanë dhënë;

- Statusi i gjyqtarit, ndër të tjera parashikon të drejtën e pagës dhe përfitimeve të tjetra me natyrë financiare dhe jo financiare, si elementet e tij më themelore, ndërkohë që me akte të tjera ligjore dhe nënligjore mund të akordohen privilegje të tjera për këtë kategori funksionarësh. Pas akordimit të këtyre privilegjeve, ato bëhen pjesë e statusit të funksionarit dhe nuk mund të cenohet me akte të mëtejshme ligjore apo nënligjore. Të vetmet përjashtime janë parashikuar në nenin 138 të Kushtetutës, si dhe në nenin 22, të ligjit nr. 96/2016, ç'ka nuk provohet të ekzistojë në situatën konkrete;

- Shtrirja e statusit të gjyqtarit edhe ndaj përfitimeve të tjera, krahas atyre me natyrë ngushtësisht financiare del jo vetëm nga përmbajtja e nenit 138 të Kushtetutës, si dhe nenit 22 të ligjit nr. 96/2016, por është konfirmuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Në disa vendime ajo është shprehur se me termin "përfitime të tjera" duhen kuptuar jo vetëm ato me natyrë financiare, por edhe të drejta të tjera, sikurse mund të jetë p.sh e drejta për karrierë e gjyqtarit, të cilat, pasi u jepen këtyre të fundit, nuk mund tu hiqen më, pasi mbrohen nga parimet kushtetuese të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe të sigurisë juridike;

- Ndër të drejtat që gëzonin gjyqtarët për shkak të ushtrimit të detyrës, ka qenë e drejta për t'u pajisur me pasaportë shërbimi me shpenzimet e institucionit. Me VKM nr. 389/2019 është prekur statusi i gjyqtarëve në dy elemente: i) heqja e së drejtës për t'u pajisur me pasaportë shërbimi dhe, për rrjedhojë, heqja e së drejtës për të gëzuar të gjitha lehtësitë e pajisjes me këtë dokument shtetëror identifikimi; ii) heqja e përfitimit financiar të përballimit të pagesës për pajisjen me të nga buxheti i institucionit ku gjyqtari ushtron detyrën;

- Shkronjat "b" dhe "c" të nenit 138 të Kushtetutës dhe neni 22 i ligjit nr. 96/2016 nuk duket të jenë marrë parasysh dhe të jenë zbatuar në VKM nr. 389/2019. I vetmi shkak justifikues i legjitimitetit të VKM nr. 389/2019 mund të ishte referimi te shkronja "a" e nenit 138 të Kushtetutës dhe neni 22 i ligjit nr. 96/2016, për ekzistencën e një situate të vështirë financiare në vend ose emergjenca të tjera kombëtare;

- Për rrjedhojë, konkludohet se VKM nr. 389/2019 në "Lidhjen 2", në pjesën që nuk përfshin gjyqtarët si subjekte që gëzojnë të drejtën për t'u pajisur me pasaportë shërbimi, si dhe kufizon të drejtën e përdorimit të pasaportave të shërbimit deri në datë 31.12.2019, vjen në kundërshtim me nenin 138 të Kushtetutës dhe nenin 22 të ligjit nr. 96/2016;

- VKM nr. 389/2019 ka shkelur nenin 118 të Kushtetutës, duke qenë se kanë dalë në kundërshtim me vetë rezervën kushtetuese dhe rezervën ligjore të paprekshmërisë së statusit të gjyqtarëve.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

A. Mbi legjitimitetin e palës paditëse

13. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim "Kolegji") sjell në vëmendje se tashmë është konsoliduar praktika gjyqësore dhe kushtetuese, sipas të cilës individët apo subjektet, që kundërshtojnë një akt nënligjor normativ me qëllim mbrojtjen e të drejtave të tyre të ligjshme, duhet të provojnë interesin e tyre real, vetjak dhe të drejtpërdrejtë, si dhe të bindin gjykatën se nuk kanë mjet tjetër për të mbrojtur këto të drejta. Në nenin 15, shkronjat "a" dhe "d" të ligjit nr. 49/2012 është përcaktuar shprehimisht se "*Të drejtën e ngritjes së padisë e ka: a) çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik; (...) d) çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cenuar një interes i ligjshëm publik: i) nga një akt normativ; ii) nga një akt administrativ, në rast se një e drejtë e tillë u njihet me ligj.*"

14. Në nisje të një procesi gjyqësor është e domosdoshme të verifikohet paraprakisht legjitimiteti formal i paditësit, me qëllim që gjykata të kontrollojë ligjshmërinë e aktit nënligjor normativ. Neni 15 i ligjit nr. 49/2012 parashikon dy lloje të subjektesh që kanë legjitimitet procedural për paraqitjen e padive pranë gjykatave administrative: njëri është konkret dhe tjetri abstrakt. Çdo subjekt i së drejtës, veçanërisht individi (ose subjektet që barazohen me të), nëse ka pretendime për paligjshmëri të një akti nënligjor normativ, duhet t'i drejtohet gjykatës në momentin kur dalin aktet individuale në bazë e për zbatim të aktit nënligjor normativ, pasi të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve nuk cenohen në mënyrë abstrakte, por konkrete. Për këtë arsye, ligji parashikon mjete efektive me të cilat individi mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave apo interesave të tij ligjore, një nga të cilat është edhe kundërshtimi në rrugë gjyqësore i aktit administrativ individual që del në zbatim të aktit

nënligjor normativ dhe që sjell pasoja të drejtpërdrejta për të. Individi nuk legjitimohet të mbrojë në mënyrë abstrakte të drejtat ose interesat e ligjshme të të tjerëve që mundet ose jo të cenohen nga zbatimi i aktit nënligjor normativ. Prandaj, individi duhet të provojë para gjykatës se akti normativ që ai kundërshton është drejtpërdrejtë i zbatueshëm dhe nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të tij. Në të kundërt, legjitimimi i individit për kundërshtimin e akteve normative nuk mund të pranohet nga gjykata. Kjo është arsyeja që neni 15 i ligjit nr. 49/2012 ka diferencuar shoqatat dhe grupet e interesit, duke u njohur posaçërisht atyre të drejtën për kundërshtimin e një akti nënligjor normativ, kur pretendojnë se cenohet një interes i ligjshëm publik, i cili përbën njëkohësisht edhe thelbin e veprimtarisë së shoqatës, ose të grupit të interesit (*shih vendimet nr. 00-2021-1938 (243), datë 22.11.2021, nr. 00–2022–320(32), datë 4.2.2022 e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

15. Sipas jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, shoqatat dhe grupet e interesit legjitimohen të kundërshtojnë aktin nënligjor normativ në Gjykatën Administrative të Apelit, ashtu si edhe aktet administrative individuale, kur pretendojnë se u cenohet një e drejtë apo interes ligjor vetjak. Ligji njeh të drejtën e padisë për kundërshtimin e aktit nënligjor normativ për shoqatat dhe grupet e interesit që synojnë mbrojtjen e një interesi të ligjshëm objektiv, për shkak të veprimtarisë, por edhe misionit të rëndësishëm publik që ato kryejnë. Nisur nga ky interes publik që synojnë të mbrojnë këto subjekte, ligji i ka pajisur me të drejtën për të ushtruar aktivisht, në kuptimin formal dhe substancial, të drejtën e padisë kundër akteve nënligjore normative.

16. Një e drejtë e tillë që legjitimon shoqatat dhe grupet e interesit për t'iu drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit lidhet me natyrën e vetë aktit nënligjor normativ, i cili vendos rregulla të përgjithshme sjelljeje, parashikon hipoteza në abstrakt, si dhe nuk shteron me një akt të vetëm zbatimi. Normat e sjelljes që parashikon akti normativ nuk u drejtohen subjekteve individualisht të përcaktueshëm, por një grupimi subjektesh, të cilët mund të mbrohen në mënyrën më eficente, nëpërmjet shoqatave dhe grupeve të interesit, të cilat kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës, duke mbrojtur të drejtat kolektive në tërësi. Kjo nuk do të thotë se këto subjekte kanë legjitimitet të pakushtëzuar në mbrojtjen e interesave të tyre për t'iu drejtuar gjykatës. Përkundrazi, verifikimi i legjitimitetit të shoqatave dhe grupeve të interesit mbetet në çdo rast detyrë kryesore e gjykatës, që shqyrton padinë për kundërshtimin e aktit normativ.

17. Nisur nga sa më lartë, duke iu referuar rastit në shqyrtim, rezulton se pala paditëse, SHKGJ-ja, është person juridik dhe ka si objekt të veprimtarisë së saj, "*mbrojtjen dhe garantimin e statusit të gjyqtarëve, si dhe ruajtjen e pavarësisë dhe garancive të tjera të pushtetit gjyqësor",* si edhe *"mbrojtjen e sistemit gjyqësor në tërësi, duke ndërmarrë iniciativa për goditjen e ligjeve... që kanë të bëjnë me këtë sistem apo me statusin e gjyqtarëve"*. Kolegji vlerëson se, ashtu siç ka arsyetuar edhe Gjykata Administrative e Apelit, pala paditëse ka arritur të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë midis qëllimit për të cilin është krijuar, veprimtarisë që ajo kryen, si dhe pasojave që rrjedhin nga dispozitat e VKM-së nr. 389/2019. Për këto arsye, SHKGJ-ja ka legjitimitet *ratione personae* për vënien në lëvizje të kontrollit të ligjshmërisë së aktit nënligjor normativ objekt kundërshtimi.

18. Njëkohësisht SHKGJ-ja ka edhe legjitimim *ratione temporis,* sepse akti objekt gjykimi, sipas nenit 18, pika 3, të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar, është kundërshtuar brenda afatit 3 vjeçar në Gjykatën Administrative të Apelit. VKM nr. 389/2019 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë 14.6.2019 dhe ka hyrë në fuqi në këtë datë. Kërkesëpadia objekt shqyrtimi gjyqësor është regjistruar pranë Gjykatës Administrative të Apelit në datën 11.7.2019.

B. Mbi legjitimitetin procedural të përfaqësuesit të palës paditëse

19. Kolegji çmon të ndalet në çështjen e legjitimimit procedural të përfaqësuesit të SHKGJ-së. Bazuar në nenin 96/a, pika 1, të Kodit të Procedurës Civile (në vijim "KPC"), *"Përfaqësimi i palëve në Gjykatën e Lartë bëhet vetëm nga avokati."*. Në rastin konkret, rekursi është ushtruar nga SHKGJ, i panënshkruar nga avokati. Pala paditëse, sipas statutit të saj, përbëhet nga gjyqtarët e gjykatave të të gjitha niveleve dhe si qëllim kryesor të veprimtarisë së saj ka mbrojtjen e pavarësisë dhe të garancive kushtetuese për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit. Kjo shoqatë ka organet drejtuese të saj, të cilat kanë tagrin e përfaqësimit. Nisur nga fakti se si anëtarësia ashtu edhe përfaqësuesit e saj janë gjyqtarë, pra profesionistë të së drejtës, rekursi i paraqitur është nënshkruar nga kryetari i shoqatës, po ashtu gjyqtar. Në këto kushte, Kolegji vlerëson të ndalet tek analiza e këtij fakti për të vendosur lidhur me legjitimimin procedural të përfaqësuesit të palës paditëse në ushtrimin e rekursit. Kolegji, me qëllim që të dalë në një përfundim të bazuar lidhur me legjitimimin procedural të përfaqësuesit të palës paditëse në këtë gjykim, çmon të nevojshme të sjellë në vëmendje qëndrimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "GJEDNJ") në rastin e kufizimeve të lejueshme që parashikojnë legjislacionet kombëtare për pranimin e ankimit nga një gjykatë më e lartë.

20. Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "KEDNJ") i garanton çdo individi të drejtën që një gjykatë të shqyrtojë çdo mosmarrëveshje në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre civile, por nuk

i jep kësaj të drejte karakter absolut. GJEDNJ-ja në vazhdimësi ka theksuar se sistemi konventor ka karakter subsidiar. Shtetet anëtare, në pajtim me parimin e subsidiaritetit, kanë përgjegjësinë kryesore të garantojnë të drejtat dhe liritë e përcaktuara në KEDNJ dhe protokollet e saj, duke gëzuar një hapësirë vlerësimi *(shih çështjet Hatton dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar; Vistiņš dhe Perepjolkins k. Letonisë; Garib k. Holandës).* Sidoqoftë, shtetet anëtare, në përputhje me hapësirën e vlerësimit të përcaktuar nga praktika e qëndrueshme e GJEDNJ-së, mund të zgjedhin të parashikojnë përfaqësim ligjor të detyrueshëm, kur vlerësojnë se ka arsye të mjaftueshme për këtë qëllim dhe është GJEDNJ-ja që analizon nëse shteti ka qëndruar brenda hapësirës së vet të vlerësimit.

21. GJEDNJ-ja ka theksuar se neni 6 i KEDNJ-së nuk detyron shtetet të ngrenë gjykata apeli apo kasacioni, por aty ku ato ekzistojnë, garancitë e këtij neni duhet të gjejnë aplikim, me qëllim që t'i garantojnë kërkuesit efektivisht të drejtën e aksesit në gjykatë (*Brualla Gómez de la Torre k. Spanjës*; *Andrejeva k. Letonisë*). Nëse legjislacioni vendas parashikon rregulla të rrepta për pranimin ose jo të ankimit pa përfaqësues (pra, përfaqësimin e detyrueshëm), GJEDNJ-ja vlerëson nëse legjislatori ka pasur arsye të mjaftueshme dhe relevante për një rregullim të tillë dhe nëse kjo gjë garanton procesin e rregullt; pra, nëse gjykatat kombëtare, gjatë zbatimit të këtij rregulli të detyrueshëm, arrijnë të japin arsye të mjaftueshme dhe relevante në vendimmarrjen e tyre *(shih çështjen Correia De Matos k. Portugalisë*). Nëse parashikimi ligjor kërkon përfaqësim të detyrueshëm kjo duhet të analizohet në këndvështrimin e rrethanave specifike të çështjes, veçanërisht të faktit nëse kërkuesi është në gjendje të paraqesë dhe të mbrojë çështjen e tij në mënyrë të kënaqshme para gjykatës pa ndihmën e një avokati (*shih çështjen McVicar k. Mbretërisë së Bashkuar).* Rregullat në lidhje me format dhe afatet kohore, që duhen respektuar për paraqitjen e një ankimi synojnë të sigurojnë administrimin e duhur të drejtësisë dhe respektimin, në veçanti, të parimit të sigurisë juridike (*Cañete de Goñi k. Spanjës*). Mospranimi i një ankese, për shkak të të metave me karakter formal, të cilat nuk i atribuohen subjektit ankues mund të cenojë të drejtën e tij për t'iu drejtuar gjykatës (*Sotiris k. Greqisë*).

22. Më tej, në çështjen *Dyluś k. Polonisë, 23 dhjetor 2021, §45*, GJEDNJ-ja trajtoi të drejtën e aksesit në gjykatë për mosmarrëveshjet me natyrë civile, e cila lidhej me mospranimin e rekursit nga Gjykata e Lartë, pasi kërkuesi, avokat në profesion, e kishte paraqitur rekursin personalisht dhe jo nëpërmjet avokatit të tij në gjykatën e apelit, vendimin e të cilit kundërshtonte. Gjykata e Apelit nuk e kishte pranuar rekursin për shkak të kësaj mangësie, ndërkohë që kërkuesi e kishte paraqitur rekursin direkt në Gjykatë të Lartë, tashmë nëpërmjet avokatit të tij. Gjykata e Lartë e kishte refuzuar sërish rekursin me argumentin se nuk ishin plotësuar në kohë të metat e rekursit. GJEDNJ-ja në këtë rast konstatoi se nga vendimi i Gjykatës së Lartë nuk kuptohet përse rekursi i kërkuesit, i cili ishte me profesion avokat dhe e kishte riparuar më pas të metën, duke riparaqitur rekursin në atë gjykatë tashmë të nënshkruar nga një përfaqësues i zgjedhur prej tij, nuk plotësonte kushtet e formës ose të përmbajtjes të parashikuara në ligj për këtë mjet ankimi. Gjithashtu, nga vendimi i Gjykatës së Lartë nuk konstatohet nëse ka pasur shkaqe të arsyeshme në rastin konkret, për të konkluduar se kërkuesi nuk kishte qasje objektive dhe të zhveshur nga pasioni, të cilat, sipas Gjykatës së Lartë, janë arsye për të shmangur përfaqësimin si duhet të çështjes në procedurat gjyqësore të natyrës kasacionale *(shih gjithashtu edhe Correia de Matos k. Portugalisë, 4 prill 2018).* Prandaj u arrit në përfundimin se qasja e Gjykatës së Lartë ishte tepër formale dhe jo proporcionale.

23. Bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së mund të arrihet në përfundimin se vendosja e kritereve formale kufizuese për t'iu drejtuar gjykatave të larta, përfshi edhe përfaqësimin e detyrueshëm me avokat është në pajtim me kërkesat e nenit 6, për sa kohë që interesi kryesor për paraqitjen e çështjes në nivelin e duhur profesional ligjor është i mundur të arrihet për një administrim sa më të mirë të procesit gjyqësor. Pikërisht këtij qëllimi i shërben edhe parashikimi ligjor për përfaqësimin e detyrueshëm të palëve në Gjykatën e Lartë me avokat të pajisur me licencë për ushtrimin e profesionit, ose, në rastin e institucioneve publike nga avokati i shtetit. Neni 474 i KPC-së, i ndryshuar në vitin 2021, parashikon "*Rekursi dhe të gjitha kërkesat e tjera që paraqiten në Gjykatën e Lartë nënshkruhen nga avokati që e përfaqëson palën.*". Nevoja e këtij parashikimi ligjor erdhi për shkak të rikonceptimit dhe ridimensionimit të Gjykatës së Lartë, si gjykatë ligji që shqyrton rekurset në vështrim të zbatimit dhe interpretimit të drejtë të ligjit nga gjykatat më të ulëta, në funksion të njësimit apo ndryshimit të praktikës gjyqësore. Pra, debati gjyqësor në Gjykatën e Lartë është i përqendruar te çështjet ligjore dhe jo te faktet e rrethanat e çështjes konkrete, pavarësisht se zgjidhja e konfliktit është e ndërvarur me interpretimin e ligjit. Për këtë arsye, një përfaqësim cilësor, me nivel të lartë profesional gjatë shqyrtimit të rekursit është jo vetëm në të mirë të palëve, por sidomos në funksion të zgjidhjes sa më të drejtë të çështjes nga ana e Gjykatës së Lartë, vendimmarrja e së cilës është me efekt për të gjithë praktikën gjyqësore, pavarësisht nëse ka karakter njësues apo jo. Është me mjaft rëndësi për gjykimin në Gjykatë të Lartë që palët dhe përfaqësuesit e tyre në proces të gëzojnë cilësi dhe aftësi profesionale ligjore të nivelit të mjaftueshëm për të ngritur para Gjykatës së Lartë çështje dhe pretendime të natyrës ligjore, interpretimi përfundimtar i të cilave nga ana e kësaj Gjykate do të kontribuojë për një zbatim të njësuar të kuadrit ligjor nga gjykatat më të ulëta. Më tej, përfaqësimi i palëve ndërgjyqëse përpara Gjykatës së Lartë është në funksion

të garantimit të një mbrojtjeje efektive, si dhe të administrimit të duhur të drejtësisë.

24. Duke mbajtur parasysh sa më lartë, Kolegji vlerëson se në rastet kur në një proces përpara Gjykatës së Lartë njëra nga palët është subjekt ose përfaqësohet nga një përfaqësues, i cili, për shkak të formimit profesional ose funksionit që ushtron, zotëron njohuritë e duhura të ligjit material dhe procedural, në një nivel të njëjtë ose më të lartë se të avokatit të licencuar dhe këto njohuri janë vlerësuar nga autoritetet përgjegjëse sipas ligjit specifik për këtë qëllim (këtu bëhet fjalë për palë ose përfaqësues të tyre që ushtrojnë funksionin si gjyqtarë, prokurorë, avokatë), do të konsiderohej e paarsyeshme dhe jo në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, që këtyre subjekteve t'u kufizohet e drejta për t'u përfaqësuar pa avokat në Gjykatën e Lartë. Qëllimi kryesor i përfaqësimit të çështjes dhe zhvillimit të debatit gjyqësor në nivelin e duhur profesional, si dhe i garantimit të një mbrojtje ligjore efektive mund të konsiderohet i arritur plotësisht dhe efektivisht në raste të tilla.

25. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se pala paditëse, person juridik i regjistruar në formën e një shoqate përbëhet nga gjyqtarë të niveleve të ndryshme të gjyqësorit. Organet e saj drejtuese kanë vendosur që në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë të përfaqësohet nga kryetari i saj, i cili është gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kolegji vlerëson se kryetari i SHKGJ-së, për shkak të funksionit të gjyqtarit që kryen, i zotëron aftësitë dhe njohuritë e nevojshme juridike për të realizuar efektivisht mbrojtjen e subjektit dhe se është plotësisht i aftë dhe "në gjendje të paraqesë dhe të mbrojë çështjen e tij në mënyrë të kënaqshme para gjykatës pa ndihmën e një avokati" (*shih çështjen McVicar k. Mbretërisë së Bashkuar).*

C. Mbi juridiksionin gjyqësor të çështjes

a) Lidhur me çështjen nëse akti normativ është në juridiksionin e Gjykatës Administrative të Apelit apo të Gjykatës Kushtetuese

26. Fillimisht, Kolegji vlerëson se qëndrimi i mbajtur nga Gjykata Administrative e Apelit për klasifikimin e vendimit objekt gjykimi, si një akt nënligjor me natyrë normative është në përputhje me përcaktimet që jep ligji mbi llojin dhe natyrën e aktit administrativ. Vendimi nr. 389/2019, me anë të të cilit shprehet vullneti i Këshillit të Ministrave në ushtrim të funksionit të tij publik që synon të rregullojë një marrëdhënie të përcaktuar me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje për të gjithë dhe që nuk shteron me zbatimin e tij, përputhet me kuptimin që jepet për "*aktin nënligjor normativ*", në nenin 2, pika 3 të ligjit nr. 49/2012.

27. Në rekursin e paraqitur para Gjykatës së Lartë, pala paditëse ka pretenduar se çështja i përket sferës së juridiksionit gjyqësor dhe jo atij kushtetues, për faktin se statusi i gjyqtarit nuk është një fushë ekskluzive e rregullimeve kushtetuese, por e nenit 22 të ligjit nr. 96/2016, si një normë e nxjerrë në bazë dhe për zbatim të nenit 138 të Kushtetutës. Pala paditëse gjithashtu ka pretenduar se VKM-ja nr. 389/2019 ka shkelur këtë normë ligjore, si dhe ka cenuar të drejtat e fituara në mënyrë të ligjshme dhe, për rrjedhojë, duhet të shfuqizohet. Pala e paditur, Këshilli i Ministrave, prapëson se përmes padisë janë ngritur çështje të karakterit kushtetues që nuk përbëjnë lëndë për Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

28. Përpara Kolegjit shtrohet për zgjidhje përcaktimi i saktë i natyrës së kësaj çështje për të konkluduar nëse zgjidhja e saj është në kompetencën e gjykatave administrative apo i përket juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese. Në kuptim të nenit 135/1 të Kushtetutës, juridiksioni gjyqësor i zakonshëm ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Objekti i veprimtarisë së tyre është shqyrtimi i marrëdhënieve juridike të natyrës private apo publike, nga të cilat lindin të drejta dhe interesa të ligjshme të bartësve të tyre, përveç atyre çështjeve për të cilat Kushtetuta dhe ligji ia ka ngarkuar juridiksionit kushtetues ose atij gjyqësor të posaçëm. Në kuptim të nenit 124/1 të Kushtetutës, juridiksioni kushtetues ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, si dhe ka për objekt të veprimtarisë së saj kontrollin kushtetues të akteve të renditura në nenin 131, duke përfshirë ligjin, marrëveshjen ndërkombëtare, aktin normativ të organeve qendrore dhe vendore, etj.

29. Raporti që krijohet mes paligjshmërisë dhe pakushtetutshmërisë për shqyrtimin e vlefshmërisë së aktit nënligjor normativ nxjerr në pah, midis të tjerave, edhe përballjen e juridiksionit gjyqësor administrativ dhe atij kushtetues. Përpara krijimit të gjykatave administrative nuk kishte ndonjë kundërshti të natyrës juridiksionale për kontrollin e aktit nënligjor normativ, sepse shqyrtimi i tij ishte përcaktuar si objekt i gjykimit kushtetues. Parashikimi i nenit 326 të KPC-së të vitit 1996 përcaktonte se, nuk mund të ngrihej padi në gjykatën e zakonshme për aktet administrative që, sipas Kushtetutës, ishin në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese. Ky parashikim ishte në koherencë të plotë me formulimin e nenit 131, shkronja c) të Kushtetutës, sipas të cilit, Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e akteve normative të organeve qendrore e vendore me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare.

30. Me miratimin e ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin*

e mosmarrëveshjeve administrative", nga njëra anë, u synua të përcaktohet juridiksioni gjyqësor administrativ për shqyrtimin e vlefshmërisë së akteve normative të organeve qendrore ose vendore, megjithatë duket se nuk u arrit të shmanget plotësisht përballja mes dy juridiksioneve. Parashikimi në nenin 7, shkronja "a", të ligjit nr. 49/2012, i kompetencës së Gjykatës Administrative të Apelit për të shqyrtuar ligjshmërinë e aktit nënligjor normativ të një organi publik krijon një lloj paqartësie apo konfondimi me kompetencën e Gjykatës Kushtetuese, që sipas nenit 131, shkronja "c", të Kushtetutës, vlerëson kushtetutshmërinë e akteve normative. Njëkohësisht, gjykatës administrative i është njohur e drejta që gjatë shqyrtimit gjyqësor të një veprimi administrativ të mos zbatojë një akt nënligjor normativ, në bazë të të cilit është kryer veprimi administrativ që shqyrtohet, kur çmon se akti nënligjor është i paligjshëm (neni 38). Një kompetencë e tillë e gjykatës administrative përballet me kompetencën e Gjykatës Kushtetuese kur shqyrton pajtueshmërinë e akteve normative me Kushtetutën (neni 131, shkronja "c"). Pavarësisht se edhe neni 8/a, i ligjit nr. 49/2012 ka përjashtuar gjykimin e mosmarrëveshjeve për aktet nënligjore normative që, sipas Kushtetutës, janë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese, nuk rezulton që ndarja mes juridiksioneve të jetë fort e qartë.

31. Nga ana tjetër, neni 54/4 dhe 56 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", përkatësisht përcaktojnë: *"Çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve ose i organeve të qeverisjes vendore, që kanë çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre, përbëjnë bazat për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve"* si dhe, *"Kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës është e lidhur me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes shqyrton edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit"*. Sipas këtij rregullimi ligjor, me qëllim zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet pushteteve, Gjykata Kushtetuese nuk përjashtohet të ushtrojë kontrollin mbi vlefshmërinë e këtyre akteve.

32. Në pamje të parë, me rregullimin që bën ligji nr. 49/2012 nuk duket se krijohet ndonjë problematikë për përcaktimin e gjykatës kompetente që do të shqyrtojë paligjshmërinë e aktit normativ, përderisa, si rregull, pranohet se Gjykata Kushtetuese është kompetente për të vlerësuar vetëm antikushtetutshmërinë e aktit. Në dallim nga ligji nr. 7491, datë 29.4.1991 *"Për dispozitat kryesore kushtetuese"* dhe nga disa kushtetuta evropiane, të cilat kanë parashikuar të drejtën e Gjykatës Kushtetuese të vendosë për papajtueshmërinë e akteve nënligjore normative me Kushtetutën dhe me ligjet (pra, të vlerësojë jo vetëm antikushtetutshmërinë, por edhe paligjshmërinë), Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka synuar ta kufizojë këtë të drejtë. Neni 131, shkronja "c" parashikon vetëm shqyrtimin e pajtueshmërisë së akteve normative me Kushtetutën, duke mos përmendur papajtueshmërinë e tyre me ligjet.

33. Nga ballafaqimi i normave kushtetuese dhe ligjore, në drejtim të kontrollit mbi aktin nënligjor normativ, si dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet organeve, kur shkak i konfliktit janë vetë aktet normative, dallohen dy juridiksione paralele që krijohen ndërmjet gjykatave administrative dhe Gjykatës Kushtetuese. Në këtë drejtim, çështja kryesore që shtrohet për diskutim përpara Kolegjit është *nëse akti normativ i nxjerrë nga organet qendrore dhe vendore do të jetë objekt shqyrtimi i juridiksionit të Gjykatës Administrative të Apelit apo i Gjykatës Kushtetuese?*

34. Ky realitet i ri juridiksional, si dhe opinionet e ndryshme doktrinare mbi vijën e ndarjes mes dy juridiksioneve kërkojnë nga jurisprudenca gjyqësore dhe kushtetuese qartësimin e kritereve, që mund të shërbejnë për përcaktimin e juridiksionit për gjykimin e vlefshmërisë së aktit nënligjor normativ. Pavarësisht se nuk është arritur të konsolidohet një qëndrim i qartë, që bën dallimin mes juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor administrativ, kritere të ndryshme janë evidentuar në këtë drejtim. Në jurisprudencën e këtyre gjykatave, si edhe në qëndrimet doktrinare për ndarjen e kufijve juridiksionalë, gjenden referime në disa kritere, si p.sh. statusi kushtetues ose jo kushtetues i organit publik që është ngarkuar me nxjerrjen e aktit nënligjor normativ, klasifikimi si organ kushtetues i nivelit qendror/vendor ose organ jo kushtetues qendror/vendor, subjektet që legjitimohen për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese apo Gjykatës Administrative të Apelit për të kundërshtuar aktin nënligjor normativ, shterimi i juridiksionit gjyqësor administrativ para se t'i drejtohen me ankim individual juridiksionit kushtetues, ose, thënë ndryshe, parimi i subsidiaritetit, natyra e pretendimeve që ngrihen nga paditësi për paligjshmërinë e aktit normativ, etj. Megjithëse kriteret nuk janë të pakta, ende nuk është arritur të identifikohet qartësisht ndonjë kriter përcaktues që zgjidh përfundimisht problematikën e mbivendosjes juridiksionale.

35. Me qëllim përcaktimin e qartë të juridiksionit, si dhe shmangien e mbivendosjes mes juridiksionit kushtetues dhe atij gjyqësor administrativ, Kolegji vlerëson se të gjitha kriteret e mësipërme mund të kenë vlerën dhe rëndësinë e tyre, por orientimi drejt parimit të subsidiaritetit dhe, në veçanti, drejt identifikimit të plotë të shkaqeve të pretenduara nga paditësi, të ngritura në nivel ligjor apo kushtetues, mund të shërbejë si kriter thelbësor për të dalluar juridiksionin gjyqësor administrativ nga ai kushtetues.

36. Nga interpretimi që u bëhet dispozitave të Kushtetutës dhe ligjeve, por edhe nga qëndrimi i mbajtur nga jurisprudenca kushtetuese, rezulton se në rrugën e kontrollit të kushtetutshmërisë së normës Gjykatës Kushtetuese nuk i krijohet hapësirë për verifikimin e paligjshmërisë së akteve normative. Nga ana tjetër, Gjykata Administrative e Apelit, si gjykata që ka kompetencë gjykimin parësor të ligjshmërisë së një akti normativ, ka qenë e prirur drejt pushtetit të saj për të shqyrtuar vetëm paligjshmërinë e aktit nënligjor normativ, por pa guxuar të bëjë dallimin me pakushtetutshmërinë. Një dallim i tillë nuk rezulton të jetë shtjelluar në mënyrë të qartë as nga vetë Gjykata Kushtetuese *(shih vendimin nr. 4/2021 të Gjykatës Kushtetuese).*

37. Për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative, Kushtetuta ka parashikuar organet publike kompetente, si dhe procedurën që duhet respektuar për nxjerrjen e tyre, duke ia lënë përcaktimin e përmbajtjes së akteve nënligjore vullnetit të organit ligjvënës, sipas çështjeve kryesore që evidenton dhe delegon. Në pjesën e shtatë, kreu I, nga neni 116 deri në nenin 120, Kushtetuta ka parashikuar disa norma me natyrë formale, por jo përmbajtësore për nxjerrjen e akteve nënligjore normative. Me këtë zgjidhje, Kushtetuta ka pranuar se normat e saj mund të shërbejnë si bazë vetëm për kryerjen e kontrollit procedural të aktit normativ dhe jo të atij përmbajtjesor. Kushtetuta ia ka besuar përmbajtjen e akteve nënligjore normative tërësisht vullnetit të ligjvënësit nëpërmjet kufijve ligjor që ai vendos, duke synuar në këtë mënyrë të bëjë edhe një dallim ndërmjet paligjshmërisë dhe pakushtetutshmërisë së aktit nënligjor normativ. Me rregullimin që bën neni 118 i Kushtetutës pranohet se aktet nënligjore normative nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjit, duke mos njohur autoritetin e organeve publike që të nxjerrin akte normative në mënyrë të pavarur. Sipas këtij neni, aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë dhe ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.

38. Kolegji vlerëson se ky rregullimi kushtetues synon të bëjë një dallim thelbësor ndërmjet "çështjeve që duhen rregulluar" nga ligji, përmes të cilave përcaktohen kufijtë normativ të organit kompetent nënligjor, si dhe përmbajtjes së vetë ligjit. Këto janë dy çështje të ndryshme që nuk duhen ngatërruar me njëra tjetrën. Një akt nënligjor normativ mund të rregullojë formalisht çështjet për të cilat ligji e ka ngarkuar, por pa e respektuar përmbajtjen e vetë ligjit. Kështu, p.sh., një akt normativ respekton korrektësisht parimin e hierarkisë së normës, nxirret në bazë dhe për zbatim të ligjit, si dhe rregullon formalisht çështjet e përcaktuara nga ligji (neni 116, 118, pika 2), por në përmbajtjen e tij rezulton me të meta thelbësore, që bien në kundërshtim ose shkojnë tej përmbajtjes së vetë ligjit. Në përgjithësi kjo është një situatë e zakonshme që ndeshet në praktikë. Kolegji vlerëson se ngritja e një pretendimi të tillë nga palët në proces mund të shërbejë si një kriter i rëndësishëm për të bërë ndarjen e juridiksionit, sepse orienton kërkimin në drejtim të verifikimit të paligjshmërisë dhe jo të pakushtetutshmërisë së aktit nënligjor normativ. Evidentimi nga paditësi i këtij argumenti si një pretendim për kundërshtimin e aktit normativ do të bëjë kompetente Gjykatën Administrative të Apelit dhe jo Gjykatën Kushtetuese. Nga ana tjetër, në rast se do të pretendohet se akti nënligjor normativ ka rregulluar çështje të papërcaktuara nga ligji, që në fakt evidentohen si shkelje të procedurës ose të kompetencës së organit publik (referuar nenit 118 dhe parimit kushtetues të ligjshmërisë së akteve nënligjore), atëherë vihet në dyshim tejkalimi i kompetencës nga organi publik që ka nxjerrë këtë akt, duke implikuar në këtë mënyrë juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe, për rrjedhojë, çështjen e pakushtetutshmërisë së aktit.

39. Në rastin në shqyrtim, Gjykata Administrative e Apelit, për të bërë dallimin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit gjyqësor, rezulton të ketë përdorur formalisht si referim kriterin e pretendimeve të ngritura nga pala paditëse për shqyrtimin e vlefshmërisë së aktit normativ, por pa arritur të ndajë qartësisht pretendimet ligjore nga ato kushtetuese. Në fakt, në këtë gjykim, siç rezulton edhe nga arsyetimi i vendimit gjyqësor, palët kanë debatuar mbi thelbin dhe natyrën e pretendimeve dhe vetë Gjykata Administrative e Apelit e ka konsideruar pajisjen e gjyqtarëve me pasaporta shërbimi, si pjesë e të drejtave të tjera të fituara prej tyre, që lidhet me statusin e gjyqtarit, duke konkluduar për mungesë të juridiksionit gjyqësor administrativ. Duke zbatuar rregullin e përparësisë së juridiksionit kushtetues në raport me juridiksionin gjyqësor administrativ, pavarësisht konstatimit të mungesës së juridiksionit gjyqësor administrativ, Gjykata Administrative e Apelit ka lejuar debatin gjyqësor, ka kryer një hetim të plotë mbi pretendimet e palëve në proces, duke arsyetuar mbi to dhe në përfundim ka vendosur të rrëzojë kërkesëpadinë. Me qëndrimin e mbajtur, Kolegji vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit, duke i dhënë zgjidhje çështjes në mënyrë përfundimtare, në thelb, nuk e ka përjashtuar juridiksionin gjyqësor administrativ.

40. Nëse Gjykata Administrative e Apelit do të mbante në vëmendje dhe do të konsideronte pretendimet e ngritura nga pala paditëse në nivelin ligjor dhe do të arsyetonte se këto kërkime nuk lidhen drejtpërdrejt me një të drejtë kushtetuese, por me një të drejtë ligjore të fituar, padyshim që do të konkludonte mbi juridiksionin

gjyqësor administrativ të kësaj çështje. Kolegji vlerëson se në rastin në shqyrtim implikohet një e drejtë ligjore që lidhet me pajisjen me pasaportë shërbimi të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, si një e drejtë që nuk parashikohet drejtpërdrejtë nga Kushtetuta, por nga ligji, pavarësisht se kjo është pjesë e statusit të gjyqtarit. Akti objekt shqyrtimi, VKM nr. 389/2019, në përmbajtjen e tij ka vlerësuar t'u heqë gjyqtarëve të drejtën e pajisjes me pasaportë shërbimi, ndërkohë që sipas ligjit kjo e drejtë ka qenë e fituar më parë. Mbi këtë analizë, Kolegji vlerëson se çështja nuk i përket juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, por është brenda juridiksionit gjyqësor administrativ, për të cilën nevojitet zgjidhja e saj në mënyrë përfundimtare.

D. Mbi pretendimet për themelin e mosmarrëveshjes

a) Lidhur me ometimin ligjor

41. Fillimisht, me VKM nr. 335/1997, *"Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit"*, ashtu si edhe për një kategori të caktuar funksionarësh publikë, është vendosur pajisja me pasaportë shërbimi e gjyqtarëve. Pas miratimit të ligjit nr. 8668, datë 23.11.2000, "*Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit*" (në vijim ligji nr. 8668/2000), i ndryshuar, në nenin 4, pika 2 të tij parashikohet se kriteret për lëshimin e pasaportës së shërbimit dhe asaj diplomatike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, në zbatim të rezervës ligjore relative të parashikuar në këtë ligj, bazuar në nenet 100, pikat 1, 2 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 28 (b), të ligjit nr. 9000/2003, ka miratuar një akt të ri nënligjor, VKM nr. 389/2019, *"Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit"*.

42. Deri në momentin e miratimit nga Këshilli i Ministrave të vendimit nr. 389/2019 rezulton se gjyqtarët e kanë gëzuar këtë të drejtë. Në Lidhjen 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi janë renditur subjektet që kanë të drejtë të pajisen me pasaporta shërbimi, ku nuk përfshihen gjyqtarët. Me hyrjen në fuqi të këtij akti nënligjor normativ shfuqizohet edhe VKM nr. 335/1997, me të cilën gjyqtarët, për shkak të funksionit, ishin përfitues të pasaportës së shërbimit. Mospërfshirja e gjyqtarëve në kategorinë e subjekteve përfituese të pajisjes me pasaportë shërbimi rezulton të jetë ometim në vendimin e Këshillit të Ministrave me pasojë (sipas pretendimit të palës paditëse) cenimin e të drejtave ligjore të fituara, që janë pjesë e rëndësishme dhe e pandashme e statusit të gjyqtarit. Konstatimi i paligjshmërisë së kësaj situate, të krijuar për shkak të ometimit të VKM nr. 389/2019, përfshihet në objektin e kërkimeve nga pala paditëse.

43. Në funksion të dhënies së një zgjidhje përfundimtare për çështjen, Kolegji e vlerëson të nevojshme të analizojë konceptin *"ometim ligjor"* dhe ndikimin që ai mund të ketë në cenimin e të drejtave të ligjshme, të fituara më parë. Ometimi ligjor është koncept tashmë i afirmuar në doktrinën juridike, praktikën gjyqësore dhe, në veçanti, atë kushtetuese. Ometimi është identifikuar, si në rastet kur norma juridike nuk ka rregulluar një marrëdhënie të caktuar, që në të vërtetë duhej të rregullohej *(ometimi absolut)*, ashtu edhe kur norma nuk ka arritur të përmbushë në mënyrën e plotë dhe të duhur këtë detyrim *(ometimi relativ)*. Shmangia e zbrazëtisë së krijuar nga mungesa e normës juridike, qoftë nëpërmjet procesit të hartimit të normës së re, ashtu edhe përmes zbatimit të ligjit me analogji, konsiderohet në jurisprudencën si çështje e ometimit legjislativ. Ometimi ligjor mund të ekzistojë në disa situata, por ai bëhet pjesë e shqyrtimit gjyqësor nëse konstatohet si shkak kryesor i cenimit të të drejtave ligjore të individit. Një rast i tillë mund të jetë mosparashikimi i rregullimeve në normat përkatëse juridike, si pasojë e të cilit shkelen parimet dhe normat kushtetuese e ligjore. Gjykata, e cila gëzon autoritetin e kontrollit të ometimit për antikushtetutshmëri ose paligjshmëri, konstaton ometimin gjatë shqyrtimit të çështjes dhe orienton organin kompetent të nxjerrë rregullimin përkatës, i cili nëpërmjet plotësimit ose ndryshimit të normës juridike, sjell si pasojë shmangien ose plotësimin e ometimit. Vetëm në këtë mënyrë gjykata arrin të garantojë rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar nëpërmjet ometimit *(shih "Problems of Legislative omission in constitutional Jurisprudence", raport i miratuar në Kongresin XIV të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese të Evropës (2009))*. Gjykata mund të deklarojë paligjshmërinë/pakushtetutshmërinë e një teksti në pjesën në të cilën nuk përmban një parashikim ligjor, që duhet domosdoshmërisht të jetë, pa dashur të thotë se norma krijohet nga Gjykata, pasi ajo nuk e ka këtë funksion *(shih vendimin nr. 190/1970 të Gjykatës Kushtetuese të Italisë, që ka deklaruar paligjshmërinë kushtetuese të nenit 304/1 të KPP, në pjesën që përjashtonte ndihmën e mbrojtësit gjatë pyetjes së të pandehurit; vendimin 364/1988, me të cilin po ajo Gjykatë deklaron paligjshmërinë kushtetuese të nenit 5 të KP-së, në pjesën që nuk përjashtonte nga përgjegjësia penale për mosnjohjen e ligjit penal, rastin kur mosnjohja është e paevitueshme; më tej edhe vendimet nr. 336/1989, nr. 471/1990, nr. 485/1992, nr. 62/1992, nr. 359/1993)*.

44. Përveçse nga Gjykata Kushtetuese, ometimi si koncept nuk ka qenë një çështje e trajtuar gjerësisht në jurisprudencën gjyqësore. Pavarësisht se Kushtetuta nuk e parashikon shprehimisht të drejtën e Gjykatës Kushtetuese për të kontrolluar dhe vlerësuar kushtetutshmërinë e ometimit ligjor, në jo pak raste ajo, nëpërmjet jurisprudencës së saj, ka mbajtur qëndrim. Gjykata Kushtetuese nuk ka hezituar të konkludojë për domosdoshmërinë që paraqet shmangia e ometimit ligjor për funksionimin normal të shtetit të së drejtës. Në

vendimin nr. 31/2003, Gjykata Kushtetuese arsyeton: *"Në qoftë se ligjvënësi nuk reagon në përgjigje të vakumit legjislativ, atëherë sistemi kushtetues nuk ofron ndonjë mjet efektiv dhe kjo situatë mund të çonte në një krizë në sistemin e demokracisë përfaqësuese."* Me zhvillimin e jurisprudencës, Gjykata Kushtetuese ka shkuar më tej, duke evidentuar cenimin e parimeve kushtetuese, për shkak të ekzistencës së zbrazëtisë ligjore. Në çështje të kësaj natyre, ajo ka shpallur antikushtetutshmërinë e normës juridike, duke ia lënë organit ligjbërës përmbushjen e këtij detyrimi, ashtu si nëpërmjet interpretimit kushtetues dhe bërjes të vetëzbatueshëm të arsyetimit të vendimit ka plotësuar rregullimin ligjor edhe pa ndërhyrjen e organit ligjbërës (*shih vendimin nr. 12/2000 të Gjykatës Kushtetuese*). Pavarësisht qëndrimeve të vërejtura në jurisprudencën kushtetuese për pozicionin e një *"ligjvënësi pozitiv",* Gjykata Kushtetuese nuk ka pasur për qëllim zhvendosjen ose zëvendësimin e parlamentit nga ushtrimi i pushtetit të tij si ligjbërës *(shih vendimet nr. 18/2003; nr. 1/2005; nr. 19/2007; nr. 12/2010 të Gjykatës Kushtetuese).*

45. Në linjën e këtij qëndrimi konstant të jurisprudencës kushtetuese, Kolegji vlerëson të nevojshme të theksojë se ometimi mund të shmanget jo vetëm nga institucionet ligjbërëse dhe Gjykata Kushtetuese, por edhe nga gjykatat e zakonshme, nëpërmjet interpretimit të ligjeve, zbatimit të ligjit me analogji, respektimit të parimeve të përgjithshme etj. Konstatimi i ometimit nga gjykatat e zakonshme, sidomos në aktet nënligjore, kufizohet vetëm për marrëdhënien juridike konkrete të lidhur me çështjen që shqyrtohet prej saj. Kështu, zgjidhja e çështjeve konkrete nga gjykatat e sistemit të zakonshëm, duke pasur për orientim zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të Kushtetutës (neni 4), të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara (neni 122), të jurisprudencës së GJEDNJ-së (neni 17) dhe, në veçanti, interpretimet përfundimtare të kryera nga Gjykata Kushtetuese (neni 132, 145), mund të realizohet, kur është rasti, edhe nëpërmjet konstatimit të ometimit dhe shmangies së tij, kur vërtetohet se një gjë e tillë është bërë shkak për cenimin e të drejtave të ligjshme.

46. Gjyqtari nuk mund të shmanget nga roli krijues gjatë interpretimit të ligjit, pasi, në rrethana të caktuara, e drejta mund të ekzistojë tej normave pozitive që nxjerr shteti, e drejtë që e ka burimin e saj në rendin juridik kushtetues si një tërësi logjike dhe që funksionon si një korrigjuese e normave të shkruara. Gjykatat kanë detyrimin ta gjejnë këtë të drejtë dhe ta bëjnë atë realitet në çështjet që kanë për shqyrtim. Kushtetuta nuk e kufizon gjyqtarin në zbatimin strikt të vullnetit legjislativ në çështjen që i është paraqitur. Funksioni gjyqësor presupozon se nuk ekziston asnjë boshllëk në rendin juridik pozitiv, një kusht që mund të jetë i dëshirueshëm në interes të sigurisë juridike, por që në praktikë është i paarritshëm. Detyra e gjyqtarit nuk kufizohet në interpretimin dhe zbatimin e vendimeve legjislative. Ai mund të jetë i detyruar të marrë një vendim në pajtim me vlerat kushtetuese, pra të ndriçojë dhe të zbatojë në vendimet e tij ato koncepte të vlerave që janë pjesë e pandarë e rendit juridik kushtetues, por që në tekstet e ligjeve të shkruara nuk janë shprehur qartë apo në mënyrë të plotë. Në kryerjen e kësaj detyre, gjyqtari duhet të ruhet nga arbitrariteti. Vendimi i tij duhet të bazohet në një arsyetim racional. Ai duhet të bëjë të qartë që ligji i shkruar nuk arrin ta përmbushë qëllimin e vet për të ofruar një zgjidhje të drejtë për problemin ligjor në shqyrtim. Është pikërisht vendimi i gjyqtarit ai që e mbush këtë hapësirë boshe, duke përdorur arsyen e shëndoshë dhe konceptet e përgjithshme të komunitetit mbi drejtësinë *(shih më gjerë vendimin e Gjykatës Kushtetuese Federale gjermane (BVerfGE 34, 269).*

47. Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim konstatohet se Këshilli i Ministrave, të cilit i është deleguar nga ligjvënësi pushteti për të nxjerrë aktin nënligjor normativ për të pajisur me pasaporta diplomatike dhe shërbimi disa funksionarë publikë, ka ometuar në rregullimin e kësaj situate për gjyqtarët, duke cenuar haptazi dhe pa asnjë arsye të përligjur një të drejtë të fituar më parë prej tyre. Në VKM nr. 389/2019, në lidhjen 2, janë renditur subjektet që kanë të drejtë të pajisen me pasaporta shërbimi, duke mos u përfshirë gjyqtarët, të cilët , për shkak të funksionit, e kishin fituar këtë të drejtë, sipas rregullimit të mëparshëm. Mosparashikimi në aktin normativ, pa një arsye të përligjur të të drejtës së gjyqtarëve për t'u pajisur me pasaportë shërbimi është një ometim ligjor që vlerësohet nga Kolegji se ka cenuar standardin *"përfitime të tjera"*, në referim edhe të konceptit kushtetues të *"të drejtave të fituara"*.

48. Jurisprudenca kushtetuese ka mbajtur qëndrim konstant lidhur me parimin e sigurisë juridike që në praktikë realisht sintetizohet nga parimi i pritshmërive legjitime, ndërsa ky i fundit "merr inerci" nga prekja e të drejtave të fituara *(shih vendimin nr. 11/2010 të Gjykatës Kushtetuese)*. Pritshmëria legjitime, sikundër interpretohet në doktrinën e të drejtës kushtetuese dhe administrative, përfshin parimin e mbrojtjes së të drejtave të fituara përmes ligjit ose akteve nënligjore dhe parimin e vazhdimësisë ose konsistencës së ligjit, në kuptimin material të tij. Koncepti për pritshmërinë legjitime është trajtuar në jurisprudencën e GJEDNJ-s ë, e cila në vendimin *Kopecký k. Sllovakisë* është shprehur se *"...pritshmëria e ligjshme bazohet mbi një besim të arsyeshëm mbi një akt ligjor, i cili ka një bazë të shëndetshme. Ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara ose të shpërfillë interesat e tyre legjitime".*

49. Rezulton se gjyqtarët e kanë përfituar të drejtën për t'u pajisur me pasaporta shërbimi me ligj dhe me akt nënligjor që ka dalë në bazë e për zbatim të tij. Në momentin që "*përfitimet e tjera*" i njihen gjyqtarit përmes një ligji apo akti nënligjor, ato bëhen pjesë integrale dhe e pandashme e statusit që ai gëzon dhe, për pasojë, nuk mund të parashikohet një rregull i ri përkeqësues përmes zhveshjes apo heqjes së të drejtës së përfituar. Padyshim që jo çdo e drejtë kushtetuese e ligjore mund të jetë absolute, por në kuadrin e respektimit të standardit të sigurisë juridike, pritshmërive legjitime dhe të drejtave të fituara nevojitet që të jepen arsye të përligjura për marrjen e një mase kufizuese.

50. Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarit parashikon se statusi i gjyqtarëve synon sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë, elemente këto që çdo palë në një proces gjyqësor i pret në mënyrë legjitime nga gjykata dhe gjyqtari, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave. Për statusin e magjistratit Kushtetuta sanksionon parimet kryesore mbi të cilat ai ekziston, duke mos qenë shterues në këtë drejtim, ndërsa rregullimi i drejtpërdrejtë reflektohet në disa ligje, në veçanti, në ligjin nr. 96/2016, i ndryshuar, përmes të cilit garantohen: "*a) të drejtat dhe detyrimet e tyre; b) pranimin dhe emërimin e tyre; c) zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre; ç) vlerësimin etik dhe profesional të tyre; d) përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre;*" (neni 1 i ligjit), përfshirë të drejtat e rrjedhura nga "*Paga dhe përfitimet e tjera*" (neni 22 i ligjit). Padyshim që në këtë ligj nuk janë listuar në mënyrë shteruese të gjitha llojet e "*përfitimeve të tjera*" që kanë gjyqtarët për shkak të funksionit, sepse ato normohen edhe me akte të tjera ligjore e nënligjore. Kështu p.sh., karriera është një nga përfitimet që gjyqtarët e gëzojnë për shkak të detyrës që kryejnë dhe, si e tillë, përfshihet në sferën e garancive që burojnë nga statusi i gjyqtarit (*shih vendimin nr. 31/2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndër përfitimet e tjera që u janë njohur më herët gjyqtarëve është edhe e drejta për t'u pajisur me pasaporta shërbimi. Të gjitha këto garanci janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Pikërisht për shkak të rëndësisë që ka statusi i gjyqtarit, si pjesë e rëndësishme e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, ligjvënësi nuk ka përcaktuar dhe as mund të përcaktojë një listë shteruese të "*përfitimeve të tjera*" që funksionari gëzon. Për këtë arsye, Kolegji ka konkluduar se, në rastin konkret, pretendimet e palës paditëse nuk kanë natyrë të drejtpërdrejtë kushtetuese, pasi në thelb ato kanë të bëjnë me statusin e gjyqtarit dhe të drejtat/privilegjet që rrjedhin prej tij, të cilat gjejnë rregullim të posaçëm në ligjin nr. 96/2016, si edhe në ligje/akte nënligjore të tjera, gjë që e bën mosmarrëveshjen objekt të juridiksionit gjyqësor dhe jo të atij kushtetues.

51. Kështu, referuar ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, *"Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit"*, që ka autorizuar Këshillin e Ministrave për të përcaktuar funksionarët që e përfitojnë një të drejtë të tillë, por edhe nenit 22, të ligjit nr. 96/2016 që sanksionon konceptin e paprekshmërisë së pagës dhe të përfitimeve të tjera, të cilat burojnë nga ushtrimi i funksionit të gjyqtarit, Kolegji vlerëson se çdo ndërhyrje me efekt përkeqësues dhe pa asnjë arsye të përligjur në të drejtat e fituara më parë që shpërfill interesat legjitime të gjyqtarëve konsiderohet e paligjshme. Përjashtimet e lidhura me përkeqësimin e statusit të funksionarit, në drejtim të cenimit të pagës dhe përftimeve të tjera janë të listuara në nenin 22, të ligjit nr. 96/2016 dhe përshijnë situata tepër specifike, si: i) vështirësi financiare në vend ose emergjenca kombëtare; ii) kur gjyqtari me dëshirën e tij kthehet në një pozicion të mëparshëm me pagë më të ulët; iii) për shkak të një mase disiplinore ose për shkak të një vlerësimi të ulët etik dhe profesional. Në rastin konkret, mospërfshirja e gjyqtarëve në kategorinë e subjekteve përfituese të pasaportës së shërbimit nuk lidhet me asnjë prej këtyre situatave.

52. Kolegji konstaton se VKM nr. 335/1997 parashikonte të drejtën për t'u pajisur me pasaportë shërbimi, si edhe të drejtën që pajisja me pasaportë të realizohej me shpenzimet e institucionit. Pra, në këtë rast, VKM nr. 389/2019 ka cenuar statusin e gjyqtarëve në dy elemente: *së pari*, në heqjen e së drejtës për t'u pajisur me pasaportë shërbimi dhe për rrjedhojë pamundësinë për të gëzuar të gjitha përfitimet që sjell ky dokument shtetëror identifikimi; *së dyti*, heqjen e përfitimit financiar të përballimit të pagesës për pajisjen me pasaportë shërbimi nga buxheti i institucionit, ku gjyqtari ushtron detyrën. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se heqja e këtyre të drejtave, të cilat nuk mund të preken pa një arsye të përligjur, vjen në kundërshtim me nenin 22, të ligjit nr. 96/2016, "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", gjë e cila prek drejtpërdrejt statusin e gjyqtarit.

53. Mbi bazën e kësaj analize, Kolegji konkludon për paligjshmërinë e lidhjes 2 të këtij vendimi, të shfaqur në formën e ometimit ligjor, për pjesën që nuk parashikon gjyqtarët si subjekte zyrtare, të cilët kanë të drejtë të pajisen me pasaportë shërbimi. Për shmangien e kësaj paligjshmërie, pala e paditur, Këshilli i Ministrave, ka detyrimin të plotësojë boshllëkun e shkaktuar në aktin normativ objekt gjykimi, duke i përfshirë gjyqtarët në kategoritë përfituese të pasaportës së shërbimit.

b) Lidhur me pretendimet e tjera

54. Me arsyetimin e mësipërm, Kolegji i ka dhënë në të njëjtën kohë përgjigje edhe pretendimit të palës së paditur, Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit se, pika e parë dhe e dytë e objekti të padisë nuk parashikohet nga legjislacioni në fuqi, më konkretisht neni 17, i ligjit nr. 49/2012. Në këtë aspekt, Kolegji sjell

edhe njëherë në vëmendje praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë dhe qëndrimin e mbajtur për konceptin procedural të "*padive që nuk mund të ngrihen*", në kuptim të nenit 299, shkronja "c", të KPC-së. Pamundësia e zhvillimit të procesit gjyqësor civil apo administrativ, për shkak të "*padive që nuk mundet të ngrihen*", përfaqëson në vetvete një tërësi shkaqesh procedurale që nuk lejojnë shqyrtimin në themel të padisë. Padia nuk mund të ngrihet dhe rrjedhimisht procesi gjyqësor nuk mund të ecë për të vlerësuar themelin e saj, në rastet kur nuk plotësohen parakushtet procedurale, apo thënë ndryshe kushtet që ligji i paracakton si mjetet ligjore procedurale për mbrojtjen e të drejtave subjektive të personit. Këto shkaqe me natyrë procedurale godasin padinë në kuptimin procedural dhe rëndojnë ekskluzivisht mbi aftësinë e padisë për të krijuar proces gjyqësor të vlefshëm. Shkaqe që pamundësojnë ngritjen e padisë janë edhe mungesa e juridiksionit, (pa)paditshmëria për shkak të imunitetit parlamentar (neni 73, pika 1 i Kushtetutës) apo juridiksional (imuniteti i diplomatit), legjitimiteti aktiv procedural (neni 95 i KPC-së), gjyqvarësia (neni 58 i KPC-së), instituti i gjësë së gjykuar (neni 451/a i KPC-së), bashkëndërgjyqësia e detyrueshme (neni 161, shkronja "ç" etj. Për këtë arsye, as neni 468 në formulimin e mëparshëm, as neni 299 shkronja "c" i KPC-së aktualisht në fuqi nuk parashikojnë listë shteruese të shkaqeve, pasi sipas rrethanave mundet të konkludohet edhe mbi shkaqe të tjera që pengojnë proceduralisht një padi të ngrihet (*shih vendimin nr. 00-2018- 476 (80), datë 3.4.2018, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).*

55. Referuar rastit në shqyrtim, Kolegji vlerëson se përmes nenit 17, të ligjit nr. 49/2012, ligjvënësi ka synuar të normojë në mënyrë specifike disa prej llojeve të padive që mund të ngrihen dhe shqyrtohen nga gjykatat administrative, por kurrsesi ky rregullim nuk mund të konsiderohet se është shterues në aspektin e të drejtës së çdo subjekti apo individi për të kërkuar gjyqësisht konstatimin e paligjshmërisë së ometimit që shfaqet tek akti nënligjor normativ dhe cenon një të drejtë të ligjshme të fituar më parë. Një interpretim i kundërt konsiderohet si cenim i të drejtës së individit për t'iu drejtuar gjykatës, në respektim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ. Kolegji sjell në vëmendje parashikimet ligjore në ligjin nr. 49/2012, i ndryshuar, nenet 7(a), 10, pika 2(b), 18, pika 3, 37, pika 3 dhe 4, të cilat në harmoni edhe me nenin 17, pika 1/a të po këtij ligji sqarojnë llojin e padisë që mund të paraqitet në Gjykatën Administrative të Apelit për të kundërshtuar paligjshmërinë e aktit normativ nënligjor. Mbi bazën e analizës së kryer më sipër dhe mbi veçorinë që paraqet kjo padi, Kolegji konkludon se pretendimet e përfaqësuesit të palës së paditur rezultojnë të pabazuara.

56. Për sa i përket pikës së tretë të objektit të kërkesëpadisë "*Konstatimin e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e pikës 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.6.2019 "Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit" në pjesën që parashikon se pasaportat e shërbimit të gjyqtarëve të lëshuara para datës 14 qershor 2019 humbin vlefshmërinë më datë 31 dhjetor 2019*", Kolegji vlerëson se me pranimin që i bëhet kërkimeve të tjera, ajo mbetet pa një objekt konkret. Rezulton se prej miratimit dhe hyrjes në fuqi të VKM nr. 389/2019, Këshilli i Ministrave ka vijuar miratimin e ndryshimeve të këtij akti me disa vendime të tjera, përmes të cilave ka zgjatur afatin e vlefshmërisë së pasaportave të shërbimit për gjyqtarët. Konkretisht, në VKM nr. 389/2019, në pikën 14 është parashikuar: "*Subjektet, që janë pajisur me pasaporta diplomatike apo shërbimi përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, kanë të drejtë të përdorin pasaportat përkatëse deri më datë 31 dhjetor 2019.*"; në VKM nr. 873, datë 24.12.2019, pika 1(b) parashikohet se, "*...fjalët "... 31 dhjetor 2019 ... zëvendësohen me ... 30 qershor 2020 ...*"; në VKM nr. 510, datë 1.7.2020, pika 1(b) parashikohet se fjalët, "*... 30 qershor 2020... zëvendësohen me ... 31 dhjetor 2020.*"; në VKM nr. 1078, datë 24.12.2020, parashikohet se fjalët: *"... 31 dhjetor 2020... zëvendësohen me ... 30 qershor 2021.*"; në VKM nr. 389, datë 30.6.2021 parashikohet se *fjalët "... pasaportat përkatëse deri më datë 30 qershor 2021... zëvendësohen me ... pasaportat e vlefshme përkatëse deri më datë 31 dhjetor 2022*". Siç rezulton nga këto ndryshime të njëpasnjëshme të aktit normativ, pala e paditur në vazhdimësi ka konfirmuar vlefshmërinë e pasaportave të shërbimit për gjyqtarët. Një fakt i tillë nuk ndikon në paligjshmërinë e aktit normativ për sa i përket heqjes apo mospërfshirjes së gjyqtarëve si subjekte përfituese. Nisur nga ndryshimet që ka pësuar VKM objekt gjykimi Kolegji vlerëson se kërkimi i tretë i objektit të padisë nuk mund të pranohet, sepse faktikisht afati "*...deri në 31 dhjetor 2019*" ka përfunduar. Nga ana tjetër, pranimi i kërkimit për konstatimin e paligjshmërisë së shtyrjes së afatit të vlefshmërisë që tashmë është deri më 31 dhjetor të vitit 2022, jo vetëm që është në kundërshtim me atë që synon të mbrojë paditësi, por do të shkaktonte njëkohësisht një tjetër cenim të së drejtës së gjyqtarëve për vijimin e gëzimit të pasaportave të shërbimit deri në afatin e caktuar. Përderisa Kolegji vlerëson si të drejtë kërkimin e parë dhe të dytë të objektit të padisë mbi konstatimin e paligjshmërisë së ometimit që ka krijuar lidhja 2, bashkëlidhur VKM 389/2021, në pjesën që nuk përfshihen gjyqtarët, atëherë nuk mund të konkludojë për të kundërtën, sa i përket kërkimit në pikën e tretë të padisë. Për rrjedhojë ky kërkim duhet të rrëzohet.

57. Për sa i përket pretendimit tjetër të palës së paditur se me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8668/2000, VKM nr. 335/1997 është shfuqizuar, Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk është i bazuar. Kolegji vëren se me dispozitat kalimtare të ligjit nr. 8668/2000 nuk rezulton që VKM nr. 335/1997 të jetë shfuqizuar në

mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Për më tepër që në vazhdimësi pala e paditur ka nxjerrë disa akte të tjera nënligjore që kanë ndryshuar VKM nr. 335/1997, përmes të cilave është njohur dhe zgjatur afati i vlefshmërisë së pasaportave të shërbimit për gjyqtarët.

c) Lidhur me zgjidhjen përfundimtare të çështjes

58. Lidhur me pushtetin ligjor të Gjykatës së Lartë për mundësinë e zgjidhjes në mënyrë përfundimtare të çështjeve dhe, në rastin konkret, të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, Kolegji vëren se ndryshimet e bëra në ligjin nr. 49/2012 që hynë në fuqi në muajin maj të vitit të kaluar kanë zgjeruar gamën dhe llojin e vendimmarrjes së Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Sipas pikës 1, shkronja "dh", të nenit 63, Kolegji ka të drejtë të disponojë me ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe t'i japë zgjidhjen përfundimtare çështjes "*...kur zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes*.".

59. Gjykata Administrative e Apelit, në këtë çështje që lidhet me ushtrimin e pushtetit të saj në rrugën e kontrollit abstrakt të paligjshmërisë së një akti nënligjor normativ, siç ka arsyetuar, i ka dhënë një zgjidhje përfundimtare çështjes. Vetë ajo gjykatë ka arsyetuar për thelbin e pretendimeve të palës paditëse mbi konceptin kushtetues të pajisjes me pasaportë shërbimi të gjyqtarëve si një e drejtë e fituar dhe që cenon statusin e gjyqtarëve. Megjithëse argumenti i përdorur lidhet me mungesën e juridiksionit gjyqësor, Gjykata Administrative e Apelit, si organi i ngarkuar nga ligji me kontrollin e paligjshmërisë së aktit normativ, në të njëjtën kohë me rrëzimin e kërkesëpadisë ka vënë në lëvizje Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë për zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje.

60. Kolegji vlerëson se rasti në shqyrtim lidhet me kontrollin e paligjshmërisë së një akti normativ dhe si i tillë është një gjykimi i veçantë që paraqet veçori nga kontrolli i zakonshëm kasacional që ushtron Gjykata e Lartë. Gjykimi i kësaj çështje bazohet në kontrollin abstrakt dhe jo konkret të paligjshmërisë së një akti normativ, i cili dallon nga kontrolli që i bëhet paligjshmërisë së një akti administrativ individual. Referuar legjislacionit procedural administrativ dhe konkretisht Kodit të Procedurave Administrative, është i njohur rregulli se parimet e sanksionuara në këtë Kod zbatohen për aq sa është e mundur edhe mbi aktet normative nënligjore. Pra, kontrolli i vlefshmërisë së akteve nënligjore normative është një gjykim i veçantë që përafron me kontrollin abstrakt të kushtetutshmërisë së normës që ushtrohet nga Gjykata Kushtetuese, për shqyrtimin e të cilit nuk mund të zbatohen në mënyrë strikte të njëjtat rregulla siç zbatohen gjatë shqyrtimit të rekursit të zakonshëm ndaj vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit. Karakteri *abstrakt* i kontrollit nënkupton shqyrtimin e vlefshmërisë së normës juridike mbi interesat objektive të bartësve të funksioneve publike. Kontrolli abstrakt konsiderohet edhe si një kontroll parandalues, për shkak të qëllimit të tij për të pastruar sistemin nga norma juridike të pavlefshme, përpara se ato të cenojnë të drejtat dhe liritë themelore të individëve dhe parimet e shtetit të së drejtës. Ekzistenca e interesave të një natyre objektive në gjykimin abstrakt e bën të domosdoshëm ushtrimin e këtij kontrolli nga një gjykatë e veçantë dhe e specializuar.

61. Karakteristikë për këtë lloj gjykimi është ushtrimi i kontrollit *in abstractio* ndaj normave juridike nga një gjykatë e specializuar për çështje kushtetuese, e cila vihet në lëvizje nga autoritetet publike ose politike dhe, që konkludon në marrjen e vendimeve me efekte *erga omnes* dhe nga një gjykatë e specializuar për çështje ligji, që është Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, si hallka e fundit. Në të vërtetë, gjithçka lidhet me rolin e gjyqtarit administrativ, si gjyqtar i ligjshmërisë. Konkretisht, ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 49/2012 (me ligjin nr. 49/2021) kanë pranuar qartazi se kontrolli i ligjshmërisë së aktit normativ kryhet me dy nivele gjykimi dhe se vendimi është përfundimtar, vetëm pasi të jetë shprehur Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Këtë e konfirmon edhe rregulli i sanksionuar në nenin 43 të ligjit se *"Vendimi për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ, pas përfundimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë, publikohet i plotë në të njëjtën mënyrë me atë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për botimin e aktit"*.

62. Për vetë specifikën që paraqet kontrolli abstrakt i ligjshmërisë së një akti normativ nga gjykatat administrative (pra, përfundimi i shqyrtimit të kësaj çështje brenda juridiksionit gjyqësor administrativ), por edhe për efektet *erga omnes* që kanë vendimet e kësaj natyre, ligji nr. 49/2012 ka përcaktuar afate procedurale të posaçme dhe të shkurtra. Për këtë arsye, çështje të tilla nuk mund t'i nënshtrohen të gjitha rregullave që ka gjykimi i zakonshëm kasacional.

63. Mbi këtë analizë, Kolegji vlerëson se pavarësisht nga arsyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit se i mungon juridiksioni të kontrollojë vlefshmërinë e aktit normativ, ajo duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë në fakt i ka dhënë zgjidhje çështjes në thelb. Prandaj, në këto kushte i mbetet Gjykatës së Lartë ta zgjidhë përfundimisht çështjen. Konkretisht, përmbushen kërkesat e nenit 63, pika 1, shkronja "dh", të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, në drejtim të faktit se zgjidhja e mosmarrëveshjes dhe shkaqeve të ngritura në rekurs lidhet me zbatimin e ligjit procedural e material dhe nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të

çështjes. Për këtë arsye, Kolegji vlerëson se gjykimi i kësaj çështje, që lidhet me kontrollin abstrakt të ligjshmërisë së një akti normativ duhet të zgjidhet në mënyrë përfundimtare.

64. Mbi të gjithë analizën e mësipërme, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi nr. 264 (86-2019-3791), datë 27.12.2019, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë është marrë në interpretim të gabuar të ligjit dhe si i tillë duhet të ndryshohet dhe kërkesëpadia duhet të pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 63, pika 1, shkronja "dh", të ligjit nr. 49/2012, "*Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative*", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 264 (86-2019-3792), datë 27.12.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në këtë mënyrë:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë.
- Konstatimin e cenimit të statusit të gjyqtarit nëpërmjet heqjes së pasaportës së shërbimit me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.6.2019, "*Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit*", si një e drejtë e fituar që nuk mund të ulet dhe që vjen në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*".
- Konstatimin e paligjshmërisë, për shkak të ometimit të normës juridike, të lidhjes 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.6.2019, "*Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit*", në pjesën që nuk parashikon gjyqtarët si subjekte zyrtarë që kanë të drejtë të pajisen me pasaportë shërbimi.

2. Rrëzimin e kërkesës për pikën 3 (tre) të objektit të padisë.

Ky vendim publikohet i plotë në Fletoren Zyrtare, në zbatim të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 49/2012.

Tiranë 12.5.2022

Kryesues: Sokol Sadushi
Anëtar: Arbena Ahmeti, Gentian Medja
Anëtar me mendim paralel: Asim Vokshi, Ervin Pupe

MENDIM PARALEL
(*i gjyqtarëve Asim Vokshi dhe Ervin Pupe*)

1. Në çështjen administrative me nr. 31003-00369-00-2020. regj.them, që i përket:
PADITËSE: Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë
I PADITUR: Këshilli i Ministrave
PERSON I TRETË: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
OBJEKTI: 1. Konstatimin e cenimit të statusit të gjyqtarit nëpërmjet heqjes së pasaportës së shërbimit, me vendimin nr. 389, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave, "*Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit*", si një e drejtë e fituar e që nuk mund të ulet, në kundërshtim me nenin 22, të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*".

2. Konstatimin e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e lidhjes 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.6.2019, "*Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit*" në pjesën që nuk parashikon gjyqtarët si subjekte zyrtarë që kanë të drejtë të pajisen me pasaportë shërbimi.

3. Konstatimin e paligjshmërisë dhe shfuqizimin e pikës 14 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.6.2019, "*Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit*" në pjesën që parashikon se pasaportat e shërbimit të gjyqtarëve të lëshuara para datës 14 qershor 2019 humbasin vlefshmërinë më datë 31 dhjetor 2019.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 116, 118 dhe 138 të Kushtetutës; nenet 1, 2 shkronja gj), 10 dhe 22 të ligjit nr. 96/2016 "*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*"; nenet 2, pika 3, 7, shkronja a), 10, pika 2, shkronja "b", 15, shkronja "d", 17, pika 1, shkronja "a", 18, pika 3, 37, pika 3 e 4; 40, pika 1, shkronja "a" dhe 43, i ligjit nr. 49/2012.

2. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë më datë 12.5.2022 vendosi:

1. "Ndryshimin e vendimit nr. 264 (86-2019-3791), datë 27.12.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në këtë mënyrë:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë.

- Konstatimin e cenimit të statusit të gjyqtarit nëpërmjet heqjes së pasaportës së shërbimit me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.6.2019, "Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit", si një e drejtë e fituar e që nuk mund të ulet, dhe në kundërshtim me nenin 22, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

- Konstatimin e paligjshmërisë, për shkak të ometimit të normës juridike, të lidhjes 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 12.6.2019, "Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit", në pjesën që nuk parashikon gjyqtarët si subjekte zyrtarë që kanë të drejtë të pajisen me pasaportë shërbimi.

2. Rrëzimin e kërkesës për pikën 3 (tre) të objektit të padisë."

3. Duke qenë pro llojit të vendimmarrjes për themelin e çështjes, por paraprakisht kundër zgjidhjes së kësaj çështje nga Gjykata e Lartë, pa e trajtuar më parë në themel nga Gjykata Administrative e Apelit, çmojmë të parashtrojmë përmbledhtazi në vijim arsyet në të cilat mbështesim mendimin tonë paralel për zgjidhjen e çështjes.

4. Gjatë diskutimeve në dhomë këshillimi, përpara se të kalohej në zgjidhjen në themel të çështjes, mendimi i trupës gjyqësore ishte i ndarë midis dy opsioneve: 1) prishjes së vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë; ose 2) vijimin e shqyrtimit në themel të çështjes dhe dhënien e një vendimi përfundimtar për kërkesat e palës paditëse. Gjyqtarët Asim Vokshi dhe Ervin Pupe ishin të mendimit se për shkak se Gjykata Administrative e Apelit nuk e kishte gjykuar çështjen në themel, sepse kishte konstatuar se mosmarrëveshja nuk i përkiste juridiksionit të zakonshëm, por atij kushtetues, duhej të prishej vendimi i saj e të kthehej çështja për rigjykim, në mënyrë që gjykata më e ulët të analizonte ligjshmërinë apo paligjshmërinë e aktit normativ nënligjor objekt gjykimi. Vetëm pasi gjykata më e ulët të shteronte kompetencën e vet funksionale, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë do të ishte në kushtet për t'u shprehur për themelin e çështjes. Shumica vendosi që duhej të vijohej me zgjidhjen në themel të çështjes, ndaj e vetmja mënyrë për evidentimin e faktit të mësipërm, është arsyetimi paralel.

5. Nga leximi i vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit arrihet në përfundimin se kjo gjykatë ka vlerësuar se mosmarrëveshja nuk është ligjore por kushtetuese dhe si e tillë hyn në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese e jo në kompetencën e Gjykatës Administrative të Apelit. Gjykata më e ulët arsyeton se bazuar në praktikën e Gjykatës së Lartë ajo nuk mund të procedonte me nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit (*pasi nuk mund t'ia dërgonte çështjen Gjykatës Kushtetuese*), por duhet ta rrëzojë padinë me argumentin se ajo është paraqitur para forumit të gabuar gjyqësor, kur në fakt pretendimet nuk duhej të parashtroheshin para gjykatave të zakonshme, por para Gjykatës Kushtetuese. Ky arsyetim është i gabuar, pasi nëse do të ishte kjo linja standarde e arsyetimit, atëherë pothuajse të gjitha rastet në të cilat palët e legjitimuara i drejtohen Gjykatës Administrative të Apelit për kundërshtimin e ndonjë akti nënligjor normativ, do të duhej të rrëzoheshin, pasi çdo herë gjendet një lidhje e të drejtave që parashikon ligji, me ato që parashikon Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë apo Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Pra, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk duhej të shqyrtonte themelin e kësaj çështjeje, por të arsyetonte se Gjykata Administrative e Apelit i kishte tagrat ligjore për ta zgjidhur atë dhe t'ia kthente për rigjykim, me detyrën që të shprehej për themelin e çështjes, sipas objektit të padisë, nëse akti nënligjor normativ binte apo jo në kundërshtim me ligjin.

6. Neni 138 i Kushtetutës ka vendosur një garanci të lartë për gjyqtarët, kur ka parashikuar shprehimisht se: "*Paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen, përveç rasteve, kur: a) nevojitet marrja e masave të përgjithshme ekonomiko-financiare për të shmangur situata të vështira financiare të vendit ose emergjenca të tjera kombëtare; b) gjyqtari kthehet në detyrën që mbante para emërimit; c) i jepet një masë disiplinore ose vlerësohet i pamjaftueshëm profesionalisht, sipas ligjit.*". I njëjti formulim gjendet edhe në nenin 22(1) të ligjit nr. 96/2016 "Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (*i ndryshuar*) i cili parashikon se: "*1. Paga dhe përfitimet e tjera të magjistratit nuk mund të ulen, me përjashtim të rasteve kur: a) ka situata të vështira financiare në vend ose emergjenca të tjera kombëtare, duke marrë parasysh faktorët si vijon: një mospërputhje e qartë midis dinamikës së pagave të magjistratëve dhe dinamikës së pagave standarde në shërbimin civil; indeksi i pagesave, ashtu si dhe indeksi i çmimeve të konsumatorit. Këta faktorë është e nevojshme që të vlerësohen, për të gjetur balancën mes paprekshmërisë së pagës dhe nevojës për të shmangur marrjen e borxheve të reja; b) magjistrati ushtron të drejtën për t'u kthyer nga një pozicion i mëparshëm më i lartë ose më i specializuar ose me mandat të kufizuar dhe me pagesë më të lartë; c) magjistrati ka masë disiplinore; ç) vlerësohet i pamjaftueshëm ose jepet masa disiplinore e uljes së përkohshme të pagës, sipas parashikimeve të këtij ligji;*"

7. Rregulli kushtetues i vendosur nga neni 138 i Kushtetutës përforcohet dhe kthehet përveçse në rregull

kushtetues, edhe në rregull ligjor, të detyrueshëm për t'u mbajtur parasysh nga të gjitha organet shtetërore, përfshirë edhe Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave. Shprehja "*[...] përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen [...]*", nuk është e pakuptimtë, boshe apo e pa zbatueshme. Kushtetuta dhe ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (*i ndryshuar*), vendosin shumë kufizime në jetën shoqërore, private, profesionale, financiare të gjyqtarëve. Kufizimet vendosen me qëllim që gjyqtarët të jenë ndër njerëzit më të kulluar në strukturën shtetërore të ngarkuar me zbatimin e ligjit dhe kjo të reflektojë rritje të besimit të publikut tek ta. Mirëpo, kufizimet e thella në jetën e gjyqtarëve, shteti dhe shoqëria i kompenson duke vendosur parimin kushtetues e ligjor se "*[...] paga dhe përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen [...]*". Këto përfitime siç përcakton neni 11(1) i ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (*i ndryshuar*) "Duhet të jenë në përputhje me dinjitetin e detyrës së magjistratit dhe të përshtatshme për të garantuar pavarësinë dhe mbrojtjen nga ndërhyrjet e jashtme në ushtrim të funksionit të tyre."

8. Në kushtet kur shumica vendosi të shqyrtojë çështjen në themel, pa u shprehur më parë gjykata Administrative e Apelit për ligjshmërinë apo paligjshmërinë e VKM-së objekt gjykimi, para gjyqtarëve shtroheshin tashmë alternativat si vijon: 1) Lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit për rrëzimin e padisë (*me arsyetim tjetër*); apo 2) ndryshimi i vendimit të gjykatës Administrative të Apelit dhe pranimi (i plotë ose i pjesshëm) i padisë. Në këto kushte, sa i përket themelit të çështjes, edhe ne gjyqtarët që mendonim se nuk duhet të shpreheshim në themel (*pa u gjykuar më parë çështja nga shkalla më e ulët*), për sa kohe që alternativat e votimit lidhen vetëm me themelin, jemi të mendimit se VKM objekt gjykimi preket nga paligjshmëri të theksuara, të cilat kanë cenuar statusin e gjyqtarëve dhe parashikimin ligjor se "*[...] përfitimet e tjera të gjyqtarit nuk mund të ulen [...]*". Ndaj iu bashkuam zgjidhjes së dhënë në dispozitivin e vendimit përfundimtar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

9. Në lidhje me themelin, natyrshëm mund të shtrohet pyetja se çfarë u duhen gjyqtarëve pasaportat e shërbimit? Nëse shihet kështu çështja, atëherë duhet të kuptohet paraprakisht se çfarë është një pasaportë shërbimi. Ligji nuk jep ndonjë përkufizim të kësaj kategorie të dokumenteve të udhëtimit, por nënkuptohet se është një pasaportë e posaçme që nxjerr në pah se mbajtësi i saj ushtron detyra zyrtare dhe për këtë qëllim i njihet e drejta që për lëvizjen jashtë shtetit, të përdorë një pasaportë të tillë që i paguhet nga shteti dhe që tregon se ai ka funksione shtetërore. Gjyqtarët i plotësonin këto cilësi si para përfshirjes së tyre në listën e përfituesve (*sipas VKM 335/1997, të ndryshuar*), ashtu edhe gjatë kohës kur u njohën si përfitues (*me ndryshimet që iu bënë VKM-së nr. 335/1997*), si dhe më pas (*pas miratimit të VKM nr. 389/2019*). Dallimi thelbësor me kategoritë e tjera të subjekteve është se, për gjyqtarët Kushtetuta dhe ligji kanë parashikuar se nëse u jepet një përfitim i caktuar, ai nuk mund t'u hiqet më pas në mënyrë arbitrare, por vetëm nëse argumentohet bindshëm një interes publik më i lartë që e justifikon këtë heqje (*asnjë argument i tillë nuk është paraqitur gjatë gjykimit*). Nëse shihet kategoria e subjekteve që përfitonte pasaporta shërbimi para miratimit të VKM-së nr. 389, datë 12.6.2019, vihet re se ajo ishte shumë e zgjeruar. Me miratimin e kësaj VKM-je u zvogëlua ndjeshëm numri i personave që mund të pajiseshin me pasaportë shërbimi, duke iu hequr kësisoj e drejta të gjithë subjekteve që nuk ishin riparashikuar si persona që kanë të drejtën e pajisjes me këtë lloj pasaportë. Bashkohemi me qëndrimin e Kolegjit, se gjyqtarëve nuk mund t'u hiqej kjo e drejtë, pa u dhënë një justifikim i fortë për nevojën e lartë publike për ta bërë një gjë të tillë. Ndaj, gjyqtarëve u është cenuar me një akt nënligjor normativ, një e drejtë e njohur më parë, çka bie ndesh me nenin 22(1), të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (*i ndryshuar*) dhe për këtë shkak VKM objekt gjykimi është i paligjshëm.

10. Në zbatim të nenit 307, paragrafi i dytë të KPC-së dhe nenit 35(3), të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", ky mendim paralel i bashkëlidhet vendimit të shumicës.

Gjyqtarë: Ervin Pupe, Asim Vokshi

VENDIM
Nr.00-2022-1036(114), datë 7.4.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:
Sokol Sadushi - kryesues,
Ilir Panda - anëtar,
Ervin Pupe - anëtar,
Sokol Binaj - anëtar,
Sandër Simoni - anëtar,
sot, më datë 7.4.2022 mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen penale me nr. 70007-00466-00-2019, akti që iu përket palëve:
KËRKUES: Kujtim Delishi.
PERSON I INTERESUAR: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;
Zyra e Gjendjes Gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.
OBJEKTI: rehabilitimin nga dënimi i dhënë me vendimin penal nr. 55-04, datë 20.11.2014, dhënë me 6 muaj burgim për veprën penale të goditjes së gjyqtarit, sipas nenit 316 të Kodit Penal, dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin;
Rehabilitimin nga dënimi i dhënë me vendimin penal nr. 158, datë 30.3.2015, dhënë me 5 muaj e 10 ditë burgim për kryerjen e veprës penale të përndjekjes, sipas nenit 121/1 të Kodit Penal, dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke u quajtur i "padënuar".
BAZA LIGJORE: neni 470, 480 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, neni 69/a i Kodit Penal.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Ilir Panda; përfaqësuesin e Prokurorisë së Përgjithshme, që parashtroi mendim për çështjet e shtruara për njësim dhe në përfundim kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe dërgimin çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë; mbrojtësin e kërkuesit Kujtim Delishi, që parashtroi mendim për çështjet dhe kërkoi pranimin e rekursit dhe prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN*:*

I. Rrethanat e çështjes

1. Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatat e faktit ka rezultuar e provuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin penal nr. 55–04, datë 20.1.2014, ka deklaruar fajtor kërkuesin Kujtim Delishi për veprën penale "Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit", parashikuar nga neni 316 *i* Kodit Penal (KP) duke e dënuar me 9 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) i pandehuri Kujtim Delishi është dënuar përfundimisht me 6 *muaj* burgim. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimit nr. 402, datë 16.3.2015, ka vendosur mospranimin e ankimit.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin penal nr. 158, datë 30.3.2015, ka deklaruar fajtor të pandehurin Kujtim Delishi për veprën penale "Përndjekja", parashikuar nga neni 121/1 i Kodit Penal duke e dënuar me 8 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i pandehuri Kujtim Delishi është dënuar përfundimisht me 5 muaj e 10 ditë burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u apeluar në gjykatat e shkallëve më të larta.

3. Kërkuesi Kujtim Delishi ka konstatuar se figuron i dënuar në regjistrin e gjendjes gjyqësore edhe pse kanë kaluar katër vjet nga vuajtja e dënimit. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me kërkesën objekt gjykimi, pasi pretendon që të njihet "i rehabilituar" duke u urdhëruar Zyra e Gjendjes Gjyqësore të pasqyrojë këtë fakt në regjistra duke bërë fshirjen e dënimeve të dhëna ndaj tij. Kërkuesi pretendon se ai plotëson kushtin e përcaktuar nga neni 69, shkronja "a", i Kodit Penal, prandaj kërkon fshirjen e dënimeve nga regjistri gjyqësor. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me kërkesën objekt gjykimi.

4. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me vendimin nr. 7, datë 5.2.2019**, ka vendosur: *"Rrëzimin e kërkesës."*

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka arsyetuar, ndër të tjera, se, në rastin konkret, gjykata vlerëson se kushtet e mësipërme nuk plotësohen në mënyrë kumulative. Kështu, rezulton e provuar se shtetasi Kujtim Delishi është dënuar dy herë brenda 2 vjetëve, duke qenë se me anë të vendimit nr. 55-04, datë 20.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale "Kundërshtim dhe goditja e gjyqtarit", parashikuar nga neni 316 të Kodit Penal. Në përfundim është dënuar me 6 muaj burgim. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me anë të vendimit nr. 402, datë 16.3.2015, ka vendosur mospranimin e ankimit kundër vendimit të mësipërm. Ndërsa, me anë të vendimit nr. 158, datë 30.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, shtetasi Kujtim Delishi është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale "Përndjekja", parashikuar nga neni 121/a/1 i Kodit Penal dhe në përfundim është dënuar me 5 muaj e 10 ditë burgim.

6. Pra, shtetasi Kujtim Delishi, pa kaluar dy vjet nga vendimi i datës 20.1.2014, por edhe pa kaluar dy vjet nga dita e përfundimit të dënimit të dhënë me anë të këtij vendimi, është deklaruar sërish fajtor me anë të vendimit të datës 30.3.2015. Në këto kushte, kur dënimi i dytë i dhënë ndaj kërkuesit është brenda afatit 2-vjeçar të përcaktuar në nenin 69/a të Kodit Penal, kërkuesi nuk mund të konsiderohet i rehabilituar. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkuesi e ka humbur mundësinë që i është ofruar nga ligjvënësi për t'u rehabilituar pasi brenda limiteve kohore, me të cilat neni 69 i Kodit Penal, lidh mundësinë e rehabilitimit, ai është dënuar sërish penalisht me vendim gjyqësor penal të formës së prerë.

7. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi Kujtim Delishi me anë të së cilit ka kërkuar: Ndryshimin e vendimit penal të datës 5.2.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pranimin e kërkesës duke i lënë detyrë Ministrisë së Drejtësisë fshirjen nga sistemi të deklarimit fajtor dhe të quhet "i padënuar", pasi dënimet janë shuar dhe kërkuesi të quhet "i padënuar".

8. **Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 72, datë 25.3.2019,** ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. 7, datë 5.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë."*

9. Gjykata e Apelit Shkodër në lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka arsyetuar, ndërmjet të tjerash, se, nga përmbajtja e kësaj dispozite evidentohen elementet që ligjvënësi ka përcaktuar si kusht për konsiderimin e një shtetasi të dënuar si të rehabilituar nga dënimi penal. Konkretisht, rehabilitimi, vërtetohet kur plotësohen njëherazi rrethanat në vijim:

- i dënuari ka vuajtur dënimin e dhënë (në rastin konkret është 6 muaj burgim);
- ka kaluar afati i parashikuar në ligj, afat i ndryshëm në varësi të masës së dënimit që është caktuar (sa më e gjatë masa e dënimit, aq më e gjatë koha e rehabilitimit);
- nuk vërtetohet kryerja e një tjetër vepre penale gjatë kësaj kohe.

10. Kërkuesi Kujtim Delishi nuk i plotëson këto kritere ligjore, pasi i dënuari mund të rehabilitohet vetëm nëse nuk kryen një tjetër vepër penale gjatë kohës së parashikuar në ligj si kusht për rehabilitimin, duke mos ia njohur këtë të drejtë shtetasve që kryejnë një tjetër vepër penale. Gjatë afatit të paplotësuar dyvjeçar nga koha e vuajtjes së dënimit të parë, ai është dënuar me burgim për një tjetër vepër penale (dënime të cituara më lart). Në këtë mënyrë ai ka humbur të drejtën për t'u konsideruar i rehabilituar.

11. Kundër vendimit nr. 72, datë 25.3.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër, ka paraqitur rekurs më datë 30.3.2019 kërkuesi Kujtim Delishi, me të cilin kërkon: *Ndryshimin e vendimit penal të datës 5.2.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, pranimin e kërkesës sipas objektit të saj duke i lënë detyrë Ministrisë së Drejtësisë, fshirjen nga sistemi të deklarimit fajtor dhe të quhem i padënuar pasi dënimet janë shuar dhe quhem i padënuar.*

12. Në rekurs kërkuesi ka parashtruar, ndër të tjera, këto shkaqe:

- Vendimet e gjykatave janë marrë në kundërshtim me ligjin.
- Me vendimin penal nr. 55-04, datë 20.11.2014, dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin jam dënuar me 6 muaj burgim për veprën penale të goditjes së gjyqtarit, ndërsa me vendimin penal nr. 158, datë 30.3.2015, dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, jam dënuar me 5 muaj e 10 ditë burgim për kryerjen e veprës penale të përndjekjes, sipas nenit 121/1 të Kodit Penal.
- Nga data e vuajtjes së dënimeve kanë kaluar më shumë se 4 vjet e megjithatë unë përsëri figuroj i dënuar.
- Sipas nenit 69 të Kodit Penal, quhen të padënuar me kalimin e dy viteve, personat e dënuar deri në 6 muaj burgim.
- Gjykata duhet të bëjë rehabilitimin e këtyre vendimeve dhe të urdhërojë fshirjen e shënimeve në regjistrin e gjendjes gjyqësore.

13. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), në seancë gjyqësore, konstatoi se ndërmjet Kolegjit Penal[10] dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë[11], si dhe midis gjykatave të rrethit gjyqësor dhe gjykatave administrative ka qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar kërkesat me objekt rehabilitimin e të dënuarit sipas nenit 69 të Kodit Penal. Për këtë arsye, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, me vendimin e datës 18.2.2022, Kolegji vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim me një trup gjykues prej 5 gjyqtarësh, për njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me këto çështje:

1. A përfshihet në fazën e ekzekutimit të vendimit penal procesi i hedhjes së të dhënave, shënimeve dhe heqja e tyre në regjistrin e gjendjes gjyqësore, sipas përcaktimeve të neneve 481–485 të Kodit të Procedurës Penale?

2. Cilit juridiksion i përket kompetenca e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave, për dhënien e informacionit apo për pretendimet eventuale mbi saktësinë e këtij informacioni që përmban regjistri i gjendjes gjyqësore?

3. Kur një person pretendon se plotëson kriteret ligjore për të përfituar nga rehabilitimi, sipas nenit 69 të Kodit Penal, por nuk arrin të realizojë këtë të drejtë, për shkak të refuzimit të shfaqur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, cila është gjykata kompetente që vendos për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje?

4. Si ndikon kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i rehabilitimit të të dënuarit sipas nenit 69 të Kodit Penal?

5. A përbën kryerja e një vepre tjetër penale shkak që subjektit t'i mohohet e drejta për të përfituar nga instituti i rehabilitimit apo kjo përbën shkak vetëm për ndërprerjen e afatit që parashikon neni 69 i Kodit Penal?

14. Në seancë gjyqësore, mbrojtësi i kërkuesit Kujtim Delishi kërkoi nga Kolegji Penal pranimin e rekursit dhe prishjen e prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në lidhje me çështjet e shtruara për njësim, nga mbrojtja e kërkuesit u parashtruan këto argumente:

- Përgjigjja e pyetjes së parë: Procesi i hedhjes së të dhënave e shënimeve dhe heqja e tyre në regjistrin e gjendjes gjyqësore përfshihen në fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Kjo për arsye se kjo zyrë vepron vetëm mbi bazën e vendimeve që i dërgohen nga gjykatat e shkallëve të para, kjo përcaktohet qartë në pikën 2, të nenit 481, të KPP-së dhe kjo zyrë nuk ka asnjë rol tjetër kryesisht për vetëm të kryejë ato detyra të përcaktuara në nenet 481, 482,483 e 484 të KPP-së.

- Përgjigjja e pyetjes së dytë: Lidhur me juridiksionin dhe kompetencat e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore e thënë më sipër që kjo zyrë sipër pikës 1, të nenit 481, të KPP-së ku thuhet, se: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, në zyrën e regjistrit Gjyqësor depozitohen shkurtimet e vendimeve për personat e gjykuar penalisht. Pra kjo është një zyrë depozitimi por gjithmonë i vendimeve të gjykatave për të gjykuarit penalisht. Theksojmë që kjo zyrë ndodhet sot Pranë Drejtorisë Përgjithshme të Burgjeve dhe varet nga drejtori i saj. Kjo në mënyrë të paligjshme pasi zyra duhet të jetë pranë Ministrisë së Drejtësisë.

- Përgjigjja e pyetjes së tretë: kompetente për gjykimin e kërkesave të personave që pretendojnë se plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga rehabilitimi sipas nenit 69 të KP-së duhet të jetë Gjykata Penale e Shkallës së Parë. Kjo është e përcaktuar qartë në nenin 470 të KPP-së ku thuhet se: gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për shqyrtimin e kërkesave e pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij. Mënyra e procedimit është përcaktuar në nenin 471 të KPP-së e vijues.

- Përgjigjja e pyetjes së katërt: Kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i rehabilitimit të dënuarit sipas nenit 69 të KP në këtë dispozitë. Pasi në të gjitha rastet e parashikuara në nenin 69 të KP-së afatet merren nga "dita e vuajtjes së dënimit". Kjo gjë është përcaktuar qartë në kapitullin VIII të Kodit Penal, ku bëhet fjalë: "Shuarja e ndjekjes penale, të dënimeve dhe mosekzekutimit të tyre", nenet 66, 67, 68 dhe 69, 70, 71 e 72 të KP-së".

- Përgjigjja e pyetjes së pestë: kryerja e një vepre tjetër penale subjektit nuk i mohohet e drejta për të përfituar nga rehabilitimi dhe kjo nuk përben as shkak për ndërprerjen e afatit të parashikuar në nenin 69 të KP-së. Në kapitullin VIII të KP-së nuk parashikon pezullimin e afateve.

15. Përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme kërkoi nga Kolegji Penal prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe dërgimin çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

[10] Shih vendimet nr. 94, datë 11.11.2021; nr. 2014-1090, datë 17.4.2014, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

[11] Shih vendimet nr. 2394-2018, datë 4.12.2018; nr. 2018-723, datë 5.6.2018; nr. 2017-556, datë 6.3.2017; nr. 2020-672, datë 9.11.2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si dhe vendimin nr. 2020-39, datë 14.9.2020, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Lezhë. Në lidhje me çështjet e shtruara për njësim u parashtruan këto argumente:

- Përfshirja, nga ana e ligjvënësit, e normave që rregullojnë veprimtarinë e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore në tërësinë e normave që rregullojnë fazën e ekzekutimit të vendimit do të thotë që kjo veprimtari, e cila konsiston në regjistrimin e të dhënave, e shënimeve, në heqjen e tyre në regjistrin e gjendjes gjyqësore, i përket kësaj faze.

- Përfundimisht, pyetjes së parë, duhet t'i përgjigjemi si më poshtë: *"Procesi i hedhjes së të dhënave, shënimeve dhe heqja e tyre në regjistrin e gjendjes gjyqësore, sipas përcaktimeve të neneve 481–485 të Kodit të Procedurës Penale, përfshihet në fazën e ekzekutimit të vendimit penal."*.

- Duhet kuptuar se Zyra e Gjendjes Gjyqësore, nuk është e vetmja ndër institucionet e juridiksionit administrativ që mbart karakteristika funksionale të përziera, shqyrtimi i pretendimeve mbi të cilat, në varësi nga natyra, ndjekin rrugë të ndryshme shqyrtimi. E tillë është Policia e Shtetit, Shërbimet e Policisë Gjyqësore, pra, të strukturave administrative, Shërbimi i Provës, ministri i Drejtësisë në rastet e ekstradimeve etj.

- Përfundimisht, pyetjes së dytë, duhet t'i përgjigjemi si më poshtë: Kompetenca e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore për mbajtjen dhe përpunimin e dhënave, për dhënien e informacionit apo për pretendimet eventuale mbi saktësinë e këtij informacioni që përmban regjistri i gjendjes gjyqësore, i përket respektivisht juridiksionit administrativ apo atij gjyqësor penal, në raport me natyrën e kompetencës, natyrë e cila determinohet nga ligji burimor. Çdo pretendim që afekton aksionin penal të shtetit (ndjekjen penale) ndaj një individi, përbën kompetencë të kësaj zyre që bie në juridiksionin gjyqësor penal.

- Ndërsa rregulli i përgjithshëm i kompetencës është ai i parashikuar në nenin 470, në rastet kur ligjvënësi ka çmuar si kompetente një gjykatë të ndryshme nga ajo e vendit të ekzekutimit, e ka parashikuar atë shprehimisht në dispozitë. Një shembull i tillë është neni 476, në të cilin kompetenca për të shqyrtuar dhe vendosur mbi kërkesën e të dënuarit, të mbrojtësit apo të prokurorit, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, i është njohur gjykatës që ka dhënë vendimin.

- Përfundimisht, pyetjes së tretë, duhet t'i përgjigjemi si më poshtë: *"Kompetenca për zgjidhjen e pretendimeve në lidhje me të drejtën e rehabilitimit, e parashikuar në nenin 69 të Kodit Penal, si një prej rasteve të parashikuar në ligj, bazuar në nenet 470 dhe 480 të Kodit të Procedurës Penale, i takon gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit."*.

- Në interpretim dhe zbatim të kësaj dispozite, një i dënuar do të konsiderohet i rehabilituar (i padënuar), në qoftë se plotësohen njëkohësisht dy kushte: së pari, të ketë kaluar afati i përcaktuar, sipas rastit, në shkronjat "a", "b", "e" ose "e" të nenit 69 të KP-së, që përfaqëson dhe afatin e rehabilitimit, dhe së dyti, gjatë këtij afati, i dënuari, të mos ketë kryer vepër tjetër penale. Duke qenë para domosdoshmërisë së plotësimit në mënyrë kumulative të dy kushteve, mungesa e të paktën njërit prej tyre passjell pamundësinë e përfitimit të së drejtës së rehabilitimit për të dënuarin për veprën e parë brenda kohës së parashikuar në një prej germave të nenit 69 të KPP-së.

- Përfundimisht, pyetjes se katërt, duhet t'i përgjigjemi: *"Kryerja e një vepre tjetër penale, gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i rehabilitimit të të dënuarit sipas nenit 69 të Kodit Penal, çon në pamundësinë e përfitimit të së drejtës së rehabilitimit, brenda afateve të përcaktuara në një prej germave të nenit 69 të K. Penal, për veprën e parë."*

- Në këtë mënyrë, pyetjes së pestë duhet t'i përgjigjemi: *"Kryerja e një vepre tjetër penale, brenda afatit të rehabilimit të parashikuar në nenin 69 të Kodit Penal, do të shërbejë si shkak për humbjen e asaj të drejte brenda atij afati, por jo për humbjen përfundimtare të saj."*

- Përfundimisht, pyetjes së mësipërme duhet t'i përgjigjemi: *"Në rastet kur, brenda afateve të përcaktuara në nenin 69 të K.Penal, nga ana e personit të dënuar, kryhet një vepër tjetër penale, afatet e rehabilitimit për secilën vepër do të fillojnë të llogariten nga data e përfundimit të dënimit të fundit dhe do të ecin paralelisht për secilin dënim."*

- Në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi, vlerësojmë se, të dy vendimet e gjykatave më të ulëta, janë të pavlefshme për shkak të mungesës së arsyetimit i cili, rezulton se është marrë në mungesë të provave të domosdoshme që këto gjykata duhet të administronin për të bërë të mundur një arsyetim sa më të bazuar. Kështu, nga përmbajtja e dispozitës së sipërpërmendur, rezulton se shqyrtimi dhe përllogaritja e afateve bëhet nga dita e përfundimit të dënimit. Ky parashikim ligjor duhet të çonte gjykatat në konkluzionin se, për të arritur në një vendim mbi kërkesën, është e domosdoshme administrimi si provë i datave të përfundimit të dënimeve ose ndryshe i dokumenteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve mbi dinamikat e vuajtjes së dënimeve që përcaktojnë datën e përfundimit të vuajtjes së dënimit.

- Referuar vendimeve të gjykatave, rezulton se arsyetimi i tyre është bërë mbi bazën e datave të disponimit gjyqësor të formës së prerë dhe jo mbi bazën ditës së përfundimit të dënimeve sikurse kërkohet nga neni 69 i KP-së, duke i bërë këto vendime të pavlefshme për shkak të mungesës së arsyetimit, sipas kërkesave të dispozitës së mësipërme, dhe në kuptim të nenit 383/3 të KPP-së.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal

16. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në funksion të gjykimit të çështjes, pranë kësaj Gjykate, vlerëson të

evidentojë faktin e ndryshimeve ligjore që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 41/2021, hyrë në fuqi më datë 29.5.2021. Në nenin 38, të ligjit nr. 41/2021, mbi dispozitat tranzitore, parashikohet se: *"1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë, rregullohen sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre".* Në kuptim të kësaj dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues, si dhe me procedurën e gjykimit, Kolegji Penal mban parasysh parashikimet e ligjit nr. 41/2021, ndërsa, në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit, ato që referojnë te ligji procedural në fuqi në kohën e depozitimit të tij.

17. Kolegji, në shqyrtim të kushteve të pranueshmërisë së rekursit të paraqitur nga kërkuesi Kujtim Delishi, në dhomë këshillimi, konstatoi verifikimin e kushteve formale, të identifikuara në paraqitjen e rekursit, prej palës rekursuese, brenda afatit ligjor të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 435 të KPP-së, si dhe të atyre substanciale, të identifikuara në mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural, sipas përcaktimit të shkronjës "a", të paragrafit të parë, të nenit 432, të KPP-së. Kolegji, në respektim të detyrimit të tij për të shqyrtuar çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs, sikurse përcaktohet në paragrafin e parë të nenit 434 të KPP-së, por pa paragjykuar të drejtën e këtij Kolegji për të vendosur, kryesisht edhe për çështje të ligjit, pavarësisht shkaqeve të paraqitura në rekurs, sikurse përcaktohet në paragrafin e dytë të kësaj dispozite, vendosi kalimin e çështjes për njësim në seancë gjyqësore me trup gjykues të përbërë prej pesë gjyqtarësh.

18. Kolegji Penal, në seancën gjyqësore të datës 18.2.2022, si dëgjoi palët, mbrojtësin e kërkuesit Kujtim Delishi dhe përfaqësuesin e Prokurorisë së Përgjithshme, vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjet e pasqyruara më sipër. Fillimisht, Kolegji çmon me vend të argumentojë se përse lindi nevoja për njësim të praktikës gjyqësore në lidhje me çështjet objekt gjykimi dhe përse janë shtruar pikërisht këto çështje për njësim nga Kolegji.

19. Kolegji vë në dukje se çështjet e shtruara për njësim, pavarësisht numrit të pyetjeve që janë pesë, mund të grupohen në dy nënndarje kryesore;

20. **Së pari**, Kolegji çmon të nevojshme të njësojë praktikën në lidhje me faktin se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar kërkesat e palëve me objekt rehabilitimin e të dënuarit, në rast se kërkuesit nuk i njihet kjo e drejtë nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore. Në lidhje me këtë çështje, lindi nevoja për njësim pasi është evidentuar praktikë jo e njëjtë gjyqësore si ndërmjet Kolegjit Penal dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ashtu edhe midis gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe gjykatave administrative të shkallës së parë.

21. Konkretisht, ndër të tjera, me vendimet nr. 94, datë 11.11.2021, dhe nr. 2014–1090, datë 17.4.2014, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrimin se kompetenca për të shqyrtuar kërkesat në lidhje me rehabilitimin sipas nenit 69 të Kodit Penal i përket gjykatës së rrethit gjyqësor, konkretisht dhomës penale. Në këtë vendim, shkurtimisht Kolegji Penal ka mbajtur këtë qëndrim: *"Kolegji vlerëson se është e vërtetë se konflikti në rastin konkret, që e detyron personin e interesuar/të dënuar që t'i drejtohet gjykatës krijohet pasi një organ i administratës shtetërore, në rastin në shqyrtim Zyra e Gjendjes Gjyqësore si institucion i krijuar që bën shënimet, nuk bën ndryshimet në regjistrin gjyqësor, por, nga interpretimi i përmbajtjes së ligjeve të mësipërme, del shumë qartë se që një person i cili ka pasaktësi në gjendjen gjyqësore të tij, nuk mund të investojë gjykatën administrative pasi nuk mjafton vetëm verifikimi që ai ka vuajtur dënimin, por duhet që të vërtetohet që ai nuk ka kryer vepër tjetër penale për një periudhë kohe të caktuar, ose vepra për të cilën ai është dënuar është shfuqizuar, është revokuar vendimi për shkak të rishikimit etj., kushte të cilat për nga vetë natyra e tyre që lidhen me zbatimin e dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale verifikohen nga gjykata penale.*

Rehabilitimi është një institut i së drejtës penale e si i tillë ai zbatohet nga gjykata penale pasi është një proces i verifikimit të kushteve penale të mosekzistencës më të pasojave të vendimit penal, duke përbërë një akt drejtësie e përmbushje të qëllimit të dënimit penal e risocializimit të të dënuarit. Efekti tipik i rehabilitimit ka të bëjë me aftësinë juridike të shkelësit për t'u rikthyer si rezultat i shkakut shues të dënimit të vuajtur duke e vënë atë në pozitën për të vepruar si para dënimit. Kushtet e caktuara nga neni 69 i KP-së janë kushte që duhen verifikuar në një procedurë të caktuar para një gjykate penale mbi bazën e kërkesës së të interesuarit."

22. Nga ana tjetër, në një sërë vendimesh, Kolegji Administrativ ka mbajtur qëndrimin se kompetenca për të gjykuar në lidhje me sa më sipër i përket gjykatës administrative të shkallës së parë *(vendimi nr. 2018-723, datë 5.6.2018; nr. 2017-556, datë 6.3.2017; nr. 2020-672, datë 9.11.2020, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë)*, ndërsa në ndonjë rast tjetër, si vendimi nr. 2394-2018, datë 4.12.2018, i Kolegjit Administrativ është mbajtur qëndrimi se kjo çështje i përket gjykatës së rrethit gjyqësor, dhomës penale.

23. Qëndrimi i Kolegjit Administrativ në vendimmarrjet e mësipërme, kur ka disponuar se gjykata kompetente për çështjen është gjykata administrative, mund të përmblidhet në këtë mënyrë: *"Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë çmon se mosmarrëveshja në shqyrtim është e natyrës administrative. Referuar objektit dhe shkakut ligjor të padisë rezulton se nuk ndodhemi përpara një mosmarrëveshje juridiko – penale (e quajtur penalo – administrative në praktikën e gjykatave shqiptare),*

por përpara një padie, përmes së cilës kërkohet detyrimi i organit publik për të kryer një veprim administrativ, siç parashikohet në ligjin nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Sipas nenit 17, shkronja "ç" të këtij ligji, "Padia mund të ngrihet: (ç) për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë;". Pra, kompetencën e shqyrtimit të çështjes, objekt gjykim, apo të rasteve të tjera analoge, për të detyruar organin publik të veprojë në raste të tilla, e kanë gjykatat administrative."

24. Gjithashtu, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 00-2017-556, datë 16.3.2017, ka mbajtur këtë qëndrim: *"Çështja objekt shqyrtimi, ka në thelb të saj shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje të natyrës administrative. Referuar objektit dhe shkakut ligjor të padisë, kërkimi i paditësit lidhet me ndryshimin e aktit administrativ vërtetim i gjendjes gjyqësore. Mosmarrëveshja objekt shqyrtimi, është pasojë/rrjedhojë e kundërshtimit të një akti administrativ të lëshuar nga organet shtetërore, i cili është produkt i vullnetit të organit publik shtetëror. Për rrjedhojë, mosmarrëveshja objekt shqyrtimi është mosmarrëveshje administrative, gjykimi i së cilës, i nënshtrohet rregullimeve të parashikuara në ligjin nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".*

Në kushtet kur çështja objekt shqyrtimi, i përket parashikimit ligjore të përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr. 49/2013, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", pika "a", e cila përcakton: Gjykatat administrative janë kompetente për: a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik, kjo çështje është e natyrës administrative dhe si e tillë, është në kompetencën lëndore të gjykatave administrative."

25. Gjithashtu, Kolegji Civil, në vendimin nr. 00-2010-1035, datë 25.6.2010, ka mbajtur qëndrimin se kompetenca për të vendosur në lidhje me kërkesëpadinë për rehabilitimin e të dënuarit i përket gjykatës civile, prandaj e ka gjykuar në themel mosmarrëveshjen objekt gjykimi.

26. Në këtë drejtim, Kolegji Penal çmon se lind domosdoshmëria që të njësohet praktika gjyqësore në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar kërkesat e palëve me objekt rehabilitimin e të dënuarit, në rast se kërkuesit nuk i njihet kjo e drejtë nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, çështje që është zbërthyer në tri pyetjet e para të shtruara për njësim. Një detyrë e tillë lind për Kolegjin, në kuadër të ushtrimit prej Gjykatës së Lartë të rolit të saj thelbësor kushtetues, sikurse është roli nomofilatik mbi zhvillimin, njësimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore, për shkak të funksionit të saj si gjykatë ligji.

27. **Së dyti**, Kolegji konstaton se e paqartë dhe jo uniforme është praktika gjyqësore edhe në lidhje me zbatimin në thelb të nenit 69 të Kodit Penal që trajton institutin e rehabilitimit të të dënuarit. Për këtë arsye, Kolegji vendosi që të njësojë praktikën gjyqësore edhe në lidhje me dy pyetjet e tjera të shtruara për njësim, konkretisht në lidhje me çështjen se a ndikon kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i rehabilitimit të të dënuarit sipas nenit 69 të Kodit Penal, dhe nëse po, si ndikon ajo? A përbën kryerja e një vepre tjetër penale shkak që subjektit t'i mohohet përfundimisht e drejta për të përfituar nga instituti i rehabilitimit apo kjo përbën shkak vetëm për ndërprerjen e afatit që parashikon neni 69 i Kodit Penal?

28. Si trajtoi arsyet pse vendimmarrja e Kolegjit në lidhje me çështjet e mësipërme duhet të shërbejë si vendimmarrje njësuese, Kolegji do të ndalet në trajtimin me radhë të çështjeve objekt njësimi. Pasi të trajtojë çështjet e shtuara për njësim të praktikës gjyqësore, Kolegji do të shprehet edhe në lidhje me çështjen objekt gjykimi, referuar kërkesës konkrete të kërkuesit Kujtim Delishi.

29. Fillimisht Kolegji ndalet në trajtimin e pyetjes së parë të shtruar për njësim: ***A përfshihet në fazën e ekzekutimit të vendimit penal procesi i hedhjes së të dhënave, shënimeve dhe heqja e tyre në regjistrin e gjendjes gjyqësore, sipas përcaktimeve të neneve 481–485 të Kodit të Procedurës Penale?***

30. Në vendimet e sipërcituara, Kolegji Penal ka arsyetuar, ndër të tjera, se ligji material penal, pikërisht neni 69 i Kodit Penal, ka përcaktuar se kur një person do të konsiderohet i padënuar/rehabilituar, në raport me kohëzgjatjen e dënimit, me kushtin që gjatë një periudhe kohore të caktuar në vazhdim të mos kryejë vepër tjetër penale. Nga ana tjetër, krahas parashikimit të nenit 69 të Kodit Penal, është miratuar dhe një ligj i posaçëm që është ligji nr. 9614, datë 2.9.2006, "Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore" dhe aktet nënligjore në bazë e për zbatim të këtij ligji. Sipas këtij ligji Zyra e Gjendjes Gjyqësore është institucioni i posaçëm që bën shënimet, hedhjen e të dhënave, ruajtjen e tyre, kryerjen e veprimeve në regjistrin e gjendjes gjyqësore sipas përcaktimeve të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

31. Kolegji vë në dukje se rehabilitimi i të dënuarit rregullohet nga dispozita penale materiale (Kodi Penal) dhe njëkohësisht procedurale (Kodi i Procedurës Penale), si dhe nga ligje të posaçme.

32. Neni 69 i Kodit Penal parashikon: *"Quhen të padënuar:*

a) ata që janë dënuar me burgim për një kohë gjer në gjashtë muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që gjatë dy vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;

b) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet dhe që gjatë pesë vjetëve nga dita e vuajtjes së

dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;

c) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga pesë gjer në dhjetë vjet dhe që gjatë shtatë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;

ç) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga dhjetë gjer në njëzet e pesë vjet dhe që gjatë dhjetë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale."

33. Nga ana tjetër, gjendja gjyqësore rregullohet nga nenet 481–485 të Kodit të Procedurës Penale:

Neni 481 i KPP-së parashikon: *"1. Pranë Ministrisë së Drejtësisë, në zyrën e regjistrit gjyqësor, depozitohen shkurtimet e vendimeve për personat e gjykuar penalisht.*

2. Gjykata e shkallës së parë dërgon në zyrën e regjistrit gjyqësor shkurtimin e vendimit të dënimit brenda 10 ditëve nga data që vendimi merr formë të prerë, kur ndaj tij nuk ushtrohet ankim dhe brenda 10 ditëve nga data e mbërritjes së akteve, kur ndaj vendimit është ushtruar ankim."

34. Neni 482 parashikon se cilat vendime regjistrohen në regjistrin gjyqësor, ndërsa neni 483 i KPP-së rregullon heqjen e shënimeve në regjistrin e gjendjes gjyqësore[12]. Nga ana tjetër, neni 484 parashikon subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë dhe marrin vërtetimin e gjendjes gjyqësore. Këto janë dispozitat procedurale të KPP-së që rregullojnë gjendjen gjyqësore dhe veprimtarinë e zyrës së gjendjes gjyqësore, për të cilën Kodi parashikon që krijohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë.

35. Gjithashtu, Zyra e Gjendjes Gjyqësore rregullohet dhe funksionon sipas një ligji të posaçëm që është ligji nr. 9614, datë 21.9.2006, "Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore". Ky ligj ka për objekt përcaktimin e rregullave për administrimin e regjistrit të gjendjes gjyqësore nëpërmjet rrugës elektronike. Neni 3 i këtij ligji përcakton: *"1. Zyra e Gjendjes Gjyqësore funksionon në Ministrinë e Drejtësisë. Organizimi dhe struktura e saj miratohen nga ministri i Drejtësisë. 2. Zyra e Gjendjes Gjyqësore mban dhe përpunon të dhënat në regjistrin themeltar elektronik të gjendjes gjyqësore, në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore, si dhe në regjistrin shkresor të gjendjes gjyqësore."* Sipas përmbajtjes së kësaj dispozite, rezulton se Zyra e Gjendjes Gjyqësore është organi publik, i ngarkuar me ligj, për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave në regjistrin themeltar elektronik të gjendjes gjyqësore, në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore, si dhe në regjistrin shkresor të gjendjes gjyqësore.

36. Ligji përcakton kompetencat e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore. Neni 4 i ligjit përcakton se Zyra e Gjendjes Gjyqësore kryen përpunimin automatik të të dhënave në regjistrin themeltar elektronik dhe në regjistrin elektronik. Gjithashtu, zyra ka kompetencë të kryejë hedhjen e të dhënave, ruajtjen e tyre, kryerjen e veprimeve logjike mbi këto të dhëna, mbrojtjen nga ndryshimet, marrjen dhe shpërndarjen e tyre nëpërmjet niveleve të sigurisë, kryerjen e shënimeve dhe heqjen e tyre. Gjithashtu, referuar dispozitave në vijim të ligjit, neni 5 e vijues, rezulton se zyra ka kompetencë të administrojë regjistrin e gjendjes gjyqësore, të kryejë shpërndarjen e certifikatave elektronike dhe shkresore, dhënien e aksesit institucioneve kompetente dhe informacionit në lidhje me regjistrin e gjendjes gjyqësore.

37. Pasi u trajtuan kompetencat që ka Zyra e Gjendjes Gjyqësore, për t'iu përgjigjur pyetjes nëse këto veprime, që ligji ia ngarkon Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, bëjnë pjesë në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, është e nevojshme të trajtohet koncepti i ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

38. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore rregullohet nga neni 462 e vijues i KPP-së. Gjithashtu, ekzekutimi rregullohet nga ligji nr. 79/2020, "Për ekzekutimin e vendimeve penale". Me ekzekutim të vendimit penal kuptohet vënia në ekzekutim e një vendimi gjyqësor penal të formës së prerë dhe vendimeve penale që ekzekutohen menjëherë, sipas nenit 462/2 të KPP-së[13]. Kodi i Procedurës Penale dhe ligji i posaçëm nr. 79/2020 ngarkon prokurorin si subjektin përgjegjës për ekzekutimin e vendimit. Prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin merr masa për ekzekutimin e vendimit. Ai bën kërkesa në gjykatën kompetente dhe ndërhyn në të gjitha veprimet e ekzekutimit.

39. Sipas nenit 11 të ligjit nr. 79/2020, prokurori merr masa dhe vë në lëvizje procedurën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal dhe, në mbështetje të neneve 463 dhe 468 të Kodit të Procedurës Penale, procedon vetë ose urdhëron organet e tjera për vënien në ekzekutim të vendimit, sipas këtij ligji. Prokurori mban dosje të veçantë për ekzekutimin e vendimit dhe për të gjitha aktet e administruara gjatë ekzekutimit. Urdhri i ekzekutimit është

[12] *1. Shënimet në regjistër hiqen pas marrjes së njoftimit zyrtar të vdekjes së personit, të cilit i referohen kur ai bëhet tetëdhjetë vjeç.*

2. Hiqen edhe shënimet lidhur me:

a) vendimet e revokuara për shkak të rishikimit ose të shfuqizimit të veprës penale;

b) vendimet e pafajësisë ose të pushimit kur kanë kaluar dhjetë vjet nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë;

c) vendimet e dënimit për kundërvajtje kur është dhënë dënimi me gjobë, me kalimin e dhjetë vjetëve nga dita kur vendimi është ekzekutuar.

ç) masat dhe vendimet e dënimit për kundërvajtje penale të kryera nga të miturit, kur ata arrijnë moshën 21 vjeç."

[13] *"Vendimi i pafajësisë, i përjashtimit të të gjykuarit nga dënimi dhe ai i pushimit të çështjes, vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes."*

akti procedural që nxjerr prokurori për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor penal. Neni 12 i ligjit parashikon elementet që përmban urdhri i ekzekutimit të vendimit penal. Ligji përcakton se urdhri i ekzekutimit nxirret nga prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin e dënimit. Në rastin e të miturve, urdhri i ekzekutimit nxirret nga prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë në të cilën është ngritur seksioni për të mitur.

40. Ligji i posaçëm nr. 79/2020, "Për ekzekutimin e vendimeve penale" përmban rregulla specifike për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale. Ligji parashikon se, si rregull, vendimet penale ekzekutohen kur marrin formë të prerë, ndërsa përjashtimisht ligji parashikon rregulla specifike për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimeve penale. Ligji përcakton rregulla për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë dhe dënimeve alternative. Rregullat specifike nuk do të trajtohen në mënyrë të detajuar nga Kolegji Penal, pasi ato nuk janë fokusi i pyetjes së parë të shtuar për njësim.

41. Vlen për t'u theksuar që vendimi penal përfundon ekzekutimin kur i dënuari përmbush të gjitha detyrimet që përmbahen në vendim, cilado qoftë mënyra e disponimit të gjykatës apo mënyra e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Në rast se i dënuari është dënuar me dënim me burgim, me përfundimin e vuajtjes së dënimit me burgim përfundon dhe faza e ekzekutimit të vendimit penal. Dënimi me burgim vlerësohet i plotësuar dhe i dënuari lirohet kur përfundon kryerjen e dënimit, i falet dënimi i mbetur, amnistohet vepra penale apo dënimi i mbetur ose lirohet me vendim gjykate. Me një nga këto forma përfundon edhe faza e ekzekutimit të vendimit penal për dënimin me burgim. Ligji parashikon rregulla edhe për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që përmbajnë dënim alternativ, duke përcaktuar rregullim specifik për secilin prej dënimeve alternative. Pikërisht nga momenti që i burgosuri lirohet dhe i dënuari shlyen përfundimisht çdo dënim të dhënë ndaj tij, përfundon faza e ekzekutimit të vendimit penal dhe fillon llogaritja e afateve të përfitimit nga instituti i rehabilitimit ligjor, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

42. Ligji nr. 79/2020 parashikon dhe një sërë organesh të tjera të ngarkuara me detyra specifike gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor si Policinë e Shtetit, Shërbimin Përmbarimor, Shërbimin e Provës, Agjencinë e Administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, organet shtetërore dhe persona të tjerë juridikë. Vlen për t'u theksuar që Zyra e Gjendjes Gjyqësore nuk bën pjesë në organet që ligji i ngarkon me detyra specifike gjatë ekzekutimit të vendimit gjyqësor apo që kanë detyrë për të bashkëpunuar me prokurorin gjatë kësaj faze.

43. Nga leximi i dispozitave të ligjit nr. 79/2020 arrihet në përfundimin se asnjëri prej veprimeve ligjore që është ngarkuar të kryejë prokurori i ekzekutimit nuk lidhet apo ndërhyn në veprimtarinë e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore që është një organizëm që ushtron funksionet pranë Ministrisë së Drejtësisë sipas ligjit të posaçëm në bazë të së cilit vepron, i cili nuk ka lidhje, varësi dhe as jep llogari për veprimtarinë e tij te prokurori.

44. Në këtë linjë arsyetimi, procesi i përpunimit të të dhënave nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore në lidhje me pasqyrimin e fakteve që provojnë faktin e qenies i dënuar apo i rehabilituar të subjektit që e pretendon, nuk i përket fazës së ekzekutimit të vendimit penal. Vendimi penal që ka disponuar me dënim me burgim, përfundon ekzekutimin kur i dënuari përfundon vuajtjen e dënimit me burgim. Gjithashtu, dënimet e tjera alternative përfundojnë ekzekutimin kur i dënuari përmbush të gjitha detyrimet që përmban vendimi gjyqësor. E drejta e të dënuarit për t'u konsideruar i rehabilituar në lidhje me dënimin e dhënë nuk është një fazë që i përket ekzekutimit të vendimit penal. Kjo e drejtë subjektit i lind më pas në kohë, jo vetëm pasi ka përfunduar faza e ekzekutimit të vendimit gjyqësor ndaj të cilit ai pretendon se është rehabilituar, por veçanërisht pasi plotësohen kushtet që kërkon neni 69 i Kodit Penal. Me këtë logjikë arsyetimi, Kolegji arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit në lidhje me të drejtën e rehabilitimit, si dhe vendimmarrja e organit kompetent në lidhje me këtë pretendim nuk përfshihet në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

45. Megjithatë, pavarësisht këtij konstatimi, fakti që ushtrimi i kompetencave të dhëna me ligj nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore nuk i përket fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal, në vlerësim të Kolegjit, nuk kushtëzon dhe as përbën një faktor përcaktues për kompetencën lëndore të gjykatës që do të shqyrtojë kërkesat e palëve në lidhje me të drejtën për rehabilitim, në paraprirje të pyetjes së tretë të shtruar për njësim prej Kolegjit. Kolegji do të elaborojë këtë qëndrim në vijim, në përgjigje të çështjeve të tjera të shtruara për njësim. Në përfundim të linjës së mësipërme të arsyetimit, Kolegji vendos që në përgjigje të çështjes së parë të shtruar për njësim, të mbajë këtë qëndrim:

I. Procesi i hedhjes së të dhënave, shënimeve dhe heqja e tyre në regjistrin e gjendjes gjyqësore, sipas përcaktimeve të neneve 481-485 të Kodit të Procedurës Penale nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore nuk përfshihet në fazën e ekzekutimit të vendimit penal.

46. Në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për njësim, Kolegji çmon të nevojshme të evidentojë fillimisht kompetencat e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore referuar dispozitave të KPP-së dhe ligjit të posaçëm. Ashtu siç u trajtua më sipër, nenet 481-485 të KPP-së trajtojnë gjendjen gjyqësore. Neni 481 i KPP-së parashikon se pranë Ministrisë së Drejtësisë, në zyrën e regjistrit gjyqësor, depozitohen shkurtimet e vendimeve për personat e gjykuar

penalisht. Gjykata e shkallës së parë dërgon në zyrën e regjistrit gjyqësor shkurtimin e vendimit të dënimit brenda 10 ditëve nga data që vendimi merr formë të prerë, kur ndaj tij nuk ushtrohet ankim dhe brenda 10 ditëve nga data e mbërritjes së akteve, kur ndaj vendimit është ushtruar ankim.

47. Neni 482 i KPP-së parashikon se cilat vendime regjistrohen në regjistrin gjyqësor, ndërsa neni 483 i Kodit rregullon heqjen e shënimeve në regjistrin e gjendjes gjyqësore[14]. Nga ana tjetër, neni 484 parashikon subjektet që kanë të drejtë të kërkojnë dhe marrin vërtetimin e gjendjes gjyqësore. Këto janë dispozitat procedurale të KPP-së që rregullojnë gjendjen gjyqësore dhe veprimtarinë e zyrës së gjendjes gjyqësore, për të cilën Kodi parashikon që krijohet dhe funksionon pranë Ministrisë së Drejtësisë.

48. Gjithashtu, Zyra e Gjendjes Gjyqësore rregullohet dhe funksionon sipas një ligji të posaçëm që është ligji nr. 9614, datë 21.9.2006, "Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore". Ky ligj përcakton rregullat për administrimin e regjistrit të gjendjes gjyqësore nëpërmjet rrugës elektronike. Zyra e Gjendjes Gjyqësore funksionon në Ministrinë e Drejtësisë. Organizimi dhe struktura e saj miratohen nga ministri i Drejtësisë. Sipas nenit 3 të ligjit Zyra e Gjendjes Gjyqësore mban dhe përpunon të dhënat në regjistrin themeltar elektronik të gjendjes gjyqësore, në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore, si dhe në regjistrin shkresor të gjendjes gjyqësore. Zyra e Gjendjes Gjyqësore është organi publik, i ngarkuar me ligj, që ka kompetencë mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave në regjistrin themeltar elektronik të gjendjes gjyqësore, në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore, si dhe në regjistrin shkresor të gjendjes gjyqësore.

49. Kompetencat e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore janë të përcaktuara me ligjin e mësipërm. Neni 4 i ligjit përcakton se Zyra e Gjendjes Gjyqësore kryen përpunimin automatik të të dhënave në regjistrin themeltar elektronik dhe në regjistrin elektronik. Gjithashtu, zyra ka kompetencë të kryejë hedhjen e të dhënave, ruajtjen e tyre, kryerjen e veprimeve logjike mbi këto të dhëna, mbrojtjen nga ndryshimet, marrjen dhe shpërndarjen e tyre nëpërmjet niveleve të sigurisë, kryerjen e shënimeve dhe heqjen e tyre. Gjithashtu, referuar dispozitave në vijim të ligjit, neni 5 e vijues, rezulton se zyra ka kompetencë të administrojë regjistrin e gjendjes gjyqësore, të kryejë shpërndarjen e certifikatave elektronike dhe shkresore, dhënien e aksesit institucioneve kompetente dhe informacionit në lidhje me regjistrin e gjendjes gjyqësore.

50. Një prej kompetencave që ligji i ka përcaktuar Zyrës së Gjendjes Gjyqësore është përpunimi automatik i të dhënave. Në kuptim të ligjit ky përpunim përfshin operacionet e hedhjes së të dhënave në regjistrin themeltar elektronik vetëm nga punonjësi i autorizuar, duke garantuar ruajtjen e të dhënave, kryerjen e veprimeve logjike dhe/ose aritmetike mbi këto të dhëna, marrjen e tyre nga institucionet përkatëse, gjykata e prokuroria dhe kalimin e këtyre të dhënave në regjistrin elektronik. Gjithashtu, ligji i ngarkon Zyrës kompetencën e administrimit të regjistrit të gjendjes gjyqësore, i cili përbëhet nga regjistri shkresor i gjendjes gjyqësore, regjistri themeltar elektronik i gjendjes gjyqësore dhe regjistri elektronik i gjendjes gjyqësore.

51. Nga leximi dhe interpretimi i dispozitave të KPP-së dhe ligjit të posaçëm, arrihet në përfundimin se Zyra e Gjendjes Gjyqësore është organ i administratës publike, i krijuar dhe që funksionon në bazë të një ligji të posaçëm dhe që ka kompetencë mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave në regjistrin themeltar elektronik të gjendjes gjyqësore, në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore, si dhe në regjistrin shkresor të gjendjes gjyqësore. Tërësia e këtyre kompetencave që organi administrativ ushtron në bazë të ligjit mund të përbëjë shkak për lindje të mosmarrëveshjeve, në eventualitetin e ngritjes së pretendimeve në lidhje me këtë veprimtari. Në rast se individi ka pretendime në lidhje me ushtrimin e këtyre kompetencave nga organi administrativ, Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ai ka të drejtë t'i drejtohet me padi gjykatës administrative, duke kundërshtuar veprimtarinë e organit administrativ, në lidhje me mbajtjen apo përpunimin e të dhënave apo kompetencave të tjera që ligji i ngarkon Zyrës.

52. Gjykata kompetente për shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në drejtim të veprimtarisë së organit publik, Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, në lidhje me hedhjen e të dhënave në regjistër, mbajtjen e tyre, heqjen e të dhënave, regjistrimin e vendimeve gjyqësore, si dhe përpunimin e këtyre të dhënave do të jetë gjykata administrative e shkallës së parë ku ka qendrën organi administrativ, veprimi administrativ i të cilit kundërshtohet. Një përfundim i tillë arrihet po të marrim në konsideratë që objekti i mosmarrëveshjes është pikërisht veprimtaria e organit administrativ, në kuadër të ushtrimit të kompetencave që i cakton ligji.

---

[14] *1. Shënimet në regjistër hiqen pas marrjes së njoftimit zyrtar të vdekjes së personit, të cilit i referohen kur ai bëhet tetëdhjetë vjeç.*
2. Hiqen edhe shënimet lidhur me:
a) vendimet e revokuara për shkak të rishikimit ose të shfuqizimit të veprës penale;
b) vendimet e pafajësisë ose të pushimit kur kanë kaluar dhjetë vjet nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë;
c) vendimet e dënimit për kundërvajtje kur është dhënë dënimi me gjobë, me kalimin e dhjetë vjetëve nga dita kur vendimi është ekzekutuar;
ç) masat dhe vendimet e dënimit për kundërvajtje penale të kryera nga të miturit, kur ata arrijnë moshën 21 vjeç."

53. Në kushtet kur kryerja e veprimeve nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore brenda sferës së kompetencave që i jep ligji; mbajtje dhe përpunim të dhënash është veprimtari tipike administrative edhe pretendimet eventuale në lidhje me këtë veprimtari i përkasin juridiksionit gjyqësor administrativ. Gjykata administrative e shkallës së parë do të shqyrtojë ligjshmërinë e veprimtarisë administrative të Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, duke disponuar në lidhje me pretendimet eventuale të palës paditëse.

54. Kolegji vlerëson të theksojë se kur flasim për ushtrim të veprimtarisë administrative, në kuadër të kompetencave që i jep ligji, duhet mbajtur në konsideratë që këtu nuk përfshihet njohja e së drejtës për t'u konsideruar i rehabilituar, si e drejtë penale materiale. Nga tërësia e kompetencave që ligji i ngarkon Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, kompetencat që u detajuan më sipër, konstatohet se njohja e së drejtës për t'u quajtur i rehabilituar nuk përfshihet në sferën e kompetencave ligjore që ligji i posaçëm dhe KPP-ja i ngarkon Zyrës së Gjendjes Gjyqësore. Kompetencat e Zyrës si hedhje të dhënash, përpunimi dhe ruajtja e tyre, kryerja e veprimeve logjike mbi këto të dhëna, mbrojtja nga ndryshimet, marrja, shpërndarja e tyre nëpërmjet niveleve të sigurisë, kryerjen dhe heqja e shënimeve nuk përfshijnë njohjen e së drejtës për t'u quajtur i rehabilituar. Ndërsa kundërshtimi i veprimtarisë administrative të organit administrativ dhe pretendimet eventuale mbi këtë veprimtari dhe mbi saktësinë e këtij informacioni i përkasin juridiksionit gjyqësor administrativ, konkretisht gjykatës administrative të shkallës së parë, të territorit të Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, veprimtaria e së cilës kundërshtohet.

55. Në këtë linjë arsyetimi, në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për njësim, Kolegji vendos të mbahet ky qëndrim njësues:

II. Kompetenca e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave, për dhënien e informacionit apo për pretendimet eventuale mbi saktësinë e këtij informacioni që përmban regjistri i gjendjes gjyqësore i përket juridiksionit gjyqësor administrativ.

56. Në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për njësim, se, referuar pretendimeve të personit që pretendon se plotëson kriteret ligjore për të përfituar nga rehabilitimi, sipas nenit 69 të Kodit Penal, por nuk arrin të realizojë këtë të drejtë, për shkak të refuzimit të shfaqur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar këto pretendime, Kolegji vlerëson se ajo që ndan juridiksionin është natyra dhe lënda e pretendimeve që ngre subjekti që lidhje me veprimtarinë e gjendjes gjyqësore. Kolegji çmon të theksojë se thelbi i pyetjes së tretë, të shtruar për njësim lidhet me faktin se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar kërkesën e palës që pretendon të drejtën e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal, por kjo e drejtë i është refuzuar nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore?

57. Kolegji vlerëson të nevojshëm rikonfirmimin e qëndrimit se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Ky Kolegj thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejtë *(shih vendimin nr. 917, datë 11.5.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).*

58. Kompetenca lëndore është një parakusht procedural, i cili determinon konceptin e gjykatës së krijuar me ligj. "Gjykata e krijuar me ligj" është pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar edhe nga neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "KEDNJ"). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka trajtuar kuptimin e "gjykatës së krijuar me ligj" duke përcaktuar se në kuadër të procesit të rregullt ligjor gjykatat gjithmonë duhet të jenë të krijuara me ligj. Kjo shprehje pasqyron parimin e shtetit të së drejtës që është pjesë e pandarë e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut parashikuar nga KEDNJ-ja dhe protokollet e saj.[15] Një organ i pakrijuar me ligj, do të privohej nga legjitimiteti i kërkuar në një shoqëri demokratike për të dëgjuar ankesat e individëve.[16]

59. Termi "ligj", në kuptim të nenit 6/1 të KEDNJ-së, sipas jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), përfshin, në veçanti, jo vetëm legjislacionin që përcakton krijimin dhe funksionimin (kompetencën) e organeve gjyqësore por edhe çdo dispozitë ligjore të legjislacionit të brendshëm që, nëse shkelet, do ta shndërronte pjesëmarrjen e një ose më shumë gjyqtarëve në shqyrtimin e një çështje konkrete në një

[15] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Jorgic k. Gjermanisë,* nr. aplikimi 74613/01, datë 12.7.2007, paragrafi i 64; *Richert kundër Polonisë,* nr. aplikimi 54809/07, datë 25.1.2012, paragrafi 41;

[16] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Lavents v Latvia,* nr. aplikimi 58422/00, datë 28.2.2003 paragrafi 114; *Gorgiladze kundër Gjerogjisë,* nr. aplikimi 4313/04, datë 20.10.2009 paragrafi 67; *Kontalexis kundër Greqisë,* nr. aplikimi 59000/08, datë 21. 11. 2011, paragrafi 38.

pjesëmarrje të paligjshme.[17] Shprehja "e caktuar me ligj" përfshin bazën ligjore për ekzistencën e gjykatës, pajtueshmërinë e veprimtarisë së gjykatës me normat e veçanta që rregullojnë veprimtarinë e saj, si dhe përbërja (kompozimi) i gjykatës në çdo rast që ajo merr në shqyrtim.[18]

60. Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese evropiane, ndër vite, kanë përpunuar disa kritere themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash, gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete[19] dhe ky është rregulli i përgjithshëm se si një gjykatë e zakonshme merr juridiksion dhe kompetencë për çështjet. Megjithëse në të drejtën pozitive procedurale penale në fuqi në Republikën e Shqipërisë nuk parashikohet në mënyrë eksplicite parimi i gjyqtarit natyral të çështjes, dispozitat ligjore në frymën e tyre, parimet kushtetuese dhe sidomos jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka pranuar se rendi juridik një ndër elementet kryesore të gjykatës së caktuar me ligj ka standardin e gjyqtarit natyral, standard[20] i cili është, nga ana tjetër, edhe e drejtë themelore e individit. Qëllimi i krijimit dhe mbrojtjes kushtetuese të kësaj figure shtetërore është te nevoja për të qenë tej çdo dyshimi dhe mundësie e paanshme përgjatë gjithë procesit gjyqësor. Nëpërmjet këtij parimi dhe kësaj figure ligjore të autoritetit shtetëror kompetent për të zgjidhur një mosmarrëveshje shteti i së drejtës siguron garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nëpërmjet një gjyqtari kompetent, të pavarur dhe të paanshëm.

61. Kjo do të thotë se në momentin kur çdo subjekt është bërë titullar i një procesi gjyqësor dhe përballë tij shteti ka caktuar një gjyqtar apo trupë gjykuese, që në kohën dhe momentin e caktimit ka marrë juridiksion dhe kompetencë, çdo lloj kompetence, në bazë dhe për zbatim të ligjit, ka garancinë e akteve të gjithëpushtetshme juridike se nuk do të ketë mundësi që ky gjyqtar apo trupë gjykuese të spostohet, ndryshohet *(translatio iudicii)* apo të shndërrohet më vonë *ex ante factum* në gjykatë/gjyqtar pa juridiksion ose jokompetent. Bëjnë përjashtim këtu rastet kur gjykata suprimohet dhe nuk ekziston më apo kur Kushtetuta, marrëveshja ndërkombëtare apo ligji me shumicë të cilësuar, për arsye objektive dhe reformuese të institucioneve të drejtësisë, urdhërojnë në mënyrë eksplicite nëpërmjet dispozitave tranzitore ndryshe *(shih vendimin njësues nr. 00-2018-148, datë 4.4.2018 dhe nr. 23, datë 27.7.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).*

62. Qëndrimi i konsoliduar jo vetëm i Kolegjit Penal, por i Gjykatës së Lartë në tërësi, është që kompetenca lëndore e gjykatës përcaktohet nga natyra e mosmarrëveshjes, nga lënda e së drejtës që pretendohet dhe jo nga subjektet pjesëmarrës në gjykim. Fakti që një nga palët në mosmarrëveshje është organ i administratës publike nuk do të thotë që mosmarrëveshja që lind me këtë organ i përket automatikisht gjykatës administrative, kur në thelb e drejta që pretendon pala i përket një lënde të caktuar, civile ose penale.

63. Kolegji Civil ka mbajtur qëndrimin se kompetenca lëndore e një mosmarrëveshje i referohet objektit të gjykimit, natyrës së konfliktit që përmban ajo, pra lëndës së gjykimit dhe jo palëve ndërgjyqëse. Fakti që palë e paditur në këtë mosmarrëveshje është organ i administratës publike nuk kondicionon natyrën e mosmarrëveshjes dhe as përcakton kompetencën lëndore të gjykatës. Karakteristikat e subjektit që kryen cenimin, subjekt privat apo organ i administratës publike, nuk ndryshojnë natyrën e mosmarrëveshjes. Nëse do të përcaktohej kompetenca lëndore e gjykatës referuar palës së paditur, atëherë do të kishim një përcaktim artificial të kompetencës lëndore, duke bërë që ajo të vlerësohej si administrative sa herë që palë e paditur do të ishte një organ i administratës publike, pavarësisht natyrës civile të mosmarrëveshjes. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se padia objekt gjykimi është në thelb një padi mohuese, ku pala paditëse kërkon nga pala e paditur pushimin e cenimit në të drejtën e tij të pronësisë. Kjo padi i përket lëndës të së drejtës civile pavarësisht natyrës që ka pala e paditur në këtë gjykim. *(shih vendimin e Kolegjit Civil nr. 00-2020- 627, datë 11.11.2020)*

64. Ashtu siç ka mbajtur qëndrim Kolegji Administrativ, për të përcaktuar natyrën e një mosmarrëveshje nuk mjafton që gjykatat të identifikojnë vetëm atë që shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë apo, e thënë ndryshe, kërkimin *prima facie* të saj. Ato duhet të shqyrtojnë më tej faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve. Vetëm pas analizimit me kujdes të kërkimeve të padisë, të së drejtës subjektive të pretenduar si të shkelur dhe të

[17] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Pandjikidzeandothers kundër Gjeorgjisë,* nr. aplikimi 30323/02, datë 27.1.2010, paragrafi 104.

[18] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Posokhov k. Rusisë,* nr. aplikimi 63486/00, datë 4.6.2003, paragrafi 39; *Fatullayev k. Azerbaizhanit,* nr. aplikimi 40984/07, datë 4.10.2010, paragrafi 144.

[19] Shiko vendimin nr. 31, datë 5.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

[20] Shiko vendimin nr. 31, datë 5.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

faktit të paligjshëm që pretendohet ta ketë shkelur këtë të drejtë subjektive, si dhe pas ballafaqimit të tyre me dispozitat e së drejtës objektive, gjykata mund të arrijë në një përfundim të saktë mbi natyrën e mosmarrëveshjes (*shih vendimin nr. 112, datë 8.6.2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

65. Përgatitja dhe gjykimi e zgjidhja e çështjes nuk mund të bazohet vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen "objekti i padisë" dhe "baza ligjore" e saj. Gjykata kur zgjidh mosmarrëveshjen merr në shqyrtim pretendimet e paditësit të cilat parashtrohen në kërkesëpadi, si dhe gjatë ushtrimit të të drejtave që rrjedhin nga procesi, duke mbajtur parasysh se konform neneve 5, 31, 154 e 185 të K.Pr.C. objekti i padisë dhe shkaku i saj nuk përmblidhen domosdoshmërisht vetëm në pjesën hyrëse të kërkesë padisë. Gjykata ka detyrimin të vlerësojë dhe të marrë parasysh të gjithë përmbajtjen e padisë dhe të identifikojë kërkimet e paditësit, në mënyrë që të mund të japë një vendim për to. Pala paditëse ka të drejtë të ngrejë pretendime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që i njeh Kushtetuta apo ligji, ndërsa gjykata, në zbatim të parimit *iura novit curia (gjykata e njeh ligjin)* analizon ligjërisht në mënyrë të pavarur këto pretendime, pa u lidhur me përcaktimin e palëve (*shih vendimin unifikues nr. 3, datë 29.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, §28*).

66. Qëndrimi i mësipërm është mbajtur në mënyrë të vazhdueshme dhe konsistente nga të tria Kolegjet e Gjykatës së Lartë, ku natyra dhe lënda e mosmarrëveshjes përcakton kompetencën lëndore të gjykatës. Interpretimi strikt i natyrës së mosmarrëveshjes duke iu referuar vetëm objektit të padisë apo kërkimit dhe jo shkakut ligjor të saj, do të çonte në një përfundim jo të drejtë në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës që duhet të shqyrtojë mosmarrëveshjen. Në të njëjtën linjë arsyetimi, Kolegji vlerëson se kur kërkuesi pretendon se ka të drejtë të përfitojë nga instituti i rehabilitimit, por Zyra e Gjendjes Gjyqësore nuk ia njeh këtë të drejtë, atëherë ai ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës duke pretenduar njohjen e së drejtës së rehabilitimit sipas nenit 69 të Kodit Penal. Kjo gjykatë është gjykata e rrethit gjyqësor, konkretisht dhoma penale, pikërisht sepse natyra e së drejtës që pretendon dhe kërkon t'i njihet subjektit është e drejtë penale materiale, e drejta e të dënuarit për t'u konsideruar i rehabilituar kur përmbush kushtet që kërkon neni 69 i Kodit Penal.

67. Kolegji vlerëson se, në çështjen konkrete, natyra e mosmarrëveshjes nuk duhet parë në mënyrë të ngushtë, duke e konsideruar objektin e mosmarrëveshjes si padi me objekt detyrimin e organit administrativ të kryejë një veprim administrativ që refuzon ta kryejë për subjektin. Në thelb kërkuesi pretendon njohjen e një drejte materiale penale, të drejtën për rehabilitim dhe mosveprimi i organit administrativ lidhet pikërisht me faktin se subjekti nuk e ka të njohur të drejtën materiale, e cila nëse do të ishte e qartë dhe e njohur do ta detyronte organin, në këtë rast Zyrën e Gjendjes Gjyqësore, të vepronte dhe të lëshonte certifikatën e gjendjes gjyqësore me shënimin "i rehabilituar", ashtu siç pretendon kërkuesi.

68. Për të identifikuar një mosmarrëveshje si administrative ose jo duhet që kumulativisht të plotësohen tri kushte, siç janë përpunuar nga praktika gjyqësore. Kriteret që gjykatat duhet të mbajnë parasysh nëse një mosmarrëveshje është apo jo e natyrës administrative kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i së drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik (*shih vendimin nr. 2, datë 10.3.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, §23*).

69. Në çështjen objekt gjykimi, njëkohësisht të shtruar për njësim prej Kolegjit, Kolegji vlerëson se nuk përmbushen në mënyrë kumulative kushtet e mësipërme, në mënyrë që mosmarrëveshja të përfshihet në lëndën e gjykimit administrativ. Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për t'iu u njohur e drejta e rehabilitimit nuk është një çështje që i përket interesit publik, por dukshëm kanalizohet si interes privat i një shtetasi të dënuar për të përfituar nga e drejta e rehabilitimit, njohur nga neni 69 i Kodit Penal.

70. Pavarësisht se në pamje të parë duket sikur objekti i mosmarrëveshjes lidhet me mosveprimin e organit publik, Zyrën e Gjendjes Gjyqësore për të kryer një veprim administrativ, nga interpretimi dhe vlerësimi i drejtë i shkakut të kërkimit, kërkuesi në thelb kërkon t'i njihet e drejta për t'u konsideruar i rehabilituar, e drejtë penale materiale që rregullohet nga neni 69 i Kodit Penal. Kërkuesi kërkon t'i njihet e drejta e rehabilitimit, sipas nenit 69 të Kodit Penal. Kërkuesi nuk padit organin publik dhe as kërkon kryerjen e ndonjë veprimi administrativ prej tij, apo ndryshimin e një akti administrativ. Zyra e Gjendjes Gjyqësore në këtë gjykim paraqitet në cilësinë e personit të interesuar dhe jo palës së paditur, pikërisht se natyra e mosmarrëveshjes nuk lidhet drejtpërdrejt me mosveprimin e saj, por me njohjen në thelb të së drejtës materiale penale të parashikuar nga neni 69 i Kodit Penal, së drejtës për t'u rehabilituar.

71. Megjithatë, as cilësia procedurale e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore si person i interesuar nuk është faktor determinant që përcakton natyrën e mosmarrëveshjes dhe për rrjedhojë kompetencën e gjykatës që do të shqyrtojë mosmarrëveshjen. Është natyra e së drejtës që pretendohet të njihet me anë të gjykimit ajo që përcakton thelbin, lëndën e mosmarrëveshjes dhe për rrjedhojë edhe kompetencën lëndore të gjykatës. Pavarësisht se kjo e drejtë njihet dhe shënohet në regjistrin përkatës nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore që është organ i administratës publike, në rast se subjekti ka pretendime në lidhje me të drejtën e rehabilitimit atëherë ai duhet t'i drejtohet gjykatës penale, që është gjykata e krijuar me ligj për interpretimin e së drejtës penale materiale dhe për njohjen e një të drejte penale materiale, siç është e drejta e të dënuarit për t'u konsideruar i rehabilituar, sipas nenit 69 të Kodit Penal.

72. Instituti i rehabilitimit është në thelb një institut juridiko – penal dhe konflikti nuk ka lindur sepse kërkuesi kërkon që të detyrohet organi publik që të kryejë një veprim administrativ i cili është refuzuar, duke pasqyruar në vërtetimin e gjendjes gjyqësore faktin e pretenduar prej tij, rehabilitimin apo pasqyrimin e shënimeve si i padënuar. Kërkuesi Kujtim Delishi në rastin konkret kërkon njohjen e së drejtës së rehabilitimit, e drejtë penale materiale dhe konflikti ka lindur pikërisht për shkak të mosnjohjes së kësaj të drejte dhe jo për shkak të mosveprimit të organit publik.

73. Kolegji çmon të nevojshme të bëjë dallimin midis kundërshtimit të veprimtarisë administrative të Zyrës së Gjendjes Gjyqësore në lidhje me mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave apo kompetencave të tjera që i ngarkon ligji dhe pretendimit të kërkuesit për njohjen e së drejtës për t'u konsideruar i rehabilituar, në kuptim të nenit 69 të Kodit Penal. Ndërsa e para përbën kundërshtim të veprimtarisë së organit administrativ dhe i përket juridiksionit gjyqësor adminitrativ, e dyta konsiston në pretendimin për njohjen e një të drejte penale materiale dhe i përket juridiksionit gjyqësor penal.

74. Kolegji shton se refuzimi i organit administrativ, konkretisht i Zyrës së Gjendjes Gjyqësore për të njohur të drejtën e kërkuesit për t'u rehabilituar, lidhet pikërisht me faktin se thelbi i së drejtës nuk është i qartë. Mosnjohja e kësaj të drejte nga zyra lidhet me përmbushjen e kushteve që kërkon dispozita, neni 69 i Kodit Penal, në thelb të tij, kushte që i referohen ekzistencës të së drejtës së rehabilitimit të pretenduar nga kërkuesi, nëse atij i takon apo jo kjo e drejtë.

75. Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji thekson se fakti që Zyra e Gjendjes Gjyqësore nuk vepron nuk do të thotë që gjithmonë mosmarrëveshja duhet të kanalizohet si mosveprim i organit publik, në ato raste kur mosveprimi lidhet pikërisht me mosekzistencën apo pamundësinë për të vërtetuar të drejtën materiale në thelb. Në rast se organi administrativ nuk vepron, pra nuk lëshon certifikatën e gjendjes gjyqësore me shënimin "i rehabilituar", nuk do të thotë që ai nuk ka vepruar, organi e ka lëshuar aktin administrativ, por nuk e ka lëshuar me shënimin që vërteton të drejtën që pretendon kërkuesi. Kjo ndodh pikërisht sepse e drejta materiale që pretendon kërkuesi, "e drejta për t'u rehabilituar", nuk është e njohur dhe kompetencën për të njohur një të drejtë të tillë, që lidhet drejtpërdrejtë me interpretimin e një instituti penal material si rehabilitimi, e ka gjykata penale e rrethit gjyqësor.

- Ligji dhe praktika gjyqësore e vendeve fqinje në lidhje me çështjen e shtruar për njësim:

76. Kolegji, në vijim, i referohet legjislacionit të vendeve fqinjë dhe praktikës gjyqësore të tyre, për të parë mënyrën se si ligji i tyre e rregullon çështjen e mësipërme të shtruar për njësim prej Kolegjit në lidhje me gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rehabilitim:

77. Neni 683 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Italisë përcakton se kompetencën për të shqyrtuar kërkesën e të dënuarit për të përfituar nga rehabilitimi e ka gjykata e ekzekutimit, e cila merr në shqyrtim kërkesën: *"1. Gjykata e ekzekutimit, me kërkesën e të interesuarit, vendos për rehabilitimin, edhe nëse ka të bëjë me dënime të dhëna nga gjyqtarë të posaçëm, kur ligji nuk parashikon ndryshe, si dhe shuarjen e dënimit plotësues në rastin e përmendur në nenin. 179, paragrafi i shtatë, i Kodit Penal. Ajo vendos edhe për revokimin e rehabilitimit, nëse nuk është urdhëruar me dënimin për një vepër tjetër (1).*

2. Kërkesa tregon elementet nga të cilat mund të konkludohet ekzistenca e kushteve të parashikuara në nenin 179 të Kodit Penal. Gjykata merr dokumentacionin e nevojshëm (2).

3. Nëse kërkesa refuzohet për mungesë të kushteve të sjelljes së mirë, ajo nuk mund të riparaqitet para se të kenë kaluar dy vjet nga dita në të cilën dispozita e refuzimit është bërë e parevokueshme."

78. Sipas dispozitës së mësipërme, gjykata e ekzekutimit ose gjykata e mbikëqyrjes ka kompetencë të vendosë edhe në lidhje me revokimin e rehabilitimit, institut penal i parashikuar nga ligji penal italian. Sipas paragrafit të dytë të dispozitës, gjykata e ekzekutimit verifikon plotësimin e kushteve të rehabilitimit, të kërkuar nga dispozita penale materiale, neni 179 i Kodit Penal dhe vendos pasi ka marrë në vlerësim dokumentacionin e nevojshëm.

79. Ky qëndrim i ligjvënësit është interpretuar edhe me një sërë vendimesh të Seksionit Penal të Gjykatës së Kasacionit në Itali. Kompetenca për të disponuar për rehabilitimin i përket Gjykatës së Apelit, në referim të nenit

15, të ligjit 3 gusht 1988, nr. 327, dispozitë akoma në fuqi, duke qenë se neni 683 i K.Pr.Penale i atribuon gjykatës së ekzekutimit kompetencën për të vendosur për kërkesat për rehabilitimin, përveç rasteve kur ligji përcakton ndryshe. *(vendim i Seksionit Penal nr. 1 të Gjykatës së Kasacionit nr. 23941 datë 25.5.2004)*

80. Gjithashtu, me vendimin nr. 786/2003, Gjykata e Kasacionit ka mbajtur qëndrimin se kompetenca për të vendosur për rehabilitimin e të miturve i përket gjykatës së ekzekutimit dhe jo gjykatës së të miturve kur kërkuesi ka kaluar moshën 25 vjeç, referuar dispozitës që parashikon mbarimin e kompetencës të gjykatës për të mitur në drejtim të mbikëqyrjes me mbushjen e kësaj moshe nga kërkuesi, është një rregull i përgjithshëm mbylljeje, që nuk i nënshtrohet përjashtimeve thjesht për faktin se institucioni në fjalë ka disa veçori të ndryshme nga rehabilitimi i zakonshëm.

81. Neni 27/3 i Kushtetutës italiane parashikon se dënimi nuk mund të jetë çnjerëzor dhe synon rehabilitimin e të dënuarit. Për herë të parë Gjykata Kushtetuese italiane ka interpretuar nenin 27/3 të Kushtetutës në vendimin nr. 204/1974, të datës 27 qershor 1974. Në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese është shprehur se në bazë të nenit 27(3) të Kushtetutës, rehabilitimi është qëllimi i çdo dënimi dhe e drejta e çdo të burgosuri. Si i tillë, duhet të ketë rishikim të dënimit, të kryer nga një gjyqtar në vend të një anëtari të ekzekutivit, për të përcaktuar nëse, duke pasur parasysh kohën e dënimit të kryer, është arritur rehabilitimi. Gjykata gjithashtu thekson se, në varësi të kushteve të përshtatshme, lirimi me kusht është thelbësor për arritjen e qëllimit të rehabilitimit. I njëjti përfundim është arritur edhe në lidhje me dënimin me burgim të përjetshëm në burgjet ushtarake nga gjykata, në vendimin nr. 192/1976, 14 korrik 1976, në lidhje me dy oficerë ushtarakë gjermanë që shërbenin të tillë dënimet për krimet e kryera gjatë Luftës së Dytë Botërore.

82. Sipas legjislacionit francez, e drejta e rehabilitimit kërkon plotësimin e dy kushteve. Së pari, dënimi duhet të jetë ekzekutuar, parashkruar ose duhet të jetë dhënë falje dhe së dyti, rehabilitimi mund të kërkohet vetëm pas një periudhe të caktuar, të përcaktuar shprehimisht nga ligji.

83. Sipas ligjit francez parashikohen dy forma rehabilitimi të të dënuarit. I pari njihet si rehabilitimi ligjor, i cili bëhet automatikisht nëse plotësohen disa kushte të përcaktuara nga ligji, të cilat variojnë nëse i dënuari është person fizik apo juridik. Neni 133-12 i Kodit Penal parashikon: *"Çdo person i dënuar me një dënim penal, korrektues ose kundërvajtës mund të përfitojë njërën nga mënyrat e rehabilitimit automatik sipas kushteve të parashikuara në këtë seksion, ose rehabilitimin gjyqësor dhënë sipas kushteve të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale."* Neni 133-13 i Kodit parashikon se rehabilitimi i jepet automatikisht personit fizik të dënuar që, pas përfundimit të dënimit, brenda afateve të mëposhtme, nuk është dënuar me një dënim të ri për dënim penal ose korrektues. Në varësi të llojit të dënimit të caktuar ndaj kërkuesit, ligji penal francez përcakton dhe afatet e rehabilitimit. Nga ana tjetër, neni 133-14 i Kodit parashikon kushtet e rehabilitimit ligjor për të dënuarin, person juridik. Neni 133-17 i Kodit parashikon se për efekt të zbatimit të rregullave të rehabilitimit, falja e dënimit është e barabartë me ekzekutimin e tij.

84. Rehabilitimi gjyqësor parashikohet nga nenet 782-799 të Kodit të Procedurës Penale franceze. Neni 782 parashikon parimin e përgjithshëm sipas të cilit: *"Kushdo që dënohet nga një gjykatë franceze me një dënim penal, korrektues ose kontravencional mund të rehabilitohet."*

85. Gjithashtu ligji parashikon procedurën për paraqitjen e kërkesës për rehabilitim, si dhe organin kompetent që merr në shqyrtim kërkesën dhe disponon në lidhje me të. Neni 790 i K.Pr.Penale franceze parashikon se: *"Personi i dënuar ia dërgon kërkesën për rehabilitim prokurorit publik të vendbanimit të tij aktual ose, nëse jeton jashtë vendit, prokurorit publik të vendbanimit të tij të fundit në Francë ose në rast të kundërt, atij të vendit të dënimit."* Prokurori publik merr informacion për vendet e ndryshme ku mund të ketë qëndruar personi i dënuar. Ai merr edhe mendimin e gjyqtarit të ekzekutimit (neni 791). Në lidhje me organin kompetent që ka të drejtë të disponojë për kërkesën për rehabilitim, ai përcaktohet nga neni 794 i K.Pr.Penale, sipas të cilit: *"Gjykata vendos në afat prej dy muajsh për konkluzionet e prokurorit publik, palës ose avokatit të tij të dëgjuar ose të thirrur në mënyrë të rregullt."*

86. Procedura sipas ligjit francez mund të përmblidhet në këtë mënyrë: Prokurori publik investohet nga kërkuesi në lidhje me kërkesën për rehabilitim. Prokurori përpilon një dosje të cilën ia dërgon prokurorit të përgjithshëm së bashku me mendimin e tij. Së fundi, ky i fundit duhet të vërë në lëvizje gjykatën, dhomën e ekzekutimit. Gjykata do të marrë në konsideratë sjelljen e mirë të personit të dënuar, rëndësinë e fakteve në origjinën e dënimit etj. Në rast refuzimi të aplikimit, një aplikim i ri nuk mund të bëhet para skadimit të një periudhe dy-vjeçare, përveç nëse refuzimi i kërkesës së parë ka qenë motivuar nga pamjaftueshmëria e afateve të gjykimit. Në këtë rast, kërkesa mund të ripërsëritet sapo të kenë mbaruar këto afate.

87. Gjithashtu, po t'i referohemi ligjit të Kosovës që rregullon institutin e rehabilitimit dhe kompetencën e gjykatës për t'u shprehur në lidhje me këtë institut, përfundimi është i njëjtë. Neni 521 i K.Pr.Penale të Kosovës parashikon: *"Kur organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore nuk merr aktvendim mbi shlyerjen e dënimit, personi i dënuar mund të kërkojë të konstatohet se shlyerja e dënimit është bërë në bazë të ligjit.*

2. Kur organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore nuk merr aktvendim sipas kërkesës së të dënuarit brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e marrjes së kërkesës, i dënuari mund të kërkojë që gjykata e cila në shkallë të parë ka marrë aktgjykimin të marrë aktvendim për shlyerje të dënimit.

3. Për këtë kërkesë vendos gjykata pasi të dëgjojë mendimin e prokurorit të shtetit kur procedura është filluar me kërkesë të tij."

88. Duke iu rikthyer çështjes konkrete dhe rregullimit të ligjit shqiptar, Kolegji Penal vlerëson se pavarësisht se ligji procedural shqiptar nuk shprehet në lidhje me gjykatën kompetente për të marrë në shqyrtim kërkesën në lidhje me rehabilitimin e të dënuarit, sipas nenit 69 të Kodit Penal, kompetenca i përket gjykatës së rrethit gjyqësor, dhomës penale dhe konkretisht gjykatës që ka dhënë vendimin penal. Nëse është më shumë se një vendim penal i kryer nga i dënuari, për të cilin pretendohet rehabilitimi, gjykata kompetente do të jetë gjykata penale që ka dhënë vendimin e fundit gjyqësor. Një përfundim i tillë arrihet po të marrim në konsideratë funksionin që ka kjo gjykatë në kuadër të shqyrtimit të kërkesës për rehabilitim. Gjykata do të verifikojë kur ka përfunduar vuajtja e dënimit të dhënë, kalimin e afatit kohor që përcakton dispozita, si dhe moskryerjen e një vepre tjetër penale nga i dënuari, kushte që, ashtu siç do të trajtohet në vijim, janë kumulative.

89. Gjithashtu, Kolegji e përjashton mundësinë që gjykata kompetente të jetë gjykata e ekzekutimit, sipas nenit 470 e vijues të K.Pr.Penale që e parashikon shprehimisht kompetencën e gjykatës së ekzekutimit: *"Gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij."*, pasi siç u argumentua më sipër pretendimi për rehabilitim nuk i përket fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

90. Në përfundim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se thelbi dhe lënda e mosmarrëveshjes përcaktojnë natyrën e mosmarrëveshjes dhe rrjedhimisht përcaktojnë edhe kompetencën lëndore të gjykatës që do të shqyrtojë pretendimet e kërkuesit me objekt të drejtën e tij për t'u konsideruar i rehabilituar edhe në ato raste kur Zyra e Gjendjes Gjyqësore ia refuzon këtë të drejtë. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se përgjigjja e pyetjes së tretë është:

III. Kur një person pretendon se plotëson kriteret ligjore për të përfituar nga rehabilitimi, sipas nenit 69 të Kodit Penal, por nuk arrin të realizojë këtë të drejtë për shkak të refuzimit të shfaqur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, gjykata kompetente që vendos për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje do të jetë gjykata penale e rrethit gjyqësor që ka dhënë vendimin penal ndaj kërkuesit që pretendon rehabilitimin. Nëse ndaj kërkuesit është dhënë më shumë se një vendim gjyqësor, gjykata kompetente do të jetë gjykata që ka dhënë vendimin e fundit gjyqësor.

91. Si trajtoi çështjen e kompetencën lëndore të gjykatës që shqyrton kërkesat e palëve dhe pretendimet në lidhje me të drejtën e rehabilitimit, Kolegji ndalet në çështjet katër dhe pesë që lidhen me trajtimin në thelb të këtij instituti penal material, të parashikuar nga neni 69 i Kodit Penal.

92. Një nga qëllimet e dënimit penal është rehabilitimi i të dënuarit, pra edukimi i tij në shoqëri që ai të mos përfshihet më në veprimtari të kundërligjshme, të jetë një qytetar i denjë dhe të përfshihet në të gjitha funksionet në shoqëri. Neni 5/3 i K.Pr.Penale parashikon: *"Të dënuarve me burgim u sigurohet trajtimi njerëzor dhe rehabilitimi moral."* Krahas rehabilitimit moral subjektit i lind e drejta të përfitojë edhe nga rehabilitimi ligjor, domethënë e drejta të figurojë i padënuar në certifikatën e gjendjes gjyqësore.

93. Instituti i rehabilitimit është një nga mekanizmat ligjorë, njëkohësisht një e drejtë themelore që garanton dinjitetin e njeriut; si një nga bazat mbi të cilat është themeluar Kushtetuta. Qëllimi i rehabilitimit është mbrojta e personalitetit dhe dinjitetit të të dënuarve, të kufizuara për shkak të vendimeve gjyqësore të dënimit për kryerjen e veprave penale, duke i risocializuar ata në përditshmërinë normale të jetës.

94. Kjo e drejtë natyrore e njeriut, mund të kufizohet vetëm për interesa publike, tepër të rëndësishme, siç do të ishte siguria e shoqërisë, por kurrsesi nuk mund të mohohet vetë thelbi i saj. Çdo njeri, përfshirë edhe personat e dënuar penalisht, ka të drejtë të jetojë me dinjitet. Kështu, kufizimi i së drejtës për të jetuar me dinjitet nuk mund të bëhet nëse nuk është e nevojshme, e domosdoshme për arritjen e qëllimit për interesat publike dhe kufizimi nuk mund të zgjasë për gjatë gjithë jetës. Instituti i rehabilitimit parashikohet në nenin 69 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Instituti i rehabilitimit, në të drejtën penale shqiptare, mbështetet në parimin se çdo qenie njerëzore vazhdimisht evoluon, vetëkorrigjohet dhe ndryshon, si në marrëdhëniet me njerëzit e tjerë, por edhe në lidhje me shoqërinë dhe institucionet e saj. Personi i rehabilituar quhet i padënuar, sikur dënimi të mos ketë ekzistuar asnjëherë dhe ai gëzon të gjitha të drejtat e kufizuara më parë, përveç kur ligji shprehet ndryshe.

95. Dënimi i autorëve ndikon në statusin juridik të tyre, duke sjellë pasoja për të dënuarit. Pasojat janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme si morale, juridike, ekonomike, sociale etj. Këtu mund të përmendet edhe konsiderimi si përsëritës, në rast se personi kryen vepër tjetër penale pas rehabilitimit. Filozofia e rehabilitimit të personave të dënuar bazohet në të drejtën që këta persona kanë që shoqëria të falë dhe të harrojë veprat penale të kryera prej tyre në të shkuarën, duke i konsideruar "të padënuar". Funksionet e rehabilitimit kanë të bëjë me

riaftësimin shoqëror të të dënuarit, duke hequr ato pengesa në jetë që kanë të bëjnë edhe me marrëdhëniet e punës pas çdo pasoje të dhënë me dënimin kryesor apo dënimin plotësues dhe me shuarjen e fenomenit kriminologjik të recidivizmit. Për rrjedhojë, instituti i rehabilitimit e motivon të dënuarin që pasi të kryejë dënimin, të sillet mirë, në mënyrë që sa më shpejtë t'i hiqen kufizimet e të drejtave për shkak të dënimit dhe të fitojë statusin e barabartë me të tjerët në shoqëri.

96. Rehabilitimi presupozon që dënimi kryesor është vuajtur ose shlyer, duke eliminuar pasojat e ardhura prej tij dhe duke i kthyer të dënuarit kapacitetin juridik që ka humbur për shkak të dënimit të dhënë ndaj tij. Duhet mbajtur në konsideratë, gjithashtu, që rehabilitimi nuk ka fuqi prapavepruese, pasi ai vepron vetëm për të ardhmen, për shembull duke mos pasur efekt për cilësimin e të dënuarit si përsëritës nëse ai kryen një vepër tjetër penale. Rehabilitimi pushon çdo efekt penal të dënimit kryesor. Termi "efekte të tjera penale" është interpretuar nga jurisprudenca në kuptimin e gjerë, si gjithëpërfshirës i të gjitha efekteve, qoftë edhe të natyrës civile apo administrative, që rrjedhin nga dënimi dhe që kanë qenë të afta për të zvogëluar aftësinë juridike të shkelësit.

97. Pasoja kryesore e rehabilitimit është aftësia e të dënuarit që të riintegrohet në shoqëri, duke u kthyer në të njëjtat kushte dhe pozicion që ishte para se ndaj tij të caktohej dënimi penal. Ky institut karakterizohet nga një funksion shpërblyes dhe promovues, pasi lidhet me shlyerjen me sukses të dënimit kryesor dhe me sjelljen e mirë të demonstruar për një periudhë të caktuar kohore nga i dënuari.

- E drejta për rehabilitimin e të dënuarit në këndvështrimin e praktikës së GJEDNJ-së.

98. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim "GJEDNJ") në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrimin se të drejtat e të dënuarve me burgim shihen në dritën e parimit të rehabilitimit, që nënkupton riintegrimin në shoqëri të një personi të dënuar (*shih Murray kundër Holandës [GC], 2016, §101)*. Megjithatë, ajo ka theksuar se ndëshkimi mbetet një nga funksionet kryesore të dënimit me burgim dhe qëllimi kryesor i dënimit me burgim është të mbrohet shoqëria, duke parandaluar shkelësin e ligjit të kryejë një dëm tjetër *(Mastromatteo k. Italisë [GC], 2002, §72)*. Në të njëjtën kohë, GJEDNJ-ja ka njohur qëllimin e ligjshëm të politikave të riintegrimit social të personave të dënuar me burgim.

99. Rehabilitimi është referuar gjithashtu në një dritë pozitive nga GJEDNJ-ja. Me kalimin e kohës, parimi ka fituar rëndësi në praktikën gjyqësore të Gjykatës, në bazë të dispozitave të ndryshme të Konventës. Kufijtë e rehabilitimit janë përcaktuar gradualisht në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Sipas GJEDNJ-së, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "Konventa") nuk garanton të drejtën për rehabilitim, si e tillë. Megjithatë, Gjykata ka deklaruar shprehimisht, se: "theksi mbi rehabilitimin dhe riintegrimin është bërë një "faktor i detyrueshëm" që shtetet anëtare duhet ta marrin parasysh kur hartojnë politikat e tyre penale".[21] Kohët e fundit, GJEDNJ-ja për herë të parë, tregoi se rehabilitimi është një "detyrim pozitiv" nga ana e shtetit.[22]

100. E drejta për rehabilitim, pra fshirja e dënimit të personit nga të dhënat personale të tij është trajtuar në jurisprudencën e GJEDNJ-së edhe në kuptim të së drejtës për t'u harruar. Në çështjen M.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata Evropiane e ka konsideruar shkelje të nenit 8 të Konventës, pra së drejtës për jetë private dhe familjare, pamundësinë e një individi për të përfituar fshirje të dënimeve të tij të mëparshme nga rekordet e tij policore, me kalimin e një periudhe të caktuar kohe. *(shih M.M. k. Mbretërisë së Bashkuar)*

101. Në M.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2012 (§§187-207), GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se regjistrimi përjetësisht i një dënimi në regjistrat e policisë, përbën shkelje të nenit 8 të Konventës. Gjykata mori në konsideratë faktin se dënimi i dhënë ndaj një individi në të kaluarën, me kalimin e kohës bëhet pjesë integrale e jetës së tij private, e cila duhet të respektohet. Edhe pse të dhënat për rekordet penale janë në një kuptim, informacion i lidhur me interesin publik, ruajtja e tij sistematike në dosjet qendrore nënkupton që ky informacion të bëhet publik pas një farë kohe, atëherë kur çdokush, përveç subjektit të të dhënave, e ka harruar këtë incident. Gjykata konkludoi se ishte shqetësues fakti që kriteret për të lejuar fshirjen e këtyre të dhënave ishin shumë strikte dhe kërkesa për fshirje pranohej vetëm në raste përjashtimore. (ibid., §202)

102. Sipas GJEDNJ-së, dënimi mbetet një nga qëllimet e burgimit, por theksi në politikën penale evropiane tani është zhvendosur drejt qëllimit të saj rehabilitues. Tani ekziston një mbështetje e qartë në të drejtën evropiane dhe ndërkombëtare për parimin që të gjithë të burgosurve, përfshirë ata që vuajnë dënimin e përjetshëm, duhet t'u ofrohet mundësia e rehabilitimit dhe perspektiva e lirimit nëse ai rehabilitim arrihet. *(shih Vinter dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar (parag. 114–115).*

[21] Shih Khoroshenko kundër Rusisë, 30 qershor 2015, parag. 121. Ai e bën këtë, duke iu referuar rasteve të Vinter dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafët 11–116) dhe Harakchiev dhe Tolumov kundër Bullgarisë (paragrafët 243–246), duke nënkuptuar kështu se rehabilitimi dhe risocializimi janë bërë një faktor i detyrueshëm gjatë gjithë kohës.

[22] *Murray v. The Netherlands*, 26 April 2016, parag. 104.

103. GJEDNJ e ka trajtuar rehabilitimin të lidhur me respektimin e dinjitetit njerëzor, i cili përfaqëson, siç ka thënë shpesh GJEDNJ, vetë thelbin e sistemit të Konventës. *(Shih Vinter dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, Pretty kundër Mbretërisë së Bashkuar.)* GJEDNJ-ja ndjek kështu Gjykatën Kushtetuese Federale Gjermane, e cila ka deklaruar se do të ishte e papajtueshme me të drejtën për dinjitet njerëzor të parashikuar në Kushtetutë që shteti t'i privojë me forcë lirinë një individi pa i dhënë së paku mundësinë atij individi për të rifituar lirinë e tij një ditë. Prandaj është detyrë e autoriteteve të burgut të përpiqen drejt rehabilitimit të të gjithë të burgosurve (të përjetshëm) dhe se rehabilitimi është një kërkesë kushtetuese për çdo shoqëri që pranon dinjitetin njerëzor si qendër të saj. *(Çështja për të burgosurit e luftës* 72 BVerfGE 105 (1986).

104. Gjithashtu, GJEDNJ ka mbajtur qëndrimin se, ndërsa një shtet ka marzhin e vet të vlerësimit për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave, është e rëndësishme që të ketë mekanizma mbrojtës që lejojnë fshirjen e këtyre të dhënave personale kur mbajtja e tyre e mëtejshme bëhet jopropocionale. *(Catt kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2019, §119; Gaughran kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2020, §94.)* Mungesa e masave mbrojtëse efektive për fshirjen e të dhënave personale të cilat nuk janë më relevante referuar qëllimit të ruajtjes së tyre është veçanërisht shqetësuese në rastin e kategorive të veçanta të të dhënave të ndjeshme për të cilat ekziston një nivel më i lartë mbrojtjeje. *(Catt kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2019, §112).*

105. Më sipër u pasqyrua një pjesë e jurisprudencës së gjerë të GJEDNJ-së, e cila e ka trajtuar institutin e rehabilitimit, në kuptim të fshirjes së të dhënave që pasqyrojnë dënimet e mëparshme të personit në kuadër të së drejtës për jetë private dhe familjare, parashikuar nga neni 8 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

106. Ligji shqiptar parashikon se dënimet penale të personave pasqyrohen në regjistrin e gjendjes gjyqësore. Në bazë të këtij regjistri del certifikata e gjendjes gjyqësore, që pasqyron nëse personi figuron apo jo i dënuar. Neni 481/1 i K.Pr.Penale parashikon: *"Pranë Ministrisë së Drejtësisë, në zyrën e regjistrit gjyqësor, depozitohen shkurtimet e vendimeve për personat e gjykuar penalisht."* Megjithatë, pasqyrimi i të dhënave në lidhje me dënimet penale të dhëna ndaj subjekteve nuk qëndron në një kohë të pakufizuar, pikërisht sepse ligji penal material parashikon institutin e rehabilitimit të të dënuarit.

107. E drejta për t'u rehabilituar rregullohet nga ligji penal material, neni 69 i Kodit Penal që parashikon: *"Quhen të padënuar:*

a) ata që janë dënuar me burgim për një kohë gjer në gjashtë muaj ose me çdo dënim tjetër më të lehtë dhe që gjatë dy vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;

b) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga gjashtë muaj gjer në pesë vjet dhe që gjatë pesë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;

c) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga pesë gjer në dhjetë vjet dhe që gjatë shtatë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale;

ç) ata që janë dënuar me burgim për një kohë nga dhjetë gjer në njëzet e pesë vjet dhe që gjatë dhjetë vjetëve nga dita e vuajtjes së dënimit nuk kanë kryer vepër tjetër penale."

108. Në kuptim të ligjit me përmbushjen e kushteve që parashikon neni 69 i Kodit Penal, i dënuari ka të drejtë të konsiderohet i rehabilituar, pra të konsiderohet i padënuar. Në përgjigje të pyetjes së katërt të shtruar për njësim; "Si ndikon kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i rehabilitimit të të dënuarit sipas nenit 69 të Kodit Penal?", Kolegji çmon të marrë në analizë cilat janë kushtet që kërkon dispozita penale materiale në mënyrë që subjektit t'i lindë e drejta për t'u rehabilituar.

109. Së pari, ligji përcakton se në mënyrë që subjekti të quhet i padënuar duhet të jetë dënuar me një dënim me burgim, i cili mund të jetë një dënim sipas masës që përcakton ligji penal, konkretisht neni 32 i Kodit Penal, që parashikon: *"Dënimi me burgim për krimet jepet për një kohë nga pesë ditë deri në tridhjetë e pesë vjet.*

Për kundërvajtje penale dënimi me burgim jepet për një kohë nga pesë ditë deri në dy vjet."

110. Ndaj të dënuarit mund të jetë caktuar një dënim me burgim, por ligji parashikon mundësinë që edhe dënimi me burgim të pezullohet dhe ndaj të dënuarit të caktohet një dënim alternativ. Mënyra e ekzekutimit të dënimit penal ka rëndësi për efekt të llogaritjes së momentit procedural të shlyerjes së dënimit dhe afatit të rehabilitimit që përcakton neni 69 i Kodit Penal.

111. Së dyti, ligji kërkon kalimin e një afati të caktuar kohor. Ky afat përcaktohet dhe kushtëzohet nga masa e dënimit me burgim të dhënë ndaj subjektit, në bazë të parimit se sa më i rëndë dënimi aq më i gjatë është afati që kërkohet të kalojë për efekt të rehabilitimit të të dënuarit. Një parashikim i tillë është logjik konform politikës penale dhe kuptimit që ka instituti i rehabilitimit. Në kushtet kur dënimi caktohet në kuadër të parimit të individualizimit të dënimit, parashikuar nga neni 47 i Kodit Penal, në caktimin e tij merret në konsideratë

rrezikshmëria shoqërore e të pandehurit, e veprës penale, shkalla e fajit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese[23]. Në këtë kuptim, dënimi i caktuar ndaj të pandehurit reflekton drejtpërdrejtë rrezikshmërinë e tij shoqërore dhe të veprës penale të kryer.

112. Është e kuptueshme që sa më i rëndë të jetë dënimi i caktuar ndaj të dënuarit, aq më e gjatë duhet të jetë koha që ai të rehabilitohet. Rehabilitimi i tij në kuptim të riedukimit psikologjik e social, riintegrimi në shoqëri, bërjes së tij një person i denjë, i cili të mos shkelë më ligjin pasqyrohet edhe në rehabilitimin ligjor të tij, pra në fshirjen e dënimit penal nga regjistri i gjendjes gjyqësore. Një parashikim i tillë ligjor, i njohur nga çdo legjislacion ligjor, lidhet me të drejtën e çdo personi për t'u rehabilituar, e cila përbën dhe thelbin dhe qëllimin kryesor të dënimit penal në një shtet demokratik. Rehabilitimi moral, psikik, social i të dënuarit do të humbiste qëllimin e tij nëse nuk do të gjente pasqyrim edhe në aktet zyrtare që regjistrojnë këto të dhëna për subjektin, të dhëna që sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së përbëjnë të dhëna personale që gëzojnë mbrojtje nga Konventa.

113. Në vijim të këtij arsyetimi, ligji kërkon kalimin e një afati kohor të caktuar në mënyrë që subjekti të konsiderohet i padënuar, afat kohor që përcaktohet dhe kushtëzohet nga masa e dënimit me burgim të caktuar me vendim gjykate. Çështje që vlen për t'u nënvijëzuar është fakti që dënimi që do të merret në konsideratë për llogaritjen e afatit të rehabilitimit është masa e dënimit përfundimtar me burgim, pavarësisht llojit të dënimit që mund të ketë caktuar gjykata. Fakti që gjykata mund të disponojë me një dënim alternativ sipas llojeve të alternativave të dënimit me burgim të parashikuar nga neni 58 e vijues i Kodit Penal nuk kushtëzon afatin e rehabilitimit, i cili përcaktohet referuar dënimit kryesor me burgim, por kushtëzon, ashtu siç do të sqarohet në vijim, momentin procedural kur do të fillojë të llogaritet ky afat.

114. Dënimi me burgim i caktuar ndaj kërkuesit do të merret në konsideratë për llogaritjen e afatit për efekt rehabilitimi, pavarësisht nëse gjykata ka pezulluar ekzekutimin e dënimit me burgim dhe ka caktuar si mënyrë ekzekutimi dënimi një nga dënimet alternative të parashikuara nga ligji penal. Ky përfundim arrihet po të merret në konsideratë se alternativat e dënimit me burgim janë mënyra ekzekutimi të dënimit me burgim, të cilat caktohen nga gjykata ajo kur vlerëson se plotësohen kushtet specifike që kërkon dispozita konkrete për atë lloj dënimi alternativ.

115. I njëjti përfundim arrihet edhe nëse i dënuari përfiton nga lirimi me kusht sipas nenit 64 të Kodit Penal. Dënimi me burgim i caktuar ndaj tij do të merret në konsideratë për efekt të llogaritjes së afatit që kërkon ligji për rehabilitimin e të dënuarit.

116. Nga ana tjetër, mënyra e vuajtjes së dënimit me burgim, fakti nëse ndaj të dënuarit është caktuar një dënim alternativ do të merret në konsideratë në lidhje me faktin se kur do të fillojë të llogaritet afati i rehabilitimit i parashikuar nga neni 69 i Kodit Penal. Ky afat do të fillojë, në parim, në momentin që i dënuari përmbush të gjitha detyrimet ndaj shtetit në lidhje me dënimin penal të caktuar ndaj tij. Ky afat fillon nga momenti i shlyerjes përfundimisht të dënimit nga i dënuari. Nëse ndaj të dënuarit është caktuar dënimi alternativ, pezullimi i dënimit me burgim dhe vënia në provë, parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal, afati i rehabilitimit i kërkuar nga dispozita do të fillojë kur i dënuari ka përmbushur të gjitha detyrimet e caktuara nga gjykata në lidhje me vendosjen në provë, në përfundim të afatit të provës.

117. Përjashtim bën dënimi alternativ i parashikuar nga neni 63 i Kodit Penal. Në rastin e nenit 63 të Kodit Penal, gjykata cakton dënim me burgim deri në një vit dhe pezullon ekzekutimin e tij duke e zëvendësuar me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik. Në këtë rast është vet dispozita ligjore që parashikon që dënimi të konsiderohet i paqenë. Në këtë rast, ligjvënësi parashikon qenien i padënuar/i rehabilituar nga i dënuari që në momentin e përfundimit të dënimit prej tij.

118. Rast tjetër është parashikimi i neneve 406/a dhe 406/b të K.Pr.Penale që parashikojnë miratimin e urdhrit penal nga gjykata. Sipas këtyre dispozitave, në rast se vepra penale e kryer është kundërvajtje penale për të cilën prokurori çmon dhe gjykata miraton që nuk duhet caktuar dënim me burgim por me gjobë, gjykata merr vendim për miratimin e urdhrit penal. Ligji parashikon se në këtë rast, dënimi i dhënë nuk shënohet në vërtetimin e gjendjes gjyqësore, përveç rastit kur i dënuari është përsëritës.

119. Kolegji vlerëson se rastet e mësipërme janë parashikime të posaçme të ligjit penal, i cili në dënime të konsideruara të dhëna për subjekte me rrezikshmëri të vogël shoqërore, e parashikon shprehimisht rehabilitimin e të dënuarit që në përfundimin e ekzekutimit të dënimit (neni 63 i Kodit Penal) ose që me dhënien e vendimit penal nga gjykata (neni 406/a dhe 406/b të K.Pr.Penale). Në të gjitha rastet e tjera, për rehabilitimin do t'i

[23] Neni 47 i Kodit Penal parashikon: *"Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese."*

referohemi dispozitës së përgjithshme materiale penale, që është neni 69 i Kodit Penal.

120. Kolegji vlerëson se, në parim, për të konsideruar të përfunduar ekzekutimin e vendimit penal, gjykata do t'i referohet dispozitave të ligjit nr. 79/2020, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", që përcakton mënyrën e ekzekutimit të secilit vendim penal dhe momentin kur dënimi konsiderohet i kryer për efekt të ligjit. Ky do të jetë edhe momenti procedural nga i cili do të fillojë të llogaritet afati që parashikon neni 69 i Kodit Penal, për efekt të rehabilitimit.

121. Në konkluzion, kushti i dytë që kërkon dispozita është caktimi me vendim gjykate të formës së prerë i një dënimi me burgim, pavarësisht mënyrës së ekzekutimit të këtij vendimi. Momenti kur do të fillojë të llogaritet afati që kërkon ligji për rehabilitimin është momenti kur i dënuari përfundon të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit, të caktuar me vendimin penal, pavarësisht se cila është mënyra e ekzekutimit të këtij vendimi penal.

122. Së treti, ligji kërkon që gjatë afatit që kërkon dispozita, në përmbushje të së cilit të dënuarit i lind e drejta të përfitojë nga rehabilitimi, pra të quhet i padënuar, i dënuari të mos kryejë vepër tjetër penale. Një parashikim i tillë është logjik dhe përputhet me kuptimin që ka rehabilitimi, i cili ka të bëjë me riintegrimin e të dënuarit në shoqëri; për shkak të vuajtjes së dënimit penal i dënuari është rehabilituar në kuptimin social, moral, psikik, rehabilitim që do të pasqyrohet dhe në të drejtën e tij për rehabilitim ligjor, pra të drejtën për të rezultuar i padënuar në certifikatën e gjendjes gjyqësore.

123. I dënuari do të konsiderohet se ka kryer vepër tjetër penale në rast se fajësia e tij për kryerjen e veprës penale vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prerë. Vetëm në rast se në ngarkim të të dënuarit ka një vendim gjyqësor të formës së prerë që provon qenien e tij fajtor për kryerjen e një vepre penale, atëherë për efekt të nenit 69 të Kodit Penal, konsiderohet i përmbushur kushti ndalues që i dënuari të përfitojë nga e drejta për t'u konsideruar i rehabilituar. Në rast se vendimi gjyqësor me të cilin i dënuari është dënuar për veprën tjetër penale nuk është i formës së prerë, atëherë nuk konsiderohet i vërtetuar kushti ndalues për efekt të përfitimit nga e drejta e rehabilitimit.

124. Për të përcaktuar vendimin e formës së prerë, i referohemi nenit 462/3 të K.Pr.Penale që parashikon: *" Janë vendime të formës së prerë:*

a) vendimi i gjykatës së shkallës së parë kur nuk ankimohet nga palët brenda afatit ligjor, kur është i paankimueshëm ose kur nuk pranohet ankimi për shkaqet e parashikuara nga neni 420 i këtij Kodi. Në çështjet me bashkëtëpandehur, vendimi merr formë të prerë për të pandehurin që nuk ka bërë ankim, pavarësisht ankimit të bashkëtëpandehurve të tjerë, me kusht që prokurori të mos ketë bërë ankim. Kur prokurori nuk ka ushtruar ankim dhe çështja shqyrtohet mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurve të tjerë, për të pandehurin që nuk ka ushtruar ankim në një gjykim me bashkëtëpandehur, vendimi merr formë të prerë pavarësisht ankimit të ushtruar nga bashkëtëpandehurit e tjerë;

b) vendimi i gjykatës së apelit kur zgjidh përfundimisht çështjen, sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të pikës 1, të nenit 428, të këtij Kodi;

c) vendimi i Gjykatës së Lartë në rastet e ekstradimit dhe transferimit të personave të dënuar."

125. Kryerja e një vepre penale brenda afatit në të cilin është duke ecur afati i rehabilitimit, afat që ka filluar të ecë por nuk është ezauruar, pra nuk ka përfunduar, përbën kusht ndalues që subjekti të përfitojë nga rehabilitimi, pra për të qenë i padënuar. Ky është një parashikim që e bën vet dispozita, e cila parashikon se i dënuari gjatë afatit të rehabilitimit nuk duhet të kryejë vepër tjetër penale. Kolegji vë në dukje se kushtet e mësipërme janë kumulative, pra ato duhet të vërtetohen të gjitha së bashku në mënyrë që subjektit t'i lindë e drejta për të përfituar nga instituti i rehabilitimit.

126. Në këto kushte, pyetjes së ngritur se: "*Si ndikon kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i rehabilitimit të të dënuarit sipas nenit 69 të Kodit Penal?",* Kolegji vendos t'i përgjigjet në këtë mënyrë:

IV. Kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i parashikuar në nenin 69 të Kodit Penal për t'u konsideruar i rehabilituar përbën kusht ndalues që i dënuari, në përfundim të këtij afati, të përfitojë nga kjo e drejtë. Për efektet e zbatimit të nenit 69 të Kodit Penal, një vepër tjetër penale do të konsiderohet e kryer kur vërtetohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

127. Përgjigjja e pyetjes së katërt ka vlerë për të drejtën e rehabilitimit gjatë afatit që parashikon neni 69 i Kodit Penal. I dënuari që kryen një vepër tjetër penale gjatë kohës që është duke u ezauruar afati i rehabilitimit për efekt të veprës së parë penale nuk ka të drejtë të përfitojë nga rehabilitimi në fund të këtij afati. Ky përfundim është logjik pasi moskryerja e një vepre tjetër penale përbën kusht ndalues ligjor për efekt të përfitimit nga ky institut. Megjithatë, Kolegji vë në dukje se kryerja e një vepre tjetër penale nuk përbën shkak që të dënuarit t'i humbasë përfundimisht e drejta për t'u konsideruar i padënuar/ rehabilituar.

128. Kolegji konstaton se ligji penal shqiptar bën një rregullim të përgjithshëm të rehabilitimit, duke përcaktuar afatet e rehabilitimit sipas masës së dënimit me burgim të caktuar, por pa rregulluar si do të zbatohet instituti i

rehabilitimit në rast të kryerjes së një vepre tjetër penale. Ky parashikim ligjor ka lenë vend për interpretime të ndryshme nga gjykatat, vendimmarrja e të cilave nuk ka qenë uniforme, duke u bërë edhe shkak për këtë vendimmarrje njësuese të Kolegjit Penal.

129. Kolegji vlerëson se kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që ecën afati i rehabilitimit ndërpret afatin e rehabilitimit që parashikon neni 69 i Kodit Penal. Me kryerjen e një vepre tjetër penale vërtetohet një kusht ndalues për rehabilitimin, çka do të thotë që afati i rehabilitimit nuk vazhdon më të llogaritet, sepse është vërtetuar kushti që pengon plotësimin e kushteve kumulative për qenien para këtij instituti. Megjithatë, vërtetimi i kushtit ndalues që kërkon dispozita për rehabilitimin, pra kryerja e një vepre penale, nuk mund të interpretohet si shkak për humbjen përfundimisht të së drejtës së të dënuarit për rehabilitim. Një interpretim i tillë do të binte ndesh me qëllimin dhe kuptimin që ka dispozita penale, kuptimin e institutit të rehabilitimit dhe për më tepër me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

130. Kolegji çmon të nevojshme të theksojë se, referuar ligjit penal shqiptar, kryerja e një vepre tjetër penale nga kërkuesi përbën shkak që i dënuari të mos konsiderohet i rehabilituar në përfundim të afatit të përcaktuar. Nëse subjekti, gjatë kohës që po ecën ky afat, kryen një vepër tjetër penale, atëherë afati i rehabilitimit për veprën e parë do të ndërpritet, pra nuk do të vazhdojë të ecë, pasi është vërtetuar kushti ndalues që pengon fitimin e së drejtës së rehabilitimit nga i dënuari. Megjithatë, Kolegji vlerëson se qëllimi i ligjvënësit nuk ka qenë që këtij subjekti të dënuar t'i humbasë përfundimisht e drejta e të qenit/konsideruarit si i padënuar në lidhje me dënimin e parë. Në rast se i dënuari dënohet me vendim gjykate të formës së prerë në lidhje me veprën e dytë penale, atëherë në përfundim të vuajtjes së dënimit të dytë, për të do të fillojë të eci afati i rehabilitimit për veprën e parë, afat që u ndërpre nga kryerja e veprës së dytë, si dhe afati i rehabilitimit për veprën e dytë, për të cilën ai gjithashtu ka të drejtën e rehabilitimit.

131. Në një konkluzion logjik, afati i rehabilitimit për të dyja dënimet do të fillojë të ecë në momentin e përfundimit të dënimit të dytë, duke u konsideruar si afat rehabilitimi afati më i gjatë. Kjo do të thotë që afati më i gjatë i rehabilitimit i përfshin afatet e rehabilitimit për të dyja dënimet e vuajtura, pavarësisht se këto afate ecin dhe llogariten më vete që nga momenti kur i dënuari përfundon së vuajturi dënimin për veprën e dytë penale.

132. Një përfundim i tillë përforcohet po të bëhet interpretimi logjik i institutit të rehabilitimit të të dënuarit por edhe vet përmbajtjes së dispozitës penale. Kryerja e një vepre tjetër penale ndërpret afatin e parashkrimit për të dënuarin për veprën e parë, pikërisht sepse përbën kusht ndalues të përcaktuar nga dispozita. Megjithatë, me përfundimin e ekzekutimit të vendimit të dytë penal, të dënuarit i lind e drejta të rehabilitohet si për dënimin e parë, afati për të cilin u ndërpre nga kryerja e veprës së dytë, ashtu edhe për veprën e dytë penale, për të cilën sapo ka përfunduar ekzekutimin e dënimit.

133. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji e vlerëson të pabazuar qëndrimin e mbajtur nga disa gjykata që kryerja e një vepre tjetër penale ia mohon përfundimisht të drejtën për t'u rehabilituar të dënuarit. Ky qëndrim jo vetëm që nuk mbështetet në qëllimin e ligjvënësit, por bie ndesh edhe me praktikën e sipërcituar të GJEDNJ-së. Kryerja e një vepre tjetër penale kushtëzon rehabilitimin e të dënuarit, pasi provon se dënimi nuk e ka realizuar funksionin e tij rehabilitues, e për rrjedhojë të dënuarit nuk i takon e drejta për t'u konsideruar i padënuar në fund të afatit ligjor. Megjithatë, ai nuk e humbet përfundimisht këtë të drejtë, por mund të thuhet se kjo e drejtë i pezullohet në kohë, për aq kohë sa ai të plotësojë edhe një herë afatin e rehabilitimit, që do të fillojë të llogaritet nga e para. Në përfundim të vuajtjes së dënimit për veprën e dytë të kryer, të dënuarit i lind e drejta që t'i fillojë të ecë afati i rehabilitimit për të dyja veprat e kryera.

134. Në këto kushte, Kolegji konkludon se kryerja e një vepre tjetër penale e penalizon të dënuarin, pasi i heq të drejtën për t'u rehabilituar në fund të afatit që parashikon ligji. Megjithatë, këtë të drejtë ai nuk e humbet përfundimisht, pasi afati i rehabilitimit do të nisë edhe një herë nga e para kur i dënuari të ketë përfunduar vuajtjen e dënimit të caktuar ndaj tij për veprën e dytë.

135. Nga mënyra e interpretimit gramatikor të nenit 69 të Kodit Penal, që kryejnë disa gjykata në vendimmarrjen e tyre, mund të deduktohet se nëse personat e dënuar kryejnë vepër tjetër penale gjatë afatit të rehabilitimit, ata nuk do mund të rehabilitohen asnjëherë, duke mos iu fshirë asnjëherë dënimet nga certifikata e gjendjes gjyqësore. Por kjo mënyrë e interpretimit ligjor të dispozitës do të mohonte të drejtën e dinjitetit të personave të dënuar, si edhe nuk do garantonte parimin e humanizmit, të cilat janë parime themelore kushtetuese të çdo shoqërie demokratike. Kështu, me qëllim që të garantohet e drejta e dinjitetit të personave të dënuar është e nevojshme që dispozitat ligjore të interpretohen me mënyrat e tjera shkencore, të cilat gjejnë zbatim sa herë që ligji mungon, është i paplotë ose i paqartë.

136. Në këtë rast, nëpërmjet interpretimit logjik dhe sistematik të dispozitave ligjore në tërësi, arrihet në konkluzionin që edhe personat që dënohen sërish gjatë afatit të rehabilitimit, kanë të drejtë të rehabilitohen, duke

u konsideruar të padënuar. Por për këta persona, për sa kohë që ligji nuk shprehet në mënyrë eksplicite, afati për rehabilitimin do të ndërpritet në momentin kur dënohen sërish për kryerjen e veprave penale dhe do të rifillojë nga e para nga momenti i vuajtjes së dënimit të fundit.

137. Ky qëndrim pasqyron parimet themelore kushtetuese të dinjitetit njerëzor dhe humanizmit në caktimin dhe vuajtjen e dënimeve penale. Për sa i përket momentit të fillimit të afatit të rehabilitimit, Kolegji konkludon se afati duhet të fillojë nga dita e vuajtjes së dënimit, përcaktim që e bën vet dispozita dhe jo nga dita kur vendimi i dënimit merr formë të prerë, siç llogaritet në disa raste në praktikë.

138. Një interpretim i tillë është konform qëllimit, funksionit që ka instituti i rehabilitimit nga njëra anë, por nga ana tjetër mbështet edhe mundësinë e të dënuarit për t'u rehabilituar, për t'u riintegruar në shoqëri dhe që të përfitojë të gjitha të drejtat që kishte para kryerjes së veprave penale, përfshirë të drejtën për të qenë i padënuar.

139. Në referim të legjislacioneve të tjera, vihet re se ka vende si Italia që e rregullojnë shprehimisht situatën e të qenit recidiv/përsëritës në kryerjen e veprës penale dhe pasojave të kësaj rrethane tek instituti i rehabilitimit. Neni 179/1 i Kodit Penal italian parashikon se afati i rehabilitimit të të dënuarit është tre vjet nga momenti i shlyerjes së dënimit, si dhe kur i dënuari ka shfaqur sjellje të mirë. Gjithashtu, paragrafi II i dispozitës parashikon se ky afat është të paktën 8 vjet nëse bëhet fjalë për të dënuar recidivist. Pra, ligji italian e ka rregulluar shprehimisht afatin nëse i dënuari që pretendon rehabilitimin është përsëritës në kryerjen e veprës penale. Paragrafi i tretë i dispozitës vijon duke përcaktuar se afati i rehabilitimit është 10 vjet nëse bëhet fjalë për të dënuar me veprimtari të spikatur kriminale apo me tendencë kriminale, rrezikshmëria shoqërore e të cilëve vlerësohet si më e lartë.

140. Edhe ligji penal francez e parashikon shprehimisht situatën e të qenit recidivist dhe pasojën e kësaj rrethane për efekt të rehabilitimit. Sipas nenit 133-13 të Kodit Penal: *"Afatet e parashikuara në këtë nen dyfishohen kur personi është dënuar për veprat e kryera në gjendje recidivizmi ligjor.*

Në rastin e dënimeve të shoqëruara tërësisht ose pjesërisht me dënim me kusht, ose dënim me kusht me detyrimin për të kryer një punë në interes publik, afatet e rehabilitimit mbarojnë për secilën prej dënimeve dhe në rastin e dënimeve të shumëfishta, nga data në të cilën dënimi konsiderohet i paqenë."

141. Referuar interpretimit të mësipërm, duke marrë në konsideratë parimet e përgjithshme, natyrën e institutit të rehabilitimit, praktikën e GJEDNJ-së në lidhje me këtë të drejtë, si dhe rregullimin që bëjnë legjislacionet e vendeve fqinje, Kolegji vlerëson se përgjigjja e pyetjes së pestë të shtruar për njësim është:

V. Kryerja e një vepre tjetër penale gjatë kohës që nuk është plotësuar afati i parashikuar në nenin 69 të Kodit Penal për t'u konsideruar i rehabilituar nuk përbën shkak që subjektit t'i mohohet përfundimisht e drejta për të përfituar nga instituti i rehabilitimit. Kryerja e një vepre tjetër penale sjell si pasojë që afati i parashikuar nga neni 69 i Kodit Penal të rifillojë të llogaritet nga përfundimi i vuajtjes së dënimit të fundit.

Në rast se i dënuari, gjatë periudhës për plotësimin e afatit për t'u rehabilituar, dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër tjetër penale, me përfundimin e vuajtjes së dënimit për veprën tjetër, do të fillojnë të ecin njëkohësisht afatet që parashikohen në nenin 69 të Kodit Penal për t'u rehabilituar edhe për vepra të tjera penale, duke u konsideruar si afat rehabilitimi ***afati më i gjatë.***

142. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete, e cila u bë shkak për njësimin e praktikës gjyqësore, Kolegji vlerëson se kërkuesi Kujtim Delishi përmbush kriteret për rehabilitim, sipas nenit 69, shkronja "a" të Kodit Penal. Rezulton se kërkuesi Kujtim Delishi është deklaruar fajtor për veprën penale "Kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit", parashikuar nga neni 316 i Kodit Penal dhe është dënuar përfundimisht me 6 muaj burgim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 16.3.2015 kur Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur mospranimin e ankimit.

143. Gjithashtu, kërkuesi Kujtim Delishi është deklaruar fajtor me vendimin nr. 158, datë 30.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë për veprën penale "Përndjekja", parashikuar nga neni 121/a i Kodit Penal dhe është dënuar përfundimisht me 5 muaj e 10 ditë burgim. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u apeluar në gjykatat e shkallëve më të larta. Kolegji vlerëson se, me përfundimin e vuajtjes së dënimit të dytë, kërkuesit i lind e drejta e rehabilitimit për të dyja vendimet penale. Në rastin konkret, për secilin dënim kërkuesi ka të drejtë rehabilitimi pas një afati 2-vjeçar, afat që fillon të llogaritet nga vuajtja e dënimit të dytë.

144. Kolegji vlerëson se për kërkuesin Kujtim Delishi është plotësuar afati i rehabilitimit që kërkon neni 69, shkronja "a" i Kodit Penal për secilin prej dënimeve, prandaj kërkesa e tij për njohjen e së drejtës së rehabilitimit duhet pranuar. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se, duke qenë se çështja lidhet vetëm me interpretimin e ligjit material penal dhe nuk konsiston në rivlerësim faktesh dhe provash, janë kushtet për ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe pranimin e kërkesës së kërkuesit Kujtim Delishi.

145. Sa më sipër, në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete, Kolegji vendos ndryshimin e vendimit nr. 7, datë 5.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe vendimit nr. 72, datë 25.3.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër

dhe pranimin e kërkesës së kërkuesit Kujtim Delishi për t'u konsideruar i rehabilituar ndaj vendimeve penale nr. 55-04, datë 20.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe nr. 158, datë 30.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 438 dhe 441, pika 1, shkronja "dh" të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 7, datë 5.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe vendimit nr. 72, datë 25.3.2019, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe pranimin e kërkesës së kërkuesit Kujtim Delishi për t'u konsideruar i rehabilituar ndaj vendimeve penale nr. 55-04, datë 20.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe nr. 158, datë 30.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

2. Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore publikohet në Fletoren Zyrtare të radhës.

Tiranë, më 7.4.2022

KRYESUES: Sokol Sadushi (kundër për pikën 3)
ANËTAR: Ervin Pupe
ANËTARË KUNDËR: Ilir Panda dhe Sandër Simoni (kundër për pikën 2), Sokol Binaj (kundër pjesërisht për pikën 3)

MENDIM I PAKICËS

NGA GJYQTARËT ILIR PANDA DHE SANDËR SIMONI, LIDHUR ME PËRGJIGJEN E PYETJES SË DYTË TË SHTRUAR PËR NJËSIM

1. Ne gjyqtarët Ilir Panda dhe Sandër Simoni jemi kundër qëndrimit njësues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në çështjen penale regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 70007-00466-2019, vetëm në lidhje me përgjigjen e dhënë për pyetjen e dytë të shtruar për njësim: *Cilit juridiksion i përket kompetenca e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave, për dhënien e informacionit apo për pretendimet eventuale mbi saktësinë e këtij informacioni që përmban regjistri i gjendjes gjyqësore?*

2. Për këtë arsye, më poshtë po paraqesim argumentet dhe qëndrimin tonë në lidhje me pyetjen e mësipërme të shtruar për njësim prej Kolegjit;

3. Në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për njësim, se cilit juridiksion i përket kompetenca e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave, për dhënien e informacionit apo për pretendimet eventuale mbi saktësinë e këtij informacioni që përmban regjistri i gjendjes gjyqësore, jemi të mendimit se ajo që ndan juridiksionin është natyra dhe lënda e pretendimeve që ngre subjekti në lidhje me veprimtarinë e gjendjes gjyqësore. Prandaj kjo pyetje duhet trajtuar dhe duhet t'i kthehet përgjigje së bashku me pyetjen e tretë se referuar pretendimeve të personit që pretendon se plotëson kriteret ligjore për të përfituar nga rehabilitimi, sipas nenit 69 të KP, por nuk arrin të realizojë këtë të drejtë, për shkak të refuzimit të shfaqur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar këto pretendime?

4. Jemi të mendimit se është e nevojshme të theksohet se thelbi i pyetjes së dytë dhe të tretë, të shtruar për njësim lidhet me faktin se: Cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar kërkesën e palës që pretendon të drejtën e rehabilitimit, sipas nenit 69 të KP, kur kjo e drejtë i është refuzuar nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore?

5. Kolegji në praktikën e tij ka rikonfirmuar qëndrimin se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Ky Kolegj thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejtë *(shih*

vendimin nr. 917, datë 11.5.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).

6. Kompetenca lëndore është një parakusht procedural, i cili determinon konceptin e gjykatës së krijuar me ligj. "gjykata e krijuar me ligj" është pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar edhe nga neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim KEDNJ). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim GJEDNJ) në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka trajtuar kuptimin e "gjykatës së krijuar me ligj" duke përcaktuar se në kuadër të procesit të rregullt ligjor gjykatat gjithmonë duhet të jenë të krijuara me ligj. Kjo shprehje pasqyron parimin e shtetit të së drejtës që është pjesë e pandarë e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut parashikuar nga KEDNJ dhe Protokollet e saj.[24] Një organ i pakrijuar me ligj, do të privohej nga legjitimiteti i kërkuar në një shoqëri demokratike për të dëgjuar ankesat e individëve.[25]

7. Termi "Ligj", në kuptim të nenit 6/1 të KEDNJ, sipas jurisprudencës së GJEDNJ, përfshin, në veçanti, jo vetëm legjislacionin që përcakton krijimin dhe funksionimin (kompetencën) e organeve gjyqësore por edhe çdo dispozitë ligjore të legjislacionit të brendshëm që, nëse shkelet, do ta shndërronte pjesëmarrjen e një ose më shumë gjyqtarëve në shqyrtimin e një çështje konkrete në një pjesëmarrje të paligjshme.[26] Shprehja "e caktuar me ligj" përfshin bazën ligjore për ekzistencën e gjykatës, pajtueshmërinë e veprimtarisë së gjykatës me normat e veçanta që rregullojnë veprimtarinë e saj, si dhe përbërja (kompozimi) e gjykatës në çdo rast që ajo merr në shqyrtim.[27]

8. Qëndrimi i konsoliduar jo vetëm i Kolegjit Penal, por i Gjykatës së Lartë në tërësi, është që kompetenca lëndore e gjykatës përcaktohet nga natyra e mosmarrëveshjes, nga lënda e së drejtës që pretendohet dhe jo nga subjektet pjesëmarrës në gjykim. Fakti që një nga palët në mosmarrëveshje është organ i administratës publike nuk do të thotë që mosmarrëveshja që lind me këtë organ i përket automatikisht gjykatës administrative, kur në thelb e drejta që pretendon pala i përket një lënde të caktuar, civile ose penale.

9. Kolegji Civil ka mbajtur qëndrimin se, kompetenca lëndore e një mosmarrëveshje i referohet objektit të gjykimit, natyrës së konfliktit që ajo përmban, pra lëndës së gjykimit dhe jo palëve ndërgjyqëse. Fakti që palë e paditur në këtë mosmarreveshje është një organ i administratës publike nuk kushtëzon natyrën e mosmarrëveshjes dhe as përcakton kompetencën lëndore të gjykatës. Karakteristikat e subjektit që kryen cenimin, subjekt privat apo organ i administratës publike, nuk ndryshojnë natyrën e mosmarrëveshjes. Nëse do të përcaktohej kompetenca lëndore e gjykatës referuar palës së paditur, atëherë do të kishim një përcaktim artificial të kompetencës lëndore, duke bërë që ajo të vlerësohej si administrative sa herë që palë e paditur do të ishte një organ i administratës publike, pavarësisht natyrës civile të mosmarrëveshjes. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se padia objekt gjykimi është në thelb një padi mohuese, ku pala paditëse kërkon nga pala e paditur pushimin e cenimit në të drejtën e tij të pronësisë. Kjo padi i përket lëndës të së drejtës civile pavarësisht natyrës që ka pala e paditur në këtë gjykim. *(shih vendimin e Kolegjit Civil nr. 00-2020- 627, datë 11.11.2020)*

10. Ashtu siç ka mbajtur qëndrim Kolegji Administrativ, për të përcaktuar natyrën e një mosmarrëveshje nuk mjafton që gjykatat të identifikojnë vetëm atë që shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë apo, e thënë ndryshe, kërkimin *prima facie* të saj. Ato duhet të shqyrtojnë më tej faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve. Vetëm pas analizimit me kujdes të kërkimeve të padisë, të së drejtës subjektive të pretenduar si të shkelur dhe të faktit të paligjshëm që pretendohet ta ketë shkelur këtë të drejtë subjektive, si dhe pas ballafaqimit të tyre me dispozitat e së drejtës objektive, gjykata mund të arrijë në një përfundim të saktë mbi natyrën e mosmarrëveshjes (*shih vendimin nr. 112, datë 8.6.2020, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

11. Përgatitja, gjykimi e zgjidhja e çështjes nuk mund të bazohet vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen "objekti i padisë" dhe "baza ligjore" e saj. Gjykata kur zgjidh mosmarrëveshjen merr në shqyrtim pretendimet e paditësit të cilat parashtrohen në kërkesëpadi, si dhe gjatë ushtrimit të së drejtave që rrjedhin nga procesi, duke mbajtur parasysh se konform neneve 5, 31, 154 e 185 të KPC-së objekti i padisë dhe shkaku i saj nuk përmblidhen domosdoshmërisht vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë. Gjykata ka detyrimin të vlerësojë dhe të marrë parasysh të gjithë përmbajtjen e padisë dhe të

[24] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Jorgic k. Gjermanisë* nr. aplikimi 74613/01, datë 12.7.2007, paragrafi i 64; *Richert kundër Polonisë,* nr. aplikimi 54809/07, datë 25.1.2012, paragrafi 41;

[25] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Lavents v Latvia* nr. aplikimi 58422/00, datë 28.2.2003, paragrafi 114; *Gorgiladze kundër Gjerogjisë;* Nr. aplikimi 4313/04, datë 20.10.2009, paragrafi 67; *Kontalexis kundër Greqisë* nr. aplikimi 59000/08, datë 21. 11. 2011, paragrafi 38.

[26] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Pandjikidzeandothers kundër Gjerogjisë* nr. aplikimi 30323/02, datë 27.1.2010, paragrafi 104.

[27] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Posokhov k. Rusisë,* nr. aplikimi 63486/00, datë 4.6.2003, paragrafi 39; *Fatullayev k. Azerbaizhanit* nr. aplikimi 40984/07, datë 4.10.2010, paragrafi 144.

identifikojë kërkimet e paditësit, në mënyrë që të mund të japë një vendim për to. Pala paditëse ka të drejtë të ngrejë pretendime për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që i njeh Kushtetuta apo ligji, ndërsa gjykata, në zbatim të parimit *iura novit curia*, analizon ligjërisht në mënyrë të pavarur këto pretendime, pa u lidhur me përcaktimin e palëve (*shih vendimin njësues nr. 3, datë 29.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ∫28*).

12. Qëndrimi i mësipërm është mbajtur në mënyrë të vazhdueshme dhe konsistente nga të tria Kolegjet e Gjykatës së Lartë, ku natyra dhe lënda e mosmarrëveshjes përcakton kompetencën lëndore të gjykatës. Interpretimi strikt i natyrës së mosmarrëveshjes duke iu referuar vetëm objektit të padisë apo kërkimit dhe jo shkakut ligjor të saj, do të çonte në një përfundim të gabuar në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës që duhet të shqyrtojë mosmarrëveshjen. Në të njëjtën linjë arsyetimi, mendoj se kur kërkuesi pretendon se ka të drejtë të përfitojë nga instituti i rehabilitimit, por Zyra e Gjendjes Gjyqësore nuk ia njeh këtë të drejtë, atëherë ai ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës duke pretenduar njohjen e së drejtës së rehabilitimit sipas nenit 69 të KP-së. Kjo gjykatë është gjykata e rrethit gjyqësor, konkretisht dhoma penale, pikërisht sepse natyra e së drejtës që pretendon dhe kërkon t'i njihet subjektit është e drejtë penale materiale, e drejta e të dënuarit për t'u konsideruar i rehabilituar kur përmbush kushtet që kërkon neni 69 i KP-së.

13. Jemi të mendimit se në çështjen konkrete, natyra e mosmarrëveshjes nuk duhet parë në mënyrë të ngushtë, duke e konsideruar objektin e mosmarrëveshjes si padi me objekt detyrimin e organit administrativ të kryejë një veprim administrativ që refuzon ta kryejë për subjektin. Në thelb kërkuesi pretendon njohjen e një të drejte materiale penale, e drejta për rehabilitim dhe mosveprimi i organit administrativ lidhet pikërisht me faktin se subjekti nuk ka të njohur të drejtën materiale, e cila nëse do të ishte e qartë dhe e njohur do ta detyronte organin, në këtë rast Zyrën e Gjendjes Gjyqësore të vepronte dhe të lëshonte certifikatën e gjendjes gjyqësore me shënimin "i rehabilituar", ashtu siç pretendon kërkuesi.

14. Për të identifikuar një mosmarrëveshje si administrative ose jo duhet që kumulativisht të plotësohen tri kushte, siç janë përpunuar nga praktika gjyqësore. Kriteret që gjykatat duhet të mbajnë parasysh nëse një mosmarrëveshje është apo jo e natyrës administrative kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i së drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik *(shih vendimin nr. 2, datë 10.3.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ∫23*).

15. Në çështjen objekt gjykimi, njëkohësisht të shtruar për njësim prej Kolegjit, mendoj se nuk përmbushen në mënyrë kumulative kushtet e mësipërme, në mënyrë që mosmarrëveshja të përfshihet në lëndën e gjykimit administrativ. Mendoj se pretendimi i kërkuesit për t'iu u njohur e drejta e rehabilitimit nuk është një çështje që i përket interesit publik, por dukshëm kanalizohet si interes privat i një shtetasi të dënuar për të përfituar nga e drejta e rehabilitimit, njohur nga neni 69 i KP-së.

16. Pavarësisht se në pamje të parë duket sikur objekti i mosmarrëveshjes lidhet me mosveprimin e organit publik, Zyrën e Gjendjes Gjyqësore për të kryer një veprim administrativ, nga interpretimi dhe vlerësimi i drejtë i shkakut të kërkimit, kërkuesi në thelb kërkon t'i njihet e drejta për t'u konsideruar i rehabilituar, e drejtë penale materiale që rregullohet nga neni 69 i KP-së. Kërkuesi kërkon t'i njihet e drejta e rehabilitimit, sipas nenit 69 të KP-së. Kërkuesi nuk padit organin publik dhe as kërkon kryerjen e ndonjë veprimi administrativ prej tij, apo ndryshimin e një akti administrativ. Zyra e Gjendjes Gjyqësore në këtë gjykim paraqitet në cilësinë e personit të interesuar dhe jo palës së paditur, pikërisht se natyra e mosmarrëveshjes nuk lidhet drejtpërdrejt me mosveprimin e saj, por me njohjen në thelb të së drejtës materiale penale të parashikuar nga neni 69 i KP-së, së drejtës për t'u rehabilituar.

17. Megjithatë, ndajmë qëndrimin se as cilësia procedurale e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore si person i interesuar nuk është faktor determinant që përcakton natyrën e mosmarrëveshjes dhe për rrjedhojë kompetencën e gjykatës që do të shqyrtojë mosmarrëveshjen. Është natyra e së drejtës që pretendohet të njihet me anë të gjykimit ajo që përcakton thelbin, lëndën e mosmarrëveshjes dhe për rrjedhojë edhe kompetencën lëndore të gjykatës. Pavarësisht se kjo e drejtë njihet dhe shënohet në regjistrin përkatës nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore që është organ i administratës publike, në rast se subjekti ka pretendime në lidhje me të drejtën e rehabilitimit atëherë ai duhet t'i drejtohet gjykatës penale, që është gjykata e krijuar me ligj për interpretimin e së drejtës penale materiale dhe për njohjen e një të drejte penale materiale, siç është e drejta e të dënuarit për t'u konsideruar i rehabilituar, sipas nenit 69 të KP-së.

18. Instituti i rehabilitimit është në thelb një institut juridiko-penal dhe konflikti nuk ka lindur sepse kërkuesi kërkon që të detyrohet organi publik që të kryejë një veprim administrativ dhe/ose i cili është refuzuar, duke pasqyruar në vërtetimin e gjendjes gjyqësore faktin e pretenduar prej tij, rehabilitimin apo pasqyrimin e shënimeve si i padënuar. Kërkuesi Kujtim Delishi në rastin konkret kërkon njohjen e së drejtës së rehabilitimit, e drejtë penale materiale dhe konflikti ka lindur pikërisht për shkak të mosnjohjes së kësaj të drejte dhe jo për shkak të mosveprimit të organit publik.

19. Në këtë linjë arsyetimi, jemi të mendimit se përgjigjja e pyetjes së dytë të shtruar për njësim është: ***Kompetenca e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave, për dhënien e informacionit apo për pretendimet eventuale mbi saktësinë e këtij informacioni që përmban regjistri i gjendjes gjyqësore i përket juridiksionit gjyqësor penal, duke qenë se ka në thelb njohjen e së drejtës penale materiale për t'u rehabilituar, që rregullohet nga neni 69 i Kodit Penal.***

Tiranë, më 7.4.2022

ANËTARË: Ilir Panda, Sandër Simoni

MENDIMI I PAKICËS

Duke qenë i dakordësuar me këtë vendim njësues me përgjigjen e pyetjes së parë, të dytë, të katërt dhe të pestë, përfundimi në të cilin ka arritur shumica për përgjigjen e pyetjes së tretë, më detyron të pozicionohem, vetëm për këtë çështje, si gjyqtar në pakicë. Me gjithë dëshirën për të qenë pjesë e shumicës për të gjitha çështjet e shtruara për njësim, arsyetimi që është ndjekur për zgjidhjen e çështjes së tretë, në fakt kundërshton përgjigjet që janë dhënë për dy çështjet e para.

Duke vijuar qëndrimin e mbajtur nga vetë shumica në përgjigjen e pyetjes së parë dhe të dytë, do argumentoj përgjigjen time për pyetjen e tretë, që fatkeqësisht nuk përputhet me atë linjë arsyetimi që mbahet në këtë vendim njësues.

Vija ndarëse mes opinionit tim dhe shumicës fokusohet te qëndrimi që duhet mbajtur ndaj kërkesës për rehabilitim që paraqet një person, i cili e ka vuajtur më parë dënimin penal. Pra, çështja shtrohet nëse kërkesa për rehabilitim do të konsiderohet e përmbushur përmes ndjekjes së procesit administrativ të regjistrimit, hedhjes, fshirjes së të dhënave në regjistrat publik, mosrespektimi i të cilit investon gjykatën administrative, apo do të duhet të investohet gjykata penale në një procedurë që vlerëson kërkesën për rehabilitim?

Tri pyetjet e para që janë shtruar për njësim kanë një lidhje të drejtpërdrejtë mes tyre, ndërkohë që përgjigjet e dhëna për dy prej tyre, krahasuar me të tretën, nuk përputhen. Përgjigjja e dhënë për pyetjen e parë, se: "*Procesi i hedhjes së të dhënave, shënimeve dhe heqja e tyre në regjistrin e gjendjes gjyqësore... nuk përfshihet në fazën e ekzekutimit të vendimit penal",* ka sjell natyrshëm edhe përgjigjen e pyetjes së dytë, se: "*Kompetenca e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave, për dhënien e informacionit apo për pretendimet eventuale mbi saktësinë e këtij informacioni që përmban regjistri i gjendjes gjyqësore i përket juridiksionit gjyqësor administrativ"*, por që në të vërtetë nuk përputhen me përgjigjen e dhënë për pyetjen e tretë, se: "*Kur një person pretendon se plotëson kriteret ligjore për të përfituar nga rehabilitimi, sipas nenit 69 të Kodit Penal, por nuk arrin të realizojë këtë të drejtë për shkak të refuzimit të shfaqur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, gjykata kompetente që vendos për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje do të jetë gjykata penale e rrethit gjyqësor që ka dhënë vendimin penal ndaj kërkuesit që pretendon rehabilitimin."*

Sipas shumicës, kompetencat e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore si hedhja e të dhënave, përpunimi dhe ruajtja e tyre, kryerja e veprimeve logjike mbi këto të dhëna, mbrojtja nga ndryshimet, marrja, shpërndarja e tyre nëpërmjet niveleve të sigurisë, kryerjen dhe heqja e shënimeve nuk e përfshijnë njohjen e së drejtës për t'u quajtur i rehabilituar.

Si gjyqtar në pakicë nuk mund të pajtohem me këtë konkluzion të shumicës. Përpara se të jepet kuptimi për procesin e hedhjes së të dhënave, shënimeve, si dhe heqjen e tyre nga regjistri i gjendjes gjyqësore dhe se çfarë ndikimi sjell ky (mos)veprim administrativ në procedurën e ekzekutimit të një vendimi penal, duhet të bëhet një analizë e qartë e statusit që gëzon Zyra e Gjendjes Gjyqësore, mënyra e organizmit dhe e funksionimit të saj, pozicioni që ka në organizimin shtetëror, lidhjet e varësisë hierarkike, kompetencat që ushtron, si dhe përgjegjësia që mban në rast të mosushtrimit të pushtetit, për të cilin është ngarkuar nga ligji.

Sipas nenit 3, të ligjit nr. 9614, datë 21.9.2006 *"Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore"*, "Zyra e Gjendjes Gjyqësore funksionon në Ministrinë e Drejtësisë" dhe se "organizimi dhe struktura e saj miratohen nga ministri i Drejtësisë". Si një organ publik dhe në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit të Drejtësisë, zyra kryen disa funksione

administrative që lidhen me *"mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave në regjistrin themeltar elektronik të gjendjes gjyqësore, në regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore, si dhe në regjistrin shkresor të gjendjes gjyqësore."*. I tërë procesi i hedhjes së të dhënave, shënimeve apo heqja e tyre nga këto regjistra (ku sipas nenit 2, pika 3 të ligjit 9614/2006, krahas të dhënave për dënimet penale, përfshihet edhe rehabilitimi), realizohet sipas kompetencave që ushtron organi publik, brenda juridiksionit të tij administrativ dhe pa ndonjë ndikim apo impakt nga juridiksioni penal. Është ky organizëm shtetëror që ka autoritet të plotë për të përmbushur këtë detyrim ligjor. Ky proces realizohet në formë shkresore dhe elektronike në regjistrat përkatës që emërtohen "regjistër shkresor i gjendjes gjyqësore", "regjistër themeltar elektronik i gjendjes gjyqësore" dhe "regjistër elektronik i gjendjes gjyqësore".

Procesi i hedhjes së të dhënave me shkrim në regjistër, referuar nenit 481 të KPP-së fillon pas depozitimit nga gjykata e shkallës së parë të shkurtimeve të vendimeve për personat e gjykuar penalisht. Pavarësisht se gjykata dërgon në zyrën e regjistrit gjyqësor shkurtimin e vendimit të dënimit, si kur ato kanë marrë formë të prerë, ashtu edhe kur ndaj tyre është ushtruar ankim, për efekt të hedhjes së të dhënave në regjistrin e gjendjes gjyqësore, personi i autorizuar do të bëjë shënimet vetëm për rastet që parashikohen në nenin 482 të KPP-së. Sipas këtij rregullimi ligjor, në regjistrin gjyqësor regjistrohen me shkurtim vendimet e dënimit me të marrë formë të prerë, vendimet e dhëna nga gjykata në fazën e ekzekutimit, vendimet që lidhen me zbatimin e vendimeve plotësuese, si dhe vendimet gjyqësore të pafajësisë e të pushimit të çështjes. Ky është një proces administrativ ku këto të dhëna që dërgohen nga gjykatat përpunohen në mënyrë automatike dhe shkresore nga punonjësi i zyrës, me qëllim krijimin e një arkivi të dhënash që përdoren apo vihen në dispozicion të organeve apo shtetasve, sipas kërkesave të ligjit.

Jo pa qëllim ligjvënësi ka autorizuar Zyrën e Gjendjes Gjyqësore si një subjekt i profilizuar dhe i specializuar që të përpunojë të gjithë të dhënat, në mënyrë automatike dhe shkresore, duke qenë e gjithëpushtetshme në funksionin e saj *"për kryerjen e veprime logjike dhe/ose aritmetike mbi këto të dhëna"* që i dërgon gjykata. Si hedhja e të dhënave, ashtu edhe heqja e shënimeve nga regjistrat (ku përfshihet edhe hedhja e shënimit *"i rehabilituar"*) kryhen nga kjo zyrë mbi atë dokumentacion ligjor që i dërgohet nga gjykata, në të cilin evidentohen vendimet përkatëse, sipas specifikimeve që parashikohen në nenet 482 dhe 483 të KPP-së. Pikërisht, kryerja e veprimeve logjike dhe/ose aritmetike mbi të dhënat që lidhen me një person që është dënuar më parë, përfshijnë edhe llogaritjen e kohës që ka kaluar nga vuajtja e dënimit për personin e dënuar që kërkon të rehabilitohet. Pra, llogaritja e afatit që ka kaluar nga vuajtja e dënimit është në vetvete një e dhënë që duhet të përpunohet për t'u hedhur në regjistrat përkatës nga personi i autorizuar i Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, pa qenë nevoja e kryerjes së një procedure *ekstra ligjore* në gjykatën penale, siç arsyeton shumica në vendimin e saj. Si gjyqtar në pakicë vlerësoj se kjo është një procedurë *extra ligjore* përderisa KPP-ja nuk parashikon ndonjë rregullim specifik që të bëjë kompetente gjykatën penale për shqyrtimin e kërkesës për njohjen si të rehabilituar.

Edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së, kur analizon rehabilitimin i referohet konceptit të mbledhjes, ruajtjes dhe fshirjes së të dhënave nga regjistrat publikë. Në çështjen M.M. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2012 (§§187–207), GJEDNJ-së arriti në përfundimin se regjistrimi përjetësisht i një dënimi në regjistrat e policisë, përbën shkelje të nenit 8 të Konventës. Gjykata mori në konsideratë faktin se dënimi i dhënë ndaj një individi në të kaluarën, me kalimin e kohës bëhet pjesë integrale e jetës së tij private, e cila duhet të respektohet. Edhe pse të dhënat për rekordet penale janë në një kuptim, informacion i lidhur me interesin publik, ruajtja e tij sistematike në dosjet qendrore nënkupton që ky informacion të bëhet publik pas një farë kohe, atëherë kur çdokush, përveç subjektit të të dhënave, e ka harruar këtë incident. Gjykata konkludoi se ishte shqetësues fakti që kriteret për të lejuar fshirjen e këtyre të dhënave ishin shumë strikte dhe kërkesa për fshirje pranohej vetëm në raste përjashtimore. (ibid., §202)

GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se, ndërsa një shtet ka marzhin e vet të vlerësimit për mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave është e rëndësishme që të ketë mekanizma mbrojtës që lejojnë fshirjen e këtyre të dhënave personale kur mbajtja e tyre e mëtejshme bëhet joproporcionale. *(Catt kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2019, §119; Gaughran kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2020, §94).* Mungesa e masave mbrojtëse efektive për fshirjen e të dhënave personale të cilat nuk janë më relevante, referuar qëllimit të ruajtjes së tyre është veçanërisht shqetësuese në rastin e kategorive të veçanta të të dhënave të ndjeshme për të cilat ekziston një nivel më i lartë mbrojtjeje. *(Catt kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2019, §112.)*

Sipas kësaj jurisprudence të zhvilluar, por edhe vetë parashikimit që bën legjislacioni shqiptar, hedhja e shënimit *"i rehabilituar",* ndryshe nga sa shprehet shumica, nuk mund të përjashtohet nga procesi i hedhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave, kryerja e veprimeve logjike mbi to, mbrojtja nga ndryshimet, si dhe kryerja dhe heqja e shënimeve. Pikërisht, i tërë ky proces i hedhjes, përpunimit dhe fshirjes së të dhënave realizohet nëpërmjet kësaj zyre, si dhe personave të specializuar brenda saj, të cilët kanë të gjithë autoritetin për të

përmbushur detyrimet që ligji i ngarkon.

Ndryshe nga sa ligji parashikon për pozicionin që ka Zyra e Gjendjes Gjyqësore, si dhe për natyrën e veprimeve që ajo kryen, në përgjigjen për pyetjen e tretë, që lidhet me rastin kur kërkuesi pretendon se ka të drejtë të përfitojë nga instituti i rehabilitimit, por zyra nuk ia njeh këtë të drejtë, shumica konkludon se ai duhet t'i drejtohet gjykatës penale, sipas nenit 69 të KP-së. Pra, meqenëse në thelb kërkohet njohja e së drejtës për t'u konsideruar i rehabilituar, si e drejtë penale materiale që rregullohet nga kjo dispozitë e KP-së, atëherë kompetente sipas qëndrimit të shumicës është gjykata penale. Argumenti i vetëm mbi kompetencën e gjykatës është fokusuar te fakti se është një kërkim i së drejtës materiale dhe jo te natyra e mosmarrëveshjes që ka lindur ndërmjet një individi dhe mospërmbushjes së detyrës apo mosushtrimit të pushtetit ligjor nga organi publik.

Nëse do të pranonim këtë kriter si përcaktues, padyshim që do të ndodheshim përpara një paradoksi për rastin kur në një gjykim penal ngrihet padia civile, që në thelb është një kërkim i së drejtës civile materiale (shkaktimi i dëmit), atëherë do të konkludonim se nuk është kompetente gjykata penale, por ajo civile! Po ashtu edhe kërkesa për kompensimin për burgim të padrejtë, që parashikohet në nenin 268 të KPP-së, nuk do të vendosej nga gjykata administrative, por nga gjykata penale! Sigurisht që një gjë e tillë nuk mund të ndodhë.

Kompetenca e gjykatës nuk lidhet apo nuk qëndron e ndërvarur thjesht dhe vetëm nga natyra e kërkimit të një të drejte materiale, penale apo civile, por nga shkaku mbi të cilin ka lindur mosmarrëveshja. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë ka mbajtur në mënyrë të vazhdueshme dhe konsistente qëndrimin, sipas të cilit natyra dhe lënda e mosmarrëveshjes juridike përcakton kompetencën lëndore të gjykatës. Për të përcaktuar natyrën e një mosmarrëveshje nuk mjafton vetëm identifikimi formalisht i kërkimit të palës. Vetëm pas analizimit me kujdes të kërkimeve të palës, të së drejtës subjektive të pretenduar si të shkelur dhe të faktit të paligjshëm që pretendohet ta ketë shkelur këtë të drejtë subjektive, si dhe pas ballafaqimit të tyre me dispozitat e së drejtës objektive, gjykata mund të arrijë në një përfundim të saktë mbi natyrën e mosmarrëveshjes.

Në rastin në shqyrtim, kërkimi i subjektit lidhet drejtpërdrejt me njohjen e së drejtës për t'u rehabilituar si një e drejtë kushtetuese. Kur e drejta e subjektit për të qenë i rehabilituar cenohet nga një fakt i paligjshëm që janë veprimet ose mosveprimet e një organi publik, i ngarkuar me ligj për të ushtruar pushtetin e konsiderimit *"i rehabilituar"*, atëherë do të kërkohet ballafaqimi i këtij pretendimi për shkeljen ligjore të kryer nga organi publik me të drejtën objektive, pra me ligjin konkret që ka shkelur nëpunësi publik. Pyetja që lind natyrshëm është se cili ligj është shkelur në këtë rast?

Rregullat bazë që rregullojnë veprimtarinë e ushtrimit të detyrës nga punonjësi i autorizuar i Zyrës së Gjendjes Gjyqësore që bën përpunimin automatik të të dhënave, si dhe kryen veprimet logjike dhe/ose aritmetike mbi këto të dhëna, mënyrën se si duhet ta ushtrojë këtë pushtet administrativ, detyrimin që ka për të hequr shënimin përkatës në regjistrin e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore etj., janë nenet 481- 484 të KPP-së dhe, në veçanti, ligji nr. 9614, datë 21.9.2006 "Për certifikatën elektronike të gjendjes gjyqësore".

Referimi në KPP duket sikur e përfshin zgjidhjen e mosmarrëveshjes në juridiksionin penal. Një referim i tillë është i pamjaftueshëm për të konkluduar, ndërkohë që mosmarrëveshja që ka lindur ndërmjet një individi dhe një organi publik lidhet me mospërmbushjen e detyrës nga funksionari i një organi publik, në kundërshtim të hapur me ligjin që rregullon veprimtarinë shtetërore të këtij organi, që nuk ka asnjë lidhje me fazat e ekzekutimit të një vendimi penal dhe as ndonjë lidhje varësie apo kontrolli me prokurorinë si organi që është ngarkuar me kontrollin e ekzekutimit të vendimeve penale.

Pikërisht, lidhja që ekziston dhe që provohet se ekziston midis një fakti të paligjshëm që pretendon individi se ka ndodhur për shkak të veprimeve/mosveprimeve të organit publik, nga njëra anë, dhe së drejtës subjektive që i është cenuar, nga ana tjetër, përbëjnë shkakun ligjor të mosmarrëveshjes dhe të kërkimit ligjor të individit përpara gjykatës. Kjo është e mjaftueshme për të përcaktuar kompetencën e gjykatës administrative, e cila sipas ligjit nr. 49/2012 shqyrton kërkimet e çdo subjekti, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik.

Mbi këtë linjë arsyetimi konkludohet me të drejtë se kompetenca e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave, për dhënien e informacionit apo për pretendimet eventuale mbi saktësinë e këtij informacioni që përmban regjistri i gjendjes gjyqësore, siç është në këtë rast hedhja e shënimit *"i rehabilituar"* i përket juridiksionit gjyqësor administrativ, duke qenë se në thelbin e vet ka kërkimin e së drejtës kushtetuese të subjektit për të qenë i rehabilituar ndaj veprimeve/mosveprimeve të paligjshme të Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, që bazon veprimtarinë e vet te ligji që rregullon veprimtarinë e organit publik.

Nga ana tjetër, nevojitet të jepet një kuptim më i qartë mbi rehabilitimin, për të mos konfonduar rehabilitimin ligjor nga rehabilitimi gjyqësor. Këto janë dy koncepte që duhen dalluar nga njeri tjetri. I pari është një proces automatik që rrjedh nga ligji (siç parashikohet në nenin 69 të KP-së) dhe për të cilin ka nevojë për një

përpunim automatik të të dhënave nga punonjësi i autorizuar i zyrës, ndërsa i dyti është vlerësim diskrecionar që lidhet me sjelljen e të dënuarit dhe marrjen e mendimit të prokurorit, të avokatit apo të institucioneve përkatëse, siç mund të jetë p.sh., rasti i aplikimit të lirimit para kohe me kusht.

Referimi që ka bërë shumica në jurisprudencën dhe legjislacionin e huaj (italian e francez), në fakt është argument që i vlen qëndrimit të mbajtur nga pakica. Rehabilitimi gjyqësor sipas ligjit italian dhe francez përcaktojnë një procedurë të detajuar që nuk parashikohet qartësisht nga legjislacioni ynë dhe që fillon me kërkesën që paraqitet te gjykata e ekzekutimit (gjykata penale), me praninë e prokurorit, dëgjimin e avokati dhe që në fund përmbyllet me vlerësimin nga gjykata të sjelljes së të dënuarit. Pikërisht rregullave të kësaj procedure i është referuar shumica në arsyetimin e qëndrimit të saj kur ka pranuar gjykatën penale si gjykata kompetente që vendos për përfitimin nga e drejta për t'u rehabilituar.

Si gjyqtar në pakicë nuk mendoj se mund të përdoret si argument për njësimin që duhet t'i bëjmë rehabilitimit ligjor, sipas nenit 69 të KP-së, koncepti për rehabilitimin gjyqësor që parashikohet nga ligji francez e italian. Për të interpretuar rehabilitimin ligjor, si dhe për të përcaktuar gjykatën kompetente që do të vlerësojë njohjen e së drejtës për t'u quajtur i rehabilituar, shumica nuk mund t'i referohet rregullave të ligjit francez e italian për rehabilitimin gjyqësor, por duhet të analizonte rregullat që ai legjislacion, si dhe vetë legjislacioni ynë parashikon për rehabilitimin ligjor automatik. Pra, rehabilitimi ligjor është ai që njihet nga legjislacioni ynë penal (neni 69), ndërsa rehabilitimi gjyqësor nuk është pjesë e këtij njësimi, por që mund të shërbejë për ndërmarrjen në të ardhmen të një nisme për ndryshime në legjislacionin penal procedural. Për këtë arsye, vlerësoj se arsyetimi i shumicës duhej të përqendrohej te qëllimi që ka ky vendim njësues për të interpretuar ligjin shqiptar që është në fuqi dhe jo dëshirën se si mund dhe duhej të ishte ky ligj.

Nëse shumica do të vijonte në përgjigjen e pyetjes së tretë mbi analizën e drejtë që ka bërë për dy çështjet e para, duke u fokusuar te natyra e organit publik (Zyra e Gjendjes Gjyqësore), funksionet e saj, natyra e veprimeve ligjore që ajo kryen, si bërja e shënimeve, heqja e tyre, refuzimi për të bërë shënime, efekti juridik që sjell mbi subjektet përkatëse moskryerja e veprimeve nga kjo zyrë për rastin e mos hedhjes së shënimit *"i rehabilituar"* etj., padyshim që zgjidhja do kishte qenë e ndryshme.

Për sa më lart, vlerësoj se përgjigjja e pyetjes së tretë duhej të shkonte në të njëjtën linjë arsyetimi me përgjigjet e dhëna dy pyetjeve të para, të cilat e kanë përjashtuar juridiksionin gjyqësor penal nga shqyrtimi i kërkesës për t'u quajtur *"i rehabilituar"* dhe kanë përcaktuar juridiksionin gjyqësor administrativ për mosmarrëveshjen që krijohet për shkak të refuzimit që i bëhet nga organi publik kërkesës së individit.

Tiranë, më 7.4.2022

GJYQTAR: Sokol Sadushi

PROCESVERBAL

MBI MOTIVET E KUNDËRSHTIMIT TË VENDIMIT

I mbajtur nga unë gjyqtar Sokol Binaj me cilësinë e anëtarit të Kolegjit Njësues të Gjykatës së Lartë, me të cilin paraqes motivet e kundërshtimit (të pjesshëm) të vendimit njësues të këtij Kolegji, datë 7.4.2022, lidhur me problematikën e institutit të rehabilitimit, të parashikuar nga neni 69 i KP-së, të evidentuar me rastin e gjykimit të kërkesës së paraqitur prej kërkuesit Kujtim Delishi, me objekt rehabilitimin, e këtij të fundit, nga dënimet e aplikuara ndaj tij prej gjykatave; të Rrethit Gjyqësor Kurbin, vendimi nr. 55–04, datë 20.11.2014 (me të cilin është deklaruar fajtor dhe dënuar për veprën penale të "goditjes së gjyqtarit", sipas nenit 316 të KP-së, me 6 muaj burgim) dhe të Rrethit Gjyqësor Lezhë, vendimi nr. 158, datë 30.3.2015 (me të cilin është deklaruar fajtor dhe dënuar për veprën penale të "përndjekjes" dhe dënuar me 5 muaj e 10 ditë burgim), në justifikim të votës time kundër për pjesën e këtij vendimi që enoncon konkluzionin e tretë njësues.

Në konkluzionin e tretë njësues të këtij vendimi afirmohet, se: "kur një person pretendon se plotëson kriteret ligjore për të përfituar nga instituti i rehabilitimit, të parashikuar në nenin 69 të KP, por nuk arrin të realizojë këtë të drejtë, për shkak të refuzimit të shfaqur nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore, kompetente për gjykimin e kësaj mosmarrëveshjeje do të jetë gjykata penale e rrethit gjyqësor që ka dhënë vendimin e dënimit penal ndaj kërkuesit që kërkon rehabilitimin".

Pikërisht me këtë trajtim, të karakterit semplist, të Kolegjit, që i atribuon një organi të rëndomtë administrativ, sikurse Zyra e Gjendjes Gjyqësore, kompetenca – diskrecion të karakterit juridiksional për sa kohë që "adreson titullarin e së drejtës, të garantuar (sanksionuar) kushtetushmërisht dhe të parashikuar në nenin 69 të KPP-së, për

të kërkuar rehabilitimin, nga një vendim dënimi të gjykatës, te një organ i kësaj natyre, në kushtet e papërshtatshmërisë evidente të tij për të disponuar në këtë cilësi", lidhen edhe objeksionet e mia në raport me konkluzionin e tretë njësues të sipërcituar.

Fakti i inercisë së ligjvënësit për të konkretizuar aspektet procedurale të aplikimit të këtij instituti të rëndësishëm, mirëfilli të së drejtës penale, në KPP, për asnjë moment dhe për asnjë arsye, nuk mund të shërbejë si alibi për të nihilizuar këtë tipar në funksion të legjitimimit, për pasojë, të Zyrës së sipërcituar, për të realizuar dhe implementuar këtë procedim të "rehabilitimit" dhe, për t'u prezantuar nën "petkat" e organit juridiksional.

Procedimi i rehabilitimit, i aktivuar mbi kërkesën e personit të dënuar, që pretendon verifikimin e kushteve të parashikuara në nenin 69 të KP-së, si pjesë e pandashme e fazës së ekzekutimit të vendimit, pashmangshmërisht implikon ndërhyrjen dhe prononcimin e organit juridiksional, të identifikuar natyrshëm në gjykatën e ekzekutimit të vendimit, vendimmarrja e së cilës, do t'i nënshtrohet (mbi bazën e ankimit të palëve), verifikimeve të gjykatave superiore sikurse, rëndom, procedohet me trajtimin e kërkimeve të kësaj natyre, karakteristike për këtë fazë terminale të procedimit penal (të ekzekutimit).

Vetëm pas implementimit të kësaj procedure dhe "fitimit" të statusit të "gjësë së gjykuar" të këtij vendimi, të "deklarimit të rehabilitimit", i cili dërgohet në Zyrën e Gjendjes Gjyqësore për t'u regjistruar dhe pasqyruar në "jetëshkrimin" penal të personit që ka iniciuar këtë procedurë.

Procesi i mëtejshëm i mënyrës së pasqyrimit të këtyre të dhënave në regjistrin e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore, problematika e krijuar (pretendimet) lidhur me mënyrën e pasqyrimit të tyre, përbën "materie" të karakterit administrativ, në diskrecion ekskluziv, me rastin e verifikimit të konfliktit të juridiksionit administrativ.

Tiranë, më 7.4.2022

GJYQTAR: Sokol Binaj

VENDIM
Nr. 00-2022-1679 (217), datë 27.7.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

Ilir Panda	kryesues;
Medi Bici	anëtar;
Sokol Binaj	anëtar;
Albana Boksi	anëtare;
Sandër Simoni	anëtar,

sot më datë 27.7.2022, mori në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen penale që i përket:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë

TË GJYKUAR: 1. Ibrahim Xhafa; 2. Xhevdet Xhafa

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale "Trafikimi i personave të rritur", kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetases Engjëllushe Xhafa, të parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtares Albana Boksi, dëgjoi përfaqësuesin e Prokurorisë së Përgjithshme, prokurorin Arqilea Koça, i cili në përfundim kërkoi: "Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda me nr. 54, datë 16.5.2016. Deklarimin fajtor të të pandehurve Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, për veprën penale "Dhuna në familje", parashikuar nga nenet 130/a e 50/e, "gj", të Kodit Penal dhe dënimin e tyre me nga dy vjet burgim."; mbrojtësin e të gjykuarve, av. Dulejman Karaj, i cili në përfundim kërkoi: "Ndryshimin e vendimit penal nr. 54, datë 16.6.2016, të Gjykatës se Apelit për Krime të Rënda, për cilësimin juridik, duke dhënë pafajësi për shtetasit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa.".

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (në vijim "prokuroria"), më datë

24.11.2015, ka paraqitur kërkesë për gjykimin e të pandehurve Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, duke iu atribuuar kryerjen e veprës penale "Trafikimi i personave të rritur", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal (në vijim "KP"). Nga aktet dhe provat e shqyrtuara rezulton që prokuroria ka regjistruar procedimin penal nr. 342, më datë 22.12.2014, mbi bazë të akteve hetimore të referuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë.

2. Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë ka referuar në prokurori rastin e trafikimit të një personi të rritur, shtetases Engjëllushe Xhafa, e cila shfrytëzohej për lypje, duke përfituar nga gjendja e saj fizike dhe mendore, rast ky i publikuar nga emisionit "Ça thu", më datë 15.12.2014, në televizionin "Agon Channel". Nga ana e prokurorisë janë kryer veprimet hetimore që ajo ka çmuar të nevojshme, duke arritur në përfundimin se shtetasja Engjëllushe Xhafa është trafikuar me qëllim shfrytëzimin e saj për lypje, nga vëllezërit, të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa. Në këto rrethana, prokurori iu ka komunikuar, në përfundim të hetimeve, akuzën për kryerjen e veprës penale "Trafikimi i personave të rritur", parashikuar nga neni 110 / a i KP-së.

3. Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar se shtetasja Engjëllushe Xhafa, e datëlindjes 14.11.1980, është motra e dy të pandehurve dhe është me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore. Sipas aktit të ekspertimit psikiatrik-ligjor nr. 235, datë 14.7.2015, të Institutit të Mjekësisë Ligjore, Tiranë, *kjo shtetase prezanton probleme të zhvillimit intelektual dhe prezanton moshë mendore të një 13–14-vjeçareje të paarsimuar.*

4. **Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 43, datë 4.4.2016**, ka vendosur: *"1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Ibrahim Xhaferr Xhafa, për kryerjen e veprës penale të: "Keqtrajtimi i të miturit", e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 124/b, paragrafi i dytë, e 25 të Kodit Penal, sipas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 144/2013 dhe dënimin e tij, në bazë të këtyre neneve me 5 (pesë) vjet burgim.*

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Xhevdet Xhaferr Xhafa, për kryerjen e veprës penale të: "Keqtrajtimi i të miturit", e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 124/b, paragrafi i dytë, e 25 të Kodit Penal, sipas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 144/2013 dhe dënimin e tij, në bazë të këtyre neneve, me 4 (katër) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim.

3. Vuajta e dënimit për të pandehurit Ibrahim Xhaferr Xhafa dhe Xhevdet Xhaferr Xhafa, të fillojë nga data e arrestimit të tyre, datë 2.3.2015, dhe të bëhet në një burg të sigurisë së zakonshme.".

4.1 Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në vendimmarrjen e saj, ndër të tjera, ka arsyetuar: "... Bazuar në aktet dhe provat e cituara më sipër, duke iu bërë një analizë dhe vlerësim secilës prej tyre dhe në tërësi me njëra-tjetrën, kjo gjykatë vlerëson që, nuk u arrit që të provohej, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, të kenë rekrutuar shtetasen Engjëllushe Xhafa, dhe më pas ta kenë detyruar atë që të lypë, duke i marrë, plotësisht apo pjesërisht, të ardhurat që ajo nxirrte nga ky "aktivitet".

4.2 Përpara se, gjykata të analizojë me hollësi, se pse, për të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, nuk u provua, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, kryerja e veprës penale të: "Trafikimi i personave të rritur", kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetases Engjëllushe Xhafa, gjykata e gjen me vend, që të bëjë, në mënyrë të përmbledhur, një analizë juridike, të elementeve të kësaj figure vepre penale, sepse, në këtë mënyrë do të kuptohet, më lehtë, nëse, ndodhemi para kësaj vepre penale apo para ndonjë vepre tjetër penale, apo që të pandehurit nuk kanë kryer me veprimet e tyre, asnjë vepër të kundërligjshme.

4.3 Pasi nga kjo gjykatë u cituan aktet dhe provat e shqyrtuara në këtë gjykim, si dhe pasi u bë dhe analiza ligjore e veprës për të cilën akuzohen të pandehurit, kjo gjykatë e gjen me vend të analizojë, se, pse për të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, nuk u arrit që provohej, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që me veprimet dhe mosveprimet e tyre, të kenë konsumuar elementet e figurës së veprës penale të: "Trafikimi të personave të rritur", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 110/a/4 i KP-së.

4.4 Në vlerësim të kësaj gjykate, e vetmja provë që tregon që këta dy të pandehur, kanë kryer veprën penale të mësipërme, janë të dhënat që jep shtetasja Engjëllushe Xhafa, të cilat janë përfituar gjatë fazës së hetimeve paraprake, në deklarimet e bëra prej saj, si dhe në procesverbalin e përgjimit audioviziv, të realizuara nga gazetarët e televizionit "Agon Channel", të dhëna, të cilat, në vlerësim të kësaj gjykate, nuk përputhen me asnjë akt dhe provë tjetër të këtij gjykimi. Të dhënat e përftuara nga shtetasja Engjëllushe Xhafa, për sa i përket faktit të trafikimit të saj, me anë të detyrimit për të lypur, nga të pandehurit Ibrahim dhe Xhevdet Xhafa, duke qenë të vetme dhe pa u përputhur me asnjë provë tjetër, nuk mund të shërbejnë për t'u vendosur në themel të këtij vendimi, sepse në këtë mënyrë, kjo provë, do të mbivlerësohej, asaj do t'i jepej një vlerë e paracaktuar, që bie në kundërshtim me pikën 1, të nenit 152, të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

4.5 Nga ana tjetër, po të bëhet një vlerësim objektiv dhe i paanshëm i të gjitha akteve dhe provave të shqyrtuara rezulton që, pozita e të pandehurve Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa nuk ndryshon nga pozita e shtetases Engjëllushe Xhafa, pasi edhe këta të pandehur, po ashtu, e sigurojnë jetesën e tyre dhe të familjeve të tyre, duke lypur si shtetasja Engjëllushe, nëpër vende të ndryshme, e si ata, dhe familjarët e tyre.

4.6 Nga aktet dhe prova e shqyrtuara, rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, kanë shtytur dhe përdorur të dëmtuarën Engjëllushe Xhafa, që ajo të lypë, por ky fakt nuk duhet të ngatërrohet me veprën penale të trafikimit të të personave të rritur, e cila kërkon si element të parë të domosdoshëm, *rekrutimin e personit dhe më pas, heqjen ose kufizimin e lirisë së vullnetit të tij dhe detyrimin e tij që të kryejë, jashtë vullnetit të tij, veprime të caktuara, ku përfshihet edhe lypja.*

4.7 Shtetasja Engjëllushe Xhafa, është e datëlindjes 14.11.1980, pra, është person madhor mbi 18 vjeçe, ndërkohë që nga gjykata konstatohet se ligji penal nuk ndëshkon penalisht, shtytjen dhe përdorimin për të lypur, të personave madhor, por vetëm të personave të mitur, veprim, i cili parashikohet si vepër penale, në paragrafin e dytë të nenit 124 të KP-së. Gjykata vlerëson që nuk provohet që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, të kenë rekrutuar shtetasen Engjëllushe Xhafa dhe më pas të kenë hequr ose kufizuar vullnetin e saj, duke e detyruar që të lypë, pasi, vepra penale e "Trafikimit të personave të rritur", e parashikuar nga neni 110/4 i KP-së, nga pikëpamja e anës objektive, siç është analizuar më lart, kërkon ndarje të subjekteve: njëri është personi që trafikohet dhe që është i dëmtuari dhe tjetri është personi që trafikon dhe që është i pandehuri.

4.8 Në rastin në gjykim, nuk provohet kjo ndarje e roleve të subjekteve, pasi si shtetasja Engjëllushe Xhafa, ashtu dhe të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, provohet që e sigurojnë jetesën e tyre dhe të familjes së tyre, në mënyrë të njëjtë, duke lypur, ato kanë të njëjtin status dhe kryejnë të njëjtin "aktivitet", atë të lypjes, por, në rastin konkret, provohet fakti që të dy të pandehurit e kanë shtyrë dhe e kanë përdorur shtetasen Engjëllushe Xhafa që ajo të lypë, në vende të ndryshme.

4.9 Zhvendosja dhe transferimi që të dy të pandehurit, por edhe familjarët e tyre, i kanë bërë shtetases Engjëllushe Xhafa, për të lypur, në kohë dhe vende të ndryshme, në kushtet kur ajo ishte në karroce invalidi, me paaftësi fizike dhe prapambetje mendore, pra, e paaftë për të kujdesur për veten e saj dhe për të lëvizur vetë nga njëri vend në tjetrin, është pjesë e shtytjes dhe përdorimit për të lypur që, të pandehurit kanë bërë ndaj shtetases Engjëllushe Xhafa, dhe nuk plotëson kushtet e transportimit dhe të zhvendosjes, si forma të kryerjes së veprës penale të: "*Trafikimit të personave të rritur", të parashikuar nga neni 110/a i KP-së, pikërisht, sepse, në këtë rast, nuk provohet që, të pandehurit të kenë bërë rekrutimin e kësaj shtetaseje dhe më pas, të kenë bërë kufizimin e lirisë së vullnetit të saj dhe detyrimin për të lypur, ashtu siç me të pa të drejtë pretendon akuza. Kjo shtetase, pasi lyp gjatë ditës, kthehet në banesë.*

4.10 Një fakt tjetër i rëndësishëm që tregon se, nuk arrihet që të provohet që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa kanë kryer veprën penale të: "Trafikimit të personave të rritur", është edhe fakti që, nga aktet dhe provat e shqyrtuara, rezultoi që të ardhurat që shtetasja Engjëllushe Xhafa siguronte nga aktiviteti, i cili kryhej nën shtytjen dhe përdorimin dy të pandehurve, përdoreshin për të siguruar ushqimin dhe jetesën e vetë shtetases Engjëllushe Xhafa, por edhe për të siguruar minimumin e jetesës, për familjet e të dy të pandehurve, anëtarët e së cilës, përfshirë edhe vetë të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, po ashtu si shtetasja Engjëllushe Xhafa, ushtronin aktivitetin e lypjes dhe ndodheshin në kushte, të varfërisë ekstreme.

4.11 Nga analiza juridike që i bëhet veprës penale të: "Trafikimit të personave të rritur", rezulton, se, që të jemi para kësaj vepra penale, kërkohet që të provohet që subjekti që kryen këtë vepër penale, të arrijë të realizojë përfitime materiale ose monetare, të cilat, zakonisht, janë në vlera të konsiderueshme, fakt i cili nuk rezultoi i provuar në këtë gjykim. Të dhënat e përftuara gjatë hetimeve paraprake, nga shtetasja Engjëllushe Xhafa, ku ajo ka deklaruar që të ardhurat që ajo nxirrte nga lypja ia merrte të gjitha i pandehuri Ibrahim Xhafa dhe i përdorte vetë ky i pandehur, sipas dëshirës së tij, janë të pabesueshme për gjykatën dhe nuk vlerësohen si provë, jo vetëm sepse nuk përputhen me aktet dhe provat e tjera, por edhe për faktin tjetër se, në seancë gjyqësore, shtetasja Engjëllushe Xhafa i mohoi në mënyrë të plotë deklarimet e bëra gjatë fazës së hetimeve paraprake.

4.12. Përfundimisht, gjykata konkludon që nuk u arrit të provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa të kenë realizuar rekrutimin e shtetases Engjëllushe Xhafa dhe më pas, t'i kenë hequr ose kufizuar vullnetin, duke e detyruar atë që të lypë, jashtë vullnetit të saj. Për pasojë, kryerja prej tyre e veprës penale të: "Trafikimit të personave të rritur" në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110/a/4 i KP-së, mbeti në kuadër të dyshimeve dhe bazuar në nenin 4 të KPP-së, i cili parashikon që çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurve, të pandehurit nuk mund të përgjigjen penalisht për kryerjen e kësaj vepre penale.

4.13 Nga ana tjetër, rezultoi plotësisht e provuar që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, kanë shtyrë dhe përdorur shtetasen Engjëllushe Xhafa që ajo të ushtrojë aktivitetin e lypjes, por duke qenë se kjo shtetase është e moshës 14.11.1980, pra është madhore, gjykata konstaton që shtytja dhe ndërmjetësimi për të lypur i personave të rritur, nuk është një vepër e dënueshme penalisht, nga legjislacioni penal shqiptar dhe për pasojë, të pandehurit, si rregull, nuk duhej të përgjigjeshin penalisht për kryerjen e ndonjë vepre. Por, në të njëjtën kohë referuar akteve dhe provave të shqyrtuara, gjykata vlerëson që rasti që ka pasur për gjykim paraqet një rast

të llojit të veçantë ose *sui generis*, pasi është e vërtetë që shtetasja Engjëllushe Xhafa, nga ana fizike ose biologjike është madhore, por nga ana e zhvillimit intelektual e mendor, ajo sipas aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor nr. 235, datë 14.7.2015, paraqet moshë mendore të një 13–14-vjeçareje, të paarsimuar. Gjykata çmon që në veprimet dhe mosveprimet e këtyre dy të pandehurve, gjenden elementet e veprës penale të: "Keqtrajtimi i të miturit", e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 124/b paragrafi i dytë, e 25 të KP-së, përfshirë ndryshimet e bëra me ligjin nr. 144/2013.

4.14 Në këto kushte, gjykata në bazë të nenit 375 të KPP-së do t'i japë faktit penal një përcaktim tjetër juridik nga ai i bërë nga prokurori, duke e kualifikuar atë nga vepra penale e "Trafikimit të personave të rritur", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110/a/4 i KP-së, në veprën penale të: "Keqtrajtimi i të miturit", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 124/b, paragrafi i dytë e 25 të KP-së. Në rastin konkret, me veprimet dhe mosveprimet e tyre të kundërligjshme të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, kanë cenuar marrëdhëniet juridike që sigurojnë lirinë dhe zhvillimin fizik intelektual, psikologjik dhe shoqëror, të shtetases Engjëllushe Xhafa, e cila për vetë karakteristikat që paraqet vlerësohet nga gjykata si e mitur e moshës nën 14 vjeç.

4.15 Nga ana objektive, të pandehurit e kanë kryer veprën penale me anë të veprimeve të kundërligjshme, të cilat kanë synuar në shtytjen dhe përdorimin e shtetases Engjëllushe Xhafa për të lypur, në kohë dhe vende të ndryshme, veprimtari të paligjshme të cilën e kanë kryer në bashkëpunim dhe për një periudhë të gjatë kohe, duke treguar një rrezikshmëri të madhe shoqërore, fakt që do të mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit ndaj tyre për këtë vepër penale. Gjykata vlerëson që, fakti që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, kanë kryer veprën penale të: "Keqtrajtimi i të miturit", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 124/b, paragrafi i dytë e 25 të KP-së, u provua në gjykim tej çdo dyshimi të arsyeshëm, me provat dhe aktet e shqyrtuara dhe të analizuara nga gjykata në vendim më sipër, siç janë: procesverbalet e vëzhgimit të realizuara nga policia gjyqësore, në zbatim të autorizimit të prokurorit për përgjime në vende publike, procesverbalet e përgjimit të bisedave telefonike të zhvilluara ndërmjet të pandehurve, si dhe ndërmjet tyre me persona të tretë, deklarimet e bëra në seancë gjyqësore nga vetë të dy të pandehurit, ku, prej tyre pranohet ky fakt, si dhe të gjitha aktet dhe provat e tjera shkresore dhe shkencore të cituara me sipër në këtë vendim.

4.16 Të pandehurit janë subjekt të veprës penale, sepse kanë arritur moshën për përgjegjësi penale dhe janë të përgjegjshëm para ligjit për veprën penale të kryer. Nga ana subjektive, të pandehurit e kanë kryer veprën me dashje direkte dhe për motive të përfitimit material, i cili në fakt në rastin konkret ka qenë sigurimi i minimumit jetik dhe i mbijetesën për veten e tyre dhe familjet e tyre, ku përfshihet edhe sigurimi i jetesës së vetë të dëmtuarës Engjëllushe Xhafa Në caktimin e dënimit ndaj të pandehurve Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, gjykata do të mbajë parasysh rrezikshmërinë e veprës dhe të të pandehurve, faktin që të pandehurit e kanë kryer veprën penale në bashkëpunim, rolin që ka pasur secili i pandehur në kryerjen e veprës penale, ku, gjykata çmon se i pandehuri Ibrahim Xhafa, ka pasur rol më kryesor. ..."

5. **Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda, si dhe dy të pandehurit**.

5.1 Prokuroria ka kërkuar: *"Ndryshimin e vendimit nr. 43, datë 4.4.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, duke vendosur përfundimisht: deklarimin fajtor të të pandehurit Ibrahim Xhafa, për veprën penale të "Trafikimit të personave të rritur", kryer në bashkëpunim, shoqëruar me detyrimin e të dëmtuarit për të lypur, të parashikuar nga neni 110/a/4 i KP dhe e tij me 15 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Xhevdet Xhafa, për veprën penale të "Trafikimit të personave të rritur", kryer në bashkëpunim, shoqëruar me detyrimin e të dëmtuarit për të lypur, të parashikuar nga neni 110/a/4 i KP dhe dënimin e tij me 15 vjet burgim.".*

5.2 Kundër vendimit të sipërcituar kanë paraqitur ankim edhe dy të pandehurit Ibrahim dhe Xhevdet Xhafa, nëpërmjet avokatit mbrojtës, duke kërkuar: *"Ndryshimin e vendimit nr. 43, datë 4.4.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, duke dhënë pafajësi për shtetasit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa".*

6. **Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në vendimin nr. 54, datë 16.5.2016,** ka vendosur: *"Lënien në fuqi të vendimit nr. 43, datë 4.4.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.".*

6.1 Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka argumentuar, referuar shkaqeve të ankimit: "... Përveç sa ka analizuar Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, lidhur me mungesën e elementeve të anës objektive të figurës së veprës penale të "Trafikimit" sipas nenit 110/a të KP-së, në veprimet e të pandehurve, gjykata e apelit gjen me vend të bëjë një analizë më të hollësishme të elementit "transportim" në dy aspekte:

- *Së pari*: A përbën transportimi brenda vendit për qëllim të shfrytëzimit të të dëmtuarës për të lypur, përmbajtje të elementit të anës objektive të figurës së veprës penale të "Trafikimit", siç parashikon neni 110/a i KP-së, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 144/2013, në kushtet kur transportimi brenda vendit nuk ka për qëllim final nxjerrjen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë?

- *Së dyti*: Ndryshimet e bëra në nenin 110/4 të KP-së, me ligjin 144/2013, lidhur me "Transportimin" brenda vendit si do të vlerësohen në raport me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3/2011, sa i përket elementit transnacional, si kusht për ekzistencën e figurës së veprës penale që lidhet me trafikimin?

6.2 Lidhur me çështjen e parë, gjykata e apelit çmon se jo çdo transportim brenda vendit duhet konsideruar si element i anës objektive të figurës së veprës penale të "Trafikimit", por ai duhet analizuar ngushtë me qëllimin e autorit të veprës penale. Në rastin në gjykim të pandehurit kanë kryer transportimin e të dëmtuarës për të realizuar qëllimin e tyre, atë të detyrimit të motrës së tyre për të lypur duke siguruar të ardhura nga puna e saj. Nga ana subjektive, del qartë se të pandehurit këtë veprim e kanë kryer në funksion të qëllimit të vetëm të tyre, përfitimit nga puna e detyruar si lypëse e motrës së tyre dhe, jo në funksion të realizimit të trafikimit të saj jashtë territorit të vendit.

6.3 Në kushtet kur, nga njëra anë mungon ana subjektive në veprimet e të pandehurve për trafikimin e të dëmtuarës, si dhe faktit që në nenin 124/b të KP-së parashikohet si figurë e veprës penale të veçantë "Keqtrajtimi i të miturit", përmes detyrimit, shfrytëzimit, shtytjes ose përdorimit të të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura apo për të lypur, gjykata e apelit, veprimet e të pandehurve, lidhur me transportimin, ashtu si dhe Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, i gjen në funksion të veprës penale të parashikuar nga neni 124/b/2 i KP-së, të "Keqtrajtimi i të miturit" dhe jo në funksion të "Trafikimit", siç parashikon neni 110/a i KP-së.

6.4 Gjykata e apelit, çmon se në rastin e veprave penale të "Keqtrajtimi i të miturit", sipas nenit 124/b/2 i KP-së dhe "Trafikimi i personave të rritur", sipas nenit 110/a të KP-së, ka elemente të përbashkëta të anës objektive, siç janë: shfrytëzimi, puna e detyruar etj., por këto vepra i bën të dallueshme nga njëra-tjetra qëllimi i autorëve të veprës penale, si element thelbësor për cilësimin e drejtë juridik të veprës penale. Në rastin konkret, veprimet e të pandehurve lidhur transportimin e të dëmtuarës nga një vend në tjetrin, gjykata e apelit, i konsideron siç u tha më lart, në funksion të realizimit të lypjes nga ana e të dëmtuarës. Gjithashtu, gjykata e apelit arrin në këtë përfundim lidhur me mungesën e anës subjektive, duke vlerësuar, ashtu si dhe gjykata e shkallës së parë, faktin që të pandehurit, ashtu si dhe e dëmtuara, së bashku kryejnë të njëjtën punë, duke lypur për të siguruar jetesën e tyre familjarisht, përmes të vetmes mundësi që ata kanë.

6.5 Lidhur me çështjen e dytë, gjykata e apelit çmon se duke analizuar rastin në gjykim në raport me përfundimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës Lartë, të dhëna në vendimin nr. 3/2011, veprimet e të pandehurve duhen cilësuar sipas nenit 124/b/2 të KP-së dhe jo sipas nenit 110/a të KP-së, për faktin se në rastin e të pandehurve "Xhafaj", si nga ana objektive, ashtu dhe nga ana subjektive nuk vërtetohet fakti që transportimi të ketë karakter transnacional, siç është konkluduar në vendimin e mësipërm të Kolegjeve të Bashkuara Gjykatës së Lartë.

6.6 Në vendimin e mësipërm, Kolegjet e Bashkuara, lidhur me veprat penale të "Trafikimit" arsyetojnë, se: "Ligjvënësi, rastet kur vepra ka karakter transnacional, ka përdorur në kodin tonë penal termin e përgjithshëm "Trafikim" për titullimin e veprës (nenet 110/a 114/b, 128/b, 138/a, 141/a, 278/a, 282/a dhe 283/a).". Më tej, Kolegjet e Bashkuara arsyetojnë se, sipas legjislacionit tonë penal, trafikimi nënkupton rastet kur veprimtaritë e kundërligjshme, duke përfshirë Shqipërinë e territorin e saj, kryhet në më shumë se një shtet por është përgatitur, programuar, drejtuar e kontrolluar në një shtet tjetër, kryhet në një shtet, por ka efekte e pasoja thelbësore në një shtet tjetër. Në mbështetje të arsyetimit të mësipërm, të Kolegjeve të Bashkuara, të Gjykatës së Lartë, arrihet në përfundimin, se: "*Kriter bazë për kuptimin e zbatimin e drejtë të veprave penale të "Trafikimit", sipas kodit tonë penal është parimi i territorit, i prekjes e përdorimit të tij, me qëllimin e realizimit në rrugë kriminale të përfitimeve, përmes lyrjes ose daljes së paligjshme të personave apo sendeve nga territori shqiptar ose kalimit të paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar.*".

6.7 Bazuar në konkluzionet e mësipërme, të vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit, edhe një herë krijon bindjen se në veprimet e të pandehurve Xhafa, nuk ekzistojnë elementet e anës objektive të veprës penale të "Trafikimit", si një nga kushtet e kërkuara në vendimin e mësipërm. Gjykata e apelit çmon se, konkluzionet e arritura nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 3/2011 janë të detyrueshme në rastin në gjykim, pasi çmohet se kemi të bëjmë me një rast të ngjashëm dhe për shkaqet e paraqitura më parë në këtë vendim nuk mund të pranohet cilësimi juridik i veprës penale sipas akuzës, si "Trafikim i personave të rritur" parashikuar nga neni 110/a/4 i KP-së.

6.8 Gjithashtu, gjykata e apelit çmon se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin e mësipërm, në mbështetje të provave të shqyrtuara prej saj gjatë gjykimit dhe, të vlerësuara në përfundim të tij me vendim përfundimtar, sipas të cilave nuk vërtetohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm që të pandehurit Xhevdet dhe Ibrahim Xhafa me veprimet e tyre të kenë konsumuar elemente të figurës së veprës penale të "Trafikimit të personave të rritur", parashikuar nga neni 110/a i KP-së, por çmon se me veprimet e tyre të pandehurit kanë

konsumuar veprën penale të "Keqtrajtimi i të miturit", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 124/b/2 dhe 25 të KP, me ndryshimet e bëra me ligjin 144/2013, duke arsyetuar, se: "Në vlerësim të kësaj gjykate, e vetmja provë që tregon që këta dy të pandehur, kanë kryer veprën penale të mësipërme, janë të dhënat që jep shtetasja Engjëllushe Xhafa, të cilat janë përftuar gjatë fazës së hetimeve paraprake, në deklarimet e bëra prej saj, si dhe në procesverbalin e përgjimit audioviziv të realizuar nga gazetarët e televizionit "Agon Channel", të dhëna të cilat, në vlerësim të kësaj gjykate, nuk përputhen me asnjë akt dhe provë tjetër të këtij gjykimi. (...)"

6.9 Të dhënat e përftuara nga shtetasja Engjëllushe Xhafa, për sa i përket faktit të trafikimit të saj, me anë të detyrimit për të lypur, nga të pandehurit Ibrahim dhe Xhevdet Xhafa, duke qenë të vetme dhe pa u përputhur me asnjë provë tjetër, nuk mund të shërbejnë për t'u vendosur në themel të këtij vendimi, sepse në këtë mënyrë kjo provë do të mbivlerësohej, asaj do t'i jepej një vlerë e paracaktuar gjë që bie në kundërshtim me pikën 1 të nenit 152 të KPP-së. Në vlerësim të kësaj gjykate, të dhënat e përftuara nga shtetasja Engjëllushe Xhafa, gjatë fazës së hetimeve paraprake, bëhen akoma më të dyshimta, në kushtet kur ajo në seancë gjyqësore i mohoi dhe i kundërshtoi plotësisht deklarimet e bëra gjatë fazës së hetimeve paraprake. Nga ana tjetër, po të bëhet një vlerësim objektiv dhe i paanshëm i të gjitha akteve dhe i provave të shqyrtuara, rezulton që pozita e të pandehurve Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa nuk ndryshon nga pozita e shtetases Engjëllushe Xhafa, pasi edhe këta të pandehur po ashtu si shtetasja Engjëllushe Xhafa, e sigurojnë jetesën e tyre dhe të familjeve të tyre duke lypur nëpër vende të ndryshme, vetë ata, si dhe familjarët e tyre.

6.10 Nga aktet dhe provat e shqyrtuara, rezulton e provuar tej çdo dyshimi ta arsyeshëm që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, kanë shtytur dhe përdorur të dëmtuarën Engjëllushe Xhafa, që ajo të lypë, por ky fakt nuk duhet të ngatërrohet me veprën penale të trafikimit të personave të rritur, i cili kërkon si element të parë të domosdoshëm rekrutimin e personit dhe më pas, heqjen ose kufizimin e lirisë së vullnetit të tij dhe detyrimin e tij që të kryejë jashtë vullnetit të tij veprime të caktuara, ku përfshihet edhe lypja.

6.11 Shtetasja Engjëllushe Xhafa, është e datëlindjes 14.11.1980, pra është person madhor mbi 18 vjeçe, ndërkohë që nga gjykata konstatohet që ligji penal nuk ndëshkon penalisht shtytjen dhe përdorimin për të lypur të personave madhor, por vetëm të personave të mitur veprim i cili parashikohet si vepër penale, në paragrafin e dytë të nenit 124 të KP-së. Gjykata vlerëson që nuk provohet që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa të kenë rekrutuar shtetasen Engjëllushe Xhafa dhe më pas të kenë hequr ose kufizuar vullnetin e saj, duke e detyruar që të lypë, pasi vepra penale e "Trafikimit të personave të rritur", e parashikuar nga neni 110/a i KP-së, nga pikëpamja e anës objektive, siç është analizuar më lart, kërkon ndarje të subjekteve: njëri është personi që trafikohet dhe që është i dëmtuari dhe tjetri është person që trafikon dhe që është i pandehuri. Në rastin në gjykim, nuk provohet kjo ndarje e roleve të subjekteve, pasi si shtetasja Engjëllushe Xhafa, ashtu dhe të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, provohet që e sigurojnë jetesën e tyre dhe të familjes së tyre në mënyrë të njëjtë, duke lypur. Ato kanë të njëjtin status dhe kryejnë të njëjtin "aktivitet", atë të lypjes, por në rastin konkret provohet fakti që të dy të pandehurit e kanë shtyrë dhe e kanë përdorur shtetasen Engjëllushe Xhafa, që ajo të lypë në vende të ndryshme.

6.12 Zhvendosja dhe transferimi që të dy të pandehurit, por edhe familjarët që i kanë bërë shtetases Engjëllushe Xhafa për të lypur, në kohë dhe vende të ndryshme, në kushtet kur ajo ishte në karrocë invalidi, me paaftësi fizike dhe prapambetje mendore, pra e paaftë për t'u kujdesur për veten e saj dhe për të lëvizur vetë nga njëri vend në tjetrin, është pjesë e shtytjes dhe e përdorimit për të lypur që të pandehurit kanë bërë ndaj shtetases Engjëllushe Xhafa dhe nuk plotëson kushtet e transportimit dhe të zhvendosjes, si forma të kryerjes së veprës penale të "Trafikimit të personave të rritur", të parashikuar nga neni 110/a i KP-së, pikërisht sepse në këtë rast, nuk provohet që të pandehurit të kenë bërë rekrutimin e kësaj shtetase dhe më pas të kenë bërë kufizimin e lirisë së vullnetit të saj dhe detyrimin për të lypur, ashtu siç me të, pa të drejtë pretendon akuza.

6.13 Të gjitha provat e tjera, siç janë procesverbalet e vëzhgimit të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore, në zbatim të autorizimit të prokurorit për përgjime në vende publike, procesverbalet e përgjimit të bisedave telefonike të zhvilluara nga të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, si dhe të gjitha aktet dhe provat e tjera shkresore, në harmoni me njëra-tjetrën, provojnë që dy të pandehurit kanë bërë shtytjen dhe përdorimin e shtetases Engjëllushe Xhafa, për të lypur me anë të transportimit të saj në vende të ndryshme ku ajo ushtronte aktivitetin e lypjes dhe me anë të kthimit të saj në shtëpi, në përfundim të ditës pasi ajo shtetase kishte lypur në vende të ndryshme.

6.14 Një fakt tjetër i rëndësishëm që tregon se nuk arrihet që të provohet që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, kanë kryer veprën penale të "Trafikimit të personave të rritur", të parashikuar nga neni 110/a i KP-së, është edhe fakti që nga aktet dhe provat e shqyrtuara rezultoi që të ardhurat që shtetasja Engjëllushe Xhafa siguronte nga aktiviteti i lypjes, i cili kryhej nën shtytjen dhe përdorimin dy të pandehurve, përdoreshin për të

siguruar ushqimin dhe jetesën e vetë shtetases Engjëllushe Xhafa, por edhe për të siguruar minimumin e jetesës për familjet e të dy të pandehurve, anëtarët e të cilës, përfshirë edhe vetë të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, po ashtu si shtetasja Engjëllushe Xhafa, ushtronin aktivitetin e lypjes dhe ndodheshin në kushte të varfërisë ekstreme.

6.15 Nga analiza juridike që i bëhet veprës penale të "Trafikimit të personave të rritur", të parashikuar nga neni 110/a i KP-së, rezulton se që të jemi para kësaj vepre penale kërkohet që të provohet që subjekti që kryen këtë vepër penale, të arrijë të realizojë përfitime materiale ose monetare, të cilat zakonisht janë në vlera të konsiderueshme, fakt i cili nuk rezultoi i provuar dot në këtë gjykim. Përkundrazi, në gjykim rezultoi e provuar që të ardhurat që siguronte nga lypja shtetasja Engjëllushe Xhafa, përdoreshin për të siguruar jetesën e vetë kësaj shtetase, si dhe të anëtarëve të familjes së të të pandehurve, të cilët së bashku me të pandehurit, ashtu si dhe vetë shtetasja Engjëllushe Xhafa, ushtronin të njëjtin aktivitet, lypjen si mjet për të jetuar. Të dhënat e përftuara gjatë hetimeve paraprake nga shtetasja Engjëllushe Xhafa, ku ajo ka deklaruar që të ardhurat që ajo nxirrte nga lypja, ia merrte të gjitha i pandehuri Ibrahim Xhafa dhe i përdorte vetë ky i pandehur sipas dëshirës së tij, janë të pabesueshme për gjykatën dhe nuk vlerësohen provë, jo vetëm sepse nuk përputhen me aktet dhe provat e tjera, por edhe faktin tjetër se në seancë gjyqësore shtetasja Engjëllushe Xhafa, i mohoi në mënyrë të plotë deklarimet e bëra gjatë fazës së hetimeve paraprake.

6.16 Në analizë të provave të mësipërme, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin që nuk u arrit që të provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, të kenë realizuar rekrutimin e shtetases Engjëllushe Xhafa dhe më pas t'i kenë hequr ose kufizuar vullnetin, duke e detyruar atë që të lypë, jashtë vullnetit të saj dhe për pasojë, kryerja prej tyre e veprës penale të "Trafikimit të personave të rritur", në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 110/a/4 i KP-së, mbeti në kuadër të dyshimeve dhe bazuar në nenin 4 të KPP-së, i cili parashikon që çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurve, të pandehurit nuk mund të përgjigjen penalisht për kryerjen e kësaj vepre penale.

6.17 Gjithashtu, gjykata e apelit çmon se përfundimet e arritura nga gjykata e shkallës së parë, lidhur me cilësimin juridik të veprës sipas nenit 124/b/2 e 25 të KP-së është i drejtë, e cila arrin në konkluzionin e mësipërm duke arsyetuar, se: "Nga ana tjetër, rezultoi plotësisht e provuar që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa kanë shtyrë dhe përdorur shtetasen Engjëllushe Xhafa, që ajo të ushtrojë aktivitetin e lypjes, por duke qenë se kjo shtetase është e moshës 14.11.1980, pra është madhore, gjykata konstaton që shtytja dhe ndërmjetësimi për të lypur i personave të rritur nuk është një vepër e dënueshme penalisht nga legjislacioni penal shqiptar dhe për pasojë të pandehurit, si rregull nuk duhej të përgjigjeshin penalisht për kryerjen e ndonjë vepre penale. (...)".

6.18 Por, në të njëjtën kohë, referuar akteve dhe provave të shqyrtuara gjykata vlerëson që, rasti për gjykim paraqet një rast të llojit të veçantë ose *sui generis*, pasi është e vërtetë që shtetasja Engjëllushe Xhafa nga ana fizike ose biologjike është madhore, por nga ana e zhvillimit intelektual dhe mendor, ajo sipas aktit të ekspertimit psikiatriko-ligjor nr. 235, datë 14.7.2015 të Institutit të Mjekësisë Ligjore, paraqet moshë mendore të një 13–14-vjeçareje, të paarsimuar. Duke u bazuar në aktin e ekspertimit psikiatriko-ligjor nr. 235, datë 14.7.2015, si dhe duke u nisur nga fakti që shtetasja Engjëllushe Xhafa është me paaftësi fizike dhe prapambetje mendore, pasi ajo lëviz me karrocë invalidi, kjo gjykatë vlerëson që, pavarësisht se nga ana biologjike dhe fizike, ajo mund të konsiderohet në moshë madhore, nga ana juridike ose ligjore ajo do të vlerësohet nga kjo gjykatë si e mitur, e moshës nën 14 vjeç.

6.19 Vlerësimi dhe konsiderimi nga ana ligjore si e mitur e shtetases Engjëllushe Xhafa bëhet nga kjo gjykatë jo në mënyrë subjektive dhe arbitrare, por në bazë të dy fakteve shumë të rëndësishme: së pari, faktit që ajo është e paaftë fizikisht dhe me prapambetje mendore, arsye për të cilat ajo lëviz me karrocë invalidi, pra është një person që nuk kujdeset dot për veten e saj, duke kërkuar vazhdimisht një përkujdesje nga persona të tretë dhe duke u barazuar kështu me të miturit e moshës nën 14 vjeç, të cilët siç dihet nuk janë të aftë të kujdesen për veten e tyre, por kërkojnë vazhdimisht, kujdesin e personave të tretë. Së dyti, në aktin e ekspertimit psikiatriko-ligjor nr. 235, datë 14.7.2015, të Institutit të Mjekësisë Ligjore, i cili konkludon që shtetasja Engjëllushe Xhafa vuan nga prapambetja mendore dhe paraqet moshë mendore të një 13–14-vjeçar, të paarsimuar.

6.20 Duke u bazuar në këto dy fakte të rëndësishme, si dhe në kushtet kur në vlerësim të kësaj gjykate, nuk u arrit që të provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm që pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, të kenë kryer veprën penale të "Trafikimit të personave të rritur", në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 110/a/4 i KP-së, gjykata çmon që në veprimet dhe mosveprimet e këtyre dy të pandehurve, gjenden elementet e veprës penale të "Keqtrajtimi i të miturit", e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 124/b, paragrafi i dytë, e 25 të KP-së, përfshirë ndryshimet e bëra me ligjin nr. 144/2013. Në këto kushte, gjykata, në bazë të nenit 375 të KPP-së do t'i japë faktit penal një përcaktim tjetër juridik nga ai i bërë nga prokurori, duke e kualifikuar atë nga vepra penale

e "Trafikimit të personave të rritur", kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 110/a/4 i KP-së, në veprën penale të "Keqtrajtimi i të miturit", e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 124/b, paragrafi i dytë e neni 25 të KP-së.

6.21 Vepra penale e kryer nga të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, "Keqtrajtimi i të miturit", parashikohet nga paragrafi i dytë i nenit 124/b i KP-së. Objekt i veprës penale të kryer nga të pandehurit, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të mbrojtur lirinë, shëndetin dhe jetën e të miturit, zhvillimin e tij, fizik, psikik, intelektual, psikologjik dhe shoqëror, nga çdo veprim ose mosveprim kriminal. Në rastin konkret, me veprimet dhe mosveprimet e tyre të kundërligjshme, të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, kanë cenuar marrëdhëniet juridike që sigurojnë lirinë dhe zhvillimin fizik, psikik, intelektual, psikologjik dhe shoqëror, të shtetases Engjëllushe Xhafa, e cila për vetë karakteristikat që paraqet, vlerësohet nga gjykata si e mitur e moshës nën 14 vjeç.

6.22 Nga ana objektive, të pandehurit e kanë kryer veprën penale me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të kundërligjshme, të cilat kanë synuar në shtytjen dhe përdorimin e shtetases Engjëllushe Xhafa për të lypur, në kohë dhe vende të ndryshme, veprimtari të paligjshme të cilën e kanë kryer, në bashkëpunim dhe për një periudhë të gjatë kohë, duke treguar një rrezikshmëri të madhe shoqërore, fakt që do të mbahet parasysh nga gjykata në caktimin e dënimit ndaj tyre për këtë vepër penale. Në pikëpamje të anës objektive, rezulton që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa e kanë kryer veprën penale, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, ku roli i të pandehurit Ibrahim Xhafa ka qenë më kryesor, pasi është ky i pandehur që ka jetuar me shtetasen Engjëllushe Xhafa dhe për këtë arsye, gjykata do të bëjë një diferencim të lehtë të dënimit për të dy të pandehurit.

6.23 Gjykata vlerëson se fakti që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa kanë kryer veprën penale të "Keqtrajtimi i të miturit", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 124/b, paragrafi i dytë e 25 i KP-së, u provua në gjykim tej çdo dyshimi të arsyeshëm me provat dhe aktet e shqyrtuara dhe të analizuara nga gjykata në vendim më sipër, siç janë procesverbalet e vëzhgimit të realizuara nga policia gjyqësore, në zbatim të autorizimit të prokurorit për përgjime në vende publike; procesverbalet e përgjimit të bisedave telefonike të zhvilluara ndërmjet të pandehurve, si dhe ndërmjet tyre me persona të tretë; deklarimet e bëra në seancë gjyqësore nga vetë të dy të pandehurit, ku prej tyre pranohet ky fakt, si dhe të gjitha aktet dhe provat e tjera shkresore dhe shkencore të cituara më sipër në këtë vendim.

6.24 Të pandehurit janë subjekt të veprës penale, sepse kanë arritur moshën për përgjegjësi penale dhe janë të përgjegjshëm para ligjit për veprën penale të kryer. Nga ana subjektive, të pandehurit e kanë kryer veprën me dashje direkte dhe për motive të përfitimit material, i cili në fakt në rastin konkret ka qenë sigurimi i minimumit jetik dhe i mbijetesës për veten e tyre dhe familjet e tyre, ku përfshihet edhe sigurimi i jetesës së vetë të dëmtuarës Engjëllushe Xhafa. Gjithashtu, gjykata e apelit çmon të drejta disponimet e bëra nga gjykata e shkallës së parë, në lidhje me provat materiale, si dhe disponimet e tjera.

6.25 Sa më sipër në mbështetje të nenit 428/1/a të KPP-së, Gjykata e Apelit arrin në përfundimin se vendimi nr. 43, datë 4.4.2016, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është i drejtë dhe i bazuar në prova dhe në ligj dhe si i tillë duhet lënë në fuqi. Në caktimin e dënimit ndaj të pandehurve Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, për veprën penale të "Keqtrajtimi i të miturit", e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 124/b, paragrafi i dytë, e 25 të KP-së, gjykata e apelit çmon se nga gjykata e shkallës së parë janë mbajtur drejt parasysh rrezikshmëria shoqërore e veprës dhe e të pandehurve, faktin që të pandehurit e kanë kryer veprën penale në bashkëpunim, rolin që ka pasur secili i pandehur në kryerjen e veprës penale dhe bazuar në të gjitha këto rrethana, si dhe në zbatim të nenit 47 të KP-së, ka vlerësuar me të drejtë që të pandehurin Ibrahim Xhafa ta dënojë me 5 (pesë) vjet burgim, ndërsa të pandehurin Xhevdet Xhafa, me 4 (katër) vjet dhe 6 (gjashtë) muaj burgim. ..."

7. **Kundër vendimit nr. 54, datë 16.5.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, ka paraqitur rekurs**, depozituar më datë 3.6.2016, **Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda**, e cila ka kërkuar: "*Ndryshimin e vendimit penal nr. 54, datë 16.5.2016, të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë për cilësimin juridik, deklarimin faktor dhe dënimin e të pandehurve të sipërpërmendur, për veprën penale të "Trafikimit të personave të rritur", të parashikuar nga neni 110/a i KP-së*". Në mënyrë të përmbledhur, në rekurs prokuroria ka parashtruar këto shkaqe:

- Kundërshtimin tonë në lidhje me vendimmarrjen e gjykatave do ta përmblidhnim në dy momentet kryesore, që përbëjnë thelbin e ndryshimit të akuzës. E para, ka të bëjë me mungesën e provave dhe e dyta, ka të bëjë me elementet përbërëse të veprës penale të parashikuar nga neni 110/a të KP-së, që sipas gjykatës nuk janë të pranishme në rastin objekt gjykimi.

- Vlerësimi dhe arsyetimi i gjykatës në lidhje me provat është i gabuar dhe në kundërshtim me përcaktimet e nenit 152 të KPP-së. Ndryshe nga sa ajo arsyeton, provë nuk janë vetëm thëniet e të dëmtuarës në fazën e hetimeve paraprake, por edhe prova me dokument: si procesverbal për këqyrjen dhe transkriptimin e bisedave të

kasetës filmike të datës 15.1.2015, në të cilën gjenden të pasqyruara bisedat e zhvilluara ndërmjet gazetarit të televizionit "Agon Channel" dhe të pandehurit Ibrahim Xhafa, si dhe ato të zhvilluara ndërmjet shtetases Engjëllushe Xhafa dhe gazetares së këtij televizioni, të marra dhe të administruara, sipas nenit 191 të KPP-së, apo dhe deklarimet e vëllait të dëmtuarës dhe njëkohësisht të të pandehurit shtetasit Lulëzim Xhafa, të datës 2.3.2015, administruar në kuadër të kundërshtimit të pjesshëm të dëshmisë.

- Deklarimet e të dëmtuarës Engjëllushe Xhafa dhe të shtetasit Xhevdet Xhafa, e Lulëzim Xhafa, shërbejnë si provë konform nenit 362/3 të KPP-së, pasi ato lidhen dhe me provat e tjera, si: pamjet filmike, përgjimet dhe vëzhgimet e autorizuara apo provat me dokument, procesverbal për kryerjen dhe marrjen e provave materiale, i datës 2.11.2015, libri i shërbimit në situata të emergjencave, e Komisariatit të Policisë Kavajë apo procesverbal për kryerjen dhe marrjen e provave materiale i datës 2.11.2015, kartela mjekësore e Spitalit Kavajë etj., që në tërësinë e tyre konfirmojnë vërtetësinë e deklarimeve.

- Provat që vërtetojnë faktin penal janë të plota dhe kjo pohohet më pas nga vetë gjykata, në mënyrë kontradiktore në pjesën në vazhdim të vendimit gjyqësor kur shprehet se, të gjitha provat e tjera, siç janë procesverbalet e vëzhgimit të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore, në zbatim të autorizimit të prokurorit për përgjime në vende publike, procesverbalet e përgjimit të bisedave telefonike të zhvilluara nga të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, si dhe të gjitha aktet dhe provat e tjera shkresore, në harmoni me njëra-tjetrën, provojnë që dy të pandehurit kanë bërë shtytjen dhe përdorimin e shtetases Engjëllushe Xhafa, për të lypur, me anë të transportimit të saj në vende të ndryshme, ku ajo ushtronte aktivitetin e lypjes dhe me anë të kthimit të saj në shtëpi, në përfundim të ditës, pasi ajo shtetase, kishte lypur në vende të ndryshme.

- Në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës, që ka të bëjë me atë që ajo e konsideron si mungesë elementit thelbësor të veprës penale të trafikimit të personave të rritur "rekrutimin e të dëmtuarës". Në lidhje me këtë moment të vendimmarrjes së saj, gjykata është përpjekur të bëjë një zbërthim mjaft të gjerë të të gjitha elementeve përbërëse të veprës penale të parashikuar nga neni 110/a të KP-së, për të arritur në fund në konkluzionin e gabuar se ekzistenca e kësaj vepre penale është e lidhur pazgjidhshmërisht me elementin "rekrutim", në një kohë mjafton të lexohet përmbajta e kësaj dispozite për të arritur në konkluzionin se elementet përbërëse të anës objektive të kësaj vepre penale përveç rekrutimit, janë edhe transportimi, e transferimi të cilët në një rast konkret, sikurse dhe praktika ka vërtetuar mund të qëndrojnë më vete, pra të shkëputur nga elementi rekrutim.

- Provohet që e dëmtuara është transportuar dhe transferuar në vende të ndryshme nga të pandehurit për të ushtruar aktivitetin e lypjes, edhe pse ky transportim është bërë brenda për brenda territorit të vendit, ashtu sikurse edhe dispozita e nenit 110/a të KP-së, e ka të parashikuar. Rezulton se gjykata ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin penal, duke bërë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga trafikim të rriturve në veprën penale të "Keqtrajtimit të të miturit", parashikuar nga neni 124/b i KP-së.

- Problemi shtrohet në një rrafsh më të gjerë, nëse do të konsiderohet si trafikim sipas nenit 110/a të KP-së, transportimi dhe transferimi brenda për brenda territorit, apo nisur dhe nga titullimi i dispozitës, ky lloj transportimi duhet bërë në kuadër të një qëllimi final të nxjerrjes jashtë kufijve shtetërorë? Për të bërë një zgjidhje përfundimtare të këtij problemi juridik, ne mendojmë se ndoshta është e nevojshme që nisur nga kjo çështje konkrete, rasti të mundësohet nga Kolegji Penal për t'u zgjidhur nga Kolegjet e Bashkuara, me qëllim interpretimin e saktë.

8. **Kundër vendimit nr. 54, datë 16.5.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, kanë paraqitur rekurs**, depozituar në datën 16.6.2016, **të gjykuarit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa**, të cilët kanë kërkuar: "*Ndryshimin e vendimit penal nr. 54, datë 16.5.2016, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, për cilësimin juridik, duke dhënë pafajësi, për shtetasit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa*". Në mënyrë të përmbledhur, në rekurs të gjykuarit kanë parashtruar këto shkaqe:

- Nga analiza juridike e fakteve, rezulton se nuk është kryer asnjë nga veprat penale të parashikuara në Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Në dosjen gjyqësore është administruar certifikata e lindjes e shtetases Engjëllushe Xhafa, e cila rezulton se është e datëlindjes 14 nëntor 1980. Pra, është në moshë madhore biologjike dhe fizike 36-vjeçare, pra nuk kemi përpara veprës penale të parashikuar nga neni 124/b të KP-së, e cila lidhet me subjektin e mitur. Në këtë dispozitë, siç është parashikuar edhe në disa dispozita të tjera të Kodit Penal, nuk është barazuar në mbrojtje personi me paaftësi mendore apo fizike me të miturin.

- Nga të gjitha aktet në dosjen gjyqësore rezulton se shtetasja Engjëllushe Xhafa, pavarësisht se është me paaftësi fizike dhe mendore nuk garanton mbrojtje nga kjo dispozite. Shtytja e detyrueshme ose jo për punë, për lypësi e një personi me paaftësi mendore apo fizike, pavarësisht moralit, nuk është parashikuar si e kundërligjshme apo vepër penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Në këto rrethana, konstatohet se veprimet e dy të

të pandehurve Ibrahim dhe Xhevdet Xhafa, nuk përmbajnë elemente të kundërligjshme të parashikuara si vepra penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.

- Në këto kushte, referuar edhe nenit 290/1, pika "c" dhe "ç" të KPP-së: "Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, sepse: c) mungon ankimi i dëmtuarit (në asnjë fletë të dosjes për procedimin penal nr. 342 të vitit 2014, të paraqitur për gjykim nga organi i akuzës, përpara gjykatës, nuk rezulton të ketë ndonjë ankesë nga e dëmtuara Engjëllushe Xhafa, ndaj të pandehurve Ibrahim dhe Xhevdet Xhafa); ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, ose kur del qartë, që fakti nuk ekziston.

- Lidhur me cilësimin e veprës penale si të kryer në bashkëpunim, në Kodin Penal, neni 28 nënvizon format e veçanta të bashkëpunimit. Por shtytja e detyrueshme ose jo për punë për lypësi e një personi me paaftësi mendore apo fizike, nuk klasifikohet në asnjërën prej formave të bashkëpunimit, në vështrim të nenit të sipërcituar. Për të bërë një zgjidhje përfundimtare të këtij problem juridik, mendojmë se është e nevojshme që duke u nisur nga ky rast, i konsideruar nga apeli si rast *sui generis* kjo çështje konkrete (lypësia), të mundësohet nga Kolegji Penal për t'u zgjidhur nga Kolegjet e Bashkuara, me qëllim për një interpretim të saktë dhe të qartë për rastin në fjalë dhe rastet e tjera të ngjashme.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

9. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim "Kolegji") në radhë të parë thekson faktin e ndryshimeve ligjore që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale (në vijim "KPP") me ligjin nr. 35/2017, ndryshime këto që kanë hyrë në fuqi në datë 1.8.2017, si dhe me ligjin nr. 41/2021, që ka hyrë në fuqi në datën 29.5.2021 (konstatim ky që lidhet me momentin e depozitimit të rekursit nga prokuroria dhe të gjykuarit/rekurset janë depozituar para së hynin në fuqi ndryshimet e KPP-së). Në nenin 38 të ligjit nr. 41/2021 mbi dispozitat kalimtare, parashikohet, se: "*1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.*". Në kuptim të kësaj dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues, si dhe procedurën e gjykimit, Kolegji Penal zbaton parashikimet e ligjit nr. 41/2021, ndërsa në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit i referohet ligjit procedural, që ka qenë në fuqi në kohën e depozitimit të tij.

10. Kolegji vlerëson se rekurset e paraqitura nga prokuroria dhe të gjykuarit plotësojnë kërkesat formale të pranueshmërisë dhe janë depozituar brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 435 të KPP-së (ligji/dispozita në fuqi në kohën e depozitimit të tij). Prokuroria dhe të gjykuarit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa janë njoftuar për rekurset respektive. Shkaqet e rekursit në Gjykatën e Lartë parashikohen nga neni 432 i KPP-së. Kjo dispozitë, në pikën 1 të saj, sipas ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të rekursit, parashikonte se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet për mosrespektimin ose për zbatimin e gabuar të ligjit penal; për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të këtij Kodi ose për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.

11. Gjatë shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, Kolegji vlerësoi se në rekurset e depozituara si nga prokuroria, ashtu edhe nga të gjykuarit, ngrihen çështje ligjore me rëndësi për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, në vështrim të kërkesave të nenit 432 pika "1", shkronja "a" të KPP-së. Kolegji, nga verifikimi i qëndrimit të mbajtur nga (ish-) gjykatat për krime të rënda (shkallë e parë dhe apel) në rastin konkret, në raport me raste të tjera të ngjashme ku janë trajtuar çështje të trafikimit të qenieve njerëzore (referuar këtu edhe qëndrimeve të Kolegjit Penal, veçanërisht qëndrimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 03/2011), vlerëson se ka qëndrime të ndryshme në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal të trafikimit të personave, të rritur apo të mitur. Këto qëndrime janë ndikuar edhe nga vendimi unifikues i lartpërmendur, në të cilin është dhënë kuptimi i termit "trafikimi", duke theksuar: "*Kështu, ligjvënësi, për rastet kur vepra ka karakter transnacional, ka përdorur në Kodin tonë Penal termin e përgjithshëm "trafikim" për titullimin e veprës (nenet 110/a, 114/b, 128/b, 138/a, 141/a, 278/a, 282/a dhe 283/a). Sipas legjislacionit tonë penal, pavarësisht nga personat e llojet e mallrave që trafikohen dhe origjinën e tyre, në thelb, trafikimi nënkupton rastet kur veprimtaria e kundërligjshme, duke përfshirë Shqipërinë e territorin e saj, kryhet në më shumë se një shtet, kryhet në një shtet por është përgatitur, programuar, drejtuar e kontrolluar në një shtet tjetër, kryhet në një shtet por ka efekte e pasoja thelbësore në një shtet tjetër. Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin se, kriter bazë për kuptimin e zbatimin e drejtë të veprave penale të "trafikimit" sipas Kodit tonë Penal është parimi i territorit, i prekjes e përdorimit të tij, me qëllimin e realizimit në rrugë kriminale të përfitimeve, përmes hyrjes ose daljes së paligjshme të personave apo sendeve nga territori shqiptar ose kalimit të paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar.*"

12. Në këto rrethana, Kolegji, mbështetur në nenin 438 të KPP-së, disponoi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë), me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me

çështjet:

1. Cilat janë format e kryerjes së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore?

2. Veprat penale të parashikuara nga nenet 110/a dhe 128/b të KP-së, janë vepra penale formale apo materiale?

3. Cili është kuptimi i termit "trafikim" në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe çfarë duhet kuptuar me "trafikim të brendshëm"?

4. Në rast se në kuptimin e termit "trafikim", përfshihet edhe trafikimi i brendshëm i personave të rritur apo të mitur, cilat janë dallimet mes veprave penale "Trafikim i personave të rritur" (neni 110/a i KP-së) dhe "Trafikim i të miturve" (neni 128/b i KP-së), me veprat penale "Shfrytëzimi i prostitucionit" (neni 114 i KP-së) dhe "Keqtrajtimi i të miturit" (neni 124/b i KP-së)?

5. Si duhet cilësuar fakti i shtytjes së detyrueshme ose jo, për punë apo për lypje e një personi me aftësi të kufizuara mendore apo fizike, kur ky person nuk është në moshë të mitur? A mund të trajtohet në këtë rast personi me aftësi të kufizuara mendore si një person që për nga zhvillimi mendor barazohet me një të mitur?

13. Në seancë gjyqësore, përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme, prokurori Arqilea Koça, në lidhje me pyetjet e shtruara për njësim mbajti këto qëndrime (parashtruar më poshtë në mënyrë të përmbledhur):

- Në lidhje me çështjen e parë, Gjykata e Lartë duhet të japë përgjigjen se: "Format e trafikimit të qenieve njerëzore janë rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e viktimës nëpërmjet njërës prej formave të deformimit të vullnetit dhe që kanë si synim shfrytëzimin për një prej formave të përshkruara por jo vetëm...".

- Në lidhje me pyetjen e dytë, Gjykata e Lartë duhet të japë përgjigjen se: "Vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore në thelb është një vepër penale materiale."

- Në lidhje me çështjen e tretë, Gjykata e Lartë duhet të japë përgjigjen se: "Trafikim i brendshëm do të thotë ushtrim i veprimtarisë kriminale të trafikimit, tërësisht brenda territorit të shtetit shqiptar."

- Për sa i përket subjektit pasiv të veprës, në veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe në veprën penale të shfrytëzimit për prostitucion, si të tillë janë personat e rritur dhe të miturit, ndërsa në veprën penale të keqtrajtimit të të miturve, nga vetë titulli i dispozitës, si të tillë janë vetëm të miturit, që ndodhen në marrëdhënie të posaçme me subjektin aktiv. Ajo që vlen të theksohet është pozita e veçantë në të cilën vendoset subjekti pasiv/viktima në veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, gjë të cilën nuk e gjejmë në dy veprat e tjera penale. Sikurse trajtuam më sipër, viktima e trafikimit vendoset në kushtet e izolimit fizik dhe social në reduktim ekstrem të lirisë personale për të mundësuar shfrytëzimin e saj. Në lidhje me anën subjektive, është e rëndësishme të nënvizojmë elementin qëllim. Te veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, sikurse u trajtua më sipër, qëllimet janë disa, përfshirë shfrytëzimin seksual që përbën qëllimin që ndeshet praktikisht më shpesh, shfrytëzimin e punës, shërbimeve etj., ndërsa te vepra penale e shfrytëzimit të prostitucionit qëllimi i vetëm është pikërisht ky i fundit. Te vepra penale e keqtrajtimit të të miturve, referuar paragrafit të dytë të dispozitës, qëllimi është shfrytëzimi i tyre për të punuar, lypur, për të nxjerrë të ardhura etj.

- Në vështrimin në tërësi të asaj çka u parashtrua më sipër, vlerësojmë se dallimi më thelbësor midis veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit për prostitucion e keqtrajtimit të të miturit qëndron në pozitën e subjektit pasiv/viktimës. Vendosjen e viktimës në pozitat e izolimit fizik dhe social, karakteristikë e veprave penale të trafikimit, nuk e gjejmë në veprën penale të shfrytëzimit për prostitucion dhe në atë të keqtrajtimit të të miturit. Niveli i cenimit të të drejtave themelore të individit nëpërmjet aktivitetit kriminal, përbën ndryshimin thelbësor mes dispozitave të trafikimit të qenieve njerëzore nga njëra anë dhe veprave penale të shfrytëzimit të prostitucionit dhe keqtrajtimit të të miturit nga ana tjetër.

- Shtytja, e detyrueshme ose jo, e një personi me aftësi të kufizuara mendore apo fizike, për punë apo lypje, kur ky person nuk është i mitur, nuk gjen rregullim ligjor në legjislacionin tonë penal Në rastin konkret, personi me aftësi të kufizuara mendore mund të trajtohet si një person që për nga zhvillimi mendor barazohet me të miturin, por nuk mund të cilësohet si keqtrajtim i të miturit apo cilëndo vepër që mbron të miturin.

14. Mbrojtësi i zgjedhur nga të gjykuarit, në lidhje me çështjet e shtruara për njësim, mbajti qëndrimin (e lidhur me rastin e të gjykuarve) se: "Çështja e aftësive të kufizuara mendore lidhet me zotësinë juridike për të vepruar në kuptimin civil dhe i papërgjegjshëm para ligjit në aspektin penal. Kurse çështja e klasifikimit si i mitur për shkak të metave mendore nuk mund të ndodhi. I mituri lidhet vetëm me moshën nën 18 vjeç ditën e kryerjes së veprës."

i. E drejta/ligji i zbatuar

15. Kolegji vlerëson se paraprakisht duhet të trajtojë ligjin/të drejtën e zbatueshme në rastin konkret, e lidhur kjo me konkluzionin e vendimit unifikues nr. 3/2011, që është referuar nga gjykatat e faktit në këtë çështje penale. Kolegji konstaton se vendimi unifikues nr. 3/2011 ka konkluduar se, *kriter bazë për kuptimin e zbatimin e drejtë të*

veprave penale të "trafikimit" sipas Kodit tonë Penal është parimi i territorit, i prekjes e përdorimit të tij, me qëllimin e realizimit në rrugë kriminale të përfitimeve, përmes hyrjes ose daljes së paligjshme të personave apo sendeve nga territori shqiptar ose kalimit të paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar. Kolegji shtroi për diskutim nëse në këtë rast konkret ishte e nevojshme inicimi i procedurës së ndryshimit të këtij vendimi unifikues në Kolegje të Bashkuara apo njësimi i praktikës gjyqësore nga Kolegji Penal. Për të arritur në një konkluzion të drejtë në këtë aspekt, Kolegji vlerëson se duhet analizuar fakti i trafikimit të qenieve njerëzore, si në aspektin kushtetues, ashtu edhe në aspektin penal.

15.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk ndalon shprehimisht trafikimin e qenieve njerëzore dhe çdo formë të saj.[28] Kolegji thekson se, nuk ka asnjë dyshim se trafikimi cenon dinjitetin njerëzor dhe liritë themelore të personave që janë viktimë e tij, ndaj nuk ka sesi të shihet si i pajtueshëm me një shoqëri demokratike, as me vlerat e sanksionuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim KEDNJ/*shih GJEDNJ, çështja Rantsev kundër Qipro dhe Rusisë/aplikimi nr. 25965/04, datë 7.1.2010*). Në thelb, trafikimi dhunon të drejtat universale të individit: të drejtën e jetës, të lirisë së lëvizjes, cenon dinjitetin e individit dhe të drejtën për t'u mbrojtur nga çdo lloj forme skllavërie. Kolegji vë në dukje se ndonëse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk e ndalon në mënyrë të shprehur trafikimin e qenieve njerëzore, në nenin 3 të saj parashikon se: "… *dinjiteti, të drejtat dhe liritë e personit, … janë baza e këtij vendi, i cili ka detyrimin t'i respektojë dhe mbrojë ato*". Ndërkohë, neni 26 i Kushtetutës sanksionon se: "*Askujt nuk mund t'i kërkohet të kryejë një punë të detyruar, përveçse në rastet e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor, të kryerjes së shërbimit ushtarak, të një shërbimi që rrjedh nga një gjendje lufte, nga një gjendje e jashtëzakonshme ose një fatkeqësi natyrore, që kërcënon jetën ose shëndetin e njerëzve*". Kolegji vë në dukje se me rëndësi për rastet kur trajtohet trafikimi i të miturve është edhe neni 54/3 i Kushtetutës, i cili sanksionon të drejtën e fëmijës për të qenë i mbrojtur nga shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, veçanërisht nën moshën minimale lidhur me punën që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojnë jetën a zhvillimin normal të fëmijës.

15.2 Kolegji, nisur nga fakti që Shqipëria është palë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, vlerëson se jo vetëm dispozitat e KEDNJ-së, por edhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "GJEDNJ"), është e detyrueshme për të. Në jurisprudencën e saj, GJEDNJ-ja ka theksuar se KEDNJ-ja, në interpretim të nenit 4 të saj, përcakton për shtetet palë detyrime pozitive në marrjen e masave për ndalimin e skllavërisë moderne, për mbrojtjen e qenieve njerëzore nga skllavëria, robëria dhe puna e detyruar (*shih GJEDNJ, çështja Siliadin kundër Francës, kërkesa nr. 73316/01, datë 26.7.2005*), për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, për marrjen e masave në mbrojtjen e viktimave apo të viktimave të mundshme. GJEDNJ-ja ka theksuar se neni 4 përcakton detyrimin për shtetet palë për të kriminalizuar e për të hetuar efektivisht çdo akt që synon mbajtjen e një personi në skllavëri, robëri apo në kushtet e punës së detyruar, si dhe për të hetuar e dënuar përgjegjësit e trafikimit (*shih GJEDNJ, çështja C.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 4239/08, datë 13.11.2012*).

15.3 GJEDNJ ka argumentuar në disa raste se trafikimi i qenieve njerëzore mbështetet në ushtrimin e disa atributeve të së drejtës së pronësisë, ku qeniet njerëzore trajtohen si mallra që mund të shiten e të blihen, mund t'i nënshtrohen një pune të detyruar, shpeshherë pak apo aspak të paguar. Trafikimi nënkupton një mbikëqyrje të rreptë të veprimtarive të viktimave dhe shpesh, këtyre të fundit ju kufizohet liria e qarkullimit, i nënshtrohen akteve të dhunës apo kërcënimeve, si dhe vendosen në kushte të papërshtatshme jetese dhe pune (*shih GJEDNJ, çështja Rantsev kundër Qipros e Rusisë, paragrafi 272, çështja M. e të tjerë kundër Italisë dhe Bullgarisë, aplikimi nr. 40020/03, datë 31.7.2012*).

15.4 Shqipëria ka ratifikuar disa marrëveshje ndërkombëtare që synojnë mbrojtjen e viktimave të trafikimit me qëllim shfrytëzimin e tyre, por në rastin konkret Kolegji vlerëson me rëndësi të evidentojë: *i)* Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar me dy protokollet e saj plotësuese – protokolli kundër trafikimit të migrantëve në rrugë tokësore, ajrore dhe detare, si dhe protokolli mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve, që janë ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002 (*protokolli i Palermos*); *ii)* Konventën e Këshillit të Evropës "Për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore", që është ratifikuar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006 (e njohur si *Konventa e Varshavës*). Me nënshkrimin e kësaj Konvente, Shqipëria ka marrë përsipër një sërë detyrimesh në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të viktimave të trafikimit. Konventa e Varshavës në kuadër të masave për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit, thekson se çdo Palë në

[28] Kolegji, në kuadër të perspektivës së integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE), e si rrjedhojë për shkak të detyrimit për të përafruar legjislacionin shqiptar me atë të BE-së, vë në dukje se neni 5 i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, titulluar "Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar" parashikon shprehimisht: "1. Askush nuk mund të mbahet në skllavëri apo robëri. 2. Askush nuk mund të shtrëngohet që të kryejë një punë të detyruar apo të detyrueshme. 3. Ndalohet trafikimi i qenieve njerëzore.".

këtë konventë duhet të marrë masat për identifikimin e viktimave, me një procedurë që merr parasysh situatën e veçantë të viktimave gra dhe fëmijë (neni 10 i kësaj konvente). Raporti shpjegues i Konventës së Varshavës e ka cilësuar trafikimin si një formë moderne e tregtisë botërore të skllevërve. Në protokollin e dytë shtesë "Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave e të fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar", në nenin 3 të tij, theksohet kuptimi që i jepet nga ky protokoll pikërisht termit "trafik i personave" - pjesë kjo e integruar edhe në dispozitat e Kodit Penal shqiptar, që penalizojnë format e ndryshme të trafikimit të qenieve njerëzore (që do të trajtohet në vijim). Më tej, në këtë dispozitë të protokollit shtesë të sipërcituar, qartësohet edhe kuptimi i termit "shfrytëzim": "*Shfrytëzimi përfshin, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikat e ngjashme me skllavërinë, heqjen e organeve ose servitutet*", si dhe përcaktohet shprehimisht se: "*Fëmijë nënkupton çdo person nën moshën 18 vjeç*" (neni 3, germa "d").

15.5 Në zbatim dhe në harmoni me standardet ndërkombëtare, Republika e Shqipërisë ka bërë disa ndryshime në Kodin Penal. Kolegji vlerëson me rëndësi të theksojë se, me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013, dispozitat e ligjit material penal mbi trafikimin e qenieve njerëzore, janë ndryshuar thelbësisht (ligj që ka hyrë në fuqi në datë 4.6.2013). Ndryshimet në Kodin Penal erdhën si rrjedhojë e rekomandimeve GRETA (Grupi i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore), që është përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore", ku palë është edhe Shqipëria. Ky mekanizëm monitorues është krijuar pikërisht në zbatim të kësaj Konvente (nenet 36–38). Me këtë ligj është shfuqizuar neni 114/a "Shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese", si dhe neni 114/b i KP-së "Trafikimi i femrave", dhe është ndryshuar neni 110/a në titull dhe në përmbajtje: "Trafikimi i personave të rritur". Me formulimin e ri të nenit 110/a të KP, trafikimi i femrave është parashikuar si rrethanë cilësuese; është parashikuar shprehimisht "*trafikimi i brendshëm*" (neni 110/a i KP-së parashikon shprehimisht se, trafikimi i personave të rritur mund të kryhet si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë), përveç atij jashtë kufijve të Shqipërisë; janë ashpërsuar dënimet për disa rrethana cilësuese. Duhet theksuar se, në nenin 128/b të këtij Kodi, nuk është parashikuar shprehimisht trafikimi i të miturve "si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë" – pra, nuk është referuar edhe në këtë dispozitë trafikimi i brendshëm. Nga ana tjetër, në paragrafin e dytë të nenit 114 (dispozitë kjo që është ndryshuar me ligjin nr. 144/2013) parashikohet se shfrytëzimi për prostitucion i një të mituri dënohet sipas kësaj dispozite, duke mos u kualifikuar si trafikim i të miturve (problematika që do të trajtohen në vijim).

15.6 Kolegji evidenton edhe ndryshimet që ka pësuar legjislacioni penal material e procedural, në lidhje me drejtësinë penale për të miturit. Konkretisht, është miratuar me ligjin nr. 37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM). KDPM-ja parashikon të drejta të posaçme për të miturin viktimë të veprës penale, duke garantuar mbrojtjen e të miturit dhe interesin e tij më të lartë, në përputhje me Kushtetutën dhe standardet ndërkombëtare. Në ndryshim nga KPP-ja, ky Kod në nenin 3 të tij jep përkufizimet, mes të cilave vlen të evidentohet parashikimi se "*i mitur është çdo person nën moshën 18 vjeç*". Ndërkohë, në pikën 5 të kësaj dispozite të KDPM-së është saktësuar edhe termi 'viktimë e mitur' – duke konsideruar si të tillë, çdo person nën moshën 18 vjeç, të cilit i është shkaktuar dëm moral, fizik ose material, si pasojë e një vepre penale. Fakti që kuptimi apo përkufizimi i termave "i mitur apo viktimë e mitur" është parashikuar në KDPM, nuk ka asnjë ndikim në rastin konkret (pavarësisht kohës së kryerjes së veprës penale), për sa kohë marrëveshjet e referuara më lart janë ratifikuar dhe si rrjedhojë, pjesë e legjislacionit të brendshëm shqiptar dhe të detyrueshëm për t'u zbatuar edhe nga organet e drejtësisë. Konkretisht, Konventa e Varshavës (KE) parashikon shprehimisht se ajo do të zbatohet për të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore, qoftë kombëtare ose transnacionale, të lidhura apo jo me krimin e organizuar (*neni 2 i Konventës së Këshillit të Evropës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore"*). Ky parashtrim u vlerësua me rëndësi nga ana e Kolegjit për të vënë theksin në faktin se, pavarësisht se në KPP apo në KP mungon një dispozitë që të përkufizojë të miturin apo viktimën e mitur në kohën e kryerjes së veprës penale, marrëveshjet ndërkombëtare të detyrueshme për t'u zbatuar edhe nga shteti shqiptar, garantojnë mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetin e të miturve, viktima të trafikimit apo të shfrytëzimit. (*shih vendimin nr. 00-2021-727 (46), datë 21.9.2021 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

15.7 Kolegji, në vijim të argumenteve të parashtruara më lart dhe në referim të ligjit/legjislacionit të zbatueshëm, vlerëson se vendimi unifikues nr. 3/2011 nuk gjen zbatim në rastin e veprave penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore. *Së pari*, ky vendim unifikues (nr. 3/2011) trajton një çështje penale që lidhet me trafikimin e lëndëve narkotike dhe/ose trafikimin e armëve, të cilat janë vepra penale që përfshihen në kreun VIII, "Krime kundër autoritetit të shtetit", seksioni III të Kodit Penal, "Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike". Ndërkohë, veprat penale që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore përfshihen në kreun II të Kodit Penal, "Krime kundër personit", konkretisht në seksionin VII "Veprat penale kundër lirisë së personit" (neni

110/a i KP-së) dhe seksioni IX "Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes" (neni 128/b i KP-së). Në rrethanat e sipërcituara, Kolegji vlerëson se nuk mund të vendoset shenja e barazimit dhe të trajtohen në mënyrë të njëjtë veprat penale të sipërcituara, vetëm për shkak të termit "trafikim" në titullin e dispozitës. *Së dyti*, siç u theksua, ligji penal ka pësuar ndryshime me ligjin nr. 144/2013, duke kriminalizuar trafikimin e qenieve njerëzore si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se në rastin konkret, nuk është e nevojshme inicimi i procedurës për ndryshimin e praktikës gjyqësore, pasi vendimi unifikues i referuar nga gjykata e apelit nuk ka lidhje dhe për pasojë, nuk gjen zbatim në rastin konkret, por edhe më gjerë në trajtimin e veprave penale të trafikimit të personave të rritur apo të mitur, duke vijuar me procedurën për njësimin e praktikës gjyqësore.

ii. Standardet ndërkombëtare dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së, në raport me trafikimin e qenieve njerëzore

16. Kolegji vlerësoi me rëndësi njësimin e praktikës gjyqësore, nisur edhe nga fakti që ligjvënësi ndonëse ka ndryshuar e përafruar me standardet ndërkombëtare nenin 110/a të KP-së, "Trafikimi i personave të rritur", nuk ka parashikuar shprehimisht trafikimin e brendshëm edhe në nenin 128/b të KP-së, "Trafikimi i të miturve". Në këtë drejtim, Kolegji vlerëson të theksojë se, sipas neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,[29] marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik shqiptar, të detyrueshme dhe të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç kur zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Këto dispozita kushtetuese përcaktojnë se, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në hierarkinë e akteve normative në Republikën e Shqipërisë, janë pas Kushtetutës. Në këtë kuptim, në rast mospërputhje ndërmjet marrëveshjes ndërkombëtare të ratifikuar dhe ligjeve apo akteve normative të Këshillit të Ministrave, norma ndërkombëtare ka përparësi dhe është e detyrueshme të zbatohet.

16.1 Në lidhje me zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së, Kolegji çmon të nevojshme të sjellë në vëmendje edhe vendimin nr. 20/2011 të Gjykatës Kushtetuese, ku, ndër të tjera, është theksuar:

"*... interpretimi i bërë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është i gabuar dhe vjen në kundërshtim me nenet 122 e 124 të Kushtetutës, si dhe me nenin 46 të KEDNJ-së ... Vendimet e GJEDNJ-së janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, palë të KEDNJ-së, duke përmbushur në këtë mënyrë zotimet që burojnë nga neni 46/1 i saj. Gjykata, konstaton, gjithashtu, se krahas domosdoshmërisë së plotësimit nga Kuvendi të boshllëkut ligjor në legjislacionin penal procedural, Gjykata e Lartë duhet të bëjë përpjekje për të gjetur zgjidhjen e duhur, për të vënë në vend të drejtën e shkelur të kërkuesit, qoftë duke përdorur edhe analogjinë me Kodin e Procedurës Civile. (...) Gjykata, në vijim të argumenteve të saj, e sheh me vend të theksojë se, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GJEDNJ-ja ka në sistemin tonë juridik një kompetencë eksklusive. Kjo kompetencë është e pranuar nga sistemi ynë i brendshëm juridik, për efekt të zbatimit të nenit 122 të Kushtetutës, po edhe të nenit 17/2 të saj, të cilët sjellin si detyrim që vendimet e GJEDNJ-së të zbatohen drejtpërsëdrejti. (...) Posaçërisht për sa u përket vendimeve të GJEDNJ-së për procedime penale, për legjislativin lind nevoja që të marrë masa për të harmonizuar legjislacionin e brendshëm me dispozitat e KEDNJ-së.* ***Nëse nuk ka harmonizim, pra, nëse jemi në rastet e vakuumit legjislativ, ose kur parashikimet ligjore bien në kundërshtim me dispozitat e Konventës, atëherë gjyqtarët e çdo niveli zbatojnë drejtpërsëdrejti vendimet e GJEDNJ-së në përputhje me nenin 122 të Kushtetutës dhe nenet 19 dhe 46 të KEDNJ-së.*** *Neni 122 i Kushtetutës përcakton shprehimisht se dispozitat e marrëveshjeve ndërkombëtare kane epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. (...) Gjykata Kushtetuese çmon se respektimi i KEDNJ-së dhe standardeve kushtetuese është detyrim jo vetëm i saj, por edhe i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, në mënyrë të veçantë Gjykatës së Lartë për shkak të kompetencave të veçanta të saj të natyrës rishikuese, por edhe në drejtim të unifikimit të praktikës gjyqësore. (...) Gjykata çmon se duke pasur parasysh edhe rolin qendror të Gjykatës së Lartë në sistemin tonë gjyqësor, lipset që kjo gjykatë, në përputhje edhe me*

[29] **Neni 116 i Kushtetutës, përcakton**: "1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:
a) Kushtetuta;
b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;
c) ligjet;
ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave."
Neni 122 i Kushtetutës, përcakton: "1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.
2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të ..."

nenin 1 të Kodit të Procedurës Penale, të mos kufizohet vetëm në dispozitat e këtij Kodi, por të zbatojë drejtpërsëdrejti Kushtetutën dhe KEDNJ-në."

16.2 GJEDNJ-ja në vendimmarrjet e saj ka theksuar se, në kontekstin e veçantë të trafikimit të qenieve njerëzore, Protokolli i Palermos dhe Konventa kundër Trafikimit (Konventa e Varshavës) përmendin, si njëri ashtu edhe tjetra, domosdoshmërinë e miratimit të një qasjeje globale për të luftuar kundër trafikimit duke vendosur, përveç masave që synojnë të sanksionojnë trafikantët, edhe disa masa për parandalim të trafikimit dhe për mbrojtje të viktimave. Sipas GJEDNJ-së, nga dispozitat e këtyre dy instrumenteve, del qartë se shtetet kontraktuese, mes të cilave figurojnë pothuajse të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, çmojnë se vetëm një kombinim masash që i trajtojnë të tria aspektet e problemit mund të japë mundësi që të luftohet në mënyrë të efektshme kundër trafikimit. GJEDNJ-ja ka theksuar edhe faktin se detyrimi për ta penalizuar trafikimin dhe për t'i ndjekur penalisht autorët e tij është vetëm njëri aspekt i angazhimit të përgjithshëm të shteteve anëtare për të luftuar kundër kësaj dukurie dhe se rrezja e veprimit të detyrimeve pozitive që rrjedhin nga neni 4 duhet të merret parasysh në kontekstin më të gjerë të këtij angazhimi (*shih GJEDNJ, çështja Rantsev kundër Qipro dhe Rusisë/aplikimi nr. 25965/04, datë 7.1.2010*).

16.3 Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja ka pohuar se tërësia e garancive të parashikuara nga legjislacioni kombëtar duhet të jetë e përshtatshme, me qëllim që të garantohet një mbrojtje konkrete dhe efektive e së drejtës së viktimave reale/të identifikuar si të tilla ose viktimave të mundshme të trafikimit. Ajo ka theksuar se, përveç masave me karakter penal që shërbejnë për të dënuar trafikantët, neni 4 u kërkon shteteve anëtare vendosjen e masave të përshtatshme me qëllim që të përcaktohen rregullat për ato veprimtari që shpesh përdoren si mbulesë për trafikimin. GJEDNJ-ja ka nënvizuar se detyrimi për hetim nuk varet nga kallëzimi i viktimës apo familjarëve të saj, duke qenë trafikimi i personave një vepër penale që ndiqet kryesisht nga prokuroria. Hetimi duhet të jetë efektiv dhe trajtimi i rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore duhet të kryhet brenda një afati të arsyeshëm, duke pasur në vëmendje mbrojtjen e viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit (*Shih çështjen Rantsev kundër Qipro dhe Rusisë/aplikimi nr. 25965/04, datë 7.1.2010, çështjen C.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 4239/08, datë 13.11.2012*).

16.4 Kolegji vlerëson se konkluzionet e cituara më lart, gjejnë zbatim edhe në rastin konkret, në zbatimin e marrëveshjeve ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, duke marrë përsipër edhe interpretimin e ligjit penal në përputhje me to. Ky konstatim lidhet me detyrimin për zbatimin e nenit 128/b, të KP-së në raport me nenin 114, pika 2, të këtij Kodi, në rastet kur viktima e trafikimit apo e shfrytëzimit është një i/e mitur. Standardet ndërkombëtare[30] dhe konventat e ratifikuara nga Shqipëria, sanksionojnë shprehimisht që pëlqimi i një të mituri për të ushtruar prostitucion nuk merret në konsideratë, duke theksuar se pëlqimi apo pranimi i një të viktime të mitur për të ushtruar prostitucion apo çdo lloj shërbimi a pune tjetër që nuk është në përputhje me zhvillimin e tij, duhet trajtuar si trafikim, pavarësisht faktit nëse ky shfrytëzim i të miturit është realizuar brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (*Ky interpretim i gabuar i ligjit nga gjykatat shqiptare është vënë në dukje edhe në rekomandimet e GRETA-s për Shqipërinë, që monitoron zbatimin e Konventës së Varshavës në vendet anëtare. Këto konkluzione kanë rëndësi për përgjigjet e pyetjeve të shtruara për njësim në këtë vendim*).

iii. Në lidhje me pyetjen e parë të shtruar për njësim: "**Cilat janë format e kryerjes së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore**?"

17. Në lidhje me këtë çështje, Kolegji gjen me vend të ritheksojë se aktualisht në Kodin Penal ka dy dispozita që në mënyrë të shprehur kriminalizojnë trafikimin e qenieve njerëzore: trafikimi i personave të rritur/neni 110/a dhe trafikimi i të miturve/neni 128/b. Trajtimi i kësaj çështje u vlerësua me rëndësi nga Kolegji, për sa kohë gjykatat e faktit në vendimmarrjet objekt rekursi kanë argumentuar se, "*rezulton e provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm, që të pandehurit Ibrahim Xhafa dhe Xhevdet Xhafa, kanë shtytur dhe përdorur të dëmtuarën Engjëllushe Xhafa, që ajo të lypë, por ky fakt nuk duhet të ngatërrohet me veprën penale të trafikimit të personave të rritur, e cila kërkon si element të parë të domosdoshëm, rekrutimin e personit dhe më pas, heqjen ose kufizimin e lirisë së vullnetit të tij dhe detyrimin e tij që të kryejë, jashtë vullnetit të tij, veprime të caktuara, ku përfshihet edhe lypja.*"

17.1 Kolegji vlerëson të gabuar këtë qëndrim të gjykatave të faktit. Për më tepër arsyetimi i tyre është edhe kontradiktor pasi në vijim ato theksojnë, "*Zhvendosja dhe transferimi që të dy të pandehurit, por edhe familjarët që i kanë bërë shtetases Engjëllushe Xhafa për të lypur, në kohë dhe vende të ndryshme, në kushtet kur ajo ishte në karrocë invalidi, me paaftësi*

[30] Kolegji vlerëson të referojë direktivën 2011/36/BE dhe direktivën tjetër nr. 29/2011/BE, që janë me rëndësi në kuadrin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, në procesin e integrimit të Shqipërisë. Nga ana tjetër, në shumë raste GRETA referon edhe këto direktiva, në kuadër të monitorimit të shteteve anëtarë në Konventën e KE-së "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore", që siç theksuam është ratifikuar nga Shqipëria, duke marrë përsipër edhe detyrimet që burojnë prej saj.

fizike dhe prapambetje mendore, pra e paaftë për t'u kujdesur për veten e saj dhe për të lëvizur vetë nga njëri vend në tjetrin, është pjesë e shtytjes dhe përdorimit për të lypur që të pandehurit kane bërë ndaj shtetases Engjëllushe Xhafa dhe nuk plotëson kushtet e transportimit dhe të zhvendosjes, si forma të kryerjes së veprës penale të "Trafikimit të personave të rritur", të parashikuar nga neni 110/a i KP-së, pikërisht sepse në këtë rast, nuk provohet që të pandehurit të kenë bërë rekrutimin e kësaj shtetaseje dhe më pas të kenë bërë kufizimin e lirisë së vullnetit të saj dhe detyrimin për të lypur, ashtu siç me të pa të drejtë pretendon akuza." Kolegji, pikërisht duke ju referuar këtij argumentimi si dhe mënyrës së zgjidhjes së çështjes konkrete, vlerëson me rëndësi trajtimin e formave të kryerjes së veprave penale të trafikimit të personave, të rritur apo të mitur.

17.2 Kolegji thekson se trafikimi i personave të rritur apo të mitur është një problem kompleks, pasi format dhe mjetet e realizimit ndryshojnë në funksion të zhvillimit të shoqërisë, të gjendjes ekonomike, sociale apo politike të shteteve të ndryshme. Sot, trafikimi trajtohet si një formë moderne e skllavërisë, nuk është thjesht një dhunim i të drejtave të njeriut, por është edhe një problem i rendit publik, prandaj me rëndësi është edhe evidentimi i formave të ndryshme të shfrytëzimit të individit, të cilat duhen trajtuar si forma të ngjashme me skllavërimin (*Në raport-vlerësimin e GRETA-s për Shqipërinë publikuar në dhjetor 2020, është theksuar shqetësimi për numrin e ulët të personave të dënuar për trafikim të qenieve njerëzore. Si një nga shkaqet e evidentuara në këtë raport është edhe kualifikimi i gabuar i faktit penal të trafikimit të personave të rritur apo fëmijëve, në një vepër tjetër penale. Ky kualifikim i gabuar sjell pasoja jo vetëm në dhënien e drejtësisë, por mbi të gjitha në faktin se viktima e veprës penale në këtë rast, nuk identifikohet si viktimë trafikimi apo viktimë e mundshme e trafikimit.*).

17.3 Kolegji vlerëson me rëndësi në funksion të zbatimit sa më të drejtë të ligjit penal material, në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, të ndalet edhe në një trajtim më të detajuar të elementeve të trafikimit. Konkretisht, për sa i takon "rekrutimit" si një nga format/veprimet e kryera nga subjekti aktiv i veprës penale, Kolegji thekson se ky element nënkupton veprimet aktive/konkrete që kryen i pandehuri për gjetjen në radhë të parë të një personi që mund të nënshtrohet lehtësisht, e lidhur kjo me shkaqe të ndryshme sociale, familjare, ekonomike apo personale. "Rekrutimi synon krijimin e një gjendje varësie mes rekrutuesit dhe të rekrutuarit, ku këto të fundit pasi më parë janë nënshtruar, vendosen në një gjendje varësie, e në vijim ato shfrytëzohen. Nënshtrimi, në të vërtetë, është një pozicion subjektiv pasiv, ku personi i nënshtruar përballet me një aktivitet fuqie që përkthehet në imponimin e detyrave ose të kushteve jo të favorshme për të. Kjo gjendje nënshtrimi dhe varësie varet nga vullneti i rekrutuesit dhe zakonisht vazhdon sipas atij vullneti." (*Shih vendimi nr. 70, datë 11.5.2017, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.*) Në këtë pikë, Kolegji thekson se gjykatat dhe prokuroria duhet të kenë në vëmendje që personat që jetojnë në një ambient social apo familjar me probleme ekonomike, financiare, personale apo psikologjike, duhen trajtuar me shumë kujdes, si viktima të mundshme të trafikimit.

17.4 Kolegji thekson se forma të trafikimit janë edhe transportimi dhe transferimi i personit, (të ngjashëm mes tyre), që nënkupton lëvizjen apo zhvendosjen e një personi nga një vend në një vend tjetër. Për të ekzistuar kjo formë e trafikimit, nuk kërkohet domosdoshmërisht që lëvizja apo zhvendosja të ketë si synim kalimin e kufijve të Republikës së Shqipërisë, por mund të realizohet edhe brenda territorit të shtetit shqiptar. Transportimi apo transferimi i personit mund të realizohet me vullnetin e lirë të viktimës, e lidhur kjo me mjetet/mënyrën që përdor i pandehuri, zakonisht duke përfituar nga besimi i viktimës apo për shkak të mashtrimit (veçanërisht mashtrimi për krijimin e një lidhjeje/marrëdhënie intime, që shoqërohet me zhvendosjen në një vend tjetër për një jetë më të mire). Qëllimi i zhvendosjes së viktimës së trafikimit është izolimi i saj, shkëputja e lidhjeve me vendin e saj të origjinës (për shembull me qytetin e lindjes), me personat e saj të afërt apo të familjes, duke e shkëputur nga njerëzit që mund ta ndihmojnë për të shmangur shfrytëzimin.

17.5 Për ta evidentuar dallimin mes këtyre dy formave të trafikimit (transportim dhe transferim), Kolegji vlerëson se transportimi i personit përfshihet brenda konceptit të transferimit, që do të thotë se sa herë që kemi transferim të personit kjo shoqërohet edhe me transportim të tij, si brenda dhe jashtë vendit. Një dallim tjetër mes transportimit dhe transferimit të personit, është fakti që tek transferimi i viktimës, subjekti i veprës penale kryen një veprimtari kriminale më të gjatë në kohë, deri sa të arrijë plotësisht zhvendosjen e viktimës nga një shtet/vend në një shtet/vend tjetër. Transportimi i personit zakonisht zgjat disa orë dhe ka si synim thjesht lëvizjen e viktimës, por jo edhe izolimin e saj apo largimin në një vend të panjohur e të huaj për të. Nisur nga natyra e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore, që zakonisht është një veprimtari kriminale e organizuar, Kolegji thekson se në kryerjen e veprës penale mund të bashkëveprojnë disa persona, ku njëri vepron përmes rekrutimit, një tjetër vepron duke e transportuar apo transferuar nga një vend në një vend tjetër, ku e pret me shumë mundësi personi që më pas do ta shfrytëzojë. Pavarësisht se mund të veprojnë në forma të ndryshme, qëllimi i tyre i përbashkët është shfrytëzimi, ndaj Kolegji thekson

se në këtë rast të gjithë bashkëpjesëmarrësit duhet të hetohen apo gjykohen për veprën penale të trafikimit të personit, qoftë ky i rritur apo i mitur.

17.6 Dispozita penale konkrete, neni 110/a i KP-së, parashikon si formë të trafikimit edhe "fshehjen e personit", që nënkupton mbajtjen e viktimës të izoluar nga ambienti i jashtëm, duke ndërprerë çdo lloj komunikimi të saj me persona të tjerë, kryesisht me familjen ose miqtë dhe të afërmit të saj. Kolegji vlerëson se, në mënyrë që të jemi para kësaj forme të kryerjes së veprës penale të trafikimit të personit, kërkohet që viktimës t'i hiqet liria dhe të mbahet e izoluar jashtë vullnetit të saj, duke i hequr çdo mundësi që ajo të komunikojë me persona të tjerë dhe me botën e jashtme. Nga ana tjetër, "pritja e personit" si një nga format e trafikimit, nënkupton veprimet që kryhen nga ana e subjektit të veprës penale që kanë të bëjnë me strehimin e personit dhe me shoqërimin e tij për në një vend të caktuar, zakonisht banesë, hotel ose në ndonjë vend tjetër. Që të jemi para formës "pritja e personit", kërkohet detyrimisht që subjekti i veprës penale të kryejë veprime aktive që kanë të bëjnë me pritjen e personit/viktimës, me shoqërimin për në vendin e strehimit dhe të qëndrimit dhe me sigurimin prej tij të kushteve të banimit për viktimën.

17.7 Ligji material penal parashikon në nenin 110/a, paragrafi parë, edhe mjetet nëpërmjet të cilave mund të realizohet secila nga format e kryerjes së trafikimit të personit të rritur. Kolegji vë në dukje se mjetet apo mënyra sesi realizohet trafikimi i personave të rritur, kanë si qëllim të krijojnë një lloj kontrolli të subjektit të veprës penale/të pandehurit mbi viktimën e tij. Në rast se i referohemi paragrafit të parë të nenit 110/a, mjetet për realizimin e trafikimit të personave të rritur janë: me anë të kërcënimit; me anë të përdorimit të forcës; me anë të formave të tjera të shtrëngimit; me anë të rrëmbimit; me anë të mashtrimit; me anë të shpërdorimit të detyrës; me anë të përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike e të dëmtuarit (pozita vulnerabël); me anë të dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër.

17.8 Kolegji, në interpretim të dispozitës penale materiale, vlerëson se mjetet për realizimin e trafikimit të personave mund të grupohen në: *a)* mjete që kërkojnë ushtrim të dhunës fizike, psikike, rrëmbim apo mënyra të tjera të përdorimit të forcës. Në këto raste, viktima jo vetëm që izolohet, por ajo vendoset në pamundësi për të lëvizur apo për të vepruar, duke u shoqëruar edhe me heqjen e paligjshme të lirisë së saj (rrëmbimi, dhuna fizike apo psikike, përdhunimi, kërcënimi me jetë, për veten apo familjarët e saj). *b)* Mjete që realizojnë apo lehtësojnë trafikimin e personit, nëpërmjet mashtrimit të viktimës apo shpërdorimit të besimit që ajo mund të ketë te një person. Forma më klasike e mashtrimit, në jurisprudencën shqiptare, është ajo e krijimit të një marrëdhënie intime, duke premtuar martesë apo bashkëjetesë, si dhe një jetë më të mirë. Në disa raste të tjera, mashtrimi realizohet edhe duke i premtuar viktimës shkollim, për punë të ndryshme apo dhe thjesht për një udhëtim jashtë vendit. *c)* Përftimi nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike e viktimës, është ajo që instrumentet ndërkombëtare e përkufizojnë si "gjendje vulnerabël" apo "pozita vulnerabël e viktimës".[31] Instrumentet ndërkombëtarë e përkufizojnë gjendjen/pozitën e vulnerabilitetit si një situatë ku personi nuk ka asnjë alternativë tjetër konkrete ose të pranueshme, përveçse t'i nënshtrohet abuzimit ku është përfshirë (*Për më tepër, direktiva e BE-së, 2011/36/BE dhe direktiva 2012/29/BE. Konkretisht, direktiva e BE-së nr. 36, viti 2011, në nenin 2, paragrafin 2, në mënyrë eksplicite parashikon çka nënkupton pozita e vulnerabilitetit në të cilin gjendet viktima e trafikimit: "Pozita e vulnerabilitetit" nënkupton situatë në të cilën personi i prekur nuk ka alternativë të mirëfilltë ose të pranueshme, përveçse t'i nënshtrohet keqpërdorimit/abuzimit/shfrytëzimit*.). *d)* Një mjet tjetër është edhe vënia nën kontroll e një personi, duke përdorur mënyra të ndryshme detyrimi si: me anë të një borxhi; me anë të izolimit nga kontakti me persona të njohur apo të afërm; me anë të marrjes së dokumenteve të identifikimit, duke kufizuar lëvizjen e lirë të personit, por mund të ketë edhe mënyra apo mjete të tjera që do t'i identifikojë praktika gjyqësore dhe standardet më të mira ndërkombëtare.

17.9 Qëllimi, si element i trafikimit të qenieve njerëzore, është shfrytëzimi i viktimës, që është dhe qëllimi final i trafikimit, qëllim ky që shfaqet në disa forma. Ligji penal shqiptar, bazuar në Protokollin e Palermos dhe në Konventën e Varshavës, përcakton disa forma të shfrytëzimit të personit të trafikuar, qoftë ky i mitur apo personi i rritur. Aktet ndërkombëtare të ratifikuar nga Shqipëria, ndonëse nuk japin një përkufizim të termit "shfrytëzim", theksojnë se shfrytëzimi përfshin *së paku*, shfrytëzimin e prostitucionit ose shërbimet seksuale. Nenet 110/a dhe

[31] Strategjia e Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Plani i Veprimit miratuar nga Këshilli i Ministrave, përcakton si grupe vulnerabël në Shqipëri: a) familjet e varfra; b) gratë e dhunuara; c) fëmijët në situatë rruge; d) komuniteti rom dhe egjiptian. Nga ana tjetër, në këtë strategji janë listuar edhe faktorët që janë identifikuar si nxitës në trafikim: 1. situata social ekonomike e vendit – rritja e pabarabartë ekonomike në zona të ndryshme; 2. migrimi brenda vendit – krijimi i komuniteteve të reja, i vendos ato në një gjendje vulnerabilitetit, pasi nuk gëzojnë mbështetje e përkrahje; 3. mundësitë e pakta për punësim, veçanërisht të grave; 4. dhuna në familje, që është një shkak i cili paraprin dhe shoqëron trafikimin.

128/b të KP-së parashikojnë si forma apo mënyra të shfrytëzimit të viktimës së trafikimit: **i.** shfrytëzim seksual, prostitucion apo edhe puna në shtëpi publike; **ii.** shfrytëzimi i punës ose shërbime të detyruara: kryerja e detyruar e punës nga viktima, e cila nuk do ta bënte atë me vullnet të lirë; krijimi i situatës ku viktima është e detyruar të bëjë një punë që nuk i përket ta bëjë; mbajtja e një personi në robëri për shkak të borxhit; puna apo shërbimet e kryera me mashtrim, shtrëngim, kërcënim dhe dhunë; **iii.** shfrytëzimi i skllavërisë apo formave të ngjashme me të.

17.10 Kolegji vë në dukje se, GJEDNJ-ja në çështjen Siliadin kundër Francës, mes të tjerave, ka theksuar se: "*a. në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 4 (...) 6. Gjykata çmoi se neni 4 i Konventës sanksionon një prej vlerave themelore të shoqërive demokratike që formojnë Këshillin e Evropës. Ajo kujtoi se, përveç Konventës, ka një sërë traktatesh ndërkombëtare që kanë si objekt mbrojtjen e qenieve njerëzore kundër skllavërisë dhe punës së detyruar ose me dhunë. Ajo kujtoi që Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka theksuar se megjithëse skllavëria është shfuqizuar që prej më se 150 vjetësh, situata të "skllavërisë shtëpiake" hasen ende në Evropë, dhe kanë të bëjnë me mijëra persona, pjesa më e madhe femra. (...) 7. Sipas Gjykatës, fakti që një shtet abstenon nga shkelja prej tij e këtyre të drejtave nuk mjafton për të arritur në përfundimin se ai respekton detyrimet e tij në bazë të këtij neni. Në bazë të këtij neni shteteve iu lindin detyrime pozitive që konsistojnë në marrjen dhe zbatimin efektiv të dispozitave penale që ndëshkojnë praktikat e parashikuara nga neni 4.*

B. Në lidhje me shkeljen e nenit 4

a) nëse ka pasur ***punë të detyruar*** *– 8. Për të vlerësuar gjendjen në të cilën mbahej kërkuesja, Gjykata vuri në dukje se gjatë viteve, znj. Siliadin kishte punuar te bashkëshortët B. pa pushin dhe në kundërshtim me dëshirën e saj dhe për më tepër nuk ka marrë asnjë shpërblim. Në kohën e fakteve të çështjes ajo ishte e mitur dhe në situatë të parregullt në një shtet të huaj dhe kishte frikëse mund të arrestohej nga policia. Për më tepër bashkëshortët B. e ushqenin këtë frikë dhe e bënin atë të shpresonte një rregullim të situatës së saj juridike. Në këto rrethana, Gjykata çmoi se znj. Siliadin i është nënshtruar të paktën një pune të detyruar në kuptimin e nenit 4 të Konventës.*

b) nëse ka pasur skllavëri – 9. Për sa i përket skllavërisë, megjithëse kërkuesja ishte privuar nga vullneti i saj i lirë, nga dosja përpara Gjykatës nuk del që ajo të ishte mbajtur në ***skllavëri*** *në kuptimin e plotë të fjalës. Pra, nuk mund të thuhet që bashkëshortët B. kishin ushtruar ndaj saj një të drejtë të mirëfilltë pronësie, duke e shndërruar në gjendjen juridike të një objekti. Gjykata pra çmoi se znj. Siliadin nuk ishte mbajtur në skllavëri në kuptimin "klasik" të këtij nocioni.*

c) nëse kishte robëri – 10. ***Nocioni i robërisë****, i përfshirë gjithashtu në nenin 4 të Konventës, konsiston në detyrimin për të ofruar shërbime në kushtet e detyrimit. Gjykata kujtoi në këtë kuadër që kërkuesja e ofronte këtë shërbim shtatë ditë në javë për 15 orë në ditë. Për më tepër ajo nuk kishte zgjedhur që të punonte te bashkëshortët B. Duke qenë e mitur dhe pa burime financiare, e dobët dhe e izoluar, ajo nuk kishte asnjë mjet jetese përveçse te bashkëshortët B ku ajo ndante të njëjtën dhomë me fëmijët.* (...)"

17.11 Kolegji vlerëson se këto konkluzione duhen mbajtur në konsideratë nga gjykatat në analizën e faktit penal, ku trafikimi duhet konsideruar si një formë e skllavërisë moderne. Viktima e trafikuar konsiderohet si "*pronë*" nga trafikanti, duke ju nënshtruar çdo lloj urdhri të tij, nuk gëzon asnjë të drejtë njerëzore përfshi dhe lirinë e lëvizjes. Në ligjin penal shqiptar parashikohet si formë shfrytëzimi edhe forma të tjera të ngjashme me skllavërinë. Kolegji në zbatim të standardeve ndërkombëtare dhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së, vlerëson se forma të tilla mund të jenë: mbajtja e viktimës në kushte të tilla, ku persona të tjerë e përdorin për qëllime të ndryshme, përfshi këtu edhe për aktivitete kriminale. Një nga format e shfrytëzimit është edhe rekrutimi i një personi me qëllim transplantimin e organeve apo edhe për eksperimente mjekësore, si një nga format më të rënda të shkeljes së dinjitetit njerëzor dhe integritetit fizik të personi. Forma të tjera shfrytëzimi të pranuara në instrumentet të ndryshme ndërkombëtare janë edhe sjellje të tilla kriminale si: birësimi i paligjshëm, martesat me detyrim, lypja e detyruar (*për më tepër, direktiva 2011/36/BE, përcakton shprehimisht se, "shprehja '***shfrytëzimi në aktivitete kriminale***' *duhet kuptuar si shfrytëzimi i një personi për të kryer, ndër të tjera, vjedhje xhepash, vjedhje dyqanesh, trafik droge, si dhe aktivitetet të tjera të ngjashme të cilat sjellin përfitim financiare.* ***Përkufizimi gjithashtu përfshin trafikimin e qenieve njerëzore*** *me qellim heqjen e organeve, duke përbërë një shkelje të rëndë të dinjitetit njerëzor dhe të integritetit fizik, si dhe, për shembull, sjelljeve të tjera të tilla si adoptim ilegal, apo martesa të detyruara, duke përmbushur kështu elemente përbërëse të trafikimit të qenieve njerëzore" (pika 11 e preambulës). Ky referim ka rëndësi dhe duhet të jetë në vëmendjen e praktikës gjyqësore në Shqipëri, për të identifikuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe format e reja në të cilat ai shfaqet*).

17.12 Kolegji thekson se duhet vlerësuar me kujdes pëlqimi dhe vullneti i viktimës për të lëvizur apo për t'u zhvendosur me të pandehurin, e më pas edhe pëlqimi i saj për të ushtruar prostitucion apo për të lejuar një formë tjetër shfrytëzimi. Gjykatat dhe prokuroria duhet të ketë në konsideratë se, ky pëlqim apo vullneti i viktimës, nuk sjell asnjë pasojë, kur provohet ekzistenca e një prej mjeteve të trafikimit të qenieve njerëzore (mjetet janë: mashtrimi, rrëmbimi, dhuna, përfitimi nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike, e të tjera forma të trajtuar gjerësisht më lart). Ky konkluzion gjen mbështetje edhe në nenin 4 të Konventës së Varshavës, ku parashikohet se: *(b)* "*Kompromisi i një viktime të trafikimit në lidhje me shfrytëzimin e synuar, nuk do të jetë i vlefshëm kur është përdorur ndonjë*

nga mjetet e parashtruara në paragrafin (a)". Konventa e Varshavës në nenin 4, shkronja "a" parashikon se: "Për qëllime të kësaj Konvente: a) "Trafikim i qenieve njerëzore" nënkupton rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin ose marrjen e personave me anë të kërcënimit, përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, kurthit, të shpërdorimit të detyrës, të atyre që kanë një pozicion të pambrojtur apo dhënien ose marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur miratimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllim shfrytëzimi." Shfrytëzimi do të përfshijë minimalisht shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve, forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë apo praktikat e ngjashme me skllavërinë ose heqjen e organeve.. Në raportin shpjegues të Konventës së Këshillit të Evropës/Konventa e Varshavës, "detyrimi" është përcaktuar në kuptimin e gjerë, si ndikim psikik mbi sjelljen e vullnetit të lirë të viktimës e që shkon përtej nxitjes (bindjes) së zakonshme të tjetrit dhe nënkupton shtrëngim të papërballueshëm psikologjik, forcë fizike ose kërcënim, rrëmbim, mashtrim, shpërdorim të pushtetit ose pozitës vulnerabël apo dhënie të pagesave ose dhënie të përfitimeve, me qëllim të sigurimit të pëlqimit nga personi i cili është nën kontrollin e trafikantit.

17.13 Ndërkohë, siç është theksuar edhe më lart, qëndrimi është i ndryshëm në rastin e trafikimit të të miturve,[32] ku mjafton të provohet ekzistenca e njërës prej formave të trafikimit dhe qëllimi i shfrytëzimit (mjetet nuk kërkohet të provohen në këtë rast, për shkak se fëmijët konsiderohen si persona vulnerabël/formë + qëllim). Kolegji çmon se ka rëndësi të evidentohet që në lidhje me të miturit, Konventa e Varshavës po në nenin 4, shkronja "c" parashikon se: *(c) "rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose marrja e një fëmije për qëllim shfrytëzimi do të konsiderohet 'trafikimi i qenieve njerëzore' edhe nëse kjo nuk përfshin një nga mjetet e parashtruara në paragrafin (a)".* Kjo do të thotë se, fakti nëse jemi para trafikimit apo jo, varet nga rezultati/qëllimi final, pavarësisht nëse është arritur shfrytëzimi i të miturit apo jo, por nga ana tjetër, duhet që qëllimi i trafikimit duhet të provohet përtej çdo dyshimi. (*Mbrojtja e fëmijës në mënyrë të posaçme është theksuar edhe në Komentin e përgjithshëm nr. 24 (2019) për të drejtat e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për fëmijë (General comment No 24 (2019) on children's rights in the child justice system), i miratuar nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, në Gjenevë më datë 18.9.2019. Komiteti, në mënyrë eksplicite thekson se fëmijët mund të bëhen viktima të formave të ndryshme të dhunës, siç është rekrutimi; stërvitja ushtarake, shfrytëzimi i fëmijëve në konflikte ushtarake dhe/ose vepra të terrorizimit, duke i përfshirë edhe sulmet vetëvrasëse, detyrimi të ekzekutojnë, të përdoren si mburojë e gjallë; rrëmbim; shitje; trafikim; shfrytëzim seksual; martesë të fëmijëve; shfrytëzim gjatë transportit ose shitjes së drogës; ose shfrytëzim për kryerjen e detyrave të rrezikshme, siç është spiunazhi, përgjimi, roja në pikën e kontrollit, patrulla ose transportimi i pajisjes ushtarake. Nga ana tjetër, direktiva 2011/36/BE mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi, parashikon shprehimisht se, fëmijët janë më vulnerabël se të rriturit dhe prandaj janë më të rrezikuar për t'u bërë viktima të trafikimit të qenieve njerëzore. Në aplikimin e kësaj Direktive, interesat më të mira të fëmijëve duhet të jenë të parat për t'u marrë në konsideratë, sipas Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, si dhe sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, e vitit 1989 (pika 8 e preambulës).*)

17.14. Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me pyetjen e parë të shtruar për njësim: "*Cilat janë format e kryerjes së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore?*", **Kolegji mban këtë qëndrim njësues**:

- Trafikimi i qenieve njerëzore në ligjin penal të Republikës së Shqipërisë (parashikuar në dy dispozita: "Trafikim i personave të rritur" – neni 110/a dhe "Trafikimi i të miturve" – neni 128/b i Kodit Penal), përfshin tri elemente thelbësore:

1. **Veprimet**/format e trafikimit (rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave);

2. **Mjetet e trafikimit/**mënyra sesi trafikantët realizojnë qëllimin e tyre (kërcënimi, përdorimi i forcës e formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabël (lehtësisht të cenueshëm) ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve);

3. **Qëllimi** (shfrytëzimi seksual, për punë ose shërbime të detyruara, skllavëria ose praktikat e ngjashme me skllavërinë);

[32] Neni 128/b, "Trafikimi i të miturve" (i ndryshuar) parashikon: "1) Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. 2) Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. 3) Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. 4) Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm. 5) Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me ¼ e dënimit të dhënë."

- Vepra penale e parashikuar nga neni 110/a i KP-së konsiderohet e kryer plotësisht, kur vërtetohet njëra nga format/veprimet, njëra nga mjetet dhe qëllimi i shfrytëzimit të viktimës. Në rastin e trafikimit të personave të rritur, pëlqimi apo vullneti i viktimës për të ushtruar prostitucion apo forma të tjera të shfrytëzimit nuk ndikon në cilësimin e veprës penale për sa kohë rezulton i provuar fakti se është përdorur një nga mjetet e referuara në dispozitën penale konkrete për arritjen e qëllimit (*mjetet në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, janë: mashtrimi, përdorimi i forcës, rrëmbimi, kërcënimi apo përdorimi i formave të tjera të shtrëngimit, shpërdorim detyre ose përftim nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike etj. – elemente këto që duhen provuar në rastin e trafikimit të një personi të rritur*).

- Në veprën penale "Trafikimi i të miturve", duhen nxjerrë në pah dy elemente:

***i)* mjetet e përdorura për të arritur qëllimin kriminal nuk kanë rëndësi. Mjetet nuk ndikojnë në cilësimin juridik të kësaj vepre penale, që do të thotë se për shkak të cilësimit juridik të veprës, mjafton të provohet ekzistenca e njërës prej formave të trafikimit, si: rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturit, me qëllim shfrytëzimin e tij;**

***ii)* vullneti apo pëlqimi i të miturit viktimë e trafikimit, në lidhje me shfrytëzimin e synuar, nuk ka vlerë, pavarësisht rrethanave apo mënyrës në të cilën është shfaqur**.

iv. Pyetja e dytë e shtruar për njësim është: "Veprat penale të parashikuara nga nenet 110/a dhe 128/b të Kodit Penal, janë vepra penale formale apo materiale?"

18. Në lidhje me këtë pyetje, Kolegji nuk ka si qëllim që të bëjë një trajtim teorik të mënyrave sesi doktrina kategorizon veprat penale. Kolegji, në lidhje me këtë çështje, vlerëson të ndalet te cilësimi i veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore si vepra penale formale apo materiale, duke e lidhur këtë analizë me qëllimin si element të kërkuar nga dispozitat konkrete (neni 110/a dhe neni 128/n i KP). Kolegji vlerëson se veprat penale që ndëshkojnë trafikimin e qenieve njerëzore (persona të rritur apo të mitur), duhen trajtuar si vepra penale formale, domethënë që nuk kërkon ardhjen e ndonjë pasoje kriminale, në mënyrë që ajo të konsiderohet e kryer. Kolegji thekson se mjafton të provohet ekzistenca e *njërës prej formave të trafikimit* (p.sh. rekrutimi ose transportimi ose pritja e të tjera), të paktën ekzistenca *e një prej mjeteve* (p.sh. mashtrimi ose rrëmbimi ose përftimi nga gjendja shoqërore/vulnerabël etj.), *si dhe qëllimi i shfrytëzimit, së paku për prostitucion* – që kryerja e kësaj vepre penale të konsiderohet plotësisht e kryer. Pra, në thelb, ekzistenca e veprës penale është një çështje fakti që duhet provuar e argumentuar rast pas rasti, duke pasur në konsideratë elementet e kësaj figure vepre penale. Me fjalë të tjera, kryerja e veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore, kërkon që të provohet ekzistenca e tre elementeve të sipërcituara, pra krahas formës (njëra është e mjaftueshme), duhet të provohet edhe ekzistenca e mjeteve si dhe qëllimi i shfrytëzimit (në rastin e trafikimit të personave të rritur). Kolegji tërheq edhe një herë vëmendjen në faktin që, pëlqimi dhe vullneti i viktimës nuk sjell asnjë pasojë, kur provohet ekzistenca e një prej mjeteve të trafikimit të qenieve njerëzore. Theksi në këtë rast vendoset te mjetet/mënyrat e përdorura për të realizuar këtë qëllim – shfrytëzimin e personit. Vetëm trafikimi me qëllim shfrytëzimi, në kushtet e shtrëngimit me forcë apo përmes mashtrimit apo përmes formave të tjerave të ngjashme me skllavërinë etj., është penalisht i dënueshëm (në rastin e trafikimit të personave të rritur).

18.1 Kolegji rithekson edhe një herë se, GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka theksuar se, shtetet janë të detyruara të marrin masa efektive për ndalimin e skllavërisë dhe robërisë moderne, e cila haset ende edhe në shtetet me traditë demokratike. (...) Në përputhje me standardet dhe prirjet bashkëkohore të mbrojtjes së qenieve njerëzore nga skllavëria, robëria dhe puna e detyruar, shtetet kishin detyrimin të kriminalizonin dhe të ndëshkonin çdo lloj akti që kishte për qëllim të vendoste një person në një situatë të papajtueshme me nenin 4 (*shih çështja Siliadin kundër Francës, kërkesa nr. 73316/01, datë 26.7.2005*.).

18.2 Kolegji, në zbatim të standardeve ndërkombëtare dhe në referim të jurisprudencës së GJEDNJ, vlerëson se vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore (trafikim i personave të rritur apo trafikimi i të miturve), do të konsiderohet si plotësisht e kryer kur provohet se subjekti aktiv i veprës penale ka realizuar të paktën rekrutimin e personit të trafikuar/viktimës së trafikimit, ose vetëm transportimin e viktimës, ose vetëm transferimin e saj, ose vetëm fshehjen, ose vetëm pritjen e personit viktimë e trafikimit. Në rastin e personave të rritur duhet provuar që secila nga format e sipërcituara është realizuar përmes përdorimit të njërit nga mjetet (mjafton pra qoftë edhe prania e njërit prej tyre), e konkretisht me anë të mashtrimit apo kërcënimit apo përftimit nga gjendja shoqërore e tij, si dhe duke vërtetuar edhe qëllimin për trafikimin e viktimës, pavarësisht faktit nëse personi i trafikuar është shfrytëzuar apo jo.

18.3 Në çdo rast kur viktima është e mitur – pëlqimi që jep i mituri për të ushtruar prostitucion apo për të kryer çdo lloj shërbimi tjetër të detyruar (përfshi këtu lypjen apo punën), nuk merret në konsideratë/nuk ka vlerë për efekt të cilësimit të faktit penal si trafikim i të miturit, pavarësisht faktit, nëse është cenuar ose jo vullneti i tij.

Ky konkluzion është logjik dhe lidhet me gjendjen vulnerabël të të miturve, për shkak të moshës dhe zhvillimit të tyre. Në akte të ndryshme ndërkombëtare, të miturit/fëmijët konsiderohen si persona veçanërisht vulnerabël (*Për më tepër, direktiva 2011/36/BE mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi, si dhe Raporti Shpjegues i Konventës së Varshavës*).

18.4 Kolegji vlerëson se, vetëm në rastet kur ligji penal material parashikon rrethana cilësuese, që lidhen me ardhjen e një pasoje konkrete, atëherë vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore do të trajtohet si një vepër penale materiale. Kjo do të thotë se, organi i akuzës në rastin kur i atribuon të pandehurit ekzistencën e një rrethane të tillë cilësuese, duhet të provojë edhe pasojën e ardhur si: dhunën e ushtruar apo keqtrajtimin apo vdekjen e viktimës së trafikimit. Ky element ka rëndësi për cilësimin e saktë të faktit penal, pasi dispozitat penale konkrete parashikojnë disa rrethana cilësuese, ekzistenca e të cilave duhet provuar rast pas rasti.

18.5 Në përfundim të kësaj analize, duke pasur në konsideratë sa është trajtuar deri tani, në lidhje me pyetjen e dytë të shtruar për njësim: "*Veprat penale të parashikuara nga nenet 110/a dhe 128/b të KP-së, janë vepra penale formale apo materiale?*", **Kolegji mban këtë qëndrim njësues**:

18.5.1 **Veprat penale që ndëshkojnë trafikimin e qenieve njerëzore (persona të rritur apo të mitur), janë vepra penale formale, që nuk kërkojnë domosdoshmërish ardhjen e pasojës kriminale në mënyrë që ajo të konsiderohet e kryer.**

18.5.2 **Kur ligji penal material parashikon rrethana cilësuese që lidhen me ardhjen e një pasoje konkrete, atëherë vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore do të trajtohet si një vepër penale materiale (e lidhur kjo me verifikimin e pasojës)**.

v. Pyetja e tretë e shtruar për njësim, e lidhur ngushtësisht me sa është trajtuar më lart, është: "Cili është kuptimi i termit "trafikim" në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe çfarë duhet kuptuar me "trafikim të brendshëm"?

19. Kolegji vë në dukje se trafikimi i qenieve njerëzore është një vepër penale që ka si qëllim kryesor jo kalimin e paligjshëm të kufirit apo zhvendosjen e personave nga një vend në një vend tjetër (qoftë edhe brenda territorit të një shteti), por shfrytëzimin e njerëzve së paku për prostitucion ose në çdo lloj forme tjetër shfrytëzimi. Në këtë kontekst, veprat penale që kanë lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore mund të kryhen edhe brenda territorit shqiptar, mjafton të provohet qoftë edhe njëri nga këto elemente: rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, për qëllime të shfrytëzimit të tyre për prostitucion, punë të detyruar, skllavërim, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, e realizuar kjo nëpërmjet kërcënimit, mashtrimit, përdorimit të forcës, shpërdorimit të detyrës etj. Pikërisht në një rast të tillë, jemi para asaj që njihet si "trafikimi i brendshëm i qenieve njerëzore".

19.1 Në lidhje me shprehjen "trafikim i brendshëm", Kolegji evidenton se në rastin e qenieve njerëzore qëllimi i shfrytëzimit të tyre së paku për prostitucion apo në kushte të ngjashme me skllavërinë, është element me rëndësi, që duhet provuar rast pas rasti. Parimi i territorit nuk ka asnjë rëndësi për kualifikimin ligjor të faktit penal, pasi në këtë rast, pra trafikimi i personave qofshin këto të rritur apo të mitur, nuk lidhet domosdoshmërish me kalimin e kufijve shtetërorë. Trafikimi i qenieve njerëzore nuk ka vetëm natyrë transnacionale. Në rastin kur trajtohet hyrja apo dalja e paligjshme e personave nga ose nëpërmjet territorit shqiptar, jemi para veprës penale të kontrabandimit/trafikimit të migrantëve – siç cilësohet nga protokolli shtesë i Konventës së OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar (*Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare, e cila plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002. Për qëllime të këtij Protokolli: a) "Trafik i migrantëve" do të thotë prokurimi për qëllim përfitimi financiar ose material, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga kalimi i paligjshëm në një Shtet Palë të një personi, në të cilin ai/ajo nuk është shtetas ose rezident i përhershëm. b) "Kalim i paligjshëm" do të thotë kalim i kufirit pa iu përmbajtur kërkesave të domosdoshme për kalimin e ligjshëm në shtetin pritës*). Në raste të tilla, Kolegji vlerëson se zbatohet parimi i territorit, siç është përcaktuar në konkluzionin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara në vendimin nr. 3/2011. Kodi Penal shqiptar, në fakt, nuk përdor termin kontrabandimi i personave apo trafikim i migrantëve, por kriminalizon kalimin e paligjshëm të kufirit apo ndihmën për kalimin e paligjshëm të kufijve (*nenet 297 dhe 298 të Kodit Penal*).

19.2 Zhvendosja apo transferimi i viktimës nga një zonë në një tjetër, nga një qytet në një qytet tjetër brenda territorit të Shqipërisë, ka si qëllim izolimin e viktimës për të lehtësuar shfrytëzimin e saj. Kolegji vlerëson se nuk ka asnjë dallim në trajtimin e trafikimit të brendshëm në rastet kur viktima është e rritur apo e mitur. Kolegji vë në dukje se e vetmja gjë që dallon në rastet e trafikimit të brendshëm është territori apo vendi ku do të shfrytëzohet viktima. Për sa u takon elementeve të tjera, ato janë të pranishëm si në rastin kur viktima trafikohet brenda apo jashtë vendit, qoftë i rritur apo i mitur.

19.3 Në rrethanat e parashtruara, Kolegji vlerëson të gabuar referimin e bërë nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda në çështjen konkrete, në konkluzionet e vendimit unifikues nr. 3/2011. Ky konkluzion bazohet në faktin se pas këtij vendimi unifikues, ligjvënësi ka ndryshuar dispozitat e KP-së, në lidhje me veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore, konkretisht me ligjin nr. 144/2013, duke parashikuar se trafikimi i personave mund të kryhet si brenda ashtu edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (ky ligj ka qenë në fuqi në momentin e shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda).

19.4 Në përfundim, në lidhje me pyetjen e tretë të shtruar për njësim: "*Cili është kuptimi i termit "trafikim" në rastin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe çfarë duhet kuptuar me 'trafikim të brendshëm'?*", **Kolegji mban këtë qëndrim njësues**:

19.4.1 **Trafikimi i qenieve njerëzore nuk kërkon domosdoshmërish kalimin e kufijve shtetërorë dhe nuk ka vetëm natyrë transnacionale. Trafikimi i qenieve njerëzore ka si qëllim kryesor shfrytëzimin e viktimës. Veprat penale që kanë lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore mund të kryhen edhe brenda territorit të shtetit shqiptar, mjafton të provohet qoftë edhe njëri nga këta elemente: rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja, pritja e personave, për qëllime të shfrytëzimit të tyre për prostitucion, punë të detyruar, skllavërim, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, e realizuar kjo nëpërmjet kërcënimit, mashtrimit, përdorimit të forcës, shpërdorimit të detyrës etj. Kolegji thekson se në këtë rast nuk gjen zbatim parimi i territorit**.

vi. Pyetja e katërt e shtruar për njësim: "Në rast se në kuptimin e termit trafikim, përfshihet edhe trafikimi i brendshëm i personave të rritur apo të mitur, cilat janë dallimet mes veprave penale "Trafikim i personave të rritur" (neni 110/a i KP-së) dhe "Trafikim i të miturve" (neni 128/b i KP-së), me veprat penale "Shfrytëzimi i prostitucionit" (neni 114 i KP-së) dhe "Keqtrajtimi i të miturit" (neni 124/b i KP-së)?"

20. Kolegji, në referim të analizës së elementeve të figurës së veprës penale të trafikimit të qenieve njerëzore vlerëson se dallimi mes trafikimit të personit të rritur dhe shfrytëzimit për prostitucion qëndron në vullnetin e viktimës dhe aftësinë e saj për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të kryera. Kolegji vë në dukje se, në këtë rast, duhet trajtuar me kujdes pikërisht elementi i ushtrimit të prostitucionit me vullnet të lirë apo nën kërcënim/me shtrëngim. Nëse merret në analizë puna përgatitore që është bërë për miratimin e protokollit të Palermos, konstatohet se shtetet palë janë treguar të kujdesshme në evidentimin e këtij dallimi. Protokolli i Palermos detyron shtetet palë që të luftojnë çdo formë të ushtrimit të prostitucionit të detyruar apo me shtrëngim, duke përfshirë në përkufizimin e trafikimit të qenieve njerëzore ekzistencën e mjeteve për realizmin e trafikimit. Dispozitat e këtij protokolli vendosin një standard minimal, në lidhje me parandalimin, ndëshkimin dhe mbrojtjen e viktimës së trafikimit, fakt ky që nënkupton se asgjë nuk i ndalon shtetet palë që të marrin masa edhe më të rrepta. Ky dallim apo përfshirja e mjeteve për realizimin e trafikimit, si element i domosdoshëm për cilësimin e faktit si trafikim i qenieve njerëzore, është i qëllimshëm për të mos ndikuar në politikat e brendshme të shteteve palë që kanë legalizuar ushtrimin e prostitucionit.

20.1 Kolegji thekson se pranimi apo pëlqimi i një personi për të kryer një punë apo shërbim, qoftë edhe ushtrimi i prostitucionit, duhet vlerësuar rast pas rasti, ku me rëndësi është analiza e fakteve të atribuuar të pandehurit. Analiza në këtë rast duhet të fokusohet në mjetet e përdorura për të kryer këtë veprim nga viktima, duke verifikuar në çdo rast nëse ushtrimi i prostitucioni ka ardhur si rrjedhojë e një mashtrimi, si rrjedhojë e dhunës fizike apo psikike apo si rrjedhojë e veprimeve të tjera shtrënguese të parashikuara shprehimisht në nenin 110/a, paragrafi i parë i KP-së. Mungesa apo në rastin kur nuk provohet ekzistenca e një prej formave shtrënguese/mjetet për realizimin e trafikimit, atëherë Kolegji vlerëson se duhet analizuar vullneti dhe vetëdija e viktimës për realizimin e veprimit konkret që lidhet me shfrytëzimin për prostitucion.

20.2 Me ligjin nr. 144 të vitit 2013, është shfuqizuar neni 114/a i KP-së që kriminalizonte shfrytëzimin e prostitucionit në rrethana rënduese. Kjo dispozitë kishte sjellë konfuzion në praktikën gjyqësore shqiptare, pasi neni 114/a në thelb parashikonte disa forma të shfrytëzimit që janë pjesë e trafikimit të qenieve njerëzore. Kolegji vlerëson se, dallimi kryesor mes shfrytëzimit të prostitucionit/neni 114 dhe trafikimi i personave të rritur/neni 110/a, kur bëhet për qëllime prostitucioni, është pëlqimi i viktimës/dijenia dhe vullneti i saj i lirë për të ushtruar prostitucion.

20.3 Problematika shfaqet më komplekse në rastin e trafikimit të të miturve dhe dallimit të kësaj figure vepre penale nga fakti i shfrytëzimit të një të mituri për prostitucion, parashikuar në paragrafin e dytë të nenit 114 të KP-së. Kolegji paraprakisht evidenton se, me ligjin nr. 9859, datë 21.1.2008, neni 128/b është ndryshuar, duke u shtuar fjala "shitja", pas fjalës "rekrutimi", si një nga format e kryerjes së trafikimit të qenieve njerëzore. Ky ndryshim në përmbajtjen e kësaj dispozite, duke shtuar si një nga format e trafikimit të të miturve edhe shitjen e

tyre, erdhi si rezultat i aderimit të Shqipërisë në protokollin opsional të Konventës së OKB-së "Mbi të drejtat e fëmijës", për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë (*ligji nr. 9834, datë 22.11.2007, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë"*). Me aderimin në këtë protokoll, Shqipëria si palë në Konventën e OKB-së "Mbi të drejtat e fëmijës", ka marrë përsipër detyrimin për të garantuar, minimalisht, "*... mbulimin nga ligji penal të veprimeve dhe aktiviteteve 'të shitjes së fëmijëve, prostitucionit me fëmijë apo pornografinë me fëmijë", pavarësisht se këto vepra penale janë kryer brenda apo jashtë vendit nga një individ apo grup individësh të organizuar ...*". (*Neni 3 i Protokollit opsional të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë", parashikon: "a) Në kontekstin e shitjes së fëmijëve sipas nenit 2: i) Ofrimi, dorëzimi ose pranimi me çfarëdo mjeti i një fëmije për qëllimin e: a) shfrytëzimit seksual të fëmijëve;*

b) transferimit të organeve të një fëmije për qëllime fitimi; c) përfshirjes së fëmijëve në punë të detyruara. ii) Marrja e pëlqimit në mënyrë të papërshtatshme, si ndërmjetës për adoptimin e një fëmije duke shkelur instrumentet e zbatueshme ligjore ndërkombëtare për miratimin. b) Ofrimi, marrja, gjetja ose dorëzimi i një fëmije për prostitucion me fëmijë, sipas përcaktimit të nenit 2. c) prodhimi, shpërndarja, importimi, eksportimi, ofrimi, shitja ose mbajtja e pornografisë me fëmijë për qëllimet e sipërshënuara, sipas përcaktimit të nenit 2") Kuptimi i shprehjes "shitja e të miturve" si një nga format e veprës penale të "Trafikimit të të miturve", është dhënë në protokollin opsional të Konventës së OKB-së "Për të Drejtat e Fëmijës", duke u përcaktuar si e tillë: "*... çdo veprim ose transaksion me anë të të cilit një fëmijë transferohet prej një personi ose grupi personash te një tjetër me pagesë ose në çdo mënyrë tjetër*" (*Neni 2 i protokollit opsional të KDF-së, cituar më lart*).

20.4 Trafikimi i të miturve parashikohet në një dispozitë të veçantë, nga trafikimi i të rriturve, duke parashikuar edhe sanksione më të ashpra. Ligji shqiptar nuk parashikon në mënyrë të shprehur se, "pranimi i një viktime trafikimi të mitur për t'u shfrytëzuar, nuk mund të konsiderohet i vlefshëm", por kjo rezulton nga mënyra e formulimit, nga përmbajtja e neni 128/b të KP-së. Në ndryshim nga trafikimi i personave të rritur, në lidhje e veprën penale "Trafikimi i të miturve" Kolegji çmon se duhen nxjerrë në pah dy konkluzione shumë të rëndësishme, që duhen mbajtur në konsideratë nga prokuroria dhe gjykatat. *Së pari*, në rastin e trafikimit të një të mituri mjetet e përdorura (që janë kërcënimi, përdorimi i forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimi, marrja me forcë, dredhi apo abuzimi me pushtetin ose pozitën vulnerabël, dhënia apo marrja e pagesave ose përfitimeve) për të arritur qëllimin kriminal nuk kanë rëndësi, pra nuk ndikojnë në cilësimin juridik të kësaj vepre penale. E thënë ndryshe, për cilësimin juridik të faktit penal, mjafton të provohet ekzistenca e njërës prej formave të trafikimit (që janë rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturit), si dhe qëllimi për shfrytëzimin e tij. *Së dyti*, vullneti apo pëlqimi i të miturit viktimë e trafikimit, në lidhje me shfrytëzimin e synuar, nuk ka asnjë vlerë, pavarësisht rrethanave apo mënyrës në të cilin ai është shfaqur.

20.5 Në rastin e trafikimit të të miturve, Kolegji konstaton se ka disa problematika, të cilat kanë ndikuar edhe në përcaktimin e një të mituri si viktimë trafikimi: *së pari*, në ndryshim nga dispozita që parashikon trafikimin e personave të rritur, neni që ndëshkon trafikimin e një të mituri nuk përmend fjalët "si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë" (*neni 128/b i Kodit Penal, "Trafikimi i të miturve"*). *Së dyti*, në ligj ka një dispozitë që ndëshkon në mënyrë të posaçme rastin kur një i mitur shtyhet/nxitet për të ushtruar prostitucion, ndërmjetësimi apo marrja e shpërblimit si rrjedhojë e shfrytëzimit të një të mituri për prostitucion, fakte këto që nuk cilësohen si trafikim, por "shfrytëzim prostitucioni" (neni 114, paragrafi i dytë i KP-së, "Shfrytëzimi i prostitucionit"). *Së treti*, "detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i një të mituri për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik apo arsimimin e tij", nuk cilësohet si trafikim por keqtrajtim i të miturit (neni 124 paragrafi i dytë i KP-së, 'Keqtrajtimi i të miturit'). *Së katërti*, në KP ka një dispozitë që dënon "kërkesën e qëllimshme ndaj një të rrituri apo fëmije për të shkuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim detyrimin për të lidhur martesë" (neni 130 paragrafi i dytë i Kodit Penal, 'Shtrëngimi apo pengimi për të bashkëjetuar ose për të lidhur apo zgjidhur martesë'), fakt ky që nuk cilësohet si trafikim, edhe pse ky detyrim ushtrohet ndaj një të mituri. Madje në këtë rast, ky veprim/fakt cilësohet nga ligjvënësi si kundërvajtje penale.

20.6 Duke u rikthyer tek ushtrimi i prostitucionit nga një i/e mitur, Kolegji vë në dukje se neni 114 në paragrafin e dytë parashikon se, "*... kur kjo vepër (shfrytëzimi i prostitucionit) kryhet ndaj një të mituri, dënohet ...*". Neni 114 i KP-së ka parashikuar si vepër penale shfrytëzimin e prostitucionit në mbrojtje të paprekshmërisë së moralit dhe dinjitetit të njeriut. Në paragrafin e parë të kësaj dispozite janë parashikuar format e kryerjes së kësaj vepre penale: shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit, ndërkohë që në paragrafin e dytë të tij janë parashikuar rrethanat që e bëjnë këtë vepër të cilësuar. Një nga këto rrethana cilësuese është kur kjo vepër penale kryhet ndaj një të mituri. Pavarësisht, parashikimit në ligj si rrethanë cilësuese kryerjen e kësaj vepre penale ndaj një të mituri, Kolegji ka konstatuar se shpeshherë gjykatat e faktit argumentojnë se viktima

ndonëse e mitur, me dëshirën dhe vullnetin e saj të lirë ka pranuar të ushtrojë prostitucion për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike e familjare, pa u shtyrë nga askush (*rast ky i trajtuar në vendimin nr. 00-2021-727 (46), datë 21.9.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Kolegji çmon se ky argumentim është joligjor. Personat që kanë shfrytëzuar një person/viktimë të mitur për prostitucion apo në çdo formë tjetër shfrytëzimi, kanë përfituar nga gjendja e saj vulnerabël, që vjen për shkak të moshës dhe/apo të gjendjes së vështirë familjare, ekonomike e sociale të saj. Gjendja vulnerabël e të miturit/miturës krijon një situatë të favorshme për rekrutimin me qëllim shfrytëzimin e tij/saj për prostitucion apo forma të tjera shfrytëzimi, përfshi këtu edhe punë e detyruar apo lypjen, nga personat e përfshirë sipas rastit konkret.

20.7 Dallimi ndërmjet paragrafit të dytë të nenit 114 dhe nenit 128/b të KP-së qëndron në përmbajtjen e tyre: *së pari*, mënyrat/format e realizimit të këtyre dy veprave penale janë të ndryshme; *së dyti*, në rastin e trafikimit të të miturve qëllimi i shfrytëzimit është më i gjerë sesa shfrytëzimi për prostitucion. Por, Kolegji vlerëson se edhe nëse kemi shtytje apo ndërmjetësim apo marrje shpërblimi për shfrytëzimin e një të mituri për prostitucion, fakti duhet trajtuar si trafikimi i të miturit sipas nenit 128/b të Kodit Penal. Ky konkluzion bazohet në instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara edhe nga vendi ynë, pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe të detyrueshme për të zbatuar nga jurisprudenca shqiptare.

20.8 Instrumentet ndërkombëtare përcaktojnë edhe se, "lypja e detyruar" duhet kuptuar si një formë e punës apo shërbimeve të detyruara, siç përcaktohet në Konventën nr. 29, e vitit 1930, të ONP-së. Kuptimi i punës së detyruar apo me dhunë jepet në nenin 2 të Konventës nr. 29/1930 të ONP-së (ILO) "*Çdo lloj pune që kërkohet nga një person me urdhër, nën kërcënimin e një dënimi, dhe për të cilën personi në fjalë nuk është ofruar vullnetarisht*". Në vitin 2008 është shtuar edhe një dispozitë tjetër në KP, neni 124/b "Keqtrajtimi i të miturit" (neni 124/b (i ndryshuar) parashikon: "1) *Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet.* 2) *Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.* 3) *Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.*".), që kriminalizon çdo veprim, me anë të të cilit një i mitur detyrohet për të punuar ose për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij. Subjekti aktiv në kryerjen e veprës penale "Keqtrajtimi i të miturit" është i posaçëm – "*personi që është i detyruar të kujdeset për të*". Me ligjin nr. 23/2012, paragrafi i parë i nenit 124/b, pësoi ndryshime, duke përcaktuar rrethin e personave, që kanë detyrimin të kujdesen për të miturin. Në analizë të përmbajtjes së nenit 128/b të KP-së, "Trafikimi i të miturve", Kolegji vlerëson se subjekti aktiv mund të jetë jo vetëm i përgjithshëm, por edhe një subjekt i posaçëm – personi që ka për detyrë të kujdeset për të miturin. Ky konkluzion gjen mbështetje në parashikimin e "shitjes të të miturit" si një formë e trafikimit të tyre, që është një veprim i cili mund të realizohet edhe nga prindi, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor. Në këtë pikë, Kolegji Penal thekson se, pasojat për të miturin mund të jenë të rënda në të dy rastet, duke dëmtuar zhvillimin fizik e psikologjik të tij. Kolegji vlerëson se edhe neni 124/b paragrafi i dytë në fakt është një formë e trafikimit të të miturve, referuar instrumenteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria. Në këtë vështrim, gjykatat duhet të tregojnë kujdesin e duhur për të arritur në konkluzione të sakta në lidhje me këtë fakt, ku në rastin e trafikimit të të miturit duhen analizuar format e trafikimit dhe qëllimi i shfrytëzimit, elemente që dallojnë nga ato të parashikuar në rastin e keqtrajtimit të të miturit.

20.9 Edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së ka cilësuar si trafikim të qenieve njerëzore, e për rrjedhojë brenda veprimit të nenit 4 të Konventës, edhe rastin kur një person shfrytëzohet për punë të detyruar apo dhe lypje, duke i trajtuar si shërbime të detyruara të ngjashme me skllavërinë. GJEDNJ-ja në interpretimin e termit "*punë e detyruar ose me dhunë*", është bazuar pikërisht te kuptimi që i është dhënë këtij termi nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP/ILO) në Konventën nr. 29 të vitit 1930. Në një çështje gjyqësore që ka lidhje me një rast të tillë, duhet vlerësuar me kujdes kompromisi apo pëlqimi i mundshëm i viktimës për të kryer një punë të tillë, ku në rastin e një fëmije/të mituri Kolegji rithekson se asnjë pranim i mundshëm nuk duhet të konsiderohet i vlefshëm (*direktiva 2011/36/BE , në lidhje me shfrytëzimin e të miturit për punë apo lypje, ka përcaktuar se, "brenda kontekstit të kësaj direktive,* ***lypja e detyruar*** *duhet kuptuar si një formë e punës apo shërbimeve të detyruara siç përcaktohet në Konventën e 1930 të ILO-së, nr. 29, në lidhje me punën e detyruar. Prandaj,* ***shfrytëzimi në lypje, duke përfshirë trafikimin e personit në kujdestari për lypje, përkufizohet si trafikim i qenieve njerëzore*** *vetëm kur ndodhin të gjitha elementet e punës ose shërbimeve të detyruara. Në dritën e një çështje gjyqësore që ka lidhje me një rast të tillë, vlefshmëria e ndonjë pranimi të mundshëm për të kryer një punë apo shërbim të tillë, do të vlerësohet mbi bazën e vlerësimit rast-pas-rasti. Megjithatë,* ***kur shqetësimi është për një fëmijë, asnjë pranim i mundshëm nuk duhet të konsiderohet i vlefshëm****." (pika 11 e preambulës së kësaj direktive)*). Kolegji vlerëson se, në çdo rast kur identifikohet një fëmijë/i mitur që shfrytëzohet për punë apo për lypje, gjykatat duhet të analizojnë më kujdes rrethanat e faktit, si dhe nëse subjekti aktiv është një i afërm, një

person që duhet të kujdeset për të miturin apo një person i tretë. Kur subjekti aktiv është një person që duhet të kujdeset për të miturin, (prindi, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të), gjykatat duhet të mos përjashtojnë se ky fakt mund të përbëjë edhe trafikim, por kjo duhet vlerësuar me shumë kujdes rast pas rasti, duke analizuar të gjitha elementet e veprës penale në fjalë (të analizuar më lart në pyetjen e parë e shtruar për njësim).

20.10 Në kuptimin e parashikimeve të Protokollit të Palermos, termi "shfrytëzim" përfshin përdorimin e një fëmije për qëllime përftimi. Në të drejtën ndërkombëtare dhe interpretimet e konventave të OKB dhe të ONP/ILO hasen ende debate dhe paqartësi në lidhje me kategorizimin e punës së palejueshme të fëmijës për lypje, si formë e rëndë e punës së fëmijës apo trafikim. ONP/ILO vë theksin tek elementi i "transferimit" dhe shfrytëzimi nga palë të treta (jo prindërit) për të identifikuar veprën e trafikimit të fëmijës. ONP/ILO sqaron se "trafikimi i fëmijës" kryhet nëpërmjet zhvendosjes dhe pikërisht ky element bën dallimin nëse ndodhemi para "shfrytëzimit të fëmijës për punë" apo "trafikimit të fëmijës". Sipas ONP/ILO shfrytëzimi i fëmijës nga palë të treta është elementi i dytë thelbësor për klasifikimin e trafikimit. Duke kujtuar përkufizimin e punës së detyruar sipas Konventës nr. 29 të ONP/ILO si "*punë apo shërbim e kryer nga personi si formë dënimi apo për të cilën personi nuk ka ofruar veten vullnetarisht*", Kolegji rithekson se të provuarit e vullnetit të fëmijës është pothuajse e pamundur, veçanërisht në situatat ku fëmija detyrohet nga vetë prindërit.

20.11 Kolegji, në lidhje me rastet e trafikimit të të miturve, vlerëson me rëndësi edhe trajtimin e çështjes V.C.L. dhe A.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar (*shih V.C.L. e A.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 77587/12 dhe nr. 74603/12, datë 16.2.2021*). Në këtë rast, GJEDNJ-ja vlerësoi lidhjen midis nenit 4 të KEDNJ-së dhe identifikimit e hetimit të viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit. Në këtë kontekst, GJEDNJ-ja gjeti shkelje të nenit 4, pasi autoritetet nuk kishin marrë masat e duhura për të mbrojtur viktimat e trafikimit. GJEDNJ-ja u shpreh se, megjithëse kërkuesit ishin identifikuar si viktima të trafikimit të qenieve njerëzore, ata u ngarkuan me përgjegjësi penale, pas kështillave të dhëna nga përfaqësuesit e tyre ligjorë, pa marrë më parë mendimin e autoritetit kompetent për trafikimin e qenieve njerëzore. Në këtë rast, GJEDNJ-ja theksoi se vendimmarrja e gjykatave të brendshme ishte në kundërshtim me mendimin e autoritetit kompetent, që kishte identifikuar aplikuesit/kërkuesit si viktima të trafikimit. Kjo çështje ka rëndësi pikërisht për faktin se GJEDNJ-ja ka theksuar se procedurat e identifikimit të një personi si viktimë apo viktimë e mundshme e trafikimit, duhen marrë në konsideratë nga prokurori dhe gjykatat. Madje, GJEDNJ-ja thekson se çdo vendim i mëvonshëm i prokurorisë ose i gjykatës, që nuk është dakord me këtë vlerësim të autoriteti kompetent për identifikimin e viktimave të trafikimit, duhet të tregojë arsye të qarta përse e kundërshton këtë konkluzion, në përputhje me përkufizimin e trafikimit të qenieve njerëzore të parashikuar në standardet ndërkombëtare. GJEDNJ-ja nisur nga praktika e saj gjyqësore në lidhje me nenet 3 dhe 8, të KEDNJ-së, thekson se fëmijët janë persona veçanërisht vulnerabël, ndaj dhe masat e zbatuara nga shteti për t'i mbrojtur ato nga akte që bien në fushën e veprimit të nenit 4, duhet të jenë efektive dhe të përfshijnë hapa të rëndësishëm për të parandaluar dënimet penale të viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit. GJEDNJ ka theksuar se në fakt, ndjekja penale e viktimave të trafikimit mund të jetë e dëmshme për rimëkëmbjen e tyre fizike, psikologjike dhe shoqërore, si dhe mund t'i ekspozojë për t'u trafikuar në të ardhmen (*Po aty, çështja V.C.L. e A.N. kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 77587/12 dhe nr. 74603/12, datë 16.2.2021*).

20.12 Kolegji vë në dukje se me vendimin nr. 499, datë 29.8.2018 të Këshillit të Ministrave, janë miratuar "Procedurat Standarde të Veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit". Këto procedura kanë për qëllim kryesor mbrojtjen, përfshirë identifikimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, të rritur apo fëmijë, shqiptarë, të huaj apo persona pa shtetësi, për të gjithë llojet e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar. Një nga përgjegjësitë kryesore të autoriteteve kompetente është: "*Identifikimi dhe referimi për ndihmë i personave të trafikuar bëhet në bashkërendim dhe bashkëpunim të plotë të të gjitha autoriteteve dhe strukturave shtetërore ose joshtetërore. Identifikimi i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit do të bëhet jo si qëllim në vetvete, por për t'i ndihmuar dhe mbrojtur ata/ato.*". Në rastin e referuar më lart, GJEDNJ-ja ka konstatuar edhe shkelje të garancive procedurale të parashikuara nga neni 6 i KEDNJ-së, duke vlerësuar se dështimi i autoriteteve për të identifikuar të miturit si viktimë trafikimi gjatë procedurave penale, ka cenuar të drejtën e tyre për një gjykim të drejtë, duke rezultuar hetimi joefektiv dhe jo i përshtatshëm. Madje në këtë rast, ato u ndihmuan nga mbrojtësi që u sugjeroi të pranonin fajësinë. Një të pandehuri, veçanërisht një të mituri në konflikt me ligjin, nuk mund t'i kërkohet që të identifikohet si viktimë trafikimi ose të ndëshkohet për dështimin e tij. Pranimi i fajit në këtë rast është cilësuar si në kundërshtim me interesin e rëndësishëm publik në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe në mbrojtjen e viktimave.

20.13 Në lidhje me pyetjen e katërt të shtruar për njësim: "*Në rast se në kuptimin e termit trafikim, përfshihet edhe trafikimi i brendshëm i personave të rritur apo të mitur, cilat janë dallimet mes veprave penale "Trafikim i personave të rritur" (neni 110/a i KP-së) dhe "Trafikim i të miturve" (neni 128/b i KP-së), me veprat penale "Shfrytëzimi i prostitucionit" (neni 114 i KP-së) dhe "Keqtrajtimi i të miturit" (neni 124/b i KP-së)?*", **Kolegji mban këtë qëndrim njësues**:

20.13.1 **Dallimi kryesor ndërmjet shfrytëzimit të prostitucionit/neni 114 dhe trafikimit të personave të rritur/neni 110/a, kur bëhet për qëllime prostitucioni, është pëlqimi i viktimës/dijenia dhe vullneti i saj i lirë për të ushtruar prostitucion**.

20.13.2 **Dallimi ndërmjet paragrafit të dytë të nenit 114 dhe nenit 128/b të KP-së qëndron në përmbajtjen e tyre: *së pari*, mënyrat/format e realizimit të këtyre dy veprave penale janë të ndryshme; *së dyti*, në rastin e trafikimit të të miturve qëllimi i shfrytëzimit është më i gjerë sesa shfrytëzimi për prostitucion. Por, Kolegji vë në dukje se edhe shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për shfrytëzimin e një të mituri për prostitucion duhet cilësuar si trafikim i të miturit, sipas nenit 128/b të KP-së. Ky konkluzion bazohet në instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara edhe nga Republika e Shqipërisë, pjesë e legjislacionit të brendshëm**.

20.13.3 **Neni 124/b, paragrafi i dytë, "Keqtrajtimi i të miturit" kriminalizon çdo veprim, me anë të të cilit një i mitur detyrohet për të punuar ose për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij. Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij – janë forma të veprës penale "Trafikimi i të miturve" (në çdo rast kur kryhet nga persona të tretë), por edhe kur kryhen nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të (në këtë rast të fundit, vetëm kur ekzistojnë dhe janë analizuar të gjithë elementet e trafikimit)**.

vii. Pyetja e pestë e shtruar për njësim është: **"Si duhet cilësuar fakti i shtytjes së detyrueshme ose jo për punë apo për lypje të një personi me aftësi të kufizuara mendore apo fizike, kur ky person nuk është në moshë të mitur? A mund të trajtohet në këtë rast personi me aftësi të kufizuara mendore si një person që për nga zhvillimi mendor barazohet me një të mitur?"**

21. Në radhë të parë, Kolegji thekson se ligji penal material nuk sqaron kuptimin e shprehjeve "punë e detyruar" apo "lypja e detyruar" apo "shërbime të tjera të detyruara". Kolegji edhe në këtë rast, referon në jurisprudencën e GJEDNJ, duke theksuar se në raste të tilla (puna apo lypja e detyruar), duhet vlerësuar me kujdes kompromisi apo pëlqimi i mundshëm i viktimës për të kryer një punë të tillë. Në këto raste, Kolegji rithekson se vullneti/pëlqimi i një personi që të vlerësohet i vlefshëm (element ky që përjashton përgjegjësinë e subjektit për sa i takon verifikimit të elementeve të trafikimit të qenieve njerëzore), duhet të jetë i plotë dhe i pandryshueshëm. Kjo do të thotë që ky pëlqim të mos ndryshohet me kalimin e kohës, pra të jetë i qëndrueshëm në të gjitha fazat e kryerjes së punës, e mbi të gjitha se personi që ka pranuar të kryejë një punë të caktuar në kushtet e përcaktuara nga "punëdhënësi", duhet të jetë në gjendje të kuptojë rëndësinë e veprimeve dhe të pasojave që atij mund t'i vijnë. Element me rëndësi që duhet verifikuar rast pas rasti, është edhe mundësia e punëmarrësit për t'u larguar dhe për të mos punuar më në këtë punë, e lidhur kjo me mundësinë e tij për të lëvizur, pa kushte apo kërcënime të çdo natyre.

21.1 Në këtë analizë merr rëndësi kuptimi i termit "person vulnerabël". Kolegji vë në dukje se në legjislacionin shqiptar, kuptimi i shprehjes "person vulnerabël" është parashikuar shprehimisht në ligjin nr. 79/2021 "Për të huajt". Ndërkohë, KP-ja referon si një nga mjetet e përdorura për trafikimin e një personi të rritur, përfitimin nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike e një personi. Në interpretim të Kolegjit, për të identifikuar gjendjen vulnerabël të një personi, ligjzbatuesit duhet të kenë në konsideratë përkufizimin që neni 3, pika 31 e ligjit për të huajt, jep për termin "persona vulnerabël" - *që janë të miturit e huaj, të miturit e pashoqëruar, persona me aftësi të kufizuara, të moshuar, femra shtatzëna, prind i vetëm me fëmijë të mitur, si dhe persona, të cilët kanë qenë objekt i torturës, përdhunimit ose formave të tjera të dhunimeve të rënda psikologjike, fizike e seksuale, migrantët që për shkak të situatës së tyre specifike nuk janë në gjendje të gëzojnë të drejtat e tyre dhe janë në kushte veçanërisht delikate, si punëtorët e shtëpisë, migrantët me orientim seksual të caktuar, migrantët në gjendje shëndetësore të rëndë dhe ata me aftësi të kufizuara.*" (Ky ligj është përafruar pjesërisht me legjislacionin e zbatueshëm në Bashkimit Evropian) Kjo do të thotë se në çdo rast, gjykatat duhet të analizojnë me kujdes situatën në të cilin ndodhet personi që po shfrytëzohet, arsyet që e kanë nxitur për të ushtruar një punë të caktuar apo për të ushtruar prostitucion (si rasti më i shpeshtë i ndeshur në praktikën gjyqësore), duhet analizuar gjendja dhe mënyra sesi personi që po e shfrytëzon apo që e ka shtyrë viktimën për të ushtruar një aktivitet të caktuar apo të kundërligjshëm, ka rënë në kontakt me viktimën, për të saktësuar pikërisht vullnetin e kësaj viktime, nëse ajo ka qenë e vetëdijshme për të kuptuar pasojat dhe nëse ka qenë e lirë për të vendosur nisur nga rrethanat

në të cilat është gjendur. Kolegji vlerëson se kjo analizë është e nevojshme në rastin kur viktima e trafikimit është person i rritur, por në rastin e viktimës së mitur, kjo analizë nuk kërkohet. Fakti që viktima është e mitur mjafton për të konkluduar se ai apo ajo nuk ka aftësinë apo zhvillimin e duhur intelektual për të kuptuar rëndësinë e veprimeve që po kryen dhe aq më pak, për të kuptuar pasojat që mund të vijnë. Është kjo arsyeja që në rastin e trafikimit të një mituri, mjafton të provohet ekzistenca e njërës prej formave apo veprimeve të parashikuara në dispozitë dhe qëllimi i shfrytëzimit të viktimës së mitur.

21.2 GJEDNJ-ja, në vendimet e saj ka marrë në analizë shprehjen "punë e detyruar ose e detyrueshme" duke referuar te Konventa e ILO/ONP nr. 29: "çdo punë ose shërbim që i kërkohet një individi nën kërcënimin e çfarëdo dënimi dhe për çka individi në fjalë nuk është treguar vetë i gatshëm me dëshirën e tij të plotë". Këtë përkufizim, GJEDNJ-ja e ka marrë si pikënisje për të interpretuar paragrafin 2 të nenit 4 të Konventës. Me qëllim për të sqaruar nocionin "punë" në kuptimin e nenit 4 § 2 të Konventës, GJEDNJ-ja ka saktësuar se jo çdo punë që i kërkohet një individi nën kërcënimin e një "dënimi" përbën medoemos një "punë të detyruar ose të detyrueshme" të ndaluar nga kjo dispozitë. Duhet të merren parasysh në fakt, veçanërisht, natyra dhe vëllimi i veprimtarisë në fjalë. Këto rrethana japin mundësi që të bëhet dallimi i një "pune të detyruar" nga çfarë u përket punëve që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme në emër të ndihmës së ndërsjellë familjare ose të bashkëjetesës (*Shih çështjen Van der Mussele kundër Belgjikës, datë 23.11.1983. Në këtë çështje, GJEDNJ-ja ka përdorur konkretisht, në, nocionin e "barrës së shpërpjesëtuar" për të përcaktuar nëse një avokat stazhier i ishte nënshtruar një pune të detyrueshme kur atij i ishte kërkuar që të siguronte falas mbrojtjen e klientëve në cilësinë e avokatit të caktuar kryesisht. Si dhe çështja C.N. dhe V.K. kundër Francës, aplikimi nr. 67724/09, datë 11.10.2012*).

21.3 GJEDNJ-ja, në interpretim të termit "e detyruar", ka theksuar se nënkupton idenë e një shtrëngimi, fizik ose moral/psikik. Për sa i përket termit të dytë, "e detyrueshme", GJEDNJ-ja ka theksuar se ky term nuk mund të ketë parasysh çfarëdo detyrimi juridik. Për shembull, një punë që duhet të kryhet në bazë të një kontrate të lidhur me vullnet të lirë nuk mund të përfshihet në fushën e veprimit të nenit 4, vetëm sepse njëri nga dy kontraktuesit është zotuar ndaj tjetrit për ta kryer atë dhe mund të ketë sanksione në qoftë se nuk e mban zotimin e vet. Duhet të bëhet fjalë për një punë që "kërkohet (...) nën kërcënimin e çfarëdo dënimi" e, për më tepër, në kundërshtim me vullnetin e të interesuarit, dhe për të cilën ky i fundit "nuk është treguar vetë i gatshëm me dëshirën e tij të plotë" (*Po aty, çështja Van der Mussele kundër Belgjikës, datë 23.11.1983*). GJEDNJ-ja ka vënë në dukje se, në raportin e përgjithshëm të miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës në 1999, nocioni "dënim" është përkufizuar në mënyrë të gjerë, çka vërtetohet nga përdorimi i shprehjes "çfarëdo dënimi". GJEDNJ-ja ka mbështetur mendimin se, ndonëse "dënimi" mund të shkojë deri te dhuna ose shtrëngimi fizik, ai mund të marrë edhe një trajtë më të hollë, me natyrë psikologjike, siç janë kërcënimet për denoncim të punonjësve në situatë të paligjshme te policia apo te shërbimet e imigrimit (*Po te çështja C.N. dhe V.K. kundër Francës, aplikimi nr. 67724/09, datë 11.10.2012*). GJEDNJ-ja në rastin Van der Mussele kundër Belgjikës ka marrë në analizë edhe faktin se aplikuesi ka pranuar të kryejë punën e caktuar me dëshirën e tij, por Gjykata nga analiza tërësore e rrethanave ka arritur në konkluzionin se pëlqimi i tij paraprak/fillestar nuk ka peshë vendimtare. Ky konkluzion është i rëndësishëm dhe mbështet atë që është theksuar edhe më lart nga Kolegji, asnjë pëlqim nuk ka rëndësi kur ekzistojnë mjetet që kanë ndikuar në vullnetin apo në perceptimin e viktimës së trafikimit (pra mashtrimi, kërcënimi, dhuna fizike apo psikologjike, përfitimi nga pozita shoqërore apo gjendja vulnerabël, e të tjera forma që janë analizuar në pyetjen e parë të shtruar për njësim).

21.4 Kolegji duke ritheksuar edhe një herë, rëndësinë që ka në një çështje gjyqësore vlerësimi i dakordësisë apo pëlqimi i mundshëm i viktimës për të kryer një punë të caktuar (përjashtim bën rasti i të miturit), çmon se duhen evidentuar disa elemente të punës apo shërbimit të detyruar. Këto elemente duhen vlerësuar rast pas rasti për të arritur në konkluzionin nëse fakti duhet cilësuar si trafikim i qenieve njerëzore (*Këto elemente trajtohen sot nga jurisprudenca ndërkombëtare, ku referenca është një rast i shkëputur nga praktika gjyqësore angleze: çështja R. vs. Connors/United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland/The Royal Courts of Justice, London/date of decision 26 march 2013*): a) natyra dhe shkalla e mashtrimit apo e shtrëngimit të përdorur për të nxitur një person që të punojë në një punë të caktuar; b) natyra dhe shkalla e shfrytëzimit të mëvonshëm, pas mbërritjes në vendin e punës; c) kushtet e vendit të punës, së bashku me metodat dhe mënyrat e kontrollit gjatë punës, me synimin që individët të qëndrojnë të bllokuar brenda vendit të punës apo organizatës/shoqërisë ku punon; d) niveli dhe shtrirja e të drejtave të individit gjatë punës, gjendja apo pozitat e tyre vulnerabël; e) shkalla e lëndimeve fizike, psikike ose financiare që pëson një individ gjatë punës së tij; f) natyra dhe shtrirja e përfitimeve financiare apo përfitimeve të tjera të punëdhënësit, si dhe numri i personave të shfrytëzuar prej tij.

21.5 Kolegji vlerëson se kuptimi që instrumentet ndërkombëtare i japin skllavërisë apo punës së detyruar, mund të shërbejnë si pikënisje për interpretimin e formave të ndryshme të shfrytëzimit edhe të personave me

aftësi të kufizuara. Në rastin e një viktime veçanërisht vulnerabël, ligji shqiptar parashikon një dënim më të lartë kur viktima është e gjinisë femërore apo e mitur. Por, ligji penal material shqiptar nuk parashikon ndonjë dispozitë të veçantë kur viktima është një person i paaftë/i papërgjegjshëm apo për shkak të gjendjes shëndetësore. Në legjislacionin shqiptar përkufizimin e termit "person vulnerabël", siç është thekuar më lart, është parashikuar në ligjin për të huajt, ku në kategorinë e personave vulnerabël përfshihen edhe personat me aftësi të kufizuara.

21.6 Me ligjin nr. 108/2012, Shqipëria ka ratifikuar edhe Konventën e OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara". duke marrë përsipër promovimin, mbrojtjen dhe të sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuara të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të promovojë respektimin e dinjitetit të tyre të lindur. Në nenin 16 të kësaj Konvente, titulluar "Lirimi nga shfrytëzimi, dhuna dhe abuzimi", parashikohet se: "*1. Shtetet palë duhet të marrin masat e duhura legjislative, administrative, shoqërore, arsimore dhe masa të tjera për të mbrojtur personat me aftësi të kufizuara, si brenda familjes dhe jashtë saj, nga të gjitha format e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit, përfshirë aspektet me bazë gjinore.* (...) *5. Shtetet palë duhet të sigurojnë legjislacionin dhe politika efektive, përfshirë legjislacionin dhe politikat në lidhje me gratë dhe fëmijët, për të siguruar se janë identifikuar, hetuar dhe kur duhet, janë ndjekur ligjërisht rastet e shfrytëzimit, dhunës dhe abuzimit ndaj personave me aftësi të kufizuara.*"

21.7 Në këtë vështrim, Kolegji vlerëson se shtytja, përdorimi apo shfrytëzimi për të lypur apo çdo lloj shfrytëzimi tjetër (sipas dispozitave mbi trafikimin e qenieve njerëzore) i një personi me probleme të shëndetit mendor ose/dhe me aftësi të kufizuara, duhet trajtuar si një nga format e trafikimit të qenieve njerëzore, nëse vërtetohen elementet e veprës penale (sipas rastit, trafikim i personave të rritur apo trafikimi i të miturit, në varësi të kriterit moshë). Në rastin e personave me aftësi të kufizuara apo me probleme të shëndetit mendor, shfrytëzuesi përfiton nga gjendja fizike dhe psikike e viktimës në këtë rast, që është një nga mjetet e parashikuara në nenin 110/a të KP-së (kur personi është i rritur/madhor). Kolegji më lart ka theksuar se, mjafton të provohet njëra nga format/veprimet e kryerjes së veprës penale, mjeti dhe qëllimi i shfrytëzimit, që vepra penale të konsiderohet e kryer. Kolegji vlerëson se gjendja fizike a mendore e një personi, duhet të jetë e tillë që ai nuk është një gjendje apo nuk është i aftë që të kujdeset për veten e tij, e si rrjedhojë e kësaj gjendje kërkohet prania dhe kujdesi i një personi tjetër. Kjo gjendje bën që personi me aftësi të kufizuar apo me probleme të shëndetit mendor, të jetë në një pozitë të pambrojtur dhe të cenueshëm (vulnerabël). Në interpretim të Kolegjit, shfaqja e vullnetit apo pranimi nga një person me aftësi të kufizuara apo me problem të shëndetit mendor, për të lypur apo për të bërë një punë a shërbim tjetër të detyruar, për sa kohë shfrytëzohet gjendja fizike apo psikike e tij/saj për të arritur këtë pëlqim apo pranim, nuk ndikon në cilësimin e faktit penal si trafikim i qenieve njerëzore. Në lidhje me veprimet apo format e kryerjes së kësaj vepre penale, Kolegji rithekson se mjafton të provohet njëra prej tyre: rekrutimi ose transportimi, ose transferimi ose fshehja ose pritja e personit viktimë të trafikimit, ndaj në këtë drejtim Kolegji vlerëson të gabuar qëndrimin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, që ekzistencën e trafikimit të personave të rritur apo të mitur, e lidh me ekzistencën e të gjitha formave të sipërcituara (arsyetimi i gjykatës së apelit në këtë rast lidhet me faktin se, viktima është motra e të pandehurve, e si rrjedhojë mungon veprimi i rekrutimit, si dhe nuk provohet që viktimës t'i jetë hequr apo kufizuar vullneti, duke u detyruar të lypë jashtë vullnetit të saj).

21.8 Në lidhje me pyetjen e pestë të shtruar për njësim: "*Si duhet cilësuar fakti i shtytjes së detyrueshme ose jo për punë apo për lypje të një personi me aftësi të kufizuara mendore apo fizike, kur ky person nuk është në moshë të mitur? A mund të trajtohet në këtë rast personi me aftësi të kufizuara mendore si një person që për nga zhvillimi mendor barazohet me një të mitur?*", **Kolegji mban këtë qëndrim njësues**:

21.8.1 **Shtytja, përdorimi apo shfrytëzimi për të lypur i një personi me probleme të shëndetit mendor ose/dhe me aftësi të kufizuara, duhet trajtuar si një nga format e trafikimit të qenieve njerëzore (sipas rastit, trafikim i personave të rritur apo trafikimi i të miturit, në varësi të kriterit moshë). Shfaqja e vullnetit apo pranimi nga një person me aftësi të kufizuara apo me probleme të shëndetit mendor, për të lypur ose për të bërë një punë tjetër të detyruar, për sa kohë shfrytëzohet gjendja fizike apo psikike e tij/saj për të arritur këtë pëlqim apo pranim, nuk ndikon në cilësimin e faktit penal si trafikim i qenieve njerëzore**.

22. Përfundimisht, në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete, Kolegji çmon se rekursi i paraqitur nga prokuroria dhe të gjykuarit përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së dhe si të tillë duhet të pranohen. Kolegji vlerëson se gjykatat kanë bërë një analizë të përciptë të rrethanave të faktit, duke arritur në konkluzione dhe zbatim të gabuar të ligjit penal material. Kjo çështje duhet kthyer për rishqyrtim në gjykatën e apelit, si gjykatë fakti dhe ligji. Kolegji vlerëson se ky kthim diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve dhe provave/akteve të marra në këtë proces penal, të cilat duhen verifikuar në raport me të drejtën/ligjin e zbatueshëm në rastin konkret. Në rigjykimin e çështjes, gjykata e apelit duhet të ketë në konsideratë konkluzionet dhe analizën e Kolegjit në këtë vendim njësues. Referuar akuzës së atribuuar të gjykuarve, "Trafikimi i personave

të rritur", parashikuar nga neni 110/a i KP-së, si dhe në referim të neneve 74 dhe 75/a të KPP-së, kjo çështje aktualisht i përket juridiksionit të përgjithshëm (gjykatave të rrethit gjyqësor), ndaj çështja duhet dërguar për rigjykim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 74, 75/a, 438 dhe 441, pika 1, shkronja "c", të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

Prishjen e vendimit nr. 54, datë 16.5.2016, të (ish-) Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë, si gjykata që ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e kësaj çështje penale.

Ky vendim është njësues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 27.7.2022
Kryesues: Ilir Panda
Anëtarë: Medi Bici, Sokol Binaj, Albana Boksi, Sandër Simoni

VENDIM
Nr. 00-2023-470 (4), datë 12.1.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:

Ilir Panda	kryesues;
Albana Boksi	anëtare;
Medi Bici	anëtar;
Sokol Binaj	anëtar;
Sandër Simoni	anëtar,

sot në seancën gjyqësore të datës 12.1.2023 mori në shqyrtim çështjen penale që i përket:
KËRKUES: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë
OBJEKTI: Parashtrim i mosmarrëveshjes së kompetencës drejtuar Gjykatës së Lartë
BAZA LIGJORE: Neni 90 e vijues i Kodit të Procedurës Penale
Në çështjen penale:
KËRKUES: Riza Çera
OBJEKTI: Aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ
BAZA LIGJORE: Neni 59/4 i Kodit Penal, neni 470, 477 dhe 480 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtares Albana Boksi, avokatin e kërkuesit Riza Çera, av. Sokol Kepi, i cili kërkoi zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës duke përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë si gjykatë kompetente, prokurorin e Prokurorisë së Përgjithshme Arqilea Koça, që kërkoi zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës duke përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë si gjykatë kompetente dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Riza Çera i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me kërkesën me objekt "Aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ". Në mbështetje të bazës ligjore përkatëse, kërkuesi ka parashtruar edhe shkaqet relevante në mbështetje të kërkimeve të tij. Në seancën gjyqësore datë 10.11.2021, bazuar në informacionin e sjellë nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (në vijim IEVP) Fushë-Krujë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë është vënë në dijeni se kërkuesi Riza Çera nuk ndodhej më në ambientet e IEVP Fushë-Krujë. Referuar urdhrit të transferimit nr. 10144/2, datë 29.9.25021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, rezultonte që i dënuari Riza Çera është transferuar për të vuajtur dënimin në IEVP Rrogozhinë.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 111, datë 10.11.2021, ka vendosur: *"Të deklarojë moskompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për gjykimin e kërkesës penale me nr. 111 akti, me datë regjistrimi 17.5.2021, me kërkues Riza Çera, me objekt "Aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ" dhe dërgimin e akteve Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si gjykata kompetente, nga pikëpamja lëndore dhe tokësore".*

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka arsyetuar ndër të tjera, se: *"... Në referim të kësaj dispozite kërkesa për aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ (qëndrim në shtëpi sipas nenit 59/a të Kodit Penal, është një kërkesë në fazë ekzekutimi të dënimit që duhet të paraqitet dhe shqyrtohet nga gjykata e vendit të ekzekutimit që pas transferimit të kërkuesit në IEVP Rrogozhinë nuk është më Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, por ajo e Rrethit Gjyqësor Kavajë..."*

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 491 akti, datë 17.10.2022, ka vendosur: *"Të parashtrojë përpara Gjykatës së Lartë mosmarrëveshjen e kompetencës tokësore midis Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për gjykimin e kërkesës penale që i përket kërkuesit Riza Çera, me objekt "Aplikimin nga dënimi me burgim në dënim alternativ.". 2. Të kërkojë nga Gjykata e Lartë prishjen e vendimit nr. 111, datë 10.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, dhe dërgimin e çështjes në po atë gjykatë për vazhdimin e gjykimit. 3. Të dërgojë në Gjykatën e Lartë, një kopje të akteve që janë të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.".*

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë në parashtrimin e mosmarrëveshjes së kompetencës ka parashtruar, ndër të tjera, se në rastin konkret, nga të dhënat e dosjes gjyqësore rezulton se çështja penale është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë më datë 27.5.2021. Ndërkohë, urdhri i transferimit nr. 10144/2, i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me të cilin kërkuesi Riza Çera është transferuar për të vuajtur dënimin e mbetur nga IEVP Krujë në IEVP Rrogozhinë, mban datën 29.9.2022. Kjo, do të thotë se në momentin e regjistrimit të kërkesës në Gjykatë, kërkuesi e vuante dënimin në IEVP Krujë dhe, për rrjedhojë në bazë të parashikimeve të neni 470/1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), kompetente për shqyrtimin e kërkesës është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.

6. Në qëndrimin e këtij trupi gjykues, "gjyqtari natyral", konstituohet në momentin e lindjes së marrëdhënies juridike procedurale penale dhe në zbatim të institutit "*perpetuatio juridictionis*", permanenca dhe vazhdimësia e pandërprerë e kësaj figure, ruhet deri në përfundim të procesit, pavarësisht ndryshimit të rrethanave fillestare të krijimit të tij. Sipas parimit bazë të së drejtës procedurale "*perpetutio jurisdictionis*", kompetenca e gjykatës përcaktohet në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe ndryshime të situatës faktike, që mund të ndodhin pas këtij momenti, nuk pasjellin ndryshimin e gjykatës kompetente.

7. Gjykata vëren se parimi i "gjyqtarit natyral të çështjes" është trajtuar gjerësisht edhe në jurisprudencën njësuese të Gjykatës së Lartë. Kështu, në vendimin njësues nr. 00 2022-1036 (114), datë 7.4.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke referuar edhe në vendimet e tjera njësuese të njëjtit Kolegj, është shprehur, se: "61. *(...) në momentin kur çdo subjekt është bërë titullar i një procesi gjyqësor dhe përballë tij shteti ka caktuar një gjyqtar apo trupë gjykuese, që në kohën dhe momentin e caktimit ka marrë juridiksion dhe kompetencë, çdo lloj kompetence, në bazë dhe për zbatim të ligjit, ka garancinë e akteve të gjithëpushtetshme juridike se nuk do të ketë mundësi që ky gjyqtar apo trupë gjykuese të spostohet, ndryshohet (translatio iudicii) apo të shndërrohet më vonë ex ante factum në gjykatë gjyqtar pa juridiksion ose jokompetent. Bëjnë përjashtim këtu rastet kur gjykata suprimohet dhe nuk ekziston më apo kur Kushtetuta, marrëveshja ndërkombëtare apo ligji me shumicë të cilësuar, për arsye objektive dhe reformuese të institucioneve të drejtësisë, urdhërojnë në mënyrë eksplicite nëpërmjet dispozitave tranzitore ndryshe* (...)."

8. Kolegji vlerësoi se ndërmjet trupave gjykues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjen se cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kur ka mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet, në kohën e shqyrtimit të çështjes.

9. Në këto kushte, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e ndërmjetëm datë 17.11.2022, ka vendosur: *"Kalimin në seancë gjyqësore për shqyrtimin e çështjes penale me nr. 80000-00691-2022, datë regjistrimi 21.10.2022, me qëllim*

njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen: Cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kur ka mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet, në kohën e shqyrtimit të çështjes?"

10. Gjithashtu, në lidhje me çështjen e mësipërme, Kolegji Penal ka kërkuar mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Shoqatës së Avokatëve Penalistë, sipas parashikimit të nenit 438/7 të KPP. Shoqata e Avokatëve Penalistë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kanë paraqitur mendim në lidhje me çështjen e shtruar për njësim, i cili është publikuar sipas parashikimit ligjor.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

11. Fillimisht, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim "Kolegji") konstaton se në çështjen në shqyrtim ekziston konflikti për kompetencë, pasi dy gjykata të ndryshme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, nuk pranojnë të gjykojnë çështjen e paraqitur, konkretisht kërkesën e kërkuesit Riza Çera me objekt "Aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ".

12. Kodi i Procedurës Penale (në vijim "KPP") në kreun II, seksionin V, titulluar "Mosmarrëveshjet për kompetencat", nenet 89, 90 dhe 91 të këtij Kodi, ka parashikuar rastet e mosmarrëveshjeve, mënyrën e parashtrimit të tyre dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për kompetencë. Neni 89/1 i KPP-së parashikon: *"Ka mosmarrëveshje, në çdo gjendje a shkallë të procedimit, kur dy a më shumë gjykata në të njëjtën kohë marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën akuzë, që i atribuohet të njëjtit person.".*

13. Neni 90 i këtij Kodi parashikon parashtrimin e mosmarrëveshjes në këtë mënyrë: *"Mosmarrëveshja mund të parashtrohet nga prokurori pranë njërës prej gjykatave në mosmarrëveshje ose nga i pandehuri dhe palët private. Parashtrimi paraqitet në sekretarinë e njërës prej gjykatave në mosmarrëveshje, me kërkesë të shkruar e të motivuar, së cilës i bashkohet dokumentacioni i nevojshëm. 2. Gjykata që ngre çështjen e mosmarrëveshjes, merr vendim, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj, duke treguar palët dhe mbrojtësit. 3. Gjykata që ka dhënë vendimin, njofton menjëherë gjykatën në mosmarrëveshje."*

14. Neni 91 e në vijim parashikon: *"1. Mosmarrëveshjet zgjidhen nga Gjykata e Lartë me vendim. Gjykata merr të dhënat, aktet dhe dokumentet që i çmon të nevojshme. 2. Vendimi u komunikohet menjëherë gjykatave në mosmarrëveshje, prokurorive përkatëse, të pandehurit dhe palëve private.".*

15. Kolegji vlerëson se parashtrimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë lidhur me mosmarrëveshjen për kompetencën e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur për gjykim është i drejtë. Për këtë arsye, aktet duhet t'i dërgohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me qëllim vazhdimin e gjykimit të çështjes, referuar argumentimit që do të trajtohet në vijim.[33]

16. Gjithashtu, rezulton se Kolegji Penal, në dhomën e këshillimit të datës 17.11.2022, ka vendosur të kalojë çështjen në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen, se cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kur ka mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet në kohën e shqyrtimit të çështjes.

17. Fillimisht, Kolegji çmon të nevojshme të sqarojë përse lindi nevoja për njësim të praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen objekt gjykimi dhe në vijim Kolegji do të trajtojë dhe do të argumentojë çështjen e shtruar për njësim.

18. Së pari, Kolegji vlerëson që kjo vendimmarrje duhet të shërbejë si vendimmarrje njësuese, pasi konstatohet se ndërmjet trupave gjykuese të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjen, se cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kur ka mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet në kohën e shqyrtimit të çështjes.

19. Konkretisht, me vendimin nr. 80002-00690-2022 regj. themeltar, datë 8.11.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *"Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës tokësore, të krijuar ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për gjykimin e kërkesës së kërkuesit Shpëtim Tema, me objekt "Ulje dënimi", (në favor) duke përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes".* Në këtë vendim është mbajtur qëndrimi se gjykata ku paraqitet për herë të parë kërkesa është gjykata e vendit të ekzekutimit, në kuptim të kompetencës tokësore për shqyrtimin e saj.

20. Gjithashtu, me vendimin nr. 00-2022-1286, datë 20.10.2022, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: "*Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier,*

[33] Ky paragraf është saktësuar/korrigjuar me vendimin nr. 470/1(4), datë 29.3.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

duke përcaktuar si gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier." I njëjti qëndrim është mbajtur në vendimin nr. 70007-961-2021 regj. themeltar datë 3.2.2022 të Kolegjit Penal. Në këto vendime, Kolegji Penal ka mbajtur qëndrimin se gjykata e vendit ku ndodhet kërkuesi në momentin e shqyrtimit të kërkesës përbën gjykatën e vendit të ekzekutimit që ka kompetencë tokësore për shqyrtimin e çështjes.

21. Nga ana tjetër, konstatohet se në Gjykatën e Lartë janë paraqitur një sërë çështjesh mosmarrëveshje kompetence ndërmjet gjykatave të rretheve gjyqësore, në lidhje me objektin e mësipërm. Rezulton se midis këtyre gjykatave ka qëndrime të ndryshme se cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kur ka mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet në kohën e shqyrtimit të çështjes.

22. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se jemi në kushtet që Kolegji të shprehet me një vendimmarrje njësuese, konform nenit 438/1 të KPP-së, që parashikon: *"Kolegji Penal, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njësuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore".*

23. Së dyti, Kolegji ndalet në trajtimin e çështjes së shtruar për njësim të praktikës gjyqësore nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë: ***- Cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kur ka mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet në kohën e shqyrtimit të çështjes?***

24. Fillimisht, Kolegji rikonfirmon qëndrimin se kompetenca nuk është gjë tjetër, veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Ky Kolegj thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale, me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejtë *(shih vendimin njësues të Kolegjit Penal nr. 23, datë 27.7.2021).*

25. Kompetenca lëndore është një parakusht procedural i cili përcakton konceptin e gjykatës së krijuar me ligj. "Gjykata e krijuar me ligj" është pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar edhe nga neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "KEDNJ"). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim "GJEDNJ"), në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka trajtuar kuptimin e "gjykatës së krijuar me ligj", duke trajtuar se në kuadër të procesit të rregullt ligjor gjykatat gjithmonë duhet të jenë të krijuara me ligj. Kjo shprehje pasqyron parimin e shtetit të së drejtës që është pjesë e pandarë e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut parashikuar nga KEDNJ-ja dhe protokollet e saj.[34] Një organ i pakrijuar me ligj, do të privohej nga legjitimiteti i kërkuar në një shoqëri demokratike për të dëgjuar ankesat e individëve.[35]

26. "Ligj", në kuptim të nenit 6/1 të KEDNJ-së, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, përfshin në veçanti jo vetëm legjislacionin që përcakton krijimin dhe funksionimin (kompetencën) e organeve gjyqësore, por edhe çdo dispozitë ligjore të legjislacionit të brendshëm, që, nëse shkelet do ta shndërronte pjesëmarrjen e një ose më shumë gjyqtarëve në shqyrtimin e një çështje konkrete në një pjesëmarrje të paligjshme.[36] Shprehja "e caktuar me ligj" përfshin bazën ligjore për ekzistencën e gjykatës, pajtueshmërinë e veprimtarisë së gjykatës me normat e veçanta që rregullojnë veprimtarinë e saj, si dhe përbërjen (kompozimin) e gjykatës në çdo rast që ajo merr në shqyrtim.[37]

27. Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese evropiane, ndër vite, kanë elaboruar disa kritere themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohet nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'u paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete[38] dhe

---

[34] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Jorgic v Germany*nr, aplikimi 74613/01, datë 12.7.2007, paragrafi i 64; *Richert v Poland,* nr. aplikimi 54809/07, datë 25.1.2012, paragrafi 41;

[35] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Lavents v Latvia*nr, aplikimi 58422/00, datë 28.2.2003, paragrafi 114; *Gorgiladze v Georgia;* nr. aplikimi 4313/04, datë 20.10.2009, paragrafi 67; *Kontalexis v Greece*nr, aplikimi 59000/08, datë 21.11.2011, paragrafi 38.

[36] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Pandjikidze and others v Georgia,* nr. aplikimi 30323/02, datë 27.1.2010, paragrafi 104.

[37] Gjykata Evropiane "Për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore" *Posokhov v Russia,* nr. aplikimi 63486/00, datë 4.6.2003, paragrafi 39; *Fatullayev v Azerbaijan* nr. aplikimi 40984/07, datë 4.10.2010, paragrafi 144.

[38] Shiko vendimin nr. 31, datë 5.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

ky është rregulli i përgjithshëm se si një gjykatë e zakonshme merr juridiksion dhe kompetencë për çështjet.

28. Kjo do të thotë se në momentin kur çdo subjekt është bërë titullar i një procesi gjyqësor dhe përballë tij, republika ka caktuar një gjyqtar apo trupë gjykuese, që në kohën dhe momentin e caktimit ka marrë juridiksion dhe kompetencë, çdo lloj kompetence, në bazë dhe për zbatim të ligjit, ka garancinë e akteve të gjithëpushtetshme juridike se nuk do të ketë mundësi që ky gjyqtar apo trupë gjykuese të spostohet, ndryshohet *(translatio iudicii)* apo të shndërrohet më vonë *ex ante factum* në gjykatë/gjyqtar pa juridiksion apo jokompetent. Bëjnë përjashtim këtu rastet kur gjykata suprimohet dhe nuk ekziston më apo kur Kushtetuta, marrëveshja ndërkombëtare apo ligji me shumicë të cilësuar, për arsye objektive dhe reformuese të institucioneve të drejtësisë, urdhërojnë në mënyrë eksplicite nëpërmjet dispozitave tranzitore ndryshe *(shih vendimin njësues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2018-148, datë 4.4.2018).*

29. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, për zgjidhjen e drejtë të çështjes Kolegji vlerëson se është e nevojshme të përcaktohet natyra procedurale e kërkesës objekt gjykimi, me të cilin është investuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, si dhe faza procedurale në të cilën ajo është paraqitur. Objekti i kësaj kërkese është "Aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ". Kërkesa e kërkuesit Riza Çera, fillimisht, është paraqitur në kohën që ai ishte duke vuajtur dënimin me burgim pranë IEVP Fushë-Krujë. Në vijim, sipas urdhrit të transferimit përkatës, kërkuesi është transferuar për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit pranë IEVP Rrogozhinë.

30. Në kushtet kur kemi të bëjmë me një kërkesë të paraqitur nga personi që vuan dënimin me burgim në një institucion ekzekutimi vendimi penal, atëherë jemi në një çështje që i përket fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Kolegji konstaton se fakti që çështja i përket fazës së ekzekutimit të vendimit gjyqësor është një çështje e pranuar nga të dyja gjykatat dhe nuk lë vend për diskutim. Diskutimi që lind në këtë çështje midis dy gjykatave në mosmarrëveshje kompetence, por edhe për të cilën trupat e Kolegjit Penal nuk ndajnë të njëjtin qëndrim, është fakti se cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor (përfshirë çështjen objekt gjykimi), kur gjykata në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykata në territorin e së cilës ai ndodhet në kohën e shqyrtimit të çështjes nuk janë e njëjta.

31. Për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështje, referimi bëhet te dispozita procedurale penale specifike, që rregullon kompetencën tokësore të gjykatës së vendit të ekzekutimit.

32. Neni 470 i KPP-së parashikon: *"Gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij".* Ndër kërkesat që shqyrton gjykata e vendit të ekzekutimit është edhe kërkesa objekt gjykimi, ajo për aplikim dënimi alternativ në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Në rastin konkret, të dyja gjykatat e përfshira në mosmarrëveshje kompetence bien dakord që gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për gjykimin e çështjes (çështje që në fakt rregullohet shprehimisht nga ligji), por ato ndahen në faktin se cila gjykatë ka konkretisht kompetencën tokësore.

33. Kolegji vlerëson se për përcaktimin e gjykatës kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e dënimit, referimi duhet të bëhet te momenti i paraqitjes së kërkesës në gjykatë. Momenti i paraqitjes së kërkesës në gjykatë përcakton edhe kompetencën tokësore të gjykatës së vendit të ekzekutimit në shqyrtimin e kërkesave në fazën e ekzekutimit, kompetencë që nuk mund të ndryshojë sa herë ndryshon vendi i vuajtjes së dënimit me burgim të kërkuesit, sipas IEVP-së përkatëse.

34. Në arritjen e përfundimit të mësipërm Kolegji çmon t'i referohet parimit bazë të së drejtës procedurale të *"perpectuatio jurisdictionis",* sipas të cilit kompetenca e gjykatës përcaktohet në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe ndryshime të situatës faktike, që mund të ndodhin pas këtij momenti, nuk pasjellin ndryshimin e gjykatës kompetente[39]. Ky parim garanton dhe minimumin e nevojshëm të sigurisë dhe stabilitetit për personin e dënuar, në mënyrë që kërkesa e tij të shqyrtohet nga Gjykata e ekzekutimit, (gjyqtari natyral), e konstituuar si e tillë në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe të mos ndryshojë (kushtëzohet) në varësi të kërkesave dhe/ose emergjencave të organit administrativ të ekzekutimit të vendimeve penale.

35. Në terma të tjerë, kompetenca, për gjykimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi Riza Çera para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë më datë 27.5.2021, me objekt "Aplikim i dënimit alternativ", në cilësinë e gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit, në kushtet e vuajtjes së dënimit, prej kërkuesit pranë IEVP Fushë-Krujë në konformitet me përcaktimet e paragrafit të parë të nenit 470 të KPP-së, e rrënjëzuar pranë kësaj gjykate, për këtë shkak, konsiderohet e imunizuar prej ecurisë së mëtejshme dinamikës të *iter*-it administrativ të sistemimit *post factum* alternativ të kërkuesit, në cilësinë e subjektit që "pëson" ekzekutimin e vendimit, dinamikë, e cila, presupozon të drejtën dhe kompetencën e organit administrativ, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të

[39] Gjykata e Kasacionit Itali, seksioni I, vendimi nr. 1137, datë 13 janar 2010; Gjykata e Kasacionit Itali, seksioni I, vendimi nr. 53177, datë 22 dhjetor 2014.

vlerësuar, pavarësisht dhe përtej qasjes së organit juridiksional, gjykatës së vendit të ekzekutimit, kërkesat dhe emergjencat e rezultuara në këtë kuadër, në funksion të zgjidhjes dhe eliminimit të pasojave të shkaktuara.

36. Në këtë mënyrë, Kolegji vlerëson se kompetenca tokësore e gjykatës së vendit të ekzekutimit bëhet mbi bazën e një raporti (marrëdhënie) të karakterizuar prej stabilitetit, midis të dënuarit dhe institucionit në të cilin ndodhet, duke përjashtuar që të marrë përparësi thjesht prania fizike e kërkuesit në çfarëdolloj institucioni, e përcaktuar për arsye të rastësishme dhe momentale (si p.sh., ato të lidhura me situata tranziti gjatë transferimit nga një institut në tjetrin etj., dhe që nuk sigurojnë minimumin e stabilitetit të nevojshëm për krijimin e një raporti midis autoriteteve dhe të dënuarit, të përshtatshëm për shqyrtimin e personalitetit të tij në këtë fazë.

37. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se kompetenca tokësore e gjykatës së vendit të ekzekutimit do të përcaktohet në momentin e paraqitjes së kërkesës së kërkuesit që pretendon një të drejtë të caktuar në fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Fakti që vendndodhja e kërkuesit mund të ndryshojë pas momentit të paraqitjes së kërkesës, duke u vendosur ai në një institucion tjetër të ekzekutimit të vendimit penal, nuk përcakton dhe as kushtëzon kompetencën tokësore të gjykatës së parë e cila kishte në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuesi. Gjykata e vendit të ekzekutimit ku ishte paraqitur për herë të parë kërkesa ka të drejtën dhe detyrimin të vazhdojë me shqyrtimin e saj në themel dhe nuk është në përputhje me dispozitat procedurale penale shpallja e moskompetencës tokësore prej saj.

38. Kolegji thekson se duke qenë se në momentin e regjistrimit të kërkesës objekt gjykimi, kërkuesi Riza Çera ka qenë duke vuajtur dënimin në IEVP Fushë-Krujë, kalimi i tij në vijim për vuajtjen e dënimit pranë IEVP Rrogozhinë nuk ndikon edhe në përcaktimin e gjykatës që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjes. Duhet vënë në dukje se kërkesa e të dënuarit Riza Çera është një kërkesë e fazës së ekzekutimit të vendimit penal. Në lidhje me shqyrtimin e kërkesave/çështjeve të fazës së ekzekutimit, gjejnë zbatim përveç Kodit të Procedurës Penale edhe ligji nr. 79/2020, "Për ekzekutimin e vendimeve penale" ose/dhe ligji nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve". Këto ligje, ashtu si dhe KPP-ja (neni 470 i këtij Kodi), përcaktojnë gjykatën kompetente, që është gjykata e vendit ku kryhet ekzekutimi i vendimit penal, përfshi këtu edhe rastet kur vendi i ekzekutimit ndryshon për shkaqe të përcaktuara shprehimisht në ligj, siç dhe ka ndodhur në rastin konkret (transferimi i të dënuarit urdhërohet nga drejtori i përgjithshëm i Burgjeve, në rastet dhe në kushtet e parashikuara në nenin 78, të ligjit nr. 81/2020).

39. Në nenin 80, të ligjit nr. 81/2020, parashikohet shprehimisht, se: "*...shqyrtimi gjyqësor i ankimeve, kundër vendimeve të IEVP apo të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve, bëhet në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal, në përputhje me parashikimet e KPP-së*". Nga ana tjetër, edhe ligji nr. 79/2020 thekson se kontrolli procedural për ekzekutimin e vendimeve, bëhet nga gjykata që ka dhënë vendimin ose nga gjykata e vendit të ekzekutimit, kur ekzekutimi i vendimit bëhet në një rreth të ndryshëm nga ai i gjykatës që ka dhënë vendimin.

40. Në rastin konkret, vendndodhja e IEVP-së ku vuante dënimin kërkuesi në kohën e paraqitjes së kërkesës përcakton edhe kompetencën tokësore të gjykatës së vendit të ekzekutimit. Kjo gjykatë që ka kompetencën tokësore nuk do të ndryshojë, pavarësisht ndryshimit që mund të pësojë IEVP ku kërkuesi vuan dënimit dhe pavarësisht shkaqeve që kanë sjellë ndryshimin e institucionit të ekzekutimit. Prandaj, kompetenca tokësore për shqyrtimin e kërkesës objekt gjykimi i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, si gjykata që ka nën juridiksion IEVP Fushë-Krujë.

41. Sa më sipër, Kolegji vlerëson se në lidhje me pyetjen e shtruar për njësim të mbahet ky qëndrim njësues: ***Në rast mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet në kohën e shqyrtimit të çështjes për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor kompetenca tokësore i përket gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën.***

42. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Kolegji vendos zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për gjykimin e kërkesës së kërkuesit Riza Çera, me objekt "Aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ", duke përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 91 dhe 438, të Kodit të Procedurës Penale

VENDOSI:

1. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për gjykimin e kërkesës së kërkuesit Riza Çera, me objekt "Aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ", duke përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes.

2. Ky vendim është njësues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 12.1.2023

Kryesues: Ilir Panda
Anëtarë: Sandër Simoni, Sokol Binaj
Anëtarë kundër: Medi Bici, Albana Boksi

MENDIM PAKICE

1. Ne gjyqtarët në pakicë, Albana Boksi dhe Medi Bici, jemi kundër mendimit të shumicës, në lidhje me çështjen e shtruar për njësim të praktikës gjyqësore, si dhe me përfundimin e arritur nga shumica lidhur me pyetjen: "*Cila është gjykata që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kur ka mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet, në kohën e shqyrtimit të çështjes*?" Ne gjyqtarët në pakicë kemi qëndrim të ndryshëm në lidhje me gjykatën që ka kompetencën për shqyrtimin e kërkesave të palëve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale, për arsyet që do të parashtrojmë në vijim.

2. Nga shqyrtimi i çështjes ka rezultuar se kërkuesi Riza Çera ka depozituar një kërkesë, me objekt "Aplikim dënimi alternativ", referuar nenit 59 pika 4 të Kodit Penal, si dhe neneve 470, 477 dhe 480 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Kjo kërkesë është paraqitur pranë gjykatës së vendit të ekzekutimit, që në zbatim të ligjit procedural penal nënkupton gjykatën në juridiksionin e së cilës ndodhet Instituti i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), pranë të cilit vuan dënimin kërkuesi. Në momentin e marrjes në shqyrtim të kësaj kërkese, gjykata e vendimit të ekzekutimit – Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka konstatuar se i dënuari është transferuar për të vuajtur dënimin në IEVP Rrogozhinë, në bazë të urdhrit nr. 10144/2, datë 29.9.2021 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Pikërisht, për këtë shkak ka lindur edhe konflikti i kompetencës mes Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë që ka disponuar shpalljen e moskompetencës lëndore për gjykimin e kësaj kërkese, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë së cilës i është dërguar për kompetencë kjo çështje.

3. Për zgjidhjen drejtë të kësaj çështje, pakica vlerëson se referimi duhet bërë tek dispozita procedurale penale specifike që rregullon kompetencën tokësore të gjykatës së vendit të ekzekutimit, si dhe te dy ligjet që lidhen me këtë fazë të procesit penal: ligji nr. 79/2020, "Për ekzekutimin e vendimeve penale" (ligji nr. 79/2020) dhe ligji nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" (ligji 81/2020). Neni 470 i KPP-së parashikon: "*Gjykata e vendit të ekzekutimit është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij.*" Ndër kërkesat që shqyrton gjykata e vendit të ekzekutimit është edhe kërkesa objekt gjykimi, ajo për aplikim dënimi alternativ në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor. Ligji nr. 79/2020 përcakton rregullat dhe procedurat për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë; vendimeve gjyqësore penale me ekzekutim të menjëhershëm; urdhërimeve të tjera me vendime gjyqësore, si dhe përcakton edhe mënyrën e kryerjes së dënimeve alternative, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi (përfshi edhe kërkesën e kërkuesit Riza Çera). Në këtë ligj parashikohet shprehimisht, se: "*Dispozitat e këtij ligji zbatohen për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të dhëna nga gjykatat vendase dhe të huaja në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, Kodin Penal, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj.*" (neni 2, pika 2, të ligjit 79/2020).

4. Gjyqtarët në pakicë, referuar kuadrit ligjor që rregullon fazën e ekzekutimit të një vendimi penal të formës së prerë, vlerësojnë se pavarësisht faktit që në momentin e regjistrimit të kërkesës objekt gjykimi, kërkuesi Riza Çera ka qenë duke vuajtur dënimin në IEVP Fushë-Krujë, kalimi i tij në vijim për vuajtjen e dënimit pranë IEVP Rrogozhinë, ndikon edhe në përcaktimin e gjykatës që ka kompetencën tokësore për gjykimin e çështjes. Një përfundim i tillë arrihet po të bëhet interpretimi teologjik i nenit 470 i KPP-së, pra përcaktimi i arsyes/qëllimit që ka pasur ligjvënësi për një parashikim të tillë. Qëllimi i përcaktimit të gjykatës së vendit të ekzekutimit, si gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesave në fazën e ekzekutimit, lidhet me nevojën për të garantuar aksesin sa më

të shpejtë dhe të lehtë të të dënuarit në gjykatë, në mënyrë që gjykata të shprehet për kërkesat e të dënuarit gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit penal. Qenia e kësaj gjykate sa më afër kërkuesit lehtëson jo vetëm aksesin e tij edhe në këtë fazë të ekzekutimit të vendimit penal, por garanton mbikëqyrjen e kontrollin mbi rregullsinë e ekzekutimit nga gjykata, si dhe verifikimin e rrethanave të ndryshme në një kohë të arsyeshme, përfshi këtu edhe garantimin e së drejtës së mbrojtjes.

5. Qëllimi i ligjvënësit në parashikimin e gjykatës së vendit të ekzekutimit dhe përcaktimin e kompetencave lëndore të saj, lidhet pikërisht me nevojën dhe domosdoshmërinë e qenies së një gjykate pranë institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Ligji nr. 81/2020 parashikon, ndër të tjera, edhe të drejtat e të dënuarit, duke përcaktuar kërkesat, mënyrat apo procedurën që ai mund të ndjekë për t'ju drejtuar gjykatës. Ky ligj ka parashikuar disa kërkime apo çështje për të cilat i dënuari mund t'i drejtohet gjykatës në lidhje me këtë fazë procedurale. Në këto raste, ky ligj përcakton se kompetenca për shqyrtimin e kërkesave që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimit penal të formës së prerë i takon "gjykatës së vendit të ekzekutimit", në përputhje me parashikimet e KPP-së (neni 80 i ligjit nr. 81/2020, ku parashikohet shprehimisht, se: "*...shqyrtimi gjyqësor i ankimeve, kundër vendimeve të IEVP-së apo të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve, bëhet në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit penal, në përputhje me parashikimet e KPP*-së").

6. Pakica vë në dukje se, edhe transferimi i të burgosurit gjatë kohës që vuan dënimin me burgim është një nga të drejtat e njohura nga ligji nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve". Neni 78, pikat 2 e 4 të këtij ligji parashikon, se: "(...) *2. Transferimi i të burgosurit bëhet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve, bazuar në kërkesën e të burgosurit ose anëtarëve të familjes së tij, prokurorit të çështjes ose drejtorit të institucionit. (...) 4. Transferimet krijojnë, për aq sa është e mundur, mundësinë që të dënuarit ta kryejnë dënimin sa më pranë vendbanimit të anëtarëve të familjes së tyre.*".

7. Sipas parashikimit të mësipërm, i burgosuri ka të drejtë të transferohet në një institucion tjetër të ekzekutimit të vendimeve penale, me qëllim për të qenë sa më afër familjes së tij, duke pasur si qëllim realizimin e funksionit primar të dënimit që është rehabilitimi dhe risocializimi sa më i shpejtë i tij. Në kushtet kur qëllimi i transferimit të personit që vuan dënimin është qenia e tij sa më afër familjes, është në logjikë të ligjvënësit që i dënuari i transferuar të jetë afër edhe gjykatës që do të shqyrtojë kërkesat e tij në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, pra gjykatës së vendit të ekzekutimit. Një përfundim i ndryshëm do të binte ndesh me qëllimin e ligjvënësit që ka parashikuar konceptin e gjykatës së vendit të ekzekutimit, por, gjithashtu, edhe me qëllimin e së drejtës së të dënuarit për t'u transferuar në një IEVP tjetër.

8. Koncepti i ligjvënësit për gjykatën e vendit të ekzekutimit nuk mund të jetë statik dhe i pandryshueshëm. Me ndryshimin e vendit ku vuhet dënimi me burgim, do të duhet të ndryshojë edhe gjykata që shqyrton kërkesat e të dënuarve në këtë fazë, në mënyrë që dënimi, por edhe ligji, të realizojë më së miri funksionin e tij në drejtim të rehabilitimit dhe risocializimit të të dënuarit. Gjithashtu, një interpretim i ndryshëm do të kufizonte të drejtën e kërkuesit për të investuar gjykatën me kërkesa që i përkasin kësaj faze, me frikën se atij do t'i vështirësohej aksesi për të qenë i pranishëm në gjykim apo për të realizuar të drejtën e mbrojtjes efektive.

9. Neni 471 i KPP-së parashikon mënyrën e procedimit nga gjykata e vendit të ekzekutimit kur shqyrton kërkesat e palëve në këtë fazë, ku veçohet se: "(...) *Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga paragrafi 2, gjykata cakton datën e seancës dhe lajmëron palët dhe mbrojtësit, të paktën dhjetë ditë para seancës. 4. Seanca zhvillohet me pjesëmarrjen e detyrueshme të prokurorit dhe të mbrojtësve. I interesuari, kur e kërkon, dëgjohet personalisht ose me letërporosi. 5. Kur kërkuesi nuk paraqitet në seancë pa ndonjë shkak të arsyeshëm, megjithëse ka dijeni rregullisht për datën dhe orën e saj, heq dorë nga kërkesa, ose ndryshon objektin e saj, gjykata e deklaron atë të papranueshme...*" Ky parashikim ligjor dhe nevoja për praninë e kërkuesit në gjykim, dëshmojnë që si rregull gjykata e vendit të ekzekutimit duhet të jetë afër IEVP-së, pikërisht për të garantuar aksesin e tij në këtë lloj gjykimi. Gjyqtarët në pakicë çmojnë se, qëllimi i ligjvënësit kur ka krijuar konceptin e gjykatës së vendit të ekzekutimit, si gjykata e krijuar me ligj për shqyrtimin e kërkesave në fazën e ekzekutimit ka qenë ai i parashtruar më sipër, dhënia e aksesit sa më lehtë kërkuesit për të pasur afër një gjykatë që shqyrton kërkesat e tij në fazën e ekzekutimit. Për më tepër, transferimi i të dënuarve nga një IEVP në tjetrën bëhet sipas procedurës së parashikuar në ligj dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 78 të ligjit nr. 81/2020.

10. Neni 470 i KPP-së ka parashikuar shprehimisht gjykatën e vendit të ekzekutimit si gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e një vendimi penal të formës së prerë. Ndërsa në dispozitën e nenit 480, pika "1" të këtij Kodi, parashikohet, se në fazën e ekzekutimit, gjykata është kompetente të vendosë për shuarjen e veprës penale pas dënimit, për shuarjen e dënimit, për dënimet plotësuese, për konfiskimin ose kthimin e sendeve të sekuestruara, si dhe për çdo rast të parashikuar me ligj.

11. Duhet vënë në dukje se, kërkesa e të dënuarit Riza Çera, është një kërkesë e fazës së ekzekutimit të vendimit

penal. Në lidhje me shqyrtimin e kërkesave/çështjeve të fazës së ekzekutimit, gjejnë zbatim edhe parimet e procesit të rregullt ligjor, ndër të tjera edhe gjykimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj, siç argumenton edhe shumica. Por, në ndryshim nga konkluzioni i shumicës, në rastin konkret, gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se duhet pasur në konsideratë edhe natyra e gjykimeve në këtë fazë të ekzekutimit. Kërkesat e fazës së ekzekutimit lidhen me mbikëqyrjen e disponimeve të përfundimtare të një vendimi gjyqësor (pra një vendim gjyqësor i ekzekutueshëm), lidhen me kërkesa që lindin gjatë ekzekutimit, të lidhura me mënyrën e ekzekutimit apo trajtimin e një të dënuari nga IEVP përkatës, që do të thotë që janë çështje që nuk kanë një karakter të mirëfilltë juridiksional apo gjyqësor. Kjo do të thotë, se ligjet që veprojnë në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale të formës së prerë, ashtu edhe KPP (neni 470 i këtij Kodi), përcaktojnë gjykatën e vendit të ekzekutimit si gjykatën kompetente për shqyrtimin e kërkesave që lidhen me këtë fazë, kanë parasysh se qëllimi primar është garantimi i kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues, trajtimi i tyre në mënyrë të barabartë, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim. Pikërisht, ky qëllim mbahet në konsideratë edhe në rastet kur vendi i ekzekutimit ndryshon për shkaqe të përcaktuara shprehimisht në ligj, siç dhe ka ndodhur në rastin konkret (transferimi i të dënuarit në rastet dhe në kushtet e parashikuara në nenin 78 të ligjit nr. 81/2020).

12. Gjyqtarët në pakicë vlerësojnë se arsyetimi i përdorur nga gjykata referuese dhe i mbështetur nga shumica, që sipas parimit bazë të së drejtës procedurale "*perpetutio jurisdictionis*", kompetenca e gjykatës përcaktohet në momentin e paraqitjes së kërkesës dhe ndryshime të situatës faktike që mund të ndodhin pas këtij momenti, nuk pasjellin ndryshimin e gjykatës kompetente, do të ishte i zbatueshëm në rastet e gjykimeve të çështjes në themel apo në rastet kur kërkimi i të dënuarit lidhet me disponimin përfundimtar të gjykatës së themelit apo dispozitivin/pjesën urdhëruese të vendimit që është vënë në ekzekutim. Në rastin konkret, kërkesa e të dënuarit lidhet me mënyrën e ekzekutimit të mëtejshëm të dënimit të caktuar, është një kërkesë që duhet trajtuar duke marrë në konsideratë edhe sjelljen e të dënuarit apo qëndrimin e tij gjatë ekzekutimit të dënimit, ndaj në këtë rast duhet zbatuar parashikimi ligjor dhe qëllimi i ligjvënësit në nenin 470 të KPP-së. Nëse kompetenca lëndore e tokësore do të përcaktohej në fillim të paraqitjes së kërkesës, duke e bërë kështu konceptin e gjykatës së vendit të ekzekutimit statik, atëherë do të binte edhe qëllimi i ligjvënësit që kjo gjykatë të jetë afër IEVP-së, duke rritur në këtë mënyrë aksesin e personave të dënuar, në kuadër të garantimit të të drejtave që ligji nr. 81/2020 parashikon për ta.

13. Në rastin konkret, pavarësisht se ku ndodhej IEVP-ja që vuante dënimin kërkuesi në kohën e paraqitjes së kërkesës, rezulton se në momentin e marrjes në shqyrtim të kësaj kërkese, i dënuari po vuante dënimin në një institucion tjetër, fakt ky që përcakton edhe kompetencën tokësore të gjykatës së vendit të ekzekutimit. Prandaj, kompetenca tokësore për shqyrtimin e kërkesës objekt gjykimi i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si gjykata që ka nën juridiksion IEVP Rrogozhinë.

14. Sa më sipër, ne gjyqtarët në pakicë kemi mendimin, se në lidhje me pyetjen e shtruar për njësim përgjigjja e dhënë prej Kolegjit Penal duhet të ishte: ***Në rast mosmarrëveshje kompetence midis gjykatës në të cilën i dënuari ka paraqitur kërkesën dhe gjykatës në territorin e së cilës ai ndodhet, në kohën e shqyrtimit të çështjes për gjykimin e çështjeve penale në fazën e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, kompetenca tokësore i përket gjykatës në territorin e së cilës kërkuesi ndodhet në kohën e shqyrtimit të çështjes.***

15. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, vlerësojmë se kompetenca tokësore për gjykimin e kërkesës së kërkuesit Riza Çera, me objekt: "Aplikim nga dënimi me burgim në dënim alternativ", i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, së cilës duhet t'i dërgoheshin aktet lidhur me këtë çështje.

Anëtarë: Medi Bici, Albana Boksi

VENDIM
Nr. 2, datë 18.11.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga gjyqtarët:
Sokol Sadushi kryesues;
Artur Kalaja anëtar;
Ilir Panda anëtar;
Ervin Pupe anëtar;
Sokol Binaj anëtar;
Albana Boksi anëtare;
Sandër Simoni anëtar;
Asim Vokshi anëtar;
Medi Bici anëtar;
Arbena Ahmeti anëtare;
Gentian Medja anëtar;
Darjel Sina anëtar;
Sokol Ngresi anëtar;
Margarita Buhali anëtare,
sot, më datë 18.11.2022, morën në shqyrtim, në seancë gjyqësore, çështjen penale me nr. 71001-00493-00-2017, akti, që i përket palëve:
KËRKUES: Adriatik Muharremi, përfaqësuar nga avokat Roland Islami.
ME OBJEKT: Rivendosje në afat të ankimit kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.
PALË E INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar nga prokurori Arqilea Koça.
BAZA LIGJORE: Nenet 147, pika 2 dhe 148 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim KPP).

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relatimin nga gjyqtarët Sokol Binaj dhe Medi Bici, prokurorin Arqilea Koça, i cili kërkoi pranimin e qëndrimit në lidhje me ndryshimin e vendimit njësues nr. 1/2011, prishjen e vendimit nr. 20-2017-38/10, datë 24.1.2017, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe të vendimit nr. 23-2016-2291, datë 2.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, avokatin Roland Islami, i cili kërkoi ndryshimin e praktikës gjyqësore në lidhje me vendimin njësues nr. 1/2011, rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe si e biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga përmbajtja e dosjes gjyqësore ka rezultuar se, kërkuesi Adriatik Muharremi, i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke kërkuar rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar ankim kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me të cilin është dënuar me 25 vjet burgim. Konkretisht, me vendimin nr. 51, datë 11.12.1999, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka vendosur:

"Deklarimin fajtor të të pandehurit Adriatik Tomorr Muharremi për veprën penale "Vjedhja me pasojë vdekjen", parashikuar nga nenet 141-22 të KP dhe dënimin e tij me 25 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Adriatik Tomor Muharremi për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", parashikuar nga neni 278/2 i KP dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të KP përfundimisht e dënon të pandehurin Adriatik Tomorr Muharremi me 25 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Dhurim Bajram Tusha për veprën penale "Vjedhje me armë" të mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 144-22 të KP dhe dënimin e tij me 8 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Dhurim Bajram Tusha për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit" parashikuar nga neni 278/2 i KP dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të KP përfundimisht e dënon të pandehurin Dhurim Tusha me 8 vjet burgim".

2. Rezulton se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është marrë në mungesë të të pandehurit Adriatik Muharremi. Ka rezultuar se kundër vendimit ka ushtruar ankim bashkipandehuri Dhurim Tusha. Gjykata e Apelit Gjirokastër, pasi ka shqyrtuar çështjen në shkallë të dytë, me vendimin nr. 15, datë 22.2.2000, ka vendosur: "*Lënien në fuqi të vendimit gjyqësor nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Sarandë, për sa i përket të pandehurit Adriatik Muharremi. Lënien në fuqi të vendimit gjyqësor nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Sarandë për sa i përket fajësisë e kualifikimit të veprës penale të kryer nga i pandehuri Dhurim Tusha. Ndryshimin e vendimit të mësipërm për sa i përket masës së dënimit të dhënë ndaj të pandehurit Dhurim Tusha, duke e dënuar atë me 4 (katër) vjet burgim.*"

2.1 Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ka arsyetuar se: "*Gjykata me të drejtë mbi bazën e provave të ndodhura në dosjen hetimore si dhe provave të administruara në hetimin gjyqësor konkludon se i pandehuri Adriatik Muharremi ka konsumuar elementet e veprës penale të "Vjedhjes me armë me pasojë vdekjen", e shtetasit Gramoz Cenkollari, si edhe të "Vjedhjes me armë", të mbetur në tentativë, nga i pandehuri Dhurim Tusha.....Pretendimet e avokatit mbrojtës të të pandehurit Adriatik Muharremi, i pranishëm në gjykimin në apel, nuk merren për bazë, pasi ky i pandehur nuk ka bërë ankim dhe se, në bazë të nenit 425/1 të KPP-së, shkaqet që pretendohen nuk janë brenda kufijve që i referohen shkaqeve të ngritura në ankim".*

3. Mbështetur në vendimin gjyqësor të formës së prerë është bërë shpallja në kërkim ndërkombëtar e të dënuarit Adriatik Muharremi. Me shkresën me nr. 2299/16, datë 6.7.2016, ZQK Interpol Tirana, ka njoftuar Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, se në datën 5.7.2016 është realizuar ekstradimi nga Greqia në Shqipëri i të dënuarit Adriatik Tomorr Muharremi.

4. Brenda 5 ditëve nga dita e ekstradimit të tij në Shqipëri, i dënuari Adriatik Muharremi, nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur, nga të afërmit e tij, ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës për të ushtruar ankim kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë që e ka deklaruar fajtor për kryerjen e dy veprave penale dhe që e ka dënuar me 25 vjet burgim, për shkak të gjykimit në mungesë, duke pretenduar mospasjen dijeni për procedimin dhe vendimin gjyqësor në ngarkim të tij. Vendimi është marrë në vitin 1999, kohë kur kërkuesi pretendon se ka qenë jashtë shtetit, në Greqi, nuk ka pasur asnjë lloj komunikimi me të afërmit e tij dhe nuk është vënë në dijeni për zhvillimin e këtij gjykimi dhe të vendimit të marrë ndaj tij. Në këto rrethana, ai nuk ka mundur të bëjë ankim, në Gjykatën e Apelit, kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

5. Kërkuesi ka pretenduar se është ndaluar në shtetin grek, sipas letërporosisë së gjykatës dhe prokurorisë shqiptare, për ekzekutimin e vendimit dhe vetë ai nuk ka ditur shkakun e ndalimit të tij nga autoritetet greke, të cilat nuk i kanë komunikuar vendimin. Në këtë mënyrë, sipas tij, gjatë kohës që ka qëndruar në Greqi, nuk ka pasur mundësi të njihej efektivisht me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe, në kushte të tilla, ka kërkuar të ekstradohet në Shqipëri. Kur është ekstraduar në Shqipëri, oficeri i policisë gjyqësore, i ka njoftuar vendimin gjyqësor që e kishte deklaruar atë fajtor dhe e kishte dënuar me 25 vjet burgim. Në këto kushte ai ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë kërkesën për rivendosje në afat të ankimit.

6. Përfaqësuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në këtë çështje, i ka kërkuar gjykatës rrëzimin e kërkesës për rivendosje në afat, pasi në rastin konkret, kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka ushtruar ankim bashkipandehuri tjetër Dhurim Tusha dhe, mbi ankimin e tij, çështja është shqyrtuar në shkallë të dytë, në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila, me vendimin nr. 15, datë 22.2.2000, ka vendosur: "*Lënien në fuqi të vendimit gjyqësor nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë edhe për sa i përket të pandehurit Adriatik Muharremi.*

7. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë,** me vendimin nr. 23-2016-2291, datë 2.12.2016, ka vendosur:*"Rrëzimin e kërkesës. Shpenzimet procedurale lihen në ngarkim të palës kërkuese. Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër brenda 10 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit".*

7.1 Gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera, ka arsyetuar se "*... kërkesa e të dënuarit Adriatik Muharremi për tu rivendosur në afat me qëllim për të ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nuk gjen mbështetje në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të rrëzohet nga gjykata. Rivendosja në afat si institut gjen rregullim në nenin 147 të KPP, sipas të cilit në qoftë se është dhënë vendim në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin. Kërkesa, sipas pikës 3 të këtij neni, në një rast të tillë, paraqitet brenda dhjetë ditëve nga dita kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për aktin. Pikërisht në rastin konkret, gjykimi është zhvilluar në mungesë të kërkuesit Adriatik Muharremi, i cili brenda dhjetë ditëve nga dita e marrjes dijeni efektivisht për vendimin gjyqësor, ka paraqitur kërkesën e tij për rivendosje në afat të ankimit, por gjykata çmon se neni 147 i KPP, nuk mund të gjejë zbatim në rastin konkret, pasi bashkëpandehuri Dhurim Tusha ka ushtruar ankim (apel) në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për të cilin kërkon të rivendoset në afat kërkuesi Adriatik Muharremi, dhe ankimi i tij (bashkëtëpandehurit Tusha) jo vetëm që nuk është lidhur me*

motive personale, por Gjykata e Apelit Gjirokastër, konform nenit 425 të KPP-së, e ka shqyrtuar çështjen në tërësi duke mos u kufizuar vetëm në shkaqet e paraqitura në ankim nga ky i pandehur dhe me vendimin e saj nr. 15, datë 22.2.2000, ka vendosur "lënien në fuqi" të vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për sa i përket edhe të pandehurit Adriatik Muharremi.

7.2 Një situate të tillë, i ka dhënë zgjidhje përfundimisht Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat, në vendimin njësues nr. 1, datë 20.1.2011, kanë përcaktuar se: "Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një të pandehuri. Pavarësisht sa më sipër, në çështjet penale me disa të pandehur, gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur ankimi i bashkëtëpandehurit nuk është pranuar për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1, të nenit 420 të KPP-së, si dhe kur gjykata është shprehur në vendim vetëm për ankimin e të pandehurit që ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe jo për gjithë të pandehurit. Pikërisht në rastin konkret, jo vetëm që bashkëtëpandehuri ka ushtruar ankim por ankimi i tij është pranuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, e cila në vendimin e saj është shprehur jo vetëm për të, por edhe për të pandehurin tjetër, kërkuesin Adriatik Muharremi, duke e lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për pjesën që i takonte këtij të pandehuri. Në këtë kuptim kërkesa për rivendosje në afat të ankimit kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë nuk mund të qëndrojë dhe si e tillë rrëzohet nga gjykata".

8. Kundër vendimit ka ushtruar ankim kërkuesi Adriatik Muharremi, duke kërkuar, ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit ndaj vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

9. **Gjykata e Apelit Gjirokastër,** me vendimin nr. 20-2017-38/10, datë 24.1.2017, ka vendosur: "*Lënien në fuqi të vendimit nr. 23-2016-2291, datë 2.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë*".

9.1. Gjykata e apelit, ndër të tjera, ka arsyetuar se " *Vendimi objekt ankimi është i drejtë dhe i bazuar në ligj e në prova, ndërsa shkaqet ankimore janë të pabazuara dhe u është dhënë përgjigje më së miri, nëpërmjet këtij vendimi. Mundësia e rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit, kundër një vendimi penal që ka marrë formë të prerë, parashikohet në pikat 1, 2, 3 të nenit 147 të KPP, ku përcaktohet se: "1. Prokurori, i pandehuri, palët private dhe mbrojtësit rivendosen në afatin e caktuar kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit fator ose të forcës madhore. 2. Në qoftë se është dhënë vendimi në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin". 3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda 10 ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast fator ose forcë madhore, kurse në rastet e parashikuara në paragrafin 2, nga dita kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për aktin…".*

9.2 Po kështu, në vendimin njësues nr. 2, datë 14.10.2002, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë shprehur se "... sipas nenit 147/2 të KPP, "Në qoftë se është dhënë vendimi në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim, kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin". Nga sa më sipër konstatohet se subjekti që mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë në mungesë është vetëm i pandehuri dhe se paraqitja e kësaj kërkese kushtëzohet me një afat 10 ditor, i cili fillon nga momenti kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për vendimin e dhënë në mungesë të tij. Mosrespektimi i këtij afati çon në humbjen e kësaj të drejte. Ky afat nuk është prekluziv, sepse KPP, në nenin 147/1/2 të tij, i jep mundësi palëve të legjitimuara në një proces penal të rivendosin në afat kryerjen e një veprimi procedural të humbur prej tyre, duke pasur barrën e provës, për të vërtetuar se kjo ka ardhur si rezultat i forcës madhore ose i rastit fator. Në bazë të nenit 43 të Kushtetutës: "Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe". Pra, e drejta e ankimit përbën një të drejtë kushtetuese dhe favorizon një proces ligjor të rregullt dhe të paanshëm.

9.3 Nga ana tjetër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin njësues nr. 1, datë 20.1.2011, kanë arritur në konkluzionin se "Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri. Pavarësisht sa më sipër, në çështjet penale me disa të pandehur, gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur ankimi i bashkëtëpandehurit nuk është pranuar për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të nenit 420 të KPP-së, si dhe kur gjykata është shprehur, në vendim, vetëm për ankimin e të pandehurit që ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe jo për gjithë të pandehurit."

9.4 Duke iu rikthyer rastit në shqyrtim, rezulton se vendimi penal nr. 51, datë 11.12.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është dhënë në kushtet e zhvillimit të gjykimit në mungesë të të pandehurit/kërkuesit Adriatik Muharremi, i cili sapo ka marrë dijeni efektivisht për të, pasi është ekstraduar në Shqipëri, më datë 5.7.2016, brenda afatit ligjor 10 ditor, më datë 11.7.2016, ka depozituar kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit. Por, sikurse rezulton nga aktet e tjera të administruara në dosjen gjyqësore, vendimi penal nr. 51, datë 11.12.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është ankimuar, më datë 21.12.1999, prej bashkëtëpandehurit Dhurim Tusha dhe, mbi bazën e këtij ankimi, më datë 2.2.2000, çështja është regjistruar për gjykim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, e cila ka konkluduar lidhur me këtë çështje, nëpërmjet vendimit penal nr. 15, datë 22.2.2000. Nga

përmbajtja e vendimit penal nr. 15, datë 22.2.2000, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, i cili ndodhet i administruar në dosje, rezulton se trupi gjykues, gjatë gjykimit të çështjes, nuk është ndalur vetëm në shkaqet e parashtruara në ankim prej të pandehurit Dhurim Tusha, por e ka shqyrtuar çështjen në tërësi, duke analizuar e konkluduar edhe për disponimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, lidhur me të pandehurin Adriatik Muharremi, duke i lënë në fuqi këto disponime.

9.5 Sa më sipër, ndryshe nga sa pretendohet në shkaqet ankimore, referuar përfundimit të Gjykatës së Lartë, në vendimin penal njësues nr. 1, datë 20.1.2011, në rrethanat kur ndaj vendimit nr. 51/1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është ushtruar ankim (apel) nga bashkëpandehuri (në të njëjtin procedim penal) Dhurim Tusha dhe Gjykata e Apelit Gjirokastër, nëpërmjet vendimit penal nr. 15, datë 22.2.2000, i ka marrë në shqyrtim shkaqet ankimore të parashtruara prej tij, duke mos u kufizuar vetëm në to, por duke e shqyrtuar në tërësi çështjen dhe duke u shprehur edhe për bazueshmërinë ligjore të konkluzioneve të atij vendimi dhe për bashkëtëpandehurin tjetër, kërkuesin Adriatik Muharremi, me të drejtë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë e ka rrëzuar kërkesën e kërkuesit Adriatik Muharremi për rivendosje në afat të ankimit ndaj vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të asaj gjykate. Vetëm në rast se ankimi i bashkëtëpandehurit Dhurim Tusha nuk do të ishte pranuar prej Gjykatës së Apelit Gjirokastër për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1, të nenit 420, të KPP, apo ajo gjykatë do të ishte shprehur në vendim vetëm për ankimin e të pandehurit Dhurim Tusha dhe jo edhe për bazueshmërinë ligjore të disponimeve të vendimit nr. 51/1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për të pandehurin Adriatik Muharremi, atëherë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë duhej të pranohej kërkesa e kërkuesit Adriatik Muharremi për rivendosje në afat të ankimit ndaj vendimit penal nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Në të tilla rrethana, nuk ka asnjë shkak që ta bëjë të cenueshëm vendimin objekt ankimi".

10. **Kundër vendimit nr. 20-2017-38/10, datë 24.1.2017, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, ka ushtruar rekurs kërkuesi Adriatik Muharremi**, duke kërkuar, prishjen e vendimit nr. 20-2017-38/10, datë 24.1.2017 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe vendimit nr. 23-2016-2291, datë 2.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Pranimin e kërkesës. Rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Prishjen e vendimit nr. 51, datë 11.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe kthimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues.

Në rekurs, në mënyrë të përmbledhur, janë parashtruar këto shkaqe:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, pa vlerësuar provat e lejuara për shqyrtim në raport me dispozitat procedurale penale që rregullojnë institutin e "rivendosjes në afat" të së drejtës së ankimit të subjekteve të procedimit penal, në keqzbatim të ligjit procedural penal, e ka rrëzuar kërkesën në kundërshtim me ligjin dhe provat e marra për shqyrtim.

- Neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionon se kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në kushtetutë parashikohet ndryshe. Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të individit, të sanksionuara nga Kushtetuta, konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH-ja garantohet vetëm përmes një procesi të rregullt gjyqësor, në themel të së cilit qëndron ofrimi i mundësive ligjore subjekteve të procedimit, jo vetëm për të siguruar ushtrimin e të drejtave procedurale gjatë procesit penal, por dhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit përfundimtar.

- E drejta e gjykatës për të lejuar rivendosjen në afatin e ankimit të subjektit realizohet vetëm në kushtet e nenit 147 të KPP-së.

- Instituti i rivendosjes në afat i krijon mundësi palëve në procesin penal që për shkaqe të përligjura dhe të parashikuara nga ligji, të kenë të drejtë të ankohen ndaj një vendimi në rast se nuk kanë mundur të ushtrojnë këtë të drejtë dhe kjo pamundësi ka ardhur për shkaqe të ligjshme, ku përfshihet dhe rasti i të pandehurit të gjykuar në mungesë që nuk ka mundur të paraqesë ankim.

- E drejta e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor konsiderohet e drejtë ngushtësisht personale e të pandehurit, fakt që kushtëzon domosdoshmërisht inicimin e procesit gjyqësor të rivendosjes në afatin e humbur vetëm nga ky subjekt ose personi i autorizuar prej tij, në format e parashikuara nga ligji, në bazë të nenit 410/1 të KPP-së.

- Në këtë kontekst, në rastet kur i pandehuri është gjykuar në mungesë, të drejtat procedurale të mbrojtësit të caktuar kryesisht gjatë gjykimit, kufizohen vetëm brenda kuadrit të procesit penal dhe ushtrimi i së drejtës së ankimit, duke përfshirë logjikisht dhe të drejtën për të kërkuar rivendosjen në afat, mund të realizohet vetëm në kushtet e pajisjes së tij me akt përfaqësimi nga vetë i pandehuri në bazë të nenit 410/2 të KPP-së.

- Vendimi nr. 51, datë 11.12.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka marrë formë të prerë dhe nga provat e administruara në gjykim rezulton se kërkuesi është vënë në dijeni të vendimit dhe ka paraqitur kërkesë për rivendosje në afat, siç vërtetohet nga kërkesa, e cila, pasi ka mbërritur pranë kësaj gjykate, është regjistruar dhe është kaluar për gjykim.

- Kërkesa për rivendosjen në afatin e ankimit të kërkuesit u gjykua nga tre gjyqtarë, pasi veprat penale për të cilat ai është dënuar është gjykuar gjithashtu nga tre gjyqtarë në zbatim të udhëzimeve të dhëna në vendimin njësues të Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 14.10.2002, i cili parashikon: "*Gjersa gjykimi i çështjes për akuzën në fjalë në të*

dyja gjykatat e faktit është bërë nga një trupë gjykuese të përbërë nga tre gjyqtarë, nuk mund të pranohet se kërkesa për rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimeve të dhëna të shqyrtohet me një gjyqtar".

- Kërkesa për rivendosje në afatin e ankimit është paraqitur nga kërkuesi. Nuk rezulton nga aktet që kërkuesi të ketë dijeni për vendimin e dënimit.

- Pretendimi i prokurorit se ankimi i paraqitur nga bashkipandehuri tjetër, në të njëjtin procedim penal Dhurim Tusha ka ezauruar rrugën e ankimit, është një pretendim në kundërshtim me ligjin procedural penal dhe me Kushtetutën e RSH-së, si dhe me të drejtën ndërkombëtare, për të drejtën e ankimit kundër një vendimi të formës së prerë. Çdo person ka të drejtë të ankohet dhe se e drejta e ankimit është një e drejtë personale dhe mund të ushtrohet vetëm nga personi mbajtës i kësaj të drejtë themelore ose nëpërmjet përfaqësuesit me prokurë dhe në asnjë mënyrë nëpërmjet bashkëtëpandehurit tjetër.

- Në kushtet kur gjykimi në gjykatën e shkallës së parë është bërë duke mos njoftuar të pandehurin si dhe kur prokurori, e më pas, edhe gjykata, kanë bazuar konkluzionet e tyre (lidhur me fajësinë e të pandehurit Muharremi) vetëm mbi thëniet e bashkëtëpandehurit tjetër Dhurim Tusha, i cili ka akuzuar të dënuarin Adriatik Muharremi për shfajësimin e vetes, thëniet e këtij janë të papërdorshme. Sa më sipër ky vendim është i pavlefshëm dhe për këtë shkak duhet të prishet dhe çështja të kthehet për rigjykim me tjetër trup gjykues.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 15.7.2022, ka vendosur inicimin e procedurës për ndryshim të praktikës gjyqësore në lidhje me vendimin njësues nr. 1, datë 20.1.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit "*Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri*".

12. Sipas konsideratës së Kolegjit Penal (në disponim të të cilit rezultoi trajtimi i rekursit të paraqitur nga i dënuari Muharremi kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër), vendimi njësues nr. 1, datë 20.1.2011, në çështjen e tretë të sentencës nuk është në harmoni me parimet kushtetuese dhe konventore (këto të fundit të "materializuara" në jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në vijim "GJEDNJ"), sepse cenon të drejtën e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës, lidhur me ankimin kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, duke kompromentuar, në të njëjtën kohë, edhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Për Kolegjin Penal, e drejta e ankimit, si një e drejtë themelore ekskluzive e personit në ngarkim të të cilit ka një çështje penale, gëzon mbrojtje si në legjislacionin e brendshëm, ashtu edhe në standardet ndërkombëtare të vendosura nga GJEDNJ-ja.

II. Qëndrimi i palëve në proces në lidhje me fillimin e procedurës për ndryshim të praktikës gjyqësore

13. ***Prokurori mbajti qëndrimin:***

13.1 Konkluzioni njësues, në mënyrën se si është formuluar, vjen ndesh dhe lejon hapësira për vendimmarrje që vijnë në kundërshtim me legjislacionin procedural penal, si dhe me standardet kushtetuese të gjykimit por edhe standardet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim "GJEDNJ"). Ai formulim vendos prevalencën e parimit të efektivitetit të procesit penal në dëm të të drejtave themelore të individit për një proces të rregullt ligjor duke orientuar njëkohësisht në mënyrë të gabuar gjithë praktikën gjyqësore.

13.2 Së pari, e drejta e ankimit, si një e drejtë themelore ekskluzive e personit në ngarkim të të cilit ka një çështje penale, ka gjetur dhe gjen mbrojtje të veçantë si në legjislacionin tonë të brendshëm ashtu dhe në standardet ndërkombëtare të vendosura nga GJEDNJ-ja. Kushtetuta, në nenin 43 të saj, parashikon se çdokush ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. E drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor, mbi bazën e parashikimit kushtetues, gjen zbatim edhe në dispozitat procedurale konkrete. Kjo e drejtë duhet kuptuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj.

13.3 Kërkesa për rivendosje në afat është një mjet procedural që i mundëson subjekteve të caktuar të ushtrojnë të drejtën e ankimit, të cilën nuk kanë pasur mundësi ta ushtrojnë brenda afateve ligjore, për shkaqe të pavarura prej tyre. Ky mjet procedural është parashikuar në nenin 147 të KPP-së, dispozitë e cila, përpara ndryshimeve ligjore, parashikonte se prokurori, i pandehuri, palët private dhe mbrojtësit, rivendosen në afatin e caktuar kur *"provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit fator ose të forcës madhore"*. Në pikën 2 të nenit 147 të KPP-së, parashikohej se "*në qoftë se është dhënë vendimi në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.".*

13.4 Aktualisht dispozita referuese e këtij instituti (pas ndryshimeve të kryera me ligjin nr. 35, datë 30.3.2017), neni 420/1 i KPP-së, në paragrafin e dytë të saj parashikon se *"kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të nenit*

351 të KPP-së, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin". Në kuptim të këtij neni, kërkesa për rivendosje në afat, duhet të tregojë se, pavarësisht se subjekti ka treguar të gjithë kujdesin e nevojshëm, depozitimi i ankimit brenda afatit ligjor, nuk ka qenë i mundur për shkaqe që nuk vareshin prej vullnetit të tij. Në rast se këto shkaqe konsiderohen të ligjshme prej gjykatës që shqyrton kërkesën krijohet mundësia për paraqitjen e ankimit prej palës, në kushtet e "ripërtëritjes" së afatit të ankimit. Ndërsa, në pikën 3 të këtij neni parashikohet afati i paraqitjes së kërkesës për rivendosjen në afat nga zhdukja e arsyes objektive, duke e kushtëzuar me ditën kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për vendimin.

13.5 Së dyti, si nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 1/2011 dhe, në të gjithë praktikën gjyqësore, ka një paqartësi mes dy instituteve të së drejtës procedurale penale, institutit të rivendosjes në afat të një ankimi dhe institutit të kufijve të shqyrtimit të ankimit. Ky konfondim ka bërë që koncepte të lidhura me kufijtë e shqyrtimit të një ankimi të përdoren padrejtësisht në arsyetime që lidhen me institutin e rivendosjes në afat të ankimit. Në përpjekjen tonë për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë në lidhje me objektin e shqyrtimit, do të dëshironim që kjo gjykatë të përqendrohej vetëm në institutin e rivendosjes në afat pasi, edhe pse në pamje të parë, korrelacioni procesual mes tyre është mjaft i ngushtë, në vetvete ato përfaqësojnë dy institute të ndryshme dhe kërkojnë dy disponime të ndryshme, bazuar në parashikime të ndryshme ligjore, si dhe në standarde të ndryshme gjykimi. Qysh në kohën e marrjes së vendimit njësues nr. 1/2011 ekzistonte e qartë baza ligjore për të argumentuar mbi këtë institut në mënyrën e duhur, arsyetim të cilin e gjejmë dhe në mendimin e pakicës, por ka qenë pikërisht trajtimi josistematik i instituteve të sipërpërmendura, i bërë nga ajo gjykatë, që e ka orientuar atë drejt konkluzioneve të njëjta të gabuara ose, në rastin më të mirë, të paplota.

13.6 Zhvillimi i mëtejshëm i praktikës gjyqësore bazuar dhe në standardet e GJEDNJ-së (*çështja Haxhia kundër Shqipërisë*) bëri të mundur të arrijmë në vendimin njësues nr. 1/2014 të kësaj gjykate, në lidhje me objektin e shqyrtimit kur ajo në çështjen e tretë që mori në shqyrtim, në pikën e dytë njësoi qëndrimin se "*Në çdo rast, i dënuari në mungesë, ka të drejtë të kërkojë rivendosje në afat për të ushtruar ankim në apel ose rekurs në Gjykatën e Lartë, përveç rasteve kur ka prova të mjaftueshme, se: (i) kishte dijeni për gjykimin e zhvilluar kundër tij: (ii) në mënyrë direkte ose të tërthortë, ka autorizuar familjarët për t'u ankimuar në apel; ose (iii) ka hequr dorë në mënyrë eksplicite nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm në gjykimin kundër tij, duke u fshehur nga drejtësia".* Po kështu, vendimi i mësipërm ka dalë dhe në konkluzione të tjera njësuese të rëndësishme mbi natyrën ekskluzive të së drejtës së ankimit. Konkluzionet njësuese të këtij vendimi u bënë pjesë e ndryshimeve të KPP-së, me ligjin nr. 35/2017 dhe më së shumti, në lidhje me objektin e shqyrtimit, u reflektuan në nenin 420/1 të KPP-së.

13.7 Megjithatë, në atë vendim, Gjykata e Lartë nuk mbajti një qëndrim të qartë në raportin që ky konkluzion njësues ka me konkluzionin njësues të vendimit nr. 1/2011, objekt shqyrtimi. Për pasojë, i takon Kolegjeve të Bashkuara që njëkohësisht me disponimin për ndryshimin e konkluzionit njësues, objekt shqyrtimi, të arsyetojë dhe mbi marrëdhënien që ky vendim do të ketë me qëndrime të ngjashme të mëparshme të kësaj gjykate.

13.8 Së treti, kjo gjykatë duhet të arsyetojë në mënyrë të qartë mbi raportin mes institutit të gjykimit në mungesë dhe dijenisë efektive mbi procesin penal si shkak për të disponuar mbi kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit. Ndërkohë që instituti i gjykimit në mungesë është një institut procesual që përfshin në vetvete zhvillimin e gjykimit pa praninë e të pandehurit si në rastin e dijenisë së tij mbi procesin dhe fshehjen ndaj drejtësisë, ashtu dhe padijenisë së plotë të tij mbi këtë proces. Instituti i dijenisë efektive, si një koncept i zhvilluar nga GJEDNJ-ja, nënkupton faktin se është e pamundur të konkludohet mbi faktin se i pandehuri ka pasur dijeni për procesin apo vendimin. E parashtrojmë këtë fakt pasi gjykojmë se, formulimi i bërë në nenin 420/1 të KPP-së nuk është i saktë kur parashikon: "*Kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të nenit 351 të këtij Kodi, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin*".

13.9 Sa më sipër, vendimi njësues nr. 1/2011, me konkluzionin se "*Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri"*, mohon të drejtën themelore të individit për akses në gjykatë dhe është në kundërshtim me parimet e procesit të rregullt ligjor. Ky rregullim vjen ndesh dhe me parashikimet kushtetuese sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, mbi të drejtën e ankimit në një gjykatë më të lartë, si dhe nenin 17 të Kushtetutës të cilat sanksionojne se "*çdo kufizim ligjor i të drejtave të njeriut nuk mund të tejkalojë kufizimet e vendosura nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut".* Parashikimet konventore e konsiderojnë në cilësinë e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pamundësinë e personit të gjykuar në mungesë, për të ankimuar vendimin e dënimit të tij, si dhe, në të njëjtën kohë, invokojnë detyrimin e shteteve firmëtare të kësaj Konvente për të garantuar të drejtën e personave të sipërcituar, për tu dëgjuar, në të njëjtat kushte, sikurse i gjykuari i pranishëm në proces.

13.10 Prokurori parashtroi qëndrimin se vendimi njësues nr. 1/2011 duhet të ndryshojë si vijon: "*Përfundimi*

i gjykimit të çështjes mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurve të tjerë, nuk mund të përbëjë shkak për mospranimin e kërkesës për rivendosje në afat të ankimit të të pandehurit që nuk ka bërë ankim, kur ai mund të vërtetojë mungesën e dijenisë efektive për vendimin ndaj të cilit kërkon të ushtrojë të drejtën e ankimit".

14. ***Mbrojtja mbajti qëndrimin:***

14.1 Në referim të argumenteve të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, në vendimin e datës 15.7.2022 për nisjen e procedurës për ndryshim të praktikës gjyqësore, në lidhje me vendimin njësues nr. 1, të vitit 2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit "*Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri*", mbrojtja kërkoi njësimin e praktikës gjyqësore si vijon:

14.2 "*Në çështjen penale të gjykuar nga Gjykata e Apelit apo Gjykata e Lartë, mbi ankimin e bashkëtëpandehurit apo të prokurorit, kur një nga bashkëtëpandehurit apo i pandehuri ka qenë në mungesë duhet të njihet e drejta e ankimit në rastet e paraqitjes së kërkesës në mënyrën dhe afatet e përcaktuara në ligj. Është Gjykata e Apelit apo Gjykata e Lartë që duhet dhe mund të vlerësojë shkaqet e parashtruara në ankim nëse janë apo jo të njëjta me shkaqet që janë gjykuar me ankimin e bashkëtëpandehurit apo të prokurorit. Kërkesa e të pandehurit në mungesë për rivendosje në afat të ankimit nuk mund të rrëzohet në rast se kërkesa është paraqitur në formën dhe afatin e përcaktuar në ligj*".

III. Vlerësimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

15. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (në vijim "Kolegjet e Bashkuara") pasi morën në shqyrtim në seancë gjyqësore, në praninë e palëve, argumentet e parashtruara nga relatorët mbi nevojën e ndryshimit të vendimit njësues penal nr. 1, datë 20.1.2011 të Kolegjeve të Bashkuara, si dhe pasi dëgjuan opinionin e prokurorit dhe mbrojtjes që mbajtën të njëjtin qëndrim për ndryshimin e vendimit të sipërcituar, vlerësojnë se praktika njësuese e deritanishme që, në një procedim me disa të pandehur, mohon të drejtën e të pandehurit të gjykuar në mungesë për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit, ndërkohë që çështja për pjesën që i përket këtij të pandehuri është gjykuar mbi bazën e shkaqeve të ankimit, jopersonale, të parashtruara prej bashkëtëpandehurit tjetër, duhet të ndryshohet.

16. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, pas ndryshimeve të vitit 2016, ka përcaktuar se "*Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet sipas ligjit".* Në kuptim të këtij rregullimi kushtetues do të duhet që procesi njësues apo ndryshues i praktikës gjyqësore dhe juridiksionalizimi i së drejtës të jetë një gjykim me karakter objektiv dhe me efekte *erga omnes,* i lidhur pazgjidhshmërisht me interesin publik dhe në funksion të garantimit të sigurisë juridike. Procesi i ndryshimit dhe njësimit të praktikës gjyqësore, nga njëra anë, dhe detyrimi i njëkohshëm i gjykatave të shkallëve më të ulëta për respektimin e vendimeve njësuese, nga ana tjetër, i shërbejnë konsolidimit të vlerave të qëndrueshmërisë dhe parashikueshmërisë në zbatimin e së drejtës, parandalimit të arbitraritetit në zbatimin e ligjit dhe garantimit të aplikimit të parimeve kushtetuese të sigurisë juridike dhe barazisë përpara ligjit.

17. Roli i gjyqtarit, detyra dhe misioni i tij kushtetues është të zhvillojë jurisprudencën nëpërmjet interpretimit teleologjik dhe, kur është e nevojshme, edhe të zgjeruar të normave juridike, me qëllim që të garantohet parimi i kushtetutshmërisë funksionale të rendit juridik normativ. Detyra dhe misioni kushtetues i interpretimit të ligjit në mënyrë të unifikuar i përket Gjykatës së Lartë, si autoriteti më i lartë gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Duke pasur një rol aktiv në interpretimin funksional të ligjit, për ta përputhur zbatimin e tij me të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme, me parimet e përgjithshme të së drejtës dhe me Kushtetutën, Gjykata e Lartë zbulon kuptimin e vërtetë të normave ligjore, bazuar në teknikat e gjithëpranuara të interpretimit të tyre. Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose të ndryshojë praktikën gjyqësore, nëpërmjet interpretimit të ligjit brenda misionit të saj për zhvillimin e jurisprudencës mbi të drejtën pozitive, me qëllim interpretimin e njëtrajtshëm të normave ligjore.

18. Një jurisprudencë gjyqësore e konsoliduar është dhe mbetet një detyrim për Gjykatën e Lartë, por, nga ana tjetër, në mënyrë të natyrshme jurisprudenca nuk mund të mos i nënshtrohet edhe evoluimit të saj. Nga kjo pikëpamje, ekziston mundësia që jurisprudenca, duke u plotësuar përmes konkluzionesh të reja interpretuese, edhe të ndryshohet, por ashtu siç thekson edhe Gjykata Kushtetuese "një ndryshim i praktikës mund të realizohet nëse ekzistojnë arsye të forta që do ta justifikojnë një ndërmarrje të tillë dhe vetëm në rastet kur kjo është e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar." (*shih më gjerë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 29.4.2010*).

19. Vendimet gjyqësore dhe, për më tepër, vendimet njësuese duhet të ndryshohen vetëm për rrethana të jashtëzakonshme. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ruajtja e qëndrimeve të mbajtura në vendimet e mëparshme

është në interes të stabilitetit, por edhe të legjitimitetit institucional. Nëse praktika gjyqësore e ka zbatuar për një periudhë të gjatë një normë ligjore, referuar një qëndrimi njësues, padyshim që kjo situatë nuk mund të mos vlerësohet si një rrethanë e rëndësishme për stabilitet jurisprudencial, por, nga ana tjetër, referimi vetëm në këtë argument për të mbajtur të pandryshuar vendimin njësues nuk do të thotë se i jepet një vlefshmëri më e lartë e aq më pak garanci të nivelit kushtetues.

20. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë ka theksuar se vendimet njësuese kanë fuqi detyruese për zbatimin në mënyrë të njëjtë të ligjit në çështje të njëjta ose të ngjashme, ndërsa ndryshimi i kësaj praktike nga Kolegjet e Bashkuara ndodh në raste më të kufizuara që diktohen nga nevoja për zgjidhjen e drejtë të çështjes konkrete, e cila nuk është e mundur të zgjidhet në kushtet e përplasjeve të jurisprudencës me interpretimet ligjore të mëparshme të vendimeve njësuese. Pra, janë pikërisht varësia e çështjes nga ndryshimi i praktikës njësuese dhe nevoja për ndryshim si dy kushte paraprake që vlerëson kolegji inicues dhe më pas Kolegjet e Bashkuara për të shqyrtuar në themel kërkesën për ndryshim. Mbi ekzistencën e këtyre dy kushteve, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 15.7.2022, ka vendosur fillimin e procedurës për ndryshim të praktikës gjyqësore në lidhje me vendimin njësues nr. 1, datë 20.1.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

21. Duke iu rikthyer çështjes, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se formulimi që është kryer për çështjen e tretë të sentencës së vendimit njësues nr. 1, datë 20.1.2011, ku konkludohet se "*Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri",* është i domosdoshëm të ndryshohet, pasi nuk përshtatet me parimet ligjore, por edhe me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së.

22. Në referim të shkaqeve të parashtruara në rekurs nga kërkuesi Adriatik Muharremi dhe të pretendimeve të parashtruara nga palët në gjykim, të cilët mbajnë qëndrimin se për zgjidhjen e çështjes duhet të ndryshohet praktika gjyqësore e njësuar vite më parë, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë të nevojshme që të mbahet parasysh kuptimi dhe zbatimi i dispozitave të KPP lidhur me institutin procedural të rivendosjes në afat. Kolegjet e Bashkuara theksojnë se ligjvënësi, në funksion të realizimit të qëllimit të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave të subjekteve të procedimit penal, në veçanti të të pandehurit dhe balancimit të tyre me interesin e përgjithshëm publik për një proces gjyqësor penal të karakterizuar nga objektiviteti, transparenca, ligjshmëria, ka përcaktuar në mënyrë të qartë në ligjin procedural penal afate për hartimin e akteve procedurale, të detyrueshme për t'u zbatuar si për gjykatat, ashtu edhe nga palët ndërgjyqëse në proces. Rivendosja në afat, që nënkupton kthim në momentin kur ka lindur e drejta për të përmbushur aktin procedural, është një institut përjashtimor, i mirëpërcaktuar dhe jo i mundshëm për t'u zbatuar për çdo lloj rasti. Instituti i rivendosjes në afat ka si qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, konkretisht, garantimin e ushtrimit të së drejtës nga palët në proces për të kundërshtuar një vendim në një gjykatë më të lartë, në ato raste, të përcaktuara në ligj, kur nuk ka qenë e mundur të ushtrohet kjo e drejtë brenda afatit ligjor. Rivendosja në afat lejon palën ndërgjyqëse të ushtrojë të drejtën e ankimit kundër vendimit të gjykimit të çështjes në themel, pavarësisht tejkalimit të afateve, të cilat për shkak të natyrës prekluzive, me plotësimin apo kalimin e tyre, kanë çuar në dekadencë të së drejtës së saj për të ushtruar këtë ankim.

23. Përpara ndryshimeve ligjore të KPP të vitit 2017, instituti i rivendosjes në afat parashikohej në Titullin III, Kreu III, neni 147, sipas të cilit "*1. Prokurori, i pandehuri, palët private dhe mbrojtësit rivendosen në afatin e caktuar kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit fator ose të forcës madhore. 2. Në qoftë se është dhënë vendimi në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin. 3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast ose forcë madhore, kurse në rastet e parashikuara në paragrafin 2, nga dita kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për aktin. Rivendosja në afat nuk lejohet më shumë se një herë për secilën palë për çdo shkallë të procedimit. 4. Për kërkesën vendos organi që procedon në kohën e paraqitjes së saj. 5. Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar. 6. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit".*

24. Rastet e parashikuara nga neni 147 i KPP për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit janë të lidhura ngushtësisht me arsyet objektive që kanë penguar palën në ushtrimin efektiv të së drejtës së saj. Kështu, pika 1 e nenit 147 të KPP parashikonte *"forcën madhore"* apo *"rastin fator",* me cilësinë e shkaqeve, verifikimi i prezencës të secilit prej tyre, (barra e provës për të provuar këtë prezencë rëndon mbi të pandehurin), përcaktonte të drejtën për t'u rivendosur në afat të ankimit kundër një vendimi penal. Ndërsa pika 2 e nenit 147 përcaktonte si kusht për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit për të pandehurin, rastin e "dhënies së vendimit në mungesë të tij", detyrimin e të pandehurit të gjykuar në mungesë, për të provuar padijeninë e tij lidhur me këtë vendim.

25. Shqyrtimi i kërkesës për vlerësimin e ekzistencës së kushteve dhe provave mbështetëse për verifikimin e tyre bëhet nga gjykata gjatë zhvillimit të një procesi, i cili nuk është i njëjtë me gjykimin e themelit të çështjes, ku

kërkuesi ka barrën për të provuar situatën në të cilën është ndodhur, që pa fajin e tij, e ka vendosur në pamundësi absolute për të respektuar afatet procedurale. Pra, gjatë shqyrtimit të kërkesës, ligjvënësi, ka normuar të drejtën e kërkuesit për t'u rivendosur në afat, vetëm nëse ai provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

26. Me ndryshimet ligjore të vitit 2017 (ligji nr. 35, datë 30.3.2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë"), është shtuar një dispozitë e re, konkretisht neni 420/1, ku parashikohet se: *"1. Palët rivendosen në afatin e ankimit kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit fator ose të forcës madhore. Kërkesa shoqërohet së bashku me ankimin, me pasojë mospranimi. 2. Kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të nenit 351, të këtij Kodi, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin. 3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast ose forcë madhore, kurse në rastet e parashikuara në paragrafin 2, të këtij neni, nga dita kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për vendimin. Rivendosja në afat nuk lejohet më shumë se një herë për secilën palë dhe për çdo shkallë të procedimit. 4. Nëse ankuesi nuk paraqitet në seancë, pa shkaqe të arsyeshme, megjithëse ka dijeni rregullisht për datën dhe orën e saj ose heq dorë nga kërkesa, gjykata vendos mospranimin e kërkesës. 5. Kur kërkesa pranohet dhe vendimi për të cilin është lejuar rivendosja në afat është një vendim dënimi me burgim, i cili është ekzekutuar, ekzekutimi i dënimit pezullohet. Gjykata urdhëron lirimin e menjëhershëm të të pandehurit në rast se nuk mbahet për shkak të një mase sigurimi me arrest. 6. Gjykata arsyeton vendimin brenda 5 ditëve nga shpallja e tij. 7. Kundër vendimit që lejon rivendosjen në afat bëhet ankim së bashku me vendimin përfundimtar. 8. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve. Gjykata e apelit shqyrton ankimin në dhomë këshillimi brenda 15 ditëve nga data e marrjes së akteve".*

27. Parashikimi i nenit 420/1 të KPP, si një dispozitë e posaçme, në kreun e "ankimeve", i diktuar nga standardi kushtetues dhe ai i GJEDNJ, në kuadër të zhvillimit të procesit të rregullt ligjor, përcakton palët, të cilat i drejtohen gjykatës për rivendosje në afat të ankimit, afatin kohor brenda së cilës kjo kërkesë paraqitet, si dhe mjetet e ankimit në rastet e pranimit/refuzimit të kërkesës për rivendosje në afat. Kjo dispozitë ka saktësuar edhe rastin se kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të nenit 351 të këtij Kodi (mosparaqitja ose mungesa e vullnetshme e të pandehurit), i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

28. Në kuptim të kësaj dispozite, kërkesa për rivendosje në afat duhet të argumentojë se, pavarësisht se subjekti ka treguar të gjithë kujdesin e nevojshëm, depozitimi i ankimit brenda afatit ligjor, nuk ka qenë i mundur për shkaqe që nuk vareshin prej tij. Në rast se këto shkaqe konsiderohen të ligjshme prej gjykatës që shqyrton kërkesën, ajo i mundëson palës të ushtrojë ankim, i cili duhet paraqitur bashkë me kërkesën për rivendosje në afat, duke kundërshtuar kësisoj vendimin dhe parashtruar shkaqet për të cilat ajo mendon se vendimi nuk është marrë në zbatim të ligjit. Ndërkohë që në pikën 2 të kësaj dispozite, parashikohet se kur gjykimi është zhvilluar në mungesë *(sipas parashikimeve të nenit 351, të këtij Kodi)*, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim, kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimmarrjen që ka përmbyllur këtë proces.

29. Përmbajtja e parashikimeve të nenit 420/1 të KPP, në raport me nenin 147 të këtij Kodi, (para ndryshimeve ligjore të vitit 2017), lidhur me të drejtën për rivendosjen në afat të ankimit, përsa i përket verifikimit të kushteve të pranueshmërisë së kërkesës së palëve, të pranishme në gjykim, që kanë humbur afatin e paraqitjes së ankimit ndaj vendimit, për shkak të shfaqjes së "rastit fator" apo të prezencës së "forcës madhore", paraqitet e njëjtë, ndërkohë që në rastin e verifikimit të kushteve të pranueshmërisë së kërkesës së paraqitur prej të pandehurit të gjykuar në mungesë, paraqitet e ndryshme. Në dispozitën para ndryshimeve ligjore (neni 147 i KPP) në paragrafin e dytë parashikohej "gjykimi në mungesë" si shkak për paraqitjen e kërkesës për rivendosje në afat, ndërsa sipas dispozitës së re, konkretisht, nenit 420/1 të KPP, paragrafi i dytë, parashikohet "*kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të nenit 351 të këtij Kodi"*. Në terma të tjera, kur gjykimi është zhvilluar në kushtet e "mungesës së vullnetshme" të të pandehurit", e barazuar kjo "mungesë" me "praninë" sipas përcaktimit të paragrafit të tretë të nenit 351 të KPP, këtij të fundit, i garantohet e drejta për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit ndaj vendimit të dhënë, në konkluzion të gjykimit, të zhvilluar në "prani" të tij (pa prezencën fizike), në kushtet kur, gjithsesi, nuk ka disponuar materialisht vendimin objekt i ankimit.

30. Sakaq, rastet e tjera, të mungesës së mirëfilltë të të pandehurit, për shkak të padijenisë, (përfshirë edhe rastet e arratisjes, shmangies së qëllimshme të të pandehurit, nëpërmjet fshehjes prej pasojave të procedimit penal të regjistruar ndaj tij), të përcaktuara në nenin 352 të KPP, janë përfshirë në strukturën e nenit 450/1, shkronja "e", në cilësinë e shkaqeve mbështetëse të kërkesës për rishikimin e vendimit të "formës së prerë", nën statusin e "gjësë së gjykuar". Risi e nenit 420/1 të KPP është edhe parashikimi në paragrafin e parë, i shoqërimit të kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit, së bashku me ankimin, me pasojë mospranimi.

31. Duke ballafaquar të dy situatat procedurale të sipërcituara, në funksion të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm lidhur me kualifikimin e kërkesës objekt gjykimi, konsiderohet se gjen zbatim neni 147/2 i KPP-së

(para ndryshimeve ligjore të vitit 2017), për sa kohë që kërkesa për rivendosje në afat të ankimit është gjykuar nga gjykatat e shkallëve më të ulëta, në kushtet dhe mbi bazën e përcaktimeve të kësaj dispozite. Rezulton se rekursi i paraqitur prej kërkuesit pranë Gjykatës së Lartë është depozituar më datë 9.2.2017, pra përpara ndryshimeve ligjore në KPP, me ligjin nr. 35/2017. Po kështu, referuar nenit 38/2 të ligjit nr. 41/2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", parashikohet se: "*rekurset e paraqitura në Gjykatën e Lartë (të pashqyrtuara) konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet në fuqi në kohën e depozitimit të tyre*".

32. Lidhur me institutin e rivendosjes në afat, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin njësues penal nr. 1, datë 20.1.2011, kanë parashtruar për shqyrtim këto pyetje:

- Pasi çështja është shqyrtuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, a ka të drejtë i pandehuri ose mbrojtësi i tij të kërkojë rivendosjen në afat për të ushtruar rekurs ndaj të njëjtit vendim të Gjykatës së Apelit, nëse i pandehuri pretendon se nuk është vënë në dijeni të vendimit? E njëjta pyetje shtrohet edhe në rastin kur i pandehuri pretendon të rivendoset në afat për të drejtën e Apelit.

- Nëse gjykata më e lartë vendos mospranimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës më të ulët për shkak të kalimit të afatit, a mund të kërkohet rivendosje në afat për të ushtruar ankim ndaj të njëjtit vendim?

- Në rastin e më shumë se një të pandehuri, kur çështja shqyrtohet mbi bazën e ankimit të një pjese të tyre, të pandehurve që nuk kanë ushtruar të drejtën e ankimit, a u lind kjo e drejtë pasi vihen në dijeni të vendimit, nëse gjykata më e lartë në përfundim është shprehur për të gjithë të pandehurit bashkë?

32.1 Në lidhje me çështjen e parë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në përfundimin se "*Pasi çështja është shqyrtuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, në mungesë të të pandehurit, ky i fundit ose mbrojtësi i tij, nuk mund të kërkojë rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar rekurs ndaj të njëjtit vendim për të cilin Kolegji është shprehur njëherë, me pretendimin se i pandehuri nuk është vënë në dijeni të vendimit. I njëjti qëndrim mbahet edhe në rastin e kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës për të bërë apel pasi çështja është shqyrtuar në gjykatën e apelit*".

32.2 Në lidhje me çështjen e dytë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në përfundimin se *"Në rastet kur gjykata më e lartë ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës më të ulët për shkak të kalimit të afatit, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të kërkojnë rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar ankim ose rekurs ndaj të njëjtit vendim"*.

32.3 Në lidhje me çështjen e tretë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në përfundimin se "*Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri.*

Pavarësisht sa më sipër, në çështjet penale me disa të pandehur, gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur ankimi i bashkëtëpandehurit nuk është pranuar për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të nenit 420 të KPP-së, si dhe kur gjykata është shprehur në vendim vetëm për ankimin e të pandehurit që ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe jo për gjithë të pandehurit".

33. Lidhur me çështjen e parë të vendimit njësues nr. 1, datë 20.1.2011, Kolegjet e Bashkuara, kanë arritur në konkluzionin se, pasi çështja është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit apo Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, në mungesë të të pandehurit, ky i fundit, ose mbrojtësi i tij nuk mund të kërkojë rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar ankim apo rekurs, ndaj të njëjtit vendim të Gjykatës së Apelit apo Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me pretendimin se i pandehuri nuk është vënë në dijeni të vendimit. Në këtë rast, Gjykata e Apelit apo Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ka shqyrtuar ankimin/rekursin në themel (kontrollin e ekzistencës ose jo të shkaqeve të ankimit/rekursit). Kolegjet e Bashkuara konstatojnë se, edhe pse ankimi apo rekursi i të pandehurit është shqyrtuar në themel, ankimi apo rekursi mund të jetë ushtruar nga mbrojtës i palegjitimuar, sikurse mund të jetë mbrojtësi i caktuar nga familjarët, duke u gjendur në situatën ku i pandehuri i gjykuar në mungesë nuk mund të kërkojë rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar ankim apo rekurs.

34. Kolegjet e Bashkuara sjellin në vëmendje se kjo problematikë ka gjetur trajtim më të zgjeruar dhe të qartësuar në vendimin njësues nr. 1, datë 10.3.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku janë shtruar për zgjidhje çështjet:

- Në kuptim të nenit 48/3 të KPP-së, në cilat raste një i afërm i të pandehurit mund të zgjedhë mbrojtës?

- Në vështrim të përcaktimit ligjor të bërë nga ligjvënësi në nenin 50, pika 1, e 410 të KPP-së, a është e drejta për të bërë ankim, një e drejtë e cila i rezervohet personalisht të pandehurit?

- A mundet i pandehuri ta delegojë të drejtën për të bërë ankim te mbrojtësi apo te një person tjetër? Nëse po, cilat janë mënyrat dhe forma e përcaktuar nga ligji për këtë delegim?

- A legjitimohet mbrojtësi i caktuar nga gjykata, apo i zgjedhur nga një i afërm i të pandehurit, i cili është gjykuar në mungesë,

sipas përcaktimit të bërë nga ligjvënësi në pikën 3 të nenit 48 të KPP-së, të bëjë ankim kundër vendimit të dënimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë?

34.1 Pikërisht, në vendimin njësues nr. 1, datë 10.3.2014, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me çështjen e parë kanë konkluduar, se: *"... përcaktimi i ligjit se i afërmi i të pandehurit ka të drejtë të zgjedhë mbrojtës, në kuptim të pikës 3 të nenit 48 të KPP-së, vetëm në rastet kur i pandehuri gjendet i izoluar, në kushtet e kufizimit të lirisë personale është i qartë dhe nuk ka nevojë për interpretim njësues. Në këtë rast, mbrojtësi i zgjedhur nga të afërmit e personit në kushtet e kufizimit të lirisë personale, do të konsiderohet, për efekt të ligjit, si mbrojtës i zgjedhur". Pra, mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët do të pranohet nga gjykata duke e legjitimuar, por duke i njohur tagrat e mbrojtësit të caktuar, që janë të drejtat procedurale që ka mbrojtësi në procesin penal me përjashtim të të drejtave që ligji ia njeh si të drejta ekskluzivisht personale të pandehurit".*

34.2 Në lidhje me çështjen e dytë, Kolegjet e Bashkuara, kanë konkluduar, se: "*E drejta për të bërë ankim, në vështrim të përcaktimit ligjor të bërë nga ligjvënësi në nenin 50, pika 1 e 410 të KPP-së, është një e drejtë e cila i rezervohet personalisht të pandehurit. Në rastin e të pandehurit të cilit i është caktuar kujdestar, kjo e drejtë i përket këtij të fundit, i cili mund ta ushtrojë personalisht ose nëpërmjet mbrojtësit".*

34.3 Lidhur me çështjen e tretë Kolegjet e Bashkuara kanë konkluduar se: "*I pandehuri lejohet që personalisht të delegojë të drejtën për të bërë ankim te mbrojtësi. Akti i delegimit mund të jetë në të njëjtin akt me të cilin bëhet zgjedhja e mbrojtësit, ose në një akt të veçantë. I pandehuri lejohet gjithashtu të delegojë të drejtën për të bërë ankim te mbrojtësi, duke e ushtruar këtë vullnet nëpërmjet delegimit te një i afërm. I afërmi nuk zgjedh mbrojtës dhe as nuk delegon të drejtën për ankim në mënyrë autonome. Ankimi i mbrojtësit të zgjedhur nga të afërmit lejohet vetëm nëse provohet, se: (i) zgjedhja e mbrojtësit; dhe (ii) delegimi i mbrojtësit për të ushtruar ankim, është rezultat i vullnetit të plotë dhe eksplicit të titullarit të kësaj të drejte, që është i pandehuri. Mënyra dhe forma e përcaktuar nga ligji për këtë delegim është ajo e përcaktuar në pikën 2 të nenit 48 të KPP-së".*

34.4 Së fundmi, në lidhje me çështjen e katërt Kolegjet e Bashkuara kanë konkluduar se "*Mbrojtësi i caktuar kryesisht nga gjykata, apo i zgjedhur nga një i afërm i të pandehurit, i cili është gjykuar në mungesë, sipas përcaktimit të bërë nga ligjvënësi në pikën 3, të nenit 48 të KPP-së, nuk legjitimohet të bëjë ankim kundër vendimit të dënimit të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë. Në çdo rast, i dënuari në mungesë ka të drejtë të kërkojë rivendosje në afat për të ushtruar ankim në apel ose rekurs në Gjykatën e Lartë, përveç rasteve kur ka prova të mjaftueshme, se: (i) kishte dijeni për gjykimin e zhvilluar kundër tij; (ii) në mënyrë direkte ose të tërthortë, ka autorizuar familjarët për t'u ankimuar në apel; ose (iii) ka hequr dorë në mënyrë eksplicite nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm në gjykimin kundër tij, duke u fshehur nga drejtësia".*

35. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, vendimi njësues nr. 1, datë 20.1.2011, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku në interpretim të çështjes së parë ka konkluduar se: "*Pasi çështja është shqyrtuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, në mungesë të të pandehurit, ky i fundit ose mbrojtësi i tij nuk mund të kërkojë rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar rekurs ndaj të njëjtit vendim për të cilin Kolegji është shprehur njëherë, me pretendimin se i pandehuri nuk është vënë në dijeni të vendimit (i njëjti qëndrim mbahet edhe në rastin e kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës për të bërë apel pasi çështja është shqyrtuar në gjykatën e apelit)",* ka humbur aktualitetin dhe efikasitetin, në kushtet kur Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin njësues nr. 1, datë 10.3.2014, kanë konkluduar se *"Mbrojtësi i caktuar nga gjykata, apo i zgjedhur nga një i afërm i të pandehurit, i cili është gjykuar në mungesë, sipas përcaktimit të bërë nga ligjvënësi në pikën 3, të nenit 48, të KPP-së, nuk legjitimohet të bëjë ankim kundër vendimit të dënimit të dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë. Në çdo rast, i dënuari, në mungesë, ka të drejtë të kërkojë rivendosje në afat për të ushtruar ankim në apel ose rekurs në Gjykatën e Lartë, përveç rasteve kur ka prova të mjaftueshme se: (i) kishte dijeni për gjykimin e zhvilluar kundër tij; (ii) në mënyrë direkte ose të tërthortë, ka autorizuar familjarët për t'u ankimuar në apel; ose (iii) ka hequr dorë në mënyrë eksplicite nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm në gjykimin kundër tij, duke u fshehur nga drejtësia".*

36. Në lidhje me çështjen e dytë të vendimit njësues nr. 1, datë 20.1.2011, ku është arritur në përfundimin se: *"Në rastet kur gjykata më e lartë ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës më të ulët për shkak të kalimit të afatit, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të kërkojnë rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar ankim ose rekurs ndaj të njëjtit vendim",* Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ky qëndrim është i drejtë dhe nuk bie ndesh me dispozitat procedurale penale.

37. Sakaq, Kolegjet e Bashkuara duke evidentuar qëndrimin e mbajtur në vendimin njësues nr. 1, datë 10.3.2014, që përligj të drejtën e pamohueshme të të gjykuarit në mungesë për tu rivendosur në afatin e ankimit (me përjashtim të rasteve të parashtruara në vendim), konstatojnë se në këtë vendim njësues, Kolegjet e Bashkuara nuk janë shprehur lidhur me të drejtën e të pandehurit, që nuk ka ushtruar ankim për shkak të padijenisë (të mospjesëmarrjes në gjykim), për të rivendosur në afat të drejtën e ankimit, ndaj vendimit të gjykimit të tij në mungesë, të prekluduar për shkak të gjykimit të çështjes në apel, mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurit në të njëjtin procedim.

38. Duke iu rikthyer rastit konkret, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se interpretimi i kryer për çështjen e tretë në vendimin njësues nr. 1, datë 20.1.2011, nëpërmjet të cilit është konkluduar se "*Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri*", nuk është në harmoni me nenin 43 të Kushtetutës dhe me standardet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Referuar jurisprudencës së kësaj gjykate konsiderohet cenim i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pamundësia e personit të gjykuar në mungesë, për të ankimuar vendimin e dënimit të tij, por edhe për të garantuar të drejtën e personave të sipërcituar, për t'u dëgjuar, në të njëjtat kushte, sikurse i gjykuari i pranishëm në proces, edhe në kushtet e "investimit" të gjykatës që trajton situatën procesuale të të pandehurit, të gjykuar në mungesë, (apo që nuk ka ushtruar ankim) mbi bazën e "shtrirjes/zgjerimit të ankimit të papersonalizuar të paraqitur prej të gjykuarit të pranishëm, pra, në thelb, për të trajtuar këtë situatë edhe për pjesën që u takon bashkëtëpandehurve të tjerë që nuk kanë ushtruar ankim brenda kufijve që referojnë shkaqet (jopersonale) të ngritura në ankim" (përcaktimi i nenit 425/1 të KPP-së).

39. Kushtetuta, në nenin 43 të saj, parashikon se "*çdokush ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe*". E drejta e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor duhet kuptuar si një mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët, në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj *(shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 5, datë 6.3.2009)*. Për këtë qëllim, dispozitat procedurale parashikojnë si mjete të zakonshme ankimi apelin, rekursin në Gjykatën e Lartë dhe si mjet të jashtëzakonshëm (për sa kohë që bëhet fjalë për ankimimin e një vendimi të formës së prerë) kërkesën për rishikim (neni 407 i KPP-së), duke parashikuar dhe afatet procedurale për ushtrimin e këtyre mjeteve të ankimit. E drejta e aksesit në gjykatë, ashtu si dhe e drejta e ankimit, si të drejta kushtetuese, mund t`u nënshtrohen kufizimeve deri në atë masë sa të mos cenojnë thelbin e këtyre të drejtave *(shih vendimin nr. 17, datë 19.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, Kolegjet e Bashkuara, vlerësojnë se mjetet procedurale të ofruara nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika duhet të tregojnë se ato kanë qenë efektive. E drejta e ankimit nuk është absolute. Kjo e drejtë mund të jetë pjesë e kufizimeve në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës dhe në respektim të standardeve që ky nen përcakton. Në funksion të garantimit të së drejtës për tu ankuar ndaj një vendimi gjyqësor penal neni 43 i Kushtetutës vihet në zbatim nga nenet 407–421 të KPP-së, që disiplinojnë të drejtën e ushtrimit të ankimit. Mbi bazën e këtyre dispozitave, është ligji ai që cakton rastet në të cilat vendimet e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e përshtatshëm ankimues, që mund të jetë apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë ose kërkesa për rishikim, duke parashikuar aspektet formale dhe afatet procedurale për ushtrimin e këtyre mjeteve ankimuese. Në nenin 407 të KPP-së të titulluar "Rastet dhe mjetet e ankimit" parashikohet shprehimisht: "*1. Ligji cakton rastet në të cilat vendimet dhe urdhrat e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit. 2. Ankimi i urdhrave të gjykatës, kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, mund të bëhet vetëm me ankimin kundër vendimit. 3. Mjetet e ankimit janë: apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim 4. E drejta e ankimit i takon vetëm atij që ligji ia njeh shprehimisht. Kur ligji nuk bën dallim ndërmjet palëve, kjo e drejtë i takon secilës prej tyre. 5. Kur ankimi bëhet në gjykatën jokompetente, ajo ia dërgon aktet gjykatës kompetente*".

41. Referuar jurisprudencës kushtetuese, e drejta e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale penale është pjesë e së drejtës së të pandehurit për të pasur akses në gjykatë. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesi në gjykatë është para së gjithash një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës.

42. Rregullat e përgjithshme të ankimit të përcaktuara në nenet 407 e vijues të KPP-së, parashikojnë, midis të tjerash, subjektet të cilat mund të ushtrojnë të drejtën e ankimit dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes nga gjykata që e shqyrton atë, duke e trajtuar mjetin "ankim" në kuadrin e një të drejte me karakter individual (pjesë esenciale e së drejtës së mbrojtjes) që sjell pasoja të caktuara vetëm për personin që e ushtron atë. Në rastet kur ka më shumë se një të pandehur, karakteri individual i ankimit vazhdon të ruhet, por për shkak të specifikës së këtij lloji gjykimi – *simultaneus processus* – ligji parashikon një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, kur, në nenin 416 të KPP-së

parashikon se: "*Ankimi i bërë nga një i pandehur, kur nuk bazohet vetëm në motive personale, vlen edhe për të pandehurit e tjerë...*".

43. Në funksion të interpretimit të paragrafit të parë të nenit 416 të KPP-së, që bën fjalë për zgjerimin e efekteve të ankimit, të paraqitur prej një të pandehuri, edhe për bashkëtëpandehurit e tjerë, që nuk kanë ushtruar ankim, Kolegjet e Bashkuara theksojnë se këto "efekte" presupozojnë të drejtën e bashkëtëpandehurve që nuk kanë ushtruar ankim për të përfituar nga vendimmarrja e gjykatës me karakter favorizues ndaj të pandehurit që ka ushtruar ankim. Dispozita e mësipërme, që bën fjalë për zgjerimin e efekteve të ankimit të ushtruar nga një i pandehur edhe për të pandehurit e tjerë (në rastet kur nuk ka ankim nga prokurori për këta bashkëtëpandehur), të cilët nuk kanë ushtruar ankim, do të ketë efekt dhe do të aplikohet, vetëm në kushtet kur favorizojnë *in-bonam parte* - pozitën e bashkëtëpandehurit që nuk ka ushtruar ankim dhe që, eventualisht, nuk është i pranishëm në atë gjykim, por jo kur e dëmtojnë atë.

44. Gjykata, që investohet për tu prononcuar, mbi bazën e ankimit të të pandehurit, edhe për pjesën e vendimit që i përket bashkëtëpandehurve të cilët nuk kanë ushtruar ankim (mbi bazën e përcaktimit të nenit 416/1 të KPP-së, gjithnjë, kur ky ankim, nuk bazohet vetëm në motive personale, që ka rezultuar i njëjtë edhe pas ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017), nuk mund të përdorë prej paraqitjes së këtij ankimi diskrecionin *in malam parte*, pra, në dëm të interesave të personit të gjykuar që nuk ka ushtruar ankim, për më tepër, si në rastin konkret, jo të pranishëm në gjykim. Mbi këtë bazë arsyetimi, vendimmarrja e gjykatës dhe prononcimi i saj edhe për bashkëtëpandehurin e gjykuar në mungesë që nuk ka ushtruar ankim, duke i hequr mundësinë për të ushtruar një të drejtë themelore kushtetuese, siç është ajo e ankimit të vendimit, konsiderohet në shkelje të hapur të kësaj të drejte.

45. Në një interpretim të kombinuar të dispozitave që legjitimojnë gjykatën (e apelit), në një procedim penal me disa të pandehur, për të disponuar mbi ankimin e ushtruar nga i pandehuri edhe mbi bashkëtëpandehurit e tjerë që nuk kanë ushtruar ankim (për më tepër kur, këta të fundit rezultojnë të gjykuar në mungesë) dhe konkretisht të nenit 425/1 të KPP-së, përpara ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, si dhe të nenit 416/1 të KPP-së, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se qëllimi i ligjvënësit për të ndërhyrë në këtë "hapësirë të padepërtueshme", justifikohet vetëm në kushtet e interpretimit të normave të sipërcituara në favor të situatës procesuale të këtyre bashkëtëpandehurve, të ndikimit të këtyre shkaqeve sikurse për të pandehurin që ka ushtruar ankim, në drejtim të lehtësimit të kësaj pozite.

46. Në terma të tjerë, ndërhyrja e gjykatës për të disponuar edhe lidhur me pjesën e vendimit (në një procedim me disa të pandehur) që i përket bashkëtëpandehurve që nuk kanë ushtruar ankim (në kushtet e zhvillimit të gjykimit pa praninë e tyre, në mungesë), mbi bazën e "shkaqeve, jopersonale, të ngritura në ankim" prej të pandehurit që ka ushtruar ankim të pranishëm në gjykim, sipas vlerësimit të Kolegjeve të Bashkuara nuk paragjykon apriori, për asnjë moment, të drejtën e bashkëtëpandehurit (joankimues, për shkak të padijenisë) për të paraqitur kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, në përputhje me përcaktimet e nenit 147/2 (para ndryshimeve të realizuara me ligjin nr. 35/2017) dhe të nenit 420/1, paragrafi i dytë të KPP-së.

47. Duke ju referuar parashikimeve të nenit 425/1 të KPP-së (përpara ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017) sipas të cilit: "*Gjykata e apelit e shqyrton çështjen në tërësi dhe nuk kufizohet vetëm me shkaqet e paraqitura në ankim. Ajo shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtëpandehurve që nuk kanë bërë ankim brenda kufijve që referojnë shkaqet e ngritura në ankim*", Kolegjet e Bashkuara konstatojnë se përmbajtja e kësaj dispozite lidhet ngushtësisht me parashikimin e nenit 416/1 të KPP-së që parashikon shtrirjen apo zgjerimin e "hapësirës" së diskrecionit gjykues të gjykatës së apelit, për të disponuar mbi ankimin e ushtruar nga bashkëipandehuri, edhe për pjesën takuese të bashkëtëpandehurve që nuk kanë ushtruar ankim, *brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në ankim*, në rastin kur ankimi i bërë nga bashkëipandehuri nuk bazohet vetëm në motive personale.

48. Me ligjin nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në KPP", neni 425 i KPP-së parashikon se "*Gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, si dhe për shkaqet e ngritura në ankim që nuk bazohen në motive personale, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtëpandehurve që nuk kanë bërë apel*". Në nenin 425/1 të KPP-së përpara ndryshimeve ligjore, parashikohej se gjykata e apelit e shqyrtonte çështjen në tërësi dhe nuk kufizohej vetëm në shkaqet e paraqitura në ankim (me përjashtim të rastit kur ajo shqyrtonte edhe pjesën që u takon bashkëtëpandehurve që nuk kanë ushtruar ankim "brenda kufijve që referojnë shkaqet e ngritura në ankim"), ndërsa dispozita aktuale (neni 425/1 i KPP-së) parashikon se kufijtë e shqyrtimit të gjykatës së apelit janë vetëm mbi bazën e shkaqeve të ngritura në ankim, me përjashtim të rasteve kur konstaton çështje ligji, të cilat shqyrtohen kryesisht. Sipas nenit 425/1 (të ndryshuar), shqyrtimi në gjykatën e apelit kufizohet brenda shkaqeve të paraqitura në ankim, të cilat do të shqyrtohen edhe për bashkëtëpandehurit që nuk kanë ushtruar ankim, kur shkaqet e ngritura në ankim nuk bazohen në motive personale.

49. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, edhe pas ndryshimeve ligjore të vitit 2017, me përjashtim të kufijve të shqyrtimit të çështjes në apel, situata mbetet e njëjtë lidhur me bashkëtëpandehurit që nuk kanë ushtruar ankim. Sipas dispozitës së pandryshuar, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtëpandehurve që nuk kanë ushtruar ankim, brenda shkaqeve të ngritura në ankim nga bashkëtëpandehurit e tjerë. Po kështu, edhe në dispozitën aktuale (neni 425/1), gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtëpandehurve që nuk kanë ushtruar ankim brenda shkaqeve të paraqitura në ankim. Për rrjedhojë, shqyrtimi i çështjes në apel për pjesën që u takon bashkëtëpandehurve që nuk kanë ushtruar ankim bëhet brenda shkaqeve të ankimit të bashkëpandehurit që ka ushtruar ankim, ndaj sentenca e tretë e vendimit njësues nr. 1, datë 20.1.2011 mohon të drejtën e bashkëtëpandehurve (të gjykuar në mungesë) që nuk kanë ushtruar ankim, për të kërkuar rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, në rastet kur parashtrohen shkaqe të ndryshme nga ato të marra në shqyrtim nga gjykata e apelit, e inicuar nga ankimi i bashkëtëpandehurve të tjerë.

50. Mbi këtë bazë arsyetimi, sentenca e tretë e vendimit njësues nr. 1, datë 20.1.2011, që ndalon paraqitjen e kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit nga i pandehuri, që nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar vetëm mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurit (të pranishëm në gjykim) dhe kur shkaqet e ankimit nuk rezultojnë të karakterit personal, konsiderohet e paarsyeshme, qartësisht e paimponuar prej përmbajtjes së dispozitave (neneve 416/1 dhe 425/1 të KPP-së).

51. Sakaq, Kolegjet e Bashkuara gjejnë me vend të evidentojnë në mbështetje të konkluzionit të formësuar me këtë rast, edhe evolimin e tyre gradual (në raport me vendimin njësues nr. 1, datë 20.1.2011), në qëndrimin e mbajtur në vendimin njësues, nr. 1, datë 10.3.2014, kur, në paragrafin nr. 65, të këtij vendimi, theksojnë se "*Neni 416 i KPP-së, përbën një rast përjashtimor e të jashtëzakonshëm, në të cilin ankimi i bërë nga një bashkëtëpandehur, kur nuk bazohet vetëm në motive personale, vlen edhe për bashkëtëpandehurit e tjerë, dënimi i të cilëve ka marrë formën e prerë. Sidoqoftë, shtrirja e apelit edhe për bashkëtëpandehurin që nuk ka paraqitur ankim në apel në kohë (pavarësisht nëse ka qenë i gjykuar në mungesë apo jo), nuk vlen in peius. Ajo është e kushtëzuar nga suksesi i ankimit të bashkëtëpandehurit që ka paraqitur apelin në kohë. Të dy këto kushte, i) motivi jopersonal i ankimit dhe ii) suksesi i ankimit, janë kumulative për prishjen e dënimit të formës së prerë të bashkëtëpandehurit jo ankimues".*

52. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se paragrafi i parë i nenit 416 të KPP-së, ku parashikohet se: "*Ankimi i bërë nga një i pandehur, kur nuk bazohet vetëm në motive personale, vlen edhe për të pandehurit e tjerë ...*", nuk mund të shërbejë "*in peius"*, për të mohuar të drejtën e bashkëtëpandehurit (të gjykuar në mungesë) që nuk ka ushtruar ankim, për t'u rivendosur në afat të së drejtës së ankimit, kur pretendon shkaqe të ndryshme nga ato të marra në shqyrtim nga gjykata nëpërmjet ankimit të bashkëtëpandehurve të tjerë (për shkaqe jopersonale të këtyre të fundit), duke iu njohur në këtë mënyrë e drejta për të qenë prezent në gjykim dhe për tu dëgjuar, në të njëjtat kushte, sikurse i gjykuari i pranishëm në proces.

53. E drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor, janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. E drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë ligjor *(shih, GJEDNJ Ektabani kundër Suedisë, 1988; Vaundelle kundër Francës, 2003)*. Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. (*shih, GJEDNJ T and V kundër Mbretërisë së Bashkuar).*

54. Vlen të theksohet se në këtë aspekt, e drejta për një proces të rregullt ligjor, nuk do të kishte asnjë kuptim pa siguruar pjesëmarrjen e palëve në gjykim. Kjo është një praktikë tashmë e njohur dhe e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas së cilës, do të ishte pa vlerë përshkrimi në detaje i garancive procedurale të palëve në proces në rast se atyre nuk do t'u sigurohej ajo që në fakt bën të mundur respektimin e këtyre të drejtave dhe që është pjesëmarrja në gjykim (*shih vendimin nr. 109, datë 28.5.2002 i Gjykatës Kushtetuese*).

55. Gjithashtu, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka theksuar si elemente përbërës të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, të drejtën e mbrojtjes dhe të drejtën për t'u dëgjuar. Këto dy të drejta, në unitet edhe me të drejta të tjera, kanë qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që para marrjes së vendimit gjyqësor të dëgjohet realisht mbi thelbin e çështjes. Në këtë mënyrë garantohet edhe zbatimi i një parimi thelbësor në procesin gjyqësor, ai i kontradiktoritetit. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t'u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklarimet e tyre, për parashtrimin e fakteve, provave e vlerësimeve ligjore. "Kushdo, qoftë në procesin penal, qoftë në procesin civil, duhet të ketë mundësinë t'i paraqesë gjykatës, në mënyrën e duhur, çështjen e vet, në kushte që nuk e vendosin atë në situatë dukshëm të pafavorshme në raport me palën kundërshtare*"* (*shih vendimin nr. 12, datë 6.6.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Do të ishte e pashpjegueshme sesi një i akuzuar do të mund të ushtronte të drejtat që i garantohen shprehimisht atij në nenin 6/3 shkronjat "c", "d" dhe "e" të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), të drejtën "për t'u mbrojtur vetë", "për të pyetur apo për të kërkuar që të pyeten dëshmitarët" dhe "të ndihmohet falas nga një përkthyes, nëse nuk e kupton apo nuk e flet gjuhën që përdoret në gjykim", nëse i pandehuri nuk do të ishte i pranishëm në gjykim. Detyrimi për t'i garantuar të pandehurit të drejtën për të marrë pjesë në gjykim (për të qenë i pranishëm në seancë gjyqësore) është një prej elementëve thelbësore të nenit 6 të KEDNJ-së.

57. Në vendimin nr. 26, datë 8.5.2012, Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera, ka arsyetuar se *"*...gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor, janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, gjykata ka përcaktuar ndër vite, disa standarde në lidhje me gjykimin në mungesë sipas të cilave: a) i pandehuri ka të drejtë të jetë i pranishëm në procesin gjyqësor të kryer në ngarkim të tij; b) i pandehuri mund të heqë dorë vullnetarisht nga ushtrimi i kësaj të drejtë; c) i pandehuri duhet të jetë në dijeni për ekzistencën e një procesi gjyqësor në ngarkim të tij; ç) duhet të ekzistojnë instrumente paraprake ose riparuese për të shmangur procese në ngarkim të të pandehurit, ose për të siguruar një proces të ri dhe, nëpërmjet depozitimit të provave të reja, të drejtën e mbrojtjes që nuk ka qenë e mundur të ushtrohet personalisht në procesin e zhvilluar në mungesë, të përfunduar tashmë (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010, nr. 45, datë, më 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

58. Duke u bazuar në këto parime, edhe GJEDNJ-ja ka përcaktuar kritere të qarta dhe të plota për drejtësinë kushtetuese lidhur me gjykimin në mungesë. Ajo ka theksuar se e drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë (*Ektabani kundër Suedisë, 1988; Vaundelle kundër Francës, 2003*). Kjo përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur procedimet kanë natyrë kontradiktore. Shteti ka detyrimin për t'i dhënë të pandehurit një njoftim efektiv dhe të përshtatshëm për seancën dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij (*Poitrimol kundër Francës, 1993; Spinatto kundër HMP Brixton dhe Italisë, 2001*). Gjykata thekson se është e një rëndësie thelbësore, që i akuzuari të jetë i pranishëm në seancë, sepse ai ka të drejtën të dëgjohet, por edhe sepse ai ka nevojë t'i verifikojë gjykatës vërtetësinë e thënieve të tij dhe t'i krahasojë këto me të palës tjetër ose dhe të dëshmitarëve. Ligjvënësi duhet të jetë në gjendje të mos nxisë mungesa të pajustifikueshme (*Geyseghem kundër Belgjikës, 1999*). Edhe pse nuk është absolute, e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, është një nga kriteret kryesore të gjykimit të drejtë. Një person i akuzuar penalisht nuk e humb këtë të drejtë thjesht për faktin se ai nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*Mariani kundër Francës, 2005).*

59. GJEDNJ-ja është shprehur gjithashtu se të informosh dikë për një proces të hapur kundër tij, është një akt gjyqësor i një rëndësie të veçantë që duhet bërë në përputhje me kërkesat procedurale dhe thelbësore, të cilat garantojnë ushtrimin efektiv të të drejtave nga ana e të pandehurit. Njoftimi i paqartë dhe joformal nuk mjafton. Ndërkohë, nëse mund të pranohet një njoftim edhe tërthorazi, heqja dorë duhet të jetë e qartë. Është një e drejtë e personit të dënuar *in absentia*, i cili nuk rezulton se ka hequr dorë në mënyrë të qartë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykim, të ketë në të gjitha rastet një vendim të ri mbi akuzat (*Sejdovic kundër Italisë, 2000*). Në këtë çështje, GJEDNJ-ja jo vetëm rikonfirmoi parimet për të pandehurin të gjykuar në mungesë, por edhe shënoi një fushë të re të konstatimit të shkeljeve nga ana e gjykatës që ka të bëjë me shkeljet e bëra nga shtetet si rezultat i mungesës së strukturës në sistemin e tyre procedural penal. Gjykata Evropiane konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së për faktin se i dënuari nuk kishte mundësinë që të arrinte një rihapje të procedimit penal, për tu gjykuar sërish në respekt të së drejtës për tu mbrojtur mbi bazueshmërinë e akuzave të formuluara kundër tij.

60. Në çështjen *Stoichkov kundër Bullgarisë*[40] GJEDNJ-ja u shpreh, se: "56. Procedimet penale që janë zhvilluar në mungesë dhe rihapja e të cilave është refuzuar më pas, pa asnjë tregues se i akuzuari ka hequr dorë nga e drejta e tij/saj për të qenë i pranishëm gjatë gjykimit, mund të përshkruhet në mënyrë të drejtë si "në kundërshtim të qartë me dispozitat e nenit 6 të KEDNJ ose parimet e misheruara në të". Në çështjen *Krombach kundër Francës*[41], GJEDNJ është shprehur se, ka shkelje të KEDNJ-së, kur të gjykuarit dhe të dënuarit në mungesë nuk i lejohet dhe i mohohet e drejta e apelimit.

[40] Shih Stoichkov kundër Bullgarisë, aplikimi nr. 9808/02, datë 24.3.2005.
[41] Shih Krombach kundër Francës, aplikimi nr. 29731/96, datë 3.2.2001.

61. Në çështjen *Shkalla kundër Shqipërisë*[42], GJEDNJ-ja, ndër të tjera, thekson se: *"....78... ishte shkelur rëndë nga autoritetet vendase e drejta e ankuesve për një gjykim të drejtë, pasi i pandehuri ishte gjykuar në mungesë, pa u njoftuar personalisht për gjykimin e zhvilluar në ngarkim të tij. Gjykata vëren se kur një ankues është dënuar për shkelje të të drejtave të tij të garantuara në nenin 6 të Konventës, ai duhet sa të jetë e mundur, të vendoset në pozicionin në të cilin ai do të kishte qenë nëse kushtet e asaj dispozite nuk do të shkeleshin dhe që në parim, forma më e duhur e shqyrtimit, do të gjykohej de novo apo rihapja e procedimeve, nëse kërkohej.....*".

62. Në çështjen *Izet Haxhia kundër Shqipërisë,* GJEDNJ-ja, ka theksuar se "*82. Megjithëse procedimet e bëra në mungesë të pandehurit nuk janë në vetvete të papajtueshme me nenin 6 të Konventës, gjithsesi mohimi i drejtësisë ndodh pa dyshim kur një person i dënuar në mungesë nuk është në gjendje, më pas, të përfitojë nga gjykata, e cila ka dëgjuar përcaktimin e tij të ri të meritave të akuzës, si për sa i përket së drejtës, ashtu edhe fakteve, kur nuk është përcaktuar se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur dhe për t'u mbrojtur vetë (...) ose se ai synonte t'i shpëtonte gjykimit (...). 83. Konventa u lë shteteve kontraktuese diskrecion të gjerë në lidhje me zgjedhjen e mjetit të llogaritur për të garantuar se sistemet e tyre ligjore janë në përputhje me dispozitat e nenit 6. Detyra e gjykatës është të përcaktojë nëse është arritur rezultati i kërkuar sipas Konventës. Në veçanti, mjetet procedurale, të ofruara nga e drejta dhe praktika e brendshme, duhet të tregojnë se janë efektive kur një person i akuzuar për një vepër penale nuk ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur dhe për t'u mbrojtur vetë dhe as nuk ka kërkuar t'i shmanget gjykimit. 84. Gjykata më tej ka vendosur se detyra për të garantuar të drejtën e të pandehurit për të qenë i pranishëm në sallën e gjyqit... ose gjatë procedimeve të para ose në rigjykim – radhitet si një nga kërkesat themelore të nenit 6 (...). Për rrjedhojë, refuzimi për të rifilluar procedimet e kryera në mungesë të të pandehurit, pa treguar se i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm gjatë gjykimit, është konstatuar si "mohim flagrant i drejtësisë", duke bërë që procedimet të jenë "haptazi në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 ose parimet e shprehura në të" (...)…..85. Gjykata ka vendosur, gjithashtu, se rivendosja në afat e ankimit kundër dënimit në mungesë, kur i pandehuri gëzonte të drejtën të merrte pjesë në seancën gjyqësore në gjykatën e apelit dhe të kërkonte pranimin e provave të reja, krijonte mundësinë e përcaktimit të ri faktik dhe ligjor të akuzës penale, prandaj procedimet në tërësi mund të thuhet se kanë qenë të drejta (...)..*".

63. Pra, referuar praktikës së GJEDNJ-së edhe pse gjykimet e zhvilluara pa praninë e të pandehurit nuk janë në vetvete në mospërputhje me nenin 6 të KEDNJ-së, padyshim do të konsiderohej një mohim i drejtësisë nëse një person i gjykuar në mungesë nuk do ishte në gjendje të kërkonte nga gjykata një rivlerësim të themelit të akuzave, në rastet kur nuk provohet se ai ka hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për t'u mbrojtur.

64. Kolegjet e Bashkuara, në garantimin e së drejtës themelore për një proces të rregull ligjor vlerësojnë të theksojnë dhe Rezolutën (75) 11 "Për kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit" të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, në të cilën rekomandohen standardet minimale për shtetet anëtarë mbi njoftimin e të gjykuarit dhe zhvillimin e procesin në mungesë të tij, të tilla si: (*i) Askush nuk duhet të gjykohet pa pasur një thirrje për gjyq në kohë; (ii) Kjo thirrje për gjyq duhet të ketë të sanksionuara edhe pasojat nëse i akuzuari nuk vjen në gjykim; (iii) Kur gjykata vëren se edhe pse i akuzuari është njoftuar dhe nuk është paraqitur, ajo, nëse çmon se prania e tij në proces është e pazëvendësueshme ose beson se i akuzuari është penguar të paraqitet, duhet të vendosë shtyrjen e procesit… (vi) Një vendim gjykate i dhënë në mungesë duhet t'i njoftohet personit sipas rregullave për njoftimet dhe marrjes dijeni brenda afatit të parashikuar për apelim. Ky afat duhet të fillojë që nga dita e marrjes dijeni efektivisht të personit, përveçse kur ai qëllimisht i fshihet drejtësisë; (vii) Çdo personi të gjykuar në mungesë duhet t'i jepet e drejta për apelim me çdo lloj mjeti ligjor, që do t'i ishte dhënë sikur ai të ishte i pranishëm; (viii) Për personin e gjykuar në mungesë, të cilit nuk i është bërë njoftimi në mënyrën e duhur, duhet të ketë një mjet ankimi që t'i mundësojë atij shfuqizimin e vendimit; (ix) Një person i gjykuar në mungesë, por që njoftimi i është bërë në rregull, duhet të ketë të drejtën e një rigjykimi në mënyrën e zakonshme, nëse ai mund të provojë mungesën e tij para gjykatës për arsye të pavarura nga vullneti i tij*".

65. Referuar praktikës kushtetuese, por edhe asaj të GJEDNJ-së, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se vendimi njësues nr. 1, datë 20.1.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në interpretimin që i ka bërë çështjes së tretë, ku ka konkluduar se: "*Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri*", nuk përputhet me standardet kushtetuese dhe konventore dhe as me parashikimet e vetë KPP-së.

66. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, i gjykuari në mungesë, kur provohet se nuk ka marrë dijeni për vendimin e dënimit, ka të drejtën të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit, pavarësisht se çështja është gjykuar në gjykatat më të larta mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri (të pranishëm). Gjykata që shqyrton kërkesën për rivendosje në afat pasi ka verifikuar më parë kushtet formale të parashikuara në nenin 420/1 të KPP-së, duhet të vlerësojë formalisht "*prima facie"* nëse shkaqet e ankimit të të gjykuarit në mungesë janë të njëjta me shkaqet

[42] Shih Shkalla kundër Shqipërisë, aplikimi nr. 26866/05, datë 10.5.2011.

jopersonale të shqyrtuara më parë nga gjykatat më të larta mbi ankimin e bashkëtëpandehurit tjetër. Gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit, të paraqitur nga i gjykuari në mungesë, i cili nuk ka ushtruar ankim, nëse ai parashtron shkaqe të tjera, të ndryshme nga ato, për të cilat është shprehur më parë gjykata më e lartë në vendimin e marrë mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurit për shkaqe jopersonale të këtij të fundit.

67. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ndërmjet dy parimeve të rëndësishme, ai i sigurisë juridike dhe procesi i rregullt ligjor, në rastin konkret, ky i fundit do të prevalojë. Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin njësues nr. 1, datë 10.3.2014, ku në paragrafin nr. 62, ndër të tjera, kanë arsyetuar se "*Në kushtet kur parimi i procesit të rregullt ligjor ka përparësi mbi atë të sigurisë juridike, investimi i gjykatave në një proces, i cili më pas do të hapej me kërkesën e të gjykuarit në mungesë, do të sillte një proces të pavlefshëm dhe një vendim të cenueshëm që nuk krijon siguri juridike...*". Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se shmangia nga parimi i sigurisë juridike nëpërmjet mundësisë së rihapjes së çështjes penale, ka si qëllim ndreqjen e gabimit gjyqësor në dhënien e drejtësisë. Në çështjen *Xherraj kundër Shqipërisë,* GJEDNJ-ja shprehet se: "Gjykata vlerëson se kërkesat e sigurisë ligjore nuk janë absolute. Largimi nga parimi justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e nevojshme nga rrethanat e një karakteri substancial ose detyrues (*Ryabykh k. Rusisë, nr. 52854/99, § 52, GJEDNJ 2003 IX*) ose kur arsye serioze legjitime janë më me peshë se siguria juridike (*shih Bratyakin k. Rusisë (dek.), nr. 72776/01, 9 mars 2006)".*

68. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se interpretimi i kryer për çështjen e tretë në vendimin njësues nr. 1, datë 20.1.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është në kundërshtim me parimet ligjore, me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së. Në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara duke konkluduar se nevoja për ndryshimin e jurisprudencës është "*e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar"*, arrijnë në qëndrimin njësues si më poshtë:

"***I gjykuari në mungesë, kur provohet se nuk ka marrë dijeni për vendimin e dënimit, ka të drejtën të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit, pavarësisht se çështja është gjykuar në gjykatat më të larta mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri.***

Gjykata që shqyrton kërkesën për rivendosje në afat vlerëson formalisht nëse shkaqet e ankimit të të gjykuarit në mungesë janë të njëjta me shkaqet jopersonale të shqyrtuara më parë nga gjykatat më të larta mbi ankimin e bashkëtëpandehurit tjetër.

Gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i gjykuari në mungesë, i cili nuk ka ushtruar ankim, nëse ai parashtron shkaqe të tjera, të ndryshme nga ato, për të cilat është shprehur më parë gjykata më e lartë në vendimin e marrë mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurit për shkaqe jopersonale të këtij të fundit."

IV. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

69. Për sa i përket zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se, gjykatat e shkallëve më të ulëta kanë rrëzuar kërkesën e kërkuesit Adriatik Muharremi, me objekt rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, bazuar në interpretimin e kryer nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në çështjen e tretë të vendimit njësues nr. 1, datë 20.1.2011, sipas të cilit: "*Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri".*

70. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, vendimet njësuese dhe ndryshuese të Kolegjeve të Gjykatës së Lartë dhe të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë hyjnë në fuqi në momentin e shpalljes së tyre dhe kanë fuqi nga ai moment e në vijim. Neni 35, pika 4 i ligjit "*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*" parashikon se "*Vendimet e Gjykatës së Lartë për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore publikohen në Fletoren Zyrtare të radhës*". Neni 76, pika 7 i ligjit "Për funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" rregullon efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese duke mos parashikuar fuqi prapavepruese, përjashtimisht rasteve që lidhen me një dënim penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar, ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë, si dhe ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar.

71. Vendimi njësues, por dhe vendimi që ndryshon praktikën gjyqësore të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë vendime me fuqi "*erga omnes"* dhe kanë pothuajse të njëjtat karakteristika me vendimet e Gjykatës Kushtetuese apo aktet normative. Nëse Kolegjet e Bashkuara ndryshojnë praktikën gjyqësore, ky ndryshim nuk duhet të cenojë parimin e sigurisë juridike, në kuptim edhe të zbatimit të drejtpërdrejtë të nenit 7 të KEDNJ-së apo nenit 29 të Kushtetutës, ku sigurohet ndalesa kategorike e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit. Edhe në rastin e veprimit në kohë të fuqisë së vendimit njësues ose ndryshues të praktikës gjyqësore zbatohet parimi i

veprimit në kohë të ligjit penal. Nuk ka një normë ligjore, qoftë në ligjet procedurale apo penale që të rregullojë veprimin në kohë të vendimeve njësuese, zhvilluese dhe ndryshuese të praktikës gjyqësore. Në sferën penale edhe procedurale penale një vendim që përkeqëson pozitën e të pandehurit apo personit nën hetim nuk mund të ketë fuqi prapavepruese.

72. Përpos rregullit të përgjithshëm të sipërcituar, në rastin objekt gjykimi, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se duhet të mbahet në konsideratë pika 3 e nenit 29 të Kushtetutës, që parashikon se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Neni 29 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj; se nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ka qenë i parashikuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës penale; se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Gjykata Kushtetuese është shprehur se e drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, e sanksionuar në nenin 29, pika 3, të Kushtetutës, është një parim themelor që ka të bëjë me thelbin e një procesi të drejtë penal dhe si i tillë është i rëndësishëm për respektimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 12, datë 15.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

73. Në vendimin nr. 35, datë 20.12.2005, Gjykata Kushtetuese shprehet se *"Gjykata Kushtetuese thekson se parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar menjëherë nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Pra, sigurisht që ky parim duhet të respektohet edhe në gjykimin që mund të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, sepse është pikërisht kjo gjykatë që kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta. Pasi çështja është gjykuar përfundimisht nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, nuk ka më vend për aplikimin e parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues. Në këto kushte, ai nuk mund të përbëjë as shkak për rishikimin e çështjes nga këto gjykata."*.

74. Nisur sa më sipër, bazuar në parimin e zbatimit të ligjit penal favorizues, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ndryshimi i praktikës njësuese të sipërcituar, e cila ka shërbyer si argument nga gjykatat e faktit në mbështetje të rrëzimit të kërkesës së kërkuesit Adriatik Muharremi për rivendosjen në afat të ankimit, do të ketë fuqi prapavepruese për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se praktika njësuese, e cila ka shërbyer në funksion të zgjidhjes së kërkesës së kërkuesit Adriatik Muharremi për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, ndaj vendimit të gjykimit në themel të akuzës, pas ndryshimit me këtë vendim, i jep mundësinë gjykatës për të shqyrtuar kërkesën e tij, me objekt rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, ndaj vendimit nr. 51, datë 11.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

75. Për sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara, vlerësojnë se, vendimi nr. 20-2017-38/10, datë 24.1.2017 i Gjykatës së Apelit Gjirokastër (që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 23-2016-2291, datë 2.12.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, që ka rrëzuar kërkesën e kërkuesit Adriatik Muharremi për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit) duhet të prishet dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Në rishqyrtim, Gjykata e Apelit Gjirokastër, duke mbajtur në konsideratë qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara në këtë vendim ndryshues të praktikës gjyqësore, duhet të marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuesit Adriatik Muharremi, me objekt rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, ndaj vendimit nr. 51, datë 11.12.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke verifikuar nëse shkaqet e ankimit të kërkuesit/të gjykuarit në mungesë, Adriatik Muharremi, janë të njëjta me shkaqet jopersonale të shqyrtuara më parë nga gjykatat më të larta mbi ankimin e bashkëtëpandehurit tjetër Dhurim Tusha.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të neneve 438 dhe 441, pika 1, shkronja "c" të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSËN:

Prishjen e vendimit nr. 20-2017-38/10, datë 24.1.2017, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

Ky vendim, që ndryshon vendimin njësues nr. 1, datë 20.1.2011, dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 18.11.2022

Kryesues: Sokol Sadushi

Anëtar: Ilir Panda, Ervin Pupe, Albana Boksi, Sokol Binaj, Sandër Simoni, Artur Kalaja, Asim Vokshi, Arbena Ahmeti, Gentian Medja, Darjel Sina.

Anëtar kundër: Medi Bici, Sokol Ngresi, Margarita Buhali.

MENDIM PAKICE

Unë gjyqtari në pakicë **Medi BICI** jam kundër vendimit nr. 2, datë 18.11.2022 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që i përket kërkuesit Adriatik Muharremi, me objekt: Rivendosjen në afat të ankimit, kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, bazuar në nenet 147, pika 2 dhe 148 të KPP, prandaj në zbatim të nenit 112/6 të KPP arsyetoj me shkrim mendimin tim kundër, për t'ia bashkëngjitur vendimit nr. 2, datë 18.11.2022 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nga shqyrtimi gjyqësor i çështjes në seancë gjyqësore publike, në mënyrë të përmbledhur ka rezultuar se:

Me vendimin nr. 51, datë 11.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, kërkuesi Adriatik Muharremi është deklaruar fajtor dhe dënuar me 25 vjet burgim për veprat penale, të parashikuara nga nenet 141-22 dhe 278/2 të KP, ndërsa bashkëautori tjetër Dhurim Tusha është deklaruar fajtor dhe dënuar me 8 vjet burgim për veprat penale, të parashikuara nga nenet 141-22 dhe 278/2 të KP-së. Ka rezultuar që vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, është marrë në mungesë të kërkuesit Adriatik Muharremi.

Kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka paraqitur ankim vetëm i pandehuri Dhurim Tusha dhe Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 15, datë 22.2.2000, ka vendosur: ...Lënien në fuqi të vendimit nr. 51, datë 11.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Sarandë, për sa i përket të pandehurit Adriatik Muharremi. Lënien në fuqi të vendimit të mësipërm për sa i përket fajësisë dhe kualifikimit ligjor të veprës penale të kryer nga i pandehuri Dhurim Tusha. Ndryshimin e vendimit për sa i përket masës së dënimit të dhënë ndaj të pandehurit Dhurim Tusha, duke e dënuar atë me 4 (katër) vjet burgim.

Pas shpalljes në kërkim ndërkombëtar, me shkresën nr. 2299/16, datë 6.7.2016, ZQK Interpol Tirana, ka njoftuar Drejtorinë e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, se më datë 5.7.2016 është realizuar ekstradimi nga Greqia në Shqipëri i të dënuarit Adriatik Muharremi. Brenda 5 ditëve nga dita e ekstradimit në Shqipëri, kërkuesi nëpërmjet mbrojtësit të zgjedhur, nga të afërmit e tij, ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës për të paraqitur ankim, kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Në kërkesën për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, kërkuesi pretendon se, ka qenë në mungesë gjatë zhvillimit të gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, nuk ka pasur dijeni për procedimin penal dhe vendimin përfundimtar të dhënë nga gjykata në ngarkim të tij. Në kohën kur është shpallur vendimi nga gjykata e shkallës së parë, kërkuesi pretendon se ka qenë në Greqi, nuk ka pasur asnjë lloj komunikimi me të afërmit e tij dhe nuk është vënë në dijeni për zhvillimin e këtij gjykimi dhe të vendimit që është marrë kundër tij. Për këto shkaqe ai pretendon se, nuk ka mundur të bëjë ankim, në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

Në përfundim të shqyrtimit të gjyqësor të kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 23-2016-2291, datë 2.12.2016 ka vendosur: ...Rrëzimin e kërkesës, ndërsa Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 20-2017-38/10, datë 24.1.2017, ka vendosur: ...Lënien në fuqi të vendimit nr. 23-2016-2291, datë 2.12.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Kundër vendimit nr. 20-2017-38/10, datë 24.1.2017 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, ka paraqitur rekurs, kërkuesi Adriatik Muharremi, i cili kërkon prishjen e vendimit nr. 20-2017-38/10, datë 24.1.2017 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe të vendimit nr. 23-2016-2291, datë 2.12.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe pranimin e kërkesës për rivendosjen në afat të së drejtës për të paraqitur ankim, kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 15.7.2022, ka vendosur dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara, me qëllim ndryshimin e praktikës gjyqësore në lidhje me vendimin njësues nr. 1, datë 20.1.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit:.. Në çështjet penale me disa të pandehur, gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri tjetër.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 2, datë 18.11.2022 kanë vendosur: ...Prishjen e vendimit nr. 20-2017-38/10, datë 24.1.2017 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim, në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Ky vendim, që ndryshon vendimin njësues nr. 1, datë 20.1.2011, dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare. Me këtë vendim shumica e ka ndryshuar praktikën gjyqësore të njësuar nga vendimi njësues nr. 1/2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si më poshtë:

1. I gjykuari në mungesë, kur provohet se nuk ka marrë dijeni për vendimin e dënimit, ka të drejtë të kërkojë

rivendosjen në afat të ankimit, pavarësisht se çështja është gjykuar në gjykatat më të larta mbi bazën e ankimit të një bashkëpandehuri.

2. Gjykata që shqyrton kërkesën për rivendosje në afat vlerëson formalisht nëse shkaqet e ankimit të të gjykuarit në mungesë janë të njëjta me shkaqet jopersonale të shqyrtuara më parë nga gjykatat më të larta mbi ankimin e bashkëtëpandehurit tjetër.

3. Gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i gjykuari në mungesë, i cili nuk ka ushtruar ankim, nëse ai parashtron shkaqe të tjera, të ndryshme nga ato, për të cilat është shprehur më parë, gjykata më e lartë në vendimin e marrë mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurit për shkaqe jopersonale të këtij të fundit.

Në ndryshim nga qëndrimi i shumicës, pakica është e mendimit që praktika e vendosur nga vendimi nr. 1, datë 20.1.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk duhet të ndryshonte dhe rekursi i paraqitur nga kërkuesi Adriatik Muharremi, kundër vendimit nr. 20-2017-38/10, datë 24.1.2017 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër nuk duhet të pranohej, pasi nuk ekzistojnë shkaqe të parashikuara shprehimisht në nenin 432 të KPP-së, i cili ka qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së rekursit. Në këtë përfundim, pakica arrin për këto shkaqe:

Kërkuesi Adriatik Muharremi është ekstraduar nga Greqia me datë 5.7.2016 dhe pas 5 ditësh nga ekstradimi ka paraqitur para gjykatës kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit, duke u bazuar në nenet 147, pika 2 dhe 148 të KPP-së, të cilët janë ndryshuar me ligjin nr. 35, datë 30.3.2017, me të cilin është shtuar edhe neni 420/1 i KPP-së, në të cilin janë parashikuar rastet se, kur mund të paraqitet kërkesa për rivendosjen në afat të ankimit, që janë: rasti fator dhe forca madhore, si dhe është përcaktuar se, bashkë me kërkesën për rivendosjen në afat pala duhet të paraqesë njëkohësisht me efekt mospranimi edhe ankimin kundër vendimit.

Në këtë dispozitë ligjore është parashikuar se, kur mund të kërkohet rivendosja në afat e ankimit në rastet kur gjykata ka proceduar në bazë të nenit 351 të KPP-së (mosparaqitja ose largimi i vullnetshëm i të pandehurit), e cila mund të bëhet vetëm në rastin kur i pandehuri provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin përfundimtar të gjykatës. Ndërsa në nenin 450/1 të KPP-së (rastet e rishikimit), me ligjin nr. 35, datë 30.3.2017, ndër të tjera është shtuar edhe shkronja "e", me këtë përmbajtje: *...Kur personi është gjykuar në mungesë sipas neni̇t 352 të këti̇j Kodi dhe kërkon rigjykimin e çështjes. Kërkesa paraqitet brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni. Kërkesa e paraqitur brenda afatit nuk mund të refuzohet.*

Duke pasur parasysh qëndrimet që mbajnë Konventa Evropiane e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), ligjvënësi ka bërë përpjekje për ta rregulluar përfundimisht institutin e rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit dhe ligji nr. 35, datë 30.3.2017, i cili ka bërë ndryshimet e mësipërme në KPP ka hyrë në fuqi me datë 1.8.2017, duke ndryshuar edhe korpusin ligjor që rregullon institutin e rivendosjes në afat të ankimit, për të cilin janë vënë në lëvizje Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë bërë njësimin e praktikës gjyqësore me vendimin nr. 1, datë 20.1.2011, prandaj ky vendim njësues që nga kjo datë është bërë i pazbatueshëm nga gjykatat, për shkak të rënies nga fuqia të dispozitave ligjore që Kolegjet e Bashkuara kanë marrë në shqyrtim.

Në të tilla raste, praktika gjyqësore ka mbajtur qëndrimin se, kur ndodhin ndryshime ligjore, vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk zbatohen nga gjykatat në zgjidhjen e çështjeve konkrete, por në vendim gjykatat mjaftohen vetëm me sqarimin e shkakut të moszbatimit të vendimit njësues. Funksioni i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është që të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore në ato raste kur legjislacioni në fuqi ka boshllëqe, duke i çuar gjykatat në interpretime të ndryshme, ose kur zbatimi në praktikë i vendimit njësues e ka çuar praktikën gjyqësore në një drejtim të gabuar, e cila lipset të ndryshohet, por me kusht që dispozitat ligjore që merren në shqyrtim duhet të kenë qenë në fuqi, si në momentin e njësimit të praktikës gjyqësore, ashtu edhe në momentin e ndryshimit të praktikës gjyqësore të mëparshme. Në rastin në shqyrtim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë që kanë ndryshuar praktikën gjyqësore, nuk kanë qenë në këto kushte, pasi vendimi njësues mbi të cilin ato kanë disponuar ka qenë pa fuqi juridike, për shkak të ndërhyrjes së legjislatorit në dispozitat ligjore që kanë qenë objekt shqyrtimi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Për të pasur një tablo më të qartë, fillimisht duhet sqaruar se, nëse çështja e themelit do të shqyrtohej në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë pas datës 1.8.2017, kohë kur ka hyrë në fuqi ligji nr. 35/2017, atëherë vetvetiu lind pyetja se në bazë të së cilës dispozitë ligjore do ta paraqiste kërkesën para gjykatës, kërkuesi Adriatik Muharremi, sipas nenit 420/1/2 të KPP-së, apo sipas nenit 450/1, shkronja "e" të po këtij Kodi?

Neni 420/1/2 i KPP-së, referon në nenin 351 të po këtij Kodi, i cili bën fjalë për rastet kur i pandehuri nuk paraqitet në gjyq, duke pasur dijeni rregullisht për ditën dhe orën e gjykimit, ose kur ai është i pranishëm në seancë gjyqësore dhe largohet me vullnetin e tij. Në këtë rast rivendosja në afat bëhet vetëm atëherë kur i pandehuri provon para gjykatës se, nuk ka marrë dijeni rregullisht për vendimin përfundimtar. Pra, sipas kërkesës së kërkuesit

nuk ndodhemi përpara këtij rasti, pasi ai nuk ka qenë prezent në gjykimin e themelit me pretendimin se, nuk ka pasur dijeni për procedimin penal në ngarkim të tij, pasi është larguar në Greqi.

Rasti i dytë që parashikon ligji procedural penal është i parashikuar nga neni 450/1, shkronja "e" i KPP-së, i cili referon në nenin 352 të po këtij Kodi, që bën fjalë për gjykimin në mungesë për të pandehurin e lirë që nuk gjendet, me gjithë kërkimet e urdhëruara nga gjykata, ose për të pandehurin që i fshihet drejtësisë. Sipas kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit, del që kërkuesi Adriatik Muharremi është gjykuar në mungesë, pikërisht sipas nenit 352 të KPP-së. Pra, e thënë ndryshe del se, pas datës 1.8.2017, i pandehuri që është gjykuar në mungesë mund të kërkojë shqyrtimin e çështjes nëpërmjet institutit të rishikimit të vendimit të formës së prerë, të parashikuar nga neni 449 e vijues i KPP-së, ndërsa për kërkesat e paraqitura përpara kësaj date, ai duhet të kërkojë rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, sipas neneve 147 e vijues dhe 420/1 të KPP-së.

Shumica mban këtë qëndrim me pretendimin se, në kohën kur është paraqitur kërkesa për rivendosjen në afat të ankimit nga ana e kërkuesit, nuk kanë qenë bërë ndryshimet në nenin 450/1 të KPP-së dhe kërkuesi nuk ka pasur rrugë tjetër ligjore për të hapur çështjen e tij. Sipas shumicës ky ndryshim i praktikës gjyqësore diktohet edhe si pasojë e qëndrimit që ka mbajtur GJEDNJ-ja në disa çështje, e cila kërkon që të bëhet njoftimi i rregullt i vendimit përfundimtar të gjykatës dhe të sigurohet një mbrojtje efektive për personat e gjykuar në mungesë.

Edhe pakica në lidhje me këtë çështje ndan qëndrim të njëjtë me shumicën, por rruga ligjore për zgjidhjen e këtij "ngërçi" sipas pakicës ka qenë vetëm paraqitja e kërkesës për rishikimin e vendimit të formës së prerë, duke u bazuar në nenin 449 e vijues të KPP-së dhe jo zbatimi i institutit të rivendosjes në afat të ankimit, të parashikuar nga nenet 147 e vijues dhe 420/1 të KPP-së. Është e vërtetë që GJEDNJ-ja kërkon që të zbatohen standardet ligjore, të parashikuara në Konventë, në lidhje me gjykimin në mungesë në çështjet penale, por se cila është rruga ligjore për zgjidhjen e kësaj çështje duhet ta përcaktojë legjislacioni i brendshëm i vendeve anëtare, ku duhet të bazohen edhe gjykatat e tyre.

Në nenin 128/1 shkronja "c" të KPP-së, të pandryshuar është parashikuar se: ...*Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me thirrjen e të pandehurit etj*... Gjithashtu në nenin 143 të po këtij Kodi janë parashikuar rastet e pavlefshmërisë së njoftimeve dhe sipas pakicës kjo duhet të ishte rruga e duhur ligjore që duhet të ndiqte kërkuesi, duke paraqitur përpara gjykatës kompetente kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë, në përputhje me nenin 449/1, shkronja "c" të KPP-së, duke paraqitur para saj prova të reja, të dala pas dhënies së vendimit (në lidhje me parregullsinë e njoftimeve), me anë të të cilave të provonte që vendimi i gjykatës së shkallës së parë që kishte marrë formë të prerë ishte i gabuar, të paktën për sa i përket zbatimit të ligjit procedural penal.

Vendimi njësues nr. 1, datë 20.1.2011 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk e lejonte paraqitjen e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit, vetëm në rastin kur vendimi i dhënë nga gjykata ishte ankimuar dhe shqyrtuar nga gjykata më e lartë, mbi bazën e ankimit të paraqitur nga i bashkëpandehuri, ankim i cili nuk lidhej me motive personale. Në rastin në shqyrtim, kundër vendimit nr. 51, datë 11.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë ka paraqitur ankim vetëm i pandehuri Dhurim Tusha dhe Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr. 15, datë 22.2.2000, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 51, datë 11.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Sarandë, për sa i përket të pandehurit Adriatik Muharremi etj... Pra, çështja është shqyrtuar në tërësi nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, në përputhje me parashikimet e nenit 416/1 të KPP-së. Qëllimi i ankimit është që vendimi i dhënë nga gjykata e shkallës së parë të mund të shqyrtohet nga një gjykatë tjetër më e lartë, sipas parashikimeve të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

Sipas pakicës ky standard ligjor në këtë çështje është përmbushur, pasi çështja e themelit që ka lidhje me kërkuesin është shqyrtuar dhe kontrolluar nga një gjykatë tjetër më e lartë. Ndërsa për mospjesëmarrjen e kërkuesit në gjykimin e çështjes në themel, neni 33 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë parashikon se: ...*Kushdo ka të drejtë të dëgjohet përpara se të gjykohet. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë*... dhe në të vërtetë në rastin në shqyrtim rezulton se, kërkuesi Adriatik Muharremi i është fshehur drejtësisë, si në fazën e hetimit paraprak, ashtu edhe atë të gjykimit në themel të çështjes. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Apelit Gjirokastër në vendimin nr. 15, datë 22.2.2000, ndër të tjera thotë: ...*Pretendimet e avokatit mbrojtës të të pandehurit Adriatik Muharremi, i pranishëm në gjykimin në apel, nuk merren për bazë, pasi ky i pandehur nuk ka bërë ankim dhe se, në bazë të nenit 425/1 të KPP-së, shkaqet që pretendohen nuk janë brenda kufijve që i referohen shkaqeve të ngritura në ankim*.....

Pakica është e mendimit se gjatë zbatimit në praktikë, jo në të gjitha rastet nga gjykatat më të ulëta është kuptuar drejtë se, çfarë kanë thënë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin njësues nr. 1, datë 20.1.2011, sepse ato fillimisht duhet të hetonin me kujdes nëse ankimi i bashkëtëpandehurit është bërë ose jo për motive personale. Në vendimin nr. 51, datë 11.12.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ndër të tjera thuhet se: ...*Nga shpjegimet*

e të pandehurit Dhurim gjatë hetimit rezultoi se, i pandehuri Adriatik hapi zjarr ndaj tij (Dhurimit) dhe viktimës G. C, pasi ky i fundit e kishte njohur në rastin e fundit pak para ngjarjes edhe sepse i pandehuri Adriatik ishte me maskë... Pikërisht këtu duhet ta përqendronin fillimisht hetimin gjyqësor gjykatat e faktit kur kanë shqyrtuar kërkesën e kërkuesit Adriatik Muharremi, me objekt rivendosjen në afat të ankimit dhe nëse nuk do të konstatonin shkelje të nenit 416/1 të KPP-së, atëherë gjykata e apelit duhet ta shqyrtonte çështjen në tërësi, siç ka vepruar në rastin objekt shqyrtimi.

Vendimi që rekursohet në Gjykatën e Lartë është vendim i gjykatës së apelit dhe mbi të cilin disponon Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vetëm për shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së, por mund të ndodhte që çështja e themelit të ishte shqyrtuar edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili mund të kishte vendosur edhe për meritën (themelin) e çështjes, atëherë kush do ta gjykonte vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përveç gjykatës kompetente që do të rishikonte vendimin e formës së prerë, sipas nenit 449 e vijues të KPP-së. Duke vendosur në këtë mënyrë, pakica vlerëson se, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me ndryshimin e praktikës gjyqësore kanë cenuar një nga parimet e rëndësishme të së drejtës procedurale penale, që është parimi i sigurisë juridike.

Çështja e fundit që duhet theksuar është se, sentenca njësuese e vendimit që bëri ndryshimin e praktikës gjyqësore, bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 420/1 të KPP-së, i cili parashikon se, kur gjykimi është zhvilluar sipas parashikimeve të nenit 350/1 të KPP-së, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit, kur provon se, nuk është njoftuar rregullisht për vendimin përfundimtar, që do të thotë se, pavarësisht parashikimeve të bëra nga neni 416/1 i KPP, gjykata është e detyruar që të pranojë kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit, kur i pandehuri provon se, vendimi i gjykatës nuk i është njoftuar në përputhje me ligjin dhe kjo nuk ka asnjë lidhje me ato që parashikon neni 416/1 i KPP-së dhe për rrjedhojë mund të lind nevoja për ndryshimin përsëri të praktikës gjyqësore së vendosur me vendimin nr. 2/2022 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ose të bëhet ndërhyrje nga ligjvënësi, me qëllim që të përputhen dispozitat e KPP-së që kanë lidhje me institutin e rivendosjes në afat të ankimit dhe të shtrirjes së tij, të parashikuara nga nenet 420/1 dhe 416/1 të KPP-së.

Për këto që u thanë më sipër, duke u bazuar në nenin 112/6 të KPP-së, vota ime është kundër vendimit nr. 2, datë 18.11.2022 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Tiranë, më datë 18.11.2022

Gjyqtar: Medi Bici

MENDIM PAKICE

Ne gjyqtarët Margarita Buhali dhe Sokol Ngresi kemi votuar kundër vendimit të marrë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me nevojën për ndryshimin e sentencës së tretë të vendimit njësues nr. 1, datë 20.1.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, dhe për rrjedhojë, edhe për zgjidhjen e çështjes konkrete objekt gjykimi.

1. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke iu referuar akteve dhe provave që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe shkaqeve të ankimit, vendosën të ndryshojnë përcaktimet e vendimit njësues nr. 1, datë 20.1.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, konkretisht sentencën e tretë të këtij vendimi, sipas së cilës: "*Në çështjet penale me disa të pandehur gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i pandehuri, i cili nuk ka ushtruar ankim, kur konstatohet se çështja është gjykuar mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri*".

2. Ky qëndrim u argumentua nga shumica me ndryshimin e kuadrit ligjor të KPP-së, nenin 43 të Kushtetutës dhe qëndrimet e mbajtura nga Gjykata e Strasburgut për të garantuar të drejtën e ankimit të të pandehurit në rastet e gjykimit në mungesë, si një garanci për mbrojtjen dhe pjesëmarrjes së të pandehurit në gjykim. Më konkretisht nga shumica është theksuar në vendim se *"Kufizimi i sipërcituar i sentencës së vendimit njësues nr. 1/2011 nuk është në harmoni me nenin 43 të Kushtetutës, si edhe me standardet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Referuar jurisprudencës së kësaj gjykate konsiderohet cenim i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pamundësia e personit të gjykuar në mungesë, për të ankimuar vendimin e dënimit të tij, por edhe për të garantuar të drejtën e personave të sipërcituar, për t'u dëgjuar, në të njëjtat kushte, sikurse i gjykuari i pranishëm në proces, edhe në kushtet e "investimit" të gjykatës që trajton situatën procesuale të të pandehurit, të gjykuar në mungesë, (apo që nuk ka paraqitur ankim) mbi bazën e "shtrirjes/zgjerimit të ankimit të papersonalizuar të paraqitur prej të gjykuarit të pranishëm, pra, në thelb, për të trajtuar këtë situatë edhe për pjesën që u takon bashkëtëpandehurve të tjerë që nuk kanë ushtruar ankim brenda kufijve që referojnë shkaqet (jopersonale) të ngritura në ankim" (përcaktimi i nenit 425/1 të KPP-së).*

3. Në përfundim nga shumica u vendos të ndryshohej sentenca e tretë e vendimit njësues nr. 1, datë 20.1.2011 në këtë mënyrë: "***I gjykuari në mungesë, kur provohet se nuk ka marrë dijeni për vendimin e dënimit, ka të drejtën të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit, pavarësisht se çështja është gjykuar në gjykatat më të larta mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri. Gjykata që shqyrton kërkesën për rivendosje në afat vlerëson formalisht nëse shkaqet e ankimit të të gjykuarit në mungesë janë të njëjta me shkaqet jopersonale të shqyrtuara më parë nga gjykatat më të larta mbi ankimin e bashkëtëpandehurit tjetër. Gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i gjykuari në mungesë, i cili nuk ka ushtruar ankim, nëse ai parashtron shkaqe të tjera, të ndryshme nga ato, për të cilat është shprehur më parë gjykata më e lartë në vendimin e marrë mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurit për shkaqe jopersonale të këtij të fundit.***"

4. Si gjyqtarë në pakicë kemi votuar kundër këtij vendimi, pasi për mendimin tonë, çështja objekt gjykimi nuk përmban shkaqe të drejtpërdrejta që përfshihen në rregullimin që ka bërë sentenca e tretë e vendimit njësues nr. 1, datë 20.1.2011, si dhe nuk ekzistojnë kushtet për ta ndryshuar këtë të fundit.

5. Sikurse pranohet nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë, vendimet njësuese kanë fuqi detyruese për zbatimin në mënyrë të njëjtë të ligjit në çështje të njëjta ose të ngjashme, ndërsa ndryshimi i kësaj praktike nga Kolegjet e Bashkuara duhet të ndodhë në raste më të kufizuara që diktohen nga nevoja për zgjidhjen e drejtë të çështjes konkrete, e cila nuk është e mundur të zgjidhet në kushtet e përplasjeve të jurisprudencës me interpretimet ligjore të mëparshme të vendimeve njësuese. Ndryshimi i një praktike të mëparshme unifikuese mund të bëhet vetëm në raste shumë të kufizuara, të cilat diktohen nga risitë e sjella me ndryshimet e legjislacionit, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Strasburgut etj.

6. Shumica ka theksuar si shkak për ndryshimin e vendimit njësues nr. 1/2011 respektimin e së drejtës së të pandehurit të gjykuar në mungesë për t'u dëgjuar dhe për t'u ankuar në një gjykatë më të lartë ndaj një vendimi gjyqësor personalisht, megjithëse vendimi mund të jetë ankimuar nga bashkëipandehuri për motive jopersonale, pasi e drejta e ankimin është një e drejtë personale.

7. Si gjyqtarë në pakicë, çmojmë të ritheksojmë qëndrimin e qartë që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë mbajtur lidhur me kuptimin kushtetues të procedurës për ndryshimin e praktikës gjyqësore, në vendimin nr. 1, datë 28.10.2022, ku kanë theksuar se,

"*17. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, pas ndryshimeve të vitit 2016, ka përcaktuar se "Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet sipas ligjit.". Në kuptim të këtij rregullimi kushtetues do të duhet që procesi njësues apo ndryshues i praktikës gjyqësore dhe juridiksionalizmi i së drejtës të jetë një gjykim me karakter objektiv dhe me efekte erga omnes, i lidhur pazgjidhshmërisht me interesin publik dhe në funksion të garantimit të sigurisë juridike. Procesi i ndryshimit dhe njësimit të praktikës gjyqësore, nga njëra anë, dhe detyrimi i gjykatave të zakonshme për të zbatuar vendimet nomofilatike, nga ana tjetër, i shërbejnë vlerave të uniformitetit, qëndrueshmërisë dhe parashikueshmërisë në zbatimin e së drejtës. Në këtë mënyrë parandalohet arbitrariteti në zbatimin e ligjit dhe garantohen parimet kushtetuese të sigurisë juridike dhe barazisë përpara ligjit.*

18. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton, midis të tjerave, edhe rregullin e vazhdimësisë së jurisprudencës gjyqësore. Edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka konsoliduar qëndrimin e saj duke pranuar se, "në aspektin kushtetues është e pamundur dhe e palejueshme që doktrina kushtetuese zyrtare të riinterpretohet në një mënyrë të tillë që ndryshon sistemin e vlerave të sanksionuara në Kushtetutë, që mohon pajtueshmërinë e vlerave me njëra – tjetrën, që redukton garancitë mbrojtëse të epërsisë së saj në sistemin juridik, që mohon konceptimin e Kushtetutës si një akt i vetëm dhe sistem harmonik, që redukton garancitë e të drejtave dhe lirive të sanksionuara dhe që ndryshon modelin e ndarjes së pushteteve të rregulluara në Kushtetutë. Çdo ndryshim i "precedentëve të Gjykatës Kushtetuese apo korrigjim i doktrinës kushtetuese zyrtare nuk mund të bëhet mbi bazën e faktorëve të rastit, siç mund të jetë edhe ndryshimi i përbërjes së saj" (shih më gjerë vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 29.4.2010)." Sigurimi i vazhdimësisë së jurisprudencës kushtetuese theksohet në vendimin e sipërcituar "përbën një detyrim për Gjykatën, por, nga ana tjetër, në mënyrë të natyrshme jurisprudenca nuk mund të mos i nënshtrohet edhe evoluimit të saj. Nga kjo pikëpamje, ekziston përherë mundësia që jurisprudenca, duke u plotësuar përmes konkluzionesh të reja interpretuese edhe të ndryshohet, por Gjykata thekson se një ndryshim i praktikës mund të realizohet nëse ekzistojnë arsye të forta që do ta justifikojnë një ndërmarrje të tillë dhe vetëm në rastet kur kjo është e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar. Duke vendosur në kundërshtim me një praktikë të konsoliduar dhe pa dhënë argumente në lidhje me këtë fakt, Gjykata shmanget nga korniza e rregullave të një procesi të drejtë e të ndershëm, duke i mohuar mbrojtjen gjyqësore kërkuesit në kuptim të asaj se çfarë ky i fundit priste, bazuar në jurisprudencën e vetë Gjykatës".

Një qëndrim i tillë është ritheksuar dhe konsoliduar më tej edhe në vendimet nr. 30, datë 17.6.2010, nr. 21, datë 29.4.2010, nr. 20, datë 1.6.2011 dhe nr. 3 datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

19. Vendimet gjyqësore dhe, për më tepër, vendimet njësuese duhet të ndryshohen vetëm për rrethana të jashtëzakonshme. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ruajtja e qëndrimeve të mbajtura në vendimet e mëparshme është në interes të stabilitetit, por edhe të legjitimitetit institucional. Nëse praktika gjyqësore e ka zbatuar për një periudhë të gjatë një normë ligjore, referuar një qëndrimi njësues, padyshim që kjo situatë nuk mund të mos vlerësohet si një rrethanë e rëndësishme për stabilitet jurisprudencial.

20. Çdo kolegj i Gjykatës së Lartë në fushën që vepron, si dhe Kolegjet e Bashkuara të kësaj gjykate bëjnë njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore lidhur me mënyrën e kuptimit e zbatimit të ligjit nëpërmjet rolit të tyre natyror kushtetues, që është ai i shqyrtimit dhe i zgjidhjes së çështjes konkrete. Nëse kolegjet me trupën gjyqësore prej pesë anëtarësh bëjnë njësimin e praktikës gjyqësore për të orientuar zbatimin unik të ligjit, Kolegjet e Bashkuara ndryshojnë praktikën gjyqësore të njësuar më parë; pra ndryshojnë mënyrën se si është orientuar kuptimi i ligjit nga kolegjet njësuese. Vendimet njësuese ose unifikuese siç njiheshin më parë, kanë fuqi detyruese për të rregulluar mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat në çështje të ngjashme, ndërsa vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë bëjnë të mundur ndryshimin e kësaj praktike gjyqësore, duke krijuar njëkohësisht një praktikë të re. Duke qenë se vendimet njësuese kanë fuqi detyruese për zbatimin unik të ligjit në çështje të njëjta ose të ngjashme, ndryshimi i kësaj praktike nga Kolegjet e Bashkuara duhet të ndodhë në raste sa më të kufizuara e të diktuara nga nevoja për zgjidhjen e drejtë të çështjes konkrete, e cila nuk është e mundur të zgjidhet në kushtet e përplasjeve të jurisprudencës me interpretimet ligjore të mëparshme të vendimeve njësuese. Pra, qëllimi që justifikon përfshirjen e Kolegjeve të Bashkuara në ndryshim të praktikës gjyqësore njësuese është zgjidhja e çështjes konkrete për shkak të specifikave që ajo paraqet. Janë pikërisht veçoritë e rrethanave të çështjes, që e vendosin kolegjin që inicion ndryshimin e vendimit njësues në pamundësi për një zgjidhje të drejtë të çështjes, për shkak të kufizimit dhe imponimit interpretues që krijon një vendim njësues në fuqi.

21. Pra, para së gjithash, kolegji iniciues ka detyrimin të arsyetojë pamundësinë e zgjidhjes së çështjes për shkak të kufizimeve të vendimit njësues ekzistues dhe të argumentojnë nevojën për ndryshimin e këtij vendimi, për shkak të arsyeve të rëndësishme që paraqiten në aspektin kushtetues, ligjor, të jurisprudencës ndërkombëtare, apo për çdo rrethanë tjetër thelbësore. Verifikimi i dy kushteve paraprake të sipërcituara, siç është a) varësia e çështjes nga ndryshimi i praktikës njësuese dhe b) nevoja për ndryshim, janë të karakterit procedural, plotësimi i të cilave i paraprin vlerësimit të mëtejshëm në themel të kërkesës për ndryshim. Vetëm kur Kolegjet e Bashkuara binden për ekzistencën e njëkohshme të këtyre dy kushteve të domosdoshme mund të operojnë me ndryshimin e praktikës njësuese (unifikuese) dhe në varësi të qëndrimit që do të mbajnë do të bëjnë interpretimin e ri të institutit të së drejtës, objekt "ndryshimi-njësimi". Përndryshe, kur këto kushte "sine qua non" nuk plotësohen, atëherë kërkesa për ndryshim të vendimit njësues është e papranueshme...

28. Përpos sa u arsyetua më sipër, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë gjithashtu se ndryshimi i praktikës njësuese është një situatë që nuk ndodh dhe as nuk duhet të ndodhë në mënyrë të shpeshtë. Përpara marrjes së një vendimi që zgjidh çështjen konkrete, çdo Kolegj i Gjykatës së Lartë mund të ndodhet në pamundësinë e zgjidhjes së çështjes për shkak të mënyrës së formulimit të dispozitës ligjore, ose të ekzistencës së një vendimi njësues të Kolegjeve të Bashkuara që ka krijuar problematikë në mënyrën e zgjidhjes që jep. Fillimisht, Kolegji do të kërkojë t'i japi zgjidhje çështjes konkrete nëpërmjet një interpretimi pajtues të normës ligjore dhe në pamundësi të zgjidhjes mund të vlerësohet nisja e procedurës për kontrollin e kushtetutshmërisë së normës, nëpërmjet gjykimit incidental. Vetëm në rastin e ekzistencës së një vendimi njësues që mund të ketë krijuar problematika në zbatim mund të nisë procedura për ndryshimin e vendimit njësues.

29. Për të ndryshuar vendimet njësuese të Gjykatës së Lartë, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se nuk mjafton vetëm pasja e një opinioni ndryshe për të, por duhet të ekzistojnë disa rrethana dhe arsye të forta, që siç thotë jurisprudenca kushtetuese, e justifikojnë një ndërmarrje të tillë dhe se nevoja për ndryshimin e jurisprudencës është "e paevitueshme, objektivisht e domosdoshme, si dhe kushtetutshmërisht e bazuar dhe e arsyetuar". Element esencial në punën e gjykatës është besueshmëria e publikut, e cila cenohet në ato raste kur gjykata ndryshon qëndrimin e saj njësues, pa një bazë të arsyeshme kushtetueshmërie e ligjshmërie për ndërmarrjen e kësaj iniciative. Është detyrë e Gjykatës së Lartë që nëpërmjet veprimtarisë së saj në njësimin e praktikës gjyqësore dhe kufizimit të mundësisë së ndryshimit të shpeshtë të praktikës së njësuar në të ardhmen të garantojë stabilitet e vazhdimësi, vendimmarrje unike për çështje të njëjta ose të ngjashme, respektim të parimit të sigurisë juridike dhe të parimit të barazisë së palëve para ligjit".

8. Si gjyqtarë në pakicë, referuar jurisprudencës së mësipërme të Gjykatës së Lartë, ndryshe nga qëndrimi i shumicës, çmojmë se nuk ka asnjë rrethanë të ndryshme apo arsye të fortë, nga ajo situatë juridike mbi të cilën, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë arritur në atë sentencë njësuese, përveçse një qëndrimi esencialisht të ndryshëm kuptimor mbi interpretimin e neneve 147, 416 dhe 425 të KPP-së (përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 35/2017). Për më tepër, ky ndryshim sjell një interpretim jo të përshtatshëm për praktikën e mëtejshme gjyqësore, në kushtet që neni 147 pika 2 i KPP i interpretuar nëpërmjet vendimit njësues nr. 1/2011, tashmë është shfuqizuar me ligjin nr. 35/2017, duke gjetur kjo situatë një trajtim të pjesshëm në nenin 420/1 dhe më tej në nenin 450 germa "e" të këtij Kodi.

9. Përpara ndryshimeve të KPP, të bëra me ligjin nr. 35/2017, rivendosja në afat, si një mjet procedural

për të garantuar të drejtën e palëve ne proces për të ushtruar të drejtën e ankimit, parashikohej në nenin 147 të këtij Kodi, rregullim që zbatohej për çdo fazë të procesit gjyqësor, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e ankimit ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë dhe të drejtën e rekursit ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës së apelit, si dhe pa diferencuar situatën që ka passjellë dhënien e vendimit në mungesë, duke përfshirë, si rastin e mungesës dhe largimit të vullnetshëm të të pandehurit, ashtu edhe rastet kur i pandehuri nuk gjendej apo i fshihej drejtësisë.

10. Ndërkohë, me ndryshimet e këtij Kodi, të bëra me ligjin nr.35/2017, rivendosja në afat e ankimit, tashmë i njihet si e drejtë procedurale vetëm të pandehurit të gjykuar në mungesë, sipas parashikimeve të nenit 351 të KPP që bën fjalë për rastin e mungesës dhe largimit të vullnetshëm të të pandehurit, duke mos ia njohur këtë të drejtë të pandehurit që i fshihet drejtësisë. Lidhur me këtë situatë, risia që ka sjellë ligji nr. 35/2017, është njohja e së drejtës së të pandehurit të gjykuar në mungesë, sipas nenit 352 të KPP (që trajton rastin e mosgjetjes së të pandehurit dhe rastin kur i pandehuri i është fshehur drejtësisë), për të kërkuar rigjykim, nëpërmjet rishikimit të vendimit.

11. Pra ligjvënësi ka reflektuar lidhur me përmbushjen e detyrimeve të rrjedhura nga jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut, duke përcaktuar qartësisht mënyrën e respektimit të së drejtës për t'u dëgjuar të kësaj kategorie të gjykuarish, ndërkohë që ka vijuar të ketë të njëjtën qasje për mënyrën e ushtrimit të së drejtës së ankimit për të pandehurit të gjykuar në mungesë, sipas nenit 351 të KPP (që bën fjalë për rastin e mungesës dhe largimit të vullnetshëm të të pandehurit). Duke pranuar se pjesë e pandarë e legjislacionit të brendshëm bëhen edhe vendimet njësuese të Gjykatës së Lartë, kjo për shkak të fuqisë detyruese për zbatimin në mënyrë të njëjtë të ligjit në çështje të njëjta ose të ngjashme, duket që ligjvënësi nuk ka dashur të ndryshojë qasje nga tradita tashmë e krijuar në zbatimin e nenit 147 të KPP, sipas njësimit të bërë me sentencën e tretë të vendimin njësues nr.1 datë 20.1.2011, sikundër çmojmë se dhe ndryshimet në dispozitat e tjera procedurale, nuk kanë sjellë ndonjë përplasje mes kësaj sentence dhe situatës së re juridike.

12. Kështu, sipas nenit 416 të KPP: "*1.Ankimi i bërë nga një i pandehur, kur nuk bazohet vetëm në motive personale, vlen edhe për të pandehurit e tjerë*". Lidhur me këtë dispozitë ende të pandryshuar, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin njësues nr.1 datë 20.1.2011 kanë theksuar se "....*Në rastet kur ka më shumë se një të pandehur, karakteri individual i ankimit vazhdon të ruhet, por për shkak të specifikës së këtij lloji vendimi, ligji parashikon një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, kur në nenin 416 të KPP parashikon se "Ankimi i bërë nga një i pandehur, kur nuk bazohet vetëm në motive personale, vlen edhe për të pandehurit e tjerë.....". Dispozitat e mësipërme favorizojnë pozitën që ka një i pandehur, i cili nuk ka bërë apel/ankim, pasi ai mund të përfitojë nga apeli/ankimi i bashkë të pandehurit, pasi gjykata, sipas rastit, mund të prishë vendimin gjyqësor pavarësisht mos ankimit prej tij*".

13. Padyshim që ky rregull i parashikuar në nenin 416 të KPP, i jep vlerë ankimit të bërë nga një prej të pandehurve, edhe për të pandehurit e tjerë, për ato elemente të gjykimit që lidhen edhe me të pandehurit e tjerë, jo në aspektin "in peius", ndërkohë që garancia për të mos rënduar pozitën e këtyre të fundit, sigurohet nga neni 425 pika 3 e KPP, sipas të cilit: "*Kur apelues është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të përcaktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar*". Vetëm në rastet kur apelues është edhe prokurori, kjo garanci cenohet, edhe për të pandehurit që nuk kanë ushtruar ankim.

14. Nga ana tjetër, neni 425 pika 1 e KPP, përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr.35/2017, parashikonte se, "*Gjykata e apelit e shqyrton çështjen në tërësi dhe nuk kufizohet vetëm me shkaqet e paraqitura në ankim. Ajo shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtëpandehurve që nuk kanë bërë ankim, brenda kufijve që referojnë shkaqet e ngritura në ankim*". Qartazi kjo dispozitë i njihte të drejtën gjykatës së apelit që, e investuar për të gjykuar çështjen në shkallë të dytë mbi ankimin e një prej bashkëtëpandehurve, lidhur me ankuesin/ankuesit e shqyrtonte çështjen në tërësi, pa u kufizuar në shkaqet e ankimit/ankimeve, gjithnjë duke respektuar garancinë e parashikuar nga pika 3 e kësaj dispozite lidhur me mospërkeqësimin e pozitës së ankuesit, ndërkohë që, për bashkëtëpandehurit joankues, shqyrtonte çështjen e kufizuar brenda shkaqeve të ngritura në ankimin e bashkëtëpandehurit që e kishte ushtruar këtë të drejtë (duke përfituar këta të fundit nga vendimmarrja e gjykatës me karakter favorizues ndaj të pandehurit ankimues).

15. Ndryshe nga sa pranon shumica, situata e krijuar me ndryshimet e nenit 425 të KPP, sipas ligjit nr. 35/2017, nuk është më e njëjtë në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes për bashkëtëpandehurit që nuk kanë ushtruar ankim (paragrafi 49 i vendimit). Edhe formalisht, për aq kohë sa ligjvënësi ka ndryshuar tërësisht pikën 1 të kësaj dispozite, nuk mund të thuhet se situata juridike ka mbetur e njëjtë.

16. Konkretisht, sipas këtyre ndryshimeve, neni 425 pika 1, ka këtë përmbajtje: "*1.Gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, si dhe për shkaqet e ngritura në ankim që nuk bazohen në motive personale, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtëpandehurve që nuk kanë bërë apel*". Gjykata e apelit, në situatën e re të krijuar mbi këto ndryshime, e investuar për të gjykuar çështjen

në shkallë të dytë mbi ankimin e disa prej bashkëtëpandehurve, lidhur me ankuesin/ankuesit e shqyrton çështjen e kufizuar brenda shkaqeve të ankimit/ankimeve. Megjithatë për bashkëtëpandehurit joankimues, tashmë gjykata e apelit ka detyrimin ta shqyrtojë çështjen, jo vetëm për shkaqet e ngritura në ankimin e bashkëtëpandehurit që nuk bazohen në motive personale (duke përfituar këta të fundit nga vendimmarrja e gjykatës me karakter favorizues ndaj të pandehurit ankimues), por edhe për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht.

17. Pra, me këto ndryshime ligjore, janë zgjeruar kufijtë e shqyrtimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së dytë, në lidhje me këtë kategori subjektesh. Tashmë gjykata e apelit ka detyrimin që çështjen ta shqyrtojë brenda shkaqeve të ankimit të bashkëtëpandehurit dhe, nëse këto shkaqe nuk bazohen në motive personale, ta shtrijë shqyrtimin gjyqësor mbi këto shkaqe edhe për bashkëtëpandehurit joankimues, por njëkohësisht të shqyrtojë me iniciativë çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, që e garantuar nga parimi i mosrëndimit të pozitës edhe për të pandehurin joankimues, i rrit garancinë këtij të fundit për kontrollin e çështjeve të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht.

18. Në këtë mënyrë, ky ndryshim ka krijuar nga njëra anë harmoni të plotë me nenin 416 pika 1 të KPP, lidhur me efektin që sjell ankimi i bërë nga një prej të pandehurve, edhe për të pandehurit e tjerë dhe nga ana tjetër, ka garantuar respektimin e standardeve ligjore për bashkëtëpandehurin joankimues, për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, siç mund të jenë kompetenca lëndore apo tokësore, rastet e pavlefshmërisë absolute të akteve procedurale, që, ndaj të pandehurit i referohen pikërisht pavlefshmërisë së njoftimeve, me pasojë cenimin e së drejtës së pjesëmarrjes, cilësimit juridik të veprës në aspektin favorizues etj. Pikërisht kjo qasje e re e ligjvënësit, ka sjellë garanci më të plota, nga njëra anë për zgjidhjen e drejtë dhe përfundimtare të çështjes dhe nga ana tjetër, sigurimin e së drejtës së të pandehurit joankimues për gjykim nga një instancë më e lartë gjyqësore.

19. Si gjyqtarë në pakicë vlerësojmë se interpretimi i së drejtës së ankimit të të pandehurit, i bërë nga shumica, i mëshon anës formale të tij, të shkëputur nga qëllimi substancial i kësaj të drejte, sikundër vjen gjithashtu i shkëputur nga disa parime të tjera të rëndësishme të legjislacionit, të cilat duhet të drejtpeshohen nga gjykata, por pa cenuar këtë baraspeshë të vendosur nga vetë ligjvënësi dhe të materializuar në dispozitat përkatëse procedurale.

20. Padyshim se e drejta e të pandehurit që çështja e tij të shqyrtohet nga një gjykatë më e lartë, është një nga të drejtat themelore dhe element i rëndësishëm i garancisë për një proces të rregullt. Kjo e drejtë sigurohet nëpërmjet njohjes së mundësisë së ankimimit të vendimit gjyqësor të një instance më të ulët, por kurrsesi kjo e fundit, e drejta e ankimit, si mjet procedural, nuk mund të trajtohet e shkëputur nga funksioni që synon të realizojë, që është e drejta e të pandehurit që çështja e tij të shqyrtohet nga një gjykatë më e lartë, në raport me gjithë garancitë e tjera që ofron legjislacioni, tej hapësirës ligjore procedurale e aq më pak, si qëllim në vetvete.

21. Gjykata Kushtetuese, lidhur me të drejtën e ankimit, në vendimin e saj nr.5/2009, ka theksuar ndër të tjera: "*Neni 43 i Kushtetutës parashikon se çdokush ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe. Gjykata Kushtetuese vlerëson se e drejta e ankimit kundër një vendimi gjyqësor është një nga të drejtat themelore të individit, e cila mbi bazën e parashikimit kushtetues gjen zbatim edhe në dispozitat materiale e procedurale konkrete. Në këtë mënyrë, çdo dispozitë ligjore që nuk respekton përmbajtjen e nenit 43 të Kushtetutës, duke sjellë si pasojë cenimin e një të drejte themelore të individit, konsiderohet si e papajtueshme me Kushtetutën dhe si e tillë duhet shfuqizuar. Në çështjen objekt kërkese, Gjykata Kushtetuese çmon se e drejta e ankimit e parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës duhet kuptuar si një mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar individit të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj, sipas kuadrit ligjor në fuqi për këtë qëllim*".

22. Qëndrimi që mban Gjykata Kushtetuese në këtë vendim, është pikërisht trajtimi dhe kuptimi i së drejtës së ankimit të parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës, si një instrument (por jo i vetëm) që i garanton individit të drejtën për tu përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj, gjithnjë sipas kuadrit ligjor në fuqi për këtë qëllim.

23. Më tej, Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr.12/2010, ka theksuar:"*Kushtetuta e Republikës se Shqipërisë, në nenin 43 të saj, ka vënë një standard më të lartë në krahasim me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, por kjo nuk do të thotë që e drejta e ankimit nuk mundet, në mënyrë absolute, t'iu shmanget kufizimeve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Kapitulli i të drejtave themelore, i parashikuar në Kushtetutë, ka një përmbajtje të tillë që, si rregull, nuk përjashton ndonjë të drejtë nga kufizimi dhe, në këtë kuptim, vlera e nenit 43 të Kushtetutës nuk mund të qëndrojë e ndarë nga vlerat e tjera kushtetuese siç është dhe ajo e rasteve përjashtimore për kufizimin e një të drejte themelore.*"

24. Në lidhje me kriteret e kufizimeve, Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr. 14, datë 5.7.2005 është shprehur se "*...kufizimet e mundshme që mund t'i bëhen njohjes dhe ushtrimit të kësaj të drejte (pra së drejtës së ankimit), nga legjislacioni i brendshëm, ...duhet të plotësojnë dy kushte themelore: të ndjekin një qëllim të ligjshëm dhe të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte".* Sipas Gjykatës Kushtetuese, këto "*...duhet të ballafaqohen para së gjithash me kërkesat e nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sipas të cilit, kufizimet e të drejtave dhe lirive kushtetuese mund të vendosen vetëm me ligj, për një interes*

publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, duke qenë gjithnjë në përpjesëtim me gjendjen që i ka diktuar. Ato nuk mund të cenojnë thelbin e së drejtës dhe në asnjë rast, nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

25. Si gjyqtarë në pakicë çmojmë se pikërisht, rregullat e përcaktuara në nenet 416 dhe 425, pika 1, të KPP-së, në përmbajtjen dhe qëllimin e tyre, të interpretuara në harmoni edhe me nenin 147 të KPP-së (përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 35/2017), si dhe sentenca e tretë e vendimit njësues nr. 1, datë 20.1.2011 të Kolegjeve të Bashkuara, janë në respektim të kësaj jurisprudence. Kufizimi i mundësisë së të pandehurit të gjykuar në mungesë për të rivendosur në afat të drejtën e ankimit, kur çështja është gjykuar më parë në themel mbi bazën e ankimit të një bashkëtëpandehuri tjetër, përveçse është vullnet i ligjvënësit, është në pajtim të plotë me jurisprudencën kushtetuese. Ky kufizim ndjek një qëllim të ligjshëm dhe që lidhet me bërjen e drejtësisë në kohë reale, garantimin e rendit juridik dhe interesit publik, parimin e sigurisë juridike, stabilitetin dhe qartësinë e politikës penale, ndërkohë që nuk prek thelbin e së drejtës së individit për tu përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj, gjithnjë sipas kuadrit ligjor në fuqi për këtë qëllim. Kërkesat e një gjykimi të drejtë duhet të shqyrtohen në çdo rast duke pasur parasysh zhvillimin e procedurës gjyqësore në tërësi dhe jo në bazë të një shqyrtimi të izoluar të një aspekti të veçantë të shkëputur nga procesi në tërësi.

26. Qëndrimi i mbajtur nga shumica, duke ndryshuar sentencën e mëparshme njësuese, në vlerësimin tonë si gjyqtarë në pakicë, prish balancën e parashikuar nga vetë ligjvënësi, në rregullat e përcaktuara në nenet 416 dhe 425 pika 1 të KPP-së, sipas përmbajtjes dhe qëllimit të tyre, të interpretuara në harmoni edhe me nenin 147 të KPP-së përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 35/2017.

27. Rishqyrtimi i çështjes nga gjykata e apelit, apo Gjykata e Lartë, pas rivendosjes në afat të të pandehurit që nuk ka ushtruar më parë ankim, ndërkohë që e njëjta çështje është shqyrtuar më parë në themel mbi ankimin e bashkëtëpandehurve të tjerë, do të sillte një vendimmarrje të re, e cila në vetvete do të krijonte premisat për rishikimin e vendimit të mëparshëm, sipas pikës 1 të nenit 450 të KPP-së. Në këtë kuptim, efektet zinxhirë të kësaj procedure, paqartësitë që do të sillnin në zgjidhjen përfundimtare duke ballafaquar dy apo me shumë vendime me zgjidhje të ndryshme, si dhe zgjatja në kohë, do të cenonin vetë thelbin e bërjes së drejtësisë si një mision kushtetues.

28. Nga ana tjetër, edhe nga pikëpamja procedurale, situata bëhet akoma më e paqartë. Sipas përmbajtjes së nenit 147 të KPP-së (para ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 35/2017) dhe nenit 420/1, gjykata që shqyrton kërkesën e të pandehurit për tu rivendosur në afat për të ushtruar të drejtën e ankimit, ka detyrimin të kufizohet në shqyrtimin e rrethanave që lidhen me pamundësinë e të pandehurit për ta ushtruar këtë të drejtë, për shkak të mosnjoftimit të vendimit që kërkohet të ankimohet. Duke zbatuar sentencën njësuese tashmë të ndryshuar, zgjerohen kufijtë e shqyrtimit gjyqësor në rastet e një kërkese të tillë, pasi gjykata do të duhet të verifikojë edhe shkaqet e parashtruara në ankimin e bashkëtëpandehurve të tjerë dhe mungesën e lidhjes që ato shkaqe kanë në raport me shkaqet e kërkuesit, si dhe në mënyrë të pashmangshme, do të kërkojë edhe një vlerësim qoftë edhe formal, të mënyrës së zgjidhjes së çështjes nga gjykata më e lartë, e investuar mbi ankimin e bashkëtëpandehurve të tjerë. Pyetja që lind natyrshëm në këtë situatë të krijuar është: A ka qenë ky vullneti i ligjvënësit në parashikimin e këtij mjeti procedural?

29. Vendimi gjyqësor që pranon kërkesën e të pandehurit për tu rivendosur në afat për të ushtruar të drejtën e ankimit, disponon vetëm mbi këtë kërkim. E vetmja konsekuencë që parashikon dispozita procedurale, neni 420/1 pika 5 është pezullimi i ekzekutimit të mëtejshëm të dënimit me burgim, i cili është vënë në ekzekutim për shkak se vendimi ka marrë formë të prerë si pasojë e mosushtrimit në kohë të ankimit. Pra në këtë rast, pasoja e vetme e vendimit gjyqësor që pranon kërkesën e të pandehurit për tu rivendosur në afat për të ushtruar të drejtën e ankimit, është rifitimi i statusit "i pandehur".

30. Edhe në çështjet penale me disa të pandehur, ky vendim gjyqësor që pranon kërkesën e të pandehurit për tu rivendosur në afat për të ushtruar të drejtën e ankimit, duhet të disponojë vetëm mbi këtë kërkim (ky ka qenë edhe vullneti i ligjvënësit), pa pasur asnjë mundësi procedurale për të cenuar efektet dhe zgjidhjen që gjykata e apelit i ka bërë çështjes me vendim përfundimtar lidhur me fajësinë për gjithë të gjykuarit, duke përfshirë edhe të pandehurin kërkues, cilësimin juridik të veprës penale, llojin dhe masat e dënimit, disponimin mbi provat materiale (për të cilat mund të jetë urdhëruar edhe asgjësimi i tyre). Për një situatë të tillë të ngjashme, ligjvënësi ka parashikuar pasojat e pranimit të ankimit, vetëm në rastin e kërkesës për rishikimin e vendimit të formës së prerë (neni 453 pika 3 e KPP-së).

31. Veç sa më sipër, si gjyqtarë në pakicë vlerësojmë se fillimi i procedurës për ndryshimin e vendimit njësues nr. 1/2011, duhet të jetë në varësi edhe të çështjes objekt shqyrtimi. Nisur nga rrethanat e kësaj të fundit, rezulton se e drejta e këtij të dënuari të gjykuar në mungesë për tu dëgjuar nga gjykata dhe e drejta e tij e ankimit, edhe pa

ndryshuar sentenca njësuese, garantohet dhe mund të realizohet nëpërmjet mjetit të jashtëzakonshëm të ankimit që është kërkesa për rishikim të vendimit. Një e drejtë e tillë ka qenë e parashikuar shprehimisht në ligjet në fuqi në kohën e dorëzimit të kërkesës së të dënuarit për rivendosjen në afat në janar 2017. Ndërsa aktualisht pas ndryshimit të KPP-së me ligjin nr. 35/2017, një e drejtë e tillë rishikimi është e parashikuar shprehimisht nga neni 450 i këtij Kodi.

32. Kështu, neni 449/1 i KPP-së në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për rivendosjen në afat parashikonte: "*Në rastet e caktuara me ligj lejohet në çdo kohë rishikimi i vendimeve që kanë marrë formë të prerë, edhe kur dënimi është ekzekutuar ose shuar*". Pra, sipas kësaj dispozite, rastet e rishikimit nuk janë parashikuar vetëm në nenin 450 të KPP-së, sikurse parashikohen aktualisht pas ndryshimit të nenit 449 nga ligji nr. 35/2017, por edhe në ligje të tjera, veç dispozitave të këtij Kodi. Kështu, në ligjin nr. 10193 datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale" në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për rivendosje, janë parashikuar raste të rishikimit të vendimeve gjyqësore penale, përveç atyre të parashikuara nga neni 450 të KPP-së.

33. Konkretisht, në nenin 42/ç të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, "Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale" (para ndryshimit nga ligji nr. 97/2021) që bën fjalë për ekstradimin e shtetasve të huaj, që janë gjykuar në mungesë, përcaktohet: "*I ekstraduari, nëse është gjykuar në mungesë, të ketë të drejtën e rishikimit të vendimit gjyqësor të dhënë ndaj tij*". Po në nenin 51/1 të këtij ligji përcaktohet: "*Kur personi i kërkuar ekstradohet, ai gëzon të gjithë të drejtat e parashikuara nga neni 42 i këtij ligji, me përjashtim të rastit kur i ekstraduari ka hequr dorë nga këto të drejta dhe kur shteti i kërkuar ka përcaktuar një gjë të tillë shprehimisht në kërkesë*". Referuar këtyre dispozitave, personi i ekstraduar si shtetas i huaj dhe ai shqiptar ka të drejtë të kërkojë rishikimin e vendimit sipas kushteve të ligjit nr. 10193/2009 kur është gjykuar në mungesë, dispozita këto që kanë qenë në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës për rivendosjen në afat nga kërkuesi.

34. I dënuari është transferuar në Shqipëri për vuajtjen e dënimit nëpërmjet procedurave të ekstradimit. Për rrjedhojë, ai gëzonte të drejtën që, nëpërmjet procedurave të rishikimit të realizonte të drejtën për tu dëgjuar dhe mbrojtur para gjykatës. Përderisa kuadri i atëhershëm i ligjit njihte të drejtën e të pandehurit për tu dëgjuar para gjykatës e pjesëmarrje në procesin penal ndaj tij nëpërmjet procedurës së rishikimit të vendimit të formës së prerë, kërkesa e të pandehurit për rivendosjen në afat është e pabazuar, pasi ankimi nuk paraqet mjetin e vetëm procedural për të garantuar këtë të drejtë të të dënuarit në mungesë për tu dëgjuar lidhur me çështjen penale në ngarkim të tij. Në kushtet, kur ka ekzistuar mjeti ligjor procedural për të garantuar të drejtën e të dënuarit për tu rihapur procesi penal i bërë ndaj tij, nuk ka pasur asnjë nevojë për të ndryshuar përcaktimet e vendimit njësues nr. 1/2011 lidhur me institutin e rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit për të dënuarin, kur çështja ishte gjykuar nga gjykata më e lartë me ankimin e bashkëtëpandehurit. Në rastin konkret, i dënuari nuk ka gjetur mjetin e duhur procedural për t'iu drejtuar gjykatës, pasi e drejta e tij e mbrojtjes garantohej nëpërmjet institutit të rishikimit dhe jo atij të rivendosjes në afat (neni 147 i KPP-së).

35. E njëjta procedurë rishikimi parashikohet aktualisht në KPP, në nenin 450 të tij për rastet e ekstradimit, si dhe gjykimit në mungesë sipas nenit 352 të KPP-së (që përkon me rastet e gjykimit në mungesë të të pandehurit sipas nenit 351 të këtij Kodi, para se të ndryshohej me ligjin nr. 35/2017).

36. Parimi i sigurisë juridike ka për qëllim të garantojë vazhdimësinë e të drejtave të të pandehurve të njohura nga ligji dhe faktin, që këto të drejta të mos ndryshojnë në mënyrë përkeqësuese. Në vendimet nr. 2/2013; nr. 26/2005; nr. 10/2008; nr. 33/2010 Gjykata Kushtetuese ka theksuar, se: *"Gjykata rikonfirmon se parimi i sigurisë juridike garanton parashikueshmërinë e sistemit normativ. Nxjerrja e normave juridike nuk i shërben vetëm zgjidhjes së një konflikti të mundshëm apo rregullimit të një situate të parregulluar më parë. Ky proces duhet të krijojë përshtypjen te subjektet e së drejtës se përmbajtja e normave juridike garanton siguri dhe qëndrueshmëri për të ardhmen. Siguria juridike trajtohet edhe si kusht për vlefshmërinë materiale të një akti, duke garantuar pandryshueshmërinë në parim të akteve normative, ku i kushtohet vëmendje rregullimit të situatave pa ndryshime substanciale në vazhdimësi, pasi në të kundërt do t'i vendosnim subjektet e së drejtës në pozicione të papëlqyeshme dhe të pafavorshme për ta. Përmbledhtazi, ligjvënësi duhej të mbajë parasysh se një situatë të rregulluar më parë, parimisht, mund ta ndryshojë vetëm nëse kjo sjell pasoja pozitive - konkretisht, trajtim më të mirë (financiar ose jo) – për subjektet përfituese dhe jo kur ndryshimi i akteve ligjore e përkeqëson situatën pra, kur i heq subjekteve përfituese një të drejtë të fituar më parë. Megjithatë, kjo Gjykatë ka theksuar se parimi i sigurisë juridike nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor i ndryshëm i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes publik, me të gjithë elementet e tij thelbësorë, ky interes natyrshëm do të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike".*

37. Sipas KPP-së, të drejtat e të pandehurve të gjykuar në mungesë ose të ekstraduar në Shqipëri garantohen nëpërmjet mjetit procedural të jashtëzakonshëm të ankimit që është kërkesa për rishikim. Të njëjtën garanci gëzonin kjo kategori të pandehurish edhe para ndryshimeve të KPP-së me ligjin nr. 35/2017, pasi kjo e drejtë njihej nga ligji nr. 10193/2009. Duke qenë se të drejtat e mbrojtjes së kësaj kategorie të pandehurish garantohej

në të njëjtën mënyrë, si para dhe pas ndryshimit me ligjin nr. 35/2017, parimi i sigurisë juridike gjendet i respektuar. Ky parim duhet të udhëheqë gjykatën edhe në interpretimin e zbatimin e ligjit, duke reflektuar se ligji i ndryshuar nuk përkeqëson pozitën e kësaj kategorie të pandehurish për të drejtën e ankimit.

38. Nga ana tjetër, kërkesa për rishikim të vendimit garanton, përveç së drejtës së të pandehurit për rishqyrtim të çështjes penale, edhe parimin e sigurisë juridike të garantuar për një vendim të formës së prerë, pasi ky institut vepron pikërisht ndaj kësaj kategorie vendimesh. Ndërkohë, siç u analizua edhe më lart, në rastet e pranimit të rivendosjes në afat të ankimit për një vendim të shqyrtuar nga gjykatat më të larta nga ankimi i bashkëtëpandehurit, ky parim cenohet pasi vendimi humb cilësinë e formës së prerë, jo vetëm për të pandehurin e rivendosur në afat, por edhe për të pandehurin tjetër që kishte bërë ankim, pasi ankimi bëhet për motive jopersonale, gjë që bën që ankimi i ri i bashkëtëpandehurit në mungesë të sjellë efekte sipas nenit 416 të KPP-së edhe për të pandehurin i cili personalisht ka bërë ankim, duke cenuar vendimin e formës së prerë edhe për të pandehurin e gjykuar në prezencë. Në këtë mënyrë do të cenohej parimi i gjësë së gjykuar për të pandehurit, pasi një çështje e zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të rishqyrtohej, përveçse nëpërmjet procedurës së rishikimit, sikurse ka garantuar ligji procedural.

39. Me vendimin nr. 51, datë 11.12.1999, Gjykata e Shkallës së Parë Sarandë, ka vendosur: "*Deklarimin fajtor të të pandehurit Adriatik Tomorr Muharremi për veprën penale "Vjedhja me pasojë vdekjen", parashikuar nga nenet 141–22 të KP-së dhe dënimin e tij me 25 vjet burgim; Deklarimin fajtor të të pandehurit Adriatik Tomor Muharremi për veprën penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit", parashikuar nga neni 278/2 i KP-së dhe dënimin e tij me 3 vjet burgim; Në aplikim të nenit 55 të KP-së, përfundimisht e dënon të pandehurin Adriatik Tomorr Muharremi me 25 vjet burgim.* Nga aktet e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se ndaj këtij shtetasi është caktuar masa e sigurimit "arrest në burg" në mungesë, masë kjo që nuk është zbatuar pasi kërkimet për gjetjen e të pandehurit nuk kanë rezultuar të suksesshme. I pandehuri është larguar menjëherë pas kryerjes së veprës penale dhe ekzekutimi i vendimit të dënimit është bërë i mundur vetëm pas një periudhe të gjatë kohe prej më shumë se 16 vjetësh, kur i pandehuri është dorëzuar në Shqipëri nëpërmjet procedurës së ekstradimit. Të gjitha këto rrethana provojnë se i pandehuri ka qenë në kërkim dhe me vullnetin e tij i është fshehur drejtësisë. Sipas nenit 33 të Kushtetutës parashikohet, se: *1. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet. 2. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.*

40. Pra, nga të gjitha rrethanat e provuara në gjykim, ky i pandehur rezulton t'i jetë fshehur drejtësisë. Megjithëse është banor i zonës, ku ka ndodhur ngjarja dhe komshi me personat viktimë, ai është larguar menjëherë jashtë shtetit dhe nuk është gjetur, edhe pse siç u tha më lart, ndaj tij është caktuar masa e sigurimit "arrest në burg". I pandehuri ka pretenduar se nuk ka qenë në dijeni të vendimit dhe të gjykimit, ndërsa nuk ka paraqitur asnjë argument për një pretendim të tillë, ndërkohë që shteti shqiptar ka marrë të gjitha masat për njoftimin e kapjen e tij. Për shkak se ai i është fshehur drejtësisë, kapja e tij është bërë e mundur vetëm pas kërkimeve ndërkombëtare. Koha e gjatë e kaluar nga kryerja e veprës, qëndrimi jashtë shtetit i të pandehurit, megjithëse banor i vendit ku kishte ndodhur ngjarja, largimi menjëherë pas ngjarjes, pranimi prej tij i faktit se ka qenë i pranishëm në vendin e ngjarjes në kohën e kryerjes së veprës dhe pavarësisht nga dijenia për ngjarjen, është larguar jashtë shtetit, si dhe masa e sigurimit e paekzekutuar, janë rrethana që dukshëm provojnë se i dënuari me dashje i është fshehur drejtësisë. Prandaj ai nuk mund të përfitojë të drejtën e rivendosjes në afat të ankimit sipas nenit 147 të KPP-së (para ndryshimit me ligjin nr. 35/2017). Në këtë kuptim, bazuar në këtë çështje konkrete objekt gjykimi, nuk ka vend për të filluar procedurën për ndryshimin e sentencës së tretë të vendimit njësues nr. 1/2011 që, sikundër është arsyetuar nga shumica, synon të njohë këtë të drejtë për rivendosjen në afat për rastin e mungesës dhe largimit të vullnetshëm të të pandehurit.

41. Sipas nenit 416 të KPP-së: *"Ankimi i bërë nga një i pandehur, kur nuk bazohet vetëm në motive personale, vlen edhe për të pandehurit e tjerë".* Sipas shumicës ky ankim vlen vetëm kur bëhet dhe sjell efekte pozitive. Pakica çmon të evidentojë faktin se kjo dispozitë procedurale ka pasur të njëjtin formulim edhe në kohën e gjykimit të çështjes në themel mbi ankimin e bashkëtëpandehurit Dhurim Tusha, pasi kjo dispozitë nuk ka pësuar ndryshim. Ndërkohë neni 425 i KPP-së, në kohën e shqyrtimit të ankimit të bashkëtëpandehurit dhe të paraqitjes së kërkesës për rivendosje në afat parashikonte se "*Gjykata e apelit e shqyrton çështjen në tërësi dhe nuk kufizohet vetëm me shkaqet e paraqitura në ankim. Ajo shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtëpandehurve <u>që nuk kanë bërë ankim brenda kufijve që referojnë shkaqet e ngritura në ankim</u>*". Me ligjin nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në KPP", neni 425 i KPP-së parashikon se "*Gjykata e apelit e shqyrton çështjen brenda shkaqeve të ngritura në ankim. Për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht, si dhe <u>për shkaqet e ngritura në ankim që nuk bazohen në motive personale</u>, gjykata e apelit shqyrton edhe pjesën që u takon bashkëtëpandehurve që nuk kanë bërë apel*"

42. Kolegjet e Bashkuara në çështjen objekt gjykimi konstatuan se "*përmbajtja e kësaj dispozite lidhet ngushtësisht me parashikimin e nenit 416/1 të KPP-së që parashikon shtrirjen apo zgjerimin e "hapësirës" së diskrecionit gjykues të gjykatës së*

apelit, për të disponuar mbi ankimin e paraqitur nga bashkëipandehuri, edhe për pjesën takuese të bashkëtëpandehurve që nuk kanë ushtruar ankim, brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në ankim, në rastin kur ankimi i bërë nga bashkëipandehuri nuk bazohet në motive personale."

43. Si gjyqtar në pakicë vlerësojmë se për të interpretuar nëse i dënuari ka të drejtën e rivendosjes në afat të ankimit në çështjen konkrete duhet të mbahej në konsideratë kuadri ligjor, që ka ekzistuar në kohën, kur çështja penale e themelit në ngarkim të tij është shqyrtuar në gjykatën më të lartë (gjykata e apelit ose gjykata e lartë) mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurit. Siç u analizua edhe më lart, sipas nenit 425 të KPP-së, si para dhe pas ndryshimit me ligjin nr. 35/2017, gjykata e apelit e shqyrton çështjen për të pandehurin që nuk ka bërë ankim brenda shkaqeve të ankimit të ngritura nga bashkëipandehuri ankues. Parashikimi i nenit 416 të KPP-së se ankimi i bashkëtëpandehurit, që nuk bazohet në motive personale vlen edhe për të pandehurin që nuk ka bërë ankim, nuk do të thotë se ky ankim konsiderohet i vlefshëm vetëm kur rezultati është pozitiv, sikurse ka interpretuar shumica, por ka kuptimin e vlerës së ankimit si mjet procedurial që legjitimon shqyrtimin e çështjes nga gjykata e apelit jo vetëm për të pandehurin ankues, por edhe për të pandehurin joankues.

44. Vendimi njësues nr. 1/2014 nuk solli ndonjë ndryshim në përcaktimet e vendimit njësues nr. 1/2011 për të drejtën e rivendosjes në afat të ankimit të bashkëtëpandehurit kur çështja ishte shqyrtuar në gjykatën më të lartë mbi ankimin e bashkëtëpandehurit tjetër për motive jopersonale, pasi ky vendim njësues nuk kishte shtruar si çështje për njësim ose ndryshim të njësimit të mëparshëm të drejtën e rivendosjes së ankimit për bashkëtëpandehurit, por të drejtën e ankimit të mbrojtësve të zgjedhur nga të pandehurit ose të mbrojtësve të caktuar nga familjarët ose kryesisht etj.

45. Kolegjet e Bashkuara në çështjen në shqyrtim konkluduan, se: ***Gjykata duhet të pranojë kërkesën për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit të paraqitur nga i gjykuari në mungesë, i cili nuk ka ushtruar ankim, nëse ai parashtron shkaqe të tjera, të ndryshme nga ato, për të cilat është shprehur më parë gjykata më e lartë në vendimin e marrë mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurit për shkaqe jopersonale të këtij të fundit.*** Si gjyqtarë në pakicë çmojmë se kjo sentencë njësuese zgjeron rastet ligjore të ushtrimit të ankimit nga i gjykuari në mungesë, megjithëse çështja është shqyrtuar në gjykatën më të lartë edhe për këtë të pandehur mbi bazën e ankimit të bashkëtëpandehurit, pasi neni 416 i KPP-së i referohet ankimit si mjet procedural që vlen edhe për të pandehurin që nuk ka bërë ankim, duke përjashtuar vetëm ankimet me motive personale. Kjo do të thotë se ankimi i bërë nga i bashkëipandehuri konsiderohet ankim i bërë edhe nga i pandehuri që nuk e ka ushtruar këtë të drejtë, pavarësisht nga fakti nëse i pandehuri ka qenë apo jo i gjykuar në mungesë.

46. Sipas nenit 416 të KPP-së gjykata kur shqyrton kërkesën për rivendosjen në afat të bërë nga bashkëipandehuri i gjykuar në mungesë, është e detyruar të verifikojë vetëm nëse ankimi i bërë nga bashkëipandehuri tjetër ka qenë për motive personale apo jo. Nëse ky ankim tashmë i shqyrtuar nga gjykatat më të lartë nuk ka qenë për motive personale, kjo prezumon se ankimi ka vlejtur si mjet procedural për shqyrtimin e çështjes në gjykatën më të lartë edhe për të pandehurin në mungesë që aktualisht kërkon rivendosjen në afat të ankimit. Ankimi i bërë nga bashkëipandehuri tej motiveve personale konsiderohet ankim edhe i bashkëtëpandehurit joankues në mungesë dhe nuk kanë rëndësi shkaqet konkrete të ankimit të prezantuara nga i pandehuri ankues. Mjafton fakti, që shkaqet e ankimit të jenë për motive jopersonale dhe ato konsiderohen të mjaftueshme për të penguar ushtrimin e një ankimi tjetër të mëvonshëm ndaj të njëjtit vendim qoftë edhe për bashkëtëpandehurin të gjykuar në mungesë pas shqyrtimit të çështjes nga gjykata më e lartë. Për më tepër, pas ndryshimeve të kësaj dispozite me ligjin nr. 35/2017, gjykata e apelit, për bashkëtëpandehurit joankimues, ka detyrimin ta shqyrtojë çështjen, jo vetëm për shkaqet e ngritura në ankimin e bashkëtëpandehurit që nuk bazohen në motive personale (duke përfituar këta të fundit nga vendimmarrja e gjykatës me karakter favorizues ndaj të pandehurit ankimues), por edhe për çështje të ligjit që duhet të shqyrtohen kryesisht.

47. Mënyra e formulimit të sentencës njësuese krijon paqartësi në zbatimin praktik pasi i jep mundësi bashkëtëpandehurit të gjykuar në mungesë, joankues, të paraqesë kërkesë për rivendosje në afat të një ankimi për shkaqe të tjera të ndryshme nga ato që janë prezantuar fillimisht nga bashkëipandehuri ankues dhe që janë shqyrtuar tashmë me vendim themeli nga gjykata më e lartë. Kjo do t'i jepte mundësi bashkëtëpandehurve në mungesë të pretendonin rishqyrtimin e çështjes nëpërmjet ankimit, megjithëse çështja në gjykatën më të lartë ishte shqyrtuar mbi bazën e një ankimi të vlefshëm edhe për ta, të bërë nga një bashkëtëpandehur ankues, por që nuk është gjendur i bazuar nga gjykata më e lartë, duke i hapur rrugë kështu cenimit të sigurisë juridike.

48. Çmojmë se arsyetimi i shumicës, që e lidh kriterin kufizues të ankimit nga bashkëipandehuri me shkaqet e ankimit të ngritura më parë nga bashkëipandehuri sipas nenit 416 të KPP-së, jo vetëm vjen në kundërshtim me qëllimin e kësaj dispozite, por vjen në kundërshtim edhe me vetë përcaktimet e nenit 425 të KPP-së. Rëndësia e shkaqeve të ankimit për shqyrtimin e çështjes në gjykatën më të lartë ishte parashikuar edhe në dispozitat në fuqi

në kohën e shqyrtimit të çështjes në apel, para ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 35/2017. Kështu, në nenin 415 të KPP-së parashikohet se palët kanë të drejtë të shtojnë shkaqet e ankimit 5 ditë para seancës gjyqësore. Kjo do të thotë se parashikimi që gjykata e apelit e shqyrton çështjen në tërësi, pavarësisht ankimit të një të pandehuri (neni 425 para ndryshimit) nënkupton se çështja shqyrtohet edhe për të pandehurin, që nuk ka bërë ankim dhe jo që gjykata shqyrton çështjen tej shkaqeve të ankimit.

49. Shkaqet e ankimit janë ato të prezantuara në ankim dhe çdo gjë që nuk është prezantuar në të ose nuk është shtuar sipas nenit 415 të KPP-së, konsiderohet se ka rënë në dekadencë. Kjo vlen jo vetëm për të pandehurin ankues, por edhe për të pandehurin joankues. Prandaj ky i pandehur nuk mund të ankimojë vendimin për shkaqe të tjera, të cilat megjithëse ndryshojnë nga ato të ankimit të bashkëtëpandehurit, kanë të bëjnë me rrethanat e faktit, kualifikimin e veprës penale etj., elemente këto të procesit që janë shqyrtuar nga gjykata më parë. Neni 416 i KPP-së lejon ankimet nga bashkëipandehuri jo ankues vetëm në rast se ankimi i bashkëtëpandehurit ankues ishte bërë për motive personale. Për rrjedhojë fokusi i interpretimit e vlerësimit ligjor nga gjykatat në rastet e kërkesave për rivendosje në afat duhet të përqendrohet te shkaqet e ankimit vetëm për të kualifikuar nëse ato përbëjnë motive personale apo jo. Për aq kohë sa shkaqet e ankimit kanë të bëjnë me ekzistencën ose jo të faktit penal, mekanizmin e ngjarjes, kushtet për lindjen e përgjegjësisë penale për secilin bashkëtëpandehur, cilësimin juridik të veprës, për rrjedhojë ato ndikojnë edhe vendimmarrjen ndaj bashkëtëpandehurit joankimues duke prodhuar një produkt përfundimtar për përfundimin e procesit penal.

50. Megjithëse në këto ankime, që shoqërojnë kërkesat për rivendosje në afat, mund të paraqiten shkaqe, të cilat janë të ndryshme në thelb nga ato të prezantuara në ankimet e mëparshme, përsëri këto shkaqe kanë të bëjnë në thelb me elementet përmbajtësore të vendimit gjyqësor dhe si të tilla janë jashtë sentencës "motive personale". Ushtrimi i ankimit nëpërmjet rivendosjes në afat për shkaqe të tjera jopersonale nga ato të shqyrtuara nëpërmjet ankimeve të mëparshme nga gjykatat më të larta, mund të rihapë procesin në gjykatën më të lartë, jo vetëm për të pandehurin e rivendosur në afat, por edhe për të pandehurin për të cilin çështja është shqyrtuar më parë në kuptim të nenit 416 e 425 të KPP, megjithëse për këtë të pandehur vendimi ka marrë formë të prerë dhe është zgjidhur përfundimisht. Në këtë kuadër, pakica rithekson vlerësimin e saj se cenohet parimi i sigurisë juridike, jo vetëm formalisht për vendimin e formës së prerë për të pandehurin joankues, por edhe për atë që e ka ushtruar ankimin më parë. Vendimet e formës së prerë për ata të pandehur, që e kanë ushtruar të drejtën e ankimit përbëjnë "gjë të gjykuar" dhe mundësia e vetme për të rrëzuar fuqinë e këtyre vendimeve në aspektin procedural është nëpërmjet procedurës së rishikimit dhe jo nëpërmjet ankimeve të bashkëtëpandehurve të tjerë të gjykuar në mungesë.

51. Në përfundim të kësaj analize, nisur nga kuadri ligjor ekzistues në kohën e paraqitjes së kërkesës objekt gjykimi, zhvillimi i ligjit procedural, respektimi i parimit të sigurisë juridike, ne gjyqtarët në pakicë vlerësojmë se e drejta e kësaj kategorie e bashkëtëpandehurve të gjykuar në mungesë, siç është edhe kërkuesi, për t'u dëgjuar e mbrojtur para gjykatës, në rastet kur çështja ishte shqyrtuar në gjykatat më të larta nga bashkëipandehuri tjetër për motive jopersonale, garantohej nëpërmjet institutit procedural të kërkesës për rishikim të vendimit.

52. Si gjyqtarë në pakicë vlerësojmë se në çështjen objekt gjykimi, për këtë kërkues kanë ekzistuar mjetet e duhura procedurale që t'i jepej mundësia për t'u dëgjuar para gjykatës dhe për rrjedhojë, për zgjidhjen e drejtë të saj, nuk ka qenë e nevojshme të ndryshohej sentenca e tretë e vendimit njësues nr. 1/2011 të Gjykatës së Lartë.

53. Për sa më sipër, lidhur me zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, votojmë për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, nr. 20-2017-38/10, datë 24.1.2017, si vendim i drejtë, i bazuar në prova dhe në ligj.

Tiranë, më 18.11.2022

Gjyqtarë: Sokol Ndresi, Margarita Buhali

VENDIM
N. 00-2022-4586 (392), datë 26.10.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga gjyqtarët:
Artur Kalaja kryesues;
Ervin Pupe anëtar;
Sandër Simoni anëtar;
Albana Boksi anëtare;
Gentian Medja anëtar,
në seancën gjyqësore më datë 26.10.2022, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, mori në shqyrtim çështjen civile, që u përket palëve:
PADITËS: Demir Fekollari
I PADITUR: 1. Shoqëria "ZIG" sh.p.k.
2. Agjencia e Trajtimit të Kredive.
OBJEKTI: Kundërshtimin, pezullimin dhe anulimin e veprimeve përmbarimore të njoftuar me vendimin "Për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm", me nr. 77215 regj.-nr. 19582-prot,., datë 22.5.2015, të shërbimit përmbarimor gjyqësor privat "ZIG" sh.p.k., për të cilin kam marrë dijeni më datë 25.5.2015, nëpërmjet shërbimit postar (njoftuar vajzën tonë të quajturën Alketa Bicala, e cila është e martuar dhe nuk banon në banesën tonë).
BAZA LIGJORE: Neni 609/1-2, 610/1-2, e vijues i Kodit të Procedurës Civile

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, Artur Kalaja dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është paraqitur një padi me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, sikurse pasqyrohet në pjesën hyrëse.

2. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 7992, datë 23.10.2015,** ka vendosur:
"*Rrëzimin e padisë…"*

3. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka arsyetuar** se kërkesëpadia e paditësit Demir Fekollari duhet të rrëzohet si e pambështetur në ligj dhe në prova. Është e provuar se paditësi ka marrë pranë ish-Bankës Tregtare Agrare në formën e kredisë prej 2000.000 lekë, me interes 25%. Provohet se paditësi ka paguar vetëm një pjesë të kësaj shume dhe jo të gjithën siç pretendon ai. Shuma e mbetur pa shlyer së bashku me interesat e saj është ajo e përcaktuar në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë nr. 6, datë 14.1.2004 për lëshimin e titullit ekzekutiv.

Gjykata ka arsyetuar se veprimet përmbarimore për ekzekutimin e këtij titulli ekzekutiv janë kryer në përputhje me kriteret e kërkuara nga nenet 581 e vijim të kreut 4 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim "KPC").

4. Rezulton se paditësi ka qenë prezent në momentin e shpalljes së vendimit nga gjykata e shkallës së parë, më datë 23.10.2015.

5. Kundër këtij vendimi, fillimisht, më datë 2.11.2015, paditësi, Demir Fekollari ka paraqitur një ankim për zënie afati. Nuk rezulton i dokumentuar në dosjen gjyqësore se kur i është komunikuar vendimi i gjykatës së shkallës së parë paditësit.

Më tej, **më datë 7.12.2015, paditësi ka ushtruar ankimin e plotë** duke parashtruar se:

- Gjatë gjykimit janë depozituar mandatet e arkëtimit që vërtetojnë kthimin e kredisë në shumën totale prej 2.021.833 lekë, të likuiduara pranë Bankës Tregtare Agrare dhe këto prova nuk janë marrë parasysh nga ana e gjykatës.

- Vendimi është marrë në kundërshtim me ligjin pasi gjykata nuk ka hetuar kërkesën në lidhje me shlyerjen e detyrimit dhe as nuk ka caktuar një ekspert për vlerësimin e mandateve.

- Në lidhje me themelin e çështjes, që nga data 4.3.1997, kur sipas afatit kontraktor ka mbaruar shlyerja e kredisë e më pas që nga koha kur është dhënë vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë në vitin 2004, Banka Tregtare Agrare nuk ka paraqitur asnjë pretendim për shlyerjen e detyrimit, pasi ai ka qenë i shlyer.

- Pasuria e vendosur si kolateral, për efekt të sigurimit të ekzekutimit të detyrimit është çliruar nga detyrimi që nga viti 1998, dhe ky fakt tregon që banka kishte hequr dorë nga pretendimet që kishte ndaj paditësit, pasi në këtë kundërt, pasuria e bllokuar si mjet garancie nuk kishte si të çlirohej. E gjithë kjo periudhë pas shlyerjes së detyrimit bankar e deri më sot dëshmon se gjykata e ka konsideruar të shlyer detyrimin dhe të parashkruar.

- Banka, në kundërshtim me VKM-në nr. 62, datë 14.9.2011, "Për miratimin e rregullores për administrimin e rrezikut të kredisë", ka asgjësuar dokumentet përkatëse për këtë problem, çka na bën të dyshojmë se veprimet janë kryer për të përvetësuar;

- Rrethanat e sipërpërmendura nuk janë hetuar nga ana e gjykatës.

6. Lidhur me ankimin e paditësit, **Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 361, datë 26.5.2016,** ka vendosur:

"*Mospranimin e ankimit kundër vendimit nr. 7922, datë 23.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*"

7. **Gjykata e Apelit Tiranë, ka arsyetuar** se, paditësi është njohur me përmbajtjen e vendimit gjyqësor më datë 23.10.2015 dhe është ankuar ndaj tij më datë 7.12.2015. Gjykata konstaton se kërkesa ankimore e depozituar sa më sipër rezulton se është paraqitur jashtë afatit ligjor 5-ditor të përcaktuar në nenin 609 dhe 610 të KPC-së.

8. KPC-ja, i ndryshuar me ligjin nr. 122/2013, në nenin 609 ka parashikuar se: "…*Gjykata shqyrton kërkesat, sipas këtij neni, brenda 5 ditëve. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë*".

Nga ana tjetër, në fund të nenit 610 të KPC-së, me ligjin nr. 122/2013, janë shtuar dy paragrafë më këtë përmbajtje: *"…Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.*"

9. Në këto rrethana gjykata çmon se kërkesa ankimore nga pala paditëse është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe si rrjedhojë duhet të vendoset mospranimi i ankimit bazuar në kërkesat e nenit 450/a të KPC-së.

10. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, më datë 20.6.2016, është ushtruar rekurs nga paditësi Demir Fekollari, i cili ka kërkuar *prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate.*

Në rekurs është parashtruar se:

- Vendimi i Gjykatës është rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit procedural.

- Gjykata ka marrë të mirëqenë vendimin nr. 6, datë 14.1.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, e cila ka miratuar kërkesën e Agjencisë së Trajtimit të Kredive duke zbatuar ligjin në mënyrë të gabuar, pa hetuar asnjë rrethanë me rëndësi për çështjen.

- Paditësi nuk ka pasur dijeni në lidhje me këtë vendim dhe është njohur me të vetëm më datë 25.6.2015, kur është vënë në dijeni nga zyra përmbarimore për të shlyer vullnetarisht një detyrim që në të vërtetë nuk ekziston.

- Është vërtetuar gjatë gjykimit se kohë më parë, bazuar në KPC, organi përmbarimor ka pushuar ekzekutimin e këtij titulli ekzekutiv, por pa bazë ligjore, ka vendosur ta vërë në zbatim me një kërkesë të dytë. Për këtë fakt, gjykata duhet të hetonte bazën ligjore të pushimit të ekzekutimit e pastaj shkakun përse është rifilluar ai si dhe për mungesën e njoftimit të paditësit.

- Gjykata e shkallës së parë, në dispozitivin e vendimit është shprehur se palët kanë të drejtë të ankimojnë vendimin brenda afateve ligjore dhe pa përcaktuar se vendimi në fjalë kundërshtohej me ankim të veçantë.

- Gjithashtu, gjykata e faktit në kundërshtim me urdhërimet ligjore nuk ka hetuar kërkesën e paditësit për caktimin e një eksperti për të këqyrur të gjithë dokumentacionin që ka dosja.

- Paditësi, për efekt të kredisë së marrë ka likuiduar përpara datës 4.3.1997, 1.900.000 lekë principal dhe 111.833 lekë interesa bankare, nga ku rezulton se vetëm një pjesë e interesave janë të pakthyera në vlerën 843.0167 lekë. Këto interesa, sipas udhëzimit të KM-së nr. 33, datë 24.9.2010 janë falur, ndaj ato duhet të hiqen nga llogaria në masën 100%.

- Që nga data 4.3.1997 kur sipas afatit kontraktor ka mbaruar shlyerja e kredisë e më pas që nga koha kur është dhënë vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë në vitin 2004, Banka Tregtare Agrare nuk ka paraqitur asnjë pretendim për shlyerjen e detyrimit, pasi ai ka qenë i shlyer.

- Pasuria e vendosur si kolateral, për efekt të sigurimit të ekzekutimit të detyrimit është çliruar nga detyrimi që nga viti 1998 dhe ky fakt tregon që banka kishte hequr dorë nga pretendimet që kishte ndaj paditësit, pasi në këtë kundërt, pasuria e bllokuar si mjet garancie nuk kishte si të çlirohej. E gjithë kjo periudhë pas shlyerjes së detyrimit bankar e deri më sot dëshmon se Gjykata e ka konsideruar të shlyer detyrimin dhe të parashkruar.

- Banka, në kundërshtim me VKM-në nr. 62, datë 14.9.2011, "Për miratimin e rregullores për administrimin e rrezikut të kredisë", ka asgjësuar dokumentet përkatëse për këtë problem, çka na bën të dyshojmë se veprimet janë kryer me qëllim përvetësimi.

II. Procedura para Gjykatës së Lartë dhe nevoja për njësimin e praktikës gjyqësore

11. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), i përbërë nga një trup gjykues prej tre gjyqtarësh, mori në shqyrtim këtë çështje në dhomë këshillimi më datë 11.4.2022. Pavarësisht se rekursi i palës së paditur është

paraqitur më datë 20.6.2016, para ndryshimeve të KPC-së në vitin 2021, ai u shqyrtua sipas dispozitave procedurale që janë në fuqi aktualisht, në lidhje me ritin e gjykimit, përbërjen e trupës gjykuese dhe mënyrën e disponimit nga Gjykata e Lartë.

Veprimi i ligjit procedural në kohë rregullohet nga dispozita tranzitore e ligjit nr. 44/2021, ku është parashikuar, se: "*1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera; 2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.*"

12. Pasi mori në shqyrtim aktet e fashikullit të gjykimit; llojin e vendimmarrjes së gjykatës së apelit sipas nenit 450/a të KPC-së, objekt rekursi dhe kontrolli nga Gjykata e Lartë, pretendimet e ngritura në rekursin e paraqitur nga paditësi, Demir Fekollari, Kolegji vlerësoi se në rastin konkret, shtrohej për zgjidhje një çështje ligjore, se sa është afati i ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka shqyrtuar ankimin e palëve ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, sipas nenit 610 të KPC-së.

13. Pas një hulumtimi mbi praktikën gjyqësore ndër vite, Kolegji konstatoi se çështja e llojit dhe afatit të ankimit, ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, që ka disponuar mbi padinë/ankimin me objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, ka qenë shumë e diskutueshme në jurisprudencën e gjykatave më të ulëta dhe po ashtu të Gjykatës së Lartë.

14. KPC-ja ka pësuar vazhdimisht disa ndryshime, duke përfshirë edhe kapitullin e dispozitave që rregullojnë fazën e ekzekutimit të detyrueshëm dhe paditë e ngritura në fazën përmbarimore (të cilat do të merren në analizë, në mënyrë më të detajuar në vijim).

15. Në praktikën mbizotëruese të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ku është interpretuar si neni 611 i KPC-së, ashtu dhe neni 610, pas ndryshimeve me ligjin nr. 122/22013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, "*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*", të ndryshuar (në vijim ligji nr. 122/2013), është mbajtur qëndrimi i vazhdueshëm se afati i ankimit ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës që ka disponuar në lidhje me një padi të ngritur sipas nenit 609 apo 610 të KPC-së është 15 ditë, sipas rregullave të zakonshme të ankimit. Ndërkohë afati 5-ditor dhe ankimi i veçantë sipas nenit 610 apo sipas nenit 611 të mëparshëm është mjet për goditjen e vendimeve të ndërmjetme të gjykatës me të cilat vendoset pezullimi i ekzekutimit të veprimeve përmbarimore (*shih vendim nr. 00-2009-1185 i vendimit (289), datë 1.10.2009; vendim nr. 00-2012-1839 i vendimit (257), datë 17.5.2012; vendim nr. 00-2015-3441 i vendimit (417), datë 7.10.2015; vendim nr. 00-2015-2903 i vendimit (347), datë 2.7.2015; vendim nr. 00-2015 -2445 i vendimit (256), datë 14.5.2015 vendim nr.(221), datë 22.6.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.*).

16. Nga ana tjetër, janë konstatuar edhe disa raste, më të pakta në numër, ku Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në interpretim të nenit 610 të KPC, ka mbajtur qëndrimin jurisprudencial që lejon ankim të veçantë ndaj vendimit përfundimtar të gjykatës, që ka disponuar mbi ankimin kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor *(shih vendim nr. 11243-1613-2018, datë 23.2.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.).*

Edhe në rastet ku Gjykata e Lartë ka konkluduar mbi të drejtën e ankimit sipas rregullave të zakonshme, sipas jurisprudencës mbizotëruese, jo pak vendime të Kolegjit janë marrë me shumicë votash. Gjyqtarët e mbetur në pakicë kanë arsyetuar se neni 610 i KPC-së ofron një mjet ankimi të veçantë për goditjen e vendimeve gjyqësore që kanë disponuar mbi kundërshtimin e veprimeve përmbarimore. I njëjti interpretim është konstatuar edhe në jurisprudencën e gjykatave të apelit në përgjithësi. Duke vlerësuar se ankimi i lejuar në të tilla raste është i veçantë, këto gjykata në zbatim të nenit 450/a të KPC-së kanë disponuar me mospranim ankimi, për shkak të paraqitjes së tij jashtë afatit 5-ditor.

17. Kolegji sjell në vëmendje se para Gjykatës së Lartë gjenden për gjykim, një numër i konsiderueshëm i rekurseve të regjistruara ndaj vendimeve të gjykatave të apelit, të marra sipas nenit 450/a të KPC-së në harmoni me nenin 610 të KPC-së, prej vitit 2015 e në vijim, që shtrojnë të njëjtin diskutim mbi interpretimin e ligjit procedural. Për shkak të paqartësisë së krijuar nga praktika gjyqësore e gjykatave me juridiksion rishikues, në jo pak raste, edhe gjykatat e shkallës së parë, kur kanë përcaktuar të drejtën e ankimit në pjesën urdhëruese të vendimit të dhënë prej tyre, sipas nenit 310/III/3 të KPC-së, nuk kanë qenë koherente mbi individualizimin e llojit të ankimit apo në rastin më të keq kanë orientuar gabimisht palën mbi të drejtën e ankimit dhe afatin e paraqitjes së tij. Edhe pse e drejta e ankimit, lloji dhe afati i paraqitjes së tij, përcaktohet nga ligji dhe nuk mund të ndryshohet me vendim gjyqësor, Kolegji konstaton se si rrjedhojë e një praktike gjyqësore jo të njësuar ndër vite, palët në një proces gjyqësor përmbarimor kanë qenë të paorientuara mbi mënyrën e interpretimit të nenit 610 të KPC-së, çka ka çuar në jo pak raste në humbjen e së drejtës së ankimit, si një e drejtë themelore kushtetuese.

18. Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se paqartësia e vazhdueshme në kohë e praktikës gjyqësore, është e papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës dhe me parimin e sigurisë juridike. Gjykata Evropiane e të

Drejtave të Njeriut (në vijim "GJEDNJ"), në disa vendime, ndër to edhe në dhomën e madhe, ka vlerësuar se njëtrajtshmëria e zbatimit të ligjit nga jurisprudenca përbën garanci për zbatimin e parimit të sigurisë juridike që është element thelbësor i shtetit të së drejtës (*shih çështjen "Chapman v United Kingdom" vendim i GJEDNJ, datë 18.1.2001*), duke patur lidhje të drejtpërdrejtë edhe me garancitë e nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim "KEDNJ").

19. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se siguria juridike që duhet të përcjellë rendi juridik lidhur me aksesueshmërinë dhe parashikueshmërinë normative duhet të jenë standard edhe për praktikën gjyqësore nomofilatike (*Shih çështjen "Lupaş and Others v.Romania", ap.nos. 1434/02, 35370/02 dhe 1385/03, paragrafi 67, ECHR 2006-XV).* Ajo ka pranuar se kundërshtitë e jurisprudencës janë të natyrshme dhe të qenësishme në të gjitha sistemet juridike, qoftë në gjykata të të njëjtës shkallë, qoftë në shkallë të ndryshme, apo qoftë edhe në autoritetin suprem më të lartë gjyqësor, duke konkluduar se kjo situatë nuk mund të jetë *apriori* në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së.

Megjithatë, GJEDNJ-ja konkludon se ajo që përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në drejtim të ushtrimit të funksionit nomofilatik të autoritetit më të lartë gjyqësor në një vend janë disa rrethana: *së pari*, nëse në jurisprudencën e gjykatave ekzistojnë qëndrime krejt të ndryshme dhe të vazhdueshme mbi të njëjtën çështje juridike; *së dyti*, nëse e drejta e brendshme parashikon mekanizma ligjorë dhe procedural që synojnë efektivisht eliminimin e mungesës së koherencës në jurisprudencë; *së treti*, nëse këto mekanizma janë zbatuar nga autoriteti më i lartë gjyqësor dhe kush ka qenë efekti i prodhuar në praktikën gjyqësore. GJEDNJ-ja ka theksuar se juridiksioni gjyqësor suprem në çdo shtet duhet të tregojë vigjilencë në shquarjen dhe eliminimin e çdo mungese koherence në jurisprudencën e gjykatave (*shih çështjen "Mariyka Popova dhe Asen Popov kundër Bullgarisë", kërkesa nr. 11260/10, seksioni i 5-të i GJEDNJ-së, vendim nr. 11.4.2019, paragrafi 40*).

20. Në vijim të kësaj analize, në çështjen ligjore të shtruar për diskutim, Kolegji,

- në ushtrim të së drejtës dhe detyrimit kushtetues dhe ligjor, që lidhet me funksionin nomofilatik;

- duke pasur parasysh praktikat e ndryshme të gjykatave të niveleve më të ulëta dhe të vetë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që vijnë për shkak se mund të ketë disa interpretime të nenit 610 të KPC-së, mbi të drejtën e ankimit;

- meqenëse përpara Gjykatës së Lartë gjenden për shqyrtim raste të ngjashme, për të cilat duhet të jepet një zgjidhje e njëjtë dhe e njësuar në interpretimin e ligjit procedural;

- në zbatim të nenit 35/3, 472/a, 481 dhe 482/a të KPC-së, të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021, ka konkluduar me vendim të ndërmjetëm se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë gjyqësore, me një trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, për arsye se rekursi ngre shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural, të një rëndësie themelore për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

21. Mbi këtë bazë, Kolegji vlerësoi se çështja që duhet të shtrohet për njësim është:

Sa është afati i ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar mbi ankimin kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor sipas nenit 610 të KPC-së?

Ankimi i veçantë i parashikuar në këtë dispozitë, nënkupton se me këtë mjet goditen vendimet e gjykatës mbi pezullimin e veprimeve përmbarimore apo vendimet e gjykatës që kanë disponuar përfundimisht mbi ankimin kundër veprimit të përmbaruesit gjyqësor?

22. Sa më sipër, Kolegji planifikoi çështjen për shqyrtim më datë 9.5.2022 dhe vijoi me procedurën e posaçme, të parashikuar në nenin 481 të KPC-së, të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021. Në këto kushte, u formua trupa gjykuese prej 5 gjyqtarësh, sipas pikës 3 të kësaj dispozite dhe u procedua, mbi vendimin e ndërmjetëm të Kolegjit, me njoftimin individual të palëve, sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit, për sa i përket datës dhe orës së seancës gjyqësore, trupës gjykuese, çështjes së shtruar për njësim, duke iu lënë palëve afatin minimum prej 15 ditësh, midis njoftimit dhe datës së seancës. Po ashtu, vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ku u pasqyrua çështja e shtruar për njësim, u publikua në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

23. Pas zhvillimit të disa seancave gjyqësore, Kolegji vendosi përfundimisht në lidhje me këtë çështje në seancën e datës 26.10.2022.

III. Vlerësimi i Kolegjit Civil

24. Ekzekutimi i detyrueshëm i titujve ekzekutivë në përgjithësi, e sidomos ekzekutimi i detyrueshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës në veçanti, konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar sipas ligjit. Karakteri unitar i procesit civil detyron respektimin e garancive të procesit të rregullt si në fazën e gjykimit, ashtu edhe të ekzekutimit të detyrueshëm. Në këtë mënyrë ligji procedural ka ndërfutur si moderator të këtij procesi gjykatën e shkallës së parë të vendit të ekzekutimit.

Republika e Shqipërisë, që me ratifikimin e KEDNJ-së, ka marrë përsipër dhe është zotuar ndërkombëtarisht për të organizuar sistemin e brendshëm ligjor, nënligjor dhe infrastrukturor në mënyrë të tillë që të përditësohen

të gjithë elementet e së drejtës për proces të rregullt ligjor.

I. Jurisprudenca relevante e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me karakterin unitar të procesit dhe zbatimin e nenit 6 të KEDNJ-së, në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.

25. Në jurisprudencën e vazhdueshme të GJEDNJ-së, e cila është cilësuar si "*konventa në veprim*", ka qenë i konsoliduar qëndrimi se faza e ekzekutimit të detyrueshëm është pjesa fundore dhe integrale e procesit gjyqësor civil dhe si e tillë meriton të gjitha garancitë dhe vëmendjen e nenit 6 të KEDNJ (*Shiko çështjen "Burdov v. Russia", kërkesa 59498/00, paragrafi 34, seksioni III, GjEDN.2002 dhe çështjen "Lyubov Stetsenko v. Russia", kërkesa 26216/07, vendimi datë 17.4.2014, paragrafi 80 etj.*). Rasti i parë që ndryshoi praktikën gjyqësore dhe mënyrën doktrinare të të konceptuarit të fazës së ekzekutimit të detyrueshëm në Shqipëri ishte çështja "*Qufaj v. Shqipërisë*".

Në këtë çështje, GJEDNJ-ja u shpreh se "*e drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk do të ishte reale, nëse sistemi ligjor i një shteti do të lejonte që një vendim gjyqësor i detyrueshëm dhe përfundimtar të mos zbatohej në dëm të njërës palë*".

26. Duke u nisur nga ky konceptim, në praktikën e konsoliduar të GJEDNJ-së është vendosur si standard se, në veçanti, ekzekutimi i detyrueshëm i një vendimi gjyqësor të formës së prerë, duhet të përfundojë brenda një afati të arsyeshëm. Vonesat në ekzekutim, cenojnë të drejtën e palës për akses në gjykatë dhe kjo qasje përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së.

Në çështjen "*Gjyli kundër Shqipërisë*", GJEDNJ-ja ka theksuar se një vonesë e tejzgjatur e paarsyeshme në zbatimin e një vendimi përfundimtar dhe detyrues mund të shkelë Konventën.

27. Kjo praktikë e GJEDNJ-së, mbi afatet e arsyeshme të ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, gjeti pasqyrim edhe në praktikën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Në gjykimin e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se gjykimi për realizimin e një të drejte, si një proces kompleks, në vetvete përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën.

Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. I gjithë procesi gjyqësor, shpesh herë i vështirë e problematik, nuk do të kishte vlerë në qoftë se nuk do të pasohej nga një proces që lidhet drejtpërsëdrejti me veprimtarinë e organeve të përmbarimit, me ekzekutimin e vendimit ose të realizimit të së drejtës së fituar.

Në fazën e dytë, kur lipset dhe ndërhyrja, qoftë dhe me masa shtrënguese për zbatimin e tij, realizohet ajo që quajmë qëllimi i drejtësisë. Duke qenë kështu, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar, nëse ajo nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit, mbetet pa asnjë vlerë (*shih vendim nr. 6, datë 31.3.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata Kushtetuese, ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të KEDNJ-së. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Ai konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces *(shih vendimin nr. 1, datë 21.1.2016 të Gjykatës Kushtetuese).*

II. Konteksti historik dhe krahasimor mbi natyrën e padive/ankimeve përmbarimore, ndryshimet që ka pësuar ndër vite legjislacioni procedural civil shqiptar.

29. Kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, i normuar në nenin 610 të KPC-së, është konceptuar nga ligji si mjet juridik mbrojtës, me natyrë thelbësisht procedurale, në dispozicion të palëve të një procesi gjyqësor civil, në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm. Ky mjet në duart e palëve, ka për qëllim të kundërshtojë veprimet (*aktet procedurale*) që kryhen nga përmbaruesi gjatë procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, ose kundër refuzimit të përmbaruesit për të ekzekutuar një titull ekzekutiv.

Me këtë mjet, nuk kundërshtohet e drejta e kreditorit, por mënyra dhe ligjshmëria e zhvillimit të vetë procesit të ekzekutimit të titullit ekzekutiv, për shkak të mosrespektimit të ligjit procedural civil në vendimmarrjen dhe veprimet e përmbaruesit.

30. Në KPC të miratuar me ligjin nr. 6341, datë 27.6.1981, kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor ishte rregulluar në nenin 214, ku parashikohej, se: "*Kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor ose kundër refuzimit të tij për të kryer një veprim, kreditori ose debitori mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit, brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes se veprimit ose refuzimit"*

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë, në të tilla raste, duke u nisur nga nevoja e përfundimit të shpejtë të fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, ishte i paankimueshëm dhe i formës së prerë. Një parashikim i tillë gjendej në

nenin 216 të këtij Kodi.

Njëlloj me parashikimin e KPC-së të Republikës së Shqipërisë të vitit 1981, ka edhe modele ligjore aktuale evropiane të cilat nuk lejojnë fare ankim, qoftë apel apo qoftë rekurs ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë që ka si kompetencë lëndore gjykimet përmbarimore. Një rast i tillë është Konfederata e Zvicrës, në KPC të së cilës, konkretisht në nenin 309 shkronja "a", parashikohet se nuk lejohet apel kundër vendimeve të tribunalit të ekzekutimit të detyrueshëm.

31. Më tej, me hyrjen në fuqi të KPC-së pas viteve 90, me ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, si mjet procedural ankimi, u rregullua në nenin 610. Në përpjekje për ta përqasur vazhdimisht me standardet ndërkombëtare, kjo dispozitë ka pësuar disa ndryshime thelbësore që prej vitit 2001 deri në vitin 2021, në lidhje me natyrën juridike të këtij mjeti, pozitën procedurale të pjesëmarrësve në proces, afatet dhe procedurën e gjykimit, në gjykatat e shkallës së parë dhe në ato me juridiskion rishikues.

32. Në formulimin e tij fillestar, neni 610 i KPC-së, parashikonte se:

"*Kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor dhe kundër refuzimit të tij për të kryer një veprim, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit apo refuzimit, kur palët kanë qenë të pranishme në kryerjen e veprimit ose kanë qenë thirrur edhe në raste të tjera nga dita që i është njoftuar ose ka marrë dijeni për veprimin ose refuzimin.*

Ankimi shqyrtohet nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë edhe palët."

33. Kjo dispozitë, e konceptonte kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, si ankim të subjekteve të përfshirë në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, ndaj akteve procedurale të realizuara nga përmbaruesi gjyqësor. Sipas kësaj dispozite, kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky Kod dhe kundër refuzimit të përmbaruesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton vendimin, brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit ose refuzimit, nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni për veprimin ose refuzimin.

Aty, përcaktohej kompetenca e gjyqtarit të vendit të ekzekutimit për shqyrtimin e ankimit, por nuk parashikohej e drejta e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kjo e drejtë rregullohej në nenin 611 të KPC-së, në këtë mënyrë: *"Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe. Kundër vendimit të gjykatës bëhet ankim i veçantë.*"

34. Me ndryshimet që pësoi KPC-ja, me ligjin nr. 8812, datë 2001, u parashikua detyrimi i gjykatës për ta thirrur përmbaruesin gjyqësor si person të tretë. Ndërsa me ndryshimet që pësoi KPC-ja, me ligjin nr. 10052, datë 29.12.2008, për herë të parë dhe të vetme, ky mjet është konceptuar si padi, ku përmbaruesi duhet të thirrej në cilësinë e palës së paditur. Me këtë ligj, u normua edhe procedura e këtij gjykimi, duke u përcaktuar një afat prej 20 ditësh për përfundimin e tij gjatë gjykimit në shkallë të parë.

35. Më tej, me ligjin nr. 122/2013, me të cilin u ndryshuan një pjesë e rëndësishme dispozitave të KPC-së, është shfuqizuar neni 611. E drejta e ankimit, në mënyrë të njëjtë sikurse parashikohej në këtë dispozitë, u integrua dhe u rregullua në nenin 610 të KPC-së, të cilit iu shtuan dy paragrafë në këtë mënyrë:

"…Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies se vendimit të pezullimit.

Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë."

36. Nga nevoja për përfundimin e ekzekutimit të detyrueshëm brenda një afati të arsyeshëm, dhe nga nevoja për një gjykim të shpejtë, si në juridiksionin fillestar, ashtu edhe në juridiksionin rishikues, me ligjin nr. 114/2016, ligjvënësi e rikonceptoi ritin e gjykimit të kundërshtimit të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, në gjykimin në shkallë të parë dhe në apel. Ankimi kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, do të shqyrtohej tashmë nga gjykata e shkallës së parë në dhomë këshillimi pa praninë e palëve brenda 20 ditëve. Përjashtimisht, gjykata e shkallës së parë mund të thërrasë palët dhe përmbaruesin gjyqësor kur e sheh të nevojshme, pa u cilësuar që përmbaruesi gjyqësor në këtë lloj gjykimi ka pozitën e palës së paditur.

Duke ndjekur një regjim të njëjtë të posaçëm edhe në juridiksionin rishikues, në këtë dispozitë u parashikua se shqyrtimi i ankimit nga gjykata e apelit, ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, duhet të bëhet brenda 30 ditëve në dhomë këshillimi. Gjykata e apelit, përjashtimisht mund ta shqyrtojë ankimin në seancë gjyqësore, brenda 45 ditëve, kur debati gjyqësor çmohet si i domosdoshëm, në rastet dhe rrethanat e parashikuara nga ligji.

37. Së fundi, me ligjin nr. 44/2021, gjykimi përmbarimor pësoi një ndryshim thelbësor. Në nenin 610 të KPC-së, u shtua paragrafi i tretë me këtë përmbajtje: *"Ankimet kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor shqyrtohen*

nga i njëjti gjyqtar i vetëm gjatë gjithë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv kur veprimet ose refuzimi i përmbaruesit gjyqësor lidhet me të njëjtin titull ekzekutiv, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe."

38. Me këtë parashikim të fundit ligjor, u centralizua kompetenca e një gjyqtari të vetëm në shqyrtimin e të gjitha ankimeve ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor të lidhura me të njëjtin titull ekzekutiv. Nevoja për këtë ndryshim erdhi si rrjedhojë e problematikës që shkaktonte decentralizimi i procesit gjyqësor në fazën ekzekutive, ku ankimet ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor shqyrtoheshin si çështje të veçanta nga gjyqtarë të ndryshëm të cilët caktoheshin me short sipas nenit 154/a të KPC-së dhe sipas vendimit nr. 238/1/a, datë 24.12.2008, "*Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore*" të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

39. Rikonceptimi i gjykimit përmbarimor, erdhi në përputhje me qasjen e GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese, mbi karakterin unitar të gjykimit në fazën njohëse dhe ekzekutive. Copëzimi i gjykimit përmbarimor, në gjykime të veçanta, cenonte parimin e ekonomizimit procesual[43] si derivat i së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Ky *modus operandi* procedural konsumonte gjyqtarët intelektualisht dhe krijonte një ngarkesë fiktive në axhendat dhe kohën fizike të tyre, pasi për çështje të ekzekutimit të të njëjtit titull ekzekutiv mundet të shortoheshin potencialisht të gjithë gjyqtarët e një gjykate. Kjo shkaktonte shkeljen e standardit të parimit të afatit të arsyeshëm në gjykimin e çështjeve të fazës së ekzekutimit të detyrueshëm. Duke qenë se ligji e lejonte mundësinë e zhvillimit dhe konstituimit të disa proceseve paralele me objekt nënçështje që kanë qenë në thelb me karakter unitar juridik, pasi bëhet fjalë për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv, krijoheshin premisat për pezullimin e gjykimit, me qëllim që të pritej zgjidhja e një çështje tjetër e lidhur ngushtë me të, apo mundej të krijoheshin premisat për zvarritjen e gjykimit me të njëjtën logjikë.

40. Ekzistenca e proceseve paralele dhe partikularizimi gjyqësor i fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të një titulli ekzekutiv, kur në fakt të gjitha ato janë dhe duhet të trajtohen juridikisht si një proces i vetëm, unitar dhe i pandashëm, krijonin premisat për dhënien e vendimeve gjyqësore kontradiktore dhe që zvarrisnin apo pezullonin procedurat përmbarimore në mënyrë të paarsyeshme. Kjo mënyrë operimi krijonte premisat për cenimin e figurës së gjyqtarit natyral të çështjes, si një ndër elementet përbërës dhe thelbësor të gjykatës së caktuar me ligj.[44]

41. Kolegji sjell në vëmendje se figura e gjyqtarit të ekzekutimit, në legjislacionin shqiptar, është përafruar fillimisht nga ligji procedural penal dhe ligji procedural gjyqësor administrativ, të cilat përcaktojnë se gjyqtari që do të gjykojë të gjitha çështjet e fazës përmbarimore të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë do të jetë ai që ka dhënë vendimin. Në nenin 66 të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar, për gjykatat administrative, është parashikuar se *"Gjatë procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, gjyqtari apo kryetari i trupit gjykues, që ka dhënë vendimin, me kërkesë të palëve ose të përmbaruesit gjyqësor, në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, urdhëron kryerjen e veprimeve të posaçme dhe marrjen e masave të tjera të nevojshme, duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e kryerjes së tyre..."*

42. Një fillesë e këtij modeli, para ndryshimeve me ligjin nr. 44/2021, gjendej edhe te neni 511 shkronja "a" të KPC-së, ku është parashikuar se gjykata kompetente për të lëshuar urdhrin e ekzekutimit, kur titulli ekzekutiv është vendim gjyqësor detyrimi që ka marrë formë të prerë, do të jetë ajo që ka dhënë vendimin, e cila disponon për këtë qëllim në dispozitivin e vendimit. *Ratio* e përbashkët e këtyre tri legjislacioneve bën të konkludohet se në të vërtetë, gjyqtari natyral i çështjeve të ekzekutimit të detyrueshëm është dhe duhet të jetë gjyqtari që ka dhënë vendimin. Kjo *ratio* përforcohet dhe plotësohet, në qëllimet juridike të synuara për t'i bërë realitet, edhe nga parimet e ekonomizimit procesual, afatit të arsyeshëm dhe sigurisë juridike.

43. Me ndryshimet që pësoi KPC-ja në vitin 2021, për ti dhënë fleksibiltet dhe shpejtësi, procedurave gjyqësore përmbarimore, në nenin 35, figura e gjyqtarit monokratik u parashikua edhe në juridiksionin rishikues të gjykatës së apelit. Në gjykatën e apelit si rregull çështjet gjyqësore shqyrtohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Përjashtimisht në këtë dispozitë u parashikua se ankimet ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë që kanë disponuar mbi kundërshtimin e veprimeve përmbarimore do të gjykohen nga gjykata e apelit me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar.

44. Në Evropë ka modele legjislacionesh që e kanë krijuar gjyqtarin e ekzekutimit edhe në procesin civil. KPC-ja e Republikës së Italisë ka krijuar figurën e posaçme të gjyqtarit të ekzekutimit të detyrueshëm, duke parashikuar se të gjitha kërkesat e palëve përgjatë kësaj faze do të gjykohen nga i njëjti gjyqtar. Kështu, duke mos e partikularizuar shqyrtimin gjyqësor gjatë kësaj faze, por duke e përqendruar atë te një gjyqtar konkret, ky legjislacion parashikon që për çdo çështje që ndodhet në ekzekutim të detyrueshëm ka një fashikull të posaçëm

[43] *Shih qëndrimin e mbajtur në vendimin njësues nr. 20315, datë 20.9.2006 të Seksioneve të Bashkuara Civile të Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë.*

[44] *Shih vendimin nr. 40, datë 11.3.2002; vendimin nr. 35, datë 20.12.2005; vendimin nr. 26, datë 2.11.2005; vendimin nr. 25, datë 10.11.2006; vendimin nr. 25, datë 10.11.2006; vendimin nr. 9, datë 26.2.2007; vendimin nr. 11, datë 4. 4.2007; vendimin nr. 23, datë 8.6.2007; vendimin nr. 36, datë 15.10.2007; vendimin nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese.*

dhe të njëjtë në gjykatë (shiko nenin 488 të këtij Kodi), ku dokumentohet çdo veprim përmbarimor dhe çdo shqyrtim gjyqësor për çfarëdo kërkese që kreditori apo debitori i bëjnë gjykatës.

45. Në legjislacionin dhe doktrinën juridike italiane[45], vendimet që lëshon gjyqtari i ekzekutimit, kur disponon mbi ankimet ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, për të njëjtin titull ekzekutiv, nuk kanë natyrën e sentencave, (analoge me vendimet përfundimtare të parashikuara në nenin 126 të Kodit tonë), por më tepër, kanë natyrën e dekreteve dhe ordinancave, (analoge me urdhrat dhe vendimet e ndërmjetme të parashikuara në nenin 125 të Kodit tonë). Arsyeja e këtij rregullimi lidhet me diferencat thelbësore midis padive të ngritura për njohjen dhe verifikimin e ekzistencës së një të drejte dhe detyrimi (faza njohëse e së drejtës), nga ankimet kundër veprimeve përmbarimore, (faza e ekzekutimit të një të drejte tashmë të njohur me një titull ekzekutiv).

46. Sipas këtij modeli ligjor, gjykimi mbi themelësinë e së drejtës, i vënë në lëvizje nëpërmjet padisë për rivendosjen apo njohjen e saj, synon formësimin e një vendimi gjyqësor përfundimtar, titull ekzekutiv, ku të certifikohet ekzistenca e së drejtës, si e shkelur, që i përket paditësit kundrejt palës së paditur dhe se kjo e drejtë e certifikuar gëzon mbrojtje nga norma juridike. Ndërkohë që padia përmbarimore, investon një proces gjyqësor ku nuk vihet më në diskutim e drejta e kreditorit, por ka për qëllim materializimin konkret të së drejtës së certifikuar tashmë në fazën njohëse. Paditë përmbarimore synojnë kontrollin gjyqësor se si kjo e drejtë po materializohet fizikisht.

Procesi gjyqësor i zhvilluar gjatë fazës ekzekutive, konceptohet një dhe i vetëm, si zgjatim i procesit gjyqësor njohës, ku gjyqtari i ekzekutimit, nëpërmjet vendimeve që lëshon gjatë kësaj faze, kontrollon veprimtarinë ekzekutive të përmbaruesit gjyqësor, njëlloj sikurse gjyqtari i çështjes së themelit kontrollon dhe drejton procesin gjyqësor njohës nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme.

47. Të njëjtën regjim juridik ndjek edhe pjesa respektive e KPC-së të Ekzekutimit të Republikës së Francës. Në këtë mënyrë ravijëzohen edhe modele të tjera legjislacionesh procedurale civile evropiane që kanë adoptuar këtë *modus operandi* për gjyqtarin e ekzekutimit gjatë fazës përmbarimore.

III. Lloji i ankimit të lejuar ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë sipas nenit 610 të KPC

48. Në vijim të këtij vështrimi historik dhe krahasimor, Kolegji vlerëson se në ndryshimet që ka pësuar KPC, në dispozitat procedurale që normojnë kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, ligjvënësi shqiptar ka synuar në vazhdimësi përsosjen, eficienën dhe përshpejtimin e fazës ekzekutive, duke e disiplinuar atë në tërësi, me afate shumë të shkurtra dhe me procedura të thjeshtëzuara gjyqësore. Këto ndryshime kanë qenë një përpjekje e vazhdueshme për ta përqasur legjislacionin relevant të brendshëm me jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe me modelet evropiane që kanë si qëllim përfundimin e shpejtë të fazës ekzekutive.

Ajo që vlen të theksohet është se për këtë arsye, faza e ekzekutimit të detyrueshëm dhe veprimtaria gjyqësore përmbarimore, ndjek një regjim juridik tërësisht të ndryshëm dhe të posaçëm në raport me normat juridike procedurale që rregullojnë veprimtarinë e gjykatës në fazën njohëse të së drejtës.

49. Në funksion të zgjidhjes së çështjes së shtruar për njësim, nga analiza e deritanishme, Kolegji arrin në një konkluzion të rëndësishëm, mbi kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, duke pasur parasysh dallimet me mjetet e tjera mbrojtëse në dispozicion të subjekteve të cenuara, sipas një interpretimi historik, krahasimor dhe pajtues të dispozitave që rregullojnë fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, me jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese.

Duke qenë një proces me karakter unitar, aktet e prodhuara nga përmbaruesi gjyqësor në fazën ekzekutive, janë vijimësi e akteve procedurale, të prodhuara nga gjykata në fazën njohëse, por me një destinim të ndryshëm procedural, materializimin fizik të së drejtës së kreditorit, kundrejt debitorit, të njohur tashmë me vendim gjyqësor të formës së prerë ose të përfshirë në titullin ekzekutiv, objekt i ekzekutimit.

50. Përmbaruesi gjyqësor shtetëror ose i organizuar mbi baza private, është një figurë e posaçme procedurale, që drejton fazën ekzekutive dhe që vihet në lëvizje me kërkesë të kreditorit. Për këtë qëllim, ligji procedural civil, e ka pajisur me kompetencën për të marrë vendime dhe për të nxjerrë urdhra, të cilat janë të detyrueshme për zbatim, pavarësisht dëshirës dhe vullnetit të debitorit. Megjithëse veprimtaria e përmbaruesit gjyqësor është e normuar nga ligji, ai nuk plotëson kualitetet e gjykatës apo kuazigjykatës (sikurse janë pavarësia, paanësia etj.), prandaj aktet procedurale të realizuara prej tij, nga të cilat mund të cenohen të drejtat pasurore të debitorit ose të personave të tretë, i nënshtrohen kontrollit gjyqësor.

Gjykimi përmbarimor ka për objekt pikërisht vlefshmërinë e këtyre akteve dhe me këtë logjikë juridike, edhe vendimet e gjykatës, në përfundim të gjykimit përmbarimor, kanë për qëllim kontrollin dhe drejtimin e fazës

[45] Shih Crisanto Mandrioli, Antonio Carrata "*Dirito Processuale Civile IV, L'esecuzione forzata, i procedimenti sommari, cautelari e camerali*", ventisettesima edizione, G.Giappichelli Editore-Torino, faqe 11, paragrafi i parë.

ekzekutive.

51. Çështja më e diskutueshme në praktikën gjyqësore, e cila është shtruar për zgjidhje në këtë vendim njësues, lidhet me të drejtën e ankimit ndaj vendimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë sipas nenit 610 të KPC-së.

52. E drejta e ankimit ndaj një vendimi të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, përbën një prezumim kushtetues, që e ka legjitimitetin nga neni 43 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kufizimi i kësaj të drejte, duhet të bëhet shprehimisht me ligj dhe vetëm për rastet dhe kushtet e parashikuara në nenet 17 dhe 43 të Kushtetutës. Ky parim kushtetues gjen përditësim në nenin 452 të KPC-së, i cili sanksionon rregullin e përgjithshëm se vendimet e gjykatës së shkallës së parë janë të ankimueshme. Kjo dispozitë ka parashikuar se: "*Mund të ankimohen në gjykatën e apelit të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë, me përjashtim të rasteve kur ankimi përjashtohet me ligj.*"

Gjithashtu, me kufizimet për shkak të juridiksionit ekskluzivisht ligjor, sipas nenit 472 të KPC-së, janë të rekursueshme në Gjykatën e Lartë të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e apelit dhe nga gjykata e shkallës së parë, në rastet e parashikuara në ligj.

53. KPC-ja ka parashikuar edhe llojet e ankimeve, duke i ndarë në dy kategori: ankimet sipas rregullave të zakonshme dhe ankimet e veçanta. Kategorizimi i tyre jepet në nenin 443 të KPC-së dhe ka si kriter ndarës primar afatin e paraqitjes së tyre.

Në këtë dispozitë është parashikuar se: *"Afati i ankimit në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, është 15 ditë. Afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë... Afati i ankimeve dhe rekurseve të veçanta është 5 ditë"*. Regjimi juridik i posaçëm i ankimeve dhe/ose rekurseve të veçanta lidhet jo vetëm me afatin 5-ditor të paraqitjes së tyre në gjykatën me juridiksion rishikues, por edhe llojin e vendimmarrjes gjyqësore që ato kundërshtojnë, ritin e gjykimit të tyre nga gjykata rishikuese dhe afatet e posaçme për shqyrtimin e tyre.

54. Kolegji sjell në vëmendje llojet e vendimeve gjyqësore të prodhuara gjatë një procesi gjyqësor, të cilat ndahen në vendime përfundimtare, të ndërmjetme dhe jopërfundimtare. Kuptimi për secilin prej tyre jepet në nenet 125–127 të KPC-së. Vendimet e ndërmjetme jepen nga gjykata në seancë gjyqësore me qëllim që t'i përgjigjet kërkesave dhe të sigurohet zhvillimi i gjykimit në pajtim me dispozitat e këtij Kodi (neni 125). Vendimi përfundimtar jepet nga gjykata në përfundim të gjykimit i cili zgjidh çështjen në themel (neni 126), ndërsa vendimi jopërfundimtar është vendimi me të cilin gjykata i jep fund gjykimit, në rastet e parashikuara nga ligji, pa e zgjidhur çështjen në themel (neni 127).

55. Në KPC, është përzgjedhur një teknikë e tillë legjislative, ku në parim, vendimet gjyqësore ankimohen sipas rregullave të zakonshme të ankimit, me përjashtim të rasteve ku ligji në mënyrë të shprehur parashikon ankimin e veçantë. Nëse merren në analizë dispozitat e KPC-së që parashikojnë në mënyrë eksplicite të drejtën e ankimit të veçantë, mund të dallohet se me këtë mjet ankimi goditen në përgjithësi vendimet e ndërmjetme dhe jopërfundimtare të gjykatave (shih p.sh. nenet 154/a/5; 194/2; 209; 301; 315; 318; 370 etj.). Përjashtim bën vetëm rasti i parashikuar në nenin 158/ç të KPC-së, ku vendimi gjyqësor me të cilin është miratuar marrëveshja e palëve për zgjidhjen e çështjes me pajtim mund të goditet me ankim të veçantë.

Kjo bëhet më e dukshme/e qartë në nenet 470 (i ndryshuar me ligjin nr. 38/2017) dhe 471/a të KPC-së (i shtuar me ligjin nr. 44/2021), ku është parashikuar se ankimet dhe rekurset e veçanta ndaj vendimit të ndërmjetëm ose jopërfundimtar të gjykatës, shqyrtohen nga gjykata më e lartë, në dhomë këshillimi dhe brenda 30 ditëve. Ndërkohë vendimet përfundimtare, me të cilat është zgjidhur mosmarrëveshja në themel, ankimohen sipas rregullave të zakonshme të ankimimit.

56. Logjika e ligjvënësit në parashikimin e ankimit të veçantë për vendimmarrje të tilla gjyqësore, lidhet me nevojën urgjente të shqyrtimit të tyre nga gjykata rishikuese si dhe me mjetin efektiv të ankimit. Duke pasur një karakter instrumental, në funksion të zgjidhjes së çështjes në themel, ligjshmëria e vendimeve të ndërmjetme të goditura me ankim të veçantë, duhet të shqyrtohet nga gjykata rishikuese, para mbylljes së gjykimit në shkallë të parë, me vendim përfundimtar. Po ashtu, edhe vendimet jopërfundimtare, duke qenë se nuk i japin zgjidhje themelit të pretendimeve të palëve, si një kufizim i aksesit në gjykatë, duhet të gjykohen me shpejtësi nga gjykata rishikuese.

Në të tilla raste jo vetëm afati i ankimit është i shkurtër (5 ditë), por edhe shqyrtimi i tyre nga gjykata rishikuese duhet të përfundojë brenda një afati të shkurtër 30-ditor, sipas ritit të gjykimit në dhomë këshillimi.

57. Kolegji risjell në vëmendje edhe një herë parashikimin e nenit 610 të KPC-së, në mënyrën se si është formuluar sot, ku është parashikuar se:

"*Kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, të kryera në kundërshtim me procedurat e parashikuara nga ky Kod dhe kundër refuzimit të përmbaruesit gjyqësor për të kryer një veprim që ia ngarkon ligji, palët mund të bëjnë ankim në gjykatën që ekzekuton*

vendimin, brenda 5 ditëve nga dita e kryerjes së veprimit ose refuzimit, kur palët kanë qenë të pranishme në kryerjen e veprimit ose kanë qenë thirrur, dhe, në raste të tjera, nga dita që u është njoftuar ose kanë marrë dijeni për veprimin ose refuzimin.

Kundër veprimeve të personave, përmbaruesit gjyqësorë, që ushtrojnë veprimtarinë publike të shërbimit përmbarimor gjyqësor të organizuar mbi baza private, pala debitore mund të paraqesë ankim në gjykatën, ku ekzekutohet titulli ekzekutiv, brenda 5 ditëve nga data e kryerjes së veprimit.

Ankimet kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor shqyrtohen nga i njëjti gjyqtar i vetëm gjatë gjithë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv kur veprimet ose refuzimi i përmbaruesit gjyqësor lidhet me të njëjtin titull ekzekutiv, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Ankimi shqyrtohet brenda 20 ditëve nga gjykata e vendit të ekzekutimit, e cila kur e sheh të nevojshme mund të thërrasë palët dhe përmbaruesin gjyqësor.

Ankimi kundër veprimeve ose refuzimit të përmbaruesit gjyqësor nuk pezullon ekzekutimin, përveç kur gjykata vendos ndryshe. Kur titulli ekzekutiv është një akt për dhënien e kredive bankare ose akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare dhe gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit, masa e pezullimit konsiderohet e rënë nga fuqia me kalimin e 20 ditëve nga momenti i dhënies së vendimit të pezullimit.

Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.

Shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, si rregull, bëhet nga gjykata e apelit pa praninë e palëve, brenda 30 ditëve. Përjashtimisht, gjykata e apelit mund të vendosë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve brenda 45 ditëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se:

a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë, në afatet e parashikuara;

b) vendimi, kundër të cilit është paraqitur ankimi, është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë;

c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë."

58. Në një paragraf më vete të kësaj dispozite, është parashikuar e drejta e ankimit të veçantë ndaj vendimit të gjykatës. Sikurse u evidentua në pjesën e evolucionit historik, në dispozitat e KPC-së, para ndryshimeve me ligjin nr. 122/2013, neni 610 nuk parashikonte të drejtë ankimi, ndërkohë e drejta e ankimit të veçantë parashikohej në nenin 611 që rregullonte në mënyrë të posaçme masat e përkohshme gjyqësore për pezullimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor.

Edhe pas riformulimit të nenit 610 të KPC-së, me ligjin nr. 122/2013, me të cilin u shfuqizua neni 611 e drejta e ankimit të veçantë është parashikuar në paragrafin që vjen fill pas atij që rregullon masat gjyqësore të përkohshme të pezullimit të ekzekutimit. Për shkak të kësaj teknike legjislative të përzgjedhur, në praktikën gjyqësore është krijuar një paqartësi, nëse ankimi i veçantë është mjet për goditjen e vendimeve të gjykatës për pezullimin e veprimeve përmbarimore apo me këtë mjet goditet edhe vendimi i gjykatës që ka zgjidhur përfundimisht ankimin ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor.

59. Në interpretimin e nenit 610 të KPC-së, në praktikën mbizotëruese të Gjykatës së Lartë, është ndjekur një logjikë argumentuese tejet formaliste, duke u nisur thjesht nga teknika legjislative dhe nga fakti se ku është vendosur e drejta e ankimit të veçantë në këto dispozita. Në vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë para ndryshimeve të KPC-së me ligjin nr. 122/2013, është theksuar se, duke vështruar në tërësi mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimeve, ankimi i veçantë kundër vendimeve të gjykatës është parashikuar shprehimisht në nenet 512, 516/3, 517/2, 539, 601 dhe 611 të këtij Kodi. Në këto vendime, Gjykata ka argumentuar se, ligjbërësi, për rastet kur ka çmuar se duhet të ushtrohet ankimi i veçantë, e ka parashikuar këtë mjet ankimi në mënyrë të posaçme. Kjo haset në të gjitha dispozitat kur lejohet ushtrimi i këtij mjeti. Në kushtet kur në nenin 610 të KPC-së nuk është parashikuar afati i ankimit, sikurse është parashikuar për të gjitha rastet e tjera kur si mjet ankimi lejohet të ushtrohet ankimi i veçantë, atëherë ankimi i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm, afatit 15-ditor dhe se ankimi i veçantë i lejuar lidhet vetëm me masat e pezullimit të ekzekutimit të detyrueshëm.

I njëjti qëndrim jurisprudencial vijoi edhe pas ndryshimeve të KPC-së me ligjin nr. 122/2013, edhe pse tashmë neni 611 ishte shfuqizuar dhe e drejta e ankimit të veçantë u integrua në një paragraf më vete në nenin 610 të KPC-së.

60. Kolegji vlerëson se një interpretim i tillë, ngushtësisht literal dhe i cunguar, duke u nisur thjesht nga vendi i vendosjes së parashikimeve ligjore që rregullojnë të drejtën e ankimit, nuk është në pajtim me parimet e përfundimit të ekzekutimit të detyrueshëm brenda një afati të arsyeshëm dhe me një interpretim teleologjik dhe sistematik të të gjitha dispozitave që disiplinojnë fazën e ekzekutimit të detyrueshëm në tërësi, sipas natyrës

juridike të ankimeve të tilla dhe qëllimit të cilin ato synojnë të realizojnë.

61. Kolegji vlerëson se ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, që disponon mbi ankimet ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, në çdo rast duhet të jetë i veçantë. Pra rregullimi i mëparshëm i nenit 611/2 të KPC-së, i integruar sot në nenin 610, si dispozitë e vetme që rregullon ankimin për kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor (me ligjin nr. 122/2013), duhet të interpretohet se rregullonte dhe rregullon të gjitha llojet e vendimmarrjes gjyqësore në lidhje me konfliktet e palëve me përmbaruesin gjyqësor në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.

62. Mjeti i parashikuar në nenin 610 të KPC-së, nuk ka natyrën e padisë, por të ankimit ndaj akteve procedurale të lëshuara nga subjekti i ngarkuar nga ligji për ekzekutimin e titullit ekzekutiv (ku faza njohëse dhe faza ekzekutive janë pjesë integrale e të njëjtit proces). Në nenin 31 të KPC-së, padia është përkufizuar si: "…*e drejta e personit që bën pretendimin, për t'u dëgjuar, mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo…".*

Ndërsa kuptimi i ankimit, ku përfshihet edhe ankimi sipas nenit 610 të KPC-së, jepet në nenin 442/, ku është parashikuar, se: *"Ankimi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës dhe veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre".*

Në këtë kuptim, ankimi i palëve ndaj akteve procedurale të realizuara nga përmbaruesi gjyqësor është analog me ankimin e palëve në gjykatën rishikuese, ndaj akteve procedurale të realizuara nga gjykata më e ulët, gjatë procesit kontencioz, në fazën njohëse të së drejtës.

63. Një dallim i tillë midis ankimeve për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore dhe padive të themelit është bërë vazhdimisht edhe në praktikën e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Ky dallim evidentohet më shumë, sidomos duke pasur parasysh që në dispozitat e pjesës së katërt të KPC-së, ka edhe mjete të tjera mbrojtjeje në disponibilitetin e debitorit dhe të personave të tretë, gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm, të cilat janë ndarë në dy kategori kryesore:

i) paditë që ngrihen gjatë procesit përmbarimor e që lidhen me mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga e drejta materiale (nenet 609, 612–614); dhe *ii)* ankimi (kundërshtimi) ndaj veprimeve ose mosveprimeve të përmbaruesit (neni 610).

64. Të dyja mjetet e parashikuara në nenet 609 dhe 610 të KPC-së, edhe pse hyjnë në rrethin e mjeteve mbrojtëse të debitorit ndaj ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv kanë:

i) shkak ligjor të ndryshëm; ii) afate të ndryshme ankimi; iii) mënyra mbrojtjeje të ndryshme; dhe iv) pasoja dhe efekte të ndryshme ndaj palëve të përfshira në një procedure ekzekutimi të detyrueshëm të titullit ekzekutiv.

65. Në nenin 609 të KPC-së, është parashikuar si mjet mbrojtjeje padia për goditjen e titullit ekzekutiv, që ngrihet nga debitori kundër kreditorit.

66. Titulli ekzekutiv si koncept juridik, tregon ekzistencën e një të drejte subjektive materiale, të cenuar ose të papërmbushur. Për këtë arsye, titulli ekzekutiv është burim i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë i legjitimimit të kreditorit për të iniciuar procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, legjitimitet i cili buron nga fakti se subjekti që ka titullin ekzekutiv ose në favor të të cilit është lëshuar titulli ekzekutiv, ka dhe të drejtën e përfshirë në të.

67. Padia për goditjen e titullit ekzekutiv konstituon një gjykim themeli që përqendrohet mbi shqyrtimin e masës dhe sasisë së të drejtës materiale që gjendet në titullin ekzekutiv dhe si e tillë i nënshtrohet një gjykimi të zakonshëm kontradiktor. Me anë të kësaj padie, nëpërmjet vërtetimit të së kundërtës, debitori synon të kundërshtojë të drejtën e kreditorit, i cili nga ana e tij, synon të procedojë me ekzekutimin e detyrimit.

Kjo padi, përmban elementet e një padie njohje negative. Shkaku ligjor i padisë së pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv qëndron në të drejtën e debitorit, për t'u çliruar nga një detyrim i cili rrjedh nga titulli ekzekutiv, për shkak të mospërputhjes ndërmjet realitetit që përfaqëson titulli ekzekutiv, me realitetin që ekziston efektivisht, kur e drejta e kreditorit nuk ka ekzistuar si e tillë që në origjinë ose për fakte shuese të ngjara pas formimit të titullit (*Shih vendim i Kolegjit Civil, nr. 214, datë 6.5.2010.*)

68. Ndërkohë mjeti tjetër juridik gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm është padia e personit të tretë për kërkimin e sendit apo për përjashtimin e tij nga ekzekutimi i detyrueshëm e rregulluar në nenin 612 të KPC.[46] Megjithëse ky mjet juridik është vendosur formalisht në rregullimet e pjesës së katërt të KPC, në thelb ka natyrën e një padie rivendikimi (*rei vindicatio*), e një lloji të veçantë, meqë ngrihet vetëm gjatë fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, pra para se të ketë përfunduar ekzekutimi i detyrueshëm dhe sendi të jetë shitur në ankand.

[46] Kjo dispozitë parashikon se:
"*Çdo person i tretë që pretendon se është pronar i sendit mbi të cilin bëhet ekzekutimi, mund të ngrejë padi për të ushtruar të drejtën e tij dhe kur është rasti për të përjashtuar sendin nga sekuestrimi dhe shitja.*
Padia ngrihet kundër kreditorit dhe debitorit në gjykatën e vendit të ekzekutimit të vendimit. Në këto raste, gjykata mund të vendosë si masë të përkohshme pezullimin e ekzekutimit me ose pa garanci."

Gjithashtu ajo ka një karakter njohës dhe detyrues në të njëjtën kohë.

Gjykata në shqyrtimin e kësaj padie investohet në verifikimin e vlefshmërisë së titujve të pronësisë, që kanë palët ndërgjyqëse, me pretendime pronësie mbi sendin. Ajo konkludon për përjashtimin e sendit nga ekzekutimi, duke i njohur dhe konfirmuar titullin e pronësisë palës paditëse që i kundërvihet titullit të pronësisë së palës të paditur. Në përfundim të gjykimit, gjykata e detyron palën e paditur që të njohë pronësinë e paditësit mbi sendin (*vendim nr. 222, datë 23.6.2016 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.*)

69. Vendimet e dhëna nga gjykata në përfundim të gjykimit të investuar nga padia sipas neneve 609 dhe 612 të KPC-së, janë vendime përfundimtare, të cilat goditen sipas rregullave të zakonshme të ankimimit.

70. Ndërkohë, kundërshtimi i veprimeve të përmbaruesit gjyqësor është mjet që ka për qëllim të godasë vlefshmërinë e akteve të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, që realizohen nëpërmjet kryerjes ose moskryerjes së veprimeve të përmbaruesit gjyqësor. Në këto lloj gjykimesh, gjykata nuk shqyrton më themelësinë e së drejtës së kreditorit të cilësuar në titullin ekzekutiv, por vlerëson, nga pikëpamja procedurale, nëse ankimi është ngritur brenda afatit ligjor të parashikuar shprehimisht në nenin 610 të KPC-së dhe nëse veprimet e përmbaruesit gjyqësor janë kryer apo jo në përputhje me ligjin.

Shkaku për të cilin mund të kundërshtohen gjyqësisht veprimet e përmbaruesit lidhen kryesisht me parregullsitë procedurale që mund të vërehen gjatë kryerjes së tyre nga ana e përmbaruesit, ose me mungesën e kushteve që duhen për të proceduar lidhur me ekzekutimin e një titulli ekzekutiv. (*vendim nr. 658, datë 17.12.2014 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

71. Karakteristikat e gjykimit përmbarimor dhe çështjet që shqyrton gjykata e investuar nga një ankim sipas nenit 610 të KPC-së, diktuan edhe përqendrimin e gjithë fazës ekzekutive në kompetencën e një gjyqtari të vetëm sipas nenit 610/3 të KPC-së, të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021, për të garantuar parimin e gjyqtarit natyral të çështjes, gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, parimin e sigurisë juridike etj.

72. Në aspektin e ngushtë teknik-procedural, centralizimi i shqyrtimit të ankimeve kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, në kompetencën e një gjyqtari të vetëm, lidhet pikërisht me faktin se në këtë fazë, gjykata nuk shqyrton themelësinë e së drejtës subjektive të kreditorit dhe ekzistencën e detyrimit të debitorit, si elemente përmbajtjesorë të marrëdhënies juridike materiale, të përfshirë në një titull ekzekutiv. Si rrjedhojë, gjyqtari i ekzekutimit nuk bëhet i papajtueshëm në ankimet e ndryshme që mund të vijnë nga palët në fazën ekzekutive, ku ai kontrollon ekskluzivisht ligjshmërinë e veprimeve të ndryshme procedurale të ndërmarra nga përmbaruesi, për ekzekutimin e të njëjtit titull ekzekutiv.

Vendimet që jep gjykata në fazën ekzekutive janë të karakterit të mirëfilltë procedural. Ato kanë natyrë të posaçme për nga kërkimet që zgjidhin dhe pasojat juridike që sjellin. Këto vendime sjellin efekte vetëm në marrëdhënien juridike procedurale ekzekutive, sa i takon vlefshmërisë së akteve të përmbaruesit gjyqësor. Në përfundim të gjykimit përmbarimor, gjykata sipas rastit mundet të anulojë veprimin përmbarimor dhe/ose të urdhërojë ripërsëritjen e tij, çka përcakton vijimësinë e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm. Si të tilla ato përafrohen më shumë nga natyra me urdhrat dhe vendimet e ndërmjetme që merr gjykata për të drejtuar dhe kontrolluar procesin gjatë fazës njohëse. Sipas parimit të gjyqtarit natyral dhe të pandërmjetshmërisë, njëlloj si në procesin gjyqësor njohës, ku gjyqtari (apo trupa gjykuese), si rregull duhet të jetë një dhe i vetëm gjatë gjithë gjykimit, edhe në fazën ekzekutive do të duhet të ruhet kjo garanci.

73. Natyra e tillë e këtyre vendimeve, bëhet më e dukshme/e qartë sidomos në gjykimin administrativ, ku gjykata apo gjyqtari që ka dhënë vendimin, me qëllim ekzekutimin e tij, në dhomë këshillimi, me kërkesë të palëve, merr masa për kryerjen e veprimeve të posaçme, duke përcaktuar afatet dhe mënyrën e tyre (neni 66 i ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar). Këto masa gjyqësore nuk kanë për qëllim të zgjidhin thelbin e së drejtës së individit kundrejt organit shtetëror, por kanë për qëllim të konkretizojnë mënyrën se si do të realizohet kjo e drejtë.

74. Sikurse u analizua më sipër, si rregull, KPC-ja parashikon ankim të veçantë për vendimmarrje të tilla gjyqësore.

75. Këtu vlen të sillet në vëmendje se me ndryshimet që pësoi KPC, me ligjin nr.114/2016, në nenin 609 të KPC-së, u bë një diferencim i shprehur midis vendimit përfundimtar dhe vendimit të ndërmjetëm të gjykatës, për sa i përket së drejtës së ankimit. Konkretisht, kjo dispozitë u riformulua në këtë mënyrë:

"*...Gjykata shqyrton kërkesat për pezullimin, sipas këtij neni, brenda 5 ditëve. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim i veçantë. Gjykata e apelit e shqyrton ankimin, brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të tij në këtë gjykatë.*

Kundër vendimit përfundimtar të gjykatës mund të bëhet ankim, sipas rregullave të ankimit të përgjithshëm. Gjykata e apelit e shqyrton ankimin, brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të tij në këtë gjykatë...".

76. Një diferencim i tillë, qëllimisht, nuk u bë me këtë ligj, në nenin 610 të KPC-së, në të cilën u la i pandryshuar paragrafi i 5, i vendosur si fjali më vete pas paragrafëve të tjerë që rregullojnë si vendimin gjyqësor në lidhje me

pezullimin, ashtu edhe vendimin që ka disponuar përfundimisht në lidhje me veprimin përmbarimor, ku thuhet se: "*Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë*".

77. Nëse vështrohet e gjithë pjesa e katërt e KPC-së apo edhe dispozita të tjera në Kod, që rregullojnë fazën e ekzekutimit të detyrueshëm dhe gjykimet përmbarimore, mund të thuhet se këto dispozita, përbëjnë një regjim juridik të posaçëm, në raport me rregullat që disiplinojnë gjykimin kontencioz të zakonshëm, të iniciuar nga padia sipas neneve 31 dhe 32 të KPC-së. Nga një vështrim sistematik, lehtësisht vërehet vullneti i qartë dhe i padiskutueshëm i ligjvënësit që, kjo fazë është e disiplinuar me afate shumë të shkurtra dhe gjykimet zhvillohen në afate të përcaktuara nga ligji, sipas ritit të gjykimit të posaçëm në dhomë këshillimi, si në gjykimin me juridiksion fillestar, ashtu edhe në gjykimin rishikues.

78. Rregullimi i posaçëm mbi afatet që disiplinojnë këtë fazë, fillimisht rezulton nga parashikimi i nenit 399/2 të KPC-së, ku janë parashikuar afatet orientuese, me qëllim shqyrtimin e kërkesave të palëve për shkelje të afateve të arsyeshme si standard i parashikuar në nenet 6 të KEDNJ-së dhe 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Për gjykimin kontencioz civil dhe administrativ, ku diskutohet themeli i së drejtës së kreditorit, ligjvënësi ka parashikuar si afate të arsyeshme kohëzgjatjen përkatësisht prej dy dhe një viti, për secilën shkallë gjykimi dhe një afat tërësor prej 6 dhe 3 vitesh deri në marrjen e një vendimi final dhe të formës së prerë (shih nenin 399/2, shkronja "a" dhe "b" të KPC-së). Ndërkohë që për zgjatjen e fazës së ekzekutimit të detyrueshëm, në të dyja llojet e gjykimeve, është parashikuar një afat tërësor prej 1 viti, nga data e paraqitjes së kërkesës për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv.

79. Sikurse mund të konstatohet, ligjvënësi, ka parashikuar afate dukshëm më të shkurtra për fazën ekzekutive. Duke qenë se në këtë fazë, materializohet fizikisht e drejta e certifikuar në procesin njohës apo në titullin ekzekutiv të parashikuar si të tillë nga ligji dhe që përbën qëllimin e drejtësisë, nuk mundet që ajo të zgjasë po njëlloj apo edhe më shumë në kohë, sesa vetë procesi gjyqësor njohës.

Duhet të mbahet parasysh në këtë drejtim që potencialisht dhe teorikisht çdo veprim përmbarimor mundet të bëhet objekt gjykimi brenda pesë ditëve në gjykatë. Nëse sjellim në vëmendje se sa veprime përmbarimore ndërmerren për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv, atëherë kuptohet se sa kohë do të mund të zgjaste faza ekzekutive nëse do të ndiqeshin rregullat e zakonshme të gjykimit.

80. Këtu, Kolegji risjell në vëmendje, se ka modele ligjore (të marra në analizë në pjesën e dytë të këtij vendimi njësues), të cilat nuk lejojnë fare ankim, qoftë apel apo qoftë rekurs ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë që ka si kompetencë lëndore gjykimet përmbarimore. Ligjvënësi jonë nuk e ka vendosur një kufizim të tillë, por ka parashikuar afate shumë të shkurtra ankimi dhe gjykimi në gjykatat rishikuese.

81. Kështu, lëshimi i urdhrit të ekzekutimi të titullit ekzekutiv, pa të cilin nuk mund të fillojë procedura e ekzekutimit të detyrueshëm, realizohet nga gjykata në dhomë këshillimi (neni 511 i KPC-së). Ndaj vendimit të gjykatës me të cilin refuzohet lëshimi i urdhrit lejohet ankim i veçantë, brenda afatit 5-ditor (neni 512 i KPC-së).

82. Më tej, afatet të cilat disiplinojnë veprimtarinë e përmbaruesit gjyqësor dhe të subjekteve të përfshira gjatë fazës ekzekutive, (shih nenet 515, 517, 553, 557, 560, 564, 567, 569, 575, 601 etj.); afatet e ankimeve në gjykatë ndaj veprimeve të veçanta të përmbaruesit (shih nenet 512, 516, 517, 539, 583, 588, 599, 601, 606, 617 etj.), janë më të shpejtat dhe më të shkurtrat ndërmjet mjeteve procedurale që mundëson e parashikon ligji procedural civil. Po ashtu, procedurat gjyqësore përmbarimore janë disiplinuar nga afate të shkurtra (shih nenet 517/3, 522 etj.).

83. Sipas nenit 610 të KPC-së, ankimi ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor duhet të paraqitet në gjykatë brenda 5 ditëve nga data e kryerjes së veprimit ose nga data e njoftimit. Po ashtu, ky ankim shqyrtohet nga gjykata, në dhomë këshillimi, si rregull, brenda një afati të shpejtë prej 20 ditësh. Edhe ankimi ndaj vendimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë, në apel, shqyrtohet, me një gjyqtar, sipas ritit të posaçëm në dhomë këshillimi, brenda një afati 30-ditor nga data e regjistrimit të ankimit (rregull analog me atë të parashikuar në nenin 470/3 të KPC-së), me përjashtim kur debati zhvillohet në seancë gjyqësore, gjykimi duhet të përfundojë brenda një afati prej 45 ditësh.

84. Nëse e gjithë veprimtaria e palëve dhe e gjykatës në fazën ekzekutive, disiplinohet nga afate shumë të shkurtra dhe nga procedura gjykimi të posaçme, të thjeshtëzuara dhe të shpejta, nuk ka asnjë arsye logjike e juridike që të justifikojë interpretimin se, përbën përjashtim, pra nuk ka ankim të veçantë, vetëm rasti i ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që disponon lidhur me kundërshtimin e veprimeve përmbarimore sipas nenit 610 të KPC-së, që përbën një dispozitë të përgjithshme dhe pilot për të gjitha ankimet e paraqitura kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor.

Kjo dispozitë nuk mundet të interpretohet si një rregull i izoluar, në raport me dispozitat e tjera dhe me frymën që përshkon në tërësi rregullat e posaçme që disiplinojnë fazën e ekzekutimit të detyrueshëm. Në të kundërt do të krijohej një anomali, ku gjykimi në këtë fazë do të zgjaste në kohë njëlloj apo edhe më shumë, në raport me procesin gjyqësor në fazën njohëse.

85. Kolegji sjell në vëmendje faktin se, ankimi ndaj veprimeve të përmbaruesit gjyqësor në gjykatë dhe, më pas,

ankimi ndaj vendimit gjyqësor për pranimin ose jo të ankimit për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, nuk kanë efekt pezullues kundrejt veprimeve të kryera ose jo nga përmbaruesi gjyqësor. Në dallim edhe nga parimi i përgjithshëm i sanksionuar posaçërisht në nenin 449 të KPC-së, sipas të cilit ankimi ndaj vendimit përfundimtar gjyqësor pezullon ekzekutimin e tij, synimi është që këto ankime të lidhur me veprimet përmbarimore të fazës së ekzekutimit të mos shërbejnë si një lojë e mjet abuzues i palës debitore pikërisht për të penguar ekzekutimin e një titulli ekzekutiv. Ligjvënësi në këtë dispozitë synon e parashikon vetëm një përjashtim, atë që vetëm gjykata, në rrethana të posaçme e përjashtimore, të urdhërojë pezullimin e ekzekutimit deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të ankimit për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore.

86. Së fundi, vlen të sillet në vëmendje se me ndryshimet që pësoi neni 35 i KPC-së, me ligjin nr. 44/2021, ligjvënësi në mënyrë të shprehur përcaktoi se ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar mbi kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, është ankim i veçantë. Konkretisht në këtë dispozitë është parashikuar se: "*Gjykata e apelit shqyrton çështjen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Gjykata e apelit shqyrton me një gjyqtar të vetëm ankimet kundër vendimeve për paditë me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, që rrjedhin nga marrëdhënie kontraktore, ankimin e veçantë kundër vendimit të refuzimit të kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit,* ***ankimet e veçanta kundër vendimit të gjykatës që ka shqyrtuar kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor****, si dhe rastet e tjera të parashikuara në këtë Kod...*".

87. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se neni 610 i KPC-së, ku parashikohet edhe mjeti i "ankimit të veçantë", nuk lidhet vetëm me vendimin e gjykatës së shkallës së parë që urdhëron pezullimin e ekzekutimit apo vetëm me pjesën eventuale të dispozitivit të vendimit që ka disponuar përfundimisht mbi ankimin kundër veprimeve përmbarimore, për pezullimin ose jo të ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Pavarësisht nga teknika legjislative jo e përsosur në formulimin e paragrafëve, për sa i përket vendndodhjes të së drejtës së ankimit të veçantë, paragrafi i gjashtë i nenit 610 përfshin natyrshëm edhe ankimin kundër vendimit gjyqësor që ka disponuar përfundimisht për çështjet me shkak ligjor dhe objekt kundërshtimin e veprimeve përmbarimore.

88. Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se ankimi i veçantë i parashikuar në nenin 610, me ndryshimet që ka pësuar KPC-ja në vitin 2021, do të duhet të ndjekë të njëjtin regjim juridik të posaçëm, si në gjykimin në apel, ashtu edhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë. Në nenin 443 të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021, është parashikuar instituti i rekurseve të veçanta, si mjet për goditjen e vendimeve të gjykatës së apelit, të vënë në lëvizje nga një ankim i veçantë, ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ligjvënësi ka pasur si qëllim që të ofrojë ankime të veçanta ndaj çështjeve për të cilat duhet adresuar gjyqësisht nga juridiksioni rishikues një zgjidhje e shpejtë, qoftë nga gjykata e apelit, qoftë nga Gjykata e Lartë.

Ndaj njëjtësimi i rregullave të gjykimit rishikues në Gjykatën e Lartë, si ndaj ankimeve të zakonshme ashtu edhe ndaj ankimeve të veçanta nuk do të ishte as në frymën e ligjit dhe as zbatim kushtetues i tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se edhe ndaj vendimeve të gjykatës së apelit që disponojnë mbi ankimet e veçanta kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, sipas nenit 610 të KPC-së, ligji lejon rekurs të veçantë në Gjykatën e Lartë, që do të thotë rekurs brenda 5 ditëve.

IV. Sentenca njësuese

89. Sa më sipër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, arrin në konkluzionin njësues si më poshtë vijon:

Neni 610 i KPC, lejon ankim të veçantë, brenda një afati 5-ditor, ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar mbi ankimin kundër veprimeve të përmbaruesit gjyqësor.

Ankimi i veçantë i parashikuar në nenin 610 të KPC-së, është mjeti me të cilin goditet si vendimi për "pezullimin e veprimeve përmbarimore" ashtu edhe vendimi që disponon përfundimisht mbi "kundërshtimin e veprimit përmbarimor".

V. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

90. Në çështjen konkrete, pala paditëse ka kundërshtuar veprimet e përmbaruesit gjyqësor, sipas nenit 610 të KPC-së. Vendimi i gjykatës është shpallur më datë 23.10.2015 dhe ai ka qenë prezent në momentin e shpalljes. Rezulton se ankimi i paditësit në gjykatën e apelit është depozituar më datë 2.11.2015 dhe më tej është plotësuar më datë 7.12.2015, pas marrjes dijeni mbi arsyetimin e vendimit.

91. Gjykata e Apelit Tiranë ka vlerësuar se sipas nenit 610 të KPC-së (të zbatueshëm në atë kohë), ankimi i lejuar është ankim i veçantë, brenda një afati 5-ditor. Ky afat ka filluar të ecë nga e nesërmja e shpalljes, sipas neneve 443 dhe 444 të KPC-së dhe ka përfunduar më datë 28.10.2015. Nuk rezulton që kjo datë dhe ditët në vijim të kenë qenë ditë pushimi ose festë zyrtare, çka do të shkaktonte shtyrjen e afatit, sipas nenit 148 të KPC-së. Si rrjedhojë, në bazë të nenit 450/a të KPC-së, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur mospranimin e ankimit.

92. Duke u bazuar në konkluzionet e këtij vendimi njësues, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit procedural dhe duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 481 dhe 485/2,
të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 30-2016-3026, datë 26.5.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Ky vendim është njësues i praktikës gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 26.10.2022

Kryesues: Artur Kalaja
Anëtarë: Ervin Pupe, Albana Boksi, Sandër Simoni, Gentian Medja

VENDIM
Nr. 00-2022-4596 (393), datë 26.10. 2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:
Artur Kalaja kryesues;
Ervin Pupe anëtar;
Sandër Simoni anëtar;
Albana Boksi anëtare;
Gentian Medja anëtar,
Në seancën gjyqësore më datë 26.10.2022, mori në shqyrtim çështjen, që u përket palëve:
PADITËS: Demir Bakanaçi
I PADITUR: Mark Pllana, Nete Pllana, Julian Pllana
OBJEKTI: 1. Interpretimin e kontratës nr. 1106, datë 9.3.1998, duke e konsideruar si një kontratë shitjeje me kusht.
2. Detyrimin e palës së paditur të më njohë pronare mbi tokën arë prej 4790 m² e ndodhur në parcelën nr. 63/11 në vendin e quajtur "Gjon Preni".
BAZA LIGJORE: Neni 32 e vijues i Kodit të Procedurës Civile dhe nenet 149, 162, 163, 168, 193, 659, 660, 662, 663, 681, 684, 705, 706, 711, 712, 750, 751 të Kodit Civil.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit, z. Ervin Pupe dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Faktet e çështjes
1. Para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, më datë 7.6.2010, është ngritur një padi me objekt dhe palë ndërgjyqëse sikurse përcaktohet në pjesën hyrëse.
2. Nga aktet e fashikullit të gjykimit ka rezultuar e provuar se, me AMTP nr. 684, datë 1.8.1994, familja bujqësore me kryefamiljar të padituri Mark Pllana, ka marrë në fshatin Sukth, Durrës, mes të tjerash edhe tokë arë prej 5 000 m², në parcelën me nr. 63/11. Kjo familje bujqësore, referuar gjendjes familjare më datë 1.8.1991 ka qenë e përbërë nga 4 anëtarë.
3. Midis palëve ndërgjyqëse, paditësit Demir Bakanaçi dhe të padituri Mark Pllana është përfunduar kontrata e qirasë nr. 1106/781, datë 9.3.1998, me akt noterial. Sipas kontratës së mësipërme, i padituri Mark Pllana i jep paditësit me qira një sipërfaqe prej 4 790 m², në parcelën nr. 63/11, sipas AMTP nr. 684, datë 1.8.1994.
4. Palët kanë deklaruar në kontratë se, kjo tokë jepet me qira për afat 30-vjeçar, kundrejt një vlere qiraje të përgjithshme prej 500 mijë lekë për të gjithë periudhën e qirasë, shumë kjo e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Po kështu në kontratën e qirasë, palët kanë parashikuar edhe një klauzolë me këtë përmbajtje: "*Palët deklarojnë se këtë*

kontratë 30-vjeçare e konsiderojnë edhe si kontratë shitjeje me detyrimin që, sapo të fillojë zbatimi i ligjit të shitblerjes së tokës bujqësore për këtë zonë, të përpilojnë aktin noterial të shitjes pa asnjë pagesë tjetër nga qiramarrësi, sepse vlera e sipërme e paguar prej tij si qira 30-vjeçare, është në fakt vlefta e plotë e shitjes së kësaj sipërfaqe tokë".

5. Të paditurit banojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Me prokurën e posaçme nr. 3434/541, datë 15.8.2013, të paditurit Mark Pllana, Nete Pllana dhe Julian Pllana kanë autorizuar të afërmin e tyre Zef Pllana që të kryejë procedurat për regjistrimin e pronës prej 4 790 m² në ZVRPP Durrës.

6. Palët e paditura gjithashtu kanë autorizuar po këtë përfaqësues, që të marrë vendimin nga Këshilli i Kujdestarisë për të miturën Eriona Pllana dhe më pas të nënshkruajë aktin noterial të shitjes së tokës në favor të z. Demir Bakanaçi, duke qenë plotësisht i lirë që të vendosë vetë për kushtet e kontratës.

7. Më datë 10.11.2009, paditësi i është drejtuar me shkrim përfaqësuesit të të paditurve, z. Zef Pllana, duke i kujtuar që të zbatojë detyrimet që i janë lënë me prokurën e posaçme të datës 15.8.2003. Ky i fundit i është përgjigjur me shkrim se nuk merr përsipër që të nënshkruajë për të paditurit në asnjë dokument, pasi ato kanë vite që ndodhen jashtë shtetit dhe se përfaqësuesi për një kohë të gjatë nuk ka pasur komunikim me ta.

8. Paditësi, duke qenë në posedim të sendit objekt gjykimi, i është drejtuar gjykatës me padinë me objekt njohje pronar kundrejt palëve të paditura, duke pretenduar se e ka fituar pronësinë mbi sendin objekt gjykimi me parashkrim fitues me titull, me mirëbesim sipas nenit 168 të KC-së.

9. Si në gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, ashtu edhe në gjykimin në apel, të paditurit janë gjykuar në mungesë, pasi rezultojnë se janë jashtë shtetit.

10. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës,** me vendimin nr. 1238/3784, datë 3.5.2012, ka vendosur:

"*-1. Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit Demir Bakanaçi me të paditur Mark Pllana, Nete Pllana, Julian Pllana dhe Eriona Pllana dhe palë të tretë ZVRPP Durrës si të pabazuar në prova dhe ligj.*

-2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë. 3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim nga palët brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Durrës. Për palët në mungesë e drejta e ankimit fillon nga marrja dijeni mbi vendimin.".

11. Gjykata ka arsyetuar se në kontratën e qirasë nuk është shprehur vullneti i gjithë bashkëpronarëve të kësaj sipërfaqe toke, por vetëm i njërit prej tyre, i cili kishte të drejtë të kryente veprime për administrimin e tokës, por jo për tjetërsimin e saj. Prona, që të jepej me qira, duhet të ishte e regjistruar pranë ZVRPP Durrës në emër të qiradhënësit. Sipas nenit 826 të KC-së "*Kontrata e qirasë e pasurive të paluajtshme që shërben për kultivimin bujqësor për një kohë mbi nëntë vjet duhet të behet me akt noterial dhe të regjistrohet".* Përveç kontratës së qirasë, paditësi ka paraqitur si provë dhe një prokurë të posaçme, nr. 2434 datë 15.8.2003 në të cilën është shënuar se, të paditurit Mark Pllana, Nete Pllana dhe Julian Pllana caktojnë si përfaqësues ligjor të tyre z. Zef Prend Pllana, të cilit i japin të drejtë që të bëjë regjistrimin pranë ZVRPP Durrës, të një sipërfaqe toke prej 4790 m², të marrë vendimin nga Këshilli i Kujdestarisë për fëmijën e mitur, Erjona Pllana dhe më pas të nënshkruajë aktin noterial për tjetërsimin e kësaj prone në emër të paditësit.

12. Gjatë gjykimit rezultoi se mes palëve nuk ka konflikt për këtë pronë. Fakti që nga përfaqësuesi nuk janë kryer veprimet administrative për regjistrimin e pronës, nuk mund të përdoret si provë para gjykatës për të bërë interpretimin e kontratës së qirasë si kontratë shitje, pasi kjo kontratë qiraje në vetvete nuk i plotëson kushtet ligjore që të interpretohet si kontratë shitje. Në një pikë të kësaj kontrate qiraje është vendosur që palët pas daljes së ligjit për shitjen e tokës bujqësore do të bënin kontratë shitje mes tyre. Që të realizohet një tjetërsim prone duhet të plotësohen disa kushte ligjore të cilat në rastin konkret nuk janë plotësuar dhe konkretisht: 1) prona duhet të jetë e regjistruar pranë ZVRPP Durrës dhe vetëm pas regjistrimit të pronës palët kanë të drejtë të lidhin kontratë shitje; 2) duhet të shprehet vullneti i të gjithë bashkëpronarëve në kontratë.

13. **Kundër vendimit** nr. 1238/3784, datë 3.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka bërë **ankim** paditësi, Demir Bakanaçi, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë, duke parashtruar se:

-gjykata në mënyrë të gabuar deklaron se vetëm pasi të paditurit të kryejnë veprimet administrative të regjistrimit të pronës në ZVRPP, mund të kryhen veprimet e shitjes;

-pala paditëse ka fituar pronësinë mbi sendin me parashkrim fitues, pasi plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 168 i KC-së, pasi sendi është zotëruar realisht për 14 vjet;

-gjykata nuk është shprehur se kush është pronari real i tokës arë, paditësi apo të paditurit.

14. **Gjykata e Apelit Durrës,** me vendimin nr. 10-2014-2291/563, datë 7.7.2014 ka vendosur:

"*-1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 3784/1238, datë 3.5.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.*

-2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs brenda 30 ditëve në Gjykatën e Lartë".

15. Në lidhje me pikën e parë të objektit të padisë, gjykata çmon se kontrata e qirasë nr. 1106/781, datë 9.3.1998, nuk mund të interpretohet si kontratë shitjeje me kusht pezullues, pasi jemi para një veprimi juridik "nul" dhe si i tillë, nuk mund të interpretohet.

16. Pavarësisht terminologjisë së përdorur nga palët për ta konsideruar këtë kontratë edhe si kontratë shitjeje, ligjërisht, ky akt nuk mund të konsiderohet si kontratë shitjeje me kusht pezullues. I padituri Mark Pllana është vetëm njëri nga bashkëpronarët e tokës për të cilën ka marrë çmimin prej 500 mijë lekësh, i cili ka shprehur vullnetin që toka të jepet si fillim me qira, dhe më pas të shitet në momentin që do të lejohet shitja e tokës bujqësore.

17. Gjykata e apelit, kryesisht, konstaton se kontrata nr. 1106/781, datë 9.3.1998, është absolutisht e pavlefshme. Si kontrata e qirasë në përmbajtje, ashtu edhe klauzola për shitjen e tokës kur të fillonte regjistrimi i tokave bujqësore, janë të lidhura pandashmërisht me njëra tjetrën, ndaj tërësisht, kontrata konsiderohet "nul". Kjo kontratë është lidhur në kundërshtim me ligjin (nenet 92/a, 200, 222 të KC), pasi qiradhënësi (i padituri Mark Pllana) nuk ka qenë pronar i vetëm i tokës arë të dhënë me qira. Qiradhënësi është vetëm një nga anëtarët e familjes bujqësore, për të cilën është dhënë AMTP nr. 684, datë 1.8.1994. Kjo familje bujqësore, referuar gjendjes familjare më datë 1.8.1991 ka qenë e përbërë nga 4 anëtarë. Si njëri nga bashkëpronarët, i padituri Mark Pllana, mund të dispononte vetëm për pjesën e tij nëse do e kishte të ndarë/pjesëtuar, por jo edhe në emër të bashkëpjesëtarëve të tjerë.

18. Gjykata e apelit, në lidhje me pikën e dytë të objektit të padisë çmon se edhe ky kërkim nuk qëndron, pasi nuk plotësohen kushtet e parashikuara nga neni 168 i KC-së në lidhje me këtë mënyrë fitimi pronësie. Toka bujqësore në kohën e përfundimit të kontratës, si send i paluajtshëm, nuk ishte e aftë për tu tjetërsuar dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve do të lindin vetëm kur të lejohej shitja e saj. Vetëm në këtë moment, toka bujqësore do të konsiderohej si send i aftë për tu tjetërsuar. Ndonëse parashkrimi fitues është rasti klasik që e mbulon pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik për shkak të mungesës së formës, në rastin konkret pavlefshmëria absolute nuk lidhet me formën, por lidhet me përmbajtjen, lidhet me mungesën e shfaqjes së vullnetit të të gjithë bashkëpronarëve. Mund të ishim para rastit të parashkrimit fitues vetëm për pjesën e kryefamiljarit të familjes bujqësore dhe vetëm në rastin se pjesa e tij në këtë tokë do të ishte e veçuar.

19. Gjykata e apelit çmon se pretendimi i palës paditëse se duhet të fitojë pronësinë edhe për shkak të dhënies së pëlqimit të të gjithë anëtarëve të familjes bujqësore (të të paditurve) me prokurën e posaçme së datës 15.8.2013, nuk është një pretendim që lidhet me këtë objekt gjykimi, për të cilën paditësi ka vënë në lëvizje gjykatën (pasi nuk kërkohet detyrimi i të paditurve për të lidhur kontratën e shitjes). Me anë të kësaj prokure, të paditurit kanë autorizuar një person tjetër (Zef Pllanën) që të kryejë shitjen e pronës në emër e për llogari të tyre te paditësi (neni 64 i KC-së) , ndonëse përfaqësuesi ka hequr dorë nga prokura (76/d i KC-së) referuar përgjigjes së kthyer paditësit mbi kujtesën noteriale të këtij të fundit.

20. **Kundër vendimit** nr. 10-2014-2291/563, datë 7.7.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës, me datë 5.8.2014, ka paraqitur **rekurs**, paditësi Demir Bakanaci, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimeve të dy gjykatave dhe pranimin e padisë duke parashtruar këto shkaqe:

- Vendimet e gjykatave më të ulëta janë të pabazuara në ligjin material;
- Pasuria objekt gjykimi është poseduar nga paditësi që në datë 9.3.1998 kur është lidhur kontrata me palën e paditur, z. Mark Pllana si kryefamiljar i familjes bujqësore e cilësuar si kontratë qiraje deri në momentin kur do të fillonte zbatimi i ligjit nr. 7501. Pas këtij momenti kjo kontratë do të konsiderohej si kontratë shitje;
- Kontrata objekt gjykimi është lidhur me vullnetin e të gjithë anëtarëve të familjes bujqësore, konkretisht kryefamiljari e ka dhënë vullnetin me kontratën e datës 9.3.1998, kurse anëtarët e tjerë me prokurën e posaçme nr. 2434 rep., datë 15.8.2003. Nga ana tjetër, anëtarja tjetër e mitur Erjona Pllana ka mbi tetë vjet që është bërë madhore;
- Sikurse ka rezultuar nga aktet e fashikullit të gjykimit, i jam drejtuar disa herë të paditurve, por nga ana e tyre nuk është shfaqur asnjë interes mbi këtë pasuri;
- Ndryshe nga sa arsyetojnë gjykatat më të ulëta, kontrata me nr. 1106/781, datë 9.3.1998, duhet interpretuar si kontratë shitje dhe për efekt të nenit 168 të KC-së si veprim juridik që ka si synim kalimin e pronësisë;
- Gjykata e Apelit Durrës ka marrë tagrat e të paditurve dhe ka mbrojtur interesat e tyre në kushtet kur vetë palët e paditura nuk kanë pasur pretendime se kjo kontratë ka cenuar të drejtat e tyre të bashkëpronësisë;
- Në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet e parashikuara nga neni 168 i KC-së për fitimin e pronësisë mbi sendin objekt gjykimi nga paditësi.

II. Procedura para Gjykatës së Lartë dhe nevoja për njësimin e praktikës gjyqësore

21. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), i përbërë nga një trup gjykues prej tre gjyqtarësh, mori në shqyrtim këtë çështje në dhomë këshillimi më datë 11.4.2022. Pavarësisht se rekursi i palës paditëse është paraqitur më datë 4.11.2014, para ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile (në vijim "KPC") në vitin 2021, ai u shqyrtua sipas dispozitave procedurale që janë në fuqi aktualisht, në lidhje me ritin e gjykimit, përbërjen e trupës gjykuese dhe mënyrën e disponimit nga Gjykata e Lartë. Veprimi i ligjit procedural në kohë rregullohet nga

dispozita tranzitore e ligjit nr. 44/2021, ku është parashikuar se: "*1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera; 2. Rekurset e paraqitura, por ende të pashqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre.*"

22. Pasi mori në shqyrtim aktet e fashikullit të gjykimit dhe pretendimet e ngritura në rekursin e paraqitur nga paditësi Demir Bakanaci, Kolegji vlerësoi se në rastin konkret, shtroheshin për zgjidhje disa çështje ligjore në lidhje me interpretimin e nenit 168 të KC-së, mbi kuptimin e veprimit juridik që nuk është i ndaluar nga ligji dhe që ka për qëllim kalimin e pronësisë.

23. Pas një studimi paraprak, Kolegji konstatoi se në praktikën e gjykatave më të ulëta janë hasur probleme të interpretimit të nenit 168 të KC-së, çka ka shkaktuar jo rrallë herë edhe praktika të ndryshme gjyqësore. Nga Gjykata e Lartë, deri më sot, nuk janë përcaktuar kritere të qarta dhe të njëjta, për të orientuar praktikën gjyqësore mbi kuptimin e kësaj dispozite, mbi kuptimin e veprimeve juridike që kanë për qëllim kalimin e pronësisë; mbi kuptimin e veprimeve që nuk janë të ndaluara nga ligji, si kushte-premisa për fitimin e pronës, me këtë mënyrë origjinale të fitimit të pronësisë, mbi fushën e zbatimit të nenit 168 etj.

24. Në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, nuk është dhënë një kuptim i unifikuar dhe i qartë mbi nocionin e "*veprimit juridik që nuk është i ndaluar nga ligji*", sipas nenit 168 të KC.

25. Me këtë nocion, shpesh herë janë identifikuar veprimet juridike absolutisht të pavlefshme, për shkak të shkeljes së një dispozite urdhëruese të ligjit, sipas nenit 92/a të KC-së. Ndërsa në disa raste është konkluduar se neni 168 i KC-së (në të njëjtën mënyrë edhe neni 91 i KC-së të vitit 1981), mbulon vetëm pavlefshmërinë e veprimit juridik për mungesë të formës (*shih vendim nr. 00-2009-1329 (456), datë 24.12.2009 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; Vendim nr. 307, datë 29.6.2010 etj.*).

26. Në raste të tjera, nga Gjykata e Lartë është konkluduar se neni 168 i KC-së nuk mbulon vetëm pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, në veçanti ato veprime juridike që vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, sipas nenit 92/a të KC-së (*shih vendim nr. (417), datë 5.4.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

27. Në disa vendime, është konkluduar se neni 168 i KC-së, mbulon çdo lloj pavlefshmërie, si atë absolute, ashtu edhe atë relative, sepse kjo dispozitë parashikon një mënyrë origjinale të fitimit të pronës që ka për bazë posedimin dhe jo një mënyrë të prejardhur. Mjafton që veprimi juridik të mos jetë i ndaluar nga ligji. Në këto vendime është theksuar se duhet bërë dallimi midis veprimeve juridike absolutisht të pavlefshme, nga veprimet juridike të ndaluara nga ligji (*shih vendim nr. 00-2010-379, datë 12.10.2010; vendim nr. 00-2014-844 (37), datë 6.2.2014; vendim nr. 290, datë 4.6.2015 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.*). Kolegji Civil ka mbajtur qëndrimin se jo çdo veprim juridik absolutisht i pavlefshëm për shkak se vjen në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, do të konsiderohet gjithashtu edhe një veprim juridik i ndaluar nga ligji, pasi ky i fundit i referohet rastit kur norma urdhëruese ndalon shprehimisht kryerjen e vetë llojit apo kategorisë së veprimit juridik, pavarësisht nga forma dhe përmbajtja e tij *(vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, nr. 11111-00655-00-2007 i Regj. Themeltar, nr. 00-2009-1329 i vendimit (456), datë 24.12.2009; vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, nr. 11111-00639-00-2006 i Regj. Themeltar, nr. 00-2008-544 i vendimit (214), datë 18.3.2008; vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, nr. 11115-01734-00-2007 i Regj. Themeltar, nr. 00-2010-973 i vendimit (307), datë 29.6.2010. Vendimi i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil nr. 11211-00165-00-2005 i Rregj. Themeltar, nr. 00-2007-584 i vendimit (417), datë 5.4.2007 etj.).*

28. Ajo që vlen të theksohet është se, zgjidhjet jurisprudenciale janë dhënë rast pas rasti, duke mos u përcaktuar disa kritere konkrete, të qarta dhe të njësuara në lidhje me këtë koncept.

29. Po ashtu, nga Gjykata e Lartë, nuk ka pasur një praktikë të njësuar mbi kuptimin e "*veprimit juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë*", për efekt të nenit 168 të KC-së.

30. Sipas një qëndrimi jurisprudencial, për efekt të kësaj dispozite, do të kuptohen ngushtësisht vetëm veprimet juridike sipas përkufizimit të nenit 79 të KC-së. Si rrjedhojë, neni 168 i KC-së, fushën e zbatimit e ka vetëm për veprimet juridike midis privatëve dhe nuk mbulon marrëdhëniet juridike shtet-individ.

31. Në një rast konkret, para Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është shtruar për diskutim çështja ligjore, nëse mund të fitohet pronësia sipas nenit 168 të KC-së, ku titulli i pretenduar nga personi që e ka zotëruar është një akt i marrjes së tokës në pronësi. Gjykatat më të ulëta e kishin rrëzuar padinë me argumentin se ky akt nuk përbën një veprim juridik për kalimin e pronësisë, por një akt administrativ i nxjerrë sipas ligjit nr. 7501/1991 "Për tokën". Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 553, datë 27.4.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit, me argumentin që nuk konstatohen shkelje të ligjit material nga gjykatat më të ulëta.

32. Në një rast tjetër të ngjashëm, Kolegji Civil, me vendimin nr. 518, datë 17.12.2015, pasi ka marrë në analizë kushtet e nenit 168 të KC-së, është shprehur se: "…*Gjykata e apelit nuk ka arritur të argumentojë se si leja e dhënë nga*

autoritetet shtetërore për ndërtimin e banesës nga paditësi, përbën njëkohësisht edhe një veprim juridik të pandaluar nga ligji…"

33. Në të njëjtën mënyrë, në vendimin nr. 205, datë 16.4.2015, Kolegji Civil është shprehur se: *"…gjykatat e faktit gabimisht pranojnë vendimin e ish-Komitetit Ekzekutiv të KP (lejen e ndërtimit), si veprim juridik për fitimin e pronësisë me anë të parashkrimit fitues. Leja e ndërtimit nuk është veprim juridik, i lidhur midis dy palëve të këtij gjykimi, që pavarësisht nga të metat në formë, përbën shkak juridik për fitimin e pronësisë me anë të parashkrimit fitues me titull…"*

34. Në të kundërt, në disa raste të tjera, është mbajtur qëndrimi se me konceptin "veprim juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë", sipas nenit 168 të KC-së do të kuptohet gjerësisht çdo lloj titulli i aftë për të kaluar pronësinë, qoftë ky veprim juridik apo akt administrativ. Kështu, në vendimin nr. 26, datë 5.4.2018, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, është shprehur se:

"…Për të fituar një send të paluajtshëm me anë të institutit të parashkrimit fitues me titull, parashikuar nga neni 168 i Kodit Civil…duhet të ekzistojnë njëherazi (në mënyrë kumulative), disa kushte…ii) fitimi i sendit duhet të bëhet në bazë të një veprimi juridik apo akti administrativ apo vullneti shtetëror që ka për qëllim kalimin e pronësisë…" Po ashtu, në disa vendime të Gjykatës së Lartë është konkluduar se: "…*Si veprim juridik për kalimin e pronësisë, ligji nuk ndalon që të jenë* ***edhe një akt administrativ,*** *apo një vendim gjykate (i ndryshuar), me anë të së cilit të jetë shprehur qartë qëllimi i kalimit të pronësisë mbi një send (në rastin tonë mbi një send të paluajtshëm)..."* (shih vendim nr. 463, datë 11.9.2014; vendim nr. 251, datë 13.5.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).

35. Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se paqartësia e vazhdueshme në kohë e praktikës gjyqësore është e papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës dhe me parimin e sigurisë juridike. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim "GJEDNJ") në disa vendime, ndër to edhe në dhomën e madhe, ka vlerësuar se njëtrajtshmëria e zbatimit të ligjit nga jurisprudenca përbën garanci për zbatimin e parimit të sigurisë juridike, që është element thelbësor i shtetit të së drejtës (*shih çështjen "Chapman v United Kingdom" vendim i GJEDNJ-së, datë 18.1.2001*), duke pasur lidhje të drejtpërdrejtë edhe me garancitë e nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim "KEDNJ").

36. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se siguria juridike që duhet të përcjellë rendi juridik lidhur me përdorueshmërinë dhe parashikueshmërinë normative duhet të jenë standard edhe për praktikën gjyqësore nomofilatike (*Shih çështjen "Lupaş and Others v. Romania", ap. nos. 1434/02, 35370/02 dhe 1385/03, paragrafi 67, ECHR 2006-XV).* Ajo ka pranuar se kundërshtitë e jurisprudencës janë të natyrshme dhe të qenësishme në të gjitha sistemet juridike, qoftë në gjykata të të njëjtës shkallë, qoftë në shkallë të ndryshme, apo qoftë edhe në autoritetin suprem më të lartë gjyqësor, duke konkluduar se kjo situatë nuk mund të jetë *apriori* në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së. Megjithatë, GJEDNJ-ja konkludon se ajo që përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në drejtim të ushtrimit të funksionit nomofilatik të autoritetit më të lartë gjyqësor në një vend janë disa rrethana: *së pari*, nëse në jurisprudencën e gjykatave ekzistojnë qëndrime krejt të ndryshme dhe të vazhdueshme mbi të njëjtën çështje juridike; *së dyti*, nëse e drejta e brendshme parashikon mekanizma ligjorë dhe procedural që synojnë efektivisht eliminimin e mungesës së koherencës në jurisprudencë; *së treti*, nëse këto mekanizma janë zbatuar nga autoriteti më i lartë gjyqësor dhe kush ka qenë efekti i prodhuar në praktikën gjyqësore. GJEDNJ-ja ka theksuar se juridiksioni gjyqësor suprem në çdo shtet duhet të tregojë vigjilencë në shquarjen dhe eliminimin e çdo mungese koherence në jurisprudencën e gjykatave (*shih çështjen "Mariyka Popova dhe Asen Popov kundër Bullgarisë", kërkesa nr. 11260/10, seksioni i 5-të i GJEDNJ-së, vendim nr. 11.4.2019, paragrafi 40*).

37. Në vijim të kësaj analize, në çështjet ligjore të shtruar për diskutim, Kolegji:

- në ushtrim të së drejtës dhe detyrimit kushtetues dhe ligjor, që lidhet me funksionin nomofilatik;
- duke pasur parasysh praktikat e ndryshme të gjykatave të niveleve më të ulëta dhe të vetë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që vijnë për shkak se mund të ketë disa interpretime të nenit 168 të KC;
- meqenëse përpara Gjykatës së Lartë gjenden për shqyrtim raste të ngjashme, për të cilat duhet të jepet një zgjidhje e njësuar në interpretimin e ligjit material;
- në zbatim të nenit 35/3, 472/a, 481 dhe 482/a të KPC-së, të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021;

ka konkluduar me vendim të ndërmjetëm se shqyrtimi i kësaj çështjeje duhet të kalojë në seancë gjyqësore, me një trupë gjyqësore prej 5 gjyqtarësh, për arsye se rekursi ngre shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural, të një rëndësie themelore për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

38. Mbi këtë bazë, Kolegji vlerësoi se çështjet që duhet të shtrohen për njësim janë:

1) Me termin "veprim juridik për kalimin e pronësisë", sipas nenit 168 të KC-së do të kuptohen ngushtësisht vetëm veprimet juridike sipas përkufizimit të nenit 79 të KC-së apo do të kuptohet gjerësisht çdo lloj veprimi tjetër i ligjshëm, titull i aftë për të kaluar pronësinë ?

2) Cili është kuptimi i veprimit juridik "...që nuk është i ndaluar nga ligji"? Cilat shkelje të normave juridike përfshihen në këtë kategori? Si vepron neni 168 i KC-së, në raport me veprimet juridike në

shkelje të dispozitave që shkaktojnë pavlefshmëri relative dhe absolute të veprimit juridik?

39. Sa më sipër, Kolegji planifikoi çështjen për shqyrtim më datë 13.6.2022 dhe vijoi me procedurën e posaçme të parashikuar në nenin 481 të KPC-së, të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021. Në këto kushte, u formua trupa gjykuese prej 5 gjyqtarësh, sipas pikës 3 të kësaj dispozite dhe u procedua, mbi vendimin e ndërmjetëm të Kolegjit, me njoftimin individual të palëve, sipas rregullave të përgjithshme të njoftimit, për sa i përket datës dhe orës së seancës gjyqësore, trupës gjykuese, çështjes së shtruar për njësim, duke u lënë palëve afatin minimal prej 15 ditësh, midis njoftimit dhe datës së seancës. Po ashtu, vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ku u pasqyrua çështja e shtruar për njësim, u publikua në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

40. Pas zhvillimit të disa seancave gjyqësore, Kolegji vendosi përfundimisht në lidhje me këtë çështje në seancën e datës 26.10.2022.

III. Vlerësimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

i) Konsiderata të përgjithshme mbi të drejtën e pronës dhe institutin e parashkrimit fitues me titull.

41. E drejta mbi pasurinë në përgjithësi dhe e drejta e pronës në veçanti përbëjnë bazën e sistemit ekonomik në Republikën tonë. Ajo është e drejtë themelore kushtetuese e kujtdo. Rregullimi kushtetues dhe ligjor i detyrohet funksionit të dyfishtë, privat dhe shoqëror, që mbart në vetvete e drejta e pronës. Funksioni privat sjell ndikimin e vet në gëzimin normal të lirive dhe të të drejtave të individit. Kuptimi historik dhe ai sotshëm i garancisë së pronës është kuptimi i një të drejte themelore që lidhet pazgjidhshmërisht me lirinë individuale[47]. Prona ka njëkohësisht edhe karakterin e dallueshëm shoqëror, sepse përdorimi i saj duhet t'i shërbejë mirëqenies publike. Për sa kohë funksioni i pronës është një mjet për ruajtjen e lirisë vetjake, prona gëzon një mbrojtje të veçantë. Nga ana tjetër, ligjvënësi mund të vendosë kufizime ndaj pronës sa më i madh të jetë funksioni social i saj[48]. Në përputhje edhe me konsideratat e mbajtura nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ndër vite, garancia kushtetuese e pronës nuk mund të pranojë kufizime joproporcionale, d.m.th. kufizime që nuk justifikohen me konsiderata sociale.[49]

42. Koncepti i pasurisë, përkufizohet në nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, ku thuhet se: *"1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. 2. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera"*.

43. Më tej, neni 11 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ka parashikuar se: "*Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Prona private dhe publike mbrohen njëlloj me ligj. Kufizimet e lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.*" Nisur nga struktura e Kushtetutës, e veçanta e nenit 11 është se ai nuk është parashikuar në grupin e të drejtave dhe lirive të tjera, por në pjesën ku parashikohen parimet themelore mbi të cilat mbështetet organizimi dhe funksionimi i shtetit. Në këtë mënyrë kushtetutbërësi ka preferuar ta konsiderojë lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe pronën private si parim bazë të sistemit ekonomik të Republikës së Shqipërisë (*shih vendim nr. 24, datë 24.7.2009 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.)* E drejta për pronë private dhe liria e veprimtarisë ekonomike janë të lidhura ngushtësisht me njëra tjetrën, pasi prona është mjet për të ushtruar lirinë e veprimtarisë ekonomike.

44. Në nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është sanksionuar se e drejta e pronës private është e garantuar. Sipas kësaj dispozite kushtetuese, prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në KC. Kjo dispozitë kushtetuese, ka vendosur si garanci se ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës për pronë vetëm për interesa publike dhe vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

45. Në bazë dhe për zbatim të këtyre parashikimeve kushtuese, KC ka parashikuar edhe mjetet ligjore të fitimit të pronës, të mbrojtjes dhe realizimit të saj. Një prej tyre është ai që në doktrinë njihet si parashkrimi fitues, i cili rregullohet në nenet 168 dhe 169 të KC-së. Parashkrimi fitues ndahet në dy lloje, me titull dhe pa titull. Parashkrimi fitues me titull, ndahet sërish në dy lloje, kur bëhet fjalë për anën subjektive të poseduesit, d.m.th. mirëbesimin apo keqbesimin. Kur posedimi i pandërprerë ka qenë në mirëbesim, atëherë afatet e kohëkalimit do të mjaftohen së qeni 10 vjet për sendet e paluajtshme dhe 5 vjet për sendet e luajtshme. Ndërsa, kur posedimi i pandërprerë ka qenë në keqbesim atëherë afatet e kohëkalimit dyfishohen. Ndërkohë parashkrimi fitues pa titull,

[47] Shiko për më tepër vendimin e Gjykatës Kushtetuese Gjermane: BverfGE 58, 225 (300).
[48] Shiko për më tepër vendimin e Gjykatës Kushtetuese Gjermane: BverfGE 52, 1.
[49] Po aty (idem).

i prezantuar rishtazi me KCKodin Civil në fuqi, parashikohet në nenin 169 të tij. Ndryshe nga parashkrimi fitues me titull, kjo mënyrë fitimi pronësie vepron ekskluzivisht mbi sendet e paluajtshme. Nën të njëjtat kushte të posedimit të qetë dhe të pandërprerë dhe nën të njëjtat kërkesa për sjellje me sendin sikur të ishte pronari i vërtetë i tij, parashkrimi fitues pa titull nuk kërkon asnjë titull për të vepruar si mënyrë fitimi pronësie; nuk kërkon anën subjektive të subjektit që përfiton nga ajo; dhe afati i kohëkalimit është gjithmonë 20 vjet.

46. Duke qenë se ky interpretim bëhet në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi, Kolegji do të trajtojë vetëm mjetin ligjor konkret që ka gjeneruar këtë proces gjyqësor, konkretisht padinë e njohjes pronar dhe parashkrimin fitues me titull sipas nenit 168 të KC-së, ku është parashikuar se "*Personi që ka fituar me mirëbesim një send, në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë dhe që nuk është i ndaluar nga ligji, bëhet pronar i këtij sendi, pas një posedimi të pandërprerë prej pesë vjetësh kur sendi është i luajtshëm dhe prej dhjetë vjetësh kur ai është i paluajtshëm. Kur posedimi nuk është me mirëbesim, afatet e posedimit të pandërprerë dyfishohen. Posedimi konsiderohet i pandërprerë edhe kur fituesi i sendit ia ka dhënë posedimin një personi tjetër. Nuk mund të fitohet me parashkrim fitues një send që është pronë publike e patjetërsueshme.*"

47. Parashkrimi fitues me titull, në klasifikimin doktrinar, është përfshirë në kategorinë e mënyrave origjinale të fitimit të pronës, ku kalimi i pronësisë mbi një send bëhet në kundërshtim me vullnetin e pronarit të tij ose kur e drejta dhe/ose sendi krijohen rishtaz, pa kaluar nga një subjekt i së drejtës tek tjetri. Në këtë rast nuk vlen parimi që "*Askush nuk mund t'i kalojë një tjetri më tepër të drejta nga sa vetë ka*", i cili zbatohet vetëm në mënyrat e prejardhura të fitimit të pronësisë.

48. Në vështrim të përcaktimit ligjor të cituar më sipër, që një person të fitojë pronësinë me anë të parashkrimit fitues me titull duhet të konstatohen këto kushte-premisa: **(i)** *ekzistenca e një sendi të aftë për t'u tjetërsuar*; **(ii)** *ekzistenca e një veprimi juridik që të ketë për qëllim kalimin e së drejtës së pronësisë dhe që të mos jetë i ndaluar nga ligji*; **(iii)** *ekzistenca e faktit juridik të posedimit të këtij sendi në mënyrë të pandërprerë*; **(iv)** *ekzistenca e mirëbesimit të poseduesit dhe sjellja e tij me sendin sikur të jetë ai pronari*; **(v)** *kalimi i afatit të parashikuar nga ligji prej 5 ose 10 vjetësh* (*vendimi (307), datë 29.6.2010, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

49. Pra, në përgjithësi kjo mënyrë fitimi pronësie kërkon posedimin e sendit nga jopronari, si të ishte i tillë, dhe vazhdimi i posedimit për një kohë të paraparë nga ligji. Për rrjedhojë nga bashkimi i kohës me posedimin rezulton *vehtësimi i së drejtës*[50], duke u bërë kështu një nga efektet më të rëndësishme të posedimit. Elementet kryesore të parashkrimit fitues janë: posedimi, pra jo thjesht mbajtja, periudha e kohëzgjatjes së posedimit, si dhe mungesa e ushtrimit të tagrave të pronësisë prej pronarit. Synimi kryesor i këtij instituti është konsolidimi i situatës juridike faktike dhe siguria juridike.

50. Posedimi i sendit në kuptimin cilësor, duhet të konsistojë në një sjellje të vazhdueshme, paqësore, të qetë dhe të pandërprerë të poseduesit me sendin, sikur të ishte ai pronari i saj. Në këtë mënyrë nga elementet cilësore të posedimit të listuara më lart në mënyrë telegrafike dhe shteruese dalin dy kategori të mëdha elementesh, kategoria materiale e elementeve cilësore të posedimit (*corpus*) dhe kategoria subjektive e elementeve cilësore të posedimit (*animus*).

51. Elementi material "*corpus*" lidhet me sjelljen dhe pushtetin faktik të ushtruar nga poseduesi mbi sendin. Ky pushtet duhet të përbëjë një sjellje faktike prej pronari, joepisodike, por të qëndrueshme në kohë dhe të pasegmentuar nëpërmjet ndërprerjesh. Po ashtu, posedimi i qetë dhe paqësor do të thotë që sjellja prej pronari e përfituesit të mos jetë e dhunshme dhe e fshehtë. Që posedimi të mos jetë i dhunshëm ka rëndësi vetëm momenti i konstituimit të tij, duke mos pasur relevancë dhuna e ushtruar më vonë. Dhuna në këtë kuptim e bën shoqërisht të pavlerësueshëm posedimin dhe për rrjedhojë juridikisht të pavlefshëm për efektet e institutit të parashkrimit fitues[51], çka do të thotë se nuk mund të ketë shkak ligjor që një posedues i tillë të preferohet përkundrejt pronarit.

52. Elementi subjektiv cilësor i posedimit (*animus rem sibi habendi*), është gjithçka që tregon në mënyrë të padyshimtë qëndrimin psikik të përfituesit përkundrejt pasurisë që ai ushtron pushtetin e pronarit, por që nuk është i tillë. Kjo do të thotë që përfituesit duhet të sillet me sendin si të ishte pronari ekskluziv i tij. Ky qëndrim subjektiv i poseduesit konsiston në bindjen subjektive të tij se ai është pronari, duke ushtruar të gjitha pushtetet faktike mbi sendin, ekskluzive këto pushtete të pronarit. Ky element lidhet me mirëbesimin, d.m.th. bindjen e poseduesit se posedimi i tij nuk lëndon pronësinë e pronarit.

53. Neni 168 i KC-së nuk jep një përkufizim të mirëbesimit, për efekt të zbatimit të kësaj dispozite. Përkufizimi i këtij elementi nuk jepej as në dispozitën analoge të KC-së të vitit 1981. Një përkufizim të tij e gjejmë në nenin 44§ 2 të ligjit "Mbi pronësinë", nga ku rezulton se: "*Fituesi i sendit është në mirëbesim, në rastin e mësipërm kur nuk ka ditur ose nuk ishte i detyruar të dinte, në kohën e fitimit, se personi nga i cili ka fituar sendin nuk ishte pronar, ose që veprimi juridik*

[50] Shiko Baltasar Benusi, "*Sendet, Zotënimi dhe modifikimet e tija*", botim i Ministrisë së Drejtësisë 1931, faqe 105.
[51] Për një interpretim krahasues shiko nenin 2233 të Kodit Civil Francez.

për kalimin e pronësisë nuk ishte i vlefshëm".

54. Duke iu rikthyer parashikimeve ligjore të KC-së në fuqi, Kolegji i referohet dispozitave të tjera që rregullojnë posedimin, të cilat duhen zbatuar dhe interpretuar në mënyrë sistematike me nenin 168 të KC-së. Në nenin 305 të KC-së, thuhet se posedimi mund të jetë i ligjshëm ose i paligjshëm. Kjo dispozitë parashikon rastet se kur posedimi është i ligjshëm dhe me një interpretim të kundërt (*per a contrario*), posedimi është i paligjshëm, kur nuk buron prej vullnetit të pronarit, në bazë të një veprimi juridik apo akti administrativ. Më tej, sipas nenit 306 të KC-së, poseduesi është në mirëbesim kur nuk e ka ditur dhe nga rrethanat nuk kishte se si ta dinte se posedimi i tij është i paligjshëm, pra se buron jo prej vullnetit të pronarit apo në bazë të një veprimi juridik të paligjshëm.

55. Mirëbesimi, si gjendje e brendshme psikike, duhet të ekzistojë vetëm për kohën e realizimit të veprimit juridik për fitimin e pronësisë. Për shkak të ekzistencës së një titulli për kalimin e pronësisë, sipas nenit 168 të KC-së, mirëbesimi prezumohet që nga data e titullit kur ka filluar posedimi deri në provën e kundërt (shih nenet 306/3 dhe 308 të KC-së). Padijenia e poseduesit se sendi nuk i ka kaluar nga pronari nuk duhet të rezultojë nga një fajësi e rëndë e tij. Kjo do të thotë se posedues në mirëbesim është ai person që në kryerjen e veprimit juridik, tregon kujdesin mesatar, të një njeriu mesatar, për të verifikuar nëse e drejta i ka kaluar nga pronari në bazë të një veprimi juridik të ligjshëm.

56. Në rastin e parashkrimit fitues të sendeve me anë të posedimit me mirëbesim, krahas periudhës kohore është e rëndësishme edhe ekzistenca e një veprimi juridik, i cili duhet të ketë një aftësi abstrakte për efektin e kalimit të pronësisë dhe të mos të jetë i ndaluar nga ligji. Meqenëse fitimi i sendit me parashkrim fitues ndodh mbi të dhëna objektive, e drejta e pronësisë fitohet e lirë nga të drejtat e tjetrit mbi sendin, në rast se këto të drejta nuk rrjedhin nga titulli dhe nga mirëbesimi i fituesit.

57. Titulli është shkaku i cili ka aftësinë të transferojë pronësinë, që provon dhe justifikon posedimin si pronar apo edhe mirëbesimin e përfituesit në këtë mënyrë fitimi pronësie. Titulli mund të konsiderohet i aftë për të kaluar pronësinë e sendit vetëm kur objekti që individualizohet në të korrespondon në mënyrë të mjaftueshme me pasurinë, me pasurinë mbi të cilën efektivisht është ushtruar posedimi në sasi dhe cilësinë e kërkuar nga ligji[52].

58. Kështu, duhet të ekzistojë një përputhshmëri e mjaftueshme midis identitetit faktik dhe juridik të sendit të poseduar dhe atij të pretenduar për t'u fituar me parashkrim fitues me titull. Titulli është një element autonom dhe esencial që individualizon sendin dhe kufijtë e veprimit të institutit të parashkrimit fitues sipas nenit 168 të Kodit, në kuptimin që ai duhet të jetë i aftë të përcaktojë pasurinë e transferuar, në mënyrë që të ruhet njëjtësia e identitetit të objektit të kësaj mënyre fitimi pronësie dhe proporcionaliteti midis pritshmërive të ligjshme të personave mbi asetet e tyre dhe mbrojtjes juridike që gëzojnë këto pritshmëri nga rendi juridik.

59. Fituesi i sendit bëhet pronar që nga çasti që parashkrimi është plotësuar[53], çka do të thotë se pavarësisht se sa e vonë është padia e fituesit të ri të pronësisë, vendimi i gjykatës sipas nenit 170 të KC-së[54] ka karakter konstatues e jokonstitutiv, që do të thotë se konfirmon një marrëdhënieje juridike ekzistuese dhe nuk e krijon atë. Data e perfeksionimit të kohëkalimit të parashikuar nga ligji shënon momentin final juridik të ndërrimit të titullaritetit të pronësisë nga ish-pronari tek pronari i ri. Ndaj neni 170 i KC-së, interpretuar sistematikisht me nenin 32/b të KPC-së, për të përmbyllur konstatimin e këtij fakti juridik, ka lënë në disponibilitetin e pronarit të bërë rishtazi, një padi njohje e cila i kundrejtohet ish-pronarit, për ta detyruar këtë të fundit të njohë të drejtën e pronësisë dhe për të mundësuar sakaq regjistrimin e pasurisë në regjistrat publik.

60. Instituti i parashkrimit fitues është edhe një politikë diskrecionare e pushtetit ligjvënës të çdo shteti, kryesisht në disiplinimin dhe ekonomizimin e tokës apo pasurive të paluajtshme në përgjithësi, që përbëjnë një burim të kufizuar natyror dhe si të tillë të shterueshëm. Nëse nuk do të ekzistonte kjo mënyrë fitimi pronësie do të justifikohej pasiviteti i papërligjur i pronarëve ndër dhjetëvjeçarë. Në përpjesëtim me kohën e kaluar prona do të bëhej e patregueshme dhe njëkohësisht "sterile" si në qarkullimin civil dhe në destinacionin e saj natyror dhe ekonomik. Në doktrinën dhe jurisprudencën civile evropiane parashkrimi

---

[52] Një qëndrim i tillë është mbajtur nga Gjykata e Kasacionit të Italisë në vendimin datë 26.1.2000, nr. 866.

[53] (*Shiko vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, nr. 11111-00639-00-2006 i Regj. Themeltar, nr. 00-2008-544 i vendimit (214), datë 18.3.2008*)

[54] Kjo dispozitë nën titullin "*Regjistrimi i sendit të fituar me parashkrim*" parashikon se: "*Personi që ka fituar me parashkrim një send të paluajtshëm ka të drejtë të paraqesë padi kundër personit të mëparshëm ose trashëgimtarëve të tij për njohjen e pronësisë së vet dhe, në bazë të vendimit gjyqësor përkatës, të kërkojë që të kryhet regjistrimi i sendit nga organi kompetent shtetëror.*"

fitues legjitimohet edhe për faktin se poseduesi dhjetëvjeçar apo më shumë se kaq, ka poseduar dhe investuar në atë pronë rregullisht.

61. Sipas jurisprudencës së vazhdueshme të GJENDJ-së, me pasuri në kuptim të KEDNJ-së do të konsiderohen, jo vetëm pasuritë ekzistuese dhe asetet, por edhe pritshmëritë e ligjshme, të cilat duhet të jenë të një natyre më konkrete se vetëm shpresë, dhe të jetë e bazuar në një dispozitë ligjore apo akt ligjor[55]. Në kërkesat lidhur me pretendimet që s'kanë të bëjnë me "prona" ekzistuese, duhet që personat në fjalë të kenë plotësuar kushtet ligjore të përkufizuara në ligjin kombëtar për akordimin e çfarëdo forme të caktuar të përfitimeve.

62. GJENDJ-ja ka theksuar se koncepti i pronës sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së ka një kuptim autonom, që nuk kufizohet vetëm në pronësinë e të mirave materiale dhe është i pavarur nga klasifikimi formal i ligjeve të brendshme. Në çdo rast duhet të ekzaminohet, nëse në tërësinë e rrethanave të rastit konkret, kemi të bëjmë me një interes sustancial të mbrojtur nga ky parashikim i Konventës (shih: *mutatis mutandis*, *Zëierzyński v. Poland*, no. 34049/96, § 63, ECHR 2001-VI). Në të njëjtën mënyrë, ashtu sikurse të mirat materiale, edhe të drejtat pasurore apo interesat e ligjshme, mund të përbëjnë asete që kategorizohen si të drejta pronësie për qëllime të nenit 1 të protokollit nr. 1 (see *Iatridis v. Greece* [GC], no. 31107/96, § 54, ECHR 1999-II, and *Beyeler v. Italy* [GC], no. 33202/96, § 100, ECHR 2000-I). Koncepti i pronësisë nuk kufizohet vetëm te pronat e ekzistuese, por mund të përfshijë edhe pretendime, në bazë të të cilave, mund të diskutohet të paktën një pritshmëri e ligjshme e arsyeshme për të fituar një të drejtë pronësie. Në këtë kuptim, pamundësia e poseduesit, i cili e ka poseduar dhe zhvilluar pronën për një kohë të gjatë, për ta mbrojtur këtë pasuri ndaj pronarit të vjetër, pasiv në ushtrimin e së drejtës së tij të pronësisë, mund të shkaktojë një shpronësim faktik të tij nga e drejta e pronës.[56]

63. Doktrina dhe jurisprudenca europiane e vlerëson të nevojshme ekzistencën e mundësisë ligjore për të shndërruar një situatë fakti të zgjatur dhe permanente në kohë në një situatë ligji dhe për rrjedhojë edhe si mënyrë fitimi pronësie. Kjo e fundit nënkupton marrëdhënien midis dy subjekteve, pronarit të mëparshëm, i cili gjatë kohëzgjatjes së parashikuar nga ligji është pasiv në ushtrimin e së drejtës së tij të pronësisë dhe poseduesit faktik që e ka mbajtur dhe zhvilluar pronën si të ishte pronari i saj gjatë kësaj kohe. Pra, fitimi i pronësisë nga poseduesi, përbën nga ana tjetër humbjen e së drejtës së pronarit të vjetër.

64. GJEDNJ-ja ka theksuar se parashkrimi fitues që titullon një subjekt tjetër pronar, duke shuar të drejtën e pronarit të mëparshëm, i shërben dy interesave publikë të rëndësishëm:

1) parandalimin e pasigurisë juridike dhe padrejtësisë në trajtimin e kërkesave të vonuara;

2) garantimin që posedimi faktik dhe e drejta e pronësisë, *de iure* të përputhen. Kjo përmbush edhe funksionin publik të pronës në mënyrën se si ajo përdoret, në kuadër të një politike të përgjithshme ekonomike dhe sociale. GJEDNJ-ja ka theksuar se ndërhyrja e shteteve anëtare, nëpërmjet parashikimit me ligj të parashkrimit fitues, hyn në sferën e kufizimeve të së drejtës së pronësisë të pronarit të mëparshëm, por sipas paragrafit të dytë të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, që lidhet më të drejtën e shteteve për të miratuar ligje për të garantuar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Në këtë kuptim, GJEDNJ-ja ka theksuar se mungesa e kompensimit të drejtë pronarit të mëparshëm, nuk është joproporcionale dhe garantohet ekuilibri i drejtë, pasi humbja e së drejtës së pronarit të mëparshëm, nuk përbën një shpronësim, por një ndërhyrje të shtetit për të garantuar përdorimin e drejtë të pronës në përputhje me interesin publik[57].

iii) Mbi kuptimin e "*veprimit juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë*"

65. Në çështjen konkrete të shtruar për njësim nga Kolegji është vënë në diskutim nëse me konceptin *"veprim juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë" sipas nenit 168 të KC-së, do të kuptohen vetëm veprimet juridike sipas nenit 79 të KC-së apo edhe çdo lloj titulli tjetër i aftë për të kaluar pronësinë.*

66. Fillimisht, Kolegji sjell në vëmendje, nenin 163 të KC-së, i cili ka parashikuar se "*Pronësia fitohet*

[55] (Kopecký kundër Sllovakisë [GC], §§ 49-50; Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë [GC], § 173; Saghinadze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë, § 103; Ceni kundër Italisë, § 39; Béláné Nagy kundër Hungarisë [GC], § 75).

[56] Shiko vendimin e High Court U.K., viti 2002, UKHL 30, [2002] 3 All ER 865 dhe Relacionin Konsultativ të Komisionit të Ligjeve të Parlamentit Anglez që shoqëron ligjin për Regjistrimin e Pronës të vitit 1998 (prepared with the Land Registry; Law Com. No. 254).

[57] Shih cështjen "*j.a. pye (oxford) ltd and j.a. pye (oxford) land ltd V. the United Kingdom", kërkesa nr. 4430202, vendim i Dhomës së Madhe të GJENDJ-së, datë 30.8.2007.*

nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë." Mënyrat e fitimit të pronësisë mund të përkufizohen teorikisht si tërësia e fakteve juridike, me vërtetimin e të cilave, ligji parashikon si pasojë lindjen e së drejtës së pronësisë. Doktrina i klasifikon faktet juridike në ngjarje natyrore dhe veprime të njerëzve. Nga ana e tyre, veprimet e njerëzve ndahen në veprime të ligjshme dhe veprime të paligjshme. Veprimet e ligjshme, më tej, klasifikohen në veprime juridike dhe veprime të tjera të ligjshme.

67. Kuptimi i përgjithshëm i veprimit juridik, si një nënkategori e veprimeve të ligjshme, jepet në nenin 79 të KC-së, i cili ka parashikuar se: "*Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile.".* Veprimi juridik sipas kësaj dispozite nënkupton shprehjen e vullnetit të një ose më shumë subjekteve të së drejtës private, të cilit/ve i jepet pushteti të disponojë/në mbi të drejtat e tij/tyre ose të marrë/in përsipër detyrime karshi një subjekti tjetër privat. Veprimet juridike që kanë për qëllim kalimin e së drejtës së pronësisë rregullohen në dispozita të tjera të KC-së. Ato mund të jenë të njëanshme (rasti tipik është testamenti) ose të dyanshme, sikurse mund të jetë kontrata. Kontrata të tilla mund të përmendim: kontratën e shitjes, kontratën e dhurimit, kontratën e shkëmbimit etj.

68. Ndërkohë me ligje të veçanta, ligjvënësi mund të parashikojë si mënyra të fitimit të pronësisë edhe fakte të tjera juridike, të përfshira në kategorinë e veprimeve të tjera të ligjshme. Të tilla mund të jenë aktet administrative, si shfaqje e ligjshme e vullnetit të shtetit, nëpërmjet të cilave kalon e drejta e pronësisë nga një subjekt i së drejtës publike tek një subjekt privat. Në këtë mënyrë shteti vetë shpronësohet në favor të individit. Vetë shpronësimi i shtetit si koncept, erdhi pas miratimit të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "*Për dispozitat kryesore kushtetuese*", kur në Republikën e Shqipërisë u sanksionua prona private, nisma e lirë dhe veprimtaritë private të pavarura, si dhe gjithë procesi i kalimit të ekonomisë së Republikës së Shqipërisë nga një ekonomi e planifikuar dhe e kontrolluar nga shteti, në një ekonomi të tregut të lirë.

69. Kuptimin e përgjithshëm të aktit administrativ, e më tej, të atij që ka për qëllim tjetërsimin e pronës shtetërore nga shteti tek individi, nuk e gjejmë në KC, por në ligjin nr. 49/2012 "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", të ndryshuar, (në vijim ligji nr. 49/2012) dhe në ligje të veçanta që kanë si objekt të rregullimit të tyre kalimin e pronësisë mbi pasuri të caktuara, nga shteti tek subjektet privatë ose ku shteti luan rolin e rregullatorit kur vihen në konflikt interesat dhe të drejtat e disa subjekteve njëkohësisht.

70. Në nenin 2 të ligjit nr. 49/2012 parashikohet se": "*…Akt administrativ individual është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete."* Nisur nga ky përkufizim, akti administrativ që ka për qëllim kalimin e pronësisë, do të konsiderohet shprehja e vullnetit të ligjshëm të organit publik, ndaj një subjekti të përcaktuar të së drejtës, që krijon apo lind të drejtën e pronësisë.

71. Në kuptimin e përgjithshëm, për nga pasojat juridike që sjellin, si aktet administrative ashtu edhe veprimet juridike, përfshihen në gamën e gjerë të titujve të pronësisë, por në kuptimin e ngushtë përfaqësojnë kategori të veçanta. Aktet administrative që kalojnë pronësinë nga shteti tek individi, dallojnë nga veprimet juridike që kanë për qëllim kalimin e pronësisë, pasi ndryshe nga subjektet e së drejtës private, shteti, në disponimin e pronës shtetërore, nuk gëzon autonomi të plotë vullneti. Veprimtaria e tij është e kufizuar nga norma të së drejtës publike që përcaktojnë kushtet dhe kriteret se si apo kujt subjekti privat do t'i kalojë pronësia mbi një send të luajtshëm apo të paluajtshëm. Kjo pasi shteti si entitet publik vepron në emër dhe për llogari të interesit publik dhe prona shtetërore duhet të administrohet në përputhje me këtë interes.

72. Këtu Kolegji sjell si shembull, aktet e marrjes së tokës në pronësi, të cilat janë akte administrative të një natyre individuale, nëpërmjet të cilave ka kaluar pronësia e tokës bujqësore nga shteti tek subjektet privatë. Me nxjerrjen e këtyre akteve konkretizohet veprimtaria e organit të përcaktuar nga ligji për kryerjen e procesit të ndarjes së tokës bujqësore, sipas kritereve të përcaktuara në ligj. Këto akte nxirren nga organe të krijuara me anë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", i ndryshuar, dhe rregullimeve ligjore të mëvonshme, në zbatim të kompetencave të dhëna nga ligji dhe sipas një procedure të caktuar, të mbështetur në KPA. Ligjvënësi u ka dhënë të drejtë organeve të krijuara me ligj të posaçëm që me anë të këtyre akteve të disponohet mbi të drejtën e pronësisë së tokës bujqësore nga pronë shtetërore në pronë private (*shih vendimin unifikues nr. 2, datë 10.3.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, paragrafi 20*).

73. Nga përmbajtja e nenit 168 të KC-së, qartazi vërehet se kjo dispozitë, si titull mbi të cilin mund të pretendohet fitimi i pronësisë, përmend vetëm veprimet juridike, duke përjashtuar sakaq të gjithë titujt e tjerë të pronësisë, si pjesë e kategorisë së fakteve juridike, si bazë për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues me titull.

74. Për të kuptuar këtë zgjedhje të legjislatorit, në lidhje me aktet që janë të afta të konstituojnë mënyrën

origjinale të fitimit të pronësisë të parashkrimit fitues me titull, Kolegji çmon të bëjë një vështrim të nenit 168 të KC-së të Republikës së Shqipërisë, së pari historik, me legjislacionin civil të mëparshëm që ka vepruar në vendin tonë dhe, së dyti krahasues, me legjislacionet e vendeve të Evropës Perëndimore, nën modelin e të cilëve është frymëzuar edhe legjislacioni ynë.

75. Dispozitat e KC-së të vitit 1929 (Kodi Civil i Mbretnisë Shqiptare), i cili është frymëzuar kryesisht nga Kodi Civil Francez, këtë mënyrë fitimi pronësie e quante *parashkrimi vehtësimtar*. Në nenin 2037 të tij KC përcaktonte se "*Ay që me mirëbesim vehtëson një send të paluejtëshëm ose një të drejtë reale mbi një t'atillë send, me fuqinë e një titulli qi asht transkiptue rregullisht dhe qi nuk asht nul për të meta forme, plotëson në favorin e vet parashkrimin, me kalimin e dhjetë vjetëve çprej datës së transkiptimit*". Kështu, ky KC parashikonte titullin e çfarëdoshëm, mjaftonte që ai të ishte i aftë të kalonte pronësinë e sendit dhe nuk kufizohej vetëm te veprimi juridik.

76. Më pas dekreti nr. 2083, datë 6.7.1955 "*Mbi pronësinë*", në nenin 44 të tij përcaktonte se "*Personi që, në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë, veprim i cili nuk është i ndaluar nga ligja, ka fituar me mirëbesim një send dhe e ka mbajtur në posedimin e tij ose ia ka dhënë posedimin një tjetri, bëhet pronar i këtij sendi, në qoftë se posedimi ka vazhduar pa ndërprerje, tre vjet për sendet e luajtshme dhe gjashtë vjet për sendet e paluajtshme. Fitimi i sendit është me mirëbesim, në rastin e sipërm kur nuk ka ditur ose nuk ishte i detyruar të dinte, në kohën e fitimit, se personi nga i cili ka fituar sendin nuk ishte pronar ose që veprimi juridik për kalimin e pronësisë nuk ishte i vlefshëm*". Ky dekret ka pasur të njëjtin qëndrim për sa i përket konceptimit të titullit si KC në fuqi, d.m.th. që kufizohet ekskluzivisht vetëm te veprimi juridik për kalimin e pronësisë.

77. Më tej, në nenin 91 të KC-së të vitit 1981 është përcaktuar se "*Personi që, në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë, veprim që nuk është ndaluar nga ligji, ka fituar me mirëbesim një send dhe e ka mbajtur në nëdorësinë e vet këtë send ose ia ka dhënë në nëdorësi një personi tjetër, bëhet pronar i këtij sendi, në qoftë se nëdorësia ka vazhduar pa ndërprerje për më tepër se tre vjet*". Kështu, edhe ky kod civil e konceptonte titullin ekskluzivisht një veprim juridik, e jo një lloj tjetër fakti juridik që passjell kalimin e pronësisë.

78. Ndërkohë, Kodi Civil Italian, kod i cili ka pasur një ndikim të fuqishëm në hartimin e shumë dispozitave të Kodit tonë Civil aktual, në nenin 1159 (*parashkrimi fitues 10-vjeçar me titull*); neni 1159-bis (*parashkrimi fitues me titull i pronës së vogël rurale*); neni 1160 (*parashkrimi fitues i universalitetit të sendeve të luajtshme*) dhe neni 1162 (*parashkrimi fitues i sendeve të luajtshëm e të regjistrueshëm*) e përkufizon titullin për efekt të institutit duke nënkuptuar çdo fakt juridik që potencialisht është i aftë të kalojë pronësinë e sendit. Pra, Kodi Civil Italian nuk e lidh titullin vetëm me kategorinë e veprimeve juridike, por quan të tillë, për efekt të dispozitës, çdo fakt juridik që është i aftë të kalojë pronësinë mbi sendin.

79. Kodi Civil Francez, i cili ka pasur një ndikim të madh në hartimin e Kodit Civil Italian, në nenin 2265 (*parashkrimi fitues i sendeve të paluajtshme me afat 10- dhe 20-vjeçar*) për qëllimet e parashkrimit fitues me titull, shquan çdo titull që është i aftë të kalojë pronësinë e sendit. Në këtë mënyrë, edhe ky kod civil i jep kuptim të gjerë nocionit titull, duke mos u kufizuar vetëm te veprimi juridik.

80. Kodi Civil Gjerman, në nenin 937 të tij (*fitimi i pronësisë me parashkrim fitues 10-vjeçar mbi sendet e luajtshme*) nuk merr parasysh fare konceptin e titullit, por vendos si kryefjalë të elementeve që duhet të përmbushen për të pasur si titull pronësie parashkrimin fitues, mirëbesimin në posedim të përfituesit.

81. Nga kjo analizë rezulton se neni 168 i KC-së të Republikës së Shqipërisë është një përqasje *mutatis mutandis* i dy ligjeve civile të sipërcituara që kanë vepruar në vendin tonë në periudhën e diktaturës komuniste, përkatësisht i nenit 44 të dekretit nr. 2083, datë 6.7.1955 "*Mbi pronësinë*" dhe nenit 91 të KC-së të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (Kodi Civil i vitit 1981). Duhet theksuar se parashikimi i nenit 168 të KC-së, i trashëguar nga legjislacioni komunist, ku nuk përfshiheshin si tituj pronësie aktet administrative, përligjej në rendin e atëkohshëm juridik dhe ishte i pajtueshëm me Kushtetutën në fuqi në atë periudhe, ku nuk njihej koncepti i vetë shpronësimit të shtetit në favor të individit. Sipas dekretit nr. 4823, datë 2.3.1971 "Për mbrojtjen e tokës", si dhe ligjit nr. 5856, datë 21.2.1978 "Mbi mbrojtjen e tokës", tjetërsimi i tokës dhe i trojeve ishte i ndaluar, lejohej vetëm tjetërsimi i banesave pronë vetjake. Edhe Kushtetuta e vitit 1976 parashikonte shprehimisht se pronësia e tokës ishte e shtetit (nenet 18 dhe 19). Në kuptim të legjislacionit të mësipërm, nga viti 1971 deri në vitin 1991, toka dhe trojet kanë qenë jashtë qarkullimit civil, ato nuk lejohej që të tjetërsoheshin apo të ishin pronë vetjake. Pra, çdo veprim juridik disponimi mbi tokën ishte i ndaluar nga ligji dhe, njëkohësisht, askush nuk mund të sillej si pronar me tokën.

82. Ndërkohë ky parashikim, nuk i përgjigjet zhvillimeve të reja ekonomike që pasuan vitet '90 në Republikën e Shqipërisë.

83. Në fillim të proceseve demokratike, një ndër veprimet e para që u kryen ishte shfuqizimi i bazës kushtetuese mbi të cilën funksiononte regjimi i mëparshëm. Me ligjin nr. 7491, datë 29.4.1991, u miratuan

dispozitat kryesore kushtetuese, ligj i cili u plotësua me ndryshimet e mëvonshme. Në nenin 45 të tij shfuqizohej Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Si rrjedhojë iu hap rruga jo vetëm një forme të re të sistemit ekonomik por edhe zhbërjes së të gjithë procesit të shtetëzimit ose kolektivizimit të pronës private që kish ndodhur gjatë regjimit të mëparshëm.

84. Me qëllim që të vendosej një rend i ri ekonomik, nga një sistem me ekonomi të centralizuar e të kontrolluar nga shteti, në një sistem ekonomik të bazuar në parimet e tregut të lirë, parashikuar në nenet 10, 11, 12 dhe 16, të ligjit nr. 7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", në Republikën e Shqipërisë u sanksionua dhe u mbrojt prona private, nisma e lirë dhe veprimtaritë private të pavarura, si dhe u zhvillua gjithë procesi i kalimit të ekonomisë së Republikës së Shqipërisë nga një ekonomi e planifikuar dhe e kontrolluar nga shteti, në një ekonomi të tregut të lirë. Pra, pas vitit 1991 u lejua edhe pronësia e subjekteve privatë mbi tokën dhe truallin, pronë shtetërore jopublike.

85. Në muajt e parë, pas miratimit të ligjit të ri kushtetues, filloi procesi i dekolektivizimit të tokës bujqësore dhe shpërbërjes së kooperativave e ndërmarrjeve bujqësore. Me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", i ndryshuar, u parashikua që toka bujqësore e ish-kooperativave bujqësore u kalonte në pronësi anëtarëve të deriatëhershëm të saj, në baza të sasisë së tokës dhe numrit të frymëve për çdo familje bujqësore. Më pas, me ligjin nr. 7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", u zhbë një padrejtësi e madhe e së shkuarës, duke iu njohur e drejta e pronësisë atyre individëve që u ishte shpronësuar, shtetëzuar apo konfiskuar prona pa të drejtë gjatë regjimit komunist, me akte ligjore, nënligjore apo vendime gjykatash dhe u kthehej aty ku ishte e mundur ose u njihej e drejta e kompensimit ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre. Me këto dy akte, por edhe me ligje të tjera të miratuara më vonë (*si p.sh. ligji nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje"*) shteti bënte shpronësimin e vetvetes, duke ia kaluar të drejtën e pronësisë individëve. Të gjitha këto mënyra kalimi pronësie përbëjnë titull për subjektin i cili fiton ose rifiton tagrat e pronarit mbi një send të paluajtshëm, pasi ato janë fakte juridike të kategorisë së veprimeve të ligjshme të njerëzve, të cilat sjellin lindjen e marrëdhënies juridike të pronësisë. Pra ato janë akte që titullojnë një subjekt të së drejtës pronar mbi një send.

86. Me ardhjen e demokracisë dhe orientimin e politikave drejt një ekonomie të lirë tregu, ndryshoi edhe konceptimi i raporteve shtet–individ, ku tashmë interesi publik, i mbrojtur dhe përfaqësuar nga shteti, nuk predominonte më mbi interesin privat dhe ky i fundit nuk ishte më i sakrifikueshëm për të parin nën një filozofi utilitariste. Kjo shprehet mjaft qartë në nenin 11 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e cila sanksionon parimin se prona publike dhe prona private mbrohen njëlloj me ligj. Si rrjedhojë e kësaj dhe në të njëjtën kohë me zgjerimin e formave në të cilat merr jetë qarkullimi civil ndryshon edhe konceptimi i instituteve juridiko-civile.

87. Sikurse mund të konkludohet, edhe pse reminishencë e kodeve të mëparshme, neni 168 i KC-së, përmban një ometim të qartë legjislativ, për shkak se legjislatori nuk ka parashikuar të gjithë rrethin e fakteve juridike të cilët mund të qëndrojnë në themel të parashkrimit fitues me titull. Kjo dispozitë ka përjashtuar *apriori* të gjitha format e tjera të kalimit të pronësisë me ligj të veçantë. Mëtimi është i tillë që nuk mund të shërohet me interpretim të zgjeruar nga ana e gjyqtarit të juridiksionit të zakonshëm, në të kundërt ai do të bënte një normë të re juridike, duke e zgjeruar tej parashikimit të ligjit kategorinë e titujve të pronësisë, të cilat ky i fundit shprehimisht i ka përjashtuar. Kjo do të vinte në kundërshtim me nenin 145/1 të Kushtetutës sipas të cilit gjykata ka detyrimin të japë drejtësi dhe të zgjidhë në përputhje me ligjin çështjet e shtruara para tij.

88. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje faktin se pajtueshmëria e nenit 168 të KC-së, me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për pjesën që ka përjashtuar nga fusha e zbatimit titujt e tjerë, të ndryshëm nga veprimet juridike sipas nenit 79 të KC-së, i është nënshtruar edhe kontrollit kushtetues nga Gjykata Kushtetuese. Kjo e fundit, në një rast konkret është vënë në lëvizje më mjetin e kontrollit incidental, sipas nenit 145 të Kushtetutës, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier. Në atë rast, pala ndërgjyqëse pretendonte se e kishte fituar pronën me një akt të marrjes së tokës në pronësi, i cili ishte i pavlefshëm dhe për këtë shkak pretendonte si mënyrë fitimi pronësie nenin 168 të KC-së. Nga gjykata referuese (gjyqtari *a quo*), janë sjellë si argumente për antikushtetutshmërinë e kësaj norme, shkelja e nenit 18 i Kushtetutës, neneve 11, 17 dhe 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Argumenti thelbësor i gjykatës parashtruese ka qenë se përjashtimi i titujve të tjerë të pronësisë, të ndryshëm nga veprimet juridike, cenon në mënyrë të pajustifikuar barazinë para ligjit për subjektet e së drejtës që ndodhen nën të njëjta kushte posedimi të pandërprerë me mirëbesim, por me tituj të ndryshëm pronësie. Po ashtu, gjykata parashtruese ka argumentuar se përjashtimi i titujve të tjerë të pronësisë kufizon në mënyrë joproporcionalë lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe të drejtën për prone private. Me vendimin nr. 19, datë 13.5.2016, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë ka vendosur mos kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me argumentin thelbësor se, gjykata referuese nuk ka parashtruar argumente serioze mbi antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar.

89. Në vijim të kësaj analize, Kolegji arrin në konkluzionin se neni 168 i KC-së, i cili i është nënshtruar kontrollit

kushtetues nga Gjykata Kushtetuese, si autoriteti ekskluziv kompetent për të verifikuar pajtueshmërinë e ligjit me rendin kushtetues, në mënyrë të qartë, si tituj pronësie, ka parashikuar vetëm veprimet juridike që kanë për qëllim kalimin e pronësisë, sipas nenit 79 të KC-së dhe sipas dispozitave të tjera të po këtij Kodi, që rregullojnë dhe titullojnë në mënyrë të posaçme se cilat janë veprimet juridike të kësaj natyre, kontratat apo veprimet juridike të njëanshme. Kolegji vlerëson se nga formulimi i dispozitës dhe nga interpretimi sistematik i KC-së, nuk ekzistojnë mënyra të tjera interpretimi. Kolegji vlerëson se për arsyet e parashtruara më sipër, është e nevojshme një ndërhyrje legjislative nga ana e ligjvënësit, për riformulimin e nenit 168 të KC-së, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe regjimit aktual ekonomik dhe pronësor të Republikës së Shqipërisë, por deri në atë moment eventual, ligji do të duhet të interpretohet dhe zbatohet sipas konkluzioneve të Kolegjit në këtë vendim njësues, nga gjykatat më të ulëta, në raste të ngjashme.

iii) Mbi kuptimin e veprimit juridik "që nuk është i ndaluar nga ligji"

90. Fillimisht, Kolegji çmon të theksojë se koncepti i "*veprimit juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë*" sipas nenit 168 të KC-së, përbën thjesht një konvencion ligjor. Legjislatori titullin e pronësisë e ka krijuar me qëllimin që të krijojë te përfituesi i kësaj mënyre fitimi pronësie pritshmëritë e ligjshme të pronarit të sendit, si dhe mirëbesimin e tij, i cili për këtë shkak, gjatë gjithë kohës së posedimit sillet si pronar. Kjo është arsyeja që ligji kufizon në kohë të drejtën e pronarit mbi sendin e tij në këtë eventualitet, me një afat të shkurtër 10-vjeçar, në raport me fitimin e pronës sipas nenit 169 të KC-së. Në këtë mënyrë, duhet kuptuar se fitimi i pronësisë, sipas nenit 168 të KC-së, nuk rrjedh për shkak të veprimit juridik në vetvete, por për shkak të vërtetimit të njëkohshëm të atyre fakteve juridike të parashikuara në këtë dispozitë, ku posedimi i gjatë dhe mirëbesimi përbëjnë bazën e lindjes së të drejtës së pronësisë. Megjithatë, legjislatori, ka vendosur një kufizim, se pronësia nuk mund të fitohet, nëse ka për bazë një veprim juridik të ndaluar nga ligji. Kjo sipas parimit të përgjithshëm se nga veprime të paligjshme nuk mund të rrjedhin pasoja të ligjshme dhe nuk mund të flitet për mirëbesim të poseduesit.

91. Kodi Civil nuk jep një përkufizim të "*veprimit juridik të ndaluar nga ligji*" dhe në pamje të parë, ky koncept është shumë i përgjithshëm. Në dhënien e një kuptimi të drejtë të këtij koncepti, duhet pasur kujdes pasi nga një interpretim i zgjeruar, mund të kufizohet në mënyrë joproporcionale e drejta e poseduesit në mirëbesim për të fituar pronën dhe për lirinë e veprimtarisë ekonomike, aq sa neni 168 i KC-së të mbetet i pazbatueshëm ose të gjejë zbatim në raste shumë të kufizuara. Kolegji vlerëson se në leximin dhe zbatimin e dispozitave të ligjit që kufizojnë të drejtat themelore të njeriut, pushteti gjyqësor duhet të qaset gjithmonë drejt interpretimit pajtues me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe të KEDNJ-së. Në çdo rast nga gjykatat duhet të mbahet në vëmendje se kufizimet ligjore të të drejtave dhe lirive kushtetuese, duhet të kalojnë testin kushtetues të parashikuar në nenin 17 të Kushtetutës, të cilat mund të vendosen: 1) vetëm me ligj; 2) për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve: 3) kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë; 4) këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

92. Në realizimin e veprimeve juridike, subjektet e së drejtës civile, udhëhiqen si rregull nga parimi i autonomisë së vullnetit, si shprehje e lirisë së përgjithshme të veprimtarisë ekonomike. Megjithatë, kjo shfaqje e vullnetit, që të sjellë pasojat e dëshiruara, duhet të realizohet në përputhje me ligjin, i cili në disa raste, mund të vendosë kufizime, për sa i përket formës së kryerjes së veprimit juridik; përmbajtjes së tij; cilësive që duhet të plotësojë subjekti i veprimit juridik për të hyrë në një marrëdhënie juridike civile etj. Sigurisht që kufizimet e parimit të autonomisë së vullnetit duhet të justifikohen nga një qëllim legjitim dhe të jenë proporcionale me qëllimin që synohet të arrihet.

iii/a) Natyra dhe rëndësia e shkeljeve të legjislacionit civil

93. Duhet thënë se jo çdo shkelje e dispozitave të KC-së apo të ligjeve të tjera që zbatohen në mënyrë komplementare në marrëdhëniet juridike midis privatëve dhe në veprimet juridike të realizuara midis tyre, mbart të njëjtën rëndësi juridike. Si rrjedhojë, edhe sanksioni ligjor civil i paraparë nga ligji është dhe duhet të jetë proporcional dhe në përpjesëtim me shkeljen apo situatën që e ka diktuar.

94. Si sanksion civil, për palët që në kryerjen e veprimeve juridike nuk ndjekin ato rekuizita ligjore të detyrueshme për prodhimin e pasojave juridike, ligjvënësi ka parashikuar institutin e pavlefshmërisë së veprimit juridik dhe rikthimin në gjendjen juridike të mëparshme. Në analizë të nenit 79 të KC-së, veprimi juridik që të jetë i vlefshëm duhet që të plotësojë këto kushte: 1) palët që kryejnë veprimin juridik duhet të kenë zotësinë për të vepruar; 2) vullneti i brendshëm i palëve në një veprim juridik duhet të përputhet me shfaqjen e tij të jashtme, i cili duhet të jetë e lirë dhe i pavesuar; 3) në përmbajtje, veprimi juridik të mos vijë ndesh me dispozita që kanë natyrë urdhëruese dhe që kufizojnë lirinë e vullnetit të palëve; 4) veprimi juridik duhet të realizohet në formën e kërkuar nga ligji. Fryma e legjislacionit tonë në fuqi është se vetëm në rast të mungesës së njërit prej këtyre

elementeve do të ndodhemi përpara rastit të pavlefshmërisë së veprimit juridik (*shih vendim unifikues nr. 1/2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

95. Në varësi të rëndësisë së shkeljes ligjore dhe përmbajtjes së dispozitës së cenuar, KC, ka parashikuar dy lloje të pavlefshmërisë së veprimeve juridike, relative dhe absolute. Me qëllim zgjidhjen e çështjes së shtruar për njësim dhe për të qartësuar konceptin e veprimeve juridike që janë të ndaluara nga ligji, fillimisht, Kolegji çmon të marrë në analizë, kuptimin, shkaqet dhe dallimin midis dy llojeve të pavlefshmërisë së veprimit juridik.

96. Neni 92 i KC-së, rregullon institutin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik, ku është parashikuar se *"Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit; b) kryhen për të mashtruar ligjin; c) kryhen nga të mitur nën moshën katërmbëdhjetë vjeç; ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluara)."*

97. Në vështrim të tërësisë së dispozitave që rregullojnë institutin e pavlefshmërisë, veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm mund të përcaktohet si veprim juridik i cili, për shkak të shkeljes së ligjit ose për shkak tjetër të parashikuar në ligj, nuk ka fuqi juridike ose është i paaftë të sjellë pasojat juridike të synuara nga palët. Ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm. Veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm, nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët. Pavlefshmëria absolute mund të pretendohet nga kushdo që ka interes, ajo mund t'i kundrejtohet si palës tjetër të veprimit juridik, ashtu edhe çdo personi të tretë. Pavlefshmëria absolute mund të merret parasysh nga gjykata edhe kryesisht, pa u kërkuar nga pala e interesuar, ose kundër dëshirës së saj. Ai nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (*quod ab initio vitiosum est tractu temporis convalescere non potest*). Këto karakteristika sjellin si rrjedhojë edhe paparashkrueshmërinë e së drejtës për goditjen e një veprimi juridik absolutisht të pavlefshëm (*shih vendim unifikues nr. 5/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

98. Nga ana tjetër, instituti i pavlefshmërisë relative të veprimit juridik është parashikuar në nenin 94 të KC-së, ku thuhet se: *"Të anulueshme quhen veprimet juridike të cilat janë të vlefshme gjersa gjykata me kërkesën e të interesuarit i shpall të pavlefshme. Të tilla janë veprimet juridike të kryera nga: a) të miturit mbi katërmbëdhjetë vjeç, kur veprimin juridik e kanë kryer pa pëlqimin e prindit ose të kujdestarit; b) personat, të cilët për shkak sëmundje psikike ose zhvillimi të metë mendor u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, kur veprimin juridik e kanë kryer pa pëlqimin e kujdestarit; c) personat, të cilët në kohën e kryerjes së veprimit juridik nuk ishin të ndërgjegjshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre, megjithëse në atë kohë nuk u ishte hequr zotësia për të vepruar; ç) personi që ka kryer veprimin juridik duke qenë i mashtruar, i kanosur, në lajthim ose për shkak të nevojës së madhe. Anulimi i këtyre veprimeve mund të kërkohet edhe pas vdekjes së personit përkatës, por vetëm kur para vdekjes është kërkuar heqja e zotësisë së tij për të vepruar."*.

99. Rastet e listuara në këtë dispozitë janë rrethana që shkaktojnë pavlefshmëri relative të veprimit juridik, i anulueshëm me vendim gjyqësor dhe vetëm me kërkesë të palës së interesuar. Këto rrethana prekin interesa të ngushta të palëve të veprimit juridik dhe lidhen me shfaqjen e vullnetit të tyre në botën e jashtme ose me zotësinë e tyre për të vepruar. Si rrjedhojë pala e dëmtuar ka të drejtën ta konvalidojë apo ta miratojë veprimin e kryer, për shkak se kjo palë ka të drejtën të disponojë lirisht të drejtat e saj. Kolegji vlerëson të theksojë se rastet e pavlefshmërisë relative, të parashikuara në nenin 94 të KC-së, nuk përbëjnë një listë shteruese. Këtu, Kolegji sjell në vëmendje parashikimin e nenit 57 dhe 94 të Kodit të Familjes, që përbën një rast të pavlefshmërisë relative të veprimit juridik të parashikuar me ligj të posaçëm. Në këto dy dispozita është parashikuar se veprimi juridik i tjetërsimit të sendit në bashkësi apo veprimet që tejkalojnë administrimin e zakonshëm të pasurisë në bashkësi, pa pëlqimin e njërit bashkëshort, a konvalidohen nëpërmjet dhënies së pëlqimit të mëvonshëm nga ana e tij ose nëse nuk kundërshtohen me kalimin e afatit njëvjeçar, nga data e përfundimit të regjimit pasuror martesor.

100. Nga analiza e mësipërme, Kolegji vlerëson se, për nga pasojat që sjellin dhe për nga rrethi i subjekteve të dëmtuara, shkeljet e ligjit civil, që shkaktojnë pavlefshmëri relative të veprimit juridik, kanë një rendësi dytësore në raport me shkeljet që shkaktojnë pavlefshmëri absolute sipas nenit 92 të KC-së. Këto të fundit janë të tilla që krahas interesave të palëve të veprimit juridik mund të prekin edhe interesa të të tretëve apo edhe një interes publik (sikurse do të analizohet në mënyrë më të detajuar në vijim). Për këtë arsye mbi veprimin juridik absolutisht të pavlefshëm, palët nuk mund të disponojnë lirisht duke e konvaliduar atë, ashtu sikurse palët nuk mund të disponojnë mbi interesin publik. Si rrjedhojë pasojat e shkeljes rrjedhin *ex legge*, pavarësisht vullnetit të tyre.

iii/b) Raporti midis veprimeve juridike të pavlefshme dhe veprimit të ndaluar nga ligji sipas nenit 168 të Kodit Civil.

- Në lidhje me veprimet juridike relativisht të pavlefshme.

101. Duke mbajtur në konsideratë, karakteristikat dhe dallimet midis llojeve të pavlefshmërisë, Kolegji vlerëson se nga fusha e zbatimit të nenit 168 të KC-së dhe nga koncepti i "*veprimeve juridike që janë të ndaluara nga*

ligji", janë të përjashtuara si rregull shkeljet, që sipas KC, shkaktojnë pavlefshmëri relative të veprimit juridik.

102. Në parim, vlen të theksohet se, nuk mund të cilësohen të ndaluara veprimet juridike, të cilat ligji i cilëson të vlefshme dhe për rrjedhojë të ligjshme deri në momentin kur pala e interesuar nuk kërkon anulimin e tyre. Veprimet e ndaluara për nga rëndësia e interesit që mbrojnë dhe për nga graviteti i shkeljes së ligjit, nuk mund të shndërrohen në veprime të lejuara me vullnetin e palës së prekur nga shkaku i pavlefshmërisë, nëpërmjet konvalidimit. Kjo do të thotë se një veprim juridik që është i ndaluar nga ligji për shkak të natyrës dhe përmbajtjes së tij, është i tillë që prej fillimit dhe mbetet i tillë deri në momentin që vetë ligjvënësi, nisur nga konsiderata sociale, ekonomike apo politike, e liberalizon me një ndryshim të mëvonshëm legjislativ. Për rrjedhojë një veprim i tillë, nuk mund të ligjërohet me vullnetin e palës, por vetëm me vullnetin e ligjvënësit në një moment të caktuar kohor.

103. Nga ana tjetër, duke qenë se veprimet juridike të anulueshme janë të vlefshme derisa të anulohen me vendim gjykate, pronësia mbi sendet, do të fitohet ose sipas veprimit juridik, si një mënyrë e prejardhur e fitimit të pronës, ose sipas një mënyre tjetër origjinale, pasi mënyrat e fitimit të pronës nuk janë konkurruese, por përjashtojnë njëra-tjetrën.

104. Në doktrinën juridike dhe në jurisprudencën ndërkombëtare, në interpretim të Kodit Civil të Republikës së Italisë dhe të Republikës së Francës, që kanë shërbyer pjesërisht si model edhe për hartimin e Kodit tonë Civil, është pranuar se mënyrat origjinale të fitimit të pronës, që kanë për bazë një veprim juridik për kalimin e pronësisë dhe posedimin, sikurse janë parashkrimi fitues me titull (shih për analogji nenin 168 të KC-së) apo fitimi i sendeve të paluajtshme me mirëbesim (shih për analogji nenin 166 të KC-së), shërojnë kryesisht situatën ku pronësia ka kaluar nga jopronari dhe jo kur jemi para një veprimi juridik të anulueshëm. Ky është edhe thelbi i këtyre dy mënyrave origjinale të fitimit të pronës, ku pronësia fitohet rishtazi, pa vullnetin e pronarit të mëparshëm dhe për këtë shkak nuk vlen parimi se askush nuk mund të transferojë më shumë të drejta nga sa ai ka (*nemo plus juris ad alium transferre potest quam ipse habet*).

105. Logjika e kësaj doktrine është se titulli i pronësisë mbi një send të luajtshëm apo të paluajtshëm, i prekur nga një prej të metave që e bëjnë të anulueshëm një veprim juridik, nënkupton situatën ku e drejta ka kaluar prej pronarit, por vullneti i palës së veprimit juridik është i vesuar. Një veprim i tillë është i vlefshëm dhe sjell pasojat e dëshiruara nga palët, që në momentin e kryerjes së tij, derisa nuk i janë anuluar efektet, në mënyrë prapavepruese, me vendim gjyqësor të formës së prerë, me kërkesën e palës së prekur nga shkaku i pavlefshmërisë. Në një situatë të tillë, poseduesi me mirëbesim i një sendi të luajtshëm apo të paluajtshëm, është pronar që prej fillimit, për shkak të titullit, si një mënyrë e prejardhur të fitimit të pronës. Këtë të drejtë të tij me karakter absolut dhe këtë titull pronësie, ai mund t'ia kundrejtojë çdo të treti, pasi asnjë tjetër, përveç palës, nuk legjitimohet të pretendojë pavlefshmërinë relative të veprimit juridik. Ndërkohë, me anulimin me efekt retroaktiv të veprimit juridik relativisht të pavlefshëm, poseduesit me mirëbesim që prej fillimit do i mungonte titulli i përshtatshëm për kalimin e pronësisë, si një nga kushtet thelbësore për fitimin e pronës sipas kësaj mënyre[58].

106. Për sa i përket palës së dëmtuar nga shkaku i pavlefshmërisë, mund të thuhet se veprimet juridike relativisht të pavlefshme, mund të konvalidohen prej saj me veprime të mëpasshme. Në doktrinën juridike është pranuar se konvalidimi mund të bëhet në 3 forma: 1) konvalidim i shprehur, i heshtur ose i prezumuar[59]. Konvalidimi i prezumuar është rasti kur pala e interesuar, e konvalidon veprimin juridik, duke mos ushtruar të drejtën e padisë për anulimin e veprimit juridik, brenda afatit të parashikuar në ligj.

107. Sipas nenit 103 të KC-së, padia për të kërkuar shpalljen e pavlefshmërisë së veprimit juridik, parashkruhet brenda 5 viteve. Për të kuptuar natyrën juridike të këtij afati, Kolegji çmon të marrë në analizë disa institute të së drejtës civile, të lidhura me të.

108. E drejta e padisë në kuptimin material, jepet në nenin 112 të KC-së. Padia është mjet juridik për mbrojtjen e së drejtës subjektive dhe si e tillë nuk duhet ngatërruar me vetë të drejtën subjektive. E drejta e padisë në kuptimin material është një e drejtë që i jepet mbajtësit të së drejtës subjektive që, në rast cenimi ose mohimi të kësaj të drejte, të rivendosë atë duke iu drejtuar gjykatës. Në teorinë e së drejtës civile është pranuar se e drejta subjektive *"...është mundësia juridike e mbajtësit të së drejtës subjektive për të kryer vetë veprime të caktuara si dhe mundësia për të kërkuar nga personi i detyruar kryerjen ose moskryerjen e veprimeve të caktuara, mundësi kjo e garantuar me mundësinë për të kërkuar, në rast nevoje, mbrojtje shtetërore, me qëllim që mbajtësi i së drejtës subjektive të kënaqë interesat e tij të ligjshme"*. Rastet e humbjes të së drejtës subjektive janë të përcaktuara shprehimisht në ligj (*shih vendim unifikues nr. 5, datë 31.5.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

[58] https://www.brocardi.it/codice-civile/libro-terzo/titolo-viii/capo-ii/sezione-ii/art1153.html.

[59] Shiko Baltasar Benusi, "*Obligimet dhe kontratat përgjithësisht*", Botim i Ministrisë së Drejtësisë 1931, faqe 178.

109. Nëse padia nuk ushtrohet brenda një afati të parashikuar në ligj, ajo parashkruhet, pra shuhet e drejta për mbrojtjen shtetërore të saj. Nga ana tjetër, KC-ja në nenet 137 e vijues, ka parashikuar edhe institutin e afatit prekluziv dhe dekadent të të drejtave subjektive. Ndryshe nga kalimi i afatit të parashkrimit shues, me kalimin e afatit prekluziv apo dekadent, në rastet e parashikuara nga ligji, shuhet e drejta subjektive në vetvete.

110. Duke u bazuar në këtë dallim midis dy instituteve, rrjedhin disa pasoja juridike. Nga e drejta për të prapësuar parashkrimin e padisë, pra shuarjen e së drejtës së subjektit titullar për mbrojtje shtetërore, debitori, ndaj të cilit ushtrohet forca shtrënguese e shtetit, mund të heqë dorë pasi të jetë plotësuar afati i tij (neni 126 i KC-së) . Kjo pasi e drejta subjektive e kreditori, gjithsesi ekziston dhe debitori mund ta realizojë në çdo kohë qoftë edhe vullnetarisht. Po ashtu, debitori nuk mund të pretendojë kthimin e shumës së parave apo të sendit të dhënë vullnetarisht, pas kalimit të këtij afati, sepse detyrimi i tij karshi kreditorit në vetvete nuk është shuar (neni 128 i KC-së) . Afati i parashkrimit nuk mund të merret parasysh nga gjykata, por vetëm me kërkesën e palës së interesuar (neni 125 i KC-së). Nga ana tjetër, nga afati prekluziv palët nuk mund të heqin dorë pas plotësimit të tij. Shuarja e së drejtës subjektive ndodh *ipso factum*, me kalimin e afatit, pavarësisht vullnetit të palëve dhe po ashtu, nuk mund të hiqet dorë nga pretendimi për një të drejtë që nuk ekziston (neni 139 i KC-së). Afati prekluziv, duke qenë se lidhet me vetë ekzistencën e së drejtës subjektive, merret parasysh nga gjykata kryesisht (neni 140 i KC-së).

111. Në vijim të kësaj analize, Kolegji vlerëson se afati 5-vjeçar, i parashikuar në nenin 103 të KC-së mbart në vetvete elemente miks të një afati prekluziv dhe një afati parashkrimi. Kjo pasi, me kalimin e këtij afati, subjektit të interesuar nuk i humb thjesht dhe vetëm e drejta e padisë, nëse nuk e ushtron atë, por njëkohësisht konvalidohet veprimi juridik, i cili mbetet përjetësisht i vlefshëm, pasi nuk ka asnjë autoritet tjetër përveç gjykatës që ti anulojë efektet. Parashkrimi sipas kësaj dispozite, është një parashkrim i veçantë që ka për bazë konfirmimin.[60] Kjo do të thotë se me kalimin e këtij afati, shuhen përjetësisht edhe të drejtat subjektive civile të tjetërsuara nëpërmjet veprimit juridik relativisht të pavlefshëm.

112. Kodi Civil, krahas parashkrimit shues, ka njohur edhe parashkrimin fitues me titull të sanksionuar konkretisht në nenin 168, objekt i kësaj analize. Afati i parashkrimit fitues për poseduesin e sendit, përbën njëkohësisht edhe një afat prekluziv dekadent për të drejtën subjektive të pronësisë së pronarit të mëparshëm. Ky i fundit e humbet të drejtën e pronësisë për shkak të neglizhencës së tij për ta ushtruar atë brenda afatit të parashikuar nga ligji. Dispozitat që rregullojnë afatin e parashkrimit shues të padisë së anulimit të veprimit juridik dhe afatin e parashkrimit fitues me titull sipas nenit 168 të KC-së, duhen analizuar sipas një lidhjeje logjike dhe juridike. Ato duhen interpretuar sipas parimit kushtetues dhe të së drejtës civile, se prona duhet të qarkullojë civilisht dhe të zhvillohet në mënyrë të pandërprerë. Lidhja midis tyre ekziston për faktin se një nga kushtet e fitimit të pronës sipas nenit 168 të KC-së është edhe ekzistenca e veprimit juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë.

113. Për të garantuar qarkullimin civil dhe zhvillimin e pronës, çka përmbush edhe funksionin publik dhe social të saj, sipas KC-së, jurisprudencës dhe doktrinës juridike, e drejta e pronës shquhet nga karakteri i vazhdueshëm dhe kalimi zinxhir i pronës nga një subjekt tek tjetri, qoftë sipas një mënyre origjinale apo qoftë sipas një mënyre të prejardhur, ku prona asnjëherë të mos mbetet pa zot. Kjo do të thotë se fitimi i së drejtës së pronësisë për një subjekt është në të njëjtën kohë humbje e së drejtës së pronësisë për një subjekt tjetër. Ky parim sanksionohet në nenin 191 të KC-së ku parashikohet si parim i përgjithshëm se pronësia humbet kur fitohet nga një tjetër. Kjo e drejtë nuk ka mbarim në kohë, pronari në mënyrë të vazhdueshme dhe të përhershme realizon të drejtën e tij të pronësisë mbi sendin duke gëzuar dhe disponuar lirisht atë, brenda kufijve të caktuar nga ligji.

114. Një nga kushtet për të fituar pronësinë sipas nenit 168 të KC-së është posedimi i pandërprerë me mirëbesim për një afat prej 5 vitesh për sendet e luajtshme dhe 10 vitesh për sendet e paluajtshme. Nëse posedimi është me keqbesim këto afate dyfishohen. Për të vlerësuar raportin midis këtyre afateve dhe afateve të parashkrimit shues të padisë së anulimit të veprimit juridik, Kolegji sjell në vëmendje rregullin e përgjithshëm të parashikuar në nenin 117 të KC-së, që parashikon momentin *a quo* se kur fillon të ecë afati i parashkrimit të padisë. Në këtë dispozitë sanksionohet si parim se afati i parashkrimit nis nga data e lindjes së të drejtës së padisë, pra nga data kur titullari i së drejtës subjektive është cenuar dhe ka marrë dijeni për cenimin dhe subjektin cenues.

115. Në nenin 104 të KC-së, parashikohet në mënyrë të posaçme momenti se kur palës së dëmtuar nga pavlefshmëria e veprimit juridik, për çdo rrethanë pavlefshmërie sipas nenit 94 të KC-së, i lind e drejta e padisë së anulimit. Kjo dispozitë ka parashikuar: *"Afati për ngritjen e padisë fillon: a) për veprime juridike të kryera nga persona që u është hequr ose kanë pasur zotësi juridike të kufizuar për të vepruar, që nga dita që janë bërë madhorë ose që u është kthyer zotësia*

[60] Shiko Baltasar Benusi, "*Obligimet dhe kontratat përgjithësisht*", botim i Ministrisë së Drejtësisë, 1931, faqe 179.

për të vepruar; b) për veprime juridike të kryera me mashtrim, kanosje ose lajthim, nga dita që mashtrimi ose lajthimi janë zbuluar, ose kanosja ka pushuar, por në çdo rast, jo më shumë se tre vjet nga dita që është kryer veprimi juridik; c) në raste të tjera, që nga dita që është kryer veprimi juridik..."

116. Në rastin e parashikuar në shkronjën "b" të nenit 104 të KC-së, pra kur veprimi juridik është kryer në kushtet e mashtrimit, kanosjes apo lajthimit, maksimalisht e drejta për të ngritur padinë e anulimit, parashkruhet brenda 8 vitesh nga data e kryerjes së veprimit juridik. Pra, afatit 3-vjetor maksimal brenda të cilit lind e drejta e padisë, i shtohet edhe afati 5-vjeçar i parashkrimit të padisë. Sikurse mund të konstatohet, ky afat është më i shkurtër se afati 10-vjeçar i parashikuar në nenin 168 të KC-së, për posedimin e pandërprerë të sendeve të paluajtshme. Sipas shkronjës "c", në të gjitha rastet e tjera, afati maksimal i ngritjes së padisë është 5 vjet nga data e kryerjes së veprimit juridik.

117. Ndërkohë, rrethanat e parashikuara në shkronjën "a" të kësaj dispozite, lidhen me rastet e pavlefshmërisë të veprimit juridik të parashikuar në shkronjat "a" dhe "b" të nenit 94 të KC-së, kur veprimi juridik është kryer nga i mituri mbi 14 vjeç pa pëlqimin e prindit ose nga personi madhor të cilit i është hequr ose kufizuar për të vepruar, pa pëlqimin e kujdestarit.

118. Një nga kushtet e vlefshmërisë së veprimit juridik është zotësia e plotë për të vepruar e palëve që marrin pjesë në të. Ligjvënësi kërkon zotësinë për të vepruar të palëve për shkak të prezumimit se vullneti i një të pazoti nuk mund të jetë i saktë. Zotësia për të vepruar nënkupton kapacitetin e palës që me veprimet e tij të marrë përsipër detyrime apo të fitojë të drejta. Ky kapacitet lidhet me zhvillimin psikik të palës dhe aftësinë për të kuptuar dhe dëshiruar pasojat e veprimit juridik që kryen dhe mund të jetë i kushtëzuar për shkak të moshës ose gjendjes mendore.

119. Kodi Civil ka parashikuar rregullin e përgjithshëm se zotësia e plotë për të vepruar arrihet në moshën 18 vjeç. I mituri deri në moshën 14 vjeç është i pazoti për të vepruar. Për këtë kategori subjektesh, KC ka prezumuar se për shkak të zhvillimit psikik, ata nuk janë të aftë të kuptojnë rëndësinë e veprimeve që kryejnë dhe pasojat që vijnë prej tyre. Veprimet juridike në emër dhe për llogari të tyre kryhen nga përfaqësuesi ligjor, që mund të jetë prindi ose kujdestari ligjor (shih nenin 8 të KC). Duke prezumuar se të miturit nën 14 vjeç i mungon tërësisht vullneti për të vepruar, ligji ka sanksionuar me pavlefshmëri absolute të gjitha veprimet juridike të kryera prej tij (shih nenin 92/c).

120. Ndërsa i mituri nga mosha 14 vjeç deri në 18 vjeç, prezumohet se ka një zhvillim më të avancuar mendor për të kuptuar veprimet e tij, por ende nuk e ka arritur maturinë dhe pjekurinë e nevojshme që të veprojë në mënyrë të pavarur, si rrjedhojë, ai mund të kryejë vetë veprime juridike, por me pëlqimin paraprak të përfaqësuesit ligjor (shih nenin 7). Ligji ka barazuar si kategori me të miturit nga mosha 14 vjeç deri në 18 vjeç edhe subjektet madhorë, të cilëve për shkak të sëmundjes psikike apo zhvillimit të metë mendor, janë pjesërisht ose tërësisht të pazotët për të vepruar dhe të cilëve iu hiqet ose kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor (shih nenin 10). Ligji ka sanksionuar me pavlefshmëri relative veprimet juridike të realizuara prej tyre.

121. Rasti i parashikuar në shkronjën "a" të nenit 104 të KC-së, lidhet në fakt me rrethana që pezullojnë ecjen e afatit të parashkrimit të padisë së anulimit. Ato nuk përcaktojnë momentin se kur pala e dëmtuar merr dijeni për shkakun e pavlefshmërisë, si datë e lindjes së të drejtës së padisë, por lidhen me pamundësinë juridike dhe objektive të tyre për të ngritur padi. Instituti i pezullimit të afatit të parashkrimit është parashikuar në nenin 129 e vijues të KC-së dhe nënkupton ngrirjen e afateve të parashkrimit me vërtetimin e rrethanave të parashikuara nga ligji, që pamundësojnë objektivisht ngritjen e padisë nga palët e interesuara.

122. Kolegji vlerëson se, neni 104/a i KC-së duhet interpretuar në harmoni me nenin 129/d të KC-së, i cili, si rregull i përgjithshëm, parashikon se pezullohen afatet e parashkrimit të padisë nga të miturit ose personat të cilëve iu është kufizuar ose iu është hequr zotësia për të vepruar, deri sa e fitojnë këtë zotësi, kur nuk kanë përfaqësues ligjor. Këtu Kolegji sjell në vëmendje nenin 171 të KC-së, i cili ka parashikuar se dispozitat mbi pezullimin dhe ndërprerjen e afatit të parashkrimit shues, zbatohen edhe për afatin e parashkrimit fitues. Kjo do të thotë se në rastin e parashikuar në shkronjën "a" të nenit 104, bashkë me afatin 5-vjeçar për ngritjen e padisë së anulimit, pezullohet njëkohësisht edhe afati 10-vjeçar i parashkrimit fitues, për poseduesin e sendit, i cili e ka fituar posedimin në bazë të një veprimi juridik që është i prekur nga një prej rrethanave të pavlefshmërisë të parashikuar në nenin 94 "a" dhe "b". Kjo do të thotë se në të tilla raste, afati i parashkrimit shues të padisë të anulimit, fillon të ecë njëkohësisht më afatin e parashkrimit fitues, si moment *a quo*. Pra edhe në këtë rast, afati i parashkrimit 5-vjeçar të padisë së anulimit ecën paralelisht me afatin e parashkrimit fitues 10-vjeçar sipas nenit 168 të KC-së.

123. Në rastet kur bëhet fjalë për veprimet juridike që kanë për objekt pasurinë e të miturve, duhet të mbahen në vëmendje edhe parashikimet e Kodit të Familjes në lidhje me përgjegjësinë prindërore për administrimin e

kësaj pasurie. Në mënyrë të veçantë në nenin 234 të Kodit të Familjes, është parashikuar se për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme të të miturit, deri në moshën 18 vjeç, duhet të vlerësohet interesi më i lartë i tij dhe ky veprim mund të kryhet me autorizim paraprak të gjykatës së vendbanimit të të miturit. Kolegji vlerëson se veprimi juridik i realizuar në kundërshtim me nenin 234 të Kodit të Familjes, nuk shkakton pavlefshmëri absolute, por relative. Kjo rezulton edhe nga paragrafi i dytë dhe i tretë i nenit 234 të KC-së, ku është parashikuar se një veprim i tillë mund të shpallet i pavlefshëm me kërkesë të prindit, kujdestarit ligjor ose të prokurorit dhe po ashtu, autorizimi i gjykatës mund të jepet edhe pasi është kryer veprimi juridik, duke konvaliduar sakaq rrethanën e pavlefshmërisë. Pavlefshmëria absolute, nuk rregullohet me veprime të mëvonshme.

124. Kur veprimi juridik i realizuar nga përfaqësuesi ligjor i të miturit plotëson kushtet e vlefshmërisë, verifikimi i përmbushjes së interesit më të lartë të fëmijës do të bëhet rast pas rasti dhe mosdhënia e autorizimit paraprak të gjykatës nuk nënkupton *apriori* se ky interes nuk është përmbushur. Madje edhe në gjykimin e iniciuar me padinë e anulimit sipas nenit 234 të KC-së, gjykata do të vlerësojë në varësi të rrethanave konkrete nëse veprimi juridik i tjetërsimit pa autorizimin paraprak të gjykatës ka përmbushur realisht interesin më të lartë të fëmijës dhe nuk do e shpallë në çdo rast të pavlefshëm, sipas një vlerësimi *apriori*, vetëm pse nuk është marrë paraprakisht miratimi nga gjykata.

125. Kolegji sjell në vëmendje faktin se neni 234 i Kodit të Familjes është trashëguar nga parashikimi i mëparshëm analog në Kodin e Familjes të vitit 1982. Në nenin 73 të këtij Kodi ishte parashikuar se: "*Tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të çdo fëmije që mitur deri në moshën 18 vjeç, si dhe të gjitha veprimet që kapërcejnë kufijtë e një administrimi të thjeshtë të çdo pasurie të të miturit, mund të kryhen vetëm kur e kërkon interesi i të miturit dhe gjithmonë me lejë të Këshillit të Kujdestarisë. Veprimi juridik që është kryer pa u marrë leja e Këshillit të Kujdestarisë, mund të shpallet i pavlefshëm, me kërkesën e Këshillit të Kujdestarisë, të të miturit që ka mbushur moshën 14 vjeç, të prindit ose të kujdestarit të të miturit. Kur Këshilli i Kujdestarisë jep pëlqimin më vonë veprimi juridik nuk shpallet i pavlefshëm.*" Edhe kjo dispozitë e konceptonte si veprim juridik të pavlefshëm, tjetërsimin e pasurisë së të miturit pa u marrë pëlqimi i Këshillit të Kujdestarisë.

126. Duke iu rikthyer nenit 168 të KC-së, kur veprimi juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë, është kryer me të mitur ose në emër dhe për llogari të të miturit, rrethanat që shkaktojnë pavlefshmërinë relative sipas KC, duhen lexuar dhe interpretuar në harmoni me nenin 234 të Kodit të Familjes. Në këtë rast padia mund të ngrihet nga palët e legjitimuara në këtë dispozitë brenda një afati 5-vjeçar nga data e kryerjes së veprimit juridik, sipas parashikimit të përgjithshëm të neneve 103 dhe 104/c të KC-së.

127. Po ashtu, edhe pse kjo nuk rezulton në mënyrë të shprehur në nenin 234 i Kodit të Familjes, si person drejtpërdrejt i legjitimuar për të ngritur padi në këtë rast, është edhe i mituri, kur arrin zotësinë e plotë për të vepruar. Kjo më shumë duket një harresë e ligjvënësit, pasi në nenin 73 të Kodit të Familjes të vitit 1982, nga e ka burimin neni 234 i Kodit aktual, i mituri ishte një prej personave të legjitimuar. Megjithatë, duke interpretuar në mënyrë sistematike dispozitat e KC-së mbi padinë e anulimit të veprimeve juridike me të mitur sipas neneve 94, 103 dhe 104 me nenin 234 të Kodit të Familjes dhe me parimin e interesit të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë për të vepruar me padi, Kolegji vlerëson se i legjitimuar për padinë e ngritur sipas nenit 234 të Kodit të Familjes duhet të jetë edhe i mituri, interesat e të cilit cenohen drejtpërdrejt nga ky veprim. Në mungesë të veprimit nga prindi ose kujdestari ligjor, të miturit i lind e drejta e padisë kur arrin moshën madhore, me analogji, sipas shkronjës "a", të nenit 104 të KC-së.

128. Në vijim të kësaj analize, mund të thuhet se, nëse pala e interesuar, e dëmtuar nga shkaku i pavlefshmërisë relative, brenda afatit 5-vjeçar apo maksimalisht 8-vjeçar të parashikuar në nenin 104, nuk ngre padinë e anulimit të veprimit juridik, ai veprim është konvaliduar. Tashmë nuk do të ishte e nevojshme që poseduesi në mirëbesim të priste edhe disa vite të tjerë që të fitonte pronësinë mbi sendin sipas një mënyre primare të fitimit të pronësisë, pasi konsiderohet se e ka fituar pronësinë me një mënyrë tjetër, të prejardhur, nëpërmjet veprimit juridik të konvaliduar për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit të padisë, i cili si rrjedhojë mbetet përjetësisht i vlefshëm.

129. Mbetet për t'u analizuar veprimi i nenit 168 mbi sendet e luajtshme, pasi për këtë kategori afati i parashkrimit fitues me mirëbesim është më i shkurtër, 5 vjet, përveç rastit kur posedimi është me keqbesim, ku afati dyfishohet deri në 10 vjet.

130. Fillimisht, Kolegji çmon të theksojë se veprimi i nenit 168 të KC-së në lidhje me sendet e luajtshme, është i kufizuar dhe diskutimi është më shumë teorik. Në praktikën gjyqësore shqiptare, të konsultuar nga Kolegji, nuk është hasur ndonjë rast ku të jetë pretenduar fitimi i pronësisë së një sendi të luajtshëm sipas nenit 168 të KC-së. Megjithatë, Kolegji do të marrë në analizë, qoftë edhe në mënyrë hipotetike, të gjitha rastet e disktutueshme për të mbështetur konkluzionin njësues në rastin konkret. Për këtë qëllim, do të trajtohen dy mënyra origjinale të fitimit të pronës që kanë për bazë dhe si shkak të fitimit të së drejtës së pronësisë, posedimin dhe ekzistencën e një veprimi juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë, të parashikuara përkatësisht në nenet

166 dhe 168 të KC-së, si dhe dallimet thelbësore midis tyre. Analiza mbi nenin 166 të KC-së dhe raporti i tij me nenin 168, do të bëhet në funksion të çështjes së shtruar për njësim, me qëllim identifikimin e fushës së zbatimit të nenit 168.

131. Në nenin 166 të KC-së, nën titullin "*Fitimi me mirëbesim i sendeve të luajtshme*". është parashikuar se: *"Personi që në bazë të një veprimi juridik për kalimin e pronësisë ka fituar kundrejt shpërblimit me mirëbesim një send të luajtshëm, bëhet pronar i këtij sendi edhe sikur tjetërsuesi të mos ishte disponues i tij. Megjithatë fituesi, qoftë edhe me mirëbesim, nuk bëhet pronar i sendit kur ky është i vjedhur. Fituesi me mirëbesim bëhet pronar i monedhave dhe i letrave me vlerë te prurësi, edhe sikur këto t'i jenë vjedhur ose t'i kenë humbur pronarit ose personit juridik publik. Dispozitat e mësipërme nuk zbatohen për sendet e luajtshme që janë të shënuara në regjistrat publikë. Prona fitohet e lirë nga të drejtat e tjetrit mbi sendin, në rast se këto të drejta nuk rrjedhin nga titulli dhe nga mirëbesimi i fituesit."*.

132. Ajo që e dallon thelbësisht nenin 166 nga neni 168 të KC-së është natyra e sendeve mbi të cilat këto dispozita veprojnë. Si rregull, neni 166 i KC-së vepron vetëm për sendet e luajtshme, ndërsa neni 168 i KC-së vepron kryesisht mbi sendet e paluajtshme. Shkaku i fitimit të pronës sipas të dyja mënyrave origjinale është i njëjtë dhe lidhet me efektet e posedimit me mirëbesim. Poseduesi i sendit, për shkak të një titulli me qëllim kalimin e pronësisë, sillet si pronar dhe beson realisht se e drejta i ka kaluar nga pronari. Ndryshimi është se sipas nenit 166 të KC-së, e drejta e pronësisë kalon menjëherë me vënien në posedim të sendit të luajtshëm, kurse sipas nenit 168, posedimi kërkon një afat më të gjatë kohor, për të sjellë si pasojë fitimin e pronësisë. Fitimi i pronësisë me vënien në posedim rezulton nga neni 167 i KC-së, i cili ka parashikuar se: "*Në rast se pronësia mbi një send të luajtshëm u kalon me anë kontratash disa personave, bëhet pronar ai që ka fituar posedimin e sendit me mirëbesim, edhe sikur kontrata të jetë e një date të mëvonshme.*".

133. Parashikimi i nenit 166 të KC-së, ku e drejta e pronësisë fitohet menjëherë me posedimin, lidhet me natyrën juridike të sendeve të luajtshme, të cilat duhet të kenë një lëvizje më të shpejtë në qarkullimin civil. Kjo thjeshtëzon jetën ekonomike pasi shitja e sendeve të luajtshme, përbën një transaksion të shpejtë, që mund të kryhet disa herë në një periudhë të shkurtër kohore. Nëse edhe për disponimin e sendeve të luajtshme do të kërkohej një formalitet dhe procedurë e caktuar, sikurse për sendet e paluajtshme, kjo do të ngadalësonte në mënyrë të konsiderueshme tregtinë, sepse do të ishte gati e pamundur që për çdo veprim të tillë të verifikohej se kush është pronari. Kjo lidhet edhe me natyrën e konsumueshme të sendeve të luajtshme, ndryshe nga pasuria e paluajtshme, e cila me posedimin në kohë afatgjatë, vetëm mund të zhvillohet dhe ti rritet vlera.

134. Në Kodet Civile analoge të shteteve evropiane, që kanë shërbyer si bazë për hartimin e Kodit tonë, si dhe në doktrinën dhe jurisprudencën ndërkombëtare përkatëse, gjen zbatim prezumimi se posedimi i sendeve të luajtshme vlen si titull pronësie.

135. Kështu, në nenin 2276 të Kodit Civil Francez, ku rregullohet kjo mënyrë fitimi pronësie, është parashikuar se "*Për sa u përket sendeve të luajtshme, posedimi vlen si titull pronësie. Megjithatë, ai që e ka humbur ose të cilit i është vjedhur sendi, mund ta rivendikojë brenda tre viteve, duke nisur nga dita e humbjes ose e vjedhjes, kundër atij që e posedon…*" Në doktrinën franceze dhe në jurisprudencën e Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Francës, është pranuar se nga ky rregull bëjnë përjashtim sendet e luajtshme në pronësi publike dhe sendet e luajtshme që i nënshtrohen regjistrimit në regjistrat publikë. Ndërsa në parim, sipas këtij rregullimi ligjor, poseduesi me mirëbesim, me posedimin, e fiton menjëherë të drejtën e pronësisë mbi sendin e luajtshëm, pa qenë i detyruar të vërtetojë një veprim juridik tjetërsimi, mjafton të besojë se sendi i ka kaluar nga pronari.

136. Nga ana tjetër, në nenin 1153 të Kodit Civil të Republikës së Italisë është parashikuar se: "*Atij të cilit i janë tjetërsuar sende të luajtshme prej personit jopronar, fiton pronësinë mbi sendin nëpërmjet posedimit, mjafton të jetë në mirëbesim në momentin që i dorëzohet dhe të ekzistojë një titull i përshtatshëm për kalimin e pronësisë. Pronësia fitohet e lirë nga të drejtat e të tjerëve mbi sendin, nëse këto të drejta nuk burojnë nga titulli dhe fituesi është në mirëbesim. Në të njëjtën mënyrë fitohen të drejtat e uzufruktit, përdorimit…*"

137. Një parashikim të ngjashëm, me Kodin Civil të Republikës së Francës, ka pasur edhe Kodi Civil i Mbretërisë Shqiptare, i vitit 1929 (Kodi Civil i Zogut), në nenin 1065 të tij, ku thuhej se: "*Sa për sendet që janë të luajtshme prej natyrës së tyne dhe për titujtë te prurësi, posedimi i të tretëve me mirëbesim ka efektin e titullit në favor të këtyne Kjo dispozitë nuk aplikohet për përgjithësien e sendeve të luajtshme.*"

138. Neni 166 i KC-së aktual, në mënyrën se si është formuluar sot, e ka origjinën nga ligjet civile pararendëse gjatë periudhës komuniste. Kështu në nenin 43 të dekretit nr. 2171/1955, ishte parashikuar se: "*Personi që në bazë të një kontrate, ka fituar kundrejt shpërblimit me mirëbesim një send të luejtshëm bëhet pronari i këtij sendi edhe sikur tjetërsuesi të mos jetë pronar. Megjithatë, fituesi, qoftë edhe me mirëbesim, nuk bëhet pronar i sendit, kur ky i është vjedhur ose i ka humbur pronarit…Fituesi me mirëbesim bëhet pronar i monedhave dhe i letrave me vlerë te prurësi…edhe sikur këto ti jenë vjedhur ose ti kenë humbur pronarit…Personi që ka fituar sendin është me mirëbesim kur nuk ka ditur ose nga rrethanat nuk kishte si ta dinte*

se tjetërsuesi nuk ishte pronar." Nën një parashikim identik rregullohej kjo mënyrë fitimi pronësie edhe në Kodin Civil të vitit 1981.

139. Nga kjo analizë mund të deduktohet se ndryshimi thelbësor midis neneve 166 dhe 168 të KC-së lidhet me natyrën e sendeve. Nga ana tjetër ato kanë një logjikë të përbashkët mbi shkakun pse fitohet pronësia mbi to. Si rrjedhojë kufizimet që vendosin këto dy dispozita, që nuk kushtëzohen nga natyra e sendit, duhet të jenë simetrike, në pajtim me nenet 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 11, 17 dhe 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

140. Kështu, së pari, neni 166 i KC-së nuk gjen zbatim, për sendet e luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë. Përjashtimisht për këtë kategori sendesh gjen zbatim neni 168 i KC-së, pasi për nga regjimi juridik ato përafrojnë me sendet e paluajtshme.

141. Së dyti, neni 166 i KC-së, nuk vepron mbi sendet e luajtshme të vjedhura ose që i kanë humbur pronarit të mëparshëm. Logjika e këtij kufizimi, lidhet me faktin se nga vepra penale nuk mund të burojnë pasoja të ligjshme. Për këtë kategori, për të njëjtën arsye, nuk gjen zbatim as neni 168 i KC. Po ashtu, nuk mund të ndështkohet pronari origjinal për pasivitet në ushtrimin e të drejtave të pronësisë, pasi ai nuk e ka braktisur sendin me vullnetin e tij, por i ka humbur. Si rrjedhojë sendet e luajtshme në rrethana të tilla, mbeten përgjithmonë në pronësinë e pronarit origjinal, i cili mund të ushtrojë padinë e rivendikimit në çdo kohë, sepse është e paparashkrueshme (*shih vendim unifikues nr. 5/2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

142. Së treti, neni 166 i KC-së nuk duhet të gjejë zbatim për sendet e luajtshme pronë publike. Këtu Kolegji sjell në vëmendje, për qëllime të interpretimit krahasues, një vendim të Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Francës, (shih vendim, Dhoma Civile nr. 1, datë 13 shkurt 2019). Në këtë vendim Gjykata ka vlerësuar se neni 2276 (analog me nenin 166 të Kodit tonë), nuk gjen zbatim për sendet e luajtshme në pronësi publike dhe kjo përbën një kufizim të justifikuar dhe legjitim të së drejtës së poseduesit në mirëbesim, në kuptim të nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Neni 166 i Kodit tonë, nuk e vendos në mënyrë të shprehur një kufizim të tillë, por në të njëjtën mënyrë sikurse nuk mund të veprojë neni 168 mbi pronën e paluajtshme publike të patjetërsueshme, e njëjta logjikë duhet të vlejë edhe për sendet e luajtshme pronë publike. Kjo sipas parimit se të mirat që i përkasin domenit publik, qofshin këto sende të luajtshme apo të paluajtshme, janë të patjetërsueshme dhe nuk mund të kalojnë në pronësinë e subjekteve privatë.

143. Së fundi neni 166 i KC-së nuk gjen zbatim për sendet e luajtshme të fituara në bazë të një veprimi juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë, pa kundërshpërblim.

144. Në vijim të kësaj analize, Kolegji konkludon se neni 168 i KC-së, në lidhje me sendet e luajtshme, përjashton fushën e veprimit të nenit 166 të KC-së dhe gjen zbatim vetëm në dy situata: 1) në lidhje me sendet e luajtshme të regjistruara në regjistrat publikë; 2) në lidhje me sendet e luajtshme të tjetërsuara pa kundërshpërblim.

145. Për veprimet juridike relativisht të pavlefshme, për tjetërsimin e sendeve të luajtshme, për të cilat vepron neni 168, si rregull, e drejta e padisë së anulimit fillon nga data e kryerjes së veprimit juridik, sipas nenit 103/c të KC-së. Në këtë rast, afati 5-vjeçar i parashkrimit shues përputhet me atë të parashkrimit fitues dhe pronësia mbi sendin ka kaluar për shkak të veprimit juridik të konvaliduar. Po ashtu, sipas analizës së realizuar në paragrafët 117 e vijues të këtij vendimi vlen i njëjti argument për veprimet juridike me objekt sende të luajtshme, të anulueshme për shkak të rrethanave të parashikuara në nenin 94, shkronjat "a" dhe b", për të cilat e drejta e padisë lind sipas nenit 104/a të KC-së, ku afatet e parashkrimit shues dhe fitues ecin njëkohësisht dhe përputhen midis tyre.

146. Teorikisht dhe me karakter mbetës, bëjnë përjashtim vetëm disa situata, kur veprimet juridike të tjetërsimit të pasurisë, me objekt sende të luajtshme për të cilat gjen zbatim neni 168, janë të anulueshme për shkak se janë kryer në kushtet e mashtrimit, lajthimit apo kanosjes, sipas neneve 95 e vijues të KC-së, ku afati maksimal i ngritjes së padisë është 8 vjet nga data e kryerjes së veprimit juridik, sipas nenit 104/b të KC-së, afat ky më i gjatë se afati 5-vjeçar i parashikuar në nenin 168 të KC-së për këtë kategori sendesh. Këtu flasim gjithmonë kur posedimi është në mirëbesim, pasi për poseduesin në keqbesim, afatet dyfishohen dhe konkluzioni është i qartë.

147. Neni 94/c i KC-së ka parashikuar tri rrethana të veseve të vullnetit që shkaktojnë pavlefshmëri relative të veprimit juridik: a) kur veprimi juridik është kryer në kushtet e mashtrimit; b) të kanosjes; c) të lajthimit. Këtu bëhet fjalë për hipotezën kur vullneti i pronarit nga i cili ka kaluar pronësia ka qenë i vesuar nga një prej këtyre veseve të vullnetit.

148. Në rastin e mashtrimit[61], që veprimi juridik të jetë i anulueshëm, duhet që mashtrimi i palës që ka kaluar pronësinë mbi sendin të ketë ardhur nga pala tjetër ose nga një person i tretë, por gjithmonë me dijeninë e palës tjetër. Në këto kushte, nuk mund të flitet për mirëbesim të poseduesit, i cili e ka ditur ose nga rrethanat duhet ta dinte se pronësia mbi sendin e luajtshëm nuk i ka kaluar me vullnetin e pronarit. Si rrjedhojë, në këtë situatë, poseduesi është me keqbesim dhe gjen zbatim paragrafi i dytë i nenit 168 të KC-së, mbi afatin 10-vjeçar të posedimit.

149. Në rastin e kanosjes[62], kur kanosja është shkaktuar nga pala tjetër e veprimit juridik sërish do të ishim para situatës së poseduesit me keqbesim, ku posedimi do të ishte fituar në mënyrë të dhunshme dhe në këtë rast afati i parashkrimit fitues është 10 vjet, më i gjatë se afati maksimal 8-vjeçar për ngritjen e padisë së anulimit.

150. Në rastin e lajthimit[63], sërish diskutimi shtrohet teorikisht. Lajthimi sipas nenit 97 të KC-së, shkakton pavlefshmërinë relative të veprimit juridik nëse lidhet me cilësitë e sendit apo të palës me të cilën kryhet veprimi juridik. Ato duhet të lidhen me rrethana të tilla thelbësore, të cilat pala tjetër po do ti dinte nuk do të kishte kryer veprimin juridik. Nëse e zbatojmë këtë parashikim të ligjit në një veprim që ka për qëllim kalimin e pronësisë, kur lajthimi ka lidhje me sendin, zbatimi i nenit 168 i KC-së mbetet pa kuptim, pasi poseduesi i sendit nëse do të kishte një pretendim të tillë nuk do të pretendonte fitimin e pronës mbi sendin as sipas nenit 168 të KC-së, as me kontratë, por në çdo rast do të kërkonte kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Mbetet situata kur pronari i sendit të luajtshëm, i ka tjetërsuar pa kundërshpërblim një send të luajtshëm apo një send të regjistruar në regjistrat publikë, poseduesit të sendit, duke pasur lajthitje mbi personin e tij. Vetëm në këtë rast, i cili gjithsesi mbetet shumë hipotetik, me kalimin e afatit 5-vjeçar, pronësia mbi sendin e luajtshëm do të fitohej jo sipas mënyrës së prejardhur, por sipas nenit 168 të KC-së dhe mbetet irrelevant fakti nëse pas kalimit të këtij afati, pala e prekur nga veprimi juridik ngre apo jo pretendimin për pavlefshmëri relative të veprimit juridik, i cili edhe pse me të meta, nuk është i tillë që të jetë i ndaluar nga ligji.

- Në lidhje me veprimet juridike absolutisht të pavlefshme

151. Në vijim të kësaj analize, me karakter mbetës, shtrohet për diskutim se cilat janë ato veprime juridike absolutisht të pavlefshme, të cilat konsiderohen njëkohësisht të ndaluara nga ligji sipas nenit 168 të KC-së dhe cilat janë ato veprime absolutisht të pavlefshme, të cilat gjithsesi plotësojnë formalisht kushtin e titullit të aftë për të sjellë si pasojë fitimin e pronësisë sipas kësaj mënyre origjinale.

152. Sipas nenit 92 të KC-së, veprimet juridike janë absolutisht të pavlefshme kur: a) kryhen në shkelje të normave juridike me karakter urdhërues: b) në mashtrim të ligjit: c) kur kryhen me të mitur nën moshën 14 vjeç; ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluara).

153. Fillimisht, Kolegji çmon të marrë në analizë, shkronjën "a" të nenit 92 të KC-së, i cili ka sanksionuar me pavlefshmëri absolute të gjitha veprimet juridike që vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit.

154. Një çështje e diskutueshme në doktrinën juridike ka qenë fakti nëse për të konkluduar mbi natyrën urdhëruese të dispozitës, mjafton formulimi i saj, apo duhet të merret në analizë edhe aspekti cilësor dhe përmbajtjesor, pra marrëdhënia juridike që ajo rregullon dhe cila është natyra e interesit që norma juridike mbron.

155. Sikurse është analizuar edhe më sipër, parimi i autonomisë së vullnetit ka origjinë kushtetuese dhe është sanksionuar në nenin 11 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Liria civile dhe qarkullimi civil kanë si bazë të ndërtimit të marrëdhënieve juridike pikërisht lirinë kontraktore, shprehje e lirisë së veprimtarisë ekonomike. Në KC detajohet rregullimi i marrëdhënieve juridike midis privatëve duke u bazuar te këto liri, nga buron natyrshëm parimi se ajo që nuk ndalohet shprehimisht nga ligji është e lejuar. Sipas nenit 79 të KC-së, veprimi juridik është një akt vullneti, i cili krijon, ndryshon apo shuan të drejta dhe detyrime civile. Nga ana tjetër, në nenin 660 të KC-së është parashikuar se: "*Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi*". Po ashtu, në shumë dispozita të tjera të KC-së mund të gjenden shprehje të këtij parimi, ku palëve iu është njohur pushteti sovran për të vendosur apo edhe për të krijuar të drejta apo detyrime të

---

[61] Shih nenin 95 të Kodit Civil i cili ka parashikuar se: "*Mashtrimi mund të shkaktojë që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm, kur gënjeshtra e përdorur nga njëra palë, për ta shpënë në gabim palën tjetër, është e tillë që pa atë pala nuk do ta kishte kryer veprimin juridik. Kur mashtrimi është bërë nga një person i tretë, pala e mashtruar mund të kërkojë shpalljen e pavlefshmërisë së veprimit juridik vetëm kur në kohën e kryerjes së tij pala tjetër ka ditur ose duhej të dinte mashtrimin.".*

[62] Shih nenin 96 të Kodit Civil ku është parashikuar se: "*Kanosja mund të shkaktojë që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm, kur është e tillë sa të frikësojë personin se ai vetë, bashkëshorti, pasardhësit ose paraardhësit e tij do të pësojnë një dëm fizik ose material të padrejtë dhe të rëndë. Kanosja mund të kryhet edhe nga një person i tretë që nuk merr pjesë në veprimin juridik.".*

[63] Shih nenin 97 të Kodit Civil ku është parashikuar se: *"Lajthimi mund të shkaktojë që veprimi juridik të shpallet i pavlefshëm vetëm në qoftë se lidhet me cilësinë e sendit, me identitetin ose cilësitë e personit tjetër, apo me rrethana aq thelbësore sa që pa ato, pala nuk do të kishte kryer veprimin juridik.".*

paparashikuara nga ligji.

156. Duke pasur parasysh rregullimet e së drejtës, pranohet gjerësisht se normat juridike në doktrinë klasifikohen në dy grupe: me karakter imperativ (urdhërues) dhe norma me karakter lejues (dispozitive). Karakteri imperativ/ndalues i dispozitave të veçanta duhet të jetë i shprehur qartë dhe në mënyrë specifike[64]. Normat lejuese janë ato që parashikohen në ligj për rregullimin e marrëdhënieve të caktuara midis palëve, por që palët me marrëveshje mund t'i shmangin gjatë lidhjes së kontratave, ose gjatë kryerjes së veprimeve të tjera juridike, duke bërë rregullime të tjera që i konsiderojnë të përshtatshme e të dobishme, pa prekur parimet themelore dhe normat urdhëruese të vendosura për mbrojtjen e rendit juridik, moralit dhe zakoneve të mira.[65]

157. Përgjithësisht, e drejta private, është një korpus normash juridike me natyrë dispozitive (lejuese), por në të mund të gjenden edhe norma me karakter imperativ ose ndalues, që janë pjesë e së drejtës publike. Karakteri imperativ/ndalues i normave juridike në të drejtën private, përbën kufizim të autonomisë së vullnetit dhe mundet të përligjet vetëm nga një interes publik apo për mbrojtjen e interesave të të tretëve, sipas neneve 11/3 dhe nenit 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këtë kuptim, nëpërmjet masave të përshtatshme, sipas parimit kushtetues të proporcionalitetit, liria e kontraktimit mund të kufizohet vetëm në atë masë që i shërben interesit të mbrojtjes së interesit publik, si garantimin e ruajtjes së rendit publik, të moralitetit dhe të zakoneve të mira.[66]

158. Në këtë kuadër dhe për të konkretizuar me shembuj trajtimet teorike të mësipërme, Kolegji sjell në vëmendje parashikimin e Kodit Civil të Mbretnisë Shqiptare të vitit 1928[67], i cili në nenin 1104, ku përcaktonte ligjshmërinë e shkakut të kontratës, si një kategori e veprimeve juridike, i referohej interesit publik dhe parashikonte se: "*Shkaku asht i paligjshëm, kur asht në kundërshtim me ligjën, me rendin publik (ordre publik) ose me zakonet e mira*". Juristë të shquar të asaj periudhe, nëpër komentarë të KC-së dhe të së drejtës civile në përgjithësi, në lidhje me parimin e autonomisë së vullnetit janë shprehur se: "*Edhe përsa i përket themelit të akteve ka fuqi parimi i autonomisë së vullnetit: gjithçka që nuk ndalohet asht e lejueme. Kjo autonomi gjen përkufizime vetëm në rregullat ligjore që i përkasin rendit publik apo zakoneve të mira. Për mbrojtjen e interesave të kolektivitetit, në asnji rast disponimet dhe konvencionet e privatëve nuk pranohen kur janë në kundërshtim me ligjat ndalimtare të Mbretnisë, të cilat u përkasin personave, sendeve apo veprimeve ose me ligjat që i përkasin në çdo mënyrë rendit publik ose zakoneve të mira.*"[68] Po ashtu edhe në jurisprudencën e saj periudhe mbahej qëndrimi se: "*Lejohet prova e lirë për atakimin e aktit për shkak të paligjëshëm. Shkaku asht i paligjëshëm kur asht në kundërshtim me ligjën, me rendin publik ose zakonet e mira; dhe nën termën gjenerike ligjë përdorun në këtë nen, përveç dispozitat e shprehuna të ligjit penal, që hyejn në sferën e gjanë të kuptimit faj, përfshihen edhe dispozitat ndalimtare të së drejtës civile të përmbajtuna në çdo ligjë" (*shih vendim nr. 40, të Gjyqit të Diktimit, Dega Civile, 12 mars 1935*).*

159. Një rregullim të ngjashëm ka Kodi Civil i Republikës së Francës, i cili në nenin 2059 ka sanksionuar parimin e autonomisë së vullnetit ku është parashikuar se: "*Kushdo mund të negociojë mbi të drejtat që janë lirisht të disponueshme*". Nga ana tjetër, në nenin 2061 vendoset kufizimi i kësaj lirie për shkaqe që lidhen përgjithësisht me interesin publik dhe konkretisht është parashikuar se: "*Nuk mund të disponohet në lidhje me çështjet etatiste, mbi zotësinë për të vepruar, mbi çështjet që kanë të bëjnë me divorcet dhe me pjesëtimin e pasurive apo mbi mosmarrëveshjet që i përkasin kolektiviteteve publike dhe në përgjithësi rendit publik".* Në nenin 1179 të këtij Kodi, ku rregullohen rastet e pavlefshmërisë absolute dhe relative të kontratave, thuhet përkatësisht se: "*Pavlefshmëria është absolute kur rregulli i shkelur ka për objekt mbrojtjen e një interesi të përgjithshëm publik. Ajo është relative për sa kohë rregulli i shkelur ka për objekt mbrojtjen e një interesi privat.*"

160. Në të njëjtën mënyrë dhe logjikë juridike, Kodi Civil i Republikës së Italisë në nenin 1322 ka parashikuar se: *"Palët mund të përcaktojnë lirisht përmbajtjen e kontratës brenda kufijve të vendosur në ligj...*". Në komentarë të Kodit Civil të Republikës së Italisë, kjo dispozitë është interpretuar se liria kontraktore nuk është absolute, por mund të kufizohet nga ligji, për shkak të interesit publik, apo të interesit të kategorive të caktuara.[69]

161. Kufizimi nga një interes publik i lirisë së vullnetit, gjen shprehje edhe në KC aktual të Republikës së Shqipërisë, konkretisht në nenin 677 ku është parashikuar se: "*Në një kontratë shkaku ligjor është i paligjshëm kur vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik, ose kur kontrata bëhet mjet për të shmangur zbatimin e një norme.*" Këtu vlen të theksohet se, parimi i autonomisë së vullnetit dhe kufizimet e tij, gjejnë shprehje si në pjesën e përgjithshme të KC-së të Republikës së Shqipërisë, ku rregullohen veprimet juridike në përgjithësi, kushtet për vlefshmërinë e

[64] Shih Thimio Kondi, "*Liria e Kontraktimit dhe kufijtë kushtetues dhe ligjorë të saj*", Avokatia 27, botim i *Revistës Avokatia.*
[65] Idem.
[66] Idem.
[67] Ky ligj ka hyrë në fuqi më datë 1.4.1929.
[68] Shih Baltasar Benussi, "*Obligimet dhe kontratat përgjithsisht*", botim i Ministrisë së Drejtësisë 1931, faqe 18.
[69] Shih "*Codice Civile Spiegato con esempi pratici, dottrina, giurisprudenca, schemi, tabelle e appendice normative*", Decima Edizione, Casa Editrice "La Tribuna", faqe 867.

tyre, ashtu edhe në pjesën e posaçme që përcakton regjimin juridik të kontratave. Kolegji risjell në vëmendje se në hartimin e Kodit tonë janë marrë për bazë kryesisht dy modele ligjore, modeli gjerman që trajton konceptin e veprimeve juridike në përgjithësi (BGB Gjerman) dhe Kodi Civil i Republikës së Italisë, në pjesën që rregullon kontratat në përgjithësi dhe në veçanti. Për këtë arsye, shpesh ndodh që të ketë përsëritje të parimeve apo edhe kundërshti, por në tërësi ligji duhet interpretuar si një i tërë, në mënyrë sistematike, ku pjesa e posaçme që rregullon kontratat duhet interpretuar sipas parimeve të përgjithshme dhe rregullave në lidhje me veprimet juridike.

162. Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji risjell në vëmendje nenet 92 dhe 94 të KC-së, ku janë parashikuar rrethanat që shkaktojnë pavlefshmërinë e veprimeve juridike, e cila mund të jetë *absolute* ose *relative*. Rrethanat që shkaktojnë pavlefshmërinë relative të veprimit juridik kanë si emërues të përbashkët se mbrojnë ngushtësisht të drejta subjektive dhe private të palëve të veprimit juridik dhe nuk i interesojnë gjerësisht publikut apo të tretëve. Si rrjedhojë vetëm pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë pavlefshmërinë e veprimit juridik nëse vërtetohet një nga faktet juridike të parashikuara në këtë dispozitë dhe sipas parimit të disponibilitetit kjo palë, mund ta konvalidojë në mënyrë të shprehur apo me heshtje, ashtu sikurse pala mund të disponojë lirisht të drejtat e saj. Në këtë kuptim mund të thuhet se instituti i pavlefshmërisë relative të veprimit juridik është shprehje e parimit të autonomisë së vullnetit.

163. Në të kundërt, neni 92 i KC-së, i cili rregullon institutin e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik shpreh në vetvete një kufizim të autonomisë së vullnetit, pasi palët nuk mund ta konvalidojnë një veprim juridik absolutisht të pavlefshëm dhe pasojat e pavlefshmërisë rrjedhin *ex legge*, pavarësisht vullnetit të palëve apo edhe kundër vullnetit të tyre. Neni 92 nuk përcakton se çfarë do të kuptohet me dispozitë urdhëruese të ligjit, por duke iu referuar analizës së mësipërme, një dispozitë urdhëruese e ligjit është e tillë që ka për objekt një interes publik ose që mbron interesa të të tretëve, që dalin përtej interesave të palëve të veprimit juridik, sepse vetëm një interes i tillë mund të përligjë dhe justifikojë kufizimin e lirisë kontraktore, në përputhje me nenet 11/3 dhe 17 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Nga ana tjetër, neni 92 duhet interpretuar në mënyrë sistematike me nenin 677 të KC-së, pasi është rregulli i përgjithshëm që gjen shprehje te parimi i posaçëm që rregullon kontratat në përgjithësi dhe kushtet për vlefshmërinë e tyre. Sipas nenit 677 të KC-së kontrata është e paligjshme nëse vjen në kundërshtim me ligjin apo me interesin publik.

164. Neni 92/a i KC-së, është një dispozitë gjithëpërfshirëse, e cila referon te dispozita të tjera ligjore, shkelja e të cilave, passjell pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik. Vetëm mënyra e formulimit të dispozitës, nuk mjafton për të konkluduar mbi natyrën e saj. Për këto parashikime të tjera ligjore nuk është e mjaftueshme të kërkojmë një veprim a mosveprim, për t'u vlerësuar automatikisht si një dispozitë urdhëruese/ndaluese në kuptimin e nenit 92 (a) të KC.[70] Një dispozitë urdhëruese/ndaluese duhet gjithashtu të përmbajë një element cilësor, që ka për qëllim mbrojtjen e rendit juridik, të moralit të shoqërisë apo të zakoneve të mira[71]. Në të kundërt, kufizimi i lirisë kontraktore nuk do të ishte proporcional me interesin publik të mbrojtur, dhe për rrjedhojë do të binte në kundërshtim me parimin kushtetues të proporcionalitetit[72]. Rrjedhimisht, duhet pasur shumë kujdes kur identifikohen dispozitat me karakter urdhërues apo ndalues, dhe ky karakter nuk duhet të interpretohet në mënyrë të gjerë.[73] Nëse do të zgjerohej pa kriter vlerësimi si imperative/ndaluese i dispozitave të KC-së dhe të ligjeve të tjera mbi kontratat e veçanta, duke i bërë ato detyruese për palët, liria kontraktore do të kufizohej vetëm për ato pjesë të paparashikuara në Kod, rrjedhimisht sfera private do të kufizohej përtej interesit publik, dhe koncepti i dispozitave me karakter lejues do të humbte çdo kuptim.[74]

165. Duke i përmbledhur rastet e listuara në nenin 92 të KC-së, mund t'i ndajmë në dy kategori: 1) shkeljet që vijnë ndesh me respektimin e rendit publik, normave juridike me natyrë urdhëruese dhe ndaluese, të cilat nuk mund të derogohen me marrëveshje të palëve (shkronja "a" dhe "b"); 2) shkeljet e dispozitave të KC-së që garantojnë kushtet e vlefshmërisë së veprimit juridik në vetvete dhe që përcaktojnë elementet strukturore tij (shih shkronjat "c" dhe "ç").

166. Kolegji vlerëson se ka një dallim midis këtyre dy kategorive. Të parat plotësojnë formalisht dhe në dukje kushtet e vlefshmërisë së veprimit juridik (zotësia e palëve, vullneti i lirë dhe i pavesuar, forma e kryerjes së veprimit juridik), por në përmbajtje dhe në pasojat juridike që ato sjellin, godasin një normë imperative të ligjit.

[70] Shih Thimio Kondi, "*Liria e kontraktimit dhe kufijtë kushtetues dhe ligjorë të saj*", Avokatia 27, botim i *Revistës Avokatia,* viti 2018.
[71] Idem
[72] Idem
[73] Idem
[74] Idem.

Sakaq, marrëdhënia juridike që ato krijojnë është e kundërligjshme. Ndërsa kategoria e dytë lidhet me mungesën e kushteve dhe të elementeve strukturore për qenësinë e veprimit juridik në vetvete, ku më thelbësori është vullneti i palës për ta realizuar atë dhe për të dëshiruar pikërisht dhe drejtpërdrejt pasojat e ardhura prej tij. Në lidhje më këtë kategori, ligji ka sanksionuar me pavlefshmëri absolute rastet ku ka një mungesë absolute të vullnetit të palëve për kryerjen e veprimit juridik. Për këtë arsye, sipas ligjit, veprime të tilla janë inekzistente dhe ato mjafton të konstatohen nga gjykatat si të pavlefshme. Ndryshe nga rastet e pavlefshmërisë absolute, në rrethanat që shkaktojnë pavlefshmëri relative sipas nenit 94 të KC-së, nuk flitet për inekzistencë absolute të vullnetit, por për ekzistencën e një vullneti të vesuar.

167. Këtu, Kolegji çmon të marrë në analizë rastet e parashikuara në shkronjat "b", "c" dhe "ç" të nenit 92 të KC-së.

168. Veprimet juridike që kryhen për mashtrim të ligjit, përfshihen në kategorinë e përgjithshme të veprimeve të kundërligjshme. Këto veprime në formë dhe në dukje paraqiten si veprime të ligjshme, por në përmbajtje të tyre kanë elemente paligjshmërie. Vullneti i shprehur në këto veprime juridike nuk korrespondon me vullnetin e brendshëm të palëve të veprimit juridik. Këto të fundit kanë dijeni për pavlefshmërinë e veprimit juridik, veprojnë me ndërgjegje dhe synimi kryesor dhe i drejtpërdrejtë nuk është ardhja e pasojave të veprimit juridik, por shmangia e një dispozite urdhëruese të ligjit. Ky ves vullneti godet drejtpërdrejt ligjin, prandaj është sanksionuar si veprim nga ligjvënësi me pavlefshmëri absolute. Ndryshe nga këto veprime, në veprimet juridike që vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit sipas shkronjës "a" të nenit 92, palët nuk kanë si qëllim ti shmangen ligjit, ato synojnë drejtpërdrejt pasojat e veprimit juridik dhe mund të mos kenë dijeni për ndalimin ligjor. Megjithatë, për nga interesi që ato mbrojnë, si të dyja kategoritë përfshihen në gamën e gjerë të veprimeve juridike që shkelin një dispozitë urdhëruese dhe imperative të ligjit.

169. Në rastet e simulimit dhe fiktivitetit (simulimit absolut) ka një mospërputhje midis vullnetit të brendshëm, pra të asaj që duan në të vërtetë palët e veprimit juridik dhe shfaqjes së tij. Veprimet juridike fiktive janë ato veprime që kryhen nga palët vetëm formalisht "për sy e faqe", pa pasur si qëllim që të sjellin pasoja juridike. Në këto veprime mungon qëllimi dhe vullneti i palës për të krijuar, ndryshuar apo shuar një marrëdhënie juridike. Nga ana tjetër, veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre *(shih vendim unifikues nr. 932, datë 22.6.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

170. Në këto situata, nuk flasim për shkelje të dispozitave urdhëruese të ligjit, por për një mungesë absolute të vullnetit dhe qëllimit real të palëve për të kaluar pronësinë mbi një send të caktuar. Këto situata janë të barazvlefshme me inekzistencën e titullit, pra të veprimit juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë. Në të tilla raste, ose posedimi i sendit nuk ka kaluar asnjëherë nga pronari tek pala tjetër e veprimit juridik, i cili është bërë për sy e faqe ose poseduesi ka qenë në keqbesim, pasi që prej fillimit e ka ditur se nuk i ka kaluar pronësia prej pronarit. Në rastin e parë nuk shtrohet fare si diskutim zbatimi i nenit 168 të KC-së, pasi mungon elementi thelbësor i tij që është posedimi. Në rastin e dytë, inekzistenca e veprimit juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë, rrëzon kushtin tjetër thelbësor të zbatimit të nenit 168 të KC-së. Në një situatë të tillë, poseduesi me keqbesim do të mund të fitonte pronësinë mbi sendin sipas parashkrimit fitues pa titull, nëse plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 169 të KC-së.

171. I njëjti argument vlen edhe për rastin kur veprimi juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë, është kryer me një të mitur që nuk ka mbushur moshën 14 vjeç. Sikurse u analizua më sipër, sipas ligjit, të miturit në këtë moshë, i mungon tërësisht vullneti për të vepruar. Si rrjedhojë çdo veprim juridik i kryer me të është i paqenë. Në këtë situatë nuk mund të flitet as për mirëbesim të poseduesit të sendit të paluajtshëm, të cilit i ka kaluar pronësia me një veprim të kryer me të mitur, pasi nuk mund të pretendojë se i ka kaluar pronësia me vullnetin e pronarit.

172. Sikurse mund të konkludohet, në rastet e parashikuara në shkronjat "c" dhe "ç" të nenit 92 të KC-së, ligji sanksionon me pavlefshmëri absolute ato veprime juridike, jo sepse vijnë ndesh në përmbajtje më një dispozitë imperative të ligjit, por sepse mungon një nga kushtet thelbësore për qenësinë e veprimit juridik në vetvete, sikurse është ekzistenca e një vullneti për ta realizuar dhe për të synuar pasojat e ardhura prej tij. Në këtë kuptim, Kolegji vlerëson se lista e parashikuar në nenin 92 të KC-së nuk është shteruese. Në Kod mund të gjenden parashikime të posaçme që shprehimisht përcaktojnë kushtet e vlefshmërisë së veprimit juridik, mungesa e të cilave e bën veprimin e paqenë, por që nuk mund të kualifikohen sipas parashikimit të përgjithshëm të nenit 92/a të KC-së, të cilat do të merren në analizë në vijim. Për këtë kategori shkaqesh të pavlefshmërisë absolute, nuk shtrohet për diskutim nëse jemi para një veprimi të ndaluar nga ligji, por nëse plotësohet kushti i parë që kërkon neni 168 i KC-së, mbi ekzistencën e një veprimi juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë.

173. Nga analiza e mësipërme, Kolegji vlerëson se, një dispozitë ndaluese, për nga formulimi duhet të ndalojë

shprehimisht kryerjen e veprimit si të tillë. Ekzistenca e një veprimi të tillë, përveç se kufizon lirinë kontraktore për shkak se sanksionon me pavlefshmëri absolute veprimin juridik, përbën edhe një kufizim të së drejtës për pronë të poseduesit në mirëbesim sipas nenit 168 të KC-së dhe që të jetë i justifikuar në aspektin kushtetues apo konventor, duhet të përligjet nga një interes publik. Norma juridike e shkelur nga veprimi juridik, duhet të jetë e tillë, sa në psikikën e poseduesit të sendit, objektivisht dhe subjektivisht, nuk mund të krijohet përgjatë gjithë kohës së posedimit mbi sendin, një pritshmëri legjitime se me kalimin e kohës, për aq sa kjo normë është në fuqi, të mund të fitohet pronësia me një mënyrë origjinale, pasi ligji ka ndaluar tjetërsimin në çfarëdo lloj rrethane, me çdo mjet dhe në çdo kohë. Dispozitat imperative/ndaluese të ligjit, mund të kenë lidhje me sendin, i cili mund të jetë jashtë qarkullimit civil, por edhe me përmbajtjen e veprimit apo me palët, të cilave me ligj u është ndaluar kryerja e një veprimi të tillë.

174. Një të dhënë se e drejta e garantuar në nenin 168 të Kodit Civil, kufizohet nga një interes publik, e marrim shprehimisht nga paragrafi i tretë i kësaj dispozite, ku është parashikuar se "*Nuk mund të fitohet me parashkrim fitues një send që është pronë publike e patjetërsueshme*." Koncepti i pronës publike jepet në ligjin nr. 8743, datë 22.2.2002 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", ku bëhet edhe dallimi me pronën e paluajtshme shtetërore jopublike.

175. Kolegji vlerëson se koncepte të tilla si interesi publik, rendi publik, zakonet e mira, morali, përmenden në disa dispozita të KC-së (p.sh. neni 677), megjithatë Kodi nuk jep një përkufizim konkret se çfarë do të kuptohet me to. Koncepti i interesit publik fillimisht gjendet në KEDNJ, më tej në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe po ashtu në KC. Nëpërmjet jurisprudencës së saj, Gjykata Kushtetuese ka elaboruar disa prej koncepteve kushtetuese që kanë të bëjnë me interesin publik dhe me respektimin e parimeve të drejtësisë, proporcionalitetit apo të shtetit social. Sipas kësaj jurisprudence, këto elemente përbëjnë njëkohësisht edhe kufijtë kushtetues të hapësirës së vlerësimit, mbi të cilat duhet të orientohet ligjvënësi, për respektimin e së drejtës së pronës (*shih vendim nr. 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Interesi publik është nocion kushtetues joshterues në kuptimin që lista e çështjeve me interes publik nuk mund të jetë kurrsesi shteruese, pasi duhet kuptuar në sensin relativ, në varësi të situatave të ndryshme që krijohen (*vendim nr. 18, datë 14.5.2003 i Gjykatës Kushtetuese*).

176. Ligji nuk mundet të parashikojë në mënyrë konkrete dhe përfundimtare një koncept të tillë. Nëse do i jepnim një përkufizim do të thoshim se interes publik është tërësia e interesave të përbashkët të një shoqërie, komuniteti apo grupi njerëzish. Ky koncept është relativ dhe i ndryshueshëm në kohë. Kjo do të thotë se ligjvënësi, në periudha të ndryshme, në përputhje me zhvillimin dhe ndryshimin e kushteve sociale, zhvillimin ekonomik, ndryshimin e mentalitetit dhe moralit të shoqërisë, mund të ndalojë kryerjen e një veprimi të caktuar në një moment të caktuar dhe në një moment tjetër ta liberalizojë atë.

177. Po ashtu, Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se një dispozitë ndaluese e ligjit është një nënkategori e dispozitave urdhëruese, shkelja e të cilave, për nga pasojat që sjell, përbën shkallën më të rëndë të cenimit të rendit publik. Jo çdo dispozitë urdhëruese e ligjit përbën njëkohësisht edhe një veprim të ndaluar nga ligji. Edhe pse të dyja kategoritë përfaqësojnë norma të rendit publik, jo të gjitha shkeljet, për nga pasojat që sjellin, mbartin të njëjtën rëndësi dhe rëndesë, si rrjedhojë edhe sanksionet duhet të përmbushin kriterin e proporcionalitetit. Normat imperative kanë karakter urdhërues, kur ato diktojnë kryerjen e veprimeve të caktuara (pra, ndalojnë mosveprimin) dhe janë me karakter ndalues, kur ndalojnë kryerjen e veprimeve të caktuara (ose, me fjalë të tjera, urdhërojnë moskryerjen e këtyre veprimeve).

178. Në vijim, Kolegji çmon të sjellë në vëmendje disa shembuj konkretë, për të kuptuar se kur shkelja e një dispozite të ligjit përbën një veprim të ndaluar nga ligji dhe kur shkakton thjesht pavlefshmëri absolute të veprimit juridik, por gjithsesi të aftë për të plotësuar kushtin sipas nenit 168 të KC-së, në mënyrë që të lindë e drejta e pronësisë për poseduesin me mirëbesim. Sigurisht që Kolegji e ka të pamundur të zgjidhë, me këtë vendim njësues, të gjitha rastet që hasen në praktikë, por duke trajtuar rastet më tipike, në mënyrë orientuese, nga gjykatat më të ulëta, do të bëhet më i qartë kriteri i veprimit të ndaluar nga ligji, kur t'ju shtrohen për zgjidhje çështje të kësaj natyre.

179. Fillimisht, Kolegji sjell si shembull, ligjin nr. 7501 "Për tokën", i cili para ndryshimeve që ka pësuar në vitin 1995 dhe 1998, ndalonte kategorikisht shitblerjen e tokës bujqësore. Në nenin 2 të këtij ligji, si një dispozitë me karakter imperativ, ndalohej shprehimisht tjetërsimi i tokës bujqësore. Ky parashikim ligjor ishte një disponim që mbronte interesin publik, pasi shteti në atë kohë kërkonte që reforma e ndërmarrë për vetëshpronësimin e tij për llogari të familjeve bujqësore të mund të krijonte pritshmëritë e synuara të zhvillimit ekonomik rural gjatë periudhës fillestare të tranzicionit në Shqipëri dhe toka bujqësore të mbetej tek ato familje bujqësore që përbënin vazhdimësinë e kooperativës bujqësore që e kishin punuar atë. Kjo ka qenë arsyeja publike për këtë masë drastike ligjore në Shqipëri. Duke qenë se ndalohej kategorikisht shitblerja e tokës bujqësore, kjo e fundit për të njëjtën arsye, nuk mund të fitohej nga subjekte të ndryshëm, me mënyra të tjera të fitimit të pronës.

180. Ndalesa me karakter publik e mos tjetërsimit të tokave bujqësore është suprimuar nga rendi juridik në vitin 1998. Fillimisht, kjo dispozitë u shfuqizua me ligjin nr. 7983, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e tokës bujqësore, livadheve dhe kullotave", (në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës objekt gjykimi). Ky ligj e lejoi tjetërsimin e tokës bujqësore, por pasi të ishte e regjistruar sipas ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", në të kundërt veprimi juridik është i pavlefshëm (neni 3 i ligjit) dhe sipas një përparësie të caktuar te të tretët. Kufizimet e përparësisë në tjetërsim u hoqën me ligjin nr. 8337, datë 30.4.1998 "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave". Sipas këtij ligji toka bujqësore mund të tjetërsohej pa kufizim te të tretët (përveç subjekteve të huaja), por duhet të ishte e regjistruar (neni 7 i ligjit).

181. Po ashtu, ligji nr. 7980/1995 "Për shitblerjen e trojeve" përmban dispozita me karakter imperativë që ndalojnë të drejtën e personave fizikë ose juridikë, publikë apo privatë të shesin trojet në mënyrë të pakufizuar, të huajve. Shkelja e këtyre dispozitave, e bën veprimin juridik të ndaluar nga ligji, pasi ato janë shprehje e një politike publike të shtetit në mënyrën se si cedohet apo ushtrohet kontroll mbi territorin shqiptar, drejt subjekteve që nuk kanë shtetësi shqiptare. Për të njëjtën arsye që ligji ndalon tjetërsimin, të huajt nuk mund të fitojnë pronësinë mbi truallin në kundërshtim me këtë ligj, me një mënyrë origjinale.

182. Në shkelje të dispozitave ndaluese janë ato akte apo fakte juridike që rrjedhin nga vepra penale[75] të cilat janë shkalla më e rëndë e shkeljes së ligjit, për sa i përket detyrimit të vullnetit të tjetërsuesve deri në atë masë sa ta shndërrojë atë në fiktiv dhe të paqenë. Një rast i tillë mund të jetë falsiteti i dokumentit që kalon pronësinë dhe që përbën veprim juridik; tjetërsimi i sendit të vjedhur mbi të cilin kurrsesi rendi jonë juridik nuk lejon të fitohet pronësia në asnjë nga mënyrat e fitimit të saj të prejardhura apo origjinale; kategoria e shkeljeve me karakter administrativ apo edhe e dispozitave të cilat urdhërojnë ndalimin e kryerjes së veprimeve të caktuara juridike si pasojë e mbrojtjes së një interesi publik.

183. Nga ana tjetër, Kolegji vlerëson të marrë si shembull, disa dispozita në KC dhe në ligje të tjera, ku formulimi i normës juridike duket i natyrës urdhëruese, por për nga elementi cilësor dhe përmbajtësor nuk mund të kategorizohet si e tillë dhe/ose nuk është e një rëndësie të tillë sa të përbëjë veprim juridik të ndaluar nga ligji.

184. Në nenin 83/1 i KC-së është parashikuar se: "*Veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm…*".

185. Kolegji vlerëson se veprimi juridik për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme, përfshihet në kategorinë e veprimeve juridike formale, ku forma e shprehjes së vullnetit të palëve është kusht për vlefshmërinë e tij (*ad validitatem*). Forma solemne, është pjesë përbërëse e strukturës dhe element konstitutiv i veprimit juridik, që i ndërgjegjëson palët për rëndësinë e tij. Mungesa e formës së veprimit juridik, në të tilla rastem e bën atë nul, por jo një veprim të ndaluar nga ligji. Palët lejohen ta kryejnë veprimin edhe në mungesë të formës, por me penalitetin e pavlefshmërisë së tij, pasi shkelja e kësaj dispozite nuk cenon drejtpërdrejt ndonjë interes publik të mbrojtur nga rendi juridik. Në këtë kuptim mund të thuhet se rasti i parashikuar në nenin 83/1 të KC-së, përbën një parashikim të posaçëm në ligj të pavlefshmërisë absolute, që i shtohet në mënyrë komplementare, listës joshteruese të parashikuar në nenin 92, por nuk përfshihet në shkronjën "a" të kësaj dispozite. Madje, shkelja e nenit 83, që shkakton pavlefshmërinë e veprimit për shkak të mungesës së formës, si një prej elementeve përbërës të tij, është një nga rastet tipike për të cilat gjen zbatim neni 168 i KC-së dhe ky interpretim përbën tashmë një qëndrim jurisprudencial të konsoliduar ndër vite të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Në të tilla raste, në jurisprudencë është mbajtur qëndrimi se nuk mungon veprimi, vullneti dhe qëllimi i palëve për kalimin e pronësisë mbi sendin, por se ky vullnet thjesht nuk është përsosur në formën e kërkuar nga ligji[76]. Në këtë kuptim, titulli, për qëllim të nenit 168 të KC-së, nuk duhet të ngatërrohet apo të njësohet me dokumentin në të cilin ai materializohet, por duhet të kuptohet më shumë si një marrëdhënie juridike vullnetare e krijuar midis transferuesit dhe marrësit të së drejtës së pronësisë.

186. Kolegji sjell në vëmendje gjithashtu, nenin 208 të KC-së, ku është parashikuar se "*Tjetërsimi i sendit të përbashkët mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të gjithë bashkëpronarëve.*" Vullneti i të gjithë bashkëpronarëve për tjetërsimin e një sendi në bashkëpronësi, është pjesë e përsosurisë të veprimit juridik dhe element i vlefshmërisë së tij, ku kërkohet vullneti i plotë i secilit bashkëpronar për të ushtruar lirisht tagrin e disponimit të pronës së tij. Kjo

[75] Një qëndrim i tillë është mbajtur nga Gjykata e Kasacionit të Italisë në vendimin datë 26.3.1968, nr. 947.

[76] Ky qëndrim është praktikë gjyqësore e konsoliduar e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Shiko: vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, nr. 11111-00655-00-2007 i Regj. Themeltar, nr. 00-2009-1329 i vendimit (456), datë 24.12.2009; vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, nr. 11111-00639-00-2006 i Regj. Themeltar, nr. 00-2008-544 i vendimit (214), datë 18.3.2008; vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil, nr. 11115-01734-00-2007 i Regj. Themeltar, nr. 00-2010-973 i vendimit (307), datë 29.6.2010. Vendimin i Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil nr. 11211-00165-00-2005 i Rregj. Themeltar, nr. 00-2007-584 i vendimit (417), datë 5.4.2007

dispozitë nuk mbron një interes publik, por garanton të drejtat e pronësisë dhe interesat privatë të secilit prej bashkëpronarëve mbi sendin. Si rrjedhojë veprimi juridik i kryer në shkelje të nenit 208 të KC-së është i pavlefshëm pjesërisht për pjesën e bashkëpronarit që nuk ka dhënë pëlqimin, por nuk është një veprim i ndaluar nga ligji dhe nuk kufizon të drejtën e poseduesit me mirëbesim, që i është tjetërsuar sendi sipas një veprimi të tillë, për të fituar pronësinë sipas nenit 168 të KC-së. Nëse pranohet në doktrinë dhe jurisprudencë se një nga rastet që tipike që mbulon neni 168 i KC-së është pavlefshmëria e veprimit juridik për shkak se e drejta kalon nga jopronari, akoma më shumë vlen ky parim kur tjetërsimi nuk është bërë me vullnetin e plotë të të gjithë bashkëpronarëve. Mjafton që poseduesi të besojë se sendi i ka kaluar me vullnetin e të gjithë bashkëpronarëve.

187. E njëjta logjikë juridike vlen edhe për interpretimin e nenit 204 të KC-së, në lidhje me veprimin juridik të kryer për shitjen e pjesës mbi sendin e paluajtshëm nga njëri prej bashkëpronarët, pa garantuar të drejtën e parablerjes te bashkëpronarët e tjerë. Madje në legjislacionin pararendës civil shqiptar, mosrespektimi i së drejtës së parablerjes, për shkak se mbron interesa ngushtësisht privatë të bashkëpronarëve të tjerë dhe nuk e bën të paqenë në vetvete veprimin juridik të shitjes së pjesës, është konceptuar si shkak për pavlefshmërinë relative të veprimit juridik, të konvalidueshëm me kalimin e një afati të caktuar në ligj. Në këtë kuadër, Kolegji sjell në vëmendje nenin 79 të dekretit nr. 2171/1955 "Për pronësinë", ku ishte parashikuar se "*Bashkëpronari që do ti shesë një të treti pjesën që ka në sendin e paluajtshëm të përbashkët, duhet ti paraqitë noterit provë me shkresë se i ka lajmëruar bashkëpronarët e tjerë nëse dëshirojnë të blejnë pjesën e tij me të njëjtat kushte dhe ti bëjë një deklaratë me shkresë se asnjë nga pronarët nuk ka pranuar. Kur bashkëpronarët nuk janë lajmëruar ose kur deklarata e bashkëpronarit shitës nuk është e vërtetë si dhe kur shitja e pjesës është bërë në kushte shumë më të favorshme nga ato që u janë njoftuar bashkëpronarëve, këta kanë të drejtë të kërkojnë me anë të gjykatës popullore, brenda tre muajve nga shitja, cartjen e saj dhe blerjen e pjesës nga ana e tyre në kushtet në të cilat kjo i është shitur të tretit*…"

188. Po ashtu, me të njëjtën logjikë mund të konkludohet mbi veprimet juridike në shkelje të neneve 57, 94, 234 të Kodit të Familjes, të cilat janë të konvalidueshme me vullnetin e palës së dëmtuar nga rrethana e pavlefshmërisë dhe në kushtet e parashikuara nga ligji.

189. Një çështje e diskutueshme mbetet në lidhje me shitjen e sendit të paluajtshëm në kundërshtim me nenin 195 të KC-së, i cili parashikon se "*Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi ato që janë fituar ose njohur sipas dispozitave të këtij Kodi, nuk mund të tjetërsohen dhe kur është rasti, të ngarkohen me barrë, në rast se nuk është bërë regjistrimi i tyre në regjistrat publikë.*" Për Kolegjin shtrohet për zgjidhje nëse kryerja e veprimit juridik të shitjes në shkelje të kësaj dispozite, krahas pasojës së pavlefshmërisë, e bën atë një veprim juridik të ndaluar sipas nenit 168 KC?

190. Legjislacioni ynë civil, sipas interpretimit të bërë nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (shih vendim unifikues nr. 5/2011), përfshihet në ato sisteme ligjore, ku transkriptimi i titullit të pronësisë, nuk është kusht për vlefshmërinë e veprimit juridik, por ka efekte deklarative dhe i shërben publicitetit ndaj të tretëve. Transkriptimi/regjistrimi në regjistrat përkatës publikë kërkohet, për veprimet juridike (kontratat) që tjetërsojnë pasuritë e paluajtshme, si dhe për sende të luajtshme të një kategorie të veçantë siç janë anije, aeroplanë, automjete, etj.

191. Transkriptimi ose regjistrimi nuk është gjë tjetër veçse një mjet i nevojshëm për t'i dhënë publicitetin kontratës, për të bërë të njohur ekzistencën e saj dhe të pronarit nga të tretët. Transkriptimi ka funksionin e publikimit deklarativ. Kontrata si veprim juridik i dyanshëm në rast se plotëson kushtet për vlefshmërinë e saj edhe në mungesë të regjistrimit, është plotësisht e vlefshme mes palëve që e kanë realizuar atë. Është kontrata ajo që transferon mes palëve pronësinë e sendit të paluajtshëm, krijon të drejta reale mbi sendin dhe legjitimon pronarin të kërkojë dhe mbrojë këto të drejta.

192. Si regjim imponues, transkriptimi ose regjistrimi karakterizohet nga parimet e deklarimit, prioritetit në kohë të regjistrimeve dhe të vazhdimësisë së regjistrimeve. Mos regjistrimi i veprimit juridik për një pasuri të paluajtshme në regjistrat e pasurive të paluajtshme nuk cenon vlefshmërinë e kontratës, por nuk i jep mundësinë blerësit që ta tjetërsojë atë te të tretët dhe ndërkohë mund të sjellë pasoja dhe rrezik për blerësin për faktin se shitësi në keqbesim mund të tjetërsojë përsëri sendin. Mund të blihet një pasuri e paluajtshme me siguri vetëm në rast se nga regjistrat e pasurive të paluajtshme rezulton duke u nisur nga shitësi dhe përpara tij një seri e vazhdueshme transkriptimesh/regjistrimesh.

193. Transkriptimi i titujve të pronësisë, i shërben interesit publik, sepse i lejon kujtdo të marrë të dhëna mbi aktet që transkriptohen. Pikërisht, marrja e saktë e informacionit nëpërmjet publikimit krijon siguri në qarkullimin e pasurive të paluajtshme duke mundësuar që përfituesi i të drejtave mbi sendin të jetë i garantuar për sendin që blen dhe të drejtat reale përkatëse. Në mungesë të transkriptimit ose regjistrimit në regjistrin publik palët nuk mund t'ua kundrejtojnë aktin të tretëve.

194. Sa më sipër, mund të thuhet se neni 195 i KC-së, që e ka kufizuar tagrin e disponimit të pronarit me regjistrimin paraprak të titullit të pronësisë, është me natyrë urdhëruese sepse në një kuptim të përgjithshëm garanton një interes publik, sigurinë juridike, mbron të tretët dhe parandalon konfliktet gjyqësore të pronësisë. Kjo pasi shitësi me keqbesim si pronari origjinal i regjistruar, mund ta tjetërsojë disa herë sendin e paluajtshëm te të tretët.

195. Shkelja e nenit 195 dhe tjetërsimi i pasurisë në kundërshtim me këtë dispozitë, sipas nenit 92/a të KC-së, shkakton pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik, por ajo ka natyrë parandaluese dhe nuk është e një rëndësie të tillë për nga pasojat që sjell, për tu kualifikuar si veprim i ndaluar nga ligji në kuptim të nenit 168 të KC-së. Rreziku i mosrespektimit të kësaj dispozite është që poseduesit të sendit të mos i ketë kaluar e drejta nga pronari i vërtetë dhe ky është një nga rastet tipike që shëron parashkrimi fitues me titull sipas nenit 168 të KC-së. Nëse pronari i vërtetë, që mund të dëmtohet nga kjo shkelje, brenda afatit të posedimit 10-vjeçar nuk ushtron padinë e rivendikimit dhe është neglizhent në ushtrimin e të drejtave të tij, atëherë është tërësisht e justifikuar dhe e përligjur që pronësinë ta fitojë ai që e ka poseduar dhe zhvilluar pronën qetësisht dhe pa ndërprerje brenda afatit ligjor të parashkrimit fitues. Pra veprimi juridik në shkelje të nenit 195 të KC-së, nuk është i një rëndësie të tillë sa të mos krijojë asnjë pritshmëri të ligjshme të poseduesit se mund ta fitojë pronën sipas nenit 168 të KC-së, për sa kohë nuk ka një ndalim kategorik për tjetërsimin e pasurisë në vetvete dhe nuk jemi para rastit kur sendi për nga natyra është i patransferueshëm.

196. I vetmi element që mund të shtrohet për diskutim lidhet me mirëbesimin e poseduesit, kur sendin që ka fituar dhe titulli i pronësisë së personit prej të cilit i rrjedh e drejta, nuk kanë qenë më parë të regjistruar. Sikurse u analizua në pjesën e parë të këtij vendimi njësues, mirëbesimi lidhet me anën psikike të poseduesit, i cili për shkak të një titulli të aftë për të kaluar pronësinë, nuk e ka ditur dhe nga rrethanat nuk kishte se si ta dinte se pronësia i ka kaluar nga jopronari. Mirëbesimi nuk nënkupton dijeninë e poseduesit se titulli është i përsosur në të gjitha kushtet ligjore të vlefshmërisë së tij, pasi, për shkak të prezumimit absolut se ligji konsiderohet i njohur nga të gjithë, nuk do të gjente asnjëherë zbatim neni 168. Mirëbesimi nënkupton preceptimin e arsyeshëm të poseduesit se me mbajtjen dhe posedimin e sendit prej tij, nuk po cenon të drejtat e pronarit të vërtetë.

197. Kështu, poseduesi do të konsiderohet në mirëbesim, nëse personi me të cilin ka kryer veprimin juridik, nga ana e tij, ka një titull pronësie që i buron prej pronarit origjinal të regjistruar më parë në regjistrin publik. Sipas ligjit tonë dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, e drejta e pronësisë mbi sendin e transkriptueshëm nuk kalon me regjistrimin, por për shkak të titullit. Pra në një situatë të tillë, poseduesi beson dhe nga rrethanat nuk ka pse të mos besojë, se personi nga i cili i rrjedh e drejta është bërë pronar mbi sendin, edhe pse titullin e ka të paregjistruar. Për marrjen dijeni dhe verifikimin mbi pronësinë, poseduesi duhet të tregojë kujdesin mesatar të një njeriu mesatar dhe në kushtet kur nuk ka një regjistrim tjetër në regjistrat publikë në emër të personave të tretë, nuk mund ti vendoset si barrë detyrimi për të vënë në dyshim dhe për të hamendësuar nëse pronari origjinal ka vepruar me keqbesim, duke e shitur sendin te disa subjekte njëkohësisht.

198. Në një vështrim krahasimor me Kodin Civil të Republikës së Francës, Kolegji sjell në vëmendje nenin 2272, i cili ka rregulluar parashkrimin fitues mbi sendet e paluajtshme. Në këtë dispozitë është parashikuar se "*Afati i parashkrimit për të fituar pronësinë mbi sendet e paluajtshme është 30 vjet. Megjithatë, për atë që e fiton pronësinë me mirëbesim dhe në bazë të një titulli të përshtatshëm, afati është 10 vjet.*" Në praktikën e Gjykatës së Kasacionit të Republikës Franceze është mbajtur qëndrimi se për efekt të parashkrimit fitues 10-vjeçar (me titull), poseduesi do të konsiderohet në mirëbesim mjafton që në momentin që ka fituar posedimin të besojë se sendin e ka fituar nga pronari[77]. Sipas praktikës gjyqësore dhe doktrinës franceze, titulli duhet të jetë i aftë të kalojë pronësinë, qoftë edhe nga ai që nuk është pronari[78]. Po ashtu, në praktikën e Gjykatës së Kasacionit të Republikës Franceze[79] është mbajtur qëndrimi se edhe në mungesë të regjistrimit të titullit të pronësisë, nëse ky i fundit ka qenë i aftë të kalojë pronësinë, mund të shërbejë si bazë për fitimin e pronësisë me parashkrim fitues me titull.[80]

199. Nga ana tjetër, Kolegji sjell në vëmendje parashikimin e KC-së të vitit 1929, i cili në nenin 2037 nën titullin "*Parashkrimi vehtësimtar"* parashikonte se "*Ay që me mirëbesim vehtëson një send të paluejtëshëm ose një të drejtë reale mbi nji t'atillë send me fuqinë e nji titulli* ***qi asht transkiptue rregullisht*** *dhe qi nuk asht nul për të meta forme plotëson në*

[77] Shih vendime të Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Francës, Civ 3, 18.1.1972; Bull Civ III nr. 39, 15.1.2005; Bull Civ III nr. 133)

[78] Shih vendime të Gjykatës së Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Francës (Civ III, 30.10.1972; Bull Civ III, nr. 575, datë 13.12.2000)

[79] https://www.legavox.fr/blog/maitre-anthony-bem/delai-conditions-application-prescription-acquisitive-16218.htm

[80] Vendim i Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Francës (Civ III, 31.1.1984)[80]

favorin e vet parashkrimin, me kalimin e dhjetë vjetëve çprej datës së transkiptimit".

200. Po ashtu, Kolegji sjell në vëmendje modelin e Kodit Civil të Republikës së Italisë, ku transkriptimi është element konstitutiv dhe i vlefshmërisë së veprimit juridik. Në kuptimin e titullit të përshtatshëm për kalimin e pronësisë për efekte të parashkrimit fitues me titull, në jurisprudencën e Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë[81] është pranuar se titulli duhet të jetë i transkriptuar. Në mënyrë të konsoliduar është mbajtur qëndrimi se veprimi i parashkrimit fitues me titull edhe në prezencë të të metës për mungesë të legjitimitetit, për shkak të tjetërsimit nga jopronari, kërkon gjithsesi transkripitmin në kuptimin që duke pasur parasysh substancën dhe formën e veprimit juridik, ai duhet të jetë i tillë që në mënyrë abstrakte dhe objektive, por jokonkrete të kalojë pronësinë mbi sendin, në mënyrë të tillë që fitimi i së drejtës, do të duhet të ishte verifikuar patjetër nëse tjetërsuesi do të ishte efektivisht pronari[82]

201. Në një vështrim krahasues, të këtyre modeleve ligjore, Kolegji vlerëson se, arsyeja e parashikimeve të ndryshme për sa i përket regjistrimit të sendit, lidhet me vlerën që ka ky element për vlefshmërinë e veprimit juridik në secilin sistem. Nëse regjistrimi ka efekte konstitutive për fitimin e së drejtës së pronësisë mbi sendin e paluajtshëm, mungesa e tij, nuk mund të prezumojë mirëbesimin e të tretëve, të cilëve sendi ju kalon nga jopronari, për shkak të mungesës së regjistrimit në regjistrat publikë. Në të kundërt, nëse regjistrimi ka efekte deklarative, i treti i cili e blen sendin është në mirëbesim, mjafton që personi nga i cili i kalon e drejta e pronësisë ka një titull të vlefshëm pronësie edhe pse ende të paregjistruar në regjistrat publikë.

IV. Sentencat njësuese

202. Sa më sipër u arsyetua, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në lidhje me çështjet e shtruara për njësim, arrin në këto konkluzione njësuese:

1) Me termin "veprim juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë" të përdorur në nenin 168 të Kodit Civil, do të kuptohen vetëm veprimet juridike sipas përkufizimit të dhënë në nenin 79 të Kodit Civil, duke përjashtuar nga zbatimi i kësaj dispozite, çdo titull tjetër të ndryshëm që përmban fitimin e një të drejte pronësie;

2) Nga fusha e zbatimit të nenit 168 të Kodit Civil janë të përjashtuara si rregull shkeljet që sipas këtij Kodi shkaktojnë pavlefshmëri relative të veprimit juridik;

3) Jo çdo shkelje e ligjit që shkakton pavlefshmëri absolute të veprimit juridik, përfshihet në konceptin e veprimit "të ndaluar nga ligji" sipas nenit 168 të Kodit Civil. Në këtë koncept do të përfshihen ato veprime juridike absolutisht të pavlefshme, në kundërshtim me një normë urdhëruese/ndaluese të ligjit e cila mbron një interes publik, në përputhje me kriteret e parashikuara në nenet 92 dhe 677 të Kodit Civil.

V. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes konkrete

203. Pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të gjykimit, duke u bazuar në konkluzionet e këtij vendimi njësues, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi, por me tjetër arsyetim.

204. Sikurse ka rezultuar e provuar në të dyja shkallët e gjykimit, të paditurit kanë qenë anëtarë të familjes bujqësore, të cilëve në zbatim të ligjit nr. 7501, ju është dhënë, në fshatin Sukth, Durrës, mes të tjerash edhe tokë arë prej 5 000 m², në parcelën me nr. 63/11, me AMTP nr. 684, datë 1.8.1994, me kryefamiljar të paditurin Mark Pllana. Ka rezultuar se kjo pasuri nuk është regjistruar në regjistrat përkatës publikë.

205. Midis, paditësit Demir Bakanaci dhe kryefamiljarit të familjes bujqësore, z. Mark Pllana, me datë 9.3.1998, është lidhur një kontratë qiraje, ku i padituri Mark Pllana i jep paditësit me qira, një sipërfaqe prej 4 790 m², në parcelën nr. 63/11, sipas AMTP nr. 684, datë 1.8.1994. Palët kanë deklaruar në kontratë se, kjo tokë jepet me qira me afat 30-vjeçar, kundrejt një qiraje të përgjithshme prej 500 mijë lekë, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe për të gjithë periudhën e qirasë. Përveç parashikimeve të mësipërme, në kontratën e qirasë, palët kanë parashikuar edhe një klauzolë me këtë përmbajtje: "*Palët deklarojnë se këtë kontratë 30-vjeçare e konsiderojnë edhe si kontratë shitjeje me detyrimin që, sapo të fillojë zbatimi i ligjit të shitblerjes së tokës bujqësore për këtë zonë, të përpilojnë aktin noterial të shitjes pa asnjë pagesë tjetër nga qiramarrësi, sepse vlera e sipërme e paguar prej tij si qira 30-vjeçare, është në fakt vlefta e plotë e shitjes së kësaj sipërfaqe toke*".

206. Ndryshe nga sa ka arsyetuar gjykata e apelit, Kolegji vlerëson se kontrata e lidhur midis palëve ndërgjyqëse duhet interpretuar si një veprim juridik (kontratë) që ka për qëllim kalimin e pronësisë, e simuluar në formën e një kontrate qiraje. Sipas nenit 681 të KC-së, kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin letrar të palëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para dhe pas përfundimit të kontratës. Nga ana tjetër, sipas nenit 683 të KC-së, kushtet e kontratës interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë efekt dhe jo në atë sipas të cilit nuk do të kishin ndonjë efekt.

[81] Vendim nr. 21796/2019 i Gjykatës së Kasacionit të Republikës së Italisë.

[82] https://www.notai.it/news/usucapione-dell-immobile-pervenuto-in-base-a-titolo-nullo-00028329.aspx

207. Pavarësisht titullimit që kanë vendosur palët në rastin konkret, duke e kualifikuar si kontratë qiraje fillimisht, qëllimi i vërtetë i tyre, ka qenë që të lidhin një kontratë shitjeje dhe që pala e paditur t'i kalonte pronësinë paditësit mbi sendin objekt gjykimi. Kjo rezulton nga sjellja e tyre para dhe pas lidhjes së kontratës, nga fakti i provuar në të dyja shkallët e gjykimit, se paditësi i ka parapaguar të paditurve, që në fillim të gjithë vlerën e qirasë për 30 vjet, i njëjtë me çmimin e shitjes dhe që përfaqësonte vlerën e tregut të pasurisë së paluajtshme. Nga ana tjetër, pala e paditur i ka kaluar posedimin mbi këtë send. Përpilimi i aktit noterial të shitjes mbetej vetëm një formalitet që do të përsoste kontratën e shitjes dhe do të formalizonte vullnetin tashmë të shprehur palëve për shitblerjen e sendit, pasi ky send të regjistrohej nga bashkëpronarët.

208. Sakaq, Kolegji vlerëson se, në rastin konkret, ekziston një veprim juridik që ka për qëllim kalimin e pronësisë dhe plotësohet kushti i parë që kërkon neni 168 i KC. Në vijim të këtij arsyetimi, shtrohet për zgjidhje nëse kontrata e lidhur midis palëve ndërgjyqëse përbën një veprim juridik të ndaluar nga ligji.

209. Gjykatat e apelit e ka kualifikuar këtë veprim juridik, si veprim të ndaluar nga ligji, për shkak se është kryer në mungesë të vullnetit të të gjithë bashkëpronarëve në tjetërsimin e sendit, Sipas gjykatës, ky veprim vjen në kundërshtim me nenet 200 dhe 222 të KC-së dhe sipas nenit 92/a të KC-së janë shkelur dispozita urdhëruese të ligjit. Këtu gjykata ka arsyetuar se, ndonëse parashkrimi fitues është rasti klasik që e mbulon pavlefshmërinë absolute të veprimit juridik për shkak të mungesës së formës, në rastin konkret pavlefshmëria absolute nuk lidhet me formën, por lidhet me përmbajtjen, lidhet me mungesën e shfaqjes së vullnetit të të gjithë bashkëpronarëve. Mund të ishim para rastit të parashkrimit fitues vetëm për pjesën e kryefamiljarit të familjes bujqësore dhe vetëm në rastin se pjesa e tij në këtë tokë do të ishte e veçuar. Po ashtu, gjykatat kanë vlerësuar se toka bujqësore në kohën e përfundimit të kontratës, si send i paluajtshëm, nuk ishte e aftë për t'u tjetërsuar dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve do të lindin vetëm kur të lejohej shitja e saj. Vetëm në këtë moment, toka bujqësore do të konsiderohej si send i aftë për t'u tjetërsuar.

210. Kolegji e vlerëson të pambështetur në ligj këtë arsyetim të Gjykatës së Apelit Durrës. Duke u bazuar në konkluzionet e këtij vendimi njësues, mosdhënia e pëlqimit nga të gjithë bashkëpronarët për tjetërsimin e sendit nuk e bën veprimin juridik të ndaluar nga ligji në kuptim të nenit 168 të KC-së. Vullneti i të gjithë bashkëpronarëve për tjetërsimin e një sendi në bashkëpronësi, është pjesë e përsosurisë të veprimit juridik dhe element i vlefshmërisë së tij, ku kërkohet vullneti i plotë i secilit bashkëpronar për të ushtruar lirisht tagrin e disponimit të pronës së tij. Kjo dispozitë nuk mbron një interes publik, por garanton të drejtat e pronësisë dhe interesat privatë të secilit prej bashkëpronarëve mbi sendin. Si rrjedhojë veprimi juridik i kryer në shkelje të nenit 208 të KC-së është i pavlefshëm pjesërisht për pjesën e bashkëpronarit që nuk ka dhënë pëlqimin, por nuk është një veprim i ndaluar nga ligji dhe nuk kufizon të drejtën e poseduesit me mirëbesim, që i është tjetërsuar sendi sipas një veprimi të tillë, për të fituar pronësinë sipas nenit 168 të KC-së.

211. Paditësi në rastin konkret, në cilësinë e poseduesit, ka qenë në mirëbesim në kohën e kryerjes së veprimit juridik. Ai ka besuar se sendi i kaluar me vullnetin e të gjithë bashkëpronarëve dhe nga rrethanat nuk kishte se si të besonte ndryshe, kur të gjithë e kishin shprehur vullnetin për kalimin e pronësisë në favor të paditësit. Kjo rezulton nga fakti se bashkëpronarët e tjerë, e kanë ditur dhe nuk kanë pasur kundërshtime për tjetërsimin e pasurisë. Edhe pse nuk e kanë shprehur këtë vullnet në formën e aktit noterial, me kontratën e datës 9.3.1998, dijenia e tyre rezulton nga akte të tjera të mëtejshme, konkretisht me prokurën e posaçme me akt noterial, nr. 3434/541, datë 15.8.2013, ku të padituri Mark Pllana, Nete Pllana dhe Julian Pllana kanë autorizuar të afërmin e tyre Zef Pllana që të kryejë procedurat për regjistrimin e pronës prej 4 790 m² në ZVRPP Durrës. Po ashtu, palët e paditura kanë autorizuar këtë përfaqësues, të marrë vendimin nga Këshilli i Kujdestarisë për të miturën Eriona Pllana dhe më pas të nënshkruajë aktin noterial të shitjes në favor të z. Demir Bakanaçi.

212. Po ashtu, ndryshe nga sa ka konkluduar Gjykata e Apelit Durrës, Kolegji sjell në vëmendje se ndalesa me karakter publik e mostjetërsimit të tokave bujqësore është suprimuar nga rendi juridik në vitin 1998. Kjo do të thotë se kundërligjshmëria me karakter publik në këtë rast ka rënë dhe se për rrjedhojë nuk mundet ta pamundësojë pas vitit 1998 veprimin e nenit 168 të KC-së, paragrafi i dytë i nenit 2 të ligjit nr. 7501/1991. Për rrjedhojë Kolegji konkludon se përfundimisht veprimi juridik, titulli dhe marrëdhënia juridike e tjetërsimit të tokës arë ndërmjet palëve ndërgjyqëse, plotëson kushtet ligjore të ekzistencës së një veprimi juridik të aftë për kalimin e pronësisë dhe njëkohësisht edhe të pandaluar nga ligji.

213. Një çështje që shtrohet për diskutim nga Kolegji, lidhet me faktin që toka e tjetërsuar nuk ishte e regjistruar në emër të anëtarëve të familjes bujqësore dhe kjo ishte arsyeja pse ato e kishin simuluar kontratën e shitjes, në formën e një kontrate qiraje. Për këtë shkak veprimi juridik i realizuar ndërmjet tyre është absolutisht i

pavlefshëm, sipas neneve 92/a dhe 195 të KC-së, si dhe nenit 7 të ligjit nr. 8337/1998 "Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave", sepse sendi është tjetërsuar pa qenë i regjistruar. Sërish, duke u bazuar në arsyetimin, në paragrafët 189 e vijues të këtij vendimi njësues, Kolegji vlerëson se ky fakt nuk e bën veprimin e ndaluar nga ligji. Nga ana tjetër, paditësi ka qenë në mirëbesim, sepse ka besuar se sendi i ka kaluar nga pronari/bashkëpronarët e vërtetë, të cilët kanë pasur një titull pronësie të vlefshëm, ku prona i ka kaluar nga shteti, me AMTP nr. 684, datë 1.8.1994. Ai është sjellë si pronar që prej vitit 1998 dhe nuk ka qenë shqetësuar nga të tretët dhe nga palët prej të cilëve ju ka kaluar e drejta.

214. Së fundi, Kolegji vlerëson të marrë në analizë, faktin se familja bujqësore, në rastin konkret përbëhej nga 4 anëtarë. Njëri prej tyre, znj. Eriona Pllana ka qenë e mitur, nën 14 vjeç. Veprimi juridik i tjetërsimit të pasurisë në bashkëpronësi, në lidhje me pjesën e saj, është realizuar nga kryefamiljari, z. Mark Pllana pa autorizimin e Këshillit të Kujdestarisë. Si rrjedhojë veprimi juridik vjen ndesh edhe me nenin 72 të Kodit të Familjes, i vitit 1982, në fuqi në kohën e kryerjes së veprimit juridik të shitjes. Kolegji risjell në vëmendje parashikimin e kësaj dispozite ku thuhet se "*Tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të çdo fëmije të mitur deri në moshën 18 vjeç, si dhe të gjitha veprimet që kapërcejnë kufijtë e një administrimi të thjeshtë të çdo pasurie të të miturit, mund të kryhen vetëm kur e kërkon interesi i të miturit dhe gjithmonë me lejë të Këshillit të Kujdestarisë. Veprimi juridik që është kryer pa u marrë leja e Këshillit të Kujdestarisë, mund të shpallet i pavlefshëm, me kërkesën e Këshillit të Kujdestarisë, të të miturit që ka mbushur moshën 14 vjeç, të prindit ose të kujdestarit të të miturit. Kur Këshilli i Kujdestarisë jep pëlqimin më vonë veprimi juridik nuk shpallet i pavlefshëm.*"

215. Sikurse u trajtua në pjesën teorike të këtij vendimi njësues, shkelja e kësaj dispozite e bën veprimin juridik të anulueshëm, por nuk përfshihet në kategorinë e veprimeve juridike të ndaluara nga ligji.

216. Nga ana tjetër, shtrohet për diskutim nëse në këtë rast, për shkak të kësaj rrethane është plotësuar afati i posedimit 10-vjeçar, si kusht për fitimin e së drejtës së pronësisë sipas nenit 168 të KC-së. E drejta e padisë së të miturit, sipas nenit 104/a të KC-së, fillon nga data kur i mituri ka mbushur moshën 18 vjeç. Edhe pse neni 73 i Kodit të Familjes i vitit 1982, parashikonte se këtë padi mund ta ngrejë i mituri që ka mbushur moshën 14 vjeç, KC i miratuar në vitin 1994, prevalon si ligj i mëvonshëm në kohë, sipas parimit *lex posterior derogat priori*. Kjo rrethanë ka pezulluar njëkohësisht edhe ecjen e afatit të parashkrimit fitues sipas nenit 171 të KC-së. E mitura, Eriona Pllana, ka qenë përafërsisht 10 vjeç, në kohën e kryerjes së veprimit juridik, në vitin 1998, moment nga i cili prezumohet të ketë filluar edhe posedimi mbi sendin prej paditësit (sipas nenit 308 të KC). Kjo rrethanë ka pezulluar ecjen e afatit të parashkrimit fitues deri në vitin 2006, kur e mitura Eriona Pllana ka fituar zotësinë e plotë për të vepruar dhe për të kundërshtuar veprimin juridik të tjetërsimit të pjesës së saj mbi sendin në bashkëpronësinë e familjes bujqësore, pa u marrë më parë pëlqimi i Këshillit të Kujdestarisë. Afati ka rifilluar të ecë pas vitit 2006 dhe do të përfundonte në vitin 2016. Padia e paditësit Demir Bakanaci, është ngritur më datë 7.6.2010 dhe në këtë kohë ende nuk ishte plotësuar afati 10-vjeçar i parashkrimit fitues me titull sipas nenit 168 të KC-së.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 481 dhe 485/2, të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 10-2014-2291/563, datë 7.7.2014, të Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Ky është vendim njësues i praktikës gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më datë 26.10.2022.

Kryesues: Artur Kalaja
Anëtarë: Ervin Pupe, Albana Boksi, Sandër Simoni, Gentian Medja

VENDIM
Nr. 00-2023-3406 (258), datë 7.7.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

Sokol Sadushi	kryesues;
Asim Vokshi	anëtar;
Arbena Ahmeti	anëtare;
Gentian Medja	anëtar;
Sokol Ngresi	anëtar.

Sot, më datë 7.7.2023, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike, çështjen administrative nr. 30002-00151-00-2023, që u përket palëve:

PARASHTRUES: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë

OBJEKTI: Përcaktimin e kompetencës lëndore midis Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 13, pika 5, i ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

Në çështjen administrative me palë:

PADITËS: Brunilda Gjeçi

TË PADITUR: Drejtoria Rajonale Arsimore e Qarkut Tiranë

Shkolla 9-vjeçare "Mihal Grameno" Tiranë

OBJEKTI: Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen me 12 muaj pagë për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme. Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen me 2 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit. Detyrimi i palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen me 2 muaj pagë mujore për mosrespektim të procedurës së largimit nga puna. Detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësen për vjetërsi në punë me pagën e një 15 ditëshi për çdo vit pune. Detyrimin e palës së paditur të paguajë shpenzimet gjyqësore.

BAZA LIGJORE: Nenet 12, 21, 143, 144, 145, 146, 149, 153 e 155 të Kodit të Punës, nenet 31, 32, 106, 153, 154 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtares Arbena Ahmeti, shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore publike dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Siç rezulton nga konstatimi i faktit prej gjykatave më të ulëta, paditësja ka ushtruar funksionin e mësueses pranë shkollës 9-vjeçare "Mihal Grameno" dhe fillimisht marrëdhënia juridike e punës është formalizuar me vendimin nr. 12, datë 28.10.2016, nëpërmjet të cilit paditësja Brunilda Gjeçi është emëruar "Mësuese provizore" deri në përfundim të paaftësisë së përkohshme në punë të mësueses E.K. Në kushtet kur paaftësia e përkohshme në punë e mësueses së profilit ka vijuar, paditësja është riemëruar më datë 11.9.2017 si mësuese provizore me kushtin që marrëdhënia punës do të përfundonte kur të përfundonte paaftësia e përkohshme në punë e mësueses E.K.

2. Rezulton se mësuesja e emëruar në profilin anglisht E.K. ka dalë në pension 25.5.2021. Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë, me vendimin nr. 197, datë 8.7.2021, ka vendosur të ndërpresë marrëdhënien e punës me paditësen Brunilda Gjeçi si mësuese zëvendësuese/provizore në shkollën 9-vjeçare "Mihal Grameno" Tiranë, për arsye të mbarimit të afatit provizor të kontratës. Në kontratën e punës së paditëses është bërë shënimi për përfundimin e marrëdhënies së punës më datë 21.7.2021, për shkak të përfundimit të afatit.

3. Pala paditëse ka pretenduar se largimi nga puna si mësuese pranë shkollës 9-vjeçare "Mihal Grameno" përbën zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës në referim të nenit 155 të Kodit të

Punës (në vijim "KP"). Në këto rrethana, më datë 15.12.2021 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë objekt gjykimi.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6068, datë 18.11.2022 ka vendosur:

"Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes nr. 17713/9192 regj. them, datë regjistrimi 16.12.2021. Dërgimin e çështjes nr. 17713/9192 regj. them, datë regjistrimi 16.12.2021, gjykatës kompetente që është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.".

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vlerësuar se Kolegji Civil i Gjykatës së lartë ka ndryshuar praktikën e Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2020-297, datë 24.6.2020, sipas së cilës në një çështje analoge që ka të bëjë me mosmarrëveshje të marrëdhënies së punës mes punëmarrësit, arsimtarit (mësues) me punëdhënësin, drejtorinë e shkollës dhe Zyrën Vendore Rajonale Arsimore. Në këtë vendim nga Kolegji vlerësohet se marrëdhënia e punës është në lëndën administrative, duke e vlerësuar aktin e lëvizjes paralele të mësuesit si akt administrativ. Për pasojë sipas Kolegjit Civil duke qenë se për zgjidhjen e mosmarrëveshjes zbatohet ligji i posaçëm nr. 69, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", atëherë në bazë të nenit 7, pika "ç" e ligjit nr. 49/2012, "Për gjykata administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, kompetente për gjykimin e saj është gjykata administrative. Gjykata referuar ndryshimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës që duhet të shqyrtojë mosmarrëveshjet e marrëdhënieve të punës mes mësuesve dhe drejtorive të shkollave përkatëse, si dhe drejtorive arsimore, e konsideron mosmarrëveshje administrative pasi rregullohet marrëdhënia e punës përmes një rregullimi të posaçëm ligjor (ligji nr. 69, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë").

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin e datës 31.1.2023 ka vendosur:

"*Të parashtrojë çështjen e konfliktit të kompetencave për çështjen me nr. 5363/1866 akti me palë paditëse Brunilda Gjeçi.*"

7. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vlerëson se paditësja ka referuar në kërkesëpadi edhe ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në përcaktimin e kompetencës lëndore i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes, nëse është e natyrës civile apo administrative. Pra, vetë ligji i posaçëm nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" referon si ligj të zbatueshëm dispozitat e KP-së. Pala paditëse sipas shkakut të padisë ka parashtruar se marrëdhënia e punës që pretendon se është ndërprerë i referohet kontratës pa afat sipas nenit 151/1 të KP-së pasi në vijim të dy kontratave të njëpasnjëshme, kontrata në vijim të vendimit nr. 12, datë 28.10.2016 dhe kontrata në vijim të vendimit nr. 26, datë 11.9.2017 marrëdhënia e punës ka vazhduar në mënyrë të heshtur. Pala paditëse pretendon se në zbatim të nenit 155 të KP-së, pala e paditur ka ndërprerë marrëdhënien e punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustifikuar. Në këto kushte, Gjykata e Shkallës së Parë Administrative Tiranë çmon se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, më datë 30.3.2023, pas shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me qëllim njësimin e praktikës duke shtruar për njësim pyetjen: "*Cila është gjykata kompetente që gjykon mosmarrëveshjet që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë?*"

9. Gjykata e Lartë për shkak të interesit që paraqiste njësimi, bazuar në nenin 62(a)(7) të ligjit nr. 49/2012, kërkoi paraqitjen e mendimit me shkrim nga Avokatura e Shtetit për çështjen ligjore të shtruar për njësim.

10. Avokatura e Shtetit me shkresën nr. 2815, datë 19.5.2023 ka depozituar mendimin me shkrim, në të cilin ka mbajtur qëndrimin se gjykatat kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve janë gjykatat e juridiksionit administrativ. Avokatura e Shtetit, ndër të tjera, ka parashtruar se:

- Referuar ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimit nr. 56, datë 12.11.2013, "Për procedurat e emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar" ka një rregullim të posaçëm që i përket marrëdhënies së punës së mësuesve.

- Ndërkohë lidhur me aspekte të cilat nuk janë rregulluar nga ligji nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" siç janë dëmshpërblimet që rrjedhin nga konstatimi i paligjshëm i zgjidhjes së marrëdhënies së punës çmojmë se duhet të zbatohen dispozitat e KP-së.

- Fakti që dispozitat e KP-së, zbatohen për të rregulluar zgjidhjen e problemeve që nuk i jep zgjidhje ligji i posaçëm, nuk bën kompetente gjykatën e juridiksionit të përgjithshëm, për sa kohë që marrëdhënia e punës së punonjësit ka një rregullim të posaçëm.

- Ligji nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcakton parimet bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. Qëllimi i këtij ligji është garantimi i së drejtës kushtetuese për arsimim, sipas kuadrit ligjor përkatës për funksionimin e sistemit arsimor parauniversitar. Fusha e zbatimit të këtij ligji është sistemi arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, përveç aspekteve të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së arsimit profesional, që rregullohen me ligj të veçantë. Vlen të theksohet se mësuesi ushtron një funksion publik, ku nga puna e tij përfiton i gjithë publiku, nëpërmjet arsimimit të brezave të rinj.

- Në këtë ligj në kreun IX, gjen rregullim edhe "Statusi i personelit mësimor", duke gjetur rregullim të posaçëm edhe emërimi, shkarkimi i drejtorit të institucionit arsimor, dhe mësuesit, kualifikimi, pranimi dhe largimi nga puna i mësuesit.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

A. Mbi nisjen e procedurës së gjykimit njësues

11. Paraprakisht Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) çmon të nevojshme të sqarojë se më datë 20.3.2023 në Gjykatën e Lartë u regjistrua parashtresa e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për përcaktimin e kompetencës lëndore në rastin objekt gjykimi.

12. Kolegji, më datë 30.3.2023, planifikoi për shqyrtim në dhomë këshillimi çështjen nr. 30002-00151-00-2023 regjistri themeltar, datë regjistrimi 20.3.2023. Kolegji konstatoi se për sa i përket gjykatës kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve të punësimit për mësuesit, vihen re praktika të ndryshme gjyqësore, në lidhje me faktin nëse gjykimi i tyre i përket gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm apo gjykatave administrative.

13. Kolegji ka identifikuar se në vendimet nr. 31003-01255-00-2018, datë 5.6.2018 dhe nr. 00-2021-718 datë 27.5.2021, ka mbajtur qëndrimin se mosmarrëveshjet mbi zgjidhjen e marrëdhënies së punës të mësuesit përbëjnë mosmarrëveshje civile, të cilat rregullohen nga dispozitat e KP-së, pasi sipas ligjit nr. 39/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", marrëdhëniet e punës në administratën publike, në gjykatë ose në prokurori, të cilat bazohen në KP, janë përjashtuar nga kompetenca lëndore e gjykatave administrative nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji. Ligji i posaçëm nr. 69, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", (në vijim "ligji 69/2012") nuk rregullon marrëdhënien në kuptim të nenit 7, shkronja "ç" të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Fakti që parashikohet një pikë e dispozitës e cila përcakton se si emërohet një mësues nuk përbën dhe nuk ka kuptimin e ligjit të posaçëm sipas dispozitës së sipërcituar. Në kuptim të nenit 7, shkronja "ç", të ligjit 49/2012, i ndryshuar, do të kuptohet si ligj i posaçëm vetëm ai ligj i cili bënë një rregullim të qartë të marrëdhënies së punës, duke filluar nga mënyra e përcaktimi të kritereve të punësimit, rekrutimit, lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, të drejtat dhe detyrimet e punonjësit, përfitimet përkatëse, masat disiplinore, të drejtën e ankimit dhe organin përkatës i cili ushtron këtë funksion, afatet dhe mënyrën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, si dhe çdo masë apo kriter tjetër që shërben për rregullimin e kësaj marrëdhënie pune. Pra, ky ligj do të quhet i posaçëm në kuptim të nenit 7/ç, të ligjit 49/2012 dhe që nuk referon në KP për rregullime të tjera apo për mënyrën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës. Ligji nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", parashikon në nenin 60, pika 2, shkronja "a", se *"... Drejtori i institucionit publik largon mësuesit nga institucioni për a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore*". Pra, po vetë ligji i posaçëm nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", referon si ligj të zbatueshëm dispozitat e KP-së.

14. Ndërsa në vendimet nr. 00-2022-1806, datë 21.7.2022 dhe nr. 00-2023-324, datë 7.2.2023, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrimin se në kuptim të nenit 57, pika 4, të ligjit nr. 69/2012, si dhe aktit nënligjor të dalë në zbatim të tij, në rastin konkret, udhëzimi nr. 38, datë 6.10.2015, i ministrit të Arsimit parashikon një procedurë të hollësishme mbi emërimin dhe, në veçanti, për largimin nga puna të mësuesve, rregulla të cilat duhet të respektohen, si nga punëdhënësi, ashtu edhe nga punëmarrësi. Marrëdhënia e punës me mësuesit gjen rregullim nga ligji i posaçëm nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe jo nga KP-ja, pasi në ligjin e posaçëm parashikohet, procedura e rekrutimit të mësuesve, e cila kalon në disa faza, ku, midis të tjerave, parashikohet edhe rruga e ankimit për çdo fazë konkurrimi.

15. Gjithashtu, Kolegji konstaton se në Gjykatën e Lartë, në lidhje me objektin e mësipërm, janë paraqitur një numër çështjesh mbi mosmarrëveshjen për kompetencë ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatave administrative. Rezulton se midis këtyre gjykatave ka qëndrime të ndryshme se cila është gjykata që ka kompetencën lëndore për gjykimin e çështjeve që lidhen me mosmarrëveshjet që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë.

16. Në lidhje me sa më sipër, në referim të nenit 62(a)(2) të ligjit nr. 49/2012, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, më datë 30.3.2023, në dhomë këshillimi, vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, duke shtruar për njësim pyetjen:

Cila është gjykata kompetente që gjykon mosmarrëveshjet që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë?

B. Ligji i zbatueshëm

17. Neni 7(ç) i ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (*i ndryshuar*), parashikon se:

"*Gjykatat administrative janë kompetente, për:*

[...]

ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Përjashtohen nga ky rregull punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës;

[...]"

18. Neni 13 i ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (*i ndryshuar*) parashikon:

"1. Moskompetenca lëndore dhe funksionale ngrihet edhe kryesisht në çdo gjendje e shkallë të shqyrtimit.

2. Moskompetenca tokësore mund të ngrihet ose kundërshtohet nga palët vetëm para se të ketë filluar shqyrtimi gjyqësor i provave.

3. Gjykata shpall me vendim moskompetencën e saj për shkaqet e parashikuara në këtë nen dhe urdhëron dërgimin e akteve gjykatës kompetente. Vendimi për shpalljen e moskompetencës dhe vendimi për rrëzimin e kërkesës për shpalljen e moskompetencës ankimohen së bashku me vendimin përfundimtar.

4. Ka mosmarrëveshje për kompetencën, kur dy ose më shumë gjykata, në të njëjtën kohë, marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën çështje administrative.

5. Gjykata, me kërkesë të palëve ose kryesisht, ngre çështjen e mosmarrëveshjes me vendim të arsyetuar, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj. Gjykata, që ka dhënë vendimin, njofton menjëherë gjykatën në mosmarrëveshje. Vendimi për ngritjen e mosmarrëveshjes, së bashku me aktet, i dërgohet Gjykatës së Lartë brenda 5 ditëve.

6. Mosmarrëveshjet zgjidhen nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i cili vendos në dhomë këshillimi me 3 gjyqtarë brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve. Vendimi u njoftohet menjëherë gjykatave në mosmarrëveshje dhe palëve."

19. Neni 61(1) i Kodit të Procedurës Civile (në vijim "KPC"), parashikon:

"*1. Gjykata, kur konstaton se nuk është kompetente për shkak të lëndës, funksionit ose të kompetencës tokësore ekskluzive, sipas neneve 45 dhe 46, të këtij Kodi, kryesisht ose me kërkesë të palëve, vendos moskompetencën e saj dhe i dërgon aktet në gjykatën kompetente.*"

20. Neni 64 i KPC-së, parashikon:

"Çështja që dërgohet për shqyrtim nga një gjykatë në një gjykatë tjetër të së njëjtës kategori ose nga një gjykatë më e lartë, duhet të pranohet dhe të shqyrtohet nga gjykata së cilës i dërgohet.

Konfliktet për kompetencë midis gjykatave nuk lejohen, por gjykata ka të drejtë t'ia parashtrojë qëndrimin e saj Gjykatës së Lartë, e cila vendos për rregullimin e kompetencës në dhomë këshillimi, me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë.

Gjykata e Lartë shprehet me vendim të arsyetuar jo më vonë se 30 ditë nga momenti i depozitimit të parashtresës.

Gjykata e Lartë në vendimin e saj për rregullimin e kompetencës jep udhëzimet e nevojshme për procesin gjyqësor të zhvilluar dhe për vazhdimin e tij nga gjykata që deklarohet kompetente."

21. Neni 60 i ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" (*i ndryshuar*), i titulluar "Pranimi dhe largimi nga puna i mësuesit" që bën pjesë në kreun IX të këtij ligji, i cili titullohet "Statusi i personelit mësimor", parashikon:

"1. Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin "Mësues për Shqipërinë". Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune, si dhe administrimi i portalit "Mësues për Shqipërinë" përcaktohen me udhëzim të ministrit.

2. Drejtori i institucionit publik largon mësuesin nga institucioni për:

a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore;

b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion;

c) mosarritje të nxënësve, të përcaktuara në mënyrë objektive, si testimet e drejtorisë së institucionit ose të njësisë arsimore vendore, rezultatet në provimet kombëtare dhe vlerësimi i institucionit përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.

3. Drejtori i institucionit arsimor publik fillon procedurën e largimit të mësuesit edhe me kërkesë të prindërve dhe vendos largimin pasi konsultohet me përfaqësues të prindërve të institucionit arsimor, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit."

22. Udhëzimi nr. 13, datë 22.5.2019, "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë", në kreun 9, të titulluar "Pezullimi dhe largimi nga puna i mësuesit", parashikon:

"1. Drejtori i shkollës merr masën e pezullimit ndaj mësuesit kur gjykata vendos ndaj mësuesit masë të sigurimit personal deri në vendimin e formës së prerë.

2. Mësuesit të pezulluar i ndërpriten marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit.

3. Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit përcaktohen në aktet e tjera nënligjore në fuqi.

4. Largimi i mësuesit nga puna bëhet sipas akteve nënligjore në fuqi.".

23. Udhëzimi nr. 12, datë 10.6.2021, "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë", i cili ka shfuqizuar udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, (hyrë në fuqi pas datës 16.6.2021), në kreun 10, të titulluar "Pezullimi dhe largimi nga puna i mësuesit" parashikon:

"1. Drejtori i IAP-së merr masën e pezullimit ndaj mësuesit kur ndaj tij gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal.

2. Mësuesit të pezulluar i ndërpriten marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit. Masa e pezullimit përfundon me shuarjen e shkaqeve të pezullimit ose të largimit nga detyra. Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit përcaktohen në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Mësuesi largohet nga detyra:

a) nëse në fund të procesit gjyqësor dënohet nga gjykata me vendim të formë së prerë me burgim për kryerjen e një vepre penale;

b) nëse në fund të procesit gjyqësor dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve.

c) nëse është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që lidhet me institucionet arsimore parauniversitare.

4. Largimi i mësuesit nga puna bëhet sipas procedurave të Kodit të Punës dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi."

24. Kreu 11 i udhëzimit të mësipërm nr. 12, datë 10.6.2021, i titulluar "Ankimi", parashikon se:

"*1. Çdo kandidat ka të drejtën e ankimit për secilën prej fazave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionin e mësuesit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.*

2. Ankimi i kandidatit protokollohet në institucionin ku bëhet ankimi menjëherë pas shpalljes së vendimeve të komisionit/ve dhe jo më vonë se 3 (tri) ditëpunë pas shpalljes së tyre.

3. Ankimi shqyrtohet nga institucioni në bashkëpunim me komisionin përkatës brenda 5 (pesë) ditëve pune.

4. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i njohur ankuesit me shkrim nga institucioni.

5. Vendimet e institucioneve ankohen tek organi epror sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi."

C. Analiza e çështjes së shtruar për njësim

25. Kolegji, referuar jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, vlerëson se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e funksioneve të saj çdo gjykate. Kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedurale e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejt *(shih vendimin nr. 917, datë 11.5.2017, nr. 00-2022- 3905, datë 15.*12.2022; *nr. 00-2023-2318, datë* 22.5.2023 *të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).*

26. Kompetenca lëndore është një parakusht procedural, i cili përcakton konceptin e gjykatës së krijuar me ligj. "Gjykata e krijuar me ligj" është pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar edhe nga neni 6(1) i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim KEDNJ). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim "GJEDNJ") në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka trajtuar kuptimin e "gjykatës së krijuar me ligj", duke përcaktuar se në kuadër të procesit të rregullt ligjor gjykatat gjithmonë duhet të jenë të krijuara me ligj. Shprehja "e caktuar me ligj" përfshin bazën ligjore për ekzistencën e gjykatës, pajtueshmërinë e veprimtarisë së gjykatës me normat e veçanta që rregullojnë veprimtarinë e saj, si dhe përbërjen (kompozimin) e gjykatës në çdo rast që ajo merr në shqyrtim. *(Shih GJEDNJ Posokhov v Russia, nr. aplikimi 63486/00, datë 4.6.2003, paragrafi 39; Fatullayev v Azerbaijan nr. aplikimi 40984/07, datë 4.10.2010, paragrafi 144.)* Kjo shprehje pasqyron parimin e shtetit të së drejtës që është pjesë e pandarë e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut parashikuar nga KEDNJ-ja dhe protokollet e saj. *(shih GJEDNJ Jorgic v Germany nr. aplikimi 74613/01, datë 12.7.2007, paragrafi i 64; Richert v Poland, nr. aplikimi 54809/07, datë 25.1.2012, paragrafi 41).* Një organ i pa krijuar me ligj, do të privohej nga legjitimiteti i kërkuar në një shoqëri demokratike për të dëgjuar ankesat e individëve. *(Shih GJEDNJ Lavents v Latvia nr. aplikimi 58422/00 datë 28.2.2003 paragrafi 114; Gorgiladze v Georgia; nr. aplikimi 4313/04 datë 20.10.2009*

paragrafi 67; Kontalexis v Greece nr. aplikimi 59000/08 datë 21. 11. 2011 paragrafi 38).

27. Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese evropiane, ndër vite, kanë përpunuar disa kritere themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash, gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete *(shih vendimin nr. 31, datë 5.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese)* dhe ky është rregulli i përgjithshëm se si një gjykatë e zakonshme merr juridiksion dhe kompetencë për çështjet.

28. Kolegji vlerëson thelbësore të evidentojë se në kuptim të nenit 6(1) të KEDNJ-së, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, në termin "ligj" përfshihet jo vetëm legjislacioni që përcakton krijimin dhe funksionimin (kompetencën) e organeve gjyqësore, por edhe çdo dispozitë ligjore të legjislacionit të brendshëm që, nëse shkelet, do ta shndërronte pjesëmarrjen e një ose më shumë gjyqtarëve në shqyrtimin e një çështje konkrete në një pjesëmarrje të paligjshme. *(Shih GJEDNJ Pandjikidze and others v Georgia nr. aplikimi 30323/02, datë 27.1.2010, paragrafi 104).* Gjithashtu edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese mbi termin "ligj" të përdorur në Kushtetutë dhe në përgjithësi në legjislacion, ka mbajtur qëndrimin se një parashikim i tillë nënkupton një interpretim të gjerë, duke mos përjashtuar, në varësi të formulimit të përdorur, aktet nënligjore. Kjo ka të bëjë me rastet që u përkasin rregullimeve të përgjithshme, që nënkuptojnë përdorimin e termit "ligj", në kuptim të legjislacionit ose të së drejtës, dhe jo të aktit të organit ligjvënës (Kuvendit). Për të përcaktuar nëse ndodhemi para njërit ose tjetrit variant, rëndësi ka të sqarohet konteksti, nga i cili del qëllimi i normës. Nisur nga konteksti, termi "ligj", në nenin 17 të Kushtetutës, nuk ka të njëjtin kuptim me atë të përdorur në nenin 18, *barazia para ligjit*. Kjo e fundit identifikohet me të drejtën në përgjithësi, ndërsa e para të referon në kompetencën e një organi të vetëm. Konteksti, në të cilën është përdorur togfjalëshi "vetëm me ligj"nuk lejon të bëhet interpretim i zgjeruar. Kjo edhe për faktin se një interpretim i tillë i normave kushtetuese mund të bëhet vetëm në aspektin pozitiv, kur ky interpretim shkon në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe jo e kundërta, si në rastin në shqyrtim. Këtë qëndrim ka mbajtur dhe GJEDNJ-në në praktikën e saj *(shih vendimi Delcourt kundër Belgjikës, datë 17.1.1970).* Koncepti i zgjeruar i termit "ligj" që përdoret në doktrinë, nuk vlen për nenin 17 të Kushtetutës. Togfjalëshi përjashtues "vetëm me ligj", i përdorur në nenet 11(3) dhe 17 të Kushtetutës, ka të bëjë me kufizime të të drejtave dhe ka kuptim të njëjtë, atë të interpretimit të ngushtë, në dallim nga dispozitat e tjera ku termi "ligj" mund të kuptohet më gjerë. Në këtë përfundim, veç sa u përmend, arrihet edhe duke iu referuar fjalës *vetëm* që përmendin nenet 11(3) e 17 të Kushtetutës. Përdorimi i kësaj fjale nuk është i rastit, por ai është bërë për të treguar se kufizime të tilla nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit. Gjykata Kushtetuese ka çmuar se rregullimi i parashikuar në nenin 17 për kufizimin e të drejtave dhe lirive vetëm me ligj, ka të bëjë edhe me përcaktimin e kompetencës së një organi konkret që në këtë rast është vetëm Kuvendi. Një shprehje e tillë të referon në kompetencën e organit ligjvënës dhe nxjerrja e akteve të tjera për të rregulluar marrëdhënie të tilla, cenon kompetencat e këtij organi *(shih vendimin nr. 20, datë 11.7.2006, vendim nr. 7 datë 27.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese).*

29. Duke marrë në konsideratë standardet e vendosura nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese mbi interpretimin e normës, si dhe bazuar në interpretimin teleologjik dhe logjik të saj, Kolegji çmon se terminologjia e përdorur në nenin 7, shkronja "ç" të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar ia ka njohur ligjit, në kuptimin e gjerë të tij, të drejtën e parashikimit të dispozitave të posaçme për rregullimin e marrëdhënies juridike. Pra, formulimi i nenit 7, shkronja "ç" të ligjit nr. 49/2012 ka lidhur kompetencën e gjykatave administrative me kushtin e rregullimit të marrëdhënies së punës me ligj organik. Konkretisht, në këtë dispozitë ligjore parashikohet: "*ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Përjashtohen nga ky rregull punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës.".* Vlen të theksohet se pas ndryshimit të vitit 2017, edhe neni 17(1)(g) do të shihet i lidhur me nenin 7(ç) të ligjit nr.49/2012 dhe do të interpretohet sipas kuptimit të këtij neni.

30. Në vijim, pas trajtimit të bërë për kuptimin e termit "ligj" për efekt të parashikimit që bëhet në nenin 7(ç) të ligjit nr. 49/2012, lidhur me rastin objekt gjykimi, Kolegji vlerëson të nevojshme të analizojë natyrën e ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të udhëzimit nr. 13, datë 22.5.2019, "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë", si edhe të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021, "*Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë*", i cili ka shfuqizuar udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019 (hyrë në fuqi pas datës 16.6.2021), për sa i përket klasifikimit të marrëdhënies së punësimit të mësuesve

si "nëpunës shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm".

31. Neni 7(ç) i ligjit nr. 49/2012 përbëhet nga dy fjali, ku e para vendos rregullin e zbatueshëm dhe e dyta përjashtimin nga ky rregull. Sipas fjalisë së parë të këtij neni, rregulli është se në kompetencën lëndore të gjykatave administrative janë mosmarrëveshjet që lindin në fushën e marrëdhënieve të punës, të:

1) nëpunësve civilë (*rregulluar sipas ligjit nr. 153/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar*);

2) nëpunësve civilë gjyqësorë (*rregulluar me ligjin nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar*);

3) nëpunësit civil të prokurorisë (*rregulluar me ligjin nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar*);

4) nëpunësit shtetërorë që sipas ligjit organik kanë rregullim të posaçëm.

32. Fjalia e dytë përjashton nga rregulli i mësipërm kategorinë e mëposhtme:

1) punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose në prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në KP.

33. Kolegji vëren se në rastin e dispozitave, si ajo e nenit 7(ç), të ligjit nr. 49/2012, për identifikimin e rregullit të së drejtës që ato përmbajnë, zbatohet teknika e interpretimit e quajtur "Ejusdem Generis" (*të të njëjtit lloj dhe natyrë*). Sipas kësaj teknike interpretimi, kur fjalë apo fraza të përgjithshme pasojnë një renditje të dy apo më shumë personave, sendeve apo rrethanave specifike, ato (fjalët e përgjithshme) gjejnë zbatim vetëm për personat, sendet apo rrethanat që përfshihen në të njëjtin lloj të përgjithshëm apo klasë me ato që përmenden specifikisht. Pra, për të kuptuar se nga se përbëhet bashkësia e *"nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë rregullim të posaçëm"*, nevojitet të gjendet e përbashkëta e tri kategorive specifike të përmendura nga dispozita që janë "nëpunësit civilë", "nëpunësit civilë gjyqësorë" dhe "nëpunësit civilë të prokurorisë".

34. Një nga të përbashkëtat e marrëdhënies së punës të kategorive "nëpunës civil", "nëpunës civil gjyqësor" dhe "nëpunës civil të prokurorisë" është se në të tria rastet ka një ligj organik të veçantë që rregullon marrëdhënien e tyre të punës, në mënyrë më shumë apo më pak të detajuar, si dhe parashikimin nga këto ligje të rregullimit me akte nënligjore të aspekteve të veçanta të këtyre marrëdhënieve. Pra, e përbashkëta që i vendos të tri këto kategori në një bashkësi, është rregullimi i aspekteve kryesore të marrëdhënies së tyre të punës ekskluzivisht me ligj të veçantë dhe në vijim rregullimi i detajuar i saj me akte nënligjore, të dala në bazë dhe për zbatimin e këtyre ligjeve. Për këtë mjafton të shihet formulimi i neneve 19(9), 22(6), 23(5), 24(5), 25(5), 26(9), 28(6), 48(7), 50(9), 56(5), 59(10) etj., të ligjit nr. 153/2013 "Për nëpunësin civil" (*i ndryshuar*); neneve 34(9), 41(2), 42(10), 43(3), 44(3), 54(7), 57(13), 58(6) etj., të ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; apo neneve 59(2), 73(9), 74(7), 77(14), 78(6), 83(4), 85(11), 86(7), 88(4), 102 etj., të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Dispozitat e mësipërme i kanë deleguar organeve të caktuara të drejtën për rregullimin e detajuar të aspekteve me rëndësi për emërimin, ecurinë në punë, transferimin apo lirimin nga detyra të kategorive të ndryshme të nëpunësve sipas ligjeve të veçanta. Pra, rregullimi i marrëdhënies së tyre të punës nuk bëhet vetëm nga ligji, por edhe nga aktet nënligjore, të cilat së bashku përbëjnë kuadrin ligjor të rregullimit të marrëdhënies së punës.

35. Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji vlerëson se do të konsiderohen marrëdhënie juridike të rregulluara me ligj organik të posaçëm edhe rastet kur përveç rregullimit pjesor të lëndës me ligj, ky i fundit në zbatim të nenit 118 të Kushtetutës autorizon nxjerrjen e akteve nënligjore që rregullojnë në mënyrë më të detajuar marrëdhënien e punës, duke përcaktuar organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte nënligjore. Ky arsyetim gjen zbatim për sa kohë ligjvënësi (ligji nr. 49/2012) nuk e ka kushtëzuar rregullimin e posaçëm të marrëdhënies së punës "vetëm me ligj".

36. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë për nxjerrjen e akteve nënligjore, në nenin 118 përcakton: *"1. Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë 2. Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte. 3. Organi i autorizuar me ligj për të nxjerrë akte nënligjore, siç specifikohet në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund t'ia delegojë kompetencën e tij një organi tjetër.* Kolegji vlerëson se neni 118 i Kushtetutës vendos disa kritere, të cilat, nga njëra anë, e detyrojnë ligjvënësin t'u përmbahet atyre në mënyrë rigoroze dhe, nga ana tjetër, orientojnë dhe kufizojnë pushtetin normativ të organeve të tjera shtetërore në nxjerrjen e akteve nënligjore. Kuvendi, nëse nëpërmjet ligjit autorizon nxjerrjen e akteve nënligjore, duhet të përcaktojë organin kompetent, çështjet që duhen rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte.

37. Konkretisht, neni 60 i ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", ia ka deleguar përcaktimin e procedurave të detajuara për konkurrimin, vlerësimin, si dhe largimin nga detyra të mësuesit, ministrit, duke i njohur këtij të fundit të drejtën për të nxjerrë akte nënligjore (udhëzime).

Kolegji çmon se ajo është një dispozitë deleguese, e cila respekton rezervën ligjore relative, si dhe kriteret për nxjerrjen e akteve nënligjore, të sanksionuara në nenin 118 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë ligjore të titulluar *"Pranimi dhe largimi nga puna i mësuesit", parashikohet: "1. Në institucionin arsimor publik, për një vend të lirë pune, mësuesi emërohet nga drejtori i institucionit arsimor, me konkurrim të hapur. Në komisionet e vlerësimit marrin pjesë përfaqësues të prindërve. Procedurat e konkurrimit dhe vlerësimit përcaktohen me udhëzim të ministrit. 2. Drejtori i institucionit publik largon mësuesin nga institucioni për: a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore; b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion; c) mosarritje të nxënësve, të përcaktuara në mënyrë objektive, si testimet e drejtorisë së institucionit ose të njësisë arsimore vendore, rezultatet në provimet kombëtare dhe vlerësimi i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit. 3. Drejtori i institucionit arsimor publik fillon procedurën e largimit të mësuesit edhe me kërkesë të prindërve dhe vendos largimin pasi konsultohet me përfaqësues të prindërve të institucionit arsimor, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit."*. Pra, neni 60 i ligjit nr. 69/2012 ka autorizuar nxjerrjen e akteve nënligjore, ka përcaktuar organin kompetent, si dhe çështjet specifike që duhen rregulluar mbi bazën e parimeve kryesore për emërimin dhe largimin nga detyra të mësuesve.

38. Për sa më sipër del në pah qëllimi i ligjvënësit për ta deleguar me akte nënligjore rregullimin e procedurës së pranimit, emërimit, largimit apo lëvizjes paralele të mësuesve, por edhe të procedurës që subjektet duhet të ndjekin pranë këtij organi në sistemin arsimor parauniversitar. Në respektim të këtij delegimi, ministri i Arsimit dhe Sportit ka nxjerrë udhëzimin nr. 38, datë 6.10.2015, "*Procedurat e lëvizjes paralele, emërimit, dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar"* dhe në vijim, udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, "*Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë"* (që shfuqizon udhëzimin nr. 38, datë 6.10.2015), si dhe udhëzimin nr. 12, datë 10.6.2021, "*Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë*", i cili ka shfuqizuar udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, (hyrë në fuqi pas datës 16.6.2021).

39. Kolegji, duke e analizuar dhe në këndvështrimin e interpretimin evolutiv, vlerëson se udhëzimi nr. 38, datë 6.10.2015, të ministrit të Arsimit, *"Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar"*, përcaktonte rregulla të hollësishme si për emërimin ashtu edhe për largimin nga puna të mësuesve. Në pikën 1, paragrafi 2, dhe 4, parashikonte se, *"[...] 2. Në institucionin arsimor publik, për një vend të lirë pune, mësuesi emërohet nga drejtori i institucionit arsimor, me konkurrim të hapur. [...] 4. Kandidatët e interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit marrin pjesë në konkurrimin, i cili zhvillohet në tri faza: a. Konkurrim me dosje. b. Konkurrim nëpërmjet testimit "Mësues për Shqipërinë". c. Zgjedhje e vendit të punës"*. Pika 6 e titulluar "*Ankimimi"*, parashikonte se "*Çdo kandidat ka të drejtën të ankimojë vendimet e komisionit në secilën prej procedurave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionin e mësuesit. Ankimimi i kandidatit protokollohet në njësinë arsimore vendore brenda tri ditëve pune nga shpallja e akteve të komisionit. Ankimimet shqyrtohen nga drejtuesi i njësisë arsimore vendore, në bashkëpunim me komisionin përkatës, brenda tri ditëve pune. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i njohur ankimuesit me shkrim nga njësia arsimore vendore. Vendimi i njësisë arsimore mund të ankimohet në MAS"*. Gjithashtu, udhëzimi në pikën 8, paragrafët 1 dhe 4, shkronja "j" të tij *"Pezullimi dhe largimi i mësuesit nga puna",* parashikonte se*: "1. Drejtori i institucionit merr masën e pezullimit ndaj mësuesit, kur ndaj mësuesit zhvillohet një proces penal dhe/ose administrativ. 4. Drejtori i institucionit arsimor fillon procedurat disiplinore të largimit të mësuesit nga institucioni publik i arsimit parauniversitar në rastet e mëposhtme: j) Ka ankim me shkrim nga prindër të nxënësve të atij institucioni."*.

40. Në vijim, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka nxjerrë udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë" (udhëzimi në fuqi në kohën e lindjes së mosmarrëveshjes), i cili në kreun 10, pika 4 ka shfuqizuar udhëzimin nr. 38, datë 6.10.2015, të ministrit të Arsimit, *"Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar"*. Megjithatë, vihet re se sërish udhëzimi i ri përmban detajime dhe procedura të hollësishme lidhur me rregullimin e marrëdhënies së punës së mësuesit. Në këtë udhëzim parashikohen procedurat e pranimit, të emërimit në një vend të lirë pune dhe të lëvizjes paralele të mësuesit. Në kreun 1, pikat 2 dhe 3, përcaktohet se: "*Shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve për mësuesit dhe pranimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit "Mësues për Shqipërinë". 3. Procedurat udhëhiqen nga parimet e ligjshmërisë e të përgjegjshmërisë, si dhe nga vlerat e profesionalizmit, transparencës, meritës, së drejtës për zgjedhjen e institucionit arsimor, barazisë dhe interesit më të lartë të nxënësve."* Në vijim, udhëzimi nr. 13, datë 22.5.2019 përmban në kreun 2 një detajim të hollësishëm të procedurës së konkurrimit, e cila zhvillohet me dy faza, vlerësimi me dosje dhe testimi i informatizuar. Drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar krijojnë komisione të posaçme për vlerësimin e dosjeve të kandidatëve sipas parashikimeve në kreun 6. Udhëzimi nr. 13, datë 22.5.2019 përmban një procedurë të hollësishme edhe për lëvizjen paralele të mësuesve, ku dhe për këtë proces parashikon ngritjen e komisioneve të posaçme, konkretisht komisionin e

vlerësimit të dosjeve të lëvizjes paralele, sipas përcaktimeve të kreut 7. Gjithashtu, udhëzimi parashikon një shkallë ankimi administrativ në kreun 8, i cili përcakton: *"1. Çdo kandidat ka të drejtën e ankimit për vendimet e komisionit në secilën prej procedurave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionin e mësuesit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. 2. Ankimi i kandidatit protokollohet në drejtorinë e institucionit ku bëhet ankimi. Menjëherë pas shpalljes së vendimeve të komisionit/ve dhe jo më vonë se 3 (tri) ditë pune pas shpalljes së tyre. 3. Ankimi/et shqyrtohen nga institucioni në bashkëpunim me komisionin përkatës brenda 5 (pesë) ditëve pune. 4. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit, i bëhet i njohur ankuesit me shkrim nga institucioni. 5. Vendimet e institucioneve ankimohen tek organi epror, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi".* Ndërsa në kreun 9 parashikohet "Pezullimi dhe largimi nga puna i mësuesit", si vijon: *"1. Drejtori i shkollës merr masën e pezullimit ndaj mësuesit kur gjykata vendos ndaj mësuesit masë të sigurimit personal deri në vendimin e formës së prerë. 2. Mësuesit të pezulluar i ndërpriten marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit 3. Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit përcaktohen në aktet e tjera nënligjore në fuqi. 4. Largimi i mësuesit nga puna bëhet sipas akteve nënligjore në fuqi."*

41. Kolegji vlerëson se marrëdhënia e punësimit të mësuesve ka qenë objekt i ndryshimeve të shpeshta të bëra me akte nënligjore, ku nëpërmjet udhëzimeve të reja janë shfuqizuar apo ndryshuar udhëzimet e mëparshme. Në këto kushte, udhëzimi nr. 12, datë 10.6.2021, "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë" ka shfuqizuar udhëzimin nr. 13, datë 22.5.2019, sipërcituar. Në tërësinë e tij ky udhëzim përmban të njëjtat etapa, faza dhe procedura, si udhëzimet e mëparshme, por ajo që vihet re është një detajim dhe shtimi i procedurave mbi konkurrimin, komisionet e vlerësimit, administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë", procedurën e emërimit në detyrë të mësuesit, lëvizjen paralele etj. Vlen për t'u theksuar rregullimi që i bëhet procedures së pezullimit dhe largimit nga detyra dhe së drejtës së ankimit në kreun 10 dhe 11 të udhëzimit nr. 12, datë 10.6.2021, ku parashikohet se *"1. Drejtori i IAP-së merr masën e pezullimit ndaj mësuesit kur ndaj tij gjykata ka vendosur masat e sigurimit personal. 2. Mësuesit të pezulluar i ndërpriten marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit. Masa e pezullimit përfundon me shuarjen e shkaqeve të pezullimit ose të largimit nga detyra. Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit përcaktohen në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi. 3. Mësuesi largohet nga detyra: a) Nëse në fund të procesit gjyqësor dënohet nga gjykata me vendim të formë së prerë me burgim për kryerjen e një vepre penale; b) Nëse në fund të procesit gjyqësor dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve. c) Nëse është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale që lidhet me institucionet arsimore parauniversitare. 4. Largimi i mësuesit nga puna bëhet sipas procedurave të KP-së dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi".* Kreu 11 "*Ankimi", "1. Çdo kandidat ka të drejtën e ankimit për secilën prej fazave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionin e mësuesit sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. 2. Ankimi i kandidatit protokollohet në institucionin ku bëhet ankimi menjëherë pas shpalljes së vendimeve të komisionit/ve dhe jo më vonë se 3 (tri) ditë pune pas shpalljes së tyre. 3. Ankimi shqyrtohet nga institucioni në bashkëpunim me komisionin përkatës brenda 5 (pesë) ditëve pune. 4. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit i bëhet i njohur ankuesit me shkrim nga institucioni. 5. Vendimet e institucioneve ankohen tek organi epror sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi."*

42. Kolegji vlerëson se në kuptim të nenit 57, pika 4, të ligjit nr. 69/2012, si dhe aktit nënligjor të dalë në zbatim të tij, në rastin konkret, udhëzimit nr. 13, datë 22.5.2019, por edhe atij pasardhës me nr. 12, datë 10.6.2021 të ministrit të Arsimit, janë bërë parashikime të hollësishme të procedurës mbi pranimin, emërimin, lëvizjen paralele dhe largimin nga puna të mësuesve, rregulla të cilat duhet të respektohen, si nga punëdhënësi, ashtu edhe nga punëmarrësi në sektorin publik. Përpara se të ushtrojnë profesionin e mësuesit, personat e interesuar duhet që paraprakisht të kenë kryer me sukses praktikën profesionale, të kenë kaluar në provimin e shtetit dhe në vijim të futen në konkurrimin e hapur, i cili kalon në tri faza, ku është parashikuar edhe procedura e ankimit për çdo fazë të konkurrimit. Ndërsa në dispozitat vijuese të ligjit përcaktohet mënyra e përfundimit të marrëdhënieve të punës së mësuesit.

43. Kolegji thekson se për sa kohë, për çdo procedurë e fazë konkurrimi parashikohet e drejta e ankimit administrativ, rrjedhimisht edhe padia në procesin gjyqësor do të duhet të merret në shqyrtim nga gjykata administrative, e cila do të vlerësojë ligjshmërinë e veprimeve/mosveprimeve të organit publik. Ky qëndrim është mbajtur, si nga Kolegji Civil, ashtu dhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, të cilët në mënyrë konsistente kanë arsyetuar se në rastet e kundërshtimit të akteve të nxjerra nga institucionet arsimore, kompetente është gjykata administrative të shkallës së parë. Kundërshtimi i vendimmarrjes së një organi publik lidhur me një veprim administrativ individual dhe bazueshmëria e tij në ligj, nuk mund të shqyrtohet nga gjykata civile, sepse mosmarrëveshja është e natyrës administrative dhe ajo çka kërkohet të shqyrtohet është pikërisht nëse ky organ ka vepruar në përputhje me ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. (*shih vendimin nr. 00-2023-322 datë 7.2.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; vendimin nr. 00-2022-399 (43), datë 9.2.2022; vendimin nr. 00-2020-297, datë 24.6.2020 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).*

44. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se do të ishte e pakuptimtë që për kundërshtimin e procedurës së ndjekur nga institucioni arsimor për konkurrimin, emërimin apo lëvizjen paralele, një mësues t'i drejtohej gjykatës administrative dhe për largimin nga detyra të investonte gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm. Marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë që rregullohet nga ligji nr. 69/2012 dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij, mbrojnë një marrëdhënie juridike. Nga kjo marrëdhënie juridike (marrëdhënia e punës) duhet të burojnë të drejta dhe detyrime, të cilat kontrollohen nga i njëjti juridiksion, si në etapat e para të nisjes së saj, ashtu edhe në përfundim. Në të kundërt, copëzimi i kompetencës lëndore sipas fazës së konkurrimit apo largimit nga detyra, do të prodhonte procese gjyqësore jo efektive, do të rriste ngarkesën e gjykatave dhe mundësinë për dhënien e vendimeve kontradiktore nga juridiksione të ndryshme.

45. Në lidhje me sa më sipër, Kolegji arrin në përfundimin se marrëdhënia e punës e mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar publik, rregullohet nga ligji organik nr. 69/2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), si dhe udhëzimet e ministrit përkatës (nr. 13, datë 22.5.2019, apo udhëzimi nr. 12, datë 10.6.2021), me të cilat janë detajuar rregullat e zbatueshme për marrëdhënien e punës së kësaj kategorie nëpunësish shtetërorë. Për shkak të bazës së mësipërme ligjore, marrëdhënia e punës së mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar publik, është pjesë e bashkësisë së nëpunësve shtetërorë, që sipas ligjit organik, marrëdhënia e tyre e punës ka rregullim të posaçëm. Fakti që ligji nr. 69/2012 nuk ka bërë të njëjtin rregullim të marrëdhënies së punës të mësuesve në sektorin publik, në raport me rregullimin që kanë bërë ligjet nr. 153/2013, 98/2016 apo 97/2016 për nëpunësit civilë, nëpunësit civilë gjyqësorë apo nëpunësit civilë të prokurorisë, nuk e përjashton këtë marrëdhënie nga të klasifikuarit si e rregulluar në mënyrë të posaçme me ligj të veçantë (përfshirë edhe aktet nënligjore të zbatueshme). Përderisa ligji nr. 69/2012, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij kanë përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurën për konkurrimin, pranimin, emërimin, vlerësimin, lëvizjen paralele, si dhe largimin nga detyra të mësuesit, por edhe procedurën që subjektet duhet të ndjekin pranë organit në sistemin arsimor parauniversitar, Kolegji vlerëson se të gjithë këto elemente e identifikojnë këtë mënyrë të rregullimit ligjor si të posaçëm. Mënyrat e ndryshme të përdorimit të teknikës legjislative, diku me procedura më të detajuara e diku më pak, por që nxjerrin në pah qartësisht të gjithë fazat në të cilat kalon procesi i rekrutimit e deri në largimin nga puna të nëpunësve, apo të procedurave të ankimit, janë një zgjedhje e ligjvënësit që nuk zbeh cilësinë e qenies së marrëdhënies së punës si të rregulluar me ligj të posaçëm, konform nenit 7(ç) të ligjit nr. 49/2012.

46. Ndaj, në kuptim të kësaj dispozite, Kolegji vëren se është në kompetencën e gjykatave administrative zgjidhja e mosmarrëveshjeve të punës së nëpunësve shtetëror, mjafton që nëpunësi shtetëror të ushtrojë një funksion publik për të cilin ka një rregullim të posaçëm me një ligj të së drejtës publike dhe marrëdhënia e tij e punës të jetë normuar po nga ky ligj, i cili të ketë autorizuar njëkohësisht rregullimin e mëtejshëm të kësaj marrëdhënie edhe me akte nënligjore. Parashikimi i nenit 60 të ligjit organik nr. 69/2012 (i ndryshuar), si dhe udhëzimet e sipërcituara të ministrit të Arsimit, përmbushin mjaftueshëm kriterin e një rregullimi ligjor të posaçëm të marrëdhënies së punës së mësuesve në sektorin publik të arsimit parauniversitar, pasi nëpërmjet kësaj baze ligjore rregullohen dhe detajohen rregullat e së drejtës që do të duhet të mbahen parasysh në të gjitha hallkat e marrëdhënies së punës së mësuesve, duke filluar nga emërimi, transferimi dhe deri tek largimi i tyre nga puna.

47. Fakti se për aspekte të veçanta të marrëdhënies së punës të kategorive të ndryshme të nëpunësve shtetëror (për të cilat nuk ka rregullim të posaçëm, ligjor ose nënligjor), gjen zbatim edhe KP-ja, nuk do të thotë se këto pushojnë së qeni të rregulluara me ligj të posaçëm, në kuptim të nenit 7(ç) të ligjit nr. 49/2012. KP-ja është *lex generalis*, i cili gjen zbatim për çdo aspekt të marrëdhënies së punës, për të cilën nuk ka rregullim të posaçëm *lex specialis*. P.sh: nëse në ligjin e posaçëm mungojnë dispozita për sigurimin dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, atëherë do të gjejnë zbatim rregullat e KP-së, apo ligjeve të tjera të zbatueshme (sipas rastit). Kjo është parashikuar shprehimisht edhe në nenin 4 të KP-së, kur është parashikuar se:

"*Përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij Kodi:*

- punësimi i personave që rregullohet me ligj të veçantë.

Dispozita të veçanta të këtij Kodi zbatohen edhe ndaj personave, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për probleme të lidhura me marrëdhëniet e punës."

48. Nga ana tjetër, në interpretim të përjashtimit që parashikon fjalia e dytë e nenit 7(ç) të ligjit nr. 49/2012, i cili përforcon rregullin e trajtuar më sipër, arrihet në përfundimin se nuk është në kompetencën lëndore të gjykatave administrative zgjidhja e mosmarrëveshjeve të punës së punonjësve në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në KP. Për të kuptuar se cilën kategori punonjësish përfshin fjalia e dytë e nenit 7(ç), të ligjit nr. 49/2012 na ndihmon interpretimi që iu bë më sipër fjalisë së parë, në

lidhje me të përbashkëtat e katër kategorive të nëpunësve, për të cilët ligji i posaçëm ka rregullim të veçantë. E përbashkëta e këtyre katër kategorive është se ato veçohen nga ligjet e posaçme nga kategoria e punonjësve të tjerë që punojnë në të njëjtët institucione, por që nuk ushtrojnë funksione publike të mirëfillta. P.sh.: në nenin 4(1)(d) të ligjit nr. 153/2012 "Për nëpunësin civil" (*i ndryshuar*) është dhënë përkufizimi si vijon: "*d) "Punonjës administrativ" është punonjësi që kryen veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtjeje, shërbimi, ruajtjeje dhe nuk ushtron një funksion publik.*" Ndërkohë sipas nenit 2(g) të ligjit nr. 153/2012, punonjësit administrativë përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij ligji, duke u rregulluar marrëdhënia e tyre e punës nga KP-ja. Kësisoj, marrëdhënia e punës e punonjësit administrativ, të punësuar në administratën publike, në ndihmë apo mbështetje të nëpunësve civile, kur marrëdhënia e tyre e punës nuk rregullohet me ligj të veçantë, nuk është në kompetencën lëndore të gjykatave administrative. Ngjashëm në nenin 70, të ligjit nr. 97/2016, janë përcaktuar kategoritë e nëpunësve civilë në prokurori, ndërsa në nenin 71 të këtij ligji është përcaktuar se "*marrëdhënia e punës e punonjësve të tjerë në prokurori rregullohet nga Kodi i Punës.*". Kjo do të thotë se të gjithë punonjësit e tjerë të prokurorisë, që nuk përfshihen në kategoritë sipas nenit 70, por që marrëdhënia e tyre e punës normohet kryesisht nga KP-ja dhe jo me ligj organik të veçantë, nëse do të kenë mosmarrëveshje nga marrëdhënia e punës, nuk i përkasin kompetencës lëndore të gjykatave administrative. Edhe ligji nr. 98/2016 ka një rregullim të ngjashëm, ku në nenin 50 të tij përcaktohen kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësor, ndërsa në nenin 51 thuhet se *"marrëdhënia e punës e punonjësve të tjerë në gjykatë rregullohet nga Kodi i Punës."*. Edhe mosmarrëveshjet e këtyre punonjësve në administratën publike, për të cilët ligji organik nuk bën rregullim të posaçëm të marrëdhënies së punës, por referon te KP-ja, nuk do të jenë në kompetencën lëndore të gjykatave administrative.

49. Bazuar në çka u tha më sipër, edhe punonjësit e tjerë në administratën publike të sistemit arsimor parauniversitar publik, për të cilët ligji organik nr. 69, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), si dhe aktet përkatëse, nuk kanë parashikuar rregullim të posaçëm të marrëdhënies së tyre të punës, nuk do të jenë në kompetencën e gjykatave administrative. Ndërsa mësuesit në sektorin arsimor parauniversitar publik, për të cilët ligji i posaçëm dhe aktet nënligjore të dala në bazë e për zbatim të këtij ligji, kanë rregulluar posaçërisht procedurën e konkurrimit, pranimit, emërimit, vlerësimit, lëvizjes paralele, si dhe largimit nga detyra të mësuesit, duke parashikuar madje edhe të drejtën e ankimit dhe kompetencën për shqyrtimin e saj. Për fazat paraprake të punësimit, hyjnë në kategorinë e nëpunësve shtetërorë që ushtrojnë një funksion publik, të rregulluar sipas ligjit organik në mënyrë të posaçme, që trajtohen nga gjykatat administrative.

50. Kolegji vlerëson gjithashtu se ligji nr. 69/2012 përcakton parimet bazë për strukturën, veprimtarinë dhe qeverisjen e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë duke përfshirë këtu institucionet e arsimit publik dhe ato privat, duke përjashtuar në mënyrë të shprehur aspekte të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së arsimit profesional, të cilat rregullohen me ligj të veçantë. Për aspekte të përgjithshme ky ligj është baza dhe shërben si ligj i posaçëm si për institucionet arsimore publike edhe për ato private. Megjithatë, përsa i përket aspekteve që normojnë marrëdhënien e punësimit të mësuesit në interpretim sistematik të neneve 42, 55 të ligjit nr. 69/2012, si dhe bazuar në parashikimet eksplicite të nenit 60, Kolegji vlerëson se parashikimet mbi procedurën që duhet të ndjekin mësuesit për pranimin, emërimin, largimin apo lëvizjen paralele janë të detyrueshme vetëm për mësuesit në institucionet arsimore publike. Për rrjedhojë, për sa kohë udhëzimi nr. 38, datë 6.10.2015, "*Procedurat e lëvizjes paralele, emërimit, dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar"* dhe në vijim, udhëzimi nr. 13, datë 22.5.2019 "*Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit "Mësues për Shqipërinë"* (i cili shfuqizon udhëzimin nr. 38, datë 6.10.2015), apo ai i vitit 2021 që shfuqizoi këtë të fundit, janë nxjerrë në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 60 të ligjit 69/2012, ato kanë si fushë zbatimi vetëm rregullimin dhe përcaktimin e procedurave të emërimit, largimit apo lëvizjes paralele të mësuesve të institucioneve arsimore publike.

51. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se ky ligj, pavarësisht se përcakton kriteret bazë të arsimimit apo kualifikimit që duhet të plotësojë një mësues për të ushtruar profesionin e tij në Republikën e Shqipërisë (*si një nga profesionet e rregulluara sipas ligjit të posaçëm*), nuk rregullon aspektet që lidhen me marrëdhënien e punës për mësuesit në institucionet arsimore private, duke e lënë në lirinë kontraktore të privatëve rregullimin e marrëdhënies së punës. Për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet se përmban dispozita që të përbëjnë rregullim të posaçëm sipas kërkesave të nenit 7, shkronja "ç", të ligjit nr. 49/2012, për këtë kategori të punësuarish.

52.Referuar jurisprudencës së deritanishme, Kolegji thekson se për të identifikuar një mosmarrëveshje, si administrative ose jo, duhet që kumulativisht të plotësohen tri kushte. Kriteret që gjykatat duhet të mbajnë parasysh, nëse një mosmarrëveshje është apo jo e natyrës administrative kanë të bëjnë me: a) njëra nga palët në mosmarrëveshje ka natyrën e organit të administratës publike, në kuptim të rregullimit ligjor në fuqi dhe, në

kuadër të kryerjes së veprimtarisë të njohur nga ligji, ushtron pushtetin e tij diskrecional ndaj palës tjetër; b) veprimtaria e organit të administratës publike bazohet në një ligj të posaçëm të së drejtës publike dhe vetë marrëdhënia juridike që krijohet në mes palëve buron nga një ligj i së drejtës publike; c) kjo veprimtari e organit të administratës publike, që konkretizohet me nxjerrjen e aktit, duhet të veprojë në drejtim dhe të ketë si bazë interesin publik *(shih vendimin nr. 2, datë 10.3.2014, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë § 23).*

53. Koncepti i marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike nënkupton ato marrëdhënie juridike që përfshijnë në mënyrë kumulative ose alternative shumë elemente, siç janë raportet e pabarazisë mes palëve, kryerjen e një misioni shërbimi publik, ushtrimin e prerogativave të fuqisë (pushtetit) publike, si dhe përmbushjen e interesit publik. Kolegji thekson se, të gjithë këto elemente që karakterizojnë të drejtën publike kanë për qëllim përmbushjen e misionit thelbësor të administratës publike, që është misioni i përmbushjes së interesit publik.

54. Kolegji për identifikimin e kuptimit të nenit 7(ç) të ligjit nr. 49/2012 (sipas ndryshimeve me ligjin nr. 39/2017) vlerëson të nevojshme referimin edhe në relacionin shpjegues të Komisionit mbi Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvend. Gjatë diskutimeve mbi projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", ndër të tjera përcaktohet se *"[...] Është bërë një riformulim i germës "ç" të nenit 7, ku thuhet: "Mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë nëpunësve civilë të prokurorisë nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm", ku përfshihet policia, shërbimet e inteligjencës e të tjerë. "Përjashtohen nga ky rregull punonjësit në administratën publike në gjykatë ose në prokurori, marrëdhëniet e të cilëve bazohen në Kodin e Punës [...]."* Siç rezulton dhe nga diskutimet mbi projektligjin në Komision, qëllimi i ndryshimeve ligjore ka qenë përfshirja në kompetencë të gjykatave administrative edhe e punonjësve të tjerë përveç nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë dhe nëpunësve civilë të prokurorisë, duke e lënë të hapur mundësinë e interpretimit në varësi të rregullimeve të posaçme që gëzon një marrëdhënie juridike punësimi. Kolegji vlerëson se një parashikim i tillë nuk kushtëzon përfshirjen në kompetencë të gjykatave administrative vetëm të kategorisë së subjekteve që kanë të njëjtën garanci, si nëpunësit civil, të cilët përfitojnë rikthimin në detyrë. Nëse ligjvënësi do kishte pasur këtë qëllim, do kishte lidhur përcaktimin e kompetencës jo me rregullimin e posaçëm në ligjin organik, por me pasojat që do të vinin nga zgjidhja e paligjshme e marrëdhënies së punës (që një nga rastet mund të jetë rikthimin në detyrë). Ligjvënësi e ka lënë të hapur kategorinë e subjekteve që synon të mbrojë apo t'i japë një garanci më të madhe nëpërmjet parashikimit të nenit 7, shkronja "ç" të ligjit nr. 49/2012, pa dashur të përcaktojë një listë shteruese të tyre, duke e lidhur domosdoshmërisht vetëm me kriterin e ekzistencës së një ligji organik që ka një rregullim të posaçëm. Pikërisht, përcaktimi si i posaçëm i rregullimit ligjor që i bëhet kategorisë së nëpunësve shtetërorë përcakton edhe kompetencën e gjykatës.

55. Kolegji çmon se në rastin objekt gjykimi marrëdhënia e punës së paditëses me palën e paditur në pozicionin e "Mësuese provizore në shkollën 9-vjeçare "Mihal Grameno", Tiranë, që ka filluar prej vitit 2016, rregullohet nga ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Kolegji vlerëson se vendimi nr. 6068, datë 18.11.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka shpallur moskompetencën për shqyrtimin e çështjes, është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi dhe çështja duhet t'i dërgohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për vijimin e shqyrtimit të mosmarrëveshjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (*sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë*) ka kualifikuar drejt natyrën e mosmarrëveshjes, duke individualizuar drejt nga pikëpamja lëndore edhe gjykatën kompetente. Nëse një gjykatë nuk ka juridiksion/kompetencë për të gjykuar çështjen objekt shqyrtimi, në përputhje me dispozitat që zbatohen sipas legjislacionit përkatës nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural. Përcaktimi i kompetencës lëndore i referohet identifikimit të natyrës së mosmarrëveshjes, nëse është e natyrës civile apo administrative.

56. Kolegji përcakton se kriter për ndarjen e kompetencës lëndore është natyra juridike e marrëdhënies midis palëve ndërgjyqëse, që në rastin konkret është marrëdhënie punësimi, e cila gjen rregullim primar nga ligjit i posaçëm nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe jo nga KP-ja, siç është arsyetuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Me ndryshimet e bëra ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", me ligjin nr. 39/2017, konkretisht neni 7, shkronja "ç", të ligjit nr. 49/2012, konkludohet se për shkak të rregullimit që i bëhet marrëdhënies konkrete me ligj të posaçëm, kompetencën lëndore për gjykimin e mosmarrëveshje të marrëdhënieve të punës të mësuesve e ka gjykata e juridiksionit të posaçëm administrativ dhe në rastin në gjykim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

57. Vlen të përmendet se në vendimin nr. 00-202-718**,** datë 27.5.2021, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i është referuar nenit 60, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 69/2012, i cili parashikon se *"[...] Drejtori i institucionit*

publik largon mësuesit nga institucioni për a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore", por ky përfundim nuk duhet të merret i shkëputur nga rasti konkret që është shqyrtuar. Pavarësisht nga referimi që përdoret për atë rast, formulimi në dispozitën e mësipërme ku përdoret si shkak për largimin e mësuesit "shkelje e dispozitave të Kodit të Punës", nuk do të thotë se aplikohet procedura e këtij Kodi për mësuesit. Përderisa ka një rregullim me ligj të posaçëm, ku parashikohen shprehimisht kriteret e emërimit apo shkaqet e largimit të mësuesve nga puna me detyrimin për zbatimin e një procedure të hollësishme, atëherë kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të tyre është gjykata administrative. *(shih vendimin nr. 00-2022-1806, datë 21.7.2022, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).*

58. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se në mbështetje të këtij arsyetimi dhe rregullave të interpretimit të sipërcituara, sipas kuptimit të ndryshimeve ligjore të vitit 2017 në nenin 7(ç), të ligjit nr. 49/2012, dhe parashikimit të posaçëm ligjor dhe nënligjor të procedurave të hollësishme mbi marrëdhënien e punës së mësuesit, mënyrën e konkurrimit, pranimit, emërimit, lëvizjes paralele, pezullimit të mësuesit nga detyra, largimin, të drejtën e ankimit tek organi publik del në pah qartë qëllimi për rregullimin e posaçëm ligjor të kësaj marrëdhënieje punësimi. I gjithë kuadri ligjor që rregullon marrëdhënien e punës së mësuesve në sistemin arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë përmbush standardin e kërkuar nga neni 7 shkronja "ç" të ligjit nr. 49/2012, pra përbën ligji organik që ka një rregullim të posaçëm, duke hyrë mosmarrëveshjet e punës në këto raste, në kompetencën lëndore të gjykatave administrative.

Ç. Rregulli i së drejtës për çështjen e shtruar për njësim

59. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në arsyetimin e mësipërm, referuar çështjes së shtruar për njësim, arrin në këtë përfundim njësues:

- **Gjykatat kompetente për gjykimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë janë gjykatat administrative.**

D. Në lidhje me zgjidhjen e parashtrimit objekt shqyrtimi

60. Në vështrim të analizës së mësipërme, Kolegji arrin në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është shpallur moskompetenca lëndore për gjykimin e çështjes, duhet të lihet në fuqi dhe çështja të dërgohet për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me të njëjtin trup gjykues.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 13(6), 62/a dhe 63(1)(c)(2) të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rregullimin e kompetencës lëndore duke përcaktuar si gjykatë kompetente Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë të Tiranë.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 6068, datë 18.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 7.7.2023

Kryesues: Sokol Sadushi
Anëtarë: Asim Vokshi, Gentian Medja, Sokol Ngresi
Anëtarë *(kundër)*: Arbena Ahmeti

MENDIM I GJYQTARIT TË MBETUR NË PAKICË

Unë, gjyqtare Arbena Ahmeti, me cilësinë e anëtares të trupës gjykuese dhe njëkohësisht relatore e çështjes jam kundër vendimit të Kolegjit Administrativ (*në vijim "Kolegji"*) për njësimin e praktikës gjyqësore, në lidhje me rregullimin e kompetencës lëndore midis gjykatave administrative dhe gjykatave të rretheve gjyqësore për gjykimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga marrëdhënia e punësimit të mësuesve pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë, duke u përcaktuar kompetente Gjykata Administrative.

Vlerësoj se, në rregullimin e kompetencës lëndore, Kolegji duhet të kishte disponuar ndryshe, duke përcaktuar si kompetente për nga pikëpamja lëndore gjykatat e rretheve gjyqësore *(aktualisht, me riorganizimin e tyre, të emërtuara Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm).*

Në zbatim të nenit 1, pg. 2, nenit 7 germa "ç", nenit 8, germa "b", nenit 13, pika 6, të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar (referuar edhe si "LGJA"), nenit 42 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, nenit 307, pg. 2, neni 308, pg. 1, si dhe nenit 35(3), të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

- Arsyet e votës kundër në këtë gjykim janë, si vijon:

I. Baza juridike për mendimin e mbetur në pakicë

- Ligji nr. 49/2012, i ndryshuar:

Neni 1, "Objekti"[83]

l. Ky ligj përcakton rregulla të detyrueshme, për:

b) juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave administrative;

2. Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.

Neni 7, "Kompetenca lëndore" *para ndryshime të pësuara me ligjin nr. 39/2017*

Gjykatat administrative janë kompetente, për:

ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është organ i administratës publike;

Neni 7, "Kompetenca lëndore"[84]

Gjykatat administrative janë kompetente, për:

ç) mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë, nëpunësve civilë gjyqësorë, nëpunësve civilë të prokurorisë dhe të nëpunësve shtetërorë që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Përjashtohen nga ky rregull punonjësit në administratën publike, në gjykatë ose prokurori, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës.

Neni 8 "Mosmarrëveshjet, të cilat nuk shqyrtohen në gjykatën administrative"

Gjykata administrative nuk shqyrton mosmarrëveshjet:

b) shqyrtimi i të cilave, sipas legjislacionit në fuqi, është në kompetencën e një gjykate tjetër.

- Kodi i Punës

Neni 4,[85] që përcakton fushën e zbatimit të tij, *sipas personave.*

Përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij Kodi:

- punësimi i personave që rregullohet me ligj të veçantë.

Ky nen, në pg. e dytë gjithashtu, përcakton dhe parimin e zbatimit subsidar të Kodit të Punës në marrëdhëniet e punës, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë.

Dispozita të veçanta të këtij Kodi zbatohen edhe ndaj personave, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për probleme të lidhura me marrëdhëniet e punës.

Neni 11,[86] që përcakton *"Përparësia e normave të së drejtës"*

1. Të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhënien e punës *rregullohen në mënyrë përparësie nga këto burime:*

a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

b) konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë;

c) ky Kod dhe aktet e tij nënligjore;

d) kontrata kolektive e punës;

e) kontrata individuale e punës;

f) rregullorja e brendshme;

g) zakonet lokale dhe profesionale.

2. Aktet nënligjore dalin në plotësim dhe zbatim të dispozitave të parashikuara nga ky Kod. Ato mund të përcaktojnë kushte pune më pak të favorshme për punëmarrësit sesa ato të parashikuara nga ky Kod vetëm kur kjo parashikohet shprehimisht në këtë të fundit.

3. Çdo dispozitë që shkel një dispozitë të një shkalle më të lartë, është e pavlefshme. Megjithatë, janë të vlefshme vetëm ato dispozita që përmirësojnë pozitën e punëmarrësit.

---

[83] *Shfuqizuar germa"a" e pikës 1 me ligjin nr. 39/2017, datë 30.3.2017.*

[84] *Ndryshuar germa"ç" me ligjin nr. 39/2017, datë 30.3.2017.*

[85] *Ndryshuar me ligjin nr. 9125, datë 29.7.2003.*

[86] *Ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.3.1996; - ndryshuar me ligjin nr. 9125, date 29.7.2003; - shtuar fjali në fund të pikës 4 me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015.*

4. Punëmarrësi nuk mund të heqë dorë nga të drejtat, që rrjedhin nga dispozitat urdhëruese të këtij Kodi ose të kontratave kolektive të punës. Janë të vlefshme marrëveshjet e bëra në prani të inspektorit të punës ose në formën e parashikuar në kontratën kolektive të punës, që kanë si qëllim të mënjanojnë me pajtim një konflikt, duke bërë lëshime të dyanshme, të pranuara me vullnet të lirë nga të dyja palët. Marrëveshjet e sipërpërmendura nuk zbatohen për pushimet vjetore të paguara.

5. Zakonet profesionale zbatohen vetëm kur mungojnë dispozitat ligjore, parashikimet në marrëveshje, kontratë, si dhe kur dispozitat ligjore i referohen shprehimisht zakoneve profesionale.

- Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"[87]

Neni 1, pg. 3, "Objekti, qëllimi dhe fusha e zbatimit të ligjit"

Fusha e zbatimit të këtij ligji është sistemi arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, përveç aspekteve të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së arsimit profesional, që rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 2, pika 15, "Përkufizime"

15. "Mësues" është personi që ka fituar të drejtën për të ushtruar profesionin e mësuesisë në arsimin parauniversitar.

Neni 56 "Mësuesi"; neni 57 "Profesioni i mësuesit"; neni 58 "Zhvillimi i vazhdueshëm profesional";

Neni 59 "Kualifikimi i mësuesve"

1. Kategoritë e kualifikimit të mësuesve janë tri:

a) "Mësues i kualifikuar";

b) "Mësues specialist";

c) "Mësues mjeshtër".

2. Rritja në kategori e mësuesit bëhet nëpërmjet përvojës, trajnimit dhe pasi të ketë dhënë me sukses provimin përfundimtar të kategorisë përkatëse të kualifikimit. Kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve përcaktohen me udhëzim të ministrit.

3. Çdo kategori kualifikimi shoqërohet me një shtesë në pagë, masa e së cilës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 60 "Pranimi dhe largimi nga puna i mësuesit"

1. Në institucionin arsimor publik, për një vend të lirë pune, mësuesi emërohet nga drejtori i institucionit arsimor, me konkurrim të hapur. Në komisionet e vlerësimit marrin pjesë përfaqësues të prindërve. Procedurat e konkurrimit dhe vlerësimit përcaktohen me udhëzim të ministrit.

2. Drejtori i institucionit publik largon mësuesin nga institucioni, për:

a) shkelje të dispozitave të Kodit të Punës, të këtij ligji e të akteve të tjera nënligjore;

b) shkelje të etikës e të sjelljes në institucion;

c) mosarritje të nxënësve, të përcaktuara në mënyrë objektive, si testimet e drejtorisë së institucionit ose të njësisë arsimore vendore, rezultatet në provimet kombëtare dhe vlerësimi i Inspektoratit Shtetëror të Arsimit.

3. Drejtori i institucionit arsimor publik fillon procedurën e largimit të mësuesit edhe me kërkesë të prindërve dhe vendos largimin pasi konsultohet me përfaqësues të prindërve të institucionit arsimor, sipas procedurave të përcaktuara me udhëzim të ministrit. [88]

II. Mendimi i mbetur në pakicë si duhet të rregullohet kompetenca lëndore.

Së pari, vlen të sillet në vëmendje se në vështrim krahasues midis rregullimit të dispozitës së nenit 7, germa "ç", të ligjit nr. 49/2012 para ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 37/2017 dhe riformulimit pas ndryshimeve, ishte e qartë se mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëmarrës ishte mësuesi i arsimit para-universitar publik i takonin kompetencës lëndore të gjykatave administrative. *Pyetja që shtrohet për zgjidhje, pas ndryshimeve që pësoi ligji nr. 49/2012 në vitin 2017, për të arritur në njësimin e praktikës gjyqësore është a janë sërish kompetente për nga pikëpamja lëndore gjykatat administrative, mbështetur në riformulimin e germës "ç" të nenit 7?*

Së dyti, vlerësoj se dispozita ligjore (*neni 7 germa "ç" pas ndryshimeve të viti 2017*) në fjalinë e parë identifikon katër kategori të nëpunësve shtetërorë, të cilët për mbrojtjen e të drejtave subjektive në marrëdhënien e punësimit kanë të drejtë të paraqesin padi administrative për mbrojtje gjyqësore pranë gjykatave administrative dhe janë si vijon:

a) Nëpunësit civilë, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë, përkatësisht ligji nr. 152/2013 i ndryshuar "Për nëpunësin civil" dhe që nuk hyjnë në fushën e zbatimit të Kodit të Punës, sipas nenit 4, pg. 1 të tij. Duhet vënë në dukje se ligji nr. 152/2013 i ndryshuar është ligj i miratuar prej Kuvendit me shumicë të cilësuar. Në

[87] *Ky ligj është përafruar plotësisht me: Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian (2000/C 364/01), datë 18 dhjetor 2000, numri CELEX 32000X1218(01) Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria C, nr. 364, datë 18.12.2000, faqe 1–22.*

[88] *Ndryshuar me ligjin nr. 56/2015, datë 28.5.2015, botuar në FLZ nr. 105, datë 23.6.2015.*

kategorinë e nëpunësve civilë janë: punonjësit e administratës tatimore (*brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit nr. 9920/20008 i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil*); punonjësit e administratës doganore, (*brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit nr. 102/2014 Kodi Doganor dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil*); punonjës të administratës shtetërore (*brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit nr. 90/2012 dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil*); punonjës administrate të njësive të qeverisjes vendore (*brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit nr. 139/2015 dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil*); punonjës administrate të institucioneve të pavarura (*brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit organik të institucionit, si p.sh., Kontrolli i Lartë i Shtetit, Banka e Shqipërisë, Avokati i Popullit etj. dhe akteve nënligjore përkatëse, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil*); kategoria e nëpunësve civilë kanë të përbashkët se, statusi i nëpunësit civil gëzohet pasi të jetë deklaruar me një akt të nxjerrë, sipas rastit, ose prej DAP[89] ose prej njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore.

b) Nëpunës civil gjyqësorë, brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit nr. 98/2016 i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Lartë Gjyqësor, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil.

c) Nëpunësve civilë të prokurorisë brenda sferës së fushës së zbatimit të ligjit nr. 97/2016 i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe punojnë në një pozicion pune të shërbimit civil;

dhe

d) nëpunësit shtetërorë, që sipas ligjit organik kanë një rregullim të posaçëm. Në këtë kategori prej *praktikës gjyqësore të konsoliduar* prej gjykatave administrative por edhe prej gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm (*në rastin përjashtues*) janë: punonjësit e Policisë së Shtetit që kanë gradë policore; punonjës të shërbimit informativ që kanë gradë në shërbim; punonjës të Gardës së Republikës së Shqipërisë që kanë gradë në shërbim; magjistratët, pra gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve; titullarët e institucioneve të pavarura, si *Guvernatori, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit*, *Avokati i Popullit*, *Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*, *Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, Kryeinspektori i ILKPDIK-së* etj., të cilët në ligjin organik kanë një mandat kohor të përcaktuar për të ushtruar kompetencat; avokatët e shtetit; punonjës të shërbimit diplomatik të Republikës së Shqipërisë, që gëzojnë statusin e diplomatit sipas gradës së diplomatit apo gradës konsullore.

Vërej se, për secilin rast më lart në kategorinë e katërt, rezulton se kanë element të përbashkët faktin se në secilin akt normative rregullues të profesionit përkatës, është *forma e ligjit të miratuar prej Kuvendit*, për nga *pikëpamja procedurale* dhe së dyti për *nga pikëpamja materiale,* në secilin ligj *(ligji nr. 108/2014 i ndryshuar, ligji 96/2016; i ndryshuar, ligji nr. 97/2016 i ndryshuar, ligji nr. 98/2016 i ndryshuar, ligji nr. 23/2015 i ndryshuar etj.)* është përcaktuar shprehimisht se, në sferën e fushës së zbatimit të ligjit përkatës është rregullimi i punësimit të kategorisë së nëpunësve shtetëror përkatës, në mënyrë të posaçme, referuar përgjegjësive administrative. Të gjithë nëpunësit shtetërorë të kësaj kategorie, *të listuar më lart, për të cilët praktika gjyqësore është e konsoliduar*, janë gjithashtu, kategori e punonjësve, që përjashtohen prej fushës së zbatimit të Kodit të Punës, sipas nenit 4, pg. 1 të tij, element dallues dhe i përbashkët i kësaj kategorie me tri kategoritë e para, pra me nëpunësit civilë, me nëpunësit civilë gjyqësor dhe me nëpunësit civilë të prokurorisë. Kuptohet se, Kodi i Punës ndaj marrëdhënies së punësimit, për nga pikëpamja materiale, të gjithë tyre, pra të katër kategorive, gjen zbatim, në secilin rast, sipas parimit të subsidaritetit (*pg. 2, neni 4, i Kodit të Punës).*

Shtrohet natyrshëm pyetja, po mësuesit pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë a janë nëpunës shtetëror, punësimi i të cilëve me ligjin nr. 69/2012 dhe rezervën ligjore përkatëse,[90] rregullohet në mënyrë të posaçme, si nga pikëpamja formale ashtu dhe nga pikëpamja materiale? A janë nëpunës shtetëror në të njëjtin nivel të aftësive profesionale, nivel drejtues dhe përgjegjës për ushtrimin e kompetencave administrative në të drejtën publike, me katër kategoritë e mësipërme?

Mësuesi, pranë sistemit arsimor parauniversitar publik në Republikën e Shqipërisë, referuar përkufizimit në pikën 15, të nenit 2, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar, është personi që ka fituar të drejtën për të ushtruar profesionin e mësuesisë në arsimin para-universitar, duke mos u përcaktuar si nëpunës shtetëror, por arrij në përfundimin se, për shkak të varësisë financiare (*pagesat prej buxhetit të shtetit)* dhe varësisë administrative strukturore *(e cila është e dyfishtë midis ministrisë përgjegjëse, Ministria e Arsimit Rinisë dhe Sporteve dhe njësisë së qeverisjes vendore me anë të*

[89] *Departamenti i Administratës Publike.*

[90] *Dispozita ligjore, neni 59, pg. 2, fjalia e dytë përcakton se: "Kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve përcaktohen me udhëzim të ministrit.".*

Zyrës Vendore të Arsimit) është nëpunës shtetëror. A është *punësimi i tyre i rregulluar me ligj organik në mënyrë të posaçme?* Në zbatim të nenit 1, pg. 3, të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar,[91] nuk rezulton se punësimi i tyre të jetë në mënyrë të posaçme i rregulluar, pasi rregullat e përcaktuara në përmbajtje të ligjit nr. 69/2012, i ndryshuar, u drejtohet edhe mësuesve pranë arsimit parauniversitar të institucioneve private, duke mos qenë një rregullim i posaçëm.

Misioni dhe detyra e mësuesit në sistemin arsimor parauniversitar si në atë publik dhe pranë institucioneve private është shumë i rëndësishëm për shoqërinë, në të gjitha nivelet e jetës, qoftë sfera publike qoftë sfera private, pa bërë dallim midis punës që bën mësuesi në arsimin publik me punën që bën mësuesi në institucioni privat. Sigurisht që punësimi i mësuesve, për nga pikëpamja materiale, *pra në drejtim të volumit të të drejtave dhe detyrimeve, si përmbajtje e marrëdhënies së punës, rregullohet prej ligjit dhe akteve nënligjore.* Këtë parashikon dhe lejon neni 11 i Kodit të Punës, në përparësinë e normave dhe zbatimin e tyre, për rregullimin e marrëdhënies së punës dhe kështu ndodh për çdo profesion, mësues, mjek, aktor, pedagog, marangoz, punonjës administrativ etj., *por pavarësisht, marrëdhënia e punësimit nuk përjashtohet prej fushës së zbatimit, sipas personave, nga Kodi i Punës, përkundrazi.*

Kjo do të thotë se, referuar rregullimit të profesionit përkatës është e nevojshme për arsye nga më të ndryshme që me ligj (*në kuptimin formal*) apo me akte nënligjore të autorizuara prej tij, të përcaktohen kritere dhe kushte për punësim, që janë detajuese për këtë profesion dhe është e kuptueshme, pasi përmbajtja e marrëdhënies së punës, nuk mund të parashikohen vetëm prej Kodit të Punës, për çdo profesion specifik. Nga ana tjetër, *"ky rregullim plotësues i profesionit"* nuk barazohet me faktin se, marrëdhënia e punësimit ka një rregullim të posaçëm, të të njëjtës kategori dhe të njëjtit nivel me të katër kategoritë e germës "ç", të nenit 7, të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar. Gjithashtu, si gjyqtare administrative vlerësoj se, në drejtim të nivelit të aftësive profesionale për ushtrimin e detyrës së mësuesit, të nivelit drejtues dhe nivelit të ushtrimit të përgjegjësive dhe kompetencave administrative në të drejtën publike, nuk mundet objektivisht të jetë e njëjtë me katër kategoritë, e përcaktuara në nenin 7, germa "ç", të ligjit me nr. 49/2012, i ndryshuar.

Gjithsesi, punësimi i mësuesve, duke qenë se hyn në fushën e zbatimit të Kodit të Punës, sipas personave, bën që sentenca unifikuese e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin me nr. 7, datë 1.6.2011 të jetë e detyrueshme për zbatim, në rastin e zgjidhjes së marrëdhënies së kontratës së punës. Kështu, Kolegjet e Bashkuara, në këtë vendim kanë shtruar midis të tjerave për unifikim dhe faktin që e trajtojnë zgjidhjen e kontratës së punës si konflikt administrativ apo si konflikt që rrjedh nga marrëdhëniet e punës dhe ato arrijnë në përfundimin se: **"Në rast të zgjidhjes së kontratës së punës, pavarësisht se organi administrativ për rastet e administratës publike shprehet me një akt të marrë nga drejtuesi i organit, kjo nuk do të thotë që jemi përpara marrëdhënieve administrative pra shprehjes së vullnetit të organit në kuptim të marrëdhënieve administrative por jemi përpara shprehjes së vullnetit të punëdhënësit për zgjidhjen e kontratës së punës. Pra, me këtë do të kuptojmë se kemi të bëjmë me një marrëdhënie pune midis punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe jo më me një marrëdhënie administrative. Pra, punëmarrësi nuk mund të ngrejë padi për goditjen e aktit administrativ por mund të ngrejë padi për kërkimin e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e kontratës së punës."**

Ndërsa, për personat punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë dhe që nuk hyn në fushën e zbatimit të Kodit të Punës, sipas personave, nuk gjen zbatim kjo sentencë unifikuese, që do të thotë që në të gjitha këto raste konflikti në gjykatë do jetë konflikt administrativ dhe rrjedhimisht mosmarrëveshja hyn në kompetencën lëndore të gjykatave administrative, ndaj dhe për katër kategoritë e germës "ç", të nenit 7, gjykatat administrative përveçse shprehen për ligjshmërinë e veprimit administrativ, që ndikon në vijueshmërinë e marrëdhënies së punësimit, rregullojnë pasojat ligjore, në rastin që kanë vlerësuar paligjshmërinë. Në të tillë mënyrë veprimi, brenda sferës së tyre të kompetencës lëndore gjykatat administrative gëzojnë të gjitha atributet për të garantuar akses efektiv, në zbatim të nenit 42 dhe nenit 43 të Kushtetutës, në gjykimin e padive administrative për mbrojtjen e të drejtave subjektive, që rrjedhin prej punësimit të nëpunësve shtetërorë, sipas katër kategorive të listuara në germën "ç", të nenit 7, të LGJA-së.

Përjashtimi i fjalisë së dytë në këtë dispozitë, duhet lexuar dhe rrjedhimisht kuptuar ngushtësisht, që i drejtohet për zbatim vetëm kategorisë së përcaktuar. Ky përjashtim sipas LGJA-së i referohet vetëm administratës në gjykatë dhe në prokurori. Përjashtimet e shprehura në ligj nuk mund të gjejnë zbatim me anë të analogjisë, për raste të ndryshme nga ato të përcaktuara në ligj. Nëse zbatojnë analogjinë mund të arrihet edhe në një përfundim tjetër në këtë rast, që është edhe më i thjeshtë, i cili mund të jetë që për sa kohë punësimi i mësuesit hyn në fushën e zbatimit të Kodit të Punës, bën përjashtim nga rregulli i germës "ç", të nenit 7, të LGJA-së. Por, vetëm kjo

[91] *Dispozita ligjore përcakton se: "Fusha e zbatimit të këtij ligji* ***është sistemi arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë,*** *përveç aspekteve të strukturës, veprimtarisë dhe qeverisjes së arsimit profesional, që rregullohen me ligj të veçantë.".*

metodë nuk mund të jetë e vlefshme për të identifikuar kompetencën lëndore midis gjykatave, ndaj duhet të analizohen në tërësi dhe të përdoren njëherësh dhe në mënyrë krahasuese disa metoda interpretimi të ligjit, për të arrirë një përfundim me baza në ligj. Vlerësoj se termi "ligji organik që ka rregullim të posaçëm" duhet interpretuar nga Kolegji brenda funksionit të tij kushtetues, pavarësisht kuptimit të termit "gjykata e caktuar me ligj" që përpunon GJEDNJ-ja, pasi siç vet ajo përcakton në shumë vendime të saj *konceptet e përpunuara në jurisprudencën e saj janë autonome në drejtim të zbatimit të KEDNJ-së*, ndërsa Kolegji ka detyrë të interpretojë ligjin organik, në këtë rast, LGJA-ja dhe t'i japë kuptim këtij termi në zbatim të këtij ligji.

III. Për çështjen konkrete.

Pala paditëse ka ushtruar detyrën e mësueses pranë shkollës 9-vjeçare "Mihal Grameno", ku është emëruar "Mësuese provizore" deri në përfundim të paaftësisë së përkohshme në punë të mësueses E.K. Në kushtet kur paaftësia e përkohshme në punë e mësueses së profilit ka vijuar, paditësja është riemëruar më datë 11.9.2017 si mësuese provizore me kushtin që marrëdhënia punës do të përfundonte kur të përfundonte paaftësia e përkohshme në punë e mësueses E.K.

Mësuesja e emëruar në profilin anglisht E.K. ka mbush moshën sipas ligjit për përfituar pensionin e pleqërisë dhe rrjedhimisht në datë 25.5.2021 është përfunduar marrëdhënia e punësimit. Me anë të vendimit nr. 197, datë 8.7.2021, punëdhënësi ka vendosur të përfundojë marrëdhënien e punës me paditësen Brunilda Gjeçi si mësuese zëvendësuese/provizore në shkollën 9-vjeçare "Mihal Grameno" Tiranë, me shkakun e mbarimit të afatit të kontratës. Në kontratën e punës së paditëses është bërë shënimi për përfundimin e marrëdhënies së punës më datë 21.7.2021, për shkak të përfundimit të afatit.

Pala paditëse ka pretenduar se largimi nga puna si mësuese pranë shkollës 9-vjeçare "Mihal Grameno" përbën zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustifikuar të kontratës së punës në referim të nenit 155 të Kodit të Punës. Në këto rrethana, në datë 15.12.2021 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë objekt gjykimi.

Në mbështetje të përfundimeve të arritura mbi analizën ligjore të mësipërme vlerësoj se, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është shpallur moskompetenca lëndore për gjykimin e çështjes është i pambështetur në ligj dhe duhet të prishet duke dërguar çështjen për shqyrtim pranë saj si gjykata kompetentë në lëndë.

Tiranë, më datë 7.7.2023

GJYQTARE
Arbena Ahmeti

VENDIM
Nr. 00-2023-3628 (302), datë 22.9.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga:

Sokol Sadushi	kryesues;
Asim Vokshi	anëtar;
Artur Kalaja	anëtar;
Sokol Ngresi	anëtar;
Gentian Medja	anëtar,

më datë 26.5.2023 dhe 22.9.2023 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr. 31003-00313-00-2021 akti që u përket palëve:

PADITËS: Kadri Tafa

TË PADITUR: Enti Kombëtar i Banesave

Drejtoria e Përgjithshme, Enti Kombëtar i Banesave

Drejtoria Rajonale Tiranë

OBJEKTI: Detyrimin e të paditurve: Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria e Përgjithshme dhe Enti Kombëtar i Banesave, Dega Rajonale Tiranë t'i kthejnë paditësit shumën e vlerës monetare, sipas ekstraktit bankar të datës 18.8.2018, të përllogaritur vetëm për periudhën pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 367, datë 18.4.2013, "Për një ndryshim në vendimin nr. 678, datë 18.6.2009, 'Për kthimin në fond banesa të disa objekteve të ish-Kombinatit

të Tekstileve të Pambukta në Tiranë, të Ndërmarrjes Mekanike Tekstile Tiranë dhe ish-Shkollës së Partisë Tiranë"', dhe faturave bankare të datës 27.8.2015, gjithsej në vlerën totale 1.319.828 lekë, derdhur nga paditësi pranë institucionit bankar "Credins Bank" sh.a., për llogari të të padituve, vjelë në kundërshtim me pikën 1, të VKM-së së sipërcituar.

BAZA LIGJORE: Neni 44 i Kushtetutës se Republikës se Shqipërisë; nenet 2, 7, 11, 14, 15, 16,1 7/9, 18, 4, të ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; nenet 4, 5, 15, 118 të "Kodit të Procedurave Administrative"; nenet 31, 48, 153, 154 të Kodit të Procedurës Civile; VKM-ja nr. 678, datë 18.6.2009, "Për kthimin në fond banesa të disa objekteve të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta në Tiranë, të Ndërmarrjes Mekanike Tekstile Tiranë dhe ish-Shkollës së Partisë Tiranë"; VKM-ja nr. 367, datë 18.4.2013, "Për një ndryshim në vendimin nr. 678, datë 18.6.2009, 'Për kthimin në fond banesa të disa objekteve të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta në Tiranë, të Ndërmarrjes Mekanike Tekstile Tiranë dhe ish-Shkollës së Partisë Tiranë", hyrë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare nr. 75, datë 10.5.2013.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË,

si dëgjoi relatimin e paraqitur nga gjyqtari Sokol Sadushi, përfaqësuesin e palës së paditur, Avokaten e Shtetit Valbona Legisi, zhvilloi gjykimin në mungesë të palës paditëse dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi Kadri Tafa ka pasur në posedim një apartament banimi, me sipërfaqe 228 m², ndodhur në katin përdhes të godinës 4-katëshe të ish-Shkollës së Partisë Tiranë.

2. Në bazë të VKM-së nr. 678, datë 18.6.2009, "Për kthimin në fond banesa të disa objekteve të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta në Tiranë, të Ndërmarrjes Mekanike Tekstile Tiranë dhe ish-Shkollës së Partisë Tiranë" *(në vijim "VKM nr. 678/2009")*, objekti në përdorim të paditësit, sikurse edhe objektet e tjera, ka kaluar në fond banesash të Entit Kombëtar të Banesave *(në vijim "EKB")*, me qëllim privatizimin në favor të personave, që i kishin në përdorim, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3. Pas verifikimit në terren, EKB-ja ka kryer procedurat teknike për hartimin e planimetrive dhe plan-rilevimeve, si dhe ato administrative duke aplikuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për pajisjen me certifikatë pronësie. Në zbatim të VKM nr. 678/2009 dhe udhëzimit nr. 17, datë 17.10.2012, "Për procedurat e shitjes së banesave, pjesë përbërëse e objekteve në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave për qëllime privatizimi", të ndryshuar, EKB-ja ka filluar procedurën e privatizimit të objektit në posedim të paditësit.

4. Rezulton që, midis EKB, me cilësinë e shitësit dhe shtetasve Kadri Tafa e Mimoza Tafa, bashkëshortja e paditësit, me cilësinë e blerësve është lidhur "Kontrata e shitjes me rezervë e pronës" me nr. 2306/1 rep., nr. 858/1 kol., datë 11.7.2011. Vlera e plotë e detyrimit financiar për t'u shlyer nga blerësi është parashikuar nga neni 2, pika 2.3.1 të kontratës, në shumën 1.374.722 lekë. Shlyerja e vlerës së plotë të çmimit nga paditësi është parashikuar të kryhet brenda një periudhe 25-vjeçare, me këste mujore të barabarta, ndërsa interesi është përcaktuar 2% në vit, sipas udhëzimit nr. 22, datë 12.10.2010, "Për procedurat e shitjes së objekteve të miratuara për privatizimin sipas VKM-së nr. 676, datë 18.6.2009" (neni 3, pikat 3.1.1 dhe 3.1.3 të kontratës).

5. Ndërkohë, me anë të VKM-së nr. 367, datë 18.4.2013, "Për një ndryshim në VKM nr. 678, datë 18.6.2009, "Për kthimin në fond banesa të disa objekteve të ish-Kombinatit të Tekstileve të Pambukta, në Tiranë, të Ndërmarrjes Mekanike Tekstile Tiranë dhe ish-Shkollës së Partisë Tiranë" *(në vijim "VKM nr. 367/2013")* është ndryshuar pika 2 e VKM-së nr. 678, datë 18.6.2009, në këtë mënyrë: "EKB të bëjë kalimin në pronësi pa kundërshpërblim të këtyre objekteve për personat, të cilët i kanë aktualisht në përdorim". Ndërkohë, paditësi në vitin 2015 ka bërë pagesën e plotë të çmimit të blerjes së apartamentit, fakt i provuar nga mandati bankar, datë 27.8.2015 i Credins Bank dhe është pajisur me certifikatë pronësie, duke i kaluar pronësia mbi pronën objekt gjykimi.

6. Duke pretenduar se pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 367/2013, paditësi nuk duhej të vijonte me pagesën e çmimit sipas kontratës dhe se pala e paditur duhet të bënte privatizimin e objektit pa kundërshpërblim, i është drejtuar disa herë me shkresë palës së paditur, duke i kërkuar kthimin e shumës së paguar.

7. Në këto kushte paditësi i është drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi, duke pretenduar se pala e paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin.

8. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin nr. 4359, datë 3.12.2018, ka vendosur: *"Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit Kadri Tafa, si e pabazuar në ligj dhe në prova [...]", **duke argumentuar se** [...] Ndryshimet që janë bërë pas lidhjes së kontratës në bazë të VKM-së nr. 367, datë 18.4.2013 [...] nuk mund t'i shtrijnë efektet ndaj palës paditëse [...]"* dhe se *"një ndryshim i tillë nuk mund të ketë efekt prapaveprues dhe të zhbëjë një kontratë të lidhur me vullnetin e palëve, në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit [...]. Për më tepër kur, shumë kohë pasi ka hyrë në fuqi ndryshimi sipas VKM, kontrata është ekzekutuar plotësisht me vullnetin e lirë të palës blerëse (paditësit), duke bërë pagesën e të gjithë vlerës së mbetur të papaguar të çmimit. Në këto kushte, gjykata çmon se pala e paditur nuk mund të detyrohet t'i kthejë paditësit shumën e paguar në përmbushje të detyrimit kontraktor."*

9. **Gjykata Administrative e Apelit**, e cila e shqyrtoi çështjen mbi bazën e ankimit të paditësit, me vendimin nr. 224 (86-2021-288), datë 21.4.2021, ka vendosur:

"*Prishjen e vendimit nr. 4359 (80-2018-4474), datë 3.12.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë [...]*", me arsyetimin se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt gjyqësor, të zhvilluar në shkelje të dispozitave procedurale mbi kompetencën lëndore.

10. Kundër vendimit të mësipërm, në datë 28.5.2021, ka ushtruar **rekurs Avokatura e Shtetit**, e cila krahas pretendimeve për themelin e çështjes është fokusuar kryesisht në çështjen e kompetencës lëndore. Sipas saj:

- Vendimmarrja e Gjykatës Administrative të Apelit është e pabazuar në ligj, pasi mosmarrëveshja objekt gjykimi është me natyrë administrative dhe, ndryshe nga sa arsyeton kjo gjykatë, çështja në fjalë nuk është me natyrë të pastër civile.

- Marrëdhënia ndërmjet palëve është një marrëdhënie administrative, pasi kontrata e shitjes e lidhur ndërmjet EKB-së, me cilësinë e shitësit dhe të paditësit me cilësinë e blerësit është shprehje e vullnetit të organit administrativ gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij administrative.

- Është e domosdoshme që të bëhet dallimi ndërmjet një kontrate që lidh një organ administrativ jashtë funksioneve të tij të ngarkuara nga ligji, siç është dhënia me qira e një ndërtese për të mbledhur të ardhura që mund të përdoren më pas për nevojat e vetë organit administrativ, me kontratën e shitjes së EKB-së, e cila konsiderohet si veprim i organit publik në funksion të përmbushjes së detyrave të tij administrative të ngarkuara nga ligji. Prandaj mosmarrëveshja në gjykim është një mosmarrëveshje me natyrë administrative.

- Është i vërtetë fakti (sikundër arsyeton Gjykata Administrative Apelit) se kontrata e shitjes e mbështetur në dispozitat e KC-së është me natyrë civile dhe ka si qëllim fitimin e së drejtës së pronësisë, por duhet bërë dallimi mes një veprimi të tillë juridik, që ka për bazë interesin publik, nga ai i cili ka për bazë interesin individual. Nëpërmjet lidhjes së këtyre kontratave midis një organi publik, siç është Enti Kombëtar i Banesave dhe një subjekti privat, kjo veprimtari e këtij organi publik ka për bazë përmbushjen e programit social për strehimin e të pastrehëve. Ndaj interesi i veprimtarisë së EKB-së nuk duhet vlerësuar si një interes mbi baza individuale/vetjake të atij, që fiton të drejta pronësie.

- Gjykata kompetente për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje objekt gjykimi është gjykata administrative. Ky qëndrim është mbajtur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimet nr. 00-2014-1219, datë 17.4.2014, nr. 00-2014-1777, datë 27.5.2014, nr. 00-2014-1638, datë 12.6.2014 etj. I njëjti qëndrim në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatave është mbajtur në praktikë edhe nga Gjykata Administrative e Apelit. Ndërkohë, me vendimin gjyqësor nr. 224, datë 21.4.2021, objekt i këtij rekursi, Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar praktikën e mbajtur deri më sot edhe nga vetë kjo gjykatë.

II. Procedura në Gjykatën e Lartë dhe nevoja për njësim të praktikës gjyqësore

11. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (*në vijim "Kolegji")* ka konstatuar se, në lidhje me këtë problematikë, duke filluar nga momenti i krijimit të gjykatave administrative e deri më sot, janë vërejtur praktika të ndryshme nga Gjykata e Lartë. Konkretisht, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-4039 (650), datë 27.11.2014, ka vendosur: *"Prishjen e vendimit nr. 288, datë 15.3.2011, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit"*. Në një çështje tjetër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2020-903, datë 16.11.2020, ka vendosur: *"1. Rregullimin e kompetencës lëndore të gjykatave në mosmarrëveshje, duke përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor **Vlorë**, si gjykatë kompetente [...]"*. Gjithashtu edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00–2021–1690, datë 18.10.2021, ka shqyrtuar këtë çështje duke vendosur: *"Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria e Përgjithshme Tiranë, kundër vendimit nr. 328, datë 16.2.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë."*

12. Kolegji ka vlerësuar se është i nevojshëm njësimi i kësaj praktike gjyqësore, me qëllim dhënien e një koncepti më të qartë mbi kontratat administrative, evidentimin e dallimeve që ekzistojnë ndërmjet kontratave administrative dhe atyre të së drejtës private, veçanërisht në rastet kur njëra nga palët është organ publik dhe merr pjesë në procedurat e shitblerjes së banesave, qoftë në kuadrin e programit social të strehimit, ashtu edhe në procedurat që i përkasin privatizimit të banesave shtetërore, si dhe për të konkluduar edhe për gjykatën kompetente që shqyrton çështje të kësaj natyre.

13. Në lidhje me sa më sipër, në referim të nenit 62/a të ligjit nr. 49/2012, "*Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" (i ndryshuar), Kolegji, pasi vlerësoi se rekursi ngre shkaqe që lidhen me zbatimin e ligjit procedural dhe material, të një rëndësie themelore për njësimin e praktikës gjyqësore, kryesisht, me vendim të ndërmjetëm datë 24.4.2023, vendosi të dërgojë çështjen në seancë gjyqësore, për njësimin e praktikës gjyqësore, duke i kërkuar edhe palëve të shprehen lidhur me çështjet që u shtruan për njësim dhe që fokusohen në pyetjet në vijim:

1. Cilët janë elementet ligjore që duhen mbajtur parasysh për identifikimin dhe dallimin e kontratave administrative nga ato civile?

2. Në kuptim të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", ose në rastin kur organi publik ndërhyn me akt nënligjor për zbatimin e një objektivi social, në favor të përfituesve, kontratat që lidhen me këtë rast do të cilësohen si kontrata administrative apo si kontrata civile?

3. Kontrata e privatizimit, në kuptim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa", është kontratë administrative apo civile?

14. Në datë 25.5.2023, pala paditëse Kadri Tafa, ka depozituar pretendimet në lidhje me thelbin e çështjes, që nuk lidhen me çështjet e shtruara për njësim.

15. Në datë 25.5.2023, pala e paditur, Enti Kombëtar i Banesave, ka depozituar pretendimet në lidhje me çështjet e shtruara për njësim, duke parashtruar:

- Kontratat civile dallojnë nga kontratat administrative për vetë faktin se në kontratat administrative organi administrativ shpreh vullnetin e tij si organ i administratës publike gjatë përmbushjes së detyrave të tij funksionale, ndërsa në kontratat me natyrë civile organi administrativ nuk kryen funksione administrative, por merr pjesë në lidhjen e tyre me cilësinë e një personi juridik të zakonshëm.

- Enti Kombëtar i Banesave, si organ i administratës publike ka si detyrë funksionale ndërtimin ose sigurimin e banesave për shtresat në nevojë, duke lidhur me qytetarët kontrata shitjeje banese, prandaj çështja në gjykim ka natyrë të pastër administrative dhe, si rrjedhojë, gjykatës civile i mungon lënda për shqyrtimin e saj.

- Për të përcaktuar natyrën e çështjes në gjykim, është e rëndësishme të saktësohet ose të shihet nëse Enti Kombëtar i Banesave është ose jo organ i administratës publike. Duke e parë në këtë këndvështrim Enti Kombëtar i Banesave është një organ shtetëror, i cili kryen administrimin e banesave të ndërtuara me fonde publike, të cilat përdoren për plotësimin e kërkesave dhe të nevojave të familjeve që janë të pastreha.

- Enti Kombëtar i Banesave, gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, ka të drejtë që në zbatim të ligjit 22/2018 dhe akteve nënligjore përkatëse të lidhë kontrata shitjeje me qytetarët që plotësojnë kriteret e ligjit për personat e pastrehë. Në këto kushte, marrëdhënia mes palëve është një marrëdhënie administrative, pasi kontratat e shitjes ndërmjet EKB-së dhe qytetarëve janë shprehje e vullnetit të organit administrativ gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij administrative.

16. Në seancën gjyqësore të datës 26.5.2023, Avokatura e Shtetit parashtroi se:

- Vendimmarrja e Gjykatës Administrative të Apelit është e pabazuar në ligj, pasi ndryshe nga ç'arsyeton kjo gjykatëse mosmarrëveshja në fjalë është me natyrë të pastër civile, mosmarrëveshja objekt gjykimi është me natyrë administrative.

- Midis paditësit Kadri Tafa dhe të padituve ka lindur një mosmarrëveshje, që buron nga veprimi juridik, kontrata e shitjes me rezervë e pronës, datë 11.7.2011 e hartuar në mbështetje të KC-së.

- Kjo pronë, në bazë të VKM-së nr. 678, datë 18.6.2009, i ka kaluar si fond banesash EKB-së, e cila ka pasur detyrimin për privatizimin e tyre në favor të personave, që i përdornin sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Me udhëzimin nr. 22, datë 12.10.2010, të ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, është përcaktuar procedura e shitjes dhe EKB,-ja pasi është pajisur me certifikatat e pronësisë, i ka privatizuar ato në favor të personave përkatës, përfshirë edhe palën paditëse.

- Për të përcaktuar natyrën e çështjes në gjykim është e rëndësishme që të analizohen dy kritere: *kriteri organik që kërkon praninë e një organi publik në kontratë* dhe *kriteri material që ka të bëjë me ekzistencën e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike*. Në këtë këndvështrim EKB-ja është organ publik (kriteri organik), që ka si veprimtari të

tij administrimin e banesave të ndërtuara me fonde publike, të cilat përdoren për plotësimin e kërkesave familjare për personat, që janë të pastrehë, duke përmbushur misionin thelbësor të administratës publike që është misioni i interesit publik.

- Për sa parashikohet në dispozitat e KPA-së është kusht që njëra nga palët kontraktuese të jetë organ publik, për realizimin e një interesi publik. Në rastin objekt gjykimi, pala e paditur EKB, që ka nënshkruar dhe kontratën e shitjes me kusht me palën paditëse, është një organ publik, i cili ka objekt veprimtarie financimin, ndërtimin, administrimin dhe shitjen e banesave në Republikën e Shqipërisë, duke përmbushur misionin thelbësor të administratës publike që është misioni i interesit publik. Në përputhje me ligjin nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, gjatë veprimtarisë së tij, EKB-ja ka të drejtë t'u shesë banesa shtetasve shqiptarë, të cilët plotësojnë kriteret e ligjit për personat e pastrehë, kundrejt një çmimi të përcaktuar në aktet nënligjore, duke ndihmuar këta persona me anë të kredive të buta. Në këto kushte marrëdhënia ndërmjet palëve është një marrëdhënie administrative, pasi kontrata e shitjes, e lidhur ndërmjet EKB-së, me cilësinë e shitësit dhe të paditësit me cilësinë e blerësit, është shprehje e vullnetit të organit administrativ gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij administrative. Ky qëndrim është mbajtur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimet nr. 00-2014-1219, datë 17.4.2014, nr. 00-2014-1777, datë 27.5.2014, nr. 00-2014-1638, datë 12.6.2014 etj.

- Për çështjet e shtruara për njësim, Avokatura e Shtetit ka parashtruar:

- Lidhur me pyetjen e parë, në kontratat civile dhe ato tregtare, ka një kriter dallues që lidhet me autonominë e palëve për të hyrë në një marrëdhënie kontraktore. Në kontratën administrative, organi administrativ që paraqitet palë në kontratë, nuk mund të ketë të njëjtën autonomi si pala private, kjo për shkak se ai vepron në marrëdhënie të tilla kontraktore, duke u pajisur me një pushtet që rrjedh nga norma ligjore të krijuara paraprakisht. E drejta publike i referohet së drejtës private për qëllimet e saj në qarkullimin juridik civil, ndërkohë që e drejta private për nga karakteristikat që paraqet në qarkullimin juridik civil, është më elastike.

- Kriteret që duhen marrë në konsideratë në dallimin e një kontrate me natyrë civile dhe një kontrate me natyrë administrative janë kriteri *"palë"*, kriteri i *"pabarazisë së palëve*", si dhe kriteri *"përmbajtje"*.

- Kontrata private me palë shtetërore janë ato kontrata që mund të identifikohen nga këto kritere:

- Interesat e administratës janë thjesht ekonomike në qarkullimin juridik civil;

- Aplikohen normat e së drejtës civile dhe jo norma të së drejtës publike;

- I mungon përmbajtja me interes të përgjithshëm publik;

- Karakterizohen nga interesi i institucioneve shtetërore për të mbrojtur interesat e saj. Kontrata të tilla janë, si p.sh., ato të mirëmbajtjeve të ndryshme, të qirave të ambienteve etj.

- Sipas legjislacionit francez, kompetent për shqyrtimin e kontratave ku palë është administrata publike, pavarësisht zbatimit të normave civile, tregtare apo atyre publike, është gjyqtari i gjykatës administrative. Në Francë, kompetenca lidhet thjesht me të qenët palë të institucionit kompetent publik. Në sistemin gjerman nuk ndiqet kriteri i palës që merr pjesë në kontratë, por përmbajtja e normave publike që rregullojnë kontratën e kësaj natyre. Në sistemin italian është gjyqtari civil që gjykon mosmarrëveshje kontraktore me palë publike apo me përmbajtje të normave të së drejtës publike dhe private.

- Lidhur me pyetjen e dytë, objekt i ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social", është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse (neni 1, pg. 1). Si rrjedhim, plotësimi i nevojave të shtetasve për strehim, përbën ndër objektivat socialë që shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private synon të arrijë (neni 59, shkronja "b" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë).

- Duke parë dhe trajtimin që i ka dhënë ligji për strehimin social, vlerësohet se në çdo rast kur organi publik ndërhyn me akt nënligjor për zbatimin e një objektivi social, në favor të përfituesve, kontratat që lidhen me këtë rast do të cilësohen si kontrata administrative.

- Lidhur me pyetjen e tretë, në rastin objekt gjykimi, duke qenë një marrëdhënie juridike, e cila i përket fushës së të drejtës publike dhe jo asaj private, ajo nuk duhet të trajtohet si një marrëdhënie kontraktore, që ka lindur nga një kontratë e thjeshtë mes palëve kontraktuese, por si një marrëdhënie kontraktore me natyrë administrative dhe mosmarrëveshjet që lindin ndërmjet palëve kontraktuese në këtë kontratë duhet të rregullohen nga ligji specifik, nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", dhe nëse ka zbrazëti në të, atëherë mund t'u drejtohemi për zgjidhjen e çështjes dispozitave të parashikuara nga KC-ja.

Organi publik, palë kontraktore, pra EKB-ja, me anë të lidhjes së kësaj kontrate qartazi vepron në drejtim të mbrojtjes së interesit publik që identifikohet me mbrojtjen e qytetarëve, të cilët, për shkak të kushteve ekonomike, janë në pamundësi për t'u strehuar pa ndihmën e shtetit.

III. Ligji i zbatueshëm

17. Ligji nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (*në vijim "ligji nr. 49/2012"):*

- në nenin 1(2), i titulluar "Objekti" parashikon: "*Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.*"

- në nenin 2, pika 6, parashikon: *"Organ publik" është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ i pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ i Forcave të Armatosura, çdo strukturë tjetër, punonjësit e së cilës gëzojnë statusin e ushtarakut, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike."*

18. Kodi i Procedurave Administrative *(në vijim "KPA"):*

- në nenin 3, pika 6 parashikon: "*Organ publik" është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ i pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ i Forcave të Armatosura, çdo strukturë tjetër, punonjësit e së cilës gëzojnë statusin e ushtarakut, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike."*

- në nenin 3, pika 4, parashikon: *"Kontrata administrative është një marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik."*

- në nenin 119 parashikon: *"1. Organi publik, për realizmin e një interesi publik, te cilit i shërben, por pa cenuar interesat apo te drejtat e palëve të treta, mund të lidhë një kontrate administrative [...]."*

- në nenin 120 parashikon: *"1. Organi publik mund të lidhë një kontratë administrative zëvendësuese me palën, së cilës mund t'i drejtonte një akt administrativ, nëse interesi publik realizohet më mirë nëpërmjet kontratës administrative."*

- në nenin 121 parashikon: *"Organet publike mund të lidhin ndërmjet tyre kontrata për rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët."*

- në nenin 122 parashikon: *"Pavlefshmëria e kontratës administrative rregullohet sipas dispozitave të Kodit Civil që parashikojnë pavlefshmërinë e veprimit juridik."*

- në nenin 123 parashikon: *"1. Nëse, për shkak të rrethanave të shfaqura pas lidhjes së kontratës dhe të paparashikueshme në kohën e lidhjes së saj, vazhdimi i ekzekutimit të detyrimeve të kontratës bëhet shumë i vështirë për njërën nga palët kontraktuese, ato mund te bien dakord për ndryshimin apo prishjen e kontratës. 2. Organi publik mund të tërhiqet nga kontrata administrative në mënyrë të njëanshme për të shmangur ose për të ndaluar cenimin e interesit publik. 3. Tërheqja bëhet me akt administrativ të shkruar dhe të arsyetuar, kundrejt kompensimit të dëmit që i është shkaktuar palës tjetër."*

- në nenin 124 parashikon: *"Për çështjet e parregulluara shprehimisht nga ky Kod për kontratën administrative, zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë apo të parashikimeve të posaçme ligjore."*

- në nenin 125 parashikon: *"Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese, që buron nga një kontratë administrative, zgjidhet drejtpërdrejt nga gjykata kompetente për çështjet administrative."*

19. Kodi Civil:

- në nenin 79 e përkufizon veprimin juridik si *"[...] shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile."*

- në nenin 659 e përkufizon kontratën si *"[...] veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike."*

- në nenin 660 parashikon: *"Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi."*

20. Ligji nr. 22/2018, "Për strehimin social";

21. Ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe ligji nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa".

IV. Vlerësimi i Kolegjit mbi çështjet e ngritura për njësim

a) Parashikimet ligjore për kontratat administrative

22. Organet administrative, krahas zbatimit të normave të së drejtës publike, me qëllim realizimin e funksioneve të tyre, janë të detyruara të veprojnë edhe sipas normave të së drejtës private dhe të kontraktojnë me subjektet e tjera të së drejtës në kontrata, të njohura si kontrata administrative. Kuptimi për kontratat administrative parashikohej për herë të parë në KPA të vitit 1999, në të cilin përcaktoheshin vetëm nocionet

kryesore, pa ndonjë shtjellim të hollësishëm. Sipas nenit 6 të atij Kodi, kontrata administrative quhen ato marrëveshje, ku të paktën njëra nga palët është organi i administratës publike dhe që synojnë të krijojnë, të ndryshojnë ose të anulojnë marrëdhënie juridike në fushën e së drejtës publike. Në nenin 151 të Kodit parashikohej, se: "Kontrata administrative është një marrëveshje nëpërmjet së cilës krijohet, modifikohet apo shuhet një marrëdhënie juridike e së drejtës publike". Kjo dispozitë e Kodit bënte, gjithashtu, një parashikim kufizues të kontratave administrative, nëpërmjet listimit të tyre në kontratat e sipërmarrjeve të punëve publike, prokurimi i punëve publike, prokurimi i shërbimeve publike, licencimi i lojërave të fatit, kontratat e furnizimit të vazhdueshëm, si dhe kontraktimi i shërbimeve të subjekteve private, në rastet e fatkeqësive natyrore. Pavarësisht këtij formulimi, legjislacioni i posaçëm dhe jurisprudenca gjyqësore e kanë zgjeruar kuptimin për kontratat administrative, duke përfshirë edhe kontrata të tjera, si ajo e koncesionit, e enfiteozës etj.

23. KPA-ja i vitit 2015 synon një rregullim më të zgjeruar, por pa dhënë ndonjë zgjidhje shteruese. Në nenin 3, pika 4, të KPA-së thuhet, se: "'*Kontrata administrative'* është një marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik." Me rregullimin që bën neni 119 i Kodit nuk ndiqet teknika e listimit të kontratave administrative, por jepet një kuptim më i zgjeruar, si dhe parashikohen kushtet dhe kërkesat që duhet të plotësohen për lidhjen e tyre. Në Kod pranohet lidhja e kontratës administrative "në formë të shkruar, përveç rasteve kur ligji parashikon një formë tjetër të posaçme". Kjo do të thotë se kontratat administrative lidhen gjithnjë së paku me shkrim, përveç kur ligji parashikon shprehimisht një formë tjetër, ndërsa kontratat e tjera, sipas së drejtës private, kur ligji nuk përcakton formën, mund të lidhen me shkrim, me gojë apo me çdo lloj shfaqje tjetër të padyshimtë të vullnetit. Forma kontraktore administrative, që lidhet për realizmin e një interesi publik dhe që nuk cenon interesat apo të drejtat e palëve të treta, nuk duhet të "ndalohet shprehimisht nga ligji" dhe as duhet të jetë "në kundërshtim me vetë natyrën e çështjes administrative" (neni 119, pika 1, shkronja "a"). Një rregullim i tillë është shumë i zgjeruar, sepse nuk kufizon organin për lidhjen e kontratës administrative, përderisa pranon apo kërkon vetëm që kjo formë e veprimtarisë administrative të jetë e tillë që nuk ndalohet nga ligji. Gjithashtu, i jepet shumë më tepër hapësirë vlerësimi organit publik, sepse autorizohet "nga ligji të vendosë për çështjen me diskrecion" (shkronja "b") dhe zgjedhja e kontraktuesit privat në një kontratë administrative i përket administratës sipas një procedure të përcaktuar me ligj. Megjithëse administrata ka pushtet diskrecionar në zgjedhjen e kontraktuesit privat, një procedurë e tillë nuk është e pakontrollueshme, në rrugën e kontrollit administrativ ose të kontrollit gjyqësor.

24. Pavarësisht parashikimeve të tilla ligjore, identifikimi i kontratës si administrative dhe dallimi i saj nga kontrata të lidhura ekskluzivisht sipas regjimit të së drejtës private nuk paraqitet aq i lehtë, si për doktrinën juridike, ashtu dhe për praktikën gjyqësore. Përcaktimi i natyrës juridike të kontratës, në të cilën një nga palët është organ publik evidenton njëkohësisht edhe kompetencën e gjykatës, që do të zgjidhë mosmarrëveshjen që mund të lindë. Për këtë, Kolegji vlerëson të nevojshme të specifikohen kriteret që shërbejnë për të dalluar natyrën administrative të një kontrate nga ajo civile, sepse në këtë mënyrë arrihet të qartësohet edhe kompetenca lëndore e gjykatës.

b) Dy mënyrat klasike që përdoren për identifikimin e kontratave administrative

25. Kolegji konfirmon qëndrimin e tij për dy mënyrat që përdoren për identifikimin e kontratave administrative. Sipas një mënyre, natyrën e kontratës dhe, për rrjedhojë, kompetencën e gjykatës që do të zgjidhë mosmarrëveshjet mes palëve, mund ta përcaktojë drejtpërdrejt vetë ligji, ndërsa mënyra tjetër është kur gjykata, në një mosmarrëveshje mes palëve, nëpërmjet zbatimit të kritereve të përgjithshme dhe kryerjes së analizës dhe metodave të interpretimit, bën cilësimin e kontratës, si administrative ose si civile. Paqartësitë apo keqkuptimet në praktikë nuk lindin për rastet kur natyrën e kontratës dhe kompetencën e gjykatës e parashikon vetë ligji, por për mënyrën se si gjykata përcakton natyrën e kontratës, si dhe kompetencën e saj, e cila është çështja kryesore që shtrohet për zgjidhje në këtë vendim njësues.

26. Nga pikëpamja e teknikës legjislative, mund të parashikohet shprehimisht në ligjin material natyra e një kontrate si administrative, ndërsa në ligjin procedural se gjykimi i mosmarrëveshjeve për një kontratë specifike i përket kompetencës lëndore të gjykatës administrative. Me një parashikim të tillë ligjor, kontrata është administrative pa qenë nevoja të përmbushen kriteret e përgjithshme të kontratës administrative, sipas neneve 3, pika 4, të KPA-së. Vetë KPA-ja ka bërë cilësime për disa kontrata administrative. Kështu, në nenin 90 parashikohet natyra administrative e një kontrate që lidhet në përfundim të një procedure administrative, ndërsa në nenin 120 përcaktohet në mënyrë të drejtpërdrejtë karakteri administrativ i kontratës që zëvendëson aktin administrativ *(kontrata administrative zëvendësuese)*. Kjo e fundit është një kontratë administrative e lidhur mes palëve

që janë eprore apo vartëse me njëra-tjetrën, që zakonisht përfshijnë organin publik nga njëra anë dhe personin privat nga ana tjetër. Nëpërmjet një kontrate të tillë *(subordinate),* organi publik bën atë që përndryshe do të kishte bërë me nxjerrjen e një akti administrativ. Në nenin 121 parashikohet një tjetër kontratë administrative me objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët ndërmjet organeve publike *(coordinate),* e quajtur ndryshe *kontratë administrative bashkërendimi* apo *koordinimi*. Parashikime për kontrata administrative gjenden edhe në ligje të tjera. Kështu, në nenin 4, pikat 14, deri 20 të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të gjitha kontratat në këtë fushë cilësohen si: *"kontrata publike"*. Në nenin 3/1 të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", parashikohet shprehimisht, se: "*Koncesion" është koncesioni i punëve publike ose koncesioni i shërbimeve publike [...]*, ndërsa në nenin 3/23 parashikohet se *"Kontratë e partneritetit publik privat" ka kuptimin e një kontrate pune publike apo kontrate të shërbimit publik*. Edhe në ligjin nr. 10416/2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor" (në nenet 49 deri 52), parashikohet lidhja e kontratave publike të shërbimeve në fushën e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, midis Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve dhe palëve të treta, subjekte publike apo private etj.

27. Nga ana tjetër, ligjvënësi mund të përcaktojë, gjithashtu, se gjykimi i mosmarrëveshjeve për një kontratë të caktuar, i përket kompetencës lëndore të gjykatave administrative. Pra, nëse ligji, pa u shprehur drejtpërdrejt për natyrën juridike të kontratës, parashikon se mosmarrëveshjet rreth kontratës konkrete do të gjykohen nga gjykata administrative, atëherë ligji ka përcaktuar edhe natyrën administrative të kontratës. Kështu, p.sh., ligji nr. 93/2015, "Për turizmin" dhe VKM-së nr. 369, datë 18.5.2016 miratimi i rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit", kanë parashikuar se zgjidhja e mosmarrëveshjeve mbi kontratën për përdorimin e hapësirës së plazhit: "*do të jetë në kompetencën e gjykatës administrative përkatëse"*. Në të gjithë rastet e sipërcituara, kontrata identifikohet si administrative, për shkak të përcaktimit të kompetencës nga vetë ligji, pa qenë nevoja të përmbushen kriteret e përgjithshme të kontratës administrative sipas nenit 3, pika 4 të KPA-së.

28. Problematika më e madhe për të identifikuar natyrën e kontratës administrative, si dhe për të përcaktuar kompetencën lëndore krijohet, kur një gjë e tillë nuk është e parashikuar nga ligji, por duhet ta zgjidhë gjykata, nëpërmjet interpretimit dhe arsyetimit gjyqësor. Kjo është mënyra tjetër për identifikimin e kontratës administrative. Pikërisht, për të qartësuar konceptin mbi kontratën administrative, me synimin për të bërë dallimin e saj nga kontrata private (civile) dhe, për rrjedhojë, për të përcaktuar kompetencën lëndore të gjykatës që do të zgjidhë mosmarrëveshjet në këto raste, Kolegji vlerëson se duhet thelluar edhe më tej analiza juridike për kriteret e përgjithshme të kontratës administrative. Në raste jo të pakta është tentuar nga doktrina dhe praktika gjyqësore dhënia e përkufizimeve për kontratat administrative, bërja e analizave dhe interpretimeve mbi natyrën e këtyre kontratave dhe dallimin nga kontratat private, gjë që ka sjellë edhe mbajtjen e qëndrimeve të ndryshme dhe jo të konsoliduara, të cilat kanë detyruar së fundmi Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë për të kryer njësimin e praktikës gjyqësore, në këtë drejtim. Jo pa qëllim, Kolegji e fillon analizën e kësaj çështjeje me shtrimin e pyetjes së parë, se: **"Cilat janë elementet ligjore që duhen mbajtur parasysh për identifikimin dhe dallimin e kontratave administrative nga ato civile?"**

c) Identifikimi i kritereve të përgjithshme të kontratës administrative

29. Së pari, Kolegji sjell në vëmendje, se për të arritur në përfundimin nëse një kontratë është apo jo administrative, analiza duhet të niset nga përkufizimi dhe rregullimi ligjor që bëhet në KPA. Kështu, në nenin 3, pika 4, të këtij Kodi parashikohet, se: "*kontrata administrative është një marrëveshje e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik.*" Referuar doktrinës juridike, mënyrës së rregullimit që bën ligji, por edhe praktikës së Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, rezulton se dy janë kriteret bazë, që ndihmojnë për identifikimin e kontratës administrative dhe dallimin e saj nga kontrata private. Njëri është *kriteri organik*, që kërkon praninë e një organi publik në kontratë dhe tjetri është *kriteri material*, që lidhet me lëndën e kontratës dhe, më konkretisht, me ekzistencën e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike. Nga mënyra si është hartuar neni 3, pika 4, e KPA-së (ashtu si edhe neni 6 i KPA-së të vitit 1999), dy kriteret rezultojnë të jenë kumulative dhe joalternative.

30. Pavarësisht se në pamje të parë, përmbushja e kriterit organik duket si një kriter formal dhe lehtësisht i identifikueshëm, me zgjidhjen që ka bërë ligjvënësi në vite, duke evoluar nga koncepti i ngushtë ligjor *"organ i administratës shtetërore*", në atë të *"organit të administratës publike",* duke ardhur gradualisht në një koncept shumë më të zgjeruar të *"organit publik"*, por edhe për arsye se koncepti i shërbimit publik dhe i interesit publik përfshihet jo vetëm te organet e mirëfillta të administratës shtetërore, por, në raste të veçanta, edhe te personat privatë që u

njihet "*e drejta e ushtrimit të funksioneve publike"*, Kolegji vlerëson të nevojshme të bëjë një analizë më të thelluar, si për *"kriterin organik"*, ashtu edhe për *"kriterin material"*. Lidhur me plotësimin e *"kriterit organik",* shtrohet pyetja: *Nëse i përmbush elementet e një kontrate administrative vetëm plotësimi i kushtit të ekzistencës si palë i një organi administrativ, ndërkohë që sipas ligjit ai kryen qoftë funksione publike administrative, të rregulluara nga e drejta administrative, ashtu edhe veprime të administratës publike që rregullohen nga e drejta private?*

31. Nga një lexim i shpejtë dhe sipërfaqësor i nenit 3, pika 4, të KPA-së, sipas të cilit: *"kontrata administrative është një marrëveshje [...] në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik"*, në jo pak raste, pyetjes së shtruar më lart i është dhënë përgjigje se kontrata është administrative. Në fakt, dispozita duhet analizuar në tërësinë e saj, sipas së cilës "kontrata administrative" është një marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, *sipas së drejtës publike[...]"*. Që një kontratë të cilësohet si administrative dhe të përputhet me kuptimin e nenit 3, pika 4, të KPA-së, nuk mjafton vetëm prania si palë kontraktore e një subjekti të së drejtës publike, por nevojitet që në ushtrimin e veprimtarisë, ai *"të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre"* (neni 1 i KPA-së). Sipas këtij vlerësimi, përfshirja në një kontratë e organit publik duhet të kuptohet si masë e ushtruar "me qëllim realizimin e interesit publik të cilit i shërben", duke përmbushur parakushtin ligjor "sipas së drejtës publike", nëse kontrata ka për qëllim të ketë ndikim të drejtpërdrejt në një çështje që rregullohet nga e drejta publike, edhe pse objekti i kontratës nuk rregullohet nga e drejta administrative. Kjo mbetet një çështje thelbësore për identifikimin e natyrës së kontratës, përderisa pranohet se organet publike nuk janë të kufizuara vetëm në kryerjen e veprimtarisë, që lidhen me funksionet publike administrative, të rregulluara nga e drejta administrative, por janë të detyruara të kryejnë veprime edhe në kuadrin e të drejtës private.

32. Kushti për praninë si palë në një kontratë të organit publik nuk përjashton faktin se kontrata administrative mund të lidhet edhe ndërmjet dy ose më shumë organeve publike, ashtu si edhe midis dy subjekteve të së drejtës private. Pra, nevojitet të analizohet, gjithashtu: *nëse do të konsiderohet kontratë administrative, kur palë në këtë kontratë nuk është organi shtetëror, por janë subjekte të së drejtës private, që sipas ligjit u njihet e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike?* Në këtë aspekt është e domosdoshme të bëhet paraprakisht një analizë e konceptit *"organ publik"*.

ç) Mbi organin publik

33. Neni 2, pika 6, e ligjit nr. 49/2012, ka dhënë, për herë të parë, një koncept të zgjeruar, sipas të cilit: *"Organ publik" është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative; çdo organ i pushtetit vendor që kryen funksione administrative; çdo organ i Forcave të Armatosura, çdo strukturë tjetër, punonjësit e së cilës gëzojnë statusin e ushtarakut, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.* Nga kjo dispozitë ligjore dallohet menjëherë se përkufizimi që i bëhet nocionit *"organ publik"* është më i zgjeruar se përkufizimi i nocionit *"organ i administratës publike"* që bën neni 3 i KPA-së i vitit 1999. Në fakt, neni 2, pika 6, të ligjit nr. 49/2012, përveçse ka marrë, në mënyrë identike, të gjithë përcaktimet e nenit 3 të KPA-së të vitit 1999, ka shtuar formulimin se organ publik është edhe: *"[...] çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike"*. Pikërisht, kjo shtesë e bërë në përkufizimin *"organ publik"* merr një rëndësi të veçantë për mundësinë e cilësimit si administrative edhe të kontratave të lidhura edhe mes personave të së drejtës private.

34. Nga zgjidhja që ka bërë ligjvënësi rezulton se çdo person fizik ose juridik mund të cilësohet organ publik, vetëm nëse nëpërmjet kontratës së lidhur i është njohur "*e drejta e ushtrimit të funksioneve publike"*. Pra, një kontratë mund të cilësohet si administrative, edhe pse është nënshkruar midis dy subjekteve të së drejtës private, me kusht që njërit nga personave të së drejtës private, i cili është palë kontraktuese, t'i jetë dhënë e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative/publike *(shih vendimin nr. 577, datë 14.1.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë).* Kështu, shoqëritë aksionare, sipas rastit, mund të përfshihen në kategorinë e subjekteve, që u është dhënë e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative/publike dhe, për rrjedhojë, të konsiderohen "organ publik", ashtu si edhe palë të një kontrate administrative *(shih vendimin e Kolegjit Administrativ nr. 00-2014-3136, datë 11.9.2014).* Nga ana tjetër, përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, kur një person juridik privat, të cilit i është njohur e drejta e ushtrimit të funksioneve publike, lidh kontrata në funksion të objektit të veprimtarisë së vet, këto nuk konsiderohen kontrata administrative, por private, përjashtimisht rasteve kur përmbajnë kushte kontraktore që shmangen nga e drejta private, ose bien nën një regjim juridik që shmanget nga e drejta private, apo kur ushtrojnë veprimtari të cilat për nga natyra e tyre hyjnë në kompetencat e organeve publike.

35. Kushti i ushtrimit të funksioneve publike nevojitet të përmbushet, gjithashtu, edhe nga çdo subjekt i së drejtës publike. Kështu, nuk do të konsiderohet i plotësuar kriteri organik në ato raste, kur me nënshkrimin e kontratës, një person juridik i së drejtës publike nuk vepron në ushtrimin e funksioneve të tij

administrative/publike, por vepron si një subjekt i së drejtës private. Këtë qëndrim jo shumë të konsoliduar e gjen edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, sipas të cilës: *"[...] pavarësisht se palë e kontratës është një organ i administratës publike, në këtë marrëdhënie ai merr pjesë jo si subjekt i së drejtës publike, që ushtron pushtet dhe sovranitet shtetëror, por si subjekt i së drejtës private, në pozita të barabarta me subjektet e tjera të së drejtës private [...]"(shih vendimin nr. 00-2017-159, datë 28.2.2017 dhe vendimin nr. 00-2017-1167, datë 22.6.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).*

36. Në përmbyllje të këtij arsyetimi, Kolegji thekson, se: **prania e një subjekti që identifikohet si organ publik nuk e bën automatikisht kontratën të cilësohet administrative. Përkundrazi, përmbushja domosdoshmërisht edhe e kriterit material është thelbësore për kontrata të tilla. Pra, ushtrimi i funksioneve administrative/publike në një kontratë është kusht që pala të cilësohet si organ publik, në kuptim të nenit 3, pika 6 të KPA-së dhe, për rrjedhojë, edhe kriteri organik të konsiderohet i plotësuar.**

d) Mbi kriterin material

37. Siç edhe u përmend më lart, neni 3, pika 4 e KPA-së përcakton një tjetër kriter të rëndësishëm që duhet përmbushur, me qëllim që kontrata të cilësohet si administrative. Përveç kriterit organik duhet që të krijohen, ndryshohen apo shuhen marrëdhënie juridike konkrete, sipas së drejtës publike. Ky është **kriteri material**, pasi ka të bëjë drejtpërdrejt me lëndën e kontratës administrative. KPA-ja ka shtuar edhe një tjetër element të rëndësishëm, që lidhet me kriterin material. Sipas nenit 119, pika 1, kontrata administrative duhet të ketë për qëllim dhe objekt *"[...] realizimin e një interesi publik, të cilit i shërben[...]."* Ky element i kriterit material shërben për të përkufizuar kontratën administrative, por edhe si një kusht vlefshmërie për lidhjen e saj.

38. Për të qartësuar konceptin mbi kriterin material, që duhet të përmbushet në një kontratë administrative, nevojitet të evidentohen të përbashkëtat apo dallimet mes konceptit ligjor *"marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike"* (neni 3, pika 4, e KPA-së) dhe konceptit të *"marrëdhënies juridike"* (neni 659 i KC-së), që është i pranishëm në një kontratë të së drejtës private. Kolegji vlerëson se një analizë e tillë shërben për të evidentuar njëkohësisht edhe dallimin mes së drejtës publike dhe së drejtës private.

i. Dallimi mes së drejtës publike dhe së drejtës private.

39. Për shkak të problematikës, por edhe të rëndësisë që paraqet kjo çështje, si doktrina juridike, ashtu edhe jurisprudenca gjyqësore e kanë trajtuar gjerësisht, me synimin për të arritur në një qëndrim të konsoliduar. E rëndësishme për të bërë dallimin ndërmjet një kontrate të së drejtës publike dhe private është mënyra e pjesëmarrjes së kontraktorit (e njohur si (pa)barazia e palëve), gjë e cila përcakton edhe natyrën e kontratës. Pranohet gjerësisht se e drejta kontraktore private është një e drejtë ku dominojnë marrëdhënie juridike midis subjektesh juridikisht të barabartë, ndërsa e drejta publike dominohet nga marrëdhënie juridike, që i vendos palët në një marrëdhënie jo të njëllojtë. Të drejtat që gëzojnë palët në një kontratë, sipas së drejtës private *(neni 660 i KC-së)*, ku përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj brenda kufijve të ligjit, nuk parashikohen njëlloj për palët edhe në kontratat administrative. Kontratat publike ose administrative janë çështje të së drejtës administrative dhe autoriteti administrativ në këto kontrata nuk qëndron në të njëjtin pozicion me palën tjetër kontraktuese. Kështu, administratës publike nuk i njihet autonomi negociuese dhe liri kontraktore, ashtu si në kontratat e së drejtës private. Në rast se palëve në një kontratë administrative do t'u jepej e njëjta liri që kanë palët në një kontratë private, kjo do të ngushtonte diferencën që ekziston mes tyre dhe nuk do të diktonte nevojën e ekzistencës së një kontrate të tillë. Kështu, e drejta e autoritetit administrativ për të ndërhyrë në çdo moment, si dhe për t'u tërhequr, qoftë edhe në mënyrë të njëanshme, përbën një veçori të këtyre kontratave. Sidoqoftë, e drejta e administratës për të kryer veprime të tilla, me efekt të njëanshëm, nuk rrjedh drejtpërdrejt nga kontrata, por nga vetë natyra e pushtetit administrativ që krijon mundësi për të vepruar si një fuqi sovrane, që ka në themel interesin publik të cilit i shërben.

40. Element dallues që shërben për të bërë ndarjen mes së drejtës publike dhe së drejtës private është *shërbimi publik*. Vetë administrata publike, nëpërmjet veprimtarisë së saj ka gjithmonë për qëllim të përmbushë një mision shërbimi publik, gjë që e bën marrëdhënien të cilësohet si një marrëdhënie juridike e së drejtës publike. Kështu, vetëm një kontratë që ka në objektin e saj *"një veprimtari të shërbimeve publike"* ose *"realizmin e një interesi publik"* (neni 119 i KPA-së) do të cilësohet si kontratë administrative.

41. Një tjetër element që ndihmon në bërjen e dallimit midis së drejtës publike dhe së drejtës private është i njohur në doktrinë me termin *prerogativat e fuqisë publike*, të cilat zotërohen nga administrata publike dhe që lidhen me nxjerrjen e *aktit administrativ të njëanshëm*, me *ushtrimin e pushtetit diskrecial* dhe me *privilegjin e ekzekutimit paraprak*. Në KPA gjendet i gjithë kuadri ligjor që rregullon këto prerogativa të fuqisë publike. Nenet 98 deri 118 të KPA-së rregullojnë konceptin për aktin administrativ të njëanshëm, neni 3, pika 3, i KPA përkufizon pushtetin diskrecial si së drejtën e organit publik *"[...] për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik"*, ndërsa

privilegji i ekzekutimit paraprak në favor të administratës publike shfaqet në disa raste (neni 133/3 i KPA-së), ku ligji përcakton mospezullimin e zbatimit të aktit administrativ në rastin e detyrimeve tatimore ndaj subjekteve tatimpaguese, ose edhe në ligje të tjera që përcaktojnë ekzekutimin e menjëhershëm të dënimit me gjobë nga organet administrative pa pritur vendimin gjyqësor të formës së prerë (si p.sh., ligji nr. 10279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative"). Pikërisht, këto tre përbërës të së drejtës publike kanë për qëllim përmbushjen e misionit më thelbësor të administratës publike, që është misioni i interesit publik.

42. Dallimi midis së drejtës publike dhe së drejtës private bazohet në teorinë e interesave, që mbrojnë normat juridike. E drejta publike është e drejtë e posaçme e shtetit dhe përmban norma juridike të cilat mbrojnë interesat e shtetit si organizim në funksion të interesit publik, ndërsa e drejta private përmban norma juridike, të cilat mbrojnë interesat e subjekteve private. Në këtë aspekt, një element kryesor i së drejtës publike, që është qëllim i administratës publike dhe që e dallon të drejtën publike nga e drejta private, është *interesi publik*. Mbrojtjen e interesit publik, KPA-ja e parashikon në shumë dispozita, si p.sh., nenet 1, 4, 12, 119/1 dhe 123, ashtu si ligji nr. 49/2012 parashikon në nenin 3/2, se: *Gjykata administrative zbaton parimin e mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave e interesave të ligjshëm të personave privatë*", si një nga parimet e gjykimit administrativ.

43. Bazuar në sa më sipër, Kolegji thekson se koncepti i ***"marrëdhënie*****ve konkrete, sipas së drejtës publike",** nënkupton marrëdhënie juridike të cilat mund të përmbledhin, në të njëjtën kohë ose veç e veç, shumë elemente, si kryerja e një shërbimi publik, ushtrimi i prerogativave të fuqisë publike, raporti jo i njëjtë mes palëve sa i përket mënyrës së formimit dhe shfaqjes së vullnetit kontraktor, përmbushja e interesit publik etj. Në këtë mënyrë, sa herë gjendemi përpara një kontrate të nënshkruar nga një organ publik, që krijon të drejta dhe detyrime të normuara nga e drejta publike të cilat mund të jenë edhe të shpërpjestuara midis palëve në favor të organit publik, që nuk bazohen në parimet e autonomisë së vullnetit dhe të barazisë midis privatëve, atëherë kriteri material (marrëdhënie juridike në fushën e së drejtës publike) konsiderohet i plotësuar.

ii. Elementet e kriterit material

44. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka analizuar, në jo pak raste, nevojën mbi ekzistencën e disa elementeve të tjera, të cilët veprojnë si tregues kryesorë për përmbushjen e kriterit material (praninë e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike). Bazuar në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, Kolegjie vlerëson të domosdoshme të ritheksojë, se*: kur plotësohet kriteri organik (një nga palët në kontratë është organ publik), atëherë kontrata do të konsiderohet si administrative, me kushtin që të përmbushet edhe kriteri material (ekzistenca e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike), i cili është i lidhur me rastet kur kontrata administrative:*

- *ka për objekt kryerjen ose ekzekutimin e një veprimtarie shërbimi publik;*
- *ka për objekt kryerjen e punëve publike;*
- *ka për objekt ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave dhe funksioneve administrative/publike;*
- *financohet nga paratë publike;*
- *rregullohet dhe i nënshtrohet një regjimi juridik të së drejtës publike;*
- *ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët të organeve publike.*

45. Të gjithë këto elemente apo nënkritere nuk janë vlerësuar si kumulative, por si alternative dhe, si të tilla, mjafton ekzistenca e njërit prej tyre në një kontratë që kriteri material të konsiderohet i përmbushur, ndonëse jo pak herë kontratat përmbajnë dy apo më tepër nga elementet e mësipërm. Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë ka zhvilluar praktikën gjyqësore, duke i dhënë një kuptim më të zgjeruar kriterit material, përmes analizës së këtyre elementeve, me synim përcaktimin e drejtë të natyrës së kontratës administrative dhe për ta dalluar atë nga kontrata civile. Konkretisht:

46. *Kontrata ka për objekt kryerjen e një veprimtarie shërbimi publik*. Sipas kuptimit që jepet në nenin 119, pika 1, të KPA-së, lidhja e një kontrate administrative bëhet në funksion të realizmit nga organi publik *"të një interesi publik, të cilit i shërben [...],"*. Pikërisht, karakteri administrativ i kontratës do të rezultojë nëse objekti i saj është i lidhur me një veprimtari shërbimi publik. Nënkriteri i kryerjes së një veprimtarie shërbimi publik nuk është gjithmonë i lehtë për t'u evidentuar në një kontratë. Prandaj, para se të arrihet në përfundimin se një kontratë është administrative duhet të identifikohet ekzistenca e një veprimtarie shërbimi publik dhe më pas të verifikohet natyra juridike e kontratës. Kështu ligji nr. 13, datë 18.2.2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", ka dhënë një përkufizim të shërbimit publik, por që nuk rezulton të jetë shterues. Ka ligje të tjera që pa dhënë ndonjë përkufizim të shërbimit publik, ose kritere për identifikimin e tij si koncept, cilësojnë shprehimisht veprimtari të caktuara si veprimtari shërbimi publik *(neni 47 i ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike")*, ose veprimtari interesi publik *(neni 6 i ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin")*, ndërkohë që jurisprudenca gjyqësore nuk ka bërë ndonjë përkufizim. Përgjithësisht është pranuar se kontrata është administrative kur i beson një personi fizik ose juridik të së drejtës private ekzekutimin e një shërbimi publik.

Shembulli tipik i kontratave që kanë për objekt kryerjen e një veprimtarie shërbimi publik janë koncesionet dhe partneritetet publike private. Duke ia besuar kontraktuesit privat ekzekutimin e një shërbimi publik, organi publik pranon ta bëjë këtë subjekt privat zbatues të vërtetë të këtij shërbimi. Pikërisht, kryerja e një veprimtarie të tillë përcakton natyrën administrative të kontratës dhe, për rrjedhojë, nënshtrimin e saj normave të së drejtës publike, por edhe kompetencën e gjykatave administrative për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lindin për shkak të tyre. Qartësimi që i ka bërë ligji natyrës së këtyre kontratave nuk ka krijuar ndonjë problematikë as për praktikën gjyqësore.

47. *Kontrata ka për objekt kryerjen e punëve publike.* Pranohet se kontrata e nënshkruar nga një organ publik do të krijojë efekte dhe pasoja juridike në fushën e së drejtës publike dhe kriteri material do të konsiderohet i përmbushur, nëse kontrata ka për objekt kryerjen e punëve publike. Përjashtimisht përkufizimit që bëhet për kontratat për punët publike në ligjin nr. 162/2020, "Për prokurimin publik" (neni 4/19), legjislacioni në tërësi, por edhe praktika gjyqësore nuk kanë bërë ndonjë elaborim të këtij koncepti. Referuar doktrinës juridike mund të thuhet se punët publike janë punët, që kryhen apo ekzekutohen në emër dhe për llogari të një organi publik dhe kanë për qëllim përmbushjen e interesit publik. P.sh.: konsiderohet se puna kryhet apo ekzekutohet në emër dhe për llogari të një organi publik, kur kryhet apo ekzekutohet mbi një objekt apo send që është në pronësi të organit publik, ose kur puna që po kryhet apo ekzekutohet, në përfundim, do të kalojë në pronësi të organit publik. Kryerja apo ekzekutimi i punëve publike është një veprimtari publike, për shkak se përgjatë kryerjes së këtyre punëve publike manifestohen prerogativa të fuqisë publike, siç mund të jenë shpronësimet për interes publik nëpërmjet nxjerrjes së një akti administrativ të njëanshëm etj. Për rrjedhojë, si nocioni i shërbimit publik dhe ai i punëve publike nënkupton prezencën e një organi publik dhe përmbushjen e një qëllimi të interesit publik. Edhe për këto kontrata nuk është vërejtur ndonjë paqartësi në praktikën gjyqësore.

48. *Kontrata ka për objekt ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave dhe të funksioneve administrative/publike.* Kriteri material i marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike, do të konsiderohet i plotësuar dhe, për rrjedhojë, kontrata është administrative, nëse organi publik e nënshkruan kontratën përgjatë dhe në funksion të ushtrimit dhe të përmbushjes së detyrave administrative/publike. Kështu, në jurisprudencën e Kolegjit Administrativ ka jo pak qëndrime që kanë orientuar praktikën gjyqësore në drejtim të plotësimit të kriterit material, për arsye se me anë të kontratës administrative palët synojnë të rregullojnë të drejta dhe detyrime, në lidhje me:

- *"[...] ndërtimin e një godine për përdorim nga organet e policisë për ushtrimin e funksionit publik"* (vendimi nr. 1235, datë 1.4.2014);

- *"[...] ndërtimin e një godine për përdorim nga organet e arkivave shtetërore për ushtrimin e funksionit publik"* (vendimi nr. 1111, datë 1.4.2014);

- *"[...] realizimin e pavijonit etnografik pranë Muzeut Historik Kombëtar, që administrohet nga kjo e fundit, në kuadër të ushtrimit të funksionit publik"* (vendimi nr. 1554, datë 6.5.2014);

"[...] dhënien në përdorim të sipërfaqes së përcaktuar për qëllim ushtrimin e veprimtarisë agropylltari sipas qëllimit të përcaktuar në kontratë, si dhe në lejen e mjedisit për përdorim nga organet shtetërore për ushtrimin e funksionit publik pjesë e fondit pyjor publik, Ekonomia Pyjore Dumre" (vendimi nr. 1637, datë 10.6.2014);

48.1. Pavarësisht se me këto kontrata organet publike synojnë ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave dhe funksioneve të tyre administrative/publike, ato lehtësisht identifikohen edhe si kontrata prokurimi publik.

49. *Kontrata financohet nga paratë publike.* Gjithashtu, kriteri material do të konsiderohet i përmbushur dhe kontrata do të jetë administrative në rastet e financimit të saj nga paratë publike. Nocioni i fondeve publike është përkufizuar në nenin 4, pika 9, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", sipas të cilit: "*Fondet publike" janë: a) çdo vlerë monetare e buxhetit të shtetit, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike; b) çdo vlerë monetare e buxhetit vendor, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike; c) fonde ndihme ose kredi, të dhëna nga donatorë të huaj, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën kërkohet zbatimi i procedurave të këtij ligji; ç) të ardhurat nga shteti, ndërmarrjet lokale, shoqëritë tregtare dhe entet e tjera, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve ose të kapitalit"*. Një kontratë e lidhur nga një organ publik dhe që financohet pjesërisht ose tërësisht nga paratë publike duhet t'i nënshtrohet regjimit juridik të së drejtës publike dhe kompetencës lëndore të gjykatës administrative, nëse marrëdhënia që krijohet dhe normohet nga e drejta publike ka të bëjë me një shërbim publik dhe është në interes të publikut.

50. Financimi i kontratës nëpërmjet fondeve publike bën që kontrata të rregullohet nga marrëdhëniet juridike të së drejtës publike dhe kriteri material të përmbushet, por kjo nuk do të thotë se një kontratë e financuar nga kontraktuesi privat me fondet e tij, ose me kredi të marrë në institucionet financiare, nuk mund të përmbushë kriterin material dhe, për rrjedhojë, të mos ketë natyrë administrative. Kështu, kontratat e koncesionit dhe të partneritetit publik privat janë kontrata administrative, për arsye se kanë për objekt kryerjen e shërbimeve dhe punëve publike, edhe pse financohen, si p.sh., koncesionet, tërësisht nga koncesionari privat dhe partneritetet

publike private, tërësisht ose pjesërisht nga partneri privat. Kur kontrata ka për objekt kryesor kryerjen e punëve e shërbimeve publike, me ose pa fonde shtetërore, kontrata do të cilësohet si administrative. **Përdorimi i parave publike është i rëndësishëm dhe mund të plotësojë karakterin administrativ të kontratës, por kontrata është administrative jo vetëm për faktin se financohet nga paratë publike, por për arsyen se ka për objekt kryesor të saj kryerjen e punëve e shërbimeve publike.** Kjo do të thotë se jo çdo financim nga paratë publike e bën domosdoshërisht kontratën administrative. Është e ditur se organi publik edhe kur vepron si subjekt i së drejtës private përdor paranë publike, sepse kjo nënkuptohet çdo herë që shteti vepron, por nevojitet të vlerësohet domosdoshmërisht natyra juridike e marrëdhënies konkrete. Kështu, është i njohur rasti kur organi publik përdor para publike që nuk u nënshtrohen procedurave të prokurimit. Në këtë aspekt ndikon edhe vlera e ulët e financimit. Ka blerje me para publike, në vlera të vogla, të cilat nuk u nënshtrohen procedurave të prokurimit publik. Kontrata të tilla, ku organi publik vepron si çdo subjekt i së drejtës (pa kufizime të lirisë kontraktore), pa qenë nevoja të përdorë fuqinë e tij sovrane konsiderohen si civile. Këtë e ka konfirmuar, në jo pak raste, edhe jurisprudenca e Gjykatës së Lartë.

51. *Kontrata rregullohet nga një regjim juridik i së drejtës publike*. Kontrata do të cilësohet si administrative edhe kur elemente të së drejtës publike, që shfaqen nëpërmjet normave ligjore ose nënligjore, rregullojnë kontratën që u imponohet palëve. Në këtë rast, bëhet fjalë për një regjim juridik të së drejtës publike. Nëse rregullat që i zbatohen kontratës i përkasin së drejtës publike, atëherë kriteri material do të gjendet i plotësuar. Përdorimi nga ligjvënësi i termit *"sipas së drejtës publike"* për përkufizimin e kontratës administrative do të thotë se zbatohet vetëm për sferën që rregullohet nga e drejta administrative, siç parashikohet edhe në pikën 1 të nenit 2 të KPA-së. Kjo do të thotë se një kontratë është administrative kur objekt i saj rregullohet nga e drejta administrative. Pra, është e drejta administrative që përcakton shprehimisht lidhjen e një kontrate administrative si e vetmja mënyrë e mundshme për zgjidhjen e një çështje të caktuar dhe se është kontrata administrative që ndryshon një marrëdhënie juridike ekzistuese që rrjedh nga e drejta administrative, si dhe vendos një detyrim ndaj organit publik që mund të plotësohet vetëm përmes nxjerrjes së një akti administrativ.

52. Në parim, regjimi juridik që i zbatohet kontratës është pasojë e përcaktimit të natyrës juridike të saj. Në këtë rast, ndodh e kundërta: nga regjimi juridik që i zbatohet kontratës evidentohet natyra juridike e saj. Pra, nëse për një kontratë të caktuar, ekziston një regjim juridik i parashikuar për këtë kontratë dhe ky regjim paraqet norma tepër origjinale, të cilat janë norma të së drejtës publike dhe që normalisht nuk zbatohen në një kontratë midis dy personave të së drejtës private, atëherë kjo kontratë do të cilësohet detyrimisht si një kontratë administrative, për shkak të normave të së drejtës publike që e rregullojnë atë.

53. *Kontrata ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët të organeve publike.* Kriteri material do të konsiderohet i përmbushur, sa herë që kontrata e lidhur midis dy ose më shumë organeve publike, do të ketë për objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët të organeve publike kontraktuese. Ky nënkriter rezulton drejtpërdrejt nga ligji dhe zbatohet vetëm për kontratat e lidhura ndërmjet organeve publike. Sipas nenit 121 të KPA-së, *"Organet publike mund të lidhin ndërmjet tyre kontrata për rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët"*. Këto kontrata i gjejmë të parashikuara kryesisht në ligjin që rregullon veprimtarinë e organeve të pushtetit vendor. Kështu, në ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në nenet 9/1, pikat 1.5 dhe 1.6, shkronja "a", 14, 21/3 dhe 30/5, është parashikuar e drejta e njësive të vetëqeverisjes vendore (bashkitë dhe qarqet) të lidhin kontrata me anë të të cilave: organet e pushtetit qendror i delegojnë funksionet dhe/ose kompetencat e tyre organeve të pushtetit vendor; organet e pushtetit vendor vendosin të ushtrojnë së bashku funksione të dhëna me ligj; organet e pushtetit vendor vendosin t'i delegojnë një pale të tretë organ publik ushtrimin e një apo disa funksioneve; si dhe kontratat midis organeve të pushtetit qendror dhe organeve të pushtetit vendor apo midis vetë organeve të pushtetit vendor për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët kontraktore, të cilit i japin autoritet dhe kompetenca të caktuara, të quajtur subjekt i kompetencave të përbashkëta. Këto kontrata kanë për objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët midis organeve të qeverisjes qendrore me organet e qeverisjes vendore apo midis vetë organeve të qeverisjes vendore. Kontrata me objekt delegimin e kompetencave midis organeve administrative, kur nuk janë në marrëdhënie varësie me njëri-tjetrin, parashikohet edhe nga neni 29/1 i KPA, sipas të cilit: *"Kur ligji e lejon, delegimi i kompetencave bëhet në çdo rast me vendim të organit delegues për organet në varësi të tij dhe me vendim ose me marrëveshje në ato raste kur organi i deleguar nuk është në varësi të organit delegues"*. Gjithashtu, neni 14/1 i ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", parashikon lidhjen e kontratave ndërmjet autoriteteve qendrore dhe vendore me objekt planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit të territorit, ose për kryerjen e shërbimeve për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, duke përcaktuar, se: *"Autoritetet kombëtare dhe vendore mund t'i delegojnë, me marrëveshje, njëra-tjetrës përgjegjësi dhe funksione të caktuara, që lidhen me planifikimin dhe kontrollin e zhvillimit*

të territorit. Autoritetet kombëtare dhe vendore mund të kontraktojnë kryerjen e shërbimeve të ndryshme për planifikimin dhe zhvillimin e territorit ose mund t'i kryejnë ato bashkërisht në marrëveshje mes tyre". Për rrjedhojë, kontrata me objekt delegimin e kompetencave nga një organ publik delegues te një organ publik i deleguar, jo në varësi të organit delegues, përbën kontratë ndërmjet organeve publike me objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët.

54. Një rast tjetër i kontratës mes dy organeve publike, me objekt rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët, është kontrata e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave me institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, në mënyrë që institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore të ofrojnë shërbimet e tyre nëpërmjet sporteleve të shërbimit dhe pikave të shërbimit me një ndalesë, që administrohen nga Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA). Kjo mundësi parashikohet nga ligji nr. 13/2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", në nenet 47, 48 dhe 49 të emërtuar "Marrëveshjet me institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore".

dh) Disa konkluzione paraprake

55. Mbi këtë analizë të hollësishme, rezulton se kontrata do të konsiderohet administrative nëse plotësohen të dy kriteret e kërkuar nga neni 3, pika 4 i KPA-së, kriteri organik (prania e të paktën një organi publik në kontratë në cilësinë e palës kontraktuese), si dhe kriteri material (ekzistenca e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike). Nga mënyra se si është hartuar neni 3, pika 4, i KPA-së bëhet fjalë për kritere të cilët plotësojnë njëri-tjetrin. Në parim, të dy kriteret duhet të gjenden të plotësuar, në përmbajtje dhe jo në formë, në mënyrë që kontrata të paraqesë karakter administrativ. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson, se: ***një kontratë do të konsiderohet administrative kur krahas pranisë si palë të një organi publik (kriteri organik) kërkohet domosdoshmërisht ekzistenca e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike (kriteri material), që do të thotë se kontrata duhet të ketë për objekt kryerjen apo ekzekutimin e një veprimtarie shërbimi publik; kryerjen e punëve publike; ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave dhe funksioneve administrative/publike; rregullimin e marrëdhënieve për kryerjen e veprimtarive në interes të përbashkët të organeve publike kontraktuese; financimin nga paratë publike; rregullimin dhe nënshtrimin një regjimi juridik të së drejtës publike.***

56. Kolegji vlerëson se një përfundim i tillë nuk është shterues, sepse nga analiza e mësipërme nevojitet të identifikohen edhe elemente të tjera që ndihmojnë për të dalluar kontratën administrative nga ajo civile. Për këtë arsye është e domosdoshme që në funksion të nxjerrjes së përfundimeve mbi pyetjen e parë, të specifikohen dhe mbahen parasysh edhe disa elemente thelbësore, që shërbejnë për identifikimin e një kontrate administrative, si:

- shërbimi në interesin publik, që përcjell një qëllim të veçantë të kontratës;

- kufizimi me ligj i lirisë kontraktore;

- epërsia e organit publik ndaj palës tjetër kontraktore, që diktohet nga nevoja për të mbrojtur interesin e përgjithshëm;

- karakteri specifik (intuitu personae) i kontratës, ku në raste të caktuara ndërprerja e saj nuk lejohet pa miratim të autoritetit publik;

- tërheqja e njëanshme nga kontrata e organit publik, kur nuk arrihet marrëveshja për ndryshim ose prishje të saj, kundrejt detyrimit për t'i paguar palës private dëmin e shkaktuar.

57. Kolegji vlerëson se një trajtim i tillë doktrinar dhe jurisprudencial, padyshim që orienton dhe ndihmon për qartësuar problematikën që ndeshet në praktikë, por për të kuptuar dhe zbatuar ligjin me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore nevojitet një analizë edhe më e thelluar.

58. Së pari, për të bërë dallimin mes kontratës publike dhe private fokusimi është tek *objekti*, *qëllimi*, si dhe *normat juridike* që rregullojnë natyrën e marrëdhënies juridike, të cilat duhet të dalin të qarta si gjatë pretendimeve që parashtrojnë palët, ashtu edhe nëpërmjet interpretimit dhe konkluzionit që nxjerr gjykata për zgjidhjen e çështjes. Për palët në gjykim, por edhe për vetë gjykatën mbetet e rëndësishme bërja e këtij dallimi, jo nëpërmjet leximit literalisht të kontratës, por nëpërmjet analizës në thelb të përmbajtjes së kontratës dhe natyrës së mosmarrëveshjes. Nuk e përcakton natyrën e kontratës apo kompetencën për shqyrtimin e saj vetëm emërtimi i kontratës, apo formaliteti i palëve pjesëmarrëse në lidhjen e saj. Vlen në këtë rast referimi edhe në vendimin njësues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 29.3.2012, sipas të cilit, "[...] **gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit, duke e analizuar padinë në tërësinë e saj dhe jo duke u kufizuar te dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj [...]. Gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar."**

59. Çështja nëse një mosmarrëveshje është e së drejtës publike apo civile, kur mungon një parashikim i shprehur i ligjvënësit që përcakton juridiksionin specifik gjyqësor, varet ngushtësisht nga natyra e marrëdhënies juridike, prej së cilës rrjedh edhe pretendimi i palëve për të ngritur padi. Gjykata duhet të niset nga mënyra se si palët i paraqesin pretendimet e tyre mbi një kontratë konkrete dhe objekti i saj për të përcaktuar natyrën e marrëdhënies juridike, llojin e mosmarrëveshjes, e për rrjedhojë edhe kompetencën e gjykatës. Kolegji vlerëson, se: ***me rëndësi përcaktuese është se si palët i ngrenë pretendimet dhe si i parashtrojnë kërkesat, "nëse ato fokusohen te marrëdhëniet juridiko-civile apo ato juridiko-publike", si dhe pasojat respektive para gjykatës kompetente*** *(shih vendimin e Gjykatës së Lartë Federale Gjermane 10, 164, 165 dhe vendimin e Gjykatës Administrative Federale gjermane BV erw GE 7, 257, 258).*

60. Ka qenë përherë e debatueshme çështja nëse kontrata pjesërisht mund të kategorizohet në të drejtën publike, ndërkohë që e njëjta kontratë rregullon edhe çështje që normohen nga e drejta private. Tashmë mbizotëron qëndrimi se një marrëdhënie juridike, e cila rrjedh nga një objekt konkret, i bazuar në ndërveprimin e të paktën dy subjekteve juridike ose e një subjekti kundrejt një çështje juridike të caktuar, do të konsiderohet tërësisht, ose si publike, ose si private. Kontrata në tërësi, përfshirë edhe pjesën ku ajo kategorizohet si private, do të konsiderohet publike, nëse pjesa e cila rregullohet sipas së drejtës publike peshon më shumë (që në jurisprudencën gjyqësore ndërkombëtare cilësohet si "teoria e pikës së rëndesës"), sa i përket evidentimit të natyrës së marrëdhënies kontraktore. Pra, në një kontratë të lidhur mes një organi publik dhe subjekteve private fokusi duhet të jetë tek *objekti i kontratës*. Në rast se objekti kryesor i kontratës është shitja e një trualli, apo dhënia me qira e një objekti, kur organi publik nuk përdor fuqinë sovrane, nuk kryen një shërbim publik dhe nuk vepron në mbrojtje apo avancim të interesit publik, por ushtron liri kontraktore, ashtu si edhe pala tjetër, atëherë bazuar në *teorinë e pikës së rëndesës*, do të kemi të bëjmë me kontratë private, pavarësisht se ndonjë nga detajet e tjera mund të rregullohen nga normat e së drejtës publike, si p.sh., metodologjia e përcaktimit të çmimit apo tarifat e tjera që vendosen me ligj, ose akt nënligjor. Në këtë rast, gjykata civile është kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Nga ana tjetër, një veprimtari publike mund të ketë efekte relevante të një veprimtarie ekonomike të ushtruar nga vetë organi. Kështu, nëse në një kontratë për shitjen e një trualli apo dhënien me qira të një objekti, organi publik *mban/ushtron sovranitet shtetëror* dhe ku dukshëm prevalon interesi publik (si p.sh., kontrata e qirasë me 1 euro, apo me një çmim simbolik, me kushtin e përmbushjes së një objektivi social etj.), atëherë kontrata do të konsiderohet publike, pavarësisht se ka edhe detaje të së drejtës civile. Në këtë rast, gjykata administrative është kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

61. Përmbajtja thelbësore e kontratës duhet të ketë disa cilësi objektive, midis të cilave kryesore është ardhja e pasojave juridike në fushën e së drejtës publike (si p.sh. zbatimi i normave të së drejtës publike ose detyrimi i organit publik për të kryer ose mos kryer një veprim administrativ). Në këtë drejtim orienton edhe jurisprudenca ndërkombëtare. Një mosmarrëveshje e së drejtës publike mund të lindë nga një marrëdhënie që bazohet në norma juridike, "të cilat nuk gjejnë zbatim për këdo, por janë e drejtë e posaçme e shtetit ose e ndonjë mbajtësi të veçantë të autoritetit publik shtetëror, dhe se këto norma i drejtohen të paktën, nga njëra anë, palës që mban/ushtron sovranitet shtetëror." *(shih vendimin e Gjykatës Federale Administrative gjermane BverwGE i datës 30 maj 2006).* "Nëse një mosmarrëveshje është në fushën e së drejtës publike apo private (në rastin e kontratave të përziera dhe/ose të përbëra) kjo përcaktohet nga natyra e marrëdhënies juridike nga e cila rrjedh pretendimi." *(Shih vendimin e Gjykatës Federale Administrative gjermane 6 A 5/09 BVerwG, datë 26 maj 2010).* Këtu merr rëndësi fakti "nëse palët në kontratë në raport me njëra-tjetrën qëndrojnë në një marrëdhënie sovrane tipike me mbi- dhe nënrenditje mes tyre dhe nëse mbajtësi i sovranitetit bazohet në të drejtën publike të posaçme." Fakti që njëra palë është organ publik nuk do të thotë se marrëdhënia përfshihet domosdoshmërisht në sferën e së drejtës publike. Gjithashtu edhe argumenti se për këtë qëllim përdoren para publike, nuk është relevant dhe as përcaktues, sepse është e njohur që shteti mund të veprojë edhe sipas së drejtës private. Kjo konsiderohet si një *"veprimtari fiskale e shtetit"* ose *"veprimtari administrative e thjeshtë"*, që nuk konsiderohen si veprime nëpërmjet të cilave shteti ushtron të drejta sovrane. **Përcaktuese në këto raste mbetet "çështja nëse palët qëndrojnë përballë njëra-tjetrës në marrëdhënie që imponohet nga parimi i ushtrimit të sovranitetit shtetëror, pra – me mbi- dhe nënvendosje të palëve në kontratë – si dhe nëse mbajtësi i sovranitetit shtetëror bazohet tek kuadri normativ i së drejtës publike apo tek e drejta civile e vlefshme për këdo".** *(Shih vendimin e Gjykatës së Lartë Federale, 41, 264, 267, si dhe vendimin e Gjykatës Federale Administrative Gjermane 7, 180, 182.)*

62. Kolegji rithekson, ashtu siç arsyetohet edhe në jurisprudencën e njohur ndërkombëtare se nuk ka një kategorizim absolut nëse një veprimtari është apo jopublike, por kjo përcaktohet nga marrëdhënia juridike konkrete në raport me personalitetin juridik, me të cilin vishet organi publik, kur vepron si i tillë. Është e pranuar se kjo çështje mbetet për t'u përcaktuar në varësi të këndvështrimit që i bëhet marrëdhënies juridike (nëse ajo

është mikse apo e paqartë), bazës ligjore të padisë dhe pasojave juridike të marrëdhënies/konfliktit. Nisur nga ky vlerësim dallues që i referohet këtyre elementeve, të cilat mund të jenë në favor ose disfavor të organit publik, vlerësohet se kompetencat e karakterit sovran nuk mund të ushtrohen ndaj çdokujt, por vetëm ndaj një rrethi të caktuar personash dhe në raste konkrete. Nëse marrëdhënia është e tillë që i vendos palët në pozita të barabarta dhe organi publik nuk bazohet në normat e posaçme të së drejtës publike, atëherë konflikti nuk është i natyrës së të drejtës publike dhe, për rrjedhojë, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes është gjykata civile. **Pra, është natyra juridike e mosmarrëveshjes që përcakton edhe kompetencën e gjykatës civile apo administrative dhe jo domosdoshmërisht prania formalisht e një organi publik në kontratë, prania ose jo e interesi publik, apo fakti nëse janë përdorur fonde publike, "sepse të gjitha këto nënkuptohen çdo herë që shteti vepron".** *(Shih vendimin e dhomës së këshillimit të Gjykatës së Lartë Federale, datë 20 maj 2009.)*

63. Të gjitha këto karakteristika të përgjithshme shërbejnë për identifikimin e një kontrate administrative dhe dallimin nga një kontratë e zakonshme e së të drejtës private. Megjithatë, pavarësisht nga mënyra sesi analizohen në doktrinën juridike apo në legjislacion elementët që shërbejnë për të dalluar një kontratë administrative nga kontrata civile, nuk mund të konkludohet se këto përfundime për kontratën administrative janë shteruese. Ky mbetet një problem jo i lehtë për t'u zgjidhur në praktikë, por sidoqoftë, Kolegji thekson se, ky vendim njësues synon të qartësojë konceptin e kontratës administrative dhe, në varësi të rastit konkret, palët dhe vetë gjykata (në referim të analizës së thelluar të këtij vendimi) të arrijnë të bëjnë dallimin me kontratën civile, me qëllim përcaktimin e saktë edhe të kompetencës.

V. Rregulli i së drejtës për çështjen e shtruar për njësim

64. Nisur nga kjo analizë e thelluar doktrinare dhe jurisprudenciale, Kolegji vlerëson të nevojshme të nxjerrë disa përfundime.

Në lidhje me përgjigjen e pyetjes së parë:

- **Së pari: Një kontratë do të konsiderohet administrative, kur krahas pranisë si palë të një organi publik (kriteri organik) verifikohet domosdoshmërisht edhe krijimi, ndryshimi apo shuarja e një marrëdhënie juridike konkrete, për shkak të zbatimit të normave të së drejtës publike (kriteri material), në funksion të një shërbimi publik dhe të realizmit të një interesi publik, të cilit i shërben. Për rrjedhojë, është edhe natyra juridike (shkaku ligjor i mosmarrëveshjes në gjykim), që do të përcaktojë gjykatën kompetente.**

- **Së dyti: Elemente kryesorë përcaktues për identifikimin e një kontrate administrative janë: shërbimi në interesin publik, që përbën shkakun e kontratës; kufizimi i lirisë kontraktore; epërsia e organit publik, në kuptim të kufizimit të vullnetit kontraktor të palës tjetër për kushte të caktuara të panegociueshme të kontratës, të rregulluara nga e drejta publike; karakteri specifik i kontratës, lidhur me të drejtën e organit publik për tërheqje të njëanshme nga kontrata, kur nuk arrihet marrëveshja për ndryshim ose prishje të saj, kundrejt detyrimit për t'i paguar palës private dëmin e shkaktuar.**

- **Së treti: Në një kontratë administrative palët qëndrojnë në raport me njëra-tjetrën në një marrëdhënie që imponohet nga parimi i ushtrimit të fuqisë/pushtetit sovran, ku mbajtësi i këtij sovraniteti bazohet te kuadri normativ i së drejtës publike. Kontrata është administrative, kur pavarësisht pjesëve të saj që normohen nga e drejta private, evidentohet qartë se rregullimi në tërësi i saj nga normat e së drejtës publike peshon më shumë.**

- **Së katërti: Dallimi mes kontratës publike dhe private, në funksion të përcaktimit të kompetencës lëndore, bëhet jo nëpërmjet leximit literalisht të kontratës, por nëpërmjet analizës në thelb të përmbajtjes së saj dhe natyrës së mosmarrëveshjes. Objekti, qëllimi dhe normat, që rregullojnë marrëdhënien juridike, duhet të evidentohen qartë si nga palët në proces, ashtu edhe në analizën dhe konkluzionin, që nxjerr gjykata lidhur me këtë çështje.**

65. Lidhur me dy pyetjet e tjera të shtruara për njësim, të cilat janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, Kolegji vlerëson t'i përgjigjet duke iu referuar analizës së mësipërme, por edhe legjislacionit të posaçëm që rregullon këto marrëdhënie.

66. Pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar në vite legjislacioni në fushën e strehimit social, në thelb, mënyra e rregullimit të marrëdhënieve dhe e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të lindura, nuk paraqet ndonjë ndryshim thelbësor që të krijojë paqartësi për efektet juridike të vendimit njësues ndaj çështjeve që janë në gjykim prej vitesh (siç është edhe rasti në shqyrtim) dhe çështjeve të reja që regjistrohen. Konkretisht ligji nr. 9232, datë 13.5.2004, "Për programet sociale të strehimit" *(në vijim "ligji nr. 9232/2004")*, si dhe ligji nr. 22/2018, "Për strehimin social" *(në vijim "ligji nr. 22/2018")*, kanë të njëjtin formulim në nenin 1 (objekti i ligjit), që lidhet me: *"përcaktimin e rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për*

strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.". Nga kjo pikëpamje, analiza dhe interpretimi në parim i dispozitave të mëparshme ligjore, krahasuar me dispozitat aktuale, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore ndihmon në marrjen e një përgjigje përfundimtare për pyetjen e shtruar, nëse: *"Kontratat që lidhen me këtë rast do të cilësohen si kontrata administrative apo si kontrata civile"?* Pra, si për mosmarrëveshjet e krijuara nga ligji nr. 9232/2004, ashtu edhe për ato që kanë lindur nga ligji nr. 22/2018, ky vendim njësues i jep zgjidhje natyrës së kontratave, që përfshihen në programin social të strehimit, por edhe kompetencës së gjykatave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve konkrete.

67. Ligji nr. 22/2018, si edhe ligji nr. 9232/2004 parashikojnë programet sociale për strehimin që rregullohen me kontrata të posaçme (kontrata sociale me qira, kontrata shitblerje me kosto të ulët, kontrata zhvillimi etj.), pa përcaktuar drejtpërdrejt natyrën administrative apo civile të tyre. Për identifikimin e këtyre kontratave nevojitet t'u referohemi kritereve, të analizuara më sipër në këtë vendim njësues. Kështu, bazuar në nenin 1 të VKM-së nr. 198, datë 4.5.1993, "Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave", të ndryshuar *(në vijim "VKM nr. 198/1993")* rezulton se organi publik që vepron, me qëllim mbështetjen e politikave sociale të strehimit dhe sigurimin e banesave me kosto të ulët, duke lidhur edhe kontratat përkatëse, është Enti Kombëtar i Banesave . Këtij organi publik i është dhënë me akt nënligjor, konkretisht pikat 1 dhe 2 të VKM-së nr. 198/1993, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike. Bazuar në këtë akt nënligjor, ndërmjet objektivave të tjerë të interesit publik, EKB-ja ka si veprimtari, administrimin e banesave të ndërtuara me fonde publike, të cilat përdoren për plotësimin e kërkesave të familjeve që janë të pastreha. Gjatë kryerjes së veprimtarisë, EKB ka të drejtë t'u shesë banesa sociale shtetasve shqiptarë, të cilët plotësojnë kriteret e ligjit për personat e pastrehë, kundrejt një çmimi të përcaktuar në aktet nënligjore, duke i ndihmuar këta persona edhe me anë të kredive të buta, si dhe t'u japë me qira banesa sociale. EKB-ja ka gjithashtu të drejtë të financojë, ndërtojë dhe shesë banesat sociale, si dhe të zgjidhë problemet e huave për blerësit. Këto detyra dhe funksione që i përkasin qartësisht një misioni interesi publik, përfshihen tek ushtrimi i funksioneve administrative publike. Në këto kushte, në lidhjen e kontratave të posaçme për llojet e ndryshme të programeve sociale për strehimin që parashikon ligji nr. 9232/2004, ashtu si edhe ligji nr. 22/2018, EKB-ja ka cilësinë e organit publik. Për rrjedhojë, në këto kontrata, kriteri organik i kontratës administrative, që lidhet me praninë e të paktën një organi publik në kontratë si palë kontraktuese, konsiderohet i plotësuar.

68. Edhe në lidhje me kriterin material rezulton se kontratat për programet sociale të strehimit kanë për objekt pikërisht ushtrimin dhe përmbushjen e detyrave dhe funksioneve administrative/publike të një organi publik. Nga referimi në dispozitat e ligjit nr. 22/2018, si edhe të ligjit nr. 9232/2004, rezulton se programi i banesave sociale me qira, apo i shitblerjes kontrollohet nga shteti. Sipas ligjit është shteti ai që përcakton çmimin e qirasë, si edhe çmimin minimal të shitjes së banesave në treg. Kontrata e qirasë së banesave sociale, pavarësisht se lidhet, bazuar në dispozitat e KC-së (neni 29/1 i ligjit nr. 22/2018), rregullohet dhe i nënshtrohet një regjimi juridik të së drejtës publike, që është element i rëndësishëm i kriterit material. Kështu, vetë kontrata e qirasë sociale përkufizohet si një kontratë, ku niveli i qirasë kontrollohet dhe/ose mund të subvencionohet nga institucionet shtetërore (neni 2/22). Gjithashtu, dispozitat ligjore rreth administrimit dhe mirëmbajtjes së banesave sociale me qira (neni 26), kushtet e menaxhimit të banesave sociale me qira (neni 28), përcaktimi i çmimit të qirasë me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, i kufizuar sipas metodikës për llogaritjen që miratohet me VKM (neni 30), zgjidhja e kontratës së qirasë në rastet kur qiramarrësi bën deklarim të rremë për të ardhurat, përfiton një banesë tjetër apo të ardhurat e qiramarrësit tejkalojnë ato të përcaktuara në ligj (neni 31), si dhe subvencioni i qirasë (nenet 33 deri 39) etj., janë tregues që ndihmojnë për të konkluduar se kontrata e qirasë së banesave sociale është një kontratë që rregullohet dhe i nënshtrohet një regjimi juridik të së drejtës publike, pasi këto rregulla nuk gjejnë zbatim për kontratat e lidhura midis privatëve, të cilat nuk lidhen për një interes publik. Interesi publik i strehimit të personave të pastrehë dhe me mundësi të ulët ekonomike, bën që në rastin konkret të ekzistojnë këto rregulla për kontratën e qirasë së banesave sociale. Për rrjedhojë, kontrata e qirasë së banesave sociale plotëson kriterin material të kontratës administrative, pranisë së marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike.

69. Gjithashtu, kontratat e sipërmarrjes që mund të lidhen midis EKB-së dhe përfituesve, referuar programit për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese (neni 11/1, shkronja b), nenet 40 deri 43 të ligjit nr. 22/2018), do të rregullohen dhe nënshtrohen një regjimi juridik të së drejtës publike. Kështu, grantet që jepen (neni 40), objektet që trajtohen (neni 41), instrumentet e programit (neni 42) dhe përfituesit nga programi (neni 43), tregojnë për nënshtrimin e këtyre kontratave një regjimi juridik të së drejtës publike. Edhe në lidhje me programin e banesave me kosto të ulët (nenet 11/1, shkronja c), 44 deri 49), parashikohet se ato shiten me çmim nën vlerën e tregut, por jo nën vlerën e kostos së ndërtimit (neni 44), ashtu siç përcaktohet se normat dhe standardet e

banesave me kosto të ulët, procedurat e blerjes nga tregu, procedurat e vlerësimit dhe të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së truallit familjeve që përfitojnë banesa me kosto të ulët, miratohen me VKM (neni 45). Ligji parashikon, gjithashtu, përfitimin e grantit të menjëhershëm për blerjen e banesave me kosto të ulët (neni 46), si dhe subvencionimin e interesave të kredisë (neni 47). Në të njëjtën mënyrë, edhe programi për zhvillimin e zonës për qëllim strehimi (nenet 11/1, shkronja "ç", 50 deri 53), programi i strehëve të përkohshme (nenet 11/1, shkronja "d", 54 deri 57), si dhe programi i banesave të specializuara (nenet 11/1, shkronja "dh", 58 deri 64), janë programe për zbatimin e të cilave kontratat që do të lidhen do të rregullohen nga një regjim juridik i së drejtës publike.

70. Të gjitha këto norma ligjore, si dhe analiza që bën Kolegji konfirmojnë qëndrimin, se: **interesi publik i strehimit të personave të pastrehë dhe me mundësi të ulët ekonomike bën që të ekzistojnë rregulla specifike për kontratën e shitjes së banesave sociale, që plotëson kriterin material të kontratës administrative - praninë e marrëdhënieve juridike në fushën e së drejtës publike. Kontrata e shitjes së banesave sociale është në funksion të një shërbimi publik, që ofron shteti, nisur nga interesi publik për zbatimin e objektivave socialë të parashikuar në nenin 59(1)(b) të Kushtetutës dhe rregullohet e i nënshtrohet regjimit juridik të së drejtës publike. Për rrjedhojë, shqyrtimi i mosmarrëveshjeve në lidhje me këtë lloj kontrate, do të jetë në kompetencën e gjykatës administrative.**

71. Lidhur me përgjigjen e pyetjes së tretë, Kolegji i qëndron analizës dhe interpretimit të zhvilluar më sipër për cilësimin, pikësëpari, të EKB-së si organi publik, që kryen shitjet te personat e së drejtës private. Për këto kontrata shitje/privatizimi të banesave shtetërore, konsiderohet i plotësuar kushti i kriterit organik të kontratës administrative (organi publik si palë kontraktuese), ndërkohë që Kolegji e vlerëson të domosdoshme edhe përmbushjen e kriterit material, pasi nuk mund të konkludohet në mënyrë kategorike se të gjitha mosmarrëveshjet, që shfaqen në fushën e privatizimit të banesave shtetërore, janë domosdoshërisht administrative.

72. Në këtë aspekt, vlen të analizohen shumë faktorë që lidhen, në këtë rast, me objektin, qëllimin, si dhe me normat juridike që rregullojnë natyrën e marrëdhënies juridike, të cilat duhet të dalin të qarta nga objekti i kërkimit, nga pretendimet që parashtrojnë palët, por edhe nga interpretimi dhe konkluzioni që nxjerr gjykata për zgjidhjen e çështjes. Kolegji vlerëson se çështje e privatizimit të banesave shtetërore kanë të përbashkëta, ashtu siç kanë edhe veçori, krahasuar me kontratat që lidhen në kuadrin e programit social të strehimit. Ato nuk janë tërësisht të njëjta në përmbajtjen e tyre dhe, për këtë arsye, duhen analizuar hollësisht.

73. Është e vërtetë që EKB-ja, kur shet këto banesa, vepron përgjatë ushtrimit dhe përmbushjes së funksioneve administrative publike dhe se qëllimi dhe objektivi i ligjit 7652/1992 dhe i ligjit nr. 9321/2004 është brenda perimetrit të misionit të shërbimit publik të strehimit, sepse i mundëson qiramarrësve të banesave shtetërore të bëhen pronarë të tyre (neni 1), si dhe krijon tregun e banesave. Gjithashtu, regjimi juridik që zbatohet për këto kontrata është ai i së drejtës publike, sepse përcaktimi i çmimit të kontratës së shitjes bëhet jo sipas tregut të lirë, por me VKM dhe se për disa banesa e kategori subjektesh që përmbushin kushte të caktuara (ata që kanë statusin e ish-të burgosurit, të internuarit, të dëbuarit politik dhe të invalidit të luftës), kalimi i pronësisë është falas. Megjithatë, Kolegji thekson se është e nevojshme se për të analizuar mosmarrëveshjet që krijohen në fushën e privatizimit të banesave shtetërore (proces i cili është pothuajse i përfunduar) duhet të orientohemi edhe nga përfundimi i arritur nga analiza e bërë në këtë vendim njësues, se: *përcaktuese është edhe mënyra se si palët i ngrenë pretendimet dhe i parashtrojnë kërkesat e tyre, duke u orientuar te marrëdhëniet juridiko-civile apo ato juridiko-publike, si dhe te zgjidhja e pasojave para gjykatës kompetente.*

74. Në këtë aspekt vlen të theksohet se pavarësisht nga natyra në dukje administrative që përmban një kontratë e privatizimit të banesave shtetërore, ndryshe paraqitet çështja kur kundërshtimi vjen nga palët në kontratë dhe ndryshe kur të tretët pretendojnë fitimin e pronësisë mbi këtë banesë (ku këto të fundit përbëjnë edhe numrin më të madh të çështjeve që kanë mbetur për zgjidhje para gjykatave). Nuk përjashtohen rastet kur çështje me objekt pavlefshmërinë absolute të kontratave të privatizimit me pasojë kalimin e tyre në favor të shtetit të identifikohen si administrative. Ndërkohë që në çështje, ku paditësi i cili nuk është palë në kontratë i kundrejtohet EKB-së dhe blerësit të banesës shtetërore, duke kërkuar detyrimin për njohjen e tij si pronar/bashkëpronar, atëherë mosmarrëveshja në një rast të tillë trajtohet si me natyrë të mirëfilltë civile dhe kompetente për shqyrtimin e tyre do të jetë gjykata e juridiksionit të përgjithshëm dhe jo gjykata administrative. Kjo është përgjithësisht edhe praktika që është ndjekur së fundmi në disa vendime të Gjykatës së Lartë.

75. Mbi këtë analizë të detajuar ligjore, doktrinare dhe jurisprudenciale, Kolegji arrin në përfundimin:

- Kontrata e privatizimit të banesave shtetërore, në kuptim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, "Për privatizimin e banesave

dhe objekteve të kthyera në banesa", ka elementet e një kontrate administrative.

- Megjithatë, për të përcaktuar gjykatën kompetente për shqyrtimin e një mosmarrëveshje, në të cilën vihet në diskutim një kontratë privatizimi banese, përcaktuese do të jetë natyra juridike e mosmarrëveshjes dhe kërkimet konkrete të palëve.

- Nëse pala kundërshton kontratën administrative, për shkak se bie ndesh me normat e të drejtës publike dhe ka për pasojë kthimin e pronës tek organi publik, kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes është gjykata administrative.

- Nëse një person i tretë, që nuk është palë në kontratë, kërkon njohjen pronar apo bashkëpronar mbi banesën e privatizuar nga pala tjetër, sipas ligjeve të mësipërme, pavarësisht se në mënyrë të tërthortë ngre pretendime edhe për vlefshmërinë e kontratës së privatizimit, mosmarrëveshja në këtë rast është e natyrës civile dhe shqyrtimi i saj është në kompetencën e gjykatës civile.

VI. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi

76. Në rastin konkret, palët kanë qenë të lidhura në një kontratë shitjeje të banesës shtetërore, për të cilën paditësi Kadri Tafa ka paguar vlerën e plotë, sipas ligjit dhe VKM-së nr. 678/2009. Ndërkohë që VKM-ja nr. 367/2013 ka ndryshuar VKM-në nr. 678/2009 dhe ka parashikuar se EKB-ja duhet të bëjë kalimin në pronësi pa kundërshpërblim të këtyre objekteve për personat, të cilët i kanë aktualisht në përdorim. Referuar parashikimeve të mësipërme, paditësi Kadri Tafa, i cili kishte paguar çmimin e plotë të kontratës, ka ngritur padinë me objekt: *"Detyrimin e të paditurve, Enti Kombëtar i Banesave, Drejtoria e Përgjithshme dhe Enti Kombëtar i Banesave, Dega Rajonale Tirane t'i kthejnë paditësit shumën e vlerës monetare sipas ekstraktit bankar të datës 18.8.2018, të përllogaritur vetëm për periudhën pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 367, datë 18.4.2013 [...]."*

77. Referuar kontratës për shitje të banesës shtetërore, të lidhur nga palët, mbi bazën e një programi social të strehimit, por edhe arsyetimit të sipërpërmendur, Kolegji vlerëson se kur organi publik ndërhyn me akt nënligjor për zbatimin e një objektivi social në favor të përfituesve, mosmarrëveshja që krijohet në këtë rast për zbatimin e kontratës, duhet të cilësohet si administrative.

78. Nga ana tjetër, Kolegji evidenton edhe faktin se, në rastin në shqyrtim padia mbështetet në pretendimin se kontrata e lidhur mes palëve i ka ndërprerë efektet e mëtejshme për shkak të një VKM-je, që vendos të kalojë në pronësi pa shpërblim banesën përkatëse. Mbi këtë pretendim, paditësi kërkon kthimin nga një organ publik të vlerës së çmimit të kontratës që ka paguar, pas hyrjes në fuqi të aktit nënligjor normativ, VKM-së nr. 367, datë 18.4.2013. Një padi me këtë objekt dhe shkak ligjor, që lidhet me pretendimin për pagim të padetyruar organit publik, e cilëson marrëdhënien juridike të pretenduar, e për rrjedhojë edhe mosmarrëveshjen, si juridiko-administrative, ndaj edhe kompetencën për gjykimin e çështjes e ka vetëm gjykata administrative.

79. Referuar analizës së mësipërme, Kolegji vlerëson se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin u vlerësua se mosmarrëveshja objekt gjykimi është në kompetencë të gjykatës civile, është i pabazuar në ligj. Gjykata Administrative e Apelit ka kompetencën të shqyrtojë mosmarrëveshjen, duke qenë detyrë e saj të vlerësojë pretendimet e ngritura në ankim për një pagim të padetyruar dhe lindjen e përgjegjësisë së EKB-së, kundrejt konkluzionit të gjykatës së shkallës së parë për vijimin e zbatimit të kontratës dhe efekteve të saj, edhe pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 367, datë 18.4.2013.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 63, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012, "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" *(i ndryshuar),*

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit nr. 224 (86-2021-288), datë 21.4.2021, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me të njëjtin trup gjykues.

2. Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore publikohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 22.9.2023

Kryesues: Sokol Sadushi,
Anëtarë: Artur Kalaja, Asim Vokshi, Gentian Medja, Sokol Ngresi

VENDIM
Nr. 00-2023-4279 (259), datë 7.7.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Sadushi	kryesues;
Asim Vokshi	anëtar;
Arbena Ahmeti	anëtare;
Gentian Medja	anëtar;
Sokol Ngresi	anëtar,

asistuar nga sekretare gjyqësore Borana Liti, sot në datën 7.7.2023, mbaroi së shqyrtuari në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen administrative me nr. 31003-00237-00-2016, që u përket:

KËRKUES: Tajar Lala, Teuta Lala, Dervish Lala, Erilinda Lala

PERSONA TË TRETË: Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, (Ish Prefekti i Qarkut Vlorë).

Bashkia Himarë, Njësia Administrative Lukovë, (Ish Komuna Lukovë).

OBJEKTI: Rivendosje në afat për paraqitjen e ankimit kundër vendimit nr. 411, datë 17.6.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.

BAZA LIGJORE: Nenet 151, 152, 445, 458 të Kodit të Procedurës Civile.

KOLEGJI ADMINISTRATIV I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Asim Vokshi, si dhe zhvilloi seancën gjyqësore më datë 26.5.2023, ku dëgjoi avokatin Ilir Jahollari të palëve kërkuese që kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, vijoi gjykimin në mungesë të palëve të tjera, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Komisioni i Ndarjes së Tokës së fshatit Borsh, Sarandë, nëpërmjet Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) datë 1.10.1995, duke përcaktuar se bazohej në ligjin nr. 7501/1991, "Për Tokën", ka trajtuar familjen Lala (Tajar Lala, Teuta Lala, Dervish Lala dhe Erilinda Lala), me 10.500 m² tokë bujqësore dhe me 600 m² truall. Prefekti i Qarkut Vlorë, duke vlerësuar se AMTP-ja në fjalë është lëshuar në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, duke kërkuar anulimin e AMTP-së të dhënë në favor të familjes Lala.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 23-2014-73 (50) datë 16.1.2014, ka vendosur: *"Të shpallë mos kompetencën lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për gjykimin e çështjes civile numër 21271- 01567-23-2013/119 Regjistri Themeltar, datë 24.7.2013, regjistrimi, të paditësit Prefekti i Qarkut Vlorë. Dërgimin e akteve për gjykim gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Kundër vendimit lejohet ankim i veçantë, brenda 5 ditëve në Gjykatën e Lartë, afat ky që për palën paditëse Prefekti i Qarkut Vlorë dhe të paditurit Tajar Lala, Teuta Lala, Dervish Lala dhe Erilinda Lala prezent, fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Për të paditurën Komuna Lukovë në mungesë, afat i ankimit fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit."*.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin nr. 411, datë 17.6.2014, ka vendosur:

"Pranimin e kërkesëpadisë pjesërisht. Deklarimin e pavlefshmërisë së pjesshme të Aktit të Marrjes së Tokës i lëshuar nga Komisioni i Ndarjes së Tokës Borsh datë 1.10.1995, në emër të të paditurit Tajar Lala në lidhje me sipërfaqen e truallit prej 500 m² duke u detyruar i padituri të lirojë këtë sipërfaqe dhe kthimin e saj në pronësi të Shtetit. Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit. Shpenzimet gjyqësore siç ju ngarkohen palëve në pjesë të barabarta. Kundër vendimit lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë nga e nesërmja e shpalljes. Për palët në mungesë këto afate fillojnë nga komunikimi i vendimit."

4. Vendimi nr. 411, datë 17.6.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, sipas shënimeve të sekretarisë gjyqësore, rezulton të ketë marrë formë të prerë më datë 23.8.2014, pa u ankimuar nga palët.

5. Duke mos qenë dakord me këtë fakt, kërkuesit Tajar Lala, Teuta Lala, Dervish Lala dhe Erilinda Lala, i janë

drejtuar, më datë 10.11.2014, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, me kërkesën objekt gjykimi, për rivendosjen në afat për paraqitjen e ankimit kundër vendimit nr. 411, datë 17.6.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, duke pretenduar ndër të tjera se:

- Me vendimin e gjykatës janë njohur më datë 4.11.2014. Kërkuesit pretendojnë për pavlefshmëri të njoftimeve për shkak se njoftimet janë bërë në adresë të gabuar dhe jo në vendbanimin e tyre.

- Njoftimet dhe komunikimi i vendimit është bërë në Komunën Lukovë, Sarandë, ndërkohë që adresa e saktë ku dhe duheshin bërë njoftimet është: Borsh, Sarandë, Lagja Shkallë. Për këtë shkak ata nuk kanë pasur mundësi të marrin njoftim për zhvillimin e procesit gjyqësor ashtu dhe për vendimin përfundimtar.

6. Rezulton se kërkesa objekt gjykimi, nuk përmban bashkëlidhur ankimin drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit për të cilin kërkohet rivendosja në afat.

7. **Gjykata Administrative e Shkallës se Parë Gjirokastër,** me vendimin nr. 2117, datë 4.12.2014, ka vendosur:

"Pranimin e kërkesës. Rivendosjen në afat të kërkuesve, Tajar Lala, Teuta Lala, Dervish Lala e Erilinda Lala, për të ushtruar ankim kundër vendimit nr. 411, datë 17.6.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të kërkuesit.

Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmja e shpalljes së tij dhe për palën në mungesë nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.".

8. Kjo gjykatë ndër të tjera, ka arsyetuar se e drejta procedurale lejon mundësinë e rivendosjes në afat për të ushtruar ankim kur palët e kanë humbur këtë të drejtë për shkaqe të arsyeshme, kjo sipas nenit 458 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, nenet 151 dhe 152 të KPC-së, përcaktojnë rregullat e përgjithshme në lidhje me të drejtën e palëve ose të prokurorit që ka ngritur padi. Në analizë të dispozitave ligjore të mësipërme, gjykata arrin në konkluzionin që rivendosja në afat e aktit procedural (ankim), duhet të realizohet vetëm pasi të ketë marrë formë të prerë vendimi ndaj të cilit do të veprojë ky akt procedural. Në rastin konkret vendimi nr. 411, datë 17.6.2014, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër ka marrë formë të prerë, dhe në përputhje më dispozitat procedural, pala kërkuese i është drejtuar gjykatës sipas kërkesës objekt kërkimi. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes u provua se të paditurit Tajar Lala, Teuta Lala, Dervish Lala e Erilinda Lala, kanë humbur afatin ligjor të paraqitjes së ankimit për shkaqe të arsyeshme. Në bazë të akteve që ndodhen në fashikullin gjyqësor nr. 298 akti, komunikimi i vendimit, kërkuesve i është bërë nëpërmjet vendosjes së shpalljes në Komunën Lukovë, Sarandë dhe në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Në fashikullin gjyqësor nuk tregohet fakti se Komuna Lukovë ka afishuar kopje të vendimit të gjykatës në mënyrë që të provohet marrja dijeni e kërkuesve për vendimmarrjen e gjykatës. Përveç sa më sipër kërkuesit pretendojnë se ata janë banorë të fshatit Borsh Sarandë, adresë në të cilën janë njoftuar dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe se në vendimin e shpalljes së mos kompetencës, ndodhej adresa e tyre e saktë. Nisur nga sa më sipër, gjykata krijon bindje se kërkuesit kanë shkak të ligjshëm për të kërkuar rivendosjen në afat, për të ushtruar ankim kundër vendimit përfundimtar të gjykatës.

9. Kundër këtij vendimi ka ushtruar **ankim** personi i tretë Prefekti i Qarkut Vlorë, i cili ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës, duke pretenduar ndër të tjera se:

- Paditësit kanë ndjekur pothuajse rregullisht seancat gjyqësore në të cilat ishin të paditur pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

- Në momentin që çështja civile i kaloi për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, paditësit nuk u paraqitën gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore ndonëse adresa e paditësve qe po ajo që ishte paraqitur edhe pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë, në të cilën ishin paraqitur thuajse në çdo seancë. Paditësja Erilinda Lala është juriste në profesion dhe presupozohet se i di shumë mirë afatet dhe procedurat ligjore të kalimit të një çështje gjyqësore nga një gjykatë në gjykatën tjetër, ndërkohë që pretendon se nuk ka pas dijeni për zhvillimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.

- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka ezauruar të gjitha rrugët ligjore të njoftimit, në fillim me fletëthirrje në adresën e tyre dhe më pas, me shpallje publike pranë Komunës Lukovë. Pala përsëri nuk është paraqitur në gjykim me pretendimin se nuk ka marrë dijeni.

- Ndodhur në këto kushte, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër ka zhvilluar gjykimin në mungesë duke vendosur pranimin e kërkesë padisë së Prefektit të Qarkut Vlorë. Sa më sipër pretendimi i paditësve është totalisht i rremë dhe i pabazuar në ligj.

- Gjykata ka zbatuar me përpikëri K.Pr.Civile dhe konkretisht nenet 130, 133, ku në fillim ka bërë njoftimin me fletë thirrje dhe më pas nëpërmjet afishimit publik.

- Gjykata pranoi kërkesën e paditësve ndonëse, mosparaqitja gjatë gjykimit në të cilën ishin paditës dhe kërkesa për rivendosje në afat nga ana e tyre, nuk është asgjë më tepër se mënyrë për zvarritje të gjykimit dhe mosekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

10. **Gjykata Administrative Apelit,** me vendimin nr. 76, datë 23.11.2015, ka vendosur:

"*Ndryshimin e vendimit nr. 2117, datë 4.12.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.*

Rrëzimin e kërkesës për rivendosje në afat.

Shpenzimet gjyqësore në Gjykatën e Apelit Administrativ nuk u kryen.

E drejta e rekursit kundër këtij vendimi mund të ushtrohet në Gjykatën e Lartë, brenda 30 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e komunikimi të tij palëve ndërgjyqëse.".

11. Gjykata Administrative Apelit ka rrëzuar kërkesën duke arsyetuar ndër të tjera se gjykata e shkallës së parë, në kuptim të nenit 17/2, të ligjit nr. 49/2012, ka gabuar në cilësimin e fakteve dhe veprimeve të lidhura me këtë kërkesë, duke identifikuar dispozitat e detyrueshme për t'u zbatuar prej saj, në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes, por duke i interpretuar ato në mënyrë jo korrekte. Referuar përmbajtjes së kërkesës së tyre, kërkuesit pretendojnë se si gjykimi në themel i konfliktit të shkallës së parë, ashtu edhe vendimi përfundimtar për zgjidhjen e tij, janë komunikuar në adresën Komuna Lukovë, Sarandë, pra në një adresë të ndryshme nga ajo e kërkuesve, duke i privuar këta të fundit nga e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për të ankimuar vendimin përfundimtar, të disponuar në disfavor të tyre. Konkretisht, kërkuesit kanë pretenduar se nuk janë banorë të Komunës Lukovë, Sarandë, por banorë të fshatit Borsh, Lagjja Shkallë. Gjykata e Apelit Administrativ konstaton, se në vendimin nr. 411, datë 17.6.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, kërkuesit (persona të tretë në atë gjykim), pasqyrohen banorë të Komunës Lukovë, Sarandë. Përkundër sa më sipër, adresa e vendbanimit të kërkuesve, i mungon vendimit nëpërmjet të cilit kërkuesit janë rivendosur në afat. Në mënyrë flagrante dhe të pashpjegueshme, në këtë vendim, lidhur me gjeneralitetet e kërkuesve, nga gjykata e shkallës së parë nuk pasqyrohet asnjë e dhënë, veç numrave të telefonit celular, për dy prej tyre.

11.1 Në mënyrë edhe më flagrante, të dhënat lidhur me vendbanimin e kërkuesve, nuk rezulton të jenë verifikuar, sipas rregullit, as në seancën gjyqësore të datës 4.12.2014, duke iu marrë vetëm numrat e telefonit dhe të dokumentit identifikues. Pavarësisht kujdesit për shmangien e këtyre të dhënave, Gjykata Administrative e Apelit konstaton se lidhur me këtë çështje, në gjykatën e shkallës së parë janë planifikuar dy seanca gjyqësore. Njoftimi i kërkueseve lidhur me seancën e parë gjyqësore të datës 25.11.2014, planifikuar për shqyrtimin e kërkesës së tyre për rivendosje në afatin e humbur ligjor të ankimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, rezulton të jetë realizuar rregullisht nëpërmjet fletëthirrjeve të datës 11.11.2014, dërguar në adresën: "Komuna Lukovë Sarandë", nënshkruar rregullisht nga kërkuesi Tajar Lala.

11.2. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar marrjen dijeni rregullisht nga kërkuesit nëpërmjet fletëthirrjeve të datës 11.11.2014 dhe mosparaqitjen prej tyre pa shkaqe që përligjnin mosparaqitjen, ka vendosur shtyrjen e seancës për datë 4.12.2014, për shkak të kërkesës për shtyrje të dorëzuar nga Prefekti i Qarkut Vlorë. Në vlerësimin e Gjykatës Administrative të Apelit, konstatimi i këtyre fakteve, konfirmon pagabueshmërinë e pretendimeve të kërkuesve, duke konfirmuar njëherësh marrjen e tyre dijeni nga njëra anë lidhur me procesin gjyqësor dhe vendimin e themelit nr. 411, datë 17.6.2014, dhe, nga ana tjetër, mungesën e vullnetit të tyre për ankimin e këtij vendimi, për sa kohë që, si fletëthirrjet, ashtu edhe vendimi përfundimtar nr. 411, datë 17.6.2014, rezultojnë të komunikuar në adresën Komuna Lukovë, Sarandë. Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit çmon se ankimi i veçantë i Prefektit të Qarkut Vlorë, përmban shkaqe që diktojnë ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

12. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar **rekurs** më datë 5.2.2016, kërkuesit Tajar Lala, Teuta Lala, Erilinda Lala, të cilët kanë kërkuar prishjen e vendimit nr. 76, datë 23.11.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 2117, datë 4.12.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër. Në rekurs, ndër të tjera, kanë pretenduar se:

- Gjykata Administrative e Apelit ka gabuar në dhënien e vendimit, duke mos marrë në shqyrtim provat shkresore të depozituara në dosjen gjyqësore. Gjithashtu, ajo ka bërë një interpretim të gabuar të ligjit duke shkelur dispozitat e ligjit material dhe procedural.

- Gjykata Kushtetuese e R.SH në shumë raste ka theksuar se: "*Privimi i palës në proces nga mundësia, që nëpërmjet përfaqësimit të mbrojë interesat e veta në gjykim, është konsideruar shkelje e standardeve të procesit të rregullt*" (Vendime të GJ. K. nr. 6/2007; nr. 13/2007, etj.).

- E drejta për t'u mbrojtur, e cila realizohet nëpërmjet të drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim, përbën një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor. Realizimi i kësaj të drejte shtron para organeve gjyqësore

detyrimin për të njoftuar palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe orën e zhvillimit të seancës, për të siguruar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar padrejtësisht nga gjykimi.

- Në rastin konkret, rezulton se Gjykata Administrative e Apelit ka zbatuar keq nenin 154 të KPC-së, parë bashkërisht me nenin 21 të ligjit nr. 49/2012, si dhe nenin 130–133 të KPC-së parë bashkërisht me nenin 22 të ligjit nr. 49/2012. Në bazë të nenit 154 të KPC-së dhe nenit 21, të ligjit 49/2012, paditësi ka detyrimin që të përcaktojë në padinë e tij, ndër të tjera edhe: emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të padituri dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë. Në rast se padia nuk plotëson kriteret e përmendura në nenet 154 e vijues të KPC-së, atëherë ajo konsiderohet me të meta dhe gjykata i kërkon paditësit që të bëjë plotësimin e tyre në kuptim të neneve 154/a dhe 158/a të KPC-së.

- Në rastin në fjalë, njoftimi i palës së paditur në procesin e themelit (kërkuesve në këtë proces) nuk është bërë i mundur, në fletëthirrje është bërë shënimi "i panjohur", për shkak se adresa e tyre nuk ishte e saktë. Komuna Lukovë përmban një sërë fshatrash dhe mungesa e përcaktimit të saktë të adresës, e bën efektivisht të pamundur gjetjen e palës nga ftuesi i gjykatës apo postieri. Paditësi gjatë gjykimit të themelit nuk ka sjellë asnjë provë që të vërtetonte se adresa e vetme e njohur e të padituve ishte ajo e përcaktuar në padi, në mënyrë që gjykata të krijonte bindjen se të padituve nuk i dihet vendbanimi ose vendqëndrimi në Republikën e Shqipërisë, në mënyrë që njoftimi i fletëthirrjes të bëhej nëpërmjet shpalljes.

- Për më tepër, në dosje rezulton të jetë vërtetuar e kundërta. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka rezultuar e provuar se adresa e saktë e kërkuesve ka qenë në fshatin Borsh, Lagja Shkallë. Në dosje është paraqitur një vërtetim i lëshuar nga Komuna Lukovë ku vërtetohet se, kërkuesja Teuta Lala është banore e fshatit Borsh, vërtetim i ndodhur në dosjen gjyqësore, për të cilin Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka marrë fare në shqyrtim si provë.

- Nga ana tjetër, kërkuesit kishin caktuar një përfaqësues (Av. Gjergji Imeraj deklaruar në seancë nga kërkuesit), në gjyqin e zhvilluar fillimisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, atëherë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër duhet që fletëthirrjet t'ia dërgonte avokatit. Ky përfaqësues as nuk është njoftuar dhe as është bërë përpjekje për njoftimin e tij nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër.

- Gjithashtu, në seancën gjyqësore u provua se edhe nga vendimi i shpalljes i moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, adresa rezulton në fshatin Borsh dhe jo në Lukovë.

- Përpos kësaj shkeljeje thelbësore të të drejtave të palëve në proces, gjykata gaboi edhe në realizimin e njoftimit të vendimit përfundimtar nëpërmjet afishimit. Ashtu sikundër kemi parashtruar gjatë procesit të rivendosjes në afat, në fashikullin gjyqësor nuk tregohet fakti se Komuna Lukovë ka afishuar kopje të vendimit të gjykatës, në mënyrë që të provohet marrja dijeni e kërkuesve për vendimmarrjen e gjykatës. Në kushtet kur gjykata në shqyrtimin e çështjes në themel nuk i garantoi të padituve pjesëmarrjen në gjykim dhe për më tepër të drejtën për të marrë dijeni për vendimin përfundimtar të gjykatës, në mënyrë që të ushtronin të drejtën e ankimit, dhe kjo për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, atëherë ata (të padituri) iu drejtuan gjykatës me kërkesën objekt gjykimi, duke kërkuar rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit.

- Gjykata Administrative e Apelit me shumicë votash vendosi të ndryshojë vendimin e mësipërm dhe të rrëzojë kërkesën për rivendosje në afat pa dhënë asnjë argument racional, por duke iu referuar faktit që kërkuesit në kërkesën e tyre nuk kanë vendosur një adresë të saktë dhe për rrjedhojë nuk i takon të rivendosen në afat. Ky arsyetim jo vetëm është në kundërshtim me dispozitat sipërcituara, por thellon paligjshmërinë, pasi i mohon për herë të dytë kërkuesve të drejtën e pjesëmarrjes në gjykim dhe të drejtën për një ankim efektiv ndaj vendimeve të dhëna nga gjykatat e ulëta.

- Gjykata Administrative e Apelit ka vepruar në kundërshtim me ligjin 49/2012, që parashikon mënyrën e njoftimit për gjykim në apelin administrativ, pasi jo vetëm që nuk na ka njoftuar me letër-thirrje për datën e gjykimit të çështjes, por as nuk e ka shpallur atë në faqen e saj zyrtare. Gjykata është mjaftuar me faktin e shpalljes së saj në ambientet e gjykatës, kur ndërkohë ka pasur detyrimin për publikimin e saj në faqen zyrtare të gjykatës dhe shpalljen e datës së gjykimit pranë njësisë administrative ku banon kërkuesi. Me të drejtë lind pyetja, si mund të marrë dijeni pala kërkuese që banimin e ka në fshatin Borsh Sarandë, për një njoftim në Tiranë?! Me këtë veprim, Gjykata e Apelit na ka mohuar të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, duke pasur interes në këtë çështje, pasi me vendim të formës së prerë na është hequr trualli ku ne kemi shtëpinë.

- Në këto kushte, Gjykata është treguar e njëanshme dhe ka cenuar parimet bazë të shtetit të së drejtës, ku mbi të gjitha prevalon e drejta e çdo individi për të pasur një proces të rregullt ligjor dhe të paanshëm. Pasojat e ekzekutimit të këtij vendimi janë tepër të rënda, për vet faktin se nëse nga ne nuk ushtrohet ankim kundër vendimit nr. 411, datë 17.6.2014, automatikisht rrezikojmë të humbasin shtëpinë ku ne jetojmë. Me të drejtë, në

vendimin e gjykatës njëri prej anëtarëve të trupit gjykues ka "votuar" kundër, duke i qëndruar arsyetimit të bërë në vendimin e shkallës së parë.

II. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ

13. Paraprakisht, sa i përket afatit për paraqitjen e rekursit në Gjykatën e Lartë, nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se aktet e komunikimit të vendimit nr. 76, datë 23.11.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit, drejtuar kërkuesve në adresën: Komuna Lukovë Sarandë, janë kthyer me shënimin e postës "i panjohur". Kërkuesit kanë marrë dijeni për vendimin më datë 8.1.2016, kur kërkuesja Erilinda Lala, ka tërhequr vendimin (edhe për kërkuesit e tjerë) në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Apelit.

14. Rrjedhimisht rekursi i ushtruar nga kërkuesit rezulton se është paraqitur më datë 5.2.2016, pra brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, të parashikuar në nenin 443(2) i Kodit të Procedurës Civile. Rekursi i kërkuesve i është komunikuar prej Gjykatës Administrative të Apelit personave të tretë, Prefekti i Qarkut Vlorë dhe Komuna Lukovë, të cilët nuk kanë paraqitur kundërrekurs.

A. Procedura në Gjykatën e Lartë dhe nevoja për njësim të praktikës gjyqësore

15. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji), çmon të nevojshme të theksojë qëndrimin e mbajtur për shkak të disa ndryshimeve thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural nga momenti, kur Gjykata Administrative e Apelit ka marrë vendimin dhe pala ka ushtruar rekursin në Gjykatën e Lartë e deri në momentin që merret ky vendim. Ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 49/2012, janë thelbësore për rregullat që duhet të ndiqen gjatë procedurës së gjykimit që zhvillon ky Kolegj. Konkretisht në nenin 9 të ligjit nr. 49/2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, datë 3.5.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, është parashikuar se: "*Përbërja e trupave gjykues si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera.*" Pikërisht rregullat e reja të gjykimit që parashikohen për procedurën e gjykimit që duhet të zhvillojë Kolegji Administrativ, janë të zbatueshme edhe për rastin në shqyrtim.

16. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga trupa gjykuese me tre gjyqtarë, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi këtë çështje më datë 23.3.2023 dhe konstatoi ekzistencën e praktikave të ndryshme, që lidheshin me kuptimin e institutit procedural të rivendosjes në afat të ankimit, lidhur me faktin nëse duhet apo jo që kërkesës për rivendosje në afat t'i bashkëlidhej edhe akti procedural i ankimit për të cilin kërkohet rivendosja në afat (*shih ndër të tjerë, vendimin nr. 00-2013-570 (73), datë 29.1.2013, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; vendimin nr. 00-2015-3386, datë 9.7.2015, të Kolegjit Administrativ i Gjykatës së Lartë; vendimin nr. 00-2022-2780 (456), datë 9.11.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, etj*).

17. Dy qëndrimet kryesore kontradiktore të konstatuara nga Kolegji dhe që janë vënë re në praktikë janë:

1. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për rivendosje në afat, nuk është e nevojshme të bashkëlidhet edhe akti procedural i ankimit, por ky i fundit depozitohet brenda një afati të ri 15-ditor, që fillon të ecë pasi vendimi gjyqësor për rivendosje në afat të apelit merr formë të prerë;

2. Kërkesës për rivendosje në afat duhet t'i bashkëlidhet edhe akti procedural për të cilin kërkohet rivendosja në afat, që është pikërisht ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit. Nëse kjo kërkesë pranohet me vendim të formës së prerë, atëherë akti procedural i paraqitur bashkëlidhur kërkesës për rivendosje në afat quhet se është paraqitur në afat dhe bëhet i aftë të nisë procedurën e apelit, sa i përket shqyrtimit të themelit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

18. Mbi këto qëndrime kontradiktore, Kolegji, mbështetur në nenet 62 (1)(b) dhe 62/a të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke shtruar për njësim çështjen kryesore si vijon:

- **Referuar nenit 152 të Kodit të Procedurës Civile, në gjykimet administrative, kur paraqitet një kërkesë për rivendosje në afat të ankimit, a duhet që kërkuesi t'i bashkëlidhë kërkesës edhe aktin procedural të ankimit për të cilin kërkon rivendosjen në afat?**

B. Ligji i zbatueshëm

19. Ligji nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar (*këtej e tutje ligji nr. 49/2012*), në nenin 1(2), i titulluar "Objekti" parashikon se:

"*Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe.*".

20. Neni 44 i ligjit nr. 49/2012, i titulluar "Mjetet dhe afatet e ankimit" parashikon:

"*Mjetet dhe afatet e ankimit të vendimeve të gjykatave administrative janë të njëjta me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.*".

21. Neni 151 i Kodit të Procedurës Civile, i titulluar aktualisht "Rivendosja në afatet procedurale", përpara ndryshimeve të vitit 2017, (*në fuqi në kohën e ushtrimit të kërkesës*), parashikonte:

"*Kur palët ose prokurori që ka ngritur padi, për shkaqe të arsyeshme kanë humbur afatin ligjor ose atë të caktuar nga gjykata, mund të kërkojnë prej saj rivendosjen në afat procedurale, përveç kur afatet kanë karakter prekluziv.*".

22. Pas ndryshimeve të vitit 2017, të bëra me ligjin nr. 38/2017, neni 151 i KPC-së, parashikon: "*Kur palët ose prokurori, për arsye që rrjedhin nga forca madhore ose që nuk mund të ishin parashikuar nga ata, kanë tejkaluar afatin procedural ligjor ose atë të përcaktuar nga gjykata, mund t'i kërkojnë gjykatës rivendosjen në këto afate procedurale, përveç kur afatet kanë karakter prekluziv.*".

23. Neni 152 i KPC-së parashikon se:

"*Kërkesa për rivendosjen e afatit të humbur shqyrtohet nga gjykata së cilës duhet t'i paraqiten edhe dokumentet që justifikojnë ose për të cilat kërkohet rivendosja e afatit. Gjatë shqyrtimit të kërkesës thirret edhe pala tjetër.*

Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.".

24. Neni 443 i Kodit të Procedurës Civile i titulluar "Afati i ankimit" parashikon se:

"*Afati i ankimit në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, është 15 ditë.*

Afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë.

Afati për të kërkuar rishikimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kundërshtimin e të tretit është 30 ditë.

Afati i ankimeve dhe rekurseve të veçanta është 5 ditë.".

25. Neni 445 i Kodit të Procedurës Civile, i titulluar "Prekluziviteti i ankimit", parashikon se:

"*Ankimi në gjykatën e apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur pala në mungesë vërteton se nuk ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve.*".

26. Ndërsa neni 458 i Kodit të Procedurës Civile, i titulluar "Rivendosja në afatin e ankimit", parashikon se:

"*Kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkaqe të arsyeshme, mund të paraqesin kërkesë për rivendosje në afat, përpara gjykatës që ka dhënë vendimin. Kjo kërkesë shqyrtohet nga gjykata dhe kundër vendimit të tij mund të bëhet ankim i veçantë.*".

C. Vlerësimi i Kolegjit Administrativ mbi çështjen e ngritur për njësim

27. Kolegji vlerëson se instituti procedural i rivendosjes në afat, është i lidhur ngushtësisht dhe është pjesë përbërëse e konceptit juridik të afateve procedurale. Ndaj, para trajtimit të këtij instituti si dhe parashtrimit të rregullit të së drejtës për çështjen e shtruar për njësim nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerësohet e nevojshme që të jepen disa konsiderata të përgjithshme në lidhje me kuptimin, llojet dhe zbatimin e afateve që parashikon ligji procedural. Kolegji vëren se afatet procedurale janë ato hapësira kohore para, brenda apo pas kalimit të cilave, ligji procedural lejon apo kërkon nga subjektet procedurale kryerjen e sjelljeve të caktuara, të cilat kanë pasoja juridike për të drejtat dhe detyrimet e tyre në atë proces. Afatet janë përshpejtuese kur ligji përcakton momentin deri kur mund të kryhet një akt procedural dhe vonuese, kur ligji përcakton momentin para të cilit nuk mund të kryhet një akt procedural i caktuar. Afatet janë veçanërisht të rëndësishme në procedurat gjyqësore, pasi janë shfaqje e formalizmit të së drejtës procedurale, të cilat kanë si funksion kryesor rregullimin, disiplinimin, orientimin dhe qartësimin e procesit gjyqësor, duke buruar nga nevoja për gjykim brenda afateve të arsyeshme, sipas kuptimit të nenit 42(2) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe mbi të gjitha për garantimin e parimit të sigurisë juridike. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) ka theksuar se: "[r]regullat që përcaktojnë hapat formalë që duhet të ndjekin palët si dhe afatet që duhen zbatuar prej tyre kur paraqesin një apel apo kërkesë për mbrojtje gjyqësore, synojnë sigurimin e administrimit të duhur të drejtësisë dhe veçanërisht, zbatimin e parimit të sigurisë juridike (*Cañete de Goñi k. Spanjës*, 2020, § 36). Po ashtu GjEDNj-ja ka theksuar se: "zbatimi i rregullave formale të procedurës civile, me anë të të cilave palët sigurojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, është me vlerë dhe i rëndësishëm, pasi ka aftësinë të kufizojë diskrecionin, të sigurojë barazinë e palëve, të parandalojë arbitraritetin, të sigurojë zgjidhjen efektive të mosmarrëveshjes brenda një afati të arsyeshëm, si dhe të sigurojë sigurinë juridike dhe respektin për gjykatën (*Zubac k. Kroacisë* [GC], 2018, § 96)". Nga ana tjetër, GjEDNj-ja ka theksuar edhe se: "[g]jatë zbatimit të rregullave procedurale, gjykatat duhet të shmangin si zbatimin e tyre me formalizëm të tepruar, që do të dëmtonte ndershmërinë e procesit, ashtu edhe fleksibilitetin e tepruar, që do të zhvleftësonte kërkesat procedurale që parashikohen në ligj (*Hasan Tunc' dhe të Tjerë k. Turqisë*, 2017, §§ 32–33).

28. Afatet procedurale gjejnë zbatim dhe rregullojnë si veprimtarinë procedurale të palëve ashtu edhe atë të gjykatës. Për këtë qëllim, në nenin 3 të Kodit të Procedurës Civile "[k]ërkesa e palëve për fillimin e një procesi gjyqësor është e lidhur me përmbushjen nga ana e tyre të detyrimeve që rrjedhin prej këtij procesi, në format dhe *afatet* e parashikuara në këtë Kod." Në nenin 4 të këtij Kodi përcaktohet se: "[g]jykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jepen nga ky Kod, vendos për *afatet*

dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme." Ndërsa në nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: "[g]jykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm *brenda një afati të arsyeshëm*." Më tej, në nenin 3(1), të ligjit nr. 49/2012, është përcaktuar se: "[g]jykata në gjykimin administrativ, siguron nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor *dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme*, mbrojtjen juridike të të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë të subjekteve, që mund të cenohen si pasojë e ushtrimit ose jo të funksioneve publike nga ana e organeve të administratës publike."

29. Në vija të përgjithshme mund të thuhet se afatet që parashikon ligji procedural janë ose detyruese ose orientuese. Afate detyruese janë ato, mosrespektimi i të cilave passjell pasoja penalizuese juridike për subjektet procedurale, duke iu pamundësuar atyre kryerjen e mëtejshme të veprimeve të caktuara procedurale apo ushtrimin e të drejtave në proces. Ndërsa afatet orientuese nuk passjellin pasoja të drejtpërdrejta penalizuese për subjektet procedurale, por parashikohen nga ligji me qëllim për të orientuar subjektet për kohën e arsyeshme që duhet të kenë parasysh për kryerjen e veprimtarive të caktuara procedurale. Nenet 145, 146, 147, 151 e 445 të Kodit të Procedurës Civile rregullojnë aspektet kryesore të afateve procedurale, duke i ndarë ato në dy kategori kryesore: 1. afatet ligjore (*ato që parashikohen shprehimisht në ligj*); 2. afatet gjyqësore (*ato, përcaktimi konkret i të cilave lihet në zgjedhjen e kujdesshme të gjykatës, pavarësisht se ligji mund të kenë parashikuar marzhe të caktuara në ushtrimin e kësaj zgjedhje*). Afatet ligjore janë: a) të zakonshme, b) të prera, c) me karakter prekluziv. Afatet gjyqësore janë gjithnjë vetëm të zakonshme, përveç kur ligji shprehimisht i jep të drejtë gjykatës për vendosjen e një afati të prerë apo prekluziv. Afatet e prera dhe ato prekluzive duhet të përcaktohen shprehimisht nga ligji si të tillë, pasi mosrespektimi i tyre passjell pamundësi apo humbje të së drejtës për të kryer një veprimtari konkrete procedurale. Gjykata mund që kryesisht apo me pëlqimin e palëve të shkurtojë apo të zgjasë afatet e zakonshme, kur një gjë e tillë është e lejueshme nga ligji, ndërsa afatet e prera dhe ato prekluzive nuk mund të shkurtohen apo të zgjaten. Nga ana tjetër të gjitha afatet mund të rivendosen, me përjashtim të atyre me natyrë prekluzive, por edhe këto të fundit mund të mos merren parasysh nga gjykata, në rrethana të caktuara shprehimisht në ligj (*si p.sh: në rastin e palës që nuk ka dijeni për procesin gjyqësor ku është palë për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve*).

30. Midis llojeve të ndryshme të afateve, ato që normojnë ushtrimin e të drejtës së ankimit, janë ndër afatet më të rëndësishme të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile dhe ligjin nr.49/2012, pasi kalimi i tyre, i shoqëruar me mosveprimin e palës së interesuar për të paraqitur ankim ndaj një vendimi gjyqësor, passjell humbjen e të drejtës për këtë palë. Nisur nga karakteristikat e nxjerra në pah më sipër, afatet e ankimit të parashikuara nga neni 443 i Kodit të Procedurës Civile janë përshpejtuese, detyruese, ligjore dhe të prera. Ndaj në nenin 444 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se afatet e ankimit janë të prera dhe fillojnë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Kalimi i afateve të ankimit passjell marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor përkatës, në kuptim të nenit 451(b) të Kodit të Procedurës Civile. Vendimi përfundimtar i formës së prerë dhe që nuk mund t'i nënshtrohet më asnjë mjeti të zakonshëm ankimi ka fuqinë e gjësë së gjykuar, në kuptim të nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile dhe e njëjta çështje nuk mund të gjykohet sërish.

31. Në lidhje me sa më sipër, dallohen disa situata që mund të verifikohen në praktikë, ndër të cilat veçohen tre, si vijon: 1. rasti kur pala është në dijeni të procesit gjyqësor, por vendimi përfundimtar i arsyetuar i gjykatës nuk i njoftohet fare (mungon procedura e njoftimit) nga sekretaria gjyqësore sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile; 2. rastin kur pala është në dijeni të procesit gjyqësor dhe i është njoftuar edhe përmbajtja e vendimit përfundimtar të arsyetuar të gjykatës, por gjatë kohëvazhdimit të afatit të ankimit, ndodhet në rrethana të tilla që pa fajin e saj, e bëjnë absolutisht të pamundur ushtrimin e të drejtës së ankimit në afat (shkaqet e arsyeshme); dhe 3. rasti kur pala në mungesë nuk ka dijeni fare për procesin dhe as vendimin përfundimtar të gjykatës, për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, por merr dijeni efektive më pas për vendimin e gjykatës.

32. Referuar rastit të parë, kur palës e cila ka dijeni për procesin (*pavarësisht se mund të ketë qenë në mungesë të vullnetshme në shpalljen e vendimit apo në ndonjë seancë tjetër gjyqësore, ose ka qenë prezent në shpalljen e vendimit nga gjykata pa arsyetim por vetëm me dispozitiv*), nuk i njoftohet vendimi përfundimtar i arsyetuar i gjykatës sipas nenit 316 të Kodit të Procedurës Civile, atëherë në këtë rast, gjykata nuk mund të konsiderojë të formës së prerë një vendim që nuk i është njoftuar palëve dhe nëse gabimisht e ka bërë një gjë të tillë, shënimi i "formës së prerë" në atë vendim nuk ka vlerë juridike. Forma e prerë është gjendje fakti dhe juridike njëkohësisht, e cila kushtëzohet nga dijenia e vërtetuar e palëve. Në këtë rast, pala e interesuar konform nenit 444 të Kodit të Procedurës Civile, ka të drejtë të paraqesë ankim në gjykatën që ka dhënë vendimin (sipas nenit 446 të Kodit të Procedurës Civile) brenda afateve të parashikuara në nenin 443 të këtij Kodi, duke filluar nga dita e nesërme e ditës kur njoftohet apo merr dijeni efektivisht për vendimin e arsyetuar. Në këtë rast është gjyqtari i ankimit ai që sipas nenit 450 të Kodit të Procedurës Civile, do të vlerësojë respektimin e kushteve formale të ankimit. Ndaj nuk shtrohet për diskutim

rivendosja në afat e ankimit, pasi afati as formalisht nuk ka filluar të ecë për palët, për shkak të mos realizimit të ndonjë njoftimi nga gjykata. Në lidhje me rastin e mosnjoftimit, GjEDNj-ja ka theksuar se: "e drejta për të paraqitur [...] apelim duhet të lindë nga momenti kur pala vjen efektivisht në dijeni për një vendim të gjykatës që vendos një detyrim kundrejt saj apo që potencialisht dëmton të drejtat apo interesat e saj të ligjshme. Përndryshe, gjykatat mund të shkurtojnë ndjeshëm kohën për paraqitjen e apelit apo edhe ta bëjnë atë të pamundur, nëpërmjet vonesave në njoftimin e vendimit. Si mjet komunikimi midis gjykatës dhe palëve, njoftimi bën që vendimi i gjykatës dhe arsyet për marrjen e tij t'i bëhen të ditura palëve, duke iu mundësuar kësisoj atyre të paraqesin apel nëse dëshirojnë" (*Miragall Escolano dhe Të Tjerët k. Spanjës*, 2000, § 37).

33. Ndryshe qëndron rasti i dytë, kur gjykatat ia njoftojnë vendimet ndaj të cilave lejohet ankim, palëve apo përfaqësuesve të tyre, por këto për shkaqe të arsyeshme, që kanë të bëjnë me rrethana objektive me natyrë absolute dhe të pavarura nga vullneti i tyre, nuk kanë mundësi të ushtrojnë të drejtën e ankimit. Në këtë rast pala ka dijeni për vendimin e arsyetuar ndaj të cilit kërkon të ushtrojë ankim, por ndodhet në kushtet e pengesave objektive absolute që nuk mund të ishin parashikuar prej saj, e që për këtë shkak nuk mundet të ushtrojë të drejtën e ankimit. Këtu gjen zbatim instituti i rivendosjes në afat të ankimit, sipas neneve 151, 152 e 458 të Kodit të Procedurës Civile.

34. Në vijim referuar rastit të tretë të parashtruar më sipër, nëse gjykata i ka zbatuar formalisht rregullat e njoftimeve sipas Kodit të Procedurës Civile (*p.sh: nenet 128–133/b dhe 141–144/a*) për palët në mungesë apo përfaqësuesit e tyre, duke u dërguar atyre njoftimet gjatë gjykimit dhe më pas edhe për vendimin e gjykatës, si dhe ka administruar aktet përkatëse të njoftimit, por këto njoftime preken nga pavlefshmëri sipas nenit 122 të Kodit të Procedurës Civile (*të tilla që krijojnë pasiguri të plotë për personin apo datën e njoftimit*), atëherë "forma e prerë" që i ka shënuar gjykata vendimit të saj (*për mosankimim nga palët në mungesë*), mund të cenohet vetëm nëpërmjet paraqitjes së kërkesës për rivendosje në afat të ankimit, në të cilën pala e interesuar shënon si shkak për humbjen formale të afatit të ankimit, pavlefshmërinë e njoftimeve të kryera nga gjykata. Po kështu vepron edhe pala që ndonëse ka dijeni për procesin, ka qenë në mungesë në shpalljen e vendimit, ose vendimi është shpallur i paarsyetuar dhe akti i njoftimit të vendimit të arsyetuar të gjykatës për të është i pavlefshëm sipas nenit 122 të Kodit të Procedurës Civile. Edhe kjo palë duhet të kërkojë rivendosjen në afat të ankimit, nëse dëshiron të ankimojë vendimin e gjykatës. Pavlefshmëria e njoftimit në këtë rast, përbën një rrethanë që nuk duhet të ketë të bëjë me vullnetin e palës, siç janë për shembull rastet e parashikuara nga nenet 129(5), 158(5) të Kodit të Procedurës Civile (*detyrimi i palëve dhe personave të tretë për të njoftuar gjykatën për ndryshimin e të dhënave të tyre elektronike të kontaktit*), përndryshe pretendimi për pavlefshmëri është i papranueshëm.

35. Nisur nga sa më sipër, Kolegji vëren se instituti procedural i rivendosjes në afat të ankimit është aspekti ekuilibrues i ngurtësisë që shoqëron në vetvete ekzistencën e afateve procedurale dhe përbën përjashtimin nga rregulli, i cili ndikon në përforcimin e vetë rregullit. Ky institut i jep elasticitetin e nevojshëm procedurave gjyqësore dhe shërben për mbrojtjen dhe garantimin e procesit të rregullt ligjor. Rivendosja në afat e cila parashikohet nga nenet 151, 152 e 458 të Kodit të Procedurës Civile, është mjeti i mbrojtjes për palën që, pa fajin e saj, humb formalisht një afat ankimi. Kjo, si në rastin kur ajo vetë apo përfaqësuesi i saj për shkaqe të arsyeshme ndodhen në kushtet e pamundësisë absolute për paraqitjen e ankimit, që nuk varet nga rrethana që mund të parashikoheshin prej tyre, ashtu edhe në rastin kur afati humbet për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, të cilat formalisht janë kryer nga gjykata, por që në thelb janë të vesuara në atë masë, sa ligji i quan të pavlefshme. Në këtë rast, pala e interesuar, e cila dëshiron të paraqesë ankim, do që të zhbëjë cilësinë e formës së prerë të vendimit gjyqësor, dhe kjo realizohet vetëm nëpërmjet procedurës së posaçme të rivendosjes në afat, e cila sipas neneve 152 e 458 të Kodit të Procedurës Civile, është një procedurë që zhvillohet në prani edhe të palës tjetër kundërshtare, pasi është zgjatim natyral i institutit procedural të ankimit dhe vlerësimit gjyqësor të respektimit apo jo të afatit të ankimit nga palët e interesuara. Neni 152 i KPC-së parashikon shprehimisht se: "[g]jatë shqyrtimit të kërkesës thirret edhe pala tjetër." Kjo bëhet me qëllim, që ushtrimi i një ankimi të munguar për shkaqe absolute objektive, të pavarura nga vullneti i palës apo përfaqësuesit të saj, të lejohet nga gjykata vetëm duke dëgjuar paraprakisht edhe palën që "dëmtohet" nga rivendosja në afat dhe heqja e cilësisë së formës së prerë të vendimit përkatës. Kjo pasi, siç u tha më lart, nëse nuk ushtrohet e drejta e ankimit (në rastet kur lejohet ankimi), vendimi merr formë të prerë dhe nuk mund të cenohet më ajo që është vendosur nga gjykata, pasi cenohet siguria juridike dhe gjëja e gjykuar (*kur nuk ka mjete të tjera ankimi në dispozicion*), përveç kur vendimi ka natyrë të tillë që ligji parashikon se mund të ndryshohet sa herë ndryshojnë rrethanat (si p.sh: vendimi që ka vendosur një detyrim për ushqim).

36. Në rastin e humbjes së afatit të ankimit për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, ky fakt përbën argument për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit të munguar, e jo paraqitjen e një padie për pavlefshmërinë e

njoftimeve. Në këtë rast, pretendimi që shërben për të mbështetur kërkesën për rivendosje në afat, ngrihet gjatë kësaj procedure të posaçme ku gjykata heton dhe vlerëson faktin nëse pretendimi i parashtruar është apo jo i vërtetë. Por, nuk ka interes juridik pala e interesuar që të iniciojë një proces gjyqësor *de novo* me palë kundërshtare vetëm për këtë pretendim, duke paraqitur padi me objekt pavlefshmërinë e njoftimeve, kundrejt palës tjetër kundërshtare të gjykimit të themelit. Aktet e njoftimit, janë akte të gjykatës dhe çdo pretendim për pavlefshmëri të tyre i adresohet gjykatës nëpërmjet kërkesës për rivendosje në afat, ku gjatë kësaj procedure, për shkak se potencialisht mund të preken të drejtat e palës tjetër, dëgjohet edhe kjo e fundit, në lidhje me qenien apo jo të pavlefshme të njoftimeve. Nëpërmjet këtij procesi, i cili ka si objekt të tij vetëm rrethanat që kanë penguar ushtrimin e të drejtës së ankimit nga pala e interesuar, mundësohet zgjidhja e pretendimit dhe eventualisht rivendosja në vend e të drejtës.

37. Nisur nga sa më sipër natyrshëm shtrohet pyetja, çfarë kuptohet me rivendosje në afat? A është ky një rifillim i afatit procedural të ankimit, i cili ndodh pasi vendimi për rivendosje në afat merr formë të prerë, apo afati i kaluar nuk rifillon më, por e drejta që do të ushtrohej brenda atij afati të kaluar, lejohet të ushtrohet më pas dhe konsiderohet njësoj si të ishte paraqitur brenda afatit?

38. Kolegji vlerëson se në nenin 152 të Kodit të Procedurës Civile është parashikuar shprehimisht se: "*[**k**]**ërkesa për rivendosjen e afatit të humbur shqyrtohet nga gjykata së cilës duhet t'i paraqiten edhe dokumentet** që justifikojnë ose **për të cilat kërkohet rivendosja e afatit***." Ky formulim i dispozitës rregullon disa çështje: 1) Përcakton se është gjykata që ka dhënë vendimin ajo që shqyrton dhe vendos për kërkesën për rivendosjen e afatit të humbur të ankimit (*shih dhe nenin 458 të KPC-së*), 2) Pala e interesuar duhet të paraqesë edhe dokumentet (provat) që justifikojnë ekzistencën e rrethanave të tilla që vlerësohen të arsyeshme dhe që i pamundësonin palës ushtrimin e të drejtës së ankimit brenda afatit të përcaktuar nga ligji, 3) Pala e interesuar ka detyrimin që bashkë me kërkesën për rivendosjen në afat, të paraqesë edhe ato dokumente për të cilat kërkohet rivendosja e afatit, d.m.th në rastin e ankimit atë akt procedural që do të duhej të ishte paraqitur brenda afatit të humbur pa fajin e palës, por që për shkak të rrethanave të justifikuara, nuk qe e mundur të paraqitej. Në këtë rast, shprehja "dokumentet" ka disa kuptime njëherësh, si në kuptim të provave që provojnë rrethanat e arsyeshme që penguan ushtrimin e të drejtës së ankimit, ashtu edhe vetë aktin e ankimit që kërkohet të rivendoset në afat.

39. Pala ka interes juridik për paraqitjen e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit, vetëm nëse e shoqëron kërkesën e saj me aktin procedural të ankimit, ashtu siç kërkon neni 152 i Kodit të Procedurës Civile, kur përcakton se pala duhet të paraqesë edhe dokumentet "për të cilat kërkohet rivendosja e afatit". Nëse pala nuk e bashkëlidh ankimin, atëherë gjykata duhet ta konstatojë me të meta kërkesën dhe t'i lërë asaj një afat për plotësimin e saj me aktin procedural për të cilin kërkohet rivendosja në afat (*sipas nenit 455 të Kodit të Procedurës Civile*). Pala nuk ka interes nëse kërkon thjesht rifillimin e afatit nga e para, në mënyrë që të ketë në dispozicion një afat të ri, gjatë të cilit të vlerësojë nëse do e bëjë apo jo ankimin. Afati i kaluar nuk mund të rifillojë edhe njëherë, por e drejta e "cenuar" mund të "shërohet". Ndaj flitet për rivendosje në afat (rivendosje në situatën *quo ante*) dhe jo rifillim të afatit. Kjo pasi, pala kur merr dijeni efektive për vendimin gjyqësor të arsyetuar, të cilin kërkon ta ankimojë, ndonëse e humbi më parë afatin ligjor të ankimit për shkaqe të pavarura nga vullneti i saj (qoftë edhe për shkak të njoftimit të pavlefshëm), duhet të paraqesë kërkesën për rivendosjen në afat të ankimit dhe bashkë me këtë kërkesë të paraqesë edhe kopjen e ankimit që kërkon të rivendosë në afat, me qëllim që edhe ai bashkë me kërkesën t'i njoftohet palëve të tjera. Në këtë mënyrë, palët e tjera kanë mundësi që të paraqesin kundërshtimet e tyre (nëse kanë) për kërkesën për rivendosje në afat dhe njëkohësisht, nëse dëshirojnë, të paraqesin edhe kundërankimet (apo kundërrekurset) përkatëse, me qëllim që nëse kërkesa për rivendosje në afat pranohet, gjykata që do të shqyrtojë ankimin, të ketë mundësi të vlerësojë edhe qëndrimin e palës kundërshtare në lidhje me përmbajtjen e tij. Kjo do të thotë se në procedurën që pason paraqitjen e kërkesës për rivendosje në afat, gjykata mban parasysh dhe zbaton *mutatis mutandis* edhe rregullat e tjera procedurale që shoqërojnë paraqitjen e mjetit përkatës të ankimit, që lidhen me pranueshmërinë e tij, si dhe plotësinë e aktit procedural të ankimit, konform neneve 442 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*për aq sa i lejohet të vlerësojë gjykatës që ka dhënë vendimin*).

40. Kolegji thekson se nëse do të pranohej se nëpërmjet institutit procedural të rivendosjes në afat, rifillon edhe njëherë një afat i caktuar, atëherë rrezikohet që ky mjet procedural të kthehet në jo efektiv, pasi mund të prodhojë situata absurde kur pas rivendosjes së afatit, lindin rrethana të tjera që i pamundësojnë palës sërish paraqitjen e ankimit, e kështu mund të kalohet në një proces ciklik kërkesash për rivënien e afateve njëri pas tjetrit, duke dëmtuar sigurinë juridike dhe afatet e arsyeshme të gjykimit. Kolegji vëren se nuk është, e nuk mund të jetë ky kuptimi i institutit të rivendosjes në afat, e për këtë qëllim ligji ka përcaktuar në nenin 152 të Kodit të Procedurës Civile se kërkesës për rivendosje në afat i duhet bashkëlidhur edhe dokumenti (në këtë rast akti procedural) për të cilin kërkohet rivendosja në afat. Në këtë mënyrë, shmanget mundësia e rifillimit disa herë të

të njëjtit afat, për shkaqe të ndryshme, ekonomizohet procesi dhe garantohet gjykimi i çështjes në afate të arsyeshme, duke u respektuar njëkohësisht edhe parimi i sigurisë juridike. E njëjta qasje legjislative gjendet edhe në nenet 147 e 420/1 të Kodit të Procedurës Penale, apo nenin 54 të Kodit të Procedurave Administrative.

41. Referuar sa më sipër dhe në lidhje organike dhe aksesore me faktin se kërkesës për rivendosje në afat të ankimit i duhet bashkëlidhur edhe akti procedural i ankimit për të cilin paraqitet kjo kërkesë, shtrohet pyetja: a ka një afat pala e interesuar për të paraqitur kërkesën për rivendosje në afat të ankimit? Në lidhje me këtë ligji procedural civil nuk ka parashikuar drejtpërdrejtë një rregull të tillë, porse në nenin 445 të Kodit të Procedurës Civile është parashikuar vetëm afati i gjatë prekluziv një vjeçar, kur është parashikuar se: "*[a]nkimi në gjykatën e apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur pala në mungesë vërteton se nuk ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve.*" Kjo dispozitë rregullon vetëm afatin prekluziv një vjeçar i cili fillon nga dita e shpalljes së vendimit dhe pasi mbaron, shuan të drejtën e ankimit të palëve. Ky rregull nuk zbatohet vetëm në rast se njoftimet janë të pavlefshme dhe për këtë shkak pala në mungesë nuk ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor. Pra, në rastin e njoftimeve të pavlefshme, pala në mungesë si më sipër nuk ndalohet të ushtrojë të drejtën e ankimit, e cila siç u tha më sipër, do të lejohet në kuadër të procedurës së rivendosjes në afat. Ndaj, meqë kërkesës për rivendosje në afat i duhet bashkëlidhur detyrimisht edhe akti procedural i ankimit, ky fakt bën që për ushtrimin e kësaj të drejte aksesore, në mungesë të një parashikimi të ndryshëm ligjor, e në funksion të garantimit të barabartë të të drejtave të palëve, të merret për referencë afati i ankimit për të cilin paraqitet kërkesa për rivendosjen në afat. Në këtë rast, mbahet një standard si për rastin kur humbja e afatit ndodh për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, ashtu edhe kur gjatë kohëvazhdimit të afatit, pala që ka dijeni për vendimin e arsyetuar të gjykatës, e humb afatin e ankimit për shkaqe të arsyeshme që nuk varen prej saj.

42. Pra, kërkesa për rivendosjen në afat të ankimit duhet të paraqitet brenda të një afati të njëjtë me atë që parashikon neni 443 i KPC-së për bërjen e ankimit përkatës i cili kërkohet të rivendoset. Ky afat do të fillojë të llogaritet sipas nenit 148 të Kodit të Procedurës Civile, nga dita e nesërme e ditës së marrjes dijeni efektivisht për vendimin e arsyetuar për të cilin kërkohet rivendosja në afat e ankimit (*në rastin e pavlefshmërisë së njoftimeve*), ose nga dita e nesërme e ditës kur ka pushuar së ekzistuari shkaku i arsyeshëm (*forcë madhore apo shkak tjetër i arsyeshëm që nuk mund të parashikohej nga pala*) që e ka penguar palën të ushtrojë të drejtën e ankimit. Ky arsyetim, sidomos sa i përket pavlefshmërisë së njoftimit, si shkak për rivendosjen në afat të ankimit, mbështetet edhe në kuptimin e paragrafit të tretë të nenin 120 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit "*[p]avlefshmëria nuk mund të prapësohet nga pala që e ka shkaktuar atë dhe as nga ajo që ka hequr dorë heshtazi.*"

43. Nëse pala e interesuar është penguar në ushtrimin e të drejtës së ankimit ndaj një vendimi gjyqësor, vetëm për shkak të njoftimeve të pavlefshme të këtij vendimi dhe më pas ndonëse merr dijeni efektivisht për këtë vendim, nuk vepron brenda të njëjtës kohë sa afati i ankimit që kërkon të rivendosë, duke mos paraqitur kërkesën për rivendosje në afat të këtij ankimi, atëherë kjo palë vlerësohet se ka hequr dorë heshtazi nga pretendimi për pavlefshmëri të njoftimit e për rrjedhojë nuk mund të gëzojë më mbrojtje e drejta e saj e ankimit dhe nuk mund të pranohet rivendosja në afat, për mungesë interesi juridik. Heqja dorë heshtazi nga pretendimi për pavlefshmërinë e njoftimit, nëse ai është i vetmi argument në të cilin pala e mbështet kërkesën për rivendosje në afat, dëmton drejtpërdrejtë mundësinë e saj për mbrojtjen e të drejtës së ankimit, pasi edhe kjo e drejtë humbet bashkë me pretendimin e pa ngritur në kohë. Kjo mënyrë të kuptuari e dispozitave ligjore të mësipërme është nga njëra anë garantuese për palën që gabimisht dhe pa fajin e saj është penguar që të ushtrojë të drejtën e ankimit, e cila mund ta rivendosë të drejtën e saj nëpërmjet paraqitjes brenda afatit të kërkesës për rivendosje në afat të ankimit, e nga ana tjetër është shkurajuese për palën që neglizhon apo qëllimisht nuk vepron në kohë dhe zvarrit pa shkak mbrojtjen e të drejtave të saj. Në rastin e fundit, balanca midis interesit për mbrojtjen e të drejtave të atij që me vetëdije nuk vepron për t'i mbrojtur ato brenda afatit dhe interesit për garantimin e sigurisë juridike që prodhojnë vendimet e formës së prerë, anon nga ana e kësaj të fundit.

44. Lidhur me sa është trajtuar më sipër në këtë vendim njësues, shtrohet për zgjidhje qëndrimi që duhet të mbajnë gjykatat për çështjet e gjykuara para njësimit të praktikës gjyqësore. Në lidhje me këtë, Kolegji thekson se gjykatat në shqyrtimin e kërkesave të paraqitura e të shqyrtuara para botimit në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi njësues, duhet të bëjnë kujdes që sa është theksuar më sipër, të mos lëndojë në mënyrë joproporcionale të drejtat procedurale të palëve. Gjykatat duhet të zbatojnë sa është arsyetuar më sipër, në dritën e orientimit të GjEDNj-së, sipas të cilës "[g]jatë zbatimit të rregullave procedurale, gjykatat duhet të shmangin si zbatimin e tyre me formalizëm të tepruar, që do të dëmtonte ndershmërinë e procesit, ashtu edhe fleksibilitetin e tepruar, që do të zhvleftësonte kërkesat procedurale që parashikohen në ligj (*Hasan Tunc' dhe të Tjerë k. Turqisë*, 2017, §§ 32–33). Rrjedhimisht gjykatat duhet të kenë parasysh si vijë orientuese, që të rregullojnë sa të jetë e mundur procedurën,

në atë mënyrë që të garantojë ushtrimin efektiv të të drejtave nga palët. P.sh: nëse një palë ka iniciuar një proces për pavlefshmëri njoftimesh, por nga kjo del qartë se kërkohet rivendosja në afat e të drejtës së ankimit të humbur për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, atëherë gjykatat duhet të vlerësojnë thelbin e kërkimit dhe të kërkojnë nga pala edhe paraqitjen e ankimit përkatës, e më pas të disponojnë për rivendosjen në afat, nëse ky kërkim rezulton i mbështetur në ligj e në prova. Në zgjidhjen e drejtë të çështjeve të parashtruara dhe të shqyrtuara para njësimit, sa i përket elementeve formale të procesit, gjykatat duhet të mbajnë parasysh parimin e së drejtës së shënuar në paragrafin e fundit të nenit 119 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit "[p]avlefshmëria nuk mund të shpallet kur akti ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar." Kësisoj, nuk mund të cenohet një vendim i marrë për një çështje të shqyrtuar para njësimit të praktikës, në të cilën p.sh: gjykata ka vendosur rifillimin e afatit procedural dhe pala e interesuar ka ushtruar më pas të drejtën e ankimit brenda afatit të rifilluar, dhe aktet janë përcjellë në gjykatën kompetente për shqyrtimin e ankimit. Në këtë rast pavarësisht të metave, akti e ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar. Në të njëjtën frymë gjykatat duhet të vlerësojnë edhe raste të tjera që mund të lindin në praktikë.

Ç. Rregulli i së drejtës për çështjen e shtruar për njësim

45. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në arsyetimin e mësipërm, referuar çështjes së shtruar për njësim, arrin në këtë përfundim njësues:

- **Në kuptim të neneve 152 dhe 458 të Kodit të Procedurës Civile, në të gjitha gjykimet administrative ku paraqitet një kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit, kërkuesi ka detyrimin që t'i bashkëlidhë kërkesës edhe aktin procedural të ankimit për të cilin kërkohet rivendosja në afat.**

D. Në lidhje me zgjidhjen çështjes objekt gjykimi

46. Kolegji vëren, se Gjykata Administrative e Apelit, ka rrëzuar kërkesën për rivendosje në afat, pasi duke ju referuar vendimit të shkallës së parë, në thelb ka konsideruar se kërkuesit janë banorë të Komunës Lukovë, dhe si të tillë, kanë marrë dijeni për vendimin e gjykatës (themelit) dhe nuk kanë ushtruar ankim. Duke qenë se komunikimi i fletë thirrjeve për këtë gjykim (rivendosja në afat) dhe njoftimet për gjykimin e themelit dhe vendimi përfundimtar, janë bërë në të njëjtën adresë Komuna Lukovë, Sarandë, Gjykata e Apelit ka konstatuar se kërkuesit kanë marrë dijeni për vendimin e themelit dhe mungesën e vullnetit të tyre për ankimin e këtij vendimi.

47. Ndërkohë gjykata e shkallës së parë, ka pranuar kërkesën për dy shkaqe: 1. në fashikullin gjyqësor nuk tregohet fakti se Komuna Lukovë ka afishuar kopje të vendimit të gjykatës që të provohet marrja dijeni e kërkuesve; 2. kërkuesit pretendojnë se janë banorë të fshatit Borsh Sarandë, adresë në të cilën janë njoftuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

48. Referuar akteve procedurale në dosjen gjyqësore, rezulton se shkalla e parë nuk e ka administruar dosjen e themelit për të parë dhe vlerësuar pretendimet mbi mosnjoftimin e rregullt të kërkuesve. Kjo e metë e hetimit gjyqësor nuk është rregulluar as nga gjykata administrative e apelit. Sa herë kërkohet rivendosja në afat e ankimit, gjykata duhet të administrojë dosjen origjinale, ose në pamundësi një kopje të vërtetuar të saj, pasi nëpërmjet kësaj mund të vlerësojë nëse qëndrojnë apo jo pretendimet e kërkuesit për pavlefshmëri të njoftimeve. Disa nga aktet e njoftimit të gjykimit të themelit, rezulton se janë depozituar nga kërkuesit, të cilët bashkëlidhur rekursit, kanë paraqitur dhe vendimin nr. 23-2014-73 (50) datë 16.1.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë (moskompetenca).

49. Kërkuesit në kërkesën e tyre shprehen se me vendimin e gjykatës (themelit), janë njohur më datë 4.11.2014. Gjykatat duhet t'i kërkonin shpjegime kërkuesve në lidhje me rrethanat se nga kush dhe në ç'mënyrë janë njoftuar në këtë datë. Gjithashtu, rezulton se kërkesa për rivendosje në afat objekt gjykimi, nuk përmban bashkëlidhur ankimin kundër vendimit të themelit, çka përbën një të metë të vetë kërkesës. Për këtë fakt, asnjë nga dy gjykatat më të ulëta nuk është shprehur. Kolegji vlerëson se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim nenin 152 të Kodit të Procedurës Civile, i cili plotëson nenin 458 të këtij Kodi, kur nuk kanë konstatuar të metë kërkesën për rivendosje në afat dhe të kërkonin nga kërkuesit që asaj t'i bashkëlidhej edhe akti procedural i ankimit për të cilin kërkohej rivendosja në afat. Kjo e metë formale i pamundëson Gjykatës së Lartë vlerësimin e mëtejshëm të argumenteve në lidhje me shkakun e mosmarrjes dijeni nga pala, që është pavlefshmëria e njoftimeve, pasi pavarësisht nëse ky pretendim është apo jo i bazuar, në gjendjen që janë aktet, nuk mund të disponohet me vendim për rivendosjen në afat të një ankimi që mungon në dosje.

50. Kolegji vlerëson, se referuar analizës së mësipërme lidhur me aktet e ndodhura në dosje, ndodhemi në kushtet kur duhet të prishet vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit dhe çështja të dërgohet për

rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues. Në rigjykim, kjo gjykatë t'i lërë afat palës kërkuese që të plotësojë kërkesën për rivendosje në afat me ankimin përkatës, të administrojë dosjen gjyqësore të themelit, për të cilën kërkohet të ushtrohet ankim, e më pas të vijojë me shqyrtimin e çështjes, duke u shprehur për shkaqet e parashtruara nga palët, në lidhje me themelësinë e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenet 62/a dhe 63(1)(c)(2), të ligjit nr. 49/2012, "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", të ndryshuar,

VENDOSI:

- Prishjen e vendimit nr. 76, datë 23.11.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, më 7.7.2023.

Kryesues: Sokol Sadushi,

Anëtar: Asim Vokshi, Arbena Ahmeti, Gentian Medja,

Anëtar pjesërisht kundër: Sokol Ngresi

MENDIM PARALEL

1. Në përfundim të shqyrtimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë të çështjes administrative me nr. 31003-00237-00-2016, unë gjyqtari Sokol Ngresi, ndërsa votoj pro zgjidhjes që ky Kolegj i ka bërë çështjes së shtruar për njehsim, si dhe zgjidhjes së çështjes konkrete objekt gjykimi, nuk ndaj të njëjtin vlerësim për një pjesë të analizës që shumica i ka bërë rrethanave dhe shkaqeve që lidhen me institutin e rivendosjes në afat të ankimit.

2. Në një situatë të tillë analize dhe vlerësimi të këtyre rrethanave, çmoj se ndodhem në kushtet e parashtrimit të arsyetimit paralel.

3. Siç theksohet edhe në vendimin përfundimtar të këtij Kolegji, prej trupës gjykuese të përbërë nga tre gjyqtarë, me të drejtë është konstatuar ekzistenca e praktikave të ndryshme, që lidhen me kuptimin e institutit procedural të rivendosjes në afat të ankimit, lidhur me faktin nëse duhet apo jo që kërkesa për rivendosje në afat, domosdoshmërish të shoqërohet edhe me aktin procedural të ankimit për të cilin kërkohet rivendosja në afat.

4. Mbi këto qëndrime kontradiktore, ajo trupë gjyqësore, mbështetur në nenet 62(1)(b) dhe 62/a të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, duke shtruar për njësim çështjen kryesore si vijon: **Referuar nenit 152 të Kodit të Procedurës Civile, në gjykimet administrative, kur paraqitet një kërkesë për rivendosje në afat të ankimit, a duhet që kërkuesi t'i bashkëlidhë kërkesës edhe aktin procedural të ankimit për të cilin kërkon rivendosjen në afat?**

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, bazuar në arsyetimin mbi natyrën e institutit procedural të rivendosjes në afat, referuar çështjes së shtruar për njësim, arriti në përfundimin njësues se: "**Në kuptim të neneve 152 dhe 458 të Kodit të Procedurës Civile, në të gjitha gjykimet administrative ku paraqitet një kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit, kërkuesi ka detyrimin që t'i bashkëlidhë kërkesës edhe aktin procedural të ankimit për të cilin kërkohet rivendosja në afat".**

6. Për të arritur në një përfundim të drejtë e ligjor lidhur me çështjen e shtruar për njehsim, janë marrë në analizë dispozitat procedurale që rregullojnë institutin e rivendosjes në afat, konkretisht nenet 152 dhe 458 të K.Pr.Civile, në raport me rrethanat që diktojnë nevojën e një instituti të tillë që synon respektimin e të drejtës së palëve për një proces të rregullt, duke përfshirë këtu edhe të drejtën për t'u gjykuar në një gjykatë më të lartë, lidhur me ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e vendimit të gjykatës më të ulët.

7. Siç me të drejtë evidentohet në pjesën arsyetuese nga shumica, rivendosja në afat i referohet situatave kur pala ka marrë dijeni për vendimin përfundimtar të dhënë nga gjykata, pra ka dijeni të plotë për atë ç'ka është shqyrtuar gjatë procesit gjyqësor, ka kryer analizën e vetë lidhur me dakordësinë ose jo, të plotë apo të pjesshme mbi vendimin gjyqësor dhe, bazuar në të drejtën e disponimit që ia njeh dhe garanton ligji procedural, vlerëson të ushtrojë të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi, në gjykatën më të lartë.

8. Ky kuptim rreth rrethanave për të cilat ligji procedural ka parashikuar këtë instrument, rezulton i qartë nga përmbajtja e nenit 151 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit : "*Kur palët ose prokurori, për arsye që rrjedhin nga forca madhore ose që nuk mund të ishin parashikuar nga ata, kanë tejkaluar afatin procedural ligjor ose atë të përcaktuar nga gjykata, mund t'i kërkojnë gjykatës rivendosjen në këto afate procedurale, përveç kur afatet kanë karakter prekluziv*".

9. Në harmoni me këtë dispozitë, edhe në nenin 458 të po këtij Kodi, parashikohet se, :*"Kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkaqe të arsyeshme, mund të paraqesin kërkesë për rivendosje në afat, përpara gjykatës që ka dhënë vendimin. Kjo kërkesë shqyrtohet nga gjykata dhe kundër vendimit të tij mund të bëhet ankim i veçantë".*

10. Sipas përmbajtjes së këtyre dispozitave, rezulton e qartë se nuk bëhet fjalë për rrethana që lidhen me padijeni të palës mbi procesin gjyqësor, apo mbi përmbajtjen e plotë apo të pjesshme të vendimit përfundimtar (siç mund të jetë rasti kur palës i është njoftuar vetëm pjesa urdhëruese e vendimit gjyqësor). Përkundrazi, siç theksova edhe më lart, ky institut nënkupton dijeni të plotë të palës nga njëra anë dhe pamundësinë për rrethana objektive për të respektuar afatin procedural të ankimit, nga ana tjetër. Në rastet e rivendosjes në afat të ankimit, afati procedural është konsumuar si formalisht, ashtu edhe materialisht, pra, si në dukje, ashtu edhe në thelb dhe për rrjedhojë, gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesave të tilla, objekti i të provuarit është vetëm vërtetimi i rrethanave objektive, nëse kanë ekzistuar ose jo dhe ndikimi me pasojë pamundësinë e palës për ta ushtruar të drejtën e ankimit brenda këtij afati.

11. Pikërisht, referuar këtij kuptimi që del nga përmbajtja e nenit 152 të K.Pr.Civile, dispozita pasardhëse, neni 152, lidhur me objektin e të provuarit gjatë këtij procesi kontencioz, ka përcaktuar se, : "*Kërkesa për rivendosjen e afatit të humbur shqyrtohet nga gjykata së cilës duhet t'i paraqiten edhe dokumentet që justifikojnë ose për të cilat kërkohet rivendosja e afatit. Gjatë shqyrtimit të kërkesës thirret edhe pala tjetër".*

12. Nisur nga këto konsiderata, pajtohem plotësisht me qëndrimin e shumicës, të shprehur edhe në sentencën njësuese se: "**Në kuptim të neneve 152 dhe 458 të Kodit të Procedurës Civile, në të gjitha gjykimet administrative ku paraqitet një kërkesë për rivendosjen në afat të ankimit, kërkuesi ka detyrimin që t'i bashkëlidhë kërkesës edhe aktin procedural të ankimit për të cilin kërkohet rivendosja në afat".**

13. Në situata të tilla, pala ka dijeni për vendimin përfundimtar të dhënë nga gjykata, pra ka dijeni të plotë për atë ç'ka është shqyrtuar gjatë procesit gjyqësor, ka kryer analizën e vetë lidhur me dakordësinë ose jo, të plotë apo të pjesshme mbi vendimin gjyqësor dhe ka vlerësuar të ushtrojë të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi, në gjykatën më të lartë. Pra, pala që kërkon të rivendoset në afat, ka dijeni mbi mënyrën, arsyet dhe analizën e zgjidhjes përfundimtare të bërë nga gjykata dhe tashmë e ka bërë zgjedhjen e vet rreth ecurisë së mëtejshme të procesit gjyqësor, ndaj edhe detyrimisht duhet ta shoqërojë kërkesën për t'u rivendosur në afat, së bashku me aktin procedural të ankimit (i shprehur qartë edhe në nenin 152 të K.Pr.Civile).

14. I njëjti qëndrim mbi shkaqet e rivendosjes në afat gjendet edhe në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative. Kështu, sipas nenit 54 të këtij Kodi, : "*1. Përveçse kur ndalohet shprehimisht me ligj, pala mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, me përjashtim të rasteve kur afatet kanë karakter prekluziv. 2. Rivendosja në afat mund të kërkohet: a) për afatet e përcaktuara për paraqitjen e kërkesës fillestare; b) në lidhje me afatet për kryerjen e veprimeve gjatë procedurës administrative; c) për afatet për paraqitjen e mjeteve të ankimit; si dhe ç) për çdo afat tjetër në dëm të palës. 3. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga dita kur janë eliminuar pengesat, por jo më vonë se 1 vit nga data e përfundimit të afatit të humbur. Në të njëjtin afat duhet kryer edhe veprimi procedurale, për të cilin pala ka humbur afatin për shkaqe të arsyeshme. 4. Afati 1-vjeçar, i përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, nuk zbatohet në rastin e forcës madhore".*

15. Edhe në dispozitën e sipërcituar evidentohet qartë se rivendosja në afat ka ngushtësisht si shkak ekzistencën e rrethanave të arsyeshme që kanë penguar palën ta respektojë afatin procedural.

16. Por çmoj se nuk mund të barazohet kjo situatë, e për pasojë, edhe ky përfundim njësues, për rastet kur pala ka pretenduar padijeninë e plotë apo të pjesshme mbi vendimin gjyqësor përfundimtar, për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, e aq më pak, kur palës as nuk i është njoftuar fare vendimi përfundimtar prej sekretarisë gjyqësore. Në rrethana të tilla, pala nuk ka dijeni (të plotë apo të pjesshme) rreth vendimit dhe për pasojë, nuk mund të detyrohet që, duke iu drejtuar gjykatës me kërkesë për shpalljen/konstatimin e pavlefshmërisë së njoftimit, t'i bashkëngjisë edhe aktin procedural të ankimit. Një detyrim i tillë, duke zbatuar këtë përfundim njësues edhe në rastet e pavlefshmërisë së njoftimit, çmoj se është në kontradiktë me natyrën e këtij mjeti procedural që ligji i ka njohur palës dhe do ta vinte atë në pozitë të pafavorshme në raport me palët që e kanë humbur afatin e ankimit për shkaqe objektive.

17. Në rastin e pavlefshmërisë së njoftimit të vendimit përfundimtar, edhe pse në dukje afati i ankimit ka kaluar, në thelb ky afat nuk ka nisur të ecë e për pasojë, ai nuk është konsumuar. Akti procedural i njoftimit, për shkak të mosrespektimit të rregullave përkatëse mbi njoftimet, nuk e ka arritur qëllimin e tij, njoftimin e palës në

mungesë të të cilit është dhënë vendimi përfundimtar. Akoma më keq, në rastet kur vendimi përfundimtar nuk i është njoftuar palës, ky afat as në dukje nuk është konsumuar. Praktika gjyqësore ka treguar se në shumicën e rasteve, pavlefshmëria e njoftimit të vendimit përfundimtar është pasojë e pavlefshmërisë së njoftimit të palës për vetë procesin gjyqësor, pra të padijenisë së plotë për gjykimin e aq më pak për vendimin gjyqësor, duke e përballur atë drejtpërdrejtë me pasojat në fazën e ekzekutimit të tij. Alternativa që shtrohet natyrshëm në një rast të tillë, mund të ishte ajo e një mekanizmi korrigjues, si p.sh. e ndreqjes së të metave të kërkesës për shpalljen e pavlefshmërisë së njoftimit të vendimit përfundimtar, me hartimin dhe dorëzimin edhe të ankimit, por kjo situatë, në vlerësimin tim do të krijonte dy probleme: së pari, se cili do të ishte afati që palës do të duhej t'i lihej për ndreqjen e kësaj të mete, afati 15 ditor i ankimit, apo afat i caktuar nga gjykata dhe së dyti, krijimi i pabarazisë në raport me palën që kërkon të rivendoset në afat, ku kjo e fundit ka pasur gjithë kohën e nevojshme dhe ndihmën juridike për të analizuar dhe vlerësuar qetësisht ushtrimin e së drejtës së ankimit, ndërsa pala që ka qenë në padijeni të vendimit përfundimtar, ndodhet nën efektin surprizë duke u përballur me pasojat në fazën e ekzekutimit të tij.

18. Edhe praktika e mëparshme e Gjykatës së Lartë, lidhur me pavlefshmërinë e njoftimit, ka theksuar qartë shkakun e ndryshëm të këtij kërkimi në raport me shkaqet për të cilat mund të kërkohet rivendosja në afat[92].

19. Pikërisht për shkak të natyrës së ndryshme që paraqesin rastet e humbjes së afatit të ankimit për shkaqe objektive, për të cilat bën fjalë edhe instituti i rivendosjes në afat, në raport me rastet e pavlefshmërisë së njoftimeve, ligji procedural ka përcaktuar pasoja krejt të ndryshme lidhur me prekluzivitetin e ankimit.

20. Kështu, sipas nenit 445 të K.Pr.Civile: "*Ankimi në gjykatën e apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur pala në mungesë vërteton se nuk ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve*".

21. Ky rregull është i kuptueshëm pikërisht referuar rrethanave që kanë diktuar mosushtrimin e ankimit, apo rekursit: në rastin e rrethanave objektive që kanë pamundësuar ushtrimin e kësaj të drejte (siç është situata e rivendosjes në afat), toleranca që ligji procedural ka njohur ka marrë në konsideratë çdo situatë hipotetike objektive që mund të pamundësojë ushtrimin e kësaj të drejte; ndërsa në rastin e padijenisë së procesit, bëhet fjalë për një nivel garancie shumë më të lartë, që lidhet me nevojën e respektimit të parimeve për një proces të rregullt,

---

1. [92]Vendimi nr. 431, datë 10.7.2013, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë:

2. 26... Fakti që përveç sa me sipër kërkuesi kërkon edhe rivendosjen në afat, nuk e bën kërkimin e "Pavlefshmërisë së njoftimeve" të pavlefshëm apo të papranueshëm, pasi kërkimi për rivendosje në afat për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, në çështjen objekt gjykimi është një kërkim dytësor që dhe mund të mos paraqitej fare (por dhe po u paraqit nuk ndryshon gjë), pasi në rast do të kemi pavlefshmëri të njoftimeve, kërkuesi automatikisht është i vendosur në afatin e ankimit.

30. Pavlefshmëria e një akti procedural, pavarësisht se është rrjedhojë e shkeljes së ligjit, në ndryshim nga veprimet juridike absolutisht të pavlefshme të cilat nuk riparohen asnjëherë, duhet të riparohet në të ardhmen, pasi ato e bëjnë procesin të parregullt dhe si rrjedhim dhe vendimi i dhënë nga gjykata është rezultat i një procesi të kryer në shkelje të ligjës. Në rast se për një akt të caktuar (siç është njoftimi në rastin konkret), ligji ka parashikuar respektimin e detyrueshëm të formës dhe të procedurës së njoftimit, atëherë duhet që kjo formë dhe kjo procedurë të respektohet detyrimisht, në të kundërt akti mund të shpallet i pavlefshëm.

32. Në lidhje me kërkimin e paditësit, ky Kolegj vlerëson të theksojë se njoftimi i palëve ndërgjyqëse për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe akteve procedurale të nxjerra si pasojë e tij, është një institut shumë i rëndësishëm i të drejtës sonë procedurale, respektimi i të cilit është i domosdoshëm për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

33. Detyrimi i gjykatës për të bërë njoftimin efektiv të palëve në një gjykim lind nga e drejta që kanë palët për të marrë pjesë në një proces gjyqësor në respektim të parimit të kontradiktorialitetit, parim ky që është parashikuar në nenin 20 të K.Pr.Civile dhe që nënkupton se çdo palë në një proces gjyqësor duhet t'i sigurohen të gjitha mundësitë ligjore për të diskutuar dhe parashtruar faktet, provat apo shpjegimet si edhe kundërshtarëve të tyre duhet t'u sigurohet mundësia ligjore e kundërshtimit; të gjitha palëve në një proces duhet t'u ofrohen mundësi të barabarta për të paraqitur pretendimet/prapësimet dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre.

34. Thelbi i këtij parimi është se asnjë nga palët e një procesi nuk mund të gjykohet pa u thirrur për të marrë pjesë në këtë proces dhe pa ushtruar të drejtat procedurale që rrjedhin prej tij (nenet 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24 të K.Pr.Civile).

35. E drejta për të marrë pjesë në gjykim lidhet ngushtë edhe me respektimin e rregullave mbi njoftimet parashikuar në nenet 128-144 të K.Pr.Civile. Vetëm pasi të jenë zbatuar me rigorozitet këto rregulla, mund të thuhet se pala ka marrë dijeni efektivisht për ditën e gjykimit dhe nëse nuk paraqitet, konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta për të marrë pjesë personalisht në këtë gjykim.

36. Mosrespektimi i këtyre rregullave çon në pavlefshmërinë e aktit procedural i parashikuar në nenin 119 të K.Pr.Civile, në të cilin thuhet shprehimisht se: "Akti mund të shpallet i pavlefshëm kur i mungojnë të dhënat e domosdoshme për arritjen e qëllimit të tij". Në analizë të kësaj dispozite rezulton se akti procedural, i cili nuk është kryer në formën e kërkuar nga ligji, mund të shpallet i pavlefshëm.

37. Ligjvënësi i ka kushtuar një rëndësi të madhe formës së akteve procedurale, si dhe procedurës që duhet të zbatohet për ekzekutimin e tyre, pasi këto të fundit janë mjetet me anë të të cilave gjykata dhe palët shfaqin vullnetin e tyre për zhvillimin e procesit gjyqësor. Në varësi të faktit nëse një akt e arrin qëllimin për të cilin është krijuar, vijnë dhe pasojat e tjera që kanë të bëjnë me vlefshmërinë e tij. Pikërisht qëllimi i aktit procedural merr një rëndësi të veçante kur diskutohet pavlefshmëria e tij.

pjesëmarrjen e palës, të drejtën për t'u dëgjuar dhe pasur në dispozicion gjithë mjetet e mundësitë për të ushtruar të drejtat procedurale, të drejta këto që janë cenuar jo për shkaqe objektive apo rrethana që lidhen me kujdesin e palës, por me mosrespektimin e ligjit procedural nga gjykata. Pra qasja që ligjvënësi ka në situatën e pavlefshmërisë së njoftimeve, është më garantiste në raport me situatën e rivendosjes në afat.

22. Nuk pajtohem me arsyetimin e shumicës, sipas të cilës, "*Në rastin e humbjes së afatit të ankimit për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve, ky fakt përbën argument për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit të munguar, e jo paraqitjen e një padie për pavlefshmërinë e njoftimeve*".

23. Në vlerësimin tim, nuk mundet që një mjet procedural, siç është kërkesa për pavlefshmërinë e njoftimit, që synon të garantojë drejtpërdrejt një standard shumë të rëndësishëm mbi procesin e rregullt, konkretisht të drejtën për pjesëmarrjen në proces, të shërbejë si shkak për një tjetër mjet procedural, siç është kërkesa për rivendosjen në afat të ankimit, që synon të garantojë një aspekt të këtij standardi, atë për t'u gjykuar nga një gjykatë më e lartë. Jo vetëm që kërkesa për rivendosjen në afat e së drejtës së ankimit bazohet krejtësisht në shkak tjetër në raport me kërkesën për pavlefshmërinë e njoftimeve, por edhe objekti i kërkesës, edhe disponimi i gjykatës që shqyrton këto kërkesa, edhe objekti i të provuarit, janë krejtësisht të ndryshëm.

24. Në rastin e rivendosjes në afat, shkaku i kërkesës është humbja e afatit të ankimit për arsye objektive dhe pamundësia për ta ushtruar këtë të drejtë në afat, ndërsa në rastin e pavlefshmërisë së njoftimit është padijenia e palës për vendimin gjyqësor e për rrjedhojë, mosecja e afatit të ankimit. Objekti i kërkesës, sipas nenit 151 të K.Pr.Civile është lejimi i palës kërkuese për ta ushtruar ankimin, pavarësisht konsumimit të afatit procedural, i cili konstatohet dhe pranohet edhe nga pala kërkuese se ka kaluar. Në rastin e pavlefshmërisë së njoftimit, objekti i kërkesës është konstatimi nga ana e gjykatës të të metave të këtij akti procedural (njoftimit) me pasojë mospërmbushjen e qëllimit për të cilin është destinuar, shpalljen e pavlefshmërisë së tij dhe kur është e mundur, ripërtëritjen e plotë ose të pjesshme të aktit. Objekti i të provuarit në kërkesën për t'u rivendosur në afat është ekzistenca e rrethanave objektive dhe ndikimi i tyre deri në pamundësi të palës për të vepruar dhe ushtruar të drejtën e ankimit, duke ia ngarkuar barrën e provës tërësisht kërkuesit. Në pavlefshmërinë e njoftimit, objekti i të provuarit janë, nga njëra anë rrethanat që lidhen me mënyrën e identifikimit konkret të personit të cilit i duhej dorëzuar kopja e aktit dhe nga ana tjetër, mosrespektimi i kërkesave procedurale mbi njoftimin e akteve, ndërkohë që barra e provës në këtë rast është e përzierë dhe kërkuesi mjafton të provojë ekzistencën e rrethanave që nuk kanë sjell identifikimin e saktë të tij apo të vendbanimit.

25. Së fundmi, edhe pasojat e rrjedhura nga vendimi përfundimtar në rastin e shqyrtimit të kërkesës për rivendosje në afat, janë të ndryshme në raport me rastin e pavlefshmërisë së njoftimit. Kështu, për rrethana të ndodhura pas dhënies së vendimit përfundimtar, i cili ka marrë formë të prerë për shkak të mosushtrimit të ankimit brenda afatit, pala që kërkon të rivendoset në afat në një moment të mëvonshëm, nuk mund të pretendojë të zhbëjë pasojat e rrjedhura nga ekzekutimi i tij, apo edhe të përfitojë nga rrethana që kanë ndodhur pas dhënies së vendimit, si p.sh. të çlirohet nga përgjegjësia për humbjen, dëmtimin ose pamundësinë e kthimit të sendit. Ndërkohë, në rastin e pavlefshmërisë së njoftimit, çdo veprim i kryer për ekzekutimin e vendimit që në dukje rezulton të ketë marrë formë të prerë, preket në vlefshmërinë e tij, sikundër edhe çdo rrethanë e ndodhur pas dhënies së vendimit, nuk mund të interpretohet në dëm të kësaj pale.

26. Duke qenë dy institute të ndryshme procedurale, të dallueshme si për sa i përket shkakut dhe objektit, por edhe pasojave ndaj gjithë procesit, në përfundim të kësaj analize, çmoj se në rastin e kërkesës për pavlefshmërinë e njoftimit, pala nuk mund të detyrohet që, njëherazi me paraqitjen e kësaj kërkese, të bashkëngjitë edhe ankimin ndaj vendimit. Për rrjedhojë, nuk pajtohem me qëndrimin e shumicës që, në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, e kanë trajtuar sentencën njësuese për zbatim edhe në rastet e kërkesave me objekt pavlefshmërinë e njoftimit.

27. Lidhur me zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, pajtohem me qëndrimin e shumicës, mbi ekzistencën e rrethanave që e bëjnë të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Apelit dhe që lidhen me nevojën për administrimin e dosjes së themelit për të vlerësuar pretendimet mbi mosnjoftimin e rregullt të kërkuesve. Por, ndryshe nga shumica, bazuar në shkaqet e sipërcituara, ndaj mendim të ndryshëm lidhur me detyrat në rigjykim. Duke qenë se kërkuesit kanë kërkuar rivendosjen në afat të ankimit, duke evidentuar si shkak jo humbjen e afatit për shkaqe objektive, por për shkak të pavlefshmërisë së njoftimit të vendimit përfundimtar, çmoj se në rigjykim, gjykata e apelit, duhet të qartësojë qëndrimin e palës lidhur me shkakun dhe objektin e kërkesës, duke e zgjidhur çështjen në respektim të parimit të disponibilitetit të kërkuesit dhe duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen.

Anëtar: Sokol Ngresi

VENDIM
Nr. 00-2023-4411, datë 2.3.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

Artur Kalaja	kryesues;
Margarita Buhali	anëtare;
Ervin Pupe	anëtar;
Enton Dhimitri	anëtar;
Darjel Sina	anëtar,

sot më datë 2.3.2023, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen civile me nr. 11243-00639-00-2013 regjistri themeltar, datë regjistrimi 5.3.2013, që i përket:

PADITËS: Nuri Hasa.

Përfaqësuar nga av. Gjergji Hyso

I PADITUR: Shoqëria "Banka Credins" sh.a.

Përfaqësuar nga av. Erind Mërkuri dhe Rei Beqiraj

PERSON I TRETË: Përmbarues gjyqësor Kastriot Kurmaku (në mungesë)

Shoqëria "Italdruri Elbasan" sh.p.k. (në mungesë)

OBJEKTI: Shuarjen e dorëzanisë së paditësit Nuri Hasa në "Marrëveshje kredi nr. 256, datë 3.7.2009", nr. 2059 rep., nr. 618/1 kol., datë 17.7.2009, lidhur ndërmjet shoqërisë Banka Credins sh.a. dhe shoqërisë "Italdruri" sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Nenet 32/a të Kodit të Procedurës Civile; neni 600 i Kodit Civil.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

- pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Artur Kalaja;
- dëgjoi përfaqësuesin e palës paditëse, avokatin Gjergji Hyso, që kërkoi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pranimin e padisë;
- dëgjoi përfaqësuesin e palës së paditur, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit;
- dhe si shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e fashikullit të gjykimit dhe referuar fakteve të pranuara nga gjykatat rezulton se pala e paditur, shoqëria Banka Credins sh.a. është regjistruar si person juridik, shoqëri anonime, në datën 31.1.2003, me objekt të saj, veprimtarinë bankare.

Personi i tretë në këtë gjykim, shoqëria "Italdruri Elbasan" sh.p.k. është regjistruar si person juridik, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në datën 1.7.1996, me objekt të veprimtarisë, ndër të tjera, prodhim dhe tregtim të lëndës drusore, mobilim etj., ndërkohë që paditësi Nuri Hasa, është njëri prej ortakëve të shoqërisë "Italdruri" sh.p.k.

2. Midis palës së paditur, shoqërisë "Banka Credins" sh.a., në cilësinë e kredidhënësit dhe të personit të tretë shoqëria "Italdruri" sh.p.k. në cilësinë e kredimarrësit është lidhur kontrata "Marrëveshje linjë kredie nr. 256, datë 3.7.2009", e noterizuar me nr. 2059 rep., nr. 618/1 kol., datë 17.7.2009. Me këtë kontratë personi i tretë ka marrë kredi shumën prej 25.000.000 lekësh, me qëllimin e financimit të aktivitetit të tij. Kontrata është lidhur për një afat 6-mujor, i cili nis të llogaritet nga dita e autorizimit në llogari (neni 3.2 i kontratës).

3. Paditësi Nuri Hasa, në cilësinë edhe të njërit prej ortakëve të shoqërisë "Italdruri" sh.p.k., në kohën e nënshkrimit të kontratës së kredisë, është përfshirë në këtë kontratë kredie në cilësinë e dorëzanësit për të garantuar përmbushjen e detyrimit nga huamarrësi.

4. Duke qenë se detyrimi sipas kontratës nuk është përmbushur nga debitori, person i tretë në këtë gjykim "Italdruri Elbasan" sh.p.k, pala e paditur shoqëria "Banka Credins" sh.a. si kreditore ka kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për kontratën e kredisë si titull ekzekutiv.

Me vendimin nr. 1016, datë 11.3.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar urdhri i

ekzekutimit për këtë titull ekzekutiv dhe me kërkesë të kreditorit, personi i tretë përmbaruesi gjyqësor Kastriot Kurmaku, ka filluar procedurat për ekzekutimin e këtij titulli.

Si debitori dhe dorëzanësi kanë marrë dijeni për fillimin e këtyre procedurave dhe lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, por nga asnjëri prej tyre nuk është përmbushur detyrimi vullnetarisht. Në këto rrethana nga ana e Zyrës së Përmbarimit ka filluar ekzekutimi i detyrueshëm duke vendosur sekuestron mbi pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe të dorëzanësit.

5. Paditësi në vijim i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padinë objekt gjykimi, e cila është regjistruar në datën 9.6.2011, duke pretenduar se dorëzania e tij është shuar, në mbështetje të nenit 600 të Kodit Civil. Paditësi ka pretenduar se duke qenë që afati i ekzekutimit të detyrimit ka qenë data 17.1.2010, me kalimin e afatit 6-mujor nga kjo datë dorëzania është shuar.

Rezulton se kreditori, shoqëria "Banka Credins" sh.a. i është drejtuar gjykatës në muajin mars 2011 me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

6. Lidhur me këtë pretendim të paditësit, pala e paditur në prapësimet e saj ka pretenduar se jemi përpara ndërprerjes së parashkrimit për faktin se si debitori edhe dorëzanësi, pas kalimit të afatit për ekzekutimin e detyrimit, e kanë pranuar këtë detyrim, duke kryer edhe pagesa pjesore të detyrimit. Kjo në mbështetje të nenit 131 të Kodit Civil, germa "a", sipas të cilit parashkrimi i dorëzanisë është ndërprerë. Pas përfundimit të afatit të shlyerjes së detyrimit, kreditori, pala e paditur në këtë proces, ka njoftuar si debitorin dhe dorëzanësin për shlyerjen e detyrimit. Nga ana e këtyre të fundit ka filluar likuidimi i detyrimit në këste, shlyerje të cilat kanë vazhduar deri në dhjetor 2010.

Sipas nenit 134 të Kodit Civil, koha e kaluar para se të vërtetohej shkaku ndërprerës nuk llogaritet dhe pas zhdukjes së këtij shkaku fillon një afat i ri parashkrimi. Meqenëse pagesat nuk kanë vazhduar gjatë vitit 2011, pala kreditore në mars 2011 i është drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit dhe ka vazhduar ekzekutimi i detyrueshëm nga përmbaruesi gjyqësor.

7. Në përfundim të këtij gjykimi, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 529, datë 27.1.2012,** ka vendosur:

"*Rrëzimin e padisë së paditësit Nuri Hasa si të pambështetur në ligj e në prova.* (...)".

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka arsyetuar, se: "(...) arrin në konkluzionin se padia e paditësit Nuri Hasa është e pambështetur në ligj dhe në prova prandaj ajo duhet rrëzuar. Paditësi Nuri Hasa ka paraqitur padinë në gjykim dhe i ka mbështetur kërkimet e tij në nenin 600 të Kodit Civil.

Sipas nenit 600 të këtij Kodi, "Dorëzania shuhet në qoftë se kreditori nuk ka ngritur padi kundër dorëzanësit brenda gjashtë muajve nga dita e mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit". Pra në kuptimin formal të këtij neni me kalimin e afatit 6-mujor nga dita e mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit, dorëzania shuhet.

Nga gjykimi dhe provat e administruara rezulton se debitori, shoqëria "Italdruri" sh.p.k. nuk ka shlyer detyrimin ndaj palës së paditur. Duke qenë se me ligj kontrata e kredisë është titull ekzekutiv, pala e paditur ka kërkuar lëshimin e urdhërim të ekzekutimit për të. Me vendimin nr. 1016, datë 11.3.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar urdhri i ekzekutimit për këtë titull ekzekutiv dhe personi i tretë Përmbaruesi Gjyqësor, me kërkesë të kreditorit ka filluar procedurat për ekzekutimin e këtij titulli.

Si debitori dhe dorëzanësi kanë marrë dijeni për fillimin e këtyre procedurave dhe lajmërimin për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, por nga asnjëri prej tyre nuk është përmbushur detyrimi vullnetarisht. Në këto rrethana nga ana e Zyrës së Përmbarimit ka filluar ekzekutimi i detyrueshëm, duke vendosur sekuestron mbi pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe të dorëzanësit. Paditësi, megjithëse ka marrë dijeni për të gjitha veprimet e përmbaruesit gjyqësor, si në cilësinë e administratorit të shoqërisë dhe si person fizik, nuk i ka kundërshtuar ata.

Pretendimi i paditësit, se dorëzania është shuar nuk është i mbështetur në ligj. Pas kalimit të afatit për shlyerjen e huas, pala e paditur shoqëria "Banka Credins" sh.a. ka njoftuar si debitorin dhe dorëzanësin se janë në vonesë të përmbushjes së detyrimit. Kështu ata janë njoftuar me shkresat nr. 364 prot., datë 28.4.2010, nr. 2537 prot., datë 6.5.2010, nr. 2880, datë 19.5.2010 dhe nr. 3417 prot., datë 2.6.2010. Të gjitha këto shkresa janë drejtuar për debitorin dhe në vëmendje të dorëzanësit, si dhe vërtetohet se paditësi ka marrë dijeni për to, pasi ka nënshkruar për marrjen dijeni. Pra me këto njoftime pala e paditur ka vënë në vonesë debitorin sipas germës "c" të nenit 131 të Kodit Civil, duke filluar kështu një afat i ri parashkrimi në mbështetje të nenit 134 të këtij Kodi. Gjatë afatit të ri të parashkrimit, pas datës 2.6.2010, debitori ka shlyer një pjesë të detyrimit, duke bërë dhjetë pagesa deri me datë 27.12.2010. Pra nga ana e debitorit ka pasur veprime në lidhje me shlyerjen e detyrimit, duke ndërprerë parashkrimin edhe në kuptim të germës "a" të nenit 131 të Kodit.

Pas kësaj date, pagesa e detyrimit është ndërprerë dhe pas dhënies së vendimit për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit ka filluar ekzekutimi i detyrueshëm nga përmbaruesi gjyqësor. Në rrethanat sa sipër jemi përpara ndërprerjes së parashkrimit, për faktin se si debitori edhe dorëzanësi, pas kalimit të afatit për ekzekutimin e detyrimit, e kanë pranuar atë, duke kryer pagesa pjesore të detyrimit. Kjo në mbështetje të nenit 131 të Kodit Civil, germa "a", që parashikon: *"Parashkrimi ndërpritet: a) me çdo veprim të personit fizik ose juridik të detyruar, që shpreh njohjen e saktë dhe të plotë të së drejtës së kreditorit. (...) c) me çdo veprim që e vë debitorin në vonesë. (...)".* Sipas nenit 134 të Kodit Civil: *"Koha e kaluar para se të vërtetohej shkaku ndërprerës nuk llogaritet dhe pas zhdukjes së këtij shkaku fillon një afat i ri parashkrimi",* për rrjedhojë, në mars të vitit 2011, pala e paditur ka qenë në afat për të kërkuar shlyerjen e detyrimit edhe nga dorëzanësi.

Ky argumentim gjen mbështetje edhe në nenin 133 të Kodit Civil, sipas të cilit: *"Parashkrimi i ndërprerë kundër debitorit kryesor, shtrihet edhe ndaj dorëzanësit përkatës".*

Pretendimi i paditësit se detyrimi nuk duhet të ekzekutohet mbi pasurinë e tij, për faktin se shoqëria debitore ka pasuri që kalojnë shumë herë vlerën e detyrimit, nuk është objekt i këtij shqyrtimi dhe nuk ka të bëjë me shuarjen e dorëzanisë. Në mbështetje të nenit 509 të Kodit Civil, palët mund të merren vesh që dorëzanësi të mos jetë i detyruar të paguajë para kryerjes së të gjitha veprimeve të nevojshme që detyrojnë debitorin të paguajë detyrimin. Me fjalë të tjera paditësi duhet të kërkojë mirëkuptimin e palëve kontraktuese në marrëveshjen e huas, që fillimisht detyrimi të ekzekutohet në pasurinë e debitorit, pasi sipas marrëveshjes në fjalë, neni 8.5, palët kanë parashikuar të kundërtën. (...).".

9. Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ka paraqitur ankim pala paditëse Nuri Hasa, duke kërkuar *ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesëpadisë* dhe duke parashtruar si shkaqe se:

- Vendimi i gjykatës nuk është i drejtë dhe i bazuar në ligj e prova; referuar nenit 600 të Kodit Civil ndodhemi përpara rastit të aplikimit të shuarjes së dorëzanisë, pasi afati i përfundimit të kontratës dhe ekzekutimit të detyrimit ka përfunduar në datën 17.1.2010, ndërsa pala e paditur i është drejtuar gjykatës në muajin mars 2011 për kërkimin e detyrimit;
- Neni 131/c që citon pala e paditur aplikohet për detyrimet monetare pa afat shlyerje detyrimi;
- Gjykata gabon kur aplikon germën "a" të nenit 131 të Kodit Civil, pasi në një marrëdhënie kontraktore detyrimi vjen si pasojë e përcaktimeve që bëjnë palët në kontratë.

10. Mbi ankimin e paditësit, **Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2364, datë 10.10.2012** ka vendosur: "*Lënien në fuqi të vendimit nr. 529, datë 27.1.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*".

11. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se: "(…) arriti në përfundimin se çështja është zgjidhur drejt nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë dhe se nuk ka shkaqe ligjore dhe provues që ta bëjnë të cenueshëm vendimin dhe të passjellin prishjen apo ndryshimin e tij. (...)".

Ndonëse është e vërtetë se afati i ekzekutimit të detyrimit ka qenë data 17.1.2010, dhe se pala e paditur i është drejtuar gjykatës në muajin mars 2011 me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, ky fakt sikurse arsyetohet në vendimin e shkallës së parë, nuk mbështet pretendimin e paditësit Nuri Hasa për shuarje të dorëzanisë. Kjo për faktin se, sikurse ka prapësuar i padituri shoqëria Banka Credins sh.a., në gjykim në shkallë të parë, në rastin konkret ndodhemi përpara ndërprerjes së parashkrimit, pasi si debitori edhe dorëzanësi, pas kalimit të afatit për ekzekutimin e detyrimit, e kanë pranuar këtë detyrim, duke kryer pagesa pjesore të detyrimit.

Kështu nga tërësia e akteve dhe provave të administruara në dosje ka rezultuar se pas kalimit të afatit për shlyerjen e huas, pala e paditur shoqëria Banka Credins sh.a. ka njoftuar si debitorin shoqëria "Italdruri Elbasan" sh.p.k., dhe dorëzanësin Nuri Hasa se janë në vonesë të përmbushjes së detyrimit. Ata janë njoftuar me shkresat nr. 364 prot., datë 28.4.2010, nr. 2537 prot., datë 6.5.2010, nr. 2880 prot., datë 19.5.2010 dhe nr. 3417 prot., datë 2.6.2010, këto shkresa janë drejtuar për debitorin dhe në vëmendje të dorëzanësit, si dhe provohet se paditësi Nuri Hasa ka marrë dijeni për to, pasi ka nënshkruar për marrjen dijeni.

Në rrethanat sa më sipër ky kolegj çmon se jemi përpara ndërprerjes së parashkrimit, për faktin se si debitori edhe dorëzanësi, pas kalimit të afatit për ekzekutimin e detyrimit, e kanë pranuar atë duke kryer pagesa pjesore të detyrimit. (...)

Me njoftimet e mësipërme rezulton e provuar se pala e paditur ka vënë në vonesë debitorin sipër germës "c" të nenit 131 të Kodit Civil, duke filluar kështu një afat i ri parashkrimi në mbështetje të nenit 134 të këtij Kodi. Gjatë afatit të ri të parashkrimit, pas datës 2.6.2010, debitori ka shlyer një pjesë të detyrimit, duke bërë dhjetë pagesa deri më datë 27.12.2010. Pra nga ana e debitorit ka pasur veprime në lidhje me shlyerjen e detyrimit, duke ndërprerë parashkrimin edhe në kuptim të germës "a" të nenit 131 të Kodit.

Pas kësaj date pagesa e detyrimit është ndërprerë dhe pas dhënies së vendimit për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit ka filluar ekzekutimi i detyrueshëm nga përmbaruesi gjyqësor. (...). Meqenëse pagesat nuk kanë

vazhduar gjatë vitit 2011, për rrjedhojë në mars të vitit 2011, pala kreditore (pala e paditur) ka qenë në afat për të kërkuar shlyerjen e detyrimit edhe nga dorëzanësi. Argumentimi si më sipër gjen mbështetje edhe në nenin 133 të Kodit Civil (...).

Edhe pretendimi tjetër i paditësit se detyrimi nuk duhet të ekzekutohet mbi pasurinë e tij, për faktin se shoqëria debitore ka pasuri që kalojnë shumë herë vlerën e detyrimit, nuk qëndron dhe me të drejtë nuk është pranuar nga gjykata e shkallës së parë, pasi ky pretendim nuk ka qenë objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor dhe nuk ka të bëjë me shuarjen e dorëzanisë. (...).".

12. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është paraqitur rekurs në Gjykatë e Lartë nga pala paditëse Nuri Hasa, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimeve gjyqësore dhe pranimin e padisë, duke pretenduar këto shkaqe:

- Vendimet e gjykatave janë dhënë në interpretim të gabuar të ligjit material civil; Gjykata në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 600 të Kodit Civil ka rrëzuar padinë objekt gjykimi, duke u mbështetur në prapësimet e palës së paditur për ndërprerjen e afatit të parashkrimit të parashikuar nga neni 600 Kodit Civil në kuptim të nenit 131 dhe 134 të Kodit Civil;

- Vendimi i gjykatës së apelit është i njëjtë me arsyetimin e vendimit të gjykatës së rrethit. Ky interpretim nuk është i bazuar në ligjin material civil si rezultat i keqkuptimit prej gjykatave të faktit të instituteve të parashkrimit të padisë dhe dekadencës së të drejtave;

- Afati 6-mujor i parashikuar nga neni 600 i Kodit Civil nuk përfaqëson një afat parashkrimi, por është një afat prekluziv (dekadence) që shuan vetë të drejtën subjektive të të paditurit kundrejt paditësit;

- Duke iu referuar nenit 600 të Kodit Civil rezulton se ndodhemi përpara rastit të aplikimit të shuarjes së dorëzanisë, pasi afati i përfundimit të kontratës dhe ekzekutimit të detyrimit ka përfunduar me 17.1.2010, ndërsa pala e paditur i është drejtuar gjykatës në muajin mars 2011 për kërkimin e detyrimit;

- Dispozita që citon pala e paditur nuk ka aplikim në rastin konkret, neni 131/c i Kodit Civil, aplikohet për detyrimet monetare pa afat shlyerje detyrimi;

- Gjykata ka gabuar që në momentin e aplikimit të germës "a" të nenit 131 të Kodit Civil, pasi një marrëveshje kontraktore detyrimi vjen si pasojë e përcaktimeve që kanë bërë palët në dispozita kontraktore.

13. Gjykimi pranë Gjykatës së Apelit është zhvilluar në prani të palës paditëse, ndërsa ka depozituar rekursin në datën 8.11.2012.

II. Procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe nevoja për njësimin e praktikës gjyqësore.

14. **Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (në vijim "Kolegji"), më datë 1.6.2016, ka vendosur kalimin për shqyrtimin e çështjes konkrete në Kolegje të Bashkuara,** për unifikimin e praktikës gjyqësore mbi interpretimin e dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë institutin e dorëzanisë, të cilat do të parashtrohen në mënyrë më të detajuar në vijim.

Pavarësisht se u mblodhën për të vendosur mbi çështjet e shtruara për njësimin e praktikës gjyqësore, ato nuk arritën të marrin një vendim, për shkak të mosplotësimit të kuorumit ligjor të gjyqtarëve.

15**.** Në këto kushte, çështja u rimor në shqyrtim nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (në vijim "Kolegjet"), pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016.

Me vendimin datë 4.10.2022, **Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë**, vendosën:

"Kalimin për shqyrtim të kësaj çështjeje pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore".

16. Në vendimin e sipërcituar, Kolegjet, fillimisht u ndalën në formimin e trupit gjykues për gjykimin e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, referuar faktit se nga momenti i marrjes së vendimit nr. s'ka, datë 18.6.2015, të Kolegjit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore për unifikim të praktikës gjyqësore dhe deri në momentin e shqyrtimit të çështjes, ka kaluar një kohë e konsiderueshme. Ky faktor reflekton, ndër të tjera, ndryshime thelbësore që ka pësuar legjislacioni procedural në këtë periudhë.

17. Para ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, paragrafi i dytë i pandryshuar i nenit 141 të Kushtetutës parashikonte, se: "*Për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë ka të drejtë të tërheqë për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore*". Nga kjo normë kushtetuese kuptohej se unifikimin e praktikës gjyqësore dhe ndryshimin e saj kishte autoritet ta bënte vetëm trupa gjyqësore e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, qoftë për krijimin e precedentëve fillestarë, ashtu edhe për ndryshimin apo zhvillimin e tyre në të ardhmen.

18. Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, amendime të cilat hynë në fuqi në datë 11.8.2016, neni 141 i Kushtetutës parashikon, se: "*1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe me zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.*

2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit."

19. Kjo do të thotë se, ndryshe nga më parë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk unifikojnë apo njësojnë praktikën gjyqësore nëpërmjet krijimit të precedentëve fillestarë jurisprudencial ose, thënë ndryshe, nuk njësojnë qëndrimet e ndryshme mbi zbatimin e ligjit procedural dhe material nga gjykatat më të ulëta. Këtë funksion të uniformitetit të praktikës gjyqësore e bën vetëm Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë për çështjet civile, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë për çështjet administrative dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për çështjet penale. Këtë funksion kushtetues dhe ligjor secili prej kolegjeve do ta realizojë nëpërmjet vendimeve njësuese, të cilat kanë zëvendësuar terminologjinë dhe praktikën e mëparshme të vendimeve unifikuese, (*shih vendimin njësues nr. 13, datë 4.4.2018, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

20. Për të konkretizuar dhe për të zbatuar në ligj parashikimet e reja të nenit 141 të Kushtetutës, ligji nr. 98/2016, "*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*", në nenin 32 normoi rastet e kompetencës funksionale të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke parashikuar, se: "*7. Gjykata e Lartë gjykon në Kolegje të Bashkuara për çështje civile, penale ose administrative, të cilat, me vendim të një prej trupave gjykues ose të kryetarit të Gjykatës së Lartë, paraqiten për shqyrtim për ndryshimin e praktikës gjyqësore. 2. Kolegjet e Bashkuara shqyrtojnë rastet kur e njëjta çështje juridike nuk është interpretuar në mënyrë të njëjtë nga kolegje të ndryshme të Gjykatës së Lartë, ose në rast se ekziston rreziku për interpretim jo të njëjtë nga kolegje të ndryshme të Gjykatës së Lartë*".

21. Ndryshimet e ligjeve procedurale gjyqësore në vitin 2017, plotësuan dhe detajuan kuadrin ligjor të nevojshëm për të ushtruar Gjykata e Lartë juridiksionin ekskluzivisht ligjor dhe rishikues, sikurse ndryshimet kushtetuese konturuan. Pavarësisht këtyre ndryshimeve, neni 481 i Kodit të Procedurës Civile, që rregullon gjykimin në Kolegje të Bashkuara, nuk pësoi ndryshime me ligjin nr. 35/2017. Kjo dispozitë ndryshoi vetëm me ligjin nr. 44/2021, ligj që ka bërë një rregullim të qartë të kompetencës së Gjykatës së Lartë për njësimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore, si dhe ka detajuar procedurën e gjykimit.

Kështu, neni 481/3 i Kodit të Procedurës Civile parashikon, se: "*Gjykimi për njësimin e praktikës gjyqësore bëhet nga Kolegji Civil me trup gjykues prej 5 gjyqtarësh, në të cilin marrin pjesë trupi gjykues që po gjykon rekursin dhe dy gjyqtarë të tjerë të Kolegjit, të caktuar me short*". Ndërsa neni 481/4 i Kodit të Procedurës Civile parashikon, se: "*Gjykimi për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njësuar bëhet nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kryetari i Gjykatës së Lartë, si kryesues i Kolegjeve të Bashkuara, cakton datën dhe orën e gjykimit të çështjes për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë gjykojnë sipas rregullave të caktuara për Kolegjin, kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të Gjykatës së Lartë*".

Në bazë të këtij konteksti të ri juridik, Kolegjet kanë vlerësuar se kjo çështje duhet të shqyrtohet nga Kolegji Civil në seancë gjyqësore me trup të përbërë nga 5 gjyqtarë.

22. Në vijim, **Kolegji, me vendimin datë 16.11.2022,** ka vendosur të caktojë datën 15 dhjetor 2022, për shqyrtimin në seancë gjyqësore publike, të çështjes civile nr. 11243-00639-00-2013 regjistri themeltar, datë 5.3.2013, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, duke vijuar me procedurën e posaçme të gjykimit njësues, në zbatim të nenit 481, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile.

23. Kolegji konstatoi se në vazhdimësi gjykatat shqiptare në të gjitha shkallët e gjykimit, kanë interpretuar dhe kanë zbatuar në mënyra të ndryshme normat materiale mbi dorëzaninë. Kjo ka sjellë edhe disponime të kundërta për sa i përket formës së veprimit procedural me të cilin kreditori investon gjykatën për kërkimin e ekzekutimit të detyrimit, legjitimimit të dorëzanësit për të kërkuar shuarjen e dorëzanisë, natyrës dhe llojit të afatit që parashikon ligji, neni 600 i Kodit Civil për ngritjen e padisë, si qëndrojnë në raporte mes tyre dhe me kreditorin, dorëzanësi dhe debitori etj.

24. Kolegji vlerëson se paqartësia e parë ka ardhur mbi çështjen e regjimit juridik të përgjegjësisë civile të dorëzanësit, nëse mundet apo jo kreditori, që pa provuar se ka gjurmuar dhe ka kryer të gjitha veprimet e mundshme ligjore për përmbushjen e kredisë me pasurinë e debitorit kryesor, t'i drejtohet dorëzanësit sakaq për të aktivizuar mjetin e tij të garancisë mbi kredinë. Në disa praktika gjyqësore praktikën gjyqësore është mbajtur qëndrimi se kreditori mundet t'i drejtohet palës dorëzanëse, vetëm atëherë kur ka kryer të gjitha veprimet e mundshme për përmbushjen e kredisë nga pasuria e debitorit kryesor, por ka qenë e pamundur një gjë e tillë.

Në disa praktika të tjera gjyqësore, në interpretim të nenit 590 të Kodit Civil, është mbajtur qëndrimi se në momentin që vërtetohet rënia në morë e debitorit kryesor, atëherë kreditori mundet të zgjedhë cilindo nga të detyruarit e tij për t'i kërkuar përmbushjen e detyrimit, qoftë debitorit kryesor dhe qoftë dorëzanësit. Në këto raste është konkluduar se nga momenti i rënies në morë të debitorit kryesor, ai dhe dorëzanësi janë debitor solidar

të kreditorit.[93]

25. Po ashtu, në praktikën gjyqësore ka pasur çështje në të cilat është pretenduar dhe është pranuar nga gjykatat se aktivizimi i përgjegjësisë pasurore të dorëzanësit kundrejt kreditorit mundet të bëhet vetëm pas ngritjes së padisë nga ky i fundit[94], si në rastet kur detyrimi kryesor nuk është titull ekzekutiv dhe në rastet kur detyrimi kryesor është titull ekzekutiv. Kjo praktikë gjyqësore është mbështetur në interpretimin literal të nenit 600 të Kodit Civil[95].

Ky qëndrim është mbajtur edhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke interpretuar se marrëdhënia e dorëzanisë është një marrëdhënie e mëvetësishme nga kontrata e kredisë bankare dhe se nuk ndjek regjimin juridik të saj si titull ekzekutiv, porse për vënien në ekzekutim të dorëzanisë kreditori duhet të ngrejë padi në gjykatë kundër dorëzanësit.[96]

26. Nga ana tjetër ka pasur edhe qëndrime apo pretendime të palëve në gjykime se neni 600 i Kodit Civil duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar, që do të thotë se kur detyrimi kryesor është titull ekzekutiv, atëherë kreditori për t'iu drejtuar dorëzanësit do të duhet ta bëjë njëlloj sikurse për aktivizimin e përgjegjësisë pasurore të debitorit kryesor, që do të thotë me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit në gjykatë[97] dhe më tej me kërkesë për ekzekutimin e detyrueshëm në shërbimin përmbarimor[98]. Ky qëndrim vijon se, kur përgjegjësia e debitorit kryesor është e aktivizueshme civilisht vetëm pas një gjykimi kontencioz dhe sakaq vetëm me ekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, atëherë i njëjti regjim juridik do të vlejë edhe për aktivizimin e përgjegjësisë pasurore të dorëzanësit kundrejt kreditorit.[99]

27. Gjithashtu, në praktikën gjyqësore ka pasur mosmarrëveshje në të cilat është vënë në diskutim fakti nëse afati gjashtëmujor apo njëvjeçar, që parashikon neni 600 i Kodit Civil, është afat parashkrimi apo është afat prekluziv.

Kështu, rezulton se në një rast Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, i ka konsideruar afatet që përmend neni 600 i Kodit Civil si afate parashkrimi *(shih vendimin nr. 00-2013-980 (223), datë 28.3.2013, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë)*. Në një vendim tjetër, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka konsideruar marrëdhënien e dorëzanisë si të mëvetësishme, dhe afatin 6-mujor të parashikuar nga paragrafi i parë i nenit 600 të Kodit Civil, si një afat prekluziv, mosrespektimi i të cilit ka si pasojë shuarjen e së drejtës së kreditorit për të realizuar të drejtën e tij nëpërmjet pasurisë së dorëzanësit *(shih vendimin nr. 00-2015-3661 (455), datë 28.10.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë)*. Ndërkohë, qasja e ndryshme e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është më e theksuar në praktikën e gjykatave më të ulëta, të cilat kanë mbajtur qëndrime të ndryshme nëse afatet e përcaktuara në nenin 600 të Kodit Civil, janë afate parashkrimi[100] apo afate prekluzive.[101]

28. Kolegji çmon të rëndësishme të theksojë se paqartësia e vazhdueshme në kohë e praktikës gjyqësore është e papajtueshme me parimin e shtetit të së drejtës dhe me parimin e sigurisë juridike.

---

[93] Shiko vendimin nr. 545, datë 15.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

[94] Shiko vendimin nr. 69, datë 28.2.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

[95] Shiko vendimin nr. 2673, datë 2.4.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimin nr. 273, datë 14.4.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

[96] Shiko vendimin nr. 11243-02393-00-2012 i regj. themeltar, nr. 00-2015-3661, i vendimit (455), datë 28.10.2015, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
Ndër të tjera Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në këtë vendim arsyeton, se:
"*Pavarësisht pozitës së posaçme që gëzon marrëdhënia e kredisë bankare, si çdo detyrim tjetër, ajo mund të sigurohet edhe me mjete të tjera që garantojnë ekzekutimin e detyrimeve në favor të kreditorit, sipas neneve 530 e vijuese të Kodit Civil, përfshirë hipotekën (e drejtë reale) apo dorëzaninë, të cilat janë marrëdhënie të veçanta dhe të mëvetësishme dhe që u nënshtrohen rregullave të parashikuara nga ana e Kodi Civil. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, vlerëson të theksojë, se* ***pala paditëse*** *ka pasur cilësinë e dorëzanësit, marrëdhënie kjo e mëvetësishme, pavarësisht se e formësuar në të njëjtin akt kontratë kredie. Mëvetësia e marrëdhënies së dorëzanisë rezulton nga neni 585 i Kodit Civil ku jepet përmbajtja e Dorëzanisë...*".

[97] Shiko nenin 511 të Kodit të Procedurës Civile. Shiko në web: http://www.qbz.gov.al/kode-pdf/Kodi%20i%20Procedures%20Civile-Maj%202017.pdf;.

[98] Shiko nenin 515 të Kodit të Procedurës Civile. Shiko në web: http://www.qbz.gov.al/kode-pdf/Kodi%20i%20Procedures%20Civile-Maj%202017.pdf;.

[99] Shiko Vendimin nr. 545, datë 15.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

[100] Shih vendimin nr. 529, datë 27.1.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimin nr. 2364, datë 10.10.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimin nr. 8851, datë 22.11.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimin nr. 1694, datë 15.7.2011, i Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimin nr. 6885, datë 16.6.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimin nr. 891, datë 21.4.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

[101] Shih vendimin nr. 545, datë 15.3.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim "GJEDNJ"), në disa vendime, ndër to edhe në dhomën e madhe, ka vlerësuar se uniformiteti i zbatimit të ligjit nga jurisprudenca përbën garanci për zbatimin e parimit të sigurisë juridike, që është element thelbësor i shtetit të së drejtës (*shih çështjen "Chapman v United Kingdom", vendimi i GJEDNJ-së, datë 18.1.2001)*, duke pasur lidhje të drejtpërdrejtë edhe me garancitë e nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim "KEDNJ").

29. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se siguria juridike që duhet të përcjellë rendi juridik lidhur me përdorueshmërinë dhe parashikueshmërinë normative duhet të jenë standard edhe për praktikën gjyqësore nomofilatike (*Shih çështjen "Lupaş and Others v. Romania", ap. nos. 1434/02, 35370/02 dhe 1385/03, paragrafi 67, ECHR 2006-XV).* Gjykata ka pranuar se kundërshtitë e jurisprudencës janë të natyrshme dhe të qenësishme në të gjitha sistemet juridike, qoftë në gjykata të së njëjtës shkallë, qoftë në shkallë të ndryshme, apo qoftë edhe në autoritetin suprem më të lartë gjyqësor, duke konkluduar se kjo situatë nuk mund të jetë *apriori* në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së.

30. GJEDNJ-ja konkludon se ato që përbëjnë shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në drejtim të ushtrimit të funksionit nomofilatik të autoritetit më të lartë gjyqësor në një vend janë disa rrethana:

- nëse në jurisprudencën e gjykatave ekzistojnë qëndrime krejt të ndryshme dhe të vazhdueshme mbi të njëjtën çështje juridike;
- nëse e drejta e brendshme parashikon mekanizma ligjorë dhe procedural që synojnë efektivisht eliminimin e mungesës së koherencës në jurisprudencë;
- nëse këta mekanizma janë zbatuar nga autoriteti më i lartë gjyqësor dhe kush ka qenë efekti i prodhuar në praktikën gjyqësore.

31. GJEDNJ-ja ka theksuar se juridiksioni gjyqësor suprem në çdo shtet duhet të tregojë vigjilencë në shquarjen dhe eliminimin e çdo mungese koherence në jurisprudencën e gjykatave (*shih çështjen "Mariyka Popova dhe Asen Popov kundër Bullgarisë", kërkesa nr. 11260/10, seksioni i 5-të i GJEDNJ, vendimit nr. 11.4.2019, paragrafi 40*).

32. Në vijim të kësaj analize, në çështjet ligjore të shtruara për diskutim, Kolegji, në ushtrim të së drejtës dhe detyrimit kushtetues dhe ligjor, që lidhet me funksionin nomofilatik;

- duke pasur parasysh praktikat e ndryshme të gjykatave të niveleve më të ulëta dhe të vetë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që vijnë për shkak se mund të ketë disa interpretime lidhur me dorëzaninë e konkretisht me parashikimet e nenit 600 të Kodit Civil;
- meqenëse përpara Gjykatës së Lartë gjenden për shqyrtim raste të ngjashme, për të cilat duhet të jepet një zgjidhje e njëjtë dhe e unifikuar në interpretimin e ligjit material;
- në zbatim të nenit 35/3, 472/a, 481 dhe 482/a të KPC-së, të ndryshuar me ligjin nr. 44/2021, ka konkluduar se duhet të vijojë me gjykimin njësues duke vlerësuar të drejta edhe çështjet e ngritura nga Kolegji i mëparshëm, në funksion të njësimit të praktikës gjyqësore, ka vlerësuar të ngrenë për njësim të praktikës gjyqësore, çështjet si më poshtë vijon:

1. A barazohet kërkesa për lëshim urdhri ekzekutimi me padinë referuar nenit 600 të Kodit Civil?

2. Referuar neneve 597, 598, 599 dhe 600 të Kodit Civil, a legjitimohet dorëzanësi të kërkojë shuarje dorëzanie?

3. Afati 6-mujor është afat prekluziv apo afat parashkrimi (neni 600 Kodi Civil)?

4. Referuar neneve 589, 590 dhe 591 të Kodit Civil, a barazohet cilësia e dorëzanësit me atë të debitorit? Nëse po, gjatë cilës fazë mund të barazohen këto dy cilësi?

III. Vlerësimi i Kolegjit Civil.

Mbi institutin e dorëzanisë, aspekti ligjor dhe kushtetues.

33. Dorëzania në ligj (shih nenin 585 të Kodit Civil), përkufizohet si një veprim juridik i dyanshëm, me të cilën një person (dorëzanësi), detyrohet t'i sigurojë kreditorit ekzekutimin e detyrimit të një personi të tretë (debitori kryesor). Pra, përmes dorëzanisë, një subjekt i tretë në marrëdhënien kreditor-debitor, dorëzanësi, garanton përmbushjen e detyrimit nga ky i fundit, (debitori), si dhe merr përsipër ta përmbushë atë, (detyrimin) vetë në eventualitetin e "dështimit" nga debitori. Si një marrëdhënie juridike detyrimi, mundet të ketë si burim krijimi ligjin, marrëveshjen ndërmjet palëve apo një vendim gjyqësor.[102]

34. Në një kuptim të përgjithshëm, dorëzania përbën një marrëdhënie juridike detyrimi[103]. Regjimi juridik i

[102] Shiko Studies, "*The suretyship in the law of the Member States of the European Communities*", Commission of the European Communities, Competition: Approximation of legislation series no. 14, 1971, Study prepared by the "Max-Pianck-Institut for auslandisches und internationales Privatrecht", Hamburg, faqe 25. Shiko, gjithashtu, edhe nenin 420 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, vitit 1994.

[103] Shih për më tepër nenin 419 të Kodit Civil, ku detyrimi përkufizohet si një marrëdhënie juridike, në një marrëdhënie juridike detyrimi, njëra palë (debitori) detyrohet të japë diçka, ose të kryejë apo të mos kryejë një veprim të caktuar në

detyrimeve përcaktohet në mënyrë të detajuar në Kodin Civil dhe në ligje të tjera, por parësisht ato janë shprehje e lirisë së veprimtarisë ekonomike, si një nga liritë themelore kushtetuese.

35. Në nenin 11 § 1 të saj, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon, se: "*Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.* Jurisprudenca kushtetuese, nocionin e lirisë së veprimtarisë ekonomike ndër të tjera e ka përkufizuar si e drejta për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe shërbimeve. Forma më e lartë e lirisë ekonomike nënkupton lirinë pa asnjë kufizim të qarkullimit të kapitalit dhe të mallrave. Po ashtu, liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete edhe lirinë e tregtisë ose mungesën e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe të shërbimeve; lirinë e investimit dhe të qarkullimit të lirë të kapitaleve etj. *(shih vendimet nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 89, datë 28.12.2017; nr. 16, datë 1.3.2017; nr. 33, datë 8.6.2016, nr. 24, datë 24.7.2009; nr. 17, datë 25.7.200,8 të Gjykatës Kushtetuese*).

Më tej, neni 41 i Kushtetutës, parashikon, se: *Prona fitohet me dhurim, ... me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.* Detyrimet juridike civile përmenden nga ligji themelor i vendit edhe në nenin 27 § 3, kur sanksionon, se: *"Askujt nuk mund t'i hiqet liria vetëm për shkak se nuk është në gjendje të përmbushë një detyrim kontraktor."*

36. Referuar këtyre parashikimeve kushtetuese dhe jurisprudencës përkatëse, Kolegji çmon se mundësia e subjekteve të njohura nga e drejta, për të hyrë në marrëdhënie juridike të ndryshme që kanë si qëllim lidhjen e kontratave për qarkullimin e mallrave, shërbimeve dhe kapitalit gëzon mbrojtje kushtetuese. Në këtë kuptim, interpretimi i dispozitave të legjislacionit civil që rregullojnë marrëdhëniet juridike të detyrimit, dhe në veçanti marrëdhënien juridike të dorëzanisë, duhet të qaset drejt asaj mënyre që i garanton këto liri.

37. Kodi Civil i vitit 1929, në nenin 1830 të tij e përkufizonte dorëzanësin si subjektin që i garanton personalisht kreditorit ekzekutimin e obligimit të një personi të tretë.[104]

Ligji nr. 2359, datë 15.11.1956, *"Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet"*[105] e përkufizonte dorëzaninë si një kontratë me anën e së cilës një person (dorëzanësi) detyrohet që t'i sigurojë kreditorit ekzekutimin e detyrimit të një personi të tretë (debitori kryesor) plotësisht ose pjesërisht. Kodi Civil i vitit 1981 nuk kishte një dispozitë përkufizimi për marrëdhënien juridike të dorëzanisë.[106]

38. Neni 765 i Kodit Civil të Republikës Federale të Gjermanisë (*Bürgerliches Gesetzbuch*) e përshkruan marrëdhënien juridike të dorëzanisë, si një marrëdhënie që nëpërmjet një kontrate dorëzanësie e vendos veten si i detyruar përballë një kreditori, duke u bërë sakaq përgjegjës për detyrimin e një pale të tretë.[107]

Ndërkohë Kodi Civil i Republikës së Italisë në nenin 1936, e përshkruan dorëzanësin si subjektin që detyrohet personalisht kundrejt kreditorit për përmbushjen e një detyrimi të një personi tjetër.[108] Kodi Civil i Republikës së Francës në nenin 2288, e përkufizon dorëzanësin si subjektin që del garant për përmbushjen e detyrimit të një debitori kundrejt një kreditori, nëse debitori nuk e përmbush atë.[109]

Ligji "*Për marrëdhëniet e detyrimeve*" i Republikës së Kosovës në nenin 1009, e përkufizon dorëzaninë si marrëdhënia juridike ku me kontratën obligohet dorëzani ndaj kreditorit se do ta përmbushë detyrimin e plotfuqishëm të debitorit të rrjedhur për pagesë, në qoftë se ky nuk e bën këtë.[110]

39. Nga një vështrim të dispozitave të Kodit Civil, edhe në planin historik dhe krahasimor, mund të deduktohet se, dorëzania, si një veprim juridik dhe shfaqje vullneti, është një kontratë e dyanshme e lidhur ndërmjet dorëzanësit dhe kreditorit, ndërsa debitori, si rregull, mbetet i palidhur me këtë marrëdhënie. Nuk kërkohet për perfeksionimin dhe konstituimin e marrëdhënies juridike të dorëzanisë vullneti i palës debitore kryesore. Qëllimi i dorëzanisë nuk është garantimi i debitorit, por garantimi i kreditorit.

---

dobi të palës tjetër (kreditorit), që, gjithashtu, gëzon të drejtën për të kërkuar që t'i jepet diçka, ose të kryhet apo të mos kryhet veprimi.

[104] Shiko Kodin Civil, Ministria e Drejtësisë, Mbretnia Shqiptare, Vlorë, Shtypshkronja G. Direttore & C. 1928, faqe 588.

[105] Shiko Gazetën Zyrtare nr. 1 e vitit 1957. Shiko, gjithashtu, "*Kodifikimi i përgjithshëm i legjislacionit në fuqi të Republikës Popullore të Shqipërisë*", Kodet, vëllimi I, Botim i Kryeministrisë, Tiranë 1961, faqe 157.

[106] Shiko nenin 179 dhe 180 të Kodit Civil të vitit 1981. Shiko në web: http://www.qbz.gov.al/doc.jsp?doc=docs/Ligj%20Nr%206340%20Dat%C3%AB%2026-06-1981.htm.

[107] Shiko në web: https://www.gesetze-im-internet.de/englisch_bgb/.

[108] Shiko në web: http://www.altalex.com/documents/codici-altalex/2015/01/02/codice-civile.

[109] Shiko në web: http://www.fd.ulisboa.pt/wp-content/uploads/2014/12/Codigo-Civil-Frances-French-Civil-Code-english-version.pdf;

[110] Shiko në web: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2828.

40. Ajo kategorizohet në mjetet e garancisë personale dhe subjektive, pasi dorëzanësi garanton përmbushjen e detyrimit të debitorit kryesor me të gjithë pasurinë e tij të tashme dhe të ardhshme, nëse në kontratën e dorëzanisë nuk parashikohet ndryshe. Subjekti dorëzanës garanton kreditorin për cilësitë personale të debitorit, për besueshmërinë dhe mundësinë e tij në përmbushjen e detyrimit. Gjithashtu, dorëzanësi merr përsipër riskun duke garantuar ekzekutimin e detyrimit me pasurinë e tij, pa dhënë si garanci një pasuri të caktuar.

Kjo karakteristikë e dallon dorëzaninë nga mjetet reale të garancisë, si për shembull pengu apo hipoteka, të cilat krijohen janë të lidhura pazgjidhshmërisht me sendin dhe pasurinë respektive që individualizojnë palët në kontratë. Si mjet garancie personale, dorëzania nuk lidhet me një pasuri konkrete, por lidhet me pasurinë në tërësi të dorëzanësit[111].

41. Dorëzania ka gjithmonë karakterin e një marrëdhënie juridike aksesore në raport me marrëdhënien juridike parësore që ekziston ndërmjet kreditorit dhe debitorit. Ajo qëndron vetëm për një detyrim efektiv dhe mund të jepet për një detyrim të ardhshëm dhe/ose një detyrim me kusht. Si e tillë ajo është e lidhur funksionalisht[112] dhe integralisht me veprimin juridik kryesor (*aksesorum sequitur principales).*

Kjo lidhje do të ndikojë gjithmonë në mënyrën se si lind, si zhvillohet dhe se si shuhet ajo. Një karakteristikë e tillë, e dallon marrëdhënien juridike të dorëzanisë me detyrimin solidar në përgjithësi[113].

42. Dorëzania ka në vetvete një qëllim ekonomik, por njëherazi edhe njerëzor sepse dorëzanësi, bëhet mbështetës i debitorit dhe rrit besueshmërinë e tij në sytë e kreditorit. Në këtë marrëdhënie, interesat e palëve qëndrojnë në këto raporte: kreditori ka interes të ketë një mundësi shtesë/plus nga një subjekt i tretë që debitori do ta përmbushë detyrimin në formën, mënyrën dhe kohën e caktuar në kontratë; debitori ka interes të ketë përkrahje të shtuar dhe një person të besuar, me qëllim që kreditorit t'i mundësojë vlerën e kërkuar; dorëzanësi niset nga një interes me natyrë sociale dhe njerëzore, duke përkrahur dhe mbështetur edhe juridikisht debitorin.

43. Dorëzania është një marrëdhënie juridike subsidiare dhe e kushtëzuar, që do të thotë se aktivizohet atëherë kur debitori kryesor nuk përmbush detyrimin. Kjo do të thotë se momenti i vërtetimit të kushtit, vonesa apo mora e debitorit në përmbushjen e detyrimit, aktivizon përgjegjësinë civile të dorëzanësit garant ndaj kreditorit. Kjo karakteristikë e dorëzanisë është shenjë tjetër dalluese e saj me detyrimin solidar[114].

44. Kontrata e dorëzanisë mund të gjendet në praktikë në formën e një kontrate bankare, ose kontratë nga një institucion finaciar jobankar.

Në paragrafin e parë, shkronja "d" të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se: "*Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë: (...) d) aktet noteriale që përmbajnë detyrim në të holla, si dhe aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare; (...)*". Parimisht, të gjitha aktet e kësaj kategorie janë tituj ekzekutivë dhe për to lëshohet urdhri i ekzekutimit, sipas përcaktimeve të nenit 511 të po këtij Kodi.

Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji çmon se dorëzania do të konsiderohet titull ekzekutiv vetëm në ato raste kur përmbushen kërkesat ligjore që parashikon neni 510 i Kodit të Procedurës Civile, në mënyrë të veçantë paragrafi i parë, shkronja "d" e kësaj dispozite, e lidhur me aktet për dhënien e kredive bankare ose aktet për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare. Për pasojë, në këto raste kemi një ndërthurje midis dy llojeve të gjykimeve, gjykimit për kontestimin e kontratës së dorëzanisë, si titull ekzekutiv dhe gjykimit për kontestimin e saj si veprim juridik i dyanshëm.

IV. Çështjet e shtruara për njësim.

1. A barazohet kërkesa për lëshim urdhri ekzekutimi me padinë referuar nenit 600 të Kodit Civil ?

45. Nisur nga fakti se si në çështjen objekt shqyrtimi dhe gjerësisht në praktikën gjyqësore, kontratat e dorëzanisë gjendet edhe në formën e një kontrate bankare, ose kontratë nga një institucion financiar jobankar, akte të cilat referuar parashikimit të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile janë tituj ekzekutiv, Kolegji ka shtruar

---

111 Shiko Giuseppe Chine, Marco Fratini, Andrea Zoppini, "*Manuale di diritto civile*", diretti da Guido Alpa e Roberto Garofoli, Manuali Superiori, IV Edizione, Nel Diritto Editore, Roma, 2013, faqe 958.

112 Shiko Giuseppe Chine, Marco Fratini, Andrea Zoppini, "*Manuale di diritto civile*", diretti da Guido Alpa e Roberto Garofoli, Manuali Superiori, IV Edizione, Nel Diritto Editore, Roma, 2013, faqe 959.

113 Shiko *Studies, "The suretyship in the law of the Member States of the European Communities*", Commission of the European Communities, Competition: Approximation of legislation series no. 14, 1971, Study prepared by the "Max-Pianck-Institut for auslandisches und internationales Privatrecht", Hamburg, faqe 16.

114 Shiko *Studies,* "*The suretyship in the law of the Member States of the European Communities*", Commission of the European Communities, Competition: Approximation of legislation series no. 14, 1971, Study prepared by the "Max-Pianck-Institut for auslandisches und internationales Privatrecht", Hamburg, faqe 16.

si pyetje, nëse kërkesa që bën kreditori në këto raste për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, mund të konsiderohet e barasvlershme me padinë që kreditori duhet të ushtrojë në respektim të nenit 600 të K. Civil.

46. Në nenin 600 të Kodit Civil parashikohet, se:

"*Dorëzania shuhet në qoftë se kreditori nuk ka ngritur padi kundër dorëzanësit brenda gjashtë muajve nga dita e mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit.*

Kur afati i ekzekutimit të detyrimit nuk është caktuar as në kontratën e dorëzanisë, as në një marrëveshje tjetër, dorëzania shuhet me kalimin e një viti nga dita e lidhjes së kontratës së dorëzanisë."

47. Kjo dispozitë, sipas njërit variant interpretimi, nuk ndjek të njëjtën logjikë juridike për përmbushjen e detyrimeve për të cilat ligji heq fazën njohëse të së drejtës, apo fazën gjyqësore të formësimit të titullit ekzekutiv. Kjo do të thotë se edhe për detyrimet kryesore, të cilat sipas ligjit janë tituj ekzekutiv, dorëzania do të duhet të ekzekutohet vetëm nëpërmjet ngritjes së padisë, marrjes formë të prerë të vendimit gjyqësor dhe më tej ekzekutimit të detyrueshëm të këtij vendimi.

48. Në variantin më të mirë të interpretimit, dispozita ometon në lidhje me ekzekutimin e dorëzanisë që është lidhur për të garantuar përmbushjen e një detyrimi kryesor, i cili sipas ligjit është titull ekzekutiv. Para këtij ometimit legjislativ, gjykata, në bazë dhe për zbatim të nenit 1 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, do të duhet të krijojë me analogji një dispozitë ligjore dhe rregull normativ të zbatueshëm për këto raste.

Nga një vlerësim *apriori* nuk mund të thuhet se kreditori nuk ka afat ligjor brenda të cilit duhet të përmbushë detyrimin kundrejt dorëzanësit, pasi kjo do të çonte në konkluzionin e papranueshëm se debitori kryesor do të gëzonte më shumë të drejta se dorëzanësi. Si rrjedhojë do të duhet të arrijmë në konkluzionin se edhe dorëzania që është pjesë e titullit ekzekutiv anulohet, nëse kreditori brenda një periudhe të caktuar kohe nuk tregon interes për kredinë e tij kundrejt dorëzanësit.

49. Kolegji vlerëson, se nëse ka disa mënyra interpretimi të normës ligjore, atëherë ndërmjet tyre duhet të zgjidhet ajo e cila vjen në pajtim me Kushtetutën. (*Shiko vendimin nr. 12/2010, vendimin nr. 30/2010, vendimin nr. 7/2013, vendimin nr. 39/2014, si dhe vendimin nr. 7/2015, të Gjykatës Kushtetuese etj.)*

50. Sa më lart, fillimisht, Kolegji vlerëson të përqendrohet tek origjina e kësaj norme ligjore dhe te modelet apo filozofia e normave analoge në shtetet evropiane.

51. Kodi Civil i vitit 1929 në nenin 1863, parashikonte se: "*Dorëzanësi mbetet i obliguem edhe mbas skadimit të afatit të obligimit kryesor, me kondítë që kreditori brenda gjashtë muajve që prej atij skadimit të ndjekë debitorin dhe të ketë vazhdue ndjekjet me shkathtësi.* (...)".

Sikurse mund të konstatohet, sipas këtij Kodi, ndjekja e kreditorit për të përmbushur kredinë e tij me dorëzani mund të bëhej në çdo rast sipas regjimit juridik të detyrimit principal apo kryesor. Kjo do të thotë se, nëse detyrimi principal ishte i kërkueshëm me padi, atëherë edhe detyrimi aksesor apo dorëzania e tij do të jetë e kërkueshme me padi dhe nëse detyrimi kryesor është titull ekzekutiv edhe ndjekja e tij bëhej sipas të njëjtit regjim juridik.

52. Pas shfuqizimit të Kodit Civil të vitit 1929, në fuqi hyri ligji nr. 2359, datë 15.11.1956, "*Mbi veprimet juridike dhe mbi detyrimet*" (në vijim "LVJD").

Kolegji vlerëson se keqrregullimi apo ometimi i sotëm i nenit 600 të Kodit Civil e ka origjinën te neni 133 i LVJD-së, i cili parashikonte, se: "*Dorëzania shuhet në qoftë se kreditori nuk ka ngritur padi kundër dorëzanësit brenda 6 muajve nga dita e mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit. Kur afati i ekzekutimit të detyrimit nuk është caktuar as në kontratën e dorëzanisë, as në një marrëveshje tjetër, dorëzania shuhet me kalimin e një viti nga dita e lidhjes së kontratës së dorëzanisë.*". Kjo normë është analogjia e nenit 600 të Kodit Civil dhe ka qenë pikërisht ky ligji nga ku është marrë dispozita që sot është në fuqi.

53. Më tej, paragrafi i dytë i nenit 180 të Kodit Civil të vitit 1981 parashikonte se: "*Dorëzania hiqet me mbarimin e detyrimit kryesor dhe, kur kreditori nuk ka ngritur padi kundër dorezanësit, brenda gjashtë muajve nga dita e mbarimit të afatit të përmbushjes së detyrimit.*" Edhe ky formulim është i ngjashëm me nenin 133 të LVJD dhe për pasojë edhe me ligjin e fundit civil pasues deri më tani, konkretisht me nenin 600 të Kodit Civil të vitit 1994.

54. Sa më lart, konstatohet se me përjashtim të Kodit Civil të vitit 1929, në vazhdimësi ligjvënësi ka përdorur termin *"padi"* për të identifikuar mjetin që duhet të përdoret nga kreditori, në përmbushje të interesave të tij, brenda afatit gjashtëmujor apo njëvjeçar, me kërkimin që ky detyrim të ekzekutohet nga dorëzanësi.

Çështja që shtrohet konkretisht për diskutim nga Kolegji është nëse me termin "padi", për qëllime të nenit 600 të Kodit Civil, do të duhet të kuptohet ngushtësisht kërkesëpadia si akt që konstituon një proces gjyqësor civil kontencioz, apo me të, do të kuptohet gjerësisht pretendimi i kreditorit kundrejt dorëzanësit për mospërmbushje të detyrimit, pavarësisht formës se si artikulohet ky pretendim, që mund të jetë edhe kërkesa për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm.

55. Kolegji vlerëson se në aspektin parimor, interpretimi i ngushtë dhe literal do të shkaktonte cenimin e nenit 11 pika 3 të Kushtetutës[115], qarkullimin civil të lirë dhe iniciativën e lirë ekonomike, duke e vështirësuar atë. Pra, një interpretim i tillë, se me termin "padi", sipas nenit 600 të Kodit Civil, do të kuptohen vetëm aktet që iniciojnë gjykime kontencioze, do të mohonte qëllimin e legjislatorit në parashikimin e shkronjave "d" të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, ku janë cilësuar si tituj ekzekutiv kontratat e kredive bankare dhe kontratat e kredive të dhëna nga institucionet financiare jo bankë.

Qëllimi i këtij parashikimi ligjor ka qenë që në qarkullimin civil të mundësohej dhënia e kredive për vitalizmin e ekonomisë dhe paralelisht me të edhe mjetet paguese, me qëllim që subjektet të ishin solvabël dhe të kishin mundësi investimi. Por nga ana tjetër kjo politikë ligjore është shoqëruar me mundësinë dhe garancinë e ofruar nga ligji për bankat apo institucionet financiare për të mbledhur kreditë e tyre.

56. Interpretimi i ngushtë dhe literal i nenit 600 të Kodit Civil, dëmton ekskluzivisht bankat dhe institucionet financiare jobankë, pasi atyre iu vështirëson realizimin e kredisë, duke dërguar në gjykatë për proces kontencioz këdo kreditor që kërkon të aktivizojë mjetin e garancisë së kredisë të individualizuar në dorëzani.

Nuk mundet të pranohet me një logjikë mesatare juridike se ekzekutimi i detyrimit aksesor dhe i mjetit të garancisë të jetë i ndryshëm dhe shumë më i vështirë në kohë sesa ekzekutimi i detyrimit principal. Kështu edhe dorëzania nuk mundet të jetë *apriori* më e vështirë për t'u ekzekutuar sesa vetë detyrimi principal, përmbushjen e të cilit ajo është destinuar juridikisht për ta garantuar.

Në këtë linjë arsyetimi, Kolegji vlerëson se neni 600 i Kodit Civil, në pjesën ku përmendet termi "padi", do të duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar dhe teleologjike.

Sakaq, është e rëndësishme të merret në analizë kuptimi juridik i padisë, qëllimi i dorëzanisë, si dhe rëndësia e kërkesës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, për të vlerësuar nëse ligji na e lejon një mënyrë interpretimi të tillë.

57. Fillimisht, Kolegji sjell në vëmendje se, në praktikën e Gjykatës së Lartë, është bërë në mënyrë të vazhdueshme dallimi midis padisë në kuptimin material dhe atij procedural.

Në kuptimin material padia është e drejta subjektive civile, pra mundësia që ka çdo person për të kërkuar realizimin e të drejtave civile përkundrejt një subjekti tjetër, pavarësisht vullnetit të këtij të fundit.

Ndërsa në kuptimin procedural, padia është mjeti juridik formal me të cilin paditësi investon gjykatën në mbrojtje të së drejtës së tij subjektive, pra është dokumenti në të cilin paditësi sqaron pretendimet e tij (*shih vendimin nr. 00-2019-245 (7), datë 10.4.2019, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë etj.)*

Ka një interpretim të qëndrueshëm në lidhje me faktin se termi *"padi"* që përdoret në Kodin Civil, si një ligj material, ka të bëjë me *"padinë",* në kuptimin e saj material. Për rrjedhojë *"padia"* që përmendet në Kodin Civil, nuk është mjeti procedural me të cilën palët i drejtohen gjykatës. Mjeti me të cilën palët i drejtohen gjykatës, nuk rregullohet nga e drejta materiale, por nga e drejta procedurale, konkretisht Kodi i Procedurës Civile, i cili parasheh mjete të ndryshme procedurale për vënien në lëvizje të gjykatës, siç janë *"kërkesëpadia"* dhe *"kërkesa"*. Përdorimi i këtyre mjeteve bëhet sipas rastit dhe llojit të gjykimit.

58. Kolegji vlerëson se neni 600 i Kodit Civil, me padi nuk nënkupton kërkesëpadinë, si mjet procedural për vënien në lëvizje të gjykatës, por padinë në kuptimin material, pra si mundësi që njihet nga ligji për t'iu adresuar gjykatës, për të arritur respektimin e të drejtave dhe të një interesi legjitim. E drejta për të vënë në lëvizje gjykatën nëpërmjet një kërkese për ekzekutim të detyrueshëm, futet brenda konceptit të padisë në kuptimin material, pasi edhe qëllimi i këtij mjeti juridik është realizimi i një të drejte dhe interesi legjitim, siç është e drejta e kreditorit, për të kërkuar përmbushjen e detyrimit nga dorëzanësi.

Vetëm kur dorëzania përbën titull ekzekutiv, kërkesa për lëshim urdhër ekzekutimi barazohet me padinë sipas nenit 600. Në rastet kur dorëzania nuk përbën titull ekzekutiv kreditori mund të shfrytëzojë nenin 600 për të *paraqitur një padi themeli, kundër dorëzanësit, duke respektuar afatet e parashikuara nga ky nen.*"

59. Në mënyrë komplementare me interpretimin teleologjik, Kolegji vlerëson të bëjë edhe interpretimin gjuhësor të dispozitës.

Fjalët e përdorura në një normë ligjore u duhet dhënë kuptimi i tyre i zakonshëm, me përjashtim kur vetë ligji u jep një kuptim tjetër. Sikurse u analizua më sipër, neni 600 i Kodit Civil, në mënyrën sesi është formuluar sot, është trashëgimi e LVJD-së së vitit 1956, e më tej e Kodit Civil të vitit 1981. Të dyja ligjet, në dispozita respektive analoge të nenit 600 të Kodit Civil aktual, përdorin termin *"padi"* në brendinë e tyre, si mjeti që duhet të përdorë kreditori ndaj dorëzanësit, për të ekzekutuar detyrimin, nëpërmjet forcës shtrënguese të shtetit.

[115] Neni 11 pika 3 i Kushtetutës parashikon, se: "*Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike*".

60. Në atë periudhë, rezulton se nga institucionet shkencore të gjuhësisë, ishte nxjerrë Fjalori i Gjuhës Shqipe të vitit 1954,[116] i cili fjalën "padi", e përkufizonte si: *"të ngrituri e tjetrit në gjyq për ndonjë faj që i vishet, kërkimi i së drejtave përpara gjyqit"*.

Më tej, Fjalori i Gjuhës Shqipe, i vitit 1980[117], që ishte në përdorim, kur u miratua Kodi Civil i vitit 1994, e përkufizonte *"padinë",* si *"kërkesa që i bën dikush gjykatës kundër një tjetri për të mbrojtur një të drejtë ose për të kërkuar zgjidhjen e një çështjeje..."*.

Bazuar në këto dy formulime shkencore, gjuha shqipe, i ka dhënë dy kuptime termit *"padi"*. Kuptimi i parë lidhet me padinë me palë kundërshtare, ndërsa kuptimi i dytë i termit *"padi",* rezulton që të jetë edhe një kërkesë nëpërmjet të cilës kërkohen të drejtat përpara gjykatës, ose për zgjidhjen një çështjeje, akt nëpërmjet të cilit vihet në lëvizje një proces pa palë kundërshtare.

61. Edhe në aspektin krahasimor, duhet theksuar se një interpretim i zgjeruar i nenit 600 të Kodit tonë, është në përputhje me qasjen e modeleve europiane ligjore, në mënyrën sesi ato e kanë konceptuar institutin e dorëzanisë.

62. Kodi Civil të Republikës Federale të Gjermanisë, pasi ka parashikuar në nenin 772, se si kreditori ndjek pasurinë e debitorit për të realizuar kredinë e tij, në nenin 777, parashikon se nëse kreditori, nga momenti kur detyrimi nuk përmbushet nga debitori kryesor, dhe detyrimi është bërë i kërkueshëm, *e deri me kalimin e afatit të përgjithshëm të parashkrimit*[118]*,* nuk ka kërkuar nga dorëzanësi përmbushjen e detyrimit, atëherë dorëzania shuhet. Sipas ligjit civil gjerman kreditori do të ndjekë dorëzanësit sipas mënyrës që ndjek debitorin kryesor për përmbushjen e detyrimit kryesor.

63. Më tej, neni 1957 i Kodit Civil të Republikës së Italisë, parashikon se dorëzanësi mbetet i detyruar ndaj kreditorit edhe pas mbarimit të afatit të përmbushjes së detyrimit kryesor, me kushtin që brenda gjashtë muajve kreditori t'i ketë kërkuar përmbushjen e detyrimit dorëzanësit dhe se kjo dispozitë zbatohet edhe kur dorëzanësi e ka kufizuar përmbushjen e detyrimit brenda afatit të përmbushjes së detyrimit nga debitori kryesor. Në këtë rast kërkesa drejtuar dorëzanësit për përmbushjen e detyrimit duhet të ushtrohet brenda dy muajve. Më tej norma italiane mbyllet me parashikimin, se *kërkesa drejtuar debitorit kryesor ndërpret ecjen e afatit edhe për dorëzanësin.*[119] Pra sipas legjislacionit italian kreditori mundet të aktivizojë ekzekutimin e dorëzanisë me të njëjtat mjete ligjore, sikurse mundet të aktivizojë ekzekutimin e detyrimit principal ndaj debitorit kryesor.

Kjo do të thotë se dorëzania në çdo rast do të ndjekë regjimin juridik të detyrimit kryesor, për faktin se ajo nuk mundet të jetë titull i mëvetësishëm dhe i pavarur, por është e lidhur integralisht dhe funksionalisht me detyrimin kryesor të cilit i shërben.

64. Jurisprudenca e Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë e ka trajtuar edhe çështjen e mënyrës dhe mjeteve juridike të cilat ka në dispozicion kreditori për të përdorur kundrejt dorëzanësit, me qëllim ekzekutimin e detyrimit dhe parandalimin e kalimit të afatit të shuarjes së dorëzanisë. Kjo jurisprudencë ka interpretuar se jo çdo veprim i kreditorit mundet të aktivizojë ekzekutimin e dorëzanisë dhe parandalojë ecjen e afatit ligjor të shuarjes së saj. Këtë gjë mundet ta bëjnë vetëm ato akte procedurale të cilat konstituojnë proces.[120]

Jurisprudenca më e vonë ka interpretuar se afati ligjor i shuarjes së dorëzanisë do të ecë vetëm kur kreditori nuk aktivizon instrumentet ligjor procedural të ekzekutimit të detyrimit si ndaj debitorit kryesor dhe ndaj dorëzanësit.[121] Kreditori nëpërmjet këtyre instrumenteve ligjore të ekzekutimit të detyrimit arrin konstituimin e procesit sipas formës dhe mënyrës së parashikuar në ligj[122] dhe çdo veprim juridik të tillë, që kreditori ndërmerr ndaj debitorit kryesor (padi, kërkesë për sekuestro konservative mbi pasurinë e debitorit, kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm, kërkesë për falimentim etj.), duhet të konsiderohet se *ipso legge* ndërpresin afatin edhe ndaj dorëzanësit.[123] Thënë ndryshe, aktivizimi i ekzekutimit të dorëzanisë nga kreditori, për qëllimet e parandalimit të

---

[116] Ky fjalor është hartuar nga një komisioni i përbërë nga K. Çipo (kryetar), E. Çabej, M. Domi, A. Krajni dhe O. Myderrizi.

[117] Hartuar nga Instituti i Gjuhësisë, pjesë e Akademisë së Shkencave.

[118] Në Republikën Federale të Gjermanisë afati i përgjithshëm i parashkrimit është 3 vjet.

[119] Shiko me analogji nenin 133 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë së vitit 1994, dispozitë e cila parashikon, se: "*Parashkrimi i ndërprerë kundër debitorit kryesor shtrihet edhe ndaj dorëzënësit përkatës.*".

[120] Shiko vendimin nr. 6604, datë 14.7.1994 dhe vendimin nr. 2898/1976 të Seksionit Civil të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.

[121] Shiko vendimin nr. 1724/2016 të Seksionit Civil të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.

[122] Shiko vendimin nr. 6604, datë 14.7.1994 të Seksionit Civil të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.

[123] Shiko vendimin nr. 8723/1994; vendimin nr. 9364/1991; vendimin nr. 13078/2008; vendimin nr. 4241/1994; vendimin nr. 1974/1994; vendimin nr. 8723/1994; vendimin nr. 1724/2016; vendimin nr. 6823/2001; vendimin nr.

shuarjes së dorëzanisë për shkak të kalimit të afatit ligjor, duhet të bëhet prej secilës formë juridiksionale të mbrojtjes së pasurisë, qoftë duke konstituuar një proces gjyqësor kontencioz apo edhe nisjen e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, mjete ligjore të cilat sipas rastit mundet të vënë në ekzekutim detyrimin kryesor ndaj debitorit kryesor apo ndaj dorëzanësit.[124]

65. Neni 1031 i ligjit mbi detyrimet të Republikës së Kosovës parashikon se detyrimi i dorëzanësit shuhet njëlloj sikur parashkruhet detyrimi principal i debitorit kryesor. Më tej ky ligj parashikon se ndërprerja e parashkrimit të kërkesave ndaj debitorit kryesor ka efekt edhe ndaj dorëzanit vetëm në qoftë se ndërprerja është shkaktuar nga ndonjë veprim i kreditorit para gjykatës kundër debitorit kryesor dhe se ngecja e parashkrimit të detyrimit të debitorit kryesor nuk ka efekt ndaj dorëzanësit. Edhe ky ligj, njëlloj sikurse ligjet gjermane dhe italiane, nuk e lidh detyrimisht aktivizimin dhe ekzekutimin e dorëzanisë me paraqitjen e padisë në gjykatë të kreditorit kundrejt dorëzanësit. Duke mos e individualizuar mjetin dhe duke mos e tipizuar atë, ligji civil kosovar lë të kuptohet se ekzekutimi i dorëzanisë nga ana e kreditorit do të arrihet njëlloj sikurse do të arrihet ekzekutimi i detyrimit principal nga ana e debitorit kryesor.

66. Kolegji vlerëson se kjo mënyrë interpretimi, garanton edhe regjimin juridik të solidaritetit në detyrime ndërmjet debitorit kryesor dhe dorëzanësit, që sanksionohet në nenin 590 të Kodit Civil. Kjo dispozitë, në momentin kur detyrimi kryesor bëhet i kërkueshëm dhe nuk ka marrëveshje të ndryshme ndërmjet palëve për dorëzani subsidiare, e bën të kërkueshme njëlloj edhe detyrimin kryesor nga debitori kryesor dhe nga dorëzanësi, që pas këtij momenti është debitor solidar apo bashkëdebitor.

Kjo do të thotë se i pajtueshëm me nenin 590 të Kodit Civil, do të jetë vetëm interpretimi që do të mundet të bëjë njëkohësisht të kërkueshëm detyrimin kryesor nga debitori kryesor dhe nga dorëzanësi dhe do t'i japë sakaq të drejtën e zgjedhjes kreditorit ndërmjet dy të detyruarve solidar.

67. Në vijim të kësaj analize, Kolegji konkludon se në rastin kur dorëzania është dhënë nga subjekte të së drejtës që nuk janë institucione bankare apo financiare jobankare, atëherë për mbrojtjen e të drejtave të tyre, këto subjekte i drejtohen gjykatës me aktin procedural, të emërtuar si *"kërkesëpadi"*.

Në rastin e institucioneve bankare dhe institucioneve financiare jobankare, ligjvënësi ka përcaktuar që kontratat e tyre përbëjnë titull ekzekutiv. Për rrjedhojë në këtë rast, këto subjekte, kur i drejtohen gjykatës, i drejtohen me aktin procedural të *"kërkesës"*.

68. Kontrata e dorëzanisë, duke qenë një kontratë aksesore që garanton një detyrim kryesor, duhet t'i shërbejë pikërisht kësaj të fundit. Në praktikën e tij, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, për çështje në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, duke analizuar, se: *"...ky Kolegj çmon se në çështjen objekt gjykimi, gjykata kompetente për të lëshuar urdhrin e ekzekutimit për kontratën e kredisë bankare është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, pra gjykata e vendit ku rezultojnë se kanë qendrën e banimit kredimarrësi A.U. dhe dorëzanësi Q.U., pasi prezumohet se në këtë qytet personat e mësipërm kanë pasuritë e tyre të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, dhe për këtë arsye në këtë vend duhet të nisin procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm...",* ka mbajtur qëndrimin se vend i ekzekutimit të detyrimit, si kriter përcaktues i kompetencës tokësore, në mungesë të parashikimit kontraktor, do të jetë, ndër të tjerë, vendbanimi i dorëzanësit, ndaj pasurive të të cilit do të shtrihet ekzekutimi i detyrueshëm, pasi është lëshuar urdhri i ekzekutimit *(shih vendimin nr. 00-2011-758 (181), datë 19.4.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).*

69. Sikurse u përmend edhe më sipër, kontrata e dorëzanisë haset më së shumti në praktikë si një kontratë bankare, ose kontratë nga një institucion financiar jobankar, në të cilën subjekti bankar ose financiar jobankar, përkundrejt kredisë që livron ndaj debitorit, preferon edhe një garanci nga një subjekt tjetër, dorëzanësi. Në kuptim të shkronjës "d" të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, parimisht të gjitha aktet e kësaj kategorie janë tituj ekzekutivë dhe për to lëshohet urdhri i ekzekutimit sipas përcaktimeve të nenit 511 të po këtij kodi.

70. Në rastin e përmendur në paragrafin e mësipërm, në interpretim të frymës dhe qëllimit të dorëzanisë, si dhe karakterit subjektiv të saj, duke e parë padinë në kuptimin material si një e drejtë subjektive, nevojitet që kreditori të ndërmarrë veprime procedurale ligjore konkrete ndaj dorëzanësit. Kreditori nevojitet që të tregojë interes të përshtatshëm dhe vigjilencë në këtë drejtim. Fakti që kreditori ndërmerr veprime procedurale konkrete duke ju drejtuar gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për kontratën e dorëzanisë, në ato raste kur ajo është një akt për dhënien e kredisë bankare apo akt për dhënien e kredive nga institucionet financiare jobankare, prezumon se ai (kreditori), synon të realizojë një të drejtë subjektive, konkretisht të drejtën për të

203/1997; vendimin nr. 6604/1994; vendimin nr. 16836/2015; vendimin nr. 8839/2007; vendimin nr. 16233/2005; vendimin nr. 16758/2002; vendimin nr. 16233/2005 të Seksionit Civil të Gjykatës Supreme të Kasacionit të Republikës së Italisë.

[124] Shiko "*Codice Civile spiegato con esempi pratici, dottrina, giurisprudenza, tabelle e appendice normativa*", Decima Edizione, Tribuna Studium, Casa Editrice La Tribuna, 2011, faqe 1253.

kërkuar ekzekutimin e detyrimit nga dorëzanësi. Pra, në këtë rast kërkesa e kreditorit për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit barazohet me padinë në kuptim procedural.

71. Në këtë konkluzion arrihet edhe po të kemi parasysh se në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile përdoren termat "padi" dhe "kërkesë" për të treguar veprimin procedural me të cilin pala e interesuar, paditës apo kërkues investon gjykatën në mbrojtje të së drejtës së tij subjektive, në këtë drejtim të dyja këto akte kanë të njëjtin qëllim.

72. Mbetet të konkludohet se brenda kujt afati kreditori duhet t'i drejtohet dorëzanësit me kërkesën për ekzekutim të detyrueshëm të dorëzanisë dhe se me kalimin e kujt afati dorëzania shuhet. Për këtë pjesë të rregullimit të posaçëm të dorëzanisë, kur ajo përbën titull ekzekutiv, ligji ometon. Në këto kushte norma duhet të krijohet rishtazi nga gjykata nëpërmjet interpretimit me analogji, në bazë dhe për zbatim të nenit 1 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile[125].

73. Kolegji çmon të marrë në analizë momentin juridik nga nis afati 6-mujor apo njëvjeçar i shuarjes së dorëzanisë, momentin që shenjon fillimin e fazës së ekzekutimit të detyrueshëm dhe afatet e parashkrimit në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm.

74. Momenti i nisjes së afatit të shuarjes së dorëzanisë deduktohet qartë nga neni 600 i Kodit Civil, i cili përkon me momentin nga ku detyrimi i kreditorit bëhet i kërkueshëm (në mënyrë më të zgjeruar, kjo çështje do të trajtohet në vijim).

Ky parashikim është i pajtueshëm me rregullin e përgjithshëm të sanksionuar në nenet 117 dhe 118 Kodit Civil. Në këto dispozita është parashikuar se afati i parashkrimit të padisë fillon nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë dhe në detyrimet kontraktore të lidhura me afat ekzekutimi, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur është plotësuar ky afat. Ndërsa në rastin kur detyrimet janë pa afat, Ligjvënësi ka bërë një parashikim të posaçëm, sipas të cilit afati i shuarjes së dorëzanisë është 1 vit dhe fillon nga data e lidhjes së kontratës së dorëzanisë.

75. Kodi Civil nuk ka një rregullim të plotë mbi parashkrimin e kërkesave për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, por për këtë, na vjen në ndihmë neni 113 i K. Civil, si e vetmja dispozitë që thotë diçka mbi këtë institut. Pasi ka përcaktuar paditë që nuk parashkruhen, kjo dispozitë, në paragrafin e dytë parashikon, se: *"nuk parashkruhen edhe kërkesat për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve që janë lidhur me padi për të cilat nuk zbatohet parashkrimi"*.

Kolegji vlerëson se me një interpretim të kundërt (*per a contrario*), kërkesat për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutivë, që lidhen me paditë që nuk përfshihen në listën e nenit 113, do të parashkruhen brenda afateve të parashkrimit të padive respektive dhe në rastet kur kemi të bëjmë me tituj ekzekutivë, të ndryshme nga vendimet gjyqësore, rregullat mbi parashkrimin e padive do të zbatohen me analogji.

76. Në këtë kuptim, duke pasur në konsideratë edhe nenet 11[126] dhe 18[127] të Kushtetutës, do të duhet të konkludohet se, dorëzania që është titull ekzekutiv duhet të shuhet brenda të njëjtave afate ligjore sikurse dorëzania që nuk është titull ekzekutiv. Për rrjedhojë arrihet në konkluzionin se neni 600 i Kodit Civil do të interpretohet dhe zbatohet me analogji edhe për afatin ligjore të shuarjes së dorëzanisë që është titull ekzekutiv.

77. Nga ana tjetër, mënyra dhe mjeti se si vihet në ekzekutim kjo lloj dorëzanie nuk rregullohet nga neni 600 i Kodit Civil, por rregullohet sipas nenit 515 i Kodit të Procedurës Civile.

78. Sipas nenit 515 të Kodit të Procedurës Civile, ligjit nr. 8/2023, "*Për shërbimin përmbarimor shtetëror*", si dhe ligjit nr. 26/2019, "*Për shërbimin përmbarimor privat*", titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nga përmbaruesi gjyqësore vetëm mbi bazën e kërkesës së kreditorit, e cila është e mëvonshme në kohë në raport me kërkesën drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, për kontratën e dorëzanisë si titull ekzekutiv, nga ana e kreditorit. Lëshimi i urdhrit të ekzekutimit nuk është momenti i fillimit të ekzekutimit të një titulli

---

[125] Neni 1 paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile parashikon, se: "*Gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë dhe të japë vendime për çështjet që i paraqiten për shqyrtim, me arsyetim se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë.*".

[126] Neni 11 i Kushtetutës parashikon se:

"*1. Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. 2. Prona private dhe publike mbrohen njëlloj me ligj. 3. Kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.*".

[127] Neni 18 i Kushtetutës parashikon se:

"*1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.*".

ekzekutiv. Lëshimi i urdhrit të ekzekutimit është një gjykim gracioz i cili ka për qëllim verifikimin e ekzistencës kushteve të vlefshmërisë së një titulli ekzekutiv.

Fillimi i ekzekutimit është momenti i paraqitjes së kërkesës përmbaruesit për nisjen e ekzekutimit të detyrueshëm. Mund të ndodhë që kreditori të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit për një titull ekzekutiv dhe më tej të mos kërkojë ekzekutimin e detyrueshëm të tij. Kjo parashikohet edhe në nenin 131/ç të Kodit Civil, i cili përcakton, se: "*Parashkrimi ndërpritet: ç) me paraqitjen e kërkesës për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor apo të arbitrazhit përkatës, si dhe të çdo titulli ekzekutiv tjetër*".

79. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se çdo veprim që kreditori ndërmerr ndaj debitorit apo ndaj dorëzanësit, (padi, kërkesë për lëshim urdhri ekzekutimi, kërkesë për ekzekutim të detyrueshëm), duhet të konsiderohet se *ipso legge* ndërpresin afatin e parashkrimit. Pra aktivizimi i ekzekutimit të dorëzanisë nga kreditori, për qëllimet e parandalimit të shuarjes së dorëzanisë, për shkak të kalimit të afatit ligjor, duhet të bëhet prej secilës formë juridiksionale të mbrojtjes së pasurisë, qoftë duke konstituuar një proces gjyqësor për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit apo edhe nisjen e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, me kërkesë drejtuar përmbaruesit gjyqësor, mjete ligjore të cilat sipas rastit mundet të vënë në ekzekutim detyrimin kryesor ndaj debitorit kryesor apo ndaj dorëzanësit.

80. Nga analiza e mësipërme konkludohet se për efekt të nenit 600 të Kodit Civil, do të barazohen kuptimi i kërkesëpadisë dhe kërkesës për lëshim urdhri ekzekutimi, në rastin kur dorëzania përbën titull ekzekutiv.

Kjo do të thotë se kreditori për të parandaluar ecjen e afatit 6-mujor ose një vjeçar duhet ti drejtohet gjykatës me kërkesë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit brenda 6 muajve ose një viti, sipas nenit 600 të Kodit Civil. Nga ky moment fillon një afat i ri 6-mujor ose njëvjeçar, brenda të cilit kreditori duhet të paraqesë kërkesën për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm drejtuar përmbaruesit gjyqësor.

81. Nisur nga sa më lart, Kolegji konkludon se, për aktet që përmbajnë detyrime në të holla dhe që sipas nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile janë tituj ekzekutivë, kërkesa e kreditorit për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit është e barasvlershme, për sa u përket efekteve juridike që sjell, me padinë e ngritur sipas nenit 600 të Kodit Civil.

82. Ndërkohë për efekt të vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit, kërkesa drejtuar përmbaruesit gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në nenin 113 të Kodit Civil, pra kjo kërkesë i nënshtrohet një tjetër afati të përcaktuar në nenin 600 të Kodit Civil.

2. Referuar neneve 597, 598, 599 dhe 600 të Kodit Civil, a legjitimohet dorëzanësi të kërkojë shuarje dorëzanie?

83. Dispozitat e mësipërme të K. Civil, përcaktojnë rastet e shuarjes së dorëzanisë. Kështu rezulton se sipas Kodit Civil shuarja e dorëzanisë ndodh për shkak të shuarjes së detyrimit kryesor (neni 597); se kreditori heq dorë nga privilegjet, pengu dhe hipoteka, për pasojë dorëzanësi shkarkohet nga detyrimi (neni 598); kreditori pranon një pasuri ose çdo gjë tjetër për pagimin e detyrimit kryesor (neni 599); plotësimi i afateve të parashkrimit prej gjashtë muajsh apo një viti (neni 600).

84. Kodi Civil i vitit 1929, në nenet 1858 deri 1863, kishte të parashikuara rastet e shuarjes së dorëzanisë, konkretisht si parim dorëzania shuhej në të gjitha rastet e shuarjes së detyrimeve të tjera në tërësi; në rastin kur: "*nga fakti i kreditorit nuk mund të ketë ma efekt në favor të po atij dorëzanësi nëvendësimi në të drejtat, në hipotekat dhe në privilegjet e kreditorit*"; në rastin kur kreditori pranon vullnetarisht një pasuri ose çdo gjë tjetër për pagimin e detës kryesor; në rastin e plotësimit të afateve të parashkrimit prej gjashtë muajsh.

85. Sipas neneve 131 deri 133 të ligjit nr. 2359, datë 15.11.1956, "Mbi veprimet juridike dhe detyrimet", raste të shuarjes së dorëzanisë konsideroheshin situatat kur: kreditori heq dorë nga privilegjet, pengu, ipoteka; me shuarjen e detyrimit kryesor; me afatin e parashkrimit gjashtëmujor apo një vjeçar.

Ndërsa sipas nenit 180 të ligjit nr. 6340, datë 26.6.1981, Kodi Civil, dorëzania shuhet me përmbushjen e detyrimit kryesor dhe plotësimin e afatit të parashkrimit prej gjashtë muajsh.

86. Ndër qëllimet e kontratës së dorëzanisë është dhënia e garancisë se debitori do të përmbushë detyrimin në kohën, mënyrën dhe kushtet e caktuara. Në këtë marrëdhënie me kreditorin, dorëzanësi nuk ka një të drejtë të tij subjektive dhe konkrete, por ai gjendet në çdo moment i riskuar në të drejtat pasurore sepse eventualisht debitori mund të ndodhet në kushtet e pamundësisë për të përmbushur detyrimin kryesor. Në këto kushte, për të mbrojtur dorëzanësin nga ky risk i "pafund", ligji ka parashikuar edhe rastet e shuarjes së detyrimit të tij.

87. Kështu, megjithëse nenet 597 deri 599 të Kodit Civil nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur të drejtën e dorëzanësit për të kërkuar gjyqësisht shuarjen e dorëzanisë, kjo e drejtë del nga përmbajtja e nenit 592 të Kodit Civil, sipas të cilit: "*Dorëzanësi ka të drejtë t'i kundrejtojë kreditorit të gjitha prapësimet që mund t'i kundrejtonte këtij debitori*

dhe të kërkojë kompensimin e asaj që kreditori i detyrohet debitorit edhe sikur ky të ketë hequr dorë nga këto të drejta ose të ketë pranuar detyrimin." Sa më lart, rezulton se ai ka një interes të ligjshëm për të mbrojtur të drejtat e tij pasurore nga veprimet e kreditorit.

88. E thënë ndryshe, për të parashtruar një kërkim është e nevojshme që subjekti të ketë interes. Ky interes prezumon kërkesën e subjektit drejtuar gjykatës me qëllim njohjen ose rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar, mohuar apo shkelur nga një subjekt tjetër, të cilin ai e thërret në gjykim. Kërkimi për njohjen ose rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar, shkelur apo mohuar është legjitim vetëm nëse parashtrohet nga ai të cilit i përket e drejta subjektive e cenuar, shkelur apo mohuar (legjitimiteti aktiv), dhe vetëm kundër atij që me sjelljen apo veprimet e tij ka cenuar, shkelur apo mohuar të drejtën subjektive të palës tjetër (legjitimiteti pasiv). Ndaj edhe dorëzanësi gëzon legjitimitet aktiv për të investuar gjykatën me padi me objekt "shuarjen e dorëzanisë". Tek e fundit dorëzanësi është palë në këtë veprim juridik sipas nenit 585 të Kodit Civil dhe për rrjedhojë gëzon të drejtën e mbrojtjes ligjore duke qenë në pozitën e palës paditëse, pra ka legjitimitet aktiv.

89. Sipas teorisë bazë të së drejtës kushtetuese, të të drejtave të njeriut, të së drejtës civile dhe e së drejtës procedurale civile, kushdo që pretendon se cenohet në të drejtat e tij kushtetuese apo ligjore mundet t'i drejtohet gjykatës. Ky parim absolut i aksesit në drejtësi është në gjendje që të zgjidhë pikëpyetjen e shtruar për njësim nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë.

90. Sigurisht që askush më shumë se dorëzanësi nuk është i interesuar dhe mundet të legjitimohet aktivisht në gjykatë për të kërkuar shuarjen e dorëzanisë. Debitori kryesor nuk mundet të ketë interes për t'iu drejtuar gjykatës, pasi me një dorëzani efektive ai ka siguri që detyrimi i marrë përsipër do të përmbushet kundrejt kreditorit. Nga ana tjetër kreditori nuk mundet të kërkojë diçka të tillë në gjykatë, pasi ai nuk mundet të ketë interes që të pakësojë mjetet ligjore që garantojnë realizimin e kredisë së tij. Të tretët janë krejt indiferent në këtë çështje. E për rrjedhojë përgjigja e pyetjes së Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë mbetet e padyshimtë se vetëm dhe ekskluzivisht dorëzanësi mundet të kërkojë në gjykatë me padi njohje shuarjen e dorëzanisë.

91. Në një rast ku paditës është dorëzanësi nuk jemi përpara ndërgjyqësisë së detyrueshme, pra dorëzanësi nuk është i detyruar të thërrasë si të paditur njëherazi kreditorin dhe debitorin. Sikurse u analizua në pjesën hyrëse, kontrata e dorëzanisë lidhet midis dorëzanësit dhe kreditorit, marrëdhënia juridike lind midis tyre dhe si rregull debitori mbetet i palidhur me këtë marrëdhënie juridike.

Nga ana tjetër, dorëzanësi legjitimohet të kërkojë shuarjen e dorëzanisë, edhe përmes prapësimit gjyqësor, në ato gjykime ku është thirrur në cilësinë e palës së paditur. Kjo deduktohet nga rregulli i përgjithshëm procedural civil, se barrën e paraqitjes së fakteve shuese, penguese apo ndryshuese të së drejtës së paditësit dhe barrën e provës për këto fakte, në një proces civil, e ka pala e paditur.

Dorëzania është një veprim juridik, pra konsiston në një manifestim të drejtpërdrejtë të vullnetit me synimin për të arritur pasoja juridike të caktuara, më konkretisht për: krijimin e një situate të re (e një marrëdhënie juridike të re); disiplinimin e një situate tashmë ekzistuese, (një marrëdhënie juridike që ekziston); mbarimin/shuarjen e një situate tashmë ekzistuese, atëherë janë të zbatueshme dispozitat materiale që parashikon Kodi Civil, nenet 79 e vijues të tij, sikundër edhe jurisprudenca e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, e manifestuar në vendimet unifikuese.

92. Në rastet kur kontrata e dorëzanisë gjendet e integruar apo në formën e një kontrate bankare, ose kontratë nga një institucion financiar jobankar, akte të cilat janë tituj ekzekutiv, mjetet e mbrojtjes të së drejtave të dorëzanësit përputhen me mjetet e mbrojtjes kundër ekzekutimit të detyrimeve të përcaktuara në nenet 609 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Këtu përmendim: padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv sipas nenit 609; ankimin për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore sipas nenit 610 dhe padinë për kërkimin e sendit nga personi i tretë neni 612.

93. Në nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet, se: "*Debitori mund të kërkojë në gjykatën kompetente të vendit të ekzekutimit që të deklarohet se titulli ekzekutiv është i pavlefshëm ose se detyrimi nuk ekziston, ose ekziston në një masë më të vogël ose është shuar…*" Pra, kërkimi i pavlefshmërisë së pjesshme apo të plotë të titullit ekzekutiv është një nga mjetet e mbrojtjes së debitorit kundër ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile.

94. Titulli ekzekutiv është akti përmes të cilit legjitimohet kërkesa për nisjen e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm. Kushtet e titullit ekzekutiv konsistojnë në ekzistencën e së drejtës materiale, e drejtë e cila duhet të jetë e sigurt, e përcaktuar dhe e kërkueshme. Nga ana tjetër nëse kundërshtohet titulli ekzekutiv për pavlefshmëri, bazuar në nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile, kërkohet të kundërshtohet tërësisht ose pjesërisht vetë e drejta e përfshirë në të. Në këtë kuadër, Kolegji vlerëson se, mjeti procedural me të cilin dorëzanësi mund të kërkojë shuarjen e dorëzanisë, në ato raste kur kjo e fundit përbën titull ekzekutiv është kërkesëpadia me objekt "*pavlefshmëri titulli ekzekutiv, kontratë dorëzanie*".

95. Mbi këtë analizë, Kolegji konkludon se, referuar përcaktimeve të neneve 597, 598, 599 dhe 600 të Kodit Civil, dorëzanësi legjitimohet të kërkojë shuarjen e dorëzanisë me padi të tij, apo ta prapësojë atë në një proces gjyqësor ku është thirrur si i paditur me kërkimin e paditësit për përmbushjen e këtij detyrimi.

96. Për aktet që janë tituj ekzekutivë, mjeti procedural me të cilin dorëzanësi mund të kërkojë shuarjen e dorëzanisë është padia, për "*Pavlefshmërinë e këtij titulli*", për sa i takon detyrimit të dorëzanësit, sipas nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile.

3. Afati 6-mujor (neni 600 Kodi Civil), është afat prekluziv apo afat parashkrimi?

97. Neni 600 i Kodit Civil, përmban në vetvete dy afate për shuarjen e dorëzanisë, afatin gjashtëmujor që nis të llogaritet "*nga dita e mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit*" dhe afatin një vjeçar që nis të llogaritet "*nga dita e lidhjes së kontratës së dorëzanisë*". Për të sqaruar natyrën juridike të këtij afati, Kolegji çmon të trajtojë dy institute të së drejtës civile materiale, parashkrimin dhe dekadencën, kuptimin dhe dallimet midis tyre.

98. Në nenin 112 të Kodit Civil, është parashikuar se: *"E drejta e padisë që nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj, shuhet dhe nuk mund të realizohet më me anë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent."*

99. Parashkrimi është një fakt juridik i kategorisë së ngjarjeve me vërtetimin e të cilit vijnë pasoja me natyrë shuese, pasoja këto të lidhura me të drejtën e përdorimit të njërit prej mjeteve bazë dhe më të rëndësishme të mbrojtjes së të drejtave civile-padisë. Ligji duke u njohur personave të drejtën subjektive për t'iu drejtuar gjykatës me anën e padisë, njëkohësisht, e kufizon ushtrimin e kësaj të drejte me afate të caktuara kohore, të gjykuara të arsyeshme dhe të mjaftueshme nga ligjvënësi për ushtrimin e kësaj të drejte.

Mosushtrimi i të drejtës brenda këtyre afateve bën që subjekti të humbasë të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës, pra të humbasë të drejtën për të detyruar palën tjetër të përmbushë detyrimin e saj nëpërmjet një vendimi gjyqësor.

100. Elementet përbërëse të parashkrimit janë dy: mosveprimi i titullarit *(mbajtësit)* të së drejtës subjektive dhe kalimi i kohës brenda të cilës ai duhet ta kishte ushtruar këtë të drejtë. Pra, parashkrimi është humbja e të drejtës së padisë për shkak të kalimit të afateve të përcaktuara në ligj. Parashkrimi shues sjell shuarjen e të drejtës subjektive. Arsyeja për të cilin rregullimi juridik e lidh me shkaqet jo të arsyeshme të titullarit shuarjen e së drejtës subjektive qëndron në nevojën e sigurisë së marrëdhënieve juridike. Kur një e drejtë subjektive nuk ushtrohet, tek njerëzit formohet bindja që ajo nuk ekziston ose se është braktisur.

101. Sipas nenit 117 të Kodi Civil, *"Afati i parashkrimit të padisë fillon nga dita kur subjektit i ka lindur e drejta e padisë"*. Për lloje të ndryshme marrëdhëniesh e drejta e padisë lind në kohë të ndryshme. Në detyrimet kontraktore të lidhura me afat ekzekutimi, parashkrimi i padisë fillon nga dita kur është plotësuar ky afat dhe kur detyrimi është i përbërë nga pagesa periodike, për secilën prej tyre afati i parashkrimit fillon të ecë në mënyrë të veçantë.

Për detyrimet kontraktore të lidhura pa afat dhe për detyrimet që ekzekutohen me kërkesën e kreditorit, afati i parashkrimit fillon nga dita kur ka lindur detyrimi.

102. Mund të ndodhë që para se të fillojë të ecë afati i parashkrimit ose pasi afati ka filluar të ecë, të vërtetohen rrethana të cilat pengojnë titullarin e së drejtës për të realizuar të drejtën i tij subjektive nëpërmjet ngritjes së padisë dhe të cilat pezullojnë ecjen e afatit.

Pezullimi i parashkrimit konsiston në mosfillimin ose mosecjen e afatit të parashkrimit për sa kohë ekziston rrethana *(ose rrethanat)* që nuk e lejojnë titullarin e të drejtës të paraqesë padinë dhe vetëm pas rënies së tij, afati vazhdon të ecë. Nëse koha e mbetur nga afati i parashkrimit, pas zhdukjes së shkakut pezullues, është më e shkurtër se gjashtë muaj, ajo zgjatet deri në gjashtë muaj. Shkaqet e pezullimit të parashkrimit parashikohen në mënyrë të shprehur dhe shteruese nga neni 129 i Kodit Civil.

103. Gjithashtu në ligj njihet edhe instituti i ndërprerjes së afatit të parashkrimit. Ndërprerja e parashkrimit është rrethana e cila pengon ecjen e afatit dhe koha e kaluar përpara vërtetimit të rrethanës/rrethanave që sjell ndërprerjen nuk llogaritet dhe pas zhdukjes së shkakut ndërprerës fillon të ecë një afat i ri parashkrimi. Rastet e ndërprerjes së afatit të parashkrimit parashikohen në nenin 131 të Kodit Civil.

104. Nga ana tjetër, Kodi Civil në nenet 137 e vijues, ka parashikuar edhe institutin e afatit prekluziv dhe dekadent të të drejtave subjektive. Ndryshe nga kalimi i afatit të parashkrimit shues, me kalimin e afatit prekluziv apo dekadent, në rastet e parashikuara nga ligji, shuhet e drejta subjektive në vetvete. Në këtë rast, pasiviteti i titullarit të së drejtës, nuk ka si pasojë vetëm humbjen e së drejtës për të ngritur padi në gjykatë, por sjell një pasojë edhe më të rëndë, që është ajo e humbjes në tërësi të së drejtës subjektive. Pra, për efekt të ligjit, titullari i së drejtës nuk konsiderohet më se i përket ajo e drejtë

105. Duke u bazuar në këtë dallim midis dy instituteve, rrjedhin disa pasoja juridike. Nga e drejta për të prapësuar parashkrimin e padisë, pra shuarjen e të drejtës së subjektit titullar për mbrojtje shtetërore, debitori, ndaj të cilit ushtrohet forca shtrënguese e shtetit, mund të heqë dorë pasi të jetë plotësuar afati i tij (neni 126 i

Kodit Civil). Kjo pasi e drejta subjektive e kreditorit edhe në këtë rast gjithsesi ekziston dhe debitori mund ta realizojë në çdo kohë qoftë edhe vullnetarisht.

106. Po ashtu, debitori nuk mund të pretendojë kthimin e shumës së parave apo të sendit të dhënë vullnetarisht, pas kalimit të këtij afati, sepse detyrimi i tij karshi kreditorit në vetvete nuk është shuar (neni 128 i Kodit Civil).

Afati i parashkrimit nuk mund të merret parasysh nga gjykata, por vetëm me kërkesën e palës së interesuar (neni 125 i Kodit Civil).

107. Nga ana tjetër, nga afati prekluziv palët nuk mund të heqin dorë pas plotësimit të tij. Shuarja e së drejtës subjektive ndodh *ipso factum*, me kalimin e afatit, pavarësisht vullnetit të palëve (neni 139 i Kodit Civil).

Afati prekluziv, duke qenë se lidhet me vetë ekzistencën e së drejtës subjektive, merret parasysh nga gjykata kryesisht (neni 140 i Kodit Civil).

108. Kolegji vijon se, ndryshimi midis parashkrimit dhe prekluzivitetit qëndron edhe te fakti nëse afatet mund të pezullohen, ndërpriten apo rifillojnë. Parashkrimi kërkon pasivitetin e pajustifikuar të titullarit të së drejtës, që do të thotë se ky institut nuk vepron në rast se ai ka një arsye objektive që justifikon pasivitetin e tij. Në rast se ndodhemi përpara një situate të tillë, do të zbatohen rregullat e pezullimit dhe ndërprerjes së parashkrimit.

Prekluziviteti nga ana tjetër, përkon në afate të prera, strikte, të cilat as nuk mund të ndërpriten apo të pezullohen, me përjashtim të rasteve kur ligji e parashikon shprehimisht një gjë të tillë.

109. Duke iu kthyer çështjes konkrete, në nenin 600 të Kodit Civil, Ligjvënësi ka përdorur termin *"*shuhet*"*, në lidhje me të drejtën e kreditorit që nuk ushtrohet për të ekzekutuar detyrimin ndaj dorëzanësit brenda afatit të parashikuar në të dhe Kolegji vlerëson se kjo ka sjellë më së shumti paqartësinë lidhur me këtë afat.

Pavarësisht terminologjisë së përdorur në ligj, në konsideratë të kuptimit dhe dallimeve midis dy instituteve të trajtuara më sipër, Kolegji vlerëson se afati i parashikuar në nenin 600 të Kodit Civil, është një afat parashkrimi.

110. Së pari, Kolegji bazohet tek fakti se ky afat lidhet me ushtrimin e të drejtës së padisë së kreditorit ndaj dorëzanësit dhe referuar parashikimit të nenit 112 të Kodit Civil, shuarja e të drejtës së padisë ndodh kur ajo nuk ushtrohet brenda afatit të caktuar të parashkrimit.

111. Gjithashtu, Kolegji vlerëson të bëjë edhe një interpretim historik të dispozitave që kanë normuar institutin e parashkrimit, duke i parë ato në mënyrë sistematike, me regjimin juridik të shuarjes së dorëzanisë ndër vite.

112. Në planin historik, legjislacioni shqiptar e ka njohur dhe rregulluar, institutin e parashkrimit në mënyrë të vazhdueshme.

Kodi Civil i vitit 1929, në librin IV, titulli XXIX (i cili ndahej në katër kaptina, nenet 2009-2047) rregullonte vetëm parashkrimin dhe konkretisht kishte këto rregullime: Kaptina I (nenet 2009-2016), titullohej "Dispozita të Përgjithshme"; kaptina II (nenet 2017-2023), titullohej "Shkaqet që ndalojnë ose pezullojnë parashkrimin"; kaptina III (nenet 2024-2031), titullohej "Shkaqet e ndërprerjes së parashkrimit", Kaptina IV (nenet 2032-2047, titullohej "Koha që lypet për parashkrim".

113. Më vonë ligji nr. 2022, datë 2.4.1955, "Mbi pjesën e përgjithshme të Kodit Civil", në nenet 75-92 të tij, parashikonte gjithashtu vetëm institutin e parashkrimit, qasje që ruante edhe Ligji nr. 6340, datë 26.6.1981 "Për Kodin Civil", në nenet 59–66, duke njohur përsëri vetëm institutin e parashkrimit.

Edhe Ligji nr. 6340, datë 26.6.1981, "Për Kodin Civil", njësoj si legjislacioni i mëparshëm, në nenet 59–66 të tij, njihte përsëri vetëm institutin e parashkrimit dhe nuk ka asnjë parashikim tjetër për prekluzivitetin e të drejtave.

114. Në vijim të kësaj analize, Kolegji evidenton faktin se prekluziviteti, si institut i së drejtës civile, në legjislacionin shqiptar është parashikuar për herë të parë nga Kodi Civil i vitit 1994, nenet 137 – 140, duke munguar në legjislacionet e mëparshme.

115. Kolegji, ka analizuar më lart dhe risjell në vëmendje se neni 600 i Kodit Civil i sotëm është pothuaj i njëjtë edhe në terminologji me nenin 133 të ligjit nr. 2359, datë 15.11.1956 "Mbi veprimet juridike dhe detyrimet", ku parashikohej se: "*Dorëzania shuhet në qoftë se kreditori nuk ka ngritur padi kundër dorëzanësit brenda gjashtë muajve nga dita e mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit. Kur afati i ekzekutimit të detyrimit nuk është caktuar as në kontratën e dorëzanisë as në një marrëveshje tjetër dorëzania shuhet me kalimin e një viti nga dita e lidhjes së kontratës së dorëzanisë.*"

116. Ligji "Për pjesën e përgjithshme të Kodit Civil", por edhe vetë LVJD, nuk kishin asnjë parashikim, që trajtonte institutin e prekluzivitetit. I vetmi institut që njihej në atë kohë ishte ai i parashkrimit.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, referoi se është në diskrecionin e ligjvënësit që të zgjedhë nëse norma që kanë qenë parashikuar në legjislacionin e mëparshëm, do të rikthehen në fuqi apo jo. Po sipas arsyetimit të mësipërm, nëse ligjvënësi vendos t'i riktheje këto norma në fuqi, duke i parashikuar në mënyrë identike

në ligjin e ri që miraton, konsiderohet se norma e re ruan të njëjtin kuptim, sic i ishte dhënë nga jurisprudenca dhe doktrina juridike e kohës.

Kolegji vlerëson se do të përbënte *non sens* juridik që e njëjta normë me përmbajtje identike të kishte kuptime të ndryshme në kohë të ndryshme. Për këtë arsye, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke respektuar zgjedhjen e ligjvënësit, si edhe duke e lidhur me parimet kushtetuese të sigurisë juridike dhe të barazisë para ligjit, çmon se neni 600 duhet të këtë të njëjtin kuptim që ka pasur neni 133 i LVJD.

117. Përveç mungesës së parashikimeve ligjore, mbi prekluzivitetin e të drejtave, Kolegji Civil i referohet edhe praktikës gjyqësore të kohës, ku fillimisht Gjykata e Lartë, në Udhëzimin e Pleniumit nr. 3, datë 20.4.1955, "Mbi parashkrimin në lëndë civile", në pikën 3 të tij, arsyetoi se: *"…Pjesa e përgjithshme e Kodit Civil përveç parashkrimit shues trajton dhe parashkrimet e shkurtër të parashikuara nga neni 83 i kësaj ligje. Këto lloj parashkrime nuk i nënshtrohen zgjatjes së afatit të parashkrimit. Mbi këtë flet paragrafi i dytë i nenit 85 të pjesës së përgjithshme të Kodit Civil. Po kështu këto lloj parashkrimesh nuk i nënshtrohen pezullimit ose ndërprerjes së parashkrimit. Mirëpo ka raste që në ligje të veçanta ekzistojnë parashkrime të shkurtra. Kur në këto ligjë nuk bëhet fjalë nëse duhet të zbatohet ose jo zgjatja, pezullimi ose ndërprerja e parashkrimit, gjykatat duhet të udhëhiqen nga analiza e brendisë së marrëdhënieve juridike, domethënë në qoftë se marrëdhëniet juridike janë të karakterit të parashikuar nga neni 83 i pjesës së përgjithshme të Kodit civil duhet të mos aplikohet zgjatja, pezullimi ose ndërprerja e parashkrimit, në rast të kundërt duhen aplikuar rregullat e përgjithshme të parashkrimit…".*

118. Në këtë rast Gjykata e Lartë, megjithëse përmend vetëm termin *"parashkrim", për afatet e shkurtra,* duke referuar se këto lloj parashkrimesh nuk i nënshtrohen pezullimit ose ndërprerjes, aludon për një formë të afateve prekluzive.

119. Jurisprudenca ndryshoi më vonë me Udhëzimin e Pleniumit nr. 4., datë 15.6.1961, pika 6, ku u vendos se: *"…Paragrafi i tretë i udhëzimit të Pleniumit të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 20-04-1955 mbi parashkrimet e shkurtra, rreshti i pestë ku thuhet "Parashkrimet e parashikuara nga neni 83 i Pjesës së Përgjithshme të Kodit Civil nuk u nënshtrohen pezullimit ose ndërprerjes së parashkrimit" mbetet pa fuqi…".*

120. Jurisprudenca e asaj kohe u konsolidua në drejtim të arsyetimit që të gjitha afatet civile, janë afate parashkrimi, duke përfshirë edhe afatin e parashikuara nga neni 133 i LVJD.

Për rrjedhojë terminologjia e nenit 133 të LVJD, si për termin *"shuhet",* ashtu edhe për afatin 6- mujor ka pasur në konsideratë afate parashkrimi dhe jo prekluziviteti.

Në vijim të analizës së tij, Kolegji Civil, analizon se përdorimi i termit *"shuhet",* nga ligjvënësi në përmbajtjen e Kodit Civil, si rregull, prezumohet se përdoret në një kuptim të caktuar dhe të njëjtë, me përjashtim të rasteve kur nga konteksti del se është përdorur në një tjetër kuptim.

Në Kodin Civil, termi *"shuhet",* përdoret në disa dispozita, nenet 112, 526, 527, 583, 597, 600, 634, 763, 955, 1033 etj.

Nga përmbajtja dhe konteksti i këtyre dispozitave, rezulton se parashikimet e disa neneve, konkretisht 526 e 527, (pamundësia e ekzekutimit), 583, (shuarja e hipotekës) 597, 763, (shuarja e dhurimit), dhe 1033 nuk kanë të bëjnë me afate dhe për rrjedhojë nuk kanë vlerë të merren në konsideratë për analizë nga ky kolegj.

Nga dispozita të tjera, konkretisht nga neni 112 i Kodit Civil, rezulton se duke na dhënë pikërisht kuptimin e parashkrimit të padisë, ligji përdor termin "shuhet", konkretisht: *"e drejta e padisë që nuk është ushtruar brenda afatit të caktuar në ligj, shuhet dhe nuk mund të realizohet më me anë të gjykatës ose të organit tjetër kompetent".*

Si konstatohet, vetë neni 112 përdor termin *"shuhet",* i njëjti term i cili përdoret nga ligjvënësi edhe në nenin 600 të Kodit Civil. Për rrjedhoje, duke qenë se në këto dy dispozita kemi të bëjmë me afate, logjika interpretuese kërkon që ky term të ketë kuptim të njëjtë, në të dyja këto norma. Pra, e thënë ndryshe, ligjvënësi, duke përdor termin *"shuhet"* në nenin 600 të Kodit Civil, ka pasur në konsideratë afatin e parashkrimit për të cilin përdoret i njëjti term.

Konkluzioni si më sipër përforcohet edhe nga fakti se në nenet 137-140 të Kodit Civil, që trajtojnë prekluzivitetin, nuk përdoret për asnjë moment termin *"shuhet".*

121. Për të kuptuar normën juridike, Kolegji Civil i referohet edhe doktrinës e studimeve të kohës, të cilat megjithëse pranonin që në legjislacione të huaja ekzistonin si afate parashkrimi ashtu edhe afate prekluzive, në Shqipëri, ky lloj i dytë afatesh nuk njihej,[128] si edhe nuk paraqiste asnjë interes.[129] Madje vetë afati 6-mujor i parashikuar, në rastin e kërkimeve për dorëzaninë njihej si afat parashkrimi.[130]

[128] Andrea Nathanaili, *"E drejta civile e Shqipërisë",* Dispenca II, Tiranë 1974, f. 153.
[129] Nazmi Biçoku, *"E drejta Civile – Pjesa e Përgjithshme 2"*, f .144.
[130] Andon Sallabanda, Valentina Ricka, *"E drejta detyrimeve - Pjesa e përgjithshme, II".*

122. Krahas interpretimit historik, Kolegji Civil, çmon të analizojë përmbajtjen e nenit 600 të Kodit Civil, në mënyrë sistematike edhe në raport me dispozita të tjera të Kodit Civil.

123. Kështu, nga përmbajtja e neneve 115, shkronja "a" dhe "c", nenit 129/d, 130, 312 dhe 313, 866 etj., rezulton se afatet 6-mujore dhe njëvjeçare janë si rregull afate parashkrimi.

Kolegji çmon të theksojë se gjatësia e afateve nuk mund të jetë gjithmonë një kriter kategorik ndarës, por shërben si tregues, në rastet kur ligji ndjek të njëjtën logjikë në përcaktimin e afateve.

124. Nga ana tjetër, Kolegji sjell në vëmendje nenin 133 të Kodit Civil në fuqi i cili parashikon, se: *"Parashkrimi i ndërprerë kundër debitorit kryesor shtrihet edhe ndaj dorëzanësit përkatës".*

Kjo dispozitë që parashikon efektet e ndërprerjes së parashkrimit, sipas rasteve të nenit 131 të Kodit Civil, i shtrin efektet e saj si për debitorin kryesor, ashtu edhe për dorëzanësin. Nëse Kolegji Civil, bazuar vetëm në termin *"shuhet"* do të konsideronte afatin 6-mujor në nenin 600, si një afat prekluziv, atëherë kjo do të sillte që neni 133 i Kodit Civil, të mbetej pa fuqi juridike, pasi sikurse u analizua më sipër, instituti i ndërprerjes gjen zbatim vetëm për afatet e parashkrimit.

Për rrjedhojë, Kolegji Civil, duhet që të bëjë një interpretim të harmonizuar të këtyre normave dhe e vetmja mënyrë që këto dy dispozita të Kodit Civil të interpretohen në mënyrë pajtuese së bashku është që afatet e nenit 600 të konsiderohen si afate parashkrimi.

125. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji arrin në konkluzionin se termi *"shuhet"* në nenin 600 të Kodit Civil është përdorur për t'ju referuar parashkrimit dhe jo prekluzivitetit apo dekadencës. E njëjta logjikë vlen edhe për afatin 1 vjeçar të parashikuar në fjalinë e dytë të kësaj dispozite. Ndryshimi midis tyre qëndron vetëm nga natyra e detyrimit, nëse jemi para detyrimeve me afat ekzekutimi ose jo.

126. Për sa më lart, Kolegji konkludon se, afati 6-mujor (gjashtëmujor) i përcaktuar në nenin 600 të Kodit Civil është një afat që lidhet me shuarjen e të drejtës për të përdorur mjetin procedural, padinë, për realizimin e të drejtës, dhe jo me humbjen e vetë të drejtës subjektive. Si i tillë ky është afat parashkrimi dhe joprekluziv.

4. Referuar neneve 589, 590 dhe 591 të Kodit Civil, a barazohet cilësia e dorëzanësit me atë të debitorit? Nëse po, gjatë cilës fazë mund të barazohen këto dy cilësi?

127. Nga analiza e ligjeve shqiptare dhe europiane, të hulumtuara për qëllimet e këtij vendimi, Kolegji vlerëson se ka dy lloje të dorëzanisë, duke marrë si kriter kategorizimi, aktivizimin e përgjegjësisë së dorëzanësit kundrejt kreditorit. Në fakt të gjitha modelet ligjore të studiuara i njohin të dy kategoritë dhe llojet e ndryshme të dorëzanisë, por mënyra se si janë normat e formuluara ndryshojnë.[131]

128. Kështu ka ligje që si rregull, në rast se palët nuk kanë parashikuar ndryshe në kontratën e dorëzanisë, vendosin prezumimin se kemi të bëjmë me *dorëzani subsidiare.*

Dorëzania subsidiare është atëherë kur, për të aktivizuar përgjegjësinë civile pasurore të dorëzanësit, kreditorit i duhet të gjurmojë dhe të ketë shteruar të gjitha mënyrat dhe mjetet e ligjshme të rikuperimit të kredisë kundrejt debitorit kryesor. Vetëm pasi del se përmbushja e kredisë nga pasuria e debitorit kryesor është e pamundur, atëherë kreditori legjitimohet t'i drejtohet dorëzanësit dhe ky është momenti kur lind përgjegjësia civile pasurore e dorëzanësit kundrejt kreditorit për përmbushjen e detyrimit të debitorit kryesor.

129. Ndërkohë, këto ligje lejojnë që palët në kontratën e dorëzanisë të regjojnë ndryshe mënyrën se si aktivizohet përgjegjësia pasurore civile e dorëzanësit kundrejt kreditorit. Kështu palët mundet të parashikojnë në kontratën e dorëzanisë se nëse maturohet detyrimi kryesor atëherë dorëzanësi përgjigjet solidarisht me debitorin kryesor dhe nga ky moment edhe kreditorit i lind e drejta që të zgjedhë se kujt do t'ia kundrejtojë detyrimin për përmbushjen e kredisë. Kjo është *dorëzania solidare.*

130. Nga ana tjetër, ka edhe ligje civile në Europë që kontratën e dorëzanisë, në mungesë të një parashikimi ndryshe në kontratën e dorëzanisë, e prezumojnë si dorëzani solidare, por palëve në kontratën e dorëzanisë u njihet e drejta që të ndryshojnë regjimin juridik të dorzanisë ligjore, duke zgjedhur regjimin juridik të dorëzanisë subsidiare. Sigurisht që dorëzania solidare e vendos kreditorin në pozita shumë më të favorshme se sa ajo subsidiare për të përmbushur kredinë e tij, pasi i jep fakultetin e zgjedhjes së pasurisë në të cilën kredia do të përmbushet, në të njëjtën kohë qoftë mbi dorëzanësin edhe qoftë mbi debitorin kryesor apo të dy së bashku.

131. Sa më lart, Kolegji vlerëson se përgjigja e kësaj pyetje të shtruar për njësimin e praktikës gjyqësore, duke nënkuptuar këtu pjesën e parë të pyetjes, zgjidhet duke kuptuar se kë model ligjor dorëzanie ka zgjedhur legjislatori

[131] Shiko Studies, "*The suretyship in the law of the Member States of the European Communities*", Commission of the European Communities, Competition: Approximation of legislation series no. 14, 1971, Study preparëd by the "Max-Pianck-Institut for auslandisches und internationales Privatrecht", Hamburg, faqe 33.

shqiptar. Pjesa tjetër e pyetjes do të zgjidhet duke pasur parasysh konkluzionin mbi pjesën e parë të çështjes së zgjidhur tashmë.

132. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson të marrë në analizë në planin historik dhe krahasimor, se si është rregulluar kjo çështje, në legjislacionin shqiptar dhe atë europian.

133. Neni 1843 i Kodit Civil i vitit 1929 parashikonte se:

"*Dorëzanësi detyrohet me pague kreditorin vetëm kur nuk paguën debitori kryesuer, i cili duhet së pari t'eskutohet në pasuniën e tij, përveç kur dorzansi ka renoncue beneficin e eskutimit ose asht obligue solidarisht me debitorin; në këtë rast efekti i obligimit të tij rregullohet sipas parimeve të caktueme për obligimet solidare.*".

Kjo do të thotë se ky ligj civil shqiptar parashikonte modelin e dorëzanisë subsidiare.

134. Neni 125 i LVJD parashikonte se:

"*Dorëzanësi është i detyruar solidarisht me debitorin kryesor, përveç kur në kontratën e dorëzanisë është parashikuar ndryshe. Kur disa persona janë bërë dorëzanës për të siguruar të njëjtin detyrim, secili prej tyre përgjigjet për të gjithë detyrimin, përveç kur ka marrëveshje për ndarjen e tij.*".

135. Ndryshe nga Kodi Civil i vitit 1929, ligji civil i parë, pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së vitit 1946, parashikoi se si rregull kontrata e dorëzanisë do të krijojë marrëdhënien e dorëzanisë solidare.

136. Paragrafi i tretë i nenit 179 të Kodit Civil të vitit 1981 parashikonte se:

"*Dorëzënësi është i detyruar solidarisht me debitorin kryesor, përveç rasteve kur në kontratën e dorëzënisë është parashikuar ndryshe.*".

137. I njëjti regjim juridik i dorëzanisë solidare u parashikua edhe në Kodin Civil të vitit 1981.

138. Neni 1016 i ligjit për detyrimet të Republikës së Kosovës[132] paraqet një rast interesant, duke qenë se pas zgjedhjes së regjimit juridik të dorëzanisë subsidiare si model të dorëzanisë ligjore, e shquan dhe identifikon në kllapa në fundin e paragrafit të parë faktin se modeli ligjor i dorëzanisë sipas ligjit civil kosovar është dorëzania subsidiare.

139. Neni 1944 i Kodit Civil të Republikës së Italisë parashikon se dorëzanësi është përgjegjës solidar me debitorin kryesor në momentin e maturimit të detyrimit principal.[133] Megjithatë ligji civil Italian lejon që palët me kontratë të ndryshojnë modelin e aktivizimit të përgjegjësisë së dorëzanësit, duke përzgjedhur dorëzaninë subsidiare. Gjithashtu mundet që edhe ligji të parashikojë ndryshe, duke pasur parasysh natyrën e normës ligjore rast pas rasti.[134]

140. Neni 771 i Kodit Civil të Republikës Federale Gjermane, nën titullin "*Mbrojtja nga mosshterimi i mjetevë*", që nënkupton prapësimin material të dorëzanësit kundrejt debitorit, parashikon se dorëzanësi mundet të refuzojë përmbushjen e detyrimit, përsa kohë kreditori nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike për përmbushjen e detyrimit nga debitori kryesor. Në këto raste, vijon kjo dispozitë, afatet ligjore të mjeteve të kreditorit kundrejt dorëzanësit përmbushjen e detyrimit pezullohen.[135] Kjo do të thotë se modeli gjerman i dorëzanisë ligjore është dorëzania subsidiare.

---

[132] Kjo dispozitë parashikon, se:

"*1. Prej dorëzanit mund të kërkohet përmbushja e detyrimit vetëm pasi debitori kryesor të mos e përmbush brenda afatit të caktuar në thirrjen e drejtuar me shkrim (dorëzania subsidiare). 2. Mirëpo, kreditori mund të kërkojë përmbushjen nga dorëzani megjithëse nuk e ka thirrur më përpara debitorin kryesor në përmbushjen e detyrimit, në qoftë se s'ka dyshim se prej mjeteve të debitorit kryesor nuk mund të realizohet përmbushja e detyrimit apo në qoftë se debitori kryesor ka rënë në falimentim. 3. Në qoftë se dorëzanisë është obliguar si dorëzanë pagues, i përgjigjet kreditorit si debitori kryesor për krejt detyrimin dhe kreditori mund të kërkojë përmbushjen e tij si nga debitori kryesor ashtu edhe nga dorëzanësi apo nga të dy njëkohësisht (dorëzania solidare). 4. Dorëzani për detyrimin e lindur nga kontrata në ekonomi përgjigjet si dorëzanë pagues, në qoftë se nuk është kontraktuar diçka tjetër.*".

[133] Kjo dispozitë në tekstin origjinal formulohet:

"*Il fideiussore [c.c. 1948] è obbligato in solido col debitore principale al pagamento del debito [c.c. 1292, 1410, 1952, 1953]. Le parti però possono convenire che il fideiussore non sia tenuto a pagare prima dell'escussione del debitore principale. In tal caso, il fideiussore, che sia convenuto dal creditore e intenda valersi del beneficio dell'escussione, deve indicare i beni del debitore principale da sottoporre ad esecuzione [c.c. 2868] (1). Salvo patto contrario, il fideiussore è tenuto ad anticipare le spese necessarie.*".

[134] Shiko Giuseppe Chine, Marco Fratini, Andrea Zoppini, "*Manuale di diritto civile*", diretti da Guido Alpa e Roberto Garofoli, Manuali Superiori, IV Edizione, Nel Diritto Editore, Roma, 2013, faqe 962.

[135] Në anglisht kjo dispozitë, nga Ministria e Drejtësisë e Republikës Federale të Gjermanisë, është përkthyer:

"*The surety may refuse to satisfy the creditor as long as the creditor has not attempted without success to obtain execution of judgment against the principal debtor (defence of unexhausted remedies). If the surety raises the defence of unexhausted remedies, the limitation of the claim of the creditor against the surety is suspended until the creditor has attempted without success to obtain execution of judgment against the principal debtor.*".

141. Neni 2298 i Kodit Civil të Republikës së Francës ka zgjedhur që në krye të herës llojin e dorëzanisë subsidiare, duke parashikuar se dorëzanësi është përgjegjës kundrejt kreditorit vetëm kur debitori dështon së përmbushuri detyrimin. Më tej kjo normë vijon se, detyrimi i dorëzanësit lind në momentin kur kreditori shteron të gjitha mënyrat e përmbushjes së detyrimit me pasurinë e debitorit. Më tej neni 2299 i këtij Kodi e parashikon si prapsim material në kuptimin e ngushtë (që do të thotë në disponibilitetin e palës) të dorëzanësit, detyrimin e kreditorit për të shteruar të gjitha mjetet dhe mënyrat e përmbushjes së detyrimit me pasurinë e debitorit kryesor.

Kjo do të thotë se nëse dorëzanësi nuk e pretendon këtë të drejtë atëherë ekzekutimi i dorëzanisë do të mundet të bëhet sikur dorëzania të ishte solidare, apo sipas modelit të aktivizimit të përgjegjësisë pasurore civile të dorëzanësit në ligjin civil shqiptar dhe italian.

142. Dorëzania subsidiare e prezumuar nga ligji, njëlloj sikurse ligji civil i Gjermanisë apo edhe i Kosovës, parashikohet edhe në ligjet civile të Francës, Luksemburgut, Belgjikës dhe Holandës.[136]

143. Dispozita në fuqi e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë që rregullon aktivizimin dhe llojin e përgjegjësisë së dorëzanësit kundrejt kreditorit është neni 590 i Kodit Civil. Kjo dispozitë parashikon se:

"*Dorëzanësi është i detyruar solidarisht mbi debitorin kryesor për ekzekutimin e detyrimit, përveç kur është parashikuar ndryshe me marrëveshje. Palët mund të merren vesh që dorëzanësi të mos jetë i detyruar të paguajë para kryerjes së të gjitha veprimeve të nevojshme, që detyrojnë debitorin të paguajë detyrimin. Në rast se dorëzanësi paditet dhe kërkon të përdorë një të drejtë të tillë, ai duhet të tregojë pasurinë e debitorit kryesor që do t'i nënshtrohet ekzekutimit. Dorëzanësi është i detyruar të parapaguajë shpenzimet e nevojshme, në qoftë se palët nuk janë marrë vesh ndryshe.*".

144. Pas kësaj analize historike dhe krahasimore e llojit të përgjegjësisë së dorëzanësit kundrejt kreditorit, është e thjeshtë për të konkluduar se Kodi Civil në fuqi, sikurse ligji civil shqiptar i vitit 1956 e 1981 dhe ligji civil italian, prezumojnë se dorëzania, në mungesë të një marrëveshje që do ta regjojë atë sipas modelit subsidiar, është solidare.

145. Në veçanti, Kolegji çmon të verë theksin tek fjalia e dytë e nenit 590 të Kodit Civil, sipas të cilit: *"…palët mund të merren vesh që dorëzanësi të mos paguajë, para kryerjes së veprimeve që detyrojnë debitorin të paguajë…"*

Kjo do të thotë se si rregull, përveç rastit kur palët parashikojnë ndryshe, nga momenti i rënies në morë të debitorit kryesor, ky i fundit dhe dorëzanësi i kreditorit përgjigjen solidarisht para tij për përmbushjen e detyrimit. Kreditori mundet të zgjedhë ndjekjen e secilës prej rrugëve apo mjeteve ligjore për ekzekutimin e detyrimit ndaj debitorit dhe dorëzanësit, i cili nga ai moment përgjigjet sikur të jetë bashkëdebitor solidar. I vetmi kufi për përgjegjësinë solidare të dorëzanësit është paragrafi i dytë i nenit 589 të Kodit Civil, i cili parashikon se dorëzania që kalon detyrimin ose që jepet në kushte më të rënda se detyrimi kryesor, është e vlefshme vetëm deri në kufijtë e këtij të fundit.

Në kuptim të neneve 589, 590 dhe 591, debitori kryesor dhe dorëzanësi janë në pozita të barasvlershme për sa i përket detyrimit kryesor edhe në drejtim të pagimit të kamatës, shpërblimit të dëmit nga vonesa, apo edhe të shpenzimeve të tjera. Njëherazi debitori dhe dorëzanësi kanë një marrëdhënie solidariteti për ekzekutimin e detyrimit, duke i lejuar kreditorit të paraqesë padi kundër të dyve njëkohësisht.

146. Aktivizimi i përgjegjësisë solidare të dorëzanësit, krahas asaj të debitorit kryesor, do të lindë në momentin kur detyrimi është maturuar, apo kur afati për të përmbushur detyrimin ka mbaruar dhe debitori kryesor ka rënë në morë. Kjo nuk duhet të çojë në konkluzionin se kontrata e dorëzanisë i jep efektet apo hyn në fuqi në momentin kur debitori kryesor bie në morë apo detyrimi bëhet i kërkueshëm.

Në të vërtetë kontrata e dorëzanisë është kontratë konsensuale, që do të thotë se ajo hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit dhe perfeksionimit të saj sipas ligjit, por përgjegjësia solidare e dorëzanësit kundrejt kreditorit dhe krahas debitorit kryesor do të varet nga vërtetimi i kushtit pezullues, që do të thotë maturimi i detyrimit apo rënia në morë e debitorit kryesor. Pikërisht ky është edhe momenti që nis të ecin afatet e parashkrimit të parashikuara në dy paragrafët e nenit 600 të Kodit Civil.

147. Kolegji vlerëson se cilësia e dorëzanësit barazohet me cilësinë e debitorit kryesor për shkak të modelit të dorëzanisë solidare që ligji civil shqiptar ka parashikuar. Por barazimi i cilësisë së dorëzanësit dhe debitorit kryesor nuk ndodh *apriori* dhe ndodh ndryshe sipas llojit të dorëzanisë së zgjedhur nga palët në kontratën e dorëzanisë.

Në dorëzaninë solidare, kur palët nuk kanë parashikuar ndryshe në kontratë, cilësia e dorëzanësit do të barazohet me cilësinë e debitorit kryesor për llogari të përmbushjes së detyrimit kundrejt kreditorit, në momentin kur detyrimi maturohet dhe debitori kryesor bie në morë.

---

[136] Shiko Studies, "*The suretyship in the law of the Member States of the European Communities*", Commission of the European Communities, Competition: Approximation of legislation series no. 14, 1971, Study prepared by the "Max-Pianck-Institut for auslandisches und internationales Privatrecht", Hamburg, faqe 33.

Nga ana tjetër, nëse dorëzania është përcaktuar në kontratë nga palët si dorëzani subsidiare, atëherë cilësia e dorëzanësit do të barazohet me cilësinë debitorit kryesor për llogari të përmbushjes së detyrimit kundrejt kreditorit, vetëm në momentin kur kreditori ka shteruar të gjitha mjetet e gjurmimit të pasurisë së debitorit kryesor dhe ka qenë e pamundur për të ekzekutimi i kredisë.

148. Në nenin 595 të Kodit Civil është parashikuar se: "*Kur dorëzanësi ka ekzekutuar detyrimin e debitorit pa u paditur në gjyq dhe pa lajmëruar debitorin kryesor, ky mund t'i kundrejtojë dorëzanësit të gjitha prapësimet që do të mund t'i kundrejtonte kreditorit në kohën e ekzekutimit të detyrimit*.".

Ratio legis e kësaj dispozite është se dorëzanësi e përmbush detyrimin, në rastet kur kreditori i drejtohet atij duke e vënë në dijeni se nuk është përmbushur detyrimi nga debitori sipas kontratës. Në këtë rast kreditori nuk paraqet padi kundër tij, por e njofton në një mënyrë tjetër, me një veprim apo mjet tjetër juridik. Ndërkohë, dorëzanësi që përmbush detyrimin në vend të debitorit kryesor ka të drejtë që t'i kundrejtojë kreditorit të gjitha prapsmet që mund t'i kundrejtonte vetë debitori, si dhe të kërkojë kompensimet që kreditori i detyrohet debitorit edhe sikur debitori të ketë hequr dorë nga e drejta ose të ketë pranuar detyrimin.

149. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji vlerëson se kontrata e dorëzanisë fillon të sjellë efektet e parashikuara në ligj që në momentin e lidhjes së saj dhe cilësia e debitorit dhe e dorëzanësit barazohet në momentin që detyrimi bëhet i kërkueshëm. Në këtë moment, si rregull, kreditori mund t'i drejtohet si debitorit, ashtu edhe dorëzanësit, përveç kur palët kanë disponuar ndryshe në kontratën e dorëzanisë.

150. Nga sa më sipër, Kolegji konkludon se kontrata e dorëzanisë fillon të japë efektet e parashikuara në ligj që në momentin e lidhjes së saj dhe cilësia e debitorit dhe dorëzanësit barazohet në momentin që detyrimi bëhet i kërkueshëm. Në këtë moment, si rregull, kreditori mund t'i drejtohet si debitorit ashtu edhe dorëzanësit.

Referuar neneve 589, 590 dhe 591 të Kodit Civil, cilësia e dorëzanësit me atë të debitorit barazohen vetëm për pjesën e detyrimit, radhën e ekzekutimit dhe ndarjen e detyrimit mes disa dorëzanësve, si palët mund të kenë përcaktuar në kontratën e dorëzanisë.

151. Në referim të nenit 485, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, disponimin njësues, për secilën prej çështjeve të shqyrtuara nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është si në vijim.

1. Njësimi për çështjen e parë. ***Për aktet që përmbajnë detyrime në të holla dhe që sipas nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile janë tituj ekzekutivë, kërkesa e kreditorit për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit është e barasvlershme, presa u përket efekteve juridike që sjell, me padinë e ngritur sipas nenit 600 të Kodit Civil. Ndërkohë për efekt të vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit, kërkesa drejtuar përmbaruesit gjyqësor i nënshtrohet rregullave të parashikuara në nenin 113 të Kodit Civil, pra kjo kërkesë i nënshtrohet një tjetër afati të përcaktuar në nenin 600 të Kodit Civil.***

2. Njësimi për çështjen e dytë. ***Referuar përcaktimeve të neneve 597, 598, 599 dhe 600 të Kodit Civil dorëzanësi legjitimohet të kërkojë shuarjen e dorëzanisë me padi të tij, apo ta prapësojë atë në një proces gjyqësor ku është thirrur si i paditur me kërkimin e paditësit për përmbushjen e këtij detyrimi. Për aktet që janë tituj ekzekutivë mjeti procedural me të cilin dorëzanësi mund të kërkojë shuarjen e dorëzanisë është padia për "Pavlefshmërinë e këtij titulli", për sa i takon detyrimit të dorëzanësit, sipas nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile.***

3. Njësimi për çështjen e tretë. ***Afati 6-mujor (gjashtëmujor) i përcaktuar në nenin 600 të Kodit Civil është një afat që lidhet me shuarjen e të drejtës për të përdorur mjetin procedural, padinë, për realizimin e të drejtës, dhe jo me humbjen e vetë të drejtës subjektive. Si i tillë ky është afat parashkrimi dhe joprekluziv.***

4. Njësimi për çështjen e katërt. ***Kontrata e dorëzanisë fillon të japi efektet e parashikuara në ligj që në momentin e lidhjes së saj dhe cilësia e debitorit dhe dorëzanësit barazohet në momentin që detyrimi bëhet i kërkueshëm. Në këtë moment, si rregull, kreditori mund t'i drejtohet si debitorit ashtu edhe dorëzanësit. Referuar neneve 589, 590 dhe 591 të Kodit Civil, cilësia e dorëzanësit me atë të debitorit barazohen vetëm për pjesën e detyrimit, radhën e ekzekutimit dhe ndarjen e detyrimit mes disa dorëzanësve, si palët mund të kenë përcaktuar në kontratën e dorëzanisë.***

***V.* Zgjidhja e çështjes objekt shqyrtimi.**

152. Si u referua në pjesën hyrëse të këtij vendimi, nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se midis palës së paditur shoqëria "Banka Credins" sh.a., në cilësinë e kredidhënësit dhe të personit të tretë shoqëria "Italdruri" sh.p.k. në cilësinë e kredimarrësit është lidhur kontrata "*Marrëveshje linjë kredie nr. 256, datë 3.7.2009*", e noterizuar me nr. 2059 rep., nr. 618/1 kol., datë 17.7.2009. Me këtë kontratë personi i tretë ka

marrë kredi shumën prej 25.000.000 lekë me qëllimin e financimit të aktivitetit. Kontrata është lidhur për një afat 6-mujor, i cili nis të llogaritet nga dita e autorizimit në llogari (neni 3.2 i kontratës).

153. Në kontratën e sipërcituar rezulton se pala paditëse, Nuri Hasa është përfshirë në marrëdhënien midis palëve, në cilësinë e dorëzanësit për të garantuar përmbushjen e detyrimit nga kredimarrësi. Në nenin 8 të kontratës, të titulluar "sigurimi i kredisë" përcaktohet pozita e dorëzanësit në këtë kontratë, e më konkretisht "... 8.*4. Dorëzanësit, garantojnë pa rezerva Bankën Kredidhënëse se do t'i përgjigjet me të gjithë pasurinë e tyre, për përmbushjen e detyrimeve totale që rrjedhin nga kjo kontratë kredie, në rast se Kredimarrësi nuk përmbush detyrimin e tij, duke përfshirë edhe pagimin e kamatës, shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit dhe shpenzimet e tjera gjyqësore, përmbarimore etj. ...*".

Po sipas kontratës, *dorëzanësi detyrohet solidarisht me debitorin pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme (neni 8.5); dorëzanësi i njeh bankës të drejtën për të përfituar pasurinë e tij të luajtshme dhe të paluajtshme (neni 8.6);* mosmarrëveshjet mes palëve do të zgjidhen referuar neneve 585 deri 600 të Kodit Civil (neni 8.7).

154. Në kohën e regjistrimit të kërkesëpadisë në gjykatë, pala paditëse Nuri Hasa, ka qenë në cilësinë e njërit prej ortakëve të kerdimarrësit, shoqërisë "Italdruri" sh.p.k., ndërsa aktualisht, referuar ekstraktit të QKB-së së kësaj shoqërie ai nuk rezulton të ketë më këtë cilësi.

155. Midis palës së paditur Shoqëria "Banka Credins" sh.a., në cilësinë e barrëmarrësit dhe personit të tretë shoqëria "Italdruri" sh.p.k. në cilësinë e barrëdhënësit është lidhur "*Marrëveshje siguruese nr. 256/1, datë 3.7.2009*", e noterizuar me nr. 2060 rep., nr. 619/1 kol., datë 17.7.2009, e cila ka për objekt krijimin e një barre siguruese mbi pasurinë e luajtshme të barrëdhënësit, si garanci për kontratën e linjës së kredisë nr. 256, datë 3.7.2009.

156. Procedura e ekzekutimit të detyrimit nga person i tretë, përmbarues gjyqësor Kastriot Kurmaku ka nisur me shkresën nr. 90 akti, datë 8.4.2011, "*Lajmërim për ekzekutim vullnetar*", për të vijuar më pas me urdhrin nr. 90 akti, datë 21.4.2011 për vendosjen e sekuestros konservative.

157. Ndërkohë rezulton se pala e paditur, "Banka Credins" sh.a., ka nisur procedurat për të kërkuar ekzekutimin e detyrimit duke i dërguar personit të tretë shoqëria "Italdruri" sh.p.k. shkresën nr. 364 prot., datë 28.4.2010, për dijeni edhe palës paditëse, dorëzanësit Nuri Hasa i cili ka nënshkruar marrjen dijeni; shkresën nr. 2537 prot., datë 6.5.2010; shkresën nr. 2880 prot., datë 19.5.2010 e nënshkruar nga pala paditëse; shkresën nr. 3417 prot., datë 2.6.2010.

Sa më lart dhe referuar vërtetimit nr. 11686 prot., datë 24.10.2011 të lëshuar nga pala e paditur "Banka Credins" sh.a. rezulton se që prej datës 17.1.2010, dita e maturimit të kredisë, deri në momentin e dorëzimit të dosjes pranë përmbaruesit gjyqësor, personi i tretë, shoqëria "Italdruri" sh.p.k., ka kryer disa pagesa duke nisur nga data 8.3.2010 në vazhdim deri në datën 27.12.2010.

158. Në analizë të këtyre fakteve Kolegji çmon se marrëdhënia e krijuar mes ndërgjyqësave është një marrëdhënie dorëzanie, në të cilën dorëzanësi dhe debitori përgjigjen solidarisht dhe në të njëjtën kohë ndaj kreditorit. Afati për ekzekutimin e detyrimit ka qenë data 17.1.2010.

Pasi është vënë në dijeni nga banka për qenien në vonesë në shlyerjen e detyrimit, pas datës 2.6.2010, debitori ka shlyer një pjesë të këtij detyrimi, duke kryer gjithsej dhjetë pagesa deri në datën 27.12.2010. Pra, nga dita e maturimit të kredisë deri në momentin e dorëzimit të dosjes pranë përmbaruesit gjyqësor, personi i tretë, shoqëria "Italdruri" sh.p.k., në cilësinë e debitorit, ka kryer disa pagesa duke nisur nga data 8.3.2010 në vazhdim deri në datën 27.12.2010.

159. Për këtë arsye, në këtë periudhë kohore kur debitori ka vijuar të kryejë pagesa, afati i parashkrimit është ndërprerë, në kuptim të nenit 131, shkronja "a" dhe nenit 133 të Kodit Civil. Kolegji vlerëson se debitori dhe dorëzanësi si debitor solidar, me veprimet e mësipërme kanë njohur detyrimin, fakt i cili referuar nenit 131, shkronja "a" të Kodit Civil ka sjellë ndërprerjen e parashkrimit. Në vijim ka nisur një afat i ri parashkrimi konform nenit 134 të Kodit Civil.

Në këto kushte, pala e paditur, Banka Crendins sh.a., në momentin që ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, në muajin mars të vitit 2011 ndodhej brenda afatit të parashkrimit prej gjashtë muajsh sipas përcaktimit të nenit 600 të Kodit Civil.

160. Për sa më sipër, ky Kolegj, vlerëson se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe material, si i tillë duhet të lihet në fuqi. Në zbatim të paragrafit të dytë të nenit 485 të Kodit të Procedurës Civile ky vendim që njëson praktikën gjyqësore botohet në Fletoren Zyrtare.

PËR KËTO ARSYE.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në bazë të neneve 481 e vijuese, 485, pika 1/e të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 2364, datë 10.10.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

- Ky vendim është njësues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Kryesues: Artur Kalaja
Anëtarë: Darjel Sina, Enton Dhimitri, Ervin Pupe, Margarita Buhali

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Qendra e Botimeve Zyrtare
Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës së Lartë :
(të botuara në Fletoret Zyrtare 2021-2023) / Qendra
e Botimeve Zyrtare.
- Tiranë : Qendra e Botimeve Zyrtare, 2024.
... f. ; ... cm
ISBN 9789928011602

1.Gjykata e Lartë 2.Vendime gjyqësore
3.Shqipëri

347.991(496.5) "2021/2023"